

الجزء الرابع والعشرون سورة غافر

وَتَرَى ٱلْمَلَٰٓئِكَةَ حَآفِّينَ مِنْ حَوْلِ ٱلْعَرْشِ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ
رَبِّهِمْ ۚ وَقُضِىَ بَيْنَهُم بِٱلْحَقِّ ۚ وَقِيلَ ٱلْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٧٥﴾

سُورَةُ غَافِرٍ

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

حمٓ ﴿١﴾ تَنزِيلُ ٱلْكِتَٰبِ مِنَ ٱللَّهِ ٱلْعَزِيزِ ٱلْعَلِيمِ ﴿٢﴾ غَافِرِ ٱلذَّنۢبِ
وَقَابِلِ ٱلتَّوْبِ شَدِيدِ ٱلْعِقَابِ ذِى ٱلطَّوْلِ ۖ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ۖ إِلَيْهِ
ٱلْمَصِيرُ ﴿٣﴾ مَا يُجَٰدِلُ فِىٓ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ إِلَّا ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ فَلَا يَغْرُرْكَ
تَقَلُّبُهُمْ فِى ٱلْبِلَٰدِ ﴿٤﴾ كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ قَوْمُ نُوحٍ وَٱلْأَحْزَابُ
مِنۢ بَعْدِهِمْ ۖ وَهَمَّتْ كُلُّ أُمَّةٍۭ بِرَسُولِهِمْ لِيَأْخُذُوهُ
وَجَٰدَلُوا۟ بِٱلْبَٰطِلِ لِيُدْحِضُوا۟ بِهِ ٱلْحَقَّ فَأَخَذْتُهُمْ ۖ فَكَيْفَ
كَانَ عِقَابِ ﴿٥﴾ وَكَذَٰلِكَ حَقَّتْ كَلِمَتُ رَبِّكَ عَلَى ٱلَّذِينَ
كَفَرُوٓا۟ أَنَّهُمْ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ﴿٦﴾ ٱلَّذِينَ يَحْمِلُونَ ٱلْعَرْشَ
وَمَنْ حَوْلَهُۥ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيُؤْمِنُونَ بِهِۦ وَيَسْتَغْفِرُونَ
لِلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ۖ رَبَّنَا وَسِعْتَ كُلَّ شَىْءٍ رَّحْمَةً وَعِلْمًا فَٱغْفِرْ
لِلَّذِينَ تَابُوا۟ وَٱتَّبَعُوا۟ سَبِيلَكَ وَقِهِمْ عَذَابَ ٱلْجَحِيمِ ﴿٧﴾

الجزء ٢٤ الحزب ٤٧

٤٦٧

Surja 40: El Gafir (mekase) 85 ajete

Ajetet 1 – 3

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ha, Mim!
2. Shpallja e Librit është prej Allahut, Krenarit, të Gjithëdijshmit,
3. Falësit të gjynaheve dhe Pranuesit të pendimit, që ndëshkon ashpër, si dhe prej Dhuruesit e Bamirësit të madh. Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij dhe tek Ai do të kthehen të gjithë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ha, Mim! Shpallja e Librit është prej Allahut, Krenarit, të Gjithëdijshmit, Falësit të gjynaheve dhe Pranuesit të pendimit, që ndëshkon ashpër, si dhe prej Dhuruesit e Bamirësit të madh." – Në ajet flitet për Shpalljen e Allahut të Madhërishëm, për Librin e Tij. Kurani është Shpallja e të Madhëruarit, të vetmit që meriton adhurimet, sepse Ai është i vetmi Absolut, i Plotë, i Pakrahasueshëm dhe i Pashembullt në veprat e Tij.

Allahu është *El Azizu* – Krenari, i Cili, me krenarinë e Tij, ka nënshtruar e mposhtur çdo krijesë. Ai është *El Alim* - i Gjithëdituri, *Gafiru Dhenbi* - Falës i gjynaheve për ata që gabojnë e Pranues i pendimit për ata që pendohen. Por Allahu është edhe *Shedidul Ikab* – Ndëshkues i rreptë për këdo që ka paturpësinë të zhytet në gjynahe dhe nuk pendohet prej tyre. Ai është *Dhuttauli* - Dhurues e Bamirës i madh, i Cili ka përfshirë gjithçka me bamirësinë e Tij.

Pas gjithë këtyre pohimeve për Veten e Vet, Allahu i Madhëruar tregon se është i vetmi që meriton adhurimin dhe të Cilit duhet t'i përkushtohen veprat me sinqeritet të plotë:

- "Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij dhe tek Ai do të kthehen të gjithë." - Ekziston një lidhje e ngushtë mes faktit që Kurani është shpallur prej Allahut dhe përmendjes së këtyre emrave dhe cilësive të Tij të mrekullueshme. Këta emra e cilësi janë pikërisht lënda që përmban dhe shtjellon Kurani i shpallur nga i Madhërishmi, sepse Kurani është:

1. ose prezantim i emrave, cilësive dhe veprave të Allahut, sikurse ndodh në fillim të kësaj sureje;
2. ose rrëfim i ngjarjeve të panjohura, që i përkasin së shkuarës e së ardhmes, të cilat vijnë nga i Gjithëdijshmi;
3. ose përshkrim i mirësive e begative të mëdha të premtuara nga i Madhërishmi,

duke treguar urdhrat e porositë nëpërmjet të cilave arrihen këto mirësi, të cilat, në ajetin e mësipërm, i gjen te dhënia e emrit të Tij *Dhuttauli* - Dhurues e Bamirës i madh, sepse nuk ka mirësi më të madhe për robërit, sesa Shpallja nga Mëshirëploti.

4. Në Kuran tregohet, gjithashtu, rreth zemërimit të Zotit dhe ndëshkimit të ashpër prej Tij, si edhe rreth atyre veprave që e shkaktojnë atë. Në ajetin në fjalë, këtë e tregon emërtimi *Shedidul Ikab*.

5. Kurani është ftesë drejtuar gjynahqarëve e gabimtarëve për pendim dhe kërkim faljeje. Në ajet, për këtë tregon emërtimi *Gafiru Dhenbi* - Falës i gjynaheve.

6. Kurani është pohim i faktit se Allahu është i vetmi Zot, që meriton dashurinë dhe madhërimin prej krijesave, duke sjellë për këtë të vërtetë argumente të shumta, duke ndaluar nga adhurimi i çdo gjëjë tjetër veç Allahut e duke dëshmuar se sa padrejtësi e madhe është idhujtaria, për ta urryer atë dhe për të kërcënuar ata që e ushtrojnë. Në ajetin në fjalë, këtë tregon fragmenti: "*Lâ ilâhe il-lâ hû*" – "Nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij".

7. Kurani tregon, gjithashtu, ligjin e shpërblimit me drejtësi të Allahut, nëpërmjet të cilit Ai shpërblen vepërmirët dhe ndëshkon gjynaqarët e pabindur. Në ajetin e mësipërm, këtë tregon fjala e Tij: "...dhe tek Ai do të kthehen të gjithë".

Këto janë synimet e larta dhe çështjet e rëndësishme të Kuranit, që përbëjnë lëndën e tij.

Ajetet 4 – 6

4. Argumentet e Allahut nuk i kundërshton kush, veç atyre që nuk besojnë, prandaj mos u mashtro nga bredhja e tyre nëpër botë.

5. Përpara tyre, mohuan populli i Nuhut dhe ata që erdhën pas. Të gjithë këta u përpoqën ta asgjësonin të Dërguarin e vet dhe polemizonin me të me kotësira, nëpërmjet të cilave synonin të zhduknin të Vërtetën, prandaj Unë i ndëshkova ata. Sikur ta dinit ju si ishte ai ndëshkim!

6. Kështu, Fjala e Zotit tënd kundër atyre që nuk besojnë do të përmbushet: ata do të jenë banorë të Zjarrit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Argumentet e Allahut nuk i kundërshton kush, veç atyre që nuk besojnë..." - Allahu i Madhëruar na tregon se, veç mohuesit polemizojnë kundër ajeteve dhe shpalljeve të Tij.

Këtu flitet për atë lloj polemike që synon hedhjen poshtë të ajeteve dhe vërtetësisë së Shpalljes së Zotit, duke e përballur atë me të kotën. Ky është veprim i qafirëve. Ndërsa besimtarët janë të përulur dhe respektues ndaj Allahut të Madhërishëm dhe Shpalljes së Tij, të cilën Ai e solli për të shkatërruar të kotën.

Njeriu nuk duhet të mashtrohet nga mirësitë e kësaj dynjaje që mund t'i jenë dhuruar dikujt. Ai nuk duhet të mendojë se mirësitë e kësaj dynjaje janë shenjë treguese se Zoti e do atë person që i ka ato, apo se ai është në rrugën e drejtë. Për këtë arsye, i Madhëruari thotë:

- "...prandaj mos u mashtro nga bredhja e tyre nëpër botë." - Mos u mashtro nga bredhja e tyre për tregti me fitime të mëdha.

Për njeriun është detyrë që t'i peshojë dhe gjykojë të tjerët me kriteret e së vërtetës. Ai duhet ta shohë drejt realitetin, duke marrë për bazë të vërtetën e sjellë nga Zoti. Ai nuk duhet t'i vlerësojë njerëzit duke u

mbështetur te orekset e tyre, ashtu siç veprojnë të padituri dhe mendjelehtët.

- "Përpara tyre, mohuan populli i Nuhut dhe ata që erdhën pas." - I Madhëruari i kërcënon ata që polemizojnë e hedhin poshtë Shpalljet dhe faktet e Tij, se do t'i ndëshkojë, ashtu siç bëri me popujt e mëparshëm, si me popullin e Nuhut (a.s.), të Adit dhe të tjerë që erdhën pas tyre, të cilët i dolën para të vërtetës, për ta hedhur poshtë atë. Ata qëndruan në anën e së kotës, për ta mbështetur dhe shfaqur atë para njerëzve, për t'i nxitur ata që ta pranojnë atë.

Përplasjet e dy grupacioneve arritën deri aty, sa armiqtë e së vërtetës tentuan që të vrisnin profetët e Zotit:

- "Të gjithë këta u përpoqën ta asgjësonin të Dërguarin e vet dhe polemizonin me të me kotësira, nëpërmjet të cilave synonin të zhduknin të Vërtetën..." - Kjo tregon për ashpërsinë e përplasjes mes së vërtetës dhe të kotës dhe për egërsinë e mohuesve ndaj së vërtetës. Aq e madhe ishte urrejtja e tyre për të vërtetën, saqë ata përndoqën, luftuan dhe u përpoqën të vrisnin edhe profetët, që janë njerëzit më të mirë, ata që sjellin nga Zoti të vërtetën e qartë. Ata të verbër e të vetëmashtruar zgjodhën të hidhnin poshtë të vërtetën dhe të torturonin e vrisnin profetët.

Atëherë, a nuk meriton kjo humbje e poshtërsi shpagim tjetër veç ndëshkimit më të madh, nga i cili nuk shpëton më kurrë? Duke treguar ndëshkimin e tyre në këtë jetë dhe në tjetrën, i Madhëruari thotë:

- "...prandaj Unë i ndëshkova ata. Sikur ta dinit ju si ishte ai ndëshkim!" - Allahu i ndëshkoi ata për organizimin e tyre kundër së vërtetës dhe për mohimin e padrejtë të saj. Ai thotë: "Sikur ta dinit ju si ishte ai ndëshkim!" Në fakt, Ai ishte ndëshkim tepër i rëndë.

Në dynja, Allahu i Madhëruar i ka ndëshkuar popujt nëpërmjet ndonjë ushtime të fuqishme, ose me ndonjë goditje nga qielli, ose ka urdhëruar Tokën që t'i përpijë ata, ose duke urdhëruar detin që t'i përmbytë etj., duke i shndërruar të gjithë ata në kufoma.

- "Kështu, Fjala e Zotit tënd kundër atyre që nuk besojnë do të përmbushet: ata do të jenë banorë të Zjarrit." - Nëse këta të mjerë nuk kthehen në rrugën e drejtë, ata i pret fati i zi: Zjarri do të bëhet vendqëndrimi i tyre.

Ajetet 7 – 9


7. Ata që mbajnë Fronin dhe ata që janë përreth tij e lartësojnë me lavde Zotin e tyre dhe i besojnë Atij. Ata kërkojnë falje për besimtarët: "Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe me diturinë Tënde ke përfshirë çdo gjë, prandaj fali ata që pendohen dhe ndjekin rrugën Tënde, dhe ruaji ata nga dënimi i Zjarrit flakërues!
8. Zoti ynë, futi ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me të mirët prej etërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre. Vërtet, Ti je Ngadhënjyesi e i Urti!
9. Ruaji ata prej të këqijave, sepse atë që Ti e mbron atë ditë prej të këqijave, vërtet e ke mëshiruar! Ky është vërtet shpëtimi i madh".

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon për butësinë dhe mirësinë e madhe të Tij ndaj adhuruesve besimtarë. Ai përkujdeset që t'u

lehtësojë atyre çdo rrugë që i çon ata drejt lumturisë, rrugë që, në fakt, janë tërësisht jashtë mundësive e aftësive të tyre për t'i arritur vetë. Prej kujdesit të Tij janë edhe lutjet e melekëve për robërit në tokë. Ata luten që Allahu të rregullojë fenë dhe ahiretin e tyre.

Këtu shfaqet, ndër të tjera, edhe grada e lartë e mbajtësve të Fronit madhështor dhe e melekëve që qëndrojnë rreth e rrotull tij, si dhe për afërsinë e tyre me Zotin. Ata shquhen për adhurimet e shumta që i përkushtojnë të Madhëruarit, si dhe për kujdesin dhe dëshirën e mirë që kanë kundrejt adhuruesve të Zotit. Ata i duan dhe luten për besimtarët, sepse e dinë shumë mirë se Zoti kënaqet dhe e dëshiron një gjë të tillë prej tyre. I Madhëruari thotë:



- "Ata që mbajnë Fronin..." – Domethënë, ata që mbajnë Fronin e Rrahmanit, i cili është çatia e të gjithë krijesave, krijimi më i madh, më i gjerë, më i bukur dhe më afër Allahut të Lartësuar. Froni i Allahut përfshin qiejt, Tokën dhe Kursijin.

Këta melekë të fuqishëm janë ngarkuar për të mbajtur Fronin e Allahu të Madhëruar. Nuk ka dyshim se ata janë ndër melekët më të mëdhenj dhe më të fuqishëm që Zoti ka krijuar, prandaj dhe Ai i ka përzgjedhur për të mbajtur Fronin e Tij. Fakti që Allahu i Madhëruar i përmend ata përpara melekëve që janë rreth Fronit, si edhe afërsia e tyre me Allahun, tregojnë se ata janë lloji më i zgjedhur i melekëve (paqja e Zotit qoftë mbi ta!).

Ditën e Gjykimit, Fronin e Allahut do ta bartin tetë melekë, siç thotë i Madhëruari: "Qielli do të çahet, sepse atë ditë është i dërrmuar. Melekët do qëndrojnë në anët e tij. Atë ditë, Fronin e Zotit tënd do ta bartin mbi vete tetë të tillë." [Hakka 16, 17].

- "...ata që janë përreth tij e lartësojnë me lavde Zotin e tyre dhe i besojnë Atij." - Rreth e rrotull Fronit janë rreshtuar melekë të afërt, të zgjedhur dhe me prestigj të lartë te Zoti. Allahu i Madhëruar i lëvdon këta melekë duke përmendur adhurimin e tyre të shumtë përkushtuar Atij, e në mënyrë të veçantë *tesbih*-ët e *tahmid*-ët e tyre. Të gjitha adhurimet bëhen për t'i thurur Zotit *tesbih* dhe *tahmid*, pra, për ta lavdëruar dhe madhëruar Zotin, për ta lartësuar Atë nga çdo e metë. *Tesbih*-u dhe *tahmid*-i tregojnë se robi nuk ia përkushton adhurimet askujt tjetër veç Zotit, sepse Ai është i pastër nga çdo e metë dhe i pashoq në meritën e adhurimit. *Tesbih*-u dhe *tahmid*-i për Zotin janë vetë adhurimi, ndërsa shprehjet

"*Subhanallah*" dhe "*Elhamdulilah*", që thotë robi, janë lloje të adhurimit.

- "Ata kërkojnë falje për besimtarët..." - Kjo është nga mirësitë e shumta dhe të mëdha që sjell imani i drejtë në Allahun. Pra, edhe melekët, që janë të pastër dhe të ruajtur nga gjynahet, kërkojnë falje për besimtarët.

Duke qenë se falja e Zotit është e lidhur ngushtë me çështje të tjera shumë të rëndësishme dhe dikush mund të mendojë se melekët luten thjesht që t'u falen gjynahet besimtarëve, Allahu i Madhëruar e sqaron më tej duanë e tyre, duke na treguar se ata luten jo vetëm për faljen e gjynaheve, por edhe për çështje të tjera, që kanë lidhje të ngushtë me faljen e gjynaheve. Ata luten edhe për shpëtim prej përfundimit të keq që sjellin gjynahet dhe prej gjurmëve të këqija që ato lënë në jetën e njeriut. Ndër të tjera, ata thonë:

- "Zoti ynë, Ti me mëshirën dhe me diturinë Tënde ke përfshirë çdo gjë..." – Kuptimi: Dituria Jote ka përfshirë gjithçka. Ty nuk të fshihet asgjë, e dukshme apo e fshehtë qoftë ajo. Diturisë Tënde nuk mund t'i shpëtojë asgjë, as sa një grimcë, më e vogël apo më e madhe qoftë, në tokë dhe në qiell. Mëshira Jote, gjithashtu, ka përfshirë gjithçka. Gjithësia, ajo e sipërmja dhe e poshtmja, është e mbushur me mëshirën Tënde. Ajo ka përfshirë çdo gjë që Ti ke krijuar.

Melekët e lusin Allahun me këto cilësi dhe atribute të Tij, që Ai t'i falë robërit që pendohen nga idhujtaria, mohimi, gjynahet dhe mosbindja. Ata luten që besimtarët të pendohen e të largohen nga ato gjëra që sjellin ndëshkimin. Gjithashtu, ata thonë:

- "...prandaj fali ata që pendohen dhe ndjekin rrugën Tënde..." - Kuptimi: Fali ata që pendohen nga shirku e poshtërsitë dhe ndjekin rrugën Tënde, duke pasuar profetët e Tu dhe duke të njësuar në adhurim e në bindje.

Pastaj luten për besimtarët, që të kryejnë ato punë që sjellin faljen e mëshirën, duke thënë:

- "...dhe ruaji ata nga dënimi i Zjarrit flakërues!" - Ata luten për ruajtjen e tyre nga ndëshkimi e nga rrugët që të çojnë në ndëshkim. [1]

---

[1] Në lidhje me të këqijat nga të cilat ruhemi dhe kërkojmë mbrojtje, imam Ibn Kajjimi thotë: "Të këqijat që e godasin robin janë dy llojesh. Njëri lloj janë gjynahet e vepruara prej tij, për të cilat meriton ndëshkim prej Allahut të Lartësuar. Këto të këqija që i kanosen njeriut janë fryt i veprave të tij, të bëra me vullnetin e tij. Këto janë pasojat e gjynaheve, rreziku më i madh, më i frikshëm dhe më i vazhdueshëm që i kanoset njeriut.

Ndërsa lloji i dytë i të këqijave që i kanosen njeriut, janë ato që i vijnë nga të tjerët, jo nga vetja. Të tjerët janë ose të përgjegjshëm ligjërisht te Zoti, ose jo të përgjegjshëm. Të përgjegjshmit janë ose njerëz ose xhindë. Të papërgjegjshmit janë akrepat, gjarpërinjtë e kafshë të tjera të rrezikshme dhe vdekjeprurëse".

Më pas, imam Ibn Kajjimi vazhdon e thotë: "E keqja nënkupton dy gjëra: së pari, dhimbje e vuajtje, së dyti, çdo gjë që i shkakton këto gjëra. E keqja vërtitet mes këtyre të dyjave dhe nuk ka kuptim të tretë.

Të këqijat janë dhimbjet dhe shkaqet e tyre. Me këtë kuptim, themi se gjynahet, mosbindja ndaj Zotit dhe profetit, kufri, idhujtaria dhe të gjitha llojet e padrejtësive konsiderohen, pa dyshim, të këqija, nga të cilat duhet të ruhesh e të kërkosh mbrojtje.

Edhe pse në ndonjë aspekt dhe rast të caktuar në këto të këqija mund të ketë ndonjë dobi për njerëzit apo kënaqësi të kufizuar, ato gjithsesi mbeten të këqija. Janë të këqija, sepse ato shkaktojnë dhimbje, vuajtje e dëshpërim për këdo që i vepron ato, ashtu sikurse çdo shkak sjell pasojën e vet. Ato sjellin në mënyrë të pashmangshme dhimbje dhe dëshpërim, ashtu sikurse helmi sjell vdekjen, apo zjarri djegien, apo uji mbytjen, apo varja në litar vdekjen, etj.

Ky rregull është i pandryshueshëm, përveç rasteve kur ekziston ndonjë pengesë apo shkak tjetër më i fortë, që e ndalon pasojën e shkakut të parë. Kështu, për shembull, pasojat që duhet të sjellin gjynahet nuk godasin nëse forca e besimit dhe veprat e mira të robit janë më të mëdha si shkak. Kështu, shkaku më i fortë e largon pasojën që sjell shkaku tjetër, që është më i dobët. Në të njëjtën mënyrë funksionojnë të gjitha shkaqet dhe pasojat, edhe në aspekte të tjera, si në shëndet dhe sëmundje, në dobësi dhe fuqi etj.

Qëllimi këtu është që të tregojmë se këto të këqija, të cilat sjellin njëfarë kënaqësie të përkohshme, edhe pse duket sikur përmbajnë ndonjë lloj "dobie" të themi, ato mbeten të këqija, prej të cilave duhet të luftosh që të ruhesh dhe të shpëtosh. Ato i përngjajnë atij ushqimi të shijshëm, që, në fakt, është i helmuar dhe sjell vdekjen. Ato i lënë gjurmët e tyre të dhimbshme, qoftë edhe me vonesë. Një fakt të tillë e vërteton vetë realiteti i jetuar, edhe nëse feja nuk do të na e kishte mësuar atë.

Subhanallah! A ka ndonjë mirësi të humbur, për largimin e së cilës të mos jetë bërë shkak mosbindja ndaj Zotit?! Çdo humbje dhe largim mirësie ndodh për shkak të gjynaheve dhe pasojave të hidhura që ato sjellin, sepse Allahu i Lartësuar, nëse e begaton robin me ndonjë mirësi, ia ruan dhe ia shton atë, nga mëshira dhe bamirësia e Tij. Ai kurrë nuk ia largon atë mirësi, derisa vetë robi nxiton dhe, me gjynahet dhe mosbindjen e tij, e largon nga vetja mirësinë e dhuruar prej Zotit. Në suren Rad, ajeti 11, i Lartësuari thotë: "Ai (njeriu) ka (melekë) mbikëqyrës para dhe prapa vetes, që, me urdhrin e Allahut, e ruajnë atë. Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata të ndryshojnë veten e tyre. Por, kur Allahu vendos ta ndëshkojë një popull, këtë nuk ka kush që mund ta sprapsë. Ata (njerëzit) nuk kanë mbrojtës tjetër veç Tij." Çdokush që mediton rreth historisë së popujve të cilëve Zoti ua hoqi mirësitë me të cilat i kishte dalluar, e vëren qartë një të vërtetë të tillë të pamohueshme. Në të gjitha rastet, shkaku i atyre pasojave të hidhura ka qenë kundërshtimi i urdhrave të Zotit dhe mosbindja ndaj profetëve dhe ndaj shpalljeve të dërguara prej Tij. Madje, çdokush që sheh ndryshimet në gjendjen e njerëzve të kohës së vet do të kuptojë se çdo mirësi e hequr prej duarsh është pasojë e mosbindjes dhe e gjynaheve, sikurse thuhet në një vjershë:

Nëse ke një mirësi, fort ta ruash në sënduk,
se gjynahu po të zuri, ta mbulon edhe ta zhduk.

Mirësitë e dhuruara prej Allahut të Lartësuar nuk i ruan dhe kultivon asgjë sikurse i ruan dhe i kultivon bindja ndaj Allahut. Ato nuk i shton asgjë sikurse i shton mirënjohja dhe falënderimi ndaj Allahut të Lartësuar dhe Bujar. Ndërsa poshtërsitë dhe mosbindja ndaj Allahut i shkatërrojnë mirësitë. Ato i djegin dhe i zhdukin mirësitë ashtu sikurse zjarri e djeg drurin e thatë. Cilido që, me mendimin e tij, shëtit dhe vështron në historinë e botës nuk ka nevojë që dikush tjetër t'i mësojë këto gjëra rreth saj.

Pasojat e të këqijave janë gjithmonë të këqija, sepse ato shkaktojnë dhimbje e dëshpërim shumë të fortë në shpirt dhe në trup. Çdo njeri me logjikë që e trajton këtë çështje ashtu si duhet bën gjithçka për t'u larguar nga shkaqet dhe pasojat e dhimbshme. Por mospërfillësit e kanë të errësuar logjikën, prandaj Allahu i Lartësuar do ta çojë deri në fund caktimin e Tij të drejtë për ta. Kur ata të përmenden nga hutimi i thellë, sigurisht që zemra do t'u dëshpërohet, kur të shohin se çfarë mirësish të mëdha u kanë ikur prej duarsh, qoftë nga mirësitë e dynjasë, qoftë nga mirësitë e ahiretit, për shkak të këqijave që bënë. Për ata, realiteti do të shihet vetëm kur të bëhen gati për t'u larguar nga kjo botë dhe për të shkuar në botën tjetër, por atëherë do të jetë tepër vonë: "Jo, mosni ashtu! Kur të dridhet toka njëpasnjëshëm! Kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt të qëndrojnë radhë-radhë! Ajo është dita kur do të sillet Xhehenemi. Atë ditë, njeriu ndërgjegjësohet, por atij nuk do t'i vlejë ky ndërgjegjësim? Ai do të thotë: "Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time!" Atë ditë, askush nuk mund të dënojë si Ai, e askush nuk mund të lidhë me pranga si Ai. O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt, i kënaqur e i pranuar! Hyr në turmën e adhuruesve të Mi! Dhe hyr në Xhenetin Tim!" [Fexhr 21- 30]. I Madhëruari thotë gjithashtu: "Edhe sikur gjithçka që gjendet në tokë, madje edhe një herë aq, të ishte e jobesimtarëve, ata do ta jepnin si kompensim për t'i shpëtuar dënimit të tmerrshëm në Ditën e Kijametit, por Allahu do t'ua japë atë dënim, të cilin nuk kanë mundur as ta imagjinojnë. Kështu, ata përballen me të këqijat, që me duart e tyre i kanë arritur. Për ta bëhet i pashmangshëm dënimi, sepse ata talleshin." [Zumer 47, 48]. Ose: "Askush të mos thotë: "O i mjeri unë, që kam shpërfillur adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut e që isha prej atyre që talleshin!" Ose të thotë: "Ah, sikur të më kishte udhëzuar Allahu e të isha si ata që u treguan të ruajtur!" Apo, kur ta shohë dënimin, të thotë: "Sikur të isha kthyer edhe një herë, e të isha bërë prej bamirësve!" Jo, ty të erdhën argumentet e Mia, por ti i mohove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besuan". [Zumer 56, 59]." Këto ishin fjalët e Ibn Kajjimit

Kështu, lutja e tyre nuk është thjesht për falje gjynahesh, por edhe për ato gjëra që e mundësojnë një gjë të tillë dhe që janë të lidhura ngushtë me faljen e gjynaheve, si: pendimi nga veprat e ndëshkueshme, kryerja e veprave të shpërblyeshme, që sjellin mëshirën e Zotit, si dhe shpëtimin nga rrugët e humbjes, që të çojnë në ndëshkim dhe e bëjnë atë të merituesshëm. Pastaj luten e thonë:

- "Zoti ynë, futi ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar..." - Kuptimi: Futi ata në Xhenetin të cilin ua ke premtuar nëpërmjet profetëve të Tu.

- "...së bashku me të mirët prej etërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre." – Pra, futi në Xhenet së bashku me ata të cilët u rregulluan dhe u bënë të mirë, nëpërmjet imanit dhe veprave sipas këtij imani.

Kësisoj, melekët luten për prindërit, bashkëshortet, shokët e miqtë e besimtarëve, si dhe për pasardhësit e tyre.

- "Vërtet, Ti je Ngadhënjyesi e i Urti!" - Ti je Krenari e Ngadhënjyesi, që ke nënshtruar çdo gjë me madhështinë Tënde. Ti u fal gjynahet robërve, largon prej tyre çdo të keqe dhe çdo shkaktar gjynahesh, si dhe u mundëson atyre të arrijnë çdo të mirë.

Ti je *El Hakimu* - i Urti, i Cili vendos gjithçka në vendin e vet. O Zoti ynë, nuk të lutemi për ndonjë gjë, nëse urtësia Jote sugjeron të kundërtën e lutjes sonë. Ne të lutemi për faljen e besimtarëve, sepse këtë e kërkon urtësia Jote, të cilën e ke sqaruar nëpërmjet profetëve të Tu. Këtë e kërkon, gjithashtu, edhe Bamirësia e Bujaria Jote.

- "Ruaji ata prej të këqijave..." - Ruaji nga veprat e këqija dhe ndëshkimet që ato sjellin. Veprat e këqija, sigurisht, bëhen shkak për ndëshkim dhe fatkeqësi për punuesin e tyre.

- "...sepse atë që Ti e mbron atë ditë prej të këqijave, vërtet e ke mëshiruar!" – Kuptimi: Atë që e shpëton nga pasojat dhe ndëshkimi që sjellin gjynahet në Ditën e Gjykimit, atë e ke përfshirë në mëshirën Tënde. Mëshira Jote i ka shoqëruar gjithmonë besimtarët. Ajo nuk largohet prej tyre, veç nëse bëjnë gjynahe dhe vepra të këqija. Atë që Ti e ke ruajtur nga të këqijat i ke dhënë sukses për të mira e bamirësi e, rrjedhimisht, edhe për shpërblimin e mirë që ato sjellin.

- "Ky është vërtet shpëtimi i madh." - Shpëtimi nga gjynahet dhe ndëshkimi që ato sjellin, si dhe udhëzimi për punë të mira dhe shpërblimi që ato sjellin, janë fitorja më e madhe. Askush nuk ka garuar për diçka më të mirë sesa kjo mirësi e fitore.

Kjo lutje e drejtuar nga melekët tregon për diturinë e tyre të thellë rreth Zotit. Që lutja të jetë më e pranueshme, ata ndërmjetësojnë tek Ai me emrat e cilësitë e Tij të bukura. Allahu i Madhëruar e dëshiron që adhuruesi të ndërmjetësojë tek Ai me emrat e cilësitë e Tij. Ai dëshiron që adhuruesi t'i lutet Atij duke iu drejtuar pikërisht me ato emra e cilësi që janë të përshtatshme me lutjen dhe kërkesën e shtruar. Kështu, edhe melekët i luten Zotit për falje duke përmendur mëshirën e Tij, e Cila përfshin gjithçka, në mënyrë që përgjigjja të ishte më e sigurt. Ata kërkojnë mëshirë dhe largim të çdo shkaku

---

në lidhje me këtë çështje. [Shih në librin "Bedâiul feuaid" të Imam Ibnul Kajim-it]

që e pengon mëshirën e Zotit, siç janë gjynahet dhe punët e këqija. Allahu i Gjithëditur njeh çdo skutë të fshehtë të shpirtit të krijesave dhe i di shumë mirë mangësitë e tyre, të cilat bëhen shkak që ata të bien në gjynahe e gabime. Për këtë arsye, melekët i luten Allahut duke ndërmjetësuar me diturinë e Tij. Allahu e di më së miri se çfarë mund t'i largojë njerëzit nga gjynahet dhe çfarë mund t'i kthejë ata në rrugën e mëshirës, duke iu druajtur diturisë gjithëpërfshirëse të Zotit.

Këto ajete tregojnë, gjithashtu, për edukatën e melekëve me Zotin. Kjo duket në faktin se ata e pranojnë dhe pohojnë që janë krijesa të Zotit, i Cili është *El Rab* - Krijuesi, Sunduesi, Pronari dhe Kujdestari i tyre, me përkujdesjen e Tij të përgjithshme dhe të posaçme. Përveç kësaj, melekët dëshmojnë se ata vetë nuk kanë asgjë në dorë. Lutja e tyre është e sinqertë, e drejtuar nga dikush që është i varfër nga çdo aspekt dhe në nevojë për mëshirën dhe përkujdesin e Zotit. Ata nuk shohin në veten e tyre asnjë meritë, me të cilën ata do të kishin të drejtën t'i luteshin apo të pretendonin përgjigje nga Zoti, por i luten Atij si të varfër dhe të përunjur, që Zoti t'u dhurojë thjesht nga mëshira, mirësia dhe bujaria e Tij.

Gjithashtu, lutja e tyre tregon se ata e duan atë që Zoti e do. Kështu ata i duan veprat e mira dhe adhurimet, sepse edhe Allahu i do ato. Për këtë arsye, melekët përpiqen maksimalisht për t'i kryer sa më mirë ato, ashtu si di të veprojë i dashuruari me Allahun e Madhëruar. Melekët, gjithashtu, i duan besimtarët, sepse edhe Allahu i do besimtarët, duke i dalluar me dashurinë e Tij mes gjithë krijesave. Ata që Zoti i do i veçon nga të tjerët, duke u dhuruar besimin, ndërsa të tjerët janë jashtë kësaj lidhjeje të ngushtë. Kështu, nga dashuria që kanë për besimtarët, melekët i luten Allahut dhe përpiqen që t'i rregullojnë ata dhe punët e tyre. Lutja për dikë është nga shenjat më të qarta të dashurisë për të, sepse çdokush lutet për atë që e do.

Allahu i Madhëruar e përcjell me imtësi lutjen e melekëve. Po të vërejmë me kujdes fjalën e Allahut: "*ue jestagfirune...*" (kërkojnë falje), do të nxjerrim një mësim shumë të vyer, që na udhëzon se si të meditojmë mbi Librin e Tij. Lexuesi i Kuranit nuk duhet të kufizohet vetëm në kuptimin e drejtpërdrejtë të tekstit e të fjalëve të tij, por duhet të mendojë për qëllimin dhe nënkuptimet e tyre. Kur robi e kupton drejt Kuranin, mendja e tij arrin të kapë jo vetëm çështjen që thuhet drejtpërdrejt, por edhe ato që lidhen me të, pa të cilat ajo çështje nuk mund të arrihet, ashtu si edhe rrugët përmes së cilave ajo realizohet e plotësohet. Kjo ndodh derisa t'i krijohet bindja se ky ka qenë pikërisht qëllimi i Allahut të Madhëruar, ashtu sikurse është i bindur për kuptimin e drejtpërdrejtë të ajetit. Siguria e medituesit për qëllimin e Allahut të Madhëruar mbështetet në dy shtylla:

1. Së pari, te dituria e tij se i tillë është nënkuptimi i ajetit, pa të cilin edhe kuptimi i drejtpërdrejtë do të ishte i pamundur.

2. Së dyti, te fakti se Allahu i Madhëruar është i Gjithëdijshëm dhe se Ai vetë i ka urdhëruar adhuruesit e Tij që të meditojnë thellë në Librin e Tij.

Allahu i Lartësuar e di shumë mirë se çfarë nënkuptojnë ajetet e Tij dhe na ka njoftuar se Libri i Tij është udhëzim, dritë dhe qartësim për çdo gjë. Libri i Tij është fjala më e qartë dhe qartësuese për gjithçka. Duke meditуar në këtë libër madhështor

dhe në mesazhet e shumta që ai përmban, çdokush mund të arrijë dituri të madhe dhe mirësi të shumta, në varësi të suksesit të dhënë nga Allahu i Madhëruar.

Edhe në tefsirin tonë ka shumë meditime të tilla, dhe falënderimi i takon vetëm Allahut të Lartësuar. Në disa ajete, mesazhet e fshehura mund të mos dallohen menjëherë, por vetëm pas një meditimi të drejtë, të ndërtuar mbi rregulla të qarta. Prandaj ne e lusim Allahun e Madhëruar që të na i hapë mendjet tona dhe t'i bëjë ato të afta për të përfituar nga pafundësia e mëshirës së Tij gjithëpërfshirëse, të nxjerrim mësime të vyera nga ajetet e Tij të mrekullueshme, që ato të bëhen dritë e udhëzim për ne dhe të rregullojnë gjendjen tonë dhe të të gjithë muslimanëve. Ne nuk kemi shpresë tjetër, veç shpresës së madhe në Bujarinë e Tij. Ne ndërmjetësojmë tek Allahu me bamirësinë dhe bujarinë e Tij për të kërkuar mirësitë e Tij. Mirësitë e Tij janë të shumta dhe të panumërta mbi ne. Ne jetojmë mes mirësive të dhuruara prej Tij në çdo kohë e çast.

E lusim Allahun Bujar të na dhurojë prej mirësive së Tij dhe të na ruajë nga ligësia e shpirtrave tanë, që bëhet pengesë dhe na largon nga mëshira e Tij. Ti, o Zoti im, je *El Kerim* - Bujari, *El Xheuad* - Bamirësi dhe *El Uehhab* – Dhuruesi! Ti i ke në dorë shkaqet dhe pasojat dhe gjithçka është thjesht dhuratë e bujari prej Teje!

Gjithashtu, njeriu gjen gëzim e lumturi me njerëzit që ka më pranë: me gruan, fëmijët, shokët, miqtë e tij etj. Afërsia ose lidhja me njerëzit e mirë bëhet shkak që mirësia t'i afrohet dhe të zbresë edhe mbi të, edhe nëse robi vetë nuk e meriton me përpjekjet e tij. Kështu ndodh kur melekët luten për besimtarët dhe të afërmit e tyre besimtarë dhe punëmirë.

Dikush mund të thotë se nga kjo lutje nuk mund të përfitojnë të gjithë, por vetëm ata që plotësojnë kushtet e përmendura në ajet, pasi i Lartësuari thotë: "...së bashku me të mirët prej etërve të tyre, bashkëshorteve të tyre dhe pasardhësve të tyre." Kështu këta të mirë i përfshin lutja e melekëve, për shkak edhe të punëve të tyre të mira. Pra, të afërmve nuk u vjen e mira pa asnjë sebep nga ana e tyre vetë.

Ajetet 10 – 12

10. Nuk ka dyshim se mohuesve do t'u thuhet: "Urrejtja e Allahut ndaj jush, kur ju ftoheshit të besonit e ju refuzonit, ishte më e madhe se urrejtja juaj sot ndaj vetvetes".
11. Ata do të thonë:"O Zoti ynë! Na bëre të vdesim dy herë dhe na ngjalle dy herë. Ne i pranojmë gjynahet tona tani, prandaj, a ka për ne ndonjë rrugëdalje?"
12. Atyre do tu thuhet: "Këtë ndëshkim e merituat vetë, sepse kur ishte fjala për ta adhuruar Allahun si Një të vetëm, ju e refuzonit, e nëse ishte për të adhuruar ndonjë tjetër veç Tij, ju e pranonit. Por i tërë sundimi i përket Allahut, të Lartit, të Madhërishmit!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon për poshtërimin dhe dëshpërimin që i godet qafirët. Ata do të luten për të dalë nga Zjarri, duke kërkuar mëshirë. Por tashmë kjo do të jetë diçka e pamundur për ta, prandaj do të mbeten atje të poshtëruar. I Madhëruari thotë:

- "Nuk ka dyshim se mohuesve do t'u thuhet..." - Këtu nuk është specifikuar se cilët mohues do të jenë, për t'i përfshirë të gjithë ata, duke filluar nga mohuesit e Zotit, mohuesit e librave të Tij, mohuesit e profetëve të Tij, të Ditës së Gjykimit etj. Kur ata të hidhen në Zjarr, do ta pranojnë se e meritojnë ndëshkimin në të. Për shkak të krimeve e padrejtësive, për shkak të gjynaheve dhe peshës së tyre, ata do të urrejnë vetveten me urrejtjen më të madhe dhe do ta përçmojnë atë me përçmimin më të madh. Atëherë, ata do të bërtasin e ulërasin, por atyre do t'u thuhet:

- "Urrejtja e Allahut ndaj jush, kur ju ftoheshit të besonit e ju refuzonit, ishte më e madhe se urrejtja juaj sot ndaj vetvetes" – Kuptimi: Urrejtja dhe përçmimi i Allahut për ju ishte më i madh sesa urrejtja dhe përçmimi juaj tani për veten tuaj. Ai ju urreu dhe ju përçmoi kur profetët dhe pasuesit e tyre ju ftuan të besonit e të bënit punë të mira, duke sjellë argumente të shumta, të cilat e qartësojnë të vërtetën, por ju i mohuat dhe i shpërfillët ata. Kur ju dolët jashtë mëshirës së gjerë të Zotit, Ai vërtet ju urreu dhe ju nënçmoi. Kjo urrejtje ishte më e madhe sesa urrejtja juaj për vetveten. Urrejtja e Bujarit të drejtë vazhdoi t'ju shoqërojë, derisa patët këtë përfundim. Edhe sot, në Ditën e Gjykimit, mbi ju godet zemërimi e ndëshkimi i Zotit, ndërkohë që besimtarët i përfshin kënaqësia e Zotit dhe shpërblimi i Tij. Këtë ditë, mohuesit do të dëshirojnë të kthehen edhe një herë në dynja:


- "Ata do të thonë:"O Zoti ynë! Na bëre të vdesim dy herë..." - Këtu kanë për qëllim vdekjen e parë dhe atë mes dy fryrjeve të Surit, sikurse mendojnë disa, ose kanë për qëllim inekzistencën e tyre para se të vinin në jetë dhe vdekjen e tyre pasi jetuan në këtë dynja, siç mendojnë disa të tjerë:

- "...dhe na ngjalle dy herë." – Na dhe jetën e dynjasë dhe jetën e ahiretit.

- "Ne i pranojmë gjynahet tona tani, prandaj, a ka për ne ndonjë rrugëdalje?" - Ata i thonë të dëshpëruar dhe të penduar këto fjalë, por kjo nuk u bën aspak dobi dhe nuk i shpëton nga ndëshkimi. Madje, ata do të poshtërohen edhe me fjalë, për shkak se nuk ndoqën rrugën e shpëtimit. Atyre u thuhet:

- "Këtë ndëshkim e merituat vetë, sepse kur ishte fjala për ta adhuruar Allahun si Një të vetëm, ju e refuzonit, e nëse ishte për të adhuruar ndonjë tjetër veç Tij, ju e pranonit." - Kur ata ftoheshin për të adhuruar Allahun si Një të vetëm dhe për t'u distancuar nga shirku, e refuzonin me forcë këtë ftesë, madje tregonin neveri ndaj saj. Ndërsa kur adhurohej diçka tjetër veç Allahut, ata kënaqeshin dhe e pasonin atë rrugë.

Kështu, - u thuhet atyre, - ajo që ju solli në këtë gradë ishte fakti se ju e refuzuat besimin e drejtë, duke u kënaqur me mohimin e Zotit. Ju ndoqën me përkushtim atë që është e keqe dhe shkatërrim për dynjanë dhe ahiretin tuaj, dhe e urryet atë që është e mirë dhe e dobishme për dynjanë dhe ahiretin tuaj. Ju parapëlqyet atë që shkakton dëshpërimin, fatkeqësinë, poshtërimin tuaj, dhe u treguat mospërfillës ndaj asaj që ju mundëson suksesin dhe arritjen e çdo mirësie. Në një ajet, i Madhëruari thotë: "Unë do t'i spraps nga


الجزء الرابع والعشرون سورة غافر
ٱلْيَوْمَ تُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍۭ بِمَا كَسَبَتْ ۚ لَا ظُلْمَ ٱلْيَوْمَ ۚ إِنَّ
ٱللَّهَ سَرِيعُ ٱلْحِسَابِ ﴿١٧﴾ وَأَنذِرْهُمْ يَوْمَ ٱلْـَٔازِفَةِ إِذِ ٱلْقُلُوبُ
لَدَى ٱلْحَنَاجِرِ كَٰظِمِينَ ۚ مَا لِلظَّٰلِمِينَ مِنْ حَمِيمٍ وَلَا شَفِيعٍ
يُطَاعُ ﴿١٨﴾ يَعْلَمُ خَآئِنَةَ ٱلْأَعْيُنِ وَمَا تُخْفِى ٱلصُّدُورُ ﴿١٩﴾ وَٱللَّهُ
يَقْضِى بِٱلْحَقِّ ۖ وَٱلَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِهِۦ لَا يَقْضُونَ
بِشَىْءٍ ۗ إِنَّ ٱللَّهَ هُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْبَصِيرُ ﴿٢٠﴾ * أَوَلَمْ يَسِيرُوا۟ فِى
ٱلْأَرْضِ فَيَنظُرُوا۟ كَيْفَ كَانَ عَٰقِبَةُ ٱلَّذِينَ كَانُوا۟ مِن قَبْلِهِمْ ۚ
كَانُوا۟ هُمْ أَشَدَّ مِنْهُمْ قُوَّةً وَءَاثَارًا فِى ٱلْأَرْضِ فَأَخَذَهُمُ ٱللَّهُ
بِذُنُوبِهِمْ وَمَا كَانَ لَهُم مِّنَ ٱللَّهِ مِن وَاقٍ ﴿٢١﴾ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ
كَانَت تَّأْتِيهِمْ رُسُلُهُم بِٱلْبَيِّنَٰتِ فَكَفَرُوا۟ فَأَخَذَهُمُ ٱللَّهُ
إِنَّهُۥ قَوِىٌّ شَدِيدُ ٱلْعِقَابِ ﴿٢٢﴾ وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا مُوسَىٰ بِـَٔايَٰتِنَا
وَسُلْطَٰنٍ مُّبِينٍ ﴿٢٣﴾ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ وَهَٰمَٰنَ وَقَٰرُونَ
فَقَالُوا۟ سَٰحِرٌ كَذَّابٌ ﴿٢٤﴾ فَلَمَّا جَآءَهُم بِٱلْحَقِّ مِنْ
عِندِنَا قَالُوا۟ ٱقْتُلُوٓا۟ أَبْنَآءَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ مَعَهُۥ وَٱسْتَحْيُوا۟
نِسَآءَهُمْ ۚ وَمَا كَيْدُ ٱلْكَٰفِرِينَ إِلَّا فِى ضَلَٰلٍ ﴿٢٥﴾
الجزء ٢٤
٤٦٩

argumentet e Mia ata të cilët, pa pasur të drejtë, tregohen mendjemëdhenj në tokë, të cilët, edhe nëse shohin çdo argument, nuk besojnë. Nëse shohin rrugën e shpëtimit, ata nuk e marrin atë rrugë, e nëse shohin rrugën e humbjesn ata e ndjekin atë rrugë. Kjo ndodh ngase ata i konsiderojnë të rreme faktet Tona dhe janë të pavëmendshëm ndaj tyre". [Araf 146].

- "Por i tërë sundimi i përket Allahut, të Lartit, të Madhërishmit!" - Atij i takon lartësimi e madhërimi i plotë, në çdo drejtim. Ai është i Lartësuar në Qenien e Tij, i Lartësuar në përcaktimet e gjykimet e Tij, i Lartësuar, Mbretërues e Nënshtrues i gjithçkaje. Prej lartësisë së përcaktimit dhe gjykimit të Tij është dhe drejtësia e Tij absolute, duke vendosur gjithçka në vendin e vet. Me drejtësinë e Tij, Ai kurrë nuk do t'i gjykojë e shpërblejë njëlloj të devotshmit me keqbërësit. Allahu është *El Kebiru* - i Madhërishmi. Atij i takon madhështia e krenaria e plotë, në emrat, cilësitë dhe në veprat e Tij. Ai është i Lartësuar dhe larg çdo të mete e mangësie. Pra, nëse është Allahu i Madhërishëm e i Gjithëpushtetshëm Ai që ju gjykon me përjetësi në zjarrin e Xhehenemit, atëherë ai gjykim nuk ndryshohet dhe askush nuk e kthen dot pas.

Ajetet 13 – 17

13. Është Ai që ju tregon shenjat e Tij dhe ju zbret rizkun prej qiellit, por askush nuk e kujton këtë, përveç atyre që kthehen tek Ai të penduar.
14. Pra, drejtojuni Allahut me lutje të sinqertë ndaj Tij, edhe nëse këtë e urrejnë jobesimtarët!
15. Ai është Zotëruesi i pozitës më të lartë, Zotëruesi i Fronit. Ai, me urdhrin e Vet, ia jep Shpirtin atij që Ai do nga robërit e Vet, për t'i paralajmëruar për Ditën e Takimit,
16. për Ditën kur ata do të dalin në shesh, e kur Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë e tyre. I kujt është pushteti sot? I Allahut, të Vetmit, Ngadhnjimtarit!
17. Sot çdokush shpërblehet për atë që ka vepruar. Sot nuk ka padrejtësi. Allahu është Llogaritës i shpejtë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar u kujton adhuruesve të Tij mirësitë e begatitë e mëdha, të cilat ua ka dhuruar atyre. Pa dyshim që mirësia më e madhe është qartësimi i të vërtetës dhe dallimi i saj nga e kota dhe humbja. Për të dalluar plotësisht këtë të vërtetë, Ai u sjell atyre shenja e argumente të shumta, që lexohen në gjithësi, në veten tyre dhe në Shpalljen e Tij. Kush i vështron dhe mediton

mbi këto argumente nuk ka më asnjë dyshim në njohuritë e përftuara rreth të vërtetës. Kjo është mirësia më e madhe për robërit, sepse nuk i lë ata të çoroditur dhe të hutuar.

Allahu i Madhëruar ka sjellë një larmi argumentesh e shenjash, në mënyrë që çdokush të jetojë i qartë për mënyrën si jeton dhe të vdesë i qartë në atë që beson. Sa më e rëndësishme të jetë një çështje, aq më të mëdha, të shumta dhe të kuptueshme janë argumentet që Ai ka sjellë për të. Shih, për shembull, çështjen e *teuhid*-it në adhurim e në çdo aspekt tjetër. Duke qenë se ajo është ndër çështjet më të rëndësishme, madje më e rëndësishmja dhe më e madhja, edhe argumentet e sjella për të janë më të shumtat e më të shumëllojshmet, qofshin ato argumente logjike apo tekstuale fetare. Edhe në këtë sure, i Madhëruari përmend disa nga këto argumente e shenja:

- "Është Ai që ju tregon shenjat e Tij..." - Pas këtij njoftimi, Allahu i Madhëruar vijon të tregojë një nga shenjat e mëdha të Tij:

- "...dhe ju zbret rizkun prej qiellit..." – Kuptimi: Ai ju lëshon ujë nga qielli, me anë të të cilit siguroni jetën tuaj dhe të kafshëve tuaja.

Kjo tregon se të gjitha mirësitë janë prej Allahut, si mirësitë e dynjasë, ashtu edhe ato të fesë e të besimit. Në mirësitë e fesë hyjnë njohuritë fetare, argumentet rreth besimit, veprat përkatëse, si dhe suksesi që Allahu u jep robërve për t'i realizuar të gjitha këto. Të dhuruara prej Tij janë, po ashtu, të gjitha mirësitë e dynjasë, që kryesisht e kanë origjinën nga uji, të cilin Allahu e zbret nga qielli për të gjallëruar tokën dhe njerëzit. Të gjitha këto tregojnë se Ai është i vetmi që meriton adhurimin dhe i vetmi të Cilit duhet t'i përkushtohesh tërësisht e me sinqeritet. Ashtu sikurse Ai është i vetmi që jep mirësi e përkujdeset për krijesat e Tij, Ai duhet të jetë i vetmi i Adhuruar.

- "...por askush nuk e kujton këtë, përveç atyre që kthehen tek Ai të penduar." - Nga shenjat dhe argumentet që Zoti sjell përfiton veçse kjo kategori njerëzish: ata të cilët kthehen te Zoti të penduar e të përkushtuar ndaj Tij, me dashuri, drojë, bindje dhe përulje. Këta përfitojnë nga shenjat dhe argumentet e Zotit, të cilat janë për ta mëshirë dhe ndihmë për të parë më qartë rrugën e Zotit.

Duke qenë se shenjat dhe argumentet e Allahut të bëjnë që ta përkujtosh Atë me madhështinë e Tij dhe meqenëse përkujtimi sjell sinqeritetin ndaj Tij, i Madhëruari vijon të nxisë për diçka që duhet të vijë natyrshëm te njerëzit që meditojnë mbi shenjat e Tij:

- "Pra, drejtojuni Allahut me lutje të sinqertë ndaj Tij..." - Ky është një urdhër për të dyja llojet e lutjes, për lutjen e kërkesës dhe lutjen e adhurimit. [2] Të jesh i sinqertë me Zotin do të thotë që të gjitha adhurimet, të detyrueshme apo të pëlqyeshme, që kanë lidhje në plotësimin e hakut të Zotit apo hakut të krijesave, t'ia përkushtosh vetëm Atij. Pra, vetëm Allahut t'ia përkushtosh të gjitha adhurimet e veprat me të cilat synoni afrimin tek Ai.

- "...edhe nëse këtë e urrejnë jobesimtarët!" – Kuptimi: Mos u kushtoni rëndësi jobesimtarëve. Pakënaqësia dhe urrejtja e

[2] Shih shpjegimin e këtyre dy llojeve të lutjes te surja Bekare ajeti 186.

qafirëve të mos bëhet shkak që ju të lini fenë tuaj. Gjithashtu, për plotësimin e detyrimeve ndaj Zotit tuaj, mos iu frikësoni asnjë kërcënimi.

Qafirët e urrejnë sinqeritetin dhe përkushtimin vetëm ndaj Allahut, sikurse thotë i Madhëruari në ajetin tjetër: "Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë botën tjetër neveriten, e kur përmenden të tjerë veç Atij, ata gëzohen". [Zumer 45].

Pastaj i Madhëruari përmend disa nga cilësitë e Tij të bukura, madhështore e absolute, të cilat e bëjnë të detyrueshme sinqeritetin në adhurimin ndaj Tij si Një të vetëm:

- "Ai është Zotëruesi i pozitës më të lartë, Zotëruesi i Fronit." - Ai është më i Lartësuari, i Cili qëndron mbi Fron, të cilin e ka veçuar për Veten. Allahu është *El Alijju* - i Larti, *El ea'lâ* - më i Lartësuari, i ndarë qartë nga krijesat e Tij. I Lartë është Ai, të larta janë cilësitë e Tij, e Lartësuar është Qenia e Tij. Tek Ai mund të afrohesh veçse nëpërmjet veprave të pastra e pastruese, pra, me veprat e mira të kryera me sinqeritet. Vetëm veprat e mira e afrojnë dhe e lartësojnë robin mbi të gjitha krijesat e tjera.

Pastaj i Madhëruari u përkujton robërve mirësinë e Tij me Shpalljen që u dhuroi:

- "Ai, me urdhrin e Vet, ia jep Shpirtin atij që Ai do nga robërit e Vet..." - Ai dhuroi Shpalljen, e cila është për zemrat si shpirti për trupin. Ashtu sikurse trupi nuk jeton dot pa shpirtin, ashtu edhe zemrat e robërve nuk kanë jetë pa shpirtin e Shpalljes e nuk mund të rregullohen. Ai e ka dhënë Shpalljen për të qenë e dobishme dhe mirësi për robërit. Këtë Shpallje i Urti ia jep atij që dëshiron prej robërve të Tij, pra, profetëve, të cilët Zoti i zgjodhi dhe i dalloi mbi të tjerë, duke i ngarkuar me detyrën e ftesës së njerëzve në rrugën e Tij.

Qëllimi i dërgimit të profetëve është arritja e lumturisë së robërve në fenë, dynjanë dhe ahiretin e tyre, siç thotë i Madhëruari më tej:

- "...për t'i paralajmëruar për Ditën e Takimit..." – Domethënë, që profetët të paralajmërojnë e qortojnë botën për t'u përgatitur për Ditën e Takimit.

Allahu i Madhëruar i frikëson robërit me përkujtimin e kësaj dite, duke i nxitur ata që të përgatiten me vepra të cilat të shpëtojnë nga telashet e asaj dite. I Madhëruari e quan atë ditë "Dita e Takimit", sepse ajo është dita e takimit mes Krijuesit dhe krijesave, e takimit mes krijesave me njëra-tjetrën, e takimit të njerëzve me veprat e tyre dhe me shpërblimin që do marrin për to.

- "...për Ditën kur ata do të dalin në shesh..." - Ata do të jenë të dukshëm mbi tokë. Të gjithë të tubuar në një vend të sheshtë, ku nuk ka as gropa, as male. Ata do thirren nga zëri i Ftuesit dhe të gjithë do të dalin sheshazi atje.

- "...e kur Allahut nuk mund t'i fshihet asgjë e tyre." - Atij nuk mund t'i fshihen as robërit, as punët e tyre dhe as ndëshkimi që ata meritojnë.

- "I kujt është pushteti sot? I Allahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit!" – E cili, përveç Allahut, është sunduesi i kësaj dite të madhe, kur do të tubohen të parët dhe të fundit, banorët e qiellit dhe të tokës?!

Atë ditë, asnjë krijesë nuk do të ketë asnjë lloj pushteti e sundimi mbi asgjë. Atë ditë, asgjë nuk i vlen askujt, veç punëve të mira. Përfundimi i secilit do të jetë në varësi të veprave që ka bërë.

Atë ditë, i gjithë pushteti, sundimi e mbretërimi i takon vetëm Allahut, të Vetmit, Gjithësunduesit. Ai është Unik, i Pashembullt dhe i Pakrahasueshëm, për sa i përket Qenies së Tij, emrave dhe cilësive të Tij, si edhe veprave të Tij. Allahu nuk ka shok të barabartë apo të ngjashëm në asnjë nga këto aspekte. Ai është *El Kahhar* - Nënshtruesi i të gjitha krijesave, të Cilit i janë dorëzuar e nënshtruar të gjitha krijesat, sidomos në atë ditë, kur fytyrat e të gjithëve do të jenë të përulura dhe të frikësuara para Atij që është *El Hajju*, *El Kajum* - i Gjallë e i Përjetshëm. Atë ditë, gjithashtu, askush nuk do të flasë pa lejen e të Madhërishmit.

- "Sot çdokush shpërblehet për atë që ka vepruar." - Gjithësecili do të shpërblehet për atë që ka bërë në dynja, me të mirë ose me të keq, për punët e mëdha e të shumta dhe për punët e vogla e të pakta. Atë ditë, askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi me shtim të këqijash apo me pakësim shpërblimi.

- "Sot nuk ka padrejtësi. Allahu është Llogaritës i shpejtë." – Pra, të mos ju duket larg ajo ditë. Çdo gjë që ka për të ardhur është afër. Allahu është Llogaritës i shpejtë i veprave të robërve të Tij në Ditën e Gjykimit, sepse Ai është Gjithëpërfshirës me dijen e Tij dhe i Plotë në pushtetin e Tij.

Ajetet 18 – 20

18. Paralajmëroji ata për Ditën e Afërt, kur zemrat do të arrijnë në fyt nga tmerri. Për zullumqarët nuk ka mik të afërt e as ndërmjetësues që i shkon fjala.
19. Ai e di për shikimin vjedhurazi dhe për atë që fshihet në zemra.
20. Allahu gjykon me drejtësi, ndërsa ata që adhurohen veç Tij nuk kanë në dorë të gjykojnë për asgjë. Me të vërtetë, Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar i drejtohet Profetit të Tij, Muhamedit (a.s.), që t'i këshillojë dhe paralajmërojë njerëzit për t'u përgatitur për Ditën e Kijametit, e cila – ashtu sikurse e përshkruan Allahu – është e afërt. Tronditja, tmerret dhe vështirësitë e saj janë shumë pranë.

- "Paralajmëroji ata për Ditën e Afërt, kur zemrat do të arrijnë në fyt nga tmerri." - Nga tmerri i madh atë ditë, zemrat do të ngrihen deri në fyt, ndërsa gjoksi do t'u zbrazet. Vështrimet e tyre do të jenë të shtangura e të tmerruara. Askush nuk do të flasë, përveç atij që Rrahmani do t'i japë leje dhe do të thotë vetëm të vërtetën.

- "Për zullumqarët nuk ka mik të afërt e as ndërmjetësues që i shkon fjala."- Atë ditë, për të padrejtët nuk do të ketë të afërt, miq apo ndërmjetësues, të cilëve do t'u dëgjohet dhe pranohet ndërmjetësimi. Ditën e Gjykimit nuk ka ndërmjetësim për ata që e kanë përlyer veten me idhujtari. Edhe sikur dikush të ndërmjetësojë për ta, – gjë që nuk ka për të ndodhur kurrë, – Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur me këtë lloj ndërmjetësimi dhe nuk e pranon atë.

- "Ai e di për shikimin vjedhurazi dhe për atë që fshihet në zemra." - Vështrim

vjedhurazi është ai që njeriu e fsheh nga ai që ka pranë. Por, nëse këtë nuk e vërejnë të pranishmit, Allahu i Madhëruar e di shumë mirë, sepse Atij nuk i fshihet as ajo që mbahet fshehur në gjoks dhe që robi nuk ua tregon të tjerëve. Allahu i Madhëruar i di dhe i sheh të fshehtat e zemrës dhe të dukshmet, sepse Ai është i Gjithëdituri.

- **"Allahu gjykon me drejtësi..."** - Fjala e Tij është e vërtetë dhe e drejtë, ligji i Tij për krijesat është i drejtë dhe i vërtetë, ashtu si edhe gjykimi i Tij shpërblyes dhe ndëshkues është i drejtë dhe i urtë. Allahu është i Drejtë dhe i Urtë në gjithçka, sepse dija e Tij përfshin gjithçka dhe se Ai ka shkruar dhe ruajtur çdo gjë me saktësi e drejtësi. Ai është i Drejtë në gjithçka, sepse Ai është i pastër nga padrejtësia, mangësia e nga çdo cen. Allahu është i vetmi në dorë të të Cilit është përcaktimi i gjithçkaje që ndodh në gjithësi. Nëse Ai dëshiron diçka, ajo është, e nëse Ai nuk dëshiron që ajo të ekzistojë, ajo kurrë nuk do të ekzistojë. Është Ai që bën ndarjen mes robërve të Tij besimtarë dhe mohuesve në jetën e dynjasë, duke u dhuruar suksesin të dashurve dhe të zgjedhurve të Tij.

- **"...ndërsa ata që adhurohen veç Tij nuk kanë në dorë të gjykojnë për asgjë."** - Kjo përfshin gjithçka që adhurohet veç Allahut. Pra, – sipas kuptimit, – çdo lloj idhulli dhe i adhuruar tjetër, veç Allahut, nuk ka asnjë grimcë pushteti. Tek idhujt nuk ekziston aspak dashuria për idhujtarët, ashtu si nuk kanë asnjë dëshirë e mundësi për të vepruar diçka a për t'i ndihmuar.

- **"Me të vërtetë, Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka."** - Allahu është Dëgjues i të gjithë zërave, me të gjithë larminë e gjuhëve apo të nevojave që shprehin ata. Ai është Shikues i asaj që është dhe i asaj që do të jetë, i asaj që ne e shohim dhe i asaj që nuk mund ta shohim, i asaj që krijesat e dinë dhe i asaj që ato nuk e dinë.

Në fillim të këtyre ajeteve, Allahu i Madhëruar thotë: "Paralajmëroji ata për Ditën e Afërt...", dhe më pas e përshkruan këtë ditë me hollësi, me ngjarjet e saj përgëzuese e frikësuese, si një nxitje për të qenë të përgatitur.

Ajetet 21 – 22

21. A nuk shëtisin ata nëpër botë e të shohin se si ka qenë përfundimi i popujve pararendës? Ata ishin edhe më të fuqishëm dhe lanë më shumë gjurmë në tokë, por përsëri Allahu i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre, ndërkohë që ata nuk patën ndonjë që t'i mbronte prej dënimit të Allahut.
22. Kjo ndodhi sepse, kur profetët u shkonin atyre me argumente të qarta, ata i mohonin ato, e kështu Allahu i ndëshkoi. Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm dhe ndëshkon ashpër.

Shpjegimi i ajeteve

- **"A nuk shëtisin ata nëpër botë e të shohin se si ka qenë përfundimi i popujve pararendës? Ata ishin edhe më të fuqishëm se këta dhe lanë më shumë gjurmë në tokë..."** – Kuptimi: Pse nuk lëvizni nëpër botë, me trup e me mendje, për të parë se ç'ka ndodhur me popujt e mëparshëm, me qëllim që kjo t'ju ndihmojë të merrni mësime e përvojë? Pse nuk meditoni rreth ngjarjeve historike? A nuk e keni mësuar se si ishte përfundimi i shumë popujve pararendës, që e mohuan dhe e injoruan të vërtetën? Atyre

iu dhanë ndëshkimet më të rënda e më poshtërueset. Në vendet e tyre do të gjeni gjurmët e ndëshkimit, poshtërimit e të përfundimit të turpshëm, edhe pse ata ishin më të fortë në fuqi, pushtet e ushtri e më të mëdhenj në trup se ju që kundërshtoni tani. Madje, ata lanë gjurmë dhe patën famë më të madhe në tokë se ju. Vendbanimet madhështore të tyre dëshmojnë për fuqinë e banorëve dhe të ndërtuesve që i ngritën ato, për pushtetin e për zhvillimin e lartë të tyre, me ndikim të gjerë në botë. Por pavarësisht nga kjo:

- "...Allahu i dënoi për shkak të gjynaheve të tyre, ndërkohë që ata nuk patën ndonjë që t'i mbronte prej dënimit të Allahut. Kjo ndodhi sepse, kur profetët u shkonin atyre me argumente të qarta, ata i mohonin ato, e kështu Allahu i ndëshkoi. Me të vërtetë, Ai është i Fuqishëm dhe ndëshkon ashpër." – Pra, Allahu i Madhëruar i ndëshkoi, sepse ata vazhdonin me gjynahe pa u ndalur dhe pa u penduar. Allahu është më i Forti dhe ka ndëshkim të ashpër. Atyre nuk u vleu aspak fuqia e pushteti i tyre përballë pushtetit dhe fuqisë së të Madhëruarit. Madje, edhe kur një ndër popujt më të mëdhenj e të fuqishëm tha: "Kush është më i fortë se ne?", Allahu i Madhëruar u dërgoi atyre një furtunë të fuqishme, e cila i shkatërroi tërësisht.

Pastaj i Madhëruari përmend një shembull, që tregon gjendjen e mohuesve të profetëve, si Faraoni e ushtritë e tij.

Ajetet 23 – 25


23. Ne e dërguam Musain me argumentet Tona e me fakte të qarta
24. te Faraoni, te Hamani dhe te Karuni, por ata i thanë: "Magjistar e gënjeshtar!"
25. Kur ai ua solli të vërtetën nga ana Jonë, ata thanë: "Vritini djemtë e atyre që besojnë si ai dhe lërini të jetojnë vajzat e tyre!" Por kurthet e mohuesve janë të destinuara të dështojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne e dërguam Musain me argumentet Tona e me fakte të qarta te Faraoni, te Hamani dhe te Karuni, por ata i thanë: "Magjistar e gënjeshtar!"" - Allahu i Madhëruar dërgoi Musain, birin e Imranit, te disa prej këtyre mohuesve të profetëve. Ai e dërgoi tek ata me mrekulli e shenja të mëdha, që dëshmonin qartë për vërtetësinë e Musait si profet i Zotit dhe për vërtetësinë mesazhit që përcillte ai. Këto mrekulli e shenja dëshmonin, gjithashtu, për kotësinë e adhurimeve të kota, poshtërsive dhe idhujtarisë, ku ishte zhytur ajo shoqëri. Në fakt, Allahu i Madhëruar i pajisi të gjithë profetët me argumente e shenja të qarta, të cilat pushtojnë dhe nënshtrojnë zemrat e sinqerta. Musait, për shembull, iu dhanë mrekulli të mëdha e të dukshme, siç qe shkopi që kthehej në gjarpër, nëpërmjet të cilave Allahu i Madhëruar e mbështeti Profetin dhe e përforcoi të vërtetën e Tij.

Ata tek të cilët shkoi Musai (a.s.) si paralajmërues ishin Faraoni, Hamani, i cili ishte ministër i Faraonit, dhe te Karuni, i cili ishte nga populli i Musait dhe e kaloi kufirin kundër popullit me arrogancën dhe pasurinë e tij. Por të gjithë këta e refuzuan me forcë e ashpërsi mesazhin dhe porositë e Musait (a.s):

- "Kur ai ua solli të vërtetën nga ana Jonë..." - Por kur Allahu i Madhëruar e pajisi Musain me shenja e mrekulli të qarta, pas të cilave pritej vetëm bindja dhe



nënshtrimi, ata përsëri nuk e pranuan mesazhin e tij. Asgjë nuk i ndali ata nga shirku dhe poshtërsitë ku ishin zhytur. Ata vazhduan me kundërshtimin e tyre, madje u thelluan edhe më tepër në këtë drejtim. Kundërshtimi dhe urrejtja ndaj të vërtetës arritën deri aty, saqë ndërmorën një krim të shëmtuar:

- "...ata thanë: "Vritini djemtë e atyre që besojnë si ai dhe lërini të jetojnë vajzat e tyre!" Por kurthet e mohuesve janë të destinuara të dështojnë." - Ata organizuan një plan, sipas të cilit do të vrisnin fëmijët meshkuj dhe do të linin të gjalla femrat. Kështu, me këtë programim të pasardhësve të besimtarëve, mendonin se do të mbanin nën kontroll ata dhe nuk do të lejonin fuqizimin e tyre. Ata planifikuan që t'i mbanin besimtarët gjithmonë në robëri. Por plani i tyre i zi ishte i destinuar të dështonte. Ata kurrë nuk do të arrinin të realizonin atë që dëshironin me besimtarët, sepse u goditën nga ndëshkimi dhe u befasuan me të kundërtën e asaj që synonin. Allahu i Madhëruar i shkatërroi dhe i shfarosi ata tërësisht.

Medito pak në këtë histori, e cila përsëritet aq shpesh në Librin e Allahut. Është e vërtetë që ajo flet në mënyrë të veçantë për Faraonin dhe parinë rreth tij, si dhe për cilësitë e veprat e tyre të shëmtuara, të cilat i Madhëruari na i rrëfen imtësisht në sure të ndryshme. Në këtë mënyrë, Allahu i Madhëruar dëshiron të na mësojë se të njëjtin gjykim dhe shpagim do të marrin të gjithë ata që bëjnë vepra të njëjta apo të ngjashme me këta qafirë. Të gjithë ata do të kenë të njëjtin fund të hidhur. E përbashkëta e tyre është se ata mohojnë Shpalljen e Zotit, mohojnë profetët e Tij, luftojnë të vërtetën dhe bartësit e saj. Por nga kuptohet ky gjykim gjithëpërfshirës, ndërkohë që në tekst flitet vetëm për një grup të caktuar? Kjo kuptohet nga fjala e Allahut, kur thotë: "Por kurthet e mohuesve janë të destinuara të dështojnë", dhe nuk thotë: "Por kurthi i Faraonit është i destinuar të dështojë". Kështu kuptojmë se ai gjykim nuk jepet vetëm për Faraonin, por për të gjithë ata që veprojnë njëlloj si ai. Po ashtu largohet edhe keqkuptimi i ndonjërit që e mendon këtë si një gjykim të kufizuar vetëm për ata që përmenden në këtë rrëfim.

Ajetet 26 – 27

26. Faraoni tha: "Më lini ta vras Musain, dhe le ta thërrasë ai Zotin e vet!" Unë në të vërtetë druhem se ai po ndryshon fenë tuaj e po nxit shkatërrimin në tokë!"

27. Musai tha: "Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj, që të më mbrojë prej çdo

kryeneçi, që nuk i beson Ditës së Përgjegjësisë!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Faraoni tha: "Më lini ta vras Musain, dhe le ta thërrasë ai Zotin e vet!"" - Me arrogancë të madhe, Faraoni iu drejtua popullit të tij injorant, duke i mashtruar, e u tha: "Më lini ta vras Musain, dhe le ta lusë pastaj ai Zotin e vet!". Allahu e shkatërroftë dhe e shëmtoftë! Ai pretendoi se, po të mos ishte përkujdesi i tij ndaj ndjenjave të popullit, ai do ta vriste Musain. A thua se ai që e pengonte ishte respekti ndaj popullit të tij dhe ndjenjave të tyre, ndërsa fakti që Musai mund t'i lutej Zotit nuk përbënte ndonjë pengesë dhe problem për të!

Më pas, ai tregoi arsyen përse donte ta vriste Musain:

- "Unë në të vërtetë druhem se ai po ndryshon fenë tuaj e po nxit shkatërrimin në tokë!" – Kuptimi: Unë thjesht po kujdesem që ai të mos ju ndërrojë fenë e besimin tuaj dhe po përpiqem që ai të mos përhapë në tokë shkatërrimin.

Kjo është nga ndodhitë më të çuditshme, që krijesa më e keqe të këshillojë njerëzit, duke pretenduar se do të mirën e tyre, kur i nxit që të largohen nga pasimi i njeriut më të mirë. Ky është pikërisht transformimi i të vërtetës, duke e shfaqur atë si të gënjeshtërt. Por kjo mënyrë ndikon veçse tek ata për të cilët Allahu thotë: "Ai e mashtroi popullin e vet duke i përçmuar, ndërsa ata e respektuan. Ata ishin vërtet një popull i shkatërruar." [Zuhruf 54].

Kur Faraoni tha këto fjalë të shëmtuara, të cilat e zhytën edhe më thellë në shfrenimin e tij, Musai duke iu mbështetur plotësisht Zotit të tij e duke u lutur, tha:

- "Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj, që të më mbrojë prej çdo kryeneçi, që nuk i beson Ditës së Përgjegjësisë!" - Kuptimi: I kërkoj mbrojtje dhe strehim Allahut, që ka nën zotërim dhe sundim të plotë të gjitha krijesat dhe çështjet e tyre. I kërkoj mbrojtje e mbështetje Atij që të më ruajë nga krijesat që nuk besojnë Ditën e Llogarisë, sepse ata që nuk e besojnë këtë ditë i shtyn kryelartësia e tyre që të kryejnë çdo ligësi e poshtërsi. Kjo përfshin Faraonin dhe të tjerët që kanë të njëjtat cilësi si ai.

Me butësinë e mëshirën e Tij, Allahu i Madhëruar e shpëtoi Musain nga ligësia e çdo krijese që nuk besonte në Ditën e Gjykimit. I Lartësuari i mundësoi Musait çdo mjet dhe rrugë që të shpëtonte dhe të ruhej nga ligësia e Faraonit dhe e pasuesve të Tij. Një nga format e ndihmës për të ishte edhe besimtari nga mesi i familjes së Faraonit. Këtij njeriu me siguri i dëgjohej fjala në kuvendet e parisë. Ai e fshihte imanin e tij dhe në dukje i miratonte ata. Ata e dëgjonin dhe e respektonin, gjë që nuk do ta bënin nëse ai do ta shfaqte imanin e tij. Po kështu e ndihmoi Allahu i Madhëruar profetin Muhamed (s.a.u.s) nëpërmjet xhaxhait të tij Ebu Talibit, i cili ishte i respektuar mes parisë së vendit dhe mbështetës i fesë së tyre. Nëse do të ishte musliman, nuk do të ishte e mundur që ai të ushtronte autoritetin e tij për mbrojtjen e nipit të vet, të paktën jo me të njëjtën forcë e masë.

Ajetet 28 – 33

28. Një besimtar nga familja e Faraonit, që e fshihte besimin e vet, tha: "A doni ta vrisni një njeri vetëm pse thotë: "Zoti im është Allahu", ndërkohë që ju ka sjellë argumente të qarta prej Zotit tuaj? Nëse ai

është gënjeshtar, dënimi për gënjeshtrën e vet do të godasë mbi të, por nëse është i drejtë, juve do t'ju godasë diçka nga ajo me të cilën ai ju kërcënon. Nuk ka dyshim se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që e tepron dhe është gënjeshtar.

29. O populli im, sot juve keni sundimin në tokë, por kush do të na mbrojë nga dënimi i Allahut kur ai të godasë mbi ne?" Faraoni tha: "Unë po ju tregoj veçse atë që shoh dhe po ju udhëzoj veçse në rrugën e drejtë!"

30. Ndërkaq, ai që kishte besuar tha: "O populli im! Unë kam frikë se do t'ju godasë ndonjë dënim ashtu si popujt e mëparshëm,

31. si dënimi i popullit të Nuhut, të Adit, të Themudit dhe brezave pas tyre. Allahu nuk dëshiron padrejtësi ndaj robërve.

32. O populli im! Unë kam frikë për ju Ditën e Britmës,

33. ditën kur, nga frika, do të sprapseni për të gjetur shpëtim, por nuk do të gjeni ndonjë që t'ju mbrojë prej Allahut. Atë që Allahu e lë në humbje, për të nuk do të gjesh udhëzues.

Shpjegimi i ajeteve

Ky burrë besimtar me mendje të ndritur dhe besim në zemër, duke treguar shëmtinë e veprave të popullit të tij, si dhe padrejtësinë e vendimit që kishin marrë për vrasjen e Musait, thotë:

- "A doni ta vrisni një njeri vetëm pse thotë: "Zoti im është Allahu"..." - Kuptimi: Si është e mundur t'i lejojmë vetes vrasjen e një personi të tillë? Cili është krimi i tij? Vallë, konsiderohet krim vetëm sepse ai thotë: "Zoti im është Allahu?!" Kjo është thjesht një fjalë goje e thënë nga ai.

Musai (a.s.) kishte sjellë argumente dhe shenja të mrekullueshme, që dëshmonin për vërtetësinë e tij, prandaj besimtari tha:

- "...ndërkohë që ju ka sjellë argumente të qarta prej Zotit tuaj?" - Aq të qarta ishin bërë mrekullitë dhe shenjat që Musai solli, saqë ato diheshin dhe diskutoheshin nga të gjithë, të mëdhenj e të vegjël. Pra, - thoshte besimtari - mendohuni mirë në vendimin tuaj. Këto fakte nuk duhet t'ju lejojnë që ta vrisni. Nuk është kjo ajo që ai meriton. Fillimisht, arsyetoni qëndrimin tuaj mohues, e pas kësaj shikoni, a meriton vrasjen apo jo. Nëse arrini të vërtetoni saktësinë e qëndrimit tuaj dhe mohimin e ftesës së tij, ndoshta do të ishte e drejtë ta vrisnit. Ama, nëse argumentet e tij mbeten të pacenuara, ose qëndrojnë shumë më lartë se kaq, atëherë nuk mund të lejoni vrasjen e tij, sepse është tërësisht e padrejtë.

Pastaj ai u tha diçka shumë të mençur, që bind çdo njeri me logjikë. Ai bëri një supozim:

- "Nëse ai është gënjeshtar, dënimi për gënjeshtrën e vet do të godasë mbi të, por nëse është i drejtë, juve do t'ju godasë diçka nga ajo me të cilën ai ju kërcënon." – Pra, për Musain (a.s) ka dy mundësi: ose është mashtrues e gënjeshtar, ose është i sinqertë dhe i vërtetë në atë që thotë e pretendon. Nëse është mashtrues, atëherë mashtrimi rëndon mbi të dhe vetëm mbi të. Ju nuk dëmtoheni aspak nga mospranimi i një gënjeshtari. Por nëse ai është i vërtetë në atë që thotë, – madje ju ka sjellë edhe shenja e mrekulli nga Zoti, edhe ju ka paralajmëruar që, nëse nuk i bindeni e nuk e besoni, juve do t'ju godasë ndëshkimi nga Zoti, në dynja dhe në ahiret, – atëherë ju do

të goditeni realisht nga ky ndëshkim, qoftë edhe nga një pjesë e tij, siç është ndëshkimi në dynja.

Kjo tregon për mendjen e ndritur të këtij njeriu, që e përdor për të mbrojtur Musain. Ai e trajtoi situatën në një mënyrë që ata të mendoheshin dhe të kuptonin se zgjidhja ishte mes dy mundësive, të cilat e përjashtonin vrasjen si një veprim të zgjuar. Kështu, ai i bëri të mendonin dhe gjykonin se vrasja e Musait në të dyja rastet do të ishte e kotë dhe mendjelehtësi.

Më pas ky burrë i zgjuar dhe besimtar, – Allahu e mëshiroftë, e faltë dhe qoftë i kënaqur prej tij! – për sa i përket mbrojtjes që i bën Musait, kalon në një nivel tjetër më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë. Ai aludon se Musai (a.s), me cilësitë e mira dhe besnikërinë që ka, është më pranë të vërtetës. Ai tha:

- "Nuk ka dyshim se Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë atë që e tepron dhe është gënjeshtar." - Allahu nuk i udhëzon në rrugën e drejtë ata që kanë dy cilësi. Së pari, ata janë teprues, sepse tejkalojnë kufijtë e Zotit me braktisjen e të vërtetës dhe me përqafimin e të kotës. Së dyti, ata janë mashtrues, të cilët e reklamojnë shfrenimin e tyre si diçka të këshilluar nga Zoti. Të tillë njerëz Zoti nuk i udhëzon tek e vërteta dhe, aq më pak, t'i ndihmojë me shenja e mrekulli bindëse. Ai nuk u jep atyre sukses për të ndjekur dhe vërtetuar rrugën e saktë dhe të drejtë. Kjo është logjika më e thjeshtë dhe e pastër.

Tani, – u drejtohet besimtari atyre, – është radha juaj të mendoheni pak për realitetin. Ju i kuptoni mirë fjalët e Musait dhe jeni të bindur se ato janë të drejta dhe të vërteta. Zoti i dha atij argumente logjike dhe mrekulli të jashtëzakonshme, që provojnë vërtetësinë e tyre. Kësisoj, ai që ka patur një mbështetje të tillë të jashtëzakonshme nga Allahu nuk mund të jetë kurrë njeri i shfrenuar e mashtrues. Mendohuni me qetësi për këto që po ju them!

Ky qëndrim i besimtarit tregonte se ai ishte burrë i mençur dhe tepër i ditur rreth Zotit.

Pastaj ai kaloi në një kështillë të hapur drejtuar popullit të tij, duke i kërcënuar për ndëshkimin e rëndë dhe të frikshëm të ahiretit. Ai i këshilloi dhe paralajmëroi që të mos mashtroheshin dhe të vetëkënaqeshin nga pushteti e pasuria që u ishte dhënë në këtë dynja, e të shpërfillin ahiretin:

- "O populli im, sot juve keni sundimin në tokë, por kush do të na mbrojë nga dënimi i Allahut kur ai të godasë mbi ne?" – Kuptimi: Këtu, në këtë botë, ju është dhënë pushtet i dukshëm. Ju sundoni mbi popullin dhe zbatoni mbi ta ligjin që ju dëshironi. Zëreni se kjo do të jetë e vazhdueshme dhe e pacenueshme, - gjë që nuk ka për të ndodhur. Atëherë, a keni menduar: kush do të na mbrojë nga dënimi i Allahut, kur ai të godasë mbi ne?

Shihni me kujdes! Ai tha: "mbi ne". Ky moment tregon se sa stil të bukur dhe tërheqës kishte ftesa e tij. Ai e quajti veten si pjesë e tyre, që kujdesej për ta si për veten e vet, me dashuri e përkushtim, që dëshironte të mirën për ta, ashtu si e dëshironte për veten e vet.

Më pas, për ta ndaluar popullin që të pasonte Musain, Faraoni tha:

- "Unë po ju tregoj veçse atë që shoh dhe po ju udhëzoj veçse në rrugën e drejtë!" – Është e vërtetë që Faraoni e ftonte popullin e tij në rrugën që, në sytë e tij, ishte e drejtë.

Por çfarë ishte kjo rrugë, që ai e mendonte si të drejtë?! Faraoni e shpërfilli të drejtën e popullit për të zgjedhur rrugën e vërtetë, sepse i detyroi ata t'i nënshtroheshin sundimit të tij dhe të bënin ashtu siç dëshironte ai.

Në fakt, Faraoni nuk pretendoi se e vërteta ishte me të. Ai ishte i sigurt se e vërteta ishte me Musain, por e refuzoi atë me armiqësi dhe arrogancë. Ai gënjeu kur tha: "unë ju udhëzoj veçse në rrugën e drejtë". Ky qe tjetërsim i të vërtetës. Po ashtu, nëse do t'i urdhëronte njerëzit që t'i bindeshin atij pa marrë parasysh zgjedhjen e vet personale për ta mohuar Musain, çështja do të ishte më e lehtë. Por Faraoni i urdhëroi që ta pasonin, duke deklaruar se rruga e tij ishte e vërteta, ndërsa ajo e Musait ishte e kotë dhe rruga e së keqes.

Megjithatë, besimtari në oborrin e Faraonit, ashtu sikurse të gjithë ftuesit në rrugën e Zotit, nuk reshti kurrë së ftuari popullin e tij në besimin e drejtë. Atë nuk e ndali aspak as refuzimi arrogant i tyre:

- "Ndërkaq, ai që kishte besuar tha: "O populli im! Unë kam frikë se do t'ju godasë ndonjë dënim ashtu si popujt e mëparshëm..." - Kuptimi: Unë i frikësohem ndëshkimit, që goditi edhe popujt e shkuar, të cilët mblidheshin bashkë kundër profetëve të tyre, për t'i ndaluar dhe kundërshtuar ata.

Pastaj sqaroi më konkretisht se për cilët popuj fliste:

- "...si dënimi i popullit të Nuhut, të Adit, të Themudit dhe brezave pas tyre. Allahu nuk dëshiron padrejtësi ndaj robërve." - Të gjithë ata kishin një të përbashkët: mohimin e Zotit dhe refuzimin e profetëve dhe të shpalljeve të Tij. Po ashtu, edhe përfundimi i tyre ishte i njëjtë për të gjithë: ndëshkim që në jetën e dynjasë, para ahiretit. Në fakt, Allahu nuk u bën kurrë padrejtësi robërve dhe asnjëherë nuk e dëshiron diçka të tillë për ta. Ai kurrë nuk do t'i ndëshkonte ata, nëse nuk do të bënin ndonjë padrejtësi e gjynah.

Pasi i frikësoi dhe i paralajmëroi për ndëshkimin në dynja, ai vijoi t'i paralajmëronte edhe për ndëshkimin në ahiret:

- "O populli im! Unë kam frikë për ju Ditën e Britmës..." – Kjo është Dita e Kijametit, ditë kur banorët e Xhenetit do t'u thërrasin banorëve të Zjarrit e do të flasin me ta, sikurse thotë i Madhëruari: "Banorët e Xhenetit thërrasin banorët e Zjarrit e u thonë: "Ne e gjetëm të vërtetë atë që na kishte premtuar Zoti ynë. Po ju, a e gjetët të vërtetë atë që ju kishte premtuar Zoti juaj?" Ata thonë: "Po". Atëherë, mes tyre thërret një zë: "Mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët, të cilët penguan nga rruga e Allahut, që kërkuan shtrembërimin e saj dhe që ishin mohues të botës tjetër!" Mes dy grupeve është një mur ndarës, mbi të cilin qëndrojnë burra që e njohin secilin grup me shenjat e tyre. Ata thërrasin banorët e Xhenetit: "Selami qoftë mbi ju!". Ata nuk kanë hyrë në të, por shpresojnë. Kur shikimi i tyre shkon nga ata të Xhehenemit, thonë: "Zoti ynë, mos na bashko me të këqijtë!" Këta të murit thërrasin pastaj disa burra të tjerë, që i njohin nga shenjat e tyre, dhe u thonë: "Sa ju vleu ajo që grumbullonit dhe kryelartësia që tregonit? Këta (besimtarët) janë ata, për të cilët betoheshit se nuk ka për t'i përfshirë mëshira e Allahut". Vazhdoni (o

besimtarë) në Xhenet, se për ju as nuk ka më frikë e as brenga!"

Banorët e Zjarrit u thërrasin banorëve të Xhenetit: "Na jepni diçka prej ujit apo nga ajo me të cilën ju ka furnizuar Allahu!" Ata u përgjigjen: "Allahu i ka ndaluar që të dyja këto për jobesimtarët!" Këta janë ata që fenë e tyre e marrin si tallje e lojë dhe të cilët janë mashtruar nga jeta e dynjasë. Por Ne i harrojmë ata sot, sikurse ata harruan takimin e kësaj dite dhe për shkak të refuzimit të argumenteve Tona!" [Araf 44 – 51].

Banorët e Zjarrit do t'i luten Malikut, melekut të Xhehenemit, që ta lusë Zotin që t'i japë fund e t'i asgjësojë ata. Por përgjigjja do t'ju vijë e dhimbshme e dëshpëruese, sikurse thotë i Madhëruari: "Dhe ata thërrasin: "O Malik, le të na e marrë shpirtin Zoti yt!". Ai u thotë: "Ju do të jeni aty përgjithmonë!" Ne jua sollëm të vërtetën, por shumica juaj ishin urryes të së vërtetës." [Zuhruf 78, 79].


Ata i luten edhe Zotit që t'i nxjerrë nga Zjarri dhe t'i kthejë në dynja, por koha e pendimit dhe e reflektimit përfundon me jetën në dynja. I Lartësuari thotë: "Ata do të thonë: "O Zoti ynë, ne na mundën të këqijat, prandaj u bëmë njerëz të humbur! Zoti ynë, na nxirr prej këtu, e nëse gabojmë përsëri, atëherë vërtet jemi të padrejtë!" Ai u thotë: "Heshtni aty e mos më flisni! Vetëm pse disa prej robërve të Mi thanë: "O Zoti ynë, ne besojmë, prandaj na fal dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!", - ju i tallët ata, saqë ajo tallje ju bëri të harronit përkujtimin ndaj Meje, madje edhe qeshnit me ta. Edhe Unë sot i shpërblej ata, për shkak se u treguan të durueshëm. Ata janë fitimtarët." [Muminun 106 -111].

Atë ditë, idhujtarëve dhe mohuesve do t'u thuhet: "Thirrni zotat tuaj!" Ata i thërrasin, por ata nuk u përgjigjen dot. Kështu, ata do të shohin dënimin. Ah, sa do të dëshironin të kishin qenë në rrugën e drejtë! Atë ditë, Ai (Allahu) do t'u thërrasë atyre e do t'u thotë: "Çfarë përgjigje u keni dhënë të dërguarve të Mi?!" Atë ditë, atyre do t'u humbasin argumentet dhe ata nuk do të mund as të pyesin njëri-tjetrin. E për sa i përket atij që është penduar, që ka besuar dhe ka bërë vepra të mira, ai le të shpresojë, se është nga të shpëtuarit." [Kasas 64 – 67].

Kështu, besimtari (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i paralajmëroi ata për ndëshkimin e kësaj dite të frikshme e të vështirë, nëse ata nuk ndaleshin nga idhujtaria e mosbindja e tyre. Atë ditë, jobesimtarët nuk do të gjejnë asnjë rrugë për shpëtim:

- "...ditën kur, nga frika, do të sprapseni për të gjetur shpëtim, por nuk do të gjeni ndonjë që t'ju mbrojë prej Allahut." – Kuptimi: Kur të rrëmbeheni për t'u hedhur në zjarrin e Xhehenemit, do të përpiqeni të ktheheni pas e të vraponi për të shpëtuar, por atë ditë askush nuk mund t'ju shpëtojë prej ndëshkimit të Allahut. Askush, veç Zotit, nuk mund t'ju shpëtojë e t'ju ndihmojë nga ndëshkimi, sikurse thuhet në një tjetër ajet: "S'ka dyshim se Ai është i Plotfuqishëm për ta rikthyer atë në jetë ditën kur do të gjurmohen të fshehtat dhe kur ai nuk do të ketë as forcë as ndihmës." [Tarik 8 - 10].

- "Atë që Allahu e lë në humbje, për të nuk do të gjesh udhëzues." - Nuk do të gjesh udhëzues, sepse udhëzimi është në dorën e Allahut të Lartësuar. Nëse Allahu i Madhëruar, me diturinë dhe urtësinë e Tij, e lë jashtë udhëzimit, për shkak se ai nuk e


الجزء الرابع والعشرون سورة غافر

وَلَقَدْ جَآءَكُمْ يُوسُفُ مِن قَبْلُ بِٱلْبَيِّنَٰتِ فَمَا زِلْتُمْ فِى
شَكٍّ مِّمَّا جَآءَكُم بِهِۦ ۖ حَتَّىٰٓ إِذَا هَلَكَ قُلْتُمْ لَن يَبْعَثَ ٱللَّهُ
مِنۢ بَعْدِهِۦ رَسُولًا ۚ كَذَٰلِكَ يُضِلُّ ٱللَّهُ مَنْ هُوَ مُسْرِفٌ
مُّرْتَابٌ ﴿٣٤﴾ ٱلَّذِينَ يُجَٰدِلُونَ فِىٓ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ بِغَيْرِ سُلْطَٰنٍ
أَتَىٰهُمْ ۖ كَبُرَ مَقْتًا عِندَ ٱللَّهِ وَعِندَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا ۚ كَذَٰلِكَ
يَطْبَعُ ٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ قَلْبِ مُتَكَبِّرٍ جَبَّارٍ ﴿٣٥﴾ وَقَالَ فِرْعَوْنُ
يَٰهَٰمَٰنُ ٱبْنِ لِى صَرْحًا لَّعَلِّىٓ أَبْلُغُ ٱلْأَسْبَٰبَ ﴿٣٦﴾ أَسْبَٰبَ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ فَأَطَّلِعَ إِلَىٰٓ إِلَٰهِ مُوسَىٰ وَإِنِّى لَأَظُنُّهُۥ كَٰذِبًا ۚ
وَكَذَٰلِكَ زُيِّنَ لِفِرْعَوْنَ سُوٓءُ عَمَلِهِۦ وَصُدَّ عَنِ ٱلسَّبِيلِ ۚ
وَمَا كَيْدُ فِرْعَوْنَ إِلَّا فِى تَبَابٍ ﴿٣٧﴾ وَقَالَ ٱلَّذِىٓ ءَامَنَ
يَٰقَوْمِ ٱتَّبِعُونِ أَهْدِكُمْ سَبِيلَ ٱلرَّشَادِ ﴿٣٨﴾ يَٰقَوْمِ
إِنَّمَا هَٰذِهِ ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَا مَتَٰعٌ وَإِنَّ ٱلْءَاخِرَةَ هِىَ
دَارُ ٱلْقَرَارِ ﴿٣٩﴾ مَنْ عَمِلَ سَيِّئَةً فَلَا يُجْزَىٰٓ إِلَّا مِثْلَهَا ۖ
وَمَنْ عَمِلَ صَٰلِحًا مِّن ذَكَرٍ أَوْ أُنثَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَأُو۟لَٰٓئِكَ
يَدْخُلُونَ ٱلْجَنَّةَ يُرْزَقُونَ فِيهَا بِغَيْرِ حِسَابٍ ﴿٤٠﴾

٤٧١

meriton udhëzimin nga ligësia që fsheh në shpirtin e tij, atë nuk mund ta udhëzojë askush.

Ajeti 34

34. Edhe më parë ju erdhi Jusufi me argumente të qarta, por ju vazhduat të kishit dyshime ndaj mesazhit që ju solli ai. Ndërsa kur ai vdiq, ju thatë: "Allahu kurrë nuk do të dërgojë më pejgamber pas tij!" Kështu, Allahu e lë në humbje këdo që e tepron dhe ka dyshime.

Shpjegimi i ajetit

- "Edhe më parë ju erdhi Jusufi me argumente të qarta, por ju vazhduat të kishit dyshime ndaj mesazhit që ju solli ai." - Kuptimi: Para ardhjes së Musait (a.s), juve ju erdhi Jusufi, biri i Jakubit (a.s.), me argumente e shenja të qarta, që tregonin vërtetësinë e besnikërinë e tij si profet i Zotit. Ai ju urdhëroi për adhurimin e Zotit si Një të vetëm dhe të pashoq. Por ju, gjatë kohës kur Jusufi ishte gjallë, kishit dyshime rreth mesazhit të tij, ndërsa kur ai vdiq, dyshimi dhe mosbesimi juaj u shtuan edhe më shumë, e ju u zhytët më thellë në idhujtarinë tuaj.

- "Ndërsa kur ai vdiq, ju thatë: "Allahu kurrë nuk do të dërgojë më pejgamber pas tij!"" - Ky ishte mendimi juaj i gabuar, i cili ishte njëkohësisht fyerje dhe shpifje ndaj madhështisë së Zotit të Plotpushtetshëm. Kjo është një shpifje e shëmtuar, sepse Allahu i Urtë dhe i Pastër nga çdo e metë, nuk do t'i linte kurrë robërit të çoroditur dhe të shpërfillur, pa u vendosur urdhra, ndalesa e kufij, që t'u përmbaheshin. Ai nuk do t'i linte pa u dërguar profetë, që do t'u tregonin krijesave rrugën ku duhet të ecnin dhe mënyrën si duhet të jetonin. Pretendimi se Zoti nuk ka dërguar profetë është i gabuar, i padrejtë dhe një devijim total nga e vërteta.

- "Kështu, Allahu e lë në humbje këdo që e tepron dhe ka dyshime." - Ky është përshkrimi real i tyre. Cilësia që ata padrejtësisht i mvishnin Musait ishte në të vërtetë cilësi dalluese e tyre. Ishin pikërisht ata tejkalues të kufirit, mashtrues dhe refuzues të së vërtetës. Ishin ata që i shkelnin kufijtë e Zotit, duke braktisur të vërtetën dhe trumbetuar të kotën. Pikërisht ata shpifën ndaj Allahut dhe mohuan profetët e Tij.

Kësisoj, ata që kanë si cilësi të tyre teprimin dhe gënjeshtrën nuk udhëzohen nga Allahu i Madhëruar, sepse këta lloj njerëzish e refuzojnë të vërtetën edhe pasi

ajo iu bëhet e qartë. Ndëshkimi i merituar i këtyre është që Allahu të mos i udhëzojë, por t'i privojë nga rruga e drejtë. Në një ajet tjetër, i Madhëruari thotë: "Ne ua devijojmë zemrat dhe vështrimet e tyre, ashtu sikurse ata nuk e besojnë atë (Kuranin) për herë të parë, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre, që të tejkalojnë kufijtë. Edhe sikur t'u dërgonim atyre engjëj, edhe sikur t'i bënim të vdekurit t'u flisnin atyre apo t'i grumbullonim të gjitha gjërat para tyre, ata përsëri nuk do të besonin, nëse Allahu nuk do të donte; por shumica e tyre janë të paditur." [En'am, 110- 111]. Ose: "...kur ata shmangen *(nga e vërteta)*, Allahu ua devijon zemrat. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që i kalon kufijtë". [Saf, ajeti 5]. Ndërsa në suren Bekare, ajeti 258, thotë: "...Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit zullumqarë."

Pastaj Allahu i Madhëruar përmend disa cilësi të këtyre gënjeshtarëve, që tejkalojnë kufijtë e Zotit.

Ajetet 35 – 37

35. Ata që polemizojnë rreth argumenteve të Allahut duke mos pasur asnjë fakt, ata janë shumë të urryer për Allahun dhe për besimtarët. Kështu e vulos Allahu çdo zemër arroganti e tirani.
36. Faraoni tha: "O Haman, më ndërto një kullë, ndoshta do t'i arrij rrugët,
37. rrugët e qiejve, e të shoh Zotin e Musait, sepse unë mendoj se ai është gënjeshtar". Kështu, Faraonit iu duk e mirë vepra e tij e keqe dhe u shmang prej rrugës së drejtë. Sigurisht që kurthet e Faraonit përfunduan të dështuara.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ata që polemizojnë rreth argumenteve të Allahut duke mos pasur asnjë fakt..."** - Argumentet e Zotit ndajnë të vërtetën nga e kota. Ato janë të qarta si drita e diellit. Megjithatë, ata e refuzojnë të vërtetën dhe polemizojnë kundër saj, thjesht dhe vetëm për ta hedhur poshtë atë. Ata veprojnë kështu, edhe pse nuk kanë asnjë argument e asnjë fakt mbështetës për mendimin që mbrojnë. Kjo është cilësi e përhershme e të gjithë atyre që polemizojnë kundër fesë së Zotit. Ata asnjëherë nuk kanë fakte apo argumente ku të mbështeten, sepse të vërtetën nuk mund ta kundërshtojë asgjë.

- **"...ata janë shumë të urryer për Allahun dhe për besimtarët."** - Hedhja poshtë e të vërtetës nëpërmjet të kotës është shumë e urryer për Allahun dhe për besimtarët. Urrejtja e Allahut për këta lloj njerëzish është shumë e madhe, sepse ata kanë kryer tre krime, njëri më i shëmtuar se tjetri: kanë refuzuar të vërtetën, kanë trumbetuar të kotën dhe kanë pretenduar se ajo është e vërteta e Zotit, duke shpifur kështu ndaj Zotit. Çdokush që ka të tilla cilësi është i urryer te Zoti. Sigurisht, edhe besimtarët, që janë të zgjedhurit e Zotit të Lartësuar, i urrejnë të tillë njerëz, ashtu sikurse Zoti i tyre. Urrejtja për kriminelët dëshmon për ligësinë e madhe të veprave që ata kryejnë.

- **"Kështu e vulos Allahu çdo zemër arroganti e tirani."** - Ashtu sikurse ua vulosi zemrat Faraonit dhe palës së tij, ashtu ua vulos zemrat Allahu çdo mohuesi mendjemadh e të padrejtë.

Këtu përmenden dy cilësi të qafirëve që u vulosen zemrat: së pari, ata janë mendjemëdhenj, që nuk pyesin për të vërtetën, por e mohojnë atë dhe, së dyti, janë

të padrejtë ndaj të tjerëve, duke i përçmuar dhe duke u bërë padrejtësi atyre.

Duke kundërshtuar Musain dhe duke e refuzuar ftesën e tij për të pranuar Zotin e botëve, i cili qëndron mbi Arsh dhe sundon mbi të gjitha krijesat e Tij, Faraoni i drejtohet Hamanit dhe i thotë:

- "O Haman, më ndërto një kullë, ndoshta do t'i arrij rrugët, rrugët e qiejve, e të shoh Zotin e Musait, sepse unë mendoj se ai është gënjeshtar." – Kuptimi: Më ndërto një kullë të madhe dhe të lartë, se "ndoshta" do të shoh Zotin e Musait. Por – thotë Faraoni, – unë mendoj se ai mashtron kur pretendon se ne kemi një Zot dhe se Ai është lart, sipër qiejve. Pra, a thua se Faraoni donte të sigurohej dhe ta verifikonte vetë saktësinë e fjalëve të Musait! Por Allahu i Madhëruar na tregon se cili qe shkaku që Faraoni veproi ashtu:

- "Kështu, Faraonit iu duk e mirë vepra e tij e keqe dhe u shmang prej rrugës së drejtë." – Siç shihet, ai i tha ato fjalë e ndërmori ato veprime, sepse ato iu zbukuruan në veten e tij. Shejtani ua zbukuron të keqen të tillë njerëzve dhe i nxit ta veprojnë atë, derisa ajo iu zbukurohet në veten e tyre, madje ata fillojnë ta mbështesin atë, a thua se po mbrojnë të vërtetën, edhe pse ajo është vetë shkatërrimi. Kështu, ata pengohen nga e vërteta dhe rruga e drejtë.

- "Sigurisht që kurthet e Faraonit përfunduan të dështuara." - Plani i Faraonit ishte që të godiste dhe të rrëzonte të vërtetën. Ai donte t'i bënte njerëzit të besonin se ajo ishte diçka e kotë dhe që Musai ishte një mashtrues, që trumbetonte diçka të pavërtetë. Por ky kurth i ulët i tij, ashtu sikurse tha Zoti, ishte i destinuar të shkatërrohej. Ai do të shërbente veçse si shkaktar i ndëshkimit të vetë atij në dynja dhe në ahiret.

Ajetet 38 – 40

38. Ai që kishte besuar tha: "O populli im, më pasoni mua, që t'ju udhëzoj në rrugën e drejtë!
39. O populli im, jeta e kësaj bote është veçse një përjetim i shkurtër, ndërsa jeta tjetër është e pasosur.
40. Kush bën ndonjë vepër të keqe, do të ndëshkohet vetëm për aq sa meriton, e kush bën ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull a femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet, ku do të shpërblehet pa masë.

Shpjegimi i ajeteve

Duke e përsëritur paralajmërimin e tij drejtuar popullit të vet, besimtari i familjes së Faraonit tha:

- "O populli im, më pasoni mua, që t'ju udhëzoj në rrugën e drejtë!" - Kuptimi: Unë ju ftoj në rrugën e drejtë të Zotit, jo në rrugën e humbjes, mashtrimit dhe të shkatërrimit, sikurse ju thërret Faraoni e pala e tij.

- "O populli im, jeta e kësaj bote është veçse një përjetim i shkurtër..." – Kjo dynja është veçse një përjetim i shkurtër dhe kalimtar. Njeriu argëtohet e kënaqet në të përkohësisht, por shumë shpejt asaj i vjen fundi dhe çdo gjë zhduket e harrohet, sikur të mos kish qenë kurrë. Atëherë, mos u mashtroni nga kjo jetë e shkurtër dhe të braktisni e shpërfillni qëllimin për hir të të cilit u krijuat, pra, adhurimin e Zotit Bujar e të Gjithëmëshirshëm. Gjithmonë kujtoni që:


- **"...jeta tjetër është e pasosur."** – Në ahiret do të përfundojnë të gjithë, prandaj atij duhet t'i jepni përparësi dhe rëndësi. Për atë jetë të pafundme duhet të përpiqeni e të punoni sinqerisht dhe me këmbëngulje. Vetëm kështu do të arrini lumturinë dhe kënaqësinë e përjetshme.

- "Kush bën ndonjë vepër të keqe, do të ndëshkohet vetëm për aq sa meriton..." - Çdokush që bën një vepër të keqe, që kryen një haram, që nuk bindet apo që bën idhujtari, shkelje kufijsh me harame, do të shpërblehet fiks sipas asaj që ka bërë, me ndëshkimin që meriton, sepse puna e keqe sjell ndëshkim për vepruesin e saj.

- "...e kush bën ndonjë vepër të mirë, qoftë mashkull a femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet, ku do të shpërblehet pa masë." - Ndërsa çdokush që kryen vepra të mira, qofshin ato të gjymtyrëve, të zemrës apo fjalë goje, atij do t'i jepet shpërblim pa masë. Allahu i Madhëruar do t'i japë këtij njeriu shumë më tepër nga ç'mendon dhe pret, më shumë nga ç'meriton me punët e tij.

Ajetet 41 – 46

41. O populli im! Ç'është kështu, unë ju thërras në shpëtim, ndërsa ju më thërrisni për në Zjarr?
42. Ju më thërrisni që të mohoj Allahun dhe të adhuroj veç Tij zota të tjerë, për të cilët nuk kam dituri, ndërsa unë ju ftoj të adhurojmë të Gjithëfuqishmin, Mëkatfalësin!
43. Është e vërtetë se ata zota, tek të cilët ju më ftoni, nuk meritojnë t'u lutesh as në dynja e as në botën tjetër. Kthimi ynë është tek Allahu. Nuk ka dyshim se ata që e


الجزء الرابع والعشرون سورة غافر الحزب ٤٨
وَيَٰقَوْمِ مَا لِيٓ أَدْعُوكُمْ إِلَى ٱلنَّجَوٰةِ وَتَدْعُونَنِيٓ إِلَى ٱلنَّارِ ﴿٤١﴾
تَدْعُونَنِي لِأَكْفُرَ بِٱللَّهِ وَأُشْرِكَ بِهِۦ مَا لَيْسَ لِي بِهِۦ عِلْمٌ وَأَنَا۠ أَدْعُوكُمْ إِلَى ٱلْعَزِيزِ ٱلْغَفَّٰرِ ﴿٤٢﴾
لَا جَرَمَ أَنَّمَا تَدْعُونَنِيٓ إِلَيْهِ لَيْسَ لَهُۥ دَعْوَةٌ فِي ٱلدُّنْيَا وَلَا فِي ٱلْءَاخِرَةِ
وَأَنَّ مَرَدَّنَآ إِلَى ٱللَّهِ وَأَنَّ ٱلْمُسْرِفِينَ هُمْ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ ﴿٤٣﴾
فَسَتَذْكُرُونَ مَآ أَقُولُ لَكُمْ ۚ وَأُفَوِّضُ أَمْرِيٓ إِلَى ٱللَّهِ ۚ
إِنَّ ٱللَّهَ بَصِيرٌۢ بِٱلْعِبَادِ ﴿٤٤﴾ فَوَقَىٰهُ ٱللَّهُ سَيِّـَٔاتِ مَا مَكَرُوا۟
وَحَاقَ بِـَٔالِ فِرْعَوْنَ سُوٓءُ ٱلْعَذَابِ ﴿٤٥﴾ ٱلنَّارُ يُعْرَضُونَ
عَلَيْهَا غُدُوًّا وَعَشِيًّا ۚ وَيَوْمَ تَقُومُ ٱلسَّاعَةُ أَدْخِلُوٓا۟ ءَالَ
فِرْعَوْنَ أَشَدَّ ٱلْعَذَابِ ﴿٤٦﴾ وَإِذْ يَتَحَآجُّونَ فِي ٱلنَّارِ
فَيَقُولُ ٱلضُّعَفَٰٓؤُا۟ لِلَّذِينَ ٱسْتَكْبَرُوٓا۟ إِنَّا كُنَّا لَكُمْ
تَبَعًا فَهَلْ أَنتُم مُّغْنُونَ عَنَّا نَصِيبًا مِّنَ ٱلنَّارِ ﴿٤٧﴾ قَالَ
ٱلَّذِينَ ٱسْتَكْبَرُوٓا۟ إِنَّا كُلٌّ فِيهَآ إِنَّ ٱللَّهَ قَدْ حَكَمَ
بَيْنَ ٱلْعِبَادِ ﴿٤٨﴾ وَقَالَ ٱلَّذِينَ فِي ٱلنَّارِ لِخَزَنَةِ جَهَنَّمَ
ٱدْعُوا۟ رَبَّكُمْ يُخَفِّفْ عَنَّا يَوْمًا مِّنَ ٱلْعَذَابِ ﴿٤٩﴾
٤٧٢

teprojnë me të këqija do të jenë banorë të Zjarrit.
44. Ju do t'i kujtoni shumë shpejt këto që po ju them! Unë çështjen time ia besoj Allahut, se Allahu i sheh robërit e Vet!"
45. Dhe Allahu e ruajti atë prej të këqijave e kurtheve që i kurdisën, ndërsa ithtarët e Faraonit i përfshiu dënimi më i rëndë.
46. Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje, ndërsa kur të arrijë Ora, do të thuhet: "Futini pasuesit e Faraonit në dënimin më të rëndë!"

Shpjegim i ajeteve

- "O populli im! Ç'është kështu, unë ju thërras në shpëtim, ndërsa ju më thërrisni për në Zjarr?" – Kuptimi: O populli im, çfarë bëni kështu? Unë ju ftoj në rrugën e drejtë, kurse ju më ftoni në Zjarr, duke më

kërkuar të mos ndjek profetin e Allahut, Musain (a.s.). Më pas, ai tha:

- "Ju më thërrisni që të mohoj Allahun dhe të adhuroj veç Tij zota të tjerë, për të cilët nuk kam dituri, ndërsa unë ju ftoj të adhurojmë të Gjithëfuqishmin, Mëkatfalësin." - Kuptimi: Ju më ftoni të adhuroj dikë tjetër si Zot, ndërkohë që ju nuk keni asnjë fakt për këtë pretendim. Ju trilloni të pavërteta rreth Zotit. Ju flisni rreth Tij pa pasur dituri, dhe ky është një nga gjynahet më të mëdha. Ndërsa unë ju ftoj që të adhurojmë vetëm Allahun, Krenarin e Plotfuqishëm, Falësin e madh të gjynaheve. Ju ftoj t'i përkushtoheni Krenarit, të Cilit i takon e gjithë fuqia dhe pushteti, ndërsa të tjerët nuk kanë asgjë në dorë. Unë ju ftoj të ktheheni të penduar tek Ai, që është *El Gaffar* - Falësi i madh. Kthehuni tek Allahu, i Cili, me gjithë pushtetin e Tij për gjithçka, i mëshiron dhe afatizon robërit e Tij, të cilët e ngarkojnë veten e tyre me gjynahe dhe vepra që e zemërojnë Atë. Nëse ata pendohen dhe i kthehen të nënshtruar, Ai ua fal dhe mbulon gjynahet dhe veprat e këqija. Me faljen e këtyre gjynaheve, Ai i shpëton ata nga ndëshkimet e dynjasë dhe të ahiretit.

- "Është e vërtetë se ata zota, tek të cilët ju më ftoni, nuk meritojnë t'u lutesh as në dynja e as në botën tjetër." - Nuk ka asnjë dyshim se ata të cilët ju më ftoni t'i adhuroj nuk meritojnë t'u lutesh dhe t'u përgjërohesh, as në dynja e as në ahiret, sepse ata janë të pafuqishëm, të papushtetshëm, të mangët e nevojtarë për vete. Ata nuk mund të bëjnë dobi e as dëm, nuk mund të falin jetë e as ta marrin atë. Ata nuk kanë pushtet të ringjallin krijesat dhe të marrin në llogari, ashtu si bën Zoti i Madhëruesëm.

- "Kthimi ynë është tek Allahu." - Të gjithë do të kthehen tek Allahu, i Cili, me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij, do t'i shpërblejë për veprat që kanë bërë.

- "Nuk ka dyshim se ata që e teprojnë me të këqija do të jenë banorë të Zjarrit." - Banorë të Zjarrit do të jenë vetëm ata që i kalojnë kufijtë e vendosur nga Zoti, duke mos iu bindur dhe duke e refuzuar adhurimin e Tij.

Pasi i këshilloi, qortoi dhe paralajmëroi dhe ata nuk iu bindën, ai iu tha:

- "Ju do t'i kujtoni shumë shpejt këto që po ju them!" - Këto këshilla do t'i kuptoni dhe kujtoni kur të shihni përfundimin e hidhur të refuzimit të saj, kur të befasoheni me ndëshkimin dhe të privoheni nga shpërblimi i madh dhe i mrekullueshëm.

- "Unë çështjen time ia besoj Allahut..." - Vetëm tek Ai kërkoj mbrojtje e strehim dhe vetëm Atij ia parashtroj të gjitha çështjet e mia. Vetëm Allahut i mbështetem për arritjen e çdo të mire dhe për shpëtimin nga çdo e keqe që i druhem. Tek Ai kërkoj mbrojtje që të më ruajë nga sherri juaj e i çdo gjëje tjetër.

- "...se Allahu i sheh robërit e Vet!" - Kuptimi: Allahu i sheh ata dhe e di imtësisht gjendjen e tyre dhe atë që ata meritojnë. Ai e di mirë, gjithashtu, edhe gjendjen time dhe dobësinë dhe Ai do të më mbrojë prej jush. Është Ai që do të më ruajë nga ligësia juaj. Ju as që mund të veproni jashtë vullnetit të Tij. Nëse ju jep pushtet mbi mua, atëherë këtë e

bën me urtësinë e Tij të madhe, dhe ashtu le të ndodhë, sepse kjo është dëshira dhe vullneti i Tij.


- "Dhe Allahu e ruajti atë prej të këqijave e kurtheve që i kurdisën..." - Allahu i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëmëshirshëm e ruajti dhe shpëtoi atë besimtar të mirë e të udhëzuar. Allahu e shpëtoi nga kurthet që Faraoni dhe pala e tij kishin përgatitur për të. Ata donin ta ndëshkonin dhe ekzekutonin, për shkak se ai i ftonte në rrugën që ata e urrenin. Besimtari ua shfaqi haptazi mbështetjen e tij për Musain (a.s), dhe i ftoi pikërisht në rrugën ku thërriste edhe Musai (a.s.). Kjo, sigurisht, ishte diçka që ata nuk mund ta toleronin dot, sepse ata ishin të pushtetshmit. Zemërimi kundër tij ishte ndezur flakë. Ata u përpoqën që ta ndëshkonin, por Allahu i Madhëruar e ruajti nga kurthet e tyre, madje ua ktheu ato kundra vetes së tyre. I Madhëruari thotë:

- "...ndërsa ithtarët e Faraonit i përfshiu dënimi më i rëndë." - Allahu i Madhëruar i fundosi dhe i mbyti të gjithë në ujë, në një mëngjes të vetëm. Ky ishte ndëshkimi i tyre në jetën e dynjasë.

Ndërsa për ndëshkimin e tyre në *berzah*, pra, në jetën e varrit, i Madhëruari thotë:

- "Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje, ndërsa kur të arrijë Ora, do të thuhet: "Futini pasuesit e Faraonit në dënimin më të rëndë!"" - Të tilla janë ndëshkimet poshtëruese që godasin mohuesit e profetëve të Zotit, kundërshtarët dhe armiqtë e rrugës së Tij.

Ajetet 47 – 50



47. Kur të grinden mes njëri-tjetrit në Zjarr, të dobëtit do t'u thonë parisë që mbahej me të madh: "Ne kemi qenë ithtarët tuaj, ndaj a mund të na e lehtësoni disi dënimin e Zjarrit?"

48. Ata që krekoseshin do të thonë: "Ne jemi të gjithë këtu! Tashmë, Allahu e ka përfunduar gjykimin mes robërve".

49. Ata që gjenden në Zjarr do t'u thonë rojtarëve të Xhehenemit: "Luteni Zotin tuaj të na e lehtësojë, qoftë edhe një ditë, dënimin!"

50. Ata do t'u thonë: "A nuk ju erdhën të dërguarit tuaj me argumente të qarta?" Ata përgjigjen: "Po!". – "Atëherë – do u thonë - lutuni vetë tani!" Por lutjet e jobesimtarëve do të jenë të kota!

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Madhëruar na tregon rreth grindjes mes banorëve të Zjarrit dhe qortimeve që ata i drejtojnë njëri-tjetrit. Ai na tregon, gjithashtu, për lutjet dhe përgjërimet që ata i drejtojnë rojes së Xhehenemit dhe pavlefshmërinë e këtyre lutjeve.

- "Kur të grinden mes njëri-tjetrit në Zjarr..." - Pasuesit do justifikohen me pretendimin se shkaktarë të devijimit ishin udhëheqësit e tyre. Por udhëheqësit do të distancohen nga pasuesit e tyre:

- "...të dobëtit do t'u thonë parisë që mbahej me të madh: "Ne kemi qenë ithtarët tuaj, ndaj a mund të na e lehtësoni disi dënimin e Zjarrit?"" – Shtresat e dobëta të pasuesve do t'u drejtohen udhëheqësve të tyre, të cilët Zoti i përshkruan si mendjemë-dhenj, sepse u treguan kryeneçë ndaj të vërtetës së Tij. Ata u kujtojnë se ishin pasues të rrugës ku i ftuan, duke iu thënë: Ne ju ndoqëm dhe ju mbështetëm në kryelartësinë dhe arrogancën tuaj. Ju na mashtruat, na devijuat nga e mira dhe na i zbukuruat idhujtarinë e çdo ligësi tjetër. Atëherë, duke qenë se ne ju jemi bindur juve dhe kërkesave tuaja, a mund të na ndihmoni e të na e lehtësoni ndëshkimin në Zjarr, qoftë edhe pak?

- "Ata që krekoseshin do të thonë: "Ne jemi të gjithë këtu!"" - Këta të mjerë, duke treguar pamundësinë e pafuqinë e tyre për të ndihmuar qoftë edhe veten e vet, shprehen se i gjithë pushteti i takon Allahut. Gjykimi i Tij është suprem dhe ekzekutohet mbi të gjithë, pa përjashtim.

- "Tashmë, Allahu e ka përfunduar gjykimin mes robërve" - Për çdo të dënuar, i Drejti ka përcaktuar ndëshkimin e merituar, pa ia shtuar apo pakësuar atë. Askush dhe asgjë nuk mund ta ndryshojë gjykimin e Allahut të Urtë e të Drejtë.

- "Ata që gjenden në Zjarr do t'u thonë rojtarëve të Xhehenemit: "Luteni Zotin tuaj të na e lehtësojë, qoftë edhe një ditë, dënimin!"" - Banorët e Zjarrit, qofshin ata ish-pasues të dobët apo ish-krerë kryeneçë e arrogantë, do iu drejtohen rojeve të Xhehenemit e do t'u kërkojnë që ata ta lusin Zotin për t'ua lehtësuar ndëshkimin atyre, me qëllim që të gjejnë sadopak çlodhje e qetësi.

Por përgjigjja që u vjen prej tyre është shumë poshtëruese dhe ua shuan çdo shpresë. Ajo përgjigje i bën të kujtojnë se tashmë nuk vlen asnjë lloj ndërmjetësimi.

- "Ata do t'u thonë: "A nuk ju erdhën të dërguarit tuaj me argumente të qarta?"" - A nuk erdhën te ju profetët e Zotit me argumente të qarta, nëpërmjet të cilëve mund të dallohej qartë e vërteta nga e kota, fjalët e veprat që të afrojnë pranë Zotit nga ato që të largojnë prej Tij?

- "Ata përgjigjen: "Po!"." – Kuptimi: Pa dyshim që ata sollën argumente shumë të qarta dhe ne nuk kemi asnjë justifikim para Allahut. Argumentet e Allahut nuk mund të kundërshtoheshin, por ne u treguam të padrejtë, duke i refuzuar ato.

"Atëherë – do u thonë - lutuni vetë tani!" - Rojet e Xhehenemit, duke u distancuar nga banorët e Zjarrit dhe duke u shprehur atyre refuzimin për t'u bërë ndërmjetësues për

zullumqarët, u thonë: "Lutuni vetë për ndihmë e shpëtim!"

Por a do t'ju sjellë kjo ndonjë dobi? Thotë Allahu i Madhëruar, i Drejtë e i Urtë:

- **"Por lutjet e jobesimtarëve do të jenë të kota!"** – Pra, lutja e tyre është e kotë, e pavlefshme dhe e padobishme. Ajo është sikur të mos ekzistonte fare, sepse mohimi i Zotit i asgjëson dhe fshin të gjitha veprat e robit dhe është pengesë e pakapërcyeshme për pranimin e lutjeve.

Ajetet 51 – 52

51. Ne patjetër që do t'i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe ata që besuan, në jetën e kësaj bote dhe në ditën kur të paraqiten dëshmitë.
52. Atë ditë, zullumqarëve nuk do t'u bëjnë dobi shfajësimet. Ata i pret mallkimi dhe një vendbanim i keq.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne patjetër që do t'i ndihmojmë të dërguarit Tanë dhe ata që besuan, në jetën e kësaj bote dhe në ditën kur të paraqiten dëshmitë."** - Pasi përmendi gjendjen e trishtueshme të Faraonit e pasuesve të tij në dynja, në *berzah* dhe në Ditën e Kijametit, Allahu i Madhëruar përshkruan gjendjen e mjerueshme dhe të tmerrshme të banorëve të Zjarrit, të cilët refuzuan t'i pranojnë, besojnë dhe të pasojnë profetët e Zotit. Ata i luftuan profetët, pasuesit e tyre dhe mesazhin që ata përcollën prej Allahut.

Allahu i Madhëruar thotë se do t'i ndihmojë profetët dhe besimtarët në përballjen me mohuesit, duke i pajisur me argumente e shenja të qarta, si edhe me fitore të sigurt. Ndërsa Ditën e Gjykimit, i Plotpushtetshmi dhe i Drejti do të gjykojë me drejtësi, duke u dhënë profetëve dhe besimtarëve shpërblime të mëdha dhe duke i ndëshkuar mohuesit dhe luftuesit e të vërtetës me formën dhe masën më të rëndë.

- **"Atë ditë, zullumqarëve nuk do t'u bëjnë dobi shfajësimet. Ata i pret mallkimi dhe një vendbanim i keq."** - Kur zullumqarët të justifikohen dhe të kërkojnë shpëtim, atyre nuk do t'u pranohet asgjë. Ata do t'i përfshijë mallkimi, dëshpërimi dhe dhimbja e madhe, kur të hidhen në vendin e ndëshkimit. Ai vend trishton dhe dëshpëron përjetësisht ata që do banojnë në të.

Ajetet 53 – 55

53. Ne i dhamë Musait udhëzimin, ndërsa bijve të Israilit u lamë në trashëgim Librin,
54. si udhërrëfyes e përkujtues për mendarët.
55. Ti bëj durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë. Kërko falje për gjynahet e tua dhe lartësoje me lavde Zotin tënd, mbrëmje e mëngjes!

Shpjegimi i ajeteve

Në ajetet e mësipërme, i Madhëruari tregoi se çfarë ndodhi me Faraonin dhe ushtrinë e Tij dhe se ku i çoi kundërshtimi e arroganca e tyre. Më pas, Ai përmendi gjykimin gjithëpërfshirës për ta dhe për të gjithë banorët e Zjarrit. Pas të gjitha këtyre, i Lartësuari tregon për mirësitë e mëdha që u dhuroi Musait dhe besimtarëve që pasuan rrugën e tij. Ai thotë:

- **"Ne i dhamë Musait udhëzimin, ndërsa bijve të Israilit u lamë në trashëgim Librin, si udhërrëfyes e përkujtues për mendarët."**

– "*El Huda*" ose "udhëzimi" quhet dituria dhe argumentet e qarta, nëpërmjet të cilave gjejnë udhën e drejtë ata që e kërkojnë dhe e synojnë atë. Ndërsa Shpalljen e dhuruar Musait, Allahu i Madhëruar ua la në trashëgim ithtarëve të Librit. Ata duhet ta përcillnin këtë trashëgimi brez pa brezi, me besnikëri. Kjo shpallje ishte Teurati, në të cilin ishte udhëzimi, dituria rreth ligjeve të fesë dhe çdo lloj diturie e nevojshme. Në të tregohej mirësia, si dhe rrugët për arritjen e saj. Teurati ishte për besimtarët nxitje për të arritur të mirën dhe paralajmërim që të ruheshin nga e keqja. Ky libër ishte udhëzim dhe ndriçues veçse për ata që Allahu i Madhëruar i quan "*ulul elbab*" – mendarët, të mençurit, të urtët, të diturit.

- "Ti bëj durim, se premtimi i Allahut është i vërtetë." - Allahu i Madhëruar e porosit Profetin e Tij që të bënte durim dhe të ishte i qëndrueshëm në misionin e tij, ashtu sikurse duruan profetët më të zgjedhur. Të bënte durim, sepse premtimi i Zotit është i vërtetë e i padiskutueshëm. Ai nuk është mashtrim apo trillim. Për këtë arsye, vërtetësia e tij duhej t'ia lehtësonte durimin dhe qëndrueshmërinë në detyrën e ngarkuar nga Zoti. Shpallja e Zotit është vetë e vërteta dhe udhëzimi i kulluar. Për hir të Shpalljes duruan dhe qëndruan durimtarët, dhe pas saj u kapën fort të urtit e të mençurit.

Thënia: "premtimi i Allahut është i vërtetë" duhet të jetë nxitje për durim dhe qëndrueshmëri në bindjen ndaj Zotit, në largimin nga ndalesat e Tij dhe në ruajtjen e kufijve të Tij.

- "Kërko falje për gjynahet e tua dhe lartësoje me lavde Zotin tënd, mbrëmje e mëngjes!" - Gjynahet e pengojnë dhe e privojnë njeriun nga arritja e të mirave dhe nga lumturia. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar porosit për pendesë dhe kërkim faljeje për të gjitha këto gjynahe. Ai porosit edhe për durim, përmes së cilit arrihet gjithçka e dëshiruar dhe e dashur. I Lartësuari urdhëron edhe për lavdërim të Tij, sidomos në dy kohë: në mëngjes dhe në mbrëmje. Këto janë kohët më të mira, në të cilat kryhen adhurime të shumta, të detyrueshme dhe të pëlqyeshme.

Këto porosi për durim, pendim, kërkim faljeje dhe për *tesbih* e adhurim në kohët e zgjedhura janë një ndihmë e lehtësim i madh për arritjen e mirësive dhe për largimin e të këqijave.

Ajeti 56

56. Ata që kundërshtojnë Shpalljen e Allahut pa pasur argument, kanë në zemrat e tyre veçse mendjemadhësi, me të cilën nuk do t'ia arrijnë qëllimit. Kërko mbrojtje tek Allahu, se Ai është vërtet Gjithëdëgjues dhe Gjithëshikues.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata që kundërshtojnë Shpalljen e Allahut pa pasur argument, kanë në zemrat e tyre veçse mendjemadhësi, me të cilën nuk do t'ia arrijnë qëllimit." - Allahu i Lartësuar na tregon se çdokush që kundërshton të vërtetën në mënyrë të padrejtë, thjesht për ta refuzuar atë, pa fakte dhe pa qenë i qartë në atë që mbron, pa dyshim që e bën nga arroganca, që ka zënë vend brenda shpirtit. Të tillët janë kryeneçë, nuk e pranojnë të vërtetën dhe i urrejnë ata që e sjellin atë. Ata synojnë veç të ngrejnë lart veten dhe qëndrimet e tyre. Por ky qëllim nuk ka për t'u realizuar kurrë nga ata.

Ky ajet është një deklaratë e qartë se çdokush që polemizon në mbrojtje të së kotës do të jetë i mposhtur dhe i mundur. Çdokush që tregohet kryeneç e mendjemadh ndaj së vërtetës, në fund do të poshtërohet.

- "Kërko mbrojtje tek Allahu, se Ai është vërtet Gjithëdëgjues dhe Gjithëshikues." - Këtu nuk përcaktohet se nga çfarë e keqe të kërkojmë mbrojtje tek Allahu. Kjo do të thotë që duhet të kërkojmë mbrojtje tek Ai për çdo lloj të keqeje. Mbrojtja të kërkohet nga ligësia që vjen nga kryeneçët, të cilët tregojnë mendjemadhësi ndaj të vërtetës, si edhe nga vetë mendjemadhësia. Kërko mbrojtje tek Allahu i Madhëruar që të jesh i ruajtur edhe nga ligësia e shejtanëve njerëz dhe xhindë. Pra, kërko mbrojtje tek Allahu për të gjitha llojet e ligësive. Allahu është *El Semiu* – Gjithëdëgjuesi, që dëgjon të gjithë zërat, me gjithë larmishmërinë e tyre. Ai është *El Basir* – Gjithëshikues, që vështron në imtësi gjithçka në çdo vend, kohë e gjendje qofshin krijesat e Tij.

Ajetet 57 – 58

57. S'ka dyshim se krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë.
58. Nuk është i barabartë i verbëri dhe ai që sheh; as ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira nuk janë të barabartë me të këqijtë. Sa pak që përkujtoni!


Shpjegimi i ajeteve

- "S'ka dyshim se krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve..." - Allahu i Madhëruar na tregon për diçka që është shumë e qartë dhe e pranueshme për logjikën. Ai na tregon se krijimi i qiejve dhe i Tokës, me madhështinë dhe gjerësinë e tyre, është shumë herë më madhështor sesa krijimi i njerëzve. Njerëzit, në krahasim me krijimin e qiejve dhe të Tokës, janë shumë të vegjël. Prandaj, Ai që krijoi qiejt dhe Tokën dhe vendosi ligjet e përpikta të funksionimit të tyre, është sigurisht i Plotpushtetshëm që t'i rikrijojë njerëzit nga e para, pas vdekjes së tyre.

Ky është një argumentim logjik shumë i thjeshtë, që tregon se ringjallja është plotësisht e mundur dhe nuk duhet të ketë dyshim për të. Çdo njeri me mend e pranon që kjo është tërësisht brenda mundësisë dhe pushtetit të Zotit, siç pranon, gjithashtu, se gjithçka që profetët dhe Shpalljet e Zotit kanë treguar për ringjalljen është e vërtetë. Megjithatë, jo çdokush e vë në punë mendjen e tij për këtë çështje dhe jo të gjithë ata që e mendojnë një gjë të tillë e pranojnë atë, që pastaj të veprojnë e jetojnë sipas saj. Prandaj i Lartësuari thotë më pas:

- "...por shumica e njerëzve nuk e dinë." - Ata nuk nxjerrin mësime nga këto fakte, argumente e shenja. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Nuk është i barabartë i verbëri dhe ai që sheh; as ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira nuk janë të barabartë me të këqijtë." - Ashtu sikurse nuk janë njëlloj i verbëri dhe ai që sheh, po kështu nuk mund të jenë njëlloj ata që besojnë Allahun dhe bëjnë punë të mira sipas këtij besimi, me ata që tregohen mendjemëdhenj e kryeneçë, të cilët refuzojnë të adhurojnë Allahun, të cilët zhyten në gjynahe dhe mosbindje ndaj Tij dhe të cilët bëjnë vepra që zemërojnë Allahun e Madhëruar.



- "Sa pak që përkujtoni!" – Kuptimi: Shumë pak po përkujtoni dhe mendoni, sepse, në të kundërt, nuk do të kishit këtë gjykim të gabuar. Nëse do të meditonit me kujdes, nëse do të gjykonit me saktësi e drejtësi, ju do të njihnit dhe të përcaktonit me saktësi të mirën dhe të keqen, si dhe nivelet e tyre të ndryshme. Kështu, ju do të arrinit të bënit dallimin mes vepërmirëve dhe vepërkëqijve të shfrenuar. Nëse do të mendoheshit mirë dhe nëse do të kishit vullnet të fortë dhe qëllime të larta, ju do t'i jepnit përparësi të mirës dhe të dobishmes, kundrejt të ligës dhe të dëmshmes, do të përqafonit udhëzimin e drejtë, kundrejt devijimit, do të punonit pa u lodhur për të arritur lumturinë e përjetshme, duke i dhënë asaj përparësi, kundrejt dynjasë, që do të zhduket shumë shpejt.

Ajeti 59

59. Sigurisht që Ora do të vijë! Për këtë s'ka dyshim, por shumica e njerëzve nuk besojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Sigurisht që Ora do të vijë! Për këtë s'ka dyshim..." - Nuk ka dyshim që momenti kur të ndodhë kijameti dhe ringjallja do të vijë. Kjo është një e vërtetë, për të cilën na njoftuan profetët, të cilët janë krijesat më të sinqerta në fjalët e lajmet që sollën nga Zoti. Për këtë të vërtetë kanë folur të gjitha shpalljet qiellore, lajmet e të cilave janë absolutisht të sakta. Atë e mbështet edhe logjika e pastër, kur sheh shenjat dhe argumentet e Zotit në gjithësi, të cilat dëshmojnë për pushtetin e Tij mbi gjithçka.

- "...por shumica e njerëzve nuk besojnë." – Pra, edhe pas gjithë këtyre fakteve nxitës për të besuar dhe për t'iu nënshtruar Zotit e për t'u përgatitur për Ditën e Takimit, shumë njerëz nuk besojnë dhe nuk e zgjedhin këtë rrugë.

Ajeti 60

60. Zoti juaj ka thënë: "M'u lutni Mua, që Unë t'ju përgjigjem! Ata që, nga mendjemadhësia, i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar".

Shpjegimi i ajeteve

- "Zoti juaj ka thënë: "M'u lutni Mua, që Unë t'ju përgjigjem!" – Ky ajet tregon për butësinë dhe mëshirën e Allahut ndaj robërve, si edhe për mirësitë e bujarinë e Tij të pakufishme. Ai i fton vazhdimisht robërit e Tij në çdo gjë që rregullon si fenë e besimin e tyre, ashtu edhe dynjanë e tyre. Ai i urdhëron robërit që t'i drejtohen dhe t'i

luten Atij me të dyja llojet e lutjes: me lutjen e adhurimit dhe me lutjen e kërkesës së drejtpërdrejtë.[3] Allahu i fton ata që të luten, duke premtuar se do t'u përgjigjet.

Por, nga ana tjetër, Allahu i kërcënon ata që tregohen kryeneçë dhe refuzojnë që ta adhurojnë dhe t'i luten Atij, duke thënë:

- "Ata që, nga mendjemadhësia, i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar." – Të tillët do të flaken në Xhehenem të poshtëruar e të përçmuar. Pra, ata do të vuajnë jo vetëm dhimbjet e atjeshme, por edhe poshtërimin. Ky është shpërblimi me drejtësi për arrogancën e tyre.

Ajetet 61 – 65

61. Është Allahu Ai që natën e bëri për të pushuar, ndërsa ditën e bëri të ndritshme. Allahu është dhurues i madh ndaj njerëzve, por shumica e njerëzve nuk falënderojnë.
62. Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i çdo gjëje. Nuk ka të adhuruar me meritë veç Tij. Atëherë, si i largoheni?
63. Kështu sprapsen ata të cilët i mohojnë argumentet e Allahut.
64. Është Allahu Ai që Tokën jua bëri vendbanim e qiellin çati. Ai ju dha formë, duke e përkryer atë dhe ju begatoi me të mira. Ky është Allahu, Zoti juaj. I Lartësuar e plot begati është Allahu, Zoti i botëve!
65. Ai është i Përjetshmi. S'ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij, prandaj vetëm Atij lutjuni, duke iu përkushtuar me adhurime të sinqerta! Lavdia e plotë i qoftë vetëm Allahut, Zotit të Gjithësisë!

Shpjegimi i ajeteve

Medito pak në këto ajete të mrekullueshme, që flasin për mëshirën e gjerë të Allahut dhe për mirësinë e bujarinë e Tij të pakufishme. Ato tregojnë se është detyrim mirënjohja ndaj Atij që na i dhuroi këto mirësi. E si të mos e lavdërosh e t'i tregosh mirënjohje Atij, që është absolut në pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Allahu është Krijuesi i gjithçkaje dhe përkujdeset Vetë për krijesat e Tij. Ai është i Plotë, Absolut, i Gjallë e i Përjetshëm. Ai ka cilësi të plota e absolute në çdo aspekt, prandaj edhe meriton të lavdërohet, të madhërohet, të duhet me gjithë shpirt dhe t'i nënshtrohesh plotësisht. Ai është i lavdëruar për cilësitë e Tij të plota e të bukura, për veprat e Tij, të cilat janë të gjitha të mira. Ai është i lavdëruar edhe për krijimin, sundimin e përkujdesjen e Tij të plotë mbi krijesat e Tij. Ai është i vetëm në këtë pozitë dhe lartësi. Allahu është i vetmi Krijues, Sundues, Zotërues dhe Administrues i çështjeve të krijesave të Tij. Çdo gjë që ndodh në botën qiellore e atë tokësore, në të shkuarën, të tashmen e të ardhmen janë tërësisht dhe vetëm në dorën e Zotit e nën pushtetin e Tij. Askush tjetër nuk ka në dorë ndonjë grimcë pushteti në dynja apo në ahiret. Të gjithë janë krijesa të dobëta, nevojtare, të nënshtruara e të përulura nën pushtetin e Absolutit. Atëherë, duke qenë i vetmi me këto atribute, Allahu duhet të jetë i vetmi i Adhuruar. Vetëm Allahu duhet të adhurohet, pra, të duhet, të madhërohet dhe vetëm Atij duhet t'i nënshtrohesh e t'i përulesh tërësisht, me bindje e përkushtim. Nëse vërtet ia njohim këto cilësi dhe merita Zotit, nga kjo, në zemrën e besimtarit, do të lindë njohja e thellë për Zotin dhe shtimi i

[3] Shih shpjegimin e këtyre dy llojeve të lutjes te surja Bekare ajeti 186.

diturisë rreth Tij, do të lindë dashuria, frikërespekti, madhërimi për Të, ashtu si do të ndriçojë shpresa për takimin me Të.

Medito pak mbi këtë çështje! Njohja e drejtë e Zotit dhe adhurimi i Tij janë dy qëllimet kryesore për të cilat Zoti i krijoi njerëzit e krijesat në përgjithësi. Me fjalë të tjera, Allahu i ka krijuar robërit e Tij thjesht që ta njohin dhe t'i shprehin Atij adhurimin e plotë. [4] Angazhimi për arritjen e këtyre dy qëllimeve të larta garanton mirësi, sukses e fitore në dynja e në ahiret. Ato janë dhurata më e madhe që Zoti u ka ofruar dhe mundësuar krijesave. Ato janë lumturia më e madhe që mund të shijojë dikush në këtë dynja dhe, pa dyshim, rruga e vetme drejt mirësisë së përjetshme në ahiret. Nëse i ke ato të dyja, ke arritur çdo mirësi e begati, e nëse nuk i ke, atëherë të ka ikur prej duarsh mirësia dhe ke rënë në humnerën e të këqijave.

E lus Allahun e Lartësuar që të na i mbushë zemrat me njohje të thella dhe të vërteta rreth Tij dhe me dashurinë për Të. Le të bëjë Allahu i Madhëruar që të gjitha lëvizjet e ndjenjat tona, të dukshmet dhe të fshehtat, të jenë tërësisht dhe sinqerisht vetëm për Të dhe për kënaqësinë e Tij! Le t'i bëjë veprat tona të sinqerta për Të dhe sipas porosive të Tij dhe të Profetit të Tij. Me të vërtetë, asnjë kërkesë nuk është e madhe për Allahun dhe askush nuk zhgënjehet kur troket në portën e Tij dhe i përgjërohet Atij.
Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Është Allahu Ai që natën e bëri për të pushuar..." – Kuptimi: Allahu i Madhëruar e bëri të errët natën, për të mirën tuaj e si mëshirë për ju, me qëllim që ju të pushoni pas aktivitetit të ditës, i cili, nëse do të ishte i pandërprerë, do t'ju shkatërronte. Ju shkoni natën në shtrat dhe Allahu i Madhëruar hedh mbi ju gjumin, që trupi dhe zemrat tuaja të qetësohen. Gjumi është një domosdoshmëri e jetës së njeriut, pa të cilin ai nuk mund të jetojë. Gjatë natës, gjithashtu, të dashurit gjejnë prehjen tek njëri tjetri. Nata u shërben të gjithëve për t'u çlodhur dhe për të rimarrë forcat që u nevojiten që të jetojnë ditën në vazhdim.

- "...ndërsa ditën e bëri të ndritshme." - Kuptimi: Allahu i Madhëruar e bëri ditën të shndritshme nëpërmjet diellit, që lëviz në orbitën e tij. Kur rrezet e diellit shkëlqejnë, ju ngriheni nga shtrati, për t'u marrë me angazhimet e fesë dhe të kësaj dynjaje.

---

[4] Fjala ibâdetun ka dy kuptime:

1. Et-teab-budu / adhurimi. Pra nënshtrimi ndaj Allahut krenar dhe të madhërishëm duke kryer urdhërat e duke i'u larguar ndalesave të Tij, nisur nga dashuria për Të dhe madhërimi i Tij.

2. El muteab-bed bihi. Pra ajo nëpërmjet së cilës kryhet adhurimi. Ka thënë shejhul islam: "Ibadeti është një emër përfshirës i gjithçkaje që e do Allahu dhe është i kënaqur me to, qofshin ato fjalë apo punë, të dukshme (të jashtme) apo të fshehura (të brendshme).

Imam Ibn Kajimi thotë: Adhurimi ndërtohet mbi 15 themele apo baza. Ai që i kompleton ato ka arritur të kompletojë të gjithë nivelet e adhurimit. Për të shpjeguar më hollësisht këtë themi: Adhurimet janë shpërndarë nëpër tre drejtime: zemër, gjuhë dhe gjymtyrë. Dispozitat ligjore që lidhen me adhurimet janë pesë. Uaxhib (e detyruar), mustehab (e pëlqyeshme), haram (e ndaluar), mekruh (e papëlqyeshme), mubah (e lejuar). Pra zemra, gjuha dhe gjymtyrët do të adhurojnë Zotin nëpërmjet këtyre 5 mënyrave. Kështu plotësohen 15 baza të adhurimit.

El kurtubij ka thënë: " Themeli dhe thelbi i adhurimit është nënshtrimi dhe përunjësia. Prandaj edhe detyrat që sherijati ka parashtruar dhe ligjëruar për të përgjegjëshmit ligjërisht janë quajtur adhurime. Sepse njerëzit i kryejnë ato në shenjë nënshtrimi dhe përunjësie ndaj Allahut të lartësuar.

El Imad ibnu Kethir ka thënë: "Adhurimi është: Bindja ndaj Allahut duke kryer urdhërat dhe duke iu larguar ndalesave. Pikërisht ky është realiteti dhe thelbi i fesë dhe besimit islam. Islam dhe istislam janë dorëzimi i plotë ndaj Allahut të lartësuar, dorëzim i cili presupozon përkushtimin, nënshtrimin dhe përunjësinë e plotë ndaj Tij."

Dikush e fillon ditën duke përkujtuar Zotin dhe duke lexuar Librin e Tij, dikush duke falur namaz, dikush duke studiuar, dikush me tregti, dikush me zanatin e vet. Shumë të tjerë nisen për udhëtim, në tokë a në det, të tjerë kujdesen për bujqësinë e bagëtinë e tyre etj.

- **"Allahu është dhurues i madh ndaj njerëzve..."** - Allahu u ka dhuruar shumë mirësi njerëzve. Është Ai që u ka mundësuar atyre mirësitë e përmendura në këto ajete dhe shumë e shumë të tjera. Allahu i Madhëruar përkujdeset për ta edhe duke larguar prej tyre shumë rreziqe e fatkeqësi. Ky fakt duhet t'i bëjë njerëzit që të jenë mirënjohës ndaj Tij dhe ta përkujtojnë e lavdërojnë Dhuruesin e madh e Bujar. Por, megjithatë:

- "...shumica e njerëzve nuk falënderojnë." - Ata nuk tregohen mirënjohës, për shkak të injorancës dhe padrejtësisë, që ka zënë vend brenda tyre. Të pakët janë mirënjohësit, ashtu sikurse thotë i Madhëruari: "Pak nga robërit e Mi janë mirënjohës." [Sebe'e 13]. Mirënjohës janë vetëm njerëzit e vetëdijshëm për mirësitë e dhuruara nga i Madhëruari. Ata i nënshtrohen me përunjësi Allahut, duke i shprehur dashurinë dhe madhërimin e tyre për Të. Mirësitë që u ka dhënë Zoti i tyre Bujar, ata i shfrytëzojnë e shpenzojnë vetëm për ta adhuruar Atë, për t'iu bindur Atij dhe për ta kënaqur Atë. Fjalët, veprat dhe sjellja e tyre shprehin mirënjohje ndaj të Adhuruarit.

- "Ky është Allahu, Zoti juaj, Krijuesi i çdo gjëje. Nuk ka të adhuruar me meritë veç Tij." - Ai i Cili ju ka falur të gjitha mirësitë dhe përkujdeset për ju është vetëm Allahu i Madhëruar. Ai është i vetmi Krijues, Furnizues, Sundues e Përkujdesës dhe i vetmi që meriton adhurimin e përkushtimin tuaj të plotë. Mirësitë e shumta të dhuruara prej Tij janë shenjë se Ai është i vetmi Zot, ndërsa mirënjohja dhe lavdërimi që Ai meriton për këto mirësi dhe për cilësitë e Tij të mrekullueshme tregojnë se Ai është i vetmi që meriton adhurimin.

- "Atëherë, si i largoheni?" – Pasi i Madhëruari pohoi zotërimin dhe sundimin absolut të Tij, Ai urdhëron që ta adhurojmë si Një të vetëm, duke thënë: Si i largoheni adhurimit të Tij, pa i bërë shok e ortak?! Si nuk i përkushtoheni vetëm Atij, pasi ju solli argumente dhe jua ndriçoi rrugën?!

- "Kështu sprapsen ata të cilët i mohojnë argumentet e Allahut." - Largimi prej adhurimit të Allahut të Madhëruar ndodh si një ndëshkim i drejtë për ata që shpërfillin dhe refuzojnë të pranojnë ajetet dhe argumentet e Tij, apo që luftojnë profetët e Tij. Me fjalë të tjera, për shkak të mohimit të Shpalljes së Zotit dhe armiqësisë ndaj profetëve e përhapësve të së vërtetës, ata devijohen dhe privohen nga teuhidi dhe nga sinqeriteti ndaj Allahut, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Kur shpallet ndonjë sure, ata shikojnë njëri-tjetrin: "A ju pa ndokush?" E pastaj largohen. Allahu i devijoi zemrat e tyre, sepse ata janë njerëz që nuk kuptojnë." [Teube 127].

- "Është Allahu Ai që Tokën jua bëri vendbanim..." – Allahu i Madhëruar e bëri Tokën një vend të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm, që njerëzit të plotësojnë nevojat e tyre. Ata mund ta punojnë tokën, ta plugojnë, ta mbjellin, të ndërtojnë banesat

mbi të ose të udhëtojnë dhe të qëndrojnë në të.

"...e qiellin çati." – Domethënë, e bëri qiellin si çati mbrojtëse për tokën, ku ju qëndroni e jetoni. Allahu i Madhëruar ka vendosur në qiell çdo gjë të domosdoshme për jetën në tokë. Ai i ka bërë yjet e qiellit si orientues, nëpërmjet të cilëve ju udhëzoheni kur është errësirë në tokë apo në det.

- "Ai ju dha formë, duke e përkryer atë..." – Asnjë krijesë e gjallë nuk ka pamje më të bukur e më të mirë se njeriu, sikurse thotë i Madhëruari në ajetin tjetër: "Ne e kemi krijuar njeriun në formën më të mirë." [Tin 4].

Nëse dëshiron të njohësh dhe të kuptosh bukurinë dhe plotësimin e njeriut, si dhe urtësitë e Allahut të Lartësuar në krijimin e Tij, vështroje atë me kujdes, gjymtyrë për gjymtyrë. A mund të gjesh ndonjë prej tyre që nuk është në vendin e vet apo të papërshtatshme për atë pozicion? Medito pak edhe për tërheqjen e zemrave të njerëzve kundrejt njëra-tjetrës: a ndodh kjo me krijesat e tjera? Shiko se si e ka dalluar Zoti njeriun mbi të tjerët, duke i dhënë mendje, forcë, arsyetim, iman, dashuri për Zotin dhe aftësi për të nxënë dituri. Këto janë disa nga dhuntitë që i Madhëruari u ka falur njerëzve, krijesave më të bukura.

- "...dhe ju begatoi me të mira." - Këtu përfshihen të gjitha mirësitë: ushqimi, pija, veshja, marrëdhëniet intime, kënaqësitë e shikueshme, të dëgjueshme etj., të cilat Zoti ua mundësoi robërve të Tij për t'i patur dhe shfrytëzuar. Është Ai që ua lehtësoi edhe rrugët e arritjes së këtyre mirësive. Prej mirësive të Allahut është edhe fakti që Ai i ndaloi ata nga çdo ligësi e dëmshme dhe e pisët, që u cenon apo prish mirësitë e tyre, që u dëmton trupin, zemrën, shpirtin, fenë dhe besimin e tyre.

- "Ky është Allahu, Zoti juaj." - Ai i Cili kujdeset për ju, Ai që ju fal gjithë këto mirësi dhe Ai që rregullon të gjitha çështjet tuaja është vetëm Allahu. Ai është i vetmi i Adhuruar, i vetmi Krijues dhe Zotërues i çështjeve.

- "I Lartësuar e plot begati është Allahu, Zoti i botëve!" - U madhëroftë dhe u shtofshin mirësitë dhe begatitë e Tij! Ai kujdeset për të gjithë botën me bujarinë dhe bamirësinë e Tij.

- "Ai është i Përjetshmi." - Allahu është i Gjalli, të Cilit i takon jeta e plotë dhe absolute, e cila presupozon që Ai të jetë i plotë në cilësitë e Qenien e Tij, pa të cilat nuk do të konsiderohej si i Gjallë me jetë të plotë dhe absolute. Ai është i Plotë e Absolut në të gjitha atributet e Tij, si shikimi, dëgjimi, pushteti, dituria, të folurit etj.

- "S'ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij, prandaj vetëm Atij lutjuni, duke iu përkushtuar me adhurime të sinqerta!" - Nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet veç Allahut të Madhërishëm e të Lavdëruar, prandaj vetëm Atij lutjuni!

Lutja është adhurim dhe adhurimi nuk lejohet t'i përkushtohet dikujt tjetër veç Allahut. Qoftë lutjet që shprehen me kërkesa të drejtpërdrejta, qoftë lutjet që shprehen me adhurim, të dyja llojet e lutjes i drejtohen veçse Allahut të Madhëruar.

Allahu i Madhëruar thotë: "...vetëm Atij lutjuni, duke iu përkushtuar me adhurime të


sinqerta!" - pra, duke ia përkushtuar tërësisht dhe vetëm Atij fenë e besimin. Me çdo adhurim e lutje, me çdo fjalë e vepër, duhet të synohet kënaqësia e Allahut të Madhëruar, sikurse ka thënë Ai në një ajet tjetër: "Ndërkohë, ata nuk ishin të urdhëruar për gjë tjetër, përveçse që të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë dhe të përkushtuar ndaj Tij, duke qenë *hunefae*, të falnin namazin, të jepnin zekatin, sepse kjo është feja e drejtë." [Bejjine 5].

- "Lavdia e plotë i qoftë vetëm Allahut, Zotit të Gjithësisë!" - Të gjitha lëvdatat, mirënjohja dhe falënderimet i takojnë vetëm Allahut. Lavdërimi dhe mirënjohja ndaj Tij bëhen me fjalë, duke e lavdëruar dhe përkujtuar Atë me llojet e ndryshme të dhikrit, si edhe me vepra. Të gjitha llojet e adhurimeve duhet t'i përkushtohen veçse Allahut të Madhëruar, që është i Vetëm dhe i Pashoq në meritën e adhurimit. Ai është i vetmi që meriton adhurimet dhe lavdërimet, sepse Ai ka emrat dhe cilësitë më të plota dhe më të larta, dhe sepse veprat e Tij janë të gjitha të drejta, plot mëshirë, bamirësi e bujari. Allahu është Dhuruesi i të gjitha mirësive të dynjasë dhe të ahiretit.

Ajetet 66 – 68

66. Thuaj: "Mua më është ndaluar të adhuroj ata që ju i adhuroni veç Allahut, pasi më kanë ardhur argumente të qarta nga Zoti im, dhe jam urdhëruar t'i dorëzohem e nënshtrohem vetëm Zotit të botëve".

67. Është Allahu Ai që ju ka krijuar fillimisht prej dheu, pastaj prej një pikë fare, e pastaj prej gjaku të ngjizur. Mandej, Ai ju bën të lindni si foshnje, e më vonë të arrini pjekurinë, e pastaj të plakeni; disa


الجزء الرابع والعشرون سورة غافر
هُوَ ٱلَّذِى خَلَقَكُم مِّن تُرَابٍ ثُمَّ مِن نُّطْفَةٍ ثُمَّ مِنْ عَلَقَةٍ ثُمَّ
يُخْرِجُكُمْ طِفْلًا ثُمَّ لِتَبْلُغُوٓا۟ أَشُدَّكُمْ ثُمَّ لِتَكُونُوا۟ شُيُوخًا
وَمِنكُم مَّن يُتَوَفَّىٰ مِن قَبْلُ وَلِتَبْلُغُوٓا۟ أَجَلًا مُّسَمًّى وَلَعَلَّكُمْ
تَعْقِلُونَ ﴿٦٧﴾ هُوَ ٱلَّذِى يُحْىِۦ وَيُمِيتُ ۖ فَإِذَا قَضَىٰٓ أَمْرًا فَإِنَّمَا
يَقُولُ لَهُۥ كُن فَيَكُونُ ﴿٦٨﴾ أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ يُجَٰدِلُونَ
فِىٓ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ أَنَّىٰ يُصْرَفُونَ ﴿٦٩﴾ ٱلَّذِينَ كَذَّبُوا۟ بِٱلْكِتَٰبِ
وَبِمَآ أَرْسَلْنَا بِهِۦ رُسُلَنَا ۖ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿٧٠﴾ إِذِ ٱلْأَغْلَٰلُ
فِىٓ أَعْنَاقِهِمْ وَٱلسَّلَٰسِلُ يُسْحَبُونَ ﴿٧١﴾ فِى ٱلْحَمِيمِ
ثُمَّ فِى ٱلنَّارِ يُسْجَرُونَ ﴿٧٢﴾ ثُمَّ قِيلَ لَهُمْ أَيْنَ مَا كُنتُمْ
تُشْرِكُونَ ﴿٧٣﴾ مِن دُونِ ٱللَّهِ ۖ قَالُوا۟ ضَلُّوا۟ عَنَّا بَل لَّمْ نَكُن
نَّدْعُوا۟ مِن قَبْلُ شَيْـًٔا ۚ كَذَٰلِكَ يُضِلُّ ٱللَّهُ ٱلْكَٰفِرِينَ ﴿٧٤﴾
ذَٰلِكُم بِمَا كُنتُمْ تَفْرَحُونَ فِى ٱلْأَرْضِ بِغَيْرِ ٱلْحَقِّ وَبِمَا كُنتُمْ
تَمْرَحُونَ ﴿٧٥﴾ ٱدْخُلُوٓا۟ أَبْوَٰبَ جَهَنَّمَ خَٰلِدِينَ فِيهَا ۖ فَبِئْسَ مَثْوَى
ٱلْمُتَكَبِّرِينَ ﴿٧٦﴾ فَٱصْبِرْ إِنَّ وَعْدَ ٱللَّهِ حَقٌّ ۖ فَإِمَّا نُرِيَنَّكَ
بَعْضَ ٱلَّذِى نَعِدُهُمْ أَوْ نَتَوَفَّيَنَّكَ فَإِلَيْنَا يُرْجَعُونَ ﴿٧٧﴾
٤٧٥

prej jush vdesin më herët, në mënyrë që të gjithë të arrini afatin e caktuar dhe që të arrini të kuptoni.

68. Është Allahu Ai që jep jetë dhe sjell vdekje. Kur dëshiron diçka, Ai vetëm thotë: "Bëhu", e ajo menjëherë bëhet.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi urdhëroi për ta adhuruar Atë si Një të vetëm, duke iu përkushtuar me sinqeritet dhe përunjësi vetëm Atij, dhe pasi tregoi argumentet dhe arsyet pse duhet ta adhurojmë si Një të vetëm, Allahu i Madhëruar ndalon më pas nga adhurimi i dikujt tjetër veç Tij. Kjo shërben për ta përforcuar e qartësuar edhe më tepër kuptimin e vërtetë të teuhidit. Ai thotë:

- "Thuaj: "Mua më është ndaluar të adhuroj ata që ju i adhuroni veç Allahut..."

- Thuaju, o Profet, unë jam ndaluar që t'i adhuroj ata të cilët ju i adhuroni përveç Allahut, duke u shprehur dashurinë e madhërimin tim, duke shpresuar tek ata e duke iu lutur, duke iu bindur e nënshtruar atyre, qofshin ata idhuj, puta e çdo gjë tjetër që adhurohet padrejtësisht veç Allahut. Unë nuk jam në dyshim për çështjen që ju ftoj, por jam i qartë, i sigurt dhe i bazuar në argumente nga Zoti:

- "...pasi më kanë ardhur argumente të qarta nga Zoti im, dhe jam urdhëruar t'i dorëzohem e nënshtrohem vetëm Zotit të botëve". - Kjo është ftesa ime, me argumente të qarta nga Zoti im. Unë jam urdhëruar t'i dorëzohem tërësisht Zotit të botëve, duke e adhuruar Atë si Një të vetëm, ashtu siç më ka urdhëruar Ai që ta adhuroj. Unë e adhuroj Zotin tim me zemrën, gjuhën dhe me trupin tim. E adhuroj Atë me të gjithë qenien time, duke u nënshtruar dhe dorëzuar ndaj ligjit të Tij. Pa dyshim ky urdhër është absolutisht urdhri më i madh, ashtu sikurse ndalesa nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Allahut është absolutisht ndalesa më e madhe.

Allahu i Madhëruar e argumenton këtë teuhid, duke na treguar se Ai është Krijuesi e Formësuesi i qenieve tona. Nëse e pranojmë Atë si të vetmin Krijues, atëherë duhet ta njohim e pranojmë edhe si të vetmin që meriton adhurimin.

- "Është Allahu Ai që ju ka krijuar fillimisht prej dheu..." - Kështu e filloi i Madhëruari krijimin e njeriut të parë, Ademin (a.s.), prej brinjës së të cilit krijoi gruan e parë.

- "...pastaj prej një pikë fare, e pastaj prej gjaku të ngjizur." - Kështu ndodh më pas me krijimin e të gjithë llojit njerëzor. Është përmendur fillimi i krijimit të njeriut, për të nënkuptuar pastaj të gjitha fazat e tjera të zhvillimit të tij në barkun e nënës: si gjak i ngjizur, si kafshatë e përtypur, si skelet kockor, me skelet dhe mish, për të përfunduar me fryrjen e shpirtit.

- "Mandej, Ai ju bën të lindni si foshnje, e më vonë të arrini pjekurinë, e pastaj të plakeni..." – Kuptimi: Kështu, ju kaloni fazë pas faze nëpër krijimin hyjnor, deri sa të arrini moshën e pjekurisë dhe të përgjegjësisë ligjore, kur plotësoheni me trupin dhe mendjen tuaj, me fuqitë e jashtme dhe të brendshme.

- "...disa prej jush vdesin më herët, në mënyrë që të gjithë të arrini afatin e caktuar..." – Disa njerëz vdesin ende pa arritur moshën e pjekurisë, ndërsa të tjerë e arrijnë atë. Sidoqoftë, të gjithë do ta plotësojnë afatin e tyre të përcaktuar nga i Urti e i Gjithëpushtetshmi. Kur të plotësojnë moshën ose kohën e jetës të dhuruar nga Zoti, të gjithë do të ktheheni tek Ai.

- "...dhe që të arrini të kuptoni." - Kuptimi: Duke medituar rreth fazave nëpër të cilat kaloni, do ta kuptoni se Allahu që e bëri këtë me ju është i aftë të bëjë gjithçka dhe, si i tillë, vetëm Atij i takon adhurimi me bindje e nënshtrim, dashuri e madhërim. Madje, do të kuptoni gjithashtu se ju jeni të mangët në çdo aspekt.

- "Është Allahu Ai që jep jetë dhe sjell vdekje." - Allahu është i vetmi që ka në dorë jetën dhe vdekjen. Çdonjë që vdes, me shkak

apo pa shkak, vdes veçse me lejen dhe caktimin e Tij. I Madhëruari thotë në një ajet tjetër: "Allahu ju krijoi prej dheu, pastaj prej një pike uji, e pastaj ju bëri çift. Çdo femër është barrëse e lind vetëm se me dijen e Tij. Çdokujt që i jepet të jetojë gjatë ose të jetojë shkurt, vetëm se është e shënuar në Libër (*Leuhi Mahfudh*), e kjo për Allahun është e lehtë". [Fatir 11].

- "Kur dëshiron diçka, Ai vetëm thotë: "Bëhu", e ajo menjëherë bëhet." - Nëse Ai dëshiron të kryhet a të ndodhë diçka, e madhe apo e vogël, e rëndësishme apo jo në dukje, Ai vetëm i thotë: "Bëhu!" dhe ajo bëhet; asgjë nuk mund ta ndalojë, ta kthejë apo ta ndryshojë atë.

Ajetet 69 – 76

69. A nuk i sheh ata që kundërshtojnë argumentet e Allahut se si largohen nga e vërteta?
70. Ata që mohojnë Librin dhe mesazhet që u kemi dhënë të dërguarve Tanë, më vonë do ta kuptojnë të vërtetën:
71. atëherë, kur zinxhirët t'u shtrëngohen në qafa e të tërhiqen zvarrë,
72. me ujë të valë dhe kur të hidhen në Zjarr.
73. Pastaj do të pyeten: "Ku janë ata që i adhuronit
74. në vend të Allahut? Ata do të thonë: "Na kanë humbur sysh! Ne nuk kemi adhuruar asgjë më parë!" Ja, kështu i shpie Allahu në humbje jobesimtarët.
75. Këtë e keni për shkak se gëzoheshit në tokë pa kurrfarë të drejte dhe për shkak se mburreshit shumë.
76. Hyni tani në dyert e Xhehenemit! Aty do të jeni përgjithmonë. Sa i shëmtuar është vendi i kryeneçëve!

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i sheh ata që kundërshtojnë argumentet e Allahut se si largohen nga e vërteta? Ata që mohojnë Librin dhe mesazhet që u kemi dhënë të dërguarve Tanë, më vonë do ta kuptojnë të vërtetën..." - Kuptimi: A nuk çuditesh me gjendjen e tmerrshme ku ndodhen ata të cilët polemizojnë padrejtësisht kundër argumenteve Tona të padiskutueshme?! Si është e mundur që devijojnë dhe largohen nga e vërteta? Çfarë duan të arrijnë, pas qartësimit të plotë të së vërtetës! A kanë fakte e prova me të cilat mund të hedhin poshtë ajetet dhe shenjat e qarta të Allahut!

Jo, për Zotin! Ata nuk kanë asnjë fakt ku të mbështeten. Ata kapen thjesht pas dyshimesh e hamendësimesh, që përputhen me dëshirat e tyre. Ata luftojnë vetëm për të mbrojtur dhe mbështetur të kotën e tyre. Sa poshtëruese është për ta kjo zgjedhje! Ata kanë zgjedhur që të mohojnë dhe refuzojnë Librin e Allahut dhe mesazhet që Ai i solli nëpërmjet profetëve të Tij. Ata kanë zgjedhur të mos i besojnë dhe të mos i zbatojnë mësimet e profetëve të Zotit, të cilët ishin njerëzit më të zgjedhur, më të mirët, më të sinqertët, të vërtetët, besnikët dhe më të mençurit, ashtu siç i bëri Zoti i tyre. Për këtë arsye, ata që mohojnë Shpalljen hyjnore dhe refuzojnë të besojnë e pasojnë profetët e Zotit, ata meritojnë veçse Zjarrin e Xhehenemit të ndezur fort, siç thotë i Madhëruari:

- "...atëherë, kur zinxhirët t'u shtrëngohen në qafa e të tërhiqen zvarrë, me ujë të valë dhe kur të hidhen në Zjarr." - Qafat do t'u mbërthehen me pranga, në një mënyrë që nuk do mund të lëvizin prej shtrëngimit të

tyre. Ata do të jenë të lidhur së bashku me shejtanët, të cilët i shoqëruan në dynja. Ashtu të lidhur do të tërhiqen zvarrë në zjarrin e Xhehenemit. Ata do të ndëshkohen me ujë të valuar dhe me zjarr, flakët e të cilit do të shtohen fort e më fort.

Pastaj, mes këtij ndëshkimi, u drejtohen fjalë torturuese e poshtëruese, duke u kujtuar *shirk*-un, mosbesimin dhe mohimin e tyre të shpalljeve dhe të profetëve të Zotit:

- "Pastaj do të pyeten: "Ku janë ata që i adhuronit në vend të Allahut?" – Kuptimi: A mund t'ju ndihmojnë ata tani? A mund t'jua largojnë apo lehtësojnë ndopak ndëshkimin?

- "Ata do të thonë: "Na kanë humbur sysh!" - Ata kanë humbur dhe nuk duken. Por edhe nëse do të ishin aty, kjo nuk do të sillte asnjë dobi.

Pastaj ata përpiqen të mohojnë faktin që ishin idhujtarë dhe që adhuronin të tjerë 'zota' veç Allahut, të cilëve u luteshin e u kushtonin sakrifica:

- "Ne nuk kemi adhuruar asgjë më parë!" - Ka mundësi që, me këto fjalë, ata të mundohen të tregojnë se nuk ishin idhujtarë, duke menduar se kjo do t'i ndihmojë për të shpëtuar nga ndëshkimi. Por ka mundësi që kështu të deklarojnë kotësinë e adhurimeve të tyre, që ua përkushtonin zotave të rremë.
Ky i fundit është kuptimi më i dukshëm i ajetit. Pra, ata e pranojnë se ishin të gabuar në dynja, kur zgjodhën të adhuronin zota të tjerë veç Allahut, sepse Allahu në të vërtetë nuk ka shok e partner në meritën e adhurimit. Ata do të pranojnë se ishin të gabuar që adhuronin diçka që nuk meritonte adhurimin. Këtë kuptim e mbështet edhe vijimi i ajetit, ku thotë i Lartësuari:

- "Ja, kështu i shpie Allahu në humbje jobesimtarët." - E tillë ishte edhe humbja e tyre në dynja. Ajo ishte e dukshme dhe e dallueshme nga të gjithë. Për këtë arsye, në Ditën e Gjykimit, edhe ata vetë do ta pranojnë se kanë qenë në humbje të qartë. Atë ditë do ta kuptojnë edhe më mirë fjalën e Allahut të Lartësuar: "Vërtet, Allahut i përket çdo gjë që është në qiej dhe çdo gjë që është në tokë, ndërsa ata të cilët adhurojnë idhuj në vend të Allahut, shkojnë pas hamendësimeve, dhe nuk bëjnë gjë tjetër, veçse gënjejnë." [Junus 66]. Për këtë tregon gjithashtu edhe thënia e Allahut: "Nëse u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kijametit, ata do ta mohojnë adhurimin tuaj ndaj tyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o i dërguar), ashtu si Ai, që është i Gjithëdijshëm." [Fatir 14]. Po kështu edhe në ajetin: "Thuaju: "A i shihni ata që i lusni veç Allahut? Më tregoni, çfarë krijuan ata në tokë? Apo kanë marrë pjesë në krijimin e qiejve? Më sillni, pra, ndonjë libër tjetër para këtij *(Kuranit)* ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë *(hyjnore)*, nëse flisni të vërtetën!". Kush është më i humbur se ai i cili, në vend të Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'i përgjigjen deri në Kijamet?! Ata *(idhujt)* janë të pavetëdijshëm ndaj lutjeve të tyre. E kur të grumbullohen të gjithë njerëzit, ata *(idhujt)* do të jenë armiq të tyre *(të idhujtarëve)* dhe do ta mohojnë adhurimin e tyre." [Ahkaf 4 – 6]. Banorëve të Zjarrit u thuhet:

- "Këtë e keni për shkak se gëzoheshit në tokë pa kurrfarë të drejte dhe për shkak se

mburreshit shumë." – Kuptimi: Ky ndëshkim i llojllojshëm që po vuani ju jepet për shkak se ju gëzoheshit dhe krekoseshit pa të drejtë me të kotën ku ishit zhytur, si dhe me diturinë që zotëronit, e cila ishte në kundërshtim me diturinë që sollën profetët. Ju lëvdoheshit e krekoseshit mes robërve të Allahut, duke i kaluar kufijtë e Allahut, duke cenuar të drejtat e tyre me armiqësinë dhe padrejtësit tuaja, si dhe duke mos iu bindur Allahut të Madhërishëm. Në fund të kësaj sureje, i Madhëruari thotë: "Kur u erdhën të dërguarit me argumente të qarta, ata *(pabesimtarët)* iu gëzuan diturisë së vet, dhe atëherë i përfshiu ajo me të cilën talleshin." [Gafir 83]. Po kështu ndodhi edhe me Karunin: "Me të vërtetë Karuni ishte nga populli i Musait, por ai i kaloi kufijtë kundër tyre. Ne i patëm dhënë aq shumë pasuri, saqë çelësat e tij mezi i bartnin edhe njerëzit më të fuqishëm. Populli i vet i tha atij: "Mos u gëzo tej mase, sepse Allahu nuk i do të shfrenuarit!" [Kasas 76].

Kjo lloj kënaqësie, pra, meriton ndëshkim nga Allahu. Ndryshe ndodh me gëzimin e lëvdueshëm dhe të shpërblyeshëm, për të cilin Allahu i Madhëruar na urdhëron që ta kemi dhe ta kultivojmë në vetet tona, duke menduar dhe e kërkuar shpesh atë: "O njerëz! Ja ku ju erdhi Këshilla (Kurani) nga Zoti juaj dhe shërimi i asaj që gjendet në kraharorin tuaj. Ai (Kurani) është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Thuaj: "Vetëm për mirësinë e Allahut dhe mëshirën e Tij gëzohuni!" Kjo është shumë herë më e dobishme se ajo (pasuria) që ata grumbullojnë". [Junus 57, 58]. Ky është gëzimi i lëvdueshëm: të gëzohesh me diturinë e dobishme e të vërtetë, si edhe me veprat e mira, që bëhen sipas saj dhe me sinqeritet për Allahun.

- "Hyni tani në dyert e Xhehenemit! Aty do të jeni përgjithmonë. Sa i shëmtuar është vendi i kryeneçëve!" - Secili grup të dënuarish, në varësi të padrejtësive që ka bërë, do të hyjë në shtresën e Zjarrit që meriton prej shtresave.


Allahu i Madhëruar thekson: "Aty do të jeni përgjithmonë", pra, nuk kanë për të dalë kurrë prej tij! Sa i keq është përfundimi i qafirëve kryeneçë e arrogantë! Ai është një fund poshtërues e përçmues! Atje do të burgosen dhe do të ndëshkohen, duke vuajtur sa në zjarrin përvëlues, e sa në të ftohtin e acartë të Xhehenemit.

Ajeti 77

77. Bëhu i durueshëm se, pa dyshim, premtimi i Allahut është i vërtetë! Ne ose do të bëjmë të shohësh diçka nga dënimi që u kemi premtuar atyre, ose do të ta marrim jetën . Por, pa dyshim, ata tek Ne do të kthehen.

Shpjegimi i ajeteve

- "Bëhu i durueshëm se, pa dyshim, premtimi i Allahut është i vërtetë!" – Kuptimi: Bëj durim, o i Dërguar! Bëj durim gjatë ftesës së popullit tënd dhe qëndro i patundur përballë mundimeve që ata të sjellin. Për të forcuar durimin, mbështetu te besimi yt. Besimi është ndihma dhe ushqimi kryesor për durimin, sidomos besimi në premtimin e vërtetë të Allahut. Përqendrohu në fjalën e Allahut: "Pa dyshim, premtimi i Allahut është i vërtetë." Atëherë, le të jetë ky premtim i vërtetë i Allahut lehtësim dhe qetësim për zemrën tënde, le të jetë ilaç për plagët dhe vështirësitë e rrugës. Ky besim të


الجزء الرابع والعشرون سورة غافر
وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلًا مِّن قَبْلِكَ مِنْهُم مَّن قَصَصْنَا عَلَيْكَ
وَمِنْهُم مَّن لَّمْ نَقْصُصْ عَلَيْكَ ۗ وَمَا كَانَ لِرَسُولٍ أَن يَأْتِيَ
بِآيَةٍ إِلَّا بِإِذْنِ اللَّهِ ۚ فَإِذَا جَاءَ أَمْرُ اللَّهِ قُضِيَ بِالْحَقِّ وَخَسِرَ
هُنَالِكَ الْمُبْطِلُونَ ﴿٧٨﴾ اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَنْعَامَ
لِتَرْكَبُوا مِنْهَا وَمِنْهَا تَأْكُلُونَ ﴿٧٩﴾ وَلَكُمْ فِيهَا مَنَافِعُ
وَلِتَبْلُغُوا عَلَيْهَا حَاجَةً فِي صُدُورِكُمْ وَعَلَيْهَا وَعَلَى
الْفُلْكِ تُحْمَلُونَ ﴿٨٠﴾ وَيُرِيكُمْ آيَاتِهِ فَأَيَّ آيَاتِ اللَّهِ
تُنكِرُونَ ﴿٨١﴾ أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَيَنظُرُوا كَيْفَ
كَانَ عَاقِبَةُ الَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ ۚ كَانُوا أَكْثَرَ مِنْهُمْ وَأَشَدَّ
قُوَّةً وَآثَارًا فِي الْأَرْضِ فَمَا أَغْنَىٰ عَنْهُم مَّا كَانُوا يَكْسِبُونَ
﴿٨٢﴾ فَلَمَّا جَاءَتْهُمْ رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَرِحُوا بِمَا عِندَهُم مِّنَ
الْعِلْمِ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُوا بِهِ يَسْتَهْزِئُونَ ﴿٨٣﴾ فَلَمَّا رَأَوْا
بَأْسَنَا قَالُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَحْدَهُ وَكَفَرْنَا بِمَا كُنَّا بِهِ
مُشْرِكِينَ ﴿٨٤﴾ فَلَمْ يَكُ يَنفَعُهُمْ إِيمَانُهُمْ لَمَّا رَأَوْا بَأْسَنَا ۖ سُنَّتَ
اللَّهِ الَّتِي قَدْ خَلَتْ فِي عِبَادِهِ ۖ وَخَسِرَ هُنَالِكَ الْكَافِرُونَ ﴿٨٥﴾
٤٧٦

lehtëson që të jesh i qëndrueshëm dhe i durueshëm në rrugën e vështirë të davetit.

Allahu i Lartësuar premton se do ta ndihmojë Profetin e Tij, do të bëjë që të triumfojë feja e Tij dhe do ta lartësojë Fjalën e Tij. Ai do t'u dhurojë fitore Profetit dhe pasuesve të tij si në dynja, edhe në ahiret.

Le të jetë, gjithashtu, si lehtësim e mbështetje edhe ndëshkimi i armiqve të tyre në dynja dhe në ahiret. Ndëshkimi që Zoti u jep jobesimtarëve dhe armiqve të Islamit le të jetë qetësim për zemrat e besimtarëve, le të jetë lehtësim për të qenë të durueshëm në rrugën e drejtë, si dhe tregues i qartë se i Madhëruari kujdeset për besimtarët dhe i mbështet ata në rrugën e tyre.

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Ne ose do të bëjmë të shohësh diçka nga dënimi që u kemi premtuar atyre, ose do të ta marrim jetën . Por, pa dyshim, ata tek Ne do të kthehen." - Ky është premtimi i Allahut, që duhet t'i qetësojë zemrat tuaja. I Madhëruari premton se ose do t'i godasë me ndonjë ndëshkim, që do të dëshmohet nga Profeti, ose do ta marrë Profetin para ndëshkimit të tyre. Por gjithsesi ata: "...tek Ne do të kthehen". Dhe kur të kthehen tek Zoti, Ai do t'i japë secilit atë që meriton, sipas veprave të tyre. Ata kurrë nuk mund t'i shpëtojnë llogarisë së të Drejtit, të Gjithëdijshmit, të Plotpushtetshmit, që thotë: "Kurrsesi mos e mendo Allahun si të pakujdesshëm ndaj asaj që veprojnë zullumqarët! Ai vetëm është duke i afatizuar ata deri në ditën kur sytë të shtangen." [Ibrahim 42].

Pas këtyre porosive të mrekullueshme dhe pas premtimeve qetësuese dhe inkurajuese për të qenë i patundur në rrugën e davetit, i Madhëruari vijon përsëri ta qetësojë dhe t'i japë forcë Profetit të Tij, duke i kujtuar vëllezërit e tij profetë:

Ajeti 78

78. Ne, edhe para teje kemi dërguar pejgamberë. Për disa prej tyre të kemi njoftuar me rrëfimet Tona, e për disa prej tyre nuk të kemi njoftuar. Asnjë pejgamber nuk mundi të sjellë ndonjë mrekulli ndryshe, por veçse me lejen e Allahut. Kur të vijë urdhri i Allahut, gjykimi do të zbatohet me drejtësi e, atëherë, ithtarët e të kotës do të dëshpërohen.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne, edhe para teje kemi dërguar pejgamberë. Për disa prej tyre të kemi njoftuar me rrëfimet Tona, e për disa prej tyre nuk të kemi njoftuar." - Kuptimi: Janë të shumtë profetët që u dërguan, me qëllim

që t'i ftonin popujt e tyre në adhurimin e Allahut si të Vetëm e të Pashoq, duke iu nënshtruar e përkushtuar vetëm Atij. Ata duruan edhe përballë mundimeve më të mëdha prej popujve të tyre. Historitë e shumë prej tyre iu rrëfyen Muhamedit (a.s.), ashtu siç pati edhe histori të të dërguarve të tjerë, që atij nuk iu rrëfyen.

Të gjithë profetët ishin thjesht zbatues të urdhrave e porosive të Zotit; ata ishin përcjellës besnikë të mesazhit të Tij. Ata ishin thjesht njerëz që Zoti i ngarkoi me detyrën e profetësisë. Ata nuk kishin në dorë asnjë lloj pushteti, ndërsa mrekullitë që u shfaqën në duart e tyre ishin thjesht shenja të dhëna nga Zoti, sikurse thotë i Madhëruari më pas:

- "Asnjë pejgamber nuk mundi të sjellë ndonjë mrekulli ndryshe, por veçse me lejen e Allahut." - Të gjitha mrekullitë dhe shenjat madhështore, të shikueshme apo të dëgjueshme, të gjitha argumentet tekstuale e logjike janë vetëm nga Allahu i Madhëruar. Ato jepen si mbështetje për Profetin dhe si shenja që ai flet me urdhër nga Allahu. Ato janë mëse të mjaftueshme që popujt të besojnë, por zullumqarët, të cilët thjesht donin të refuzonin besimin, kërkonin argumente, shenja e mrekulli të veçanta, sipas dëshirave të tyre. Ata i kërkonin mrekullitë jo për të besuar dhe për t'u bindur, por thjesht për të refuzuar të vërtetën dhe për të justifikuar mosbesimin e tyre. Për këtë arsye, mbi ta goditi fort ndëshkimi i Allahut.

Mrekullitë e profetëve janë tregues i mjaftueshëm për besnikërinë e tyre dhe vërtetësinë e mesazhit të tyre. Ato janë shenja të jashtëzakonshme të dhëna nga Zoti. Vetë profetët nuk kanë në dorë asnjë fuqi për të sjellë ndonjë mrekulli.

Ai që nuk do të besojë, nuk ka për të besuar, edhe sikur t'i jepen të gjitha shenjat që kërkon, por të mos harrojë se do të vijë dita kur të bëhet ndarja e drejtë mes profetëve dhe popujve. I Madhëruari thotë:

- "Kur të vijë urdhri i Allahut, gjykimi do të zbatohet me drejtësi e, atëherë, ithtarët e të kotës do të dëshpërohen." – Pra, kur të vijë dita që do të bëhet gjykimi i drejtë mes profetëve dhe popujve të tyre, e vërteta do të dalë në shesh. Pas këtij gjykimi të drejtë, i Madhëruari do të shpërblejë profetët dhe pasuesit e tyre, ndërsa mohuesit do të humbasin dhe do të dëshpërohen shumë. Këta të fundit i Madhëruari i ka përshkruar si "ithtarët e të kotës". Dituria dhe veprat e tyre janë të kota, ashtu sikurse edhe qëllimet e tyre.

Le të kenë kujdes ata që dëgjojnë këtë Kuran, ata të cilët dëgjojnë dhe dinë për Shpalljen që solli Muhamedi (a.s.), dhe të mos vazhdojnë në rrugën e të shkatërruarve e të humburve. Nëse vazhdojnë në kotësinë e tyre, edhe këta do t'i presë i njëjti ndëshkim dhe dëshpërim si popujt e shkuar. Nëse nuk pasojnë të vërtetën, atëherë nuk ka më mirësi tek ta. Të tillët nuk kanë ndonjë premtim nga Zoti se do të jenë të shpëtuar dhe të ruajtur nga ndëshkimi.

Ajetet 79 – 81

79. Është Allahu Ai që i krijoi kafshët për ju, që disa t'i shaloni e disa të tjera t'i përdorni për ushqim.
80. Ju prej tyre keni dobi të shumta dhe përmes tyre plotësoni nevojat tuaja. Nëpërmjet tyre dhe mbi anije ju mbartni e udhëtoni

81. Ai ju mundëson t'i shihni shenjat e Tij. Cilën shenjë të Allahut mohoni ju?

Shpjegimi i ajeteve

- "Është Allahu Ai që i krijoi kafshët për ju, që disa t'i shaloni e disa të tjera t'i përdorni për ushqim." - Allahu i Madhëruar u përkujton robërve mirësitë e Tij, mes të cilave edhe kafshët që u ka vënë në zotërim. Ato përdoren si kafshë shpine, për të mbajtur peshat e rënda e për transport, por edhe si ushqim, duke konsumuar mishin, qumështin apo vezët e tyre. Po ashtu, lëkura, leshi apo pendët përdoren për veshje apo për të mbajtur trupin ngrohtë. Njerëzit shfrytëzojnë në dobi të tyre çdo gjë të kafshëve.

- "Ju prej tyre keni dobi të shumta dhe përmes tyre plotësoni nevojat tuaja." – Kafshët shërbejnë për transport, për të udhëtuar në vende të largëta. Kështu, ato plotësojnë nevojat dhe dëshirat e njerëzve.

- "Nëpërmjet tyre dhe mbi anije ju mbartni e udhëtoni." – Kuptimi: Ju lëvizni e bartni mirësitë e Zotit nëpërmjet mjeteve tokësore dhe atyre detare. Është Ai që i lehtësoi për ju kushtet për funksionimin e atyre mjeteve.

- "Ai ju mundëson t'i shihni shenjat e Tij." – Ai na mundëson të shohim shenjat që tregojnë për njëshmërinë e Tij në meritën e adhurimit, ashtu si edhe për emrat e cilësitë e Tij të mrekullueshme. Pa dyshim, sjellja dhe ekzistenca e këtyre shenjave përreth nesh dhe në vetet tona është nga mirësitë më të mëdha që na i ka dhuruar Allahu i Madhëruar. Të gjitha mirësitë që na i ka lehtësuar dhe dhuruar Allahu janë të mjaftueshme që ne të jemi mirënjohës dhe lavdërues të Tij. Por kur Allahu i Madhëruar na udhëzon që ne t'i vështrojmë dhe të meditojmë në to, kur na i numëron dhe vë më në dukje, atëherë edhe kjo është një mirësi shumë e madhe, sepse na bën të mendojmë, të shtojmë njohuritë tona rreth Zotit, dhe si rrjedhim do ta përkujtojmë më shumë e do ta duam e adhurojmë ashtu sikurse Ai na mëson.

- "Cilën shenjë të Allahut mohoni ju?" - Cilën shenjë a mirësi të Allahut po mohoni?! Ju edhe në veten tuaj jeni të bindur se të gjitha mrekullitë dhe mirësitë vijnë prej Allahut. Atëherë, mospranimi i kësaj të vërtete është i pakuptimtë, dhe po ashtu është edhe mosmirënjohja juaj dhe mosnënshtrimi ndaj Atij që jua dhuroi. Njerëzit e mençur duhet të bëjnë maksimumin për ta adhuruar Allahun, Dhuruesin e çdo mirësie, duke iu bindur dhe duke iu përkushtuar vetëm Atij dhe shërbimit ndaj Tij.

Ajetet 82 – 85

82. A nuk lëvizin ata nëpër botë, për të parë se si qe fundi i atyre që jetuan më herët? Ata ishin më të shumtë dhe më të fortë për nga forca e gjurmët që lanë në tokë, por atyre nuk u bënë aspak dobi ato që kishin fituar.
83. Kur u erdhën të dërguarit me shenja të qarta, ata iu gëzuan diturisë së vet, dhe atëherë i përfshiu ai me të cilin talleshin.
84. E kur e panë dënimin Tonë, thanë: "Ne i besojmë vetëm Allahut dhe i mohojmë ata që adhuronim veç Tij".
85. Por besimi i tyre pasi panë dënimin Tonë, nuk u bëri dobi. Ky është ligj i Allahut ndaj robërve të Tij. Ai çast do të jetë dëshpërim për jobesimtarët."

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk lëvizin ata nëpër botë..." - Allahu i Madhëruar u drejtohet mohuesve të profetëve dhe të shpalljeve hyjnore e u thotë që të udhëtojnë nëpër botë ose të studiojnë për historinë e saj. Le të pyesin njerëzit e dijshëm apo të shikojnë vetë shenjat e lëna nga Zoti në vende të ndryshme. Le t'i shohin me kujdes ato, për të nxjerrë mësime dhe me synimin e mirë për të kuptuar të vërtetën.

- "...për të parë se si qe fundi i atyre që jetuan më herët? Ata ishin më të shumtë dhe më të fortë për nga forca e gjurmët që lanë në tokë..." - Të tillë ishin popujt e Adit, Themudit etj. Ata ishin më të mëdhenj, më të fuqishëm dhe më të pasur se ata të mëvonshmit. Ata lanë shumë gjurmë të dukshme në këtë botë, si ndërtesa të mëdha dhe kështjella të larta. Ata lanë pas pasuri e toka të begatshme.

- "...por atyre nuk u bënë aspak dobi ato që kishin fituar." - Kur u zbatua vendimi i Zotit për të ndëshkuar ata, atyre nuk iu bëri aspak dobi fuqia dhe pushteti i tyre. Ata nuk mund të shpëtonin kurrsesi nga ndëshkimi duke dhënë pasuritë e tyre. Edhe kështjellat apo ushtritë që kishin nuk mundën t'i mbronin nga ndëshkimi i Zotit.

Pastaj i Madhëruari përmend krimin e tyre, për shkak të të cilit merituan atë që merituan:


- "Kur u erdhën të dërguarit me shenja të qarta, ata iu gëzuan diturisë së vet..." - Kur profetët e Zotit sollën libra hyjnorë, mrekullitë madhështore dhe diturinë e dobishme, nëpërmjet së cilës mund të dallonin udhëzimin e drejtë nga devijimi dhe të vërtetën nga e kota, pabesimtarët u vetëkënaqën me diturinë që kishin, edhe pse ajo ishte në kundërshtim me fenë e Zotit dhe me diturinë e sjellë nga profetët.

Kuptohet lehtë se ky gëzim i tyre me njohuritë që kishin ishte vetëkënaqësi e tepruar. Nga ana tjetër, ajo tregonte për armiqësinë dhe urrejtjen e madhe të tyre për të vërtetën me të cilën erdhën profetët. Ata i trumbetonin idetë e tyre sikur ishin e vërteta e sigurt, që duhet mbrojtur e pasuar.

Këtu futen edhe idetë e filozofisë greke, nëpërmjet të cilave disa njerëz përpiqen që të hedhin poshtë ajetet kuranore ose që të zbehin rëndësinë dhe vlerën e Librit të Allahut në zemrat e robërve. Sipas tyre, dituria e sigurt e Kuranit mund të vihet në dyshim. Për ta është më e pranueshme që të pranosh logjikën e mendjelehtëve, të cilët mbështeten në rregulla të kota, që i vendosin vetë dhe i besojnë si të mirëqena. Ky këmbim konsiderohet si mohimi më i madh i Shpalljes së Allahut dhe si armiqësi e hapur ndaj saj. Por Allahu është Mbrojtësi dhe Ndihmuesi më i mirë kundër mohuesve e refuzuesve të së vërtetës.

- "...dhe atëherë i përfshiu ai me të cilin talleshin." - Mbi ta zbriti ndëshkimi, për shkak të shpërfilljes dhe talljes me shenjat dhe Shpalljen e Zotit.

- "E kur e panë dënimin Tonë, thanë: "Ne i besojmë vetëm Allahut dhe i mohojmë ata që adhuronim veç Tij". - Kur të tillët të shohin ndëshkimin, ata do të pranojnë besimin e drejtë në Allahun, por kjo nuk do t'ju vlejë, sepse koha për pendim dhe besim përfundon me vdekjen. Ata do të distancohen nga idhujt ose gjithçka që kanë


الجزء الرابع والعشرون سورة فصلت

سورة فصلت

بسم الله الرحمن الرحيم

حم ﴿١﴾ تنزيل من الرحمن الرحيم ﴿٢﴾ كتاب فصلت آياته
قرءانا عربيا لقوم يعلمون ﴿٣﴾ بشيرا ونذيرا فأعرض أكثرهم
فهم لا يسمعون ﴿٤﴾ وقالوا قلوبنا في أكنة مما تدعونا إليه
وفي آذاننا وقر ومن بيننا وبينك حجاب فاعمل إننا عاملون
﴿٥﴾ قل إنما أنا بشر مثلكم يوحى إلي أنما إلهكم إله واحد
فاستقيموا إليه واستغفروه وويل للمشركين ﴿٦﴾ الذين
لا يؤتون الزكوة وهم بالآخرة هم كافرون ﴿٧﴾ إن الذين
آمنوا وعملوا الصالحات لهم أجر غير ممنون ﴿٨﴾ قل أئنكم
لتكفرون بالذي خلق الأرض في يومين وتجعلون له أندادا
ذلك رب العالمين ﴿٩﴾ وجعل فيها رواسي من فوقها
وبارك فيها وقدر فيها أقواتها في أربعة أيام سواء
للسائلين ﴿١٠﴾ ثم استوى إلى السماء وهي دخان فقال
لها وللأرض ائتيا طوعا أو كرها قالتا أتينا طائعين ﴿١١﴾

الحزب ٤٨

٤٧٧

adhuruar në dynja, veç Allahut të Madhëruar. Po ashtu, ata do të pendohen për çdo dituri e vepër që binte ndesh me mësimet dhe udhëzimet e profetëve të Zotit.

- "Por besimi i tyre pasi panë dënimin Tonë, nuk u bëri dobi. Ky është ligj i Allahut ndaj robërve të Tij." - Por besimi dhe pendimi i tyre nuk u vlen në atë çast. Ky është rregulli i pandryshueshëm, që ka vendosur Zoti. Besimi i mohuesve në momentet e zbritjes së ndëshkimit është i pavlefshëm. Ai tashmë nuk i shpëton më nga ndëshkimi i Zotit, sepse është besim i detyruar, dhe jo besim me zgjedhje të lirë. Ai është tashmë besim i diçkaje të dukshme nga shqisat. Ndërsa besimi i vërtetë dhe i saktë, që i sjell dobi njeriut, është besimi me zgjedhje të lirë dhe besimi në gjërat dhe çështjet që nuk dëshmohen nga shqisat. Gjithashtu, kusht për vlefshmërinë e imanit është që të ndodhë para se të vijnë shenjat e dukshme të ndëshkimit dhe para se të vijë Dita e Gjykimit (ose disa nga shenjat e afrimit të saj).

- "Ai çast do të jetë dëshpërim për jobesimtarët." - Pikërisht në këtë kohë, kur të vuajnë ndëshkimin e madh, qafirët do të binden për humbjen dhe dështimin e tyre. Ata tashmë kanë humbur fenë, dynjanë dhe ahiretin e tyre. Por humbja e mirësive nuk do të jetë e vetmja gjë që i pret. Ata do të hidhen në ndëshkimin më të rëndë, që do ta vuajnë në përjetësi.

Këtu përfundon edhe tefsiri i sures "El mu'min" (besmtari)[5], me mirësinë, butësinë dhe ndihmën e Allahut të Madhëruar. Asgjë nuk arrihet me forcën dhe punën tonë. Vetëm Allahut i takon lavdia, mirënjohja dhe të gjitha lavdërimet.

Surja 41: El Fussilet (mekase) 54 ajete

Ajetet 1 – 8

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ha, Mim.
2. Kjo është Shpallje prej të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!
3. Ky është Libër, ajetet e të cilit janë shtjelluar qartë. Ky është Kuran në arabisht, për një popull me dije.
4. Ai është përgëzues dhe qortues, por shumica e tyre i kthejnë shpinën dhe nuk e dëgjojnë.
5. Ata thonë: "Zemrat tona janë të mbyllura nga ajo që ti na thërret, kurse veshët tanë janë shurdhuar keq; ndërmjet nesh dhe

[5] Kështu quhet ndryshe surja "El gafir"

teje ekziston një perde, prandaj ti vepro sipas tëndes, kurse ne do vazhdojmë me tonën!"

6. Thuaj: "Unë jam veçse një njeri, sikurse edhe ju. Mua më shpallet se i adhuruari juaj është vetëm Zoti Një, ndaj përqendrohuni në rrugën drejt Tij dhe kërkoni falje prej Tij! Mjerë për ata që, veç Tij, adhurojnë zota të tjerë,

7. e të cilët nuk e japin zekatin dhe mohojnë jetën tjetër.

8. Nuk ka dyshim se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira kanë shpërblim të pandërprerë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ha, Mim. Kjo është Shpallje prej të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!" - Allahu i Lartësuar u tregon besimtarëve, adhuruesve të Tij, se ky Kuran i bukur dhe madhështor është Shpallje e Atij, që është *El Rahman* dhe *El Rahim*, i Gjithëmëshirshmi e Mëshiruesi.

Mëshira e Allahut ka përfshirë gjithçka. Ndër shenjat më të mëdha të mëshirës së Tij është edhe shpallja e Kuranit madhështor. Dituria, udhëzimi, drita, shërimi, mëshira dhe mirësitë e këtij libri janë aq të shumta dhe të mrekullueshme, saqë ai e meriton të quhet si begatia dhe bekimi më i madh që i është dhuruar botës dhe robërve. Ai është rruga drejt lumturisë në dynja dhe ahiret.

Më pas, Allahu i Lartësuar e lëvdon këtë libër, duke treguar se ai është shpallur në formën më të plotë dhe më të bukur:

- "Ky është Libër, ajetet e të cilit janë shtjelluar qartë. Ky është Kuran në arabisht..." - Kurani ka shtjelluar dhe sqaruar çdo çështje në mënyrë të plotë. Ajeti tregon se sqarimi i çështjeve të përmendura në këtë libër është i tërësishëm, duke përmendur çdo element të nevojshëm për të treguar vërtetësinë e gjërave.

Gjithashtu, Kurani është në arabisht, me një gjuhë të pastër e të plotë.

- "...për një popull me dije." – Ashtu sikurse janë të qarta fjalët dhe shprehjet e Kuranit, po ashtu janë të qarta edhe kuptimet e përnxjerra prej tij. Në këtë mënyrë, ata që dinë do të mund të dallojnë udhën e drejtë nga e gabuara ose të vërtetën nga e kota. Ndërsa për injorantët, ky libër nuk bën dobi, por përkundrazi, ua shton humbjen, devijimin dhe verbërinë. Nga fjala e Zotit përfitojnë të diturit, ndërsa mohuesit e të padrejtët nuk përfitojnë prej saj, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Nuk ka dyshim, se për ata që mohojnë është njëlloj: ua tërhoqe vërejtjen apo jo, ata nuk besojnë. Allahu ua ka vulosur zemrat dhe të dëgjuarit e tyre. Në shikimet e tyre ka perde dhe ata do të kenë dënim të rëndë." [Bekare 6 - 7].

- "Ai është përgëzues dhe qortues, por shumica e tyre i kthejnë shpinën dhe nuk e dëgjojnë." – Kurani i përgëzon ata që e pranojnë dhe zbatojnë atë për shpërblime të shumta në dynja dhe ahiret. Por ai edhe paralajmëron për dënime të dhimbshme në jetën e dynjasë dhe në ahiret ata që e shpërfillin dhe nuk e vënë në zbatim.

Megjithëse cilësitë e këtij libri bëjnë që ai të pranohet, të respektohet, të besohet dhe të zbatohet lehtësisht, shumica e krijesave i kthejnë shpinën atij me mendjemadhësi dhe mospërfillje. Ata nuk e dëgjojnë Kuranin, me kuptimin që nuk e pranojnë atë, edhe pse mund ta dëgjojnë me veshë atë. Ose dëgjimi i tyre nuk u sjell dobi, madje zhvleftëson çdo

lloj justifikimi para Zotit për moszbatimin e porosive të Tij.

- "Ata thonë: "Zemrat tona janë të mbyllura nga ajo që ti na thërret, kurse veshët tanë janë shurdhuar keq..."" - Kundërshtarët dhe armiqtë e së vërtetës, duke treguar shkakun e mospërfitimit prej ajeteve të Kuranit, thonë: Zemrat tona janë të mbyllura, të kyçura e të vulosura, prandaj ne nuk mund ta kuptojmë dhe pranojnë atë. Veshët tanë – thonë ata - janë bllokuar, prandaj nuk mund t'i dëgjojmë porositë e Allahut.

- "...ndërmjet nesh dhe teje ekziston një perde" – Kuptimi: Ne nuk mund të shohim. Në këtë mënyrë, ata shfaqin armiqësi të hapur ndaj Profetit (a.s.) dhe Shpalljes hyjnore. Nga ana tjetër, ata shprehin vetëkënaqësinë me gjendjen në të cilën ndodhen:

- "...prandaj ti vepro sipas tëndes, kurse ne do vazhdojmë me tonën!" - Kuptimi: Ashtu sikurse ti je i kënaqur me veprat dhe përkushtimin në fenë tënde, edhe ne jemi të kënaqur me veprat në fenë tonë.

Ky është tregues i humbjes së tyre të thellë, të cilën e shohin si lumturi dhe mirësi. Ata e shesin imanin për të blerë kufrin dhe sakrifikojnë ahiretin për të fituar diçka nga kjo dynja.

- "Thuaj: "Unë jam veçse një njeri, sikurse edhe ju. Mua më shpallet se i adhuruari juaj është vetëm Zoti Një..." - Kuptimi: Thuaju atyre, o Profet, se kjo është detyra ime dhe këto janë cilësitë e mia. Unë jam një njeri, ashtu si ju, dhe nuk kam në dorë asnjë çështje. Edhe ndëshkimi, që ju e kërkoni me ngulm që t'ju përshpejtohet dhe ta shihni me sy, nuk është në dorën time. E vetmja veçori me të cilën Zoti më ka dalluar mua mbi ju, është shpallja e Kuranit dhe Urtësisë, për të cilët më ka urdhëruar që të jetoj sipas tyre dhe t'ju ftoj edhe ju ta bëni një gjë të tillë.

- "...ndaj përqendrohuni në rrugën drejt Tij dhe kërkoni falje prej Tij!" - Kuptimi: Ndiqni rrugën e qartë dhe të drejtë, që ju çon drejt Zotit të Lartësuar, duke pohuar dhe besuar çdo lajm që Ai kumton, dhe duke ruajtur kufijtë e Tij, me zbatimin e urdhrave dhe largimin nga ndalesat, në shenjë dëshurie, nënshtrimi dhe madhërimi për Të. Vetëm kështu mund të quheni të përqendruar në rrugën e drejtë të Zotit.

Në ajet thuhet: "...përqendrohuni në rrugën drejt Tij", që nënkupton pajisjen me sinqeritet për Allahun e Madhëruar. Pra, shërbestarët e ahiretit duhet që me punën e tyre të synojnë vetëm kënaqësinë e Allahut të Madhëruar. Qëllimi i tyre i vetëm të jetë arritja e takimit me Allahun e Lartësuar dhe me Xhenetin e Tij, vendin ku Allahu do t'i begatojë me bujarinë e Tij. Në këtë mënyrë, pra, duke punuar sipas Shpalljes dhe porosisë së Zotit dhe duke i kryer këto punë me sinqeritet vetëm për të kënaqur Zotin, veprat e tyre do të jenë të mira, të pranueshme dhe të shpërblyeshme. Në të kundërt, nëse njëri nga këto kushte cenohet, veprat e tyre do të jenë të kota dhe të pavlefshme.


Megjithatë, robi patjetër do të cenojë kushtet e qëndrueshmërisë ose duke lënë ndonjë urdhër pa kryer ose duke bërë ndonjë haram. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar porosit që këto mangësi të kurohen me kërkim falje dhe pendim të sinqertë sa herë që të ndodhin.

Pastaj i Lartësuari i kërcënon ata që largohen nga rruga e drejtë, duke thënë:

- "Mjerë për ata që, veç Tij, adhurojnë zota të tjerë, e të cilët nuk e japin zekatin dhe mohojnë jetën tjetër..." - Mjerë për ata të cilët adhurojnë idhuj, të cilët nuk kanë në dorë as dëm e as dobi, as vdekje, as jetë e as ringjallje. Ata jo vetëm që nuk e pastrojnë vetveten, por zhyten më thellë në llumin dhe pisllëkun e idhujtarisë e mosbindjes. Ata nuk e pastrojnë veten nëpërmjet teuhidit, nuk e pastrojnë veten duke u pajisur me sinqeritet ndaj të vetmit Zot që meriton adhurimet, ndaj Allahut të Gjithëmëshir-shëm. Ata nuk falin namaz dhe nuk japin zekatin. Ata nuk tregojnë bamirësi me krijesat, duke i ndihmuar dhe udhëzuar drejt. Përveç këtyre cilësive të ulta, ata nuk besojnë se do të ringjallen dhe as në ekzistencën e Xhenetit dhe Xhehenemit. Për këtë arsye, ata jepen tërësisht pas gjërave që i dëmtojnë dhe që do i dëshpërojnë në ahiret.

Pasi foli për mohuesit, Allahu i Madhërishëm vijon me besimtarët, duke përshkruar cilësitë e tyre dhe shpërblimin që i pret:

- "Nuk ka dyshim se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira kanë shpërblim të pandërprerë." - Ata që besojnë Kuranin dhe gjithçka që mëson ai, pastaj e vërtetojnë këtë besim me vepra të mira, të sinqerta dhe në përputhje me porositë e Zotit të tyre, përgëzohen me një shpërblim të madh, i cili kurrë nuk ka për t'u ndërprerë dhe as për të mbaruar. Ai do të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë kohës, në përjetësi, madje do të shtohet dhe do të zbukurohet gjithnjë e më shumë në çdo çast që kalon. Në Xhenet do të


الجزء الرابع والعشرون سورة فصلت
فقضاهن سبع سموات في يومين وأوحى في كل سماء أمرها
وزينا السماء الدنيا بمصابيح وحفظا ذلك تقدير العزيز
العليم ﴿١٢﴾ فإن أعرضوا فقل أنذرتكم صاعقة مثل صاعقة
عاد وثمود ﴿١٣﴾ إذ جاءتهم الرسل من بين أيديهم ومن
خلفهم ألا تعبدوا إلا الله قالوا لو شاء ربنا لأنزل ملائكة
فإنا بما أرسلتم به كافرون ﴿١٤﴾ فأما عاد فاستكبروا في
الأرض بغير الحق وقالوا من أشد منا قوة أولم يروا أن الله
الذي خلقهم هو أشد منهم قوة وكانوا بآياتنا يجحدون
﴿١٥﴾ فأرسلنا عليهم ريحا صرصرا في أيام نحسات لنذيقهم
عذاب الخزي في الحياة الدنيا ولعذاب الآخرة أخزى وهم
لا ينصرون ﴿١٦﴾ وأما ثمود فهديناهم فاستحبوا العمى على
الهدى فأخذتهم صاعقة العذاب الهون بما كانوا يكسبون
﴿١٧﴾ ونجينا الذين آمنوا وكانوا يتقون ﴿١٨﴾ ويوم يحشر أعداء الله
إلى النار فهم يوزعون ﴿١٩﴾ حتى إذا ما جاءوها شهد عليهم
سمعهم وأبصارهم وجلودهم بما كانوا يعملون ﴿٢٠﴾
٤٧٨

kenë të gjitha llojet e kënaqësive dhe mirësive, që ata t'i shijojnë dhe dëshirojnë.

Ajetet 9 – 12

9. Thuaju: "Ju jeni ata që nuk i besoni Atij, që e krijoi Tokën për dy ditë dhe i përshkruani Atij shok, kur Ai është Zoti i botëve?!

10. Është Ai që në të vuri male të fuqishme, ia shtoi të mirat asaj dhe brenda katër ditëve të plota përcaktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të." Ky është shpjegimi për ata që pyesin.

11. Më pas, Ai iu drejtua qiellit, i cili ishte si tym, dhe i tha atij dhe tokës: "Bindjuni urdhrit Tim, me dëshirë ose me dhunë!" Ata të dy thanë: "Po, i bindemi me dëshirë!"

12. Dhe Ai krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve, duke i caktuar secilit qiell atë që i

nevojitej. Qiellin më të afërt e stolisëm me yje plot shkëlqim dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i të Plotfuqishmit e të Dijshmit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaju: "Ju jeni ata që nuk i besoni Atij, që e krijoi Tokën për dy ditë dhe i përshkruani Atij shok, kur Ai është Zoti i botëve?! Është Ai që në të vuri male të fuqishme, ia shtoi të mirat asaj dhe brenda katër ditëve të plota përcaktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të." Ky është shpjegimi për ata që pyesin." – Kjo është një pyetje, që tregon habi, por edhe ndalesë nga krimi që bëjnë qafirët, të cilët adhurojnë idhuj, duke iu përulur e duke i barazuar me Allahun e Madhërishëm, Mbretëruesin Bujar, i Cili e krijoi Tokën vetëm për dy ditë, pastaj e sheshoi atë për dy ditë të tjera, duke vendosur malet si shtylla, të cilët e mbajnë Tokën të qëndrueshme nga dridhjet dhe lëvizjet. Krijimi i saj u plotësua më tej, duke nxjerrë bimësinë e çdo gjë tjetër. E gjithë kjo ndodhi në katër ditë, për ta ditur ata që pyesin rreth krijimit të saj. E kush mund të përgjigjet më mirë se i Gjithëdituri e i Plotpushtetshmi? Ky është një fakt i vërtetë, i cili nuk ka as mangësi dhe as shtesa.

Pas krijimit të Tokës, Allahu iu drejtua krijimit të qiellit, i cili ishte tym. Pastaj u tha qiellit dhe Tokës:

- "Më pas, Ai iu drejtua qiellit, i cili ishte si tym, dhe i tha atij dhe tokës: "Bindjuni urdhrit Tim, me dëshirë ose me dhunë!"" - Ky është një urdhër që duhet të shkojë në vend dhe të ekzekutohet në çdo mënyrë.

- "Ata të dy thanë: "Po, i bindemi me dëshirë!"" – Kuptimi: Ne kurrsesi nuk mund të dëshirojmë diçka që kundërshton dëshirën dhe urdhrin Tënd, o Zot. Ne nënshtrohemi vullnetarisht e me dëshirë.

Kështu u kompletua krijimi i qiejve dhe Tokës në gjashtë ditë të plota, duke filluar nga dita e diel e duke përfunduar ditën e premte. Edhe pse fuqia e Zotit është aq e madhe sa të krijojë gjithçka në një çast të vetëm, edhe pse Ai është i Plotpushtetshëm për gjithçka, Ai gjithashtu është i Urtë, i Butë e i Mëshirshëm. Prej mëshirës dhe butësisë së Tij, Ai vendosi që krijimi i botës të jetë në këtë mënyrë dhe kohë.

Nga ajeti: "Më pas, Ai iu drejtua qiellit, i cili ishte si tym, dhe i tha atij dhe tokës: "Bindjuni urdhrit Tim, me dëshirë ose me dhunë!", kuptohet se Allahu i Lartësuar e ka krijuar qiellin pas krijimit të Tokës. Ndërsa në suren Naziat, Allahu i Lartësuar thotë:

"...e pastaj tokën e sheshoi....". Në pamje të parë duket sikur këto dy ajete janë në kundërshtim me njëri-tjetrin. Por, pa dyshim, në Librin e Zotit nuk mund të gjesh kurrë kundërshtime e kundërthënie. Shpjegimi për këtë është se – ashtu siç thonë shumë komentues të Kuranit, – vërtet që krijimi i Tokës si trup qiellor ka ndodhur para krijimit të qiejve, ashtu sikurse thuhet në këtë sure, por shtrimi dhe përgatitja e saj, duke e nxjerrë bimësinë, ujin etj., ka ndodhur pas krijimit të qiejve, sikurse thuhet në suren Naziat: "A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit, të cilin Ai e ngriti! Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë. Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi. E pastaj Tokën e sheshoi, prej së cilës nxori ujin dhe kullotat e saj, kurse malet ia përforcoi, si furnizim për ju dhe për kafshët tuaja.". Edhe në këtë ajet nuk thuhet: "E pastaj Tokën e krijoi", por thuhet: "E pastaj Tokën e sheshoi....". Pra,

pas krijimit të qiellit, ka ndodhur shtrimi i tokës dhe jo krijimi i saj.

- **"Dhe Ai krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve, duke i caktuar secilit qiell atë që i nevojitej. Qiellin më të afërt e stolisëm me yje plot shkëlqim dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i të Plotfuqishmit e të Dijshmit."** - Për çdo qiell u dhanë urdhra dhe u caktuan ato që ishin të nevojshme, ashtu sikurse di të vendosë më i Urti. Ndërsa qielli i dynjasë u zbukurua me yje, nëpërmjet të cilëve krijesat ndriçohen dhe udhëzohen në errësirë. Yjet janë zbukurim për qiellin e errët, por shërbejnë edhe si gjuajtës për shejtanët e mallkuar, për të mos i lejuar që të dëgjojnë dhe të vjedhin nga lajmet e qiellit.

Toka dhe qielli me gjithçka mes tyre u krijuan sipas përcaktimit të Krenarit të Gjithëdijshëm. Me krenarinë dhe pushtetin e Tij të plotë, Ai i nënshtroi krijesat e tashmë administron çështjet e tyre. Ndërsa me dijen e Tij, Allahu i ka përfshirë të gjitha krijesat, të dukshmet dhe të padukshmet.

Megjithatë, politeistët i largohen përkushtimit me sinqeritet ndaj Zotit të Madhërishëm, që është i Vetëm dhe Ngadhënjyes mbi gjithçka. Allahut i janë nënshtruar të gjitha krijesat dhe çdo gjë funksionon sipas përcaktimit dhe dëshirës së Tij, por, në vend të Tij, mushrikët adhurojnë idhuj. Ky shkëmbim është tepër i çuditshëm, kur dihet se idhujt e tyre kanë cilësi të mangëta e të ulëta. Sidoqoftë, nëse vazhdojnë në kundërshtimin dhe mohimin e tyre, për ta nuk ka shpagim tjetër veç ndëshkimit në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ajetet 13 – 14

13. Në qoftë se ata shmangen, ti thuaju: "Ju paralajmëroj për një rrufe, si rrufeja e Adit dhe Themudit!
14. Kur atyre u erdhën të dërguarit nga çdo anë, duke i këshilluar: "Mos adhuroni asgjë tjetër veç Allahut", ata thanë: "Po të donte, Zoti ynë do të dërgonte engjëj. Prandaj ne nuk i besojmë mesazhit që përcillni ju!"

Shpjegimi i ajeteve

- **"Në qoftë se ata shmangen, ti thuaju: "Ju paralajmëroj për një rrufe, si rrufeja e Adit dhe Themudit!"** - Nëse edhe pas përmendjes së cilësive të larta të Kuranit dhe cilësive të Allahut të Madhërishëm, ata do vazhdonin në mohimin dhe kundërshtimin e tyre, atëherë do të paralajmëroheshin për një ndëshkim të dhimbshëm dhe shfarosës, të ngjashëm me ndëshkimin e popujve Ad dhe Themud. Këta dy popuj të njohur u ndëshkuan ashpër, për shkak të padrejtësisë së tyre me mohimin e profetëve dhe të shpalljeve të Zotit.

- **"Kur atyre u erdhën të dërguarit nga çdo anë, duke i këshilluar: "Mos adhuroni asgjë tjetër veç Allahut"..."** – Pra, të dërguarit e Zotit shkonin njëri pas tjetrit, për t'u përkujtuar Zotin dhe për t'i ftuar në adhurimin e Tij.

Mesazhi i të gjithë profetëve ka qenë i njëjtë: Mos adhuroni asgjë tjetër veç Allahut. Ata kanë urdhëruar për sinqeritet ndaj Allahut dhe kanë ndaluar nga idhujtaria, me të gjitha format dhe rrugët e saj.

Megjithatë, ata i refuzuan porositë e Zotit, duke i konsideruar gënjeshtra dhe trillime. Ata thanë:

- "Po të donte, Zoti ynë do të dërgonte engjëj. Prandaj ne nuk i besojmë mesazhit që përcillni ju!" – Kuptimi: Ju jeni njerëz të zakonshëm si ne, prandaj nuk e pranojmë thirrjen tuaj.

Ky lloj justifikimi i kotë vazhdon e përsëritet nga njerëzit. Ai është vërtet justifikim pa bazë, sepse nuk është kusht që të jesh engjëll për të qenë profet. Asnjëherë nuk ka ekzistuar një kusht i tillë. Që një profet të dëshmojë se ai vërtet është i dërguar dhe i ndihmuar nga Zoti në misionin e tij, mund të sjellë mrekulli prej Zotit. Nëse profeti i sjell mrekullitë dhe argumentet e dukshme për vërtetësinë e tij, atëherë kundërshtarët le të mblidhen dhe t'i hedhin poshtë ato me argumente të tjera! Por kjo është e pamundur të ndodhë. Ata kurrë nuk mund të hedhin poshtë mrekullitë dhe faktet e sjella nga një profet i Allahut.

Ajetet 15 – 16

15. Sa i përket popullit Ad, ata u treguan arrogantë në tokë dhe pa kurrfarë të drejte thanë: "Kush është më i fortë se ne?" A nuk e dinin ata se Allahu, i Cili i krijoi, është më i fortë se ata?! Ata i refuzuan padrejtësisht shenjat Tona.
16. Për këtë shkak, Ne lëshuam kundër tyre një erë shumë të ftohtë për disa ditë shkatërruese, për t'i bërë që ta vuajnë dënimin nënçmues që në jetën e kësaj bote, ndërsa në botën tjetër dënimi do të jetë edhe më i shëmtuar, ndërkohë që nuk do të kenë asnjë ndihmë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Sa i përket popullit Ad, ata u treguan arrogantë në tokë dhe pa kurrfarë të drejte thanë: "Kush është më i fortë se ne?"" - Këtu flitet për historinë e popujve Ad dhe Themud. Populli i Adit, përveç se ishin mohues të Zotit, të shenjave të Tij dhe të profetëve të Tij, ata ishin njerëz të prishur e shkatërrimtarë. Ata dhunonin padrejtësisht të tjerët, ishin shumë arrogantë dhe të vetëkënaqur me fuqinë e tyre, aq sa thoshin: "E kush është më i fortë se ne?".

- "A nuk e dinin ata se Allahu, i Cili i krijoi, është më i fortë se ata?! Ata i refuzuan padrejtësisht shenjat Tona." - Por Allahu i Lartësuar kthen përgjigjen për ta, duke përmendur diçka që e dinë të gjithë. I Madhëruari thotë: A nuk e dinin ata se Allahu, i Cili i krijoi, është më i fortë se ata?! Nëse Ai nuk do t'i kishte krijuar, ata nuk do të ekzistonin. Për këtë arsye, nëse ata do të kujtonin këtë fakt, nuk do të silleshin me kryelartësi dhe arrogancë.

- "Për këtë shkak, Ne lëshuam kundër tyre një erë shumë të ftohtë për disa ditë shkatërruese..." – Ajo ishte një stuhi e furishme, aq sa prej saj krijohej një ushtimë shumë e frikshme, si një bubullimë. Allahu i Lartësuar ua vazhdoi atë furtunë për shtatë net e tetë ditë rresht, sikurse thotë në suren Hakka: "Ndërsa Adi u shkatërrua me një stuhi të fuqishme e të zhurmshme, që Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht. T'i shihje njerëzit të shembur përdhe, si të ishin trungje hurmash të zgavruara." Kështu i shkatërroi i Madhërishmi ata. Pas kësaj gjëme, mbetën veçse rrënojat e vendbanimit të tyre.

Pastaj i Lartësuari thotë:

- "...për t'i bërë që ta vuajnë dënimin nënçmues që në jetën e kësaj bote, ndërsa në botën tjetër dënimi do të jetë edhe më i

shëmtuar, ndërkohë që nuk do të kenë asnjë ndihmë." - Allahu u dha atë ndëshkim, që t'i turpëronte para krijesave që në jetën e kësaj dynjaje, ku ata krenoheshin me forcën e tyre. Ndërsa ndëshkimi i ahiretit do të jetë edhe më poshtërues. Atje ata nuk do të kenë mundësinë të mbrohen dhe shpëtojnë.

Ajetet 17 – 18

17. Sa i përket Themudit, Ne ua treguam udhën e drejtë, por ata parapëlqyen verbërinë kundrejt udhëzimit. Ata i kapi tmerri i dënimit poshtërues, për shkak të asaj që vepruan.
18. Ndërkaq, Ne i shpëtuam ata që kishin besuar dhe që ishin të ruajtur.

Shpjegimi i ajeteve

- "Sa i përket Themudit, Ne ua treguam udhën e drejtë..." - Themudi është një popull i njohur, që ka jetuar në El Hixhr dhe në rrethinat e saj. Allahu i Lartësuar dërgoi tek ata profetin Salih (a.s.), për t'i ftuar në *teuhid* dhe për t'i ndaluar nga *shirk*-u. Ai u solli atyre si mrekulli një deve të madhe dhe i urdhëroi që t'i ndanin ditët me devenë për shfrytëzimin e ujit dhe burimeve të tij: një ditë për devenë, një ditë për ta. Një ditë pinin ujë dhe ditën tjetër pinin nga qumështi i devesë, edhe pse nuk shpenzonin gjë për ushqimin dhe mirëmbajtjen e saj. Ajo thjesht ushqehej në tokën e Zotit. Siç shihet, kjo qe një shenjë tepër e qartë për të gjithë atë popull, shenjë e cila nuk u linte atyre asnjë justifikim.


- "...por ata parapëlqyen verbërinë kundrejt udhëzimit. Ata i kapi tmerri i dënimit poshtërues, për shkak të asaj që vepruan." – Allahu i Lartësuar ua tregoi qartë rrugën e vërtetë, dhe ky fakt përforcohet në këtë ajet, ku thuhet: "Ne ua treguam udhën e drejtë".

Të gjithë popujve që u dërgoi profet Allahu i Lartësuar ua qartësoi plotësisht të vërtetën dhe u solli mrekulli, që të mos kishin më asnjë justifikim për mosbesimin, por në rastin e Themudit, mrekullia ishte aq e dukshme dhe aq e qartë, sa çdokush e pa dhe e dëshmoi, i madh dhe i vogël, burra e gra. Megjithatë, për shkak të ligësisë dhe padrejtësisë së tyre, ata dëshiruan më shumë verbërinë kundrejt udhëzimit, deshën kufrin dhe padrejtësinë kundrejt besimit dhe bamirësisë, zgjodhën injorancën dhe *shirk*-un kundrejt diturisë dhe adhurimit të Zotit. Pra, Allahu i Lartësuar nuk u bëri ndonjë padrejtësi atyre.

- "Ndërkaq, Ne i shpëtuam ata që kishin besuar dhe që ishin të ruajtur." - Allahu i Lartësuar e shpëtoi Salihun (a.s.) dhe besimtarët të cilët e pasuan atë, duke u ruajtur nga *shirk*-u dhe poshtërsitë.

Ajetet 19 – 24

19. Paralajmëroji ata për ditën kur armiqtë e Allahut të tubohen për në Zjarr dhe të shtyhen me forcë në të.
20. Kur ata t'i afrohen atij, kundër tyre do dëshmojnë të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë vepruar.
21. Ata do t'u thonë lëkurave të veta: "Përse dëshmoni kundër nesh?" Ato do thonë: "Është Allahu Ai që na bëri të flasim, Ai i Cili çdo gjëje ia ka dhënë të folurit. Është Ai që ju krijoi ju herën e parë, dhe pastaj vetëm tek Ai do të ktheheni".
22. Ju nuk kishit frikë se kundër jush do të dëshmonin të dëgjuarit tuaj, të parit tuaj



dhe lëkurat tuaja. Ju menduat se Allahu nuk dinte për shumë gjëra që ju vepronit.
23. Pikërisht mendimi i gabuar që ju patët për Zotit tuaj ju shkatërroi, dhe tani jeni më të dëshpëruarit.
24. Nëse arrijnë ta durojnë, Zjarri është vend i tyre, e nëse kërkojnë të kthehen atje ku dëshirojnë, nuk kanë për ta arritur.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na tregon për armiqtë e Tij dhe të Profetit, për gjendjen e tmerrshme dhe të frikshme në të cilën ata do të ringjallen:

- "Paralajmëroji ata për ditën kur armiqtë e Allahut të tubohen për në Zjarr dhe të shtyhen me forcë në të." - Ata do të mblidhen nga i pari deri tek i fundit dhe me ashpërsi do të shtyhen për në Xhehenem. Ata nuk do mund ta pengojnë hedhjen e tyre në Xhehenem, nuk mund të ndihmohen dhe shpëtojnë nga ai fund i hidhur dhe vuajtje e përhershme.

- "Kur ata t'i afrohen atij, kundër tyre do dëshmojnë të dëgjuarit e tyre, të parit e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë vepruar." - Kur t'i afrohen Zjarrit, ata do të mohojnë krimet që kanë bërë në dynja. Por kundër tyre do të dëshmojnë dëgjimi, shikimi dhe lëkura e tyre, për çdo vepër që kanë bërë. Në fakt, çdo pjesë e trupit të tyre do të dëshmojë dhe do të thotë. "Unë veprova kështu e ashtu, në këtë e atë ditë", por Allahu i Lartësuar veçon organet e mësipërme, sepse shumica e gjynaheve bëhen nëpërmjet tyre ose për shkak të tyre.

- "Ata do t'u thonë lëkurave të veta: "Përse dëshmoni kundër nesh?"" - Ky fakt dëshmon që të gjitha organet do të dëshmojnë. Pra, kuptimi është: Përse dëshmoni kundër nesh, ndërkohë që ne jemi përpjekur gjithmonë t'ju mbrojmë dhe t'ju kënaqim?!

- "Ato do thonë: "Është Allahu Ai që na bëri të flasim, Ai i Cili çdo gjëje ia ka dhënë të folurit." – Kuptimi: Është jashtë mundësive tona që të mos dëshmojmë të vërtetën, kur është Allahu i Madhërishëm Ai që na bëri të flasim. Dëshira dhe urdhri i Tij nuk mund të kundërshtohen.

- "Është Ai që ju krijoi ju herën e parë, dhe pastaj vetëm tek Ai do të ktheheni." - Ashtu sikurse ju ka krijuar ju, me trup dhe shpirt, po ashtu Ai ka krijuar edhe aftësinë tuaj për të folur. Pastaj, ju do të ktheheni tek

Allahu, i Cili do t'ju shpërblejë për ato që keni bërë.

Ka shumë mundësi, gjithashtu, që këto fjalë t'i referohen vërtetësisë së ringjalljes. Domethënë, Allahu që ju krijoi herën e parë është i Plotfuqishëm që t'ju rikrijojë dhe t'ju ringjallë, për t'ju llogaritur dhe shpërblyer për punët tuaja.

- "Ju nuk kishit frikë se kundër jush do të dëshmonin të dëgjuarit tuaj, të parit tuaj dhe lëkurat tuaja." - Kuptimi: Ju nuk mendonit rreth kësaj dëshmie dhe nuk ruheshit që organet tuaja të mos ju shihnin dhe të dëshmonin veprat tuaja. Jo vetëm kaq, por...

- "Ju mendonit se Allahu nuk dinte për shumë gjëra që ju vepronit." - Ky mendim i gabuar bëri që ata të zhyteshin gjynah pas gjynahu. Ky mendim u bë shkak për shkatërrimin dhe dëshpërimin e tyre.

- **"Pikërisht mendimi i gabuar që ju patët për Zotit tuaj ju shkatërroi, dhe tani jeni më të dëshpëruarit."** - Ky mendim i gabuar nuk lidhet aspak me madhështinë e Allahut të Lartësuar. Ky mendim i shkatërron ata, të cilët do të përfundojnë të dëshpëruar. Ata humbin familjet dhe fenë e tyre nëpërmjet veprave që bëjnë. Ndëshkimi i Zotit bëhet i merituesheëm mbi ta, ndëshkim që do të jetë i përjetshëm e që asnjë çast nuk do t'u lehtësohet.

- "Nëse arrijnë ta durojnë, Zjarri është vend i tyre..." – Sigurisht, ata nuk do kenë mundësi që ta përballojnë dhe durojnë atë zjarr. Çdo gjë mund të përballohet dhe durohet, por jo zjarri i Xhehenemit. E si mund të durohet ai zjarr, që është shtatëdhjetë herë më i nxehtë se zjarri më i fortë i kësaj dynjaje. Xhehenemi vlon me një nxehtësi të tmerrshme. Era e çliruar prej tij është shumë e keqe dhe e papërballueshme. Edhe i ftohti i Xhehenemit është tejet i acartë. Prangat e tij janë shumë të rënda dhe të mëdha. Rojet e Zjarrit janë të ashpër, të vrazhdë dhe të pamëshirshmëm. Por më i rëndë se gjithçka është zemërimi i të Madhërishmit, Ngadhënjyesit, dhe sidomos fjala që Ai u thotë të ndëshkuarve kur ata luten: "Heshtni, rrini aty të poshtëruar dhe mos flisni!"

- "...e nëse kërkojnë të kthehen atje ku dëshirojnë, nuk kanë për ta arritur." – Pra, edhe nëse luten e përgjërohen që të shpëtohen nga ndëshkimi dhe të kthehen në dynja, me qëllim që të veprojnë ndryshe nga ajo që kanë bërë më parë, kjo assesi nuk do t'u pranohet. Koha kur njeriu mund të reflektojë dhe të ndryshojë sjelljet dhe punët e tij përfundon me vdekjen e tij. Allahu i Madhërishëm i jep njeriut jetë të mjaftueshme për të reflektuar dhe nxjerrë mësim. Gjithashtu, Ai ka sjellë profetë dhe shpallje hyjnore, që çdokush të gjejë rrugën e drejtë.

Gjithsesi, ky pretendim i tyre është thjesht një gënjeshtër, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "E sikur t'i shihje ata, kur, të ndalur pranë Zjarrit, do thonë: "Ah, sikur të ktheheshim (në dynja), që të mos mohonim më faktet e Zotit tonë e të bëheshim besimtarë!" Jo, atyre u doli në shesh ajo që e mbanin fshehtë më parë. Edhe sikur të ktheheshin, ata sërish do të bënin atë që e kanë të ndaluar. S'ka dyshim se ata janë gënjeshtarë." [En'am 27, 28].

Ajeti 25

25. Ne u shoqëruam atyre shokë të këqij, që vazhdimisht ua hijeshonin veprat e këqija në jetën e tyre dhe mohimin e asaj që i priste më vonë. Për këtë arsye, dënimi i tyre duhet të bëhet realitet, ashtu si ai i popujve xhindë dhe njerëz, që ishin para tyre. Me të vërtetë, ata ishin të humbur.

Shpjegimi i ajetit

- "Ne u shoqëruam atyre shokë të këqij, që vazhdimisht ua hijeshonin veprat e këqija në jetën e tyre dhe mohimin e asaj që i priste më vonë." - Zullumqarëve që janë armiq me të vërtetën u janë vënë si shoqërues shejtanët, të cilët nuk u ndahen dhe i nxisin për të këqija, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "A nuk e di ti, se Ne kemi lëshuar kundër jobesimtarëve shejtanët, të cilët i nxisin pandërprerë për vepra të këqija?" [Merjem 83]. Ata i shtyjnë drejt gjynaheve, duke ua zbukuruar jetën e dynjasë. Shejtanët i joshin qafirët me kënaqësi haram dhe ata bien brenda, duke i ndjekur verbërisht. Ata nxisin gjithashtu për të luftuar kundër Allahut dhe profetëve të Tij. Nga ana tjetër, shejtanët i bëjnë ata që të harrojnë krejtësisht ahiretin ose i bëjnë të besojnë se Kijameti nuk ka për të ndodhur kurrë. Për këtë shkak, zemrat e tyre nuk kanë më drojë, prandaj është e thjeshtë që ata të zhyten në kufër, bidate dhe poshtërsi.

Allahu i Lartësuar ua shoqëron atyre shejtanët, për shkak se ata i kanë kthyer shpinën përkujtimit të Allahut dhe shpërfillin Shpalljen e Tij. Në një ajet tjetër, i Madhëruari thotë: "Kush i kthen shpinën Përkujtimit të Zotit, Ne i shoqërojmë nga një shejtan, i cili nuk i ndahet kurrë. Ai *(shejtani)* e devijon nga rruga e drejtë, ndërkohë që ai *(jobesimtari)* mendon se është i udhëzuar mirë. E kur të vijë ai *(jobesimtari)* para Nesh, do të thotë: "Oh, mjerë për mua! Ah, sikur mes meje dhe teje *(o shejtan)* të kishte një largësi sa lindja prej perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!" Ju bënit zullume *(do t'u thuhet)*, prandaj sot nuk do t'ju lehtësojë aspak fakti se nuk jeni të vetmit që po ndëshkoheni!" [Zuhruf 36 – 39].

- "Për këtë arsye, dënimi i tyre duhet të bëhet realitet, ashtu si ai i popujve xhindë dhe njerëz, që ishin para tyre. Me të vërtetë, ata ishin të humbur." – Është bërë detyrë e pashmangshme që mbi ta të godasë ndëshkimi i përcaktuar nga Zoti, ashtu sikurse u veprua me shumë popuj para tyre, qofshin xhindë apo njerëz. Ata u shkatërruan duke humbur dynjanë dhe ahiretin. Të humburit do të jenë gjithmonë të poshtëruar, të dëshpëruar dhe të ndëshkuar.

Ajetet 26 – 29

26. Ata që nuk besojnë thonë: "Mos e dëgjoni këtë Kuran dhe, kur të lexohet, llomotitni, se ndoshta ia dilni mbanë!"
27. Ne do të bëjmë që mohuesit të shijojnë një dënim të ashpër. Ne do t'i ndëshkojmë ata sipas veprave më të këqija që punuan.
28. Ky është ndëshkimi i armiqve të Allahut: Zjarri. Atje është vendi i tyre i përhershëm, si shpërblim për refuzimin e padrejtë të argumenteve Tona.
29. Jobesimtarët do të thonë: "O Zoti ynë, na i trego ata xhindë dhe njerëz që na devijuan, që t'i shkelim me këmbët tona; qofshin të poshtëruar!"

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon se mohuesit jo vetëm që i kthejnë shpinën Kuranit, por edhe e kështillojnë njëri-tjetrin për një krim të tillë:

- "Ata që nuk besojnë thonë: "Mos e dëgjoni këtë Kuran dhe, kur të lexohet, llomotitni, se ndoshta ia dilni mbanë!"" – Kuptimi: Mos e dëgjoni Kuranin dhe mos u mendoni shumë rreth mesazhit që ai përcjell. Shpërfillini, gjithashtu, edhe ata që ju flasin për Kuranin. Nëse ju ndodh që të dëgjoni diçka prej këtij libri, atëherë bëni zhurmë e dërdëllisni sa të mundeni, që askush të mos e dëgjojë atë.

Njerëz të tillë shpresojnë se, po të veprojnë ashtu, ndoshta mund të shpëtojnë nga ndikimi i fuqishëm që ka Kurani në shpirtrat e njerëzve.

Kjo është një dëshmi shumë e qartë prej armiqve të Librit të Zotit, se ata mund të përballen me Kuranin veçse duke mos e dëgjuar atë. E vetmja mënyrë që ata zgjedhin për të mos iu nënshtruar atij është që të mos e dëgjojnë dhe të mos e pranojnë të vërtetën e tij, e cila është e pamohueshme. Sidoqoftë, e vërteta kurrë nuk mund të mposhtet dhe të zhduket, dhe këtë e dinë shumë mirë miqtë dhe armiqtë e saj.

Sigurisht, kjo zgjedhje e tyre është tregues i qartë i padrejtësisë dhe i armiqësisë që kanë ndaj së vërtetës. Kështu, ata nuk i lënë asnjë mundësi vetes së tyre për të gjetur udhëzimin. Për ta mbetet veçse ndëshkimi dhe dëshpërimi. Prandaj i Madhëruari thotë:


- "Ne do të bëjmë që mohuesit të shijojnë një dënim të ashpër. Ne do t'i ndëshkojmë ata sipas veprave më të këqija që punuan." – Veprat e tyre janë kufri, gjynahet, mosbindja ndaj Zotit dhe shpërfillja e Shpalljes së Tij. Sa të këqija janë këto vepra! Ndëshkimi i tyre është i drejtë, sepse ai godet vetëm njerëzit që bëjnë të këqija dhe shpërfillin të vërtetën. Allahu i Lartësuar nuk i bën padrejtësi askujt.

- "Ky është ndëshkimi i armiqve të Allahut: Zjarri. Atje është vendi i tyre i përhershëm, si shpërblim për refuzimin e padrejtë të argumenteve Tona." - Ky është ndëshkimi i atyre që luftojnë kundër Allahut dhe kundër të dashurve të Tij. Ata mohojnë të vërtetën, duke e konsideruar atë si gënjeshtër, madje e paraqesin atë si rrugë të shtrembër në mënyrë të vazhdueshme dhe këmbëngulëse.

Zjarri ka për të qenë vendqëndrimi i tyre i përjetshëm. Atyre nuk do t'u lehtësohet aspak ky ndëshkim dhe kurrë nuk kanë për t'u ndihmuar.

- "...si shpërblim për refuzimin e padrejtë të argumenteve Tona." - Ato janë ajete dhe fakte të qarta, argumente të prera, të cilat sjellin siguri e bindje. Pa dyshim, mohimi me urrejtje dhe armiqësia ndaj tyre konsiderohet si padrejtësia më e madhe.

- "Jobesimtarët do të thonë: "O Zoti ynë, na i trego ata xhindë dhe njerëz që na devijuan, që t'i shkelim me këmbët tona; qofshin të poshtëruar!" - Të mashtruarit që ndiqnin udhëheqësit e tyre, të dëshpëruar, do t'i drejtohen Allahut të Lartësuar, duke thënë: "Na i trego ata njerëz dhe xhindë që na devijuan nga rruga e drejtë dhe na çuan në humbje, dhe pastaj në këtë ndëshkim. Na i trego cilët janë ata shejtanë njerëz dhe xhindë, të cilët na ftuan dhe na tërhoqën në Xhehenem. Na i trego, që t'i shkelim dhe copëtojmë me këmbët tona. Ashtu sikurse na


الجزء الرابع والعشرون سورة فصلت

إِنَّ ٱلَّذِينَ قَالُوا۟ رَبُّنَا ٱللَّهُ ثُمَّ ٱسْتَقَٰمُوا۟ تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ
ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ أَلَّا تَخَافُوا۟ وَلَا تَحْزَنُوا۟ وَأَبْشِرُوا۟ بِٱلْجَنَّةِ
ٱلَّتِى كُنتُمْ تُوعَدُونَ ﴿٣٠﴾ نَحْنُ أَوْلِيَآؤُكُمْ فِى ٱلْحَيَوٰةِ ٱلدُّنْيَا
وَفِى ٱلْءَاخِرَةِ ۖ وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَشْتَهِىٓ أَنفُسُكُمْ وَلَكُمْ
فِيهَا مَا تَدَّعُونَ ﴿٣١﴾ نُزُلًا مِّنْ غَفُورٍ رَّحِيمٍ ﴿٣٢﴾ وَمَنْ أَحْسَنُ
قَوْلًا مِّمَّن دَعَآ إِلَى ٱللَّهِ وَعَمِلَ صَٰلِحًا وَقَالَ إِنَّنِى مِنَ
ٱلْمُسْلِمِينَ ﴿٣٣﴾ وَلَا تَسْتَوِى ٱلْحَسَنَةُ وَلَا ٱلسَّيِّئَةُ ۚ ٱدْفَعْ
بِٱلَّتِى هِىَ أَحْسَنُ فَإِذَا ٱلَّذِى بَيْنَكَ وَبَيْنَهُۥ عَدَٰوَةٌ كَأَنَّهُۥ
وَلِىٌّ حَمِيمٌ ﴿٣٤﴾ وَمَا يُلَقَّىٰهَآ إِلَّا ٱلَّذِينَ صَبَرُوا۟ وَمَا يُلَقَّىٰهَآ
إِلَّا ذُو حَظٍّ عَظِيمٍ ﴿٣٥﴾ وَإِمَّا يَنزَغَنَّكَ مِنَ ٱلشَّيْطَٰنِ نَزْغٌ
فَٱسْتَعِذْ بِٱللَّهِ ۖ إِنَّهُۥ هُوَ ٱلسَّمِيعُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٣٦﴾ وَمِنْ ءَايَٰتِهِ
ٱلَّيْلُ وَٱلنَّهَارُ وَٱلشَّمْسُ وَٱلْقَمَرُ ۚ لَا تَسْجُدُوا۟ لِلشَّمْسِ
وَلَا لِلْقَمَرِ وَٱسْجُدُوا۟ لِلَّهِ ٱلَّذِى خَلَقَهُنَّ إِن كُنتُمْ
إِيَّاهُ تَعْبُدُونَ ﴿٣٧﴾ فَإِنِ ٱسْتَكْبَرُوا۟ فَٱلَّذِينَ عِندَ
رَبِّكَ يُسَبِّحُونَ لَهُۥ بِٱلَّيْلِ وَٱلنَّهَارِ وَهُمْ لَا يَسْـَٔمُونَ ﴿٣٨﴾ سجدة
٤٨٠

poshtëruan ne, duke na devijuar nga e mira për të na drejtuar tek e keqja, ashtu na jep mundësinë që t'i vëmë poshtë këmbëve tona!"

Në këtë ajet tregohet urrejtja e madhe që dy palët, pasues dhe të pasuar, do të kenë në Zjarr ndaj njëri-tjetrit. Ata do mallkojnë dhe do të distancohen nga njëri-tjetri.

Ajetet 30 – 32

30. S'ka dyshim se atyre që thonë: "Allahu është Zoti ynë", dhe pastaj tregohen të palëkundur në këtë, do t'u zbresin engjëjt *(e do t'u thonë)*: "Mos u frikësoni, mos u pikëlloni, por gëzohuni me Xhenetin, që ju është premtuar!

31. Ne jemi miqtë tuaj, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër. Atje ju do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka që kërkoni.

32. Kjo është pritje e nderuar prej Falësit e Mëshiruesit!"

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar sjell një lajm të gëzuar për të dashurit e Tij të zgjedhur, për besimtarët e devotshëm dhe të sinqertë. Kështu, Ai kalit vullnetin e tyre dhe nxit tek ata ambicien për punë të mira dhe për bindje ndaj Tij. Kjo është, gjithashtu, një nxitje për të gjithë, që të bëhen si ata. Ai thotë:

- **"S'ka dyshim se atyre që thonë: "Allahu është Zoti ynë", dhe pastaj tregohen të palëkundur në këtë..."** – Të tillët e pranojnë me zemër, e dëshmojnë me fjalë dhe janë të kënaqur që Allahu është Zoti, Sunduesi, Pronari dhe Rregulluesi i çështjeve të krijesave. Gjithashtu, ata i nënshtrohen plotësisht urdhrit dhe vullnetit të Zotit të tyre. Përveç kësaj, ata janë sistematikë dhe të palëkundur në ndjekjen e rrugës së drejtë.

Ecja në rrugën e drejtë varet nga dy kushte: nga pasja e dijes së saktë dhe të sigurt prej Zotit dhe, së dyti, nga puna e sinqertë, në përputhje me atë dituri.

Domethënë, për të tillë njerëz është lajmi i mirë në dynja dhe në ahiret, se:

- **"...do t'u zbresin engjëjt *(e do t'u thonë)*: "Mos u frikësoni, mos u pikëlloni, por gëzohuni me Xhenetin, që ju është premtuar!"** - Melekët zbresin tek këta të zgjedhur dhe i vizitojnë në çastet e vdekjes.

Engjëjt iu drejtohen besimtarëve, që po presin vdekjen, me fjalët më të ëmbla e qetësuese. Ata iu thonë: "Mos kini frikë nga ajo që ju pret pas vdekjes! Mos u trishtoni nga ato që kanë kaluar!" Kështu, ata i sigurojnë besimtarët se janë të shpëtuar nga

çdo e keqe që lidhet me të shkuarën apo me të ardhmen e tyre.

Më pas: "...gëzohuni me Xhenetin, që ju është premtuar!" – pra, gëzohuni, sepse Xheneti është i sigurt për ju, duke u zbatuar kështu premtimi i Zotit për robërit e Tij besimtarë.

Në vijim, duke i përgëzuar dhe qetësuar besimtarët, melekët u thonë:

- "Ne jemi miqtë tuaj, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër." - Në jetën e dynjasë, melekët i nxisin besimtarët për punë të mira dhe ua zbukurojnë ato në zemrat e tyre. Po ashtu, ata ua bëjnë të shëmtuar të keqen në zemër dhe i frikësojnë besimtarët që të mos e veprojnë atë. Engjëjt i luten Allahut për besimtarët, madje i mbështesin realisht ata në kohë sprovash dhe frike, e sidomos në momentet e vdekjes, në jetën e varrit, gjatë errësirës dhe vetmisë së tij, në Ditën e Kijametit, gjatë tmerreve të saj, në kalimin mbi Sirat etj. Madje, edhe në Xhenet ata nuk iu ndahen, por vazhdimisht i përgëzojnë dhe i urojnë për mirësitë dhe begatitë e Allahut të Lartësuar. Ata hyjnë nga çdo portë, sikurse thotë i Madhëruari: "Këtyre u takon shpërblimi në Shtëpinë e fundit: Xheneti i Adnit, ku do të hyjnë ata dhe prindërit, gratë dhe fëmijët e tyre, të cilët kanë qenë vepërmirë. Melekët do t'i vizitojnë ata, duke u hyrë nga çdo portë. (Iu thonë:) "Selamun alejkum! Me durimin tuaj gjetët shpëtimin. Sa përfundim i lavdishëm është ky vend!"" [Rad 22, 23, 24].

- "Atje ju do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka që kërkoni." - Në Xhenet, ata do të kenë gjithçka që ua dëshiron shpirti, gjëra të cilat do t'i gjejnë gati. Ata do të kërkojnë atje atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe që askush nuk ka mundësi ta përfytyrojë në këtë botë, dhe gjithçka që do kërkojnë do t'u jepet.

- "Kjo është pritje e nderuar prej Falësit e Mëshiruesit!" - I gjithë ky shpërblim kaq i madh, e gjithë kjo mirësi e përjetshme është begati dhe bujari e Allahut të Madhërishëm, i Cili përmend dy emra të mrekullueshëm të Tij. Ai është Falësi, i Cili fal gjynahet dhe mangësitë e robërve të Tij. Allahu është gjithashtu Mëshiruesi, i Cili jep forcën dhe suksesin për të vepruar çdo të mirë, dhe pastaj i pranon ato, pavarësisht nga mangësitë e tyre. Me faljen e Tij, Allahu largon të keqen prej njerëzve, ndërsa me mëshirën e Tij, Ai u mundëson të arrijnë të mirat dhe gjërat që dëshirojnë.

Ajeti 33

33. E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam musliman!"?

Shpjegimi i ajetit

- "E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut..." - Kjo është një pyetje së cilës i dihet përgjigjja. Pra, nuk ka më të mirë sesa fjala, qëndrimi dhe drejtimi i atyre që ftojnë në rrugën e Allahut. Këta të zgjedhur u mësojnë dijen e dobishme të paditurve, u tërheqin vëmendjen të pavëmendshmëve dhe atyre që i kanë kthyer shpinën të vërtetës. Ata përballen me armiqtë e të vërtetës me forcën e fjalës dhe të fakteve. Ata luftojnë për të bartur dhe përcjellë të vërtetën e Zotit ndër njerëz. Ata këshillojnë që të adhurohet Allahu si Një i vetëm, me çdo mënyrë të drejtë dhe të lejueshme, duke e zbukuruar këtë në zemrat e njerëzve. Ata qortojnë dhe paralajmërojnë për t'u larguar nga veprat e këqija, të ndaluara nga Zoti, duke qartësuar shëmtinë dhe dëmin e tyre për individin dhe

shoqërinë. Ata polemizojnë me armiqtë e të vërtetës me mënyrën më të mirë, për t'i ndaluar ata nga mohimi i Zotit, idhujtaria dhe nga mosbesimi i Shpalljes së Zotit dhe i Profetit të Tij. Ata urdhërojnë për tek e mira dhe ndalojnë nga e keqja.

Ftesa e njerëzve në rrugën e Zotit bëhet me shumë mënyra dhe rrugë, si më poshtë:

- Njohja me Zotin, me madhështinë dhe lavdinë e Tij të plotë, ashtu sikurse është në të vërtetë.
- Futja në zemër e dashurisë për Zotin, duke përmendur mirësitë dhe begatitë e Tij të shumta, duke përmendur emrat, cilësitë dhe atributet e Tij të mrekullueshme, si edhe duke përmendur mëshirën dhe bujarinë e Tij të pakufishme.
- Njohja me adhurimet ndaj Zotit në formën më të mirë, ashtu siç janë në të vërtetë, duke i zbukuruar këto në sytë dhe zemrat e njerëzve.
- Nxitja e njerëzve që të ndriçohen nga dituria e madhe dhe e mrekullueshme që gjendet në Librin e Zotit dhe në traditën e Profetit të Tij të zgjedhur. Kjo bëhet duke inkurajuar për nxënien e kësaj diturie me çdo mënyrë të mundshme dhe të lejueshme.
- Nxitja për t'u pajisur me virtytet më të larta: për të qenë bamirës ndaj krijesave, falës dhe tolerantë, sa të keqen ta kthejnë me më të mirën e mundshme, duke mbajtur lidhjet farefisnore dhe për bamirësi ndaj prindërve e të afërmve.
- Përkujtimi dhe këshillimi i njerëzve në përgjithësi, në kohë adhurimesh dhe grumbullimesh, për gëzim apo hidhërim qoftë.

Një tjetër cilësi e këtyre të përzgjedhurve është:

- "...që bën vepra të mira..." – Pra, përveç ftesës së të tjerëve që ta adhurojnë Zotin si Një të vetëm, duke bërë punë të mira, ata janë të parët që nxitojnë dhe garojnë në kryerjen e këtyre punëve të mira. Ata janë të parët që e adhurojnë Allahun duke zbatuar porositë e Tij dhe duke qëndruar brenda kufijve të Tij, vetëm me qëllimin e pastër për të kënaqur Atë. Të tillët deklarohen:

- "Unë jam musliman!" – Kuptimi: Unë jam i nënshtruar ndaj urdhrave dhe udhëzimeve të Zotit. Unë jam pasues i përpiktë i rrugës së Tij.

Të sinqertët janë në gradat më të larta të adhuruesve të Zotit, sepse ata punojnë sinqerisht për të përsosur veten dhe të tjerët. Ata kanë pjesën më të madhe të përfitimit nga trashëgimia e Profetit (a.s.). Këta janë njerëzit më të mirë.

Ndërsa nga krahu tjetër janë njerëzit më të këqij, të cilët i ftojnë njerëzit në humbje, ku janë zhytur vetë, dhe në skutat e errëta të Shejtanit. Të parët qëndrojnë në gradat më të larta të *Ilijjin*-it, ndërsa të dytët janë zhytur në humnerat më të frikshme të *Sixhxhin*-it. Mes këtyre dy niveleve, ka grada dhe nivele të shumta, të cilat i di vetëm Allahu i Lartësuar, sepse Ai i ka krijuar dhe Ai i di me hollësi se çfarë bëjnë krijesat e Tij. I Lartësuari thotë: "Për secilin ka shkallë, sipas punëve që bëjnë. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që veprojnë." [En'am 132].

Ajetet 34 – 35

34. E mira nuk është e barabartë me të keqen, prandaj ktheje atë *(të keqen)* me mënyrën më të mirë, se atëherë edhe ai me të cilin ke njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.

35. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm; dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë virtyt të lartë.

Shpjegimi i ajeteve

- "E mira nuk është e barabartë me të keqen..." - Kurrë nuk mund të jenë të njëjta në vlerësim dhe shpërblim veprat e mira në bindje ndaj të Madhëruarit, duke synuar kënaqësinë e Tij dhe sipas porosive të Tij, me veprat e këqija, të cilat e zemërojnë të Madhëruarin. Po kështu, nuk janë të njëjta bamirësia ndaj krijesave dhe padrejtësia ndaj tyre. Ato nuk janë të njëjta në vlerësimin, sasi cilësi dhe as në shpërblimin që meritojnë. Në një ajet tjetër, i Madhërishmi thotë: "A nuk është shpërblimi i veprës së mirë veçse e mira!" [Er-rahman, 60]

Në vijim, Allahu i Madhëruar na urdhëron për një lloj shumë të veçantë të *ihsan*-it: bamirësia ndaj atyre që të kanë bërë keq. Kështu, i Urti e i Gjithëdijshmi thotë:

- "...ktheje atë *(të keqen)* me mënyrën më të mirë..." - Nëse ndonjëri sillet keq me ty, - dhe në mënyrë të veçantë kur kjo ndodh nga ata ndaj të cilëve ke përgjegjësi dhe detyrime ligjore, si të afërmit, miqtë e farefisi, - pra, nëse ndonjë nga ata sillet keq ndaj teje, me fjalë apo me vepra, ti ktheja me formën më të mirë të mundshme, duke bërë bamirësi ndaj tyre. Nëse ai i ndërpret lidhjet me ty, ti vazhdoi t'i mbash ato të lidhura, nëse të bën padrejtësi, ti fale, nëse flet kundër teje ose të shan në sy apo pas krahëve, mos bëj edhe ti të njëjtën gjë, por fale dhe toleroje. Madje, foli fjalë të mira, të buta dhe të ngrohta. Nëse ai të braktis dhe nuk të flet fare, ti jepi selam e mundohu t'i drejtohesh me fjalë të buta dhe të ngrohta.


Nëse gjen forcën dhe durimin që të keqes t'i përgjigjesh me formën më të mirë, atëherë do të ndodhë diçka e mrekullueshme, për të cilën i Lartësuari thotë:

- "...se atëherë edhe ai me të cilin ke njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt." – Atëherë, ju do të jeni sikur mes jush nuk ka pasur asnjëherë armiqësi, por sikur keni qenë gjithmonë miq të ngushtë dhe të dashur.

Por kjo nuk është një arritje e thjeshtë. Ajo u jepet të zgjedhurve, për të cilët i Madhëruari thotë:

- "Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm..." Këtë virtyt të lartë mund ta arrijnë veç ata që e kanë kalitur durimin në vështirësi dhe e kanë nënshtruar shpirtin dhe trupin e tyre që të kryejnë veçse gjëra që Zoti i pëlqen. Natyrshëm, njeriu është i prirur që t'i kundërvihet të keqes me të keqe, duke mos falur. Është shumë e vështirë që ai thjesht ta falë tjetrin, e jo më t'i bëjë mirësi dhe t'i përgjigjet të keqes me të mirë, e aq më tepër me më të mirën e të mirës.

Robi duhet të kujtojë se, duke bërë durim, ai po zbaton urdhrin e Zotit të tij dhe se për këtë e pret një shpërblim i madh. Pastaj le të kujtojë se të kundërpërgjigjurit me të njëjtën monedhë nuk i sjell atij ndonjë përfitim, përkundrazi, ia shton edhe më tepër urrejtjen dhe armiqësinë e ndërsjelltë. Pastaj të kujtojë se, nëse ia kthen me më të mirën e të mirës, ai nuk e cenon aspak personalitetin e vet dhe kurrsesi të mos e shohë si dobësi. Madje, ta dijë mirë se kush tregohet modest për hir të Allahut, Allahu ka për ta ngritur


الجزء الرابع والعشرون سورة فصلت

وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦٓ أَنَّكَ تَرَى ٱلْأَرْضَ خَٰشِعَةً فَإِذَآ أَنزَلْنَا عَلَيْهَا ٱلْمَآءَ
ٱهْتَزَّتْ وَرَبَتْ ۚ إِنَّ ٱلَّذِىٓ أَحْيَاهَا لَمُحْىِ ٱلْمَوْتَىٰٓ ۚ إِنَّهُۥ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ
قَدِيرٌ ﴿٣٩﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ يُلْحِدُونَ فِىٓ ءَايَٰتِنَا لَا يَخْفَوْنَ عَلَيْنَا ۗ أَفَمَن
يُلْقَىٰ فِى ٱلنَّارِ خَيْرٌ أَم مَّن يَأْتِىٓ ءَامِنًا يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ ۚ ٱعْمَلُوا۟ مَا شِئْتُمْ
إِنَّهُۥ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٤٠﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ بِٱلذِّكْرِ لَمَّا جَآءَهُمْ ۖ
وَإِنَّهُۥ لَكِتَٰبٌ عَزِيزٌ ﴿٤١﴾ لَّا يَأْتِيهِ ٱلْبَٰطِلُ مِنۢ بَيْنِ يَدَيْهِ وَلَا مِنْ
خَلْفِهِۦ ۖ تَنزِيلٌ مِّنْ حَكِيمٍ حَمِيدٍ ﴿٤٢﴾ مَّا يُقَالُ لَكَ إِلَّا مَا قَدْ قِيلَ
لِلرُّسُلِ مِن قَبْلِكَ ۚ إِنَّ رَبَّكَ لَذُو مَغْفِرَةٍ وَذُو عِقَابٍ أَلِيمٍ
﴿٤٣﴾ وَلَوْ جَعَلْنَٰهُ قُرْءَانًا أَعْجَمِيًّا لَّقَالُوا۟ لَوْلَا فُصِّلَتْ ءَايَٰتُهُۥٓ ۖ
ءَا۬عْجَمِىٌّ وَعَرَبِىٌّ ۗ قُلْ هُوَ لِلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ هُدًى وَشِفَآءٌ ۖ وَٱلَّذِينَ
لَا يُؤْمِنُونَ فِىٓ ءَاذَانِهِمْ وَقْرٌ وَهُوَ عَلَيْهِمْ عَمًى ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ
يُنَادَوْنَ مِن مَّكَانٍۭ بَعِيدٍ ﴿٤٤﴾ وَلَقَدْ ءَاتَيْنَا مُوسَى ٱلْكِتَٰبَ
فَٱخْتُلِفَ فِيهِ ۚ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ مِن رَّبِّكَ لَقُضِىَ
بَيْنَهُمْ ۚ وَإِنَّهُمْ لَفِى شَكٍّ مِّنْهُ مُرِيبٍ ﴿٤٥﴾ مَّنْ عَمِلَ صَٰلِحًا
فَلِنَفْسِهِۦ ۖ وَمَنْ أَسَآءَ فَعَلَيْهَا ۗ وَمَا رَبُّكَ بِظَلَّٰمٍ لِّلْعَبِيدِ ﴿٤٦﴾

٤٨١

dhe krenuar atë. Përfundimisht, nëse robi i kujton dhe rikujton të gjitha këto, atij ka për t'iu lehtësuar durimi, madje do të bëjë bamirësi me kënaqësi të plotë dhe me një lehtësi të çuditshme.

- **"...dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë virtyt të lartë."** - Ky është një virtyt, të cilin e kanë veçse më të zgjedhurit e krijesave. Nëpërmjet të tilla virtytesh, robi lartësohet në dynja dhe në ahiret. Durimi dhe bamirësia qëndrojnë në krye të të gjitha virtyteve të larta. Ato janë cilësitë më të zgjedhura, që Allahu i Madhërishëm i pëlqen që t'i shohë te robërit e Tij.

Ajetet 36 – 39

36. E nëse ty të prek ndonjë ngacmim prej Shejtanit, ti kërko mbrojtje prej Allahut, se vërtet Ai është Dëgjuesi e i Dijshmi!

37. Nga faktet e madhështisë së Tij janë nata, dita, Dielli e Hëna. Mos i bëni sexhde as Diellit, as Hënës! Sexhde i bëni vetëm Allahut, i Cili i krijoi ato, nëse vërtet e adhuroni vetëm Atë!

38. Po nëse ata refuzojnë, atëherë ata që janë pranë Zotit tënd i bëjnë *tesbih* vetëm Atij, natën e ditën, dhe ata kurrë nuk mërziten me adhurimin.

39. Nga shenjat e Tij është edhe toka, që ti e sheh të thatë, e kur Ne i lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet. E s'ka dyshim se Ai që e gjallëron atë do t'i ngjallë të vdekurit, sepse Ai është i Plotpushtetshëm për çdo gjë.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi na mësoi se si t'i kundërvihemi dhe të shpëtojmë nga armiqësia e njerëzve, pra, duke ua kthyer të keqen me të mirë, Allahu i Lartësuar vijon të na mësojë si të mbrohemi nga armiqësia e xhindëve. Prej tyre mund të mbrohesh dhe të ruhesh veçse duke ia kërkuar këtë ndihmë Allahut të Madhëruar. Thotë i Lartësuari:

- **"E nëse ty të prek ndonjë ngacmim prej Shejtanit, ti kërko mbrojtje prej Allahut..."** - Nëse në ndonjë moment ndien ndonjë ngacmim prej Shejtanit të mallkuar, i cili ta zbukuron të keqen dhe të josh për ta vepruar atë, ose ta shëmton të mirën dhe të dembelos a të pengon që ta kryesh atë, ose të mbush me lloj-lloj vesvesesh të ndryshme të tij, atëherë menjëherë kërko mbrojtje tek i Gjithëmëshirshmi i Gjithëpushtetshmi, duke thënë: "*Eudhu bil-lahi minesh-shejtanir-raxhim*!". Lutju Allahut me përgjërim e përulje të plotë, si një rob i pafuqishëm, që të të ruajë prej sherrit të Shejtanit. Gjithashtu,

dije mirë se po i lutesh Atij që dëgjon gjithçka dhe di gjithçka:

- **"...se vërtet Ai është Dëgjuesi e i Dijshmi!"** - Ai e dëgjon lutjen dhe përgjërimin tënd. Allahu e di shumë mirë pafuqinë dhe nevojën tënde të domosdoshme për ndihmën e Tij.

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar përmend disa nga shenjat e Tij madhështore, të cilat tregojnë qartë për pushtetin e Tij të plotë mbi gjithçka, për sundimin dhe mbretërinë e Tij gjithëpërfshirëse dhe të gjerë, për mëshirën e Tij të pafundme, që ka përfshirë gjithçka. Në gjithësi ndodh ajo që Zoti dëshiron, me dijen, urtësinë, drejtësinë dhe mëshirën e Tij. Këto shenja tregojnë se Ai është i vetmi i Adhuruar me meritë. Askush tjetër nuk meriton adhurimin veç Tij. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Nga faktet e madhështisë së Tij janë nata, dita, Dielli e Hëna." - Gjatë ditës së ndritshme, njerëzit kërkojnë të përfitojnë prej begative të Allahut dhe të mbledhin prej mirësive të Tij. Ndërsa gjatë natës së errët dhe të qetë, ata qetësohen e çlodhen, që të rimarrin forcat për ditën e re.

Nëpërmjet dy krijesave të tjera të Zotit, Diellit dhe Hënës, bëhet e mundur jeta në tokë, pra, jeta e njerëzve, e kafshëve dhe e bimëve. Këto janë mirësi që nuk mund të mënjanohen dhe që vetëm Zoti që i krijoi i di me hollësi.

- "Mos i bëni sexhde as Diellit, as Hënës! Sexhde i bëni vetëm Allahut, i Cili i krijoi ato, nëse vërtet e adhuroni vetëm Atë!" - Ato janë thjesht krijesa të Allahut dhe të nënshtruara ndaj urdhrit dhe vullnetit të Tij dhe, si të tilla, ato nuk meritojnë që t'u biesh në sexhde, t'i adhurosh apo t'u nënshtrohesh me dashuri, madhërim, shpresë dhe frikë. Adhurimet i takojnë vetëm Allahut të Vetëm dhe të Pashoq, sepse vetëm Ai është Krijuesi dhe Sunduesi madhështor. Vetëm Allahu duhet të adhurohet, duke qëndruar sa më larg adhurimit të krijesave, sado të mëdha, të çuditshme apo të dobishme të duken ato. Në fakt, madhështia, mrekullia apo dobia e tyre janë dhunti që Zoti ua ka falur, prandaj vetëm Ai duhet lavdëruar e adhuruar për çdo mirësi.

Nëse njerëzit pretendojnë se adhurojnë një Zot të vetëm, atëherë vetëm Atij t'ia përkushtojnë çdo adhurim me sinqeritet, dashuri madhërim, bindje dhe nënshtrim. Ky është besimi i drejtë, kjo është e vetmja fe e pranueshme nga Allahu i Madhëruar.

- "Po nëse ata refuzojnë, atëherë ata që janë pranë Zotit tënd i bëjnë *tesbih* vetëm Atij, natën e ditën, dhe ata kurrë nuk mërziten me adhurimin." – Kuptimi: Nëse refuzojnë që të adhurojnë Allahun e Lartësuar dhe nuk i përulen Atij, le ta dinë se ata nuk mund ta cenojnë aspak madhështinë e Allahut. Allahu është jonevojtar për ta dhe për adhurimet e tyre. Nga ana tjetër, Allahu i Madhëuar ka krijuar robër të bindur, të cilët kurrë nuk e thyejnë urdhrin e Tij, por zbatojnë gjithçka që u urdhërohet. "Ata që janë pranë Zotit", domethënë melekët e Tij, e madhërojnë dhe e lavdërojnë me *tesbih* Atë natë e ditë, dhe kurrë nuk lodhen apo ta pakësojnë adhurimin. Ata janë shumë të fuqishëm, ashtu siç është e fuqishme edhe dashuria e tyre për Zotin, prandaj edhe përkushtimi i tyre është i pandërprerë.

- **"Nga shenjat e Tij është edhe toka, që ti e sheh të thatë, e kur Ne i lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet."** - Prej shenjave madhështore që dëshmojnë për pushtetin dhe mbretërinë e plotë të Allahut dhe për faktin se Ai është i Vetëm në sundimin dhe administrimin e çështjeve të krijesave, është edhe toka e tharë dhe e pajetë, e cila, kur Allahu i Lartësuar zbret shiun nga qielli, ajo ringjallet, merr jetë dhe fillon të gëlojë. Prej saj lulëzon bimësi e madhe, si furnizim për njerëzit dhe kafshët. Kështu zbret jeta nga qielli dhe përhapet begatia dhe gëzimi.

- **"E s'ka dyshim se Ai që e gjallëron atë do t'i ngjallë të vdekurit..."** – Kuptimi: Është po ky Krijues Madhështor, që kujdeset për ju dhe që risjell jetën në tokën e vdekur, Ai i Cili do t'i ringjallë të vdekurit e do t'i nxjerrë nga varret e tyre Ditën e Ringjalljes.

- "**Ai është i Plotpushtetshëm për çdo gjë."** – Pra, ashtu sikurse është i Plotpushtetshëm për të ringjallur tokën pas vdekjes së saj, po ashtu Allahu është i Plotpushtetshëm që të ringjallë të vdekurit nga varret e tyre.

Ajetet 40 – 42

40. Ata që shtrembërojnë ajetet Tona, nuk munden kurrë të na fshihen. Si mendoni, a është më i mirë ai që do të hidhet në Zjarr, apo ai që në Ditën e Kijametit do të vijë i sigurt? Veproni si të dëshironi, por ta dini se Ai është Shikues i gjithçkaje që ju punoni.
41. Ata që e mohojnë Përkujtimin, kur ai u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një libër i pacenueshëm.
42. Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë. Ai është Shpallje prej të Urtit e të Lavdishmit.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ata që shtrembërojnë ajetet Tona, nuk munden kurrë të na fshihen."** – Këtu flitet për shtrembërimin e të vërtetës së ajeteve të Allahut, me çfarëdolloj mënyre qoftë ajo. Mënyrat e shtrembërimit të së vërtetës që sjellin ajetet e Zotit janë të shumta, si për shembull:
- mohimi dhe refuzimi i plotë i ajeteve;
- mohimi i përcjellësve të këtyre ajeteve ose konsiderimi i tyre si gënjeshtarë;
- tjetërsimi i ajeteve, ndryshe nga ç'janë në realitet;
- shpjegimi i tyre me kuptime që Zoti kurrë nuk ka dashur apo synuar prej tyre.

Të gjithë ata që cenojnë ajetet e Tij në këto mënyra, Allahu i Madhëruar i kërcënon duke u kujtuar se ata nuk mund t'i fshihen kurrë Atij. Ai është Mbikëqyrësi i përhershëm i tyre, i cili u di dhe u sheh të jashtmen dhe të brendshmen. Le ta dinë ata se Ai do t'i shpagojë me drejtësi, për cenimin e ajeteve të Tij dhe për çdo gjë tjetër që kanë bërë.

- **"Si mendoni, a është më i mirë ai që do të hidhet në Zjarr, apo ai që në Ditën e Kijametit do të vijë i sigurt?"** - A janë njëlloj ata që do të hidhen në Zjarr - siç janë cenuesit e ajeteve të Zotit - me ata që në Ditën e Gjykimit do të vijnë të sigurt nga ndëshkimi i Zotit, duke merituar shpërblimin dhe begatitë e Tij? Sigurisht që dihet se cila është përgjigjja.

Më tej, Allahu i Madhëruar i paralajmëron robërit duke u thënë:

- "Veproni si të dëshironi, por ta dini se Ai është Shikues i gjithçkaje që ju punoni." – Bëni si të dëshironi: ose ndiqni rrugën e drejtë, e cila ju çon në kënaqësinë e Allahut dhe te Xheneti i Tij, ose ndiqni rrugën e mashtrimit, që ju çon në zemërimin e Allahut dhe në ndëshkim. Por gjithmonë kujtoni një të vërtetë të përhershme:

- "...ta dini se Ai është Shikues i gjithçkaje që ju punoni." - Allahu vështron dhe di gjithçka që ju veproni dhe synoni, dhe për këtë do t'ju shpërblejë me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij, secilin sipas veprave të veta. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Ata që e mohojnë Përkujtimin, kur ai u vjen, do të dënohen rëndë." - "Përkujtimi" është Kurani; kështu e ka quajtur Allahu i Madhëruar. Kurani është një libër që u përkujton dhe u mëson njerëzve çdo të mirë, në lidhje me fenë, dynjanë dhe ahiretin e tyre. Ai e lehtëson këdo që pason dhe zbaton udhëzimet dhe dritën e Tij. Sjellja e Kuranit është mirësi dhe begati e madhe nga Zoti. Atë e përcolli tek ne më i miri i krijesave të Zotit, Muhamedi (a.s.).

- "Ai është vërtet një libër i pacenueshëm." - Kurani është një libër me cilësi të mrekullueshme. Ai është i pacenueshëm, i ruajtur nga çdo mundësi tjetërsimi e ndryshimi. Për të përforcuar këtë fakt, i Lartësuari thotë më tej:

- "Atij nuk mund t'i mvishet e pavërteta nga asnjë anë." - Kuranit nuk mund t'i afrohen shejtanët, njerëz apo xhindë qofshin ata, për t'i hequr apo për t'i shtuar diçka që s'është e tij. Ai nuk mund të tjetërsohet dhe ndryshohet. Kurani është i sigurt dhe i ruajtur si në aspektin e tekstit, edhe në kuptimet që përcjell. Allahu që e shpalli këtë Kuran ka premtuar: "Ne e shpallëm Kuranin dhe Ne jemi mbrojtës të tij." [Hixhër 9]. Dhe, vërtet, Ai e ka ruajtur tekstin e këtij libri nga ndryshimet e tjetërsimet, ashtu siç ka ruajtur kuptimet dhe shpjegimet e tij nëpërmjet traditës dhe Sunetit të profetit Muhamed. Kështu është përcjellë ky Kuran nga zanafilla e tij, brez pas brezi, nën kujdesin e të Madhërishmit.

- "Ai është Shpallje prej të Urtit e të Lavdishmit." - Ai që e shpalli dhe e ruan këtë Kuran është *Hakim* - i Urtë. Ai është i Urtë si në krijimin, ashtu edhe në ligjin e urdhrat e Tij. Çdo gjë që Allahu ka krijuar dhe çdo ligj që ka vendosur është në vendin e vet.

Allahu është *Hamid* - i Lavdëruar për të gjithë ato cilësi të mrekullueshme dhe atribute të shkëlqyera, për drejtësinë dhe bamirësinë e Tij. Ai është Allahu i Vetëm e Absolut dhe e tillë është edhe fjala e Tij, Kurani madhështor. Kurani është fjala e Allahut, prandaj është i mbushur me urtësi të plotë. Nëpërmjet tij arrihet çdo mirësi dhe begati, e largohet çdo e keqe dhe fatkeqësi. Fjala e Tij është mirësia më e madhe për krijesat, për të cilën Ai duhet të lavdërohet e falënderohet.

Ajeti 43

43. Ty nuk po të thuhet gjë tjetër, veç asaj që u është thënë të dërguarve para teje. Vërtet, Zoti yt është Falës i madh, por edhe ndëshkimin e ka të dhimbshëm.

Shpjegimi i ajetit

- "Ty nuk po të thuhet gjë tjetër, veç asaj që u është thënë të dërguarve para teje." –

Kuptimi: Fjalët që drejtohen në adresën tënde, o i Dërguar, nga ana e atyre që e mohojnë Shpalljen hyjnore, janë të njëjta me shpifjet dhe fyerjet që u janë bërë të gjithë të dërguarve të Zotit.

Është e çuditshme se të gjithë popujt jobesimtarë dhe refuzues të së vërtetës i kanë trajtuar njëlloj të gjithë të dërguarit, të cilët i ftonin për të qenë të sinqertë në adhurimin e një Zoti të vetëm. Ata iu përgjigjën kësaj ftese të mrekullueshme me mënyrën më të shëmtuar. Shpesh ata thonin: "Ju jeni veçse njerëz, sikurse ne, dhe Allahu nuk ju ka shpallur asgjë. Ju jeni veçse mashtrues." [Ja sin 15]. Ndërsa herë të tjera, ata u kërkonin profetëve shenja dhe argumente të panevojshme, thjesht për të justifikuar refuzimin e tyre. Zemrat e tyre ishin të mbushura me mosbesim, prandaj ashtu ishin edhe fjalët e tyre.

Megjithatë, të gjithë profetët bënë durim kundrejt mundimeve dhe mohimeve, e kështu duhet të bënte durim edhe profeti Muhamed (a.s.) në rrugën e Zotit, në ftesën që u bënte njerëzve.

Në vijim, Allahu i Lartësuar fton në pendim dhe në çdo gjë që mundëson faljen dhe mëshirën e Tij. Ai, gjithashtu, kërcënon jobesimtarët që të mos vazhdojnë më në rrugën e humbjes, duke thënë:

- "Vërtet, Zoti yt është Falës i madh, por edhe ndëshkimin e ka të dhimbshëm." - Allahu është Falës i madh. Me faljen e Tij të madhe, Ai ua fshin gjynahet atyre që pendohen dhe ndalen nga gjynahet. Por, nga ana tjetër, edhe ndëshkimi i Tij është i rreptë për ata që vazhdojnë në gjynahe dhe tregohen kryeneçë.

Ajeti 44

44. Sikur ta kishim shpallur Kuranin në një gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Përse nuk janë të kuptueshme ajetet e tij? Përse, vallë, ai është në gjuhë të huaj, ndërkohë që ai është arab?!" Thuaju: "Ai, për besimtarët, është udhëzim e shërim. Ndërsa ata që nuk besojnë i kanë veshët të shurdhuar, dhe për ta ai është verbëri. Këta janë njësoj si të thirren prej një vendi të largët".

Shpjegimi i ajetit

- **"Sikur ta kishim shpallur Kuranin në një gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Përse nuk janë të kuptueshme ajetet e tij? Përse, vallë, ai është në gjuhë të huaj, ndërkohë që ai është arab?!""** - Allahu i Lartësuar na flet për mirësinë dhe bujarinë e Tij, kur i shpalli Kuranin në arabisht një profeti arab, domethënë me gjuhën e popullit të tij, me qëllim që ai t'ua përcillte sa më qartë fjalët dhe kuptimet e këtij libri. Ky fakt duhet t'i bëjë njerëzit që të përkujdesen më shumë për këtë Shpallje dhe t'i japin më shumë rëndësi asaj. Ata duhet që të nënshtrohen dhe ta zbatojnë atë.

Nëse Allahu i Madhëruar do ta shpallte Kuranin në një tjetër gjuhë, gënjeshtarët dhe refuzuesit e profetëve do të thonin: "Po pse të mos thuheshin më qartë ajetet e tij". Ata do të thoshin gjithashtu: "Si është e mundur?! Profeti arab, ndërsa Libri i tij me gjuhë tjetër?!" Por kjo nuk mund të ndodhte, prandaj i Madhëruari hedh poshtë çdo pretendim të mohuesve, duke e përshkruar Kuranin me cilësi të larta, që e bëjnë të detyrueshme nënshtrimin ndaj mësimeve të tij. Por, gjithsesi, ata që përfitojnë dhe lartësohen nëpërmjet Kuranit janë besimtarët, të cilëve Zoti u ka dhënë sukses dhe i ka ndihmuar që të kuptojnë të

vërtetën, me dritën e besimit që u ka dhuruar. Ndërsa mospërfillësit e Shpalljes dhe refuzuesit e profetëve, ndryshe nga besimtarët, janë të shurdhët ndaj mësimeve dhe udhëzimeve të tij. I Lartësuari thotë:

- "Thuaju: "Ai, për besimtarët, është udhëzim e shërim."" - Kurani i udhëzon besimtarët në rrugën e drejtë dhe u mëson dituri të dobishme, përmes të cilave ata ndriçohen dhe ecin të sigurt drejt Zotit dhe Xhenetit. Në Kuran, ata gjejnë shërimin e shpirtit dhe të trupit të tyre nga çdo sëmundje. Kurani i edukon ata që të ndalen nga çdo ves i ulët dhe vepër e shëmtuar. Ai i nxit dhe u jep forcë që të pendohen sinqerisht, që t'u pastrohen të gjitha gjynahet dhe t'u shërohen zemrat.

Ndërsa nga ana tjetër qëndrojnë të humburit:

- "Ndërsa ata që nuk besojnë i kanë veshët të shurdhuar, dhe për ta ai është verbëri." - Ata që nuk e besojnë Kuranin, që është prej Zotit, janë të shurdhët nga mësimet dhe udhëzimi që ai ofron dhe i kanë kthyer tërësisht shpinën atij. Ata nuk arrijnë që, nëpërmjet Kuranit, të shohin udhën e drejtë. Ata zhyten edhe më thellë në humbjen e tyre, duke e shtuar verbërinë që u ka zënë sytë.

- "Këta janë njësoj si të thirren prej një vendi të largët" - Ata thirren për të besuar të vërtetën, por nuk përgjigjen. Ata janë sikur i thërret dikush nga një vend shumë i largët, ku as zëri i thirësit nuk dëgjohet dhe as përgjigjja nuk është e mundur.

Kuptoje se ata të cilët nuk e besojnë Kuranin si një Shpallje të Zotit, nuk mund të përfitojnë nga udhëzimi dhe drita e tij. Ata nuk mund të ndriçohen dhe as të arrijnë të lumturohen me mrekullitë dhe begatitë e Kuranit. Janë ata vetë që ia mbyllin vetes portat e udhëzimit, duke i kthyer shpinën kësaj Shpalljeje dhe duke e refuzuar atë pa i dhënë as hakun më vogël.


Ajetet 45 – 46

45. Ne i dhamë edhe Musait një libër, lidhur me të cilin pati kundërshtime. Sikur të mos ishte vendimi i Zotit tënd i vendosur më parë, gjykimi ndaj tyre do të kryhej menjëherë. Me të vërtetë, ata janë në një dyshim të thellë rreth tij.
46. Kush bën mirë, bën mirë për veten e vet, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes së vet. Zoti yt nuk bën padrejtësi ndaj robërve.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne i dhamë edhe Musait një libër, lidhur me të cilin pati kundërshtime." – Kuptimi: Ashtu sikurse të dhamë ty një Libër, ashtu i dhamë edhe Musait, por njerëzit vepruan me të ashtu sikurse vepruan me ty. Ata u kundërshtuan mes tyre rreth Shpalljes së Zotit. Prej tyre pati që e besuan Shpalljen e Zotit, dhe kjo u bëri dobi dhe u udhëzuan. Por pati shumë që e refuzuan, dhe kështu ajo nuk u bëri dobi.

- "Sikur të mos ishte vendimi i Zotit tënd i vendosur më parë, gjykimi ndaj tyre do të kryhej menjëherë." - Me butësinë dhe mëshirën e Tij, Allahu i Lartësuar u la afat atyre. Sikur të mos ishte vendimi i Tij për vonimin e ndëshkimit të Ditës së Gjykimit deri në afatin e përcaktuar, pa e shpejtuar dhe pa e vonuar atë, çështja e këtyre të mjerëve do të kishte përfunduar. Me t'u bërë dallimi mes besimtarëve dhe mohuesve,



këta të fundit do të ndëshkoheshin menjëherë, sepse e kanë plotësuar kushtin. Duke mohuar dhe refuzuar Shpalljen e Zotit, për ta bëhet i detyrueshëm ndëshkimi.

- **"Me të vërtetë, ata janë në një dyshim të thellë rreth tij."** – Kuptimi: Dyshimet e tyre janë të thella e të mëdha, prandaj mohojnë.

- **"Kush bën mirë, bën mirë për veten e vet, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes së vet."** - Vepër e mirë është ajo që Zoti dhe Profeti i Tij e kanë porositur dhe urdhëruar. Pra, çdokush që bën një vepër të tillë do të marrë shpërblimin për të në dynja dhe në ahiret. Po kështu, çdokush që bën një punë të keqe, ai dëmton vetveten me të dhe bën të merituesëm ndëshkimin e tij në dynja dhe në ahiret.

Sigurisht, ky ajet është një nxitje për të kryer vepra të mira dhe për t'u larguar nga të këqijat. Gjithashtu, ai tregon se veprat e mira janë dobiprurëse dhe lumturuese për atë që i bën, ndërsa veprat e këqija janë dëmprurëse dhe dëshpëruese për atë që i bën. Dobia dhe dëmi i veprave të robit shfaqet si në dynja, edhe në ahiret. Përveç kësaj, ajeti tregon se askush nuk mban përgjegjësinë e tjetrit.

- **"Zoti yt nuk bën padrejtësi ndaj robërve."** - Askush nuk do të merret në përgjegjësi për gjynahet e të tjerëve, ashtu si nuk do t'i llogariten më shumë gjynahe sesa ka bërë.

Ajetet 47 – 48

47. Vetëm tek Ai është dituria për Orën e Kijametit. Asnjë fryt nuk del prej lëvozhgës së vet dhe asnjë femër nuk mbars e as nuk lind pa dijen e Tij. Ditën kur Ai t'i thërrasë njerëzit e t'u thotë: "Ku janë ata që i konsideronit si ortakët e Mi?" Ata do thonë: "Ne të kemi njohur vetëm Ty, e nuk ka ndonjë që dëshmon se ke shok!"

48. Kështu zhduken ata që adhuroheshin më parë, e ata binden se nuk kanë më shpëtim.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Vetëm tek Ai është dituria për Orën e Kijametit."** - Ky ajet na mëson rreth diturisë së gjerë të Allahut të Madhërishëm. Ai është i vetmi që di të fshehtat, siç është, për shembull, koha kur do të ndodhë Kijameti. Të gjitha krijesat, kur flasin për Kijametin, nuk mund të japin kohën e tij, por thonë se atë e di veç Zoti. As profetët, as melekët dhe askush tjetër nuk di gjë për këtë ngjarje të madhe.

- **"Asnjë fryt nuk del prej lëvozhgës së vet..." -** Allahu i Lartësuar di për çdo fryt që del nga sythi, nga çdo lloj bime që Ai ka krijuar. Dituria e Tij rreth çdo gjëje është e plotë dhe e imtësishme.

- "...dhe asnjë femër nuk mbars e as nuk lind pa dijen e Tij." - Çdo kafshë e çdo krijesë që bart është në diturinë e Zotit. Qoftë mbarsja, qoftë lindja e krijesave ndodh me dijen e Zotit. Ai di në imtësi për të dhe për gjithçka tjetër në dynja dhe ahiret. Atëherë, si është e mundur që idhujtarët përzgjedhin zota të tjerë, për t'i barazuar me Allahun e Gjithëdijshëm e të Gjithfuqishëm?! Si munden të barazojnë idhujt pa dije dhe të verbër, me Allahun e Lartësuar, që di dhe sheh gjithçka?

Për ta shfaqur qartë refuzimin e padrejtë të idhujtarëve ndaj të vërtetës dhe për të treguar dëshpërimin e tyre Ditën e Kijametit, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ditën kur Ai t'i thërrasë njerëzit e t'u thotë: "Ku janë ata që i konsideronit si ortakët e Mi?"" – Kuptimi: Ku janë idhujt tuaj, për të cilët pretendonit se janë ortakët e Allahut? Ku janë ata të cilët i adhuronit, madje prej tyre ju u kundërviheshit edhe profetëve!

- "Ata do thonë: "Ne të kemi njohur vetëm Ty, e nuk ka ndonjë që dëshmon se ke shok!"" - Ata do thonë: Ne tashmë të pranojmë vetëm Ty. Askush prej nesh nuk beson më në "hyjninë" e atyre idhujve të kotë. Ne e mohojmë adhurimin tonë "të kotë", që ua përkushtonim idhujve, dhe distancohemi nga ky krim.

- "Kështu zhduken ata që adhuroheshin më parë..." - Çdo gjë që ata kanë adhuruar veç Allahut do të zhduket. Çdo besim, për hir të së cilit kanë harxhuar jetën e tyre, do të zhduket. Çdo gjë që kanë adhuruar veç Allahut dhe mendonin se do t'u sillte dobi apo do t'i ruante, do të zhduket sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Kështu, do të dështojnë përpjekjet e tyre, do të shuhen shpresat dhe ëndrrat e tyre. Idhujt e tyre nuk do t'u vlejnë për asgjë. Në këto momente:

- "...ata binden se nuk kanë më shpëtim." – Për ta nuk ka më ndihmës apo shpëtimtarë, nuk ka më strehë, ku mund të futen e të mbrohen. Ky do të jetë përfundimi për ata që adhurojnë diçka tjetër veç Zotit. Allahu i Lartësuar i sjell këto paralajmërime, që robërit të ruhen nga idhujtaria dhe t'i përkushtohen vetëm Atij.

Ajetet 49 – 51

49. Njeriu nuk lodhet së luturi për mirë, por kur atë e godet e keqja, ai ligështohet shumë dhe humb e shpresën.
50. Nëse pas të këqijave që e godasin, Ne i dhurojmë mëshirë nga ana Jonë, ai padrejtësisht thotë: "Këtë e kam merituar vetë. Nuk besoj se do të ndodhë ndonjëherë Kijameti. Por edhe sikur të kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë mua më shumë të mira!" Por Ne, patjetër, do t'ua tregojmë mohuesve se çfarë kanë bërë dhe do t'u japim të vuajnë një ndëshkim të rëndë.
51. Kur Ne e begatojmë njeriun, ai nuk falënderon, por kthen shpinën. Por kur e godet e keqja, ai përulet dhe lutet shumë.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete na zbulojnë natyrën e njeriut, që është i paduruar, i paqëndrueshëm dhe i dobët. Ai është i paduruar qoftë në kryerjen e veprave të mira, qoftë në largimin nga të këqijat. Kjo është natyra e njerëzve në përgjithësi, përveç atyre që Zoti i nxjerr nga kjo gjendje, për t'u plotësuar me besim dhe punë të mira.

- "Njeriu nuk lodhet së luturi për mirë..." – Njeriu nuk resht asnjëherë së luturi për kërkesat dhe synimet e tij. Ai gjithmonë e lut Allahun për pasuri, mall, fëmijë e bukuri të tjera të kësaj dynjaje. Ai punon dhe shpenzon të gjithë energjitë e veta për t'ia arritur këtyre synimeve dhe gjithmonë është i pakënaqur, sado që të arrijë, pak apo shumë. Sado e madhe të jetë pasuria e dynjasë që ai zotëron, gjithmonë do të kërkojë shtesë.

- "...por kur atë e godet e keqja, ai ligështohet shumë dhe humb e shpresën." - Por kur goditet nga ndonjë e keqe, si sëmundje, varfëri etj., ai e humbet shpresën nga mëshira e Zotit dhe mendon se i ka ardhur fundi, duke e lëshuar veten e duke hequr dorë nga përpjekjet.

Kështu janë njerëzit në përgjithësi, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Ata, nëse u vijnë të mira dhe gjëra që i duan, falënderojnë Allahun, madje druhen se mos ndoshta këto mirësi bëhen gradualisht shkak për t'u kënaqur me këtë dynja dhe për të gjetur prehjen në të. Ndërsa kur i godet ndonjë sprovë në veten, pasuritë apo fëmijët e tyre, ata bëjnë durim, shpresojnë mëshirën dhe çlirimin nga Zoti i tyre dhe kurrë nuk e lëshojnë veten. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Nëse pas të këqijave që e godasin, Ne i dhurojmë mëshirë nga ana Jonë..." - Kur njeriut të padurueshëm, i cili lutet pa pushim vetëm për të mira, Allahu i Lartësuar i dhuron të mira ose e mëshiron duke ia larguar të këqijat, ai nuk e falënderon Allahun e Lartësuar, por tregon mospërfillje dhe i kalon kufijtë, duke thënë:

- "Këtë e kam merituar vetë." – Kuptimi: Kjo e mirë më erdhi sepse unë e meritoja atë. E kujt tjetër, veç meje, duhej t'i jepej kjo e mirë?! Kështu bëjnë mosmirënjohësit.

- "Nuk besoj se do të ndodhë ndonjëherë Kijameti." - Ky është, së pari, mohim i Ditës së Gjykimit nga ana e tij, pastaj është mosmirënjohje për mëshirën dhe mirësitë që Zoti i ka dhuruar.

- "Por edhe sikur të kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë mua më shumë të mira!" - Kuptimi: Edhe nëse e pranojmë se ringjallja është e vërtetë dhe unë dal para Zotit tim, atëherë sigurisht që kam për të gjetur sërish të mira. Ashtu sikurse po kënaqem me të gjitha këto mirësi në dynja, po ashtu do t'i kem edhe në ahiret. Këto fjalë janë tregues i paturpësisë dhe i guximit të tyre për të folur rreth Zotit pa dije. Prandaj i Madhëruari i kërcënon, duke thënë:

- "Por Ne, patjetër, do t'ua tregojmë mohuesve se çfarë kanë bërë dhe do t'u japim të vuajnë një ndëshkim të rëndë." - Allahu i Madhëruar e përshkruan ndëshkimin e tyre si '*ĝaliđh*', pra, shumë të ashpër.

- "Kur Ne e begatojmë njeriun, ai nuk falënderon, por kthen shpinën." - Allahu i Madhëruar e begaton njeriun me shëndet të mirë, me furnizim të bollshëm e me shumë mirësi të tjera, kurse ai i kthen shpinën Allahut dhe mirënjohjes ndaj Tij. Madje, Allahu i Madhëruar thotë: "*ue ne'â bi xhanibih*", që, fjalë për fjalë, do të thotë: "kthen shpinën, me arrogancë e vetëkënaqësi".

- "Por kur e godet e keqja, ai përulet dhe lutet shumë." - Por kur e godet sëmundja, skamja apo ndonjë sprovë tjetër, njeriu lutet e përgjërohet gjatë, për shkak të padurimit të tij. Ai është i padurueshëm gjatë vështirësive dhe mosmirënjohës gjatë mirësive, ndryshe nga ata që Zoti i ka udhëzuar dhe i ka privilegjuar.

Ajetet 52 – 54


52. Thuaj: "Më tregoni! Nëse ky është vërtet prej Allahut, ndërsa ju e mohoni atë, atëherë kush është në humbje më të madhe se ata që janë në kundërshtim të hapur me të?!"
53. Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin shenjat Tona në horizont dhe në veten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmues për çdo gjë?
54. Vërtet, ata janë në dyshim për takimin me Zotin e tyre, por le ta dinë se pushteti i Tij përfshin gjithçka.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Më tregoni! Nëse ky është vërtet prej Allahut, ndërsa ju e mohoni atë, atëherë kush është në humbje më të madhe se ata që janë në kundërshtim të hapur me të?!"" - Thuaju atyre që e mohojnë Kuranin dhe që nxitojnë të mohojnë Zotin, profetët dhe shpalljet e Tij: "Më tregoni! Nëse ky Kuran është Shpallje e Allahut të Lartësuar, – gjë për të cilën nuk ka asnjë dyshim, – dhe ju zgjidhni që ta mohoni atë, atëherë, a nuk është ky tregues i qartë për humbjen e thellë, ku keni rënë?! Pa dyshim, kjo është shprehje e mohimit dhe armiqësisë ndaj Allahut dhe Profetit, sepse ju keni devijuar nga e vërteta pasi ajo ju është bërë plotësisht e qartë. Ju e keni braktisur Shpalljen e Zotit jo për shkak se synoni të vërtetën dhe të drejtën, ashtu siç pretendoni, por për hir të së kotës dhe injorancës, prandaj, me këtë veprim, meritoni të jeni njerëzit më të humbur, më të devijuar dhe më të padrejtë.

- "Ne do t'ua bëjmë atyre të mundshme që t'i shohin shenjat Tona në horizont dhe në veten e tyre, derisa t'u bëhet e qartë se ai është i vërtetë." – Kuptimi: Nëse pretendoni se keni dyshime për saktësinë e kësaj Shpalljeje, atëherë dijeni se Allahu i Lartësuar ka për t'ju bërë të shihni shenjat e Tij në gjithësi, në qiell dhe në tokë, ose në ngjarjet madhështore, të cilat i japin dritë kujtdo që kërkon ta shohë të vërtetën. Gjithashtu, Allahu ju ka sjellë shenja e fakte edhe në vetet tuaja. Çdokush mund të shohë te vetja çuditë e krijimit të Allahut të Madhëruar, që të bindet për madhështinë dhe fuqinë e Tij. Nga ana tjetër, duke parë ndëshkimet me të cilat ai ka goditur mohuesit e të vërtetës, si dhe suksesin e mirësitë që u ka dhuruar besimtarëve, ju do të bindeni se Kurani dhe gjithçka që ai përmban është e vërteta e sigurt nga Zoti i Madhëruar.

Allahu i Lartësuar u ka dhënë gjithmonë shenja dhe argumente të shumta adhuruesve të Tij, nëpërmjet të cilave u jepet


الجزء الخامس والعشرون سورة الشورى

سُورَةُ الشُّورَىٰ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

حمٓ ﴿١﴾ عٓسٓقٓ ﴿٢﴾ كَذَٰلِكَ يُوحِيٓ إِلَيْكَ وَإِلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكَ
اللَّهُ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٣﴾ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ
وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ ﴿٤﴾ تَكَادُ السَّمَاوَاتُ يَتَفَطَّرْنَ مِن فَوْقِهِنَّ
وَالْمَلَائِكَةُ يُسَبِّحُونَ بِحَمْدِ رَبِّهِمْ وَيَسْتَغْفِرُونَ لِمَن فِي
الْأَرْضِ ۗ أَلَا إِنَّ اللَّهَ هُوَ الْغَفُورُ الرَّحِيمُ ﴿٥﴾ وَالَّذِينَ اتَّخَذُوا
مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ اللَّهُ حَفِيظٌ عَلَيْهِمْ وَمَا أَنتَ عَلَيْهِم بِوَكِيلٍ
﴿٦﴾ وَكَذَٰلِكَ أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ قُرْآنًا عَرَبِيًّا لِّتُنذِرَ أُمَّ الْقُرَىٰ وَمَنْ
حَوْلَهَا وَتُنذِرَ يَوْمَ الْجَمْعِ لَا رَيْبَ فِيهِ ۚ فَرِيقٌ فِي الْجَنَّةِ وَفَرِيقٌ فِي
السَّعِيرِ ﴿٧﴾ وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَهُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَٰكِن يُدْخِلُ مَن
يَشَاءُ فِي رَحْمَتِهِ ۚ وَالظَّالِمُونَ مَا لَهُم مِّن وَلِيٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٨﴾ أَمِ
اتَّخَذُوا مِن دُونِهِ أَوْلِيَاءَ ۖ فَاللَّهُ هُوَ الْوَلِيُّ وَهُوَ يُحْيِ الْمَوْتَىٰ وَهُوَ
عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿٩﴾ وَمَا اخْتَلَفْتُمْ فِيهِ مِن شَيْءٍ فَحُكْمُهُ
إِلَى اللَّهِ ۚ ذَٰلِكُمُ اللَّهُ رَبِّي عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ وَإِلَيْهِ أُنِيبُ ﴿١٠﴾

٤٨٣

siguri e plotë se Kurani është i vërtetë nga Zoti. Allahu i Lartësuar është i vetmi që jep dritën e imanit. Ai udhëzon atë që Ai dëshiron, me mëshirën dhe bujarinë e Tij, dhe e lë jashtë rruge Atë që Ai dëshiron, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij.

- **"A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmues për çdo gjë?"** - Kuptimi: A nuk u mjafton atyre që të binden se Kurani është i vërtetë dhe se njeriu që e përcolli atë është besnik, fakti që vetë Allahu dëshmon për një gjë të tillë? Vetë Allahu i Madhëruar dëshmon për vërtetësinë e Profetit (a.s.) dhe të Kuranit, dhe dihet se Allahu është Dëshmuesi i vërtetë. Përveç kësaj, për të provuar vërtetësinë e Kuranit dhe besnikërinë e Muhamedit (a.s.), Allahu i Lartësuar e ndihmoi dhe i dhuroi atij fitoren në botë. Kjo qe një shenjë e fortë dhe dëshmi e gjallë dhe e prekshme, për ata që meditojnë pak në historinë e Profetit dhe të kësaj feje madhështore.

- **"Vërtet, ata janë në dyshim për takimin me Zotin e tyre..."** - Ata janë të pasigurt për ringjalljen dhe për llogarinë në Ditën e Gjykimit. Për sytë e tyre ekziston veçse jeta e kësaj bote, prandaj ata nuk punojnë aspak për ahiretin dhe nuk i kushtojnë fare rëndësi atij. Por të mos harrojnë:

- **"...le ta dinë se pushteti i Tij përfshin gjithçka."** - Allahu i Madhërishëm përfshin gjithçka me dijen, pushtetin dhe krenarinë e Tij. Askush nuk del jashtë kësaj diturie dhe askush nuk mund t'i shmanget pushtetit të Fuqiplotit.

Këtu përfundon edhe tefsiri i sures Fussilet, me mirësinë e Allahut të Lartësuar!

Surja 42: Esh Shûrâ (mekase) 53 ajete

Ajetet 1 – 9

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Ha, Mim.**
2. **Ajn, Sin, Kaf.**
3. **Kështu të shpall ty, – ashtu si atyre që ishin para teje, – Allahu, Krenari, i Urti.**
4. **Vetëm e Tij është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë; Ai është i Larti, Madhështori!**
5. **Qiejt e lartë mbi ta, gati pëlcasin. Ndërkaq, engjëjt vazhdimisht bëjnë *tesbih*, duke e falënderuar Zotin e tyre, si edhe kërkojnë falje të gjynaheve për ata që janë në tokë. Ta dini se Allahu është Falësi e Mëshiruesi!**
6. **Për ata që veç Tij adhurojnë zota të tjerë, Allahu është mbikëqyrës i tyre. Ti nuk je përgjegjës për ta.**

7. **Ne ta shpallëm ty këtë Kuran në arabisht, që ta këshillosh Kryeqendrën dhe ato përreth saj, dhe t'u tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit, për të cilën nuk ka dyshim, kur një grup do të jetë për në Xhenet dhe një grup për në Zjarr.**
8. **Po të dëshironte, Allahu do t'i bënte ata një bashkësi të vetme, por Ai fut në mëshirën e Vet atë që do. Ndërsa jobesimtarët nuk kanë as miq dhe as ndihmës.**
9. **Mos vallë, ata zgjedhin mbrojtës të tjerë veç Atij, kur vetëm Allahu është Mbrojtësi, kur është Ai që ngjall të vdekurit dhe Fuqiploti për gjithçka!**

Shpjegimi i ajeteve

- **"*Ha, Mim. Ajn, Sin, Kaf.* Kështu të shpall ty, – ashtu si atyre që ishin para teje, – Allahu, Krenari, i Urti."** - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai ia shpalli Kuranin madhështor Profetit të Tij të zgjedhur, ashtu sikurse u shpalli edhe profetëve të tjerë para tij. Kështu, këtu shprehet mirësia e madhe që Allahu i Lartësuar i ka dhuruar njerëzimit me shpalljet e librave të shenjtë në mënyrë të vazhdueshme dhe me dërgimin e profetëve. Po ashtu, Allahu i Lartësuar na tregon se Muhamedi (a.s.) nuk qe i pari njeri që u zgjodh si profet. Tradita dhe gjendja e tij i përngjajnë traditës dhe gjendjes së të dërguarve paraardhës. Edhe Shpallja të cilën ai e përcolli prej Zotit të tij është e ngjashme me atë çka sollën edhe profetët para tij. Të gjitha shpalljet e Zotit janë të vërteta dhe të mbushura me mirësi, vërtetësi dhe drejtësi. Ato janë të tilla, sepse janë shpallje nga Ai që ka cilësitë absolute, si i vetmi i Adhuruar në qiell dhe në tokë, me fuqi, pushtet, krenari dhe urtësi të pakrahasueshme.

- **"Vetëm e Tij është ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë; Ai është i Larti, Madhështori!"** - Çdo botë që ekziston, bota e qiejve apo e tokës, është prona dhe mbretëria e Tij, e nënshtruar ndaj pushtetit dhe administrimit të Tij. Çdo gjë i nënshtrohet gjykimit të Allahut. Allahu i Lartësuar është *El Aliju* - i Larti. Ai është i Lartësuar në Qenien e Tij, në pushtetin e Tij dhe në sundimin e Tij. Allahu i Lartësuar është *El Aðhîm* - Madhështori. Madje, prej madhështisë së Tij:

- **"Qiejt e lartë mbi ta, gati pëlcasin."** - Me gjithë madhështinë dhe gjerësinë e tyre, qiejt gati sa nuk shpërbëhen e shkatërrohen.

- **"Ndërkaq, engjëjt vazhdimisht bëjnë *tesbih*, duke e falënderuar Zotin e tyre..."** - Engjëjt e pastër dhe të afruar tek Zoti i nënshtrohen të përulur madhështisë së Zotit të tyre. Ata shprehin varfërinë dhe përuljen e tyre kundrejt krenarisë së të Madhërishmit. Ata janë të nënshtruar dhe të bindur ndaj urdhrave të Allahut të Lartësuar. Ata e madhërojnë Allahun pandërprerë dhe e lartësojnë Atë nga çdo mangësi që ia përshkruajnë krijesat. Melekët e lavdërojnë Allahun, duke përmendur çdo cilësi të Tij madhështore dhe absolute.

- **"...si edhe kërkojnë falje të gjynaheve për ata që janë në tokë."** – Ata, gjithashtu, i kërkojnë falje Zotit për çdo gabim që kryhet prej banorëve të tokës, që nuk i shkon madhështisë dhe krenarisë së të Lartësuarit. Ata kërkojnë falje, edhe pse e dinë që Allahu i Lartësuar është Falës e Mëshirues.

- **Ta dini se Allahu është Falësi e Mëshiruesi!"** - Sikur të mos ishte falja dhe

mëshira e Allahut, krijesat do të shkatërroheshin e do të zhdukeshin.

Allahu i Lartësuar e përshkruan Veten me të tilla cilësi të shkëlqyera pikërisht pasi përmend faktin që është Ai i Cili u ka dhënë Shpallje profetëve në përgjithësi, dhe në mënyrë të veçantë profetit të përzgjedhur Muhamed (a.s.). Kjo përmendje e këtyre dy fakteve pranë njëri tjetrit jep një mesazh të rëndësishëm. Ajo tregon se Kurani madhështor përmban në vetvete argumente, shenja dhe fakte shumë të qarta, që tregojnë se Krijuesi i Lartësuar ka cilësi të larta dhe emra madhështorë. Nëpërmjet Kuranit, Ai na prezanton Veten me të gjithë emrat dhe atributet e Tij të shkëlqyera, që e mbushin zemrën e robit me dije të plotë rreth Tij, me dashuri për Zotin e vetëm në qiej dhe në Tokë, me madhërim dhe frikërespekt për Madhështorin, Krenarin e të Lartësuarin. Nga ky prezantim, të gjithë duhet t'ia drejtojnë adhurimet e tyre, të çfarëdolloji qofshin, veç Allahut të Lartësuar.

Çdokush që lexon Kuranin bindet dhe qartësohet se gjynahu më i rëndë është adhurimi i diçkaje tjetër veç Allahut, me dashuri, madhërim, nënshtrim dhe bindje. Është krim të adhurosh diçka që nuk ka në dorë as dëm e as dobi, as për veten e vet dhe as për të tjerët. Madje, gjithçka tjetër veç Allahut të Lartësuar është krijesë, dhe si e tillë, ajo është e nevojshme për ndihmën e Allahut të Lartësuar dhe përkujdesin e Tij. Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Për ata që veç Tij adhurojnë zota të tjerë..."** - Këta kanë parapëlqyer të zgjedhin miq dhe të dashur të tjerë, veç Allahut të Lartësuar. Këta u shprehin zotave të tyre të gjithë dashurinë, madhërimin, nënshtrimin dhe bindjen e vet. Ata i adhurojnë idhujt sikurse do duhej të adhuronin Allahun dhe u nënshtrohen atyre sikurse do duhej t'i nënshtroheshin Allahut. Por le ta kuptojnë këta të mjerë, se zotat që ata i adhurojnë dhe u nënshtrohen janë të kotë dhe të pafuqishëm t'u sjellin ndonjë dobi apo t'i ruajnë nga ndonjë e keqe. Ata zota kurrë nuk mund t'u përgjigjen lutjeve të tyre. Përveç kësaj, le të marrin vesh edhe diçka tjetër të frikshme, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- **"Allahu është Mbikëqyrës i tyre."** – Pra, jo vetëm që nuk përfitojnë gjë nga adhurimet dhe nënshtrimi ndaj idhujve, por Allahu i Lartësuar do t'ua regjistrojë dhe ruajë të gjitha veprat, dhe pastaj do t'i shpërblejë për mirë ose për keq.

- "Ti nuk je përgjegjës për ta." – Kuptimi: Nuk je ti kujdestari apo roja i tyre, që të pyesësh për veprat e tyre. Ti je veçse një përcjellës, një lajmërues, që e ka kryer detyrën e vet.

Pastaj Allahu i Lartësuar na përkujton mirësinë që Ai i dhuroi Muhamedit (a.s.) dhe njerëzimit me shpalljen e këtij Kurani. Ai thotë:

- "...Ne ta shpallëm ty këtë Kuran në arabisht, që ta këshillosh Kryeqendrën dhe ato përreth saj..." - Allahu i Lartësuar na kujton mirësinë e Tij të madhe me shpalljen e Kuranit në arabisht, me tekst dhe kuptime të qarta. Ai e shpalli këtë libër për të paralajmëruar dhe këshilluar Kryeqendrën, pra, Mekën. Madje, jo vetëm Mekën, por, edhe vendet që janë rreth saj, pra, të gjitha viset arabe, që më pas të përhapej në të gjithë botën. Kurani u shpall edhe për një qëllim tjetër:

- "...t'u tërheqësh vërejtjen për Ditën e Tubimit, për të cilën nuk ka dyshim..." - Ai u shpall për të paralajmëruar njerëzimin rreth Ditës së Tubimit. Atë ditë, Allahu i Lartësuar do të grumbullojë para Tij të parët dhe të fundit, për të dhënë llogari. Ai e zbriti Kuranin që të sigurojë njerëzit se ajo është një ditë për të cilën nuk ka asnjë dyshim. Atë ditë krijesat do të ndahen në dy grupe.

- "...kur një grup do të jetë për në Xhenet dhe një grup për në Zjarr." - Njëri grup do të jetë për në Xhenet. Këta janë ata që e besojnë Allahun e Lartësuar dhe, pa dyshim, të gjithë të dërguarit e Tij. Ndërsa grupi tjetër do të jetë në Zjarr. Këtu hyjnë të gjithë ata që mohojnë Zotin e gjithësisë dhe të dërguarit e Tij.

- "Po të dëshironte, Allahu do t'i bënte ata një bashkësi të vetme, por Ai fut në mëshirën e Vet atë që do." - Allahu i Lartësuar është i Plotfuqishëm për gjithçka. Po të donte, Ai i bënte të gjithë njerëzit të udhëzuar në rrugën e drejtë. Por Allahu Krenar dhe i Urtë dëshiron që në mëshirën e Tij të fusë ata që Ai dëshiron, duke i përzgjedhur dhe dalluar. Ndërsa të padrejtët, domethënë, ata që shkelin kufijtë e Zotit, ata të cilët nuk falënderojnë për mirësitë që u jepen dhe nuk bëjnë mirë, ata do të jenë të privuar nga mëshira e Zotit të gjithësisë. Për këta, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ndërsa jobesimtarët nuk kanë as miq dhe as ndihmës." - Për ata nuk do të ketë ndonjë mik, që t'i ndihmojë për ndonjë të mirë, dhe as ndihmës, që t'i ruajë nga e keqja që i pret.

- "Mos vallë, ata zgjedhin mbrojtës të tjerë veç Atij..." - Ata kanë zgjedhur zota të tjerë, veç Allahut të Lartësuar, të cilët i adhurojnë dhe u nënshtrohen. Por ky është një gabim shumë i ulët dhe i paarsyeshëm që ata bëjnë, sepse është Allahu i Lartësuar Ai që meriton të adhurohet, t'i bindesh dhe t'i nënshtrohesh.


- "...kur vetëm Allahu është Mbrojtësi..." - Pra, Allahu është *El Uelijj* – Mbrojtësi, i Dashuri ose Miku i besimtarëve. Allahu është Ai të Cilit duhet t'i përkushtohen të gjitha adhurimet. Allahu është *El Uelijj* për krijesat, që zbaton vendimet e Tij të drejta dhe plot mëshirë për ta. Ai përkujdeset në mënyrë të veçantë për adhuruesit e Tij të sinqertë, duke i nxjerrë ata prej errësirave në dritë. Me butësinë dhe mëshirën e Tij, Allahu është gjithmonë në ndihmë të besimtarëve, për çdo çështje të tyre.

- "...kur është Ai që ngjall të vdekurit dhe Fuqiploti për gjithçka!" - Është Allahu i Lartësuar që ka në dorë jetën dhe vdekjen. Është Ai që ka pushtetin e plotë mbi gjithçka. Vetëm Allahu jep jetë dhe vdekje dhe vetëm ajo që Ai dëshiron do të ndodhë. Atëherë, vetëm Ai e meriton adhurimin, dashurinë, madhërimin, bindjen dhe nënshtrimin tonë. Ai është i Vetëm dhe i Pashoq në çdo aspekt.

Ajetet 10 – 12

10. **Për çdo çështje që nuk pajtoheni, gjykimin për të e gjeni tek Allahu. "Ai është Allahu, Zoti im! Vetëm tek Ai mbështetem dhe vetëm Atij i drejtohem!"**

11. **Ai është Krijuesi i qiejve e i Tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte; edhe nga kafshët krijoi çifte, që t'ju**


الجزء الخامس والعشرون سورة الشورى

فَاطِرُ السَّمَٰوَٰتِ وَالْأَرْضِ ۚ جَعَلَ لَكُم مِّنْ أَنفُسِكُمْ أَزْوَاجًا
وَمِنَ الْأَنْعَٰمِ أَزْوَاجًا ۖ يَذْرَؤُكُمْ فِيهِ ۚ لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ ۖ وَهُوَ
السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ﴿١١﴾ لَهُۥ مَقَالِيدُ السَّمَٰوَٰتِ وَالْأَرْضِ ۖ يَبْسُطُ
الرِّزْقَ لِمَن يَشَآءُ وَيَقْدِرُ ۚ إِنَّهُۥ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٢﴾ ۞ شَرَعَ
لَكُم مِّنَ الدِّينِ مَا وَصَّىٰ بِهِۦ نُوحًا وَالَّذِىٓ أَوْحَيْنَآ إِلَيْكَ وَمَا
وَصَّيْنَا بِهِۦٓ إِبْرَٰهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰٓ ۖ أَنْ أَقِيمُوا۟ الدِّينَ
وَلَا تَتَفَرَّقُوا۟ فِيهِ ۚ كَبُرَ عَلَى الْمُشْرِكِينَ مَا تَدْعُوهُمْ إِلَيْهِ ۚ اللَّهُ
يَجْتَبِىٓ إِلَيْهِ مَن يَشَآءُ وَيَهْدِىٓ إِلَيْهِ مَن يُنِيبُ ﴿١٣﴾ وَمَا تَفَرَّقُوٓا۟
إِلَّا مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَهُمُ الْعِلْمُ بَغْيًۢا بَيْنَهُمْ ۚ وَلَوْلَا كَلِمَةٌ سَبَقَتْ
مِن رَّبِّكَ إِلَىٰٓ أَجَلٍ مُّسَمًّى لَّقُضِىَ بَيْنَهُمْ ۚ وَإِنَّ الَّذِينَ أُورِثُوا۟
الْكِتَٰبَ مِنۢ بَعْدِهِمْ لَفِى شَكٍّ مِّنْهُ مُرِيبٍ ﴿١٤﴾ فَلِذَٰلِكَ
فَادْعُ ۖ وَاسْتَقِمْ كَمَآ أُمِرْتَ ۖ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَآءَهُمْ ۖ وَقُلْ
ءَامَنتُ بِمَآ أَنزَلَ اللَّهُ مِن كِتَٰبٍ ۖ وَأُمِرْتُ لِأَعْدِلَ بَيْنَكُمُ ۖ
اللَّهُ رَبُّنَا وَرَبُّكُمْ ۖ لَنَآ أَعْمَٰلُنَا وَلَكُمْ أَعْمَٰلُكُمْ ۖ لَا حُجَّةَ
بَيْنَنَا وَبَيْنَكُمُ ۖ اللَّهُ يَجْمَعُ بَيْنَنَا ۖ وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿١٥﴾

٤٨٤

shumojë. Nuk ka të ngjashëm me Të; Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.

12. Të Tij janë çelësat e qiejve e të tokës. Ai ia liron rizkun atij që Ai do, dhe po Ai ia shtrëngon. Ai është i Dijshëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajeteve

- "Për çdo çështje që nuk pajtoheni, gjykimin për të e gjeni tek Allahu." – Kuptimi: Për çdo mospajtim që keni, qoftë për sa u përket çështjeve themelore të fesë, qoftë për ato më të imtat, të jeni të bindur se gjykimin e drejtë për to e ka dhënë Allahu i Lartësuar. Kësisoj, është detyrë për ju që ta kërkoni zgjidhjen në Librin e Allahut dhe në Traditën e Profetit (a.s.). Çdo udhëzim që përputhet me linjën e Kuranit dhe të Sunetit është udhëzim i drejtë, ndërsa çdo udhëzim që bie ndesh me mësimet e Kuranit dhe Sunetit është devijim dhe humbje e sigurt.

"**Ai është Allahu, Zoti im!**" - Ashtu sikurse e pranojmë që Allahu i Lartësuar është Zoti, Krijuesi, Furnizuesi dhe Administruesi, po ashtu duhet të kujtojmë dhe të pranojmë se Ai është i vetmi që sundon dhe gjykon mes krijesave të Tij, në të gjitha aspektet e jetës së tyre.

Nga ky ajet kuptohet se mendimi unanim i umetit islam është një argument i pakontestueshëm dhe i sigurt për çdo çështje, sepse Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'i kthehemi Librit të Tij dhe mësimeve të Profetit të Tij veçse në rastet e kundërshtimeve mes nesh. Ndërsa kur i gjithë umeti është unanim në një qëndrim, kjo mjafton për të treguar saktësinë e atij qëndrimi. Umeti islam është i ruajtur në atë mënyrë që nuk mund të jetë unanim në një mendim të gabuar dhe jo të drejtë. Por duhet kuptuar se, sigurisht, edhe unanimiteti rreth një çështjeje duhet të jetë i bazuar në Librin e Zotit dhe në Traditën e Profetit (a.s.).

- **"Vetëm tek Ai mbështetem dhe vetëm Atij i drejtohem!"** – Kuptimi: Vetëm tek Allahu i Lartësuar kërkoj mbështetje me zemrën time, për të arritur çdo të mirë dhe për t'u ruajtur nga çdo e keqe, duke pasur siguri të plotë se Ai do të m'i përgjigjet lutjeve të mia. Vetëm Atij i drejtohem, me zemrën dhe me trupin tim. Me gjithë qenien time i jam përkushtuar adhurimit dhe bindjes ndaj Allahut.

Adhurimi dhe mbështetja tek Allahu janë dy shtylla për njeriun, të cilat Allahu i Lartësuar i ka përmendur shpesh së bashku në Kuran. Me bashkërendimin e të dyjave, arrihet përsosmëria e robit. Me cenimin e tyre apo të njërës prej tyre, cenohet edhe përsosmëria e tij. Ja dy ajete të tjera, ku

adhurimi dhe mbështetja përmenden bashkë: "Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm tek t'i ndihmë kërkojmë". Dhe: "Vetëm Atë adhuroje dhe vetëm Atij mbështetju".

- "Ai është Krijuesi i qiejve e i tokës." – Allahu është Shpikësi dhe Krijuesi i tyre, me pushtetin, dëshirën dhe urtësinë e Tij.

- "Ai, nga lloji juaj, krijoi për ju bashkëshorte..." – Kuptimi: Allahu krijoi për ju bashkëshorte, që të gjeni qetësi dhe prehje në to, që prej jush të vijnë pasardhës e plot mirësi të tjera.

- "...edhe nga kafshët krijoi çifte..." – Të gjitha llojet e kafshëve Allahu i krijoi çift, mashkull dhe femër, që ato të shtohen dhe t'u bëjnë dobi njerëzve. Allahu i Lartësuar thotë se kafshët i krijoi për ne. Pra, qëllimi i ekzistencës së tyre është thjesht për të mirën dhe dobinë tonë.

- "...që t'ju shumojë." - Allahu i Lartësuar i krijoi njerëzit dhe kafshët çift, që mirësitë të shtohen sa më shumë.

- "**Nuk ka të ngjashëm me Të."** - Asgjë nuk i shëmbëllen Allahut të Lartësuar. Asnjë krijesë nuk është si Ai dhe nuk i përgjan Atij, as në Qenien e Tij, as në emrat, as në cilësitë dhe as në veprat e Tij. Emrat e Allahut janë të gjithë të bukur, ndërsa cilësitë e Tij janë absolutisht të larta dhe tregojnë madhështinë e Tij. Nëpërmjet veprave të Tij, Allahu i Lartësuar i solli në ekzistencë krijesat pa pasur nevojë për askënd. Ai nuk ka nevojë për shoqërues dhe ndihmës. Allahu nuk ka të ngjashëm, sepse Ai është i Vetëm dhe absolutisht i Plotë në çdo aspekt.

- "Ai është Dëgjuesi, Shikuesi." - Allahu është *Semîun* - Dëgjuesi i të gjitha zërave, në të gjitha gjuhët, kur ato luten për çdo nevojë. Ai është *Basîr* - Shikuesi absolut. Ai sheh edhe gjurmët e milingonës së zezë, kur ajo ecën mbi një shkëmb gjatë natës së errët. Ai sheh se si depërton ushqimi në trupat e krijesave më të vogla. Ai sheh edhe lëvizjen e ujit nëpër enët më të vogla të trupit.

Ky ajet dëshmon për saktësinë e *Ehli Suneti uel Xhemah* në besimin e tyre për emrat dhe cilësitë e Zotit. Ata pohojnë për Zotin çdo emër dhe cilësi të Tij, që Ai e ka pohuar për Veten e Tij dhe që Muhamedi (a.s.) e ka pohuar për Të. Por, nga ana tjetër, ata mohojnë përgjasimin apo shëmbëllimin e emrave dhe cilësive të Tij me emrat dhe cilësitë e krijesave. Ata i besojnë emrat dhe cilësitë e Tij, por besojnë se asnjë krijesë nuk i përngjet apo i shëmbëllen Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij.

- "Të Tij janë çelësat e qiejve e të Tokës." - Në dorën e Allahut është pushteti, mbretërimi dhe sundimi i qiejve dhe Tokës. Në dorën e Tij janë çelësat e mëshirës dhe të rizkut. Është Ai që dhuron mirësitë e dukshme dhe ato të fshehtat. Të gjitha krijesat janë të varfëra dhe kanë nevojë për Allahun e Lartësuar, që Ai t'u mundësojë dhe dhurojë arritjen e çdo të mire, si dhe t'i shpëtojë dhe mbrojë prej çdo dëmi e çdo të keqeje. Ata janë të gjithë të varfër dhe të nevojshëm për të Madhëruarin, në çdo çast dhe gjendje të jetës së tyre. Asnjë krijesë nuk ka qoftë edhe gjënë më të vogël nën pushtetin e vet. Sundimi i qiejve dhe i Tokës i takon të Gjithëfuqishmit, të Gjithëmëshirshmit.

Allahu i Lartësuar është Dhënësi dhe Privuesi, Ai sjell dobinë dhe dëmin. Çdo

mirësi mes krijesave është dhuratë e Tij. Gjithashtu, askush nuk mund ta largojë të keqen prej tyre veç Tij. Në një ajet të Kuranit, i Lartësuari thotë: "Atë që Allahu ua dhuron njerëzve nga mëshira e Tij, nuk ka kush që mund ta pengojë; e atë që Ai e ndal, nuk ka kush që mund ta lirojë veç Tij; Ai është Ngadhënjyesi, i Gjithëdijshmi." [Fatir 2].

Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Ai ia liron rizkun atij që Ai do, dhe po Ai ia shtrëngon." - Allahu i Lartësuar ia liron dhe shton rizkun kujt të dëshirojë, me urtësinë e Tij, dhe furnizon me larmi mirësish. Por, po me urtësinë e Tij, Allahu ia ngushton dhe pakëson rizkun atij që Ai dëshiron. Allahu i Lartësuar ia ngushton dikujt rizkun, aq sa të plotësojë vetëm nevojat e tij jetike, jo më shumë se kaq. Por dihet mirë se të gjitha këto përcaktime ndodhin në bazë të dijes dhe urtësisë së Tij absolute. Për këtë arsye, i Lartësuari dhe i Urti thotë më pas:

- **"Ai është i Dijshëm për gjithçka."** - Allahu është i Gjithëdijshëm për gjendjen e krijesave. Ai përcakton atë që duhet për cilindo, në bazë të urtësisë dhe kaderit të Tij të drejtë.

Ajeti 13

13. Ai ka caktuar për ju si fe atë me të cilën porositi Nuhun, atë që ta shpalli ty, si dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. ***(porosia ishte)*** **Praktikoni fenë e drejtë dhe mos u përçani në të! Për idhujtarët është rëndë kjo ku ju i ftoni. Allahu përzgjedh për të atë që Ai do dhe e udhëzon në të atë që i kthehet Atij.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Ai ka caktuar për ju si fe..." - Feja është mirësia më e madhe që Allahu u ka falur adhuruesve të Tij. Ai ka caktuar për ta fenë e përkryer, të mrekullueshme, më të pastrën dhe më të ndriturën. Kjo është feja Islame, të cilën Ai u ka falur më të zgjedhurve dhe më të mirëve ndër adhuruesit e Tij.

Madje, Allahu na tregon se kjo fe e ndritur ka qenë po ajo që Ai ua dhuroi edhe më të zgjedhurve ndër më të zgjedhurit, që ishin pesë profetët e Tij, emrat e të cilëve përmenden në këtë ajet.

- atë me të cilën porositi Nuhun, atë që ta shpalli ty, si dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. - Islami është feja e krijesave më të zgjedhura dhe më të larta. Pa dyshim, për këta njerëz të mrekullueshëm Allahu i Lartësuar do të zgjidhte fenë më të mrekullueshme. Madje, kjo fe do të ishte ajo që do të përkryente madhështinë e tyre. Pa Islamin, askush nuk do të lartësohej dhe nuk do të rregullohej. Islami është shtëpia e lumturisë dhe baza e përsosmërisë. Islami është pikërisht feja që na mëson ky libër i shenjtë, Kurani. Ai na fton që ta njëjësojmë Allahun e Lartësuar, të punojmë sipas porosive të Tij dhe të pajisemi me moralin që ai na mëson.

- ***(porosia ishte)*** **"Praktikoni fenë e drejtë..."** - Allahu i Lartësuar urdhëron që të zbatohen të gjitha ligjet dhe dispozitat e fesë, themelore apo jo qofshin ato. Ai urdhëron që të zbatojmë fenë në veten tonë dhe të përpiqemi sa më shumë për bamirësi ndaj njëri-tjetrit, duke bashkëpunuar për vepra të mira dhe jo për gjynahe dhe armiqësi.

- "...dhe mos u përçani në të!" - Synimi ynë të jetë gjithmonë uniteti, si për çështjet

themelore të fesë, edhe për degëzimet e saj. Nuk duhet të na përçajnë çështjet ku kemi mendime të ndryshme. Nuk duhet të bëhemi armiq të njëri tjetrit, ndërkohë që themeli ynë i përbashkët është Islami, njëjësimi i Allahut në adhurim dhe ndjekja e Traditës së Profetit (a.s.). Disa nga adhurimet apo ritet fetare që na ftojnë në bashkim janë haxhi, bajramet, namazet me xhemat, xhihadi etj., të cilat nuk janë të plota nëse besimtarët nuk grumbullohen bashkë për t'i kryer ato.

- "Për idhujtarët është rëndë kjo ku ju i ftoni." – Kuptimi: Për idhujtarët janë shumë të vështira ato gjëra në të cilat ti i fton. Kështu, ti i fton ata që të jenë të sinqertë në adhurimin e Allahut si Një të vetëm dhe të largohen nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Tij.

Njësimi i Zotit në adhurim dhe largimi nga idhujtaria është diçka shumë e vështirë për ta, sikurse thotë i Madhëruari në ajete të tjera: "Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë botën tjetër neveriten, e kur përmenden të tjerë, përveç Atij, ata gëzohen." [Zumer 45]. "A mendon ai (thonë idhujtarët) t'i bëjë zotat tanë një Zot të vetëm?! Vërtet, kjo është shumë e çuditshme!" [Sad 5]

- "Allahu përzgjedh për të atë që Ai do..." - Allahu i Urtë dhe i Gjithëditur përzgjedh mes krijesave të Tij atë që meriton të zgjidhet, për të bartur Shpalljen e Tij dhe për t'u bërë i zgjedhuri dhe i dashuri i Tij.

Nga kjo kuptohet se është pikërisht Allahu i Urtë dhe i Gjithëditur Ai që e përzgjodhi dhe e dalloi këtë umet mbi të gjithë umetet e tjera dhe përcaktoi për ta fenë më të mirë dhe më të plotë.

- "...dhe e udhëzon në të atë që i kthehet Atij." – Fjala është për kthimin tek Allahu i Lartësuar me pendesë dhe me sinqeritetin për t'iu bindur Atij. Është pikërisht kjo që kërkohet prej robit, nëse dëshiron të udhëzohet. Nëse robi pendohet sinqerisht tek Allahu, ai do të mund ta gjejë udhëzimin e plotë, që është dhuratë prej Allahut të Lartësuar. Nëse robi kthehet tek Zoti i tij, duke u penduar sinqerisht për gabimet e tij dhe me angazhimin për të bërë çdo gjë që e kënaq Allahun, atëherë ka bërë kthim të vërtetë tek Zoti i tij. Sinqeriteti i robit në qëllimin e tij për të arritur udhëzimin e vërtetë të Zotit dhe përpjekjet e mjaftueshme për arritjen e tij, janë nga shkaqet më të mrekullueshme që e lehtësojnë dhe e bëjnë të mundur arritjen e udhëzimit. Për hir të përpjekjeve të sinqerta të robit, Allahu i Lartësuar i dhuron atij udhëzimin e plotë, të cilin nuk mund t'ia japë askush tjetër veç Allahut. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Allahu udhëzon nëpërmjet tij *(Kuranit)* në rrugët e shpëtimit ata që kërkojnë kënaqësinë e Tij dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë, me ndihmën e Tij. Ai i udhëzon ata në një rrugë, që është e drejtë." [Maide 16]. Pra, jo çdokush që lexon Kuranin mund të gjejë rrugën e drejtë dhe udhëzimin e plotë. Udhëzimin e vërtetë e gjejnë vetëm ata që Zoti ua dhuron atë, pas përpjekjeve të tyre të sinqerta për t'u penduar dhe për t'iu bindur të Gjithëdijshmit e të Urtit. [6]

---

[6] Nuk ka dyshim se Allahu i madhërishëm është Krijuesi dhe Sunduesi i krijesave. Nuk ndodh asgjë në qiell dhe në tokë pa lejën dhe përcaktimin e Tij të urtë dhe të drejtë. Nuk ka dyshim gjithashtu edhe se udhëzimi është dhurata më e mirë që i Gjithëmëshirëshmi u ka dhuruar njerëzve. Udhëzimi

është dhuratë e të madhërishmit të cilën Ai e dhuron i bazuar në dijen e Tij absolute dhe urtësinë e Tij hyjnore. Thotë i Urti: "...është Allahu, Ai që jua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t'i urreni. Këta janë ata që gjetën rrugën e drejtë. Kjo është dhuratë dhe begati prej Allahut. Allahu është i gjithëdijshëm dhe i urtë. Huxhurat 7, 8. Ai e di më mirë se kush e meriton udhëzimin e Tij dhe kush jo.

Allahu i lartësuar askujt nuk i bën padrejtësi dhe është e papranueshme që, dikush të dojë rrugën e drejtë dhe i Gjithmëshirëshmi ta devijojë atë nga rruga e drejtë. Por i madhërishmi është i Drejtë dhe nuk është e pranueshme që Ai të gjykojë njëlloj si mirënjohësit e bindur ndaj Tij ashtu edhe përbuzësit e mirësive që shkelin dhe shpërfillin Kufijt e Tij. Thotë i lartësuari: A mos do t'i barazojmë ata që besuan dhe bënë vepra të mira me ata që bënë shkatërrime në tokë, apo do t'i konsiderojmë njësoj si të ruajturit prej të këqijave, si ata që janë mëkatarë?! Sad 28. Dhe thotë: Është e sigurt se për të devotshmit do të ketë tek Zoti i tyre kopshte të begatshme. A do t'i konsiderojmë kriminelët të barabartë me muslimanët?! Ç'është me ju, si gjykoni ashtu?! A mos keni ndonjë libër, e prej tij mësoni dhe se ju do të keni atje çka të dëshironi?! A mos keni ndonjë zotim të fortë prej Nesh që vazhdon deri në kijamet, se do ta arrini atë që gjykoni dhe dëshironi?! Kalem 34-39.

Allahu i lartësuar me urtësinë dhe drejtësinë e Tij absolute na ka njoftuar se pengesë për udhëzimin e plotë janë disa gjëra. Për ne është detyrë që të ruhemi prej tyre që të mos bëhemi shkak dhe pengesë që Ai të na dhurojë udhëzimin e Tij të plotë. Prej këtyre shkaqeve ndër më të rëndësishme janë: Dhulmi (padrejtësia) me të gjitha llojet e saj, fisku shfrenimi dhe shkelja e kufijve të Zotit, shpërfillja e ftesës së Allahut dhe porosive të Tij. Për këto i madhëruari thotë: "Allahu nuk e udhëzon në udhën e drejtë një popull të pa drejtë" *(dhulmi)*. Thotë gjithashtu: "Allahu nuk e udhëzon në udhën e drejtë një popull të shfrenuar *(që shkel kufijtë e zotit)*". Dhe thotë i lartësuari: "Por kur ata u shmangën *(nga e verteta)*, Allahu ua largoi Zemrat e tyre *(nga besimi)*. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë *(të pa bindur, të pa nënshtruar)*". Saf 5

Allahu i lartësuar ka përcaktuar si udhëzues Kur'anin famëlart dhe na ka njoftuar se vetëm ai që e mori udhëzimin dhe dritën prej tij është i udhëzuar në rrugën e drejtë. Ai e ka lehtësuar këtë Kur'an për të marë mësim, por jo të gjithë përfitojnë prej udhëzimit të tij. Kështu pra udhëzimi i Allahut të lartësuar për krijesat është dy llojesh: udhëzim i përgjithshëm dhe udhëzim i posaçëm. Përsa i përket udhëzimit të përgjithshëm (qartësimin dhe sqarimin e të vërtetës) Allahu i lartësuar atë ua ka ofruar të gjithëve, ndërsa udhëzimin e posaçëm nuk ia dhuron veçse atyre të cilët i përzgjodhi mes krijesave të Tij, i përzgjodhi me dijen e Tij absolute dhe urtësinë e Tij hyjnore. Për të fituar udhëzimin e plotë apo të posaçëm Allahu i lartësuar na ka mësuar se si të lutemi dhe këtë lutje e ka bërë të detyrueshme në çdo namaz. Ajo është lutja në zemër të sures Fatiha. Në varësi të çiltërsisë, sinqeritetit dhe përkushtimit të robit në këtë lutje do të jetë edhe suksesi që Zoti do ti japë atij dhe Zoti i madhërishëm është shumë më Bujar se lutjet tona. Kjo pra është pjesa e robit: lutje e sinqertë për të fituar udhëzimin e posaçëm ashtu sikurse të mësoi Krijuesi të lutesh.

Allahu i lartësuar thotë në një hadith Kudsij: "O robrit e mij! Të gjithë ju jeni të humbur përveç atyre që unë i kam udhëzuar. Kërkojeni udhëzimin prej meje, që t'ju udhëzoj". E pra, Allahu i lartësuar të gjithëve u ka dhënë mundësinë dhe aftësinë që të luten dhe të kërkojnë prej tij. Por dikush kërkon të mirën dhe udhëzimin dikush tjetër kërkon këtë dynja dhe plotësimin e dëshirave të tij ne të. Allahu askujt nuk i bën padrejtësi, por janë krijesat që me injorancën dhe nxitimin e tyre kërkojnë padrejtësinë. Le të sjellim këtu një fjalë të shejhul islam Ibnu Tejmije rreth rrëndësisë së kësaj lutjeje dhe nevojës së robit për të.

Shejhul islam thotë: "Ajo dua që është bërë e detyrueshme gjithmonë në çdo namaz, madje në çdo rekat namazi, farz apo nafile qoftë ai, është pikërisht duaja brenda fatihasë, nënës së Ḳur'ânit. Allahu i lartësuar na mëson që të lutemi dhe të themi:
Na udhëzo në rrugën e drejtë! Në rrugën e atyre të cilët i begatove, jo në rrugën e atyre që merituan Zemërimin dhe as në rrugën e të humburve.

Ai na udhëzon dhe porosit që të lutemi me këtë lutje sepse çdo njeri, çdo rob, është i varfër dhe ka nevojë të domosdoshme për atë që synon të realizojë kjo dua, pra për udhëzimin në rrugën e drejtë. Nuk mund të shpëtosh nga ndëshkimi dhe trishtimi veçse nëpërmjet kësaj duaje dhe nuk mund të arrish lumturinë veçse nëpërmjet saj. Ai të cilit i shpëtoi ky udhëzim do të jetë ose nga ata që merituan zemërimin e Zotit, ose nga ata që humbën rrugën dhe devijuan larg të vërtetës.

Ky udhëzim nuk mund të egzistojë veç nëse e mundëson dhe e dhuron Allahu i urtë dhe i gjithëdijshëm. Thotë i lartësuari duke e vërtetuar këtë


fakt: "Atë që Allahu e udhëzon ai është i udhëzuari dhe atë që Allahu e lë në humbje (nuk e udhëzon) për të nuk do të gjesh ndonjë mik udhëzues." Kehf 17. Në këtë ajet ka argument të qartë që hedh poshtë medhhebin e ḳaderij-jeve të cilët pretendojnë se robi nuk ka nevojë për këtë udhëzim që e jep vetëm Zoti. Ata pretendojne se robi mund të udhëzojë vetveten pa pasur nevojë për udhëzimin e Allahut të lartësuar. Pra robi sipas tyre është i plotpushtetshëm për të arritur edhe bindjen ndaj Zotit edhe për të mos iu bindur Atij dhe për këtë nuk ka asnjë nevojë që Zoti ta udhëzojë. Sipas tyre të gjithë janë njëlloj përsa i përket udhëzimit që marin prej Zotit dhe Ai nuk i ka dalluar besimtarët me ndonjë udhëzim të posaçëm vetëm për ta. Por këtë temë e kemi shtjelluar në tjetër vend.

Këtu kemi si qëllim të vërtetojmë faktin se çdo rob është gjithmonë i varfër dhe nevojtar që t'i ofrohet dhe mundësohet ky lloj udhëzimi. Disa thonë: "Besimtarët që Zoti i udhëzoi të besojnë nuk kanë më nevojë që të kërkojnë udhëzimin prej Tij. Të tjerë i përgjigjen kësaj duke thënë: Kur lutemi për udhëzim, ne në të vërtetë, thjesht kërkojmë forcimin e këtij udhëzimi të dhënë nga Zoti". Por si vërejtja dhe përgjigja nuk janë të drejta dhe të plota. Të dyja ato tregojnë për paditurinë e tyre për gjendjen e njeriut dhe asaj me çfarë ai është urdhëruar. Ŝirâtul musteḳîm rruga e drejtë shfaqet apo interpretohet duke kryer në çdo kohë dhe moment të jetës ato vepra dhe për të folur ato fjalë, për të cilat je urdhëruar dhe të largohesh nga çdo punë e fjalë prej së cilave je ndaluar. Rruga e drejtë nuk mund të realizohet derisa të robit t'i lindë një dëshirë e fortë për të punuar ato për të cilat urdhërohet dhe t'i lindë një urrejtje e fortë e mjaftueshme për tu larguar nga ato prej të cilave ndalohet. Kjo është ajo dija e shtjelluar dhe dëshira për të vepruar. Por kjo dije dhe kjo dëshirë nuk mund të përfytyrohet që të ndodhë përnjëheresh dhe në një moment të vetëm. Madje në çdo moment robi ka nevojë që Allahu i lartësuar të vendosë në zemrën e tij ato lloj njohurish dhe dëshirash (ambicje) për të zbatuar dhe punuar me atë dije në atë moment.

Po. Është e vërtetë që me pranimin e islamit ai ka arritur një nivel udhëzimi të përgjithshëm dhe dije të përgjithshme rreth faktit që Ḳur'âni është Ĥaḳ, feja islame është Ĥaḳ, profeti i islamit është Ĥaḳ, etj si këto çështje të përgjithshme. Por ky udhëzim (dije dhe ambicje) i përgjithshëm shpesh herë nuk është i mjaftueshëm nëse atij nuk i dhurohet një udhëzim i shtjelluar në çdo çështje që atij i del para në jetën e tij, çështje në të cilat shumë krijesa devijojnë dhe çoroditen.

Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar thotë: "...dhe e udhëzon në të atë që i kthehet Atij.". Ndërsa në një ajet tjetër, i Lartësuari urdhëron e thotë: "...ndiqe rrugën e atyre që janë kthyer tek Unë!" Duke qenë se sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) ishin njerëzit që bënë kthimin më të plotë dhe më të sinqertë tek Allahu, këto ajete na japin të kuptojmë se qëndrimet dhe gjykimet e sahabëve janë baza mbi të cilat mund të ngresh gjykime fetare, sidomos kur flitet për Katër Kalifët e Drejtë, për pasimin e të cilëve na ka urdhëruar edhe Profeti (a.s.) shprehimisht kur ka thënë: "Ndiqni

Nëse nuk të ofrohet udhëzimi (dija dhe ambicja) i posaçëm do të mbizotërohesh nga epshet (dëshirat e shfrenuar dhe të devijuara) dhe dyshimet. Sepse dyshimet dhe epshet (dëshirat e shfrenuara) e mbizotërojnë zemrën e robit dhe kjo është natyra e tij gabimtare. Njeriu u krijua đhalûmen xhehûlâ i pa drejtë dhe i pa ditur. Pra ai është i orientuar dhe i prirur që të jetë i pa ditur dhe të anojë drejt plotësimit me çdo kusht të dëshirave qoftë edhe sikur të jenë të orjentuara drejt së keqes (sherrit). Pra duke qenë me një natyrë të tillë ai gjithmonë ka nevojë për një udhëzim të posaçëm që të largojë paditurinë e tij si dhe për një ambicje dhe dëshirë të fortë për drejtësi që të ekuilibrojë ndjenjat dhe veprimet e tij, të vendosë një raport të drejtë mes dashurisë dhe urrejtjes, kënaqësisë dhe zemërimit, veprimit dhe lënies (mos veprimit), dhënies dhe mos dhënies. Madje ai ka nevojë për një rregullator që ta ekuilibrojë atë në gjithçka që duhet të flasë dhe veprojë në këtë jetë dhe ta shpëtojë nga tendenca shumë e fuqishme e tij drejt đhulmit padrejtësisë. Nëse Allahu i urtë dhe i gjithëdijshëm nuk e pajis atë me dije dhe drejtësi të posaçme dhe të detajuar, në çdo moment të jetës së tij, ai pakthyeshmërisht do të anojë drejt natyrës së tij të padrejtë dhe të paditur dhe kjo do ta largojë nga ŝirâtul musteḳîm rruga e drejtë. ..." **Mexhmuatul fetaua 22 /**



udhëzimin tim dhe të kalifëve të drejtë pas meje!..” [7]

Ajetet 14 – 15

14. Po ata u përçanë mes njëri-tjetrit veçse pasi u erdhi e vërteta, për shkak të zilisë mes tyre. Sikur të mos ishte vendimi i hershëm i Zotit tënd për t'i lënë deri në një afat të caktuar, çështja e tyre do kish përfunduar. Nuk ka dyshim se ata që e kanë trashëguar deri tani Librin kanë dyshime të thella për të.

15. E pikërisht për këtë, ti fto të tjerët, ji i qëndrueshëm, ashtu si të është urdhëruar, dhe kurrë mos shko pas dëshirave të tyre. Thuaju: “Unë u besoj librave që Allahu ka shpallur dhe jam urdhëruar që të mbaj drejtësi mes jush! Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj! Ne kemi përgjegjësi për veprat tona e ju për veprat tuaja! Nuk ka polemika mes nesh e jush! Allahu do të na mbledhë të gjithëve dhe vetëm tek Ai është përfundimi!”

Shpjegimi i ajeteve

- “Po ata u përçanë mes njëri-tjetrit veçse pasi u erdhi e vërteta, për shkak të zilisë mes tyre.” - Pasi i urdhëroi muslimanët që të unifikojnë radhët e tyre dhe të mos përçahen në fe, Allahu i Lartësuar i porosit ata që të mos vetëkënaqen e të mjaftohen thjesht me faktin që Allahu i Lartësuar u shpalli atyre një libër që shtjellon gjithçka dhe që është garanci për ruajtjen nga humbja. Arsyeja është se edhe ndjekësit e librave të mëparshëm hynorë fillimisht e kishin librin e Zotit të plotë në duart e tyre, i cili u jepte porosi dhe u siguronte bashkimin, nëse do të besohej dhe zbatohej ashtu si duhej. Por ata, përkundrazi, u përçanë mes njëri-tjetrit, për shkak të zilisë dhe urrejtjes që mbanin në zemrat e tyre. Ata ushqyen urrejtjen dhe smirën kundër njëri-tjetrit, prandaj mes tyre lindi armiqësia dhe kundërshtimi rreth të vërtetës. Kështu ata i përçanë radhët e tyre. Prandaj, jini të kujdesshëm, o muslimanë, që të mos gaboni, sikurse gabuan ata!

- “Sikur të mos ishte vendimi i hershëm i Zotit tënd për t'i lënë deri në një afat të caktuar, çështja e tyre do kish përfunduar.” - Nëse nuk do të ishte vendimi i të Gjithëpushtetshmit për ta lënë në një afat ndëshkimin final, çështja e tyre do të kishte përfunduar. Por Allahu i Lartësuar, me mëshirën dhe urtësinë e Tij, ka vendosur që t’i lërë ata deri në afatin e caktuar.

[7] Ruga e drejtë është pasimi i Kuranit e Sunetit sipas metodologjise së sahabëve dhe brezave të parë të ummetit islam.

- "Nuk ka dyshim se ata që e kanë trashëguar deri tani Librin kanë dyshime të thella për të." - Edhe dijetarët që e trashëguan Librin hyjnor nga të parët e tyre janë në mospajtime dhe paqartësi të shumta, gjë kjo që sjell edhe përçarjen mes tyre. Nuk ka se si të ndodhë ndryshe. Kjo e ka zanafillën tek të parët e tyre, të cilët u përçanë për shkak të urrejtjes dhe smirës që kishin në zemra. Në disa ajete të tjera, Madhëruari tregon: "Për shkak se ata e thyen zotimin e dhënë, Ne i mallkuam dhe zemrat e tyre i bëmë të ashpra. Ata i ndryshuan fjalët *(në Teurat)* nga domethënia e tyre dhe e braktisën një pjesë të asaj Mirësie, me të cilën u ngarkuan. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përveç një pakice nga ata. Fali ata dhe, me butësi, tolero! Allahu i do ata që bëjnë mirë. Ne morëm zotimin edhe të atyre që thanë: "Ne jemi *nesara*", por edhe ata e harruan një pjesë të udhëzimit, prandaj Ne kemi ndërsyer ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje, deri në Ditën e Kijametit. Më pas, Allahu do t'ua shpalosë se çfarë kanë bërë." [Maide 13, 14].

Kështu, dyshimi dhe pasiguria në rrugën që ndjekin është cilësi që ata e trashëgojnë, dhe kjo, pa dyshim, do të bëjë që zemrat e tyre të jenë gjithmonë të përçara keqas.

- "E pikërisht për këtë, ti fto të tjerët..." - Pikërisht për këtë fe të drejtë, për të cilën Zoti shpalli librat qiellorë dhe dërgoi profetët, pikërisht për këtë nxite popullin tënd që ta besojë dhe pasojë, që ta praktikojnë në jetën e tyre dhe të ftojnë gjithë botën në përqafimin e saj! Pikërisht për këtë fe dhe besim të drejtë, që sjell mbarësinë, paqen dhe bashkimin, lufto këdo që qëndron si pengesë para saj apo që kërkon ta shkatërrojë!

- "...ji i qëndrueshëm, ashtu si të është urdhëruar..." - Ky është një urdhër që i drejtohet Profetit (a.s.) për *istiḳâmeh,* pra, për qëndrueshmëri dhe vazhdimësi në rrugën e Allahut, ashtu sikurse Ai ka urdhëruar. Kuptimi i ajetit është: Ji i qëndrueshëm në zbatimin e porosive të Zotit, ashtu sikurse Ai të ka urdhëruar, pa e tepruar, por edhe pa neglizhuar dhe pa bërë lëshime. Adhuroje Zotin tënd duke qenë i vazhdueshëm, sistematik dhe korrekt në zbatimin e urdhrave të Tij dhe në largimin nga ndalesat e Tij!

Ky është një urdhër i mrekullueshëm, që i Gjithëdituri jep në këtë Kuran. Ai është urdhër, nga njëra anë, për të plotësuar vetveten, duke qenë i vazhdueshëm dhe këmbëngulës në adhurimin e Zotit dhe, nga ana tjetër, për t'u përpjekur që të udhëzohen edhe të tjerët në adhurimin e një Zoti të vetëm, për të jetuar sipas porosive të Tij.

Ky urdhër vërtet i drejtohej Profetit, por - sikurse dihet - të gjithë urdhrat që Zoti ia ka drejtuar Profetit (a.s.) vlejnë edhe për umetin e tij, përveç rasteve kur ka dëshmi të qarta që ata kanë qenë të posaçëm vetëm për Profetin (a.s.).

- "...dhe kurrë mos shko pas dëshirave të tyre." – Kuptimi: Kurrsesi mos u bëj pasues i dëshirave dhe prirjeve të njerëzve të devijuar e të prishur: qafirë, munafikë idhujtarë apo çfarëdolloj qofshin ata.

Pasimi i tyre mund të bëhet me forma nga më të ndryshmet. Pasues i dëshirave të tyre mund të bëhesh duke ndjekur fenë a tyre apo një pjesë të saj, duke lënë thirrjen në rrugën e Allahut dhe në fenë e Tij të drejtë,

ose duke neglizhuar në zbatimin e urdhrave dhe kryerjen e ndalesave. Nëse i ndjek hapat e tyre, do të bëhesh si të padrejtët.

Vërej me kujdes! Allahu i Lartësuar thotë: "*mos shko pas dëshirave të tyre*", dhe jo: "*...mos paso fenë e tyre*!", sepse origjina e fesë së tyre është pikërisht feja që Zoti e solli nëpërmjet profetëve, por ata e kanë shtrembëruar dhe nuk e kanë zbatuar atë si duhej. Ata ndjekin dëshirat e tyre dhe e konsiderojnë fenë si lojë dhe si gjë të parëndësishme.

- "Thuaju: "Unë u besoj librave që Allahu ka shpallur..." - Kjo është një porosi e vyer rreth mënyrës së polemizimit me ta. Polemika me ta duhet të jetë e bazuar në një themel të rëndësishëm, që është besimi në të gjitha shpalljet e Allahut të Lartësuar. Kështu, atyre duhet të bëjmë të ditur se Islami na udhëzon që të besojmë të gjitha shpalljet hyjnore, dhe kjo tregon madhështinë, mirësinë dhe sigurinë e kësaj feje mbi të gjitha fetë e tjera. Madje, feja që ata pretendojnë se pasojnë nuk është gjë tjetër, por veçse një pjesë e Islamit. Feja Islame është feja e Zotit, e plotësuar dhe e ruajtur nga çdo devijim.

Nëse ithtarët e Librit kërkojnë që të polemizojnë me muslimanët mbi bazën e besimit të disa librave hyjnorë dhe mohimit të disa të tjerëve (në rastin konkret: të Kuranit), kjo është jo e drejtë dhe e papranueshme. Besimtar i vërtetë te Zoti është ai që i beson të gjitha shpalljet e Zotit dhe të gjithë profetët e Tij.

Në fakt, gabimi i ithtarëve të Librit është shumë i madh, sepse edhe profetët që ata pretendojnë se pasojnë janë urdhëruar dhe kanë urdhëruar popujt e tyre që të besojnë Profetin e Fundmë, Muhamedin (a.s.), dhe Librin madhështor që do t'i shpallej atij nga Zoti, pra, Kuranin famëlartë. Duke mohuar Muhamedin (a.s.), ata në të vërtetë kanë mohuar edhe profetin e tyre, që pretendojnë se e pasojnë. Duke mohuar Kuranin, ata kanë mohuar edhe librat që pretendojnë se i besojnë dhe zbatojnë. Nga ana tjetër, Kurani është mundësia e tyre e vetme për të vërtetuar saktësinë e atyre librave, apo më saktë, pjesë librash që u kanë mbetur në duar. Profeti ynë na ka urdhëruar që t'i besojmë të gjithë profetët e Zotit, mes të cilëve Musain e Isain. Ai na ka urdhëruar që të besojmë edhe Teuratin me Ungjillin, të cilët iu shpallën profetëve përkatës. Por, sidoqoftë, Kurani është e vetmja mundësi për të vërtetuar çfarë është e saktë në librat që kanë në duart e tyre dhe çfarë jo. I Lartësuari thotë: "O ithtarë të Librit, juve ju ka ardhur i Dërguari Ynë, që ju sqaron shumë gjëra që ju keni fshehur prej Librit, e që për shumë të tjera, ai fal. Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë. Allahu udhëzon nëpërmjet tij në rrugët e shpëtimit ata që kërkojnë kënaqësinë e Tij dhe i nxjerr ata prej errësirave në dritë, me ndihmën e Tij. Ai i udhëzon ata në një rrugë, që është e drejtë." [Maide 15, 16]. Ose: "19. O ithtarë të Librit, ja ku ju erdhi i Dërguari Ynë, që ju sqaron, pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi i dërguar që të na përgëzonte e të na tërhiqte vërejtjen". Ja, pra, ku ju erdhi Përgëzuesi dhe Paralajmëruesi. Allahu është i Fuqishëm për gjithçka." [Maide 19].

Kështu pra, muslimani është i urdhëruar që të besojë Teuratin dhe Ungjillin, – që iu shpallën respektivisht Musait dhe Isait, – për aq sa ato tekste janë në përputhje me Kuranin, dhe jo pjesët e tyre që janë shtrembëruar dhe keqinterpretuar nga

pasuesit e dëshirave personale, pa dritë e udhëzim prej Zotit.

- "...dhe jam urdhëruar që të mbaj drejtësi mes jush!" – Kuptimi: Unë jam urdhëruar që t'i gjykoj me drejtësi rastet kur ju keni mospajtime. Mua nuk më pengon armiqësia juaj ndaj meje që t'ju gjykoj me drejtësi, duke miratuar atë që është e saktë dhe e drejtë dhe duke refuzuar atë që është gabim dhe e pavërtetë. Kriteri i gjykimit të drejtë është Libri i Zotit tim.

- "Allahu është Zoti ynë dhe Zoti juaj! Ne kemi përgjegjësi për veprat tona e ju për veprat tuaja!" - Të gjithë jemi të barabartë përpara Zotit. Askush nuk ka ekskluzivitetin për të qenë adhurues i vërtetë i Tij. Ne kemi punët tona, të mira apo të këqija, për të cilat do të japim llogari, dhe ju keni punët tuaja, të mira apo të këqija, për të cilat do të jepni llogari. Dallimi qëndron në faktin se ku mbështetemi dhe ku e gjejmë udhëzimin. Pra, le të shohim mirë se nga i marrim udhëzimet për të adhuruar Zotin.

- "Nuk ka polemika mes nesh e jush!" - Nëse rruga e drejtë e Zotit është qartësuar, atëherë nuk mbetet më vend për polemika, por duhet që vendin e tyre ta zërë besimi i sinqertë dhe puna sipas udhëzimeve të Zotit.

Pas qartësimit të së vërtetës nga e kota, njerëzit ndahen në dy grupe: të sinqertët, që e besojnë dhe e pasojnë udhëzimin të drejtë, dhe pasuesit e dëshirave të veta, që nuk e duan të vërtetën dhe para të cilëve nuk ka mbetur asnjë justifikim që mund ta përdorin para Zotit të tyre.

Në fakt, këtu nuk është për qëllim që të ndërpritet dialogimi me ithtarët e librave hyjnorë të mëparshëm, por të zgjidhet mirë çështja që do të diskutohet dhe të përcaktohen rregulla të qarta në polemizimin me ta. Sigurisht, kushti i parë mbi të cilin duhet të ngrihet diskutimi duhet të jetë besimi në librat dhe profetët e Zotit, me kriteret e tyre përkatëse. I Lartësuari thotë: "Me ithtarët e Librit polemizoni veçse ashtu si është më e mira, me përjashtim të atyre që janë zullumqarë, duke iu thënë: "Ne i besojmë Shpalljes që na u zbrit neve dhe që ju zbriti juve. Zoti ynë dhe Zoti juaj është Një dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar." [Ankebut 46].

Kjo është detyra jonë në këtë jetë. Ndërsa në jetën tjetër:

- "Allahu do të na mbledhë të gjithëve dhe vetëm tek Ai është përfundimi!" – Pra, Ditën e Gjykimit është Allahu i Lartësuar dhe i Gjithëditur që do të gjykojë me drejtësi për veprat tona dhe për atë që besuam. Atë ditë do të dallohen të sinqertët nga gënjeshtarët, dhe secili do të shpërblehet me atë që e meriton.

Ajeti 16

16. Ata që kundërshtojnë fenë e Allahut, pasi ajo është pranuar, sjellin argumente që janë të pavlefshme te Zoti i tyre. Mbi ta do të bjerë zemërimi i Tij dhe do të kenë një dënim të rëndë.

Shpjegimi i ajetit

Ky është vazhdim dhe shpjegim i ajetit të mësipërm: "Nuk ka polemika mes nesh e jush!". Kështu, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Ata që kundërshtojnë fenë e Allahut, pasi ajo është pranuar..." – Domethënë, ata të cilët polemizojnë rreth Allahut dhe fesë së

drejtë me argumente të kota, të paqarta dhe të pabaza, – edhe pse këtë fe e kanë pranuar dhe ndjekur njerëzit e mençur, për shkak të argumenteve të qarta dhe fakteve të pamohueshme të saj, – në të vërtetë tregojnë se janë refuzues dhe armiq të së vërtetës, pasi ajo është bërë e qartë.

- "..sjellin argumente që janë të pavlefshme te Zoti i tyre." - Argumentet e tyre janë të kota, të pavlefshme dhe të papranueshme tek Zoti i tyre, sepse ato synojnë që të mohojnë dhe të fshehin të vërtetën, që Zoti dëshiron të përhapet ndër njerëz. Çdo gjë që kundërshton dhe lufton të vërtetën është e kotë dhe e gabuar. Ajo shkakton zemërimin e të Plotpushtetshmit dhe, më pas, ndëshkim të rëndë.

- "Mbi ta do të bjerë zemërimi i Tij dhe do të kenë një dënim të rëndë." - Ata e meritojnë këtë ndëshkim të rëndë, sepse i kanë kthyer shpinën udhëzimit të Zotit, që mbështetet në fakte të pakundërshtueshme.

Ajetet 17 – 18

17. Allahu është Ai që e zbriti Librin me të vërtetën e sigurt dhe me drejtësinë. Ti nuk mund ta dish: ndoshta çasti i Shkatërrimit është afër!
18. Ata që nuk i besojnë atij, kërkojnë që ai të vijë sa më shpejt, ndërsa ata që i besojnë, i druhen atij momenti, pasi e dinë se ai është e vërtetë. Ta dini se ata që bëjnë polemika, duke vënë në dyshim çastin e Katastrofës së Përgjithshme, janë në një humbje të thellë.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi bëri të ditur se argumentet e Tij janë të qarta, të padiskutueshme dhe të pranueshme nga çdokush që ka mirësi në shpirt, Allahu i Lartësuar tregon cilësitë themelore të Librit të Tij, madje të të gjitha shpalljeve që ai ka zbritur për njerëzit, që ata të mund të dallojnë lehtë të vërtetën nga e kota, të drejtën nga e padrejta:

- "Allahu është Ai që e zbriti Librin me të vërtetën e sigurt dhe me drejtësinë." - Libri që Zoti e shpalli për njerëzit është Kurani. Ai u shpall me të vërtetën e qartë dhe në mënyrë të sigurt, pra, nëpërmjet Xhibrilit - besnikut të engjëjve - tek Muhamedi - besniku i njerëzve. Kurani përmban drejtësinë, të vërtetën dhe dijen e sigurt nga çdo shtrembërim dhe dyshim. Ai është i gjithi i përbërë nga ajete të sqaruara plotësisht. Ajetet e tij janë thellësisht të kuptueshme dhe shtjellojnë çdo gjë që lidhet me besimin e drejtë dhe qëllimet hyjnore. Ai është treguesi më i mirë dhe më i besueshëm i rrugës së drejtë.

Kurani udhëzon te veprimet e drejta dhe na mëson që të gjykojmë me drejtësi, duke përdorur analogji të bazuar mbi rregulla të drejta dhe argumente logjike të drejta. Kjo do të thotë që, të gjitha gjykimet e drejta, të përftuara nga faktet e vëzhguara në vetet tona dhe në ambientin që na rrethon, në ligjet dhe rregullat e Sheriatit, në dispozitat dhe urtësitë e fesë apo në ligjësitë shkak-pasojë të kësaj bote, të gjitha këto, pra, hyjnë në drejtësinë që Zoti e zbriti për njerëzit, që ata të peshojnë dhe gjykojnë drejt çdo çështje të paqartë të tyre. Çdokush që, kur gjykon, nuk i përmbahet Librit të Zotit dhe logjikës së drejtë e të shëndoshë, ai nuk gjykon drejt, prandaj gjykimi i tij është i pavlefshëm. Kush gjykon duke mos u bazuar në Librin

hyjnor dhe në logjikën e drejtë (*mizan*) ka shembur themelet e gjykimit, dhe gjithçka e ndërtuar mbi themele të tilla është e rrënuar. Që të marrësh për bazë një tekst hyjnor, fillimisht duhet të vërtetosh saktësinë e burimit dhe besnikërinë e transmetimit të tij deri tek ne. Më pas, duhet të përzgjedhësh mënyrën e saktë të shpjegimit dhe interpretimit të tij. Kështu dallohet argumenti ligjor, mbi të cilin mund të ndërtosh gjykime, nga ai që nuk konsiderohet i tillë. Ndërsa ata që flasin me fjalë të bukura, por që nuk janë të bazuar në tekst hyjnor dhe në logjikë të drejtë, ata janë shumë larg të vërtetës dhe drejtësisë.

Më pas, Allahu i Lartësuar kërcënon ata që, në shenjë mosbesimi, kërkojnë përshpejtimin e Kijametit:

- "Ti nuk mund ta dish: ndoshta çasti i Shkatërrimit është afër!" – Momenti se kur do të ndodhë Kijameti nuk mund të përcaktohet nga ju. Ai pritet të ndodhë në çdo kohë, madje mund të jetë shumë shpejt.

- "Ata që nuk i besojnë atij, kërkojnë që ai të vijë sa më shpejt..." – Për të treguar mosbesimin e tyre, mohuesit e kësaj dite kërkojnë përshpejtimin e saj. Ndërsa besimtarët, ata që janë të sigurt për vërtetësinë e saj, i druhen Kijametit dhe punojnë për atë ditë.

- "...ndërsa ata që i besojnë, i druhen atij momenti, pasi e dinë se ai është e vërtetë." - Ata i druhen Kijametit, sepse e besojnë me siguri të plotë që ai do të ndodhë. Besimtarët e dinë mirë që atë ditë çdokush do të llogaritet dhe shpërblehet për veprat e tij. Ata druhen, sepse e njohin mirë Zotin e tyre, që është i Drejtë dhe i Gjithëdijshëm. Ai i di të gjitha veprat e tyre dhe di t'i llogarisë me drejtësi për çdo gjë që kanë bërë. E si mund të kenë dyshim për diçka që Zoti e ka thënë në Librin e Tij të vërtetë, në Kuranin madhështor?! Kijameti është i sigurt, prandaj lum ata që përgatiten për të dhe mjerë ata që e shpërfillin atë.

- "Ta dini se ata që bëjnë polemika, duke vënë në dyshim çastin e Katastrofës së Përgjithshme, janë në një humbje të thellë." - Edhe pse ata polemizojnë me profetët dhe pasuesit e tyre rreth vërtetësisë së këtij momenti, ata përsëri kanë dyshime. Ata janë shumë larg së vërtetës.

E ku ka humbje më të madhe sesa humbja e atij që nuk beson jetën e pasosur të ahiretit, atë jetë që u krijua për të qenë e tillë? Ajo është jeta në të cilën do të jepen shpërblimet e veprave. Në atë jetë, Allahu i Lartësuar do të shfaqë dukshëm dhe me të gjithë dimensionin e tyre, drejtësinë dhe bamirësinë e Tij mes krijesave. Madje, kjo jetë në dynja, në krahasim me atë të ahiretit, është si ai udhëtari që qëndron nën hijen e një peme për të pushuar, dhe pastaj ngrihet dhe e lë atë, për të vazhduar më tej udhëtimin e gjatë. Kjo dynja është thjesht një vend kalimtar, dhe jo një vendprehje.

Ndërsa mjeranët përkujdesen vetëm për këtë botë, e cila do të zhduket një ditë, dhe mohojnë ekzistencën e asaj tjetrës në ahiret, për të cilën janë shpallur të gjithë librat hyjnorë dhe janë dërguar të gjithë profetët e Zotit. Atë mohojnë jetën për të cilën janë sjellë lajme dhe fakte të sakta e të vërteta nga pasuesit e profetëve, deri në ditët e sotme. A nuk e mendojnë ata që profetët dhe pasuesit e tyre janë njerëzit më të ditur, më të mençur dhe më të urtë?! Atëherë, çfarë udhëzimi marrin parasysh?!

Ajetet 19 – 20

19. Allahu është Bamirës me robërit e Vet. Ai begaton atë që Ai do. Ai është i Gjithëfuqishmi e Ngadhënjyesi.
20. Atij që dëshiron fitimin në botën tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë fitim, ndërsa atij që dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne kemi për t'i dhënë prej tij, por në botën tjetër ai nuk ka më pjesë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Allahu është Bamirës me robërit e Vet."** – Këtu Allahu i Lartësuar na tregon se Ai është Bamirës, Bujar e i Dashur me robërit e Vet. Ai përkujdeset për ta, që ata ta njohin, ta duan, ta kërkojnë bamirësinë e Tij dhe ta arrijnë atë.

Bamirësia është një nga cilësitë e Allahut të Lartësuar, që tregon për dijen e Tij të thellë dhe të gjerë, për butësinë, mëshirën dhe përkujdesjen e Tij të madhe për krijesat. Është Ai që di në imtësi se çfarë fshehin gjokset dhe çdo të fshehtë tjetër. Është Allahu që i udhëzon dhe ua lehtëson robërve, në veçanti besimtarëve, rrugët e mirësive, rrugë që ata nuk i dinë dhe as nuk i mendojnë. Pikërisht prej bamirësisë së Tij, Ai i ka udhëzuar besimtarët, adhuruesit e Tij, ashtu si atyre kurrë nuk u shkonte ndër mend më parë, duke ua lehtësuar çdo shkak dhe ndihmues udhëzimi. Allahu u ka dhuruar atyre një natyrë të pastër. Ai i ka pajisur besimtarët me një dashuri të natyrshme për të vërtetën dhe me vullnet të mjaftueshëm për ta pasuar këtë të vërtetë. Është Allahu që i bën engjëjt e Tij të mbështesin e ndihmojnë besimtarët, t'i nxisin ata për vepra të mira dhe për bindje ndaj Tij, të hedhin në zemrat e tyre dashuri të mjaftueshme për fenë, punët e mira dhe për bindjen ndaj Tij, duke ua zbukuruar e lehtësuar të gjitha këto. Thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "…është Allahu Ai që jua bëri të dashur besimin dhe jua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin jua bëri që t'i urreni. Vetëm të tillët janë të udhëzuarit." [Huxhuratë 7]. Ose: "Ata të shprehin ty mirënjohje që u bënë muslimanë. Thuaju: "Pranimin tuaj të fesë Islame mos ma njihni mua, sepse është Allahu Ai që meriton mirënjohjen tuaj për udhëzimin tuaj në besim, nëse jeni të sinqertë". [Huxhuratë 17]. Prej bamirësisë së Allahut janë edhe rregullat e dispozitat e mrekullueshme, me të cilat Ai ndihmon besimtarët në plotësimin dhe ruajtjen e udhëzimit, që po Ai ua jep. Me këtë qëllim, për shembull, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët për disa adhurime kolektive, të cilat forcojnë vullnetin e tyre për të punuar, madje tek ta lind natyrshëm dëshira për të garuar në vepra të mira dhe për të përfituar nga virtytet e njëri-tjetrit.

Prej bamirësisë së Allahut është edhe fakti që Ai, me bujarinë dhe mëshirën e Tij, u mundëson robërve forcën, mundësinë, mjetet e kushtet e nevojshme për t'i penguar nga rruga e keqe dhe gjynahet. Kështu, Allahu i Gjithëditur e i Gjithëmëshirshëm e di mirë se dynjaja, pasuria dhe pushteti, për arritjen e të cilave garojnë njerëzit në përgjithësi, mund të bëhet pengesë për ndonjë adhurues, madje mund ta çojë atë në pakujdesi, poshtërsi dhe në largimin nga bindja dhe nënshtrimi ndaj Atij, prandaj me urtësinë dhe butësinë e Tij, Allahu ia largon ose ia pakëson ato. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë në vazhdim:

- "Ai begaton atë që Ai do. Ai është i Gjithëfuqishmi e Ngadhënjyesi." - Allahu u dhuron rizk robërve aq sa kërkon urtësia dhe bamirësia e Tij. Është Ai që zotëron begatitë e qiejve dhe të tokës, të dynjasë dhe ahiretit. Nuk ka fuqi për robin dhe ndryshim të gjendjes së tij pa ndihmën e të Plotfuqishmit e Ngadhënjyesit. Të gjithë janë të nënshtruar para pushtetit dhe sundimit të Tij gjithëpërfshirës. Pastaj i Lartësuari thotë:


- "Atij që dëshiron fitimin në botën tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë fitim..." - Çdokush që synon shpërblimin dhe mirësitë e ahiretit, duke i besuar ato dhe duke u përpjekur ashtu si duhet për arritjen e tyre, ka premtimin e pakthyeshëm se Allahu i Lartësuar do t'ia shtojë dhe shumëfishojë shpërblimin e punëve të tij. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Kush ka për qëllim botën tjetër, duke qenë besimtar dhe duke u përpjekur për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tij do të marrë shpërblim. [Isra 19]. Një njeri i tillë, edhe pse angazhohet me çështjet e ahiretit, nuk do humbë gjë nga pjesa e dynjasë, por do t'i jepet me bujari dhe mirësi.

- "...ndërsa atij që dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne kemi për t'i dhënë prej tij, por në botën tjetër ai nuk ka më pjesë." - Ndërsa ata që duan vetëm jetën e dynjasë, ata që me përpjekjet dhe mundin e tyre kanë qëllim vetëm këtë jetë, ata që nuk e besojnë ahiretin dhe nuk përpiqen për të, ata që nuk shpresojnë për shpërblimin në ahiret dhe nuk i ruhen ndëshkimit në të, ata kanë për të marrë prej kësaj dynjaje, – siç thotë Allahu i Lartësuar, – veçse atë që e kanë për pjesë nga ajo. Ndërsa në ahiret, ata nuk do ta shijojnë kurrë Xhenetin, nuk do të jetojnë mes mirësive të tij. Ata e kanë të ndaluar hyrjen në të, por do të ndëshkohen në Xhehenem. Ata, me mosbesimin dhe me veprat e tyre, do ta meritojnë Zjarrin dhe ndëshkimin në të.

Ky ajet u përngjan shumë disa ajeteve të tjera, si: "Kush ka për qëllim jetën e kësaj bote dhe të mirat e saj, Ne do t'ua plotësojmë atyre shpërblimin e veprave të tyre në të, dhe atyre nuk do t'u mungojë gjë. Por të këtillëve u përket vetëm Xhehenemi në botën tjetër. Gjithçka që ata kanë bërë do të humbasë dhe do të shkatërrohet." [Hud 15, 16]. Ose: "Atyre që kanë për qëllim vetëm këtë botë, Ne u japim në të – atyre që Ne duam – aq sa Ne duam, e pastaj i bëjmë të hyjnë në Xhehenem të nënçmuar e të përbuzur." [Isra 18].

Ajetet 21 – 23

21. Ata kanë miq, të cilët u përcaktojnë atyre një fe, të cilën nuk e ka vendosur Allahu. Sikur të mos ishte vendimi final, mbi ta do të kryhej dënimi. Por, pa dyshim, mohuesit do të kenë dënim të dhembshëm.
22. Ke për t'i parë jobesimtarët të tmerruar nga veprat e veta, por, sidoqoftë, ai do t'i godasë ata. Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të jenë në kopshtet e Xheneteve. Ata do të kenë gjithçka që dëshirojnë tek Zoti i tyre, dhe kjo është mirësia e madhe.
23. Kjo është ajo me të cilën Allahu i përgëzon adhuruesit e Tij, të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Thuaju: "Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time, përveç dashurisë për hir të afrimitetit.". Kush bën ndonjë të mirë, Ne e shtojmë mirësinë e saj. Vërtet, Allahu është Falës e Mirënjohës.


الجزء الخامس والعشرون سورة الشورى

ذَٰلِكَ ٱلَّذِى يُبَشِّرُ ٱللَّهُ عِبَادَهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ ۗ
قُل لَّآ أَسْـَٔلُكُمْ عَلَيْهِ أَجْرًا إِلَّا ٱلْمَوَدَّةَ فِى ٱلْقُرْبَىٰ ۗ وَمَن يَقْتَرِفْ
حَسَنَةً نَّزِدْ لَهُۥ فِيهَا حُسْنًا ۚ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ شَكُورٌ ﴿٢٣﴾ أَمْ يَقُولُونَ
ٱفْتَرَىٰ عَلَى ٱللَّهِ كَذِبًا ۖ فَإِن يَشَإِ ٱللَّهُ يَخْتِمْ عَلَىٰ قَلْبِكَ ۗ وَيَمْحُ ٱللَّهُ
ٱلْبَٰطِلَ وَيُحِقُّ ٱلْحَقَّ بِكَلِمَٰتِهِۦٓ ۚ إِنَّهُۥ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ ٱلصُّدُورِ ﴿٢٤﴾
وَهُوَ ٱلَّذِى يَقْبَلُ ٱلتَّوْبَةَ عَنْ عِبَادِهِۦ وَيَعْفُوا۟ عَنِ ٱلسَّيِّـَٔاتِ
وَيَعْلَمُ مَا تَفْعَلُونَ ﴿٢٥﴾ وَيَسْتَجِيبُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟
ٱلصَّٰلِحَٰتِ وَيَزِيدُهُم مِّن فَضْلِهِۦ ۚ وَٱلْكَٰفِرُونَ لَهُمْ عَذَابٌ
شَدِيدٌ ﴿٢٦﴾ ۞ وَلَوْ بَسَطَ ٱللَّهُ ٱلرِّزْقَ لِعِبَادِهِۦ لَبَغَوْا۟ فِى ٱلْأَرْضِ
وَلَٰكِن يُنَزِّلُ بِقَدَرٍ مَّا يَشَآءُ ۚ إِنَّهُۥ بِعِبَادِهِۦ خَبِيرٌۢ بَصِيرٌ ﴿٢٧﴾ وَهُوَ
ٱلَّذِى يُنَزِّلُ ٱلْغَيْثَ مِنۢ بَعْدِ مَا قَنَطُوا۟ وَيَنشُرُ رَحْمَتَهُۥ ۚ وَهُوَ ٱلْوَلِىُّ ٱلْحَمِيدُ
﴿٢٨﴾ وَمِنْ ءَايَٰتِهِۦ خَلْقُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَمَا بَثَّ فِيهِمَا مِن دَآبَّةٍ ۚ
وَهُوَ عَلَىٰ جَمْعِهِمْ إِذَا يَشَآءُ قَدِيرٌ ﴿٢٩﴾ وَمَآ أَصَٰبَكُم مِّن مُّصِيبَةٍ فَبِمَا
كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ وَيَعْفُوا۟ عَن كَثِيرٍ ﴿٣٠﴾ وَمَآ أَنتُم بِمُعْجِزِينَ
فِى ٱلْأَرْضِ ۖ وَمَا لَكُم مِّن دُونِ ٱللَّهِ مِن وَلِىٍّ وَلَا نَصِيرٍ ﴿٣١﴾

الجزء ٢٥
٤٨٦

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon se idhujtarët kanë miq të ngushtë shejtanët njerëz dhe xhindë, të cilëve iu binden atyre në vepra kufri dhe poshtërsie. Ata lidhin aleancë me ftuesit në mohimin e Zotit dhe në braktisjen e fesë së Tij.

- **"Ata kanë miq, të cilët u përcaktojnë atyre një fe, të cilën nuk e ka vendosur Allahu."** - Ata i urdhërojnë për idhujtari e për kufër. Ata ua bëjnë të lejuara ato gjëra që Zoti i ka ndaluar dhe ua ndalojnë ato gjëra që Zoti i ka lejuar. Ata i urdhërojnë për fjalë dhe vepra që përputhen me epshet dhe prirjet e tyre të shëmtuara dhe të shfrenuara.

Feja është programi i jetës që Allahu i Lartësuar e solli për njerëzit, që ata të nënshtrohen dhe ta zbatojnë në jetën e tyre dhe, nëpërmjet saj, të afrohen te Krijuesi i tyre, me adhurime dhe vepra të mira. Feja është e vetmja mënyrë që krijesat të jetojnë në paqe me Krijuesin. Prandaj, çdokush që sjell një fe apo sistem që kundërshton fenë e Zotit, duhet të braktiset menjëherë. Kështu duhet të sillemi edhe me ata që përçojnë udhëzime të devijuara, për të cilat nuk kanë mbështetje tek Allahu dhe Profeti.

Të mjerët, jo vetëm që pasojnë rrugët e humbjes, por bëhen edhe bashkëpunëtorë në këtë krim. Sigurisht, ata do të llogariten me drejtësi dhe do të marrin atë që meritojnë, por kur të vijë momenti i caktuar:

- **"Sikur të mos ishte vendimi final, mbi ta do të kryhej dënimi."** - Allahu i Lartësuar ka përcaktuar një afat, në të cilin Ai do të llogarisë me drejtësi veprat e robërve dhe do të vendosë drejtësinë në çdo çështje për të cilën krijesat kanë patur mospajtime. Për këtë arsye, Ai nuk i ndëshkon menjëherë ata që pengojnë njerëzit nga rruga dhe udhëzimi i Tij. Po të mos ishte ky vendim i hershëm i të Gjithëditurit, çështja e tyre do të merrte fund. Nëse nuk do të ishte afati që ka vendosur i Lartësuari, e drejta do të dilte në shesh menjëherë: të padrejtët do të ndëshkoheshin dhe të drejtët do të merrnin shpërblimin e tyre.

- **"Por, pa dyshim, mohuesit do të kenë dënim të dhembshëm."** - Pra, të mos mashtrohen nga ky afatizim, se përpara i pret një ndëshkim i rreptë.

Ajo ditë është shumë e vështirë dhe e frikshme. Pamjet e asaj dite janë vërtet të tmerrshme:

- **"Ke për t'i parë jobesimtarët të tmerruar nga veprat e veta..."** - Ata që i bëjnë padrejtësi vetes së tyre me kufër, idhujtari

apo me gjynahe të tjera, do t'i shikosh të llahtarisur prej veprave të veta, sepse do shohin ndëshkimin duke iu afruar.

Për të shuar çdo shpresë se ata mund të shpëtojnë nga ky tmerr, Allahu i Lartësuar na tregon se ndëshkimi do të godasë patjetër mbi ta, dhe ata assesi nuk mund të shpëtojnë:

- **"...por, sidoqoftë, ai do t'i godasë ata."** – Pra, ndëshkimi të cilit ata i frikësohen, do t'i godasë, sepse vetë me duart e tyre e bënë ndëshkimin të pakthyeshëm për ta, pa kryer asgjë që mund ta ndalonte këtë ndëshkim, siç mund të ishte pendimi ose kërkimi i faljes. Ata i ka kapur vdekja pa u penduar për poshtërsitë e tyre, dhe dihet se, pas vdekjes, nuk bëjnë më dobi vërejtjet.

- **"Kurse ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira..."** – Domethënë, ata që besojnë me zemër gjithçka që Zoti, përmes të dërguarve të Tij, ka urdhëruar të besohet. Ata besojnë Zotin, librat e Tij, profetët dhe udhëzimet e tyre. Por përveç bartjes së besimit në zemër, ata edhe e demonstrojnë këtë besim në jetën e tyre. Kështu, ata e shfaqin besimin te ndjenjat e tyre (siç është droja ndaj Zotit, shpresa tek Ai, dashuria për Të, dashuria dhe respekti për Profetin dhe besimtarët, mbështetja e plotë te Zoti etj.) dhe te veprat e tyre (si namazi, xhihadi, haxhi etj.), qofshin ato detyrime apo vepra vullnetare. Pra, ata që kanë besimin e drejtë, të bazuar në Shpalljen e Zotit, dhe që punojnë me sinqeritet për të kënaqur Zotin, kanë një premtim të ndryshëm nga ai i zullumqarëve:

- **"...do të jenë në kopshtet e Xhenetit."** - Ata do të jenë jo në kopshte dosido, por në kopshtet e Xhenetit. Mos pyet për bukurinë e këtyre kopshteve të lulëzuara, për lumenjtë që gurgullojnë me zhurmë të këndshme dhe qetësuese, për bimësinë e dendur dhe panoramat e mrekullueshme, për zogjtë cicërues dhe zërat e bukur që këndojnë, për takimet me të dashurit dhe për intimitetet e papërshkrueshme! Prej çdo lloj kënaqësie, atje do të provojnë më të lartën dhe më të plotën që mund të ekzistojë apo të përfytyrohet. Çdo ditë që kalon ia shton bukurinë dhe kënaqësinë asaj jete. Çdo ditë që kalon ua shton dashurinë dhe shijimin banorëve të saj për çdo kënaqësi të re që provojnë në të. Megjithatë, çfarëdo që të flasim, nuk mund të bëjmë një përshkrim të plotë. Mjafton të themi atë që thotë Allau i madhëruar:

- "Ata do të kenë gjithçka që dëshirojnë tek Zoti i tyre..." - Në Xhenet, ata do të kenë gjithçka që ua dëshiron shpirti i tyre dhe që kënaq vështrimet e tyre. Ata do të kenë atje çfarë syri nuk e ka parë, çfarë veshi nuk e ka dëgjuar dhe çfarë mendja nuk e ka menduar.

- **"...dhe kjo është mirësia e madhe."** - E ku ka mirësi më të madhe sesa të kesh arritur të kënaqësh të Gjithëmëshirshmin dhe të kesh fituar të drejtën për të jetuar pranë Tij, në përjetësi?!

- "Kjo është ajo me të cilën Allahu i përgëzon adhuruesit e Tij, të cilët besojnë dhe bëjnë vepra të mira." – Ky është përgëzimi më i madh i të Gjithëmëshirshmit e Mëshirëplotit, të cilin Ai ua përcolli njerëzve përmes më të mirit Profet dhe më të mirës Shpallje. Ky është përgëzimi i Kuranit për besimtarët, që kanë përqafuar fenë e drejtë, të bazuar në Shpalljen e paprekshme hyjnore, dhe të cilët punojnë me sinqeritet

sipas porosive të Profetit të Zotit. Ky është premtimi më i mrekullueshëm për ta dhe kjo është rruga që të çon tek ai.

- **"Thuaju: "Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time, përveç dashurisë për hir të afrimitetit."" –** Kuptimi: Unë, për kumtimin e këtij Kurani dhe për ftesën që ju t'u bindeni udhëzimeve të tij, nuk po ju kërkoj ndonjë shpërblim. Unë nuk po synoj që të marr pasurinë tuaj dhe as që të kem pushtet mbi ju. Unë nuk kam asnjë interes të tillë tek ju.

Por çfarë kuptimi ka: "...përveç dashurisë për hir të afrimitetit"? Kjo frazë mund të kuptohet në dy mënyra:

1. "Unë nuk pres për veten time asgjë nga ju, veç dashurisë dhe respektit për hir të farefisnisë."

Dihet se për çdo njeri është detyrë që ta dojë Profetin (a.s.) më shumë se çdo gjë tjetër, pas dashurisë për Zotin. Madje, dashuria për Zotin nuk është e vërtetë, nëse nuk do Muhamedin (a.s.). Por përveç kësaj dashurie, Profeti (a.s.) kërkoi prej fisit të tij, prej Kurejshve, që ta donin edhe për hir të farefisnisë. Thuhet se nuk ka degëzim të fisit të Kurejshëve që Profeti (a.s.) të mos ketë lidhje me të. Ky është njëri nga kuptimet e kësaj fraze. Ndërsa kuptimi tjetër mund të jetë:

2. "Me përpjekjet e mia për përhapjen e Kuranit dhe udhëzimeve të tij ndër ju, nuk synoj gjë tjetër, veç dashurisë së Allahu të Lartësuar për mua, dashuri që të afron tek i Madhëruari."

Gjithsesi, sido që të jetë kuptimi i saj, Profeti (a.s.) nuk kërkoi prej njerëzve asnjë lloj shpërblimi për veten e vet. Çdo gjë që ai kërkoi prej tyre ishte thjesht në dobi të tyre dhe konsiderohet si bamirësi e tij për këtë umet.

- "Kush bën ndonjë të mirë, Ne e shtojmë mirësinë e saj." - Çdokujt që bën ndonjë vepër të mirë si namaz, agjërim, haxh apo bamirësi ndaj krijesave, Allahu i Lartësuar i premton se do t'ia shtojë mirësinë mbi mirësitë që i ka dhënë.

Shtimi i mirësive vjen në forma të ndryshme. Për shembull, Allahu i Lartësuar i dhuron kënaqësi dhe qetësi shpirtërore, ia lehtëson çështjet, i jep rrugëzgjidhje për çdo nevojë, i hap dyert e suksesit për të tjera punë të mira, i jep vullnet dhe forcë të mjaftueshme për t'i shtuar veprat e mira dhe për t'u ngritur në grada, i jep një pozitë të veçantë dhe të lartë si në mbretërinë e qiellit, ashtu edhe ndër njerëzit në tokë. Allahu i dhuron shpërblim në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

- "Vërtet, Allahu është Falës e Mirënjohës." - Allahu i fal edhe gjynahet më të mëdha, nëse pendohesh sinqerisht dhe shpreh dëshirën për t'u kthyer tek Ai i bindur dhe i nënshtruar. Allahu tregohet Mirënjohës dhe Bujar i madh edhe për veprat me të vogla që kryen robi në emër të dashurisë për Të. Për punë të vogla, Ai jep shpërblim shumë të madh. Allahu është Falës, që, me faljen e Tij, e ndihmon robin për pendim të sinqertë, ia mbulon të metat dhe ia fshin të këqijat. Allahu është, gjithashtu, *Shekûr* – Mirënjohës, që, me mëshirën dhe bujarinë e Tij, i pranon veprat e mangëta të adhuruesve të penduar dhe e shumëfishon shpërblimin e Tij për ta.

Ajeti 24

24. A mos thonë ata se ai trillon gënjeshtra ndaj Allahut?! Po të dojë Allahu, Ai ta vulos zemrën tënde. Allahu e zhduk të pavërtetën dhe, me urdhrat e Tij, e forcon të vërtetën. Ai e di shumë mirë çfarë përmbajnë zemrat.

Shpjegimi i ajetit

- **"A mos thonë ata se ai trillon gënjeshtra ndaj Allahut?!"** - Ata që mohojnë Profetin, në shenjë arrogance dhe mosbesimi, shpifin kundër tij nga gjërat më të shëmtuara. Ata shpifin se Muhamedi (a.s.), thjesht pretendon se është i Dërguari i Zotit, por ai në të vërtetë është mashtrues.

Allahu i Lartësuar sjell me një pyetje, së cilës i dihet përgjigjja dhe e cila përmban në vetvete një lloj habije dhe kërcënimi për ata që bëjnë të tilla shpifje të ulëta. Ata e dinin shumë mirë sinqeritetin e Muhamedit (a.s.), të cilin e kishin emërtuar *El Emîn* – Besniku, që në kohën paraislamike. Pra, si është e mundur që ata bënin të tilla shpifje, që as vetë nuk i besonin?! A nuk kishin frikë nga kjo gënjeshtër e qartë?! Madje, një pretendim i tillë ishte, para së gjithash, një fyerje dhe gënjeshtër ndaj Allahut të Lartësuar. Ata pretendonin që Allahu i Lartësuar, edhe pse e dinte që – sipas tyre – ai njeri ishte një "mashtrues i madh", që devijonte njerëzit nga rruga e vërtetë, e lejonte atë që të kishte sukses, madje e ndihmonte atë me mrekulli të shumta dhe të pakundërshtueshme, i jepte atij fitore pas fitoreje kundër armiqve të tij, derisa i dha pushtet të plotë mbi kundërshtarët e tij! I Pastër dhe i Lartësuar është Allahu nga të tilla shpifje të ulëta! Si mund të kishin të tilla mendime për të Gjithëpushtetshmin e të Gjithëmëshirshmin, kur Ai është i Plotfuqishëm për ta shuar një mashtrim të tillë që nga rrënjët dhe fillesat e tij?! Prandaj i Gjithëmëshirshmi e i Urti thotë më pas:

- **"Po të dojë Allahu, Ai ta vulos zemrën tënde."** – Kuptimi: Allahu i Lartësuar është i Plotfuqishëm që ta vulosë zemrën e Muhamedit (a.s.) dhe ta bëjë atë që të mos jetë në gjendje për asgjë, të mos mundet të bëjë asgjë të mirë. Pra, nëse Allahu i Lartësuar do të dëshironte, çështja e Muhamedit (a.s.) do të kishte marrë fund me kohë.

Kjo është një dëshmi e padiskutueshme, që tregon se Muhamedi (a.s.) është i dërguari i vërtetë i Zotit dhe Shpallja që ai e solli ndër njerëz është Shpallje e Zotit të qiejve dhe të tokës.

- **"Allahu e zhduk të pavërtetën dhe, me urdhrat e Tij, e forcon të vërtetën."** - Urtësia dhe mëshira e të Plotpushtetshmit nuk mund ta lejojë që e kota të triumfojë mbi të vërtetën. Përkundrazi, Ai e fshin dhe e zhduk të kotën, dhe ky është rregull i pandryshueshëm në gjithësi. Edhe pse në ndonjë periudhë, e kota mund të shfaqet dhe të mbizotërojë, përfundimi i saj i pakthyeshëm është shkatërrimi dhe zhdukja.

Ndërsa e vërteta, që Zoti kërkon dhe dëshiron që të shfaqet dhe të triumfojë, do të lartësohet dhe triumfojë gjithmonë, sepse ky është një rregull në gjithësinë tonë, që Zoti i Madhëruar e ka krijuar dhe e sundon.

Allahu i Lartësuar bën që, me urdhrat e Tij, e vërteta të triumfojë. Urdhrat apo vendimet e Zotit janë dy llojesh:

1. Vendime *keunije* (ligjet e ekzistencës së krijesave), të cilat nuk ndryshojnë dhe nuk mund t'i tjetërsojë dot askush. Kjo do të thotë që shfaqja e të vërtetës është një ligj i pakthyeshëm dhe i patjetërsueshëm i Sunduesit të gjithësisë.
2. Vendime *sher'ijeh*, të cilat janë ligjet që i Madhëruari ka caktuar për njerëzit, përmes librave të shenjtë që u shpalli profetëve. Nëpërmjet këtyre ligjeve, i Lartësuar argumenton të vërtetën dhe e bën atë të triumfojë mbi mashtrimin dhe të kotën. Nëpërmjet Shpalljeve të ndritura, Allahu ndriçon mendjet e të mençurve dhe të atyre që e duan të vërtetën dhe e kërkojnë atë me sinqeritet.

Madje i Lartësuari, për ta bërë edhe më të qartë të vërtetën, i lejon të devijuarit që të ngrejnë dyshime rreth saj dhe të polemizojnë me të sinqertët. Por, nga ana tjetër, i Lartësuari dhe i Urti e ndihmon palën e Tij që ta shpalosë dhe mbrojë të vërtetën me argumente dhe fakte të qarta dhe të pakundërshtueshme. Në këtë mënyrë, e kota del zbuluar dhe kuptohet nga të gjithë që është e kotë, ndërsa e vërteta shfaqet si e tillë për të gjithë.

- "Ai e di shumë mirë çfarë përmbajnë zemrat." - Allahu di në imtësi gjithçka që mbajnë zemrat, të mira apo të këqija qofshin ato. Ai di çfarë shfaqet jashtë dhe çfarë qëndron e fshehur në shpirt. Allahu e di atë që kërkon të vërtetën me sinqeritet, ashtu siç di edhe atë tjetrin që shtiret si i sinqertë, por në të vërtetë nuk është i tillë. Allahu i Madhëruar ia fal udhëzimin e drejtë atij që Ai dëshiron dhe e lë në humbje atë që Ai dëshiron, sipas dijes, urtësisë dhe mëshirës së Tij.

Ajetet 25 – 26

25. Është Ai që pranon pendimin e adhuruesve të Tij, që i fshin gjynahet dhe që e di se çfarë punoni.
26. Atij i përgjigjen ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, të cilëve Ai ua shton të mirat nga mirësia e Vet. Ndërsa jobesimtarët do të dënohen ashpër.

Shpjegimi i ajeteve

- Është Ai që pranon pendimin e adhuruesve të Tij, që i fal gjynahet..." – Këtu tregohet bujaria e pakufishme e Allahut të Lartësuar, mirësia absolute dhe butësia e madhe e Tij. Është i Gjithëmëshirshmi Ai që ua pranon pendimin robërve, kur ata ndiejnë keqardhje pas kryerjes së gjynahut dhe dëshirojnë që kurrë të mos i kthehen më atij gjynahu. Allahu ua pranon pendimin atyre që janë të sinqertë dhe kërkojnë sinqerisht kënaqësinë e Tij. Edhe pse gjynahet janë shkak që robërit të goditen nga ndëshkimet e dynjasë dhe të âhiretit, Allahu i Lartësuar, me butësinë, mëshirën dhe bujarinë e Tij, ua fal dhe ua mbulon gjynahet dhe nuk i ndëshkon në këtë jetë dhe as në jetën tjetër, por vetëm nëse ata pendohen sinqerisht, duke plotësuar kushtet e nevojshme për këtë. [8]

---

[8] Një pendim i pranuar duhet të plotësojë disa kushte:
1. Sinqeriteti për Allahun e lartësuar në pendimin tënd. Pra njeriu me pendimin e tij të synojë që të kënaqë Allahun e lartësuar. Të dëshirojë që Allahu t'ia pranojë pendimin, dhe ta falë për gjynahet e tij. Me pendimin e tij nuk duhet të synojë të kënaqë njerëzit dhe të afohet tek ta, ose të ketë për qëllim thjesht t'i shpëtojë dënimeve të shtetit. Por me pendimin e tij të kërkojë vetëm kënaqësinë e Zotit dhe që Ai t'ia falë gjynahet e tij.
2. Kushti i dytë. Të largohet menjëherë prej gjynaheve dhe ky është një nga kushtet më të rëndësishme të saktësisë dhe pranimit të pendimit. Nëse gjynahu është lënie uaxhibi pendimi realizohet duke filluar zbatimin

dhe kryerjen e këtij uaxhibi. P.sh nëse dikush nuk jepte zekatin dhe dëshion që Allahu ta falë, ai duhet të japë zekatin e pasurisë që nuk e ka dhënë gjatë viteve që kanë shkuar. Nëse dikush ka qenë i mangët në bamirësinë ndaj prindërve, ai duhet të përpiqet maksimalisht për të qënë bamirës ndaj tyre. Nëse ke qënë i mangët në mardhëniet dhe mbajtjen e lidhjeve farefisnore ai duhet të lidhë ato sërisht. Nëse kryente harame ai duhet të largohet menjëherë prej tyre dhe të mos vonohet asnjë çast. Nëse ka qenë pej atyre që përfitonin nëpërmjet ribasë duhet të ndërpres menjëherë këtë mënyrë fitimi dhe të largohet prej saj. Duhet gjithashtu që shtesën e fituar prej ribasë ta shpenzojë me mënyrën e lejuar nga sherjati. Nëse ka qenë mashtrues dhe vjedhës i pasurisë së njerëzve me hile e padrejtësi ai duhet të ndalet dhe të pastrohet nga këto cilësi (mashtrimi, gënjeshtra, tradhëtia). Nëse pasuritë i ka marrë padrejtësisht prej dikujt duhet që t'ia kthej atij dhe ti kërkoj hallallëkun prej tij. Nëse ka qenë përgojues dhe nëpërkëmbës i nderit të njerëzve ai duhet të ndalet nga kjo vepër e keqe.

Nuk ka asnjë vlerë që dikush të thotë: "U pendova" dhe pastaj të vazhdojë në gjynahet e tij, në lënien e vaxhibeve, në kryerjen e harameve. E pra ky pendim është i pa vlefshëm dhe i pa pranueshëm tek Allahu i lartësuar dhe i gjithëditur. Madje ky lloj pendimi është si tallje ndaj Zotit Krenar dhe të lartësuar. E si mund të pretendosh se u pendove ndërkohë vazhdon në gjynahet e tua dhe në mos bindje ndaj Zotit?!

Nëse dikujt prej njerëzve ndaj të cilit ke gabuar do ti drejtoheshe duke i thënë: "më fal unë kam gabuar kundrejt teje dhe kurrë nuk do ti kthehem atij gabimi," por në zemrën tënde ti përsëri dëshiron që ti kthehesh atij gabimi, kjo padyshim do të konsiderohej si tallje dhe nënvlerësim për atë person. Po kur bëhet fjalë për Zotin e gjithësisë çfarë mund të mendohet dhe si mund të konsiderohet një vepër e tillë?!

Kështu pra i penduar sinqerisht konsiderohet ai i cili largohet nga gabimi dhe ka vendosur që të mos i kthehet më atij. Është e habitshme se si disa njerëz bisedojnë me ty dhe shprehin keqardhjen e madhe për çështjen e ribasë, megjithatë përsëri vazhdojnë me të, Allahu na ruajt dhe na udhëzoftë!! Të tjerë tregojnë keqardhe për çështjen e gibetit dhe shkeljes së të drejtave të njerëzve ndërkohë që ata janë më të keqijtë që kryejnë këtë gjynah dhe vazhdojnë në të. Allahu na ruajt dhe na shpëtoftë nga çdo e keqe! Dikush tjetër shpreh urrejtjen dhe dëshpërimin nga mashtrimet dhe shkeljet të të drejtave të njerëzve e moskorrektësinë e tyre, e pastaj vazhdon të jetë njeriu më mashtrues dhe jo korrekt në plotësimin e të drejtave të njerëzve.

Pra çdo njeri duhet të lërë gabimin prej të cilit u pendua ose në të kundërt pendimi i tij është i rrefuzuar dhe i pa vlefshëm, i pa dobishëm tek Zoti.

***

Gabimet e njeriut ndahen në dy kategori:

1. Gabime ndaj Zotit.
2. Dhe gabimet ndaj krijesave.

Për gabimin ndaj Zotit mjafton të pendohemi dhe të ndalemi prej tij me vendosmëri për të mos iu kthyer kurrë. Në këtë rast mjafton kjo dhe nuk është e nevojshme, madje mund të themi se nuk lejohet, që t'u tregosh njerëzve për gjynahet e tua qofshin lënie vaxhibesh apo kryerje haramesh. Sepse ato kanë qenë gjynahe mes teje dhe Allahut dhe, i lartësuari ti fshehu dhe mbuloi nga sytë e njerëzve. Pra nuk është me vend që të zbulosh atë që Zoti me mirësinë e bujarinë e tij t'i mbuloi.

Profeti a.s ka thënë: "Çdo pjestar i umetit tim është i sigurt e i falur, përveç muxhahirinëve (të shfaqurve në gjynahet e tyre) [Buhari dhe Muslimi], sikurse është përmendur edhe në haadith muxhahirinë janë ata që bëjnë gjynahe dhe kur gdhihen u flasin e tregojnë njerëzve që bënë kështu dhe ashtu…."

Disa dijetarë kanë thënë se nëse dikush bën një gabim që përmban ndëshkim sherijati, nuk ka problem që të shkojë tek imami që egzekuton ndëshkimet ti tregojë për gabimin dhe të kërkojë prej tij që të egzekutojë ndëshkimin e sherijatit si pastrim për të. Por megjithatë më e mira është që ai t'ia mbulojë vetes atë që Zoti ia mbuloi dhe të pendohet sinqerisht sepse i lartësuari është Bujar, Falës dhe shumë i mëshirshëm. Ai e pranon pendimin nga robërit e Tij dhe i fal të këqiat.

Lloji i dytë i gjynaheve janë gjynahet ndaj krijesave. Në këtë rast, pendimit, përveç kushtit të mësipërm, nëse ka të bëj në mënyrë të posaçme me hakun e krijesës, atëherë i shtohet një kusht tjetër: Ti kthejë hakun atij që i takon. P.sh nëse ka vjedhur nga dikush duhet t'ia kthesh atij atë që i ke vjedhur ose vlerën e saj. Nëse ke mohuar të drejtën e dikujt, p.sh e ke mohuar se i ke borxh që në të vërtet ia ke, atëherë pendimi presupozon që të pranosh të vërtetën dhe t'ia japësh hakun e tij.

Nëse i zoti i të drejtës ka vdekur atëherë ia jep trashëgimtarëve të tij. Nëse nuk e njeh apo nuk ka mundësi ta gjesh atë apo trashëgimtarët e tij, atëherë jepe sadeka në emër të tij dhe Allahu të çliron prej saj dhe ia jep atij hakun e tij.

Nëse padrejtësia ndaj njerëzve është e natyrës fizike p.sh i ka rrahur apo të njgjashme me këto, atëherë pendimi e kërkon që të shkosh tek ata dhe t'u mundësosh të të godasin ashtu sikurse i godite, sepse Allahu i lartësuar ka thënë : "Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do zullumqarët. E kush hakmerret për padrejtësitë që i

janë bërë, ndaj të tillëve nuk ka ndonjë përgjegjësi. Përgjegjësia *(ndëshkimi)* është vetëm kundër atyre që u bëjnë njerëzve padrejtësi dhe kundër atyre që pa farë arsye bëjnë çrregullime në tokë. Për të tillët është përgatitur një dënim i dhembshëm. Kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë *(i lavdishëm)*. El shura 40 – 43 Dhe thotë: "...Pra, kush ju sulmon juve, sulmojeni edhe ju po në atë masë. Kini frikë nga Allahu dhe dijeni se Allahu, pa dyshim, është me të devotshmit *(të cilët i respektojnë kufijtë e Zotit)*. Bekare 194.

Nëse padrejtësia është bërë me fjalë rënduese e fyese mes njerëzve atëherë pendimin e kërkon që të shkosh tek ai dhe të kërkosh hallallëkun e të përmbushësh kërkesat e tij sipas asaj që do të bini dakort që e drejta të shkojë në vend. Madje edhe nëse të thotë që nuk të fal derisa të më japësh kaq e aq, jepja atij.

Nëse padrejtësia është gibet përgojim, pra ke folur në mungesë të tij dhe e ke përgojuar ndër njerëz. Për këtë çështje dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa janë të mendimit se një pendim i sinqert e kërkon që të shkosh tek ai dhe t'i kërkosh hallallëkun. Por të tjerë thonë: Jo gjithmonë veprohet kështu. Nëse ai e ka marrë vesh këtë gjë atëherë mund të shkosh tek ai dhe t'i kërkosh hallallëkun. Por nëse nuk e ke marë vesh, atëherë mjafton që në atë mexhlis ku e ke përmedur për keq ta përmendësh për mirë dhe të përmendësh anët e tij të mira e të kërkosh falje për të. Në këtë mënyrë të këqiat fshihen nga të mirat. Ky mendim është më i saktë dhe më i drejtë.

Në hadith është përmendur: "falja për atë që e ka përgojuar është: "Të kërkosh falje për të.".

Kështu pra pendimi e kërkon që të drejtat t'u kthehen atyre që i kanë.

3. Kushti i tretë. Vendosmëria për të mos iu kthyer kurrë në të ardhmen gabimit nga i cili u pendove. Nëse në zemrën tënde ende egziston dëshira për t'u kthyer kur të të jepet mundësia, pendimi është i pa saktë i pa vlefshëm. P.sh dikush me pasurinë e tij merret me tregëtinë e pijeve dehëse apo e shfrytëzon në udhëtime për të bërë zina e poshtërsi, Allahu na ruajt! Por më pas e kapi varfëria dhe thotë: O Zot unë pendohem tek ty." Por në të vërtet ai është gënjeshtar, ngase në zemrën e tij ai ka dëshirën që po të kishte pasuri, do të bënte përsëri të njëjtin gabim. Ky lloj pendimi është pendimi i atij që nuk ka mundësi të bëjë gjynahe. Pra, u pendua apo jo, nuk ka mundësi të bëjë gjynahe. Shumë njerëz pasi i kap varfëria thonë: " U pendova", por ende kanë dëshirë që nëse Zoti do t'i jepte përsëri pasuri, do të ktheheshin në të njëjtën gjendje si më parë. Ky lloj pendimi është i papranueshëm tek Zoti.

4. Kushti i katert. Pendimi duhet të jetë në kohën kur pranohet pendimi. Nëse pendohet në kohën kur pendimi është i papranueshëm, kjo është e padobishme.

Koha shihet në dy kënvështrime:

1. Në lidhje me njeriun dhe gjendjen e tij.
2. Në përgjithësi.

Sa i përket pikës së parë themi se pendimi duhet të jetë para mbarimit të exhelit, pra para momentit të vdekjes. Në të kundërt ajo nuk i sjell dobi robit, sepse Allahu i madhëruar thotë: "Nuk është i pranueshëm pendimi i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, thotë: "Unë tani me të vërtetë u pendova!"; e as pendimi i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër." El nisa 18 Dhe thotë: "E kur e panë dënimin tonë, thanë: "Ne i kemi besuar vetëm Allahut dhe i kemi mohuar ata që dhuronim veç Tij". Por besimi i tyre, kur e vërejtën dënimin tonë, nuk u bëri dobi. Ky është ligj i Allahut ndaj robërve të Tij. Ai çast do të jetë dëshpërim për jobesimtarët." El Gafir 84 – 85.

Kur njeriu sheh vdekjen dhe afrimin e exhelit të tij, kjo do të thotë që ai e ka humbur shpresën se do të mund të vazhdojë të jetojë dhe pendimi në këto kushte nuk është në vendin e vet. Pasi sigurohet se nuk ka për të jetuar më në jetën e kësaj bote, pretendon se je kthyer dhe je penduar?! Ky është një pendim i detyruar që nuk i sjell asnjë dobi vepruesit të tij. Pendimi që të jetë i pranuar dhe i dobishëm duhet të bëhet më pare.

Sa i përket pikes së dytë pra kufizimi i kohës së pendimit në përgjithësi, Profeti a.s. na ka njoftuar se: "Hixhreti kurrë nuk ka për t'u ndërprerë deri sat ë jetë ndërprerë mundësia e pendimit dhe mundësia e pendimit numk do të ndërpritet derisa të lindë djelli nga perëndimi."[8]

Pra pasi dielli të ketë lindur nga perëndimi askujt nuk do ti bëjë dobi pendimi. Allahu i lartësuar ka thënë: "A mos janë duke pritur gjë tjetër veçse t'ju vijnë engjëjt (t'ua marrin shpirtin), të vijë Zoti yt (për të gjykuar me drejtësi) ose të vijnë disa nga shenjat e Zotit tënd?! (në) Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, asnjë njeriu nuk i vlen besimi i Tij nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë kurrfarë të mire (i motivuar) nga besimin e tij. Thuaj: "Pritni! Edhe ne jemi duke pritur!". El en'am 158. Me fjalën disa nga shenjat e Zotit aludohet për lindjen e diellit nga perëndimi, sikurse e ka shpjeguar Profeti a.s.

Kështu pra, pendimi duhet të bëhet në një kohë kur është e mundur pranimi i tij, në të kundër teubja është e pavlefshme inegzistente.

Shtrohet një pyetje: A është i pranueshëm pendimi për një gjynah të caktuar nëse robi është i vazhdueshëm në kryerjen e një gjynafi tjetër? Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për këtë çështje:

Allahu i Lartësuar e përforcon këtë premtim kur thotë se: "Ai i fal gjynahet", pra, i fshin ato të këqija, sikur të mos ishin bërë kurrë. Ai madje fshin edhe gjurmët e të këqijave dhe largon ndëshkimin, që është pasojë e tyre. Nëse Allahu i Gjithëmëshirshëm të fal, Ai të do, dhe kështu tek Ai je i nderuar dhe i pastër nga çdo gjynah që ke bërë. Duke të mëshiruar, Ai të jep sukses për çdo vepër të mirë që të afron tek Ai dhe në Xhenetin e Tij.

---

1. Prej tyre ka që janë të mendimit se pendimi për një gabim të caktuar është i saktë edhe nëse robi vazhdon të jetë i vazhdueshëm në kryerjen e një gjynahu tjetër. Atij i pranohet pendimin për gjynahun prej të cilit pendohet dhe mbetet gjynahu për gabimin të cilin vazhdon ta kryejë.

2. Të tjerë thane: "Nuk pranohet pendimi për një gabim përsa kohë robi vazhdon të jetë i vazhdueshëm në kryerjen e një gabimi tjetër.

3. Të tjerë kanë dhënë shpjegimin se nëse gjynahu të cilin ai vazhdon ta kryejë është i të njëjtit lloj me gjynahun prej të cilit është penduar, atëherë pendimi nuk është i saktë, në të kundërt ai është i pranueshëm.

Le të japim një shembull: Një njeri është penduar nga konsumimi i fajdesë, por vazhdon të jetë konsumues i pijeve dehëse ose mardhënieve jashtëmartesore. A është i pranueshëm pendimi i tij në çështjen e konsumimit të fajdesë?

E pra, prej dijetarëve, disa janë të mendimit se pendimi i tij për fajdenë është i papranueshëm përderisa ai vazhdon të konsumojë gjynahet e tjera. Por dijetarë të tjerë, mes tyre edhe autori i librit, janë të mendimit se pendimi për fajdenë është i pranueshëm, sipas mendimit më të pranueshëm dhe të saktë mes dijetarëve. Këto ishin mendimet për një rast të tillë.

Ndërsa përsa i përket rastit tjetër si psh një njeri që pendohet nga kryerja e mardhëieve jashtëmartesore dhe i lë ato, por vazhdon të kryejë gjynahun e shikimit në haram dhe shikimit me epsh në gratë që nuk i lejohet, atëherë në këtë rast, a pranohet apo jo pendimi i tij? Edhe për këtë rast dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa thonë se pranohet e disa të tjerë thonë që jo.

Gjithsesi, mendimi më i saktë në këtë çështje është se pendimi i robit pranohet në të gjitha rastet për gabimin nga i cili pendohet, edhe pse vashdon të jetë i vazhdueshëm në gjynahe të tjera. Por duhet të theksojmë se ai nuk mund të quhet me emrin "i penduar" dhe nuk meriton lëvdimin që meritojnë "Të penduarit" sepse pendimi i tij nuk është pendim i plotë nga çdo gjynah por pendim i mangët.

Është e vërtetë që ai u pendua nga një gjynah i caktuar dhe vërtet nuk meret në përgjegjësi për atë gjynah, por nuk meriton të quhet me titullin "i pendur" për të cilët Zoti ka përmendur aq mirësi dhe ka premtuar atë që ka premtuar, derisa të pendohet nga çdo gjynah që kryen. Ky është mendimi në të cilin qetësohet zemra dhe e besojmë si më të saktë.

[Shpjegimi i "Rijadus-salihin" nga Ibn Uthejmin]

- "...dhe që e di se çfarë punoni." - Pendimi i robërve nuk ka tek të gjithë të njëjtin karakter. Disa mund të jenë të sinqertë në pendimin e tyre, por disa mund të jenë edhe hipokritë, me qëllime të kësaj dynjaje të pavlefshme. Këto dallime në pendimin e robërve nuk mund t'i dijë askush veç Zotit, i Cili është i Dijshëm për gjithçka. Prandaj i Lartësuari e mbylli ajetin me këto fjalë. Le të vlejë kjo si vërejtje, që njerëzit të jenë të kujdesshëm dhe të ruhen shumë nga qëllimet jo të sinqerta me Zotin e tyre.

Allahu i Lartësuar i fton robërit që të pendohen nga gjynahet dhe mosbindja e tyre ndaj Tij, dhe pastaj të kthehen tek Ai të bindur dhe të nënshtruar. Por në varësi të reagimit ndaj kësaj ftese, njerëzit ndahen në dy grupe: ata që i përgjigjen asaj pozitivisht dhe ata që nuk e pranojnë këtë ftesë. Sa i përket grupit të parë, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Atij i përgjigjen ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira..." - Ata që i përgjigjen ftesës së Zotit të tyre, ata pendohen dhe kthehen të bindur tek Ai, duke patur besimin e drejtë, të bazuar në dritën e ardhur nga Allahu. Ata, gjithashtu, punojnë me këtë besim, sipas udhëzimeve të Profetit dhe me sinqeritet vetëm për Allahun e Lartësuar. Imani dhe veprat e tyre të mira i bëjnë që gjithmonë t'i përgjigjen thirrjes së Allahut dhe të Profetit të Tij, kur ata i ftojnë në fenë që jep jetë dhe që siguron lumturinë në të dyja botët. Dhe, sigurisht, përpjekjet

dhe mundi i tyre nuk mund të lihen pa u shpërblyer nga Bamirësi dhe Bujari i madh, që thotë:

- "...të cilëve Ai ua shton të mirat nga mirësia e Vet." - Duke qenë se ata i përgjigjen thirrjes së Tij për besim të drejtë dhe vepra të sinqerta, atëherë Allahu ua shton edhe më shumë mirësitë dhe u jep suksese të mëtejshme për të kryer vepra të mira. Ai u dhuron atyre motivimin dhe vullnetin e mjaftueshëm për të kryer edhe më shumë adhurime ndaj Tij, për t'i shprehur më mirë Atij dashurinë dhe madhërimin. Allahu jo vetëm që u jep sukses për punë të mira, por edhe shpërblimin e këtyre punëve ua shumëfishon nga bujaria e Tij. Ai shpërblen shumë më tepër sesa ne mund të kërkojmë prej Tij, sepse është Bujar dhe Bamirës. Allahu është Mirënjohës i madh edhe për vepra që në sytë e robit janë shumë të vogla, nëse ato kryhen me sinqeritet. Ky është një sukses i madh për robërit që i përgjigjen ftesës së Zotit.

Ndërsa ata që zgjedhin të mos i përgjigjen ftesës bujare të Allahut, në fakt kanë zgjedhur me vetëdije të plotë që të bashkohen me mohuesit e Allahut dhe të profetëve të Tij. Për këtë arsye, i Lartësuari i quan ata jobesimtarë, kur thotë:

- "Ndërsa jobesimtarët do të dënohen ashpër." - Ata do të goditen nga ndëshkimi i rreptë në dynja dhe në ahiret. Ata që nuk e vlerësojnë ftesën e Zotit nuk ka kush që mund t'i udhëzojë në rrugën e drejtë, prandaj janë në një humbje të sigurt. Kjo është rruga që vetë e kanë zgjedhur dhe merituar me veprat e tyre. Allahu i Lartësuar ia jep gjithësecilit mundësinë për të ndjekur rrugën e drejtë, por jo të gjithë zgjedhin mirësinë e Tij.

Ajetet 27 – 28

27. Sikur Allahu t'ua shtonte tej mase begatinë robërve të Vet, ata do t'i kalonin kufijtë, por Ai i furnizon me masën që dëshiron. Pa dyshim, Ai di dhe sheh gjithçka te robërit e Tij.
28. Është Ai që, pasi ata i kanë humbur shpresat, u lëshon shiun dhe shpërndan mëshirën e Vet. Ai është Mbikëqyrësi dhe i Lavdëruari.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na kujton se, me butësinë dhe mëshirën e Tij për robërit, ai përcakton me masë të caktuar gjithçka nga mirësitë e kësaj dynjaje. Ai nuk ua shton pa kriter pasurinë e kësaj bote. Nëse Allahu do ta bënte këtë pa masë, në botë do të kishte shumë shkatërrime. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Sikur Allahu t'ua shtonte tej mase begatinë robërve të Vet, ata do t'i kalonin kufijtë..." – Po të ndodhte ashtu, robërit do të tregoheshin të pavëmendshëm ndaj adhurimit të Allahut dhe bindjes ndaj Tij. Ata do të kërkonin gjithnjë e më tepër vetëm plotësimin e kënaqësive të tyre të shfrenuara. Ata do t'i përkushtoheshin plotësisht vetëm kësaj bote, edhe nëse kjo do t'i çonte në shkeljen e kufijve të Allahut të Madhëruar dhe në padrejtësi ndaj krijesave.

- "...por Ai i furnizon me masën që dëshiron. Pa dyshim, Ai di dhe sheh gjithçka te robërit e Tij." - Allahu i shpërndan mirësitë e kësaj bote me masën

që Ai dëshiron, sipas butësisë dhe urtësisë së Tij. Ai e di shumë mirë se çfarë është e dobishme dhe çfarë është e dëmshme për robin. Sipas një rrëfimi të përcjellë deri tek ne, Allahu i Lartësuar ka thënë: "Me të vërtetë, ka nga robërit e Mi, imani i të cilëve rregullohet veçse duke qenë të pasur, prandaj nëse do t'i varfëroja, kjo do ta rrënonte imanin e tyre. Po ashtu, ka nga robërit e Mi, imani i të cilëve rregullohet veçse duke qenë të varfër, prandaj nëse do t'i pasuroja, kjo do ta rrënonte imanin e tyre. Gjithashtu, disa prej robërve të Mi u rregullohet imani veçse nëpërmjet sëmundjes, prandaj nëse do t'i shëroja, kjo do ta rrënonte imanin e tyre. Me të vërtetë, Unë i rregulloj çështjet e robërve të Mi, duke patur dijen Time të plotë rreth përmbajtjes së zemrave të tyre. Unë jam i Gjithëditur e Gjithëvështrues".

- "Është Ai që, pasi ata i kanë humbur shpresat, u lëshon shiun dhe shpërndan mëshirën e Vet." – Këtu flitet për shiun e madh dhe të dobishëm, nëpërmjet të cilit Allahu i Lartësuar u jep jetë njerëzve dhe vendeve. Ai vjen si mëshirë, edhe pasi njerëzit i kanë humbur shpresat se ai do të vijë. Kjo është mëshira e Allahut të Lartësuar për krijesat. Nëpërmjet shiut aq të dëshiruar, dalin bimë e fryte për njerëzit dhe kafshët e tyre. Kur bie shi, njerëzit gëzohen për jetën dhe mëshirën që Zoti po u fal.

- "Ai është Mbikëqyrësi dhe i Lavdëruari." - Allahu mbikëqyr dhe kujdeset për robërit e Vet, që ata të rregullojnë dynjanë dhe ahiretin e tyre. Ai është i Lavdëruar për kujdesin e Tij ndaj tyre dhe për mirësitë e shumta që dhuron, por edhe për atributet e tjera të mrekullueshme që Ai ka.


Ajeti 29

29. Nga shenjat e Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës, bashkë me gjallesat e shpërndara në to. Me fuqinë e Tij, Ai mund t'i grumbullojë ato kur të dëshirojë.

Shpjegimi i ajetit

- "Nga shenjat e Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës, bashkë me gjallesat e shpërndara në to." - Allahu i Lartësuar përmend disa nga shenjat madhështore, që dëshmojnë për fuqinë absolute të Tij për të bërë gjithçka dhe për faktin se Ai do t'i ringjallë krijesat pas vdekjes së tyre. Ndër këto shenja është edhe krijimi i qiejve dhe i Tokës, me madhështinë dhe gjerësinë e tyre. Këto krijesa janë dëshmi e fuqisë së Tij të plotë për të bërë gjithçka. Përpikmëria dhe rregullsia e pabesueshme në to tregojnë, gjithashtu, për dijen dhe urtësinë e madhe të Allahut. Mirësitë dhe dobitë e vendosura në to tregojnë për mëshirën dhe bujarinë e Tij. Shenja të mrekullueshme mund të gjejmë edhe në krijesat që Ai ka vendosur dhe shpërndarë në qiej e në Tokë, të cilat janë krijuar për dobinë e njerëzve dhe në ndihmë të tyre. Të gjitha këto tregojnë se Ai është i Vetmi që meriton të gjitha llojet e adhurimeve, dhe askush tjetër veç Tij. Çdo adhurim i përkushtuar ndaj dikujt tjetër është i kotë dhe i papranueshëm. Çdo gjë e adhuruar veç Allahut është e kotë dhe e gënjeshtërt.

- "Me fuqinë e Tij, Ai mund t'i grumbullojë ato kur të dëshirojë." - Ai që krijoi këto krijesa madhështore dhe të dobishme, Ai është i Plotpushtetshëm për t'i



tubuar ato sërish pas vdekjes dhe sërish të gjallë në Ditën e Gjykimit.

Është plotësisht e mundur logjikisht që Allahu i Lartësuar t'i ringjallë dhe llogarisë njerëzit, sepse pushteti dhe drejtësia e Tij janë të plotë. Por që të besojmë se një gjë e tillë do të ndodhë vërtet, kjo ka nevojë për lajme të sigurta prej Tij. Dhe, sigurisht, janë të shumta transmetimet e sigurta që vijnë prej Zotit, të cilat vërtetojnë pa as më të voglin dyshim se kjo ngjarje e madhe do të ndodhë. Për këtë ngjarje kanë folur të gjithë të dërguarit e Zotit dhe e gjen të përmendet në të gjithë librat qiellorë.

Ajetet 30 – 31

30. Çfarëdo e keqe që ju godet, është pasojë e veprave tuaja, ndërkohë që për shumë të tjera, Ai ju fal.

31. Ju nuk mund t'i shpëtoni dënimit në tokë dhe, përveç Allahut, nuk mund të gjeni ndihmës a mbrojtës tjetër.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Çfarëdo e keqe që ju godet, është pasojë e veprave tuaja..."** - Allahu i Lartësuar na tregon se çdo fatkeqësi dhe sprovë që na ndodh në jetë, qoftë në shëndet, në pasuri apo te fëmijët tanë, ndodh për shkak të gjynaheve që kemi bërë. Çdo goditje në gjërat tona të shtrenjta është pasojë e veprave tona të këqija.

Megjithatë, Allahu i Lartësuar fal dhe toleron shumë. Ai thotë:

- **"...ndërkohë që për shumë të tjera, Ai ju fal."** - Ato gjëra që Allahu i Lartësuar i fal janë më të shumta sesa ato për të cilat Ai sjell ndëshkime. Allahu i Lartësuar kurrë nuk u bën padrejtësi robërve, por janë ata që i bëjnë padrejtësi vetvetes. Thotë i Madhëruari: "Sikur Allahu t'i merrte në përgjegjësi njerëzit për atë që bëjnë, nuk do të linte në faqen e dheut asnjë krijesë".

Allahu i Madhërishëm është i Plotfuqishëm dhe i Plotpushtetshëm që t'i ndëshkojë ata dhe ata kurrë nuk mund t'i shpëtojnë ndëshkimit të Tij duke u fshehur në tokë. Por i Urti i toleron dhe u jep mundësi për të reflektuar dhe për t'u kthyer nga rruga e humbjes, siç thotë më pas:

- **"Ju nuk mund t'i shpëtoni dënimit në tokë..."** – Kuptimi: Ju nuk mund ta bëni pushtetin dhe forcën e Zotit të paaftë mbi ju. Të paaftët dhe të pafuqishmit jeni ju, që jetoni në tokë. Ju nuk mund të pengoni asnjë urdhër që i Madhëruari jep për t'u zbatuar në qiej dhe në tokë.

- **"...dhe, përveç Allahut, nuk mund të gjeni ndihmës a mbrojtës tjetër."** - Nëse Sunduesi i vetëm dhe absolut i qiejve dhe i tokës urdhëron ndëshkimin tuaj, askush nuk mund t'ju marrë në mbrojtje prej Tij. Askush nuk mund t'ju mundësojë të arrini të mirat apo të shpëtoni nga të këqijat!

Ajetet 32 – 35

32. Ndër shenjat e Tij janë anijet, të cilat lundrojnë në det dhe ngjajnë me malet.
33. Po të dojë Ai, e ndal erën, dhe ato ngelin të palëvizshme mbi sipërfaqen e ujit. S'ka dyshim se këto fakte vlejnë për çdo durimtar e mirënjohës.
34. Ai edhe mund t'i mbysë ata, për shkak të veprave që bëjnë, por për shumë të tjera Ai i fal.
35. Ata që i kontestojnë argumentet Tona, le ta dinë se nuk kanë shpëtim.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ndër shenjat e Tij janë anijet, të cilat lundrojnë në det dhe ngjajnë me malet."** - Shenja që dëshmojnë mëshirën e madhe të Allahut të Lartësuar për njerëzit janë edhe ligjet e fizikës, që Ai ka krijuar në gjithësi, të cilat njerëzit i shfrytëzojnë për nevojat e tyre në këtë botë. Këtu futen anijet e mëdha, që duken si male të larta në mes detit, sepse janë pikërisht ligjet e mrekullueshme të fizikës, – të cilat Allahu i ka bërë të tilla, – që i mbajnë anijet e mëdha mbi valët e detit. Pastaj, nëpërmjet tyre, njerëzit transportojnë gjithçka që dëshirojnë nëpër vende të largëta.
Është Allahu që mundëson funksionimin e anijeve dhe që ua lehtëson lëvizjen atyre, pasi, në të kundërt:

- **"Po të dojë Ai, e ndal erën, dhe ato ngelin të palëvizshme mbi sipërfaqen e ujit."** – Pra, nëse Allahu i Lartësuar ua ndalon erën, ato qëndrojnë në vend e nuk lëvizin.

Dikush mund të përmendë anijet e sotshme, që punojnë me karburant, por edhe ato nuk mund të funksionojnë nëse mungojnë kushtet fizike, të cilat është i Gjithëdijshmi dhe i Gjithëmëshirshmi që i ka krijuar të tilla.

- **"S'ka dyshim se këto fakte vlejnë për çdo durimtar e mirënjohës."** - Të tilla fakte i shohin veçse ata që kanë dy cilësi:
1. Ata, me durim, qëndrojnë të patundur në bindjen ndaj Zotit. Ata nënshtrojnë nefsin e tyre, që të kryejnë adhurimet ndaj Allahut të Lartësuar, edhe pse kjo mund të duket e vështirë. Duke duruar, ata arrijnë ta kontrollojnë nefsin e tyre, që ai të mos lëshohet në harame dhe që ai të jetë gjithmonë i kënaqur me caktimet e dhimbshme, me të cilat Zoti sprovon njerëzit. Në këtë mënyrë, ata ushtrojnë të trija llojet e durimit, që janë: durimi për kryerjen e urdhëresave të Zotit, durimi për largimin nga haramet dhe durimi për të qenë i kënaqur me caktimin e Zotit, i mirë apo i hidhur qoftë ai.
2. Ata janë mirënjohës të vazhdueshëm për dhuratat e Allahut, mirënjohje që shprehet me nënshtrim dhe adhurim të sinqertë ndaj Tij.

Këta janë njerëzit që mund të përfitojnë nga shenjat e Allahut. Ndërsa ata që nuk kanë durim dhe nuk tregojnë mirënjohje për mirësitë e Allahut, ata janë kundërshtarë dhe mosbesues, që i kanë kthyer shpinën argumenteve të Allahut dhe që nuk përfitojnë prej tyre.

- **"Ai edhe mund t'i mbysë ata, për shkak të veprave që bëjnë, por për shumë të tjera Ai i fal."** - A nuk mendojnë ata të mjerë dhe të pafuqishëm se, po të dëshirojë, Allahu i Madhërishëm mund t'i mbysë ata në mes të detit, për shkak të gjynaheve të shumta të tyre?! Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka, por edhe është Falës dhe Mëshirues i madh. Allahu i toleron dhe u lë kohë që të reflektojnë, për t'u penduar dhe për t'u kthyer të dorëzuar ndaj Tij. Ai u mundëson të shohin shenja të mjaftueshme për një besim të mirë. Por, gjithashtu, Allahu i Madhërishëm dhe i Urtë u ka lënë atyre mundësinë të zgjedhin atë që dëshirojnë.

- **"Ata që i kontestojnë argumentet Tona, le ta dinë se nuk kanë shpëtim."** - Ata që mundohen të hedhin poshtë shenjat e Allahut e dinë shumë mirë se askush nuk mund t'i shpëtojë prej Allahut të Madhërishëm. Nëse Ai zbret dënimin, askush nuk mund ta kthejë pas atë apo ta shmangë.

Ajetet 36 – 39

36. Gjërat që tashmë ju janë dhënë janë bukuritë e kësaj bote, ndërsa ato që janë tek Allahu janë shumë herë më të mira dhe të përjetshme, por ato janë për ata që besojnë dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten.
37. Ata iu ruhen gjynaheve të mëdha e veprave të pista dhe, kur zemërohen, ata falin.
38. Ata i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe e falin namazin rregullisht. Ata konsultohen me njëri-tjetrin për çështje të përbashkëta, ashtu siç e ndajnë me të tjerët atë që u japim Ne.
39. Por kur u bëhet padrejtësi, ata kundërveprojnë.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na nxit për të qenë më tepër shpërfillës ndaj kësaj dynjaje dhe sa më shumë të interesuar për ahiretin. Ai, gjithashtu, na tregon edhe rrugën për arritjen e këtij qëllimi.

- **"Gjërat që tashmë ju janë dhënë janë bukuritë e kësaj bote..."** - Çdo lloj mirësie që kemi, si: pasuria, fëmijët, pushteti, shëndeti i mirë, siguria, stabiliteti etj., janë thjesht stoli të kësaj bote të shkurtër, që do të përfundojë një ditë. Si e tillë, nuk ia vlen që të sakrifikosh shumë për të.

Më pas, i Madhëruari nxit njerëzit që t'i japin pikërisht ahiretit rëndësinë që i takon:

- **"...ndërsa ato që janë tek Allahu janë shumë herë më të mira dhe të përjetshme..."** - Ato që janë përgatitur dhe tani ekzistojnë tek Allahu, në Xhenet, janë shumë herë më të mira sesa mirësitë dhe lezetet e kësaj bote. Madje, mes tyre as që mund të bëhet ndonjë krahasim i përpiktë. Përveçse gjërat atje janë më të mira dhe më të bukura, ato kanë edhe një veçori tjetër, që i bën të pashembullta: ato janë të përjetshme, që nuk ndërpriten. Mirësitë e ahiretit do të shijohen pa mundime paraprake dhe pa merakun se një çast do të mbarojnë. Banorët e Xhenetit, gjithashtu, nuk do të mërziten kurrë apo të velen me këto mirësi.

Por për cilët është përgatitur ky lloj shpërblimi? I Gjithëmëshirshmi thotë:

- **"...por ato janë për ata që besojnë dhe që vetëm Zotit të tyre i mbështeten."** – Kështu, Allahu i Lartësuar na jep cilësitë dalluese të këtyre fatlumëve. Së pari, ata kanë besimin e

drejtë, të mbështetur në argumente të sakta dhe të sigurta nga Zoti. Sipas këtij besimi, ata kanë ndjenjat e zemrës dhe veprat e mira, sigurisht, të gjitha të sinqerta për Zotin, sepse besimi që deklarohet me gojë vërtetohet kur shprehet në ndjenjat e zemrës dhe në veprat e njeriut.

Cilësia e dytë e tyre është "*et-tuekkul*" ose: mbështetja e plotë e zemrave te Zoti për arritjen e çdo gjëje të mirë, që ata e dëshirojnë dhe për ruajtjen nga çdo gjë e keqe, së cilës ata i druhen, me sigurinë e plotë se Allahu i Lartësuar do t'ua japë atë që kërkojnë. *Teuekkul*-i është i domosdoshëm për kryerjen e çdo pune dhe për arritjen e çdo synimi. Çdo punë pa *teuekkul* është e mangët, jo e plotë.

- **"Ata iu ruhen gjynaheve të mëdha e veprave të pista..."** - Cilësi tjetër e atyre që meritojnë premtimin e të Madhërishmit për të hyrë në Xhenet është edhe largimi nga gjynahet e mëdha dhe veprat e pista.

Këtu janë përmendur dy gjëra: *kebâiral ithmi* - gjynahet e mëdha dhe *el feuâhish* - veprat e pista. Te gjynahet e mëdha hyjnë edhe veprat e pista, por këtu ato janë përmendur veçmas për të treguar rëndësinë e ndalimit të tyre. Ndryshimi mes të dyjave qëndron në faktin se *el feuâhish* quhen ato gjynahe të mëdha që nxiten nga nefsi ose nga tundimi i tij, si, për shembull, imoraliteti etj. Ndërsa gjynahet e tjera të mëdha nuk janë të tilla. Nëse përmenden së bashku, dallimet janë këto që sapo përmendëm, e nëse përmenden të veçuara ato përfshijnë njëra-tjetrën.

- **"...dhe, kur zemërohen, ata falin."** - Ata kanë cilësitë më të larta dhe virtytet e njerëzve më të mirë. Kështu edhe të falurit e tjetrit është cilësi e tyre, pjesë e karakterit të tyre. Kur dikush i zemëron me fjalë apo me vepra, ata nuk e shprehin këtë dhe nuk ndërmarrin veprime për ta shkarkuar zemërimin e tyre, por përkundrazi, e mbajnë të fshehur në shpirt, madje, çfarë është më e mrekullueshme, ata dinë të falin, ta justifikojnë tjetrin dhe të tolerojnë me mirësjellje. Ata dinë t'i përgjigjen padrejtësisë veçse me falje dhe bamirësi.

Me virtytin e lartë të të falurit arrihen shumë mirësi dhe u pritet rruga të këqijave të pallogaritshme. Shpirti i atij që fal gjen qetësi dhe lumturi, kurse ai që falet merr një mësim të mirë për mëshirën dhe faljen. Kështu mbillet dashuria dhe respekti, falja dhe toleranca në zemrat e njerëzve. Ky është morali i muslimanit me krijesat e Zotit, sikurse thotë i Gjithëdijshmi: "E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam musliman!"? E mira nuk është e barabartë me të keqen, prandaj ktheje atë (të keqen) me mënyrën më të mirë, se atëherë edhe ai me të cilin ke njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt. Mirëpo këtë nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që janë të durueshëm; dhe nuk mund ta arrijë kush, përveç atyre që kanë virtyt të lartë. E nëse ty të prek ndonjë ngacmim prej Shejtanit, ti kërko mbrojtje prej Allahut, se vërtet Ai është Dëgjuesi e i Dijshmi!" [Fussilet 33-36].

- **"Ata i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre..."** - Ata i përgjigjen Zotit të tyre, pra, vendosin t'i nënshtrohen dhe t'i binden Atij. Ata e presin ftesën e Allahut me respekt dhe vlerësim të lartë. Sapo dëgjojnë këtë ftesë, qëllimi i jetës së tyre bëhet arritja e kënaqësisë së Allahut të Madhëruar,

nëpërmjet fjalëve dhe veprave që Ai i dëshiron prej tyre.

Pjesë e përgjigjes së thirrjes së Zotit është edhe falja e namazit dhe shpenzimi për hir të Tij, por Allahu i Lartësuar i përmend këto vepra veçmas, për të treguar vlerën dhe rëndësinë e madhe të tyre:

- **"...e falin namazin rregullisht... (dhe) e ndajnë me të tjerët atë që u japim Ne."** - Ata kryejnë namazet e detyrueshme dhe ato të pëlqyeshme, me të gjithë elementët përbërës të tyre.

Ata, gjithashtu, shpenzojnë pasurinë e tyre për hir të Zotit, qoftë në drejtime të detyrueshme, siç është zekati, ndihma për të afërmit etj., qoftë në drejtime të tjera të pëlqyeshme.

- "Ata konsultohen me njëri-tjetrin për çështje të përbashkëta..." - Secili prej tyre nuk ia imponon mendimin e tjetrit në çështjet e përbashkëta.

Sigurisht, një virtyt i tillë mund të ekzistojë veçse në një shoqëri të bashkuar dhe të ndërtuar mbi një lidhje dashurie shumë të fortë. Pjesëtarët e kësaj shoqërie janë njerëz të formuar, me edukatë dhe të mençur. Nëse ata i shqetëson një çështje, e cila ka nevojë të studiohet dhe të pleqërohet mirë, ata mblidhen bashkë dhe e diskutojnë atë. Nëse shohin që është e dobishme, ia nisin punës për ta kryer atë. Kështu, për shembull, ata diskutojnë për çështjet e luftës, për emërimin e drejtuesve apo të gjykatësve, për çështje fetare e për çështje të tjera, që janë të nevojshme të trajtohen e të zgjidhen ashtu si është më e mira.

- **"Por kur u bëhet padrejtësi, ata kundërveprojnë."** - Nëse i luftojnë, ata me krenari nuk lejojnë që të shtypen nga të tjerët. Ata nuk i frikësohen takimit me armikun. Nëse luftojnë, Allahu i Lartësuar u dhuron fitoren. Ata luftojnë ose për fitore, ose për të rënë dëshmorë në rrugën e Zotit, duke mbrojtur të drejtën e tyre.

Këto, pra, janë cilësitë e tyre: besimi i drejtë, veprat e sinqerta sipas këtij besimi, mbështetja e plotë tek Allahu i Lartësuar, largimi nga gjynahet e mëdha dhe veprat e pista (largim që bën të mundur faljen e gjynaheve të vogla), nënshtrimi dhe bindja e plotë ndaj Zotit, përgjigjja ndaj ftesës së Zotit, kryerja e plotë e namazeve, shpenzimi i pasurisë për hir të Allahut, këshillimi mes njëri-tjetrit për çështje të përbashkëta dhe të rëndësishme, forca e madhe shpirtërore dhe krenaria mbi armiqtë e tyre. Duke qenë se ata kanë të tilla cilësi kaq të larta, për gjëra të tjera që janë edhe më të thjeshta dhe poshtë për nga rëndësia, ata janë edhe më të rregullt dhe më të mirë.

Ajetet 40 – 43

40. Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, por kush fal e përmirëson, shpërblimin e ka tek Allahu. Vërtet, Ai nuk i do të padrejtët.
41. Për ata që hakmerren për padrejtësinë që iu është bërë nuk ka ndonjë masë.
42. Masat janë vetëm për ata që u bëjnë njerëzve padrejtësi dhe për ata që bëjnë çrregullime në tokë pa të drejtë. Për të tillët është përgatitur një dënim i dhembshëm.
43. Por kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ai është virtyti më i lartë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ndëshkimi i të keqes bëhet me një të keqe në të njëjtën masë.."** - Allahu i

Lartësuar përmend në këtë ajet karakterin që mund të marrë shpagimi i një të keqeje. Ai mund të jetë: me drejtësi, me tolerancë dhe me padrejtësi.

Shpagimi me drejtësi është kur e keqja kthehet me të njëjtën formë, pa shtuar dhe pa pakësuar gjë, për shembull: kur jeta shpaguhet me jetë, plaga me plagë, pasuria me pasuri, me të njëjtën masë dhe mënyrë. Ndërsa shpagimi me tolerancë është kur e fal atë që të ka bërë keq, madje ia kthen me të mirë. Për këtë, i Gjithëmëshirshmi thotë:

- "...por kush fal e përmirëson, shpërblimin e ka tek Allahu." - Për këta njerëz, Allahu i Lartësuar ka përgatitur shpërblim të madh dhe mirësi të shumta.

Vërej me kujdes! Allahu i Lartësuar nuk ka urdhëruar thjesht për të falur, por ka shtuar edhe përmirësimin e gjendjes. Kjo do të thotë që, nëse shpresohet përmirësimi i gjendjes së atij që ka bërë padrejtësi, atëherë falja e tij është e shpërblyeshme dhe sjell mirësi të shumta. Por nëse falja nuk e përmirëson gjendjen e atij, nuk sjell të mira apo sjell shtimin e të këqijave, atëherë në këtë rast falja nuk është e shpërblyeshme, madje mund të jetë edhe e palejueshme.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar nuk ka përmendur ndonjë shpërblim të veçantë për këtë rast, por thjesht ka thënë se shpërblimi është tek Ai. Kjo e nxit më shumë njeriun dhe e bën të mendohet mirë për mënyrën se si sillet me njerëzit. Kjo e nxit atë që të shpresojë dhe të përpiqet më shumë për të arritur faljen e Allahut, duke falur dhe toleruar njerëzit ose duke u sjellë me ta ashtu sikurse shpreson që të trajtohet nga Allahu i Lartësuar. Dihet mirë se nëse ti fal të tjerët, edhe Allahu të fal ty, por të mos harrojmë se falja e Tij është shumë herë më e madhe dhe më bujare. Shpërblimi nga Allahu është sipas llojit të punës së robit. Kush do që Allahu ta falë, le të përpiqet që t'i falë njerëzit. Kush do që Allahu ta mëshirojë dhe t'ia mbulojë të metat, le të mëshirojë dhe të mbulojë të metat e të tjerëve.


Ndërsa për sa i përket shpagimit me padrejtësi, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Vërtet, Ai nuk i do të padrejtët." - Të padrejtë janë ata që u bëjnë padrejtësi të tjerëve, por edhe ata të cilët, kur duan të marrin hakun e tyre, e tejkalojnë masën. Edhe kjo e fundit konsiderohet padrejtësi, prandaj është e ndëshkueshme.

- "Për ata që hakmerren për padrejtësinë që iu është bërë nuk ka ndonjë masë." – Nëse dikush kërkon hakun e vet dhe vepron për ta arritur atë, pasi i është bërë padrejtësi, për të nuk ka qortim dhe as masa ndëshkimore, nëse nuk i kalon kufijtë.

Në këtë ajet thuhet: "për padrejtësinë që iu është bërë". Ndërsa pak më sipër thuhet: "Por kur u bëhet padrejtësi, ata kundërveprojnë.". Këto ajete tregojnë se hakmarrja bëhet ose kërkohet vetëm pasi të jetë kryer padrejtësia. Ndërsa ata që bëjnë padrejtësi pa asnjë shkak duhen ndëshkuar, që të vënë mend dhe të edukohen, që të mos u bien në qafë të tjerëve, me fjalët apo me veprat e tyre.

- "Masat janë vetëm për ata që u bëjnë njerëzve padrejtësi dhe për ata që bëjnë çrregullime në tokë pa të drejtë." - Masat ndëshkimore të vendosura nga Sheriati ekzekutohen mbi ata që u bëjnë padrejtësi njerëzve dhe mbi ata që bëjnë çrregullime në tokë, duke kaluar kufijtë. Këtu bëhet fjalë



për të gjitha llojet e krimeve, qofshin ata që cenojnë jetën, nderin apo pasurinë e të tjerëve. Për të gjithë ata është ky kërcënim:

- "Për të tillët është përgatitur një dënim i dhembshëm." – Ndëshkimi është i dhembshëm për zemrën dhe për trupin e tyre, në varësi të krimit që kanë bërë.

- "Por kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ai është virtyti më i lartë." - Ata që tregohen të durueshëm ndaj ngacmimeve që të tjerët u bëjnë, me fjalë apo me vepra, dhe i tolerojnë ata, – pra, nuk ndërmarin masa ndëshkuese kundër tyre thjesht për të plotësuar dëshirën e tyre hakmarrëse, – me të vërtetë kanë përvetësuar një nga cilësitë më të vyera. Allahu i Lartësuar ka nxitur shumë për t'u pajisur me këtë cilësi, të cilën, në fakt, e fitojnë veç njerëzit që Ai ua jep suksesin ta fitojnë. Nga ana e tyre, njerëz të tillë kanë vullnet të çeliktë, mençuri dhe dituri.

Në të vërtetë, lënia e hakmarrjes për vetveten është shumë e vështirë për shpirtin, sepse ai gjithmonë kërkon ta shkarkojë zemërimin dhe urrejtjen e tij. Ndërsa falja, tolerimi apo bamirësia ndaj atij që të ka bërë keq janë edhe më të vështira sesa thjesht lënia e hakmarrjes. Sidoqoftë, ato janë të thjeshta për atë që Allahu i Lartësuar ia lehtëson, pasi ai është përpjekur sinqerisht për të qenë i tillë dhe e ka lutur Allahun që t'ia arrijë qëllimit. Kur robi ia arrin këtij qëllimi, ai ndien ëmbëlsinë e virtytit dhe bëhet më i motivuar për të vazhduar atë rrugë, duke mos i lejuar vetes sjellje tjetër.

Ajetet 44 – 46

44. Atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë ndihmës tjetër veç Tij. Do t'i shohësh zullumqarët që, kur ta vërejnë dënimin, do të thonë: "A ka ndonjë rrugë për rikthim?"

45. Do t'i shohësh ata duke iu afruar atij të përulur nga nënshtrimi, se si e shikojnë tinëz me bisht të syrit. Besimtarët do të thonë: "Vërtet, të humbur në Ditën e Kijametit janë ata që e humbën veten dhe familjen e tyre!" Ta dini, pra, se të padrejtët do të jenë në dënim të përjetshëm.

46. Ata nuk do të kenë ndihmës që t'i mbështesë, përveç Allahut. Për atë që Allahu e çon në humbje, nuk ka asnjë shpëtim tjetër.

Shpjegimi i ajeteve

- "Atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk ka ndonjë ndihmës tjetër veç Tij" - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai është i vetmi që e

mundëson udhëzimin. Nëse Ai nuk të udhëzon në rrugën e drejtë, je i humbur dhe kurrë nuk mund ta gjesh udhëzimin pa ndihmën e Tij. Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë, prandaj udhëzon në rrugën e drejtë veçse ata që e meritojnë të udhëzohen, ndërsa të padrejtët dhe të pabindurit e kërkojnë humbjen vetë dhe e refuzojnë udhëzimin e Tij. Ata që refuzojnë udhëzimin e të Madhëruarit dhe e shpërfillin ftesën e Tij, askush nuk mund t'i ndihmojë për të dalë nga humbja dhe të gjejnë udhën e drejtë.

- "Do t'i shohësh zullumqarët që, kur ta vërejnë dënimin, do të thonë..." - Ajo është një skenë e frikshme, e trishtueshme dhe e pashpresë. Kur ata të shohin ndëshkimin që po u afrohet, do të pendohen shumë për çfarë kanë bërë në dynja. Ata do të brengosen për shpërfilljen e ftesës bujare të të Madhërishmit, por tashmë çdo gjë ka marrë fund dhe nuk kthehet më pas. Në një gjendje të tillë tmerri dhe dëshpërimi, ata do të thonë:

- "A ka ndonjë rrugë për rikthim?" – Kuptimi: A ka ndonjë mënyrë për t'u kthyer në dynja, që të veprojmë ndryshe nga ato që bëmë dhe që na futën këtu në Xhehenem?

Kjo është një kërkesë e dëshpëruar, që kurrë nuk do t'u plotësohet.

- "Do t'i shohësh ata duke iu afruar atij të përulur nga nënshtrimi, se si e shikojnë tinëz me bisht të syrit." - Kur ata të tërhiqen zvarrë për t'u flakur në Zjarr, do të shohësh tmerr të madh. Trupat dhe fytyrat e tyre janë shumë të frikësuara, sepse të tilla janë edhe zemrat e tyre. Të tmerruar, ata do vështrojnë tinëz Zjarrin, por nuk kanë më shpresë se do mund të shpëtojnë prej tij. E si mund ta shohin Zjarrin e frikshëm drejtpërdrejt?! Por, gjithsesi, kjo nuk u vlen aspak, sepse nuk ua lehtëson frikën që i ka pushtuar dhe që kurrë nuk do t'i lëshojë.

- "Besimtarët do të thonë: "Vërtet, të humbur në Ditën e Kijametit janë ata që e humbën veten dhe familjen e tyre!" - Kjo është dita kur do të shfaqet hapur përfundimi i krijesave: do të dallohen qartë të sinqertët nga gënjeshtarët. Në këtë ditë, besimtarët do të thonë: 'Të dështuarit e vërtetë janë ata që humbën vetveten dhe familjen e tyre, në këtë ditë të fitores ose humbjes së madhe. Atyre u iku përfundimisht shpërblimi i madh i të Gjithëmëshirshmit, sepse zgjodhën për veten e tyre ndëshkimin e dhimbshëm dhe poshtërues. Kësaj vuajtjeje i shtohet edhe dhimbja e ndarjes nga familjet e tyre, me të cilat kurrë nuk do të bashkohen!'

Fundi i këtyre është i trishtueshëm, siç thotë i Drejti:

- "Ta dini, pra, se të padrejtët do të jenë në dënim të përjetshëm." - Ata që kanë dëmtuar vetveten me gjynahe, mosbindje dhe mohim, do të jenë të zhytur në mes të Zjarrit: kurrë nuk kanë për të dalë prej andej dhe kurrë nuk do t'u lehtësohet ndëshkimi. Atje do të mbesin përgjithmonë dhe të pashpresë.

- "Ata nuk do të kenë ndihmës që t'i mbështesë, përveç Allahut." - Në dynja, ata gjejnë mbështetje te forca, pasuria dhe aleatët e tyre. Por në atë ditë që nuk do të ketë fund, ata nuk do t'i gjejnë pranë ndihmuesit e tyre dhe do të kuptojnë se çdo lidhje ka marrë fund. Tashmë ndëshkimi i

Zotit është i pashmangshëm dhe askush nuk mund t'i mbrojë ata. Këta të mjerë janë në humbje të sigurt, kur mendojnë se ndihmësit dhe aleatët e tyre mund t'u sjellin dobi apo t'i mbrojnë nga të këqijat.

- **"Për atë që Allahu e çon në humbje, nuk ka asnjë shpëtim tjetër."** - Ata që nuk e pranojnë udhëzimin e Allahut askush nuk mund t'i udhëzojë në rrugën e drejtë. Atë ditë do të shfaqen qartë të udhëzuarit nga të humburit.

Ajetet 47 – 48

47. Përgjigjjuni thirrjes së Zotit tuaj, para se të vijë dita kur Allahu nuk do të lejojë më kthim prapa. Atë ditë, ju nuk do të gjeni strehim dhe as nuk do të mund të mohoni.
48. Nëse ata refuzojnë, dije se Ne nuk të kemi dërguar ty si përgjegjës të tyre. Ti ke për detyrë vetëm komunikimin. Vërtet, kur Ne i dhurojmë njeriut nga ana Jonë ndonjë të mirë, ai gëzohet për të, e kur e godet ndonjë e keqe që e ka merituar vetë, atëherë njeriu bëhet përçmues.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Përgjigjjuni thirrjes së Zotit tuaj..."** - Allahu i Lartësuar na urdhëron që t'i përgjigjemi plotësisht dhe me përkushtim ftesës së Tij plot jetë dhe mirësi. Pranimi i kësaj ftese nënkupton kryerjen me sinqeritet të porosive të Allahut të Lartësuar dhe largimin nga ndalesat e Tij me durim dhe këmbëngulje. Gjithashtu, ky pranim duhet të bëhet menjëherë dhe të mos shtyhet me: "Do të...".

- **"...para se të vijë dita kur Allahu nuk do të lejojë më kthim prapa."** - Ne duhet të nxitojmë të zbatojmë porositë dhe udhëzimet e Tij, para se të vijë dita që nuk ka dyshim në vërtetësinë e saj. Ajo është Dita e Kijametit, ditë kur nuk mund të arrihet më çfarë është lënë pas dhe nuk mund të rregullohet çfarë është shkatërruar.

- **"Atë ditë, ju nuk do të gjeni strehim dhe as nuk do të mund të mohoni."** - Atë ditë nuk mund të gjesh strehim dhe mbrojtje nga drejtësia e të Drejtit. Atë ditë nuk mund t'i shpëtosh llogarisë, por çdokush do të marrë atë që meriton. Atë ditë, melekët do t'i rrethojnë krijesat nga të gjitha drejtimet dhe do t'u thonë: "O turmë e xhindëve dhe e njerëzve! Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës, dilni! Por ju nuk mund ta bëni këtë, pa patur fuqi." Atë ditë, robi nuk mund t'i mohojë padrejtësitë dhe krimet që ka bërë. Edhe sikur ta bënte, do të dilnin t'i dëshmonin të kundërtën vetë gjymtyrët e tij.

Ky ajet, e të tjerë të ngjashëm me të, kritikon vonesën e të vetëmashtruarve, të cilët nuk shpejtojnë për zbatimin e porosive të Zotit, por gjithmonë justifikohen duke thënë: "Do të... do të....". Allahu i Lartësuar na urdhëron që të nxitojmë për zbatimin e urdhëresave të Tij dhe të shfrytëzojmë sa më shpejt çdo mundësi që Ai na ofron për punë të mira.

- **"Nëse ata refuzojnë, dije se Ne nuk të kemi dërguar ty si përgjegjës të tyre."** – Kuptimi: Nëse ata, pas qartësimit të plotë të së vërtetës, të kthejnë shpinën dhe shpërfillin ftesën tënde për në rrugën e Allahut, kujto që Allahu nuk të ka dërguar ty që të jesh përgjegjës për veprimet e tyre. Nuk është përgjegjësia jote që ata nuk e pranojnë udhëzimin e Allahut. Detyra jote

është vetëm kumtimi dhe qartësimi i të vërtetës për ta.

- **"Ti ke për detyrë vetëm komunikimin**. - Nëse t'i bën detyrën tënde të transmetimit të plotë të së vërtetës, do të marrësh shpërblimin tënd tek Allahu i Lartësuar, pavarësisht a i përgjigjen njerëzit ftesës tënde apo nuk i përgjigjen, e pranojnë atë apo nuk e pranojnë. Llogaria e veprave të tyre është tek Allahu i Drejtë, i Cili do të shpërblejë gjithësecilin për çfarë ka bërë në këtë jetë, të vogël a të madhe, të dukshme a të fshehur.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar flet për gjendjet në të cilat kalon njeriu dhe për mënyrën se si ai sillet në këto gjendje:

- "Vërtet, kur Ne i dhurojmë njeriut nga ana Jonë ndonjë të mirë, ai gëzohet për të..." - Kur Allahu i Lartësuar, nga bujaria e Tij, i dhuron njeriut mirësi të ndryshme, si: shëndet, qetësi, pasuri, fëmijë, famë, pushtet, etj., njeriu gëzohet. Allahu i Lartësuar thotë: "*...ai gëzohet për të*", pra, gëzohet me mirësinë që ka, dhe vetëm kaq. Me fjalë të tjera, kënaqësia e tij lidhet veçse me mirësinë e dhënë, ndërkohë që njeriu duhet ta gjejë gëzimin, kënaqësinë dhe lumturinë veçse me Zotin e tij, me Allahun e Lartësuar. Vetëm duke u afruar pranë të Gjithëmëshirshmit me adhurime dhe vepra të mira, vjen qetësia dhe lumturia. Edhe mirësitë e shumta që njeriu ka, nuk janë gjë tjetër veçse dhurata të Allahut të Lartësuar, prandaj ato duhet që ta shtojnë më tepër dashurinë dhe madhërimin për Të. Nëse ne gëzohemi thjesht dhe vetëm me mirësitë që kemi, duke harruar Allahun e Lartësuar që na i ka falur, kjo është vërtet një mosmirënjohje ndaj Tij, që patjetër do të sjellë trishtim dhe vuajtje.

- "...e kur e godet ndonjë e keqe që e ka merituar vetë, atëherë njeriu bëhet përçmues." - Kur njeriu goditet me ndonjë fatkeqësi, si sëmundje, varfëri, etj., ai menjëherë i harron të gjitha mirësitë që gëzonte para kësaj fatkeqësie.


Sprovat vijnë si pasojë e vetë punëve të këqija të robit. Madje, për shumë gjynahe, i Madhërishmi fal dhe afatizon. Sikur Zoti ta dënonte njeriun për çdo gjynah të bën, atëherë nuk do të mbetej askush mbi faqen e dheut, por Zoti i Lartësuar është Mëshirues dhe Falës. Allahu e sprovon njeriun, me qëllim që ai të kthejë rrugë dhe të reflektojë për mosmirënjohjen e treguar deri në atë çast, para se të vijë dita kur nuk bën më dobi reflektimi dhe pendimi. Por sërish, njeriu ka një natyrë mosmirënjohëse, prandaj sapo goditet nga një fatkeqësi, i harron të gjitha mirësitë që Zoti i ka dhuruar. Në vend të durimit dhe falënderimit, ai shpreh zemërimin dhe pakënaqësinë për caktimin e Zotit të Urtë dhe të Gjithëmëshirshëm.

Ajetet 49 – 50

49. Vetëm i Allahut është pushteti i qiejve e i tokës. Ai krijon çfarë të dojë. Ai i fal vetëm vajza atij që Ai do, e i fal vetëm djem atij që Ai do.
50. Ose fal edhe djem, edhe vajza. Ndërsa atë që Ai dëshiron e lë pa fëmijë. Ai është i Dijshëm, i Plotpushtetshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vetëm i Allahut është pushteti i qiejve e i tokës." - Pushteti i qiejve e i tokës është në dorë të Allahut. Ai krijon çfarë të dojë dhe


الجزء الخامس والعشرون سورة الزخرف

وَكَذَٰلِكَ أَوْحَيْنَآ إِلَيْكَ رُوحًا مِّنْ أَمْرِنَا ۚ مَا كُنتَ تَدْرِى مَا ٱلْكِتَٰبُ
وَلَا ٱلْإِيمَٰنُ وَلَٰكِن جَعَلْنَٰهُ نُورًا نَّهْدِى بِهِۦ مَن نَّشَآءُ مِنْ عِبَادِنَا ۚ
وَإِنَّكَ لَتَهْدِىٓ إِلَىٰ صِرَٰطٍ مُّسْتَقِيمٍ ﴿٥٢﴾ صِرَٰطِ ٱللَّهِ ٱلَّذِى لَهُۥ
مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۗ أَلَآ إِلَى ٱللَّهِ تَصِيرُ ٱلْأُمُورُ ﴿٥٣﴾

سُورَةُ الزُّخْرُفِ

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

حمٓ ﴿١﴾ وَٱلْكِتَٰبِ ٱلْمُبِينِ ﴿٢﴾ إِنَّا جَعَلْنَٰهُ قُرْءَٰنًا عَرَبِيًّا
لَّعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿٣﴾ وَإِنَّهُۥ فِىٓ أُمِّ ٱلْكِتَٰبِ لَدَيْنَا
لَعَلِىٌّ حَكِيمٌ ﴿٤﴾ أَفَنَضْرِبُ عَنكُمُ ٱلذِّكْرَ صَفْحًا
أَن كُنتُمْ قَوْمًا مُّسْرِفِينَ ﴿٥﴾ وَكَمْ أَرْسَلْنَا مِن نَّبِىٍّ فِى
ٱلْأَوَّلِينَ ﴿٦﴾ وَمَا يَأْتِيهِم مِّن نَّبِىٍّ إِلَّا كَانُوا۟ بِهِۦ يَسْتَهْزِءُونَ
﴿٧﴾ فَأَهْلَكْنَآ أَشَدَّ مِنْهُم بَطْشًا وَمَضَىٰ مَثَلُ ٱلْأَوَّلِينَ
﴿٨﴾ وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ لَيَقُولُنَّ
خَلَقَهُنَّ ٱلْعَزِيزُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٩﴾ ٱلَّذِى جَعَلَ لَكُمُ ٱلْأَرْضَ
مَهْدًا وَجَعَلَ لَكُمْ فِيهَا سُبُلًا لَّعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ ﴿١٠﴾

٤٨٩

vepron në krijimin e Tij si të dëshirojë. Nuk ndodh asgjë në këtë gjithësi pa lejen dhe fuqinë e Tij. Është Allahu që rregullon çështjet e krijesave, me urtësinë dhe mëshirën e Tij, qoftë për gjërat më të vogla në dukje. Madje, Ai ka nën kontroll edhe ato çështje, sebepet e të cilave i ka lënë në dorë të krijesave. Është e vërtetë që njerëzit martohen me njëri-tjetrin për të bërë fëmijë, por është i Gjithëdituri e i Urti Ai që përcakton se çfarë do t'u japë ose nuk do t'u japë atyre. Kështu, i Madhërishmi thotë:

- "Ai krijon çfarë të dojë. Ai i fal vetëm vajza atij që Ai do, e i fal vetëm djem atij që Ai do. Ose fal edhe djem, edhe vajza. Ndërsa atë që Ai dëshiron e lë pa fëmijë." - Me urtësinë e Tij, Allahu i Lartësuar i fal vetëm vajza dikujt që Ai dëshiron, ndërsa dikujt tjetër i fal vetëm meshkuj; ose i fal edhe djem, edhe vajza. Po ashtu, dikë tjetër, – siç Allahu dëshiron, – e lë pa fëmijë. Çdo përcaktim i Allahut fsheh urtësi që ne nuk i dimë. Ai është i Urtë e i Gjithëdijshëm, prandaj ne duhet të kënaqemi gjithmonë me përcaktimin e Tij dhe t'i shprehim mirënjohjen tonë për çdo gjë. Mirënjohësit janë të lumtur në çdo gjendje, ndërsa përçmuesit kurrë nuk kënaqen.

- "Ai është i Dijshëm, i Plotpushtetshëm." - Allahu është i Gjithëdijshëm për krijesat e tij dhe i Plotpushtetshëm për gjithçka që dëshiron. Ai ka përcaktuar çdo gjë me përpikmëri dhe saktësi.

Ajetet 51 – 53

51. Nuk ka asnjë njeri që Allahu t'i ketë folur ndryshe, përveçse me anë të frymëzimit, ose pas një perdeje, ose me anë të një të dërguari, që i shpall – me lejen e Tij – atë që Ai do. Vërtet, Ai është më i Larti, më i Urti.
52. Po kështu të shpallëm edhe ty Shpirtin. Ti nuk dije çfarë ishte Libri dhe as ç'ishte imani, por Ne e bëmë atë dritë, me të cilën e udhëzojmë në rrugë të drejtë atë që Ne dëshirojmë prej robërve Tanë. Pa dyshim, edhe ti udhëzon në rrugën e drejtë,
53. në rrugën e Allahut, të Cilit i takon ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë. Ta dini, se tek Allahu kthehen të gjitha çështjet.

Shpjegimi i ajeteve

Mohuesit e Zotit dhe të profetëve të Tij thoshin: "Pse të mos na flasë vetë Zoti, ose të na sjellë ndonjë shenjë të madhe?!" Kjo qe vërtet një arrogancë nga ana e tyre. Kësaj kërkese të paturpshme, Allahu i Lartësuar i përgjigjet duke treguar se cilat janë format e ardhjes së Shpalljes hyjnore:

- "Nuk ka asnjë njeri që Allahu t'i ketë folur ndryshe, përveçse me anë të frymëzimit..." – Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar e jep mesazhin e Tij duke e hedhur atë drejt e në zemrën e profetit, pa i folur drejtpërdrejt dhe pa ndërmjetësinë e Melekut të Shpalljes (Xhibrilit a.s.) apo të melekëve të tjerë. Kjo është njëra formë e Shpalljes. Forma e dytë është:

- "...pas një perdeje..." - Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar i flet vetë profetit, por pas perdes. Pra, profeti e dëgjon Krijuesin e tij, por nuk e sheh Atë. Kështu iu shpall revelata Musait (a.s.), i cili u quajt edhe "*Kelîmur-rahmân*" (ai të cilit Mëshiruesi i foli). Po këtë mënyrë iu shpall Muhamedit (a.s.) detyrimi i pesë namazeve ditore, kur u ngjit në qiell Natën e Israsë dhe të Mi'râxhit. Mënyra e tretë e Shpalljes është:

- "....me anë të një të dërguari, që i shpall – me lejen e Tij – atë që Ai do." - Allahu i Lartësuar dërgon te profeti një lajmëtar prej melekëve, si Xhibrili apo ndonjë melek tjetër, dhe i përcjell atij çfarë Ai dëshiron.

Këtu, Allahu i Lartësuar bën dy cilësime shumë të rëndësishme, kur thotë, së pari: "*me lejen e Tij*", pra, jo kur dhe si dëshiron meleku apo njeriu, por kur dhe si dëshiron Allahu. Së dyti, Ai cilëson: "*atë që Ai do*", pra, atë që do Zoti dhe jo atë që do meleku apo njeriu.

- "Vërtet, Ai është më i Larti, më i Urti." - Allahu i Madhërishëm është më i Larti në Qenien e Tij, më i Larti dhe i Madhërishmi në cilësitë dhe emrat e Tij, më i Larti dhe i Urti në veprat e Tij. Para krenarisë dhe madhështisë së Tij është nënshtruar çdo krijesë. Të gjithë janë krijesa të varfra, të nënshtruara dhe nevojtare për mëshirën dhe përkujdesin e Tij dhe vetëm Allahu është i Lartësuari, i Madhërishmi, që nuk ka nevojë për asgjë. Askush nuk është i përafërt apo i ngjashëm me Allahun. Ai është Urti, që gjithçka e vendos në vendin që i takon. Urtësia e Tij është absolutisht e plotë si në aspektin e krijimit, ashtu edhe në aspektin e ligjeve, që Ai u solli njerëzve përmes librave dhe profetëve të Tij.

- "Po kështu të shpallëm edhe ty Shpirtin." – Kuptimi: Ashtu sikurse u dhamë mesazhe profetëve para teje, edhe ty po të shpallim këtë Kuran madhështor.

Allahu i Lartësuar e ka quajtur Kuranin *Rûh* - Shpirt, sepse ashtu sikurse trupi nuk jeton dot pa shpirtin, ashtu edhe zemrat e njerëzve nuk mund të jetojnë pa Kuranin. Ky libër u jep jetë zemrave dhe, nëpërmjet tij, njerëzit përfitojnë nga mirësitë e dynjasë dhe të fesë.

Kurani është një mirësi thjesht e dhuruar nga Zoti për profetin e Tij dhe për besimtarët, pa asnjë përpjekje prej tyre, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Ti nuk dije çfarë ishte Libri dhe as ç'ishte imani..." - Kuptimi: Para Shpalljes së Kuranit, ti nuk dije gjë rreth librave të mëparshëm të shpallur nga Allahu i Lartësuar. Ti nuk kishe dijeni për imanin dhe as për ligjet fetare të kaluara, të përcaktuara nga Zoti për profetë dhe popuj të ndryshëm. Ti ishe thjesht një *ummij*, që nuk dinte shkrim e lexim. Megjithatë, është Allahu Ai që të përzgjodhi ty për të të dhuruar këtë libër madhështor, këtë dritë, me të cilën njerëzit shohin dhe gjejnë rrugën e drejtë të adhurimit të një Zoti të vetëm.

- "...por Ne e bëmë atë dritë, me të cilën e udhëzojmë në rrugë të drejtë atë që Ne dëshirojmë prej robërve Tanë." - Nëpërmjet Kuranit, njerëzit shohin të ndriçuar rrugën për të shkuar tek Allahu i Dashur dhe i Lartësuar. Drita e Kuranit largon errësirat e kufrit, të idhujtarisë dhe të çdo lloj devijimi. Ai është drita që e shpëton robin nga errësirat dhe greminat e dëshirave të shfrenuara dhe të poshtra, që sjellin veçse shkatërrim dhe dëshpërim. Nëpërmjet Kuranit, adhuruesit e Allahut shohin qartë realitetin e kësaj bote dhe e trajtojnë gjithçka ashtu sikurse e meriton. Ai është rruga e drejtë e Allahut, dhe nuk ka rrugë tjetër që të afron tek Ai, veç asaj që është e ndriçuar nga ky libër.

- "Pa dyshim, edhe ti udhëzon në rrugën e drejtë..." - Allahu i Lartësuar e përgëzon dhe inkurajon Profetin e Tij, duke i kujtuar se edhe ai si profet është udhëzues për në rrugën e drejtë.

Udhëzimi që bën një profet është qartësimi i plotë i rrugës së drejtë, me fakte dhe argumente të pakundërshtueshme, duke nxitur njerëzit për ta ndjekur këtë rrugë. Pjesë e udhëzimit që bën profeti është, gjithashtu, edhe sqarimi i rrugëve të së keqes dhe thirrja për t'u larguar prej tyre.

Pastaj Allahu i Lartësuar përcakton më mirë se cila është rruga e drejtë:

- "...në rrugën e Allahut, të Cilit i takon ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë." - Rruga e drejtë është rruga që Allahu, Krijuesi dhe Sunduesi i qiejve dhe Tokës e solli dhe e bëri të qartë për njerëzit, nëpërmjet profetëve të Tij dhe librave të shenjtë. Vetëm kjo është rruga që të çon tek Ai dhe të fut në Xhenetin e mirësive. Për këtë arsye, le të zgjedhë gjithësecili rrugën dhe fjalët ku bazohet. Por le të kujtojë edhe një fakt shumë të rëndësishëm:

- "Ta dini, se tek Allahu kthehen të gjitha çështjet." - Le të kujtojmë vazhdimisht se, do të vijë një ditë, kur të gjitha veprat tona do të llogariten nga i Drejti e i Gjithëdijshmi. Nëse kemi punuar mirë dhe sipas besimit të drejtë të bazuar në Librin e Allahut, shpërblimi ynë do të jetë Xheneti dhe kënaqësia e përjetshme pranë Krijuesit. Por nëse kemi shpërfillur Shpalljen e Allahut dhe nuk kemi punuar me sinqeritet, atëherë fundi do të jetë Xhehenemi - Allahu na ruajtë prej tij!

Këtu përfundon tefsiri i sures Esh-shûrâ. Falënderimi dhe lavdia e plotë i qoftë Allahut të Madhërishëm, fillim e mbarim, haptas dhe fshehtas, për lehtësimet dhe dhuratat e Tij bujare!

Surja 43: Ez Zuhruf (mekase) 89 ajete

Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ha, Mim.
2. Betohem në Librin e qartë!
3. Me të vërtetë, Ne e shpallëm Kuranin në arabisht, që të jetë i kuptueshëm për ju.
4. Nuk ka dyshim se, në Pllakën e Ruajtur (*Levhi Mahfudh*) te Ne, ai është i lartë dhe plot urtësi.
5. Vallë, a do ta lëmë Ne përkujtimin tuaj e t'ju braktisim, për shkak se jeni popull i shfrenuar?!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ha, Mim. Betohem në Librin e qartë!" - Ky është një betim i Allahut për Kuranin. Allahu i Lartësuar e ka quajtur Kuranin *mubîn* - të qartë dhe qartësues. Duhet theksuar se i Lartësuari nuk e ka përcaktuar se për çfarë është sqarues ky libër madhështor, për të na dhënë të kuptojmë se ai është sqarues i gjithçkaje për të cilën kanë nevojë robërit, qoftë në çështjet e dynjasë, qoftë në ato të besimit dhe të ahiretit.

- "Me të vërtetë, Ne e shpallëm Kuranin në arabisht, që të jetë i kuptueshëm për ju." – Është Allahu që e shpalli Kuranin madhështor në gjuhën më të zgjedhur, më të qartë, më të kuptueshme, pra, në gjuhën arabe.

Më pas, i Lartësuari tregon qëllimin e shpalljes së Kuranit në arabisht, duke thënë: "...që të jetë i kuptueshëm për ju". Pra, Ai e përzgjodhi këtë gjuhë për Kuranin, që mesazhit i Tij të jetë më i kuptueshëm dhe më i kapshëm për mendjen tonë.

- "Nuk ka dyshim se, në Pllakën e Ruajtur (*Levhi Mahfudh*) te Ne, ai është i lartë dhe plot urtësi." - Ky libër është shumë i nderuar dhe i lartësuar në mbretërinë e qiellit. Ai është përshkruar me dy cilësi: i lartë dhe plot urtësi. Kurani është i lartë në gradën, famën, rëndësinë dhe madhështinë e tij. Ai është plot urtësi në diturinë që përmban, në urdhëresat, ndalesat dhe lajmet që sjell. Në të nuk gjendet asnjë gjykim dhe dispozitë që të jetë në kundërshtim me urtësinë dhe drejtësinë.


Pastaj i Lartësuari na tregon se urtësia dhe mëshira e Tij kurrë nuk do t'i linte robërit e Tij të shpërfillur dhe të braktisur, pa u dërguar libra të shenjtë dhe profetë, që t'i udhëzojnë ata në rrugën e drejtë, edhe pse njerëzit janë të padrejtë dhe i kalojnë kufijtë. Pra, fakti që njerëzit tregohen të padrejtë, nuk bën që Allahu t'i braktisë dhe të mos përkujdeset për udhëzimin e tyre. Për këtë arsye, i Lartësuari sjell një pyetje, e cila përmban mohim dhe habi njëkohësisht.

- "Vallë, a do ta lëmë Ne përkujtimin tuaj e t'ju braktisim, për shkak se jeni popull i shfrenuar?!" - Asnjëherë të mos mendohet se Allahu mund t'i linte njerëzit pa u shpallur libra hyjnorë dhe pa u dërguar profetë, që do t'i udhëzonin në rrugën e drejtë për të gjetur lumturinë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Fakti që njerëzit i kundërshtojnë librat dhe profetët e Tij nuk mund ta pengonte të Gjithëmëshirshmin që t'u jepte Shpallje hyjnore, ku t'u tregonte gjithçka për të gjetur rrugën e drejtë dhe lumturinë në të dyja jetët. Kështu, nëse ata besojnë, kjo është mirësi dhe dhuratë nga i Madhëruari, që është Shpërblyesi më i mirë, për përpjekjet e tyre modeste. Por nëse zgjedhin të refuzojnë, atëherë ata nuk do të kenë më asnjë justifikim para Allahut të Drejtë, por i pret ndëshkimi i përjetshëm.

Ajetet 6 – 8

6. Sa e sa profetë kemi dërguar në popujt e mëparshëm?!
7. Por sa herë që u vinte një profet, ata talleshin me të.
8. Ne kemi shkatërruar popuj edhe më të fuqishëm se këta, të cilëve jua kemi treguar shembullin e popujve të shkuar.

Shpjegimi i ajeteve


الجزء الخامس والعشرون سورة الزخرف
وَٱلَّذِى نَزَّلَ مِنَ ٱلسَّمَآءِ مَآءًۢ بِقَدَرٍ فَأَنشَرْنَا بِهِۦ بَلْدَةً مَّيْتًا ۚ
كَذَٰلِكَ تُخْرَجُونَ ﴿١١﴾ وَٱلَّذِى خَلَقَ ٱلْأَزْوَٰجَ كُلَّهَا وَجَعَلَ
لَكُم مِّنَ ٱلْفُلْكِ وَٱلْأَنْعَٰمِ مَا تَرْكَبُونَ ﴿١٢﴾ لِتَسْتَوُۥا۟ عَلَىٰ ظُهُورِهِۦ
ثُمَّ تَذْكُرُوا۟ نِعْمَةَ رَبِّكُمْ إِذَا ٱسْتَوَيْتُمْ عَلَيْهِ وَتَقُولُوا۟ سُبْحَٰنَ
ٱلَّذِى سَخَّرَ لَنَا هَٰذَا وَمَا كُنَّا لَهُۥ مُقْرِنِينَ ﴿١٣﴾ وَإِنَّآ إِلَىٰ رَبِّنَا
لَمُنقَلِبُونَ ﴿١٤﴾ وَجَعَلُوا۟ لَهُۥ مِنْ عِبَادِهِۦ جُزْءًا ۚ إِنَّ ٱلْإِنسَٰنَ
لَكَفُورٌ مُّبِينٌ ﴿١٥﴾ أَمِ ٱتَّخَذَ مِمَّا يَخْلُقُ بَنَاتٍ وَأَصْفَىٰكُم
بِٱلْبَنِينَ ﴿١٦﴾ وَإِذَا بُشِّرَ أَحَدُهُم بِمَا ضَرَبَ لِلرَّحْمَٰنِ مَثَلًا
ظَلَّ وَجْهُهُۥ مُسْوَدًّا وَهُوَ كَظِيمٌ ﴿١٧﴾ أَوَمَن يُنَشَّؤُا۟ فِى
ٱلْحِلْيَةِ وَهُوَ فِى ٱلْخِصَامِ غَيْرُ مُبِينٍ ﴿١٨﴾ وَجَعَلُوا۟ ٱلْمَلَٰٓئِكَةَ
ٱلَّذِينَ هُمْ عِبَٰدُ ٱلرَّحْمَٰنِ إِنَٰثًا ۚ أَشَهِدُوا۟ خَلْقَهُمْ ۚ سَتُكْتَبُ
شَهَٰدَتُهُمْ وَيُسْـَٔلُونَ ﴿١٩﴾ وَقَالُوا۟ لَوْ شَآءَ ٱلرَّحْمَٰنُ مَا عَبَدْنَٰهُم ۗ
مَّا لَهُم بِذَٰلِكَ مِنْ عِلْمٍ ۖ إِنْ هُمْ إِلَّا يَخْرُصُونَ ﴿٢٠﴾ أَمْ ءَاتَيْنَٰهُمْ
كِتَٰبًا مِّن قَبْلِهِۦ فَهُم بِهِۦ مُسْتَمْسِكُونَ ﴿٢١﴾ بَلْ قَالُوٓا۟ إِنَّا
وَجَدْنَآ ءَابَآءَنَا عَلَىٰٓ أُمَّةٍ وَإِنَّا عَلَىٰٓ ءَاثَٰرِهِم مُّهْتَدُونَ ﴿٢٢﴾
٤٩٠

- “Sa e sa profetë kemi dërguar në popujt e mëparshëm?!” - Allahu i Lartësuar tregon një nga rregullat e pandryshueshme të Tij, që e ka vendosur në gjithësi. Ai nuk i ka lënë njerëzit pa udhëzim dhe pa profetë. Janë të shumtë profetët e dërguar, të cilët kanë urdhëruar popujt e tyre për adhurimin e një Zoti të vetëm, për adhurimin e Allahut të Lartësuar. Ata kanë urdhëruar për t’u larguar nga idhujtaria dhe për bindje ndaj Allahut. Por, megjithatë, mosbesimi dhe mosbindja kanë ekzistuar gjithmonë ndër popuj, siç thotë i Lartësuari:

- “Por sa herë që u vinte një profet, ata talleshin me të.” - Ata e kanë refuzuar me arrogancë të vërtetën e sjellë nga profetët e Allahut dhe me paturpësi janë tallur me ta. Por si ishte përfundimi i tyre, vallë? Allahu i Lartësuar thotë:

- “Ne kemi shkatërruar popuj edhe më të fuqishëm se këta, të cilëve jua kemi treguar shembullin e popujve të shkuar.” – Kuptimi: Allahu i Madhërishëm i ka shkatërruar popujt e shfrenuar dhe të pabindur. Prandaj edhe ju të mos ju mashtrojë fuqia dhe pushteti që keni. Allahu i Lartësuar ka shkatërruar popuj edhe më të fuqishëm e më të mëdhenj se ju. Historitë e tyre janë përmendur shumë qartë në Kuran. Merrni mësim dhe ruajuni që të mos ju godasin edhe ju ndëshkimet që kanë goditur ata. Mos shpërfillni Shpalljen e Allahut dhe kujdes me pasimin e rrugës së Profetit!

Ajetet 9 – 14

9. Nëse ti i pyet ata: “Kush i krijoi qiejt e Tokën?” Me siguri do të thonë: “Ato i krijoi i Gjithëfuqishmi e i Dijshmi!”
10. Është Ai i Cili e bëri Tokën si shtrat për ju dhe ju mundësoi të keni rrugë e të orientoheni në të.
11. Është Ai i Cili lëshon nga qielli shi me masë, me të cilin i japim jetë tokës së shkretuar. Ja, kështu do të ringjalleni edhe ju!
12. Është Ai i Cili ka krijuar gjithçka në çift dhe që ju ka mundësuar anije dhe kafshë, që të udhëtoni me to.
13. Kur të uleni mbi to, përkujtojeni këtë të mirë që ju ka dhënë Zoti juaj dhe, pasi të qëndroni mbi to, thoni: “I Lavdëruar qoftë Ai, që i nënshtroi këto për ne, sepse përndryshe, vetë ne nuk do të kishim mundësi ta bënim!
14. Ne, me siguri, te Zoti ynë do të kthehemi!”

Shpjegimi i ajeteve

- “Nëse ti i pyet ata: “Kush i krijoi qiejt e Tokën?” Me siguri do të thonë: “Ato i

krijoi i Gjithëfuqishmi e i Dijshmi!" – Allahu i Lartësuar na tregon rreth besimit të idhujtarëve. Kështu, nëse i pyet ata se kush i krijoi qiejt e lartë dhe Tokën e mrekullueshme, ata do të pohojnë se Krijuesi i tyre është Allahu i Lartësuar, Fuqiplotë e i Gjithëdijshëm. Pra, ata e pranojnë që Krijuesi i gjithësisë është Allahu i Madhërishëm dhe e pranojnë se Ai është Fuqiplotë dhe i Gjithëdijshëm. Çdo krijesë është e nënshtruar dhe e përulur para Tij. Allahu di për gjithçka në këtë gjithësi. Ai di të dukshmen dhe të fshehtën dhe Atij nuk mund t'i fshihet asgjë.

Subhanallâh! Kur ata e pranojnë një gjë të tillë, si është mundur që shpifin ndaj Allahut, duke thënë se Ai ka fëmijë, grua apo partner në pushtetin dhe zotërimin e Tij?! Si është e mundur që t'i përkushtojnë adhurime dikujt që nuk ka fuqi të krijojë, të furnizojë, të japë jetë dhe të japë vdekje?!

Pastaj i Lartësuari argumenton për pushtetin e Tij gjithëpërfshirës dhe mirësitë e Tij të shumta me faktin që Ai është Krijuesi dhe Rregulluesi i Tokës, me të gjitha kushtet e përshtatshme në të. Ai thotë:

- **"Është Ai i Cili e bëri Tokën si shtrat për ju dhe ju mundësoi të keni rrugë e të orientoheni në të."** - Është Allahu i Lartësuar Ai që e bëri Tokën të përshtatshme për jetën në të, me të gjitha kushtet e nevojshme. Ai e bëri atë të qëndrueshme, që njerëzit të arrijnë çfarë të dëshirojnë në të. Është i Gjithëmëshirshmi që, përmes vargmaleve mundësoi rrugëkalime, që njerëzit të lëvizin atje ku dëshirojnë. Nëpërmjet këtyre rrugëkalimeve, ata orientohen dhe nuk humbasin. Por këto mirësi dhe kushte për jetën në Tokë Allahu i Madhëruar i bëri edhe me qëllimin që ne të meditojmë dhe të kuptojmë madhështinë dhe mrekullinë e krijimit të Tij.

- "Është Ai i Cili lëshon nga qielli shi me masë..." - Allahu i Madhëruar e zbret shiun nga qielli me masë të caktuar, pra, jo më pak sesa është e nevojshme, dhe jo më shumë sesa duhet, që të dëmtojë njerëzit dhe vendet. Ai e zbret shiun si jetë dhe gjallëri, për të shpëtuar vendet nga shkretimi dhe për t'i mbushur njerëzit me shpresë, siç thotë më pas i Madhëruari:

- "...me të cilin i japim jetë tokës së shkretuar." - Nëpërmjet shiut, Allahu i Lartësuar ngjall një vend të shkretuar e të vdekur.

Ky është një shembull i thjeshtë për të kuptuar pushtetin e plotë të Allahut për të ringjallur krijesat pas vdekjes së tyre. Pra, ashtu sikurse Ai është i Plotfuqishëm për të ringjallur një tokë pas vdekjes së saj, po ashtu është i Plotfuqishëm që të ringjallë edhe njerëzit pas vdekjes së tyre, siç thotë më tej:

- "Ja, kështu do të ringjalleni edhe ju!" – Kuptimi: Edhe ju do të ringjalleni kështu Ditën e Gjykimit, për të marrë shpërblimin e punëve tuaja.
Pra, sa herë që shohim shiun t'i japë jetë një toke të vdekur, le të kujtojmë ringjalljen dhe llogarinë tonë para Krijuesit të Drejtë dhe të Gjithëdijshëm.

- **"Është Ai i Cili ka krijuar gjithçka në çift..."** - Allahu i Lartësuar ka krijuar gjithçka në çift: njerëzit, kafshët, bimët, fenomenet natyrore etj. Për shembull, Ai ka krijuar natën dhe ditën, të ngrohtën dhe të

ftohtën, mashkullin dhe femrën e kështu me radhë.

- "..dhe që ju ka mundësuar anije dhe kafshë, që të udhëtoni me to." - Kuptimi: Allahu i Lartësuar ju ka mundësuar që të ndërtoni anije, nëpërmjet të cilave të kryeni shërbimet tuaja të nevojshme. Ai krijoi për ju edhe kafshë të bartjes, të cilat Ai i ka nënshtruar për ju, që t'i përdorni për shërbimet tuaja dhe të përkujtoni mirësitë e Allahut mbi ju.

- "Kur të uleni mbi to, përkujtojeni këtë të mirë që ju ka dhënë Zoti juaj dhe, pasi të qëndroni mbi to, thoni..." - Allahu i Lartësuar na i dhuroi këto mirësi, që t'i jemi mirënjohës dhe ta lavdërojmë Atë me *dhikr* dhe adhurime. Tregues falënderimi dhe mirënjohjeje është edhe kjo *dua,* që Allahu i Lartësuar na e mëson ta themi kur të hipim dhe qëndrojmë mbi mjetet e transportit, kafshë apo sende qofshin ato:

- "I Lavdëruar qoftë Ai, që i nënshtroi këto për ne, sepse përndryshe, vetë ne nuk do të kishim mundësi ta bënim!" - Kuptimi: Nëse Allahu i Lartësuar nuk do të na i lehtësonte dhe dhuronte këto mirësi, ne nuk do të mund t'i siguronim ato. Është Allahu i Lartësuar që, me mëshirën e Tij, i ka nënshtruar ato për ne dhe na ka lehtësuar arritjen e tyre.


- "Ne, me siguri, te Zoti ynë do të kthehemi!" - Qëllimi i përmendjes së këtyre mirësive është që të besojmë dhe të bindemi se Ai që i mëshiroi robërit duke u dhënë të tilla mirësi, është i Vetmi që meriton t'i përkushtohen të gjitha mënyrat e adhurimit, si namazi, dhikri, mirënjohja, falënderimi, lutja etj. Gjithashtu, nuk duhet të harrojmë se, një ditë, të gjithë do të kthehemi tek Ai dhe do të llogaritemi për mirësitë që shfrytëzojmë në këtë jetë. Nëse i kemi shfrytëzuar për qëllime të mira e adhurime, do të shpërblehemi me të mira, e nëse nuk jemi treguar mirënjohës për to, do të marrim atë që meritojmë.

Ajetet 15 – 25

15. Ata i konsiderojnë disa krijesa të Tij si pjesë e Tij. Me të vërtetë, njeriu është mohues i hapur.
16. Mos vallë, nga ato që krijoi, Ai zgjodhi për vete vajza, kurse juve ju fali djem?!
17. Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet për lindjen e saj (vajzës), të cilën e pretendon për të Gjithëmëshirshmin, fytyra i nxihet dhe fryma i zihet.
18. Vallë, a është ajo që rritet me stoli e që ka argumentim të dobët?
19. Edhe engjëjt, të cilët janë adhuruesit e të Gjithëmëshirshmit, ata i konsiderojnë femra. A ishin të pranishëm ata në krijimin e tyre?! Dëshmia e tyre do të regjistrohet dhe ata do të merren në pyetje.
20. Ata thonë gjithashtu: "Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do t'i adhuronim ata!" Por ata nuk kanë ndonjë provë për këtë. Ata, faktikisht, vetëm gënjejnë.
21. A mos u kemi dhënë ndonjë libër para këtij, të cilit ata i përmbahen?
22. Jo, por ata thonë: "Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fe, prandaj do t'i ndjekim gjurmët e tyre me këmbëngulje.".
23. Në fakt, Ne nuk kemi dërguar para teje profet në ndonjë vendbanim, që paria e shfrenuar e tij të mos i ketë thënë: "Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fé, prandaj do t'i ndjekim gjurmët e tyre me këmbëngulje".

24. **Ai u thoshte: "Vallë, edhe pse ju kam sjellë një udhëzim më të mirë nga ai që ju keni gjetur tek të parët tuaj?" Ata thoshin: "Ne e mohojmë atë gjë për të cilën ju jeni dërguar!"**

25. **Atëherë, Ne i goditëm me ndëshkime. Shih tani se si qe përfundimi i mohuesve!**



Shpjegimi i ajeteve

- "Ata i konsiderojnë disa krijesa të Tij si pjesë e Tij. Me të vërtetë, njeriu është mohues i hapur. Mos vallë, nga ato që krijoi, Ai zgjodhi për vete vajza, kurse juve ju fali djem?!" - Allahu i Lartësuar na tregon për fjalët e shëmtuara të idhujtarëve, të cilët shpifin se Allahu i Lartësuar ka fëmijë, ndërkohë që Ai është i Vetmi, Absoluti në zotërimin dhe pushtetin e Tij. Allahu është Ai të Cilit i drejtohen të gjitha krijesat me lutje dhe përgjërim për nevojat e tyre, është Ai i Cili nuk ka nevojë për grua dhe as për fëmijë. Askush nuk mund të jetë i përafërt apo i ngjashëm me Allahun, as në Qenien e Tij, as në cilësitë dhe madhështinë e Tij.

Kjo shpifje e idhujtarëve hidhet poshtë për shumë arsye të tjera, ndër të cilat:

- Çdo gjë, veç Allahut, është krijesë, dhe të gjitha krijesat janë robër të Tij. Por robëria bie ndesh me birësinë.

- Fëmija është një pjesë prej prindit të tij, por dihet që Allahu i Lartësuar është jashtë krijesave dhe asgjë prej krijesave nuk mund të jetë pjesë e Tij. Askush nuk mund të jetë pjesë e Zotit dhe as e kundërta. Ai është shumë më i Lartësuar dhe i Madhëruar që të jetë pjesë e krijesave. Ai ndryshon nga ato në emrat dhe cilësitë e Tij të madhështisë dhe të pushtetit. Askush nuk mund t'i afrohet Allahut në ato emra dhe cilësi, e aq më pak të jetë i barabartë me Të. Atëherë, si mund të ekzistojë dikush që ka cilësitë e Zotit?!

- Ata pretendonë se melekët janë fëmijët e Zotit dhe janë femra. Ndër njerëz, vajzat janë fëmijë më pak të preferuar se djemtë. Atëherë, si mund të pretendojnë se Allahu ka mbajtur për vete pjesën më pak të preferuar dhe atyre u ka dhënë djem, që janë më tepër të preferuar?! A mos vallë, ata janë më të rëndësishëm se vetë Zoti?! I Lartësuar qoftë Allahu nga të tilla shpifje!

Ata ndihen të fyer dhe të pakënaqur kur njoftohen se u ka lindur vajzë, sikurse i përshkruan i Madhërishmi:

- **"Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet për lindjen e saj (vajzës), të cilën e pretendon për të Gjithëmëshirshmin, fytyra i nxihet dhe fryma i zihet."** – Atëherë, si e pretendojnë një gjë të tillë për të Madhërishmin?!

Femrat, që ata pretendojnë se janë engjëjt e Zotit dhe fëmijët e Tij, janë në një nivel më të ulët se meshkujt në aspekte të ndryshme, sikurse i përshkruan i Gjithëdituri:

- **"Vallë, a është ajo që rritet me stoli e që ka argumentim të dobët?"** – Për femrat, – të cilat janë të mangëta në bukurinë e tyre, prandaj vënë lloj-lloj stolish për t'u zbukuruar, – ata pretendojnë se janë fëmijë të Zotit! Ato janë më të mangëta se meshkujt edhe në aftësinë për të argumentuar dhe për të shprehur atë që kanë në zemrën e tyre. Atëherë, si pretendojnë idhujtarët se ato janë fëmijët e Zotit?!

- "Edhe engjëjt, të cilët janë adhuruesit e të Gjithëmëshirshmit, ata i konsiderojnë femra." - Pretendimi i tyre që melekët, adhuruesit e palodhur dhe të vazhdueshëm të Allahut, janë femra, është gjithashtu një shpifje për ta. Së pari, sepse në aspektin e nënshtrimit ndaj të Madhërishmit, ata i konsiderojnë engjëjt si pjesë e Zotit, pra, i ngrejnë më lart se ç'janë. Ndërsa nga ana tjetër, ata i ulin engjëjt, duke pretenduar se janë femra e jo meshkuj. Kjo është një kontradiktë në të menduarit e tyre. Engjëjt nuk kanë gjini dhe janë thjesht adhurues të përkushtuar të Allahut të Lartësuar. Kështu që kjo është një shpifje, për të cilën ata nuk kanë asnjë argument. Ata nuk ishin dëshmitarë kur Allahu krijoi engjëjt, siç thotë i Lartësuari:

- "A ishin të pranishëm ata në krijimin e tyre?! Dëshmia e tyre do të regjistrohet dhe ata do të merren në pyetje." - Si flasin për diçka që nuk kanë dije, fakt ky i pranuar nga të gjithë? Të mos mendojnë ata se kjo shpifje e tyre do të kalojë dhe ata nuk do të merren në përgjegjësi. Ata do të pyeten për këtë dëshmi të gënjeshtërt, e cila do t'u shënohet në regjistër, dhe pastaj do të ndëshkohen për të.

- "Ata thonë gjithashtu: "Sikur të kishte dashur Allahu, ne nuk do t'i adhuronim ata!"" -Ata justifikohen për adhurimin e melekëve, duke pretenduar se kjo ishte dëshira e Zotit.

Ky është një justifikim që idhujtarët e përdorin gjithmonë për krimin e idhujtarisë dhe për gjynahet që kryejnë. Por ky argumentim është i kotë, i pavlefshëm dhe i padrejtë. Ai është i papranueshëm si në aspektin logjik, ashtu edhe në atë fetar. Asnjë njeri me mend nuk e pranon justifikimin me vullnetin e Zotit. Nëse do të vepronin në të njëjtën mënyrë në marrëdhëniet ndërnjerëzore, kjo do të ishte e papranueshme. Për shembull, nëse dikush që ka shkelur të drejtën tënde do të justifikohej se ndodhi ashtu, pasi i tillë ishte vullneti i Zotit, për ty sigurisht që do të ishte justifikim i papranueshëm. Edhe në aspektin fetar, ky justifikim është i papranueshëm dhe jo i drejtë. Madje, Allahu i Madhëruar nuk ka përmendur ndonjë grupacion tjetër që ta ketë përdorur si justifikim, përveç idhujtarëve dhe mohuesve të profetëve. Allahu i Madhëruar e ka zhvleftësuar justifikimin e tyre me faktet dhe argumentet e qarta që ka sjellë nëpërmjet profetëve dhe shpalljeve. Pas profetëve dhe shpalljeve hyjnore, asnjë njeri nuk ka më justifikim.
Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Por ata nuk kanë ndonjë provë për këtë. Ata, faktikisht, vetëm gënjejnë." - Ata thjesht hamendësojnë, pa ditur se çfarë flasin e çfarë synojnë.

- "A mos u kemi dhënë ndonjë libër para këtij, të cilit ata i përmbahen?" – Kuptimi: Mos, vallë, u kemi dhënë ndonjë libër, që t'u tregojë për saktësinë e veprave të tyre dhe për vërtetësinë e fjalëve të tyre?!

Sigurisht, kjo nuk është e vërtetë, sepse Allahu i Madhëruar ka dërguar vetëm Muhamedin (a.s.) si paralajmërues e udhëzues për këta njerëz. Pra, si në aspektin logjik, edhe në atë fetar, ata nuk kanë mbështetje për trillimet dhe justifikimet e tyre. Si rrjedhim, ato janë të pasakta e të pavlefshme; dhe jo vetëm kaq, por ata do të merren në llogari për to. I vetmi arsyetim që ata përdorin është se ndjekin të parët e tyre, të cilët, në fakt, ishin të humbur dhe të devijuar.

Në përgjithësi, pasimi i brezave të mëparshëm në mënyrë të verëbër është sjellë gjithmonë si justifikim për refuzimin e ftesës së profetëve të Zotit, i Cili na tregon edhe këtë justifikim që ata paraqesin për mosbesimin dhe refuzimin e ftesës së Zotit.

- "Jo, por ata thonë: "Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fe, prandaj do t'i ndjekim gjurmët e tyre me këmbëngulje."." - Kuptimi: Ne i gjetëm të parët tanë në një fe të caktuar. Për këtë arsye, ne do të vazhdojmë të ndjekim gjurmët e tyre e nuk do të pasojmë Muhamedin dhe mesazhin që ka sjellë ai.

- "Në fakt, Ne nuk kemi dërguar para teje profet në ndonjë vendbanim, që paria e shfrenuar e tij të mos i ketë thënë: "Ne i kemi gjetur të parët tanë në këtë fé, prandaj do t'i ndjekim gjurmët e tyre me këmbëngulje"." - Kështu ka ndodhur gjithmonë kur Zoti dërgonte paralajmërues. Pasanikët dhe ata që ishin në mes të mirave, të cilët mashtroheshin dhe verboheshin nga pasuria e madhe, tregoheshin kryeneçë dhe refuzonin të vërtetën. Ata mjaftoheshin thjesht duke thënë: "Ne i gjetëm të parët tanë në një fé, kështu që do të vazhdojmë me këmbëngulje t'i ndjekim ata". Pra, këta të sotmit nuk janë të parët dhe as të vetmit që thonë të tilla fjalë. Edhe justifikimi i idhujtarëve me vullnetin e Zotit është i njëjtë me justifikimin e të parëve të tyre. Ata janë thjesht pasues të verbër të rrugës së të parëve të tyre. Ata i pasojnë të parët jo se kanë për qëllim të ndjekin të vërtetën dhe rrugën e drejtë. Nuk është aspak ky qëllimi i tyre. Ai është thjesht fanatizëm ndaj rrugës së tyre të gabuar, është një përpjekje e kotë për të hedhur poshtë të vërtetën dhe rrugën e drejtë me justifikime të pavlera. Ato janë të pavlera, sepse ftesa e sjellë nga profetët është dukshëm shumë më e qartë dhe më e drejtë sesa kotësirat e të parëve të tyre. Prandaj edhe profetët u drejtoheshin atyre gjithmonë me fjalët:

- "Vallë, edhe pse ju kam sjellë një udhëzim më të mirë nga ai që ju keni gjetur tek të parët tuaj?" – Kuptimi: Nëse unë ju sjell një udhëzim më të drejtë se ai i të parëve tuaj, a do të më pasoni, vallë? Nëse vërtet synoni udhëzimin në rrugën e drejtë dhe gjetjen e të vërtetës, atëherë a do të më pasoni? Por ju nuk e dëshironi këtë.

- "Ata thoshin: "Ne e mohojmë atë gjë për të cilën ju jeni dërguar!"" – Pra, ata nuk synonin gjetjen e udhëzimit të drejtë dhe të vërtetë, por thjesht dëshironin të vazhdonin në kotësitë dhe devijimin e trashëguar nga të parët e tyre, ku kishin gjetur rehati dhe kënaqësi për epshin dhe dëshirat e tyre.

- "**Atëherë, Ne i goditëm me ndëshkime.**" - Allahu i Madhëruar i ndëshkoi ata, për shkak se ata refuzuan të vërtetën, duke e konsideruar ata si gënjeshtër, dhe për justifikimet e tyre të pavlera.

- "**Shih tani se si qe përfundimi i mohuesve!**" – Kuptimi: Le të jenë të kujdesshëm ata që mohojnë dhe nuk besojnë në profetët dhe mesazhin e tyre! Le të kujtojnë se edhe ata do t'i godasë ndëshkimi që goditi brezat para tyre, nëse vazhdojnë në rrugën e mohimit dhe të refuzimit të së vërtetës.

Ajetet 26 – 32

26. Kur Ibrahimi i tha babait të vet dhe popullit të tij: "Unë i urrej dhe u qëndroj larg atyre që ju adhuroni,
27. përveç Atij që më krijoi, i Cili është Ai që më ka udhëzuar në rrugën e drejtë!"
28. Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata gjithmonë të kthehen.
29. Unë i lashë këta dhe etërit e tyre të kënaqen, derisa u erdhi e vërteta dhe i Dërguari me fakte.
30. Po, kur u erdhi e vërteta, ata thanë: "Kjo është magji, prandaj nuk i besojmë asaj!"
31. Pastaj thanë: "Përse të mos i zbriste ky Kuran një njeriu që gëzon reputacion në dy qytete?!"
32. A thua se janë ata që e përcaktojnë mëshirën e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar për ta se si do të jetojnë në këtë botë. Ne i kemi ngritur disa më lart se të tjerët, që të përfitojnë me shërbimet ndaj njëri-tjetrit. Mëshira e Zotit tënd është shumë më e vlefshme sesa çfarë grumbullojnë ata.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Madhëruar na tregon rreth Ibrahimit (a.s.) dhe cilët janë pasuesit e Ibrahimit. Shumë pretendojnë se janë pasues të Ibrahimit (a.s.), madje edhe ithtarët e Librit apo idhujtarët. Të gjithë pretendojnë se ecin në rrugën e tij. Por Allahu i Madhëruar na tregon rreth besimit dhe fesë së të dashurit të Tij, Ibrahimit (a.s), fe dhe besim të cilin ai ua la trashëgim dhe amanet brezave pasardhës.

- **"Kur Ibrahimi i tha babait të vet dhe popullit të tij..."** - Ibrahimi (a.s) iu drejtua babait të tij dhe popullit të tij, – të cilët adhuronin zota të tjerë veç Allahut, duke u bërë flijime e përkushtime, me qëllimin për t'u afruar tek ata, – dhe u tha:

- "**Unë i urrej dhe u qëndroj larg atyre që ju adhuroni...**" – Kuptimi: Unë distancohem dhe shpreh urrejtjen time kundër këtyre idhujve dhe kundër atyre që e ndjekin këtë rrugë të humbjes.

- "**...përveç Atij që më krijoi, i Cili është Ai që më ka udhëzuar në rrugën e drejtë!**"" - Allahu është i Dashuri dhe i Adhuruari im, të Cilit unë ia besoj çështjet e mia dhe i dorëzohem tërësisht. Unë shpresoj dhe i lutem Atij që të më udhëzojë tek e vërteta dhe të më japë forcë e sukses që të punoj e të jetoj sipas fesë së vërtetë. Ashtu sikurse Allahu më krijoi, ashtu si përkujdeset dhe administron çështjet e mia të kësaj dynjaje, ashtu jam i kënaqur dhe e lus Atë që të më udhëzojë në gjithçka që është e mirë për besimin, fenë dhe ahiretin tim.

- **Ai e bëri këtë fjalë të përhershme te pasardhësit e tij, me qëllim që ata**

gjithmonë të kthehen." - Cilësia më e lavdërueshme dhe më e rëndësishme e robit është sinqeriteti i tij në adhurimin e Allahut si Një i vetëm dhe distancimi nga çdo gjë tjetër që adhurohet veç Allahut. Edhe Ibrahimi (a.s) e bëri këtë cilësi të lartë si bazë të përhershme për të gjithë brezat pas tij. Të gjitha ata do t'i kthehen kësaj baze, për të ndërtuar mbi të besimin dhe fenë e tyre.

Ky besim i Ibrahimit është shumë i njohur. Ai qe një porosi shumë e rëndësishme, madje më e rëndësishmja, që ai u la pasardhësve të tij. Kjo porosi u transmetua ndër breza. Kështu vepruan edhe Ishaku me Jakubin, kur porositën fëmijët dhe pasardhësit e tyre, sikurse thotë i Madhëruari: "Ibrahimi ua dha këtë porosi bijve të tij; po ashtu edhe Jakubi: "O bijtë e mi, Allahu ua ka zgjedhur fenë, prandaj mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Tij!" A ishit ju të pranishëm, kur Jakubi, në momentin e vdekjes, u tha bijve të vet: "Çfarë do të adhuroni pas meje?" Ata thanë: "Do të adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, që është një Zot i vetëm. Vetëm Atij i nënshtrohemi!" [Bekare 132, 133.]

Kjo porosi vazhdoi të transmetohej te pasardhësit e tij, derisa u futën në mes shpifjet dhe padrejtësitë.

- "Unë i lashë këta dhe etërit e tyre të kënaqen..." - Allahu i Madhëruar i begatoi ata me shumë mirësi, kurse ata u harruan në plotësimin e dëshirave të tyre të shfrenuara, derisa ato u bënë pikësynimi i vetëm i tyre. Dashuria për dynjanë vazhdoi të rritej dita-ditës, derisa u shndërrua në një lloj feje e tyre.

- "...derisa u erdhi e vërteta dhe i Dërguari me fakte." - Kështu vazhduan ata, derisa u erdhi e vërteta dhe Profeti i qartë në mesazhin që përcillte, i mbështetur me mrekulli të shumta nga Zoti dhe i pajisur me moralin më të lartë. Ligji që solli ky profet ishte i plotë dhe tregues i të mirës në çdo kohë. Ai ishte në të njëjtën linjë me shpalljet hyjnore që sollën të gjithë profetët e tjerë. Vetë ftesa e tij për njësimin e Zotit tregon për vërtetësinë dhe besnikërinë e tij.

Por, vallë, a ndryshuan ithtarët e Librit pas ardhjes së Profetit besnik? Vallë, a u hapën sytë dhe zemrat e tyre, për t'u çliruar nga dëshirat e shfrenuara dhe përkushtimi pas kësaj dynjaje? Thotë i Madhëruari:

- "Po, kur u erdhi e vërteta, ata thanë: "Kjo është magji, prandaj nuk i besojmë asaj!"" - Kur erdhi e vërteta, – të cilën çdokush, me sadopak arsye e logjikë të drejtë, do ta pranonte dhe do t'i nënshtrohej, – ata thanë: "Kjo është magji, prandaj nuk e pranojmë atë." Kjo, sigurisht, është shfaqja më madhe e urrejtjes dhe e armiqësisë ndaj Profetit dhe Shpalljes së Zotit. Atyre nuk u mjaftoi refuzimi i të vërtetës, madje as lufta ndaj saj, por vazhduan me shpifjet më të shëmtuara dhe më të padrejta që mund t'i bëhen asaj. Ata e quajtën të vërtetën 'magji', me të cilën merren krijesat më të këqija, më të pështira dhe më mashtruese. Në këtë shpifje të ulët ndaj të vërtetës i shtyu pikërisht shfrenimi i tyre në gjynahe dhe humbja në mirësitë e shumta të kësaj dynjaje, me të cilat i begatoi Allahu i Madhëruar.

- "Pastaj thanë: "Përse të mos i zbriste ky Kuran një njeriu që gëzon reputacion në dy qytete?!"" - Kjo ishte kërkesa që parashtruan ata, me mendjet e tyre të prishura. Përse, pra, të mos i zbriste Kurani

një njeriu me reputacion, që – sipas përcaktimit të tyre – duhej të ishte i pasur, i respektuar dhe zulmëmadh për banorët e qyteteve Mekë dhe Taif, si për shembull, Uelid Ibn Mugira apo ndonjë tjetër, që i përkiste parisë së tyre të respektuar. Por Allahu i Madhëruar, duke kundërshtuar këtë propozim të tyre të padrejtë, thotë:

- "A thua se janë ata që e përcaktojnë mëshirën e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar për ta se si do të jetojnë në këtë botë." – Vallë, a mos është mëshira e Allahut në dorën e tyre dhe ata e shpërndajnë atë si të duan?! A mos janë ata që ia dhurojnë profetësinë atij që ata dëshirojnë? Jo, kurrsesi! Është Allahu i Madhëruar Ai që e shpërndan mëshirën e Vet si të dojë mes robërve, në këtë dynja. Gjithashtu, siç na tregon Allahu i Madhëruar më pas, mëshira e Tij është më e mirë se pasuria që njerëzit grumbullojnë në këtë botë.

Në këtë mënyrë, duhet të kuptojmë se gjithçka që ka lidhje me jetën e njerëzve në këtë dynja jepet nga Allahu i Madhëruar. Është Ai që i shpërndan mirësitë mes robërve të Tij, Ai që ia shton rizkun dikujt e ia pakëson dikujt tjetër, sipas urtësisë së Tij. Mëshira e Allahut në dynja, – grada më e lartë e së cilës është dhurimi i profetësisë, – është veç në dorë të Tij. Allahu i Madhëruar është më i Dituri dhe më i Urti për çështjen se kujt ia dhuron profetësinë dhe cilin bën lajmëtar të Tij.

Kësisoj, propozimi i tyre është i papranueshëm dhe i pabazë, sepse rregullimi dhe përcaktimi i çështjeve të kësaj dynjaje apo dhe i çështjeve të fesë, janë tërësisht dhe vetëm në dorën e Zotit të Plotpushtetshëm. Allahu i Madhëruar u thotë këtyre njerëzve që të jenë të bindur për gabimin që bëjnë me kërkesa të tilla të pakuptimta. Ata duhet ta kuptojnë mirë që nuk u takon asgjë nga çështjet e dynjasë dhe të ahiretit dhe se propozimi i tyre është veçse shprehje arrogance dhe përpjekje për të refuzuar të vërtetën.

Ata thanë: "Përse të mos i zbriste ky Kuran një njeriu që gëzon reputacion në dy qytete?!" Por nëse ata do ta njihnin mirë realitetin, nëse do të njihnin virtytet nga të cilat vlerësohen burrat tek Allahu dhe te njerëzit, do të arrinin në përfundimin se Muhamed Ibn Abdullah Ibn Abdul Mutalib (a.s.) ishte burri më i madh dhe më i lartë në karakter. Ai ishte njeriu më i plotë dhe më i pastër në intelektin, urtësinë, vullnetin e në moralin e tij. Ai ishte më i mëshirshmi, më i buti, më bujari dhe më bamirësi me njerëzit, ashtu siç ishte dhe më i devotshmi ndaj Zotit të tij. Ai mbetet boshti rreth të cilit sillet çdo virtyt i lartë dhe kufiri ku mund të arrijë përsosmëria e burrave. Ai është burri më i madh i kohërave në të gjithë botën, fakt ky i pranuar dhe i ditur nga miqtë dhe armiqtë e tij.

Atëherë, si mundet që këta idhujtarë injorantë të preferonin dikë tjetër, që as nuk i afrohej virtyteve të Muhamedit (a.s). Sigurisht, njerëz të tillë nuk duhen marrë aspak në konsideratë. Nga mendjelehtësia dhe injoranca e thellë, ata quanin si perëndi të tyre një putë apo një skulpturë, një pemë apo një gur, domethënë gjëra që nuk sjellin as dëm e as dobi, që nuk japin e as nuk marrin, madje që janë barrë për të tjerët, sepse kanë nevojë për përkujdesje e shërbim. Prandaj themi se propozimet e një niveli të tillë njerëzish nuk meritojnë që të përfillen. Ato janë kërkesa prej mendjeprishurve. Ata mund të kënaqen vetëm me një të llojit të tyre. Por një njeri me nivelin e tyre nuk

mund të krahasohet kurrë me Muhamedin (a.s.), e aq më tepër të parapëlqehet mbi të. E si mund të përzgjidhen të tillë njerëz kundrejt Profetit të Fundmë dhe pasardhësit më të mirë të Ademit (a.s.)? Por qafirët nuk logjikojnë e nuk dinë të arsyetojnë.

- "Ne i kemi ngritur disa më lart se të tjerët...." - Ky ajet tregon për urtësinë e madhe të Allahut të Lartësuar në dallimet që Ai ka bërë mes robërve në jetën e kësaj dynjaje. Kjo është bërë që:

- "...të përfitojnë me shërbimet ndaj njëri-tjetrit." – Domethënë, që njerëzit t'i shërbejnë njëri-tjetrit, me zanatet dhe aftësitë e tyre. Nëse ata do të ishin të njëjtë në pasuri dhe aftësi, atëherë nuk do të kishin nevojë për njëri-tjetrin, por kështu do të kishin shumë probleme në marrëdhëniet me njëri-tjetrin.

- "Mëshira e Zotit tënd është shumë më e vlefshme sesa çfarë grumbullojnë ata." – Kjo dëshmon se mirësitë që kanë lidhje me ahiretin janë më të mira sesa mirësitë që kanë lidhje me dynjanë, ashtu sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "O njerëz! Ja ku ju erdhi Këshilla (Kurani) nga Zoti juaj dhe shërimi i asaj (zemrës) që gjendet në kraharorin tuaj. Ajo (Fjala e Zotit) është udhëzim dhe mëshirë për besimtarët. Thuaj: "Gëzohuni vetëm për mirësinë e Allahut dhe për mëshirën e Tij. Kjo është shumë herë më e vlefshme se ajo (pasuria) që ata grumbullojnë". [Junus 57, 58].

Ajetet 33 – 35


33. E sikur të mos ishte për njerëzit, që priren drejt një besimi, Ne atyre që nuk e besojnë Mëshiruesin do t'ua bënim prej argjendi tavanet e shtëpive edhe shkallët mbi të cilat ata ngjiten,
34. madje edhe dyert e shtëpive apo kolltukët mbi të cilët mbështeten,
35. e shumë stoli të tjera. Por të jeni të sigurt se të gjitha këto nuk janë gjë tjetër, veçse kënaqësi e jetës së kësaj bote, kurse bota e ardhshme te Zoti yt është për të devotshmit.

Shpjegimi i ajeteve

- "E sikur të mos ishte për njerëzit, që priren drejt një besimi, Ne atyre që nuk e besojnë Mëshiruesin do t'ua bënim prej argjendi tavanet e shtëpive..." - Allahu i Madhëruar na tregon se dynjaja nuk ka asnjë vlerë tek Ai. Sikur të mos ishte butësia dhe mëshira e Tij për adhuruesit e Tij të sinqertë, para së cilës Ai nuk vë asgjë, që ata të mos josheshin nga mirësitë e kësaj dynjaje, Ai do t'u jepte qafirëve pasuri të pallogaritshme të kësaj dynjaje, sikurse thotë më pas:

- "...edhe shkallët mbi të cilat ata ngjiten, madje edhe dyert e shtëpive apo kolltukët mbi të cilët mbështeten, e shumë stoli të tjera." - Edhe shkallët, që i përdorin për të hipur në tarracat e shtëpive të tyre, do t'ua bënte prej argjendi. Pra, i Madhëruari do t'u jepte ç'të dëshironin. Por Ai nuk e bën këtë, nga mëshira e madhe dhe përkujdesi i Tij për të dashurit dhe të zgjedhurit e Tij besimtarë, të cilët, nëse Zoti do t'u jepte qafirëve të tilla pasuri, kjo do t'i trazonte shpirtrat e tyre dhe do t'i tundonte për të shkuar drejt gjynaheve, mosbindjes dhe harresës së qëllimit kryesor pse janë krijuar, pra, të adhurimit të Allahut.

Nga ana tjetër, kjo tregon se Allahu i Madhëruar mund t'i privojë besimtarët në përgjithësi ose ndonjë grup prej tyre, për t'i ndihmuar ata.



- "Por të jeni të sigurt se të gjitha këto nuk janë gjë tjetër, veçse kënaqësi e jetës së kësaj bote, kurse bota e ardhshme te Zoti yt është për të devotshmit." - Dynjaja nuk vlen tek Allahu as sa një flatër mushkonje. Të gjitha stolitë e përmendura e shumë e shumë të tjera, janë thjesht pasuri të kësaj dynjaje, të cilat, gjithsesi, arrihen me lodhje e mundime, bashkë me frikën se një ditë do të përfundojnë. Prandaj le ta dinë mirë se ahireti është shumë më i mirë për të devotshmit, të cilët i ruhen zemërimit dhe ndëshkimit të Zotit të tyre, duke ruajtur kufijtë e Tij. Ahireti është më i mirë për ta sepse mirësitë, bukuritë dhe kënaqësitë që do të përjetohen në të janë të plota në çdo aspekt dhe të përjetshme. Atje do të kenë gjithçka që e dëshiron shpirti i tyre dhe me të cilat kënaqen sytë e tyre. Atje do të jenë të freskët e të lumtur përgjithmonë, pa ndërprerje. Sa ndryshim të madh ka mes këtyre dy botëve dhe këtyre dy llojeve të mirësive!

Ajetet 36 – 39

36. Kush i kthen shpinën Përkujtimit të Zotit, Ne i shoqërojmë nga një shejtan, i cili nuk i ndahet kurrë.
37. Ai (shejtani) e devijon nga rruga e drejtë, ndërkohë që ai (jobesimtari) mendon se është i udhëzuar mirë.
38. E kur të vijë ai (jobesimtari) para Nesh, do të thotë: "Oh, mjerë për mua! Ah, sikur mes meje dhe teje (o shejtan) të kishte një largësi sa lindja prej perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!"
39. Ju bënit zullume (do t'u thuhet), prandaj sot nuk do t'ju lehtësojë aspak fakti se nuk jeni të vetmit që po ndëshkoheni!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na paralajmëron për ndëshkimin e Tij të rëndë, me të cilin godet ata që nuk e përkujtojnë Atë. Ai thotë:

- "Kush i kthen shpinën Përkujtimit të Zotit, Ne i shoqërojmë nga një shejtan, i cili nuk i ndahet kurrë." - Këtë ndëshkim të rëndë e meriton Ai që dobësohet dhe e rrallon apo e braktis fare Përkujtimin e Allahut.

Po çfarë është, në fakt, Përkujtimi i Allahut, për të cilin bëhet fjalë këtu? Përkujtimi i Allahut është Kurani madhështor, i cili është mëshira më e madhe e Mëshiruesit për krijesat e Tij. Kush e pranon këtë Kuran, kanë fituar një dhuratë të madhe, pas së cilës do të arrijnë plot mirësi të tjera. Ndërsa ata që e refuzojnë ose e shpërfillin atë, kanë për të pësuar ndëshkim të rëndë, pas të cilit nuk ka më

lumturi. Këtyre Allahu i Madhëruar u shoqëron një shejtan shumë dinak dhe tinzar, që u rri gjithmonë nga pas, pa iu ndarë asnjë çast. Ai i mbush me ëndrra boshe, i nxit për gjynahe dhe ua zbukuron ato. Përveç kësaj, i Madhëruari thotë:

- "Ai (shejtani) e devijon nga rruga e drejtë, ndërkohë që ai (jobesimtari) mendon se është i udhëzuar mirë." - Shejtani i pengon ata nga rruga e drejtë e adhurimit të Allahut, duke ua vështirësuar dhe duke ua paraqitur të rëndë në sytë e tyre. Por ç'është më e keqja, ata verbohen aq shumë, saqë mendojnë se janë në udhë të mbarë. Aq shumë u është zbukuruar e keqja dhe aq shumë janë larguar nga e vërteta, saqë rruga e humbjes u duket si rruga e drejtë.

Dikush mund të pyesë e të thotë: Përderisa këta mendojnë se janë në rrugë të drejtë dhe se po veprojnë mirë, a nuk janë të justifikuar para Zotit? Përgjigjja është se nuk ka justifikim për këta lloj njerëzish, të cilët e refuzojnë diturinë e sjellë nga Shpallja e Zotit, edhe pse e kanë mundësinë që ta përvetësojnë atë. Ata veprojnë kështu, sepse parapëlqejnë të kotën dhe gjynahet e shumta.

E tillë është gjendja e atyre që nuk i kushtojnë rëndësi Shpalljes së Allahut. Në jetën e dynjasë, ata të mjerë bien pre e kurtheve dhe joshjeve devijuese të shejtanit, të cilat ua tjetërsojnë realitetin dhe ua sëmurin logjikën. Ndërsa gjendja e tyre në ahiret do të jetë edhe më e keqe. Atje do të shfaqin pendesë dhe keqardhje për krimet e tyre, por kjo nuk ua lehtëson aspak ndëshkimin. Jo vetëm kaq, por ata do të duan të distancohen nga shejtani që i ka shoqëruar në dynja, duke shprehur urrejtje dhe armiqësi ndaj tij, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "E kur të vijë ai (jobesimtari) para Nesh, do të thotë: "Oh, mjerë për mua! Ah, sikur mes meje dhe teje (o shejtan) të kishte një largësi sa lindja prej perëndimit! Sa shok i keq paske qenë ti!"" – Ky ajet ngjan shumë me fragmentin tjetër në Kuran: "Atë ditë, sundimi i vërtetë i takon të Gjithëmëshirshmit. Ajo do të jetë një ditë e vështirë për jobesimtarët. Atë ditë, zullumqari do të kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "Oh, i mjeri unë, pse nuk ndoqa udhën e drejtë së bashku me Profetin! O shkatërrimi im! Oh, i mjeri unë, të mos e kisha bërë filanin mik! Pikërisht ai më largoi mua prej udhëzimit, pasi më ishte bërë i qartë." Shejtani është ai që e humb dhe e lë të vetmuar njeriun." [Furkan 26-29].

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "Ju bënit zullume (do t'u thuhet), prandaj sot nuk do t'ju lehtësojë aspak fakti se nuk jeni të vetmit që po ndëshkoheni!" – Kuptimi: Fakti që do ta vuani ndëshkimin bashkë me të tjerë, që kanë qenë shoqëruesit dhe të dashurit tuaj në dynja, nuk ka për t'ju sjellë ndonjë lehtësim a ngushëllim. Ashtu sikurse ishit bashkë në dynja në bërjen e gjynaheve dhe padrejtësive, ashtu do të vuani bashkarisht dënimin e të Drejtit.

Është e vërtetë që, në jetën e dynjasë, njerëzit gjejnë ngushëllim kur nuk janë vetëm në fatkeqësi, pasi kjo ua lehtëson sadopak dhimbjen. Ndërsa në ahiret kjo nuk funksionon, pasi ndëshkimi i atjeshëm nuk ka asnjë çast pushimi apo lehtësimi, qoftë edhe në përmasat më të vogla.

Të lusim, o Allah, o Zoti ynë, që të na shpëtosh dhe të na ruash nga çdo ndëshkim,

në dynja dhe ahiret, dhe të na japësh prehje me mëshirën Tënde!

Ajetet 40 – 45

40. Vallë, ti do ta bësh të shurdhërin të dëgjojë, ti do ta drejtosh të verbërin dhe atë që ka humbur keq?
41. Edhe sikur të të tërheqim ty, Ne patjetër që do të hakmerremi ndaj tyre.
42. Ne mund edhe të bëjmë që ti ta shohësh të realizuar premtimin që u kemi dhënë atyre. Pa dyshim, Ne jemi të Plotfuqishëm mbi ta.
43. Atëherë, ti përmbaju fort Shpalljes që po të jepet! S'ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë.
44. Me të vërtetë, ajo është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd, dhe për këtë do të përgjigjeni.
45. Pyeti ata që i dërguam para teje: a kemi lejuar që, në vend të Allahut, të adhurohen zota të tjerë?

Shpjegimi i ajeteve

Duke dashur të qetësonte Profetin e Tij të dashur, i cili ishte tepër i shqetësuar nga mospranimi i thirrjes së tij prej qafirëve, Allahu i Madhëruar i thotë se ata janë njerëz tek të cilët nuk gjendet ndonjë mirësi. Ata nuk janë aspak të denjë që Zoti t'i udhëzojë në rrugën e drejtë. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull të prishur.

- "Vallë, ti do ta bësh të shurdhërin të dëgjojë, ti do ta drejtosh të verbërin dhe atë që ka humbur keq?" – Kuptimi: Vallë, ti do t'i bësh të shurdhërit ndaj të vërtetës të dëgjojnë?! Ti do t'i udhëzosh në rrugën e drejtë të verbuarit nga kjo rrugë, të cilët nuk duan ta shohin atë rrugë?! E si do t'i udhëzosh ata që kanë humbur larg, me vetëdije të plotë nga ana e tyre?! Madje, ata janë të kënaqur për rrugën e humbjes ku janë futur.

Pra, ashtu sikurse të shurdhërit nuk dëgjojnë dhe të verbërit nuk shikojnë asgjë, edhe të humburit që janë të kënaqur me humbjen e tyre, nuk mund ta gjejnë dot rrugën e drejtë. Logjika e tyre është e sëmurur rëndë, për shkak të shpërfilljes dhe refuzimit të Shpalljes së Zotit. Ata bien në grackën e shejtanit, duke u marrë me besime e doktrina të kota e të paqëna. Si rrjedhojë e përzgjedhjes së gabuar të tyre, ata marrin cilësi të shëmtuara, që i pengojnë të kthehen tek e vërteta. Madje, ato cilësi i zhysin edhe më shumë në llumin që i ka mbuluar. Përfundimisht, për ata ka mbetur që vetëm të ekzekutohet ndëshkimi në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Për këtë arsye, i Madhëruari thotë:

- "Edhe sikur të të tërheqim ty, Ne patjetër që do të hakmerremi ndaj tyre." – Kuptimi: Nëse Ne të marrim ty para se të shohësh ndëshkimin e premtuar për ta, ji i bindur në premtimin Tonë të pakthyeshëm se Ne kemi për t'i ndëshkuar ata.

- "Ne mund edhe të bëjmë që ti ta shohësh të realizuar premtimin që u kemi dhënë atyre. Pa dyshim, Ne jemi të Plotfuqishëm mbi ta." – Kuptimi: Ne edhe mund të ta tregojmë ndëshkimin e premtuar për ta. Allahu është i Plotfuqishëm t'i ndëshkojë ata në të dyja rastet. Kjo varet se si e përcakton urtësia e Tij përshpejtimin apo vonimin e ndëshkimit.

- "Atëherë, ti përmbaju fort Shpalljes që po të jepet!" - Përqendrohu dhe ji i vazhdueshëm në veprat e mira, në cilësitë

dhe virtytet e larta, për të cilat i fton njerëzit dhe për të cilat Zoti të ka urdhëruar. Ji i durueshëm, që këto urdhëresa t'i zbatosh për veten tënde dhe të nxisësh të tjerët për t'i zbatuar ato. Gjithashtu, të jesh i sigurt se:

- "S'ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë." - Kjo rrugë të çon tek Allahu, në vendin e paqes dhe begatisë së përjetshme. Kjo le të shërbejë që të ngulmosh në këtë rrugë. Duke mësuar se rruga që ke nisur është e vërteta, atëherë do të jesh më i qetë e më i motivuar, sepse e di që je mbi një themel të fuqishëm. Kështu nuk ndikohesh aspak nga fakti që të tjerët koten mes dyshimesh, hamendësimesh, padrejtësish dhe errësirash të mëdha.

- "Me të vërtetë, ajo është lëvdatë e madhe për ty dhe për popullin tënd..." - Kurani madhështor është famë dhe lavdi për ty dhe për popullin tënd. Ai është një vlerë e jashtëzakonshme dhe mirësi e paçmueshme për ju. Nëpërmjet Kuranit, Allahu i Madhëruar ju udhëzon në mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit dhe ju nxit që të punoni për t'i arritur ato. Gjithashtu, Ai ju mëson si të ruheni nga ligësitë dhe ju paralajmëron që të largoheni prej tyre.


- "...dhe për këtë do të përgjigjeni." - Kuptimi: Ju do të përgjigjeni për Kuranin: a keni përfituar prej tij dhe jeni lartësuar me të, apo e keni shpërfillur atë, duke mos e vënë në zbatim?! A do të jetë ai provë kundër jush apo pro jush?!

- "Pyeti ata që i dërguam para teje: a kemi lejuar që, në vend të Allahut, të adhurohen zota të tjerë?" – Domethënë, pyeti ata, që ndoshta të kenë ndonjë arsye apo argument ku mund të kapen! Jo, ata nuk kanë asnjë bazë ku mund ta mbështesin idhujtarinë e tyre. Asnjë profet nuk ka përcjellë një mesazh të tillë. Sado të kërkosh në mesazhet e profetëve, nuk do të gjesh asnjë që të ketë porositur dhe urdhëruar për të adhuruar zota të tjerë veç Allahut. Të gjithë profetët, nga i pari deri tek i fundit, kanë urdhëruar për adhurimin e Allahut si Një të vetëm dhe të pashoq. Thotë i Madhëruari: "Ne dërguam në çdo popull profetë, që t'u thonë: "Adhuroni vetëm Allahun e largojuni idhujve!" Por, pati nga ata që Allahu i udhëzoi, ashtu siç pati edhe nga ata që ishin përcaktuar të humbnin. Atëherë, udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si qe fundi i gënjeshtarëve?" [Nahl 36].

Gjithashtu, çdo profet i Zotit i thoshte popullit: "Adhuroni vetëm Allahun! Ju nuk keni Zot tjetër veç Tij!" [A'raf 59]. Kjo tregon që idhujtarët nuk kanë asnjë argument ku të kapen e mbështeten, as në logjikën e shëndoshë e as në tekstet hyjnore prej qiellit.

Ajetet 46 – 56

46. Ne e dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe rrethi i tij, dhe ai u tha: "Unë jam i dërguari i Zotit të gjithësisë!"
47. Por kur ai u shpalosi shenjat Tona, ata u tallën dhe qeshën me to.
48. Ne nuk u treguam asnjë mrekulli, që të mos ishte më e madhe se paraardhësja e saj. Ndaj tyre zbritëm edhe ndëshkime, që të tërhiqeshin nga ajo rrugë e tyre.
49. Por ata thanë: "O magjistar! Lute për ne Zotin tënd, sipas besës që ta ka dhënë, se ne po besojmë!"
50. E kur Ne ua hoqëm ndëshkimet, ata përsëri e thyen besën.
51. Ndërkohë, Faraoni thirri popullin e vet e u tha: "O populli im! A nuk janë nën



pushtetin tim Egjipti dhe këta lumenj, që rrjedhin nën pallatin tim?! A e shikoni?

52. Atëherë, cili është më i mirë? A nuk jam unë, apo është ai qyqar, që mezi flet?!

53. Përse nuk i janë dhënë atij bylyzykë floriri? Përse nuk kanë ardhur engjëj bashkë me të, si shoqërues?"

54. Ai e frikësoi popullin e vet, kurse ata e dëgjuan. Ata ishin vërtet një popull i shkatërruar.

55. Kur ata shkaktuan zemërimin Tonë, Ne u hakmorëm ndaj tyre, duke i përmbytur të gjithë.

56. Kështu, Ne i bëmë ata shembull e mësim për të tjerët.

Shpjegimi i ajeteve

Pas ajetit: "Pyeti ata që i dërguam para teje: a kemi lejuar që, në vend të Allahut, të adhurohen zota të tjerë?", Allahu i Madhëruar rrëfen ngjarjen e Musait, thirrja e të cilit është ndër më të njohurat në botë. Në fakt, historia e Musait është përmendur shumë herë në Librin e Tij.

- "Ne e dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe rrethi i tij..." - Këto shenja nuk linin asnjë dyshim për saktësinë e mesazhit që ai solli prej Allahut të Madhëruar. Disa prej këtyre shenjave ishin shkopi i tij, gjarpri, vërshimi i karkalecave, i morrave etj.

- "...dhe ai u tha "Unë jam i dërguari i Zotit të gjithësisë!"" - Ai i ftoi që të besonin Zotin e tyre dhe t'i largoheshin adhurimit të gjithçkaje tjetër.

- "Por kur ai u shpalosi shenjat Tona, ata u tallën dhe qeshën me to." - Ata i kundërshtuan të gjitha shenjat e Zotit, madje u tallën me to, duke u treguar kështu të padrejtë e kryeneçë. Ata mohuan jo se shenjat që panë ishin të pamjaftueshme apo të paqarta, por sepse thjesht nuk donin t'i pranonin. Më pas, i Madhëruari thotë:

- "Ne nuk u treguam asnjë mrekulli, që të mos ishte më e madhe se paraardhësja e saj." - Çdo shenjë apo mrekulli që u shfaqej ishte më e madhe se simotra e saj pararendëse.

- "Ndaj tyre zbritëm edhe ndëshkime..." - Ndër ndëshkimet që Zoti u dërgoi ishin vërshimi i karkalecave, i morrave, i bretkosave, uji i shndërruar në gjak etj. Të gjitha këto ishin edhe shenja, që ata të pranonin ftesën e Musait (a.s.), sikurse thotë i Madhëruari:

- **"...që të tërhiqeshin nga ajo rrugë e tyre."** – Pra, këto ndodhën me shpresë që ata të ktheheshin në Islam, duke iu dorëzuar Zotit të vetëm dhe të vërtetë dhe duke u larguar nga idhujtaria e gjynahet ku ishin zhytur.

- **"Por ata thanë: "O magjistar!"" -** Kur mbi ta goditën dënimet e Zotit, si shenja të qarta të Tij, ata iu drejtuan Musait duke e quajtur 'magjistar'. Këtë e kanë bërë ose për tallje, ose për nderim, sepse ky term përdorej edhe si titull nderi nga ata. Sipas shpjegimit të dytë, ata iu drejtuan atij me përunjësi, duke e respektuar ashtu si të mëdhenjtë e tyre. Ata i thanë:

- "Lute për ne Zotin tënd, sipas besës që ta ka dhënë, se ne po besojmë!" – Kuptimi: Me dhuntitë e veçanta që ke, lute Zotin tënd që t'i largojë prej nesh ndëshkimet, sepse ne atëherë do të udhëzohemi.

Por a e mbajtën fjalën, vallë? Thotë i Madhëruari:

- "E kur Ne ua hoqëm ndëshkimet, ata përsëri e thyen besën." - Ata nuk e mbajtën fjalën, por tradhtuan, duke vazhduar me mosbesimin e tyre.

Kjo pjesë i përngjan fragmentit tjetër në Kuran: "Kur u vinin të mirat, ata thonin: "Këto vijnë, se e meritojmë". Por kur i godiste ndonjë e keqe, atë e konsideronin si fatkeqësi të ardhur nga prania e Musait dhe atyre që ishin me të. Në fakt, fati i tyre i zi ishte prej Zotit, por shumica e tyre nuk e kuptonin këtë. Ata thanë: "Me çfarëdo mrekullie të na magjepsësh, ne përsëri nuk do të besojmë ty". Atëherë, Ne lëshuam kundër tyre përmbytje, karkaleca, rriqra, bretkosa dhe gjak, fakte të qarta njëra pas tjetrës. Por ata sërish treguan arrogancë, sepse ishin popull i padrejtë. Kur i goditi belaja, ata thanë: "O Musa, lute Zotin tënd për ne, sipas premtimit që të ka dhënë! Nëse na e largon dënimin, ne do të të besojmë ty dhe do t'i lejojmë beni israilët të rrinë me ty.". Por kur Ne e larguam dënimin nga ata, duke u lënë një afat të caktuar, ata e shkelën premtimin." [A'raf 133 – 137].

- "Ndërkohë, Faraoni thirri popullin e vet e u tha..." – Me një arrogancë të pashembullt, i mashtruar nga pushteti, pasuria dhe forcat e tij, Faraoni tha:

- "O populli im! A nuk janë nën pushtetin tim Egjipti dhe këta lumenj, që rrjedhin nën pallatin tim?! A s'i shikoni?" – Shumë degëzime të Nilit kalonin përmes kështjellave dhe kopshteve plot bimësi të Faraonit, prandaj ai thoshte: "A nuk e shihni gjithë këtë mbretëri e bukuri, që kam nën këmbët e mia?! A nuk tregojnë ato për madhështinë time?"

Fjalët e Faraonit dëshmonin se sa injorant i madh ishte ai, pasi ai lëvdohej me gjëra që nuk kishin lidhje me meritat dhe veten e tij. Ai nuk lëvdohej për ndonjë cilësi të mirë që kishte apo për ndonjë vepër të drejtë. Për të ishte e drejtë mburrja me pasurinë e pushtetin, nëpërmjet të cilave, në fakt, Allahu sprovon cilin të dëshirojë.

Faraoni, me injorancën e tij të thellë, vazhdonte të lëvdohej duke thënë:

- "Atëherë, cili është më i mirë? A nuk jam unë, apo është ai qyqar, që mezi flet?!" - Me këto fjalë, i mallkuari kishte për qëllim Musain, birin e Imranit, atë që Rrahmani i foli me fjalë, duke e nderuar dhe lartësuar mbi shumë profetë të tjerë.

Kështu, Faraoni po pretendonte se ishte burrë më i mirë e më fisnik se Musai (a.s.), ndërsa – sipas tij – Musai ishte njeri i pavlerë. Veç kësaj, – thoshte ai gojëndyrë, – Musai ishte gati i paaftë që të shprehte me fjalë atë që mbante në zemër. E tha këtë, sepse Musai (a.s.) haste pak vështirësi në të shprehur, por jo në aftësinë për të dhënë të qartë mesazhin që duhej të përçonte ndër njerëz. Vështirësia në të folur ose oratoria jo e madhe nuk i llogaritej aspak si mangësi, sepse ai, në fund të fundit, e shprehte qartë dhe kuptueshëm atë që kishte në zemër.
Pastaj Faraoni tha:

- "Përse nuk i janë dhënë atij bylyzykë floriri?" – Kuptimi: Përse Musai nuk erdhi i stolisur me bizhuteri, por vjen në këtë gjendje?

Pra, këto ishin kriteret e tij për të vlerësuar rëndësinë ose jo të njerëzve.

- "Përse nuk kanë ardhur engjëj bashkë me të, si shoqërues?" - Përse Musai nuk erdhi i shoqëruar nga melekët, që ta ndihmonin dhe t'i shërbenin si vërtetim i fjalëve dhe mesazhit të tij?

A thua se, nëse do të ndodhnin këto, atëherë ata do ta besonin Musain! A thua se gjithë ato mrekulli të tjera, që ata i panë me sy, nuk ishin të mjaftueshme! E vërteta është se këto ishin thjesht justifikime të Faraonit për të mos besuar dhe përpjekje për të manipuluar mendjen dhe arsyen e popullit të tij, siç thotë i Madhëruari më pas:

- "Ai arriti ta frikësonte popullin e vet, të cilët e dëgjuan." - Nëpërmjet këtyre arsyetimeve boshe, Faraoni arriti të manipulonte mendjet e pasuesve të tij.

Në fakt, ato 'argumente' të tij nuk vlejnë aspak si arsyetime, madje janë një fyerje për inteligjencën dhe logjikën e shëndoshë. Ato nuk tregojnë asgjë dhe nuk ndihmojnë për asgjë, as për mirë e as për keq. Të tilla 'argumente' mund të trullosin vetëm njerëz mendjelehtë. Vallë, a kishte Faraoni të drejtë vetëm sepse sundonte Egjiptin apo se kishte në pronësi toka, lumenj e përrenj? Kjo na qenka prova e cila mund të hidhte poshtë profetësinë dhe mrekullitë e Musait?! Apo ishte fakti që Musai nuk pati shumë pasues, apo që nuk ishte i stolisur me rroba të bukura, apo që nuk kishte oratori të madhe?! A vlenin të gjitha këto për të hedhur poshtë shenjat e mrekullitë e Musait, të cilat tregonin hapur se atë e mbështeste Zoti i Plotfuqishëm?! Vërtet, këto arsyetime të Faraonit ishin shumë fyese për logjikën e shëndoshë dhe natyrën e pastër, por duke qenë se populli i tij ishte mendjelehtë dhe pa logjikë, ato u konsideruan të pranueshme. Ai popull injorant dhe i shfrenuar mund të pranonte çdo ftesë, pa bërë dallimin mes të vërtetës dhe të kotës. I Madhëruari thotë për ta:

- "Ata ishin vërtet një popull i shkatërruar." – Madje, për shkak të shfrenimit të tyre në gjynahe e padrejtësi, Allahu i Madhëruar u vuri në krye Faraonin, që ua zbukuronte edhe më tepër të keqen dhe idhujtarinë.

- "Kur ata shkaktuan zemërimin Tonë, Ne u hakmorëm ndaj tyre, duke i përmbytur të gjithë. Kështu, Ne i bëmë ata shembull e mësim për të tjerët." - Kur ata e zemëruan Allahun e Madhëruar me fjalët dhe veprat e tyre, Ai i ndëshkoi. Kështu, ata u bënë


shembull e mësim për njerëzit që dinë të nxjerrin mësime nga ngjarje të tilla.

Ajetet 57 – 65

57. Kur popullit tënd iu përmend si shembull Biri i Merjemes, ata u entuziazmuan
58. dhe thanë: "A janë më të mirë zotat tanë apo ai?!" Ata e thanë këtë veçse për polemikë, sepse ata janë vërtet njerëz ngatërrestarë.
59. Ai ka qenë veçse një adhurues, të cilit i dhuruam mirësi dhe e bëmë shembull të jashtëzakonshëm për bijtë e Israilit.
60. Po të donim, Ne mund të bënim engjëj në vendin tuaj, që t'ju zëvendësonin në tokë.
61. Pa dyshim, ai qe parashenjë e Momentit, prandaj kurrsesi mos dyshoni në të, por pasoni rrugën time, sepse kjo është rruga e drejtë!
62. Të mos ju pengojë Shejtani, se ai është armiku juaj i hapur!
63. Kur erdhi Isai me shenja të qarta, tha: "Erdha te ju me urtësinë dhe që t'ju sqaroj një pjesë të çështjeve, për të cilat keni mospajtime. Kini frikë Allahun dhe bindmuni mua!
64. S'ka dyshim që Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj vetëm Atë adhurojeni! Kjo është rruga e drejtë!"
65. Por grupacionet u përçanë mes tyre. Mjerë zullumqarët për dënimin e Ditës së Dhembshme!

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur popullit tënd iu përmend si shembull Biri i Merjemes, ata u entuziazmuan..." - Allahu i Madhëruar i ka ndaluar njerëzit nga adhurimi i çdo gjëje tjetër veç Tij, çfarëdo dhe kushdo qoftë.



Pjesë e këtij ndalimi ishte edhe adhurimi i Isait, birit të Merjemes. Adhurimi i tij është njëlloj si adhurimi i çdo idhulli tjetër, prandaj është i ndaluar. Por kur Allahu i Madhëruar solli si shembull të adhurimeve të gabuara adhurimin e Isait (a.s.), birit të Merjemes, mohuesit e Profetit (a.s.) pandehën se e gjetën ku të kapeshin. Të entuziazmuar, ata kujtuan se tashmë fituan me këtë "zbulim" nga ana e tyre.

Por cili ishte "zbulimi" i tyre gjenial? Ata aludonin për ajetin në suren Enbija: "Pa dyshim, ju dhe ato që ju i adhuroni veç Allahut, keni për të qenë lëndë djegëse e Xhehenemit." Kështu, ata thanë: "Si ne, ashtu edhe ti Muhamed, e pranojmë që Isai ishte nga robërit e afërt dhe të zgjedhur të Allahut, që do të kenë një përfundim të mirë. Po sipas ajetit të mësipërm, ai duhet të jetë lëndë djegëse e Xhehenemit, ashtu sikurse idhujt tanë, sepse edhe ai adhurohet

veç Allahut. A nuk është ky një paradoks nga ana jote? Pse duhet të trajtohet Isai ndryshe nga idhujt tanë, ndërkohë që ata kanë të përbashkëta disa gjëra?!"

- **"A janë më të mirë zotat tanë apo ai?!" Ata e thanë këtë veçse për polemikë, sepse ata janë vërtet njerëz ngatërrestarë."** – Domethënë, nëse adhurimi i Isait, ashtu sikurse edhe i idhujve tanë, është i ndaluar, atëherë pse ai duhet të jetë më i mirë se idhujt tanë? Nëse idhujt tanë dhe ne do të jemi në Zjarr, po kështu duhet të ndodhë edhe me Isain. Por nëse pretendon se Isai është nga robërit e mirë të Zotit, që do të kenë përfundim të mirë, atëherë këtë duhet ta pranosh edhe për idhujt tanë. Ose, në të kundërt, ke rënë në kundërshtim me veten. Atëherë, nëse vërtetohet që ke rënë në kundërshtim me veten, kjo tregon se argumentet që ti përdor janë të gjitha të papranueshme, prandaj duhen hedhur poshtë." Ky ishte, pra, "zbulimi" i tyre gjenial, me të cilin ata u gëzuan. Por ky lloj arsyetimi ishte nga më të dobëtit e bërë ndonjëherë, dhe lavdia i takon vetëm Allahut për këtë libër që na ka dhënë, i cili sqaron gjithçka!

Në këtë temë duhen dalluar dy çështje. Së pari, është e ndaluar të adhurohet çdo gjë apo çdokush tjetër, veç Allahut. Kjo do të thotë që Allahu i Madhëruar i ka konsideruar njëlloj të ndaluar si adhurimin e idhujve, ashtu edhe adhurimin e Isait (a.s.). Ky është gjykim gjithëpërfshirës, sepse adhurimi është e drejtë dhe meritë vetëm e Allahut, Krijuesit dhe Zotit të gjithësisë, të Vetëm e të Pashoq, dhe e askujt tjetër. Asnjë lloj krijese nuk meriton asnjë grimë adhurimi, as melekët e afërt të Zotit, as profetët e Tij dhe askush tjetër. Kjo është çështja e parë, që duhet kuptuar mirë.

Së dyti, Isai (a.s.) ishte profet dhe rob i zgjedhur i Allahut të Lartësuar. Kështu, gjykimi dhe vlerësimi për të nuk ka asnjë lidhje me faktin se ai adhurohet veç Allahut. Këto janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme dhe pa lidhje me njëra-tjetrën. Ata të adhuruar që do të digjen në Zjarr bashkë me adhuruesit e tyre janë ata që e kanë pëlqyer këtë gjë për vete ose që e kanë miratuar nga ana e tyre. Ndërsa Isai ishte, sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar:

- "Ai ka qenë veçse një adhurues, të cilit i dhuruam mirësi..." - Ai ka qenë veçse një rob dhe adhurues i Allahut, të cilin Allahu e nderoi duke i dhuruar profetësinë, urtësinë, dijen e dobishme dhe punën e sinqertë, me atë dije dhe urtësi. Për veprën e tij, ai meriton vlerësimin dhe shpërblimin nga Allahu i Madhëruar. Ndërsa adhurimi i tij si zot është një krim që e kanë bërë të tjerët, krim për të cilin do të ndëshkohen pikërisht ata që e kryejnë.

- "...dhe e bëmë shembull të jashtëzakonshëm për bijtë e Israilit." - Isai (a.s.) ishte një shenjë për bijtë e Israilit, që ata të njihnin dhe të siguroheshin për pushtetin dhe fuqinë absolute të Zotit të Lartësuar. Edhe lindja e Isait (a.s.) pa baba ishte një mrekulli në funksion të këtij qëllimi, ashtu siç shërbente edhe si provë për ta besuar si profet besnik të Zotit dhe për të punuar sipas thirrjes së tij.

Atëherë, ç'lidhje ka fakti që Isai ishte rob i zgjedhur dhe i dalluar i Zotit, me krimin e idhujtarëve, që e adhurojnë atë apo idhuj të tjerë, adhurim për të cilin do të meritojnë ndëshkimin e drejtë të Zotit në Xhehenem?!

Ata përdorin ajetin: "Pa dyshim, ju dhe ato që ju i adhuroni veç Allahut, keni për të qenë lëndë djegëse e Xhehenemit.", duke thënë: 'Edhe Isai duhet të jetë ashtu si idhujt tanë, pra, lëndë e Xhehenemit." Por ky lloj argumentimi hidhet poshtë nga tri fakte:

1. Po të shohim ajetin nga ana gjuhësore, Allahu i Madhëruar thotë: "*...in-nekum ue ma tea'budune min dunil-lahi...*" (Pa dyshim, ju dhe ato që ju i adhuroni veç Allahut...). Përemri '*ma*' (ato), në arabisht, përdoret për të zëvendësuar emra sendesh dhe jo frymorët. Pra, kuptimi i ajetit është: "Pa dyshim, ju dhe ato sende që ju i adhuroni veç Allahut, keni për të qenë lëndë djegëse e Xhehenemit". Atëherë, ky ajet nuk e mbështet aspak mendimin e idhujtarëve, siç pretendojnë ata.

2. Ky ajet u drejtohej pikërisht idhujtarëve që jetonin në Mekë e rreth e rrotull saj, të cilët adhuronin idhuj e puta dhe nuk adhuronin Isain (a.s). Edhe për këtë arsye, pretendimi i tyre hidhet poshtë.

3. Pas ajetit që ata citojnë, Allahu i Madhëruar ka thënë: "Pa dyshim ju dhe ato që ju i adhuroni veç Allahut keni për të qenë lëndë djegëse e Xhehenemit. Ju atje do të kaloni. Sikur të kishin qenë zota, ata nuk do të hynin në të, por ata që të gjithë do të jenë aty përgjithmonë. Atje ata do të ngulçojnë dhe nuk do të dëgjojnë. Ndërsa ata të cilëve u priu e mbara nga ana Jonë, ata do të jenë larg tij (Xhehenemit). Ata nuk do ta dëgjojnë as zhurmën e tij, por do të jenë atje ku ua dëshiron shpirti, përjetësisht. Ata nuk do t'i shqetësojë frika e madhe, por do t'i presin engjëjt (duke i uruar): "Kjo është dita juaj, që ju premtohej". [Enbija 98 – 103]. Kjo do të thotë që, Isai (a.s.) dhe profetët e tjerë do të jenë të parët që e meritojnë këtë mirësi, ashtu si edhe besimtarët e sinqertë.

Në vijim, i Madhëruari thotë:

- "Po të donim, Ne mund të bënim engjëj në vendin tuaj, që t'ju zëvendësonin në tokë." – Kuptimi: Nëse do të dërgonim engjëj si të dërguar, do t'ju zëvendësonim edhe ju me engjëj, që të rrinin si ju në tokë. Por meqë në tokë jeni vendosur ju, o njerëz, ju nuk mund ta përballoni një profet-engjëll. Është mëshirë dhe butësi nga Zoti juaj që ju dërgoi si profet një njeri, ashtu siç jeni ju, e jo engjëll. Ai ju dërgoi një njeri, që ju ta merrni me lehtësi dhe qartësi mesazhin e Zotit.

- "Pa dyshim, ai qe parashenjë e Momentit..." - Isai (a.s) ishte shenjë që dëshmonte për vërtetësinë e ringjalljes. Kështu, Ai që është i plotfuqishëm për të krijuar një njeri me nënë dhe pa babë, Ai është i plotfuqishëm që t'i ringjallë të vdekurit nga varret e tyre. Gjithashtu, Isai (a.s) do të zbresë në tokë në fazën e fundit të kësaj bote, zbritje e cila do të jetë një nga shenjat e afrimit të Kijametit.

- "...prandaj kurrsesi mos dyshoni në të, por pasoni rrugën Time..." - Kurrsesi mos dyshoni në vërtetësinë e Ditës së Ringjalljes, ditë kur çdokush ka për t'u shpërblyer sipas meritës e veprave. Dyshimi në këtë ditë është tregues i mosbesimit të Zotit. Besoni çdo gjë që jeni urdhëruar të besoni dhe pasoni rrugën e Zotit, duke zbatuar urdhëresat dhe duke iu larguar ndalesave të Tij.

- "...sepse kjo është rruga e drejtë!" - Rruga e drejtë, ajo që të çon te Zoti Krenar dhe i Lartësuar, është besimi i plotë i gjithçkaje që Zoti ka urdhëruar të besohet dhe pasimi i rrugës së Profetit të Tij.

- "Të mos ju pengojë Shejtani, se ai është armiku juaj i hapur!" - Mos lejoni që Shejtani i mallkuar t'ju pengojë nga rruga e drejtë, duke bërë që të mos zbatoni atë që jeni urdhëruar ta zbatoni, apo të bëni atë që Zoti ju ka ndaluar ta bëni. Shejtani i mallkuar është armiku juaj i përbetuar, që lufton pa mëshirë për t'ju devijuar nga rruga e drejtë. Ai përpiqet me çdo mënyrë për t'ia arritur qëllimit të tij.

- "Kur erdhi Isai me shenja të qarta, tha..." - Isai (a.s) u solli atyre fakte, shenja e mrekulli të shumta, që tregonin për vërtetësinë e tij si profet i Zotit, si dhe për vërtetësinë e mesazhit që ai solli. Ndër mrekullitë e mëdha që ai solli ishin ringjallja e të vdekurit, shërimi i të verbërve të lindur, shërimi i lebrozëve etj. shenja të mëdha. Kur ai solli këto mrekulli, u tha bijve të Israilit:

- "Erdha te ju me urtësinë dhe që t'ju sqaroj një pjesë të çështjeve, për të cilat keni mospajtime." - Urtësia (*hikmeh*) është profetësia dhe dituria e plotë dhe e saktë mbi çështjet. Allahu i Madhëruar ia dhuroi këtë urtësi, që t'u sqaronte atyre të vërtetën rreth çështjeve për të cilat ata kishin mospajtime. Isai (a.s.) ishte për t'i dhënë përgjigje çdo çështjeje të paqartë dhe për t'i udhëzuar njerëzit në të drejtën, duke i larguar kështu nga padrejtësitë dhe gabimet. Isai (a.s) erdhi si plotësues i Sheriatit të Musait (a.s) dhe i dispozitave të Teuratit. Ai ligjëroi gjithashtu disa lehtësime, të cilat duhet të sillnin mirënjohje ndaj Allahut, si edhe bindje e nënshtrim ndaj Tij.

- "Kini frikë Allahun dhe bindmuni mua! S'ka dyshim që Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, prandaj vetëm Atë adhurojeni! Kjo është rruga e drejtë!" - Adhurojeni Allahun si Një të vetëm dhe të pashoq, plotësoni urdhëresat e Tij, largojuni ndalesave të Tij, ruajini kufijtë e vendosura nga Ai. Më besoni mua dhe mesazhin që sjell nga Zoti dhe bindjuni porosive të mia.

Ky është, së pari, një pohim i qartë i *rububije*-s së Allahut të Madhëruar, pra, pohim i faktit që Ai është Krijuesi, Furnizuesi, Kujdestari, Rregulluesi i çdo çështjeje të krijesave, i Përhershmi, Zotëruesi, Sunduesi. Ai ka kujdes të plotë për krijesat, duke u dhuruar mirësi të panumërta, të jashtme dhe të brendshme.

Pas *rububije*-s së Allahut, ai pohon edhe meritën e Allahut për t'u adhuruar si Një i vetëm e i pashoq. Veç kësaj, ai deklaron se ishte thjesht një krijesë, një rob, një adhurues i Zotit, ashtu si çdo krijesë tjetër, ndryshe nga ajo që sot pretendojnë të krishterët, se ai është biri i Zotit ose pjesë e Trinisë.

Isai (a.s) i deklaroi të gjitha këto, dhe në fund tha: "Kjo është rruga e drejtë", rruga që të çon tek Allahu dhe që mundëson hyrjen në Xhenetin e Tij. Domethënë, njësimi i Zotit në çdo aspekt, pra, në *rububije* dhe *uluhije*, dhe nënshtrimi ndaj Tij, si një adhurues i sinqertë në zbatim të porosive dhe ligjit të Zotit, është rruga e shpëtimit, ashtu sikurse ka qenë gjithmonë. Ai që i zbaton të gjitha këto ka premtimin për Xhenet, ndërsa ai që i shpërfill ka për të humbur.

- "Por grupacionet u përçanë mes tyre." – Edhe pasi Isai (a.s.) solli këto argumente, grupacionet u përçanë mes tyre. Secili grup kishte nga një ide të gabuar për Isain, duke hedhur poshtë kështu mesazhin e vetë Isait (a.s.). Përjashtim bënë vetëm besimtarët e sinqertë të udhëzuar nga Zoti, të cilët e

besuan Isain si profet të zgjedhur dhe pranuan gjithçka që ai solli prej Zotit të tij. Ata e besuan ashtu sikurse ai ishte në të vërtetë, si rob e adhurues i Zotit dhe si profet i Tij.

- "Mjerë zullumqarët për dënimin e Ditës së Dhembshme!" - Mjerë zullumqarët, për dënimin dhe dëshpërimin e madh që do të përjetojnë atë ditë të dhimbshme dhe të vështirë.

Ajetet 66 – 78

66. A mos presin gjë tjetër ata, përveçse t'u vijë Ora befas dhe pa e kuptuar?!
67. Atë ditë, edhe miqtë e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç të devotshmëve.
68. (Allahu do tu thotë): "O adhuruesit e Mi, sot nuk ka pse të frikësoheni e as pse të brengoseni!
69. Ju të cilët besuat shpalljet Tona dhe u treguat të dorëzuar!
70. Hyni në Xhenet duke u gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja!
71. Aty do t'u shërbejnë me enë e kupa të arta. Aty ka çdo gjë që shpirti e dëshiron dhe syri e pëlqen. Aty do të jeni përgjithmonë.
72. Ky është Xheneti, të cilin e fituat prej veprave që keni bërë.
73. Aty keni plot fruta, nga të cilat do të hani!"
74. Ndërkaq, kriminelët do të vuajnë ndëshkimin e përjetshëm në Xhehenem.
75. Për ta nuk do të ketë asnjë lehtësim. Të dëshpëruar do të jenë gjithmonë!
76. Ne nuk u bëjmë padrejtësi atyre, sepse ata kanë bërë krime.
77. Ata do të thërrasin: "O Malik! Le të na e marrë shpirtin Zoti yt!". Ai u thotë: "Aty do të jeni përgjithmonë!
78. Ne jua sollëm të vërtetën, por shumica juaj treguan urrejtje ndaj saj!"

Shpjegimi i ajeteve

- "A mos presin gjë tjetër ata, përveçse t'u vijë Ora befas dhe pa e kuptuar?!" – Kuptimi: Çfarë presin mohuesit e profetëve dhe të shpalljeve të Zotit? Vallë, mos presin t'i zërë Kijameti befas, pa e ndier? Por kur të vijë ajo ditë, mos pyet për tmerrin që i pret mjeranët, të cilët e mohojnë vërtetësinë e saj.


- "Atë ditë, edhe miqtë e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit..." - Atë ditë, edhe ata që në jetën e kësaj bote mbahen për miq dhe aleatë të ngushtë, të cilët i bashkon kufri, gjynahet dhe mohimi i shpalljeve të Zotit, do të jenë armiq të njëri-tjetrit. Dashuria dhe miqësia do të shndërrohet në urrejtje e armiqësi, sepse lidhja e tyre në dynja nuk është për hir të Allahut. Në fakt, kështu do të përfundojë çdo dashuri dhe lidhje jo për hir të Allahut.

Allahu i Madhëruar përjashton nga ky gjykim një kategori të zgjedhurish, duke thënë:

- "...përveç të devotshmëve." – Përveç atyre që ruhen nga *shirk*-u dhe padrejtësitë, sepse dashuria dhe lidhja mes tyre do të vazhdojë e pakëputur. Miqësia e tyre do të jetë e përjetshme, sepse i Përjetshëm është Ai për hir të të Cilit ata janë dashur.

Pastaj i Madhëruari tregon shpërblimin e të devotshmëve. Ditën e Kijametit, Ai do t'u flasë me dashuri e do t'u thotë:

- "O adhuruesit e Mi, sot nuk ka pse të frikësoheni e as pse të brengoseni!" - Kuptimi: Nuk do t'ju shqetësojë frika për përfundimin që ju pret në të ardhmen dhe as


الجزء الخامس والعشرون سورة الزخرف
إِنَّ ٱلْمُجْرِمِينَ فِى عَذَابِ جَهَنَّمَ خَٰلِدُونَ ﴿٧٤﴾ لَا يُفَتَّرُ عَنْهُمْ وَهُمْ
فِيهِ مُبْلِسُونَ ﴿٧٥﴾ وَمَا ظَلَمْنَٰهُمْ وَلَٰكِن كَانُوا۟ هُمُ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿٧٦﴾
وَنَادَوْا۟ يَٰمَٰلِكُ لِيَقْضِ عَلَيْنَا رَبُّكَ ۖ قَالَ إِنَّكُم مَّٰكِثُونَ ﴿٧٧﴾ لَقَدْ
جِئْنَٰكُم بِٱلْحَقِّ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَكُمْ لِلْحَقِّ كَٰرِهُونَ ﴿٧٨﴾ أَمْ أَبْرَمُوٓا۟ أَمْرًا
فَإِنَّا مُبْرِمُونَ ﴿٧٩﴾ أَمْ يَحْسَبُونَ أَنَّا لَا نَسْمَعُ سِرَّهُمْ وَنَجْوَىٰهُم ۚ بَلَىٰ
وَرُسُلُنَا لَدَيْهِمْ يَكْتُبُونَ ﴿٨٠﴾ قُلْ إِن كَانَ لِلرَّحْمَٰنِ وَلَدٌ فَأَنَا۠ أَوَّلُ
ٱلْعَٰبِدِينَ ﴿٨١﴾ سُبْحَٰنَ رَبِّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ رَبِّ ٱلْعَرْشِ
عَمَّا يَصِفُونَ ﴿٨٢﴾ فَذَرْهُمْ يَخُوضُوا۟ وَيَلْعَبُوا۟ حَتَّىٰ يُلَٰقُوا۟ يَوْمَهُمُ
ٱلَّذِى يُوعَدُونَ ﴿٨٣﴾ وَهُوَ ٱلَّذِى فِى ٱلسَّمَآءِ إِلَٰهٌ وَفِى ٱلْأَرْضِ
إِلَٰهٌ ۚ وَهُوَ ٱلْحَكِيمُ ٱلْعَلِيمُ ﴿٨٤﴾ وَتَبَارَكَ ٱلَّذِى لَهُۥ مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ
وَٱلْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ۚ وَعِندَهُۥ عِلْمُ ٱلسَّاعَةِ ۚ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ
﴿٨٥﴾ وَلَا يَمْلِكُ ٱلَّذِينَ يَدْعُونَ مِن دُونِهِ ٱلشَّفَٰعَةَ إِلَّا
مَن شَهِدَ بِٱلْحَقِّ وَهُمْ يَعْلَمُونَ ﴿٨٦﴾ وَلَئِن سَأَلْتَهُم مَّنْ خَلَقَهُمْ
لَيَقُولُنَّ ٱللَّهُ ۖ فَأَنَّىٰ يُؤْفَكُونَ ﴿٨٧﴾ وَقِيلِهِۦ يَٰرَبِّ إِنَّ هَٰٓؤُلَآءِ قَوْمٌ
لَّا يُؤْمِنُونَ ﴿٨٨﴾ فَٱصْفَحْ عَنْهُمْ وَقُلْ سَلَٰمٌ ۚ فَسَوْفَ يَعْلَمُونَ ﴿٨٩﴾
٤٩٥

brenga për gjërat që kanë kaluar. Nëse nuk ju godet e keqja, kjo tregon se ju pret vetëm e mira. Lumturia është përfundimi juaj, ashtu sikurse e shpresonit, madje edhe më mirë se aq.

- "Ju të cilët besuat shpalljet Tona dhe u treguat të dorëzuar!" - Allahu i Madhëruar i përshkruan ata me dy cilësi:

1. Ata e kanë besuar Shpalljen hyjnore. Kjo do të thotë që ata fillimisht e kanë pranuar si të vërtetë dhe të saktë Shpalljen e Zotit, por jo vetëm kaq. Ata e kanë ditur mirë kuptimin e Shpalljes dhe e kanë zbatuar atë. Vetëm kështu mund të quhet se e kanë besuar Shpalljen e Zotit.
2. Ata janë treguar të përulur dhe të përkushtuar ndaj Zotit, në çdo aspekt, si me fjalë e vepra, ashtu edhe me ndjenjat e zemrës. Këtyre fatlumëve u thuhet:

- "Hyni në Xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja!" - Hyni në vendin e kënaqësisë, prehjes dhe lumturisë së përjetshme, bashkë me *ezuaxhukum*. Fjala '*ezuaxhukum*' ka kuptimin 'bashkëshortët', por edhe kuptimin tjetër: "të njëjtë me ju" pra, që bëjnë punë të mira si ju, qofshin ato gratë, fëmijët, miqtë, shokët, të afërmit tuaj etj. Të gjithë do të kënaqen në Xhenet me mirësitë e tij. Zoti do t'u dhurojë mirësi, kënaqësi, gëzim e lumturi, që nuk mund të përshkruhen me fjalë.

- "Aty do t'u shërbejnë me enë e kupa të arta." - Mes tyre do të vërtiten shërbëtorët, djelmosha të përjetshëm, që servirin plot hijeshi ushqimet me enë të bukura prej floriri e argjendi. Edhe pijet do t'u shërbehen me gota të mrekullueshme, që janë prej argjendi dhe të tejdukshme.

- "Aty ka çdo gjë që shpirti e dëshiron dhe syri e pëlqen." - Në Xhenet, banorët do të kenë gjithçka që ua pëlqen shpirti dhe syri.

Ky ajet është gjithëpërfshirës në kuptimin e tij. Këto fjalë përfshijnë në përshkrimin e tyre çdo mirësi e gëzim që të kënaq syrin dhe shpirtin. Kështu, besimtarët do të gjejnë në Xhenet çdo gjë që dëshiron shpirti e trupi i tyre, qofshin ato ushqime, pije, veshje apo marrëdhënie. Sytë e tyre do të kënaqen me pamjet e mrekullueshme të Xhenetit, si me bimësinë e dendur, me ndërtesat madhështore dhe me gjithçka rreth e rrotull. Të gjitha ato janë për ta dhe atje do të jenë përjetësisht. Çdo gjë në Xhenet është e përkryer në gradën më të lartë të bukurisë dhe hijeshisë, sikurse thotë i Madhëruari: "Ata do të kenë atje fruta dhe gjithçka që dëshirojnë." Atyre u thuhet edhe diçka

tjetër, që ua shton edhe më tepër kënaqësinë dhe lumturinë:

- "Aty do të jeni përgjithmonë." - Kjo e vulos lumturinë e banorëve të Xhenetit. Përjetësia në të do të thotë që të gjitha këto mirësi do të jenë të pandërprera, madje në rritje të vazhdueshme.

- "Ky është Xheneti, të cilin e fituat prej veprave që keni bërë." – Kuptimi: Allahu i Madhëruar jua la këto kopshte kaq të bukura për hir të punëve të mira që keni bërë. Ju u bindët dhe bëtë vepra të mira me sinqeritet, në shenjë madhërimi, dashurie e nënshtrimi ndaj Allahut, prandaj Ai e bëri Xhenetin si shpërblim për ju, duke ju përfshirë në mëshirën e Tij.

- "Aty keni plot fruta, nga të cilat do të hani!" - Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar thotë: "Prej çdo frute do të ketë nga dy lloje." [Rrahman 52]. Pra, banorët e Xhenetit do të mund t'i hanë të gjitha ato fruta të shijshme dhe të këndshme.
Pas përshkrimit të mirësive në Xhenet, Allahu i Madhëruar tregon për ndëshkimin në Xhehenem:

- **"Ndërkaq, kriminelët do të vuajnë ndëshkimin e përjetshëm në Xhehenem."** – Kriminelët, domethënë ata që kanë kaluar kufijtë e Zotit duke bërë gjynahe, padrejtësi dhe duke mohuar të vërtetën e sjellë nga Zoti nëpërmjet profetëve, do të jenë të zhytur në zjarrin e Xhehenemit, i cili do t'i përfshijë nga çdo anë. Atje do të jenë përgjithmonë dhe kurrë nuk kanë për të shpëtuar prej tij.

- "Për ta nuk do të ketë asnjë lehtësim. Të dëshpëruar do të jenë gjithmonë! Ne nuk u bëjmë padrejtësi atyre, sepse ata kanë bërë krime." - Atyre nuk do t'u ndërpritet apo t'u lehtësohet ndonjëherë ndëshkimi, në asnjë çast. Ata do të vuajnë dhe njëkohësisht do të jenë të pashpresë. Ata nuk do të shpresojnë se do të arrijnë ndonjë të mirë apo se do të shpëtojnë ndonjëherë nga ndëshkimi. Sikurse thuhet në ajete të tjera, ata do t'i luten Zotit duke thënë: "Zoti ynë, na nxirr prej tij, e nëse gabojmë përsëri, atëherë vërtet jemi të padrejtë!" Ai do thotë: "Heshtni aty e mos më flisni! Kur disa prej robërve të Mi thanë: "O Zoti ynë, ne të besojmë, prandaj na fal dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!", ju i tallnit ata, saqë ajo tallje ju bëri të më harronit Mua, madje edhe qeshnit me ta." [Mu'minun 107 – 110].

Ky ndëshkim i madh u jepet për shkak të punëve që kanë bërë, duke dhunuar vetveten. Allahu i Madhëruar nuk i bën padrejtësi askujt; Ai nuk ndëshkon asnjë pa gjynah e pa faj.

- "Ata do të thërrasin: "O Malik! Le të na e marrë shpirtin Zoti yt!"." - Duke pandehur se mund të ketë ndonjë lloj shpëtimi për ta, ata, që nga brendësia e Zjarrit, do të bërtasin duke iu lutur rojes së Xhehenemit: "O Malik, le të na japë fund Zoti yt! Le të na vdesë, që të shpëtojmë një herë e mirë, sepse po vuajmë shumë. Ne nuk mund ta përballojmë këtë ndëshkim!" Por kur ata të kërkojnë që të vdesin dhe të shkatërrohen përfundimisht, Maliku u përgjigjet:

- **"Aty do të jeni përgjithmonë!"** – Kuptimi: Aty do të qëndroni dhe kurrë nuk keni për të dalë prej andej!

Pra, jo vetëm që nuk do të marrin atë përgjigje që presin, por do t'u jepet krejt e kundërta e saj. Kjo thjesht ua shton më tepër vuajtjen dhe dëshpërimin. Veç kësaj, dhimbja iu shtohet përsëri kur t'u thuhen disa fjalë qortuese:

- **"Ne jua sollëm të vërtetën..."** - Juve ju ofrua e vërteta, e cila ishte e mjaftueshme dhe mjaft bindëse që ju të nënshtroheshit dhe të jetonit sipas saj, por nuk e bëtë një gjë të tillë. Nëse do të kishit pranuar ftesën bujare të Allahut, do të fitonit të gjitha të mirat dhe do të shpëtonit nga të gjitha të këqijat, duke u lumturuar përjetësisht.

- "...por shumica juaj treguan urrejtje ndaj saj!" - Por ju e urryet të vërtetën dhe parapëlqyet të ndiqnit dëshirat tuaja, prandaj e zgjodhët vetë vuajtjen dhe dëshpërimin, pas të cilit nuk do të gjeni më lumturinë.

Ajetet 79 – 80

79. A mos po ngrejnë ndonjë kurth ata?! Por edhe Ne ngrejmë kurthe!
80. A mendojnë ata se Ne nuk ua dëgjojmë të fshehtat dhe bisedat sekrete mes tyre? Po, i dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë, që janë pranë tyre, i mbajnë shënim ato.

Shpjegimi i ajeteve

- "A mos po ngrejnë ndonjë kurth ata?! Por edhe Ne ngrejmë kurthe!" – Vallë, kundërshtarët e të vërtetës dhe të profetëve thurin plane për të luftuar dhe hedhur poshtë të vërtetën? A mos ngrejnë kurthe për të dëmtuar përcjellësit e të vërtetës, për të ndaluar përhapjen e saj dhe për të përhapur të kotën, e cila është e bukur në sytë e tyre? Le ta dinë, atëherë, se edhe Allahu ka planifikuar me urtësi çdo çështje. Por planifikimi i Allahut qëndron mbi të gjitha planet dhe intrigat e tyre. Ai i shkatërron të gjitha kurthet e tyre, duke forcuar të vërtetën dhe duke e zhdukur të kotën, sikurse thuhet në ajetin tjetër: "Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën, dhe ajo triumfon mbi të pavërtetën, e cila zhduket. Mjerë ju, për shpifjet tuaja!" [Enbija 18].

- "A mendojnë ata se Ne nuk ua dëgjojmë të fshehtat dhe bisedat sekrete mes tyre?" - Me paditurinë dhe padrejtësinë që i karakterizon, ata mendojnë se Allahu nuk i di dhe nuk i dëgjon gjërat që i mbajnë fshehur në zemrat e tyre ose që i bisedojnë fshehtas mes njëri-tjetrit. Për këtë arsye, ata mendojnë se nuk do të merren në përgjegjësi dhe nuk do të ndëshkohen për gjërat që i thonë dhe i bëjnë fshehtas. Por Allahu i Madhëruar ua kthen përgjigjen, kur thotë:

- "Po, i dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë, që janë pranë tyre, i mbajnë shënim ato." - Allahu i di imtësisht të fshehtat e tyre dhe bisedat sekrete që zhvillojnë me njëri-tjetrin. Ndërsa engjëjt e Allahut, të cilët Ai i ka ngarkuar për regjistrimin e veprave të tyre, shkruajnë me përpikmëri çdo fjalë e veprim të robërve. Ato mbahen shënim e ruhen të pandryshuara deri kur të dalin para Zotit, Ditën e Gjykimit. Atë ditë, ata do të gjejnë gjithçka që kanë bërë në dynja, për të cilat do të japin llogari. Allahu i Madhëruar nuk i bën padrejtësi askujt.

Ajetet 81 – 83

81. Thuaj: "Sikur Mëshiruesi të kishte fëmijë, unë do të isha i pari adhurues i tij!"

82. I Lartësuar dhe larg të metave është Zoti i qiejve e i Tokës, Zoti i Fronit, nga ajo që ata e përshkruajnë.

83. Po lëri ata të zhyten më thellë dhe të argëtohen, derisa të arrijnë ditën që u është përcaktuar.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Sikur Mëshiruesi të kishte fëmijë, unë do të isha i pari adhurues i tij!" – Kuptimi: O i Dërguari besnik! Ata shpifin se Zoti ka fëmijë, ata shpifin për Atë që është Një, i Vetëm, i Pashoq dhe i Pakrahasueshëm, për Atë që çdokush i drejtohet për nevojat e veta, për Atë që është i Plotë, Jonevojtar e Absolut në çdo drejtim. Atij nuk i takon që të ketë grua e as fëmijë. Askush nuk mund të jetë i barabartë apo i njëjtë me Allahun dhe as mund t'i afrohet madhërisë së Tij. Thuaju këtyre mjeranëve: "Nëse vërtetë Zoti do të kishte fëmijë, unë do të isha i pari adhurues i këtij fëmije, sepse ai do të ishte pjesë e të atit. Nëse kjo do të ishte e vërtetë dhe diçka e dashur për Zotin, unë do ta zbatoja me korrektësi, sepse unë jam i pari zbatues i asaj që Zoti e dëshiron dhe e do. Por çështja nuk është kështu, prandaj unë jam i pari që e mohoj një paturpësi të tillë!"

Kjo teori e stisur nga injorantët është diçka e papranueshme për profetët e Zotit. Ata janë njerëzit më të përkushtuar në bindjen dhe adhurimin e Zotit, si dhe në zbatimin e urdhrave dhe veprave të dashura për Të. Po ashtu, ata janë njerëzit më të kujdesshëm për t'u larguar nga çdo gjë e keqe dhe për të qortuar njerëzit nga ato. Nëse Mëshiruesi vërtet do të kishte bir, Muhamedi (a.s.) do të ishte i pari adhurues i tij dhe nuk do të ishin idhujtarët ata që do të mund t'ia kalonin atij në këtë çështje. Por duke qenë se Profeti nuk e bëri këtë gjë, pra, nuk e pranoi se Zoti ka fëmijë, atëherë kjo është diçka jo e vërtetë.

Ka mundësi që ajeti të kuptohet edhe në një mënyrë tjetër: "Nëse Mëshiruesi do të kishte fëmijë, atëherë unë do të isha përsëri i pari që do të adhuroja Mëshiruesin. Mënyra kryesore e shprehjes së adhurimit për Allahun është që të pohoj për Të gjithçka që Ai ka pohuar për Veten e Vet dhe të mohoj çdo gjë që Ai e ka mohuar për Veten e Vet, kur flitet për cilësitë, emrat dhe atributet e Tij." Në këtë rast, pranimi i fëmijës për Zotin do të ishte një prej adhurimeve të shprehura thjesht me fjalë dhe me zemër.

Përfundimisht, pretendimet e idhujtarëve janë të gabuara dhe të papranueshme, qoftë nga ana logjike, qoftë nga ana e fakteve hyjnore.

- "I Lartësuar dhe larg të metave është Zoti i qiejve e i Tokës, Zoti i Fronit, nga ajo që ata e përshkruajnë." - Allahu i Madhëruar është i pastër dhe shumë lart pasjes së të barabartëve apo të njëjtëve me Të, shumë lart pasjes së ndihmuesve e aleatëve, shumë lart pasjes së fëmijëve e çdo lloj përshkrimi të ngjashëm që i kanë bërë idhujtarët.

- "Po lëri ata të zhyten më thellë dhe të argëtohen..." - Lëri ata të zhyten në të kotën dhe të luajnë me gjëra të paqena e të pavërteta. Njohuritë e tyre janë të dëmshme dhe aspak të dobishme. Ata merren me dituri të dëmshme, nëpërmjet së cilës synojnë të përmbysin të vërtetën, që profetët sollën. Ndërsa veprat e adhurimet e tyre janë me të vërtetë mendjelehtësira. Ato janë vepra nëpërmjet të cilave shpirti nuk mund të pastrohet dhe vepra që nuk prodhojnë dituri e mirësi.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i paralajmëron për atë që i pret në Ditën e Gjykimit:

- "...derisa të arrijnë ditën që u është përcaktuar." - Atë ditë do të shohin realisht se çfarë kanë arritur me gjynahet dhe padrejtësitë e tyre. Atë ditë do të vuajnë ndëshkimin dhe dëshpërimin e pafund.

Ajetet 84 – 89

84. Ai është i vetmi Zot *(që meriton adurimin)* në qiell dhe i vetmi Zot *(që meriton adurimin)* në Tokë. Ai është i Urti e i Dijshmi.
85. I Lartësuar qoftë Ai, në dorën e të Cilit është sundimi i qiejve e i Tokës dhe i çfarë gjendet ndërmjet tyre! Vetëm Ai e di çastin e Kijametit dhe tek Ai do të ktheheni.
86. Çfarë adhurohet në vend të Allahut nuk mund të ndërmjetësojë, përveç atyre që dëshmojnë të vërtetën dhe kanë dituri.
87. Nëse ti i pyet se kush i krijoi, ata, me siguri, do të thonë: "Allahu!" Përse, atëherë, i kthejnë shpinën Atij?
88. Ai thotë: "O Zoti im! Vërtet, këta janë njerëz që nuk besojnë!"
89. Distancohu prej tyre dhe thuaju: "*Selam*!" Ata do ta kuptojnë më vonë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ai është i vetmi Zot *(që meriton adurimin)* në qiell dhe i vetmi Zot *(që meriton adurimin)* në Tokë." - Allahu i Madhëruar na tregon se Ai është Një dhe i Vetëm në meritën e adhurimit, në qiej dhe në Tokë. Të gjithë banorët e qiellit dhe besimtarët në Tokë e adhurojnë Atë, e madhërojnë, i nënshtrohen lartësisë së Tij, tregojnë dobësinë, varfërinë dhe nevojën e tyre të plotë ndaj pushtetit, bujarisë dhe mëshirës së të Plotit e Absolutit. Në një ajet tjetër, i Madhëruari thotë: "Me *tesbih* e madhërojnë Atë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka në to. Nuk ka asnjë që nuk e madhëron duke e lavdëruar Atë, por ju nuk e kuptoni madhërimin e tyre. Ai është i Butë dhe Falës." [Isra 44]. Ose: "Gjithçka në qiej e në Tokë i bën sexhde vetëm Allahut, me dëshirë ose me dhunë, madje edhe hijet e tyre, në mëngjes e mbrëmje." [Ra'd 15].
Allahu i Lartësuar është Zoti i vetëm me meritë, të Cilit duhet t'i përkushtohen adhurimet, në shenjë dashurie, madhërimi e nënshtrimi ndaj Tij. Atij i përulen të gjitha krijesat: ose me dëshirë dhe vullnet, ose të detyruara.
Në një ajet të ngjashëm thuhet: "Ai është Zoti ***(që meriton adurimin)*** në qiej dhe në Tokë. Ai di çfarë kini të fshehta dhe çfarë jo të fshehta; Ai e di se çfarë veproni ju." [En'am 3]. Adhurimi dhe dashuria për Të kanë mbushur qiejt dhe Tokën, ndërsa Ai është sipër Fronit të Tij, i veçuar nga krijesat e Tij, i Vetëm në madhështinë e Tij, i Vetmi, i Lartësuari, i Lavdishmi dhe i Ploti në çdo aspekt.

- "Ai është i Urti e i Dijshmi." - Allahu është *El Hakim*, Ai që përsosi me urtësinë e Tij gjithçka që krijoi dhe çdo ligj që përcaktoi. Krijimi i Tij, ligjet për krijesat e Tij dhe shpërblimi që premtoi për ta, janë bërë të gjitha me urtësi të padiskutueshme. Allahu është, gjithashtu, *El Alim* – i Dijshëm për gjithçka. Ai di në imtësi dhe thellësisht çdo të fshehtë dhe jo të fshehtë. Atij nuk mund t'i fshihet gjë, as sa grima më e vogël, në botën qiellore dhe atë tokësore.

- "I Lartësuar qoftë Ai, në dorën e të Cilit është sundimi i qiejve e i Tokës dhe i çfarë gjendet ndërmjet tyre!" - U madhëroftë dhe u lartësoftë Allahu, u shtofshin begatitë dhe mirësitë e Tij, u lavdëroftë për cilësitë e Tij, për pushtetin e Tij dhe mbretërimin e Tij!

Jo më kot sundimi i Tij gjithëpërfshirës mbi qiejt, Tokën e gjithçka mes tyre përmendet bashkë me faktin se Allahu është i Dijshëm për gjithçka. Madje, Allahu i Madhëruar është i vetmi që ka dituri mbi shumë çështje, për të cilat nuk di askush tjetër, qofshin profetë apo engjëj, si për shembull:

- **"Vetëm Ai e di çastin e Kijametit..."** - Dituria për çastin e Kijametit i takon vetëm Zotit. Askush tjetër nuk e di se kur do të ndodhë Kijameti.

Tregues i mbretërimit dhe i pushtetit të Tij absolut është edhe fakti se Ai është Sunduesi i dynjasë dhe ahiretit, prandaj thuhet më pas:

- **"...dhe tek Ai do të ktheheni."** - Kur të ktheheni tek Ai, në ahiret, Ai do të japë gjykimin e Tij të drejtë për veprat tuaja.

Tregues i pushtetit dhe i sundimit të plotë të Allahut është edhe fakti se askush tjetër nuk ka në dorë ndonjë çështje të caktuar, madje edhe për të ndërmjetësuar tek Ai nevojitet patjetër leja e Tij, të cilën Allahu ia jep atij që Ai dëshiron. I Plotpushtetshmi dhe Sunduesi i vetëm i dynjasë dhe i ahiretit thotë:

- "Çfarë adhurohet në vend të Allahut nuk mund të ndërmjetësojë..." - Të gjithë ata që janë adhuruar në dynja, qofshin profetë, melekë etj., nuk do të kenë asnjë mundësi tek Allahu i Madhëruar pa lejen e Tij. Edhe ata që do të lejohen, do të mund të ndërmjetësojnë vetëm për ata me të cilët Zoti është i kënaqur. I Madhëruari thotë:

- "...përveç atyre që dëshmojnë të vërtetën dhe kanë dituri." - Përveç atyre që dëshmojnë të vërtetën, duke e pranuar me zemër, duke qenë të qartë dhe të ditur për atë të vërtetë. Kjo është dëshmia për njëshmërinë e Allahut të Madhëruar në çdo aspekt, për vërtetësinë e të dërguarve si profetë të Zotit dhe të shpalljeve hyjnore. Ajo është dëshmia për vërtetësinë e themeleve e fesë dhe të degëzimeve të saj. Vetëm për këta do të vlejë ndërmjetësimi i profetëve, i melekëve dhe i të tjerëve që do t'u jepet leja. Këta do të jenë të shpëtuarit nga ndëshkimi i Allahut të Lartësuar.

Pastaj Allahu i Madhëruar thotë:

- "Nëse ti i pyet se kush i krijoi, ata, me siguri, do të thonë: "Allahu!"" - Po t'i pyesje idhujtarët se kush është Krijuesi, Sunduesi, Furnizuesi dhe Kujdestari i krijesave, ata do të dëshmonin se Ai është vetëm Allahu.

- "**Përse, atëherë, i kthejnë shpinën Atij?"** – Kuptimi: Kur ata dëshmojnë se është vetëm Allahu Krijuesi, Sunduesi, Furnizuesi dhe Kujdestari i krijesave, atëherë si është e mundur që adhurimet, dashurinë dhe përuljen ia përkushtojnë dikujt tjetër veç Tij?! Nëse pranojnë teuhidin në *rububije*, ata duhet që të pranojnë edhe njëshmërinë e Allahut në meritën e adhurimit.

Ky argument konsiderohet si nga më të fuqishmit në hedhjen poshtë të idhujtarisë.

- **"Ai thotë: "O Zoti im! Vërtet, këta janë njerëz që nuk besojnë!""** - Ky ajet ka lidhje me fjalinë e mësipërme: "Vetëm Ai e di

çastin e Kijametit.". Domethënë, vetëm Ai ka dijeni për Kijametin, ashtu si edhe për fjalët e Profetit (a.s), kur tha: "Këta janë njerëz që nuk besojnë". Pra, Allahu i Madhëruar e ka dëgjuar edhe ankesën e Profetit, që flet me shqetësim për refuzimin e popullit të tij. Allahu ka dijeni të plotë për gjendjen e tyre dhe është i Plotfuqishëm që t'ua përshpejtojë ndëshkimin, por Ai tregohet *Halim* - i Butë e Tolerues, që nuk nxitohet të ndëshkojë, por afatizon, që robërit të mund të pendohen dhe të kthehen në udhën e drejtë.

- "Distancohu prej tyre dhe thuaju: "*Selam*!"" – Domethënë, ji tolerant dhe falës ndaj tyre, kundrejt mundimeve që të shkaktojnë me fjalët, sjelljet dhe veprimet e tyre. Kundërpërgjigjja jote ndaj tyre të jetë veçse me selam, ashtu siç dinë të sillen të mençurit me të paditurit. Vepro ashtu siç dinë të reagojnë adhuruesit e Rrahmanit, siç thuhet në një ajet tjetër: "Adhuruesit e Rahmanit janë ata që ecin në tokë të qetë dhe, kur u flasin injorantët, thonë: "*Selam*!" [Furkan 63].

Dhe, me të vërtetë, Profeti (a.s.) e zbatoi porosinë e Zotit të tij. Ai u tregua tolerant, falës dhe i mëshirshëm, me gjithë mundimet e gjata dhe të dhimbshme që i shkaktoi populli i tij. Ai iu kundërpërgjigj këtij trajtimi të ashpër veçse me fjalët më të bukura dhe më të zgjedhura. Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Profetin (a.s.), mbi njeriun me moralin më të lartë, mbi atë që Zoti e dalloi me dhunti të veçanta, me të cilat ai i tejkaloi gradat e banorëve të qiellit dhe të Tokës, madje duke qëndruar më lart se yjet.

- "Ata do ta kuptojnë më vonë." – Më vonë do ta mësojnë përfundimin e gjynaheve dhe ndëshkimin për krimet e tyre.


Surja 44: Ed Duhan (mekase) 59 ajete

Ajetet 1 – 16

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. ***Ha, Mim.***
2. **Betohem në Librin e qartë!**
3. **Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar. Vërtet, Ne kemi qenë gjithmonë paralajmërues!**
4. **Atëherë vendoset në mënyrë të prerë çdo çështje e urtë,**
5. **me urdhër nga Vetë Ne. S'ka dyshim se Ne kemi dërguar gjithmonë profetë,**
6. **si mëshirë nga Zoti yt. Me të vërtetë, Ai është Gjithëdëgjuesi e i Gjithëdijshmi.**
7. **Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet mes tyre, që të jeni të bindur.**
8. **Nuk ka zot tjetër, veç Tij. Ai jep jetën dhe sjell vdekjen. Ai është Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të lashtë.**
9. **Kurse ata dyshojnë e dëfrehen.**
10. **Qëndro dhe prit ditën kur qielli të lëshojë një tym të qartë,**
11. **që do t'i mbulojë njerëzit. Ky do të jetë një ndëshkim i dhimbshëm.**
12. **"Zoti ynë! Largoje dënimin prej nesh! Ne tashmë jemi besimtarë!"**
13. **E si mund të përfitojnë më ata nga këshillat, kur atyre u erdhi Profeti me mesazh të qartë,**
14. **ndërsa ata i kthyen shpinën atij, duke thënë: "E kanë mësuar! Është i çmendur".**
15. **Ne do t'jua largojmë dënimin për pak kohë, por ju do t'i ktheheni përsëri të kotës.**

16. Ditën kur t'ju japim ndëshkimin e madh, atëherë do të hakmerremi!



Shpjegimi i ajeteve

- **"*Ha, Mim*. Betohem në Librin e qartë! Ne e zbritëm atë në një natë të bekuar. Vërtet, Ne kemi qenë gjithmonë paralajmërues!"** - Ky është një betim në Kuranin madhështor për të pohuar vërtetësinë po të Kuranit. I Madhëruari betohet në këtë libër, i cili është sqaruesi i gjithçkaje që ka nevojë për t'u sqaruar, dhe na tregon se ai u shpall në një natë të bekuar, me plot mirësi të mëdha. Ajo është Nata e Kadrit, e cila është më e mira e netëve dhe më e vlefshme se një mijë muaj.

Kështu, i Madhëruari e shpalli më të mirin e librave të Tij në më të mirën e netëve dhe të ditëve, duke ia dhuruar më të mirit të krijesave, Muhamedit (a.s.), me gjuhën më të zgjedhur dhe të kulluar arabe. Ai e shpalli këtë Kuranin që të paralajmëronte një popull të zhytur në padituri e mjerim, të humbur në dëshpërim, që ata të ndriçoheshin nga drita e tij, të merrnin jetë nga udhëzimi i tij, të ndiqnin rrugën e qartësuar prej tij, dhe kështu të arrinin mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit.

Kurani u shpall që të jetë këshillues dhe paralajmërues, prandaj i Madhëruari thotë: "Vërtet, Ne gjithmonë kemi qenë paralajmërues!"

- **"Atëherë vendoset në mënyrë të prerë çdo çështje e urtë, me urdhër nga Vetë Ne."** - Gjatë Natës së Kadrit përcaktohet çdo çështje. Ky lloj përcaktimi që bëhet Natën e Kadrit është vetëm njëri ndër llojet e përcaktimeve që bëhen në kohë të ndryshme dhe të cilat janë të gjitha në përputhje me ato çfarë gjenden në *Leuhi Mahfudh*, ku Allahu i Madhëruar ka shkruar gjithçka rreth krijesave: kohën e jetës dhe vdekjes së tyre, furnizimin, punët që do të kryejnë, gjendjet nëpër të cilat do të kalojnë e çdo gjë tjetër.

Një tjetër lloj përcaktimi është ai që bëhet kur njeriu është në barkun e nënës së vet. Në këtë moment, Zoti urdhëron melekët për të shkruar se çfarë do të ndodhë me robin në këtë dynja. Pasi del në këtë dynja, i Madhëruari ngarkon melekët besnikë, që të shkruajnë me saktësi çdo vepër të robit. Gjithashtu, në çdo Natë Kadri, i Madhëruari përcakton se çfarë do të ndodhë gjatë atij viti. Të gjitha këto lloje të përcaktimit nga Allahu i Madhëruar tregojnë për diturinë e Tij të plotë dhe absolute, për urtësinë e Tij gjithëpërfshirëse, për ruajtjen dhe përkujdesin që Ai tregon për krijesat e Tij. Të gjitha këto, përfshirë edhe përcaktimin vjetor që bëhet Natën e Kadrit, bëhet me urdhrin dhe urtësinë e Zotit, siç thotë Ai: "...me urdhër nga Vetë Ne".

Për qartësimin e porosive të Tij, Allahu i Madhëruar dërgoi profetë e shpalli libra të shenjtë.

- "S'ka dyshim se Ne kemi dërguar gjithmonë profetë, si mëshirë nga Zoti yt." - Dërgimi i profetëve me mrekullira dhe libra, më i miri i të cilëve është Kurani, është tregues i mëshirës së Allahut, Zotit të botëve, mbi robërit e Tij. Mëshira më e madhe që Zoti i botëve ka treguar me robërit e Tij është pikërisht sjellja e librave qiellorë dhe e profetëve. Çdo mirësi që njerëzit arrijnë në dynja dhe çdo mirësi që ka lidhje me ahiretin, e ka burimin te kjo mëshirë e dhuruar nga Zoti: nga librat dhe nga mësimet e profetëve.

- "Me të vërtetë, Ai është Gjithëdëgjuesi e i Gjithëdijshmi." - Allahu i Madhëruar i dëgjon të gjitha zërat dhe i di të gjitha çështjet, të dukshmet e të padukshmet. Ai i di dhe i sheh të gjitha veprimet e njerëzve. Ai e di shumë mirë nevojën e domosdoshme që ata kanë për profetët dhe shpalljet e Tij. Allahu i Madhëruar i mëshiroi ata duke u dhënë udhëzimin e drejtë dhe profetët, të cilët ishin shembujt më të mirë të zbatimit të atij udhëzimi. Vetëm Allahut i takon mirënjohja dhe lavdia e plotë për këtë mirësi të madhe.

- "Ai është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet mes tyre, që të jeni të bindur." - Allahu është Krijuesi, Sunduesi dhe Ai që përkujdeset për qiejt, Tokën e gjithçka mes tyre. Ai vepron në to ashtu sikurse dëshiron, me urtësinë dhe zotërimin e Tij të plotë. Kësisoj, nëse jeni të sigurt që Ai është Zoti i qiejve, i Tokës e i gjithçkaje mes tyre, atëherë duhet të pranoni edhe që Ai duhet të jetë i vetmi që duhet të adhurohet.

- "Nuk ka zot tjetër, veç Tij. Ai jep jetën dhe sjell vdekjen. Ai është Zoti juaj dhe Zoti i etërve tuaj të lashtë." – Kuptimi: Nuk ka të adhuruar me të drejtë dhe meritë veç Tij. Ai dhe vetëm Ai jep jetë dhe e merr atë. Jeta dhe vdekja janë vetëm në dorën e Tij. Është Ai që do t'ju ringjallë pas vdekjes tuaj, për t'ju marrë në llogari dhe për t'ju shpërblyer për veprat tuaja. Nëse keni punuar mirë, do t'ju shpërblejë me të mira, e nëse keni punuar keq, Ai do t'ju japë atë që meritoni, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij. Allahu është Zoti i të parëve dhe të fundit. Ai është përkujdesur për të parët dhe të fundit, duke u falur mirësi dhe duke i shpëtuar nga ligësitë.

Në këto ajete, Allahu i Madhëruar ripohon faktin se Ai është i vetmi Zot Krijues, Sundues, Mëshirues dhe Kujdestar i krijesave të Tij, prandaj duhet të jetë i vetmi i Adhuruar, të Cilit krijesat duhet t'i binden e nënshtrohen, në shenjë dashurie të thellë dhe madhërimi për Të. Këto janë fakte që duhet të sjellin siguri të plotë dhe të largojnë çdo dyshim. Këto ajete duhet të shuajnë çdo mëdyshje e pasiguri rreth të vërtetës së Zotit dhe njëshmërisë së Tij në çdo aspekt. Por me gjithë këto sqarime, mohuesit e Zotit përsëri janë në dyshime dhe të shkujdesur, siç thotë i Gjithëdijshmi:

- "Kurse ata dyshojnë e dëfrehen." - Ata sorollaten në dyshime e pasiguri. Ata as nuk mendojnë ndonjëherë për qëllimin e krijimit të tyre. Ata kanë humbur në argëtimet e kësaj dynjaje mashtruese.

- "Qëndro dhe prit ditën kur qielli të lëshojë një tym të qartë, që do t'i mbulojë njerëzit. Ky do të jetë një ndëshkim i dhimbshëm. "Zoti ynë (do të thonë ata)! Largoje dënimin prej nesh! Ne tashmë jemi besimtarë!"" - Kuptimi: Prit ndëshkimin që do t'u vijë, sepse koha e tij është afruar. Një tym do t'i gllabërojë të gjithë ata, të cilëve do t'u thuhet: "Ky është një ndëshkim i dhimbshëm".

Shpjeguesit e Kuranit kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të këtij tymi të dukshëm, që do të vijë si ndëshkim. Disa thonë se flitet për tymin që do të përfshijë kriminelët Ditën e Gjykimit, atëherë kur zjarri i Xhehenemit do t'u afrohet atyre. Me këtë kuptim, Allahu i Madhëruar i kërcënon ata me këtë ndëshkim, që do të ndodhë Ditën e Gjykimit dhe, njëkohësisht, e urdhëron Profetin e Tij që të presë me durim këtë ditë të vështirë për mohuesit. Ky kuptim është në përputhje me stilin e Kuranit, që vazhdimisht kërcënon mohuesit dhe na porosit që të bëjmë durim, derisa të vijë dita e ndëshkimit të tyre. Edhe ky ajet, nga njëra anë, kërcënon mohuesit me ndëshkimin e Ditës së Gjykimit, që ata të kthehen në rrugën e drejtë dhe, nga ana tjetër, qetëson Profetin (a.s) dhe besimtarët, duke i porositur ata që të jenë të durueshëm, se ndëshkimi i të padrejtëve, që i luftojnë dhe u shkaktojnë mundime, do të ndodhë patjetër dhe drejtësia do të vihet në vend.

Këtë mënyrë shpjegimi e përforcon edhe vazhdimi i këtij ajeti, që thotë:


- "E si mund të përfitojnë më ata nga këshillat, kur atyre u erdhi Profeti me mesazh të qartë, ndërsa ata i kthyen shpinën atij, duke thënë: "E kanë mësuar! Është i çmendur"." - Pa dyshim që këto fjalë u thuhen mohuesve në Ditën e Gjykimit, kur ata kërkojnë të kthehen sërish në dynja, por koha e pendimit ka përfunduar me vdekjen e tyre. Kështu, i tërë konteksti lidhet me Ditën e Gjykimit dhe ndëshkimet që do të përjetohen atë ditë.

Disa të tjerë janë të mendimit se këtu bëhet fjalë për atë që u ndodhi kurejshëve, kur ata refuzuan Muhamedin (a.s.) si profet të Zotit dhe fenë e sjellë prej tij. Për këtë shkak, ai (a.s.) u lut kundër tyre duke thënë: "O Allah! Më ndihmo kundër tyre, duke u dërguar vite vështirësie e thatësire, si vitet që dërgove në kohën e Jusufit (a.s.)!". Pas kësaj, Allahu i Madhëruar i goditi kurejshët me uri të madhe dhe mjerim, derisa filluan të hanin ngordhësira dhe kocka kafshësh. Aq shumë vuajtën nga uria, saqë po u dukej sikur mes qiellit dhe tokës kishte tym, edhe pse, në të vërtetë, nuk kishte asgjë. Në këtë rast, fjala e Allahut të Madhëruar: "Qëndro dhe prit ditën kur qielli të lëshojë një tym të qartë...." nënkupton se kjo do të ndodhë në dukje për sytë e tyre, jo në të vërtetë.

Gjendja e kurejshve vazhdoi e tillë, derisa i kërkuan Profetit të kishte mëshirë dhe ta luste Allahun e Madhëruar që ta largonte ndëshkimin nga ata. Profeti (a.s.) e luti Allahun e Madhëruar, i Cili e largoi urinë e mjerimin nga ata. Sipas këtij kuptimi, vjen edhe ajeti më pas:

- "Ne do t'jua largojmë dënimin për pak kohë, por ju do t'i ktheheni përsëri të kotës." - Por këto fjalë janë, në të njëjtën kohë, edhe kërcënim për ata që vazhdojnë në mosbesimin e tyre me mendjemadhësi ndaj të vërtetës.

Allahu i Madhëruar tregon, gjithashtu, se shumë nga ata do të ktheheshin përsëri në mosbesim, në rrugën e humbjes. Dhe, vërtet,


الجزء الخامس والعشرون سورة الدخان

وَأَن لَّا تَعْلُوا۟ عَلَى ٱللَّهِ ۖ إِنِّىٓ ءَاتِيكُم بِسُلْطَٰنٍ مُّبِينٍ ﴿١٩﴾ وَإِنِّى عُذْتُ
بِرَبِّى وَرَبِّكُمْ أَن تَرْجُمُونِ ﴿٢٠﴾ وَإِن لَّمْ تُؤْمِنُوا۟ لِى فَٱعْتَزِلُونِ ﴿٢١﴾
فَدَعَا رَبَّهُۥٓ أَنَّ هَٰٓؤُلَآءِ قَوْمٌ مُّجْرِمُونَ ﴿٢٢﴾ فَأَسْرِ بِعِبَادِى لَيْلًا إِنَّكُم
مُّتَّبَعُونَ ﴿٢٣﴾ وَٱتْرُكِ ٱلْبَحْرَ رَهْوًا ۖ إِنَّهُمْ جُندٌ مُّغْرَقُونَ ﴿٢٤﴾ كَمْ
تَرَكُوا۟ مِن جَنَّٰتٍ وَعُيُونٍ ﴿٢٥﴾ وَزُرُوعٍ وَمَقَامٍ كَرِيمٍ ﴿٢٦﴾ وَنَعْمَةٍ
كَانُوا۟ فِيهَا فَٰكِهِينَ ﴿٢٧﴾ كَذَٰلِكَ ۖ وَأَوْرَثْنَٰهَا قَوْمًا ءَاخَرِينَ ﴿٢٨﴾ فَمَا
بَكَتْ عَلَيْهِمُ ٱلسَّمَآءُ وَٱلْأَرْضُ وَمَا كَانُوا۟ مُنظَرِينَ ﴿٢٩﴾ وَلَقَدْ
نَجَّيْنَا بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ مِنَ ٱلْعَذَابِ ٱلْمُهِينِ ﴿٣٠﴾ مِن فِرْعَوْنَ ۚ إِنَّهُۥ
كَانَ عَالِيًا مِّنَ ٱلْمُسْرِفِينَ ﴿٣١﴾ وَلَقَدِ ٱخْتَرْنَٰهُمْ عَلَىٰ عِلْمٍ عَلَى
ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٣٢﴾ وَءَاتَيْنَٰهُم مِّنَ ٱلْءَايَٰتِ مَا فِيهِ بَلَٰٓؤٌا۟ مُّبِينٌ ﴿٣٣﴾
إِنَّ هَٰٓؤُلَآءِ لَيَقُولُونَ ﴿٣٤﴾ إِنْ هِىَ إِلَّا مَوْتَتُنَا ٱلْأُولَىٰ وَمَا نَحْنُ
بِمُنشَرِينَ ﴿٣٥﴾ فَأْتُوا۟ بِـَٔابَآئِنَآ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٣٦﴾ أَهُمْ
خَيْرٌ أَمْ قَوْمُ تُبَّعٍ وَٱلَّذِينَ مِن قَبْلِهِمْ ۚ أَهْلَكْنَٰهُمْ ۖ إِنَّهُمْ كَانُوا۟
مُجْرِمِينَ ﴿٣٧﴾ وَمَا خَلَقْنَا ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَٰعِبِينَ
﴿٣٨﴾ مَا خَلَقْنَٰهُمَآ إِلَّا بِٱلْحَقِّ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٣٩﴾

٤٩٧

ashtu ndodhi. Megjithatë, Allahu i Madhëruar paralajmëron për një ndëshkim tjetër të madh:

- "Ditën kur t'ju japim ndëshkimin e madh, atëherë do të hakmerremi!" - Sipas disave, ky dënim i madh ishte lufta e Bedrit. Sidoqoftë, ky mendim nuk është aq i pranueshëm dhe i qartë.

Disa komentues të tjerë janë të mendimit se në ajet flitet për njërën nga shenjat e Kijametit. Në fazën e fundit të kësaj bote do të dalë një tym, që do t'i mbysë të gjithë njerëzit, përveç besimtarëve, të cilët do t'i shqetësojë veçse pak, sikurse ndodh me një tym të zakonshëm.

Megjithatë, sipas një mendimi tjetër, në ajetin: "Qëndro dhe prit ditën kur qielli të lëshojë një tym të qartë..." bëhet fjalë për atë që do të ndodhë në Ditën e Gjykimit, ndërsa në ajetin: "Ne do t'jua largojmë dënimin për pak kohë, por ju do t'i ktheheni përsëri të kotës..." bëhet fjalë për ngjarjen që u ndodhi kurejshve, sikurse u tha më lart. Nëse ajetet i përmbajnë të dyja këto dy kuptime, nuk ka përse të mos i pranojmë të dyja. Ky shpjegim është tërësisht në harmoni me shkakun e Shpalljes. Gjithashtu, këtë unë e shoh si shpjegimin më të saktë, ndërkohë që Allahu është më i Dituri për gjithçka.

Ajetet 17 – 33

17. Përpara tyre, Ne sprovuam popullin e Faraonit, kur atyre u erdhi i dërguari i ndershëm.

18. "M'i lini mua (u tha ai) robërit e Allahut, sepse unë jam një i dërguar besnik për ju.

19. Mos u tregoni arrogantë ndaj Allahut, sepse unë po vij tek ju me shenja të qarta.

20. Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj, që ju të mos më vrisni me gurë.

21. Nëse nuk më besoni, atëherë distancohuni prej meje!"

22. Ai iu lut Zotit të vet (duke iu ankuar): "Këta janë vërtet kriminelë!".

23. "Bashkë me adhuruesit e Mi udhëtoni gjatë natës, sepse ata do t'ju ndjekin nga pas!

24. Lëre detin pas, ashtu si është, sepse ushtria e tyre do të përmbytet."

25. Sa e sa kopshte e burime lanë pas ata!

26. Sa ara të mbjella e vende të bukura!

27. Sa begati e stoli, në të cilat argëtoheshin!

28. Të gjitha ato, Ne ua lamë trashëgim një populli tjetër.

29. Për ta nuk vajtuan as qielli e as toka dhe as nuk iu dha afat!

30. Ne i shpëtuam bijtë e Israilit prej dënimit poshtërues,

31. prej Faraonit, i cili qe vërtet mizor dhe i shfrenuar!
32. Ne, me dije të plotë, i zgjodhëm ata ndër popujt e tjerë
33. e u dhamë shenja, të cilat ishin prova të qarta.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për ata që mohuan profetin e Tij, Muhamedin (a.s.), Allahu i Madhëruar tregon se edhe para tyre ka patur mohues të profetëve. Kështu, Ai rrëfen ngjarjen që i ndodhi Musait dhe mohuesve të tij. Në këtë histori kujtohet dënimi që goditi jobesimtarët e asaj kohe, në mënyrë që ata të kohës së Muhamedit (a.s.) të nxirrnin mësim dhe të mos vazhdonin me refuzimin e Profetit dhe të Shpalljes. I Madhëruari thotë:

- "Përpara tyre, Ne sprovuam popullin e Faraonit, kur atyre u erdhi i dërguari i ndershëm." – Kuptimi: Allahu i vuri në provë ata, duke u dërguar profetin Musa, të birin e Imranit, njërin nga më të nderuarit dhe më të zgjedhurit e profetëve të Tij, që ishte i shquar për fisnikëri të lartë.

- "M'i lini mua (u tha ai) robërit e Allahut..." - Musai i tha Faraonit dhe palës së tij: "Lirojini robërit e Allahut dhe lejojini të vijnë me mua." Këtu kishte për qëllim bijtë e Israilit. Ai po u kërkonte që t'i lironin, për t'i shpëtuar nga torturat dhe mundimet që u jepnin. Ata ishin familja e Musait dhe njerëzit më të mirë të kohës. Faraoni me njerëzit e vet ishin treguar të padrejtë ndaj tyre, duke i skllavëruar, munduar e torturuar. Musai (a.s.) kërkonte që ata të liroheshin, për të qenë të lirë të adhuronin Zotin e tyre.

- "...sepse unë jam një i dërguar besnik për ju." - Kuptimi: Unë jam profet i dërguar nga Zoti i botëve, besnik i Shpalljes, me të cilën Zoti më ngarkoi. Unë nuk ju fsheh asgjë nga Shpallja e Zotit, as nuk shtoj e as nuk pakësoj gjë prej saj.

Kjo duhet t'i bënte ata që ta pasonin Musain dhe t'u bindeshin porosive të tij.

- "Mos u tregoni arrogantë ndaj Allahut..." - Mos u tregoni kryeneçë, duke mos iu dorëzuar Allahut, dhe as dhunues të robërve të Allahut.

- "...sepse unë po vij tek ju me shenja të qarta." – Po vij me shenja të dallueshme lehtësisht, me mrekulli madhështore e fakte bindëse.
Ata përsëri e mohuan dhe tentuan ta vrisnin, por Musai kërkoi mbrojtje dhe strehim tek Allahu, për t'i ruajtur nga sherri i tyre. Ai tha:

- **"Unë i jam mbështetur Zotit tim dhe Zotit tuaj, që ju të mos më vrisni me gurë. Nëse nuk më besoni, atëherë distancohuni prej meje!"** - Kuptimi: Unë kërkoj mbrojtje te Zoti, që ju të mos më vrisni me formën më të keqe, që është vrasja me gurë. Ju keni këto mundësi: së pari, të më besoni dhe të pranoni ftesën time për adhurimin e Allahut, dhe ky është qëllimi im. Nëse nuk e pranoni këtë, atëherë mos më luftoni, por më lini të lirë.

Por ata i refuzuan të dyja alternativat. Ata vazhduan me kryelartësi duke refuzuar adhurimin e Allahut dhe duke luftuar profetin e Allahut, Musain (a.s). Madje, ata vendosën për të mos e lejuar Musain të largohej me popullin e tij, me bijtë e Israilit.

- "Ai iu lut Zotit të vet (duke iu ankuar): "Këta janë vërtet kriminelë!"." – Krimi i tyre e bënte të pashmangshëm përshpejtimin e ndëshkimit mbi ta.

Musai (a.s) u lut kundër Faraonit dhe rrethit të tij thjesht duke treguar gjendjen e tyre, dhe kjo është më domethënëse sesa lutja e drejtpërdrejtë. Po në këtë mënyrë, pra, thjesht duke përmendur gjendjen, Musai u lut edhe për veten e vet, kur tha: "O Zoti im, unë jam nevojtar për çdo mirësi që të më japësh!" [Kasas 24].

Më pas, Allahu i Madhëruar e urdhëroi që të nisej në udhëtim me robërit e Tij natën, duke e njoftuar se Faraoni do t'i ndiqte nga pas:

- **"Bashkë me adhuruesit e Mi udhëtoni gjatë natës, sepse ata do t'ju ndjekin nga pas! Lëre detin pas, ashtu si është, sepse ushtria e tyre do të përmbytet."** - Kur Musai (a.s.) u nis natën bashkë me bijtë e Israilit, ashtu sikurse Allahu e urdhëroi, nga pas iu vu Faraoni. Allahu i Madhëruar e urdhëroi Musain që ta godiste detin me shkopin e tij. Kur Musai e goditi detin, në të u hapën dymbëdhjetë shtigje, mes të cilave masat gjigande të ujit qëndronin si male të larta. Në këto shtigje kaluan Musai dhe populli i tij. Pasi ata kaluan të gjithë, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Musain që ta linte detin ashtu siç ishte, të hapur, që edhe Faraoni me ushtrinë e tij të hynin në të. Kur Faraoni me ushtrinë e tij hynë në shtigjet e hapura, Allahu i Madhëruar e urdhëroi detin që t'i mbulonte me ujin e tij, dhe ata u mbytën të gjithë, deri në ushtarin e fundit. Më pas, të gjitha ato pasuri që ata kishin patur në këtë dynja, Allahu i Madhëruar ua dha bijve të Israilit, që deri dje kishin qenë skllevër, siç thotë më pas:

- "Sa e sa kopshte e burime lanë pas ata! Sa ara të mbjella e vende të bukura! Sa begati e stoli, në të cilat argëtoheshin! Të gjitha ato, Ne ua lamë trashëgim një populli tjetër." – Kështu, i Madhëruari ua la ato të mira që t'i gëzonte një popull tjetër. Ndërsa në një ajet tjetër, Ai thotë: "Kështu, Ne ua lamë ato në trashëgim bijve të Israilit." [Shuara 59].

- "Për ta nuk vajtuan as qielli e as toka..." - Kur Allahu i Madhëruar e shkatërroi Faraonin me ushtrinë e tij, për ta nuk qanë as qielli e as toka. Askush nuk u shqetësua e nuk trishtua për largimin e tyre nga dynjaja. Madje, përkundrazi, çdo gjë u gëzua dhe u kënaq me shkatërrimin e tyre. Edhe qielli, edhe toka u kënaqën me këtë ndëshkim të drejtë të të Lartësuarit, sepse ata lanë pas vepra të këqija, që ua kishin nxirë fytyrat. Ata e bënë të merituesheëm mallkimin dhe derdhjen e zemërimit nga Zoti dhe nga e gjithë bota.

- "...dhe as nuk iu dha afat!" - Atyre nuk iu la afat, domethënë nuk iu shty ndëshkimi, por i përfshiu menjëherë.

Më pas, Allahu i Madhëruar u kujton bijve të Israilit mirësitë, kur thotë:

- "Ne i shpëtuam bijtë e Israilit prej dënimit poshtërues, prej Faraonit..." - Allahu i Madhëruar i shpëtoi ata nga vuajtja dhe poshtërimi, që Faraoni dhe pala e tij u bënë, duke u vrarë fëmijët meshkuj dhe duke ua lënë femrat të gjalla.

- "...i cili qe vërtet mizor dhe i shfrenuar!" – Faraoni ishte një arrogant i mbushur me

padrejtësi. Ai e kishte tepruar duke shkelur kufijtë e Zotit.

- "Ne, me dije të plotë, i zgjodhëm ata ndër popujt e tjerë..." - Allahu i Madhëruar na tregon se Ai i përzgjodhi dhe i dalloi bijtë e Israilit mbi të tjerët, me diturinë e Tij të plotë rreth tyre, dhe për faktin se ata e merituan një dallim të tillë. Ai i dalloi mbi njerëzit e tjerë të asaj kohe dhe të kohëve para e pas tyre. Kështu vazhdoi, derisa Allahu solli ymetin më të zgjedhur, në mënyrë të padiskutueshme, ymetin e Muhamedit (a.s.). Ky populli i kohës së fundit do të jetë populli më i zgjedhur i të gjitha kohëve, deri në Ditën e Gjykimit. Ata do të jenë populli më i mirë i nxjerrë për të mirën e njerëzimit, popull të cilit Zoti i ka dhuruar mirësi dhe begati, që nuk ua ka dhënë askujt prej popujve të tjerë të historisë njerëzore.

- "...e u dhamë shenja, të cilat ishin dëshmi e qartë." - Bijve të Israilit u dhanë shenja dhe mrekulli madhështore, të cilat ishin treguese të mirësisë dhe bujarisë së madhe të Allahut të Lartësuar. Ato ishin, gjithashtu, prova të padiskutueshme për vërtetësinë e Shpalljes që Musai përcillte, gjë e cila kërkon mirënjohje dhe përkushtim të plotë në adhurimin e Zotit si Një të vetëm.

Ajetet 34 – 37

34. Ata, me siguri, thonë:
35. "Ajo që ekziston është veçse vdekja jonë e parë, pasi ne nuk do të ringjallemi!
36. Përndryshe, na i sillni këtu etërit tanë, nëse thoni të vërtetën!"
37. A janë këta më të mirë se populli i Tubbeit apo se pararendësit e mëhershëm të tyre, të cilët Ne i shkatërruam?! Ata ishin vërtet kriminelë!

Shpjegimi i ajeteve


- "Ata, me siguri, thonë: "Ajo që ekziston është veçse vdekja jonë e parë, pasi ne nuk do të ringjallemi!" - Allahu i Madhëruar na tregon se mohuesit e ringjalljes dhe llogarisë para Zotit, thonë: "Ne jetojmë dhe vdesim në këtë botë. Më pas nuk ka ringjallje dhe shpërblim, nuk ka Xhenet dhe Xhehenem." Pastaj këta të mjerë, duke marrë guximin për të sfiduar Zotin e Madhërishëm, thonë:

- "Përndryshe, na i sillni këtu etërit tanë, nëse thoni të vërtetën!" - Të tilla janë kërkesat e kryeneçëve, që kanë humbur shumë larg së vërtetës. Po ç'lidhje ka mes vërtetësisë së një profeti dhe vënies së këtij kushti për t'i besuar atij ose jo?! Përse duhet ta kushtëzojnë pranimin e profetësisë me një shenjë të tillë?! Profetët e Zotit kanë sjellë shumë mrekulli, të cilat janë të mjaftueshme për t'i pranuar ata. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "A janë këta më të mirë se populli i Tubbeit apo se pararendësit e mëhershëm të tyre, të cilët Ne i shkatërruam?! Ata ishin vërtet kriminelë!" – Vallë, ata të cilëve u drejtohet ky ajet janë më të mirë se popujt që shkuan, të cilët Zoti i ndëshkoi, për shkak të refuzimit të profetëve dhe shpalljeve të Tij?! Kurrsesi nuk janë më të mirë se ata, sepse kanë bërë të njëjtin krim, prandaj le të presin të njëjtin ndëshkim si vëllezërit e tyre kriminelë e refuzues të së vërtetës.

Ajetet 38 – 42

38. Ne nuk i krijuam qiejt, Tokën dhe ç'ka ndërmjet tyre për t'u zbavitur.
39. Ne i krijuam ato veçse me një qëllim të caktuar, por shumica e tyre nuk dinë.


الجزء الخامس والعشرون سورة الدخان
إِنَّ يَوْمَ ٱلْفَصْلِ مِيقَٰتُهُمْ أَجْمَعِينَ ﴿٤٠﴾ يَوْمَ لَا يُغْنِى مَوْلًى
عَن مَّوْلًى شَيْـًٔا وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤١﴾ إِلَّا مَن رَّحِمَ ٱللَّهُ
إِنَّهُۥ هُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلرَّحِيمُ ﴿٤٢﴾ إِنَّ شَجَرَتَ ٱلزَّقُّومِ ﴿٤٣﴾ طَعَامُ
ٱلْأَثِيمِ ﴿٤٤﴾ كَٱلْمُهْلِ يَغْلِى فِى ٱلْبُطُونِ ﴿٤٥﴾ كَغَلْىِ
ٱلْحَمِيمِ ﴿٤٦﴾ خُذُوهُ فَٱعْتِلُوهُ إِلَىٰ سَوَآءِ ٱلْجَحِيمِ ﴿٤٧﴾ ثُمَّ
صُبُّوا۟ فَوْقَ رَأْسِهِۦ مِنْ عَذَابِ ٱلْحَمِيمِ ﴿٤٨﴾ ذُقْ إِنَّكَ
أَنتَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْكَرِيمُ ﴿٤٩﴾ إِنَّ هَٰذَا مَا كُنتُم بِهِۦ تَمْتَرُونَ
﴿٥٠﴾ إِنَّ ٱلْمُتَّقِينَ فِى مَقَامٍ أَمِينٍ ﴿٥١﴾ فِى جَنَّٰتٍ وَعُيُونٍ
﴿٥٢﴾ يَلْبَسُونَ مِن سُندُسٍ وَإِسْتَبْرَقٍ مُّتَقَٰبِلِينَ ﴿٥٣﴾
كَذَٰلِكَ وَزَوَّجْنَٰهُم بِحُورٍ عِينٍ ﴿٥٤﴾ يَدْعُونَ فِيهَا بِكُلِّ
فَٰكِهَةٍ ءَامِنِينَ ﴿٥٥﴾ لَا يَذُوقُونَ فِيهَا ٱلْمَوْتَ إِلَّا
ٱلْمَوْتَةَ ٱلْأُولَىٰ ۖ وَوَقَىٰهُمْ عَذَابَ ٱلْجَحِيمِ ﴿٥٦﴾ فَضْلًا مِّن
رَّبِّكَ ۚ ذَٰلِكَ هُوَ ٱلْفَوْزُ ٱلْعَظِيمُ ﴿٥٧﴾ فَإِنَّمَا يَسَّرْنَٰهُ بِلِسَانِكَ
لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ ﴿٥٨﴾ فَٱرْتَقِبْ إِنَّهُم مُّرْتَقِبُونَ ﴿٥٩﴾
سورة الجاثية
٤٩٨

40. S'ka dyshim se Dita e Kijametit është premtimi i pakthyeshëm për të gjithë.
41. Atë ditë, miku nuk mund ta ndihmojë dot mikun, por as veten nuk do mund ta ndihmojë,
42. përveç atyre që Allahu i ka mëshiruar. Pa dyshim, Ai është Ngadhënjyesi e Mëshirëploti.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne nuk i krijuam qiejt, Tokën dhe ç'ka ndërmjet tyre për t'u zbavitur. Ne i krijuam ato veçse me një qëllim të caktuar..."** – Duke treguar se Ai nuk i krijoi qiejt dhe Tokën kot dhe pa qëllim, Allahu i Madhëruar dëshmon rreth pushtetit të Tij absolut dhe për urtësinë e Tij të plotë. Ai i krijoi ato veçse për një qëllim të madh: për të qenë dëshmuese të së vërtetës. Allahu i Madhëruar e solli këtë botë në ekzistencë që krijesat ta adhurojnë Atë si Një, të Vetëm dhe të Pashoq, që t'i urdhërojë robërit dhe t'i ndalojë ata, që t'i shpërblejë e t'i ndëshkojë, sipas asaj që meritojnë.

- **"...por shumica e tyre nuk dinë."** - Prandaj nuk mendojnë thellë mbi qëllimin e krijimit të qiejve dhe të Tokës.

- **"S'ka dyshim se Dita e Kijametit është premtimi i pakthyeshëm për të gjithë. Atë ditë, miku nuk mund ta ndihmojë dot mikun, por as veten nuk do mund ta ndihmojë..."** - Dita e ndarjes dhe dallimit, Dita e Gjykimit me drejtësi mes të parëve dhe të fundit, mes kundërshtarëve të njëri-tjetrit, është dita e premtuar, kur do të grumbullohen të gjithë njerëzit. Allahu i Madhëruar do t'i grumbullojë të gjithë dhe do t'u paraqesë veprat e tyre. Në bazë të këtyre veprave, do të jetë edhe shpërblimi e ndëshkimi me drejtësi. Askush nuk mund t'i vijë në ndihmë tjetrit, as i dashuri të dashurve, as i afërmi të afërmve, as miku mikut. Askush nuk do të ndihmohet që të mund t'i shpëtojë ndëshkimit të Allahut të Drejtë, Krenar e të Lartësuar, sepse asnjë krijesë nuk zotëron ndonjë grimë pushteti dhe mundësie. Të vetmit të shpëtuar dhe të ruajtur do të jenë ata që Zoti ka mëshiruar, siç thotë Ai:

- **"...përveç atyre që Allahu i ka mëshiruar. Pa dyshim, Ai është Ngadhënjyesi e Mëshirëploti."** - Këta përfitojnë thjesht nga mëshira e Zotit, për të cilën janë përpjekur në dynja që ta arrijnë. Ata kanë punuar në dynja që të hyjnë në mëshirën e Zotit, duke zbatuar ato vepra e fjalë që Zoti i ka bërë si mundësi për të fituar mëshirën e Tij.

Më pas, i Lartësuari thotë:

Ajetet 43 – 50

43. Është e vërtetë se pema e Zekumit,
44. do të jetë ushqim i keqbërësve.
45. Si tunxh i shkrirë, ajo u vlon në bark,
46. ashtu sikurse vlon uji i nxehtë.
47. "Rrëmbejeni atë dhe flakeni në mes të Zjarrit!
48. Pastaj, mbi kokën e tij derdhni ujin e valë të ndëshkimit!"
49. Shijoje këtë tani, t'i që ishe ai i forti e fisniku!
50. Ky është ai që e vinit në dyshim!

Shpjegimi i ajeteve

Në ajetet e mësipërme, Allahu i Madhëruar na foli rreth Ditës së Gjykimit, e cila është një e vërtetë e padiskutueshme, duke na treguar që Ai do të gjykojë me drejtësi, duke bërë ndarjen mes të gjithë krijesave. Atë ditë, krijesat do të ndahen në dy grupe: një për në Xhenet dhe një për në Xhehenemin e ndezur fort. Këta të fundit do të jenë gjynahqarët, që kanë bërë vepra kufri dhe nuk i janë bindur Zotit. Nëse pyet për ushqimin e tyre, Allahu thotë:

- "Është e vërtetë se pema e Zekumit, do të jetë ushqim i keqbërësve. Si tunxh i shkrirë, ajo u vlon në bark, ashtu sikurse vlon uji i nxehtë. "Rrëmbejeni atë dhe flakeni në mes të Zjarrit! Pastaj, mbi kokën e tij derdhni ujin e valë të ndëshkimit!"" - Zekumi është pema më e tmerrshme. Frutat e saj janë si qelbi i pështirë. Era dhe shija e tyre janë të llahtarshme. Ushqimi që del prej kësaj peme është aq i nxehtë, saqë do të vlojë brenda barkut ku futet, ashtu si vlon uji i nxehtë. Të ndëshkuarve do t'u thuhet:

- "Shijoje këtë tani, t'i që ishe ai i forti e fisniku!" - Shijojeni këtë ndëshkim të dhembshëm dhe poshtërues. Ju pretendonit se ishit të pamposhtur, fisnikë e se nuk do të ndëshkoheshit kurrë. Tani mësojeni mirë se nuk jeni të pamposhtur e krenarë, por jeni të poshtëruar, të nënçmuar dhe të pavlerë!

- "Ky është ai që e vinit në dyshim!" - Ky është ndëshkimi i madh, rreth të cilit ju kishit dyshime, pasi ju dukej i pavërtetë. Sot do ta kuptoni plotësisht se ai është një e vërtetë e padiskutueshme.

Ajetet 51 – 59

51. Vërtet, ata që i druhen Zotit, do të jenë në një vend të sigurt,
52. me kopshte mirësie e me burime të rrjedhshme.
53. Do të veshin rroba mëndafshi të hollë dhe të trashë e do të qëndrojnë ulur ballë për ballë njëri-tjetrit.
54. Ja, kështu do të jetë! Ne do t'i martojmë ata me hyri symëdha.
55. Atje do kërkojnë që t'ju sjellin çdo lloj frute. Atje do të ndihen të sigurt.
56. Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë. Ai i ka ruajtur prej vuajtjeve të Xhehenemit.
57. Kjo është dhuratë nga Zoti yt. Kjo është fitorja e madhe!
58. Ne ua bëmë të lehtë atë në gjuhën tënde, që të mund të përkujtojnë.
59. Prandaj t'i prit, se edhe ata janë duke pritur.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, ata që i druhen Zotit, do të jenë në një vend të sigurt, me kopshte mirësie e me burime të rrjedhshme." - Ky është shpërblimi i të devotshmëve, të cilët i ruhen

zemërimit dhe ndëshkimit të Allahut të Madhëruar. Ata zbatojnë urdhrat dhe nuk cenojnë kufijtë e Tij. Të gjitha këto i kryejnë me sinqeritet për Krijuesin e tyre dhe sipas traditës së Profetit të Tij. Për këtë meritojnë jo vetëm shpëtimin nga zemërimi dhe ndëshkimi i Zotit, por edhe shpërblime të mëdha. Allahu i Madhëruar është i kënaqur me ta, prandaj u dhuron begati të pafundme. Ata do të pushojnë të lumtur nën hije të dendura, mes pemëve plot fruta, pranë burimeve gurgulluese të mrekullueshme e çlodhëse. Lumenjtë do të rrjedhin pranë ndërtesave e kopshteve të tyre dhe kudo ku ata i dëshirojnë që të jenë.
I Madhëruari i ka përshkruar kopshtet e Xhenetit si "kopshte mirësie", për të treguar se çdo gjë në to është e mrekullueshme dhe lumturisjellëse. Kopshtet e atjeshme janë vetë mirësia, në çdo aspekt, dhe nuk mund të cenohen nga asgjë e keqe, që mund të dëmtonte sadopak atë mrekulli.

- **"Do të veshin rroba mëndafshi të hollë dhe të trashë e do të qëndrojnë ulur ballë për ballë njëri-tjetrit."** - Veshjet e tyre do të jenë prej mëndafshi jeshil, të punuar trashë ose hollë, ashtu si e dëshirojnë. Kështu do të qëndrojnë përballë njëri-tjetrit, tërësisht të kënaqur, të qetë e të rehatuar, të mbushur me dashuri, me komunikim të këndshëm dhe edukatë të lartë.
Mes këtyre mirësive të plota dhe kënaqësive të mrekullueshme, Allahu i Madhëruar do t'i martojë ata me gra të bukura dhe të hijshme, shumë tërheqëse dhe të dashura. Ai thotë:

- "Ja, kështu do të jetë! Ne do t'i martojmë ata me hyri symëdha." - Ato janë aq tërheqëse, saqë sytë mbërthehen tek ato dhe nuk shqiten më prej tyre. Teksa i vështron, mendja turbullohet dhe frymëmarrja shpeshtohet. Ato janë të përkryera dhe të magjepsin me çdo detaj të bukurisë së tyre. Allahu i Madhëruar i ka cilësuar si 'hyri symëdha', sepse sytë e tyre janë të mëdhenj dhe shumë të bukur.

- **"Atje do kërkojnë që t'ju sjellin çdo lloj frute. Atje do të ndihen të sigurt."** - Atje ata do të kërkojnë fruta, të cilat kanë nga një shembull përkatës në dynja, por edhe fruta që nuk kanë shembull në dynja. Sa herë që dëshirojnë ndonjë lloj frute, ajo u serviret pa lodhje dhe pa vështirësi. Kur të shijojnë këto mirësi, ata do të jenë - ashtu sikurse i përshkruan Allahu i Lartësuar – të sigurt, të patrazuar nga meraku apo frika se kjo gjendje ndoshta do të përfundojë. Ata janë të sigurt, gjithashtu, nga frika se mos dëbohen jashtë atyre mirësive apo se mos u vjen sërish vdekja, siç thotë i Madhëruari më pas:

- **"Atje nuk do ta provojnë më vdekjen, përveç vdekjes së parë. Ai i ka ruajtur prej vuajtjeve të Xhehenemit."** - Atje nuk do të provojnë më vdekje, kurrën e kurrës, sepse përndryshe i Madhëruari nuk do ta përjashtonte vdekjen e provuar në jetën e dynjasë. Me këtë përgëzim, mirësitë mbi ta do të përkryhen, pasi për ta do të jetë e përjetshme çdo gjë të cilën ata e pëlqejnë.

- **"Kjo është dhuratë nga Zoti yt."** – Të gjitha mirësitë e dhëna dhe ruajtja nga ndëshkimi janë thjesht mëshirë, bujari e dhuratë nga Allahu i Madhëruar. Është Allahu i Madhëruar Ai që i mëson të bëjnë vepra të mira dhe të sinqerta, nëpërmjet të cilave arrihen mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit. Është po Ai që, pastaj, i shpërblen

dhe u dhuron mirësi, të cilat nuk mund t'i mendojnë kurrë apo t'i arrijnë me forcat e tyre.

- "Kjo është fitorja e madhe!" - E ku ka fitore më të madhe se arritja e kënaqësisë së Allahut, futja në Xhenetin e bujarisë së Tij, si dhe shpëtimi nga zemërimi dhe dënimi i Allahut.


- "Ne ua bëmë të lehtë atë në gjuhën tënde, që të mund të përkujtojnë." - Allahu e lehtësoi përfitimin prej Kuranit, duke e shpallur në gjuhën arabe, e cila është absolutisht gjuha më shprehëse, më e pasur dhe më e bukura e të gjitha gjuhëve. Ai lehtësoi shqiptimin dhe këndimin e Kuranit, ashtu siç lehtësoi edhe të kuptuarit e tij. I Madhëruari e bëri këtë, sikurse thotë: "...që të mund të përkujtojnë". Pra, të përkujtojnë porositë e Tij, duke kryer ato gjëra që Ai ka urdhëruar dhe duke u ruajtur nga ato gjëra që Ai i ka ndaluar.

- "Prandaj t'i prit, se edhe ata janë duke pritur." - Kuptimi: Ti prit, se do ta shohësh fitoren që Zoti të ka premtuar, e t'i do të lumturohesh. Edhe ata le të presin, se do ta shikojnë shpejt ndëshkimin, që do t'i godasë ashpër.

Pra, ka ndryshim të madh mes këtyre dy pritjeve. Profeti i Zotit dhe pasuesit e rrugës së tij presin të mirën në dynja dhe në ahiret. Ndërsa kundërshtarët e tyre presin të keqen dhe dëshpërimin e madh në dynja dhe në ahiret.

Këtu përfundon edhe tefsiri i sures Duhan. Falënderimi dhe mirënjohja e plotë i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar!

Surja 45: El Xhathije (mekase) 37 ajete


الجزء الخامس والعشرون سورة الجاثية

بسم الله الرحمن الرحيم

حم ﴿١﴾ تنزيل الكتاب من الله العزيز الحكيم ﴿٢﴾ إن في السموات
والأرض لآيات للمؤمنين ﴿٣﴾ وفي خلقكم وما يبث من دابة آيات
لقوم يوقنون ﴿٤﴾ واختلاف الليل والنهار وما أنزل الله من السماء
من رزق فأحيا به الأرض بعد موتها وتصريف الرياح آيات لقوم
يعقلون ﴿٥﴾ تلك آيات الله نتلوها عليك بالحق فبأي حديث بعد
الله وآياته يؤمنون ﴿٦﴾ ويل لكل أفاك أثيم ﴿٧﴾ يسمع آيات
الله تتلى عليه ثم يصر مستكبرا كأن لم يسمعها فبشره بعذاب أليم
﴿٨﴾ وإذا علم من آياتنا شيئا اتخذها هزوا أولئك لهم عذاب
مهين ﴿٩﴾ من ورائهم جهنم ولا يغني عنهم ما كسبوا شيئا
ولا ما اتخذوا من دون الله أولياء ولهم عذاب عظيم ﴿١٠﴾ هذا
هدى والذين كفروا بآيات ربهم لهم عذاب من رجز أليم ﴿١١﴾
* الله الذي سخر لكم البحر لتجري الفلك فيه بأمره ولتبتغوا
من فضله ولعلكم تشكرون ﴿١٢﴾ وسخر لكم ما في السموات وما في
الأرض جميعا منه إن في ذلك لآيات لقوم يتفكرون ﴿١٣﴾

الجزء ٥٠

٤٩٩

Ajetet 1 – 11

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. *Ha, Mim.*

2. **Zbritja e Librit është prej Allahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit!**

3. **Vërtet, në qiej dhe në Tokë ka plot shenja për besimtarët.**

4. **Edhe në krijimin tuaj dhe të gjallesave të kudogjendura ka fakte për njerëzit me bindje.**

5. **Edhe në shkëmbimin e natës me ditën, në reshjet që Allahu lëshon prej qiellit, si furnizim dhe si gjallërues të tokës pas vdekjes së saj, ashtu edhe në lëvizjen e erërave ka fakte për njerëzit me logjikë.**

6. **Këto janë faktet e Allahut, të cilat po t'i lexojmë me korrektësi. Atëherë, çfarë fjale tjetër, veç fjalës së Allahut dhe fakteve të Tij, besojnë ata?!**

7. **Mjerë për çdo gënjeshtar e gjynahqar të madh,**
8. **që i dëgjon faktet e Allahut kur i lexohen, e pastaj vazhdon sërish të tregohet mendjemadh, sikur nuk i ka dëgjuar ato. Paralajmëroji të tillët për vuajtje të rënda.**
9. **Kur dëgjojnë faktet Tona, ata i trajtojnë me tallje. Të tillët do të kenë një dënim poshtërues.**
10. **Përpara tyre ndodhet Xhehenemi. Atyre nuk do t'u bëjnë aspak dobi ato që kanë grumbulluar dhe as ata të cilëve iu kërkojnë ndihmë në vend të Allahut. Ata do të vuajnë një dënim të ashpër.**
11. **Ky është udhëzim i plotë. Ndërsa ata që nuk i pranojnë faktet e Zotit të tyre, i pret një dënim poshtërues dhe i mundimshëm.**

Shpjegimi i ajeteve

- "*Ha, Mim.* Zbritja e Librit është prej Allahut, të Gjithëfuqishmit, të Urtit!" - Allahu i Madhëruar na tregon disa cilësi të mrekullueshme të Kuranit, duke na urdhëruar indirekt për t'i dhënë rëndësinë, përkushtimin dhe respektin që meriton. Kurani është Libër i zbritur nga Allahu i Gjithëditur, i Cili është i vetmi i adhuruar me meritë. Vetëm Ai meriton të duhet me gjithë shpirt, të madhërohet dhe të lavdërohet. Emrat dhe atributet e Tij janë të mrekullueshme dhe absolute. Ai është i vetmi që i ka në dorë të gjitha mirësitë e i vetmi që i dhuron ato. Ai është i Gjithëfuqishmi dhe Atij i takon urtësia e plotë.

Kurani është Shpallje e këtij Zoti të Madhërishëm, i Cili është i vetmi që meriton adhurimin, dashurinë dhe që t'i nënshtrohesh. Ky fakt përforcohet në ajetet më pas, ku Allahu i Madhëruar përmend shenjat që mund të dallohen në natyrë dhe në vetet tona. Ai thotë:

- "Vërtet, në qiej dhe në Tokë ka plot shenja për besimtarët. Edhe në krijimin tuaj dhe të gjallesave të kudogjendura ka fakte për njerëzit me bindje. Edhe në shkëmbimin e natës me ditën, në reshjet që Allahu lëshon prej qiellit, si furnizim dhe si gjallërues të tokës pas vdekjes së saj, ashtu edhe në lëvizjen e erërave ka fakte për njerëzit me logjikë." - Krijimi i qiejve, i Tokës dhe i gjallesave të shpërndara në to, dobitë dhe mirësitë e tyre për jetën, shiu që zbret nga qielli, me të cilin gjallërohet toka dhe jetojnë krijesat, të gjitha këto, pra, janë shenja të qarta, të kuptueshme dhe të pakundërshtueshme, që tregojnë për madhështinë e Kuranit dhe për faktin se ai është Shpallje e të Allahut të Madhërishëm. Ato dëshmojnë, gjithashtu, për vërtetësinë e çdo fjale, informacioni, mesazhi e dispozite që gjendet në të. Ato dëshmojnë se Allahu i Madhëruar është i Plotë dhe Absolut në çdo drejtim, në emrat, cilësitë dhe atributet e Tij. Por ato pohojnë edhe të vërtetën e ringjalljes dhe të llogarisë së drejtë para Krijuesit.

- "Këto janë faktet e Allahut, të cilat po t'i lexojmë me korrektësi. Atëherë, çfarë fjale tjetër, veç fjalës së Allahut dhe fakteve të Tij, besojnë ata?!" - Allahu i Madhëruar na tregon se, në lidhje me të përfituarit ose jo nga faktet e Kuranit, njerëzit ndahen në dy grupe:
1. Ata që mendojnë thellë rreth këtyre fakteve, duke kuptuar domosdoshmërinë e besimit në Allahun e Lartësuar. Ata përfitojnë shumë nga udhëzimi i Allahut, duke e ngritur veten lart. Ata e besojnë plotësisht Allahun e Madhëruar, ashtu si edhe melekët e Tij, shpalljet e Tij, profetët e

Tij dhe Ditën e Gjykimit. Besimi i tyre është i plotë, larg çdo dyshimi. Nëpërmjet Kuranit dhe fakteve të Allahut të shfaqura në krijimin e Tij, shpirtrat e tyre pastrohen dhe dituria iu shtohet.

2. Ata të grupit tjetër i dëgjojnë faktet e Allahut, por i shpërfillin menjëherë ato, prandaj nuk do të kenë më asnjë justifikim para Zotit. Ata e shpërfillin të vërtetën, sikur të mos e kenë dëgjuar atë. Faktet e Allahut nuk i prekin zemrat e tyre dhe nuk i pastrojnë ato. Përkundrazi, për shkak të mendjemadhësisë që kanë, ato ua shtojnë edhe më shumë shfrenimin në kalimin e kufijve. Ata, kur dëgjojnë ndonjë fakt të Allahut, e marrin me tallje. Por i Madhëruari i kërcënon këta, duke thënë:

- **"Mjerë për çdo gënjeshtar e gjynahqar të madh, që i dëgjon faktet e Allahut kur i lexohen, e pastaj vazhdon sërish të tregohet mendjemadh, sikur nuk i ka dëgjuar ato. Paralajmëroji të tillët për vuajtje të rënda. Kur dëgjojnë faktet Tona, ata i trajtojnë me tallje. Të tillët do të kenë një dënim poshtërues."** - I Madhëruari i përshkruan këta të mjerë me dy cilësi: "*effak*" - gënjeshtarë në fjalë dhe "*ethim*" - gjynahqarë në vepra. Çdokush që ka këto cilësi kërcënohet se do të ketë një ndëshkim të dhimbshëm. Për të kuptuar këtë ndëshkim, mjafton të thuhet se ata i pret Xhehenemi, siç thotë i Lartësuari më pas:

- **"Përpara tyre ndodhet Xhehenemi. Atyre nuk do t'u bëjnë aspak dobi ato që kanë grumbulluar dhe as ata të cilëve iu kërkojnë ndihmë në vend të Allahut. Ata do të vuajnë një dënim të ashpër."** - Atyre nuk do t'u bëjnë dobi pasuritë që kanë fituar në botë dhe as miqtë apo zotat, të cilëve iu luten e kërkojnë mbështetje. Ata do t'u kërkojnë ndihmë, por idhujt e tyre do t'i lënë në baltë në momentet më të nevojshme.

Pasi foli për shenjat e Tij të sjella në Kuran, për dëshmitë që gjenden në krijimin e Tij dhe për faktin që njerëzit ndahen në dy grupe, në lidhje me përfitimin apo jo prej shenjave të Tij, Allahu i Madhëruar pohon një tjetër fakt të rëndësishëm: Kurani i përmban të gjitha qëllimet e larta, të cilat çdo njeri duhet të përpiqet që t'i arrijë, dhe është udhëzues i qartë për arritjen e mirësive të dynjasë dhe të ahiretit. Kështu, i Madhëruari thotë:

- **"Ky është udhëzues i plotë."** – Këtu bëhet një përshkrim i përgjithshëm i Kuranit. Ky libër na udhëzon duke na mundësuar njohjen e Allahut të Madhëruar, me cilësitë e Tij të mrekullueshme dhe të pastra nga çdo mangësi, si dhe me veprat e Tij të lavdëruara. Kurani na mundëson njohjen e profetëve të Allahut, të të dashurve e të zgjedhurve të Tij, si dhe na prezanton qartë armiqtë e Tij, duke bërë një përshkrim të plotë të secilit grup. Ai udhëzon drejt punëve të mira dhe inkurajon për kryerjen e tyre, ashtu siç na qartëson se cilat janë vepra të këqija dhe na ndalon nga ato. Kurani na tregon me detaje se si do të jetë shpërblimi për veprat e robërve, në këtë dynja dhe në ahiret.

Të udhëzuarit që përfitojnë nga mësimet e Kuranit, do të gjejnë lumturinë, ndërsa ata që nuk i pranojnë mësimet e tij i pret diçka tjetër:

- **"Ndërsa ata që nuk i pranojnë faktet e Zotit të tyre, i pret një dënim poshtërues dhe i mundimshëm."** - Për ata që mohojnë faktet e Zotit, të cilat janë të qarta e të prera,

është përgatitur një ndëshkim poshtërues dhe i dhembshëm, sepse ato fakte i mohojnë veçse të shfrenuarit në tejkalimin e kufijve të Zotit.

Ajetet 12 – 13

12. Allahu është Ai që nënshtroi detin për ju, në mënyrë që mbi të, me lejen e Tij, të lundrojnë anijet. Kështu ju mund të kërkoni prej mirësive të Tij dhe të jeni mirënjohës.
13. Për ju, Ai nënshtroi gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë; të gjitha janë prej Tij. Pa dyshim, në to ekzistojnë fakte për njerëzit që mendojnë thellë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahu është Ai që nënshtroi detin për ju, në mënyrë që mbi të, me lejen e Tij, të lundrojnë anijet." - Allahu i Lartësuar na tregon për disa mirësi, që Ai u ka dhuruar robërve të Tij. Është Ai që, me ligjet fizike që ka vendosur, u ka bërë të mundur atyre të lëvizin në det me anije. Më pas, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Kështu ju mund të kërkoni prej mirësive të Tij dhe të jeni mirënjohës." – Kështu mund të arrini të realizoni shumë të mira, siç është edhe tregtia, prandaj të jeni mirënjohës ndaj Allahut të Lartësuar. Nëse tregoni mirënjohje ndaj Tij, Ai ka për t'jua shtuar mirësitë që ju ka dhuruar dhe, veç kësaj, do t'ju shpërblejë për mirënjohjen tuaj.

- "Për ju, Ai nënshtroi gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë; të gjitha janë prej Tij." - Të gjitha janë thjesht mirësi prej bujarisë së Allahut. Qiejt e lartë dhe gjithçka që gjendet në to: Dielli, Hëna, yjet, planetet etj., që lëvizin sipas një ligji të mrekullueshëm apo që qëndrojnë pa lëvizur; Toka, me gjithë botën bimore e shtazore të saj, me larminë e kafshëve, pemëve, frutave, mineraleve etj., të gjitha janë prej Allahut dhe janë krijuar për të mirën e njerëzve. Për këtë arsye, këto mirësi duhet të jenë nxitje për njerëzit, që ata të japin maksimumin për të shprehur mirënjohjen ndaj Zotit të tyre. Ata duhet të meditojnë gjatë rreth shenjave dhe gjykimeve të Tij, siç thotë i Madhëruari:

- "Pa dyshim, në to ekzistojnë fakte për njerëzit që mendojnë thellë."- Krijimi madhështor i gjithësisë, nënshtrimi i saj ndaj vullnetit të të Madhërishmit, përkujdesja dhe administrimi i saj nga Zoti dhe Krijuesi i saj, dëshmojnë për pushtetin absolut dhe për vullnetin e padiskutueshëm të Tij. Rregullsia, bukuria, hijeshia dhe përsosmëria e gjithsësisë dëshmojnë për diturinë dhe urtësinë absolute të Allahut. Madhështia e kësaj gjithësie, si dhe krijesat e shumta të shpërndara në të, tregojnë për madhështinë e mbretërimit, sundimit dhe pushtetit të Krijuesit të saj. Ndërsa funksionimi i të kundërtave në këtë gjithësi tregojnë se Ai vepron çfarë dëshiron. Dobitë e shumta fetare, apo që kanë lidhje me këtë dynja, të cilat Zoti i ka vendosur në këtë gjithësi, tregojnë për mëshirën e Tij të gjerë, për bamirësinë dhe bujarinë e Tij gjithëpërfshirëse, për butësinë dhe përkujdesjen e Tij të pashembullt. Të gjitha këto tregojnë se Allahu është i vetmi i Adhuruar me të drejtë. Vetëm Atij i duhet përkushtuar çdo adhurim, duke i shprehur dashurinë, madhërimin, nënshtrimin e përkushtimin e plotë. Ato tregojnë gjithashtu se profetët e Zotit kanë thënë të vërtetën dhe e kanë përcjellë mesazhin e Tij me besnikëri. Ky arsyetim logjik është i


padiskutueshëm në saktësinë dhe vërtetësinë e tij. Mbështetja në faktet e krijimit të mrekullueshëm të Allahut të Lartësuar u jep besimtarëve siguri të plotë në besim dhe largon prej tyre çdo dyshim rreth faktit se Ai është i vetmi i Adhuruar me meritë.

Ajetet 14 – 15

14. Thuaju besimtarëve që t'i durojnë ata që nuk presin takimin me Allahun, që Ai vetë t'i dënojë njerëzit për shkak të veprave që bëjnë.
15. Kush bën vepra të mira, bën për vete, e kush bën keq, bën kundër vetes. Në fund, te Zoti juaj do të ktheheni!

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaju besimtarëve që t'i durojnë ata që nuk presin takimin me Allahun, që Ai vetë t'i dënojë njerëzit për shkak të veprave që bëjnë." - Allahu i Madhëruar i urdhëron adhuruesit e Tij besimtarë që të pajisen me moral të lartë, duke u bërë të durueshëm përballë mundimeve që u sjellin idhujtarët, të cilët nuk shpresojnë takimin me Allahun dhe llogarinë e drejtë para Tij. Ata nuk shpresojnë shpërblimin e Allahut dhe ndëshkimet që Ai premton për të pabindurit, por Allahu i Lavdëruar do ta shpërblejë çdo njeri sipas asaj që ka bërë me duart e veta. Besimtarët e Tij të dashur do t'i shpërblejë pa masë për imanin, tolerancën dhe durimin e tyre. Edhe nëse jobesimtarët vazhdojnë me mohimin e tyre të shpalljeve dhe të profetëve të Zotit, veprat dhe mosbesimi i tyre nuk do t'i dëmtojë aspak besimtarët. Ndëshkimi i dhimbshëm dhe poshtërimi do të godasë veçse mbi ta, siç thotë i Madhëruari më pas:


الجزء الخامس والعشرون سورة الجاثية
قُل لِّلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ يَغْفِرُوا۟ لِلَّذِينَ لَا يَرْجُونَ أَيَّامَ ٱللَّهِ لِيَجْزِىَ
قَوْمًۢا بِمَا كَانُوا۟ يَكْسِبُونَ ﴿١٤﴾ مَنْ عَمِلَ صَٰلِحًا فَلِنَفْسِهِۦ ۖ
وَمَنْ أَسَآءَ فَعَلَيْهَا ۖ ثُمَّ إِلَىٰ رَبِّكُمْ تُرْجَعُونَ ﴿١٥﴾ وَلَقَدْ ءَاتَيْنَا
بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ ٱلْكِتَٰبَ وَٱلْحُكْمَ وَٱلنُّبُوَّةَ وَرَزَقْنَٰهُم مِّنَ ٱلطَّيِّبَٰتِ
وَفَضَّلْنَٰهُمْ عَلَى ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿١٦﴾ وَءَاتَيْنَٰهُم بَيِّنَٰتٍ مِّنَ ٱلْأَمْرِ ۖ
فَمَا ٱخْتَلَفُوٓا۟ إِلَّا مِنۢ بَعْدِ مَا جَآءَهُمُ ٱلْعِلْمُ بَغْيًۢا بَيْنَهُمْ ۚ إِنَّ رَبَّكَ
يَقْضِى بَيْنَهُمْ يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ فِيمَا كَانُوا۟ فِيهِ يَخْتَلِفُونَ
﴿١٧﴾ ثُمَّ جَعَلْنَٰكَ عَلَىٰ شَرِيعَةٍ مِّنَ ٱلْأَمْرِ فَٱتَّبِعْهَا وَلَا تَتَّبِعْ
أَهْوَآءَ ٱلَّذِينَ لَا يَعْلَمُونَ ﴿١٨﴾ إِنَّهُمْ لَن يُغْنُوا۟ عَنكَ مِنَ ٱللَّهِ
شَيْـًٔا ۚ وَإِنَّ ٱلظَّٰلِمِينَ بَعْضُهُمْ أَوْلِيَآءُ بَعْضٍ ۖ وَٱللَّهُ وَلِىُّ ٱلْمُتَّقِينَ
﴿١٩﴾ هَٰذَا بَصَٰٓئِرُ لِلنَّاسِ وَهُدًى وَرَحْمَةٌ لِّقَوْمٍ يُوقِنُونَ ﴿٢٠﴾
أَمْ حَسِبَ ٱلَّذِينَ ٱجْتَرَحُوا۟ ٱلسَّيِّـَٔاتِ أَن نَّجْعَلَهُمْ كَٱلَّذِينَ
ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ سَوَآءً مَّحْيَاهُمْ وَمَمَاتُهُمْ ۚ سَآءَ
مَا يَحْكُمُونَ ﴿٢١﴾ وَخَلَقَ ٱللَّهُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ بِٱلْحَقِّ
وَلِتُجْزَىٰ كُلُّ نَفْسٍۭ بِمَا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ ﴿٢٢﴾
٥٠٠

- "Kush bën vepra të mira, bën për vete, e kush bën keq, bën kundër vetes. Në fund, te Zoti juaj do të ktheheni!"

Ajetet 16 – 17

16. Ne u dhamë bijve të Israilit Librin, pushtetin për të gjykuar njerëzit dhe profetësinë. Ne i furnizuam ata me të mira, duke i dalluar mbi të gjithë botën.
17. U dhamë edhe fakte të qarta për çështjet fetare. Por edhe pse iu dha dituria, ata u përçanë, dhe kjo për shkak të zilisë që kishin ndërmjet tyre. Nuk ka dyshim se, Ditën e Kijametit, Zoti yt do të gjykojë mes tyre për çdo gjë që ata janë përçarë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne u dhamë bijve të Israilit Librin, pushtetin për të gjykuar njerëzit dhe

profetësinë." – Zoti u dhuroi bijve të Israilit mirësi e begati, që nuk i ishin dhënë asnjë populli më parë. Ai u dha Librin, domethënë Teuratin dhe Ungjillin, u dha pushtetin për të gjykuar njerëzit, si dhe profetësinë, me të cilën ata u dalluan nga popujt e tjerë. Madje, në atë kohë, profetësia ishte e kufizuar pikërisht te pasardhësit e Ibrahimit (a.s.). Gjithashtu, ndër mirësitë me të cilat u dalluan ata ishin edhe furnizimet e veçanta me ushqime, pije, veshje etj., siç qe për shembull zbritja e *el menn*-it dhe *el selua*-s nga qielli, gjatë udhëtimit të tyre dyzetvjeçar në shkretëtirë.

- "Ne i furnizuam ata me të mira, duke i dalluar mbi të gjithë botën." - Me mirësitë e dhuruara, Ata u dalluan mbi të gjithë botën. Por, sigurisht, nga ky përgjithësim përjashtohet ymeti i fundit, ai i Muhamedit (s.a.u.s.), që është ymeti më i mirë i të gjitha kohërave. Vetë konteksti i ajeteve tregon se aty nuk përfshihet ymeti i Muhamedit (a.s). Ato flasin për mirësitë që Zoti u dhuroi bijve të Israilit, duke i dalluar mbi popujt e tjerë. Por me shfaqjen e Muhamedit, pasuesit e këtij të fundit u bënë populli më i mirë i nxjerrë ndonjëherë për të mirën e njerëzimit. Gjithashtu, mirësitë që iu dhuruan bijve të Israilit, si Libri hyjnor, pushteti për të gjykuar, profetësia dhe të gjitha mirësitë e tjera, i Lartësuari ia dha edhe ymetit të fundit, por duke u shtuar edhe mirësi të tjera, që nuk i kishin të tjerët. Sheriati i mrekullueshëm që iu dhurua këtij ymeti, është universal, ndërsa sheriatet e popujve të shkuar kanë qenë thjesht një pjesë e tij. Kurani, gjithashtu, është siguruesi i vërtetësisë së shpalljeve të mëparshme. Ndërsa Muhamedi (s.a.u.s) ishte vërtetuesi e përforcuesi i të gjithë profetëve të kaluar.

- "U dhamë edhe fakte të qarta për çështjet fetare." - Zoti u dha bijve të Israilit fakte të qarta dhe të padiskutueshme, nëpërmjet të cilave ata mund të dallonin të vërtetën nga e kota dhe të gjenin rrugën e drejtë. Këto fakte u përforcuan më tepër me mrekulli të shumta, që Zoti ua shfaqi atyre në duart e Musait (a.s.). Kështu, të gjitha këto mrekulli dhe argumente të qarta duhej t'i nxisin ata që të bashkoheshin rreth të vërtetës, për të zbatuar porositë e sjella nga profeti i Zotit. Por ata u sollën krejtësisht kundër asaj që pritej dhe që ishte detyrë për ta. Ata filluan të përçaheshin pikërisht rreth asaj të vërtete, siç thotë i Madhëruari:

- "Por edhe pse iu dha dituria, ata u përçanë, dhe kjo për shkak të zilisë që kishin ndërmjet tyre." - Dija që iu dhurua atyre duhej t'i bënte që të mos kishin mospajtime, por padrejtësia kundrejt njëri-tjetrit i përçau keq e më keq.

- "Nuk ka dyshim se, Ditën e Kijametit, Zoti yt do të gjykojë mes tyre për çdo gjë që ata janë përçarë." - Allahu i Lavdëruar do ta qartësojë të vërtetën nga e kota dhe do t'i dallojë mbrojtësit e të vërtetës nga mbrojtësit e të kotës. Gjithashtu, Ai do të zbulojë edhe shkakun që i shtyu ata të përçaheshin, siç është ndjekja e epshit apo diçka tjetër.

Ajetet 18 – 19

18. Më pas, Ne të udhëzuam ty në rrugën e drejtë të fesë, prandaj t'i ndiq atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë.
19. Ata nuk mund të të mbrojnë prej Allahut. Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse Allahu është mbrojtësi i besimtarëve të devotshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Më pas, Ne të udhëzuam ty në rrugën e drejtë të fesë..." – Kuptimi: Më pas, Ne të dhamë ty një fe të plotë e të mrekullueshme, që udhëzon tek e mira dhe ndalon nga e keqja. Ne të shpallëm një ligj të drejtë, prandaj zbatoje rigorozisht, sepse zbatimi i tij sjell lumturinë e përjetshme, sjell arritjen e çdo të mire dhe shpëtimin nga çdo e keqe, në dynja dhe në ahiret.

- "...prandaj t'i ndiq atë e mos ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë." - Kurrë mos iu bind atyre! Synimet e tyre nuk udhëhiqen nga dituria dhe nuk ngrihen sipas saj. Mos paso ata që kundërshtojnë rrugën e profetëve, kushdo qofshin ata! Çdokush apo çdo gjë që fton në kundërshtimin e Zotit dhe profetëve, është kundërshtues i rrugës së drejtë, prandaj nuk duhet ndjekur, qofshin këto edhe dëshirat vetjake.

- "Ata nuk mund të të mbrojnë prej Allahut." – Prej tyre nuk keni ndonjë favor te Zoti. Ata as nuk mund t'ju ndihmojnë për mirë dhe as nuk mund t'ju mbrojnë nga ndonjë e keqe. Edhe nëse ndiqni rrugën e tyre, ata nuk do t'ju trajtojnë si veten. Ju përsëri do të jeni të huaj për ata, sepse ata janë miq dhe aleatë të njëri-tjetrit. Mohimi juaj thjesht ju largon nga Zoti juaj dhe nuk ju sjell asnjë dobi. Ata janë miq e aleatë të njëri-tjetrit, ndërsa Allahu është miku dhe ndihmëtari i besimtarëve të devotshëm.

- "Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse Allahu është mbrojtësi i besimtarëve të devotshëm." - Allahu i nxjerr besimtarët nga errësirat në dritë, për shkak të devotshmërisë ndaj Tij. Kjo devotshmëri shprehet me plotësimin e urdhrave, largimin nga haramet dhe ruajtjen të paprekur të kufijve të Allahut, në shenjë dashurie, madhërimi e nënshtrimi ndaj Tij.

Ajeti 20

20. Ky është ndriçues, udhëzues e mëshirë për njerëzit që besojnë me siguri të plotë.

Shpjegimi i ajetit

Ky Kuran është dritë dhe udhërrëfyes për njerëzit. Tek ai njerëzit gjejnë udhëzime të qarta për të gjitha çështjet. Nëpërmjet këtyre udhëzimeve, besimtarët përfitojnë shumë mirësi për dynjanë dhe ahiretin e tyre. Kurani tregon se ç'është e mirë dhe ç'është e keqe. Ai është mëshirë e dhuruar nga Zoti i Madhërishëm.

Kurani është i tillë jo për çdo njeri, por, ashtu sikurse thotë i Madhëruari: "...për njerëzit që besojnë me siguri të plotë", për ata që besojnë çfarë duhet besuar dhe që janë të sigurt në vërtetësinë e Shpalljes së Zotit. Nëpërmjet Shpalljes së Zotit, të cilën e besojnë pa asnjë dyshim, ata arrijnë të shohin dhe të ecin në rrugën e drejtë. Nëpërmjet saj, ata shohin të vërtetën, në lidhje jo vetëm me boshtin kryesor të fesë, por edhe me degëzimet e saj. Kështu, ata arrijnë të bëjnë për vete dhe të ruajnë çdo mirësi dhe gëzim, duke siguruar lumturinë e tyre në dynja dhe në ahiret.

Kjo Shpallje, për ata që e besojnë me siguri të plotë, është tërësisht ashtu sikurse e përshkruan Allahu i Urtë, i Lavdëruar dhe i Mëshirshëm: "ndriçues, udhëzues e mëshirë". Nëpërmjet saj, zemrat e tyre pastrohen dhe ndriçohen, ndërsa mendjet e tyre lartësohen dhe fuqizohen. Me zbatimin

rigoroz të Kuranit, siguria për vërtetësinë e tij shtohet edhe më shumë.

Ndërsa për kryeneçët, të cilët ndjekin pasionet e tyre, sepse i parapëlqejnë ato kundrejt kësaj mëshire të dhuruar, Kurani është dëshpërim, sepse për ta është shuar çdo justifikim para Zotit. Ata nuk do të mund të justifikohen para Zotit për mosbesimin dhe mosdorëzimin e tyre.

Ajeti 21

21. A mos mendojnë ata që e teprojnë me të këqija, se do t'i trajtojmë si të barabartë me ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, si në jetë, edhe vdekje?! Sa i ulët është ky gjykim i tyre?!

Shpjegimi i ajetit

- "A mos mendojnë ata që e teprojnë me të këqija, se do t'i trajtojmë si të barabartë me ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, si në jetë, edhe vdekje?! – Kuptimi: Vallë, a mos mendojnë keqbërësit, që e teprojnë me gjynahe, se Allahu do t'i trajtojë ata njëlloj si besimtarët e sinqertë, që bëjnë vepra të mira?! E si mund të trajtohen njëlloj mosmirënjohësit me njerëzit e zgjedhur, të cilët punojnë sinqerisht që të plotësojnë të drejtat e Zotit të tyre dhe, me shumë kujdes, largohen nga çdo gjë që zemëron Zotin e tyre?! Si mund të trajtohen njëlloj të shfrenuarit në epshet dhe dëshirat e tyre me ata fatlumë që i japin gjithmonë përparësi kënaqësisë së Zotit, kundrejt dëshirave të tyre të padrejta?!

Le të jenë të sigurt se kriminelët nuk do të gjykohen dhe trajtohen njëlloj me besimtarët, në dynja apo në ahiret qoftë. Nëse mendojnë ndryshe, atëherë e kanë tërësisht gabim, siç thotë i Madhëruari:

- "Sa i ulët është ky gjykim i tyre?!" - Shumë e gabuar dhe e keqe është ajo që mendojnë. Ajo është tërësisht në kundërshtim me gjykimin e më të Urtit, më të Diturit dhe më të Drejtit, që është Allahu i Lartësuar. Madje, gjykimi i tyre është në kundërshtim edhe me logjikën e shëndoshë dhe me natyrën e pastër të njeriut. Ai është në kundërshtim me të gjitha shpalljet e Zotit dhe mesazhin e tyre, ashtu siç bie ndesh me mësimet e urta të të gjithë profetëve të dërguar nga Zoti.

Le ta dinë ata, se gjykimi i padiskutueshëm i Zotit ka vendosur që besimtarët, të cilët besojnë drejt, sipas dijes së saktë e të sigurt nga Zoti, por edhe që punojnë me sinqeritet sipas atij besimi dhe asaj diturieje, ata kanë premtimin nga Zoti se do të arrijnë suksesin e sigurt. Premtimi i pakthyeshëm për ta është lumturia dhe shpërblimet e shumta në dynja dhe në ahiret. Secili do të shpërblehet sipas bamirësisë së vet.

Ndërsa punëkëqijtë do t'i godasë zemërimi i Zotit, prandaj do të vuajnë poshtërimin, ndëshkimin, dhimbjen dhe dëshpërimin në dynja dhe në ahiret.

Ajeti 22


22. Allahu i ka krijuar qiejt dhe Tokën me urtësi të plotë, me qëllim që çdo njeri të shpërblehet për veprat e veta. Atyre nuk do t'u bëhet padrejtësi.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar i ka krijuar qiejt dhe Tokën me urtësi të madhe. Ai i krijoi njerëzit dhe xhindët që ta adhurojnë Atë si Një, të Vetëm dhe të Pashoq, dhe pastaj t'i shpërblejë ata sipas punëve që kanë bërë.

Me bamirësinë dhe drejtësinë e Tij, Ai do të shpërblejë të ngarkuarit me detyra, duke u dhënë mirësi të shumta, të dukshme e të fshehta. Por së pari, të gjithë do të japin llogari para Allahut të Madhëruar: a kanë qenë mirënjohës ndaj Tij, duke zbatuar urdhëresat dhe duke iu larguar ndalesave, apo kanë qenë mosmirënjohës, duke treguar mospërfillje për detyrimet ndaj Zotit dhe ndaj krijesave, duke merituar në këtë mënyrë ndëshkimin që është përgatitur për mohuesit.

Ajetet 23 – 26


الجزء الخامس والعشرون سورة الجاثية

أَفَرَءَيْتَ مَنِ ٱتَّخَذَ إِلَٰهَهُۥ هَوَىٰهُ وَأَضَلَّهُ ٱللَّهُ عَلَىٰ عِلْمٍ وَخَتَمَ عَلَىٰ سَمْعِهِۦ
وَقَلْبِهِۦ وَجَعَلَ عَلَىٰ بَصَرِهِۦ غِشَٰوَةً فَمَن يَهْدِيهِ مِنۢ بَعْدِ ٱللَّهِ ۚ أَفَلَا
تَذَكَّرُونَ ﴿٢٣﴾ وَقَالُوا۟ مَا هِىَ إِلَّا حَيَاتُنَا ٱلدُّنْيَا نَمُوتُ وَنَحْيَا وَمَا يُهْلِكُنَآ
إِلَّا ٱلدَّهْرُ ۚ وَمَا لَهُم بِذَٰلِكَ مِنْ عِلْمٍ ۖ إِنْ هُمْ إِلَّا يَظُنُّونَ ﴿٢٤﴾ وَإِذَا تُتْلَىٰ
عَلَيْهِمْ ءَايَٰتُنَا بَيِّنَٰتٍ مَّا كَانَ حُجَّتَهُمْ إِلَّآ أَن قَالُوا۟ ٱئْتُوا۟ بِـَٔابَآئِنَآ إِن
كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٢٥﴾ قُلِ ٱللَّهُ يُحْيِيكُمْ ثُمَّ يُمِيتُكُمْ ثُمَّ يَجْمَعُكُمْ إِلَىٰ
يَوْمِ ٱلْقِيَٰمَةِ لَا رَيْبَ فِيهِ وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ ٱلنَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٢٦﴾ وَلِلَّهِ مُلْكُ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَيَوْمَ تَقُومُ ٱلسَّاعَةُ يَوْمَئِذٍ يَخْسَرُ ٱلْمُبْطِلُونَ ﴿٢٧﴾
وَتَرَىٰ كُلَّ أُمَّةٍ جَاثِيَةً ۚ كُلُّ أُمَّةٍ تُدْعَىٰٓ إِلَىٰ كِتَٰبِهَا ٱلْيَوْمَ تُجْزَوْنَ مَا كُنتُمْ
تَعْمَلُونَ ﴿٢٨﴾ هَٰذَا كِتَٰبُنَا يَنطِقُ عَلَيْكُم بِٱلْحَقِّ ۚ إِنَّا كُنَّا نَسْتَنسِخُ
مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿٢٩﴾ فَأَمَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ
فَيُدْخِلُهُمْ رَبُّهُمْ فِى رَحْمَتِهِۦ ۚ ذَٰلِكَ هُوَ ٱلْفَوْزُ ٱلْمُبِينُ ﴿٣٠﴾ وَأَمَّا
ٱلَّذِينَ كَفَرُوٓا۟ أَفَلَمْ تَكُنْ ءَايَٰتِى تُتْلَىٰ عَلَيْكُمْ فَٱسْتَكْبَرْتُمْ وَكُنتُمْ قَوْمًا
مُّجْرِمِينَ ﴿٣١﴾ وَإِذَا قِيلَ إِنَّ وَعْدَ ٱللَّهِ حَقٌّ وَٱلسَّاعَةُ لَا رَيْبَ فِيهَا
قُلْتُم مَّا نَدْرِى مَا ٱلسَّاعَةُ إِن نَّظُنُّ إِلَّا ظَنًّا وَمَا نَحْنُ بِمُسْتَيْقِنِينَ ﴿٣٢﴾

٥٠١

23. A e ke parë atë që, me vetëdije, egon e vet e konsideron si Zot?! Allahu, me urtësinë e Tij, e ka humbur atë nga rruga e drejtë, ia ka bllokuar të dëgjuarit dhe zemrën, dhe mbi sytë e tij ka vënë perde. Tani, përveç Allahut, kush tjetër mund ta udhëzojë atë?! A nuk e kuptoni?!

24. Ata thonë: "Nuk ka jetë tjetër, veç jetës sonë në këtë botë. Ne vdesim dhe jetojmë dhe asgjë tjetër nuk na shkatërron, përveç kohës." Ata nuk kanë asnjë lloj diturie për këtë, por vetëm hamendësojnë.

25. Kur atyre u lexohen faktet Tona të qarta, reagimi i tyre i vetëm është: "Ringjallini prindërit tanë, nëse thoni të vërtetën!"

26. Thuaju: "Allahu jua jep jetën dhe më pas ju bën të vdisni. Pastaj, Ai do t'ju grumbullojë Ditën e Kijametit, për të cilën nuk ka dyshime, por shumica e njerëzve nuk kuptojnë".

Shpjegimi i ajeteve

- "A e ke parë atë që, me vetëdije, egon e vet e konsideron si Zot?!" – Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar na flet për ata njerëz, të cilët si Zot të tyre, që e adhurojnë, iu binden dhe i nënshtrohen, nuk konsiderojnë Allahun e Madhëruar, por dëshirat e veta të pakontrolluara. Ata ndjekin egon e vet, pa u shqetësuar në e kënaqin Allahun apo e zemërojnë Atë. Këta lloj njerëzish Allahu i Gjithëdijshëm, me urtësinë dhe diturinë e Tij absolute mbi krijesat, i ka lënë në humbje. Ai i ka lënë në humbje, sepse, me diturinë e Tij, ka gjykuar drejt që ata nuk e meritojnë udhëzimin, sepse nuk i plotësojnë kushtet për ta patur atë.

- "Allahu, me urtësinë e Tij, e ka humbur atë nga rruga e drejtë, ia ka bllokuar të dëgjuarit dhe zemrën, dhe mbi sytë e tij ka vënë perde." - Atyre që adhurojnë dëshirat e veta dhe shpërfillin adhurimin e Allahut, u është bllokuar dhe vulosur dëgjimi, prandaj nuk mund të dëgjojnë atë që u bën dobi. Ata nuk mund të kuptojnë drejt të mirën, për ta pranuar atë. Edhe në shikimin e tyre ka

perde, që i pengon të shohin të vërtetën. Të tillët nuk mund të udhëzohen më, nëse Allahu i Madhëruar nuk i udhëzon. Ata që Allahu i Gjithëditur, i Urtë dhe i Drejtë ua ka mbyllur rrugët e udhëzimit, duke u hapur dyert e humbjes, për shkak të padrejtësisë së tyre e jo të Allahut, askush nuk mund t'i udhëzojë. Ky ndëshkim është tërësisht i merituar për ata zullumqarë të vetvetes, të cilët nuk e pranojnë ftesën e Zotit, duke e privuar veten nga rruga e mirësisë dhe e të vërtetës.

- "Tani, përveç Allahut, kush tjetër mund ta udhëzojë atë?! A nuk e kuptoni?!" - A nuk e kuptoni se çfarë ju bën mirë, që të punoni ta arrini atë. A nuk e kuptoni se çfarë ju bën keq, që të përpiqeni të ruheni prej saj? Mohuesit e ringjalljes dhe të llogarisë para Zotit thonë:

- "Ata thonë: "Nuk ka jetë tjetër, veç jetës sonë në këtë botë. Ne vdesim dhe jetojmë dhe asgjë tjetër nuk na shkatërron, përveç kohës."" – Kuptimi: Ajo që ndikon tek ne është thjesht koha, gjatë së cilës disa njerëz vdesin e disa të tjerë lindin. Kështu ka qenë dhe kështu do të vazhdojë; ky është një proces i pandalshëm. Nuk ka ditë ringjalljeje, kur njerëzit të kthehen sërish të gjallë e të llogariten për veprat e tyre.

Por këto fjalë të tyre nuk mbështeten në dije, por në hamendësime të largëta. I Madhëruari thotë:

- "Ata nuk kanë asnjë lloj diturie për këtë, por vetëm hamendësojnë." - Ata thjesht hamendësojnë për të mohuar ringjalljen, duke hedhur poshtë fjalët e profetëve besnikë, të pajisur me fakte e mrekulli. Ata nuk kanë asnjë provë që justifikon hedhjen poshtë të mesazhit të profetëve. Si mund të hidhen poshtë fjalët e profetëve të mbështetur nga Zoti me mrekulli të mëdha, thjesht me hamendësime, me arsyetime të kota ose me kërkesa të çuditshme! Prandaj i Madhëruari thotë:

- "Kur atyre u lexohen faktet Tona të qarta, reagimi i tyre i vetëm është: "Ringjallini prindërit tanë, nëse thoni të vërtetën!"" - Kjo është paturpësia dhe padrejtësia e tyre ndaj Zotit të gjithësisë. Ata pretendojnë që vërtetësia e mesazhit të profetëve mund të pranohet vetëm nëse ata do të sillnin atë shenjë që kërkojnë ata. Me fjalë të tjera, edhe sikur profetët të sillnin çdo lloj shenje të fuqishme, ajo duhet të konsiderohet e pamjaftueshme që ata të besojnë. Kështu pretendojnë ata, por dihet që kjo është thjesht një gënjeshtër, një justifikim për të mohuar të vërtetën. Qëllimi i tyre, siç kuptohet, është thjesht refuzimi i ftesës së profetëve, e jo arritja tek e vërteta.

- **"Thuaju: "Allahu jua jep jetën dhe më pas ju bën të vdisni. Pastaj, Ai do t'ju grumbullojë Ditën e Kijametit, për të cilën nuk ka dyshime, por shumica e njerëzve nuk kuptojnë"."** - Nëse bindja rreth Ditës së Gjykimit do të arrinte në zemrat e tyre, ata do të fillonin të përgatiteshin mirë për të.

Ajetet 27 - 37

27. Vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës! Atë ditë, kur të vijë Ora, polemizuesit do të dëshpërohen shumë.
28. Çdo popull do ta shohësh të gjunjëzuar. Çdo popull thirret tek Libri i vet. Sot do të shpërbleheni për ato që keni vepruar.

29. **Ky është libri Ynë, që dëshmon të vërtetën. Ne kemi kërkuar të shkruhet gjithçka që ju vepronit.**

30. **Për sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t'i pranojë ata në mëshirën e Vet. Ky është suksesi më i madh!**

31. **Për sa u përket atyre që nuk besojnë: "A nuk ju janë lexuar shpalljet e Mia?! Por ju tregonit arrogancë dhe u bëtë të këqij!"**

32. **Edhe kur ju thuhej: "Premtimi i Allahut është i saktë! Ora do të vijë dhe për të s'ka dyshim", ju përgjigjeshit: "Ne nuk e dimë se ç'është kjo Ora! Ne mendojmë se është vetëm një hamendje dhe nuk jemi të bindur!"**


33. **Atyre do t'u dalin në shesh të këqijat që kanë bërë dhe do t'i përfshijë ai me të cilin talleshin.**

34. **Atyre do t'u thuhet: "Sot po ju lëmë të harruar, ashtu sikurse ju e harruat takimin e kësaj dite. Vendi juaj është Zjarri dhe nuk ka se kush t'ju shpëtojë!**

35. **Kjo ndodh, për shkak se ju u tallët me shpalljet e Allahut dhe u mashtruat me jetën e dynjasë." Atë ditë nuk do të nxirren prej tij e as nuk do t'u kërkohet që të kthehen.**

36. **Falënderimi dhe lavdia e plotë i qoftë vetëm Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të Tokës, Zotit të gjithësisë!**

37. **Vetëm Atij i takon gjithë madhështia në qiej e në Tokë. Ai është Ngadhënjyesi e i Urti.**


الجزء السادس والعشرون سورة الأحقاف

وَبَدَا لَهُمْ سَيِّـَٔاتُ مَا عَمِلُوا۟ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُوا۟ بِهِۦ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٣٣﴾ وَقِيلَ ٱلْيَوْمَ نَنسَىٰكُمْ كَمَا نَسِيتُمْ لِقَآءَ يَوْمِكُمْ هَٰذَا وَمَأْوَىٰكُمُ ٱلنَّارُ وَمَا لَكُم مِّن نَّٰصِرِينَ ﴿٣٤﴾ ذَٰلِكُم بِأَنَّكُمُ ٱتَّخَذْتُمْ ءَايَٰتِ ٱللَّهِ هُزُوًا وَغَرَّتْكُمُ ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَا ۚ فَٱلْيَوْمَ لَا يُخْرَجُونَ مِنْهَا وَلَا هُمْ يُسْتَعْتَبُونَ ﴿٣٥﴾ فَلِلَّهِ ٱلْحَمْدُ رَبِّ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَرَبِّ ٱلْأَرْضِ رَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٣٦﴾ وَلَهُ ٱلْكِبْرِيَآءُ فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿٣٧﴾

سورة الأحقاف

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الجزء ٢٦ الربع ٥١

حمٓ ﴿١﴾ تَنزِيلُ ٱلْكِتَٰبِ مِنَ ٱللَّهِ ٱلْعَزِيزِ ٱلْحَكِيمِ ﴿٢﴾ مَا خَلَقْنَا ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَآ إِلَّا بِٱلْحَقِّ وَأَجَلٍ مُّسَمًّى ۚ وَٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ عَمَّآ أُنذِرُوا۟ مُعْرِضُونَ ﴿٣﴾ قُلْ أَرَءَيْتُم مَّا تَدْعُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ أَرُونِى مَاذَا خَلَقُوا۟ مِنَ ٱلْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ ۖ ٱئْتُونِى بِكِتَٰبٍ مِّن قَبْلِ هَٰذَآ أَوْ أَثَٰرَةٍ مِّنْ عِلْمٍ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٤﴾ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُوا۟ مِن دُونِ ٱللَّهِ مَن لَّا يَسْتَجِيبُ لَهُۥٓ إِلَىٰ يَوْمِ ٱلْقِيَٰمَةِ وَهُمْ عَن دُعَآئِهِمْ غَٰفِلُونَ ﴿٥﴾

٥٠٢

Shpjegimi i ajeteve

- **"Vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës! Atë ditë, kur të vijë Ora, polemizuesit do të dëshpërohen shumë."** - Allahu i Madhëruar na tregon për pushtetin dhe mbretërimin e Tij të gjerë, si dhe për faktin se Ai është i vetëm në administrimin, rregullimin e çështjeve dhe përkujdesjen për botën, në çdo moment. Gjithashtu, Ai na tregon se edhe në Ditën e Kijametit, Ai është i Plotfuqishmi. Ai do t'i mbledhë krijesat dhe të gjithë do të qëndrojnë para Krijuesit të tyre.

Atë ditë, *mubtilun*-ët do të dëshpërohen kur të shohin ndëshkimin që i pret. Këta janë ata që polemizojnë për të hedhur poshtë të vërtetën, pa patur asnjë argument të drejtë. Veprat e mira të këtyre janë të pavlefshme dhe jo të shpërblyeshme, prandaj Ditën e Gjykimit ato do të asgjësohen, sepse janë të ndërtuara mbi të kotën. Atë ditë do të dalë në pah e vërteta. Ndërsa e kota, të cilën ata e mbrojnë, do të tretet para syve të tyre, duke i lënë në dëshpërimin e humbjes së mirësive të Zotit dhe në ndëshkimin e rëndë për refuzimin e të vërtetës.

Pastaj Allahu i Madhëruar përshkruan tmerrin dhe vështirësitë e Ditës së madhe të

Kijametit, për t'i bërë robërit që t'i druhen asaj dhe të përgatiten me adhurime e përkushtime në punë të mbara. Kështu, i Madhëruari thotë:

- "Çdo popull do ta shohësh të gjunjëzuar." - Çdo njeri të sjellë në këtë botë do ta shohësh në gjunjë, të tmerruar e duke pritur në ankth gjykimin dhe vendimin e Mbretëruesit të Gjithëmëshirshëm.

- "Çdo popull thirret tek Libri i vet. Sot do të shpërbleheni për ato që keni vepruar." - Çdo popull do të pyetet për Shpalljen hyjnore që profeti i tyre u ka përcjellë nga Zoti. Ata do të merren në llogari: a e kanë pranuar dhe zbatuar atë, për të përfituar shpërblimin dhe shpëtimin nga ndëshkimi? Apo e kanë shpërfillur atë, duke merituar ndëshkimin dhe humbjen e mirësive të premtuara nga Zoti? Për shembull, ymeti i Musait (a.s) do të thirret të japë llogari në lidhje me Shpalljen e Musait. Ymeti i Isait do të japë llogari për Shpalljen e Isait (a.s), ashtu si edhe ymeti i Muhamedit (a.s.) do të llogaritet për Shpalljen e Muhamedit (a.s). Pra, çdo popull do të pyetet në lidhje me Librin hyjnor me të cilin është ngarkuar që ta besojë dhe ta zbatojë. Ky është njëri nga shpjegimet e ajetit, i cili është, pa dyshim, një kuptim i saktë.

Por ka, gjithashtu, mundësi që fjala "*libri*" në ajet të ketë kuptimin 'libri i veprave". Në këtë mënyrë, çdo njeri do të gjykohet sipas shënimeve në librin e veprave, ku janë regjistruar të gjitha veprat e tij të mira apo të këqija. Çdokush do të shpërblehet sipas veprave që ka bërë vetë, sikurse thotë i Madhëruari në suren Fusilet, ajeti 46: "Kush bën mirë, e bën mirë për veten e vet, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes së vet. Zoti yt nuk bën padrejtësi ndaj robërve."

Por ka mundësi që ajeti t'i përmbajë të dyja këto kuptime, të cilat nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Këtë e mbështet edhe ajeti në vijim:

- "Ky është libri Ynë, që dëshmon të vërtetën." - Ky është libri Ynë, të cilin Ne e shpallëm për t'ju qartësuar të vërtetën dhe për t'ju përshkruar drejtësinë që Zoti do të vendosë mes krijesave. Pastaj thotë:

- "Ne kemi kërkuar të shkruhet gjithçka që ju vepronit." - Ja ku flitet edhe për librin e veprave.

Më pas, i Madhëruari sjell gjykimin e Tij të drejtë në lidhje me dy grupet e njerëzve, sipas trajtimit që ata i kanë bërë librit hyjnor, të shpallur nga Ai, dhe sipas veprave të regjistruara në librin e gjithësecilit. Kështu, i Allahu i Madhëruar thotë:

- "Për sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t'i pranojë ata në mëshirën e Vet." - Ata që besojnë me besim të saktë të ndërtuar mbi dituri të saktë dhe të vërtetë nga Zoti dhe veç kësaj e vërtetuan sinqeritetin e besimit të tyre me punë të mira për të cilat nxit ky besim, punë të detyrueshme apo vullnetare e të pëlqyeshme, këta Zoti do t'i fusë në mëshirën e Tij, vendi i të cilës është Xheneti. Mëshira e Zotit është në Xhenet dhe atje të lumturit dhe të përjetojnë çdo mirësi të dhuruar nga mëshira e Allahut të lavdëruar mirësi e lumturi që do të vazhdojë e pafundme në përjetësi. Aty do të jetojnë një jetë të lumtur dhe të sigurt nga çdo e keqe e shqetësim.

- "Ky është suksesi më i madh!" - Kjo është fitorja, shpëtimi dhe arritja e çdo mirësije. Ai është suksesi i qartë, i dukshëm dhe i vërtetë, sukses i cili nëse arrihet nga robi ose më sakt nëse i dhurohet robit, atëherë ai ka arritur çdo të mirë dhe ka shpëtuar nga çdo e keqe.

- "Për sa u përket atyre që nuk besojnë..." - Këtyre u drejtohen fjalë për t'i dëshpëruar dhe për t'ua shtuar vuajtjen, për mohimin e tyre të së vërtetës, u thuhet:"

- "A nuk ju janë lexuar shpalljet e Mia?! Por ju tregonit arrogancë dhe u bëtë të këqij!" - Shpalljet e Mia jua qartësuan të vërtetën dhe jua treguan atë duke ju udhëzuar kështu në rrugën e mirësisë dhe lumturisë tuaj. Shpalljet e Allahut ju urdhëruan për çdo mirësi dhe ju ndaluan nga çdo e keqe që është në dëmin tuaj. Shpalljet e Zotit janë mirësia më e madhe që Zoti solli ndër njerëz nese do të dinin t'i respektonin t'i besonin e të nënshtroheshin sipas saj. Por ju u treguat kryeneçë ndaj mesazhit dhe porosive të Tij dhe i kthyet shpinën Shpalljes së Tij. Duke i mohuar Shpalljet e Zotit dhe duke refuzuar të nënshtroheni për të jetuar e punuar sipas tyre ju kryet krimin më të madh. Sot do të shpërbleheni për atë që punuat. Gjithashtu për t'i dëshpëruar u thuhet:

- "Edhe kur ju thuhej: "Premtimi i Allahut është i saktë! Ora do të vijë dhe për të s'ka dyshim", ju përgjigjeshit: "Ne nuk e dimë se ç'është kjo Ora!"" - Pra kur ju përkujtohej se dita e ringjalljes dhe e gjykimit është e vërtetë dhe premtimi i Zotit por shpërblimi dhe ndëshkim sipas punëve është i pakthyeshën ju duke i mohuar dhe shpërfillur këto paralajmërime thoshit: "Ne nuk dimë çfarë është Kijameti?"

- "Ne mendojmë se është vetëm një hamendje dhe nuk jemi të bindur!" - Kjo ishte gjendja e tyre në dynja. Ata e mohonin dhe nuk e besonin ringjalljen dhe llogarinë me drejtësi para Zotit. Ata mohuan dhe i quanin gënjeshtarë ata që i paralajmëronin për ditën e hakut, dhe nuk e pranonin vërtetësinë dhe besnikërinë e tyre.

I Madhëruari thotë:

- "Atyre do t'u dalin në shesh të këqijat që kanë bërë dhe do t'i përfshijë ai me të cilin talleshin." - Ditën e Gjykimit, atyre do t'u tregohen veprat e këqija që kanë bërë dhe mbi ta do të godasë ndëshkimi me të cilin talleshin, sepse nuk e besonin se do të ndodhte. Ata tallen në dynja me Ditën e Llogarisë dhe me ata që e paralajmërojnë këtë ditë, por për këtë do të vuajnë të plotë ndëshkimin e të Drejtit. Atë ditë, atyre do t'u thuhet:

- "Sot po ju lëmë të harruar, ashtu sikurse ju e harruat takimin e kësaj dite." – Kuptimi: Sot do t'ju lëmë të harruar në ndëshkim, ashtu sikurse ju e latë të harruar takimin e kësaj dite. Shpërblimi jepet sipas punës që ke bërë!

- "Vendi juaj është Zjarri dhe nuk ka se kush t'ju shpëtojë!" - Vendqëndrimi dhe përfundimi juaj është zjarri i Xhehenemit. Askush nuk mund t'ju ndihmojë të shpëtoni nga ndëshkimi i Allahut.

- "Kjo ndodh, për shkak se ju u tallët me shpalljet e Allahut dhe u mashtruat me jetën e dynjasë." - Kuptimi: Ky ndëshkim

është shpagimi i drejtë, për shkak se ju i keni marrë me tallje argumentet dhe shpalljet e Allahut të Madhëruar, ndërkohë që ato duhej të trajtoheshin ashtu si e meritojnë: me seriozitet dhe përkushtim të plotë. Ju duhej t'i pranonit ato me kënaqësi dhe të jetonit sipas tyre, e jo të të talleshit me to. Por kjo ndodhi sepse ju u mashtruat nga bukuritë e dynjasë dhe gjetët prehje në të, duke u përkushtuar tërësisht pas saj. Kështu, ju braktisët punën për ahiretin, që është i përjetshëm dhe do të mbetet gjithmonë.

- "Atë ditë nuk do të nxirren prej tij e as nuk do t'u kërkohet që të kthehen." - Atyre nuk u jepet më afat që të reflektojnë dhe as mundësi për t'u kthyer në dynja, që të bëjnë vepra të mira.

- "Falënderimi dhe lavdia e plotë i qoftë vetëm Allahut, Zotit të qiejve, Zotit të Tokës, Zotit të gjithësisë!" - Allahut i takon lavdia, lavdërimet dhe mirënjohja, ashtu si i shkon madhërisë së Tij dhe madhështisë së pushtetit të Tij! Atij i takon lavdërimi i krijesave e mirënohja e tyre, për shkak se Ai është Krijuesi dhe Kujdestari i tyre, që u dhuron mirësi të panumërta, të dukshme e të fshehta dhe që u rregullon çdo çështje. Gjithçka është nën pushtetin dhe mbretërimin e Tij.

- "Vetëm Atij i takon gjithë madhështia në qiej e në Tokë." - Allahut i takon madhështia, lartësia e krenaria më e plotë.

Falënderimi ndaj Allahut kryhet duke thurur lavde për Të, duke e përmendur me cilësitë e Tij të plota dhe absolute, duke i shprehur dashurinë e plotë, duke treguar frikërespekt ndaj Tij dhe nderim për atributet e mrekullueshme të Tij. Nëpërmjet lavdërimit, shprehet dashuria, lavdia, respekti e admirimi për të Madhërishmin.

Më pas vihet në dukje madhështia, pushteti e mbretërimi absolut i Allahut, që duhet të kultivojë tek ne frikërespektin, madhërimin e përunjësinë ndaj Tij, sepse adhurimi, - për hir të të cilit Allahu na krijoi, - ndërtohet mbi këto dy shtylla kryesore: dashuria për Të dhe nënshtrimi ndaj Tij. Por këto të dyja nuk mund t'i kesh pa patur diturinë e nevojshme për Allahun, për madhështinë, krenarinë dhe lavdinë e Tij.

- "Ai është Ngadhënjyesi e i Urti." - Allahu është Ngadhënjyesi, që mposht gjithçka. Ai është i Urti, që vendos çdo gjë në vendin e vet. Nëse Allahu vendos për diçka, këtë e bën për dobi të mëdha. Nëse Ai krijon diçka, edhe këtë e bën në funksion të mirësisë dhe dobisë.

Përfundoi edhe tefsiri i sures Xhathije.

Surja 46: El Ahkaf (mekase) 35 ajete

Ajetet 1 – 3

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. *Ha, Mim.*

2. Shpallja e Librit është prej Allahut, të Plotfuqishmit, të Urtit.

3. Ne i krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka që ekziston ndërmjet tyre, veçse me një qëllim të vërtetë dhe për një afat të caktuar. Megjithatë, ata që nuk besojnë janë mospërfillës ndaj paralajmërimeve që u bëhen.

Shpjegimi i ajeteve

- "*Ha, Mim.* Shpallja e Librit është prej Allahut, të Plotfuqishmit, të Urtit." - Ky është një lavdërim që Allahu i Madhëruar i

bën Librit të Tij të mrekullueshëm dhe madhështor. Kjo është dhe ftesë për njerëzit, që ata të udhëzohen me dritën e Kuranit dhe të meditojnë më shumë rreth ajeteve të tij, sepse kështu mund të përfitojnë prej thesareve të fshehura të tij.

- "Ne i krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka që ekziston ndërmjet tyre, veçse me një qëllim të vërtetë dhe për një afat të caktuar." - Pasi përmendi shpalljen e Librit, i cili përmban ligjin e Tij, Allahu i Madhëruar tregon se është Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën. Në këtë mënyrë, Ai pohon për Veten dy atribute: krijimin e krijesave dhe vendosjen e ligjeve për to. Vetëm Atij i takon çështja e krijimit dhe e vendosjes së ligjit, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Atij i takon krijimi dhe ligjvënia". [El ea'raf 54]. Ose: "Allahu është Ai që krijoi shtatë qiej dhe prej Tokës aq sa ata. Në to zbatohet vendimi i Tij, për ta ditur se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka dhe se Allahu ka përfshirë gjithçka me dijen e Vet." [Talak 12]. Ose: "Me urdhrin e Tij, Ai ia zbret Shpalljen nëpërmjet engjëjve atij robi të Vet që Ai dëshiron, që të lajmërojë se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Meje. Prandaj, kini drojë prej Meje!" [Nahl 2].

Është Allahu i Lartësuar që i krijoi njerëzit e xhindët, që do mbajnë përgjegjësi për veprat e tyre, e krijoi gjithçka tjetër që ekziston. Ai krijoi edhe vendin ku ata jetojnë e banojnë. Përveç kësaj, Allahu i Lartësuar krijoi gjithçka që ndodhet mes qiejve e Tokës, për t'ua vënë në shërbim njerëzve e xhindëve. Pastaj, gjatë kohërave, dërgoi tek ata profetë, të cilëve u shpalli libra qiellorë. Në këto libra, Ai u përcaktoi robërve urdhra dhe ndalesa, u vendosi kufij dhe ligje, sipas të cilëve ata duhet të jetojnë në këtë jetë. Ai i njoftoi, gjithashtu, se kjo jetë është koha kur duhet të punojnë. Kjo është botë kalimtare, e jo vendqëndrimi i përhershëm i tyre. Do të vijë një ditë që ata të largohen nga kjo botë, për të shkuar në botën tjetër, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Atje do ta marrin të plotë shpërblimin për veprat që bëjnë në këtë dynja dhe për mënyrën si iu përgjigjën profetëve dhe si i trajtuan shpalljet që ata sollën.

Allahu i Madhëruar ka sjellë fakte të pamohueshme për vërtetësinë e jetës së ahiretit. Ai ka bërë që njerëzit ta provojnë shpërblimin dhe ndëshkimin që në këtë jetë, që t'u shërbejë si nxitës i fortë për të arritur të mirën dhe për t'u ruajtur nga e keqja.

I Madhëruari thotë: "Ne i krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka që ekziston ndërmjet tyre, veçse me një qëllim të vërtetë dhe për një afat të caktuar.". Pra, ato nuk u krijuan kot, pa ndonjë qëllim, por me një qëllim shumë të rëndësishëm: që robërit të njohin dhe të binden për madhështinë e Krijuesit, si dhe të gjejnë në to fakte që dëshmojnë se Krijuesi i tyre është i Plotë në çdo aspekt e pa mangësi. Ata duhet të jenë të bindur se Allahu që krijoi këtë gjithësi madhështore dhe kaq të rregullt është tërësisht i Plotfuqishëm që t'i ringjallë krijesat pas vdekjes së tyre, për t'i marrë në llogari dhe për t'i shpërblyer për veprat e tyre. Allahu i Lartësuar na njofton, gjithashtu, se kjo botë do të vazhdojë të jetë deri në një afat të caktuar.

Por edhe pse i Madhëruari, i Cili është më i Vërteti në fjalët e Tij, na mëson se cili është qëllimi i krijimit tonë, duke na ndriçuar faktet që e dëshmojnë këtë, përsëri ka disa krijesa që nuk i përgjigjen ftesës dhe porosive të Tij, por u kthejnë shpinën atyre. Ata shpërfillin Shpalljen e Zotit dhe

kundërshtojnë, madje luftojnë dhe u përpiqen me të gjitha forcat për të penguar ftesën e profetëve. Duke treguar për gjendjen e këtyre të mjerëve, i Lartësuari thotë:

- "Megjithatë, ata që nuk besojnë janë mospërfillës ndaj paralajmërimeve që u bëhen." - Ndërsa ata që besojnë, kur kuptojnë realitetin dhe gjendjen e tyre, i pranojnë këshillat dhe porositë e Zotit të tyre, madje i dorëzohen plotësisht Atij, me dashuri e drojë. Kështu, ata kanë fituar çdo të mirë dhe kanë shpëtuar nga çdo e keqe.

Ajetet 4 – 6

4. Thuaju atyre: "A nuk i shihni ata që i lusni në vend të Allahut? Më tregoni, çfarë kanë krijuar ata në tokë? Apo, vallë, kanë marrë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni ndonjë libër tjetër para këtij ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë hyjnore, nëse flisni të vërtetën!"
5. Kush është më i humbur se ata të cilët, në vend të Allahut, u luten atyre që nuk mund t'u përgjigjen, qoftë deri në Kijamet?! Ata nuk i marrin vesh aspak lutjet e tyre.
6. Ndërsa kur të mblidhen bashkë të gjithë njerëzit, ata do të jenë armiq dhe do t'ua mohojnë adhurimin e tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaju atyre: "A nuk i shihni ata që i lusni në vend të Allahut?..." – Fol me ata që, në vend të Allahut, adhurojnë idhuj, të cilët nuk bëjnë as dëm e as dobi, nuk japin jetë e nuk e marrin atë, idhuj që nuk mund të ringjallin për të marrë në llogari. Fol me ta, duke u shpjeguar pafuqinë dhe pamundësinë e këtyre idhujve, si dhe faktin se ata nuk meritojnë aspak të adhurohen.

- "Më tregoni, çfarë kanë krijuar ata në tokë? Apo, vallë, kanë marrë pjesë në krijimin e qiejve?!" - A kanë krijuar idhujt tuaj ndonjë gjë në madhështinë e qiejve dhe të Tokës? Vallë, ata i kanë krijuar malet e i kanë bërë lumenjt të rrjedhin?! Ata i kanë krijuar kafshët dhe i kanë shpërndarë në tokë?! Apo mos kanë ndihmuar ndopak në krijimin e diçkaje tjetër?! Asgjë nga këto nuk ka ndodhur.

Vetë ata e pranojnë se i vetmi Krijues është Allahu. Atëherë, njëshmëria e Tij në krijimin, furnizimin, sundimin dhe mbretërimin në këtë gjithësi tregon se Ai është dhe duhet të jetë i vetëm edhe në meritën e adhurimit. Ky është një argument logjik i thjeshtë dhe i pakundërshtueshëm.

Pas këtij argumenti logjik, i Lartësuari flet edhe për argumente tekstuale, që flasin për njëshmërinë e Tij në meritën e adhurimit:

- "Më sillni ndonjë libër tjetër para këtij ose ndonjë gjurmë të mbetur prej diturisë hyjnore, nëse flisni të vërtetën!" – Kuptimi: Sillni një libër të shpallur nga Zoti, që fton për idhujtari! Ose sillni ndonjë argument tekstual të ardhur nga profetët, që të urdhërojë për diçka të tillë!


Sigurisht, idhujtarët nuk kanë asnjë mundësi që të sjellin argumente nga Zoti ose nga profetët, për idhujtarinë që praktikojnë. Përkundrazi, të gjithë profetët, pa përjashtim, i kanë ftuar popujt e tyre në njësimin e Zotit në adhurim dhe i kanë ndaluar ata nga idhujtaria, me të gjitha format e saj. Madje, këto ishin porositë më të mëdha dhe më të rëndësishme që ata u sollën popujve nga Zoti i tyre, sikurse thotë i

Madhëruari: "Ne dërguam në çdo popull profetë, që t'u thonë: "Adhuroni vetëm Allahun e largojuni idhujve!" Por pati nga ata që Allahu i udhëzoi, siç pati edhe nga ata që ishin përcaktuar të humbnin. Udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si qe fundi i gënjeshtarëve!" [Nahl 36]. Çdo profet i tha popullit të vet: "O populli im, adhurojeni Allahun. Nuk keni zot tjetër veç Tij, që meriton të adhurohet. Unë kam frikë për ju dënimin e një dite të madhe!" [A'raf 59].

Nga të gjitha këto kuptohet se, argumentimi i idhujtarëve për të mbrojtur idhujtarinë e tyre është i padrejtë dhe i pabazuar, qoftë në logjikë, qoftë në fakte tekstuale nga profetët. Bazat ku ata mbështeten janë thjesht paragjykime e hamandësime të kota ose arsyetime të dobëta dhe të sëmura. Kotësinë e pretendimeve të tyre e sheh edhe te aktiviteti që bëjnë. Shih, gjithashtu, edhe idhujt, të cilëve iu përkushtohen: vallë, a i ndihmojnë për ndonjë të mirë apo a i ruajnë dot nga ndonjë e keqe, në dynja ose në ahiret?! Prandaj thotë i Madhëruari:

- "Kush është më i humbur se ata të cilët, në vend të Allahut, u luten atyre që nuk mund t'u përgjigjen, qoftë deri në Kijamet?!" - Ata kurrë nuk kanë për t'iu përgjigjur ndonjë lutjeje të tyre, deri në përfundimin e kësaj dynjaje. Ata nuk mund t'u sjellin adhuruesve të tyre asnjë dobi. Madje, sikurse thotë i Madhëruari:

- "Ata nuk i marrin vesh aspak lutjet e tyre." - Ata as që i dëgjojnë lutjet që u drejtohen dhe aq më pak, t'u përgjigjen atyre. Kjo është gjendja e idhujve në jetën e dynjasë. Ndërsa në ahiret, idhujt do të distancohen nga idhujtaria dhe nga


الجزء السادس والعشرون سورة الأحقاف

وَإِذَا حُشِرَ ٱلنَّاسُ كَانُوا۟ لَهُمْ أَعْدَآءً وَكَانُوا۟ بِعِبَادَتِهِمْ كَٰفِرِينَ ﴿٦﴾ وَإِذَا
تُتْلَىٰ عَلَيْهِمْ ءَايَٰتُنَا بَيِّنَٰتٍ قَالَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ لِلْحَقِّ لَمَّا جَآءَهُمْ هَٰذَا
سِحْرٌ مُّبِينٌ ﴿٧﴾ أَمْ يَقُولُونَ ٱفْتَرَىٰهُ ۖ قُلْ إِنِ ٱفْتَرَيْتُهُۥ فَلَا تَمْلِكُونَ
لِى مِنَ ٱللَّهِ شَيْـًٔا ۖ هُوَ أَعْلَمُ بِمَا تُفِيضُونَ فِيهِ ۖ كَفَىٰ بِهِۦ شَهِيدًۢا بَيْنِى
وَبَيْنَكُمْ ۖ وَهُوَ ٱلْغَفُورُ ٱلرَّحِيمُ ﴿٨﴾ قُلْ مَا كُنتُ بِدْعًا مِّنَ ٱلرُّسُلِ
وَمَآ أَدْرِى مَا يُفْعَلُ بِى وَلَا بِكُمْ ۖ إِنْ أَتَّبِعُ إِلَّا مَا يُوحَىٰٓ إِلَىَّ وَمَآ أَنَا
إِلَّا نَذِيرٌ مُّبِينٌ ﴿٩﴾ قُلْ أَرَءَيْتُمْ إِن كَانَ مِنْ عِندِ ٱللَّهِ وَكَفَرْتُم بِهِۦ
وَشَهِدَ شَاهِدٌ مِّنۢ بَنِىٓ إِسْرَٰٓءِيلَ عَلَىٰ مِثْلِهِۦ فَـَٔامَنَ وَٱسْتَكْبَرْتُمْ ۖ
إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿١٠﴾ وَقَالَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟
لِلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَوْ كَانَ خَيْرًا مَّا سَبَقُونَآ إِلَيْهِ ۚ وَإِذْ لَمْ يَهْتَدُوا۟ بِهِۦ
فَسَيَقُولُونَ هَٰذَآ إِفْكٌ قَدِيمٌ ﴿١١﴾ وَمِن قَبْلِهِۦ كِتَٰبُ مُوسَىٰٓ
إِمَامًا وَرَحْمَةً ۚ وَهَٰذَا كِتَٰبٌ مُّصَدِّقٌ لِّسَانًا عَرَبِيًّا لِّيُنذِرَ
ٱلَّذِينَ ظَلَمُوا۟ وَبُشْرَىٰ لِلْمُحْسِنِينَ ﴿١٢﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ قَالُوا۟ رَبُّنَا
ٱللَّهُ ثُمَّ ٱسْتَقَٰمُوا۟ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ﴿١٣﴾
أُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلْجَنَّةِ خَٰلِدِينَ فِيهَا جَزَآءًۢ بِمَا كَانُوا۟ يَعْمَلُونَ ﴿١٤﴾

٥٠٣

idhujtarët, sikurse thotë i Madhëruari më pas:

- "Ndërsa kur të mblidhen bashkë të gjithë njerëzit, ata do të jenë armiq dhe do t'ua mohojnë adhurimin e tyre." - Ata do të mallkojnë dhe do të distancohen prej njëri-tjetrit. Idhujt do të mohojnë adhurimin që u kanë bërë adhuruesit e tyre dhe nuk do t'u bëjnë asnjë dobi para Zotit.

Ajetet 7 – 10

7. Kur u lexohen ajetet Tona të qarta, mohuesit thonë për të vërtetën që u ka ardhur: "Kjo është magji e dukshme!"
8. Ose thonë: "Ai e ka trilluar vetë atë." Ti thuaju: "Nëse unë e kam trilluar atë, ju nuk keni asnjë mundësi që të më mbroni prej Allahut. Ai i di më së miri të gjitha shpifjet tuaja për të. Por mjafton që Ai është

dëshmitar ndërmjet meje dhe jush. Ai është Falësi e Mëshirëploti".

9. Thuaju: "Unë nuk jam i pari i dërguar e nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua e as me ju. Unë ndjek vetëm atë që më shpallet dhe unë jam veçse një i dërguar, që jep paralajmërime të qarta".

10. Thuaju: "Më tregoni se ç'do të bëhet me ju, nëse ai është prej Allahut, kurse ju e mohoni?! Ndërkaq, një dëshmitar nga bijtë e Israilit e dëshmoi si të tillë dhe i besoi, kurse ju tregoheni kryelartë!" Sigurisht, Allahu nuk i udhëzon në rrugën e shpëtimit njerëzit e padrejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur u lexohen ajetet Tona të qarta, mohuesit thonë për të vërtetën që u ka ardhur: "Kjo është magji e dukshme!" - Kur mohuesve të Zotit u lexohen dhe u sqarohen plotësisht shpalljet e Tij, kjo nuk u bën asnjë dobi. Ky sqarim thjesht nuk u lë më asnjë justifikim para Zotit.

Madje ata, duke dashur thjesht të mohojnë, kur dëgjojnë fjalën e Zotit, shpifin dhe thonë: "Kjo është magji e qartë!". Pra, për të vërtetën e sjellë nga Zoti dhe për faktet e padiskutueshme të sjella nga profetët e Tij, këta mashtrues shpifin e thonë se janë thjesht magji. Kjo nuk është gjë tjetër, por veçse një përmbysje e realitetit. Megjithatë, kjo mënyrë mund të gënjejë veçse mendjelehtët.

E si mundet që shpalljet dhe mrekullitë, me të cilat Zoti ka mbështetur profetët duke dëshmuar për vërtetësinë e tyre, t'i mohosh e t'i krahasosh me magjinë dhe ligësinë e saj?! Mes dy rasteve ka një ndryshim të madh, sa largësia mes qiellit dhe Tokës. E vërteta është ajo që ngrihet mbi gjithçka. Drita e saj e tejkalon dritën e diellit. Saktësia e saj dëshmohet nga një mori faktesh të shfaqura në natyrë dhe në vetet tona. Të vërtetën e pranojnë dhe i nënshtrohen mendjet më të ndritura dhe krijesat më të zgjedhura, që të jetojnë e punojnë sipas saj. Prandaj, si mund të krahasohet e vërteta me magjinë, e cila është gjëja më e kotë dhe e cila buron veçse nga të devijuarit dhe të padrejtët, nga shpirtligjtë e punëkëqijtë. Në fakt, magjia u shkon për shtat pikërisht atyre që e krahasojnë atë me Shpalljen dhe të vërtetën e Zotit. Këto pretendime janë veçse pallavra, me të cilat synohet thjesht justifikimi për të mos pranuar të vërtetën.

- "Ose thonë: "Ai e ka trilluar vetë atë." - Ata pretendojnë se Kuranin e trilloi vetë Muhamedi (a.s), domethënë se nuk është Shpallje e Zotit? Për t'iu kundërvënë këtij pretendimi, Allahu i Lartësuar e udhëzon të Dërguarin e Vet të thotë:

- "Ti thuaju: "Nëse unë e kam trilluar atë, ju nuk keni asnjë mundësi që të më mbroni prej Allahut." - Mendohuni pak! Allahu ka dijeni të plotë për pretendimin tuaj. Si është e mundur që Ai nuk më ndëshkon për trillimin tim, sikurse pretendoni ju? A mund të më mbroni ju nga Zoti, nëse Ai dëshiron të më ndëshkojë? Po nëse Ai dëshiron të më mëshirojë, vallë, a mund ta pengoni ju mëshirën e Tij?

- "Ai i di më së miri të gjitha shpifjet tuaja për të." - Nëse unë do të isha trillues ndaj Allahut, Ai do të më ndëshkonte me fuqinë e Tij dhe do të ma këputste arterien e zemrës sime. Ai do të jepte një ndëshkim, që do ta vërente dhe do ta dinte çdokush, sepse trillimi ndaj Tij dhe shtirja si i dërguar i Tij

është krimi më i madh ndaj Zotit dhe shpifja më e dënueshme.

Më pas, duke i ftuar që të pendohen për armiqësinë ndaj të vërtetës dhe për refuzimin me inat të saj, Allahu i Madhëruar udhëzon e thotë:

- "Por mjafton që Ai është dëshmitar ndërmjet meje dhe jush. Ai është Falësi e Mëshirëploti". - Pendohuni tek Ai dhe ndaluni nga ato gjëra që veproni dhe trilloni! Nëse pendoheni sinqerisht tek Zoti, Ai do t'jua pranojë pendimin dhe do t'ju mëshirojë, duke ju dhënë sukses të bëni të mira dhe duke ju dhururuar për to shpërblime të shumta e të mëdha.

- "Thuaju: "Unë nuk jam i pari i dërguar e nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua e as me ju."". - Unë nuk jam i pari i dërguar i Zotit, e kjo dihet! Pse habiteni me mesazhin që unë sjell? Pse, pra, e refuzoni ftesën time? Shumë profetë të tjerë kanë ardhur para meje dhe mesazhi im është tërësisht në përputhje me mesazhin e tyre. Atëherë, për çfarë arsyeje e refuzoni mesazhin tim, që unë po jua përcjell prej Zotit?

- "Unë ndjek vetëm atë që më shpallet...". - Unë jam veçse një njeri, dhe si i tillë nuk kam në dorë asnjë çështje. Vetëm Allahu i Madhëruar i ka në dorë të gjitha çështjet, të miat dhe tuajat. Ai do të gjykojë mbi mua dhe mbi ju. Unë nuk vij tek ju me diçka nga vetja ime.

- "...dhe unë jam veçse një i dërguar, që jep paralajmërime të qarta." - Nëse ju e pranoni Shpalljen që unë përcjell nga Zoti juaj e nëse dëgjoni porositë e mia, ky do të jetë fati juaj i mirë dhe lumturia juaj në dynja dhe në ahiret. Por nëse më refuzoni dhe e shpërfillni mesazhin e Zotit të sjellë prej meje, llogaria juaj do të bëhet nga Zoti. Por mos harroni, se unë ju paralajmërova dhe jua tërhoqa vërejtjen, prandaj nuk kam më asnjë përgjegjësi para Zotit tim.

- "Thuaju: "Më tregoni se ç'do të bëhet me ju, nëse ai është prej Allahut, kurse ju e mohoni?! Ndërkaq, një dëshmitar nga bijtë e Israilit e dëshmoi si të tillë dhe i besoi, kurse ju tregoheni kryelartë!"" – Ju e mohoni Kuranin, por çfarë ndodh nëse ai është libri i Allahut të Madhëruar? Çfarë ndodh, kur për vërtetësinë e tij dëshmojnë më të zgjedhurit dhe më të udhëzuarit nga mesi i ithtarëve të Librit, të cilët kishin patur shumë shenja e fakte për të njohur të vërtetën? Nëse ju e mohoni atë, a nuk është ky krimi më i madh? Nëse mesazhi i sjellë prej meje është në përputhje me mesazhin e të gjithë profetëve, dhe kjo është pranuar nga pasuesit e denjë të profetëve, ndërsa ju nuk doni ta pranoni, a nuk është ky tregues i padrejtësisë, i kufrit, i mendjelehtësisë dhe i injorancës tuaj? Dijeni, atëherë, se me mendjemadhësi dhe me shpërfilljen e fakteve të pamohueshme të sjella nga Zoti, ju nuk keni për ta gjetur kurrë të vërtetën. Allahu i Madhëruar thotë:

- "Sigurisht, Allahu nuk i udhëzon në rrugën e shpëtimit njerëzit e padrejtë." - Prej padrejtësisë është edhe shpërfillja me fodullëk e të vërtetës, pasi të krijohet mundësia ta kuptosh dhe ta pranosh atë.

Ajetet 11 – 12

11. Jobesimtarët thonë për besimtarët: "Sikur të ishte ajo ndonjë gjë e mirë, ata nuk do ta besonin para nesh!" Duke qenë

se nuk e pranojnë udhëzimin e saj, ata thonë: "Ajo është një sajesë e vjetër!".
12. Para këtij është shpallur Libri i Musait, si udhërrëfyes dhe mëshirë, dhe ky është një libër që e vërteton atë. Ai është shpallur në gjuhën arabe, për t'u tërhequr vërejtjen atyre që bëjnë gjynahe dhe si lajm i mirë për vepërmirët.

Shpjegimi i ajeteve

- "Jobesimtarët thonë për besimtarët..." - Mohuesit e të vërtetës, të cilët shfaqin armiqësi ndaj ftesës së Zotit, thonë:

- "Sikur të ishte ajo ndonjë gjë e mirë, ata nuk do ta besonin para nesh!" – Kuptimi: Nëse besimi dhe nënshtrimi ndaj kësaj, që ju e quani Shpallje e Zotit, do të ishte diçka e mirë, nuk do të na kalonte kush në këtë aspekt. Pra, do të ishim ne të parët që do ta përqafonin atë, e jo këta që quhen 'besimtarë'.

Kjo është thjesht një mendjemadhësi e shëmtuar nga ana e tyre. E si mund të gjykosh për vërtetësinë apo jo të diçkaje duke u nisur nga fakti se e preferon atë apo jo? Çfarë kriteri qenka ky? Vallë, ata janë më zemërpastërtit, më shpirtkulluarit, më mendjendriturit e më të urtët?! Apo çështja e udhëzimit në rrugën e drejtë është e drejta e tyre ekskluzive?! Jo, kurrsesi nuk është kështu! Këto fjalë janë thjesht ngushëllim dhe justifikime, që ata gjejnë për veten e tyre, për diçka që nuk e arrijnë dot. Ata nuk mund ta gjejnë udhëzimin, sepse u janë përkushtuar epsheve e dëshirave të tyre për këtë dynja, prandaj gjejnë si rrugëzgjidhje që ta shpërfillin dhe ta shajnë atë. Prandaj i Madhëruari thotë:

- "Duke qenë se nuk e pranojnë udhëzimin e saj, ata thonë: "Ajo është një sajesë e vjetër!"" - Ky është shkaku i vërtetë që i shtyu ata që të shpërfillin dhe të trillojnë gënjeshtra për të vërtetën. Ata nuk e pranojnë udhëzimin e Shpalljes hyjnore, kështu që nuk ndriçohen me dritën e saj, duke u shpëtuar nga duart, në këtë mënyrë, gjëja më e vyer që dikush mund të synojë. Si rrjedhojë, ata gjejnë si zgjidhje cenimin e madhështisë së Shpalljes, duke thënë se ajo është mashtrim e trillim. Ata shpifin për të, edhe pse ajo është e vërteta, për të cilën nuk duhet të ketë asnjë dyshim dhe pasiguri.


Kurani është në të njëjtën linjë dhe vërtetues i të gjitha shpalljeve të Zotit të sjella para tij, ndër të cilët është edhe Teurati, libri që Zoti i shpalli Musait (a.s.). I Madhëruari thotë:

- "Para këtij është shpallur Libri i Musait, si udhërrëfyes dhe mëshirë..." - Zoti e bëri Teuratin udhëzim dhe mëshirë, që bijtë e Israilit të gjenin nëpërmjet tij rrugën e udhëzimit dhe të kishin ligjet e jetës dhe të adhurimit. Nëse do ta zbatonin, do të arrinin mirësinë në dynja dhe në ahiret.

- "..dhe ky është një libër që e vërteton atë." - Ky libër është vërtetues dhe miratues i shpalljeve hyjnore të mëparshme. Atë që Kurani e dëshmon si të vërtetë, ajo është e vërtetë, sepse ai është në përputhje të plotë me të gjitha shpalljet e tjera të Zotit. Këtë libër Allahu i Madhëruar e shpalli në gjuhën arabe, që kuptimi dhe përfitimi prej tij jenë më të thjeshtë. Po në këtë mënyrë, ai është bërë i thjeshtë për t'u mësuar përmendësh.

- "Ai është shpallur në gjuhën arabe, për t'u tërhequr vërejtjen atyre që bëjnë

gjynahe dhe si lajm i mirë për vepërmirët.” - Allahu i Madhëruar e shpalli Kuranin që të paralajmërojë ata që i bëjnë padrejtësi vetes duke shkelur e tejkaluar kufijtë e Zotit dhe duke mos iu bindur Atij. Ai i paralajmëron ata për një ndëshkim të rëndë nëse vazhdojnë me padrejtësitë dhe rrugën e tyre të humbjes. Por ky libër u shpall, gjithashtu, edhe që të përgëzojë vepërmirët, të cilët i kryejnë të gjitha adhurimet e përkushtuara Allahut dhe janë bamirës me krijesat e Allahut. Ata përgëzohen me një shpërblim të madh në dynja dhe në ahiret. Në Kuran janë treguar qartë veprat nga të cilat duhet të ruhemi dhe veprat që duhet t’i kryejmë.


الجزء السادس والعشرون سورة الأحقاف

وَوَصَّيْنَا ٱلْإِنسَٰنَ بِوَٰلِدَيْهِ إِحْسَٰنًا ۖ حَمَلَتْهُ أُمُّهُۥ كُرْهًا وَوَضَعَتْهُ
كُرْهًا ۖ وَحَمْلُهُۥ وَفِصَٰلُهُۥ ثَلَٰثُونَ شَهْرًا ۚ حَتَّىٰٓ إِذَا بَلَغَ أَشُدَّهُۥ وَبَلَغَ
أَرْبَعِينَ سَنَةً قَالَ رَبِّ أَوْزِعْنِىٓ أَنْ أَشْكُرَ نِعْمَتَكَ ٱلَّتِىٓ أَنْعَمْتَ
عَلَىَّ وَعَلَىٰ وَٰلِدَىَّ وَأَنْ أَعْمَلَ صَٰلِحًا تَرْضَىٰهُ وَأَصْلِحْ لِى فِى ذُرِّيَّتِىٓ ۖ
إِنِّى تُبْتُ إِلَيْكَ وَإِنِّى مِنَ ٱلْمُسْلِمِينَ ﴿١٥﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ نَتَقَبَّلُ
عَنْهُمْ أَحْسَنَ مَا عَمِلُوا۟ وَنَتَجَاوَزُ عَن سَيِّـَٔاتِهِمْ فِىٓ أَصْحَٰبِ
ٱلْجَنَّةِ ۖ وَعْدَ ٱلصِّدْقِ ٱلَّذِى كَانُوا۟ يُوعَدُونَ ﴿١٦﴾ وَٱلَّذِى قَالَ
لِوَٰلِدَيْهِ أُفٍّ لَّكُمَآ أَتَعِدَانِنِىٓ أَنْ أُخْرَجَ وَقَدْ خَلَتِ ٱلْقُرُونُ مِن
قَبْلِى وَهُمَا يَسْتَغِيثَانِ ٱللَّهَ وَيْلَكَ ءَامِنْ إِنَّ وَعْدَ ٱللَّهِ حَقٌّ فَيَقُولُ
مَا هَٰذَآ إِلَّآ أَسَٰطِيرُ ٱلْأَوَّلِينَ ﴿١٧﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ حَقَّ عَلَيْهِمُ ٱلْقَوْلُ
فِىٓ أُمَمٍ قَدْ خَلَتْ مِن قَبْلِهِم مِّنَ ٱلْجِنِّ وَٱلْإِنسِ ۖ إِنَّهُمْ كَانُوا۟ خَٰسِرِينَ
﴿١٨﴾ وَلِكُلٍّ دَرَجَٰتٌ مِّمَّا عَمِلُوا۟ ۚ وَلِيُوَفِّيَهُمْ أَعْمَٰلَهُمْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ
﴿١٩﴾ وَيَوْمَ يُعْرَضُ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ عَلَى ٱلنَّارِ أَذْهَبْتُمْ طَيِّبَٰتِكُمْ فِى حَيَاتِكُمُ
ٱلدُّنْيَا وَٱسْتَمْتَعْتُم بِهَا ۖ فَٱلْيَوْمَ تُجْزَوْنَ عَذَابَ ٱلْهُونِ بِمَا كُنتُمْ
تَسْتَكْبِرُونَ فِى ٱلْأَرْضِ بِغَيْرِ ٱلْحَقِّ وَبِمَا كُنتُمْ تَفْسُقُونَ ﴿٢٠﴾

٥٠٤

Ajetet 13 – 14

13. Për ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, dhe pastaj qëndrojnë të palëkundur, për ta nuk ka frikë dhe as pse të brengosen.

14. Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, si shpërblim për çfarë kanë bërë.

Shpjegimi i ajeteve

- “Për ata që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, dhe pastaj qëndrojnë të palëkundur, për ta nuk ka frikë dhe as pse të brengosen.” - Ata të cilët e besojnë Zotin e tyre si të vetmin Krijues, Sundues, Mbretërues dhe Administrues të çështjeve të tyre, dëshmojnë se Ai është Një, i Vetëm dhe i Pashoq, pastaj janë të patundur në këtë bindje ndaj Tij, gjatë gjithë jetës ë tyre, ata nuk do të kenë frikë për të ardhmen dhe as brenga për të kaluarën.

- “Ata do të jenë banorë të Xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë...” – Të tillët do të jenë banorët e Xhenetit, ku do të jenë gjithmonë dhe kurrë nuk do të kërkojnë të ikin prej atij apo ta shkëmbejnë atë me diçka tjetër.

- “...si shpërblim për çfarë kanë bërë.” - Ata do të jenë të përjetshëm në Xhenet, të cilin Zoti e ka bërë si shpërblim për të mirat që kryejnë në dynja, duke filluar me besimin e pastër tek Allahu, dhe duke vazhduar me veprat të mira të nxitura nga ky iman, si dhe përqendrimi në këtë rrugë.

Ajetet 15 – 16

15. Ne e kemi urdhëruar njeriun për bamirësi ndaj prindërve të vet. Nëna e vet e ka bartur me mundim dhe me vështirësi e ka lindur. Barra dhe ushqimi me gji zgjasin tridhjetë muaj. Kur arrin pjekurinë e vet dhe mbush dyzet vjeç, ai thotë: “Zoti

im, më mundëso që të të falënderoj Ty për mirësitë që më ke falur mua dhe prindërve të mi! Më mundëso që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti të jesh i kënaqur! M'i bëj të mirë pasardhësit e mi! Unë pendohem tek Ti dhe të jam dorëzuar!"

16. Këta janë njerëzit të cilëve Ne ua pranojmë veprat në mënyrën më të mirë, ua mbulojmë të këqijat dhe i bëjmë banorë të Xhenetit. Ky është premtimi i vërtetë, që u bëhet atyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne e kemi urdhëruar njeriun për bamirësi ndaj prindërve të vet. Nëna e vet e ka bartur me mundim dhe me vështirësi e ka lindur. Barra dhe ushqimi me gji zgjasin tridhjetë muaj." - Kjo tregon butësinë dhe mëshirën e madhe të Allahut të Madhëruar për robërit dhe vlerësimin e lartë të Tij për rolin dhe gradën e prindërve. Ai i ka porositur dhe u ka marrë premtimin fëmijëve që të jenë të mirë me prindërit e tyre, dhe këtë ta tregojnë me fjalë, vepra dhe sjellje shembullore ndaj tyre. Ata duhet të tregohen bamirës ndaj prindërve, duke shpenzuar pasuri ose duke bërë çdo gjë tjetër, me qëllim që të fitojnë kënaqësinë e tyre.

Allahu i Madhëruar tregon edhe arsyen pse duhet të jemi bamirës ndaj prindërve. Është nëna ajo që vuan e mundohet aq shumë për fëmijën e saj, që në periudhën e shtatzënisë e deri në dhimbjet e mëdha gjatë lindjes. Por nuk është vetëm kaq. Po kujdesi i mëtejshëm, periudha e gjidhënies, lodhja dhe netët pa gjumë, derisa fëmija të rritet e forcohet? Të gjitha këto nuk kalojnë shpejt, por është një periudhë që zgjat 30 muaj. Nëntë muaj prej tyre janë të shtatzënisë, në shumicën e rasteve, ndërsa pjesa tjetër është gjidhënia dhe përkujdesja tjetër e nevojshme.

Duke e parë këtë ajet së bashku me ajetin tjetër, ku thuhet: "Nënat le t'u japin gji foshnjave të tyre dy vite të plota, për ato që duan ta plotësojnë gjidhënien" [Bekare 233], arrijmë në përfundimin se koha më e shkurtër e shtatzënisë është gjashtë muaj. Me fjalë të tjera, është e mundur që pas gjashtë muaj barre, të lindë një fëmijë.

- "Kur arrin pjekurinë e vet dhe mbush dyzet vjeç, ai thotë..." - Në kohën kur njeriu arrin kulmin e fuqisë fizike dhe të pjekurisë së mendimit, ai fillon të lutet:

- "Zoti im, më mundëso që të të falënderoj Ty për mirësitë që më ke falur mua dhe prindërve të mi!" – Kuptimi: Më jep forcë dhe sukses që të jem mirënjohës për çfarë më ke dhuruar! Mirësitë e Tua ndaj meje janë të shumta. Ato janë mirësi në fe dhe besim, pasi Ti me ke udhëzuar në rrugën e drejtë dhe më ke larguar nga rruga e keqe. Por ato janë edhe mirësi që kanë lidhje me këtë dynja.

Mirënjohja për gjitha këto shprehet vetëm duke i shfrytëzuar dhe shpenzuar ato në bindje ndaj Atij që t'i dhuroi. Për të arritur statusin e mirënjohësit, duhet t'i vlerësosh dhe t'i respektosh shumë këto mirësi, duke shfaqur në të njëjtën kohë edhe pamundësinë tënde për t'i shprehur të plotë Allahut mirënjohjen që i takon. Duhet të përpiqesh shumë që ta lavdërosh Allahun për ato mirësi që të ka dhuruar.

Duhet ditur se mirësia që u është dhuruar prindërve konsiderohet si mirësi që u është dhuruar edhe fëmijëve të tyre. Mirësitë që kanë prindërit i përfshijnë edhe fëmijët,

sidomos mirësitë që kanë lidhje me fenë. Nëse prindërit përmirësojnë veten me dituri të pastër fetare dhe me vepra të mira, ky u shërben si shkak i fuqishëm për rregullimin e fëmijëve dhe pasardhësve të tyre.

- "Më mundëso që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti të jesh i kënaqur!" - Veprat që Zoti i do dhe e kënaqin Atë, janë ato që i plotësojnë kushtet për të qenë të mira dhe që janë të ruajtura nga çdo gjë që i shkatërron. Këto janë ato vepra të cilat Ai i pranon dhe i shpërblen.

- "M'i bëj të mirë pasardhësit e mi!" - Pasi lutet për veten, që Zoti t'ia përmirësojë çështjet e tij, ky njeri vijon të lutet edhe për pasardhësit, që Zoti t'ua përmirësojë gjendjen dhe veprat e tyre. Në fakt, duke u lutur për rregullimin e pasardhësve, ai lutet për veten e vet, sepse fëmijët e mirë janë mirësi dhe për prindërit e tyre.

- "Unë pendohem tek Ti dhe të jam dorëzuar!" - Pendohem për gjynahet, poshtërsitë dhe mosbindjen time! Unë kthehem tek Ti, o Zoti im, i dorëzuar tërësisht, për të të madhëruar Ty!

- "Këta janë njerëzit të cilëve Ne ua pranojmë veprat në mënyrën më të mirë..." – Njerëzve që veprojnë kështu, Allahu ua pranon veprat më të mira që kanë bërë në bindje ndaj Tij. Ndërsa për veprat e tyre jo të mira, Allahu i Madhëruar thotë:

- "...ua mbulojmë të këqijat dhe i bëjmë banorë të Xhenetit." - Allahu ua fal përgjithësisht të këqijat, nëse pendohen sinqerisht për to, dhe i bashkon me banorët e Xhenetit. Kështu, i Madhëruari u dhuron atyre të gjitha të mirat dhe i ruan nga çdo e keqe.

- "Ky është premtimi i vërtetë, që u bëhet atyre." - Ky është premtimi i vërtetë nga Allahu, i Cili është më besniku në fjalët e Tij dhe që kurrë nuk i thyen premtimet e Tij.

Ajetet 17 – 19

17. Dikush u thotë prindërve të vet: "Uf, ju të dy! A më premtoni se do të ringjallem, kur sa e sa breza kanë kaluar para meje?!" Ata të dy e lusin Allahun që ta udhëzojë (e i thonë): "I mjeri t'i, beso, se premtimi i Allahut është i vërtetë!" Por ai thotë: "Këto nuk janë gjë tjetër, por veçse përrallat e të lashtëve!"
18. Këta janë ata njerëz, kundër të cilëve ka marrë fund vendimi, sikurse u veprua me popujt e xhindëve dhe të njerëzve që kaluan para tyre, të cilët edhe ata dështuan.
19. Të gjithë do të kenë gradën e merituar, sipas asaj që kanë bërë. Shpërblimi për veprat e tyre do t'u jepet i plotë e nuk do t'u bëhet padrejtësi.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për bamirësit ndaj prindërve, Allahu i Madhëruar përshkruan se si janë të padrejtët ndaj prindërve:

- "Dikush u thotë prindërve të vet: "Uf, për ju të dy!..." - Këtë njeri prindërit e thërrasin të besojnë Allahun dhe Ditën e Kijametit. Ata e këshillojnë që t'i frikësohet llogarisë para Zotit në Ditën e Gjykimit.

Këto këshilla të mrekullueshme janë kujdesi më i madh që prindërit mund t'u bëjnë fëmijëve të tyre. Nuk ka gjë më të rëndësishme sesa t'u mësosh fëmijëve

rrugën e drejtë, për të arritur lumturinë në dynja dhe në ahiret.

Por ftesës së tyre për të arritur të mirën dhe për të shpëtuar nga e keqja në të dyja jetët, ky lloj fëmije iu përgjigjet me mënyrën më të shëmtuar. Ai u thotë atyre "Uf, ju të dy!". Pra: "Vdekshi ju, çfarë më thoni!" Pastaj tregon se e sheh si krejt të pamundur dhe të pavërtetë Ditën e Gjykimit:

- "A më premtoni se do të ringjallem, kur sa e sa breza kanë kaluar para meje?!" – Kuptimi: Vallë, a po më thoni se unë do të dal përsëri nga varri im Ditën e Gjykimit? Sa breza njerëzish kanë kaluar para meje dhe nuk e besonin ringjalljen, që thoni ju! Madje, edhe ata që kanë qenë udhëheqës e pasanikë, e kanë mohuar ringjalljen dhe llogarinë para Zotit.

Këtë të mjerë, që mbajnë si model të tyre armiqtë e të vërtetës, injorantët dhe të degjeneruarit, janë të dashuruar pas kësaj dynjaje dhe bukurive të saj:

- "Ata të dy e lusin Allahun që ta udhëzojë..." - Ndërsa prindërit e tij duan ta ndihmojnë, prandaj i thonë: "I mjeri t'i, beso!" Ata bëjnë çdo gjë që ai të udhëzohet në rrugën e drejtë. Nga dashuria dhe meraku i madh që kanë për fëmijën e tyre, ata i ankohen e përgjërohen Allahut të Madhëruar, ashtu si vepron njeriu që është duke u mbytur, kur thërret për ndihmë, që ta shpëtojnë. Ata i drejtohen Allahut me lutje e lot, duke shprehur dobësinë dhe përunjësi e tyre, që fëmija i tyre të udhëzohet. Plot dashuri, butësi dhe mëshirë, ata përpiqen që t'ia sqarojnë fëmijës të vërtetën e besimit:

"I mjeri t'i, beso, se premtimi i Allahut është i vërtetë!" - Premtimi i Allahut është i vërtetë dhe për të nuk duhet të kesh asnjë dyshim!

Pastaj, me dëshirën e madhe e të çiltër që ai të udhëzohet, përpiqen t'i sjellin sa më shumë argumente dhe fakte. Por ky fëmijë jobesimtar e shton edhe më tepër mohimin dhe mendjemadhësinë, duke thënë:

- "Por ai thotë: "Këto nuk janë gjë tjetër, por veçse përrallat e të lashtëve!"" – Kuptimi: Këto janë thjesht rrëfenja të marra nga librat e gojëdhënat e të parëve, e nuk janë mesazhe të Zotit.

Por të gjithë e dinë dhe e pranojnë se Muhamedi (a.s.) ishte analfabet. Ai nuk dinte as shkrim, as lexim! Atëherë, nga mund t'i merrte ai këto lajme? Pastaj, krijesat nuk mund të sjellin kurrë një libër hyjnor si Kurani, edhe sikur të ndihmojnë dhe të mbështesin të gjithë njëri-tjetrin.

- "Këta janë ata njerëz, kundër të cilëve ka marrë fund vendimi, sikurse u veprua me popujt e xhindëve dhe të njerëzve që kaluan para tyre..." – Për njerëzit që bëjnë të tilla gjëra do të ekzekutohet patjetër vendimi për ndëshkim. Edhe ata do të futen mes popujve të tjerë me njerëz e xhindë, të cilët kanë mohuar të vërtetën. Edhe ata do të ndëshkohen bashkë me turmën e madhe të të devijuarve e të humburve.

- "...të cilët edhe ata dështuan." - Dështimi është humbja e tërë pasurisë së njeriut. Kur humbet gjithçka, atëherë nuk flitet e nuk mendohet më për fitim. Ata nuk e meritojnë mirësinë e Zotit, sepse e kanë shpërdoruar mundësinë për t'u pajisur me iman, që është

pasuria kryesore e njeriut. Kështu, atyre u ikin nga duart të gjitha mirësitë dhe nuk mund të shpëtojnë nga dënimi i dhimbshëm në zjarrin e Xhehenemit.

- **"Të gjithë do të kenë gradën e merituar, sipas asaj që kanë bërë."** - Si punëmirët, ashtu edhe punëkëqijtë do të marrin gradën që meritojnë. Sipas veprave që kanë bërë, do të meritojnë shpërblimin ose ndëshkimin e Allahut të Drejtë. I Madhëruari thotë:

- **"Shpërblimi për veprat e tyre do t'u jepet i plotë e nuk do t'u bëhet padrejtësi."** - Askujt nuk do t'i shtohen të këqijat, por do të ketë vetëm aq sa bërë vetë, ashtu si askujt nuk do t'i mohohen apo pakësohen të mirat që ka bërë.

Ajeti 20

20. Atë ditë, ata që nuk besojnë do t'i afrohen Zjarrit: "Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe u kënaqët me to, ndërsa sot do të shpaguheni me dënim poshtërues, për shkak të kryelartësisë së padrejtë që keni treguar në tokë dhe për shkak se nuk keni respektuar urdhrat e Zotit!".

Shpjegimi i ajetit

- **"Atë ditë, ata që nuk besojnë do t'i afrohen Zjarrit..."** - Allahu i Madhëruar përshkruan gjendjen e jobesimtarëve kur ata të përballen me Zjarrin. Në këtë moment, atyre u thuhen disa fjalë dëshpëruese, që ua shtojnë më tepër dhimbjet dhe vuajtjet:


- **"Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe u kënaqët me to..."** - Ju kërkuat prehjen në jetën e dynjasë. Ju u mashtruat nga kënaqësitë e saj. Ju parapëlqyet plotësimin e qejfeve në dynja, kundrejt kënaqësive të përjetshme të ahiretit. Rendja pas atyre kënaqësive të përkohshme ju shpërqendroi nga veprat me të cilat fitohej lumturia e ahiretit. Ju u zbavitët të hutuar në dynja, ashtu si bagëtitë, të pashqetësuar për fundin tuaj në ahiret. Atëherë, në atë dynja mbaruan kënaqësitë tuaja.

- **"...ndërsa sot do të shpaguheni me dënim poshtërues..."** - Këtë ndëshkim poshtërues do ta vuani për krimin tuaj të shpifjes nda Allahut të Madhëruar. Ju mashtronit dhe pretendonit se rruga juaj e humbur ishte e vërteta nga Allahu, ishte gjykimi, caktimi dhe vullneti i Tij. Me të tilla pretendime, ju thjesht donit të justifikonit rrugën e humbjes, të cilën e parapëlqyet vetë, edhe pse ishit të vetëdijshëm për faktin se po mashtronit. Ndëshkimi poshtërues është i merituar për ju edhe për një shkak tjetër:

- **"...për shkak të kryelartësisë së padrejtë që keni treguar në tokë dhe për shkak se nuk keni respektuar urdhrat e Zotit!"** - Ju tregoheshit mendjemëdhenj para bindjes dhe nënshtrimit ndaj Allahut.
Siç shihet, njerëz të tillë bëjnë dy krime njëkohësisht: ata flasin të pavërteta dhe punojnë sipas tyre. Ata shpifin ndaj të vërtetës, duke ia mveshur këto shpifje Allahut, dhe tregohen arrogantë, duke e refuzuar këtë të vërtetë. Për këtë arsye, ata meritojnë ndëshkimin më të rëndë.

Ajetet 21 – 26

21. Kujto vëllanë e fisit Ad, që paralajmëroi fisin e vet në Ahkaf, megjithëse pati edhe paralajmërues të tjerë, qoftë para apo pas tij. "Të mos adhuroni asgjë tjetër veç Allahut, se unë i druhem dënimit të Ditës së Madhe për ju!"


الجزء السادس والعشرون سورة الأحقاف
الحزب ٥١
* وَٱذْكُرْ أَخَا عَادٍ إِذْ أَنذَرَ قَوْمَهُۥ بِٱلْأَحْقَافِ وَقَدْ خَلَتِ ٱلنُّذُرُ
مِنۢ بَيْنِ يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِۦٓ أَلَّا تَعْبُدُوٓا۟ إِلَّا ٱللَّهَ إِنِّىٓ أَخَافُ عَلَيْكُمْ
عَذَابَ يَوْمٍ عَظِيمٍ ﴿٢١﴾ قَالُوٓا۟ أَجِئْتَنَا لِتَأْفِكَنَا عَنْ ءَالِهَتِنَا فَأْتِنَا
بِمَا تَعِدُنَآ إِن كُنتَ مِنَ ٱلصَّٰدِقِينَ ﴿٢٢﴾ قَالَ إِنَّمَا ٱلْعِلْمُ عِندَ ٱللَّهِ
وَأُبَلِّغُكُم مَّآ أُرْسِلْتُ بِهِۦ وَلَٰكِنِّىٓ أَرَىٰكُمْ قَوْمًا تَجْهَلُونَ ﴿٢٣﴾ فَلَمَّا
رَأَوْهُ عَارِضًا مُّسْتَقْبِلَ أَوْدِيَتِهِمْ قَالُوا۟ هَٰذَا عَارِضٌ مُّمْطِرُنَا ۚ
بَلْ هُوَ مَا ٱسْتَعْجَلْتُم بِهِۦ ۖ رِيحٌ فِيهَا عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٢٤﴾ تُدَمِّرُ كُلَّ
شَىْءٍۭ بِأَمْرِ رَبِّهَا فَأَصْبَحُوا۟ لَا يُرَىٰٓ إِلَّا مَسَٰكِنُهُمْ ۚ كَذَٰلِكَ نَجْزِى
ٱلْقَوْمَ ٱلْمُجْرِمِينَ ﴿٢٥﴾ وَلَقَدْ مَكَّنَّٰهُمْ فِيمَآ إِن مَّكَّنَّٰكُمْ فِيهِ
وَجَعَلْنَا لَهُمْ سَمْعًا وَأَبْصَٰرًا وَأَفْـِٔدَةً فَمَآ أَغْنَىٰ عَنْهُمْ سَمْعُهُمْ
وَلَآ أَبْصَٰرُهُمْ وَلَآ أَفْـِٔدَتُهُم مِّن شَىْءٍ إِذْ كَانُوا۟ يَجْحَدُونَ بِـَٔايَٰتِ
ٱللَّهِ وَحَاقَ بِهِم مَّا كَانُوا۟ بِهِۦ يَسْتَهْزِءُونَ ﴿٢٦﴾ وَلَقَدْ أَهْلَكْنَا
مَا حَوْلَكُم مِّنَ ٱلْقُرَىٰ وَصَرَّفْنَا ٱلْءَايَٰتِ لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ ﴿٢٧﴾
فَلَوْلَا نَصَرَهُمُ ٱلَّذِينَ ٱتَّخَذُوا۟ مِن دُونِ ٱللَّهِ قُرْبَانًا ءَالِهَةً ۖ
بَلْ ضَلُّوا۟ عَنْهُمْ ۚ وَذَٰلِكَ إِفْكُهُمْ وَمَا كَانُوا۟ يَفْتَرُونَ ﴿٢٨﴾
٥٠٥

22. **Ata i thanë: "A mos ke ardhur që të na largosh prej zotave tanë?! Po të jesh kaq i sigurt, na e sill tani atë që na e paralajmëron!"**

23. **Ai tha: "Dijeninë për të e ka vetëm Allahu. Unë thjesht ju kumtoj atë për të cilën jam dërguar. Megjithatë, po shoh se qenkeni njerëz krejt pa dije!".**

24. **Kur ata panë një ré, që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, thanë: "Kjo ré po sjell shiun!" - "Jo, - tha ai – kjo është ajo që ju e kërkonit me ngut: një stuhi, që mbart një dënim të dhembshëm,**

25. **dhe që, me urdhrin e Zotit të saj, shkatërron çdo gjë." Kur agoi, nuk shihej gjë tjetër, përveç banesave të tyre. Kështu i ndëshkojmë Ne popujt keqbërës!**

26. **Ne u kishim dhënë atyre gjëra që nuk jua kemi dhënë juve. Ne u dhamë atyre dëgjim, shikim dhe zemër, por as dëgjimi, as shikimi e as zemrat e tyre nuk u bënë dobi, sepse ata mohonin faktet e Allahut, prandaj edhe i përfshiu ai me të cilin talleshin.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Kujto vëllanë e fisit Ad..." – Kuptimi: Kujto me respekt profetin e popullit të Adit, pra, Hudin (a.s.). Ai ishte një ndër profetët e Zotit, që u veçua mbi të tjerët, për të ftuar njerëzit në rrugën e drejtë. Profetët janë udhërrëfyesit e njerëzve për te Krijuesi i tyre.

- "...që paralajmëroi fisin e vet në Ahkaf..." - Allahu i Madhëruar e dërgoi Hudin (a.s.) tek fisi i tij Ad, që jetonte në Ahkaf, në shkretëtirën e madhe të Jemenit.

- "...megjithëse pati edhe paralajmërues të tjerë, qoftë para apo pas tij." – Profeti Hud nuk ishte një risi. Ai nuk ishte i pari i të dërguarve të Zotit. Ai nuk ishte as kundërshtues i profetëve të tjerë të mëparshëm. Ashtu si të gjithë profetët, ai i tha popullit të tij:

- "Të mos adhuroni asgjë tjetër veç Allahut, se unë i druhem dënimit të Ditës së Madhe për ju!" - Ai i porositi të adhuronin Allahun nëpërmjet çdo fjale të mirë dhe pune të dashur për Allahun, si dhe i ndaloi nga idhujtaria. Ai i paralajmëroi, gjithashtu, për një ndëshkim të rëndë, nëse nuk do t'i bindeshin. Por ky paralajmërim nuk ndikoi aspak tek ata:

- "Ata i thanë: "A mos ke ardhur që të na largosh prej zotave tanë?!" - Kuptimi: Ti nuk ke asnjë qëllim të lartë, por ke vetëm zili për idhujt tanë, prandaj edhe dëshiron që të na largosh prej tyre, pa të drejtë!

- "Po të jesh kaq i sigurt, na e sill tani atë që na e paralajmëron!" - Ky është kulmi i injorancës dhe i arrogancës: të kërkosh përshpejtimin e ndëshkimit të Zotit në formë sfide!

- "Ai tha: "Dijeninë për të e ka vetëm Allahu. Unë thjesht ju kumtoj atë për të cilën jam dërguar."" - Është Allahu i Madhëruar, Ai që ka në dorë të gjitha çështjet. Ai ka edhe diturinë për gjithçka. Është Ai që e sjell ndëshkimin për ju, nëse dëshiron. Ndërsa unë, si çdo profet tjetër, kam për detyrë veçse përcjelljen e qartë të së vërtetës dhe mesazhit të Zotit.

- "Megjithatë, po shoh se qenkeni njerëz krejt pa dije!" – Ky qe shpjegimi i veprimeve të paturpshme dhe të nxituara të tyre. Ata guxuan të refuzonin të vërtetën e Zotit dhe, në formë sfide, të kërkonin përshpejtimin e ndëshkimit të Tij. Prandaj i Plotfuqishmi lëshoi kundër tyre ndëshkimin e rëndë: një furtunë, e cila i shkatërroi tërësisht. Të mjerët, kur panë në qiell renë e ndëshkimit që po afrohej, nuk ua mori mendja se çfarë ishte, për shkak të mendjemadhësisë që i karakterizonte!

- "Kur ata panë një ré, që u duk se vinte në drejtim të luginave të tyre, thanë: "Kjo ré po sjell shiun!" - Ata menduan se ishin re të mëdha, që zakonisht sjellin reshje. Kështu, ata po prisnin të binte shi mbi tokat e tyre, të mbusheshin puset dhe rezervuarët e tyre, që i shfrytëzonin për të pirë ujë vetë dhe për të vaditur të mbjellat. Të gëzuar, ata thanë: "Kjo re do të na sjellë shi!" Por nuk ishte ashtu:

- "Jo, - tha ai – kjo është ajo që ju e kërkonit me ngut..." - Kjo qe përgjigjja e kërkesës së tyre, kur thanë: "Po të jesh kaq i sigurt, na e sill tani atë që na e paralajmëron!"

- "...një stuhi, që mbart një dënim të dhembshëm..." - Ajo qe një erë aq e fortë, saqë kudo ku kalonte, shkatërronte dhe dëmtonte gjithçka. Kjo stuhi veproi egërsisht mbi ta, ashtu sikurse thotë i Madhëruari në ajete të tjera: "Adi u shkatërrua me një stuhi të fuqishme e të zhurmshme, që Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht. T'i shihje njerëzit të shembur përdhe, si të ishin trungje hurmash të zgavruara." [Haka 7, 8]. E gjitha kjo ndodhi me urdhrin e Allahut të Madhëruar.

Pas këtyre ditëve dhe netëve ndëshkimi, duke treguar gjurmët e dhembshme që ajo la pas, Allahu thotë:

- "...dhe që, me urdhrin e Zotit të saj, shkatërron çdo gjë." Kur agoi, nuk shihej gjë tjetër, përveç banesave të tyre." - Çdo gjë ishte shkatërruar: kafshët, pasuritë dhe vetë ata.

- "Kështu i ndëshkojmë Ne popujt keqbërës!" - Për shkak të krimeve dhe padrejtësive të tyre, e meritojnë ndëshkimin e Allahut të Lartësuar. Allahu i Madhëruar u dhuron begati të shumta, por ata nuk e lavdërojnë dhe nuk tregojnë mirënjohje ndaj Tij, siç thotë i Madhëruari për fisin Ad:

- "Ne u kishim dhënë atyre gjëra që nuk jua kemi dhënë juve." - Kuptimi: Ne u mundësuam atyre të kishin komoditet dhe pushtet, duke shfrytëzuar mirësitë Tona. Ne u mundësuam që të kënaqnin të gjitha

dëshirat e pasionet, duke u dhënë edhe jetë të mjaftueshme për këtë. Të gjitha këto shërbejnë që të marrin mësim të udhëzuarit në rrugën e drejtë. Ne i dhamë popullit të Adit gjithë ato mirësi, ashtu sikurse edhe juve, të cilëve po ju shpallet ky Kuran. Mos mendoni se këto të mira që ju keni, në pasuri apo në pushtet qofshin, janë të veçanta për ju. Kurrsesi mos mendoni se ato do t'ju shpëtojnë apo do t'ju ndihmojnë të shpëtoni nga ndëshkimi i Allahut! Madje, popujt paraardhës kanë qenë më të fuqishëm se ju, por pasuria, pushteti, fëmijët e ushtritë e tyre nuk i ndihmuan dhe as nuk i mbrojtën dot prej Allahut të Madhëruar.

- "Ne u dhamë atyre dëgjim, shikim dhe zemër..." - Ata nuk ishin aspak të mangët në të dëgjuar, të shikuar apo në logjikë, që të pretendonin se e braktisën të vërtetën nga paaftësia, pamundësia apo nga padituria. Logjika dhe aftësitë e tyre nuk ishin të mangëta, por është Allahu i Madhëruar dhe i Urtë që i jep sukses atij që Ai dëshiron.

- "...por as dëgjimi, as shikimi e as zemra e tyre nuk u bënë dobi, sepse ata mohonin faktet e Allahut..." - Këto rrugë të marrjes dhe perceptimit të së vërtetës nuk u bënë aspak dobi atyre. Sidoqoftë, kjo u shkaktua nga vetë ata, sepse qenë ata që refuzuan, mohuan dhe shpërfillën padrejtësisht faktet e Allahut, që vërtetonin pa lënë asnjë dyshim njëshmërinë e Allahut të Madhëruar në meritën e adhurimit.

- "...prandaj edhe i përfshiu ai me të cilin talleshin." - Ata i goditi pikërisht ai dënim, të cilin nuk e besonin dhe me të cilin talleshin. Ata talleshin edhe me Profetin, i cili i paralajmëronte për afrimin e dënimit të Allahut.

Ajetet 27 – 28

27. Ne kemi shkatërruar qytete përreth jush edhe më parë, duke ua shpjeguar fillimisht Shpalljen Tonë, me qëllimin se ndoshta mund të kthenin rrugë.
28. Përse atyre nuk u erdhën në ndihmë idhujt, të cilët i adhuronin krahas Allahut, me qëllim që t'u afroheshin? Vërtet, idhujt i braktisin ata, sepse janë thjesht sajesa dhe iluzione të tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne kemi shkatërruar qytete përreth jush edhe më parë, duke ua shpjeguar fillimisht Shpalljen Tonë..." - Duke paralajmëruar arabët, por edhe çdo popull tjetër, Allahu i Madhëruar u kujton shkatërrimin e popujve të mëparshëm, që kishin mohuar profetët, popuj të cilët jetonin rreth e rrotull vendbanimeve të arabëve. Madje, shumë prej tyre jetonin në Gadishullin Arabik, si populli i Adit, i Themudit e të tjerë.

Por para se t'i shkatërronte, Allahu i Madhëruar u solli një larmi shenjash dhe mrekullish, dhe të gjitha këto me një qëllim:

- "...me qëllimin se ndoshta mund të kthenin rrugë." – Kjo u bë me qëllimin që ata t'i largoheshin rrugës së kufrit, rrugës së mohimit të profetëve dhe shpalljeve të Zotit. Por kur ata nuk e bënë këtë, Allahu i ndëshkoi, ashtu siç di të ndëshkojë i Plotfuqishmi, dhe atyre nuk u erdhën në ndihmë idhujt, që ata i adhuronin krahas Allahut. I Madhëruari thotë:


- "Përse atyre nuk u erdhën në ndihmë idhujt, të cilët i adhuronin krahas Allahut,

me qëllim që t'u afroheshin?" – Kuptimi: Për t'iu afruar idhujve, ata i adhuronin e u kushtonin flijime, duke shpresuar ndihmë dhe begati prej tyre. Përse, atëherë, nuk u ndihmuan?!

- "Vërtet, idhujt i braktisin ata, sepse janë thjesht sajesa dhe iluzione të tyre." - Idhujt nuk u përgjigjen atyre, duke mos i mbrojtur dot nga dënimi në ahiret, ashtu sikurse edhe në dynja nuk kanë asnjë mundësi për t'i ndihmuar. Çdo gjë është nën pushtetin e Allahut. Idhujt janë thjesht sajime të politeistëve, me të cilët ata gënjejnë veten dhe justifikojnë mosbesimin e tyre. Ata e ushqejnë veten me ëndrra të pabaza, duke pandehur se janë në të vërtetën dhe se adhurimet që ua përkushtojnë idhujve do t'u bëjnë dobi e do t'i shpëtojnë. Por këto iluzione e shpresa të kota tashmë u shuhen dhe shkatërrohen njëherë dhe përgjithmonë.

Ajetet 29 – 32

29. Përkujto kur drejtuam disa xhindë tek t'i, që të dëgjonin Kuranin. Ata u afruan, e dëgjuan dhe thanë: "Heshtni!" Në përfundim, ata u kthyen te populli i vet si këshillues.
30. Atje thanë: "O populli ynë! Ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait, që vërteton ata para tij, që udhëzon tek e vërteta dhe në rrugën e drejtë!
31. O populli ynë! Përgjigjjuni thirrësit të Allahut dhe besojini atij! Allahu ju fal gjynahet dhe ju shpëton prej ndëshkimit të dhembshëm.
32. Ata që nuk i përgjigjen thirrësit në rrugën e Allahut, nuk kanë për t'i shpëtuar dënimit në tokë dhe, përveç Allahut, ata nuk kanë se kush t'i mbrojë. Të tillët janë në humbje të sigurt!"


الجزء السادس والعشرون سورة الأحقاف

وَإِذْ صَرَفْنَآ إِلَيْكَ نَفَرًا مِّنَ ٱلْجِنِّ يَسْتَمِعُونَ ٱلْقُرْءَانَ فَلَمَّا
حَضَرُوهُ قَالُوٓا۟ أَنصِتُوا۟ ۖ فَلَمَّا قُضِىَ وَلَّوْا۟ إِلَىٰ قَوْمِهِم مُّنذِرِينَ
﴿٢٩﴾ قَالُوا۟ يَٰقَوْمَنَآ إِنَّا سَمِعْنَا كِتَٰبًا أُنزِلَ مِنۢ بَعْدِ مُوسَىٰ
مُصَدِّقًا لِّمَا بَيْنَ يَدَيْهِ يَهْدِىٓ إِلَى ٱلْحَقِّ وَإِلَىٰ طَرِيقٍ مُّسْتَقِيمٍ
﴿٣٠﴾ يَٰقَوْمَنَآ أَجِيبُوا۟ دَاعِىَ ٱللَّهِ وَءَامِنُوا۟ بِهِۦ يَغْفِرْ لَكُم مِّن
ذُنُوبِكُمْ وَيُجِرْكُم مِّنْ عَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٣١﴾ وَمَن لَّا يُجِبْ دَاعِىَ ٱللَّهِ
فَلَيْسَ بِمُعْجِزٍ فِى ٱلْأَرْضِ وَلَيْسَ لَهُۥ مِن دُونِهِۦٓ أَوْلِيَآءُ ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ
فِى ضَلَٰلٍ مُّبِينٍ ﴿٣٢﴾ أَوَلَمْ يَرَوْا۟ أَنَّ ٱللَّهَ ٱلَّذِى خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ
وَٱلْأَرْضَ وَلَمْ يَعْىَ بِخَلْقِهِنَّ بِقَٰدِرٍ عَلَىٰٓ أَن يُحْۦِىَ ٱلْمَوْتَىٰ ۚ بَلَىٰٓ
إِنَّهُۥ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿٣٣﴾ وَيَوْمَ يُعْرَضُ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ عَلَى ٱلنَّارِ
أَلَيْسَ هَٰذَا بِٱلْحَقِّ ۖ قَالُوا۟ بَلَىٰ وَرَبِّنَا ۚ قَالَ فَذُوقُوا۟ ٱلْعَذَابَ بِمَا
كُنتُمْ تَكْفُرُونَ ﴿٣٤﴾ فَٱصْبِرْ كَمَا صَبَرَ أُو۟لُوا۟ ٱلْعَزْمِ مِنَ ٱلرُّسُلِ
وَلَا تَسْتَعْجِل لَّهُمْ ۚ كَأَنَّهُمْ يَوْمَ يَرَوْنَ مَا يُوعَدُونَ لَمْ يَلْبَثُوٓا۟ إِلَّا
سَاعَةً مِّن نَّهَارٍۭ ۚ بَلَٰغٌ ۚ فَهَلْ يُهْلَكُ إِلَّا ٱلْقَوْمُ ٱلْفَٰسِقُونَ ﴿٣٥﴾
سورة محمد
٥٠٦

Shpjegimi i ajeteve

- "Përkujto kur drejtuam disa xhindë tek t'i, që të dëgjonin Kuranin." - Allahu i Madhëruar e dërgoi profetin Muhamedin (a.s.) si mëshirë dhe udhëzues për të gjitha krijesat, për njerëzit dhe për xhindët. Ishte detyra e Profetit që t'i ftonte të gjithë në rrugën e Zotit dhe t'ua përcillte qartë të vërtetën e shpallur nga Zoti.

Sa u përket njerëzve, Profeti (a.s) i ftonte dhe paralajmëronte ata haptazi, pasi kjo ishte diçka e mundshme. Ndërsa sa u përket xhindëve, Allahu i Madhëruar, me pushtetin e Tij, i solli ata te Profeti (a.s.), që të dëgjonin mesazhin e përcjellë nga ai. Thotë i Lartësuari:

- "Ata u afruan, e dëgjuan dhe thanë: "Heshtni!" - Kur ata iu afruan Profetit (a.s.), që ishte duke kënduar Kuranin, porositën

njëri-tjetrin për të qëndruar të bashkuar dhe në heshtje, me qëllim që të dëgjonin më mirë dhe më qartë.

- **"Në përfundim, ata u kthyen te populli i vet si këshillues."** – Në përfundim të këndimit të Kuranit, ata e kishin kuptuar mirë mesazhin e tij, prandaj shkuan menjëherë te populli i tyre, tani si këshillues e udhëzues. Allahu i Madhëruar i bëri muslimanë dhe u mundësoi atyre të bëheshin përhapës së ftesës së Profetit (a.s.) ndër xhindë.

- "Atje thanë: "O populli ynë! Ne dëgjuam një libër të shpallur pas Musait..." - Ata përmendën Librin e Musait, sepse ai ishte në themel edhe të Ungjillit. Gjithashtu, ai ishte libri bazë, ku bijtë e Israilit mbështeteshin për marrjen e dispozitave ligjore. Ndërsa Ungjilli ishte plotësues i Teuratit, ashtu sikurse edhe lehtësues për disa dispozita.

Pastaj, ata e përshkruajnë Kuranin duke thënë:

- "...që vërteton ata para tij, që udhëzon tek e vërteta dhe në rrugën e drejtë!" – Kuptimi: Libri që e dëgjuam nga ky profet është vërtetues i librave të parë hyjnorë dhe udhëzues në rrugën e drejtë. Ai tregon rrugën që të çon tek Allahu dhe Xheneti i Tij. Ky libër udhëzon nëpërmjet diturisë së jashtëzakonshme mbi Allahun e Madhëruar, diturisë rreth dispozitave ligjore dhe rregullave të jetës dhe të adhurimit, si dhe diturisë për shpërblimin dhe ndëshkimin e Allahut të Madhëruar.

Pasi lavdëruan Kuranin, duke treguar gradën dhe rëndësinë e lartë të tij, xhindët filluan të ftonin popullin e tyre që ta besonin këtë libër dhe mesazhet e këtij profeti, duke thënë:

- **"O populli ynë! Përgjigjjuni thirrësit të Allahut dhe besojini atij!"** - Bindjuni atij që ju fton në adhurimin e Allahut si Një të vetëm dhe që nuk ka asnjë interes personal ndaj jush. Ai thjesht ju fton që të lidheni fort me Zotin tuaj dhe të arrini shpërblimin që fal bujaria e Tij. Ai ju thërret që të fitoni të mirat dhe të largoni nga vetja të gjitha të këqijat e ligësitë.

- "Allahu ju fal gjynahet dhe ju shpëton prej ndëshkimit të dhembshëm." - Nëse Allahu ju fal gjynahet, të cilët janë shkaktarë të shumë sprovave, dhe nëse ju shpëtoni nga ndëshkimi i dhimbshëm, atëherë mbetet të vijnë veç të mirat dhe lumturia e përjetshme. Ky është shpërblimi për këdo që i përgjigjet ftuesit të Allahut për në rrugën e drejtë.

- **"Ata që nuk i përgjigjen thirrësit në rrugën e Allahut, nuk kanë për t'i shpëtuar dënimit në tokë dhe, përveç Allahut, ata nuk kanë se kush t'i mbrojë."** - Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka. Asgjë nuk mund t'i shpëtojë pushtetit të Tij. Askush nuk mund të arratiset e të fshihet prej Tij dhe askush nuk mund të përballet e të fitojë kundër Tij.

- **"Të tillët janë në humbje të sigurt!"** - E ku ka më të humbur se ata që ftohen në rrugën e Zotit, që e dëgjojnë dhe kanë të qartë mesazhin e Tij, që vihen përballë argumenteve të pakundërshtueshme të Tij, që mësojnë premtimet e Tij, dhe pastaj me arrogancë e refuzojnë këtë ftesë?!

Ajeti 33

33. A nuk e dinë ata se Allahu, i Cili krijoi qiejt dhe Tokën dhe nuk u lodh me krijimin e tyre, është i Plotfuqishëm që t'i ngjallë të vdekurit?! Po, Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Shpjegimi i ajetit

Ky është një argumentim shumë i bukur dhe i kuptueshëm i Allahut i Madhëruar për vërtetësinë e ringjalljes pas vdekjes. Ai që është i Plotfuqishëm që të krijojë qiejt dhe Tokën, aq madhështore, të përsosura e të rregullta, pa u lodhur dhe pa pasur vështirësi, si mund të mendohet se e ka të vështirë që t'i rikthejë në jetë njerëzit, pas vdekjes së tyre?! Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.

Ajetet 34 – 35

34. Ata ditë, kur jobesimtarët përballen me Zjarrin: "Po tani, a nuk është i vërtetë?!" Ata thonë: "Po, për Zotin tonë!" Ai do t'u thotë: "Atëherë vuani dënimin, për shkak të mohimit tuaj!"
35. Prandaj, t'i bëhu i durueshëm, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur, dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ta! Ditën kur të marrin atë që u është premtuar, atyre do t'u duket sikur kanë jetuar vetëm se një çast të ditës. Ky është njoftim i qartë! E kush tjetër meriton të shkatërrohet, përveç atyre që janë të pabindur?!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ata ditë, kur jobesimtarët përballen me Zjarrin..."** - Allahu i Madhëruar na njofton për gjendjen e tmerrshme dhe të shëmtuar të qafirëve kur përballen me Zjarrin dhe dënimin, të cilin nuk e besonin se do të ndodhte dhe madje talleshin me ata që i këshillonin për t'u ruajtur prej tij. Atyre do t'u shtohet dëshpërimi dhe dhimbja kur t'u thuhet:

- **"Po tani, a nuk është i vërtetë?!"** – Kuptimi: Si ju duket ky dënim, të cilin e merrnit për tallje? A e besoni tani, që e shihni dhe e vuani me gjithë qenien tuaj?!

- "**Ata thonë: "Po, për Zotin tonë!"** - Kështu i pranojnë ata gjynahet dhe krimet e tyre. Kështu del në pah edhe mashtrimi i tyre. Atëherë u thuhet:

- **"Atëherë vuani dënimin, për shkak të mohimit tuaj!"** - Ky ndëshkim nuk do t'ju ndahet kurrë. Ashtu sikurse mohimi juaj i të vërtetës në jetën e dynjasë ishte i përhershëm nga ana juaj, ashtu do të jetë edhe ndëshkimi juaj në ahiret.

Në vijim, Allahu i Madhëruar e porosit Profetin e Tij që të tregojë durim ndaj mundimeve dhe fyerjeve që i bëjnë mohuesit dhe armiqtë e të vërtetës, si edhe të mos reshtë së ftuari në rrugën e Tij. Ai e porosit, gjithashtu, që të marrë shembull durimin e profetëve më të zgjedhur dhe të dalluar, të krijesave më të përkryera dhe më të mira.

- **"Prandaj, t'i bëhu i durueshëm, ashtu sikurse duruan të dërguarit e vendosur..."** - Profetët ishin të gjithë të paepur. Durimi i tyre ushqehej vazhdimisht nga siguria në premtimin e Zotit. Ata ishin shembull e dritë edhe për rrugën e Profetit të fundit.

Dhe, me të vërtetë, Profeti (a.s.) e zbatoi me korrektësi porosinë e Zotit të tij. Ai bëri një durim, që askush para tij nuk e kishte bërë. Të gjithë armiqtë e të vërtetës u mblodhën si grusht i vetëm për ta

gjunjëzuar dhe penguar nga përhapja e mesazhit të Zotit. Ata përdorën çdo mënyrë dhe mjet luftimi për ta zbrapsur, ndërsa ai qëndronte i patundur në zbatimin e porosive të Zotit të tij dhe në luftën kundër të keqes. Ai nuk u lëkund asnjëherë nga mundimet dhe vuajtjet që i shkaktoheshin në rrugën e përhapjes së të vërtetës, derisa Zoti e bëri t'i vinte përfund armiqtë e tij. Kështu, mesazhi i Zotit u përhap në të gjithë botën anembanë dhe feja e Tij triumfoi mbi të gjitha fetë e tjera. Allahu i Madhëruar e bëri ymetin e Muhamedit më të mirin të dalë për të mirën e njerëzimit. Paqja bekimet e mirësitë e Zotit qofshin mbi të Dërguarin e Tij!

- **"...dhe mos kërko shpejtimin e dënimit për ta!"** - Mos u ngut për ndëshkimin e këtyre mohuesve, të cilët e kërkojnë vetë përshpejtimin e ndëshkimit, sepse kjo vjen nga injoranca dhe mendjelehtësia e tyre. Mos bjer në nivelin e këtyre të mjerëve dhe mos u nxito të lutesh kundër tyre! Ata janë krejt të parëndësishëm, aq sa edhe për t'u lutur kundër tyre nuk ia vlen. Çdo gjë që pritet të ndodhë, do të ndodhë, prandaj nuk ka nevojë të nxitohesh për ta!

- **"Ditën kur të marrin atë që u është premtuar, atyre do t'u duket sikur kanë jetuar vetëm se një çast të ditës."** - Kur ta shohin atë që u është premtuar, atëherë do ta kuptojnë se në dynja kanë kaluar veçse një kohë të shkurtër. Për këtë arsye, t'i mos u gënje nga luksi i tyre në këtë jetë! Këto kënaqësi të shkurtra të tyre janë të papërfillshme, në krahasim me ndëshkimin e rëndë që i pret, të cilin ata e shpërfillin, por nga i cili nuk do të shpëtojnë dot.

- **"Ky është njoftim i qartë!"** – Kuptimi: Është njoftim i qartë se kjo dynja, me bukuritë e saj, është një kënaqësi që të ngec në fyt, e lodhshme për t'u arritur dhe brengosëse pasi arrihet. Ajo është thjesht harxhim ose humbje e kohës së shkurtër që të është dhënë për ta jetuar.

Ky qe njëri nga kuptimet e kësaj fjalie. Kuptimi tjetër është: Kurani madhështor, në të cilin ju kemi shpjeguar gjithçka në mënyrë të plotë, është udhërrëfyesi dhe furnizimi juaj, që ju duhet për të arritur lumturinë në ahiret. Ai të çon në vendin e mirësive dhe të mbron nga ndëshkimi i dhimbshëm. Ai është udhërrëfyesi dhe furnizimi më i mirë që kanë pasur ndonjëherë krijesat dhe mirësia më e madhe që Krijuesi u ka dhuruar atyre.

- **"E kush tjetër meriton të shkatërrohet, përveç atyre që janë të pabindur?!"** - Ndëshkimet godasin veç të pabindurit, të cilët i kalojnë kufijtë e Allahut dhe nuk kanë asnjë të mirë. Ata i janë larguar bindjes ndaj Allahut dhe nuk e pranojnë të vërtetën që kanë përcjellë profetët. Allahu i Lartësuar u ka sjellë udhëzime e paralajmërime, por ata e shpërfillin thirrjen e Tij.

E lusim Allahun të na ruajë dhe mbrojë nga çdo rrugë humbjeje e devijimi! Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botërave!

Surja 47: Muhamed (medinase) 38 ajete

Ajetet 1 – 3


Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. **Atyre që nuk besojnë, madje që pengojnë edhe të tjerët nga rruga e Allahut, Ai ua asgjëson veprat.**
2. **Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e vërteta prej Zotit të tyre, ua mbulon të këqijat dhe ua përmirëson gjendjen.**
3. **Kjo, sepse ata që nuk besojnë ndjekin të pavërtetën, ndërsa ata që besojnë ndjekin të vërtetën që ka ardhur prej Zotit të tyre. Kështu ua sjell shembujt Allahu njerëzve.**

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete flitet për shpërblimin e besimtarëve dhe ndëshkimin e gjynahqarëve, që të shërbejë si mësim për krijesat dhe si ftesë për të përqafuar rrugën e drejtë. I Lartësuari thotë:

- **"Atyre që nuk besojnë, madje që pengojnë edhe të tjerët nga rruga e Allahut, Ai ua asgjëson veprat."** - Këta janë krerët e kufrit ose udhëheqësit për në humbje e dëshpërim. Ata jo vetëm që e refuzojnë për vete të besojnë Zotin dhe Shpalljen e Tij, por luftojnë që të pengojnë edhe të tjerët nga rruga e drejtë e besimit të sinqertë në gjithçka që kanë udhëzuar profetët. Këtij lloji të njerëzve Allahu i Madhëruar ua asgjëson veprat. Ai nuk pranon asgjë nga mundi i shpenzuar prej tyre. Madje, veprat e tyre janë shkaku pse ata do të ndëshkohen.


الجزء السادس والعشرون سورة محمد
بسم الله الرحمن الرحيم
الذين كفروا وصدوا عن سبيل الله أضل أعمالهم ١ والذين
ءامنوا وعملوا الصلحت وءامنوا بما نزل على محمد وهو الحق من
ربهم كفر عنهم سيئاتهم وأصلح بالهم ٢ ذلك بأن الذين كفروا
اتبعوا الباطل وأن الذين ءامنوا اتبعوا الحق من ربهم كذلك يضرب
الله للناس أمثالهم ٣ فإذا لقيتم الذين كفروا فضرب الرقاب حتى
إذا أثخنتموهم فشدوا الوثاق فإما منا بعد وإما فداء حتى تضع الحرب
أوزارها ذلك ولو يشاء الله لانتصر منهم ولكن ليبلوا بعضكم
ببعض والذين قتلوا في سبيل الله فلن يضل أعمالهم ٤ سيهديهم
ويصلح بالهم ٥ ويدخلهم الجنة عرفها لهم ٦ يأيها الذين
ءامنوا إن تنصروا الله ينصركم ويثبت أقدامكم ٧ والذين كفروا
فتعسا لهم وأضل أعمالهم ٨ ذلك بأنهم كرهوا ما أنزل الله
فأحبط أعمالهم ٩ أفلم يسيروا في الأرض فينظروا كيف كان
عاقبة الذين من قبلهم دمر الله عليهم وللكافرين أمثالها ١٠ ذلك
بأن الله مولى الذين ءامنوا وأن الكافرين لا مولى لهم ١١
الجزء ٥١
٥٠٧

Ndër veprat më të shëmtuara të tyre janë lufta, intrigat dhe kurthet e tyre, me të cilat ata synojnë të godasin e zhdukin të vërtetën dhe përhapësit e saj, të dashurit e Allahut dhe pasuesit e denjë të profetëve të Tij. Por Allahu i Madhëruar ua kthen ato kurthe t'i vuajnë mbi kurriz. Ata nuk arrijnë asnjë qëllim të vetin.

Gjithashtu, edhe veprat e tyre "të mira", për të cilat shpresojnë se do të shpërblehen, Allahu i Madhëruar do t'ua asgjësojë, prandaj ata nuk do të marrin kurrë atë që shpresojnë. Ky është një vendim i drejtë i të Urtit, sepse ata ndjekin të kotën dhe refuzojnë të vërtetën. Çdo vepër me të cilën nuk synohet të kënaqet Allahu, është e refuzuar dhe e asgjësuar. Të tilla janë adhurimet e përkushtuara idhujve, putave dhe çdo të adhuruari tjetër, veç Zotit Një dhe të Vetëm. Të tilla janë edhe veprat me të cilat synohet që të mbështetet e kota. Çdo

punë me të cilën mbështetet e kota është e asgjësuar dhe e papranueshme nga Allahu i Madhëruar.

- "Ndërsa atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe e besojnë atë që iu shpall Muhamedit, e cila është e vërteta prej Zotit të tyre..." - Këta janë njerëzit që i besojnë të gjitha shpalljet dhe profetët e Zotit dhe, në mënyrë të veçantë, Shpalljen që iu dha Muhamedit (a.s.). Përveç besimit të saktë dhe të sinqertë, ata bëjnë vepra të mira, duke plotësuar detyrimet ndaj Allahut dhe detyrimet ndaj krijesave. Të tillëve, Allahu i Madhëruar u dhuron mirësi të shumta. Ndër to, Ai përmend:

- "...ua mbulon të këqijat..." – Ai ua mbulon të këqijat që bëjnë në dynja, qofshin gjynahe të vogla apo të mëdha. 'Mbulim i gjynaheve' do të thotë shpëtim nga ndëshkimi i dynjasë dhe i ahiretit.

- "...dhe ua përmirëson gjendjen." - Nëpërmjet besimit të drejtë dhe veprave që kryhen sipas këtij besimi, Allahu i Madhëruar ua rregullon gjendjen në dynja dhe në ahiret. Ai ua pastron zemrat dhe ua përmirëson më tej veprat e mira, duke ua shumëfishuar numrin këtyre të fundit dhe duke ua shtuar shpërblimin, me bujarinë e Tij. Kështu, Allahu i Madhëruar e rregullon gjendjen e tyre në të gjitha drejtimet.

Po cili është shkaku i kësaj bujarie? I Madhëruari thotë:

- "Kjo, sepse ata që nuk besojnë ndjekin të pavërtetën, ndërsa ata që besojnë ndjekin të vërtetën që ka ardhur prej Zotit të tyre." – Ata e ndjekin të vërtetën duke respektuar dy parime të saj: sinqeritetin ndaj të Adhuruarit, duke e kryer çdo vepër vetëm për Të, dhe, së dyti, duke patur sigurinë e plotë se kjo e vërtetë është prej Zotit dhe se çdo shpërblim i premtuar nga i Madhëruari do të jepet.

E vërteta iu dhurua nga Zoti i tyre, i Cili kujdeset gjithmonë që ata ta duan të vërtetën dhe ta pasojnë atë. Nëse ata e përqafojnë të vërtetën e sjellë nga Zoti i tyre, Ai ua rregullon të gjitha çështjet. Me qëllimin e sinqertë për hir të Allahut, që është i Përjetshëm dhe i Vërtetë, veprat e tyre janë pranueshme dhe të shpërblyeshme nga Ai. Ky shpërblim do të jetë pa masë, i mrekullueshëm dhe i përjetshëm.

- "Kështu ua sjell shembujt Allahu njerëzve." - Allahu i Madhëruar i përshkroi edhe të mirët, edhe të këqijtë me cilësitë e tyre, në mënyrë që çdokush të jetë i qartë se cilit grup do t'i përkasë, me veprat që do të kryejë.

Ajetet 4 – 6

4. Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditini në qafë, derisa t'i dërrmoni! Më pas, lidhini mirë, e kështu mund t'i lironi falas ose mund të kërkoni çmim për ta, derisa të përfundojë lufta. Po të donte, Allahu jua jepte fitoren ndaj tyre, por Ai dëshiron që t'ju sprovojë me njëri-tjetrin. Atyre që bien dëshmorë në rrugën e Allahut, Ai nuk ua humbet kurrë veprat!
5. Ai i udhëzon dhe e përmirëson gjendjen e tyre.
6. Ai do t'i fusë ata në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar i udhëzon adhuruesit e Tij në gjithçka të mirë, që u mundëson

atyre begati, lumturi dhe fitore mbi armiqtë. Ai thotë:

- "Kur të ndesheni me jobesimtarët, goditini në qafë, derisa t'i dërrmoni!" - Nëse përballeni në luftë me mohuesit, luftoni me trimëri dhe gjuajini pa mëshirë në qafa, derisa t'i sfilitni e t'i mposhtni. Pasi t'i mundni, nëse e shihni si më të dobishme që t'i mbani robërit e luftës, atëherë mbajini, por:

- "Më pas, lidhini mirë, e kështu mund t'i lironi falas ose mund të kërkoni çmim për ta..." – Kini kujdes, që robërit të mos ju shpëtojnë! Lidhini mirë, që të mos kenë mundësi të arratisen. Për robërit, ju jeni të lirë të zgjidhni: ose t'i lironi pa kërkuar çmim për lirimin e tyre, ose t'i mbani derisa ata ose miqtë e tyre të paguajnë për lirinë e tyre, ose edhe mund t'i shkëmbeni me robër muslimanë, që janë tek ata. Kështu le të vazhdojë, derisa:

- "...të përfundojë lufta." – Pra, derisa të përfundojë lufta dhe të arrini paqe ose armëpushim me ta.

Çdo kohë dhe situatë ka rregullat që i përshtaten më mirë. Rregulli i mësipërm vlen gjatë kohës së luftës, ndërsa në të kundërt, nëse nuk ka luftë, atëherë nuk flitet më për robër e vrasje.

- "Po të donte, Allahu jua jepte fitoren ndaj tyre..." – Kuptimi: Nëpërmjet sprovës së luftës, ngrihet 'tregu' i xhihadit dhe zbulohen qartë cilësitë e vërteta të robërve, duke u dalluar të sinqertët nga gënjeshtarët. Madje, në të tilla raste, besimi i atyre që besojnë drejt shtohet më tepër. Ndërsa ata që nuk kanë besim të drejtë, por kanë vetëm interesa të kësaj dynjaje, bëhen palë vetëm me ata që fitojnë. Për këtë arsye, besimi i tyre nuk vazhdon gjatë, por arrin edhe të zhduket gjatë sprovave e vështirësive.

- "...por Ai dëshiron që t'ju sprovojë me njëri-tjetrin." - Allahu i Madhëruar ka vendosur që t'i sprovojë besimtarët me jobesimtarët, duke bërë që ditët e fitoreve të vërtiten mes tyre, domethënë duke fituar herë njëra palë e herë tjetra. Por po të dëshironte Allahu i Madhëruar, Ai do të bënte që muslimanët t'i mposhtnin gjithmonë qafirët, sepse Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka. Po do të dëshironte, Ai do të bënte që qafirët të mos provonin kurrë fitore mbi muslimanët, por Allahu i Urtë e ka një qëllim. Ai thotë:

- "Atyre që bien dëshmorë në rrugën e Allahut, Ai nuk ua humbet kurrë veprat!" - Ata kanë një shpërblim shumë të madh, sepse kanë luftuar kundër armiqve të Zotit, me synimin që fjala e Zotit të jetë më e larta. Allahu i Lartësuar nuk ka për t'ua humbur kurrë veprat atyre. Përkundrazi, Ai do t'ua pranojë, madje do t'ua kultivojë e shtojë më tepër.

- "Ai i udhëzon dhe e përmirëson gjendjen e tyre." - Allahu i Madhëruar i udhëzon ata drejt Xhenetit, duke i bërë të qëndrueshëm në këtë rrugë. Gjithashtu, Ai përmirëson gjendjen dhe çështjet e tyre. Ai ua shumëfishon shpërblimin për veprat që kanë bërë, pa mundime e vështirësi nga ana e tyre.

- "Ai do t'i fusë ata në Xhenet, të cilin ua ka bërë të njohur më parë." - Allahu i Madhëruar ua ka prezantuar e përshkruar

me hollësi Xhenetin, duke i bërë të përmallohen për të. Ai u ka treguar edhe veprat që të çojnë në Xhenet, mes të cilave është edhe lufta në rrugën e Zotit. Në fakt, është Allahu i Madhëruar Ai që u jep sukses të zbatojnë atë që janë urdhëruar ta zbatojnë. Më pas, Ai i fut ata në Xhenet, duke i drejtuar te gradat më larta. Kështu, Ai i lumturon ata, me stolitë e mrekullueshme të Xhenetit. Atje ata do të jetojnë në paqe e siguri, dhe kjo do të vazhdojë përgjithmonë.

Ajetet 7 – 9

7. O ju që keni besuar! Nëse ju ndihmoni Allahun, Ai ju ndihmon ju dhe jua forcon këmbët tuaja.
8. Ndërsa ata që nuk besojnë, qofshin të shkatërruar! Ai i asgjëson veprat e tyre.
9. Ata e urrejnë Shpalljen e Allahut, prandaj Ai i asgjëson veprat e tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Nëse ju ndihmoni Allahun, Ai ju ndihmon ju dhe jua forcon këmbët tuaja." - Ky është një urdhër që Allahu i Madhëruar u drejton besimtarëve, që ata të ndihmojnë fenë e Tij, duke jetuar sipas saj, duke e zbatuar atë për veten e tyre, duke ftuar të tjerët të jetojnë sipas saj e duke luftuar armiqtë e kësaj feje. Por çka është më e rëndësishme, me të gjitha këto vepra ata duhet të kenë si qëllim arritjen e kënaqësisë së Allahut të Madhëruar. Nëse ata veprojnë kështu, Allahu i Madhëruar ka për t'i ndihmuar, ka për t'u dhuruar fitore, ka për t'ua forcuar këmbët, besimin dhe pozitat e tyre. Ai do t'ua forcojë edhe zemrat, duke u dhuruar durim e qëndrueshmëri para çdo lloj vështirësie dhe para armiqve të së vërtetës. Ky është një premtim i dhënë nga Bujari, i Cili është Besnik në premtimet e Tij.


- "Ndërsa ata që nuk besojnë, qofshin të shkatërruar! Ai i asgjëson veprat e tyre." - Ndërsa ata që e mohojnë Zotin dhe rreshtohen me palën e të keqes, ata do të dështojnë gjithmonë në çështjet e tyre. Përpjekjet e tyre për të dobësuar dhe zhdukur të vërtetën, Allahu i Madhëruar ka për t'i shkatërruar. Të vetmit që do të rrënohen do të jenë ata. Allahu ka për t'ua kthyer mbi kokën e tyre intrigat që ata thurin. Edhe ato vepra me të cilat pretendojnë se do kënaqin Zotin, Ai ka për t'i asgjësuar dhe nuk do t'u japë asnjë shpërblim. Ky ndëshkim është i merituesham për ta, sepse:

- "Ata e urrejnë Shpalljen e Allahut, prandaj Ai i asgjëson veprat e tyre." - Ata e meritojnë humbjen, sepse e urrejnë atë që Zoti e shpalli si udhëzim për njerëzit, pra, Kuranin madhështor. Allahu i Lartësuar e shpalli Kuranin që të jetë rregullues dhe udhërrëfyes për robërit, për të arritur çdo të mirë e për të shpëtuar nga çdo e keqe, por ata nuk e pranojnë atë. Përkundrazi, ata e urrejnë Shpalljen e Zotit, e refuzojnë dhe e shpërfillin atë. Për këtë shkak, Allahu i Drejtë dhe i Urtë i asgjëson veprat e tyre.

Ajetet 10 – 11

10. A nuk udhëtojnë ata nëpër botë, për të parë se si qe përfundimi i më të hershmëve?! Allahu i rrënoi ata plotësisht, e po kështu do të përfundojnë të gjithë jobesimtarët!
11. Allahu është Miku i atyre që besojnë, kurse për jobesimtarët nuk ka miq!

Shpjegimi i ajeteve


الجزء السادس والعشرون سورة محمد
إِنَّ ٱللَّهَ يُدۡخِلُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ وَعَمِلُواْ ٱلصَّٰلِحَٰتِ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي مِن
تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُۖ وَٱلَّذِينَ كَفَرُواْ يَتَمَتَّعُونَ وَيَأۡكُلُونَ كَمَا تَأۡكُلُ ٱلۡأَنۡعَٰمُ
وَٱلنَّارُ مَثۡوٗى لَّهُمۡ ١٢ وَكَأَيِّن مِّن قَرۡيَةٍ هِيَ أَشَدُّ قُوَّةٗ مِّن قَرۡيَتِكَ
ٱلَّتِيٓ أَخۡرَجَتۡكَ أَهۡلَكۡنَٰهُمۡ فَلَا نَاصِرَ لَهُمۡ ١٣ أَفَمَن كَانَ عَلَىٰ بَيِّنَةٖ مِّن
رَّبِّهِۦ كَمَن زُيِّنَ لَهُۥ سُوٓءُ عَمَلِهِۦ وَٱتَّبَعُوٓاْ أَهۡوَآءَهُمۡ ١٤ مَّثَلُ ٱلۡجَنَّةِ ٱلَّتِي
وُعِدَ ٱلۡمُتَّقُونَۖ فِيهَآ أَنۡهَٰرٞ مِّن مَّآءٍ غَيۡرِ ءَاسِنٖ وَأَنۡهَٰرٞ مِّن لَّبَنٖ لَّمۡ يَتَغَيَّرۡ
طَعۡمُهُۥ وَأَنۡهَٰرٞ مِّنۡ خَمۡرٖ لَّذَّةٖ لِّلشَّٰرِبِينَ وَأَنۡهَٰرٞ مِّنۡ عَسَلٖ مُّصَفّٗىۖ وَلَهُمۡ
فِيهَا مِن كُلِّ ٱلثَّمَرَٰتِ وَمَغۡفِرَةٞ مِّن رَّبِّهِمۡۖ كَمَنۡ هُوَ خَٰلِدٞ فِي ٱلنَّارِ وَسُقُواْ
مَآءٗ حَمِيمٗا فَقَطَّعَ أَمۡعَآءَهُمۡ ١٥ وَمِنۡهُم مَّن يَسۡتَمِعُ إِلَيۡكَ حَتَّىٰٓ إِذَا
خَرَجُواْ مِنۡ عِندِكَ قَالُواْ لِلَّذِينَ أُوتُواْ ٱلۡعِلۡمَ مَاذَا قَالَ ءَانِفًاۚ أُوْلَٰٓئِكَ
ٱلَّذِينَ طَبَعَ ٱللَّهُ عَلَىٰ قُلُوبِهِمۡ وَٱتَّبَعُوٓاْ أَهۡوَآءَهُمۡ ١٦ وَٱلَّذِينَ ٱهۡتَدَوۡاْ
زَادَهُمۡ هُدٗى وَءَاتَىٰهُمۡ تَقۡوَىٰهُمۡ ١٧ فَهَلۡ يَنظُرُونَ إِلَّا ٱلسَّاعَةَ
أَن تَأۡتِيَهُم بَغۡتَةٗۖ فَقَدۡ جَآءَ أَشۡرَاطُهَاۚ فَأَنَّىٰ لَهُمۡ إِذَا جَآءَتۡهُمۡ
ذِكۡرَىٰهُمۡ ١٨ فَٱعۡلَمۡ أَنَّهُۥ لَآ إِلَٰهَ إِلَّا ٱللَّهُ وَٱسۡتَغۡفِرۡ لِذَنۢبِكَ
وَلِلۡمُؤۡمِنِينَ وَٱلۡمُؤۡمِنَٰتِۗ وَٱللَّهُ يَعۡلَمُ مُتَقَلَّبَكُمۡ وَمَثۡوَىٰكُمۡ ١٩
٥٠٨

- “A nuk udhëtojnë ata nëpër botë, për të parë se si qe përfundimi i më të hershmëve?! Allahu i rrënoi ata plotësisht, e po kështu do të përfundojnë të gjithë jobesimtarët!” - A nuk udhëtojnë nëpër botë këta mohues të së vërtetës dhe të shohin se si qe përfundimi i popujve pararendës, të cilët nuk pranuan të besonin mesazhet që profetët e Zotit u sollën? Le ta bëjnë këtë, dhe do të mësojnë se ai qe përfundimi më i keq. Le të shohin majtas e djathtas, e do të kuptojnë se ata u shkatërruan dhe u zhdukën nga faqja e dheut, për shkak të mohimit. Allahu u shkatërroi pasuritë, pushtetin e vendbanimet, bashkë me veprat dhe intrigat e tyre. Të njëjtin përfundim të dhimbshëm kanë pasur mohuesit e çdo kohe dhe vendi. Të gjithë i ka përfshirë ndëshkimi dhe janë bërë mësim për brezat.

Ndërsa besimtarët, Allahu i Lartësuar i shpëton nga ndëshkimi dhe i shpërblen me mirësi të shumta.

- “Allahu është Miku i atyre që besojnë...” - Allahu i Gjithëmëshirshëm përkujdeset për besimtarët, duke i nxjerrë ata nga errësirat në dritë. Ai kujdeset për ta duke u dhuruar sukses në çdo çështje dhe shpërblimin më të mirë për çdo vepër të bërë prej tyre.

- “...kurse për jobesimtarët nuk ka miq!” - Ata që mohojnë dhe refuzojnë përkujdesjen e posaçme të Allahut ia kanë mbyllur vetes portën e mëshirës së Tij. Për këta të mjerë nuk ka udhëzues, që mund t’i drejtojë në rrugën e paqes, ashtu siç nuk kanë ndonjë që mund t’i shpëtojë nga dënimi i Zotit. Miqtë e tyre, të cilëve ata u kanë besuar çështjet e tyre, janë idhujt dhe gjithçka që adhurohet veç Allahut. Miku i tyre është Shejtani, i cili i nxjerr ata nga drita, për t’i humbur tërësisht mes errësirave. Këta do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

Ajeti 12

12. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu do t’i fusë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Ndërsa për ata që nuk besojnë, të cilët bëjnë qejf dhe hanë ashtu si kafshët, Zjarri është vendi i tyre!

Shpjegimi i ajetit

Pasi tregoi se është Miku i dashur i besimtarëve, i Cili kujdeset plot mëshirë për ta, Allahu i Madhëruar na bën të ditur se si do të veprojë me ta në ahiret. Ai premton se do t’i fusë besimtarët në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, që ujitin pemët e bukura plot fruta.

Gjithashtu, pasi tregoi se mohuesit nuk kanë ndonjë mik që t'i ndihmojë dhe që përkujdeset për ta, Allahu i Madhëruar thotë se ata lihen qëllimisht që të mbështeten te vetja, e cila është tepër nevojtare, por ata janë të padrejtë dhe mospërfillëse ndaj ftesës së Zotit. Ata nuk pranojnë të pajisen me cilësitë e mira, që rregullojnë personalitetin e tyre. Ata i kanë shkatërruar një nga një cilësitë e mira njerëzore, duke rënë shumë poshtë e duke u shndërruar në krijesa më poshtë se kafshët, të cilat nuk kanë as logjikë e as arsye. Ata thjesht kërkojnë të përmbushin çdo dëshirë të egos së tyre kafshërore. Qëllimi i jetës së tyre është thjesht përmbushja e dëshirave dhe e kënaqësive të kësaj dynjaje. Të gjitha veprat dhe qëllimet e tyre vërtiten rreth kësaj bote, duke mos menduar fare rreth ahiretit dhe atyre çështjeve të cilat, nëse plotësohen, do t'u mundësonin lumturinë në të dyja jetët. Ata e shpërfillin ahiretin dhe nuk përgatiten për të, prandaj edhe vendqëndrimi i tyre si shpërblim do të jetë Zjarri. Atje do të ndëshkohen përgjithmonë dhe kurrë nuk do t'u lehtësohen vuajtjet!

Ajeti 13

13. Sa e sa qytete, që ishin shumë më të fortë se qyteti që të dëboi ty, Ne i kemi shkatërruar, duke mos patur për ta asnjë ndihmues!

Shpjegimi i ajetit

Kuptimi: Janë të shumta vendet ose qytetet e mohuesve të profetëve, që ishin më madhështorë dhe më të fuqishëm sesa këta që refuzojnë të të pranojnë ty, por Allahu i Madhëruar i shkatërroi ata të gjithë. Kur ata mohuan profetët Tanë, duke pretenduar dhe shpifur se ata ishin gënjeshtarë, atëherë mbi ta goditi me ashpërsi ndëshkimi i Zotit të Plotfuqishëm. Askush nuk mund t'i ndihmonte a shpëtonte nga ai ndëshkim. Edhe pushteti, pasuria dhe fuqia e tyre nuk u bënë dobi. As mjetet luftarake, fëmijët dhe ushtritë e shumta nuk u dolën në krah.

Atëherë, çfarë do të ndodhë me ata të mjerë të pafuqishëm, të cilët e dëbuan Profetin nga vendi i vet, të cilët e mohuan, e urryen dhe e luftuan atë, ndërkohë që ai ishte më i zgjedhuri mes të gjithë profetëve dhe më i miri njeri mes të parëve dhe të fundit?! A nuk e meritonin ata ndëshkimin më shumë se çdo popull tjetër mohues?! Pa dyshim që e meritonin një ndëshkim të ashpër dhe të dhembshëm, por Allahu i Madhëruar e dërgoi profetin Muhamed si mëshirë për të gjithë botërat. Ai u dërgua për të qenë i durueshëm, tolerant, falës, i butë dhe i dhembshur me popullin e tij.

Ajeti 14

14. Vallë, a është i njëjtë ai që i përmbahet udhëzimit të qartë prej Zotit të vet, me atë të cilit i janë zbukuruar veprat e këqija dhe ndjek epshet e veta?!

Shpjegimi i ajetit

Kurrsesi nuk është njëlloj ai që është i qartë tërësisht për fenë dhe besimin e tij, duke u bazuar në dituri të saktë, të drejtë dhe të vërtetë, dhe duke punuar me sinqeritet me atë dituri vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut, me atë që ka një zemër të verbër. Ky i fundit, ndryshe nga i pari, e refuzon të vërtetën dhe ka devijuar nga rruga e drejtë, duke pasuar dëshirat dhe epshet e veta, pa pasur udhëzim dhe dritë nga Allahu. Ç'është më e keqja, ky i mjerë pandeh se është në rrugë të mbarë! Sa i

madh është dallimi mes këtyre dy njerëzve! Sa larg qëndrojnë ata nga njëri-tjetri, qoftë në veprat që bëjnë, qoftë në shpërblimin që meritojnë!

Ajeti 15

15. Ja përshkrimi i Xhenetit, i cili u është premtuar të devotshmëve: në të ka lumenj me ujë gjithmonë të pastër e të freskët, lumenj me qumësht që nuk prishet, lumenj me verë të këndshme për ata që pinë dhe lumenj me mjaltë të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash, ndërkohë që do të jenë të falur nga Zoti i tyre. A mund të konsiderohen këta njëlloj me ata që do të rrinë përgjithmonë në Zjarr, ku etja do t'u shuhet me ujë të valë, që ua copëton zorrët?!

Shpjegimi i ajetit

- "Ja përshkrimi i Xhenetit, i cili u është premtuar të devotshmëve..." - Ja si është Xheneti, të cilin Zoti e ka përgatitur për besimtarët që i ruhen ndëshkimit të Tij dhe kërkojnë kënaqësinë e Tij, duke zbatuar detyrimet dhe duke iu larguar harameve.

- "...në të ka lumenj me ujë gjithmonë të pastër e të freskët..." - Ky ujë nuk prishet dhe nuk e ndryshon shijen apo aromën e tij. Ai nuk turbullohet, por është gjithmonë kristal, i freskët dhe shumë i dashur për ata që e pinë. Ai është uji me shijen dhe aromën më të këndshme. Ai është uji që fal kënaqësinë më të madhe për ata që e pinë.

- "...lumenj me qumësht që nuk prishet..." - Ai qumësht nuk thartohet apo prishet, por qëndron i freskët dhe i shijshëm.

- "...lumenj me verë të këndshme për ata që pinë..." - Ai që e shijon këtë lloj vere ndien kënaqësi të pakrahasueshme. Ajo nuk është si vera e kësaj dynjaje, që ka shije të keqe dhe sjell dhimbje koke e marrje mendsh.

- "...dhe lumenj me mjaltë të kulluar." - Mjalti është i kulluar, pra, i pastër nga çdo mbeturine dylli apo substancë tjetër.

- "Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash..." – Atje do të kenë pemë hurmash, rrushi, molle, shege, qitro, ullinj e fruta të tjera, të cilat kanë shembull të tyre në dynja ose jo. Këto janë mirësi, që ata i përfitojnë nga bujaria e Zotit të tyre.

- "...ndërkohë që do të jenë të falur nga Zoti i tyre." - Me faljen e Zotit, ata shpëtojnë dhe janë të sigurt nga çdo gjë që u shkakton ankth.

- "A mund të konsiderohen këta njëlloj me ata që do të rrinë përgjithmonë në Zjarr, ku etja do t'u shuhet me ujë të valë, që ua copëton zorrët?!" - Cilët janë në gjendje më të mirë: këta fatlumët apo ata që do të jenë përjetë në zjarrin e Xhehenemit, nxehtësia e të cilit është e padurueshme. Atje do t'u jepet për të pirë ujë i nxehtë e i valuar, i cili ua copëton zorrët dhe të brendshmet e tyre.

I Lartësuar dhe i Pastër nga çdo e metë është Allahu, që bëri dallime mes të mirëve dhe të këqijve, mes shpërblimeve të secilës palë dhe mes Xhenetit e Xhehenemit!

Ajetet 16 – 17

16. Prej tyre ka që bëjnë sikur të dëgjojnë ty, por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre më të diturve e u thonë: "Çfarë tha ai pak më parë?" Këta janë ata, zemrat e të cilëve i ka vulosur Allahu dhe të cilët janë dhënë pas dëshirave të veta.

17. Kurse atyre që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton edhe më shumë udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe më të devotshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Prej tyre ka që bëjnë sikur të dëgjojnë ty..." – Kuptimi: Disa prej munafikëve të dëgjojnë me vëmendje teksa flet. Në fakt, ata të dëgjojnë me vëmendje jo për të mësuar fenë e drejtë, për ta pranuar dhe për ta zbatuar atë, por me synimin që ta mohojnë.

Ata thjesht shtireshin sikur besonin, sepse i Madhëruari thotë:

- "...por kur largohen prej teje, u drejtohen atyre më të diturve e u thonë: "Çfarë tha ai pak më parë?"" - Ata u drejtoheshin besimtarëve duke u kërkuar shpjegime rreth asaj që thoshte Profeti (a.s.). Ata i kishin dëgjuar qartë, me veshët e tyre, por ata thjesht nuk kishin dëshirën për ta zbatuar.
"Çfarë tha ai pak më parë?" - Ky është një nënçmim shumë i rëndë për ta, sepse tregon që ata nuk kishin synim aspak të pranonin të vërtetën. Nëse ata do të ishin të interesuar për të vërtetën, do ta dëgjonin atë me përqendrim të thellë, do ta kuptonin me zemër, dhe kështu e gjithë qenia e tyre do të nënshtrohej të punonte dhe jetonte sipas asaj të vërtete. Por ata ishin krejt ndryshe, siç thotë Allahu i Madhëruar:

- "Këta janë ata, zemrat e të cilëve i ka vulosur Allahu dhe të cilët janë dhënë pas dëshirave të veta." - Allahu i Madhëruar ua vulosi zemrat dhe ua mbylli çdo portë, nga e cila mund t'u vinte ndonjë mirësi dhe udhëzim, për shkak se ata e refuzuan ftesën e Tij dhe pasuan dëshirat e veta, të cilat i nënshtroheshin veçse të kotës. Pastaj Allahu i Madhëruar përshkruan gjendjen e të udhëzuarve, duke thënë:

- "Kurse atyre që ndjekin rrugën e drejtë, Ai ua shton edhe më shumë udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe më të devotshëm." - Atyre të cilët ndjekin udhëzimin, duke besuar drejt, të mbështetur në dituri të saktë, të sigurt e të vërtetë nga Zoti, duke u nënshtruar për ta zbatuar atë në jetën e tyre, me qëllim që të kënaqin Allahun, Ai do t'ua shtojë edhe më tepër udhëzimin, ngase Ai është Mirënjohës, Shpërblyes i madh dhe Bujar. Gjithashtu, Ai do t'u mundësojë që të arrijnë gradën e lartë të devotshmërisë. Ai do t'u japë sukses duke ua lehtësuar çdo punë të mirë dhe do t'i mundësojë që të ruhen dhe të shpëtojnë nga çdo e keqe.

Kështu, për të udhëzuarit, i Madhëruari përmend dy shpërblime: diturinë e mirë, të saktë dhe të dobishme dhe veprat e mira e të sinqerta sipas kësaj diturie. Është Allahu i Gjithëmëshirshëm Ai që përkujdeset që besimtarët t'i marrin këto dy mirësi në formën më të plotë.

Ajeti 18

18. Vallë, a po presin ata gjë tjetër veç Kijametit, i cili do t'u vijë befas, ndërkohë që parashenjat e tij tashmë kanë ardhur?! E si presin t'u bëjë dobi reflektimi kur të vijë Kijameti?!

Shpjegimi i ajetit

- "Vallë, a po presin ata gjë tjetër veç Kijametit, i cili do t'u vijë befas, ndërkohë që parashenjat e tij tashmë kanë ardhur?!" - Çfarë presin mohuesit e të vërtetës, që të besojnë? Vallë, mos presin t'u vijë Kijameti befas dhe pa e ndier? Disa nga shenjat që tregojnë afrimin e Kijametit tashmë janë

shfaqur, prandaj tani mbetet vetëm që ai t'i kapë në befasi. Por atë ditë nuk do të ketë më mundësi pendimi, siç thotë i Lartësuari:

- "E si presin t'u bëjë dobi reflektimi kur të vijë Kijameti?!" - Nëse vjen Kijameti i madh ose kijameti i vogël (vdekja) për secilin nga ata, nuk do t'u jepet më mundësia për të reflektuar e për t'u penduar. Koha për pendim mbaron me dynjanë. Ata jetojnë në dynja mjaftueshëm për të reflektuar e për t'u penduar, pasi lajmësit e Zotit e kanë qartësuar të vërtetën.

Ky ajet është një nxitje që të përgatitemi mirë, para se vdekja të na vijë befas. Vdekja është kijameti për çdo njeri. Për çdo njeri që vdes ka filluar kijameti, ndërkohë që veprat e tij mbyllen.

Ajeti 19

19. Dije se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Allahut! Kërko falje për gjynahet e tua, për besimtarët e për besimtaret! Allahu i di mirë lëvizjet dhe vendqëndrimin tuaj.

Shpjegimi i ajetit

- "Dije se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Allahut!" – Për të ditur një çështje është e domosdoshme të njohësh plotësisht kuptimin e saj dhe ta pranosh atë me zemër. Kështu, kur urdhërohemi që të dimë diçka, kjo do të thotë që ta njohim mirë kuptimin e saj dhe ta pranojmë me zemër atë. Gjithashtu, që dija të quhet e plotë, duhet të punosh e të veprosh sipas asaj dijeje.

Në ajet, dituria për të cilën Allahu i Madhëruar urdhëron që ta marrim dhe përvetësojmë është ajo për njëshmërinë e Tij. Kjo dituri është detyrim individual për çdo njeri, domethënë që askush nuk shpëton prej këtij detyrimi, kushdo qoftë ai. Të gjithë janë nevojtarë për këtë lloj njohurie.

Rrugët e marrjes së diturisë mbi njëshmërinë e Allahut janë disa:

1. Me meditim. Kjo do të thotë të meditosh thellë rreth emrave, cilësive dhe veprave të Allahut të Madhëruar, të cilat janë tregueset më të mëdha dhe më të qarta për madhështinë, lartësinë dhe pushtetin e Tij absolut. Ato e nxisin dhe e edukojnë njeriun që të përpiqet maksimalisht për ta adhuruar Atë si të Një të vetëm. Njohja e thellë me emrat, cilësitë dhe veprat e përkryera, madhështore, të bukura dhe të urta të Allahut, bëjnë që ta duash Atë me gjithë shpirt, ta madhërosh dhe t'i nënshtrohesh, duke u distancuar nga çdo adhurim tjetër.

2. Siguria në faktin se Allahu është i vetmi Krijues, Furnizues dhe Administrues i çdo çështjeje në gjithësi. Ai kujdeset për krijesat e Tij në çdo çështje. Kush fiton siguri se Ai është i vetmi Krijues dhe Rregullues i çështjeve në dynja dhe ahiret, atëherë është i sigurt se po Ai duhet të jetë i vetmi të Cilit duhet t'ia kushtosh adhurimin.

3. Pranimi i faktit se Allahu i Madhëruar është burimi i vetëm i çdo mirësie të dynjasë dhe ahiretit, i mirësive të dukshme dhe atyre të fshehta. Kjo bën që zemra të lidhet fort pas Tij, të mbushet me dashurinë për Të dhe të nënshtrohet për ta adhuruar vetëm Atë si Një, të Vetëm dhe të Pashoq.

4. Dëshmitë që shohim apo dëgjojmë rreth mirësive që kanë miqtë dhe të dashurit e Allahut, të cilët e kanë plotësuar me zemër njësimin e Zotit të Madhëruar. Zoti i ka begatuar ata me mirësi të shumta në dynja e ahiret dhe u ka dhuruar fitore kundër armiqve. Ndërsa idhujtarët dhe armiqtë e Zotit, të profetëve dhe të besimtarëve, nga

ana tjetër, Ai i ndëshkon dhe poshtëron në dynja dhe ahiret. Këto dëshmi nga realiteti e përforcojnë diturinë se Ai është i vetmi që meriton adhurimin, me të gjitha llojet e tij.

5. Njohja e cilësive të idhujve dhe bindja se ata janë të mangët nga të gjitha këndvështrimet, të varfër dhe nevojtarë në veten e tyre. Ata nuk zotërojnë asnjë mundësi për të bërë dobi apo dëm, as për veten e as për adhuruesit e tyre. Ata nuk mund të dhurojnë jetë apo ta marrin atë dhe nuk mund të ringjallin krijesat pas vdekjes, për t'i marrë në përgjegjësi. Ata nuk mund të ndihmojnë asnjë apo t'u dhurojnë fitore adhuruesve të tyre. Ata nuk mund të japin asnjë grimë mirësie apo të largojnë një grimë vështirësie. Kjo njohuri e përforcon sigurinë se nuk ka zot tjetër që meriton adhurimin, lutjet, përkushtimin e nënshtrimin ndaj tij, veç Allahut të Vetëm dhe të Pakrahasueshëm

6. Të gjitha shpalljet hyjnore janë unanime dhe kategorike në lajmin se Allahu është i vetmi Zot që meriton adhurimin.

7. Njerëzit më të zgjedhur, më të ditur, më të mençur, më të përkryer dhe me dhuntitë më të shumta, kanë dëshmuar se Zoti është i Vetëm, Një, i Pashoq dhe i vetmi që meriton të adhurohet.

8. Shenjat e shumta që Zoti ka vendosur në natyrë dhe në vetet tona, të cilat tregojnë se Ai është Një, i Vetëm e i Pashoq si në krijimin, zotërimin dhe administrimin e çështjeve të krijesave, ashtu edhe në merituesshmërinë e adhurimit. Ato fakte dëshmojnë madhështinë, përpikmërinë dhe urtësinë e Krijuesit, që do të thotë se Allahu është i vetmi që meriton ta duash, ta madhërosh, t'i nënshtrohesh dhe të shpresosh tek Ai.

Këto janë disa nga mënyrat e përdorura më shpesh nga Allahu i Madhëruar, me të cilat Ai na mëson se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Tij. Nëse do të meditonim me kujdes vetëm qoftë edhe në njërën prej tyre, do të arrinim siguri të plotë dhe të patundshme se nuk ka të adhuruar tjetër me meritë veç Allahut. Ndërsa po t'i arrish bashkë të gjitha këto mënyra të njohjes, pa dyshim që siguria e robit rreth kësaj çështjeje bëhet e palëkundshme, duke u ngulitur mirë në zemrën e tij. Atë nuk mund ta trondisin dyshimet dhe as supozimet e kota, por veçse ia shtojnë edhe më tepër bindjen dhe sigurinë.

Po t'u shtojmë këtyre rrugëve një portë të madhe të njohurive e mirësive, Kuranin madhështor, atëherë suksesi bëhet i pallogaritshëm. Meditimi në ajetet kuranore dhe në mesazhet tyre është një rrugë shumë e gjerë për marrjen e njohurisë së teuhidit. Në Kuran jepen hollësi të kësaj njohurie, si dhe argumente e fakte që nuk mund të gjenden tjetërkund. [9]

---

[9] Kurani vjen me disa trajtesa dhe funksione:

1. Ai vjen si lajm dhe prezantim me emrat, cilësitë, veprat dhe fjalët e Allahut, dhe ky është teuhidi në njohjen dhe besimin rreth Allahut.
2. Ai vjen si ftesë për ta adhuruar Allahun si Një, të Vetëm e të Pashoq dhe për t'u larguar nga çdo gjë që adhurohet veç Tij. Ky është teuhidi në meritën e adhurimit.
3. Ai vjen me urdhra dhe ndalesa prej Zotit. Ky quhet plotësuesi i teuhidit.
4. Në Kuran mëson rreth shpërblimit dhe bujarisë së madhe, me të cilën Zoti do të nderojë ata që plotësojnë teuhidin. Ai na përshkruan me imtësi se si do t'i trajtojë Allahu i Lartësuar njësuesit në dynja dhe çfarë ka përgatitur për ta në ahiret. Ky është shpërblimi i teuhidit.
5. Kurani të mëson rreth idhujtarëve, rreth mënyrës se si vepron Zoti me ta në dynja dhe çfarë ndëshkimi i pret në ahiret. Ky është shpërblimi i atyre që largohen nga teuhidi.


Përfundimisht, i gjithë Kurani shërben për qartësimin e teuhidit, të parimeve kryesore dhe plotësuese të tij, të

- "Kërko falje për gjynahet e tua për besimtarët e për besimtaret!" – Kuptimi: Kërkoji falje Allahut për gabimet e tua!

Kërkimi i faljes bëhet duke zbatuar ato vepra që Zoti i ka bërë shkaqe për faljen e gjynaheve, si: pendimi i sinqertë, lutja e sinqertë për falje gjynahesh, veprat e fjalët e mira që fshijnë gjynahet, largimi nga gjynahet, falja e atyre që të bëjnë padrejtësi etj.

Për shkak të imanit të tyre, besimtarët kanë të drejta dhe detyrime ndaj njëri-tjetrit. Ndër këto detyrime është që besimtari të lutet dhe të kërkojë falje për besimtarin dhe për gabimet e tij. Kërkimi i faljes sjell për të fshirjen e gjynaheve dhe largimin e ndëshkimit prej tij. Gjithashtu, një ndër detyrimet kundrejt muslimanit është që të duash për të atë që dëshiron për veten tënde dhe të urresh për të atë që e urren dhe nuk e dëshiron për veten tënde. Besimtari e urdhëron besimtarin për çdo gjë që mundëson mirësinë dhe lumturinë e tij, dhe e ndalon nga çdo gjë që është në dëm të tij. Gjithashtu, ai e fal dhe e toleron atë për gabimet dhe për ndonjë mangësi që ka. Muslimani përpiqet që të forcojë unitetin dhe të bashkojë zemrat e muslimanëve, të sheshojë mosmarrëveshjet, të ulë gjakrat dhe të largojë urrejtjen mes tyre, dukuri këto që sjellin armiqësi dhe përçarje. Pa dyshim, armiqësitë mes muslimanëve bëjnë që gjynahet e tyre të shtohen dhe të zmadhohen.

- "Allahu i di mirë lëvizjet dhe vendqëndrimin tuaj." - Allahu i Madhëruar


الجزء السادس والعشرون سورة محمد

وَيَقُولُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَوْلَا نُزِّلَتْ سُورَةٌ ۖ فَإِذَآ أُنزِلَتْ سُورَةٌ
مُّحْكَمَةٌ وَذُكِرَ فِيهَا ٱلْقِتَالُ رَأَيْتَ ٱلَّذِينَ فِى قُلُوبِهِم مَّرَضٌ
يَنظُرُونَ إِلَيْكَ نَظَرَ ٱلْمَغْشِىِّ عَلَيْهِ مِنَ ٱلْمَوْتِ ۖ فَأَوْلَىٰ لَهُمْ
٢٠ طَاعَةٌ وَقَوْلٌ مَّعْرُوفٌ ۚ فَإِذَا عَزَمَ ٱلْأَمْرُ فَلَوْ صَدَقُوا۟ ٱللَّهَ
لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ ٢١ فَهَلْ عَسَيْتُمْ إِن تَوَلَّيْتُمْ أَن تُفْسِدُوا۟
فِى ٱلْأَرْضِ وَتُقَطِّعُوٓا۟ أَرْحَامَكُمْ ٢٢ أُو۟لَٰٓئِكَ ٱلَّذِينَ لَعَنَهُمُ
ٱللَّهُ فَأَصَمَّهُمْ وَأَعْمَىٰٓ أَبْصَٰرَهُمْ ٢٣ أَفَلَا يَتَدَبَّرُونَ ٱلْقُرْءَانَ
أَمْ عَلَىٰ قُلُوبٍ أَقْفَالُهَآ ٢٤ إِنَّ ٱلَّذِينَ ٱرْتَدُّوا۟ عَلَىٰٓ أَدْبَٰرِهِم
مِّنۢ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ ٱلْهُدَى ٱلشَّيْطَٰنُ سَوَّلَ لَهُمْ وَأَمْلَىٰ
لَهُمْ ٢٥ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ قَالُوا۟ لِلَّذِينَ كَرِهُوا۟ مَا نَزَّلَ ٱللَّهُ
سَنُطِيعُكُمْ فِى بَعْضِ ٱلْأَمْرِ ۖ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ إِسْرَارَهُمْ ٢٦
فَكَيْفَ إِذَا تَوَفَّتْهُمُ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ يَضْرِبُونَ وُجُوهَهُمْ
وَأَدْبَٰرَهُمْ ٢٧ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمُ ٱتَّبَعُوا۟ مَآ أَسْخَطَ ٱللَّهَ
وَكَرِهُوا۟ رِضْوَٰنَهُۥ فَأَحْبَطَ أَعْمَٰلَهُمْ ٢٨ أَمْ حَسِبَ
ٱلَّذِينَ فِى قُلُوبِهِم مَّرَضٌ أَن لَّن يُخْرِجَ ٱللَّهُ أَضْغَٰنَهُمْ ٢٩

٥٠٩

di gjithçka për veprimet tuaja, për lëvizjet apo moslëvizjet, për vajtjet dhe ardhjet tuaja. Përveç kësaj, Ai do t'ju shpërblejë për punët tuaja të mira, madje duke ua shtuar ato, me bujarinë e Tij.

Ajetet 20 – 23

20. Besimtarët thonë: "Sikur të ishte shpallur një sure për këtë!" Por kur shpallet një sure e qartë që flet për luftë, ata të cilët kanë zemra të sëmura, të shikojnë sikur të ishin në agoninë e vdekjes. Më të volitshme për ta do të ishin
21. bindja dhe fjala e mirë! Kur merret vendimi, do të ishte më mirë për ata që të jenë besnikë ndaj Allahut!
22. Nëse ju i ktheni shpinën besimit, atëherë prej jush nuk pritet gjë tjetër, veç të përhapni shkatërrimin në tokë dhe të ndërprisni lidhjet farefisnore.

---

shpërblimit të tij, si dhe për të treguar ndëshkimin e atyre që i largohen teuhidit.

23. Këta janë ata të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon për disa besimtarë, të cilët, duke u nxituar, kërkojnë të marrin përsipër detyrime, plotësimi i të cilave është i vështirë.

- "Besimtarët thonë: "Sikur të ishte shpallur një sure për këtë!""" - Besimtarët kërkonin dhe dëshironin që të shpallej ndonjë sure, ku të bëhej e detyruar lufta.

- "Por kur shpallet një sure e qartë që flet për luftë, ata të cilët kanë zemra të sëmura, të shikojnë sikur të ishin në agoninë e vdekjes." – Kuptimi: Kur zbret surja që e bën të pakthyeshme luftën, e cila është gjëja më e vështirë për shpirtin e njeriut, ata me iman të dobët tërhiqen dhe nuk qëndrojnë si burrat, për ta plotësuar këtë detyrim. I Madhëruari thotë: "...të shikojnë sikur të ishin në agoninë e vdekjes." Kur dëgjojnë urdhrin për luftë, nga frika e madhe e vdekjes, ata shikojnë njëlloj si ai njeriu të cilit i bie të fikët para vdekjes. Kjo pjesë i ngjan ajetit tjetër, ku Allahu i Madhëruar thotë: "A nuk i ke parë (o Muhamed) ata të cilët u porositën: "Largohuni prej luftës, faleni namazin dhe jepeni zekatin!", e që kur iu bë detyrim lufta, një grup prej tyre iu frikësuan njerëzve ashtu si duhet t'i frikësohesh Allahut, madje edhe më shumë. Ata thanë: "O Zoti ynë! Pse na e bëre detyrim luftën? Sikur të na e kishe shtyrë pak më vonë!" Thuaju: "Kënaqësitë e kësaj bote janë të pakta, ndërsa bota tjetër është shumë më e dobishme për ata që janë të devotshëm. Juve nuk do t'ju bëhet padrejtësi aspak." [Nisa 77].

Më pas, duke i edukuar dhe udhëzuar besimtarët në më të mirën, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Më të volitshme për ta do të ishin bindja dhe fjala e mirë!" - Është më mirë për ta që t'i zbatojnë me korrektësi urdhrat aktualë dhe të mos kërkojnë urdhra të tjerë, me të cilët Zoti nuk i ka ngarkuar. Le të grumbullojnë dhe shpenzojnë të gjitha fuqitë e tyre në zbatimin e porosive, që tashmë i kanë marrë. Më mirë të mos nxitohen, duke kërkuar nga Allahu detyrime, që ndoshta do ta kenë të vështirë t'i plotësojnë. Le të kënaqen me faljen dhe mëshirën e Allahut të Madhëruar, me lehtësinë dhe thjeshtësinë e gjithçkaje që Ai ofron.

- "Kur merret vendimi, do të ishte më mirë për ata që të jenë besnikë ndaj Allahut!" - Kur t'u vijë nga Allahu urdhri i prerë për të luftuar, është më mirë të tregohen të sinqertë në kërkimin e ndihmës dhe forcës nga Allahu për përmbushjen e urdhrit të Tij Tij, por edhe duke dhënë maksimumin e mundësive të tyre. Kjo është më mirë për ta, sesa ta kërkojnë vetë zbritjen e urdhrit për luftë. Kjo ka arsyet e veta, disa prej të cilave do t'i rendisim më poshtë:

1. Robi është i mangët dhe i dobët në çdo aspekt. Ai nuk ka mundësi ta arrijë suksesin vetë, nëse Zoti nuk e ndihmon dhe nuk i jep forcë. Kështu që ai nuk duhet të kërkojë detyra shtesë, mbi ato që është ngarkuar dhe është duke kryer.

2. Nëse robi lidhet tepër me të ardhmen, atëherë do të dobësohet në lidhje me plotësimin e detyrave të së tashmes, madje edhe në lidhje me detyrimet për të ardhmen.

Në lidhje me detyrimet e së tashmes, ai do të dobësohet, sepse qëllimet e tij nuk janë të fokusuara tek e tashmja, ndërkohë që niveli i punës së njeriut varet shumë nga qëllimet e tij. Ndërsa në lidhje me të ardhmen, dobësimi ndodh zakonisht sepse ajo që pritet të vijë kërkon kohë, por me kalimin e kohës, qëllimi fillon e zbehet. Kështu, kur i vjen koha, ai nuk është më në nivelin e tij të duhur.

3. Ai që mendon vetëm për të ardhmen, pa i dhënë hakun të tashmes, thjesht është një ëndërrimtar, që pandeh se ka fuqi të arrijë gjithçka, por tregohet i paaftë edhe për gjërat që i ka në dorë. Ai që nuk është i zoti të përmbushë detyrimet e kohës është i destinuar të mos plotësojë asnjë përgjegjësi të së ardhmes. Kësisoj, për njeriun është më mirë që t'i mbledhë forcat për të realizuar detyrat e së tashmes, dhe kjo nuk e pengon aspak në përgatitjet për të ardhmen. Madje, nëse ai është gjithmonë aktiv në plotësimin e përgjegjësive të kohës, vullneti i tij mbetet i lartë. Në këtë mënyrë, kur të vijë koha e veprimeve të planifikuara, ai - ashtu siç bën gjithmonë - do t'i realizojë ato në formën më të mirë dhe më të plotë të mundshme. Një njeri i tillë e meriton gjithmonë të jetë i suksesshëm në të gjitha çështjet e tij.

Pastaj i Madhëruari flet për ata që mohojnë dhe për fundin e keq të tyre:

- "Nëse ju i ktheni shpinën besimit, atëherë prej jush nuk pritet gjë tjetër, veç të përhapni shkatërrimin në tokë dhe të ndërprisni lidhjet farefisnore." – Pra, dy janë mundësitë: ose përkushtim ndaj Allahut, që sjell vetëm mirësi, mbarësi dhe sukses, ose mosbindjes ndaj Allahut, pas së cilës vjen degjenerimi, veprat e këqija, padrejtësitë dhe shkëputjet e lidhjeve farefisnore.

- "Këta janë ata të cilët Allahu i ka mallkuar..." - Ata të cilët refuzojnë t'i binden Allahut, bëjnë gjynahe, shkatërrojnë në tokë dhe ndërpresin lidhjet farefisnore, Allahu i Madhëruar i ka mallkuar, duke i larguar nga mëshira e Tij. Këta meritojnë zemërimin dhe dënimin e Allahut.

- "...i ka bërë të shurdhër dhe ua ka verbuar shikimin." - Allahu i Madhëruar i ka bërë që të mos e dëgjojnë as ta shikojnë atë gjë që u bën dobi. Ata e kanë shqisën e të dëgjuarit, por nuk marrin vesh e të binden. Ata e kanë edhe shqisën e të shikuarit, por nuk e përdorin për të parë shenjat e Allahut. Ata as nuk ua hedhin sytë Shpalljes së Zotit dhe argumenteve të qarta që Ai ka vendosur në gjithësi dhe në vetet tona.

Ajeti 24

24. A nuk meditojnë ata mbi Kuranin, apo kanë zemra të kyçura nga drynat e vet!

Shpjegimi i ajetit

- "A nuk meditojnë ata mbi Kuranin..." - A nuk është më mirë për ata që i kthejnë shpinën Librit të Allahut, që të meditojnë më thellë në mesazhin e tij?! Nëse do të mendonin kështu, ai do t'i udhëzonte tek çdo e mirë dhe do t'i paralajmëronte nga çdo e ligë. Ai do t'i mbushte zemrat e tyre me iman dhe me siguri tek e vërteta. Kurani do t'ua bënte më të afërta qëllimet më të larta dhe do t'u mundësonte dhuratat më të mrekullueshme nga Zoti. Ky libër do t'u tregonte qartë rrugën që të çon te Zoti dhe në Xhenetin e Tij, me të gjitha hollësitë e

nevojshme, duke mësuar edhe pengesat e mënyrën e kapërcimit të tyre. Me këtë libër do të kuptonin kurthet e Shejtanit dhe rrugët që të çojnë në ndëshkimin e të Drejtit, por do të mësonin edhe mënyrën e shpëtimit nga kjo rrugë dhe nga kurthet e armikut të tyre. Kurani madhështor do t'i njihte me Zotin e tyre: me emrat, cilësitë dhe veprat e Tij. Kështu, ai do t'i bënte të prisnin me mall takimin me Zotin, duke shpresuar për shpërblimin e Tij bujar.

- "...apo kanë zemra të kyçura nga drynat e vet!" – Zemrat e tyre janë vulosur, duke mbajtur brenda ligësinë. Në këtë mënyrë, as e mira nuk mund të hyjë kurrë në to. Kjo është e vërteta. Ata janë gjithmonë në humbje, sepse i kanë zemrat të kyçura.

Ajetet 25 – 28

25. Nuk ka dyshim se atyre që ndërrojnë rrugë, pasi u është bërë e qartë udha e drejtë, është Shejtani që ua hijeshon devijimin dhe që i mban me iluzione.
26. Në fakt, e meritojnë, sepse janë ata që u thonë atyre të cilët e urrejnë Shpalljen e Allahut: "Ne do t'ju bindemi për disa çështje!" Por Allahu i di sekretet e tyre.
27. Si do të jetë halli i tyre kur engjëjt t'ua marrin shpirtin, duke i goditur në fytyrë dhe kurriz?
28. Arsyeja është se ata kërkojnë zemërimin e Allahut dhe nuk duan ta arrijnë kënaqësinë e Tij. Si rrjedhojë, Ai i asgjëson veprat e tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuk ka dyshim se atyre që ndërrojnë rrugë, pasi u është bërë e qartë udha e drejtë, është Shejtani që ua hijeshon devijimin dhe që i mban me iluzione." - Allahu i Madhëruar na tregon rreth atyre të cilët i kthejnë shpinën udhëzimit. Ata e bëjnë këtë zgjedhje jo duke u mbështetur në fakte nga Zoti, por thjesht ndjekin verbërisht se çfarë u thotë dhe ua zbukuron Shejtani, i cili është armiku i tyre. Ai ua hijeshon rrugën e humbjes me premtime të rreme e ëndrra të kota dhe i nxit që t'i përkushtohen asaj, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Ai u premton atyre dhe i bën të shpresojnë, por Shejtani premton veçse mashtrim. Ata e kanë vendin në Xhehenem, prej të cilit nuk kanë shpëtim." [Nisa 120].

Kjo ndodh për shkak se atyre iu është bërë e qartë udha e drejtë, por ata e shpërfillin atë, duke parapëlqyer plotësimin e dëshirave personale. Ndodh edhe për një shkak tjetër:

- "Në fakt, e meritojnë, sepse janë ata që u thonë atyre të cilët e urrejnë Shpalljen e Allahut: "Ne do t'ju bindemi për disa çështje!"" - Ata pajtohen me njerëzit që e urrejnë Shpalljen dhe që janë armiqësorë ndaj Allahut dhe Profetit të Tij. Ata u deklarojnë atyre se do t'u binden në disa çështje, që u shkojnë dëshirave të tyre të shfrenuara. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar i ndëshkon duke i lënë në humbje, të zhytur thellë e më thellë në të. Ai i bën ta vazhdojnë rrugën e nisur, e cila përfundon me dëshpërim dhe dënim të përhershëm.

- "Por Allahu i di sekretet e tyre." – Allahu e di se çfarë mbajnë fshehur, prandaj ua nxjerr të palarat e tyre, duke ndihmuar besimtarët që të mos mashtrohen nga këta zullumqarë.


- "Si do të jetë halli i tyre kur engjëjt t'ua marrin shpirtin, duke i goditur në fytyrë dhe kurriz?" - Si do të jetë gjendja e tyre e shëmtuar, kur melekët e ndëshkimit të dërgohen për t'ua shkulur shpirtin me dhimbje?! Kjo vërtetë është një tablo e tmerrshme. Ata do t'i godasin fort në fytyrë dhe kurriz, me ashpërsi dhe pa mëshirë.

- "Arsyeja është se ata kërkojnë zemërimin e Allahut dhe nuk duan ta arrijnë kënaqësinë e Tij. Si rrjedhojë, Ai i asgjëson veprat e tyre." - Ata e meritojnë ndëshkimin, për shkak se bëjnë gjëra që e zemërojnë Allahun e Madhëruar. Ata zhyten në kufër, padrejtësi, imoralitet dhe mosbindje ndaj Allahut. Për ta nuk ka aspak rëndësi arritja apo jo e kënaqësisë së Zotit! Ata nuk kanë as më të voglën dëshirë që të veprojnë atë që i afron tek Allahu dhe ta kënaqin Atë. Për këtë arsye, i Madhëruari ua asgjëson veprat e tyre, duke ua bërë të pavlera.

Ndryshe ndodh me ata të cilët kërkojnë kënaqësinë e Allahut, duke kryer ato vepra të mira që Ai i përcaktoi si të tilla dhe duke u ruajtur nga ato vepra që sjellin zemërimin dhe ndëshkimin e Tij. Këtyre, Allahu i Madhëruar do t'ua falë gjynahet, do t'ua mbulojë të metat dhe do t'ua shumëfishojë shpërblimin e tyre.

Ajetet 29 – 31

29. Vallë, a mendojnë ata që i kanë zemrat e sëmura, se Allahu nuk do t'ua zbulojë urrejtjen e tyre të brendshme?
30. Po të donim, Ne mund t'i tregonim se si janë ata, dhe pastaj t'i, me siguri, do t'i njihje nga shenjat e tyre. Por t'i do t'i njohësh ata nga e folura e tyre. Allahu e di se cilat janë veprat tuaja.


الجزء السادس والعشرون سورة محمد
وَلَوْ نَشَآءُ لَأَرَيْنَٰكَهُمْ فَلَعَرَفْتَهُم بِسِيمَٰهُمْ ۚ وَلَتَعْرِفَنَّهُمْ فِى
لَحْنِ ٱلْقَوْلِ ۚ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ أَعْمَٰلَكُمْ ﴿٣٠﴾ وَلَنَبْلُوَنَّكُمْ حَتَّىٰ نَعْلَمَ
ٱلْمُجَٰهِدِينَ مِنكُمْ وَٱلصَّٰبِرِينَ وَنَبْلُوَا۟ أَخْبَارَكُمْ ﴿٣١﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ
كَفَرُوا۟ وَصَدُّوا۟ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ وَشَآقُّوا۟ ٱلرَّسُولَ مِنۢ بَعْدِ
مَا تَبَيَّنَ لَهُمُ ٱلْهُدَىٰ لَن يَضُرُّوا۟ ٱللَّهَ شَيْـًٔا ۗ وَسَيُحْبِطُ أَعْمَٰلَهُمْ
﴿٣٢﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ أَطِيعُوا۟ ٱللَّهَ وَأَطِيعُوا۟ ٱلرَّسُولَ
وَلَا تُبْطِلُوٓا۟ أَعْمَٰلَكُمْ ﴿٣٣﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ وَصَدُّوا۟ عَن سَبِيلِ
ٱللَّهِ ثُمَّ مَاتُوا۟ وَهُمْ كُفَّارٌ فَلَن يَغْفِرَ ٱللَّهُ لَهُمْ ﴿٣٤﴾ فَلَا تَهِنُوا۟
وَتَدْعُوٓا۟ إِلَى ٱلسَّلْمِ وَأَنتُمُ ٱلْأَعْلَوْنَ وَٱللَّهُ مَعَكُمْ وَلَن يَتِرَكُمْ
أَعْمَٰلَكُمْ ﴿٣٥﴾ إِنَّمَا ٱلْحَيَوٰةُ ٱلدُّنْيَا لَعِبٌ وَلَهْوٌ ۚ وَإِن تُؤْمِنُوا۟ وَتَتَّقُوا۟
يُؤْتِكُمْ أُجُورَكُمْ وَلَا يَسْـَٔلْكُمْ أَمْوَٰلَكُمْ ﴿٣٦﴾ إِن يَسْـَٔلْكُمُوهَا
فَيُحْفِكُمْ تَبْخَلُوا۟ وَيُخْرِجْ أَضْغَٰنَكُمْ ﴿٣٧﴾ هَٰٓأَنتُمْ هَٰٓؤُلَآءِ
تُدْعَوْنَ لِتُنفِقُوا۟ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۖ فَمِنكُم مَّن يَبْخَلُ ۖ وَمَن يَبْخَلْ
فَإِنَّمَا يَبْخَلُ عَن نَّفْسِهِۦ ۚ وَٱللَّهُ ٱلْغَنِىُّ وَأَنتُمُ ٱلْفُقَرَآءُ ۚ وَإِن
تَتَوَلَّوْا۟ يَسْتَبْدِلْ قَوْمًا غَيْرَكُمْ ثُمَّ لَا يَكُونُوٓا۟ أَمْثَٰلَكُم ﴿٣٨﴾
الحزب ٥١
٥١٠

31. Ne do t'ju sprovojmë, me qëllim që të njohim luftëtarët dhe të palëkundurit nga mesi juaj. Gjithashtu, Ne kemi për t'i ndarë qartë veprat tuaja.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vallë, a mendojnë ata që i kanë zemrat e sëmura, se Allahu nuk do t'ua zbulojë urrejtjen e tyre të brendshme?" – A mos mendojnë ata që i kanë zemrat të infektuara nga dyshimet dhe epshi, se Allahu nuk do t'ua nxjerrë jashtë mllefin, urrejtjen, armiqësinë dhe ligësinë që mbajnë fshehur në kraharor?!

Sëmundjet e zemrës e nxjerrin njeriun nga natyrshmëria e pastër dhe e fusin në pellgun e zullumit. Mendimi i tyre se Allahu nuk do t'ua nxjerrë në dukje urrejtjen ndaj Islamit dhe muslimanëve, është shumë i gabuar dhe bie ndesh me urtësinë e Allahut të

Madhëruar. Urtësia e Tij e bën të domosdoshme që të dallohen të sinqertët nga gënjeshtarët, nëpërmjet sprovave dhe vështirësive. Ata që janë të qëndrueshëm në këto sprova dhe nuk i tradhtojnë bazat e fesë së tyre, ata janë besimtarë të vërtetë. Ndërsa ata që lëkunden nga këto sprova dhe nuk bëjnë durim, ata nuk kanë besim të fortë dhe të vërtetë. Kur ata janë në vështirësi, e humbasin toruan dhe u dobësohet imani, aq sa fillojnë të vjellin vrer kundër të vërtetës, duke e nxjerrë jashtë në këtë mënyrë ligësinë që fshihnin në zemër dhe duke shfaqur hipokrizinë e tyre. Kështu, me urtësinë e Tij, Allahu i Madhëruar nxjerr në pah besimtarët e vërtetë dhe mashtruesit hipokritë. Madje Ai thotë:

- "Po të donim, Ne mund t'i tregonim se si janë ata, dhe pastaj t'i, me siguri, do t'i njihje nga shenjat e tyre." – Do t'i njihje nga shenjat e tyre, që janë si vragat e dallueshme në fytyrë.

- "Por t'i do t'i njohësh ata nga e folura e tyre." - Ajo që fshihet brenda zemrave të tyre do të dalë në shesh nëpërmjet fjalëve, që do t'u shpëtojnë nga goja. Gjuha është zëdhënësja e zemrës: nëpërmjet saj shfaqet e mira dhe e keqja që fshihet në të.

- "Allahu e di se cilat janë veprat tuaja." - Për këto vepra, Ai do t'ju shpërblejë me drejtësi. Pastaj në ajet flitet për sprovën më të madhe mbi robërit e Allahut, për xhihadin në rrugën e Tij:

- "Ne do t'ju sprovojmë, me qëllim që të njohim luftëtarët dhe të palëkundurit nga mesi juaj. Gjithashtu, Ne kemi për t'i ndarë qartë veprat tuaja." - Allahu do të vërë në provë besimin tuaj, në mënyrë që të spikasin qartë ata që luftojnë sinqerisht dhe durojnë në rrugën e Tij. Ata që e zbatojnë urdhrin dhe luftojnë për të lartësuar fenë e Allahut, ata janë besimtarë të vërtetë. Ndërsa ata që ngurrojnë në këtë drejtim, e bëjnë për shkak të mangësisë në besimin e tyre.

Ajeti 32

32. Ata që nuk besojnë, që i pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut dhe që kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është sqaruar udha e drejtë, ata nuk mund ta dëmtojnë aspak Allahun, por Ai do t'i asgjësojë veprat e tyre.

Shpjegimi i ajetit

- "Ata që nuk besojnë, që i pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut dhe që kundërshtojnë të Dërguarin, pasi u është sqaruar udha e drejtë..." - Ky është një kërcënim i ashpër për ata që e kanë ngarkuar veten me ligësitë më të mëdha, që janë mohimi i Allahut dhe pengimi i të tjerëve nga rruga e Allahut, të cilën Ai e ka bërë për të arritur tek Ai dhe te Xheneti i Tij. Ata kundërshtojnë të vërtetën me vetëdije të plotë, me inat dhe kokëfortësi, domethënë jo nga padituria, jo gabimisht dhe jo duke qenë të paqartë. Atëherë, le ta dinë këta të mjerë, se:

- "...ata nuk mund ta dëmtojnë aspak Allahun, por Ai do t'i asgjësojë veprat e tyre." - Sjellja e tyre armiqësore nuk mund ta cenojë aspak mbretërimin dhe pushtetin e Allahut. Madje, Ai do të asgjësojë çdo vepër të tyre në funksion të së kotës dhe ligësisë. Përpjekjet e tyre në këtë drejtim do të sjellin veçse dëshpërim dhe zhgënjim për ta. Edhe

ndonjë punë, nga e cila kanë shpresë për t'u shpërblyer nga Zoti, nuk do t'u pranohet, sepse i mungon kushti i pranimit të saj, që është imani.

Ajeti 33

33. O ju besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit, e mos i çoni dëm veprat tuaja!

Shpjegimi i ajetit

- "O ju besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit..." - Allahu i Madhëruar u jep besimtarëve një urdhër, që, nëse e zbatojnë, kanë për të qenë të lumtur në dynja dhe në ahiret. Ky është urdhri për bindje të plotë ndaj Allahut dhe ndaj Profetit të Tij, për çështjet themelore të fesë dhe për degëzimet e saj. Bindja nënkupton plotësimin e urdhëresave dhe largimin nga haramet, në mënyrën e përcaktuar nga Allahu e Profeti i Tij dhe me qëllimin e sinqertë për të kënaqur vetëm Allahun e Madhëruar.

- "...e mos i çoni dëm veprat tuaja!" - Kjo është një porosi nga i Lartësuari për t'i ruajtur veprat tona të mira që kemi bërë, nga çdo gjë që i cenon ose i fshin fare ato, siç është përfolja e atyre punëve, vetëkënaqësia, mburrja apo shtirja. Edhe gjynahet i fshijnë veprat e mira dhe shpërblimin e tyre. Gjithashtu, veprat e mira i prish edhe ndërprerja e tyre në mes, pa i plotësuar, apo kryerja e ndonjë vepre specifike, që Sheriati e ka përcaktuar si dëmtuese të punës së mirë. Kështu ndodh, për shembull, me namazin, agjërimin ose haxhin, që mund të prishen me disa vepra e fjalë të caktuara.

Juristët fetarë mbështeten në këtë ajet kur thonë se është e ndaluar ndërprerja e një adhurimi farz dhe është e papëlqyeshme ndërprerja e një adhurimi të pëlqyeshëm, por jo i detyrueshëm për t'u plotësuar. Nëse Allahu i Madhëruar na ka ndaluar të prishim punët e mira, nga ana tjetër na ka urdhëruar për rregullimin dhe plotësimin e tyre. Me fjalë të tjera, ne duhet t'i përkryejmë gjithmonë veprat tona, me qëllimin e sinqertë për të kënaqur Allahun e Lartësuar.

Ajetet 34 – 35

34. Ata që nuk besojnë për vete dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut, pastaj vdesin duke qenë jobesimtarë, Allahu nuk do t'i falë kurrë.
35. Mos u tregoni të dobët e të kërkoni paqe, kur ju jeni më të lartët dhe Allahu është me ju! Ai nuk do t'jua pakësojë kurrë veprat tuaja.

Shpjegimi i ajeteve

Ky ajet, së bashku me ajetin 217 në suren Bekare, ku thuhet: "E kush zbrapset nga feja e Tij dhe vdes si jobesimtar, atij i zhduken veprat në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të Zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht", janë kufizuese të çdo teksti gjithëpërfshirës, ku thuhet se *kufr*-i i fshin të gjitha veprat. Pra, kushti është që mohuesin ta kapë vdekja në atë gjendje, domethënë, pa u penduar para vdekjes. Kështu, i Madhëruari thotë në këtë ajet:

- "Ata që nuk besojnë për vete dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut, pastaj vdesin duke qenë jobesimtarë, Allahu nuk do t'i falë kurrë." - Ata të cilët mohojnë Allahun, engjëjt, librat, profetët e Tij, Ditën e Fundit, madje pengojnë edhe të tjerët nga feja e Allahut, duke ua shtrembëruar të vërtetën dhe duke ua zbukuruar të kotën, pastaj vdesin në këtë

gjendje, pa u penduar nga këto punë të këqija, këtyre Allahu nuk ka për t'ua falur gjynahet. Këtyre nuk kanë për t'iu falur gjynahet as nëpërmjet ndërmjetësuesve e as me ndonjë mënyrë tjetër. Për ta bëhet i pakthyeshëm ndëshkimi dhe i paarritshëm shpërblimi. Për ta bëhet e detyrueshme përjetësia në zjarrin e Xhehenemit, duke iu mbyllur pëfundimisht porta e Mëshiruesit dhe Falësit të madh.

Nga ajeti kuptojmë se, nëse ata pendohen për këto punë para vdekjes, Allahu i përfshin në faljen dhe mëshirën e Tij, dhe i fut në Xhenet. Sikur të gjithë jetën e tyre ta kenë kaluar duke mohuar Allahun e gjithçka që nuk duhet mohuar, duke penguar njerëzit nga rruga e Allahut e duke bërë gjynahe pa fre, në qoftë se ata, para vdekjes, pendohen dhe kthehen te Zoti me kërkim faljeje, i Gjithëmëshirshmi i fal dhe i mëshiron. I Lartësuar dhe i Lavdëruar qoftë Allahu i Madhëruar, i Cili ia ka hapur portën e pendimit dhe nuk ia ka mbyllur askujt, për sa kohë është gjallë dhe mund të pendohet. I Lavdëruar qoftë Ai, që është i Butë e i Mëshirshëm, që nuk nxitohet të ndëshkojë gjynahqarët, por, përkundrazi, i ruan, u jep shëndet e i furnizon, sikur të mos kishin bërë asnjë gjynah, edhe pse është i Plotfuqishëm që t'i ndëshkojë!

Pastaj i Madhëruari thotë:

- **"Mos u tregoni të dobët e të kërkoni paqe, kur ju jeni më të lartët dhe Allahu është me ju! Ai nuk do t'jua pakësojë kurrë veprat tuaja."** - Mos u tregoni të pafuqishëm në luftën kundër armiqve tuaj! Mos u frikësoni, por bëhuni të durueshëm dhe qëndroni të patundur! Vazhdimisht përgatituni për luftë dhe vështirësi, por bëjeni këtë me qëllimin për të kënaqur Zotin tuaj, në ndihmë të Islamit, si dhe për të poshtëruar Shejtanin! Mos kërkoni paqëtim me qafirët, thjesht për të rënë rehat, sepse ju jeni më të lartët dhe Allahu është me ju! Ai kurrë nuk ka për t'jua cenuar shpërblimin dhe rezultatet e përpjekjeve tuaja.

Këtu renditen tri arsye të forta, të cilat duhet patjetër t'i motivojnë besimtarët për të qenë të duruar dhe të qëndrueshëm:

1. Ata janë më të lartët. Kjo do të thotë që ata i plotësojnë të parët kushtet e fitores dhe të marrjes së premtimit të Allahut. Njeriu ndihet më i ulët se armiku i tij jo vetëm kur është më poshtë në numër, në përgatitje e mjete se ai, por edhe kur është më i dobët në forcën shpirtërore.

2. Allahu është me ata. Allahu është me besimtarët, duke i ndihmuar, forcuar dhe duke u dhënë fitoren. Ky fakt i fuqizon zemrat e tyre dhe i bën të ndihen superiorë mbi armiqtë.

3. Allahu nuk i pakëson aspak veprat dhe përpjekjet e tyre. Ai jo vetëm që do t'ua dhurojë të plotë shpërblimin që meritojnë, por do t'ua shtojë atë edhe më tepër, nga mirësia dhe bujaria e Tij. Në mënyrë shumë të veçantë, Ai shpërblen adhurimin që quhet xhihad, sepse çdo shpenzim për të shpërblehet deri në shtatëqindfish e më shumë. I Lartësuari thotë: "O ju që keni besuar! Të jeni të devotshëm ndaj Allahut dhe të jeni me të drejtit! Nuk do të ishte me vend për banorët e Medinës e as për beduinët rreth tyre, të ngelin pa shkuar pas të Dërguarit të Allahut dhe as të kursejnë veten e tyre në vend të tij. Nuk do të ishte me vend, ngaqë sa herë që ata preken nga etja, lodhja e uria në rrugën e Allahut, sa herë që shkelin ndonjë vend që i hidhëron jobesimtarët, sa herë që arrijnë kundër armiqve çfarëdolloj fitoreje, të gjitha ato do

t'u shkruhen si vepra të mira. Allahu nuk ua humb kurrë shpërblimin vepërmirëve. Çdo herë që ata bëjnë ndonjë shpenzim, të vogël ose të madh, dhe sa herë që kapërcejnë ndonjë luginë, atyre do u regjistrohet, që Allahu t'i shpërblejë më së miri për atë që kanë bërë." [Teube 119 – 121]. Atëherë, kur robi sigurohet se Allahu i Madhëruar nuk do t'ia shkojë kot luftën dhe përpjekjet e tij, kjo ia shton vullnetin dhe forcat për ta kryer sa më mirë çdo lloj detyrimi. Po nëse bashkohen të tria arsyet e mësipërme? Pa dyshim, ato ia forcojnë vullnetin dhe aktivitetin, duke i bërë të pathyeshëm.

Kështu, Allahu i Madhëruar i gjallëron dhe i forcon shpirtërisht besimtarët, për t'u bërë të durueshëm dhe të qëndrueshëm në çdo rrugë që sjell suksesin e tyre.

Ajetet 36 – 38

36. Vërtet, jeta e kësaj bote është vetëm lojë e dëfrim! Nëse besoni dhe ruheni prej të këqijave, Ai do t'jua japë shpërblimin tuaj. Ai nuk kërkon prej jush tërë pasurinë tuaj.
37. Sikur t'ua kërkonte të gjithën dhe t'ju shtrëngonte, ju do të tregoheshin koprracë dhe do të shfaqnit urrejtje!
38. Ju ftoheni për të shpenzuar në rrugën e Allahut, por ka prej jush që tregohen koprracë. Megjithatë, kush bëhet koprrac, e bën kundra vetes. Allahu është i Pasuri Jonevojtar, ndërsa ju jeni të varfrit. Nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, jeta e kësaj bote është vetëm lojë e dëfrim!" - Duke u zbuluar realitetin e kësaj dynjaje, Allahu i Madhëruar i nxit adhuruesit e Tij që të mos jepen shumë pas saj. Ai u tregon se kjo dynja është lojë e argëtim. Njerëzit, në përgjithësi, jepen tërësisht pas pasurisë, fëmijëve, femrave, ushqimeve, pijeve, banesave, argëtimeve dhe pushtetit. Ata shpesh hutohen pas lojrave të padobishme, në pasivitet, shpërqendrim e gjynahe. Kështu vazhdojnë të mjerët, derisa u mbaron afati në dynja dhe i gllabëron vdekja. Të gjitha qejfet shkatërrohen dhe tashmë ata e kuptojnë që nuk kanë fituar asgjë me to. Madje, afati i tyre jo vetëm që ka përfunduar pa asnjë dobi, por u sjell një pasojë të hidhur. Në ahiret, ata do të privohen nga çdo e mirë dhe do të hidhen në ndëshkim të rëndë. Kësisoj, nëse robi e sheh këtë të vërtetë në sy, atëherë, nëse ka pak logjikë, do t'i shpërfillë qejfet e tepërta të kësaj jete dhe do të tregohet më i përkorë. Ai do t'i kushtojë vëmendje asaj që Allahu thotë më pas:

- "Nëse besoni dhe ruheni prej të këqijave, Ai do t'jua japë shpërblimin tuaj." - Robit i sjell dobi besimi tek Allahu, për engjëjt e Tij, shpalljet, profetët, Ditën e Gjykimit, si edhe përpjekja për të qenë i devotshëm ndaj Tij, duke kryer urdhëresat dhe duke lënë ndalesat, në emër të dashurisë për Zotin dhe për nënshtrim ndaj Tij. Puna e vazhdueshme për të kënaqur Allahun, duke iu larguar gjynaheve dhe mosbindjes ndaj Tij, i sjell robit vetëm mirësi. Për këtë arritur këtë qëllim, ai duhet të garojë dhe të shpenzojë të gjithë mundin dhe kohën e mjaftueshme. Këto vepra, që përmblidhen me fjalën 'adhurim', janë qëllimi kryesor pse Allahu i Madhëruar i krijoi njerëzit. Ato janë, në fakt, mëshirë dhe butësi për ta. Nëse i kryejnë ato, Allahu i Madhëruar do t'i shpërblejë pa masë.

- "Ai nuk kërkon prej jush tërë pasurinë tuaj." – Kuptimi: Allahu i Madhëruar nuk dëshiron t'ju ngarkojë me diçka që ju rëndon së tepërmi. Ai nuk dëshiron t'ju pakësojë pasurinë apo t'ju lërë pa të. Nëse Ai do t'ju kërkonte të gjithë pasurinë tuaj, ju do të tregoheshit koprracë dhe do të dilte në shesh urrejtja që keni në zemër, kur ju kërkohet diçka që ju nuk e dëshironi. I Madhëruari thotë më pas:

- "Sikur t'ua kërkonte të gjithën dhe t'ju shtrëngonte, ju do të tregoheshin koprracë dhe do të shfaqnit urrejtje!" – Arsyeja që njerëzit do të vepronin kështu shpjegohet më pas: edhe kur u kërkohet të shpenzojnë për një çështje që sjell mirësi në dynja dhe në ahiret, përsëri ka disa që tregohen dorështrënguar, siç thotë i Madhëruari:

- "Ju ftoheni për të shpenzuar në rrugën e Allahut, por ka prej jush që tregohen koprracë." – Atëherë, çfarë do të bënin ata nëse do t'u kërkohej të shpenzonin për një çështje që nuk e shohin si të dobishme për të tashmen e prekshme? Sigurisht që do të tregoheshin më koprracë. Por le ta dinë, se:

- **"Megjithatë, kush bëhet koprrac, e bën kundra vetes."** – Ky veprim thjesht dëmton ata vetë, duke u privuar nga shpërblimi i madh i Allahut, i Cili është i Pasur dhe Jonevojtar, prandaj nuk dëmtohet aspak nga koprracia e tyre.

- "Allahu është i Pasuri Jonevojtar, ndërsa ju jeni të varfrit." - Njerëzit kanë nevojë për mëshirën dhe përkujdesin e Allahut në të gjitha çështjet e në çdo çast.

- "Nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju." – Zëvendësuesit nuk do të jenë kundërshtues, por do jenë të bindur ndaj Allahut dhe Profetit të Tij. Ata do ta duan Allahun dhe Profetin e Tij, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "O ju që keni besuar! Kush largohet, prej jush, nga feja e vet, (le ta dijë se) nuk ka dyshim se Allahu do të sjellë një popull tjetër, që Ai i do dhe ata e duan Atë; që është modest e i butë ndaj besimtarëve, por i ashpër dhe i fortë ndaj mohuesve; që lufton në rrugën e Allahut dhe që nuk i frikësohet kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo është dhuratë e Allahut, që ia jep atij që Ai do. Allahu është Dhurues i madh e i Gjithëdijshëm." [Maide 54].

Surja 48: El Fet'h (medinase) 29 ajete

Ajetet 1 – 3
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!


1. Ne të dhamë një çlirim të madh,
2. me qëllim që Allahu të t'i falë gabimet e kaluara dhe ato të mëvonshme, ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj teje, të të udhëzojë në rrugë të drejtë,
3. dhe që Allahu të të ndihmojë ty me një fitore krenuese.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne të dhamë një çlirim të madh..."** - Çlirimi për të cilën bëhet fjalë është Marrëveshja e Hudejbijes, që u bë mes Profetit dhe mekasve idhujtarë, pasi këta të fundit pengonin Profetin e Zotit që të kryente umren. Pas përpjekjeve të shumta dhe bisedimeve të gjata, Profeti (a.s.) arriti një marrëveshje me ta, ku, ndër të tjera, u vendos:

1. Paqe e armëpushim mes palëve për dhjetë vjet.
2. Muslimanët ta ndërprisnin umren atë vit dhe ta kryenin vitin e ardhshëm.
3. Çdokush që dëshironte të bashkohej në aleancë me kurejshit, të lejohej nga muslimanët, e çdokush që dëshironte të bashkohej në aleancë me muslimanët, të lejohej nga idhujtarët etj.

Për shkak të kësaj marrëveshjeje, u krijua një situatë paqeje dhe sigurie, dhe kështu hapësira për t'i ftuar njerëzit në fenë e Zotit ishte më e gjerë. Çdo musliman, në çdo vis ku gjendej, i ftonte njerëzit në Islam, kështu çdo njeri i interesuar mund të gjykonte dhe arsyetonte me qetësi për mesazhin e kësaj feje dhe ta njihte atë realisht, ashtu siç ishte, të pamjegulluar e shtrëmbëruar nga qafirët. Gjatë kësaj kohe, njerëzit nisën të hynin në fenë e Zotit grupe-grupe. Allahu i Madhëruar e quajti 'çlirim', madje 'çlirim i madh', sepse qëllimi i çlirimit të vendeve ku jetojnë idhujtarë është lartësimi i fesë së Allahut dhe fitorja përfundimtare e muslimanëve. Të gjitha këto u arritën nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.
Allahu i Madhëruar solli me këtë ngjarje shumë gjëra të dobishme për Islamin dhe muslimanët. Ai thotë:


الجزء السادس والعشرون سورة الفتح
سورة الفتح
بسم الله الرحمن الرحيم
إنا فتحنا لك فتحا مبينا ١ ليغفر لك الله ما تقدم من ذنبك
وما تأخر ويتم نعمته عليك ويهديك صراطا مستقيما ٢
وينصرك الله نصرا عزيزا ٣ هو الذي أنزل السكينة في قلوب
المؤمنين ليزدادوا إيمانا مع إيمانهم ولله جنود
السموات والأرض وكان الله عليما حكيما ٤ ليدخل المؤمنين والمؤمنات
جنات تجري من تحتها الأنهار خالدين فيها ويكفر عنهم
سيئاتهم وكان ذلك عند الله فوزا عظيما ٥ ويعذب
المنافقين والمنافقات والمشركين والمشركات الظانين
بالله ظن السوء عليهم دائرة السوء وغضب الله عليهم
ولعنهم وأعد لهم جهنم وساءت مصيرا ٦ ولله جنود
السموات والأرض وكان الله عزيزا حكيما ٧ إنا
أرسلناك شاهدا ومبشرا ونذيرا ٨ لتؤمنوا بالله ورسوله
وتعزروه وتوقروه وتسبحوه بكرة وأصيلا ٩
٥١١

Zotit. Fakti që Allahu i Madhëruar ia fali Profetit (a.s.) të gjitha gabimet, të shkuarat dhe të ardhmet, është një nga privilegjet më të mëdha që i janë dhuruar Muhamedit (a.s.). Përveç kësaj:

- "...ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj teje..." – Kuptimi: Të plotësojë mirësinë e Tij ndaj teje, duke ngritur lart fenë tënde, duke të dhënë epërsi mbi armiqtë dhe duke e përhapur fjalën tënde gjerësisht.

- "...të të udhëzojë në rrugë të drejtë..." - Nëpërmjet këtij udhëzimi, Allahu i Madhëruar ju mundëson që të arrini lumturinë e përjetshme, duke fituar çdo të mirë dhe duke shpëtuar nga çdo e keqe.

- "...dhe që Allahu të të ndihmojë ty me një fitore krenuese." – Kuptimi: Ndihma e Alllahut do të jetë e madhe dhe Islami nuk

- "...me qëllim që Allahu të t'i falë gabimet e kaluara dhe ato të mëvonshme..." - Kjo erdhi – dhe Allahu e di më mirë - për shkak të veprave të shumta në bindje ndaj Allahut dhe për shkak të masës së madhe të njerëzve që përqafuan fenë e Tij. Gjithashtu, ndodhi edhe për shkak të pranimit nga ana e Profetit (a.s.) të kushteve të mekasve, gjë e cila kërkonte një durim të hekurt, të cilin e kanë veçse më të zgjedhurit e profetëve të

do të kërcënohet më. Triumfi i Islamit dhe muslimanëve do të jetë i plotë dhe mohuesit do të poshtërohen, do të nënshtrohen e do rrallohen. Fuqia e muslimanëve, në aspektin ushtarak, ekonomik etj., do të mbizotërojë.

Pastaj i Madhëruari tregon frytet e këtij çlirimi te muslimanët, duke thënë:

Ajetet 4 – 6

4. Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua shtuar edhe më tepër besimin, mbi besimin që kishin. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.
5. Besimtarët dhe besimtaret do të futen në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të jenë përgjithmonë. Gjynahet e tyre, gjithashtu, do të falen. Kjo për Allahun është një fitore e madhe.
6. Ndëshkimi është për hipokritët dhe hipokritet, për idhujtarët dhe idhujtaret, të cilët kanë për Allahun mendime të ulëta. Ata meritojnë më të keqen! Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe u ka bërë gati Xhehenemin, që është vendi më i keq.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Është Ai që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua shtuar edhe më tepër besimin, mbi besimin që kishin."** - Allahu i Madhëruar na tregon një mirësi, me të cilën privilegjon besimtarët: qetësia në zemrat e tyre. Kjo qetësi e zbritur nga i Madhëruari sjell qëndrueshmëri në çdo situatë sprove. Ajo sjell durim e vendosmëri në kalimin e këtyre situatave. Arsyeja është se sprovat dhe ngjarjet e rënda e trondisin zemrën, mendjen dhe arsyen e njeriut. Ato ia dobësojnë shpirtin dhe vullnetin. Por nëpërmjet paqes shpirtërore të zbritur prej Tij, Allahu i Madhëruar i forcon zemrat dhe këmbët e besimtarëve, kthjellon arsyen dhe logjikën e tyre, që në situatat e vështira të veprojnë me maturi dhe durim, duke plotësuar çdo porosi të Tij në formën më të plotë. Gjithashtu, qetësia e zbritur nga Allahu ua shton imanin besimtarëve dhe ua forcon sigurinë në premtimin e Tij.

Shiko sahabët dhe çfarë ndodhi pas marrëveshjes së Profetit (a.s.) me idhujtarët e Mekës. Në pamje të parë, ajo dukej sikur ishte ulje dhe humbje për muslimanët, në disa pika të saj, siç ishte moskryerja e umres atë vit apo ndonjë kusht tjetër. Të tilla kushte ishin të vështira të pranoheshin, aq më tepër kur muslimanët tashmë ishin fuqizuar dhe me një ushtri të rregullt. Por urtësia e Allahut është mbi gjithçka tjetër, dhe kjo ishte e qartë për ta, prandaj bënë durim dhe iu nënshtruan vendimit të Allahut e Profetit të Tij. Kur ata bënë durim dhe iu nënshtruan urdhrit, Allahu i Lartësuar u zbriti qetësi në zemra dhe ua shtoi sigurinë në premtimin e Tij.

- **"Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë."** - Të gjitha ushtritë e qiejve dhe të Tokës janë nën komandën e Tij. Ato i janë nënshtruar vullnetit, ligjit dhe caktimit të Allahut. Kështu, të mos mendojnë idhujtarët se Allahu nuk do ta ndihmojë dhe mbështesë Profetin dhe fenë e Tij. Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshmi dhe i Urti, që ditët e fitores dhe epërsisë i vërtit mes njerëzve, prandaj ndonjëherë e vonon triumfin e muslimanëve.

- **"Besimtarët dhe besimtaret do të futen në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të jenë përgjithmonë. Gjynahet e**

tyre, gjithashtu, do të falen." - Ky është premtimi i mrekullueshëm për muslimanët. Duke hyrë në kopshtet e Xhenetit, ata do të arrijnë gjithçka të mirë që dëshirojnë, ndërsa me faljen e gjynaheve të tyre, do të shpëtojnë nga gjithçka e keqe së cilës i druhen.

- "Kjo për Allahun është një fitore e madhe." – Arritja e këtij suksesi nga besimtarët vlerësohet nga Allahu i Madhëruar si një fitore e madhe.

- **"Ndëshkimi është për hipokritët dhe hipokritet, për idhujtarët dhe idhujtaret, të cilët kanë për Allahun mendime të ulëta. Ata meritojnë më të keqen!"** - Ndërsa për munafikët dhe munafiket, idhujtarët dhe idhujtaret, ky sukses i muslimanëve ishte trishtim i madh. Qëllimi i tyre ishte dëmtimi i muslimanëve dhe zhdukja e Islamit, duke menduar se Allahu nuk do ta ndihmonte fenë e Tij dhe nuk do ta bënte të triumfonte. Ky qe mendim shumë i gabuar për Allahun. Ata e përkeqësuan mendimin për të Madhëruarin e të Urtin edhe më shumë, kur planifikuan që të mposhtnin pasuesit e të vërtetës. Por Allahu i Madhëruar dhe i Plotfuqishëm ua shkatërroi dhe ua ktheu mbrapsht planet e tyre të dështuara. Përveç kësaj:

- **"Allahu është zemëruar me ta, i ka mallkuar dhe u ka bërë gati Xhehenemin, që është vendi më i keq."** - Për shkak të armiqësisë dhe luftës së tyre kundër të vërtetës dhe ithtarëve të saj, mbi ta goditi ashpër zemërimi i Zotit. Ai i mallkoi dhe i largoi nga mëshira e Tij. Ata i pret Xhehenemi, që është përgatitur si vendqëndrim për çdo mohues, kundërshtues dhe armik të së vërtetës.

Ajeti 7

7. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës. Allahu është Ngadhënjyesi e i Urti.

Shpjegimi i ajetit

- "Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës." - Allahu i Madhëruar e përsërit këtë të vërtetë, për ta përforcuar faktin se vetëm Atij i takon pushteti e sundimi i qiejve, i Tokës e gjithçka mes tyre. Nën sundimin e Tij janë të gjitha ushtritë dhe Ai do t'i ndihmojë gjithmonë ata që luftojnë për të lartësuar fenë dhe fjalën e Tij. Askush nuk mund t'i mposhtë ushtarët e Zotit, besimtarët e sinqertë të Tij, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Premtimi Ynë u është dhënë më parë robërve Tanë të dërguar, se ata sigurisht që do të ndihmohen dhe se ushtria Jonë do të jetë ngadhënjyese!" [Saffat 171 – 173].

- **"Allahu është Ngadhënjyesi e i Urti."** - E si mund të fitojë kush kundër ushtrisë së Allahut, që është *El Aziz* - Ngadhënjyesi, i Fuqishmi, Krenari e Nënshtruesi i gjithçkaje?! Por Ai është edhe *El Hakim* - i Urti, që çdo gjë e ka krijuar me një funksion e qëllim, sipas urtësisë së Tij.

Ajetet 8 – 9

8. Ne të dërguam ty si dëshmitar, si përgëzues dhe paralajmërues,
9. që ju ta besoni Allahun, ashtu edhe të Dërguarin e Tij, të cilin ta përkrahni e ta respektoni, dhe që të bëni *tesbih* mëngjes e mbrëmje.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne të dërguam ty si dëshmitar, si përgëzues dhe paralajmërues..." – Allahu i Madhëruar e dërgoi Profetin besnik, që të dëshmojë mbi ymetin e tij, rreth qëndrimit të tyre, të mirë apo të keq. Ai do të dëshmojë për fjalët dhe veprat e ymetit, për ato të saktat e të vërtetat, ashtu edhe për ato të stisurat, të kotat e të pasaktat.

Ai u dërgua, gjithashtu, si dëshmues për njëshmërinë e Zotit në meritën e adhurimit dhe për atributet e Tij të plota e absolute në çdo drejtim.

Përveç këtyre, Profeti (a.s.) u dërgua që përgëzojë të gjithë ata që i binden Allahut dhe fjalës së tij, për shpërblime dhe mirësi të shumta, që kanë lidhje me dynjanë, fenë dhe ahiretin e tyre.

Ndërsa për ata që nuk i binden Allahut e Profetit të Tij, ai u dërgua që t'i paralajmërojë për ndëshkimin në këtë jetë dhe në tjetrën.

Që përgëzimi dhe paralajmërimi të përcillen me sukses, duhet që të tregohen dhe sqarohen të gjitha fjalët dhe veprat për të cilat ka përgëzim ose kërcënim. Profeti (a.s.) ishte qartësuesi i të mirës dhe i të keqes, i rrugës të lumturisë dhe i shkaqeve të ndëshkimit, qartësues i të vërtetës dhe të kotës. Ai e bëri këtë detyrë në formën më të plotë, pa lënë asnjë boshllëk dhe mangësi. Prandaj, pas përshkrimit të tij si dëshmues e përgëzues, i Madhëruari thotë:

- "...që ju ta besoni Allahun, ashtu edhe të Dërguarin e Tij..." – Për shkak të ftesës së qartë dhe të bukur të Profetit, për shkak të mësimit prej tij të çdo gjëje të mirë dhe të dobishme, ai u dërgua që njerëzit të besojnë Allahun dhe Profetin e Tij në mënyrën të saktë dhe të qartë. Ky besim kërkon që njerëzit të binden dhe të jetojnë sipas urdhrave e porosive të tyre, në të gjitha çështjet.

- "...të cilin ta përkrahni e ta respektoni..." - Ta respektoni, duke plotësuar të drejtat dhe përgjegjësitë ndaj tij. Profeti meriton respektin tuaj të plotë, sepse nëpërmjet tij, Zoti ju çliroi nga mosbesimi dhe ju dhuroi lirinë që ju fal besimi.

- **"...dhe që të bëni *tesbih* mëngjes e mbrëmje."** – Kuptimi: Ta madhëroni, lartësoni e lavdëroni Allahun, duke bërë *tesbih* mëngjes e mbrëmje!

Në këtë ajet përmenden tri lloje detyrimesh:

1. Detyrimi i robërve kundrejt Allahut dhe Profetit, i cili është besimi tek ata të dy dhe bindja ndaj tyre.

2. Detyrimi i veçantë ndaj Profetit (a.s.), i cili është respektimi i tij.

3. Detyrimi i veçantë ndaj Zotit, i cili është madhërimi e lavdërimi i Tij me *tesbih*, namaz e vepra të tjera.

Ajeti 10

10. Ata që të japin besën ty, në të vërtetë ata i japin besën Allahut! Dora e Allahut është mbi duart e tyre! Kush e shkel atë, e shkel vetëm në dëm të vetes, ndërsa kush e zbaton besën që i ka dhënë Allahut, do të marrë prej Atij shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajetit

Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar flet për të ashtuquajturën "*Bejatul Riduan*" ose "Besëlidhja e Kënaqësisë së Allahut", kur Profeti (a.s.) mori besën e sahabëve që ata nuk do ta tradhtonin kurrë. Ajo qe një besëlidhje shumë e veçantë, sepse kërkonte nga sahabët që të mos e braktisnin kurrë Profetin (a.s.) gjatë luftës, madje edhe në

rastet kur largimi nga lufta është i lejueshëm. Ata do të qëndronin me të në çdo situatë, deri në vdekje. Kështu, Allahu i Madhëruar na tregon:

- "Ata që të japin besën ty, në të vërtetë ata i japin besën Allahut!" – Kuptimi: Ata të cilët lidhin besë me ty, o i Dërguar, në të vërtetë lidhin besë me Allahun e Madhëruar! Për ta përforcuar edhe më shumë rëndësinë e kësaj besëlidhjeje në zemrat e besimtarëve, Allahu i Madhëruar tha:

- "Dora e Allahut është mbi duart e tyre!" – Kjo është një besë e lidhur dorë më dorë me vetë Allahun!


Kjo është thënë për të theksuar rëndësinë e madhe të kësaj besëlidhje dhe për t'i nxitur besimtarët që t'i përmbaheshin asaj me çdo kusht. Madje, për t'ia shtuar peshën edhe më tepër, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Kush e shkel atë, e shkel vetëm në dëm të vetes..." - Ai që nuk e çon në vend besën që i ka dhënë Allahut, ka dëmtuar vetveten, sepse ndëshkimin e Tij nuk mund ta pengojë asgjë. Ndërsa për ata që do t'i përmbaheshin besës me përpikmëri, Allahu i Madhëruar thotë:

- "...ndërsa kush e zbaton besën që i ka dhënë Allahut, do të marrë prej Atij shpërblim të madh." – Askush nuk e di dhe nuk mund ta përshkruajë madhësinë e këtij shpërblimi, përveç Allahut, që e dhuroi, duke ua mundësuar besimtarëve që ta arrijnë.

Ajetet 11 – 13

11. Beduinët që nuk erdhën do të thonë: "Na penguan pasuria dhe familjet tona,


الجزء السادس والعشرون سورة الفتح
إِنَّ ٱلَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَ ٱللَّهَ يَدُ ٱللَّهِ فَوْقَ
أَيْدِيهِمْ ۚ فَمَن نَّكَثَ فَإِنَّمَا يَنكُثُ عَلَىٰ نَفْسِهِۦ ۖ وَمَنْ أَوْفَىٰ
بِمَا عَٰهَدَ عَلَيْهُ ٱللَّهَ فَسَيُؤْتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١٠﴾ سَيَقُولُ
لَكَ ٱلْمُخَلَّفُونَ مِنَ ٱلْأَعْرَابِ شَغَلَتْنَآ أَمْوَٰلُنَا وَأَهْلُونَا
فَٱسْتَغْفِرْ لَنَا ۚ يَقُولُونَ بِأَلْسِنَتِهِم مَّا لَيْسَ فِى قُلُوبِهِمْ ۚ قُلْ
فَمَن يَمْلِكُ لَكُم مِّنَ ٱللَّهِ شَيْـًٔا إِنْ أَرَادَ بِكُمْ ضَرًّا أَوْ أَرَادَ بِكُم
نَفْعًا ۚ بَلْ كَانَ ٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرًا ﴿١١﴾ بَلْ ظَنَنتُمْ أَن لَّن
يَنقَلِبَ ٱلرَّسُولُ وَٱلْمُؤْمِنُونَ إِلَىٰٓ أَهْلِيهِمْ أَبَدًا وَزُيِّنَ ذَٰلِكَ فِى
قُلُوبِكُمْ وَظَنَنتُمْ ظَنَّ ٱلسَّوْءِ وَكُنتُمْ قَوْمًۢا بُورًا ﴿١٢﴾ وَمَن لَّمْ يُؤْمِنۢ
بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ فَإِنَّآ أَعْتَدْنَا لِلْكَٰفِرِينَ سَعِيرًا ﴿١٣﴾ وَلِلَّهِ مُلْكُ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ يَغْفِرُ لِمَن يَشَآءُ وَيُعَذِّبُ مَن يَشَآءُ ۚ
وَكَانَ ٱللَّهُ غَفُورًا رَّحِيمًا ﴿١٤﴾ سَيَقُولُ ٱلْمُخَلَّفُونَ إِذَا
ٱنطَلَقْتُمْ إِلَىٰ مَغَانِمَ لِتَأْخُذُوهَا ذَرُونَا نَتَّبِعْكُمْ ۖ يُرِيدُونَ
أَن يُبَدِّلُوا۟ كَلَٰمَ ٱللَّهِ ۚ قُل لَّن تَتَّبِعُونَا كَذَٰلِكُمْ قَالَ ٱللَّهُ مِن قَبْلُ ۖ
فَسَيَقُولُونَ بَلْ تَحْسُدُونَنَا ۚ بَلْ كَانُوا۟ لَا يَفْقَهُونَ إِلَّا قَلِيلًا ﴿١٥﴾
٥١٢

ndaj kërko falje për ne!" Ata thonë me gojë gjëra që nuk i kanë në zemër. Thuaju: "Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron që t'ju përfshijë ndonjë gjëmë ose t'ju vijë ndonjë e mirë?!" Nuk është ashtu! Allahu e di shumë mirë se çfarë veproni ju!

12. Ju pandehët se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të ktheheshin më te familjet e veta, dhe kjo, thellë në zemër, ju duk gjë e mirë. Ju patët mendim të keq, sepse jeni njerëz të prishur.

13. Nëse dikush nuk i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë Ne, sigurisht, kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr shumë të fortë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Beduinët që nuk erdhën do të thonë: "Na penguan pasuria dhe familjet tona, ndaj kërko falje për ne!"" - Allahu i Madhëruar i

qorton ata të cilët u dembelosën dhe nuk shkuan së bashku me Profetin të luftonin në rrugën e Tij. Këta ishin disa beduinë me iman të dobët dhe me zemër të sëmurë. Ata patën një mendim të keq për Allahun e Lartësuar. Ata u justifikuan duke thënë se i kishte penguar pasuria dhe familja nga pjesëmarrja në xhihad. Ata, gjithashtu, i kërkuan Profetit (a.s.) që të kërkonte falje për ta. Më pas, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Ata thonë me gojë gjëra që nuk i kanë në zemër. Thuaju: "Kush mund ta pengojë Allahun, nëse Ai dëshiron që t'ju përfshijë ndonjë gjëmë ose t'ju vijë ndonjë e mirë?!" Nuk është ashtu! Allahu e di shumë mirë se çfarë veproni ju!" - Kur i thanë Profetit që të kërkonte falje për ta, ata donin të tregonin se e pranonin fajin dhe se ishin të penduar për të. Faji i tyre ishte mosmarrja pjesë në luftë me Profetin (a.s.). Por, në fakt, ata nuk ishin penduar me zemër. Nëse vërtet do të ndienin keqardhje për veprimin e tyre, atëherë lutja e Profetit (a.s.) për ta do t'u vlente, sepse pendimi është i dobishëm për ata që, sinqerisht, kthehen te Zoti të nënshtruar. E vërteta qe se ata nuk morën pjesë në luftë, pasi kishin mendim të keq për Allahun:

- "Ju pandehët se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të ktheheshin më te familjet e veta, dhe kjo, thellë në zemër, ju duk gjë e mirë. Ju patët mendim të keq, sepse jeni njerëz të prishur." - Ata menduan se Profeti (a.s.) dhe besimtarët do të vriteshin në luftë dhe nuk do të ktheheshin më në shtëpitë e tyre. Dalëngadalë, ky mendim po iu pëlqente thellë në zemër, derisa iu bë ide e palëkundur. Dy ishin shkaqet e kësaj: së pari, ata ishin njerëz të prishur, tek të cilët nuk kishte asnjë hajër. Nëse në shpirtrat e tyre do të kishte ndonjë mirësi, ata kurrsesi nuk do t'i mendonin këto gjëra. Kurse shkaku i dytë ishte dobësia e imanit dhe e sigurisë së tyre në premtimin e Allahut për lartësimin e fjalës së Tij. I Lartësuar thotë:

- "Nëse dikush nuk i beson Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë Ne, sigurisht, kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr shumë të fortë." - Ai që nuk i beson Allahut dhe Profetit të Tij, është qafir dhe meriton ndëshkimin në Zjarrin e ndezur fort.

Ajeti 14

14. Vetëm Allahut i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës! Ai fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të dojë. Allahu është Falës i gjynaheve e Mëshirues.

Shpjegimi i ajetit

- "Vetëm Allahut i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës!" - Allahu i Madhëruar është i Vetëm dhe i Pashoq në pushtetin, mbretërimin dhe sundimin e qiejve dhe të Tokës. Është Ai që ka vendosur në gjithësi ligjet e funksionimit të saj dhe çdo gjë e krijuar ekziston dhe funksionon sipas këtyre ligjeve. Është vetëm Ai që ka vendosur ligjet e Sheriatit për robërit e Tij, të cilët janë të detyruar që ta zbatojnë atë. Ata duhet t'i nënshtrohen me vetëdije dhe vullnet të plotë ligjeve të Tij, nëse duan shpëtimin. Është Allahu, gjithashtu, që ka vendosur rregullat e shpërblimit dhe të ndëshkimit. Ai shpërblen dhe ndëshkon në bazë të diturisë, urtësisë, mëshirës e bujarisë së Tij, por edhe të drejtësisë së Tij, sipas zbatimit të ligjit nga krijesat e Tij. Allahu i Madhëruar e ka lidhur shpërblimin dhe ndëshkimin me

zbatimin e dispozitave ligjore të vendosura nga Ai. Më pas, i Madhëruari thotë:

- **"Ai fal kë të dojë dhe ndëshkon kë të dojë."** - Allahu i fal ata që Ai dëshiron. Të falurit janë ata që zbatojnë ligjin e Zotit, në shenjë dashurie, nënshtrimi, madhërimi e përunjësie ndaj Tij, me mënyrën, rrugët, fjalët dhe veprat që Ai i ka përcaktuar.

Po ashtu, Allahu ndëshkon ata që Ai dëshiron. Këta janë ata që e shpërfillin ligjin e Zotit dhe nuk e trajtojnë atë si i takon, me respekt, dashuri e përkushtim.

- **"Allahu është Falës i gjynaheve e Mëshirues."** – Allahu fal dhe mëshiron në çdo kohë. Ai vazhdimisht i fal gjynahqarët, i afatizon ata dhe pranon pendimin e tyre. Mirësitë e Tij të shumta vërshojnë mbi krijesat natë e ditë, në çdo çast e çdo gjendje.

Ajeti 15

15. Kur ju të shkoni për të mbledhur plaçkën e luftës, ata që ngelën pas do të thonë: "Na lini të vijmë edhe ne me ju!" Kështu, ata duan të ndryshojnë vendimin e Allahut! Ti thuaju: "Kurrsesi! Ju nuk keni për të ardhur me ne! Kështu ka thënë Allahu më herët!" Kurse ata do t'ju thonë: "Nuk është ashtu! Ju na keni zili!" Por ata logjikojnë shumë pak.

Shpjegimi i ajetit

- **"Kur ju të shkoni për të mbledhur plaçkën e luftës, ata që ngelën pas do të thonë: "Na lini të vijmë edhe ne me ju!""** - Pasi përshkroi gjendjen e përbuzur dhe të dënueshme të njerëzve që nuk morën pjesë në luftë me Profetin (a.s.), Allahu i Madhëruar na tregon një prej mënyrave me të cilën ata u ndëshkuan që në dynja. Kur Profeti (a.s.) dhe shokët e tij, me mirësinë e Zotit, fituan plaçkë lufte pa zhvilluar asnjë betejë dhe shkuan për ta marrë atë, këta të mjerë kërkuan që të merrnin ndonjë pjesë, duke thënë: "Na lejoni të vijmë edhe ne me ju, që të marrim nga plaçka luftës!"

Kështu ata donin të ndryshonin gjykimin e Allahut rreth plaçkës së luftës dhe atyre që e meritojnë atë. Allahu i Madhëruar kishte vendosur që këtyre të mos u jepej gjë nga plaçka e luftës, si ndëshkim për ta, por ta përfitonin vetëm besimtarët e vërtetë. Ky qe caktimi i Zotit dhe ligji i Tij.


- **"Kështu, ata duan të ndryshojnë vendimin e Allahut! Ti thuaju: "Kurrsesi! Ju nuk keni për të ardhur me ne! Kështu ka thënë Allahu më herët!""** - Thuaju atyre: "Kurrë nuk keni për të ardhur! Ju jeni të privuar nga ky nder, sepse ia bëtë vetes padrejtësinë duke mos marrë pjesë në luftë, kur u ftuat të bashkoheshit me ne!"

- "E ata do t'ju thonë: "Nuk është ashtu! Ju na keni zili!" Por ata logjikojnë shumë pak." - Kur atyre iu përcoll gjykimi i Allahut, që ishte ndëshkim për ta, si përgjigje thanë: "Ju na keni zili! Nga zilia juaj, nuk doni që të marrim pjesë me ju në plaçkën e luftës!"

Ja, deri këtu arriti logjika e tyre në këtë çështje. Nëse do të logjikonin drejt, do ta kuptonin se ata u privuan nga plaçka e luftës për shkak të mosbindjes së tyre. Do ta kuptonin se mosbindja sjell ndëshkime në dynja dhe në ahiret.

Ajetet 16 – 17

16. Atyre beduinëve që ngelën pas, thuaju: "Ju do të thirreni të dilni kundër një



populli luftarak e të fuqishëm, që ose do të luftohen, ose do të dorëzohen. Nëse i përgjigjeni thirrjes, Allahu do t'ju japë shpërblim të mirë, e nëse nuk dilni, - sikurse nuk dolët edhe më parë, - Ai do t'ju ndëshkojë me një dënim të dhembshëm".

17. Por nuk marrin gjynah të verbërit, të çalët e të sëmurët. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta fusë në kopshtet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj, e kush kthen shpinën, Ai do ta ndëshkojë me një dënim të dhembshëm.

Shpjegimi i ajeteve

Më sipër, Allahu i Madhëruar foli për ata të cilët nuk morën pjesë në xhihad së bashku me Profetin (a.s.), dhe për këtë nxorën justifikime të kota. Aq të pafytyrë ishin, saqë po të dilte rasti ku, së bashku me ushtrinë muslimane, të mund të merrnin plaçkë lufte pa bërë luftë, kërkonin që të përfitonin edhe ata. Ata donin të merrnin pjesë thjesht në ndarjen plaçkës e jo të jepnin kontribut në luftë. Por Allahu i Madhëruar, duke dashur të nxjerrë në shesh qëllimet e tyre të ulëta, tha:

- "Atyre beduinëve që ngelën pas, thuaju: "Ju do të thirreni të dilni kundër një populli luftarak e të fuqishëm, që ose do të luftohen, ose do të dorëzohen."" - Do të vijë dita që, kur Profeti apo ata që do të jenë në vend të tij (si kalifët e drejtë), t'ju thërrasin për luftë kundër një populli të fuqishëm.

Populli për të cilin aludohet këtu mund të ishin persët, romakët ose të tjerë si ata, për sa i përket fuqisë ushtarake. Por kur të ndodhte kjo, para atyre popujve do të ishin vetëm dy mundësi: ose luftë, ose të dorëzoheshin duke pranuar Islamin, pasi për shkak të fuqisë së tyre, ata nuk pranonin të jepnin xhizjen, si alternativë e tretë. Megjithatë, pas fitoreve të muslimanëve, ata e kuptuan se tashmë ishin të pafuqishëm kundrejt muslimanëve, prandaj u ngelën dy mundësitë e tjera: ose të pranonin Islamin, ose të jepnin xhizjen.

Kjo qe prova e Allahut të Madhëruar për munafikët, që të shihej si do të vepronin:

- "Nëse i përgjigjeni thirrjes, Allahu do t'ju japë shpërblim të mirë...". - Nëse do t'i bindeshin thirrjes për luftë, do të fitonin një shpërblim të mirë, të cilin Allahu e ka vendosur për ata që luftojnë në rrugën e Tij. Por, në të kundërt:

- "...e nëse nuk dilni, - sikurse nuk dolët edhe më parë, - Ai do t'ju ndëshkojë me një dënim të dhembshëm." – Nëse do të vepronin sikurse më parë, duke i bërë bisht

ftesës së Profetit për të luftuar në rrugën e Zotit, atëherë i priste një ndëshkim i dhembshëm.

Ky ajet është edhe vlerësim i lartë i kalifëve të drejtë pas Profetit (a.s.), të cilët udhëhoqën luftën kundër fuqive të mëdha të asaj kohe, si Persia, Roma etj. Ai tregon se bindja ndaj urdhrit të tyre për luftë ishte e detyrueshme.

Pastaj Allahu i Madhëruar na bën të ditur kategoritë që lejohen të mos marrin pjesë në xhihad:

- **"Por nuk marrin gjynah të verbërit, të çalët e të sëmurët."** - Për këto grupe sociale nuk ka gjynah nëse nuk marrin pjesë në xhihad, për arsye të pamundësisë dhe paaftësisë së tyre fizike.

- "Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai do ta fusë në kopshtet e Xhenetit, ku rrjedhin lumenj..." - Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, duke përmbushur urdhëresat e tyre, Allahu do t'i fusë në kopshtet e Xhenetit, në të cilët rrjedhin lumenj. Atje do të kenë gjithçka që ua dëshiron shpirti dhe që ua kënaq sytë.

- "...e kush kthen shpinën, Ai do ta ndëshkojë me një dënim të dhembshëm." - Ndërsa ata që i kthejnë shpinën bindjes ndaj Zotit dhe Profetit të Tij, i Madhëruari ka për t'i ndëshkuar me një dënim të dhembshëm. Lumturia është e lidhur me bindjen ndaj Allahut dhe Profetit, ndërsa dëshpërimi është rezultat i drejtpërdrejtë i kundërshtimit të tyre.

Ajetet 18 – 21

18. Vërtet, Allahu u kënaq me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën ty. Ai e dinte mirë çfarë kishin në zemër ata, prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt,
19. por edhe me një plaçkë të madhe, që do ta fitojnë. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë.
20. Allahu ju premton plaçkë të madhe, që do ta fitoni, kurse këtë jua dha më shpejt. Ai i pengoi duart e njerëzve kundra jush, që të shihej si shenjë e mirë nga besimtarët dhe që t'ju udhëzonte në rrugë të drejtë.
21. Por do të keni edhe të tjera, të cilat nuk keni patur mundësi t'i arrinit, sepse Allahu i ka të gjithë nën sundim. Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, Allahu u kënaq me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën ty." - Allahu i Madhëruar na tregon për mirësinë e madhe që u bëri besimtarëve kur deklaroi kënaqësinë e Tij ndaj tyre, në momentin që ata i dhanë besën Profetit (a.s.) poshtë një peme. Kjo qe një besëlidhja historike, që ua zbardhi faqen atyre. Atë ditë, ata nënshkruan për lumturinë e dynjasë dhe ahiretit. Kjo besëlidhje u quajt "*Bejatul Riduan*" - "Besëlidhja e Kënaqësisë", sepse Allahu i Madhëruar u kënaq me ata që morën pjesë në të. Gjithashtu, ajo u quajt si "*Bejatul Shexherah*" - "Besëlidhja e Pemës", prej vendit në të cilin u lidh kjo besë, nën hijen e një peme.

Shkak i kësaj besëlidhjeje u bë ngjarja që ndodhi me Profetin (a.s.), kur u nis drejt Qabes për të kryer umren. Profeti (a.s.) komunikoi me idhujtarët e Mekës, për t'u bërë të ditur se nuk ishte nisur për luftë, por thjesht për të kryer vizitë në Shtëpinë e Zotit. Këtë njoftim Profeti (a.s.) e dërgoi te mekasit nëpërmjet Uthman Ibn Afanit. Pak

kohë pas dërgimit të Uthmanit, vjen një lajm i rremë se idhujtarët e kishin vrarë Uthmanin. Atëherë, Profeti (a.s.) grumbulloi menjëherë ata që ishin nisur me të, të cilët ishin rreth 1500 vetë. Poshtë një peme, ata betuan të gjithë që do të luftonin idhujtarët dhe që nuk do të largoheshin kurrë nga lufta, derisa të fitonin ose të vdisnin të gjithë.

Allahu i Madhëruar na njoftoi se Ai u kënaq me besimtarët për këtë besëlidhje të tyre, e cila ishte një nga shprehjet më të mëdha të bindjes së plotë ndaj Tij dhe Profetit.

- "Ai e dinte mirë çfarë kishin në zemër ata, prandaj u dhuroi qetësi..." - Allahu e dinte shumë mirë se çfarë besimi të plotë kishte në zemrat e tyre, prandaj, si shpërblim, u fali qetësi e siguri. Allahu është Shpërblyes i madh edhe për punë të vogla.

Gjithashtu, Allahu i Urtë dhe i Gjithëdijshëm e dinte mirë edhe vështirësinë e besimtarëve për t'i pranuar kushtet që vendosën idhujtarët për arritjen e marrëveshjes, prandaj, me mëshirën e Tij, Ai zbriti mbi besimtarët qetësi në zemër. Kështu, ata do të ishin të qëndrueshëm në zbatimin e porosive dhe vendimeve të Allahut dhe Profetit të Tij dhe, përveç kësaj, do të ishin të kënaqur me zgjedhjen e tyre.

- "...dhe i përgëzoi me një fitore të afërt, por edhe me një plaçkë të madhe, që do ta fitojnë." - Ky ishte çlirimi i Hajberit, ku morën pjesë vetëm ata të Besëlidhjes së Kënaqësisë. Ata ishin të vetmit që përfituan nga plaçka e luftës së Hajberit, si shpërblim për bindjen ndaj Allahut dhe Profetit të Tij. Ata zbatuan atë që kënaqte Zotin, dhe Zoti i kënaqi me ato gjëra që ua dëshironte zemra.

- "Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." - Allahu është Ngadhënjyesi, i Plotfuqishmi, i Cili ka nënshtruar gjithçka me pushtetin e Tij. Nëse do të dëshironte Ai, në çdo përplasje e luftë do t'i mposhte qafirët dhe do t'ua jepte fitoren besimtarëve, por Ai është i Urtë, prandaj i sprovon besimtarët dhe qafirët me njëri tjetrin.

- "Allahu ju premton plaçkë të madhe, që do ta fitoni, kurse këtë *(fitoren e Hajberit)* jua dha më shpejt." – Ky premtim përmbledh të gjithë plaçkën e luftës dhe betejat që do të fitojnë muslimanët, deri në Ditën e Kijametit.

Fragmenti: "...kurse këtë jua dha më shpejt" ka për qëllim plaçkën e Hajberit. Kështu, ajeti do të thotë: Mos mendoni se shpërblimi i Allahut mbaron me plaçkën e Hajberit! Përkundrazi, pasuri të mëdha ju presin edhe në të ardhmen. Atëherë, lavdërojeni dhe falënderojeni Allahun për këtë!

- "Ai i pengoi duart e njerëzve kundra ndaj jush, që të shihej si shenjë e mirë nga besimtarët..." - Allahu i ndali njerëzit që ishin të aftë dhe të gatshëm t'ju luftonin! Kjo qe një ndihmë e madhe për ju. Gjithashtu, plaçka e luftës e fituar nga ju le të jetë si dëshmi se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe shpërblimi i Tij për besimtarët është i madh. Ai që caktoi për ju pasurinë e Hajberit është i Plotfuqishmi, i Cili do t'ju dhurojë edhe të tjera si ajo.

- "...dhe që t'ju udhëzonte në rrugë të drejtë." - Nëpërmjet rrugëve dhe shkaqeve të përcaktuara nga Ai, Allahu do t'ju udhëzojë në rrugën e drejtë. Kjo rrugë e

drejtë është dija e saktë dhe e vërtetë, besimi i sinqertë, si edhe veprat e mira, sipas dijes së saktë dhe besimit të sinqertë.

- "Por do të keni edhe të tjera, të cilat nuk keni patur mundësi t'i arrinit, sepse Allahu i ka të gjithë nën sundim." - Allahu ju premton edhe plaçkë tjetër, që ende nuk e keni shtënë në dorë. Të jeni të sigurt se Allahu është i Plotfuqishëm për t'jua dhuruar, sepse gjithçka është nën sundimin dhe pronësinë e Tij, aq më tepër që Ai jua ka premtuar ato, dhe premtimi i Tij duhet të shkojë patjetër në vend.

Premtimi i Allahut nuk mund të shkelet kurrë, sepse Ai është i Plotë në pushtetin dhe mbretërimin e Tij, siç thotë vetë Ai më pas:


- "Allahu është i Plotfuqishëm për çdo gjë."

Ajetet 22 – 23

22. Nëse jobesimtarët ju hapin luftë, do të jenë ata që do të sprapsen, pa mundur të gjejnë më pas as mbrojtës e as ndihmës.
23. I tillë ka qenë ligji i Allahut edhe më herët. Në ligjin e Allahut nuk ke për të gjetur ndryshime.

Shpjegimi i ajeteve

Këtu është premtimi i Allahut të Madhëruar për adhuruesit e Tij besimtarë: fitore kundër armiqve të tyre qafirë. Edhe sikur qafirët të nisin ndonjë luftë me besimtarët, ata do të tërhiqen, duke mos gjetur pastaj as mbrojtës, as ndihmëtarë. Ata nuk kanë për të gjetur ndonjë mik, që të marrë përsipër të mbrojë kauzën e tyre, dhe as aleatë që t'i ndihmojnë për fitoren në luftën e tyre. Përkundrazi, ata do të


الجزء السادس والعشرون سورة الفتح
وَهُوَ ٱلَّذِى كَفَّ أَيْدِيَهُمْ عَنكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ عَنْهُم بِبَطْنِ مَكَّةَ مِنۢ
بَعْدِ أَن أَظْفَرَكُمْ عَلَيْهِمْ ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرًا ﴿٢٤﴾
هُمُ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ وَصَدُّوكُمْ عَنِ ٱلْمَسْجِدِ ٱلْحَرَامِ
وَٱلْهَدْىَ مَعْكُوفًا أَن يَبْلُغَ مَحِلَّهُۥ ۚ وَلَوْلَا رِجَالٌ مُّؤْمِنُونَ وَنِسَآءٌ
مُّؤْمِنَٰتٌ لَّمْ تَعْلَمُوهُمْ أَن تَطَـُٔوهُمْ فَتُصِيبَكُم مِّنْهُم مَّعَرَّةٌۢ
بِغَيْرِ عِلْمٍ ۖ لِّيُدْخِلَ ٱللَّهُ فِى رَحْمَتِهِۦ مَن يَشَآءُ ۚ لَوْ تَزَيَّلُوا۟ لَعَذَّبْنَا
ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ مِنْهُمْ عَذَابًا أَلِيمًا ﴿٢٥﴾ إِذْ جَعَلَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟
فِى قُلُوبِهِمُ ٱلْحَمِيَّةَ حَمِيَّةَ ٱلْجَٰهِلِيَّةِ فَأَنزَلَ ٱللَّهُ سَكِينَتَهُۥ
عَلَىٰ رَسُولِهِۦ وَعَلَى ٱلْمُؤْمِنِينَ وَأَلْزَمَهُمْ كَلِمَةَ ٱلتَّقْوَىٰ
وَكَانُوٓا۟ أَحَقَّ بِهَا وَأَهْلَهَا ۚ وَكَانَ ٱللَّهُ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمًا ﴿٢٦﴾
لَّقَدْ صَدَقَ ٱللَّهُ رَسُولَهُ ٱلرُّءْيَا بِٱلْحَقِّ ۖ لَتَدْخُلُنَّ ٱلْمَسْجِدَ
ٱلْحَرَامَ إِن شَآءَ ٱللَّهُ ءَامِنِينَ مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ
لَا تَخَافُونَ ۖ فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُوا۟ فَجَعَلَ مِن دُونِ ذَٰلِكَ
فَتْحًا قَرِيبًا ﴿٢٧﴾ هُوَ ٱلَّذِىٓ أَرْسَلَ رَسُولَهُۥ بِٱلْهُدَىٰ وَدِينِ
ٱلْحَقِّ لِيُظْهِرَهُۥ عَلَى ٱلدِّينِ كُلِّهِۦ ۚ وَكَفَىٰ بِٱللَّهِ شَهِيدًا ﴿٢٨﴾
٥١٤

mposhten dhe do të zbrapsen. Ky ka qenë ligji i Allahut edhe në popujt e mëparshëm: "Ushtria dhe luftëtarët e Allahut janë gjithmonë fitimtarët." Ky rregull i Allahut nuk ka për të ndryshuar kurrë.

Ajetet 24 – 25

24. Është Ai që, brenda në Mekë, pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, pasi ju dhuroi fitoren kundër tyre. Allahu ju vëzhgon se çfarë veproni.
25. Janë mohuesit e besimit të drejtë që ju pengojnë t'i afroheni Shtëpisë së Shenjtë, duke ndaluar edhe kurbanet të arrijnë në vendin e vet. Sikur të mos ishin ata besimtarë dhe besimtare, që ju nuk i njihnit e që mund t'i sulmonit duke mos e ditur, duke u turpëruar kështu me vrasjen e ndonjërit prej tyre, Allahu do t'ju urdhëronte për t'i luftuar ata, me qëllim që

Allahu ta merrte në mëshirën e Vet atë që Ai do. Po të ishin ata të ndarë veç e veç, Ne do t'i ndëshkonim jobesimtarët me një dënim të rëndë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar u kujton edhe një herë besimtarëve mirësinë e Tij të madhe kur i ruajti nga e keqja e qafirëve:

- "Është Ai që, brenda në Mekë, pengoi duart e tyre kundër jush dhe duart tuaja kundër tyre, pasi ju dhuroi fitoren kundër tyre." - Ishte Allahu i Madhëruar që i ruajti besimtarët nga sherri i qafirëve të Mekës. Por ishte, gjithashtu, Allahu i Madhëruar që i ruajti besimtarët të mos bënin luftë në Mekë me qafirët, edhe pse e kishin mundësinë t'i luftonin e asgjësonin.

Rasti i dytë flet konkretisht për një grup qafirësh prej tetëdhjetë burrash nga Meka, që planifikuan të godisnin muslimanët në pabesi e befasi. Muslimanët arritën që t'i kapnin këta qafirë dhe nuk i vranë, por i lëshuan. Ishte mëshira e Allahut që nuk i lejoi muslimanët ta asgjësonin atë grup.

- "Allahu ju vëzhgon se çfarë veproni." – Allahu sheh dhe do ta shpërblejë çdo njeri sipas punës që ka bërë. Për besimtarët, Ai përkujdeset në mënyrë të veçantë, duke i udhëzuar në veprat më të mira dhe më të dashura për Të.

Në vijim, Allahu i Madhëruar tregon arsyet për luftën kundër idhujtarëve:

- "Janë mohuesit e besimit të drejtë që ju pengojnë t'i afroheni Shtëpisë së Shenjtë, duke ndaluar edhe kurbanet të arrijnë në vendin e vet." – Këto arsye ishin: 1. Mohimi nga ana e tyre i Allahut dhe refuzimi i Profetit të Tij. 2. Pengimi i njerëzve nga feja e Allahut. 3. Pengimi i Profetit dhe i besimtarëve për të vizituar Shtëpinë e Zotit, ku të adhuronin Zotin, nëpërmjet haxhit dhe umres. 4. Pengimi i bagëtive të kurbanit që të mbërrinin në vendin e kurbanit, në Mekë. Të gjitha këto vepra të tyre ishin arsye të mjaftueshme që t'i luftoje. Por ekzistonte një pengesë: prania në Mekë, mes idhujtarëve, e shumë burrave dhe grave muslimane, që nuk ishin të veçuar diku, ku mund të ishin të mbrojtur nga lufta dhe vrasja. I Madhëruari thotë:

- "Sikur të mos ishin ata besimtarë dhe besimtare, që ju nuk i njihnit e që mund t'i sulmonit duke mos e ditur, duke u turpëruar kështu me vrasjen e ndonjërit prej tyre, Allahu do t'ju urdhëronte për t'i luftuar ata, me qëllim që Allahu ta merrte në mëshirën e Vet atë që Ai do." – Atëherë, lufta u ndalua me qëllim që, nga pamundësia për t'u dalluar, të mos dëmtoheshin edhe besimtarët që jetonin në Mekë.

Gjithashtu, ekzistonte edhe një shkak tjetër për të mos zhvilluar luftë në Meke. Allahu i Madhëruar dëshiroi që shumë prej banorëve të Mekës të pranonin Islamin dhe, me mëshirën e Tij, të bëheshin muslimanë të dorëzuar tërësisht ndaj Tij. Ai dëshiroi t'i udhëzonte shumë prej tyre në fenë e pastër, pasi ishin të harruar e të zhytur në kufër. Ai dëshiroi t'u dhuronte udhëzimin e qartë, pasi ishin në një humbje të thellë. Edhe kjo arsye ishte shumë e fortë për të penguar luftën në Mekë.

- "Po të ishin ata të ndarë veç e veç, Ne do t'i ndëshkonim jobesimtarët me një dënim të rëndë." - Nëse besimtarët e Mekës do të

mund të largoheshin e veçoheshin nga idhujtarët, Allahu i Madhëruar do t'i ndëshkonte mohuesit kryeneçë, duke e lejuar luftën kundër tyre dhe do t'u dhuronte fitoren besimtarëve.

Ajeti 26

26. Kur në zemrat e jobesimtarëve u ndez fodullëku pagan, Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të Dërguarin të Tij dhe mbi besimtarët. Për ata zgjodhi Fjalën e Devotshmërisë, sepse ata dhe njerëzit e saj e meritonin më shumë dhe ishin më të denjë për të. Allahu di gjithçka.

Shpjegimi i ajetit

- **"Kur në zemrat e jobesimtarëve u ndez fodullëku pagan..."** – Si fillim, jobesimtarët refuzuan që të shkruanin në hapje të dokumentit të Marrëveshjes së Hudejbijes: "*Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim*". Pastaj, ata vendosën si kusht që Profeti (a.s.) dhe sahabët, të cilët kishin ardhur për umre në Qabe, të mos hynin në Mekë atë vit, me qëllim që njerëzit të mos thoshin: "Muslimanët hynë në Mekë duke poshtëruar kurejshët". Të tilla kushte, që ishin shprehëse të injorancës dhe mendjemadhësisë së tyre, i bënë ata të zhyteshin në shumë gjynahe e padrejtësi.

- "Allahu zbriti qetësinë e Vet mbi të Dërguarin të Tij dhe mbi besimtarët." Me këtë qetësi të dhuruar nga Allahu, besimtarët nuk i pushtoi ndjenja e zemërimit, që t'ju përgjigjeshin idhujtarëve me të njëjtën monedhë. Përkundrazi, ata u treguan të durueshëm dhe të nënshtruar ndaj gjykimit të Allahut, duke iu përmbajtur kushteve, të cilat, sigurisht, i ruanin të paprekshme simbolet e Allahut, edhe pse kjo gjë kërkonte që ata të nënshtronin egoizmin e tyre. Ata iu bindën Allahut të Madhëruar dhe nuk iu kushtuan aspak rëndësi fjalëve të injorantëve e as qortimit të dashakeqësve.

- **"Për ata zgjodhi Fjalën e Devotshmërisë..." -** Fjala e Devotshmërisë është deklarata: "*La ilahe il-l'Allah*". Pra, Allahu i Madhëruar i urdhëroi që t'i përmbaheshin kësaj fjale, të drejtave dhe përgjegjësive që lidhen me të, si dhe veprave që ajo kërkon. Dhe ata iu përmbajtën kësaj fjale, duke zbatuar me durim të madh të gjitha detyrimet që vinin prej saj. Për këtë sjellje të tyre, Zoti i lëvdoi duke thënë:

- "...sepse ata dhe njerëzit e saj e meritonin më shumë dhe ishin më të denjë për të. Allahu di gjithçka." - Ata ishin njerëzit më të denjë për zbatimin dhe bartjen e përgjegjësisë së kësaj fjale. Allahu i Madhëruar dëshmon se ata e meritonin të ishin shërbëtorë të kësaj fjale. Ajo u bë fjala e tyre dhe ata njerëzit e saj, sepse Allahu e dinte mirësinë që gjendej në zemrat e tyre.

Ajetet 27- 28

27. Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij dhe e bëri realitet: "Do të hyni në Shtëpinë e Shenjtë të sigurt, me vullnetin e Allahut. Kokat tuaja do të jenë të rruara ose të qethura dhe nuk do të keni frikë!" Ai dinte atë që ju nuk e dinit! Para kësaj, Ai ju dha një fitore të shpejtë.
28. Është Ai që e dërgoi Profetin e Tij me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fé. Mjafton Allahu si dëshmitar.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Allahu e vërtetoi ëndrrën e të Dërguarit të Tij..."** - Profeti (a.s.) pa një ëndërr në Medinë, të cilën ua tregoi edhe shokëve të tij. Ai pa sikur po hynin në Mekë dhe po bënin *tavaf* rreth Qabes. Por pas ngjarjes në Hudejbije, kur muslimanët u kthyen pa hyrë dot në Mekë dhe pa bërë *tavaf*, mes muslimanëve po qarkullonin fjalë. Madje, disa ju drejtuan Profetit (a.s.) duke i thënë: "A nuk na kishe thënë se do të hynim në Mekë e do të bënim tavaf?!" Profeti (a.s.) u tha: "Vallë, a mos ju thashë se do të ndodhte këtë vit? – "Jo" – u përgjigjën ata. Atëherë, Profeti (a.s.) u tha: "Ju patjetër që do të hyni atje dhe do të bëni *tavaf*." Allahu i Madhëruar thotë më pas:

- **"...dhe e bëri realitet..."** - Kjo është një ëndërr që do të ekzekutohet patjetër. Nuk ka asnjë mundësi që ajo të mos realizohet, edhe pse kjo gjë mund të vonojë.

- **"Do të hyni në Shtëpinë e Shenjtë të sigurt, me vullnetin e Allahut. Kokat tuaja do të jenë të rruara ose të qethura dhe nuk do të keni frikë!"** - Do të hyni në Mekë me përunjësi të thellë, duke e nderuar dhe respektuar Shtëpinë e Zotit dhe duke kryer adhurimet e umres. Ju do të plotësoni adhurimin e umres, duke rruajtur kokat apo duke i qethur flokët, dhe nuk do t'i frikësoheni asgjëje veç Zotit.

- "Ai dinte atë që ju nuk e dinit! Para kësaj, Ai ju dha një fitore të shpejtë." – Kuptimi: Allahu dinte atë që ju nuk e dinit, për sa i përket dobisë që do të sillte Marrëveshja e Hudejbijes. Ai ju bëri të arrinit një fitore tepër të shpejtë.

Në fakt, shumë sahabë u ngushtuan nga kjo ngjarje dhe patën vesvese në zemër, për shkak se nuk arrinin të kuptonin urtësinë që fshihej në atë gjykim. Por Allahu i Madhëruar, ashtu si me të gjitha dispozitat e Tij, e qartësoi urtësinë e Tij dhe qëllimet që synoheshin me atë ngjarje. Ajo ngjarje, nëpërmjet së cilës u arritën të plotësoheshin shumë urtësi dhe qëllime të larta të Zotit, ishte e gjitha mëshirë dhe udhëzim i qartë për besimtarët. Në vijim, Allahu i Madhëruar na tregon për një vendim të përgjithshëm të Tij:

- "Është Ai që e dërgoi Profetin e Tij me udhëzim të plotë dhe me fenë e vërtetë, që të triumfojë mbi çdo fé. Mjafton Allahu si dëshmitar." - Allahu i Madhëruar e dërgoi Profetin e Tij me dy dhurata të mrekullueshme:

- *El Huda*, e cila është dituria e saktë, e vërtetë dhe e dobishme, e cila të ndriçon rrugën dhe të nxjerr nga errësira në dritë. Ajo të bën të dallosh rrugën e mirësisë nga rrugët e ligësisë.

- *Dinul Hak*, që është feja e vërtetë dhe e drejtë. Kjo fe udhëzon në drejtësi, bamirësi dhe mëshirë. Kjo fe ndërtohet nga veprat e mira, pastron zemrat, përsos shpirtrat dhe edukon virtytet e larta. Allahu i Madhëruar e bëri me gjithë këto mirësi, që të triumfojë mbi çdo fé tjetër. Ajo do t'i nënshtrojë të gjitha besimet e tjera, me të vërtetën e saj, me forcën e argumentit dhe me forcën e shpatës.

Ajeti 29

29. Muhamedi është profet i Allahut. Ata që e shoqërojnë atë janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin. Ata i sheh të bëjnë *ruku* dhe *sexhde*, duke kërkuar mirësi prej Allahut dhe


kënaqësinë e Tij. Në fytyrat e tyre shihen gjurmët e sexhdes. Këto janë cilësitë e tyre, që përshkruhen në Teurat. Ndërsa në Ungjill ata përshkruhen si një farë e mbjellë, nga e cila shpërthen filizi. Kur ai trashet, përforcohet dhe qëndron vetë në kërcellin e tij, ai e mahnit mbjellësin. Kështu, u shtohet dëshpërimi jobesimtarëve. Atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u premton falje të gjynaheve dhe shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajetit

Në këtë ajet, Allahu i Madhëruar flet për Profetin dhe shokët e tij muhaxhirë dhe ensarë, duke na thënë se ata ishin njerëzit me cilësitë më të plota dhe virtytet më të larta. I Madhëruari thotë:

- **"Muhamedi është profet i Allahut. Ata që e shoqërojnë atë janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm me njëri-tjetrin."** - Sahabët ishin të rreptë e të ashpër ndaj qafirëve. Mohuesit e Zotit panë prej tyre veçse ashpërsi dhe vrazhdësi, prandaj u nënshtruan dhe u mundën. Ndërsa mes njëri-tjetrit, besimtarët ishin të mëshirshëm, të dashur, të butë e të dhembshur. Ata ishin si një trup i vetëm. Çdokush nga ata dëshironte për vëllain besimtar atë që dëshironte për veten e vet. Të tillë ishin ata në lidhje me krijesat, ndërsa në lidhje me Krijuesin e tyre:

- "Ata i sheh të bëjnë *ruku* dhe *sexhde*, duke kërkuar mirësi prej Allahut dhe kënaqësinë e Tij." - Ata shquheshin për faljen e shumë namazeve, që kanë si shtylla kryesore sexhden dhe rukunë. Me adhurimin e tyre, ata synonin të kënaqnin


الجزء السادس والعشرون سورة الحجرات
مُحَمَّدٌ رَّسُولُ اللَّهِ ۚ وَالَّذِينَ مَعَهُ أَشِدَّاءُ عَلَى الْكُفَّارِ رُحَمَاءُ بَيْنَهُمْ ۖ
تَرَاهُمْ رُكَّعًا سُجَّدًا يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّنَ اللَّهِ وَرِضْوَانًا ۖ سِيمَاهُمْ
فِي وُجُوهِهِم مِّنْ أَثَرِ السُّجُودِ ۚ ذَٰلِكَ مَثَلُهُمْ فِي التَّوْرَاةِ ۚ وَمَثَلُهُمْ فِي
الْإِنجِيلِ كَزَرْعٍ أَخْرَجَ شَطْأَهُ فَآزَرَهُ فَاسْتَغْلَظَ فَاسْتَوَىٰ
عَلَىٰ سُوقِهِ يُعْجِبُ الزُّرَّاعَ لِيَغِيظَ بِهِمُ الْكُفَّارَ ۗ وَعَدَ اللَّهُ الَّذِينَ
آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ مِنْهُم مَّغْفِرَةً وَأَجْرًا عَظِيمًا ﴿٢٩﴾
سورة الحجرات
بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ
الجزء ٥٢
يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تُقَدِّمُوا بَيْنَ يَدَيِ اللَّهِ وَرَسُولِهِ ۖ وَاتَّقُوا
اللَّهَ ۚ إِنَّ اللَّهَ سَمِيعٌ عَلِيمٌ ﴿١﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَرْفَعُوا
أَصْوَاتَكُمْ فَوْقَ صَوْتِ النَّبِيِّ وَلَا تَجْهَرُوا لَهُ بِالْقَوْلِ كَجَهْرِ بَعْضِكُمْ
لِبَعْضٍ أَن تَحْبَطَ أَعْمَالُكُمْ وَأَنتُمْ لَا تَشْعُرُونَ ﴿٢﴾ إِنَّ الَّذِينَ
يَغُضُّونَ أَصْوَاتَهُمْ عِندَ رَسُولِ اللَّهِ أُولَٰئِكَ الَّذِينَ امْتَحَنَ
اللَّهُ قُلُوبَهُمْ لِلتَّقْوَىٰ ۚ لَهُم مَّغْفِرَةٌ وَأَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿٣﴾ إِنَّ الَّذِينَ
يُنَادُونَكَ مِن وَرَاءِ الْحُجُرَاتِ أَكْثَرُهُمْ لَا يَعْقِلُونَ ﴿٤﴾
٥١٥

Allahun dhe të fitonin shpërblimin e kënaqësinë e Tij.

- "Në fytyrat e tyre shihen gjurmët e sexhdes. Këto janë cilësitë e tyre, që përshkruhen në Teurat." - Sexhdet e shumta që bënin kishin lënë gjurmë në fytyrat e tyre. Pas ndriçimit të zemrës me dritën e besimit te Zoti, tani shndriste edhe fytyra e tyre. Kështu përshkruheshin ata në Teurat. Ndërsa në Ungjill, ata kanë një tjetër përshkrim:

- "Ndërsa në Ungjill ata përshkruhen si një farë e mbjellë, nga e cila shpërthen filizi. Kur ai trashet, përforcohet dhe qëndron vetë në kërcellin e tij, ai e mahnit mbjellësin." – Në Ungjill, shokët e profetit Muhamed (a.s.) përshkruhen si fara, nga mbin filizi i ri, i cili forcohet, lulëzon dhe rritet, për të qëndruar vetë në kërcellin e tij.

Me forcën dhe bukurinë e tij, ai e çudit mbjellësin.

Të tillë ishin sahabët, - Allahu qoftë i kënaqur me ta! Ata ishin si bimët, për sa i përket dobisë së tyre për krijesat. Forca e imanit dhe veprave të tyre të mira ishin si kërcelli i një bime, që ushqehet dhe mbahet nga rrënjë të thella. Ndërsa ata që erdhën pas sahabëve ishin filizat e rinj, që dolën nga ky kërcell i qëndrueshëm, të cilët u zhvilluan duke e fuqizuar më shumë bimën dhe duke i dhënë asaj pamje më të plotë. Pasardhësit e sahabëve, që trashëguan diturinë profetike dhe besimin e patundur, ashtu sikurse mësuesit e tyre, e ndihmuan dhe përhapën këtë fe duke i mësuar njerëzit se si të jetonin sipas saj. Në fund, kjo bimë e kënaq mbjellësin e saj dhe i trishton armiqtë e tij, siç thotë i Lartësuari:

- "Kështu, u shtohet dëshpërimi jobesimtarëve." - Ata ligështohen kur shohin forcën dhe unitetin që kanë muslimanët në fe. Ndërsa kur ballafaqohen me muslimanët në sheshin e luftës, atyre iu hyn tmerri.

- "Atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu u premton falje të gjynaheve dhe shpërblim të madh." - Kështu sahabët, - Allahu qoftë i kënaqur me ta! - patën si besimin e sinqertë, ashtu edhe veprat e mira, prandaj Allahu u premtoi atyre dy gjëra: së pari, falje gjynahesh, që nënkupton se do të ishin të mbrojtur dhe të shpëtuar nga të këqijat në dynja dhe në ahiret; së dyti, shpërblim të madh në dynja dhe ahiret.

Le të sjellim këtu historinë e plotë të marrveshjes së Hudejbijes ashtu siç e ka sjellë Imam Shemsudin Ibnul Kajim në librin e tij "El hadju nebeuij," ose siç quhet ndryshe "Zadul miad", "furnizimi për ditën e premtimit". Kuptimi i kësaj historie na jep një kuptim më të plotë të kësaj sureje. Ai ka sjellë në këtë histori shumë kuptime të fshehta dhe dobi të detajuara prej xhevahireve të fshehura në këto sure. Ka thënë Ibnul Kajimi, Allahu e mëshiroftë:

Marrëveshja e Hudejbijes

Nafiu thotë se kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 6, në muajin *dhul kide*, dhe ky është qëndrimi më i saktë. Ky është edhe mendimi i Zuhriut, Katades, Musa Ibn Ukbes, Muhamed Ibn Ishakut etj.

Hisham Ibn Urve përcjell nga i ati se: "Pejgamberi a.s. u nis për në Hudejbije në muajin *ramazan* dhe, si marrëveshje, ajo përfundoi në *sheval*." Por këtu kemi të bëjmë me një ngatërrim, sepse ajo që ndodhi në *ramazan* ishte Lufta e Çlirimit.

Ebu Esuedi, duke përcjellë prej Urves, thotë se nisja për në Hudejbije u bë në muajin *dhul kide*, sipas mendimit më të saktë dhe të pranueshëm.

Tek *Sahih*-ët e Buhariut dhe Muslimit, është hadithi i Enesit, sipas të cilit Pejgamberi a.s. kreu gjithsej katër *umre*, të gjitha në muajin *dhul kide*. Mes tyre ai përmendi edhe umren e kryer gjatë Hudejbijes.

Sa vetë morën pjesë në Hudejbije

Së bashku me Pejgamberin a.s., në atë udhëtim ishin 1500 vetë, sipas dy *Sahih*-ëve, të Buhariut dhe Muslimit, ku tregon Xhabiri r.a. Megjithatë, po nga Xhabiri r.a., në të njëjtat referenca, thuhet se kanë qenë 1400 vetë. Në të njëjtët libra, sillet gjithashtu

hadithi i Abdullah Ibn Ebu Eufai, që thotë: "Ishim 1300 vetë."

Katadeja tregon: "Pyeta Seid Ibn Musejibin: "Sa ishin ata që dëshmuan "Besëlidhjen e Kënaqësisë?" Ai tha: "Një mijë e pesëqind." Atëherë i thashë përsëri: "Por Xhabir Ibn Abdullahi ka thënë se atje ishin 1400 vetë?!" Ai u përgjigj: "Allahu e mëshiroftë! Ka qenë një ngatërrim nga ana e tij, sepse pikërisht ai më ka treguar se ishin një mijë e pesëqind vetë."[10] Prej Xhabirit kanë ardhur në mënyrë të saktë të dyja versionet.

Gjithashtu është përcjellë saktësisht prej tij se atë vit ata kanë bërë kurban 70 deve; çdo deve mjaftonte në emër të shtatë vetave, dhe kur është pyetur: "Sa ishit ju atë ditë?" Xhabiri është përgjigjur: "Ishim 1400 vetë, kalorës dhe këmbësorë."[11] Dhe zemra na anon më shumë drejt këtij varianti. Ky është edhe mendimi i Bera Ibn Azibit, Malik Ibn Jesarit dhe Seleme Ibn Ekuait – sipas transmetimit më të saktë të ardhur prej tij. Gjithashtu, ky është edhe mendimi i Musejib Ibn Hazmit. Kështu Shejbei përcjell prej Katades, ky prej Seid Ibn Musejibit, e ky prej të atit: "Së bashku me Pejgamberin a.s., poshtë pemës (ku u bë Besëlidhja e Kënaqësisë), kemi qenë 1400 vetë."

Ndërsa ata që thonë se pjesëmarrës në Hudejbije ishin vetëm 700 vetë, kanë gabuar shumë qartë. Ajo që i ka shtyrë në këtë mendim ishte pikërisht rrëfimi që tregon se atë ditë u bënë kurban 70 deve, dhe, duke qenë se një deve mund të jetë e mjaftueshme si kurban në emër të 10 vetëve, arritën në përfundimin se gjithsej kanë qenë 700 vetë. Kjo nuk mund të pranohet, sepse, së pari, në hadith thuhet shprehimisht se një deve qe e mjaftueshme për shtatë vetë, prandaj, sipas kësaj logjike, duhet të ishin 4900 vetë; por, në përfundim të të njëjtit hadith ai thotë vetë se kanë qenë 1400 persona.

***

Me të mbërritur në Dhul Hulejfe, Pejgamberi a.s. shënoi bagëtitë e përgatitura për kurban dhe veshi *ihram*-in e bëri nijetin për të kryer *umren*. Ai dërgoi para tij një patrullues, prej fisit Huza, për të mbledhur informacione rreth kurejshëve. E kështu, kur Pejgamberi a.s. ishte pranë Usfanit, vjen informatori që e lajmëron dhe i thotë: "Lashë pas Kab Ibn Luejin, që ka thirrur në luftë Ahbashët kundër teje. Shumë njerëz janë grumbulluar kundër teje. Ata janë të vendosur të të luftojnë dhe të të përzënë nga Shtëpia e Shenjtë." Atëherë Pejgamberi a.s. këshillohet me shokët e tij, duke u thënë: "Si mendoni, a u drejtohemi këtyre fiseve që shkojnë në ndihmë të tyre (kurejshëve), dhe ua tregojmë vendin? Nëse tërhiqen dhe nuk dalin në luftë, le të kthehen të mposhtur dhe, nëse dalin në luftë, atëherë le ta gjejnë fundin e tyre! Apo mendoni të vazhdojmë drejt Qabes dhe, kush na del përpara, ta luftojmë?" Ebu Bekri tha: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë! Ne dolëm nga vendi ynë veçse për të kryer umrën. Nuk kemi dalë të luftojmë ndonjë, por ama kush na pengon nga Shtëpia e Allahut, le ta

---

[10] Këto të dhëna i sjell dhe Ismaili, siç e ka përmendur Hafidhi në librin e tij "*Fet'ĥul Bârî*" vëll. 7, prej Amër Ibn Ali el Felasit, ky prej Ebu Daud el Tajalisit që thotë: "Na ka treguar Kurate, prej Katades…" Buhariu sjell prej Esalt Ibni Muhamed që thotë se na ka treguar Jezid Ibnu Zeri'i, prej Seid, prej Katades, i cili tregon se i ka thënë Seid ibni Museid: "Më ka mbëritur një lajm se Xhabir ibni Abdilah gjithmonë thoshte se ata ishin 1400. Seidi mu përgjigj: " Xhabiri më ka treguar se ata të cilët i dhanë besën Profetit a.s ditën e Hudejbijes ishin 1500.

[11] Ahmedi vëll. 3; Ibn Sadi, vëll. 2/100, përafërsisht si më lart, me sened të fortë. E sjell Muslimi, me nr. 1318 dhe Maliku vëll. 2, prej Xhabir Ibn Abullahit, që thotë: "Kemi therur me Pejgamberin a.s. në Hudejbije nga Në Hudejbije ne therëm 70 deve, dhe një deve ishte e mjaftueshme për 7 veta."

luftojmë!" Atëherë Pejgamberi a.s. tha: "Nisuni pra, marshoni!"

E kështu ecën dhe, pasi kishin bërë një pjesë të rrugës, Pejgamberi a.s. tha: "Halid Ibn Uelidi është në El Gamim, në krye të një kalorësie pararojë e kurejshëve. Merrni djathtas!" Për Allah, Halidi nuk i vuri re aspak, derisa muslimanët u afruan pranë ushtrisë së tij. Atëherë Halidi menjëherë nxitoi të lajmëronte kurejshët.

Pejgamberi a.s. eci derisa mbërriti në grykë. [12] Pikërisht aty u ul deveja e Pejgamberit a.s. "Ec, ec!" filluan t'i bërtisnin njerëzit. Kur ajo nuk po lëvizte, njerëzit thanë: "U ndal Kasuaja (emri i deves së Pejgamberit a.s.), u ndal Kasuaja." Por Pejgamberi a.s. tha: "Jo, nuk u ndal Kauaja, dhe as s'e ka huq këtë gjë, por atë e pengon Ai që pengoi dhe elefantin. [13] " Pastaj Pejgamberi a.s. vazhdoi: "Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im! Çfarëdo propozimi të më parashtrojnë, që përmban madhërimin e gjërave që Allahu i ka bërë të paprekshme, unë kam për ta pranuar!"

Pastaj i bërtiti deves së tij dhe ajo u çua. Kështu, e ndryshoi drejtimin dhe vazhdoi të ecte derisa arriti në qosh të Hudejbijes, dhe aty zbriti te një hurdhë me shumë pak ujë, prej së të cilit njerëzit filluan të merrnin pak e nga pak, me shumë kursim. Por pa kaluar shumë kohë uji i hurdhës shteroj, dhe tani njerëzit po ankoheshin prej etjes. Pejgamberi a.s. mori një shigjetë prej trastës së vetë dhe urdhëroi njerëzit që ta vendosnin në atë burim. Për Zotin! Burimi vazhdoi të nxirrte ujë, derisa i ngopi të gjithë dhe derisa kaluan të gjithë. [14]

Kurejshët u tmerruan kur menduan se ai po synonte trojet e tyre. Pejgamberi a.s. po kërkonte të dërgonte një nga njerëzit e tij tek ata. Në fillim ftoi Omer Ibn Hatabin, për ta ngarkuar me këtë detyrë, por ai i tha: "O i Dërguari i Allahut! Unë nuk kam në Mekë asnjë prej fisit Benu Kab, që të më mbrojë nëse dikush merr guximin të më prekë! Dërgo më mirë Othman Ibn Afanin sepse fisi i tij është atje dhe ai ka për ta përçuar më së miri atë që dëshiron. Atëherë Pejgamberi a.s. e ftoi Othman Ibn Afanin për ta dërguar tek kurejshët, duke i thënë: "Lajmëroji ata se ne nuk kemi ardhur për luftë, por për të vizituar Shtëpinë e Allahut, dhe ftoji të pranojnë Islamin!" Më pas Pejgamberi a.s. e porositi që të shkonte tek ata muslimanë të mbetur në Mekë, burra dhe gra besimtarë, dhe t'i përgëzonte ata me çlirimin e afërt që po i priste; t'i lajmëronte se Allahu i Lartësuar do ta shfaqte fenë e Tij dhe do ta bënte që ajo të triumfonte edhe në Mekë; do të bënte që edhe në Mekë Islami të mos fshihej, por të shfaqej haptazi dhe plot krenari.

Othmani u nis. Duke kaluar pranë disa kurejshëve, në Beldah, ata e pyetën: "Për ku je drejtuar?" Ai u përgjigj: "Më ka dërguar Pejgamberi i Allahut që t'ju ftoj në rrugën e Allahut dhe t'ju ftoj të pranoni Islamin. Ai më dërgoi t'ju lajmëroj se ne nuk kemi ardhur për luftë, por kemi ardhur si vizitorë të shtëpisë së Allahut." – "E morëm vesh përse ke ardhur, – thanë ata – vazhdo rrugën tani." Madje Eban Ibn Seid Ibn Asi shkon, i uron mirëseardhjen, i vë shalën kalit të vet

[12] Një grykë mali, që të çonte drejt e në Hudejbije.

[13] Flitet për elefantin e Abrahasë, që përmendet në Kuran, në suren Fil.

[14] Buhariu vëll. 5; Abdurrezaku, me nr. 9720; Ahmedi vëll. 4.

dhe e hipën mbi kalë. Kështu ai e mori Othmanin pas, në kalë, dhe i doli edhe dorëzanë gjatë futjes në Mekë.

Muslimanët, para se Othmani të kthehej po thoshin: "Othmani shkoi përpara nesh te Shtëpia, dhe po bën tavafin." Por Pejgamberi a.s. i kundërshtoi: "Nuk mendoj se ai do të bëjë tavafin kur ne jemi ende të penguar këtu." Ata i thanë: "E përse të mos e bëjë tavafin, o i Dërguari i Allahut, kur është aq pranë tij?!" Pejgamberi a.s. u përgjigj: "Ky është mendimi im për Othmanin. Ai kurrë nuk do ta bënte tavafin i vetëm, pa qenë edhe ne me të."

Ndërkohë muslimanët (e Mekes) i hynë një konflikti me idhujtarët rreth çështjes së marrëveshjes me Pejgamberin a.s., pasi një anëtar i njërës palë kishte goditur një anëtar të palës tjetër, e kështu filloi një shkëmbim shigjetash e gurësh mes tyre. Secila filloi të thërriste në ndihmë mbështetësit e saj dhe çështja u mbyll me kërcënimin me anë të pengjeve, që mbaheshin nga të dyja palët.

Në këto çaste u hap me të shpejtë një lajm se Othmanin e kishin vrarë. Menjëherë pas këtij lajmi, Pejgamberi a.s. i ftoi sahabët në një besëlidhje për jetë a vdekje. Të gjithë u mblodhën rreth Pejgamberit a.s i cili ndodhej poshtë një peme dhe atje i dhanë besën që kurrë nuk do të largoheshin nga fushë-beteja dhe kurrë nuk do të dezertonin. Në fund Pejgamberi a.s. kapi dorën tjetër të tij dhe tha. "Kjo dorë është në vend të dorës së Othmanit" [15].

Pasi përfundoi besëlidhja, nuk vonoi dhe mbërriti Othmani r.a. Muslimanët i thanë: "Të lumtë, o Ebu Abdullah, se ia arrite ta bësh tavafin rreth Shtëpisë. Othmani ua kthen: "Shumë mendim të keq paskeni për mua! Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim! Sikur edhe një vit të qëndroja në Mekë, dhe Pejgamberi a.s. në Hudejbije, nuk do t'ia lejoja kurrë vetes të bëja tavaf i vetëm, pa e bërë fillimisht Pejgamberi i Allahut a.s. Madje vetë kurejshët më ftuan që të bëja tavafin, dhe isha unë ai që refuzova." Atëherë muslimanët thanë: "Pejgamberi i Allahut a.s. ishte më i dituri rreth Allahut të Lartësuar dhe më i miri në gjykim."

Ishte Omeri ai që i mbante dorën Pejgamberit a.s., kur muslimanët po i jepnin besën nën pemë. Ata ia dhanë besën të gjithë me radhë, përveç El Xhedd Ibn Kajsit. [16] Ndërkohë, Ma'kil Ibn Jesari largonte një degë nga Pejgamberi a.s., duke e ngritur lart atë.[17]

I pari që i dha besën Pejgamberit a.s. ishte Ebu Sinan el Esedi. Ndërsa Seleme Ibn Ekua ia dha besën Pejgamberit a.s. tri herë, një herë në fillim, një herë në mes dhe një herë në fund.[18]

Gjatë kësaj kohe, te Pejgamberi a.s. vjen Budejl Ibn Uerka el Huzai, së bashku me një grup burrash nga fisi Huza'. Ata e informonin shpesh Pejgamberin a.s. me çilrtësi për shumë ngjarje. Ata i drejtohen Pejgamberit a.s. dhe i thonë: "Ne i pamë Kab Ibn Luejin dhe Amër Ibn Luejin që po zbrisnin pranë burimeve të Hudejbijes, e me vete kishin edhe deve me qumësht, edhe deve me pjellat e tyre. Kështu, ata kanë marrë masat dhe janë bërë gati të përleshen me ty. Ata synojnë të luftojnë kundra teje dhe që të pengojnë nga vizita e Qabes, për

[15] Buhariu vëll. 7; Ahmedi vëll. 1. dhe në të përmendet se Profeti a.s tregoi dorën e tij të djathtë dhe tha: "Kjo është dora e Othmanit. Pastaj e shtrëngoi me dorën tjetër të tij, duke thënë: "Kjo është për Othmanin".

[16] Muslimi, nr 1856, 69 prej Xhabirit.
[17] Muslimi, nr. 1858.
[18] Muslimi, nr. 1807.

ku je drejtuar." Pejgamberi a.s. u thotë: "Ne nuk kemi ardhur për të luftuar kundër kujt, por synojmë të kryejmë umren. Ne jemi të sigurt që kurejshët janë shumë të lodhur dhe të dobësuar nga lufta. Nëse ata dëshirojnë, unë mund të bëj marrëveshje armpushimi të përkohshme me ta, me qëllim që të më lejojnë dorë të lirë me njerëzit. Pas marrëveshjes, nëse dëshirojnë të pranojnë atë që pranuan njerëzit, le ta bëjnë, në të kundërt do të rehatoheshin nga mundimi i luftës. Por nëse me patjetër duan luftën, betohem në Atë në Dorën e të Cilit është shpirti im, unë do të luftoj kundër tyre për hir të çështjes sime derisa të vdes, ose derisa Allahu i Lartësuar të çojë në vend çështjen e Vet!" Budejli i thotë Pejgamberit a.s.: "Do t'ua përcjell të qartë këtë që më the!"

Dhe vërtet, ai u largua për të shkuar tek kurejshët. U thotë atyre: "Po vij tek ju prej atij burri. Betohem në Allah, se unë dëgjova prej tij disa fjalë, të cilat, nëse keni interes t'i dëgjoni, do t'jua përcjell." Disa mendjelehtë të pranishëm nxituan të thonin: "Nuk kemi nevojë të dëgjojmë gjë prej tij." Por menjëherë ndërhyjnë ata më të maturit dhe më të urtët: "Na e trego atë që dëgjove!" Ai ua tregon fill e për pe, gjithçka që kishte dëgjuar prej Pejgamberit a.s. Pas pak, Urve Ibn Mesud el Thekafiu thotë: "Ai po ju ofron një zgjidhje të arsyeshme, që ju duhet ta pranoni. Më lejoni mua që të shkoj tek ai." – "Po, – thanë ata, – mund të shkosh."

Urvei shkoi te Pejgamberi a.s. dhe filloi t'i fliste. Atëherë Pejgamberi a.s. edhe atij i tha fjalë të ngjashme me ato që i tha Budejlit. Urvei, pasi e dëgjoi, i thotë Pejgamberit a.s.: "O Muhamed! A ke dëgjuar ndonjë para teje që të ketë shfarosur popullin e vet?! Veç kësaj, unë shoh rreth teje ca fytyra vulgarësh, ca fundërrina njerëzish që nuk e kanë për gjë të të braktisin dhe të të lënë në mes të rrugës." Ebu Bekri, i cili po e dëgjonte, në këtë moment e shan rëndë atë dhe i thotë: "Shko ore thithja Lat-it! [19] Ne t'ia mbathim prej tij dhe ta braktisim?!" Urvei, i shokuar nga kjo fyerje e rëndë, u hodh: "Kush qe ai që foli?" – "Ebu Bekri!" – thanë njerëzit. – "Betohem në Atë që ka në dorë shpirtin tim! Sikur të mos ishin nderet e tua ndaj meje, që ende nuk t'i kam shpërblyer, do të të ktheja tjetër përgjigje!" – tha Urvei dhe vazhdoi bisedën me Pejgamberit a.s.

Gjatë bisedës, ai vazhdimisht e afronte dorën e tij për të luajtur me mjekrën e Pejgamberit a.s. Por në këmbë qëndronte i veshur në hekur Mugira Ibn Shu'ba, i cili, me këllëfin e shpatës së tij godiste dorën e Urveit sa herë që guxonte ta prekte mjekrën e Pejgamberit a.s., duke i thënë: "Largoje dorën nga mjekra e Pejgamberit a.s.!" Urvei ngriti kokën dhe pyeti: "Kush është ky?" – "Mugira Ibn Shuba." Atëherë Urvei i drejtohet Mugiras: "O i pabesë, a nuk ta kam mbuluar mjaft tradhtinë tënde?" Mugira, para se të pranonte Islamin, ishte duke u shoqëruar njëherë me disa kurejshë, të cilët, pabesisht i vrau dhe ua grabiti pasuritë. Pas kësaj, ai shkoi te Pejgamberi a.s. dhe pranoi Islamin. Por Pejgamberi a.s. i tha: "Islamin ta pranoj, por pasuritë që ke grabitur s'mund t'i pranoj kurrsesi."

Pastaj Urvei po vërente shokët e Pejgamberit a.s. Ai shihte se sa i respektuar dhe i nderuar ishte ai në mesin e tyre. Pështyma e tij kurrë nuk binte në tokë, por të gjithë nxitonin ta kapnin atë pa rënë përdhe dhe me të fërkonin fytyrat dhe lëkurën. Nëse urdhëronte për diçka, të gjithë nxitonin ta çonin në vend urdhrin e tij. Kur

[19] Lati ishte një idhull.

ai merrte abdes, ata gati sa s'vriteshin për të marrë ujin e abdesit të tij. Nëse ai fliste, zërat e të gjithëve uleshin. Kurrë nuk i ngrinin shikimet e tyre drejt tij, për shkak të respektit të madh që kishin.

Pas këtyre skenave, Urvei kthehet te shokët e vet dhe u thotë: "O njerëz, vallahi, shumë mbretër kam vizituar; kam vizituar Kisranë, Kajzerin, Nexhashiun, por betohem në Allah, se nuk kam parë ndonjë mbret që të respektohet nga rrethi i tij ashtu siç respektohet Muhamedi nga shokët e tij. Për Zotin, pështyma e tij përfundonte gjithmonë në dorën e ndonjërit, me të cilën do të fërkonte fytyrën dhe lëkurën. Nëse jepte një urdhër, nxitonin të gjithë ta zbatonin atë. Kur merrte abdes gati sa s'vriteshin për të marrë ujin e abdesit të tij. Kurrë nuk e vështronin drejtpërdrejt në sy, nga respekti i madh që kishin për të. Ai ju ka propozuar një ftesë të mirë dhe të drejtë. Pranojeni atë!" Në këtë çast, ngrihet një burrë prej fisit Benu Kinane dhe thotë: "A më lejoni mua të shkoj tek ai?" – "Shko" – i thanë, dhe ai iku. Kur u afrua te Pejgamberi a.s. dhe shokët e tij, Pejgamberi a.s. e njohu atë dhe u tha shokëve të tij: "Ky është filani. Ai është nga një vend ku i madhërojnë shumë kurbanet. Shfaqini bagëtitë e kurbanit para tij, shfaqini ato para tij!" Gjithashtu njerëzit filluan të ngrenë zërin, duke thënë refrenin e haxhinjve: "Ty të përgjigjemi, o Allah…" Kur i pa dhe i dëgjoi, burri tha: "*Subhan-Allah*! Këta nuk duhet të ndalohen assesi nga vizita e Shtëpisë së Shenjtë!" U kthye te shokët e vet dhe u tha: "Unë pashë bagëtitë e shënuara për kurban, prandaj mendoj që të mos i pengojmë nga vizita e Shtëpisë së Shenjtë."

Pas tij u ngrit Mikrez Ibn Hafsi dhe tha: "A më lejoni mua të shkoj tek ai?" – "Shko!" – i thanë. Kur u afrua te kampi i muslimanëve, Pejgamberi a.s. u tha sahabëve: "Ky është Mikrez Ibn Hafsi, një burrë i poshtër ." Edhe Mikrezi foli me Pejgamberin a.s.

Gjatë kësaj kohe, nga larg u duk Suhejl Ibn Amri, i cili po i afrohej kampit. Pejgamberi a.s., kur e pa, tha: "Me sa duket, çështja juaj do të lehtësohet." [20] Ndërsa Suhejlit i tha: "Eja pra, të nënshkruajmë një marrëveshje mes nesh!" Pejgamberi a.s. ftoi shkruesin, protokollistin, dhe i tha: "Shkruaj: *Bismilahi Rrahmani Rrahim*" Suhejli ndërhyn: "*Rrahmanin* nuk e njohim, por shkruaj: "Me emrin Tënd, o Allah!", ashtu siç shkruanim më parë." Muslimanët filluan të flisnin: "Për Zotin, ne kështu e shkruajmë: *Bismilahi Rrahmani Rrahim*!" Pejgamberi a.s. ndërhyri dhe i tha shkruaj: "Me emrin Tënd, o Allah!". Pas kësaj tha: Shkruaj: "Ky është marrëveshja që nënshkroi Muhamedi, i Dërguarit i Allahut…" Suhejli i thotë: "Për Zotin, nëse ne do ta dinim se ti je i Dërguari i Allahut, atëherë nuk do të të pengonim prej Shtëpisë së Shenjtë dhe nuk do të luftonim kundër teje. Kështu pra, shkruaj: *Muhamed Ibn Abdilah*." Pejgamberi a.s. ia kthen: "Unë jam i Dërguari i Allahut, edhe nëse ju e mohoni këtë fakt; shkruaj: *Muhamed Ibn Abdilah*!"

Pas kësaj, Pejgamberi a.s. parashtroi kushtet e tij për marrëveshjen: "Së pari, ju duhet të na lejoni të shkojmë drejt Shtëpisë së Shenjtë dhe të bëjmë tavaf atje." Suhejli e kundërshtoi pjesërisht këtë kërkesë të Pejgamberit a.s., duke thënë: "Për Zotin, nëse bëhet një gjë e tillë tani, arabët do të thonë që ne u frikësuam në shtëpinë tonë. Ne do t'ju lejojmë ta kryeni një gjë të tillë,

[20] Emri "*Suhejl*" d.m.th. "i lehtë, i thjeshtë".

por vitin që vjen, jo tani." Pastaj Suhejli paraqiti një kusht nga ana e kurejshëve: "Nëse tek ti vjen ndonjë i arratisur prej nesh, ti duhet të na i kthesh neve, edhe nëse ka pranuar fenë tënde!" Muslimanët u acaruan nga ky kusht i kurejshëve dhe ngritën zërat duke thënë: "*Subhan-Allah*! E si t'ua kthejmë mbrapsht ata që kanë pranuar Islamin?!" Pikërisht në këto çaste, mes muslimanëve mbërrin Ebu Xhendeli, biri i Suhejl Ibni Amrit, një i arratisur prej kurejshëve, që kishte pranuar Islamin. Ai del nga fundi i Mekës, duke ecur ngadalë me pranga në këmbë dhe hidhet mu përpara muslimanëve. Këtë rast, Suhejli nuk mund ta linte t'i shpëtonte, prandaj i thotë Pejgamberit a.s.: "Ky është rasti i parë për të cilin të kërkoj të zbatosh marrëveshjen, domethënë ta kthesh tek ne." Pejgamberi a.s., i cili nuk dëshironte ta kthente Ebu Xhendelin, i thotë: "Por ne ende nuk e kemi nënshkruar marrëveshjen tonë." Suhejli, me të shpejtë, ia kthen: "Atëherë kurrë nuk do të bëj marrëveshje me ty." Pejgamberi a.s. ngul këmbë dhe i thotë: "Atëherë bëj një përjashtim dhe lejoje këtë rast për mua." Por Suhejli këmbëngul: "Nuk kam për të toleruar dhe nuk kam për ta lejuar ta bësh këtë." – "Po po, do të ma lejosh kësaj radhe…" – "Jo, nuk do ta bëj…" Këtu ndërhyn Mikrezi, që thotë: "Mirë pra, do ta lejojmë kësaj radhe."

Ndërkohë Ebu Xhendeli, i dërrmuar nga torturat e rënda që kishte hequr në kurriz nga kurejshët për hir të Allahut, u drejtohet muslimanëve dhe u thotë: "O vëllezër! Si mund të kthehem tek idhujtarët, kur unë erdha tek ju si musliman?! A nuk e shihni ç'kam hequr prej tyre?!"

Për këtë ngjarje, Omer Ibn Khatabi tregon: "Për Zotin, kurrë nuk isha luhatur që kur kisha pranuar Islamin, para asaj dite. Unë shkova te Pejgamberi a.s. dhe i thashë:

– O i Dërguari i Allahut! A nuk je vërtet Pejgamberi i Allahut?
– Unë jam Pejgamberi i Allahut – tha ai.
– A nuk jemi me të Vërtetën dhe armiku pra është në të kotën?
– Po, – tha.
– Atëherë, përse duhet të zbrapsemi, të përulemi e të nënshtrohemi në punët që i përkasin fesë sonë? Përse duhet të kthehemi para se Allahu të sjellë ndarjen mes nesh dhe armiqve tanë?
– Unë jam i Dërguari i Allahut, – thotë Pejgamberi a.s., – dhe Ai është Ndihmuesi im. Unë kurrë nuk e kundërshtoj udhëzimin e Tij.

Unë vazhdova t'i flisja:

– A nuk na ke thënë që do të shkojmë në Shtëpinë e Shenjtë dhe do të bëjmë tavaf rreth saj?!
– Po, kështu kam thënë. Po a mos të kam thënë gjë që do ta bëjmë në këtë vit? – më pyeti.
– Jo, – i thashë.
– E pra, ti do të vish dhe do të bësh tavaf – më tha.

Më pas, shkova tek Ebu Bekri dhe i thashë atij të njëjtat fjalë që i kisha thënë Pejgamberit a.s. Ai më ktheu të njëjtën përgjigje, sikurse dhe Pejgamberi a.s. duke shtuar: "Kapu fort për litarin e tij, derisa të vdesësh! Betohem në Allah, se nuk ka asnjë dyshim që ai është i udhëzuar në Rrugën e Drejtë." Pas asaj dite – rrëfen Omeri – kam punuar shumë për të shlyer gabimin tim të asaj dite."

Pasi nënshkruan marrëveshjen, Pejgamberi a.s. urdhëroi dhe tha: "Çohuni dhe therni kurbanet, pastaj rruani kokat!" Por, për Zotin! Nuk u ngrit qoftë dhe një burrë i vetëm, edhe pse urdhri u përsërit tri herë. Kur pa që askush nuk u çua për të zbatuar urdhrin, Pejgamberi a.s. u ngrit dhe hyri në

çadrën e Ummu Selemes. Atje i tregon bashkëshortes për sjelljen e njerëzve ndaj tij. Ummu Selemeja i thotë: "O i Dërguari i Allahut! A e dëshiron vërtet një gjë të tillë? Atëherë dil dhe, pa i folur askujt, asnjë fjalë, bëj kurbanin tënd dhe thirr dikë që të të rruajë flokët."

Pejgamberi a.s. u ngrit dhe doli jashtë. Ai, pa i folur askujt, theri kurbanet dhe rruajti flokët. E kështu, kur njerëzit e panë këtë, u ngritën, prenë kurbanet e tyre dhe filluan të rruajnë kokat e njëri-tjetrit. Nga marazi (kundër kurejshëve), gati sa s'po gjakosnin njëri-tjetrin gjatë rruajtjes.

Më vonë, te besimtarët mbërrijnë një grup grash besimtare, të cilat ishin larguar nga Meka. Në këtë kohë, Allahu i Lartësuar zbriti ajetin që sqaron dispozitat për një situatë të tillë, në suren Mumtehine (10): "O besimtarë, kur ju vijnë besimtaret të mërguara, provoni (besimin) tek ato. Allahu e di më mirë besimin e tyre. Nëse bindeni se ato janë besimtare, mos i ktheni te jobesimtarët. Ato nuk janë (bashkëshorte) të ligjshme për ata dhe as ata nuk janë (bashkëshortë) të ligjshëm për ato. Kthejuni jobesimtarëve pajën, që u kishin dhënë atyre. Nuk ka pengesë që t'i merrni ato për bashkëshorte, pasi t'u jepni pajën e martesës. Mos qëndroni në martesë me idhujtare. Kërkoni atë që keni dhënë (si pajë), por dhe jobesimtarët le të kërkojnë atë që kanë dhënë. Ky është ligji i Allahut, Ai ju gjykon ju; Allahu di çdo gjë dhe është i Gjithëdijshëm e i Urtë." Pas këtij ajeti, Omeri i ndau dy gra të tijat që ende ishin në idhujtari. Njëra prej tyre u martua me Muavijen, ndërsa tjetra u martua me Safuan Ibn Umejen.

Pastaj Pejgamberi a.s. mori rrugën e kthimit për në Medinë. Gjatë kthimit të tij për në Medinë, Allahu i Lartësuar i shpall atij ajetet e sures Fet'h (1-3): "Ne të dhamë ty një fitore të qartë, për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme, për ta plotësuar dhuntinë e Vet ndaj teje dhe për të të udhëzuar në Rrugën e Drejtë, dhe që Allahu të të japë ndihmë të madhe." Omeri e pyet: "Çlirim quhet ky, o i Dërguari i Allahut?" – "Po" – u përgjigj Pejgamberi a.s. Sahabët thanë: "E gëzofsh dhuratën dhe mirësinë e Allahut, o i Dërguari i Allahut! Po për ne çfarë ka?" Atëherë zbret ajeti tjetër: "Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t'ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." (Fet'h 4) (fundi i fjalës së ibnul kajimit.)

Surja 49: El Huxhurat (medinase) 18 ajete

Ajetet 1 – 3

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. O ju që keni besuar! Mos u ngutni e të dilni para Zotit dhe të Dërguarit të Tij! Gjithashtu, kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu është Gjithëdëgjues e i Gjithëditur.
2. O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos iu drejtoni atij me zë të lartë, sikurse i drejtoheni njëri-tjetrit, e kështu t'ju asgjësohen veprat tuaja, duke mos e ndier.
3. Me të vërtetë, ata që e ulin zërin pranë të Dërguarit të Allahut, Allahu ua ka sprovuar zemrën për të parë devotshmërinë. Për ta ka falje gjynahesh dhe shpërblim të madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar! Mos u ngutni e të dilni para Zotit dhe të Dërguarit të Tij! Gjithashtu, kijeni frikë Allahun!" - Këto ajete janë porosi për një edukatë të lartë në lidhje me Allahun e Lartësuar dhe me Profetin e Tij. Kështu, Allahu i Lartësuar na udhëzon që ta adhurojmë Atë si të Vetëm e të Pashoq dhe të vlerësojmë lart Profetin e Tij, duke e respektuar dhe nderuar atë.

Besimtarët urdhërohen të bëjnë atë që kërkon besimi i tyre tek Allahu dhe Profeti i Tij. Imani i vërtetë sjell plotësimin e urdhrave të Allahut dhe largimin nga ndalesat e Tij. Ky iman i bën besimtarët që të ecin sipas porosive të Allahut e të qëndrojnë brenda kufijve të Tij, duke ndjekur traditën e Profetit, në të gjitha çështjet e tyre. Ata nuk i lejojnë vetes kurrsesi që të dalin para Zotit dhe Profetit të Tij. Ata nuk flasin, derisa Zoti të flasë, ata nuk japin urdhra, derisa Ai t'i japë ato. Pikërisht ky përkushtim me sinqeritet dhe përunjësi është esenca e edukatës së domosdoshme me Allahun dhe Profetin e Tij. Kjo edukatë është rruga e lumturisë dhe e fitores së robit. Nëse nuk i hyn kësaj rruge, ai humb lumturinë e përjetshme dhe dështon.

Në këto ajete është një ndalesë kategorike për të mos e braktisur fjalën e Profetit për fjalën e asnjë njeriu tjetër, kushto qoftë ai. Nëse vjen e qartë fjala e Profetit (a.s.) dhe vërtetohet saktësia e saj, nuk lejohet të mbështetesh te fjala e dikujt tjetër, kushdo qoftë ai.

Më pas, Allahu i Lartësuar urdhëron për devotshmëri ndaj Tij, në mënyrë të përgjithshme. Devotshmëria ndaj Allahut është ashtu sikurse e ka përkufizuar Talk Ibn Hubejbi: Të punosh në bindje ndaj Allahut, i ndriçuar nga drita e Allahut e duke shpresuar shpërblimin e Allahut; t'u largohesh gjynaheve e mosbindjes ndaj Allahut, i ndriçuar nga drita e Allahut e duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij.

- "Vërtet, Allahu është Gjithëdëgjues e i Gjithëditur." - Allahu është Dëgjuesi i të gjitha zërave, në çdo kohë, nga çdo skutë dhe drejtim. Ai është gjithashtu *El Alim* - i Gjithëdijshëm rreth asaj që shfaqet dhe asaj që mbahet fshehur, rreth të shkuarës dhe të ardhmes, i Gjithëdijshëm për të mundshmen dhe të pamundshmen, si dhe për ato gjëra që domosdoshmërisht ekzistojnë.

Pasi Allahu i Lartësuar na ndaloi nga kundërshtimi i fjalës së Profetit dhe pasi na urdhëroi për devotshmëri ndaj vetë Atij, përmendja e këtyre dy emrave të mrekullueshëm të Tij është, sigurisht, një nxitje e fortë për t'iu përmbajtur me përpikmëri këtyre porosive. Nga ana tjetër, është edhe një kërcënim për ata që nuk u përmbahen këtyre porosive.

Pastaj i Madhëruari thotë:

- "O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos iu drejtoni atij me zë të lartë, sikurse i drejtoheni njëri-tjetrit, e kështu t'ju asgjësohen veprat tuaja, duke mos e ndier." - Ky është një urdhër për edukatën që duhet të kenë besimtarët me Profetin e Allahut, në mënyrën e komunikimit me të. [21]

Kush bisedonte me Profetin (a.s.) nuk duhej ta ngrinte zërin më lart se Profeti (a.s.), por t'i drejtohej atij me zë të ulët, me


[21] Këto fjalë u drejtoheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë bashkëkohësve të Profetit. Ndërsa për ne sot, ajeti është urdhër për edukatë të lartë në mënyrën e trajtimit të traditës dhe figurës së Profetit (a.s.).

edukatë, butësi e nderim të thellë, ashtu sikur u flitet njerëzve të mëdhenj, të nderuar e të respektuar. Me Profetin nuk duhej të silleshin njëlloj si me njëri-tjetrin, por me edukatë të veçantë, ashtu sikurse e meriton një profet nga ymeti i tij. Ymeti e ka detyrë që ta besojë plotësisht profetin e vet. Ai e ka detyrë, gjithashtu, që ta dojë Zotin dhe profetin e Tij më shumë se çdo gjë tjetër. Ashtu sikurse e ka detyrë besimin dhe dashurinë për Profetin, ashtu e ka detyrë edhe edukatën e lartë me të. Mosplotësimi i këtij detyrimi sjell asgjësimin e punëve të robit, pa e ndier dhe kuptuar. Nga ana tjetër, edukata me të sjell shpërblime të mëdha dhe pranim të veprave nga Allahu i Madhëruar.

- "Me të vërtetë, ata që e ulin zërin pranë të Dërguarit të Allahut, Allahu ua ka sprovuar zemrën për të parë devotshmërinë. Për ta ka falje gjynahesh dhe shpërblim të madh." - Këtu Allahu i Lartësuar i lëvdon ata të cilët e ulin zërin e tyre kur janë te Profeti (a.s.). Allahu i vuri në provë zemrat e tyre, pas përfundimit të së cilës zemrat e tyre dolën të qëndrueshme dhe të denja për t'u pajisur me devotshmëri.

Më pas, Allahu i Lartësuar u premton atyre falje për gjynahet dhe mangësitë e tyre, që nënkupton siguri nga çdo e keqe dhe shpërblim tepër të madh, realitetin e të cilit mund ta dijë veçse Ai, Allahu i Madhëruar. Shpërblim i madh do të thotë arritja e gjithçkaje të dashur dhe të synuar.

Ky ajet dëshmon se Allahu i Madhëruar i provon zemrat, duke i vënë përballë urdhrash që duhen zbatuar, përballë ndalesash që duan respektim, si dhe përballë fatkeqësish që duan durim, të shoqëruar me kënaqësi për caktimin e Tij. Çdokush që përqendrohet dhe i qëndron


الجزء السادس والعشرون سورة الحجرات

وَلَوْ أَنَّهُمْ صَبَرُوا حَتَّىٰ تَخْرُجَ إِلَيْهِمْ لَكَانَ خَيْرًا لَّهُمْ ۚ وَاللَّهُ غَفُورٌ
رَّحِيمٌ ﴿٥﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِن جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَإٍ فَتَبَيَّنُوا أَن
تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ ﴿٦﴾
وَاعْلَمُوا أَنَّ فِيكُمْ رَسُولَ اللَّهِ ۚ لَوْ يُطِيعُكُمْ فِي كَثِيرٍ مِّنَ الْأَمْرِ لَعَنِتُّمْ
وَلَٰكِنَّ اللَّهَ حَبَّبَ إِلَيْكُمُ الْإِيمَانَ وَزَيَّنَهُ فِي قُلُوبِكُمْ وَكَرَّهَ
إِلَيْكُمُ الْكُفْرَ وَالْفُسُوقَ وَالْعِصْيَانَ ۚ أُولَٰئِكَ هُمُ الرَّاشِدُونَ ﴿٧﴾
فَضْلًا مِّنَ اللَّهِ وَنِعْمَةً ۚ وَاللَّهُ عَلِيمٌ حَكِيمٌ ﴿٨﴾ وَإِن طَائِفَتَانِ
مِنَ الْمُؤْمِنِينَ اقْتَتَلُوا فَأَصْلِحُوا بَيْنَهُمَا ۖ فَإِن بَغَتْ إِحْدَاهُمَا
عَلَى الْأُخْرَىٰ فَقَاتِلُوا الَّتِي تَبْغِي حَتَّىٰ تَفِيءَ إِلَىٰ أَمْرِ اللَّهِ ۚ فَإِن فَاءَتْ
فَأَصْلِحُوا بَيْنَهُمَا بِالْعَدْلِ وَأَقْسِطُوا ۖ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ
﴿٩﴾ إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ فَأَصْلِحُوا بَيْنَ أَخَوَيْكُمْ ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ
لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴿١٠﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا يَسْخَرْ قَوْمٌ مِّن قَوْمٍ
عَسَىٰ أَن يَكُونُوا خَيْرًا مِّنْهُمْ وَلَا نِسَاءٌ مِّن نِّسَاءٍ عَسَىٰ أَن يَكُنَّ خَيْرًا
مِّنْهُنَّ ۖ وَلَا تَلْمِزُوا أَنفُسَكُمْ وَلَا تَنَابَزُوا بِالْأَلْقَابِ ۖ بِئْسَ الِاسْمُ
الْفُسُوقُ بَعْدَ الْإِيمَانِ ۚ وَمَن لَّمْ يَتُبْ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿١١﴾

٥١٦

besnik përherë porosive të Allahut, synon kënaqësinë e Tij dhe garon për vepra të mira, duke u dhënë atyre përparësi kundrejt dëshirave të tij të devijuara, me të vërtetë quhet besnik dhe i denjë për t'u pajisur me *takua*. Në të kundërt, kuptohet se ai nuk bën për këtë gradë të lartë.

Ajetet 4 – 5

4. Sa u përket atyre që të thërrasin nga jashtë mureve, shumica nuk kanë logjikë!
5. Sikur ata të bënin durim, derisa të dilje vetë, do të ishte më mirë për ta. Megjithatë, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

- "Sa u përket atyre që të thërrasin nga jashtë mureve, shumica nuk kanë logjikë!" - Këto ajete erdhën për shkak të një grupi

beduinësh, që shkuan te Profeti (a.s.). Prej vrazhdësisë së tyre, Allahu i Lartësuar i përshkruan ata si njerëzit më të prirur për të mos i njohur dhe zbatuar porositë dhe kufijtë e Tij.

Kështu, ky grup beduinësh vajti në Medinë, dhe pastaj drejt e te shtëpia e Profetit (a.s.). Atje nuk pritën fare që ai të dilte vetë në pritje të tyre, por u afruan te porta dhe filluan ta thërrisnin: "O Muhamed, o Muhamed!". Për këtë shkak, Allahu i Lartësuar i qortoi dhe i quajti njerëz pa logjikë. Ata ende nuk ishin pajisur me edukatën e duhur kundrejt Profetit, siç kishte porositur Allahu i Madhëruar. Edukata e mirë është shenjë e logjikës dhe arsyes së shëndoshë. Nëse dikujt i jepet moral i mirë, i është dhënë edhe arsyetim i mirë, dhe kjo tregon se Allahu dëshiron të mirën për të. Më pas, i Madhëruari thotë:

- **"Sikur ata të bënin durim, derisa të dilje vetë, do të ishte më mirë për ta. Megjithatë, Allahu është Falës e Mëshirues."** – Allahu është Falës për gjynahet e robërve të Tij dhe për mungesën e edukatës së kështilluar nga Ai. Allahu, gjithashtu, është Mëshirues, që nuk nxitohet t'i ndëshkojë ata për gjynahet e kryera.

Ajeti 6

6. O ju që keni besuar, nëse ndonjë i prishur ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, në mënyrë që të mos e lëndoni ndonjë njeri pa dashje, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.

Shpjegimi i ajetit

Edhe kjo është kështillë për një virtyt të lartë, të cilin duhet ta ketë çdo njeri i mençur dhe i urtë. Kështu, nëse një njeri i prishur, apo siç e quan i Lartësuari "*fasikun*", përcjell një lajm të caktuar, besimtari nuk duhet të nxitohet dhe ta pranojë menjëherë atë ose të ndërtojë gjykim mbi të, por ta verifikojë mirë dhe me kujdes.

Marrja si e vërtetë e çdo lajmi përbën një rrezik të madh dhe një shkak potencial për të rënë në gjynah dhe padrejtësi. Nëse marrim si të mirëqënë një lajm të rremë, do të gjykojmë duke u bazuar në të dhe, si rrjedhim, mund të dëmtojmë jetën, pasurinë ose nderin e njerëzve padrejtësisht. Pasojat janë tepër të rënda. Prandaj të mençurit nuk veprojnë kurrë kështu. Ata e dinë se është detyrë verifikimi i çdo lajmi që sjell një njeri i prishur. Më pas, nëse faktet tregojnë për vërtetësinë e atij lajmi, atëherë gjykohet dhe punohet sipas tij. Nëse faktet vërtetojnë të kundërtën, atëherë ai nuk pranohet dhe nuk punohet sipas tij.

Nga ajeti kuptohet se lajmi i sjellë nga një njeri i sinqertë, i drejtë dhe i besueshëm, është i pranueshëm. Ndërsa lajmi i një personi që njihet botërisht si gënjeshtar është i papranueshëm. Nga ana tjetër, lajmi i një njeriu të prishur, domethënë, i atij që bën shumë gjynahe e shkel kufijtë e Zotit, shihet në varësi të fakteve të tjera plotësuese, pastaj gjykohet për pranimin ose jo të tij. Për këtë arsye, shumë dijetarë muslimanë të hershëm i pranonin hadithet e sjella nga *hauarixh*-ët, të cilët nuk gënjenin në fjalët që transmetonin, edhe pse bënin gjynahe të tjera dhe kishin devijuar nga rruga e drejtë.[22]

[22] Ngrihet pyetja: A lejohet transmetimi i haditheve nga bidatçinjtë? Imam Muslimi nuk e ka lejuar një gjë të tillë. Kurse imam Neveviu, në parathënien e "*Sahihu i Muslimit*", thotë: "Dijetarët e hadithit të *fikh*-ut dhe të *usul*-it janë unanimë në mendimin se transmetimet e atyre që bëjnë bidate kufri nuk duhet të pranohen. Ndërsa për transmetimet e atyre që nuk bëjnë bidate kufri ka mendime të ndryshme. Disa thonë se ato janë

Ajetet 7 – 8

7. Dijeni se mes jush gjendet i Dërguari i Allahut. Sikur ai t'ju dëgjonte ju në shumë çështje, ju do të rëndoheshit, por është Allahu Ai që jua bën të dashur besimin dhe jua zbukuron atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, jua bën që t'i urreni. Pikërisht dhe vetëm këta janë ata të udhëzuarit

8. Kjo është dhuratë dhe begati prej Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Dijeni se mes jush gjendet i Dërguari i Allahut. Sikur ai t'ju dëgjonte ju në shumë çështje, ju do të rëndoheshit..." - Allahu i Madhëruar u kujton besimtarëve se mes tyre ishte Profeti (a.s.), i Dërguari besnik i Tij. Ai ishte njeriu bamirës, që dëshironte vetëm të mirën për besimtarët. Ai ishte udhëzuesi në rrugën e drejtë, që frymëzohej nga vetë Allahu. Ata ndonjëherë mund të dëshironin gjëra që, në fakt, ishin të dëmshme për ta, ndërsa ai dëshironte vetëm të mirën për ata, duke mos i miratuar dëshirat e tyre të dëmshme. Nëse ai do t'u bindej shumë prej kërkesave të tyre, ato do të bëheshin shkak që ata të rëndoheshin dhe çështjet t'u vështirësoheshin. Profeti (a.s.) i udhëzonte në më të mirën dhe më të dobishmen për ata, prandaj besimtarët duhej t'i bindeshin atij.

- "...por është Allahu Ai që jua bën të dashur besimin dhe jua zbukuron atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, jua bën që t'i urreni." – Kuptimi: Duke iu bindur Profetit (a.s.), ju keni gjetur udhëzimin e drejtë. Është Allahu Ai që jua bën besimin të dashur dhe të këndshëm për zemrat tuaja. Është Ai që i mbush zemrat tuaja me dashuri për të vërtetën, duke i dhënë asaj përparësi mbi gjithçka tjetër. Ai jua përforcon këtë dashuri me fakte të shumta, që e mbështesin atë. Allahu ju mundëson që

---

të papranueshme në mënyrë të prerë dhe të padiskutueshme, sepse bidatçiu e ka të cenuar pastërtinë e tij fetare, e cila është kusht për pranueshmërinë e transmetuesit. Disa janë të mendimit se transmetimet e tyre janë të pranueshme, përderisa në medhhebin e tyre e kanë të ndaluar gënjeshtrën dhe nuk e bëjnë atë të lejueshme për hir të mbështetjes të mendimit dhe rrugës së tyre. Këtu nuk prish gjë fakti në e propagandojnë bidatin e tyre apo jo, a i ftojnë të tjerët në pasimin e medhhebit të tyre apo jo. Ky dëshmohet edhe si qëndrim i imamit tonë, Shafiiut (Allahu e mëshiroftë!), i cili ka thënë: "Unë nuk e pranoj dëshminë e bidatçinjve të quajtur *el hattabije*, nga sekti i shiitëve, sepse ata e shohin si të lejuar dëshminë e rreme, kur bëhet fjalë për të qëndruar në medhhebin e tyre." Ndërsa disa dijetarë të tjerë bëjnë dallim mes bidatçinjve që janë propagandues të bidatit të tyre dhe atyre bidatçinjve që nuk janë të tillë. Sipas këtyre, transmetimet e të parëve nuk lejohen, ndërsa të atyre të fundit lejohen. Ky, në fakt, është mendimi i shumicës së dijetarëve dhe, sigurisht, që është mendimi më i drejtë në këtë çështje. Disa nxënës dhe pasues të imam Shafiiut kanë qenë unanimë në mendimin se transmetimet e bidatçiut që propagandon dhe fton në pasimin e bidatit të tij janë të papranueshme. Ndërsa për atë që nuk është i tillë, ata kanë patur mendime të ndryshme: a pranohet transmetimi i tij apo jo. Ebu Hatim Ibn Hibani ka thënë: "Imamët tanë janë unanimë në qëndrimin se është i palejueshëm argumentimi me transmetimet e sjella nga bidatçinjtë që e propagandojnë bidatin e tyre. Asnjë nuk e kundërshton këtë qëndrim."

Për sa i përket mendimit të parë në këtë çështje, ai është shumë i dobët. Në të dy '*Sahih*'-ët dhe në librat e imamëve të hadithit, ka shumë transmetime të pranuara nga shumë bidatçinj, të cilët nuk janë propagandues të bidatit të tyre. Dijetarët e parë dhe ata të mëvonshmit i kanë pranuar vazhdimisht transmetimet e kësaj kategorie bidatçinjsh. Ata vazhdimisht kanë dëgjuar hadithe prej tyre dhe u kanë mundësuar edhe atyre të dëgjojnë hadithet që transmetonin imamët e mëdhenj, pa kurrfarë vërejtjeje. Sidoqoftë, Allahu i Lartësuar është më i ditur. (Për më gjerë, shih parathënien e imam Neveviut në "*Komentari i Sahihut të Muslimit*".) [Sh.p.].

të pendoheni dhe të ktheheni tek Ai të nënshtruar dhe të bindur. Nga ana tjetër, Ai jua ka bërë të urryer kufrin, gjynahet dhe mosbindjen ndaj Tij. Ai futi në zemrat tuaja urrejtjen për ligësinë dhe mosdëshirën për ta vepruar atë. Ai solli argumente të shumta që tregojnë për dëmet e të keqes dhe e orientoi natyrën e pastër njerëzore që të mos e pranojë atë, por ta urrejë e ta trajtojë si diçka të neveritshme.

- "Pikërisht dhe vetëm këta janë ata të udhëzuarit." - Këta janë fatlumët, të cilëve Zoti ua bëri imanin të dashur dhe të bukur për zemrat e tyre, ndërsa *kufr*-in, gjynahet dhe mosbindjen ua bëri të urryera. Këta janë *el rashidun*, që kanë dituri dhe siguri rreth të vërtetës, si edhe vepra sipas kësaj diturie, me qëllimin e sinqertë vetëm për të fituar kënaqësinë e Krijuesit. Këta janë të përqendruar në fenë e vërtetë dhe nuk i ndahen rrugës së drejtë të Zotit.

Të kundërtët e tyre janë *el gaun*, që iu është bërë i dashur dhe i bukur në zemër *kufr*-i, gjynahet dhe mosbindja, ashtu si iu është bërë i urryer besimi dhe veprat sipas tij. Për këtë përmbysje, faji është vetëm i tyre. Kur ata i shkelin kufijtë e Zotit, Ai ua vulos tërësisht zemrat, sikurse thotë i Madhëruari: "...kur ata devijojnë, Allahu ua largon zemrat (nga besimi). Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që i kalon kufijtë." [Saff 5]. Kur ata nuk e pranojnë imanin, kur iu prezantohet për herë të parë, Allahu ua rrotullon zemrat për nga humbja.[23] Pastaj Allahu i Madhëruar thotë:

- "Kjo është dhuratë dhe begati prej Allahut." - Udhëzimi në rrugën e drejtë është mirësi e dhuruar nga Allahu Bujar dhe Bamirës, e jo i merituar me forcën dhe përpjekjet e tyre.

- "Allahu është i Gjithëdijshëm e i Urtë." - Allahu i di ata që tregohen falënderues ndaj mirësive të Tij, prandaj ua shton ato edhe më tepër. Ai i di edhe ata që nuk i japin hakun mirësive të Tij, duke treguar mosmirënjohje. Ata nuk e meritojnë dhuratën e Tij, prandaj dhe i privon nga ajo. Allahu ia jep udhëzimin atij që Ai e gjykon, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij absolute.

Ajetet 9 – 10

9. Nëse dy grupe besimtarësh zhvillojnë luftë midis tyre, ju pajtojini ata. Nëse njëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë ju luftoni atë grup që ka sulmuar pa të drejtë, derisa t'i binden udhëzimit të Allahut. Nëse kthejnë rrugë, atëherë bëni pajtimin e tyre me drejtësi dhe paanësi. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.
10. Me të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, prandaj pajtojini vëllezërit tuaj dhe kini frikë Allahun, që të mëshiroheni!

Shpjegimi i ajeteve

- "Nëse dy grupe besimtarësh zhvillojnë luftë midis tyre, ju pajtojini ata." - Kjo është një dispozitë që i ndalon besimtarët nga padrejtësia apo lufta ndaj njëri-tjetrit. Nëse dy grupe besimtarësh nisin luftë kundër njëri-tjetrit, është detyrë për besimtarët e tjerë që ta shuajnë këtë sherr të

[23] Në suren En'am, ajeti 110, Allahu i Lartësuar thotë: "Ne ua rrotullojmë zemrat dhe shikimet e tyre, ashtu sikurse ata nuk e besojnë atë *(Kuranin)* për herë të parë *(kur iu paraqitet)*, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre, që të tejkalojnë kufijtë."

madh. Të gjithë e kanë detyrë që të pajtojnë palët në konflikt, duke shfrytëzuar çdo rrugë e mjet të lejuar për arritjen e këtij qëllimi të lartë. Nëse ia arrijnë t'i pajtojnë, kjo është mirësi e madhe. Por:

- "Nëse njëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë ju luftoni atë grup që ka sulmuar pa të drejtë, derisa t'i binden udhëzimit të Allahut." - Luftoni atë grup që ka sulmuar pa të drejtë, derisa të kthehen në kufijtë e vendosur nga Zoti dhe të sqaruar nga Profeti i Tij.

Allahu i Madhëruar urdhëron gjithmonë për të bërë mirë dhe për t'iu larguar të ligës dhe, pa dyshim, një ndër ligësitë më të mëdha është lufta mes besimtarëve dhe përçarja e tyre.

- "Nëse kthejnë rrugë, atëherë bëni pajtimin e tyre me drejtësi dhe paanësi." - Ky është urdhër për rregullim të marrëdhënieve mes besimtarëve, por duke mbajtur drejtësinë e pa cenuar asnjë palë. Allahu i Madhëruar e ka theksuar një kusht të marrëveshjes, duke thënë: "me drejtësi", sepse shpesh palët mund të bien dakord dhe të pajtohen, por duke shkelur të drejtën e njërës palë. Të tilla marrëveshje nuk janë të porositura nga Allahu i Drejtë dhe i Urtë. Drejtësia e kërkon që të mos i jepet përparësi njërës palë, në kurriz të tjetrës, për çfarëdolloj shkaku, si mund të jetë afërsia farefisnore apo ndonjë tjetër, që sjell devijimin nga drejtësia.

- "Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët." - Allahu i do të drejtët në gjykimet e tyre mes njerëzve, në çdo çështje që u ngarkohet apo për të cilën u kërkohet gjykim. Madje, këtu mund të hyjë edhe drejtësia në familje apo në trajtimin e fëmijëve. Në një hadith të saktë të Profetit (a.s.) thuhet: "Të drejtët do të jenë tek Allahu në poltrona prej drite. Këta janë njerëzit që gjykojnë me drejtësi në familjet e tyre dhe për çdo çështje me të cilën ngarkohen."

- "Me të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, prandaj pajtojini vëllezërit tuaj..." - Vëllazëria është një lidhje e fortë dhe e pazgjidhshme, që Zoti ka bërë mes besimtarëve. Çdo njeri në lindje apo perëndim të botës, që e beson drejt Allahun, engjëjt, librat e Tij, profetët e Tij, Ditën e Gjykimit dhe çdo gjë tjetër që duhet besuar, ai është vëlla i besimtarëve. Për këtë vëllazëri mes tyre, çdo musliman duhet të dëshirojë për vëllain e tij atë që dëshiron për veten e vet dhe të urrejë për vëllain e tij atë që e urren për veten e vet. Prandaj edhe Profeti (a.s.), duke treguar detyrimet e plotësimit të vëllazërisë në besim, thotë: "Mos kini smirë njëri-tjetrin, mos bëni hile ndaj njeri-tjetrit, mos urreni njëri-tjetrin dhe askush të mos bëjë tregti mbi tregtinë e vëllait të tij besimtar! Jini robër të Zotit, vëllezër të njëri-tjetrit! Besimtari është vëlla i besimtarit! Ai nuk i bën padrejtësi atij, nuk e tradhton, nuk e lë në baltë dhe nuk e përçmon atë." Profeti (a.s.), gjithashtu, ka thënë: "Besimtari për besimtarin është si ndërtesa që forcon dhe mban vetveten", - dhe, duke thënë këtë, ka gërshetuar gishtat.

Allahu dhe Profeti i Tij na kanë urdhëruar që të përpiqemi e të punojmë për të kryer detyrimet ndaj besimtarëve dhe çdo gjë tjetër që sjell harmoni, dashuri, dhembshuri e afrimitet mes tyre. Kështu për shembull, nëse mes disa besimtarëve ndodhin keqkuptime e konflikte, të cilat shkaktojnë urrejtje, përçarje dhe largim

zemrash, besimtarët e tjerë janë të urdhëruar që t'i pajtojnë vëllezërit e tyre. Ata duhet të përpiqen me çdo mënyrë, për të larguar urrejtjen dhe përçarjen mes tyre.

Pastaj Allahu i Madhëruar urdhëron për devotshmëri, për plotësim të urdhëresave dhe largim nga ndalesat, në emër të dashurisë për Të dhe si bindje, nënshtrim e madhërim të Tij. Nëse ne plotësojmë urdhrin për devotshmëri dhe porosinë për detyrimet ndaj muslimanëve, Allahu i Lartësuar na premton mëshirë. Në fund të ajetit, Ai thotë:

- "...dhe kini frikë Allahun, që të mëshiroheni!" - Nëse të përfshin mëshira e Zotit, ke gjetur gjithë mirësinë e dynjasë dhe të ahiretit. Kjo tregon se shpërfillja e të drejtave të besimtarëve është një nga shkaqet më të mëdha të privimit nga mëshira e Allahut. Nga këto ajete nxirren edhe dobi të tjera:

1. Lufta mes besimtarëve bie ndesh me vëllazërinë e tyre në besim, prandaj konsiderohet si një nga gjynahet më të mëdha.

2. Vëllazëria në Islam nuk asgjësohet tërësisht, edhe nëse mes besimtarëve ka luftë e vrasje. Allahu i Madhëruar i quan ata besimtarë kur thotë: "Nëse dy grupe besimtarësh luftojnë mes njëri-tjetrit...". Pra, ata vazhdojnë të jenë besimtarë muslimanë dhe mes tyre qëndron ende lidhja e besimit, por ata kanë rënë në një gjynah shumë të madh.

Po kështu trajtohet çdo gjynah i madh, poshtë idhujtarisë e mohimit të Zotit: vepruesi i tyre nuk del nga Islami. Vepruesi i gjynaheve, veç shirkut e kufrit, konsiderohet si vëlla në Islam, por është i rrezikuar nga ndëshkimi për gjynahet e tij. Ky është besimi i pasuesve të Traditës profetike dhe i Xhematit.

3.Rregullimi i marrëdhënieve mes muslimanëve dhe pajtimi i tyre, duke respektuar drejtësinë, është detyrë që duhet plotësuar.

4. Në rast konflikti mes muslimanëve është detyrë lufta kundër palës që nuk pranon të ulet në bisedime për vendosjen e drejtësisë sipas ligjit të Zotit dhe porosive të Profetit të Tij, derisa ata të nënshtrohen. Nëse ata gjykojnë jo me ligjin e Zotit, por propozojnë ndonjë zgjidhje e cila nuk mund të pranohet fetarisht, Ajo refuzohet e u kthehet mbrapsht.

5. Ajeti lejon që t'i luftojmë ata muslimanë që nuk shtrohen për të gjykuar sipas ligjit të Zotit në konfliktet e tyre, ndoshta edhe t'i vrasim ata, por nuk na lejohet të prekim gjë prej pasurive të tyre. Pra, edhe pse na është lejuar luftimi e vrasja e tyre, kur e drejta arrihet veçse në këtë mënyrë, përsëri pasuritë e tyre janë të paprekshme, sepse ata vazhdojnë të trajtohen si muslimanë.

Ajeti 11

11. O ju që keni besuar, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, sepse të tallurit mund të jenë më të mirë nga ata që tallin; as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që ato të jenë më të mira se ato që tallin. Mos tallni veten tuaj e mos e etiketoni njëri-tjetrin me nofka tallëse! Sa e shëmtuar është të vësh nofka tallëse, pasi ke besuar! Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, sepse të tallurit

mund të jenë më të mirë nga ata që tallin; as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që ato të jenë më të mira se ato që tallin." - Edhe ky është një nga detyrimet e ndërsjellta të muslimanëve: ata nuk lejohet të tallen me njëri-tjetrin, qoftë me fjalë apo me vepra e gjeste. Ky është një veprim që Zoti e ka bërë haram. Sjellja e tillë tregon që tallësi ka rënë në vetëkënaqësi. Ndoshta i talluri është më i mirë se tallësi, ashtu siç ndodh në shumicën e rasteve, pasi tallja buron nga zemra që është e mbushur me vese të ulëta. Për këtë, Profeti (a.s.) ka thënë: "I mjafton njeriut si gjynah, përçmimi i vëllait të tij besimtar."

- "Mos tallni veten tuaj..." - Mos tejkaloni caqet, duke përmendur të metat e njëri-tjetrit! Kjo mund të bëhet me fjalë ose me veprime. Që të dyja janë haram, madje për vepruesin e tyre ka kërcënim për ndëshkim në Zjarr, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Mjerë për ata që ofendojnë e tallin të tjerët!" [Humeze 1].

Vëreni me kujdes! Allahu i Madhëruar thotë: "Mos tallni veten tuaj!" Pra, vëllai besimtar duhet trajtuar si vetja. Kështu duhet të jenë besimtarët: si një trup i vetëm! Gjithashtu, nëse tall të tjerët, edhe ata do të veprojnë njëlloj me ty, e në këtë rast, njeriu është vetë shkaktar për talljen e vetvetes.

- "...e mos e etiketoni njëri-tjetrin me nofka tallëse!" - Muslimani nuk duhet ta tallë vëllain e tij duke e thirrur me nofka që ai nuk dëshiron ta thërrasin. Ky veprim është haram. Ndërsa nofkat jo fyese, të cilat njeriu i pranon, nuk hyjnë në këtë ndalesë.

- "Sa e shëmtuar është të vësh nofka tallëse, pasi ke besuar!" - Kthimi pas në injorancë, mosbindje dhe gjynahe, pasi ke besuar dhe ke bërë vepra të mira sipas ligjit të Zotit, është diçka shumë e shëmtuar. Kjo do të thotë që përdorimi i nofkave fyese e tallëse për tjetrin është kthim në injorancën paraislame dhe një vepër e shëmtuar.

- "Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës." - Ky është detyrim i besimtarit musliman. Ai duhet të pendohet tek Allahu i Lartësuar dhe t'i japë hakun vëllait të tij musliman. Ai duhet t'i kërkojë falje vëllait të tij, ashtu si duhet t'i kërkojë falje Zotit të tij. Gjithashtu, duhet që, nëse e ka ofenduar, sharë dhe mbajtur nëpër gojë për keq vëllain musliman, tani le ta lëvdojë atë dhe të çojë në vend nderin e tij.


Nga ky ajet kuptohet se njerëzit ndahen dy grupe: 1. Të padrejtët ndaj vetes, të cilët nuk pendohen për gjynahet e tyre. 2. Ata që bëjnë gjynahe, por që pendohen për gjynahet e tyre. Këta të fundit përfitojnë mirësinë e shpëtojnë nga çdo e keqe. Nuk ka grup të tretë, veç këtyre.

Ajeti 12

12. O ju që keni besuar, largohuni prej paragjykimeve! Vërtet që disa paragjykime janë padrejtësi. Mos rrëmoni për zbulimin e të metave të tjetrit dhe mos përgojoni! Vallë, a ka ndonjë prej jush që dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Në fakt, për ju është e neveritshme kjo gjë! Ruhuni nga ndëshkimi i Allahut! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i madh i pendimit e Mëshirues.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, largohuni prej paragjykimeve! Vërtet që disa paragjykime


الجزء السادس والعشرون سورة الحجرات

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱجْتَنِبُواْ كَثِيرًا مِّنَ ٱلظَّنِّ إِنَّ بَعْضَ ٱلظَّنِّ
إِثْمٌ ۖ وَلَا تَجَسَّسُواْ وَلَا يَغْتَب بَّعْضُكُم بَعْضًا ۚ أَيُحِبُّ أَحَدُكُمْ أَن
يَأْكُلَ لَحْمَ أَخِيهِ مَيْتًا فَكَرِهْتُمُوهُ ۚ وَٱتَّقُواْ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ
تَوَّابٌ رَّحِيمٌ ﴿١٢﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّاسُ إِنَّا خَلَقْنَٰكُم مِّن ذَكَرٍ وَأُنثَىٰ وَجَعَلْنَٰكُمْ
شُعُوبًا وَقَبَآئِلَ لِتَعَارَفُوٓاْ ۚ إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِندَ ٱللَّهِ أَتْقَىٰكُمْ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ
عَلِيمٌ خَبِيرٌ ﴿١٣﴾ * قَالَتِ ٱلْأَعْرَابُ ءَامَنَّا ۖ قُل لَّمْ تُؤْمِنُواْ وَلَٰكِن
قُولُوٓاْ أَسْلَمْنَا وَلَمَّا يَدْخُلِ ٱلْإِيمَٰنُ فِى قُلُوبِكُمْ ۖ وَإِن تُطِيعُواْ ٱللَّهَ
وَرَسُولَهُۥ لَا يَلِتْكُم مِّنْ أَعْمَٰلِكُمْ شَيْـًٔا ۚ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٤﴾
إِنَّمَا ٱلْمُؤْمِنُونَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ ثُمَّ لَمْ يَرْتَابُواْ
وَجَٰهَدُواْ بِأَمْوَٰلِهِمْ وَأَنفُسِهِمْ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۚ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ
ٱلصَّٰدِقُونَ ﴿١٥﴾ قُلْ أَتُعَلِّمُونَ ٱللَّهَ بِدِينِكُمْ وَٱللَّهُ يَعْلَمُ مَا فِى
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۚ وَٱللَّهُ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿١٦﴾ يَمُنُّونَ
عَلَيْكَ أَنْ أَسْلَمُواْ ۖ قُل لَّا تَمُنُّواْ عَلَىَّ إِسْلَٰمَكُم ۖ بَلِ ٱللَّهُ يَمُنُّ
عَلَيْكُمْ أَنْ هَدَىٰكُمْ لِلْإِيمَٰنِ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿١٧﴾ إِنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ
غَيْبَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَٱللَّهُ بَصِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾
الجزء ٥٢
٥١٧

janë padrejtësi." – Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na ndalon të paragjykojmë e të mendojmë keq për besimtarët, pasi disa paragjykime të tilla janë gjynah.

Këtu bëhet fjalë për hamendësimet e pabazuara në fakte, të cilat të shtyjnë më shumë fjalë të këqija e në vepra të padrejta. Nëse në zemër ekzistojnë mendime të këqija, ato nuk mbeten gjatë të tilla, por forcohen dhe e bëjnë bartësin e tyre që të flasë e të veprojë padrejtësisht. Paragjykimet dhe mendimet e këqija për muslimanin janë nxitëse të urrejtjes dhe e përçarjes, ndërkohë që jemi urdhëruar për të kundërtën.

- "Mos rrëmoni për zbulimin e të metave të tjetrit..." - Mos hetoni të zbuloni sekretet dhe intimitetin e muslimanit! Lëreni të qetë muslimanin dhe mos u merrni me çështjet delikate të tij, që nuk duhet të përhapen e të zbulohen.

- "...dhe mos përgojoni!" - Përgojimi (*gibet*), ashtu sikurse e ka përkufizuar Profeti (a.s.), është: "Të thuash rreth vëllait tënd besimtar diçka që ai nuk e dëshiron të përmendet, edhe nëse vërtet e ka atë gjë."
Allahu i Madhëruar bën një krahasim të përgojimit, për të treguar se sa vepër e shëmtuar është:

- "**Vallë, a ka ndonjë prej jush që dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Në fakt, për ju është e neveritshme kjo gjë!"** - Allahu i Lartësuar e ka krahasuar *gibet*-in me ngrënien e mishit të njeriut të vdekur, që është gjëja më e shëmtuar dhe më e neveritshme nga njeriu. Pra, ashtu sikurse ai e urren që të hajë mishin e njeriut, në mënyrë të veçantë kur është i vdekur, ashtu duhet ta urrejë përgojimin e tij, që, në njëfarë mënyre, është si ta hash mishin e tij për së gjalli!

- "Ruhuni nga ndëshkimi i Allahut! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i madh i pendimit e Mëshirues." – Allahu është *El Teuab*, Ai që lejon dhe u jep sukses robërve të Tij që të pendohen, dhe pastaj ua pranon pendimin. Ai është, gjithashtu, *El Rahim* - Mëshirues për robërit e Tij. Prej mëshirës së Tij është edhe fakti që Ai i fton e ndihmon ata që të arrijnë më të dobishmen për ta dhe e pranon prej tyre pendimin, kur gabojnë.

Ky ajet është një kërcënim i rëndë për ata që merren me përgojim. Ai tregon se përgojimi është gjynah i madh, sepse Allahu e ka krahasuar me ngrënien e mishit të njeriut të vdekur, gjë e cila është e ndaluar dhe prej gjynaheve të mëdha.

Ajeti 13

13. O njerëz! Vërtet, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, që të njiheni mes jush. Nuk ka dyshim se më i nderuari tek Allahu është më i devotshmi mes jush. Pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Njohës i çdo gjëje.

Shpjegimi i ajetit

- "O njerëz! Vërtet, Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, që të njiheni mes jush." - Allahu i Madhëruar na tregon se Ai e krijoi njerëzimin prej një origjine të vetme. Gjithë njerëzimi e ka zanafillën nga Ademi dhe Havaja. Prej atyre të dyve, Allahu i Madhëruar nxori shumë burra e gra. Ai i bëri ata të shpërndahen nëpër tokë, të ndarë në kombe e fise, disa të vegjël e disa të mëdhenj. Ai i bëri në fise e kombe, që ata të njohin njëri-tjetrin. Nëse do t'i bënte që secili njeri të jetonte i vetëm, atëherë nuk do të kishte lidhje mes tyre, nuk do të kishte ndihmë dhe mbështetje për njëri-tjetrin, nuk do të kishte trashëgimi, lidhje gjaku apo plotësim të të drejtave të familjes e të farefisit.

- "Nuk ka dyshim se më i nderuari tek Allahu është më i devotshmi mes jush." - Kriteri vlerësues për njerëzit është devotshmëria. Më i nderuar tek Allahu është ai që është më i devotshmi, pra, njeriu më i përkushtuar në bindjen ndaj Tij dhe më i ruajturi nga gjynahet. Kjo do të thotë që nuk është më i nderuari ai që ka më shumë njerëz e farefis, apo prejardhje më të ndritur.

- "Pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe Njohës i çdo gjëje." - Allahu është i Gjithëdijshëm. Ai e di se cili prej robërve është i devotshëm haptazi dhe fshehtazi dhe cili është vetëm haptazi e jo fshehtazi. Allahu do t'i japë secilit atë që meriton.

Ky ajet tregon se njohja e gjenealogjisë së familjes është e ligjshme, sepse Allahu i Lartësuar na ndau në fise e kombe që ne të njohim njëri-tjetrin dhe prejardhjen tonë.

Ajetet 14 – 18

14. Beduinët thanë: "Ne kemi besuar!" Thuaju: "Ju ende nuk keni besuar, prandaj thoni: 'Hymë në Islam', pasi besimi nuk ka hyrë ende në zemrat tuaja. Nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja, se Allahu është vërtet Falës e Mëshirues".
15. Besimtarë janë vetëm ata që i besojnë Allahut, të Dërguarit e Tij, e mandej nuk luhaten, por luftojnë me pasurinë dhe me jetën e tyre në rrugën e Allahut. Këta janë besimtarët e vërtetë.
16. Thuaju: "Vallë, ju do t'i tregoni Allahut për fenë tuaj, ndërkohë që Allahu di ç'ka në qiej dhe ç'ka në Tokë dhe kur Allahu është Dijshëm për gjithçka?!"
17. Ata të lëvdohen ty që u bënë muslimanë. Thuaju: "Me pranimin tuaj të Islamit mos më thoni se ma dini për faleminderit mua, pasi Ai që meriton falënderimin tuaj për udhëzimin në besim, është vetëm Allahu, nëse jeni të sinqertë".
18. S'ka dyshim se Allahu i di të fshehtat e qiejve e të Tokës. Allahu ju sheh se çfarë bëni.

Shpjegimi i ajeteve

- "Beduinët thanë: "Ne kemi besuar!"" - Allahu i Madhëruar na tregon se çfarë thanë beduinët, të cilët hynë në Islam në kohën e Profetit (a.s.), por pa qenë të qartë dhe pa

bërë ato vepra që kërkon imani i vërtetë. Megjithatë, ata përsëri deklaronin se kishin një besim të plotë. Atëherë, Allahu e urdhëroi Profetin e Tij që t'ua hidhte poshtë këtë pretendim të madh, duke u thënë:

- **"Ju ende nuk keni besuar, prandaj thoni: 'Hymë në Islam', pasi besimi nuk ka hyrë ende në zemrat tuaja."** – Kuptimi: Mos pretendoni se keni arritur gradën e imanit të plotë, me të gjithë elementët e tij. Por mund të thoni "Hymë në Islam" dhe mjaftohuni me këtë, sepse besimi ende nuk ka zënë vend në zemrat tuaja. Ju thjesht keni besuar nga frika, nga ndonjë shpresë apo për arsye të tjera si këto.

E tillë ishte gjendja e beduinëve, të cilët më pas u pajisën me besim të plotë, madje luftuan në rrugën e Zotit.

- "Nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai nuk ju pakëson asgjë nga veprat tuaja...". - Nëse i bindeni Allahut dhe Profetit të Tij, me kryerjen e veprave të mira dhe largimin nga veprat e këqija, Allahu i Madhëruar nuk ka për t'jua pakësuar veprat tuaja, as sa një thërrmijë. Përkundrazi, Ai ka për t'jua dhënë shpërblimin të plotë, të vogla apo të mëdha qofshin veprat tuaja.

- **"...se Allahu është vërtet Falës e Mëshirues."** - Allahu është *Gafurun* - Falës për ata që pendohen dhe kthehen tek Ai të nënshtruar dhe të bindur. Ai është, gjithashtu, *Rrahim* - Mëshirues me ta, sepse u jep sukses të pendohen dhe ua pranon pendimin e tyre.

- "Besimtarë janë vetëm ata që i besojnë Allahut, të Dërguarit e Tij, e mandej nuk luhaten, por luftojnë me pasurinë dhe me jetën e tyre në rrugën e Allahut." - Besimtarë të vërtetë janë ata që plotësojnë dy kushte:

1. Kanë besimin e plotë dhe të sinqertë tek Allahu, që sjell punë të mira dhe largon nga të këqijat.
2. Luftojnë dhe përpiqen në rrugën e Allahut, pasi çdokush që lufton jobesimtarët dëshmon për iman të plotë, që ka zënë vend në zemrën e tij. Ai që lufton për përhapjen e Islamit dhe fton të tjerët për të zbatuar ligjin e Zotit në jetën e tyre, pa dyshim që, së pari, i ka plotësuar këto kërkesa për veten e vet. Ndërsa ai që nuk ka fuqi të luftojë për përhapjen e fesë së Zotit dëshmon për dobësinë e imanit të tij.

Duke treguar një kusht të domosdoshëm për një besim të saktë, Allahu i Madhëruar thotë: ... e mandej nuk luhaten". Zemrën dhe veprat e robit i rregullon vetëm besimi i sigurt dhe i patundur në çdo gjë që Zoti ka urdhëruar të besohet, pa pasur as më të voglin dyshim.

- **'Këta janë besimtarët e vërtetë."** - Të vërtetët janë ata të cilët besimin e tyre e pasqyrojnë me vepra të mira, ashtu si e kërkon besimi i pastër dhe i vërtetë.

Vërtetësia e besimit është një pretendim shumë serioz. Në fakt, çdokush që ka një pretendim duhet që ta mbrojë atë me fakte, nëse është i vërtetë. Edhe kur bëhet fjalë për besimin, i cili është porta e lumturisë në dynja dhe në ahiret, jo çdokush që e pretendon, e ka arritur vërtet. Vetëm ai që kryen detyrimet që kërkon besimi, me vepra e fjalë, vetëm ai ka pretendim të pranueshëm ose vetëm ai është besimtar i vërtetë. Nëse dikush nuk i plotëson këto kushte, atëherë pretendimi i tij se ka besim nuk qëndron. Pretendimi i tij nuk ka asnjë

vlerë për krijesat, sepse besimin në zemër e vlerëson veçse Allahu i Madhëruar.


Në fakt, pretendimi se ke apo jo besim në zemër është një lloj mungese edukate me Allahun e Lartësuar. A thua se po i mëson Allahut se çfarë ke në zemër! Ky është një mendim i gabuar për Allahun.[24] Kështu, i Madhëruari thotë:

- "Thuaju: "Vallë, ju do t'i tregoni Allahut për fenë tuaj, ndërkohë që Allahu di ç'ka në qiej dhe ç'ka në Tokë dhe kur Allahu është Dijshëm për gjithçka?!"" - Dija e Allahut ka përfshirë gjithçka, pa përjashtim, mes të cilave edhe ato që fsheh zemra, besim apo mohim qoftë, mirësi apo ligësi. I Lartësuari i di të gjitha ato me imtësi dhe do t'i shpërblejë me drejtësi. Nëse ke punuar mirë, do të fitosh mirësi, e nëse ke punuar keq, do të marrësh atë që meriton.

- "Ata të lëvdohen ty që u bënë muslimanë. Thuaju: "Për pranimin tuaj të Islamit mos më thoni se ma dini për faleminderit mua..." - Ata që dëshmojnë për veten se kanë iman të plotë, ndërkohë nuk janë të tillë, mund ta bëjnë për disa arsye, një prej të cilave është pandehma se kështu do t'ia bëjnë të njohur besimin e tyre Allahut të Madhëruar, ndërkohë që Allahu është i Gjithëdijshëm për gjithçka, prandaj kjo sjellje e tyre është e ulët dhe e panevojshme. Arsye tjetër është që t'i tregojnë Profetit (a.s.) se kanë besuar jo për të fituar ndonjë gjë për veten e tyre, por për t'i bërë nder Profetit. Me fjalët e tyre, ata sikur po ia kujtonin Profetit nderin që po i bënin duke e besuar dhe u bërë pasues të fesë së tij. Kjo sigurisht qe diçka jo e këndshme, që nuk u takonte ta bënin përpara Profetit të Zotit. Në fund të fundit, nëse imani qe i vërtetë në zemrat e tyre, kjo ishte bamirësi e Allahut për ta. Ishte vetëm Allahu që ua dhuroi atë mirësi e çdo mirësi tjetër që kishin. Ashtu sikurse është Allahu i vetmi që i krijon, i furnizon dhe u dhuron njerëzve mirësi të dukshme e të padukshme, po ashtu Ai është i vetmi që u dhuron atyre imanin dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Mirësia e Islamit, e të besuarit dhe e udhëzimit në rrugën e drejtë është mirësia më e madhe dhe më e rëndësishme që Ai u dhuron njerëzve. Prandaj vetëm Atij i duhet shprehur

---

[24] Dijetarët selefë dhe të tjerë kanë shprehur mendime të ndryshme për rastin kur njeriu deklaron besimin e tij. Disa kanë qenë të mendimit se nuk lejohet të thuash për veten: "*Unë jam besimtar*", pa e shoqëruar me: "*...në dashtë Allahu*" nga pas. Disa deklarojnë se ky ka qenë mendimi i shumicës së dijetarëve filozofë (*mutekellimin*) të medhhebit Shafiij.
Disa të tjerë mendojnë se është e lejueshme të thuash: "Unë jam besimtar" edhe pa thënë nga pas: "*...në dashtë Allahu*". Ky është mendimi më i përzgjedhur, që mbështetet edhe nga dijetarët analistë kritikë "*muhakkikin*".
Ndërsa El Euzaijju dhe të tjerë kanë qenë të mendimit se që të dyja mënyrat janë të lejuara, në varësi të këndvështrimit apo të qëllimit. Pra, lejohet të thuash thjesht: "*Unë jam besimtar*", nëse ke për qëllim gjendjen aktuale, përderisa konsiderohesh nga Sheriati si "besimtar". Por, gjithashtu, mund të thuash: "*Unë jam besimtar, në dashtë Allahu*!", nëse ke për qëllim lutjen për begati dhe sukses nga Allahu, ose nëse shpreh shpresën për përfundimin tënd, pasi ne nuk e dimë a do të jemi të qëndrueshëm në besimin tonë deri në vdekje apo jo. Edhe ky mendim është i pranueshëm, nëse duam që t'u largohemi sa më shumë përplasjeve të mendimeve.
Për sa i përket deklarimit se dikush është jobesimtar, ka gjithashtu mendime të ndryshme të dijetarëve. Kështu, disa janë të mendimit se mund të thuhet: "*Ai është qafir*" edhe pa thënë: "*...në dashtë Allahu*". Disa të tjerë thonë se me këtë rast veprohet njëlloj si për deklarimin e besimit. Pra, në varësi të qëllimit, mund të themi: "*...në dashtë Allahu*", ose jo. Kjo do të thotë që, nëse kemi qëllim të tregojmë se si do të jetë përfundimi i tij, duhet të themi: "*...në dashtë Allahu*", pasi ne nuk e dimë se si do të jetë përfundimi i tij. Ky mendim është parapëlqyer nga disa prej dijetarëve *muhakkikin*. Sidoqoftë, Allahu është më i ditur për gjithçka. [Shih "*Komentari i Sahihut të Muslimit*" nga imam Neveviu, vëllimi 1].


الجزء السادس والعشرون سورة ق

سورة ق

بسم الله الرحمن الرحيم

ق ۚ وَالْقُرْآنِ الْمَجِيدِ ﴿١﴾ بَلْ عَجِبُوا أَن جَاءَهُم مُّنذِرٌ مِّنْهُمْ
فَقَالَ الْكَافِرُونَ هَٰذَا شَيْءٌ عَجِيبٌ ﴿٢﴾ أَإِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا ۖ ذَٰلِكَ
رَجْعٌ بَعِيدٌ ﴿٣﴾ قَدْ عَلِمْنَا مَا تَنقُصُ الْأَرْضُ مِنْهُمْ ۖ وَعِندَنَا كِتَابٌ
حَفِيظٌ ﴿٤﴾ بَلْ كَذَّبُوا بِالْحَقِّ لَمَّا جَاءَهُمْ فَهُمْ فِي أَمْرٍ مَّرِيجٍ ﴿٥﴾
أَفَلَمْ يَنظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا
وَمَا لَهَا مِن فُرُوجٍ ﴿٦﴾ وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ
وَأَنبَتْنَا فِيهَا مِن كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ﴿٧﴾ تَبْصِرَةً وَذِكْرَىٰ لِكُلِّ عَبْدٍ
مُّنِيبٍ ﴿٨﴾ وَنَزَّلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً مُّبَارَكًا فَأَنبَتْنَا بِهِ جَنَّاتٍ
وَحَبَّ الْحَصِيدِ ﴿٩﴾ وَالنَّخْلَ بَاسِقَاتٍ لَّهَا طَلْعٌ نَّضِيدٌ ﴿١٠﴾ رِّزْقًا
لِّلْعِبَادِ ۖ وَأَحْيَيْنَا بِهِ بَلْدَةً مَّيْتًا ۚ كَذَٰلِكَ الْخُرُوجُ ﴿١١﴾ كَذَّبَتْ قَبْلَهُمْ
قَوْمُ نُوحٍ وَأَصْحَابُ الرَّسِّ وَثَمُودُ ﴿١٢﴾ وَعَادٌ وَفِرْعَوْنُ وَإِخْوَانُ
لُوطٍ ﴿١٣﴾ وَأَصْحَابُ الْأَيْكَةِ وَقَوْمُ تُبَّعٍ ۚ كُلٌّ كَذَّبَ الرُّسُلَ فَحَقَّ وَعِيدِ
﴿١٤﴾ أَفَعَيِينَا بِالْخَلْقِ الْأَوَّلِ ۚ بَلْ هُمْ فِي لَبْسٍ مِّنْ خَلْقٍ جَدِيدٍ ﴿١٥﴾

٥١٨

falënderimi dhe mirënjohja e plotë, siç thotë i Madhëruari:

- "...pasi Ai që meriton falënderimin tuaj për udhëzimin në besim, është vetëm Allahu, nëse jeni të sinqertë". Pastaj i Madhëruari thotë:

- "S'ka dyshim se Allahu i di të fshehtat e qiejve e të Tokës." - Allahu është i Gjithëdijshëm për çështjet e fshehta, që krijesat nuk i dëshmojnë dhe as i dinë. Ai e di çfarë fshihet në thellësitë e errëta të oqeanit, Ai e di çfarë fsheh nata dhe çfarë zbulon dita. Allahu di për çdo pikë shiu, madje edhe ku ajo zbret. Ai di edhe për çdo thërrmijë rëre. Allahu e di çfarë fshihen në gjokse dhe çdo çështje të fshehtë tjetër, sikurse thotë në një ajet tjetër: "Çelësat e fshehtësive janë vetëm tek Ai, ato (fshehtësitë) nuk i di askush veç Tij. Ai di çka në tokë dhe në det. Ai di për çdo gjethe që bie. S'ka kokërr në thellësi të tokës, s'ka të njomë dhe s'ka të thatë, që nuk gjendet në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)." [En'am 59].

- "Allahu ju sheh se çfarë bëni." - Allahu që ju vështron në çdo gjendje e punë, do t'jua japë shpërblimin për to të plotë, ashtu siç e gjykon Ai, me mëshirën e Tij të gjerë dhe me urtësinë e Tij të madhe.

Përfundoi edhe tefsiri i sures Huxhurat, me ndihmën dhe suksesin e dhuruar prej Allahut. Ty, o Allah, dhe vetëm Ty të takon lavdia! Ti je Bujari dhe Bamirësi më i madh e Mëshirëplotë!

Surja 50: Kaf (mekase) 45 ajete

Ajetet 1 - 5
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. *Kaf*. Betohem në Kuranin e lavdishëm!
2. Po! Ata u çuditën që nga gjiri i tyre u erdhi një profet. Jobesimtarët thonë: "Kjo është vërtet shumë e çuditshme!
3. Po pasi të vdesim e të bëhemi dhé?! Ai kthim është larg!"
4. Ne dimë se ç'ha toka prej tyre. Te Ne është libri që ruan çdo gjë.
5. Ata e mohojnë të vërtetën, kur ajo u vjen, dhe janë vazhdimisht të luhatur.

Shpjegimi i ajeteve

- "*Kaf*. Betohem në Kuranin e lavdishëm!" - Allahu i Lartësuar betohet në Kuranin e lavdishëm.

Kurani është shumë i gjerë dhe madhështor në kuptimet dhe urtësitë që përmban. Cilësimi *el mexhîd* vjen nga fjala *el mexhd,* që do të thotë: me kuptime dhe urtësi

madhëshore. Pa dyshim, fjala e Allahut të Urtë dhe të Gjithëdijshëm është më e denja për patur cilësi të tilla. Kurani përmban njohuritë, dituritë dhe urtësitë e të parëve dhe të fundit. Stili i tij është më i larti dhe më i mrekullueshmi. Fjalët e tij janë më të plotat dhe më shprehëset. Kuptimet dhe urtësitë e tij janë më të bukurat dhe më gjithëpërfshirëset. Tërë këto cilësi të bëjnë që ta besosh dhe ta pasosh plotësisht dhe pa u vonuar udhëzimin e tij. Ato të bëjnë që të nënshtrohesh, për të zbatuar me përunjësi çdo porosi të tij. Ato, gjithashtu, të nxisin që ta lavdërosh dhe t'i shprehësh mirënjohjen maksimale Atij që i dhuroi, Allahut të Madhëruar. Megjithatë, shumica e njerëzve nuk i çmojnë dhuratat dhe mirësitë që Zoti u dhuron dhe nuk u kushtojnë vëmendjen e duhur.

- **"Po! Ata u çuditën që nga gjiri i tyre u erdhi një profet."** – Ata u çuditën që u vajti një profet, i cili u tërhiqte vërejtjen për çdo gjë që i dëmtonte dhe i mësonte çdo gjë të mirë, që u sillte dobi dhe lumturi. Zoti e përzgjodhi këtë profet nga gjiri i tyre, në mënyrë që ata ta kishin plotësisht të mundur të njihnin sinqeritetin dhe virtytet e tij të larta e, si rrjedhojë, ta dëgjonin, ta besonin dhe të ndiqnin rrugën e tij. Atëherë, këtu nuk kishte asgjë për t'u habitur. Ajo ishte mëse normale dhe plotësisht në përputhje me urtësinë dhe mëshirën e Allahut të Madhërishëm, i Cili ua lehtëson gjithmonë krijesave gjetjen e rrugës së drejtë. Për t'u habitur ishte vetëm arsyetimi i tyre i mbrapshtë. Në fakt, ata nuk vuanin aspak nga të metat mendore, por çudia e tyre për Profetin e Zotit vinte nga prirja e tyre djallëzore për mohimin e të vërtetës. Prandaj i Lartësuari i quan ata *kafirun* - jobesimtarë, kur thotë:

- **"Jobesimtarët thonë: "Kjo është vërtet shumë e çuditshme!""** – Habia e tyre shpjegohet me dy mënyra:

1. Të ishin të sinqertë në fjalët e tyre, dhe kështu kjo tregonte injorancën e thellë dhe logjikën e mangët të tyre. Në këtë mënyrë, ata i ngjanin atij budallait që çuditet dhe qesh me fjalët e një të mençuri, ose frikacakut që çuditet me trimin zemërluan, që sulet si shigjetë në mes të armikut dhe lufton; ose i ngjanin koprracit, i cili habitet me bujarinë e njerëzve zemërmirë etj. E çfarë dëmi mund t'i sjellë habia e këtyre të mangtëve atij që sheh me dritën e imanit?!
2. Të shfaqnin çudi në formë përçmimi, pasi e dinin shumë mirë se e vërteta ishte ndryshe, dhe kjo konsiderohet si grada më e ulët dhe më e shëmtuar e padrejtësisë.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar na shtjellon më shumë shkakun e habisë së tyre dhe të mospranimit të Profetit:

- **"Po pasi të vdesim e të bëhemi dhé?! Ai kthim është larg!"** – Ata, me një naivitet të pabesueshëm, krahasuan pushtetin absolut të Krijuesit të gjithësisë nga hiçi, Atij që është i Plotë nga çdo këndvështrim, me pamundësinë dhe fuqinë e kufizuar të njeriut. Nga padituria e thellë, ata gjykuan padrejtësisht rreth Allahut të Gjithëdijshëm për gjithçka që ka krijuar. Por i Madhërishmi u kujton atyre një fakt shumë të thjeshtë, që ata të binden sa më parë për fuqinë e Tij absolute për të ringjallur krijesat:

- "**Ne dimë se ç'ha toka prej tyre." -** Allahu i Lartësuar i di në imtësi edhe se çfarë ha toka prej trupave të njerëzve, gjatë qëndrimit të

tyre në varre. Çdo gjë është shkruar me përpikmëri në *Leuhi Mahfudh*, në librin e Tij të ruajtur nga ndryshimet apo nga mangësitë.

- "**Te Ne është libri që ruan çdo gjë.**" - Atje është shkruar gjithçka që do të ndodhë me njerëzit, gjatë jetës dhe pas vdekjes.

Kështu, Allahu i Lartësuar argumenton për vërtetësinë e ringjalljes, duke na kujtuar dijen e Tij absolute mbi gjithçka.

- "Ata e mohojnë të vërtetën, kur ajo u vjen..." - Shkaku i habisë së tyre ishte mohimi dhe armiqësia ndaj të vërtetës. Ata thjesht nuk donin ta pranonin të vërtetën e sjellë nga Profeti besnik i Zotit të gjithësisë. Duke qenë se nuk kishin asnjë arsye dhe argumentim për të refuzuar të vërtetën, ata ishin gjithmonë të çoroditur dhe të paqëndrueshëm në fjalët dhe pretendimet e tyre, siç thotë i Gjithëdijshmi:

- **"...dhe janë vazhdimisht të luhatur."** - Ata i karakterizonte një pasiguri e thellë, në çdo arsyetim që paraqisnin. Asnjëherë nuk i qëndronin një fjale. Herë thoshin se ai Muhamedi (a.s.) ishte magjistar, herë i çmendur, herë poet dhe herë orator. Pastaj hidheshin te Kurani dhe i bënin gjithfarëlloj cilësimesh, si: poezi, magji, përrallë nga e kaluara etj. Secili ia këpuste fjalëve sipas qejfit të vet.

Njerëzit që mohojnë të vërtetën janë të çoroditur dhe pa një qëndrim të qartë. Ata janë gjithmonë kontradiktorë në fjalë dhe arsyetim. Ndërsa ata që e besojnë të vërtetën me bindje dhe siguri të plotë, ata janë të qëndrueshëm, të qartë dhe të paluhatshëm nga rruga e tyre. Veprat e tyre janë në përputhje me besimin dhe fjalët që thonë.

Ajetet 6 – 11

6. A nuk e vështrojnë qiellin sipër tyre, se si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa lejuar në të asnjë të çarë?!
7. Edhe Tokën e kemi shtrirë dhe kemi vendosur në të male përforcuese. Ne e kemi bërë që në të të mbijnë larmi bimësh të bukura.
8. Këto janë dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për çdo adhurues që kthehet i penduar e i bindur.
9. Ne e lëshojmë nga qielli shiun e bekuar dhe me të bëjmë të mundur që të mbijnë e lulëzojnë kopshte, të korra
10. dhe palma të larta hurmash, me vile frutash të stivosura njëra mbi tjetrën,
11. si ushqim për njerëzit. Ne e ngjallim me të tokën e vdekur, ashtu si do të jetë edhe ringjallja juaj.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për gjendjen e jobesimtarëve që mohuan profetët, Allahu i Lartësuar i fton ata që të vështrojnë shenjat e Tij në natyrë, për të mësuar mbi pushtetin absolut të Tij. Kështu, i Madhërishmi thotë:

- "**A nuk e vështrojnë qiellin sipër tyre...**" - Nuk është e nevojshme që të lodhesh shumë për të konstatuar madhështinë e Allahut dhe të krijimit të Tij të mrekullueshëm. Mjafton të hedhësh vështrimin lart në qiell, për të parë rregullsinë dhe bukurinë e krijimit të Zotit të gjithësisë.

- "...se si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa lejuar në të asnjë të çarë?!" - Vëreni se si e kemi ndërtuar qiellin, me rregullsinë dhe qëndrueshmërinë e tij të pabesueshme.

Pastaj shihni yjet, që e zbukurojnë atë për çdo sy që sheh. Në këtë madhështi nuk mund të vëresh asnjë të çarë, asnjë defekt apo çrregullim. Allahu i Lartësuar e ka bërë qiellin si çati mbrojtëse për krijesat e tokës dhe ka vendosur në të gjëra që konsiderohen si domosdoshmëri për jetën në tokë.

- "Edhe Tokën e kemi shtrirë dhe kemi vendosur në të male përforcuese." - Vështroni Tokën, se si Allahu i Lartësuar e shtriu dhe e bëri të qëndrueshme për banorët e saj. Ai e rregulloi atë, në mënyrë që çdo krijesë të mund të jetojë dhe t'i plotësojë nevojat e veta në të. Allahu i Lartësuar vendosi në Tokë malet, që shërbejnë si përforcuese të saj, që ajo të mos ishte e lëvizshme dhe e pabanueshme.

- "Ne e kemi bërë që në të të mbijnë larmi bimësh të bukura." - Përveç qëndrueshmërisë, Allahu i Lartësuar e pajisi Tokën me gjithçka të nevojshme për zhvillimin e bimësisë, me të gjithë larmishmërinë dhe hijeshinë e saj. Kush vështron këtë bimësi, gjen kënaqësi dhe çlodhje, ai që mediton rreth tyre, habitet dhe mrekullohet, ai që pret prodhimin e tyre, qetësohet dhe gëzohet. Allahu i Lartësuar e solli këtë mirësi si ushqim për bijtë e Ademit dhe për kafshët e tyre.

- "Këto janë dëshmi të dukshme dhe përkujtuese për çdo adhurues që kthehet i penduar e i bindur." - Kush vështron dhe mediton në këto mirësi të dhuruara nga i Gjithëmëshirshmi, shërohet nga vërbëria që sjell padituria dhe mohimi. Këto janë argumente shumë të qarta, që ushqejnë besimin. Ato janë edhe një përkujtim për zemrat e pavëmendshme, që të kujdesen për të arritur të mirat të kësaj dynjaje dhe të ahiretit, duke përkujtuar dhe zbatuar porositë e Zotit dhe të profetëve të Tij. Ato nuk janë dritë dhe përkujtim për çdo lloj njeriu. Prej tyre nxjerrin mësime vetëm ata që Zoti i ka përshkruar si 'të kthyer tek Ai me pendim të sinqertë, me drojë, me shpresë dhe dashuri për Të, si edhe të bindur dhe pasues të Profetit të Tij'. Ndërsa për ata që i kthejnë shpinën Profetit dhe Librit të Zotit nuk vlejnë këto shenja dhe argumente. Vërejtjet dhe shenjat nuk i bëjnë dobi një njeriu që nuk beson.

- "Ne e lëshojmë nga qielli shiun e bekuar dhe me të bëjmë të mundur që të mbijnë e lulëzojnë kopshte, të korra..." - Pa ujin e begatshëm që Zoti e zbret nga qielli, nuk ka mundësi të jetojë asnjë gjallesë në tokë. Nëpërmjet tij, i Mëshirshmi i jep jetë gjithçkaje. Kështu lulëzojnë kopshtet, vreshtat, agrumet plot hijeshi dhe aromë, shegët, mollët e çdo frut i shijshëm dhe i këndshëm. Me të rriten edhe të lashtat, si gruri, elbi, orizi etj.

- "...dhe palma të larta hurmash, me vile frutash të stivosura njëra mbi tjetrën, si ushqim për njerëzit." - Shikoni hurmat e larta, me degët e rënduara nga frutat palë-palë, aq të dobishme për njerëzit dhe kafshët. Njerëzit ushqehen me to për momentin dhe i magazinojnë për më vonë. Me to ushqejnë edhe kafshët e tyre shtëpiake. Nëpërmjet ujit që zbret nga qielli dhe atij që buron nga toka, Allahu krijon lumenjtë, aq të nevojshëm për jetën në tokë.
Uji është vërtet jetë, siç thotë i Lartësuari më pas:

- **"Ne e ngjallim me të tokën e vdekur, ashtu si do të jetë edhe ringjallja e përgjithshme."** - Të gjitha këto krijesa të mrekullueshme, të mëdha dhe të forta, janë një dëshmi e pamohueshme për pushtetin dhe fuqinë absolute të Allahut të Lartësuar. Bukuria dhe rregullsia, përpikmëria dhe hijeshia e tyre tregojnë qartë se Allahu i Lartësuar është më i Urti dhe i Gjithëdijshmi, për gjithçka dhe në hollësi. Nevoja e madhe që njeriu ka për këto krijesa dëshmon për mëshirën e madhe të Allahut, e cila ka përfshirë gjithçka, dhe për bamirësitë e Tij, që prek çdo gjallesë. Kjo gjithësi e rregullt dhe madhështore tregon qartë se Allahu i Lartësuar është i Vetëm dhe i Pashoq në pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Ai është *Es-Samedu* - Zotëruesi, Mbretëruesi dhe Ai të Cilit çdo krijesë i drejtohet për nevojat e saj. Është Allahu që nuk ka nevojë të ketë grua dhe fëmijë. Me Allahun nuk barazohet apo përngjason askush. Allahu është i vetmi që meriton adhurimin, me përunjësi, madhërim dhe dashuri.

Ringjallja e tokës pas vdekjes së saj është provë që Allahu i Lartësuar ka për t'i ringjallur krijesat pas vdekjes së tyre, për t'i shpërblyer me drejtësi, sipas punëve të tyre.

Ajetet 12 – 15

12. Para tyre mohuan populli i Nuhut, banorët e Ressit, populli i Themudit,
13. Adi, Faraoni, vëllezërit e Lutit,
14. banorët e Ejkes dhe populli i Tubbeit. Të gjithë mohuan profetët, prandaj meritojnë ndëshkimin Tim.
15. Vallë, a mos u lodhëm Ne me krijimin e parë?! Jo, por ata kanë pasiguri për rikrijimin e ri.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Para tyre mohuan populli i Nuhut, banorët e Ressit, populli i Themudit, Adi, Faraoni, vëllezërit e Lutit, banorët e Ejkes dhe populli i Tubbeit."** - Pas përmendjes së disa shenjave të mëdha, Allahu i Lartësuar u tërheq vërejtjen njerëzve, duke u kujtuar ndëshkimet që kaluan popujt e mëparshëm, të cilët shpërfillën shenjat dhe porositë e Tij. Ai i këshillon ata që të mos vazhdojnë me mohimin dhe shpërfilljen e Librit dhe Profetit të Tij, që të mos ndëshkohen si popujt e kaluar.

Allahu i Lartësuar përmend disa nga këta popuj dhe profetët e tyre. Kështu, Profeti Nuh (a.s.) u refuzua nga populli i tij. Populli i Themudit refuzoi profetin Salih, populli i Adit mohoi profetin Hud, vëllezërit e Lutit refuzuan profetin Lut, banorët e Ejkes refuzuan profetin Shuajb. Edhe banorët e Tubbeit refuzuan profetët e tyre. Tubbei quhej çdo mbret që sundonte në Jemen në kohët e shkuara, para Islamit. Allahu i Lartësuar nuk na tregon për emrin e profetit që u dërgua në popullin e Tubbeit, por na tregon që ata e mohuan atë.

- **"Të gjithë mohuan profetët, prandaj meritojnë ndëshkimin Tim."** - Të gjithë këta popuj i refuzuan profetët që Zoti dërgoi ndër ta, prandaj merituan ndëshkimin e paralajmëruar të Tij. Për këtë arsye, edhe ata që mohonin udhëzimin e profetit Muhamed nuk ishin më të mirë se popujt e ndëshkuar më herët, ashtu si edhe profeti Muhamed nuk ishte më pak i vlefshëm se profetët e dërguar para tij. Prandaj edhe ata i priste i njëjti ndëshkim, nëse vazhdonin të bënin të njëjtin krim!

Pastaj Allahu i Madhëruar u sjell një provë tjetër, që të binden plotësisht për fuqinë e Tij të plotë për të ringjallur krijesat:

- **"Vallë, a mos u lodhëm Ne me krijimin e parë?!"** – Kuptimi: Vallë, a mos e patëm të vështirë krijimin për herë të parë, që të mendoni se rikrijimi është i pamundur?! Jo, sigurisht që nuk është kështu. Asgjë nuk është e pamundur për pushtetin absolut të Sunduesit të gjithësisë. Ai që i krijoi ata për herë të parë nga hiçi, është i Plotfuqishëm për t'i rikthyer në jetë, edhe pse do të jenë bërë dhé.

- "Jo, por ata kanë pasiguri për rikrijimin e ri." - Jobesimtarët vazhdojnë të kenë pasiguri, megjithëse ajo është e pakuptimtë, sepse Ai që krijoi gjithçka nga hiçi, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëditur që t'i rikrijojë ata nga mbetjet e tyre në tokë. Edhe logjikisht, rikthimi i tyre në jetë është më i thjeshtë për t'u arritur, sikurse thotë i Lavdëruari në një ajet tjetër: "Është Ai që e ka bërë krijimin për herë të parë, dhe pastaj e përsërit atë, gjë e cila është edhe më e lehtë për Të". [Rum 27].

Ajetet 16 – 18

16. Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne dimë se ç'pëshpërit ai në vetvete. Ne jemi më afër tij se damari i qafës së vet.
17. Dy engjëj qëndrojnë pranë tij, në të djathtë dhe në të majtë.
18. Ai nuk thotë ndonjë fjalë pa patur pranë një regjistrues të gatshëm.


Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne dimë se ç'pëshpërit ai në vetvete. Ne jemi më afër tij se damari i qafës së vet."** - Allahu i Madhërishëm na tregon se Ai është i vetmi që krijoi njeriun apo llojin njerëzor. Ai është, gjithashtu, i Gjithëdijshëm për atë që ka krijuar. Madje, Allahu di në hollësi edhe atë që njeriu pëshpërit në veten e vet. Ai di atë që e shfaqim dhe atë që e mbajmë fshehur. Allahut nuk i fshihet asgjë në qiell dhe në Tokë, sado e vogël të jetë ajo. Ai është Mbikëqyrësi, Vështruesi, Dëshmuesi i gjithçkaje që ndodh në gjithësinë, që vetë e krijoi. Askush nuk mund të jetë më i ditur për krijesat sesa Allahu, që i krijoi ato.

Allahu është pranë njerëzve, madje më pranë sesa damari i qafës së tyre. Kjo duhet të forcojë tek ne ndjenjën e drojës dhe edukatën me Krijuesin tonë. E si mund të ndihesh ndryshe, kur ndien kaq pranë shikimin e Atij që di të shfaqurën dhe të fshehurën, që di dhe sheh çdo mendim që vërtitet në shpirtin e njeriut?! Ai të sheh në çdo gjendje, në çdo kohë dhe kudo që të jesh. Kjo duhet ta na bëjë të kemi turp dhe të mos lejojmë që Allahu i Lartësuar të na gjejë duke vepruar, folur apo menduar keq, në kundërshtim me urdhëresat e Tij.

- "Dy engjëj qëndrojnë pranë tij, në të djathtë dhe në të majtë." - Njeriu duhet të kujtojë vazhdimisht edhe praninë e dy melekëve të nderuar, që i qëndrojnë njëri në të majtë dhe tjetri në të djathtë, për të shkruar çdo fjalë e vepër të tij. Ai duhet ta respektojë praninë e tyre, duke mos e lejuar veten në fjalë dhe vepra jo të denja për besimtarin dhe që nuk e kënaqin Zotin e botëve. Asnjë fjalë dhe vepër nuk u shpëton këtyre shkruesve besnikë të Zotit të botëve.

- **"Ai nuk thotë ndonjë fjalë pa patur pranë një regjistrues të gatshëm."** - Çdo fjalë a


الجزء السادس والعشرون سورة ق
وَلَقَدْ خَلَقْنَا ٱلْإِنسَٰنَ وَنَعْلَمُ مَا تُوَسْوِسُ بِهِۦ نَفْسُهُۥ ۖ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ
مِنْ حَبْلِ ٱلْوَرِيدِ ﴿١٦﴾ إِذْ يَتَلَقَّى ٱلْمُتَلَقِّيَانِ عَنِ ٱلْيَمِينِ وَعَنِ ٱلشِّمَالِ
قَعِيدٌ ﴿١٧﴾ مَّا يَلْفِظُ مِن قَوْلٍ إِلَّا لَدَيْهِ رَقِيبٌ عَتِيدٌ ﴿١٨﴾ وَجَآءَتْ سَكْرَةُ
ٱلْمَوْتِ بِٱلْحَقِّ ۖ ذَٰلِكَ مَا كُنتَ مِنْهُ تَحِيدُ ﴿١٩﴾ وَنُفِخَ فِى ٱلصُّورِ ۚ ذَٰلِكَ
يَوْمُ ٱلْوَعِيدِ ﴿٢٠﴾ وَجَآءَتْ كُلُّ نَفْسٍ مَّعَهَا سَآئِقٌ وَشَهِيدٌ ﴿٢١﴾ لَّقَدْ
كُنتَ فِى غَفْلَةٍ مِّنْ هَٰذَا فَكَشَفْنَا عَنكَ غِطَآءَكَ فَبَصَرُكَ ٱلْيَوْمَ حَدِيدٌ
﴿٢٢﴾ وَقَالَ قَرِينُهُۥ هَٰذَا مَا لَدَىَّ عَتِيدٌ ﴿٢٣﴾ أَلْقِيَا فِى جَهَنَّمَ كُلَّ كَفَّارٍ
عَنِيدٍ ﴿٢٤﴾ مَّنَّاعٍ لِّلْخَيْرِ مُعْتَدٍ مُّرِيبٍ ﴿٢٥﴾ ٱلَّذِى جَعَلَ مَعَ ٱللَّهِ إِلَٰهًا
ءَاخَرَ فَأَلْقِيَاهُ فِى ٱلْعَذَابِ ٱلشَّدِيدِ ﴿٢٦﴾ ۞ قَالَ قَرِينُهُۥ رَبَّنَا مَآ أَطْغَيْتُهُۥ
وَلَٰكِن كَانَ فِى ضَلَٰلٍۭ بَعِيدٍ ﴿٢٧﴾ قَالَ لَا تَخْتَصِمُوا۟ لَدَىَّ وَقَدْ قَدَّمْتُ
إِلَيْكُم بِٱلْوَعِيدِ ﴿٢٨﴾ مَا يُبَدَّلُ ٱلْقَوْلُ لَدَىَّ وَمَآ أَنَا۠ بِظَلَّٰمٍ لِّلْعَبِيدِ ﴿٢٩﴾
يَوْمَ نَقُولُ لِجَهَنَّمَ هَلِ ٱمْتَلَأْتِ وَتَقُولُ هَلْ مِن مَّزِيدٍ ﴿٣٠﴾ وَأُزْلِفَتِ
ٱلْجَنَّةُ لِلْمُتَّقِينَ غَيْرَ بَعِيدٍ ﴿٣١﴾ هَٰذَا مَا تُوعَدُونَ لِكُلِّ أَوَّابٍ حَفِيظٍ
﴿٣٢﴾ مَّنْ خَشِىَ ٱلرَّحْمَٰنَ بِٱلْغَيْبِ وَجَآءَ بِقَلْبٍ مُّنِيبٍ ﴿٣٣﴾ ٱدْخُلُوهَا
بِسَلَٰمٍ ۖ ذَٰلِكَ يَوْمُ ٱلْخُلُودِ ﴿٣٤﴾ لَهُم مَّا يَشَآءُونَ فِيهَا وَلَدَيْنَا مَزِيدٌ ﴿٣٥﴾
الجزء ٥٢
٥١٩

vepër, e mirë apo e keqe, shënohet nga engjëjt. Engjëlli në të djathtë shënon fjalët dhe veprat e mira, ndërsa engjëlli në të majtë shënon fjalët dhe veprat e këqija. Këta të dy janë gjithmonë dhe kudo të pranishëm me njeriun, në çdo gjendje të tij. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Sigurisht, me ju qëndrojnë mbikëqyrësit! Ata janë shkrues besnikë. Ata dinë çdo gjë që ju veproni." [Infitar 10-12].

Ajetet 19 – 22

19. Kur të vijë agonia e vdekjes me të vërtetën: Kjo është ajo së cilës i largoheshe!
20. Po kur t'i fryhet Surit! Ajo është Dita e Kërcënimit!
21. Çdo njeri do të vijë bashkë me përcjellësin dhe dëshmitarin vet.
22. Ti ke qenë i papërgatitur për këtë, por Ne tani ta heqim perden dhe shikimi yt sot është shumë i qartë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Kur të vijë agonia e vdekjes me të vërtetën: Kjo është ajo së cilës i largoheshe!"** - Ky është një kërcënim për çdo mohues apo neglizhent të së vërtetës. Allahu i Lartësuar na përkujton momentin kur agonia e vdekjes afrohet, për ta përjetuar me të gjithë dimensionin e saj. Në ato çaste, çdokujt do t'i shfaqet realiteti i pamohueshëm i ahiretit. Askush që përjeton ato çaste nuk mund ta mohojë më dhe as të shpëtojë prej saj. Gjatë jetës së dynjasë, çdokush i frikësohet këtij momenti, por përpara vjen një ditë më e vështirë, dita kur i fryhet Surit.

- **"Po kur t'i fryhet Surit! Ajo është Dita e Kërcënimit!"** - Ajo është dita kur kriminelët jobesimtarë do të ballafaqohen me atë që u kërcënohej, ndërsa besimtarët do të shohin shpërblimin që u është premtuar.

- **"Çdo njeri do të vijë bashkë me përcjellësin dhe dëshmitarin vet."** – Çdo njeri, atë ditë, do të shoqërohet nga dy engjëj. Njëri është engjëlli që e përcjell drejt vendqëndrimit të Ditës së Kijametit, prandaj askush nuk mund të shmanget e të mos shkojë në këtë vendqëndrim të frikshëm. Engjëlli tjetër është dëshmitari, i cili i ka ruajtur me besnikëri të gjitha veprat e robit dhe do të dëshmojë me vërtetësi.

Atë ditë dalin në pah veprat e mira dhe të këqija, që tregon për drejtësinë dhe përkujdesjen e madhe të Allahut të Lartësuar për krijesat. Ai ua ruan të gjitha veprat e tyre dhe do t'i shpërblejë me

drejtësi dhe bamirësi për to. Ky është një fakt që njerëzit duhet ta rikujtojnë vazhdimisht, por shumica e tyre rrinë neglizhentë dhe të papaërgatitur, siç thotë i Lartësuari më pas:

- **"Ti ke qenë i papërgatitur për këtë..."** - Kështu i thuhet Ditën e Kijametit çdo mohuesi që i kthen shpinën udhëzimit të Zotit. Këto janë fjalë të ashpra dhe poshtëruese. Pra: "Ti ishe ai që mohove këtë të vërtetë dhe nuk u përgatite për të."

- **"...por Ne tani ta heqim perden..."** - Tani po ta heqim perden e zemrës dhe të syve, që ta shohësh dhe ta vuash atë që e ke mohuar dhe shpërfillur. Për shkak të perdes së mohimit, që të mbuloi zemrën, gjumi yt qe i thellë dhe shpërfillja e së vërtetës u bë e vazhdueshme. Kështu që, erdhi koha që tani ta përjetosh gjithçka realisht.

- **"...dhe shikimi yt sot është shumë i qartë." –** Kuptimi: Sot do të shohësh tmerrin dhe ndëshkimin që të pret.

Ky ajet mund të merret edhe si përkujtim, që Allahu i Lartësuar i drejton robit në këtë dynja, që ai të udhëzohet. Robi në dynja është shpërfillës i kësaj të vërtete dhe do të përmendet vetëm kur të vijë Dita e Premtuar. Por ajo ditë është koha kur asgjë nuk të bën më dobi dhe kur nuk mund të arrish më gjërat që i ke lënë të ikin. Për këtë arsye, le të nxitojnë të mençurit për të bërë punë të mira, duke zbatuar udhëzimet e Zotit të tyre të dashur dhe të mëshirshëm, para se të vijë dita kur nuk bën më dobi asgjë.

Ky është një paralajmërim i hapur, që njeriu të marrë masat për t'i shpëtuar ndëshkimit të përgatitur për jobesimtarët dhe shpërfillësit e udhëzimeve të Zotit.

Ajetet 23 – 29

23. Shoqëruesi i tij do të thotë: "Ky në dorën time është gati!"
24. "Hidheni në Xhehenem çdo mohues kryeneç,
25. që ka qenë pengues i mirësisë, i padrejtë e dyshues!
26. Atë që, krahas Allahut, adhuronte zota të tjerë, hidheni në ndëshkimin më të rëndë!".
27. Ndërsa shoku i tij do të thotë: "Zoti ynë, atë nuk e devijova unë prej rrugës së drejtë, por ai ishte vetë në humbje të largët".
28. Ai do thotë: "Mos u grindni para Meje, se Unë ju kam paralajmëruar me kohë.
29. Vendimi Im nuk ndryshon tashmë! Unë nuk jam i padrejtë me robërit."

Shpjegimi i ajeteve

- **"Shoqëruesi i tij do të thotë: "Ky në dorën time është gati!""** - Engjëlli shoqërues i këtij mohuesi, të cilin Allahu i Lartësuar e ka ngarkuar me detyrën e ruajtjes së robit dhe të veprave të tij, do ta sjellë robin në sheshin e gjykimit dhe do të tregojë regjistrin e veprave të tij, me qëllim që gjykimi të jetë i drejtë. Për ata që meritojnë Zjarrin, thuhet:

- **"Hidheni në Xhehenem çdo mohues kryeneç..."** - Allahu i Lartësuar dhe i Drejtë i ka përshkruar këta njerëz me disa cilësi. Së pari, ata janë mohues të betuar të së vërtetës. Por ata janë edhe arrogantë e kryeneçë ndaj argumenteve të Allahut dhe atyre që e përhapin atë, duke bërë vazhdimisht gjynahe e padrejtësi.

- **"...që ka qenë pengues i mirësisë, i padrejtë e dyshues!"** - Ata janë pengues të mirësive. Mirësia më e madhe që ata ia ndalojnë vetes dhe të tjerëve është besimi tek Allahu, engjëjt, librat dhe profetët e Tij. Ata janë pengues të të mirave që mund t'i kryejnë me trupin dhe me pasurinë e tyre. Përveç kësaj, ata janë shumë agresivë dhe të padrejtë ndaj robërve të Allahut. Ata janë, gjithashtu, dyshues dhe mosbesues ndaj premtimeve të Allahut të Lartësuar.

Siç kuptohet, këta lloj njerëzish nuk kanë as *iman*, as *ihsan*. Ata i ka pushtuar kufri dhe urrejtja për të vërtetën dhe pasuesit e saj. Ata kanë dyshime të shumta rreth të vërtetës që iu paraqitet dhe janë koprracë. Ç'është më e keqja, ata adhurojnë idhuj, krahas Allahut të Lartësuar.

- **"Atë që, krahas Allahut, adhuronte zota të tjerë, hidheni në ndëshkimin më të rëndë!"** - Dy engjëjve shoqërues u jepet urdhri: Hidheni të përbuzur në ndëshkimin më të madh, më të shëmtuar dhe më të frikshëm atë person që, krahas Allahut të Vetëm dhe të Lartësuar, adhuronte idhuj, të cilët nuk ishin të aftë të bënin keq apo mirë, as për veten e tyre e as për të tjerët, idhuj që nuk mund të merrnin dhe as të jepnin jetë!

- "Ndërsa shoku i tij do të thotë: "Zoti ynë, atë nuk e devijova unë prej rrugës së drejtë, por ai ishte vetë në humbje të largët"." - Kur afrohet ndëshkimi, Shejtani që e ka shoqëruar në dynja, duke dashur të distancohet dhe të shfajësohet, thotë: "Zoti ynë, atë nuk e devijova unë nga rruga e drejtë, sepse unë nuk kisha pushtet mbi të, ashtu si nuk kisha fakte dhe argumente. Ai e përqafoi vetë rrugën e humbjes dhe gjeti prehje në të. Ai u largua nga e vërteta me zgjedhjen e tij të lirë."

Në një ajet tjetër të Kuranit, fjalimi i të Mallkuarit në Xhehenem përmendet më i plotë: "Kur gjithçka të ketë përfunduar, Shejtani do të thotë: "Po, Allahu ju kishte dhënë premtimin e vërtetë! Edhe unë ju kisha bërë një premtim, por nuk e mbajta fjalën. Sidoqoftë, unë nuk pata asnjë forcë detyruese ndaj jush, përveçse ju bëra një ftesë, ndërsa ju m'u përgjigjët. Atëherë, mos më fajësoni mua, po fajësoni veten! Tashmë, unë nuk mund t'ju shpëtoj ju, e as ju nuk mund të më shpëtoni mua! Unë distancohem nga adhurimi që ju më përkushtuat mua në të shkuarën!" Sigurisht, për jobesimtarët ka një dënim të dhembshëm." [Ibrahim 22].

Ndërsa besimtarët vepërmirë, që jetuan dhe punuan sipas besimit të tyre, janë larg këtij fjalimi të shëmtuar dhe dëshpërues. I Lartësuari thotë: "Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të vendosen në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë, me lejen e Zotit të tyre. Përshëndetja e tyre atje është *selam*-i." [Ibrahim 23]. Por polemikës së dëshpëruar mes banorëve të Xhehenemit, Allahu i Lartësuar i përgjigjet:

- **"Mos u grindni para Meje, se Unë ju kam paralajmëruar me kohë."** – Kuptimi: Nuk ka asnjë dobi nga kjo polemikë e dëshpëruar para Meje, sepse ju jeni paralajmëruar me kohë, para se të meritonit këtë dënim. Profetët e Mi erdhën tek ju me shenja e mrekulli të qarta, me arsyetime dhe argumentime bindëse e të pakundërshtueshme. Askush nuk mund të justifikohet tani para Meje, sepse çdo gjë e tillë tani është e pavlefshme. Tashmë për ju flasin vetëm

veprat tuaja, për të cilat duhet të jepet shpërblimi i merituar.


- **"Vendimi Im nuk ndryshon tashmë! Unë nuk jam i padrejtë me robërit."** - Gjykimi i Zotit të gjithësisë nuk mund të kthehet pas apo të kundërshtohet, sepse gjykimi i Tij është i vetmi gjykim i drejtë. Kujdes! Edhe ky lajm i madh nuk mund të mohohet, sepse askush nuk jep lajm më të vërtetë se Allahu i Lavdishëm. Llogaria e të Lartësuarit është me drejtësi. Ju do të shpërbleheni për atë që keni bërë vetë, mirë apo keq qoftë. Nëse keni punuar mirë, Ai jua shton të mirat nga bujaria e Tij. Nëse keni punuar keq, do të merrni me drejtësi të plotë atë që meritoni. Të mirat nuk do t'ju lihen pa u shpërblyer, ndërsa të këqijat nuk do t'ju shtohen.

Ajetet 30 – 35

30. **Atë ditë, Ne do t'i themi Xhehenemit: "A u mbushe?" Ndërsa ai do të thotë: "A ka edhe më?"**
31. **Ndërsa besimtarëve të devotshëm u afrohet Xheneti.**
32. **Ky është premtimi për secilin që është penduar e që ka ruajtur besën e dhënë,**
33. **që i është druajtur të Gjithëmëshirshmit edhe atëherë kur nuk e shihte kush, dhe që është kthyer me zemër tek Allahu.**
34. **Hyni në paqe dhe të sigurt, se kjo është dita e përjetësisë.**
35. **Atje kanë çfarë të dëshirojnë, por prej Nesh ka edhe më tepër.**

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i frikëson robërit e Tij, duke thënë:


الجزء السادس والعشرون
سورة ق
وَكَمْ أَهْلَكْنَا قَبْلَهُم مِّن قَرْنٍ هُمْ أَشَدُّ مِنْهُم بَطْشًا فَنَقَّبُوا
فِي الْبِلَادِ هَلْ مِن مَّحِيصٍ ﴿٣٦﴾ إِنَّ فِي ذَٰلِكَ لَذِكْرَىٰ لِمَن
كَانَ لَهُ قَلْبٌ أَوْ أَلْقَى السَّمْعَ وَهُوَ شَهِيدٌ ﴿٣٧﴾ وَلَقَدْ خَلَقْنَا
السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ وَمَا مَسَّنَا
مِن لُّغُوبٍ ﴿٣٨﴾ فَاصْبِرْ عَلَىٰ مَا يَقُولُونَ وَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ
قَبْلَ طُلُوعِ الشَّمْسِ وَقَبْلَ الْغُرُوبِ ﴿٣٩﴾ وَمِنَ اللَّيْلِ فَسَبِّحْهُ
وَأَدْبَارَ السُّجُودِ ﴿٤٠﴾ وَاسْتَمِعْ يَوْمَ يُنَادِ الْمُنَادِ مِن مَّكَانٍ قَرِيبٍ
﴿٤١﴾ يَوْمَ يَسْمَعُونَ الصَّيْحَةَ بِالْحَقِّ ذَٰلِكَ يَوْمُ الْخُرُوجِ ﴿٤٢﴾ إِنَّا
نَحْنُ نُحْيِي وَنُمِيتُ وَإِلَيْنَا الْمَصِيرُ ﴿٤٣﴾ يَوْمَ تَشَقَّقُ الْأَرْضُ
عَنْهُمْ سِرَاعًا ذَٰلِكَ حَشْرٌ عَلَيْنَا يَسِيرٌ ﴿٤٤﴾ نَّحْنُ أَعْلَمُ بِمَا يَقُولُونَ
وَمَا أَنتَ عَلَيْهِم بِجَبَّارٍ فَذَكِّرْ بِالْقُرْآنِ مَن يَخَافُ وَعِيدِ ﴿٤٥﴾
سورة الذاريات
بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ
وَالذَّارِيَاتِ ذَرْوًا ﴿١﴾ فَالْحَامِلَاتِ وِقْرًا ﴿٢﴾ فَالْجَارِيَاتِ يُسْرًا ﴿٣﴾
فَالْمُقَسِّمَاتِ أَمْرًا ﴿٤﴾ إِنَّمَا تُوعَدُونَ لَصَادِقٌ ﴿٥﴾ وَإِنَّ الدِّينَ لَوَاقِعٌ ﴿٦﴾
٥٢٠

- **"Atë ditë, Ne do t'i themi Xhehenemit: "A u mbushe?""** - Aq të shumtë do të jenë ata që do të tërhiqen zvarrë deri në Xhehenem, saqë Xhehenemit do t'i thuhet: "A u mbushe?" E si përgjigjet Xhehenemi?

- **"Ndërsa ai do të thotë: "A ka edhe më?""** - Xhehenemi do të kërkojë shtesë, që të përpijë me zemëratë sa më shumë jobesimtarë dhe të pabindur ndaj Zotit. Ai vlon nga urrejtja për ata që meritojnë dënimin e të Drejtit dhe të Madhërishmit.

Allahu i Madhërishëm ka paralajmëruar se do ta mbushë Xhehenemin plot, siç thotë në një ajet tjetër: "Po të donim Ne, do t'i udhëzonim të gjithë, por fjala Ime ka marrë fund: Do ta mbush Xhehenemin me xhindë e njerëz bashkë!" [Sexhde 13]. Xhehenemi do të vazhdojë të kërkojë shtesë, derisa Zoti i krenarisë dhe madhështisë të vendosë mbi të këmbën e Tij, e cila nuk i përngjan asgjëje

dhe asgjë nuk i përngjan asaj. Atëherë, Xhehenemi do të digjet brenda për brenda vetes dhe do të thotë: "Mjaf! Mjaf! U mbusha! U plotësova!""

- **"Ndërsa besimtarëve të devotshëm u afrohet Xheneti."** – Xheneti do t'u afrohet aq pranë, saqë besimtarët do mund të shohin lehtësisht mirësitë që ndodhen në të. Ai afrohet për hir të devotshmërisë së tyre ndaj Zotit, duke iu larguar *shirk*-ut të madh dhe të vogël, duke zbatuar urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave të Zotit. Duke iu uruar mirëseardhjen, atyre u thuhet:

- "**Ky është premtimi për secilin që është penduar e që ka ruajtur besën e dhënë..."** – Kuptimi: Xheneti, që po e shihni tashmë kaq pranë, me bukuritë që i pëlqen shpirti e syri, është ai që Zoti premtoi për besimtarët që kanë patur disa cilësi. Së pari, ata janë penduar te Zoti i tyre në të gjitha kohët dhe gjendjet, duke i shprehur Atij dashurinë e madhe për Të, që kalon çdo lloj dashurie. Ata e kanë shprehur pendimin e tyre duke e përkujtuar Allahun me adhurime që e kënaqnin Atë, duke iu lutur Atij, të mbushur me drojë e madhërim për Krenarin e Plotfuqishëm dhe me shpresë të madhe për faljen dhe shpërblimin e Bujarit të Gjithëmëshirshëm. Ata kanë qenë gjithmonë të kujdesshëm në ruajtjen e kufijve të Zotit. Ata i kanë plotësuar porositë e Tij me sinqeritet dhe në formën më të plotë të mundshme. Këta besimtarë kanë patur edhe *el hashjetu* ose drojë, siç thotë i Lartësuari:

- **"...që i është druajtur të Gjithëmëshirshmit edhe atëherë kur nuk e shihte kush..."** - *El hashjetu* është droja e bazuar në dijen e plotë rreth Allahut, e cila është e shoqëruar me shpresën për mëshirën e Tij. Pra, ata e kanë patur frikë Zotin e tyre, sepse e njihnin Atë plotësisht, përmes burimeve të sakta të diturisë rreth Tij, por frika e tyre ishte e përzier me një shpresë të madhe për mëshirën, faljen dhe shpërblimin e të Gjithëmëshirshmit.

Por këtu duhet theksuar një tipar shumë i rëndësishëm: ata kanë patur frikë Allahun jo vetëm haptazi, por edhe kur njerëzit e tjerë nuk i shihnin. Kjo është *el hashjetu* e vërtetë, sepse ai që tregohet se e ka frikë Zotin vetëm në prani të njerëzve, ai nuk është i sinqertë, dhe këtë mund ta bëjë për famë dhe dukje. Ky ishte njëri nga kuptimet e ajetit.

Ndërsa kuptimi tjetër është: "...ai që i është druajtur të Gjithëmëshirshmit fshehtazi", pra, që e besoi dhe e pati frikë Zotin, edhe pse nuk e pa Atë haptazi në dynja. Ai e besoi Allahun sikurse besoi në çdo gjë të fshehtë, që nuk e sheh haptazi.

- **"...dhe që është kthyer me zemër tek Allahu."** – Cilësi tjetër e tyre është që kthehen gjithmonë me pendesë, bindje dhe përunjësi tek Allahu i Madhërishëm. Ata i shpenzojnë të gjitha energjitë e tyre për të kënaqur Zotin. Këtyre robërve të devotshëm dhe vepërmirë u thuhet:

- **"Hyni në paqe dhe të sigurt..."** - Hyni të shoqëruar me paqe dhe të ruajtur nga çdo gjë e keqe. Atje do të jeni të sigurt nga çdo gjë që i frikësoheni. Atje nuk do të kenë fund mirësitë dhe lumturia juaj, nuk do të ketë lodhje, trishtim dhe asnjë lloj shqetësimi për ju.

- **"...se kjo është dita e përjetësisë."** – Kjo është dita pas së cilës nuk ka vdekje, nuk ka

fund dhe as mundime dhe trishtime për të devotshmit.

- "**Atje kanë çfarë të dëshirojnë, por prej Nesh ka edhe më tepër."** - Të devotshmit do të kenë atje çfarë të dëshirojnë, madje edhe më shumë se kaq. Ata do të kënaqen me mirësitë që Mëshiruesi u ka premtuar, mirësi që as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe as zemra nuk i ka ëndërruar. Madje, do të kenë edhe më shumë se kaq. Atje do të shohin fytyrën e Allahut Bujar dhe të Lartësuar dhe do të lumturohen duke dëgjuar fjalën e Tij. Ata do të kënaqen përjetësisht me praninë e Krijuesit të gjithësisë. E lusim Allahun e Lartësuar të na bëjë prej tyre!

Ajetet 36 – 37

36. Sa e sa breza kemi shkatërruar para tyre, të cilët ishin shumë më të fortë e më të pushtetshëm se këta! Ata u përhapën nëpër tokë, por a gjetën shpëtim?!
37. Të gjitha këto janë fakte për cilindo që ka zemër, që dëgjon me vëmendje dhe dëshmon.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar u drejton një kërcënim të gjithë idhujtarëve, që mohojnë dhe nuk pasojnë udhëzimin e sjellë prej profetëve:

- **"Sa e sa breza kemi shkatërruar para tyre, të cilët ishin shumë më të fortë e më të pushtetshëm se këta!"** - Sa popuj kanë kaluar para këtyre, të cilët ishin edhe më të fuqishëm dhe të pushtetshëm se këta të sotmit. Ata lanë gjurmë të shumta, më të dukshme dhe më të mëdha në këtë botë.

- **"Ata u përhapën nëpër tokë, por a gjetën shpëtim?!"** - Ata pushtuan shumë vende, ndërtuan kështjella e ndërtesa të larta, me plantacione dhe lumenj. Por ata përhapën edhe shkatërrimin. Kështu, kur mohuan profetët e Zotit dhe shpërfillën udhëzimet e Tij, ata u goditën nga ndëshkimi i rëndë e poshtërues. As pushteti dhe pasuria, as fëmijët dhe ushtritë e tyre nuk mundën t'i shpëtonin nga vdekja dhe ndëshkimi i të Madhërishmit. Asgjë nuk mund ta ndalonte ndëshkimin e të Plotfuqishmit mbi ta. Kësisoj, le të shërbejnë ata si shembull për çdo brez që vjen në këtë botë.

- **"Të gjitha këto janë fakte për cilindo që ka zemër, që dëgjon me vëmendje dhe dëshmon."** - Këto fakte janë të vlefshme për çdo njeri që ka zemër të gjallë, të madhe, të pastër e të shëndetshme. Të tillë njerëz, kur dëgjojnë faktet e Zotit, reflektojnë, përkujtojnë, nxjerrin mësime dhe lartësohen në grada te Zoti i tyre.

Këto fakte janë të vlefshme edhe për njerëzit që i dëgjojnë me vëmendje ato, të përqendruar me zemrën e tyre. Për të gjithë këta, ky Kuran është mësim, shërim, përkujtim, udhëzim dhe mëshirë.

Ndërsa ata që i kthejnë shpinën udhëzimit dhe nuk iu vënë veshin ajeteve të Zotit, ata nuk përfitojnë gjë prej tyre. Të tillët nuk e pranojnë udhëzimin dhe urtësia e Allahut nuk e ka përcaktuar që ata të udhëzohen.

Ajetet 38 – 40

38. Ne krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh, pa ndier aspak lodhje.
39. Por t'i ji i durueshëm ndaj fjalëve të tyre dhe madhëroje Zotin tënd në agim dhe në muzg!
40. Edhe në një pjesë të natës madhëroje Atë, ashtu si edhe pas namazeve!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka që gjendet ndërmjet tyre brenda gjashtë ditësh..."** - Allahu i Lartësuar na tregon për pushtetin e Tij madhështor dhe të padiskutueshëm, me të cilin i krijoi të gjitha krijesat. Ai i krijoi ato për gjashtë ditë. Dita e parë e krijimit ishte e diela dhe e fundit ishte dita e xhuma.

- **"...pa ndier aspak lodhje."** - Me gjithë madhështinë e këtyre krijesave, Allahu i Lartësuar nuk pati lodhje dhe aspak vështirësi. Atëherë, Ai që i bëri këto krijime madhështore pa asnjë vështirësi dhe lodhje, Ai është i Plotfuqishëm që t'i ringjallë të vdekurit.

- **"Por t'i ji i durueshëm ndaj fjalëve të tyre dhe madhëroje Zotin tënd në agim dhe në muzg! Edhe në një pjesë të natës madhëroje Atë, ashtu si edhe pas namazeve!"** - Ji i durueshëm ndaj fyerjeve që të bëjnë, si dhe ndaj mohimit të fesë që solle prej Zotit tënd! Përqendrohu në adhurime dhe *tesbih* për Zotin tënd, në fillim të ditës dhe në fund të saj. Po kështu vepro edhe gjatë natës dhe në përfundim të çdo namazi.

Pa dyshim, përkujtimi dhe angazhimi me adhurimin e Allahut e ngushëllon dhe i sjell qetësi shpirtit. Adhurimet e lehtësojnë dhe forcojnë durimin.

Ajetet 41 – 45

41. **Dëgjo thirrësin, kur ai të thërrasë nga ndonjë vend i afërt!**
42. **Dita kur të dëgjohet thirrja për të vërtetën, është dita e daljes.**
43. **Sigurisht, Ne e japim jetën dhe vdekjen dhe vetëm tek Ne është kthimi.**
44. **Ditën kur toka të çahet e ata të nguten për të dalë, tubimi do të jetë i lehtë për Ne.**
45. **Ne e dimë shumë mirë se çfarë thonë ata, ndërsa t'i nuk mund t'i detyrosh dot. Ti përkujto me këtë Kuran atë që i druhet kërcënimit Tim!**

Shpjegimi i ajeteve

- **"Dëgjo thirrësin, kur ai të thërrasë nga ndonjë vend i afërt!"** - Dëgjo me zemrën tënde, kur Israfili t'i fryjë Surit. Kjo do të ndodhë në një vend pranë krijesave, jo larg tyre.

- **"Dita kur të dëgjohet thirrja për të vërtetën, është dita e daljes."** - Atë ditë, të gjithë do ta dëgjojnë atë zë rrëqethës, që lajmëron për të vërtetën, që është Dita e Llogarisë. Kjo është dita e daljes nga varret. Vetëm i Madhërishmi është Ai që ka zotësinë për të bërë ringjalljen, askush tjetër. Prandaj i Madhëruari thotë:

- **"Sigurisht, Ne e japim jetën dhe vdekjen dhe vetëm tek Ne është kthimi."** - Vetëm Allahu mund të japë jetën dhe vdekjen dhe të gjithë tek Ai do të kthehen një ditë. Ajo është dita kur toka do të çahet, që prej saj të dalin ata që janë varrosur në të, siç thotë i Lartësuari:

- **"Ditën kur toka të çahet e ata të nguten për të dalë..."** - Të vdekurit do të dalin me nxitim nga varret e tyre, për të shkuar në vendin ku do të gjykohen. Ai që i krijoi dhe ua dha jetën, Ai ua solli edhe vdekjen, dhe në ditën e caktuar do t'i tubojë para Tij, për llogarinë dhe shpërblimin me drejtësi. Allahu është i Afti për gjithçka.

- **"...tubimi do të jetë i lehtë për Ne."** - Kjo është diçka e thjeshtë për të Plotfuqishmin dhe nuk e lodh aspak Atë.

- **"Ne e dimë shumë mirë se çfarë thonë ata..."** - Allahu i Lartësuar ka dijeni të plotë rreth çdo fjale me të cilat idhujtarët të mundojnë ty! Por mjafton që t'i, o i Dërguar, të kujtosh kujdesin Tonë të madh për ty, lehtësimin e punëve të tua dhe fitoret që të kemi dhuruar kundër armiqve të t'u, në mënyrë që zemra jote të gëzohet dhe shpirti yt të gjejë prehje dhe qetësi. Kujtoje faktin që Allahu i Lartësuar është më i mëshirshëm dhe më i dashur për ty sesa t'i për veten tënde! Për ty nuk mbetet gjë tjetër, veçse të plotësohet premtimi i Allahut dhe pasimi i traditës së profetëve më të zgjedhur.

- **"...ndërsa t'i nuk mund t'i detyrosh dot."** - Ti nuk ke fuqi detyruese mbi ta. Ti nuk mund t'i bësh ata të besojnë. Ti je thjesht një këshillues dhe përkujtues.

- **"Ti përkujto me këtë Kuran atë që i druhet kërcënimit Tim!"** - Përkujtimi bëhet për diçka që është e njohur dhe e pranuar nga natyra njerëzore. Njeriu përkujtohet që të bëjë ato vepra që janë të mira dhe që natyra e pastër e tij i pranon si të tilla. Por ata që përkujtohen realisht, janë ata që i frikësohen kërcënimit të Allahut të Madhërishmit. Ndërsa për ata që nuk i frikësohen Allahut nuk bën dobi asnjë përkujtim. Këtyre njerëzve, përkujtimi thjesht ua zhvlerëson justifikimin ndaj Zotit, prandaj Ditën e Gjykimit nuk mund të thonë që nuk dinin gjë.

Ky ishte edhe fundi i tefsirit të sures Kaf. Falënderimi i takon Allahut të Lartësuar, në fillim dhe në mbarim, haptazi dhe fshehtazi!

Surja 51: Edh Dharijat (mekase) 60 ajete

Ajetet 1 – 6
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!


1. Për erërat, që ngrejnë grimcat dhe i shpërndajnë,
2. për retë e ngarkuara rëndë,
3. për lundruesit, që lëvizin lehtë,
4. për engjëjt, që zbatojnë urdhrat!
5. S'ka dyshim se ajo që u premtohet është e vërtetë e sigurt.
6. S'ka dyshim se gjykimi dhe shpërblimi me drejtësi do të ndodhin!

Shpjegimi i ajeteve

Këto janë betime të rëndësishme prej Allahut të Madhërishëm, i Cili është më i vërteti në betimet e Tij. Ai betohet në këto krijesa madhështore dhe aq të domosdoshme për robërit, për një çështje shumë të rëndësishme: premtimi i Tij për Ditën e Kijametit është i vërtetë dhe llogaria me drejtësi e veprave të robërve nuk ka dyshim se do të ndodhë. Askush nuk mund ta pengojë këtë vendim të Zotit të Madhërishëm.

Kur ky lajm vjen prej të Madhërishmit, të Vërtetit në fjalët e Tij dhe, përveç kësaj, Ai betohet në vërtetësinë e kësaj ngjarjeje dhe sjell prova të pamohueshme, që tregojnë pushtetin dhe dijen e Tij absolute, atëherë si mundet që këtë fakt ta mohojë dikush; si mundet që dikush të mos nënshtrohet dhe të mos punojë i bindur ndaj të Madhërishmit?!

- *El dharijat* janë erërat e lehta, që me butësi dhe shpejtësi transportojnë pjalmin dhe kokrriza të ndryshme nëpër tokë, duke bërë një punë shumë të madhe, që njeriu nuk do të mundej kurrë ta bënte.


الجزء السادس والعشرون سورة الذاريات

وَٱلسَّمَآءِ ذَاتِ ٱلْحُبُكِ ۝٧ إِنَّكُمْ لَفِى قَوْلٍ مُّخْتَلِفٍ ۝٨ يُؤْفَكُ عَنْهُ مَنْ
أُفِكَ ۝٩ قُتِلَ ٱلْخَرَّٰصُونَ ۝١٠ ٱلَّذِينَ هُمْ فِى غَمْرَةٍ سَاهُونَ ۝١١ يَسْـَٔلُونَ
أَيَّانَ يَوْمُ ٱلدِّينِ ۝١٢ يَوْمَ هُمْ عَلَى ٱلنَّارِ يُفْتَنُونَ ۝١٣ ذُوقُوا۟ فِتْنَتَكُمْ
هَٰذَا ٱلَّذِى كُنتُم بِهِۦ تَسْتَعْجِلُونَ ۝١٤ إِنَّ ٱلْمُتَّقِينَ فِى جَنَّٰتٍ وَعُيُونٍ
ءَاخِذِينَ مَآ ءَاتَىٰهُمْ رَبُّهُمْ ۚ إِنَّهُمْ كَانُوا۟ قَبْلَ ذَٰلِكَ مُحْسِنِينَ ۝١٦
كَانُوا۟ قَلِيلًا مِّنَ ٱلَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ ۝١٧ وَبِٱلْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ ۝١٨
وَفِىٓ أَمْوَٰلِهِمْ حَقٌّ لِّلسَّآئِلِ وَٱلْمَحْرُومِ ۝١٩ وَفِى ٱلْأَرْضِ ءَايَٰتٌ
لِّلْمُوقِنِينَ ۝٢٠ وَفِىٓ أَنفُسِكُمْ ۚ أَفَلَا تُبْصِرُونَ ۝٢١ وَفِى ٱلسَّمَآءِ رِزْقُكُمْ
وَمَا تُوعَدُونَ ۝٢٢ فَوَرَبِّ ٱلسَّمَآءِ وَٱلْأَرْضِ إِنَّهُۥ لَحَقٌّ مِّثْلَ مَآ أَنَّكُمْ
تَنطِقُونَ ۝٢٣ هَلْ أَتَىٰكَ حَدِيثُ ضَيْفِ إِبْرَٰهِيمَ ٱلْمُكْرَمِينَ ۝٢٤ إِذْ
دَخَلُوا۟ عَلَيْهِ فَقَالُوا۟ سَلَٰمًا ۖ قَالَ سَلَٰمٌ قَوْمٌ مُّنكَرُونَ ۝٢٥ فَرَاغَ إِلَىٰٓ
أَهْلِهِۦ فَجَآءَ بِعِجْلٍ سَمِينٍ ۝٢٦ فَقَرَّبَهُۥٓ إِلَيْهِمْ قَالَ أَلَا تَأْكُلُونَ
فَأَوْجَسَ مِنْهُمْ خِيفَةً ۖ قَالُوا۟ لَا تَخَفْ ۖ وَبَشَّرُوهُ بِغُلَٰمٍ عَلِيمٍ ۝٢٨
فَأَقْبَلَتِ ٱمْرَأَتُهُۥ فِى صَرَّةٍ فَصَكَّتْ وَجْهَهَا وَقَالَتْ عَجُوزٌ عَقِيمٌ
قَالُوا۟ كَذَٰلِكِ قَالَ رَبُّكِ ۖ إِنَّهُۥ هُوَ ٱلْحَكِيمُ ٱلْعَلِيمُ ۝٣٠

٥٢١

- *El hamilati uikra* janë retë e zeza të rënda, që bartin ujin, aq të domosdoshëm për jetën e tokës dhe të gjitha krijesave.
- *El xharijati jusra* janë yjet, që lundrojnë me lehtësi dhe hijeshi në rrugën e tyre. Me këto yje, Allahu i Urtë zbukuron qiellin, ndërsa robërit orientohen gjatë natës, në tokë dhe në det. Ato dëshmojnë për madhështinë e Krijuesit të tyre, për diturinë dhe pushtetin e Tij të pamatë.
- *El mukassimati* janë melekët, të cilët, me lejen e Zotit, zbatojnë të gjitha urdhrat e Tij. Secilin prej engjëjve, Zoti i Madhëruar e ka ngarkuar me një detyrë të caktuar të dynjasë ose të ahiretit. Askush prej tyre nuk e tejkalon kufirin dhe nuk i cenon urdhrat e të Madhërishmit, por i zbaton ato me përpikmëri.

Ajetet 7 – 9

7. **Për qiellin plot hulli!**

8. **Ju vërtet jeni zhytur në gjithfarë mendimesh kontradiktore.**

9. **Nga ai largohen ata që shpërfillin të vërtetën.**

Shpjegimi i ajeteve

- **"Për qiellin plot hulli!"** – Si hullitë që krijojnë valëzimet e rërës apo të ujit, prej një flladi të lehtë.

- **"Ju vërtet jeni zhytur në gjithfarë mendimesh kontradiktore."** - Ju që mohoni Muhamedin (a.s.) keni kundërshti në fjalët dhe mendimet që shfaqni për të. Disa thonë se ai është magjistar, disa thonë se është fallxhor, disa thonë se ai është i çmendur etj., qëndrime kontradiktore, që dëshmojnë për paqartësinë e tyre. Kjo paqartësi tregon se pretendimet e tyre janë të pabaza e të paarsyeshme.

- **"Nga ai largohen ata që shpërfillin të vërtetën."** - Prej tij largohen ata që shpërfillin imanin, duke e penguar zemrën që të ndriçohet nga argumentet e pamohueshme të Zotit. Qëndrimet e tyre kontradiktore rreth Muhamedit (a.s.) dëshmojnë për pasaktësinë e tyre, përkundër të vërtetës që solli Muhamedi (a.s.), e cila është në harmoni të plotë me vetveten. Fjalët dhe udhëzimet e tij sqarojnë e vërtetojnë njëra tjetrën. Kjo tregon për vërtetësinë e tyre dhe për faktin se ato janë shpallje e Allahut të Lartësuar, sikurse thotë i Lartësuari: "...A nuk meditojnë me kujdes në Kuranin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, jo prej Allahut, do të gjenin shumë kundërthënie në të." [Nisa 82].

Ajetet 10 – 14

10. **Mallkuar qofshin gënjeshtarët,**

11. ata të cilët janë të zhytur në humbje dhe të çoroditur!
12. Ata pyesin: "Kur është Dita e Gjykimit?"
13. Ajo është dita kur ata do të digjen në zjarr!
14. "Shijojeni dënimin tuaj! Ky është ai që e kërkonit t'ju shpejtohej!"

Shpjegimi i ajeteve

- **"Mallkuar qofshin gënjeshtarët, ata të cilët janë të zhytur në humbje dhe të çoroditur!"** – Janë të mallkuar ata që trillojnë gënjeshtra për Allahun dhe refuzojnë padrejtësisht faktet e Tij. Ata zhyten tërësisht në të kotën dhe me këtë synojnë të mposhtin dhe të fshehin të vërtetën. Ata thonë rreth Allahut gjëra për të cilat nuk kanë dijeni. Ata gjenden mes dallgëve të errëta të kufrit, paditurisë rreth Zotit dhe të harruar në skutat e humbjes.

- **"Ata pyesin: "Kur është Dita e Gjykimit?"" -** Duke shprehur mosbesimin e tyre, ata pyesin se kur do të jetë dita e ringjalljes së tyre. Kështu duan të tregojnë se ajo u duket shumë e pabesueshme. Për këtë arsye, mos pyet se si do të jetë përfundimi i tyre! Sa i shëmtuar dhe i tmerrshëm do të jetë vendqëndrimi i tyre!

- **"Ajo është dita kur ata do të digjen në zjarr! "Shijojeni dënimin tuaj! Ky është ai që e kërkonit t'ju shpejtohej!"" -** Për shkak të poshtërsisë që i karakterizon, ata do të ndëshkohen. Atyre do t'u thuhet: "Shijojeni ndëshkimin në Zjarr!" Ky është përfundim i merituar për veprat e tyre. Ata nuk i kaluan sprovat e dynjasë, por ranë në kufër dhe humbje. Ky ndëshkim është pikërisht ai që ata e kërkojnë t'u përshpejtohet në dynja, në shenjë mosbesimi ndaj tij. Prandaj u thuhet: "Kënaquni" me të gjitha llojet e ndëshkimit, me pranga e zinxhirë, në zemërimin e të Plotfuqishmit!

Ajetet 15 – 19

15. Vërtet, të devotshmit janë mes kopshteve e burimeve.
16. Ata marrin atë që u jep Zoti i tyre. Në fakt, ata ishin vepërmirë edhe më parë.
17. Ata flinin pak natën,
18. ndërsa në agim, ata kërkonin falje.
19. Në pasurinë e tyre kishin përcaktuar pjesë për lypësit dhe për nevojtarët.

Shpjegimi i ajeteve

Duke përshkruar shpërblimin e të devotshmëve dhe veprat e tyre të mrekullueshme, të cilat u bëjnë shkak për të fituar këtë shpërblim, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Vërtet, të devotshmit janë mes kopshteve e burimeve."** - Ata të cilët si shenjë dalluese të tyre kanë *takua*-n, pra, adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut, ata do të jenë në kopshte të mbushura me të gjitha llojet e pemëve, me fruta që kanë shembull në këtë dynja, por edhe me fruta të cilat nuk kanë shembull në këtë dynja. Atje do të gjejnë atë që sytë nuk e kanë parë, veshët nuk e kanë dëgjuar dhe mendjet as kanë mundur ta përfytyrojnë. Ata, gjithashtu, do të jenë pranë burimesh, që gurgullojnë e ujisin kopshtet e bukura dhe prej të cilëve do të pinë. Ata mund t'i bëjnë këto burime që të burojnë dhe vërshojnë ku të dëshirojnë.

- **"Ata marrin atë që u jep Zoti i tyre."** - Kjo fjali mund të kuptohet në dy mënyra:

1. Zoti u dhuron Xhenetin, me gjithçka që ata dëshironin dhe nga të gjitha llojet e mirësive. Ata i marrin këto mirësi duke qenë plotësisht të kënaqur. Do të kënaqen sytë e tyre me atë që shohin, do të kënaqet shpirti i tyre me atë që përjetojnë dhe kurrë nuk do të kërkojnë që të largohen nga ai vend apo që t'u zëvendësohet me diçka tjetër. Çdokush do marrë aq shumë mirësi, saqë nuk do të mendojë kurrë për më tepër.
2. Në jetën e dynjasë, ata i marrin në konsideratë urdhrat dhe ndalesat e Zotit të tyre, duke i pranuar ato me kënaqësi, nënshtrim dhe përkushtim të plotë. Sa u përket urdhëresave, ata përkushtohen maksimalisht për t'i vënë në zbatim në formën më të plotë, me sinqeritet për Allahun dhe sipas traditës së Profetit të Tij. Edhe sa u përket ndalesave, ata e largojnë veten me forcë e durim prej tyre. Sigurisht, porositë e Zotit jetën e dynjasë janë dhurata më e madhe që Ai u ka dhënë, prandaj është e detyrueshme mirënjohja e tyre ndaj Tij, duke iu nënshtruar me bindje e vullnet të plotë.

Kuptimi i parë është më afër kontekstit të ajeteve, sepse Allahu i Lartësuar i përmend më poshtë veprat dhe cilësitë e të devotshmëve në dynja, kur thotë:

- "Në fakt, ata ishin vepërmirë edhe më parë." - Ata ishin vepërmirë para se të vinte momenti kur të shijonin këto dhurata prej Zotit. Në jetën e dynjasë, ata e arrijnë gradën e *ihsan*-it në dy drejtime:
1. Në drejtim të adhurimit të përkushtuar ndaj Zotit të tyre, duke e adhuruar Atë sikur ta shihnin haptazi me sy, pasi edhe pse nuk e shohin, ata janë të sigurt se Ai i sheh. Ata e kanë vazhdimisht ndjesinë e mbikëqyrjes së Allahut.
2. Në drejtim të bamirësisë ndaj krijesave të Zotit, duke qenë njerëzit më të dobishëm ndaj krijesave. Ata janë bamirës me pasurinë e tyre, me diturinë e tyre, me famën dhe pushtetin e tyre, me këshillat e tyre, me urdhërimin për të mirë, me ndalimin nga të këqijat etj. Këtu futen, gjithashtu, fjala e mirë dhe e butë, sjellja e mëshirshme ndaj skllevërve, shërbëtorëve, vartësve etj.
Ndër veprat më të mira të këtyre robërve të zgjedhur të Allahut është edhe namazi i natës, i cili është treguesi më i qartë i sinqeritetit të tyre në adhurimin e Allahut të Madhërishëm, prandaj i Madhëruari thotë:

- "Ata flinin pak natën..." - Ata flenë pak natën, sepse pjesën më të madhe të saj e kalojnë me adhurim. Gjatë natës, ata i gjen duke lexuar Kuran, duke falur namaz, duke bërë *dhikër dua* e duke iu lutur Zotit të tyre.

- "...ndërsa në agim, ata kërkonin falje." – Pra, në *es'har*, në çastet pak para hyrjes së kohës së sabahut, ata i kërkojnë falje Zotit të tyre. Ata e zgjasin namazin e natës deri pranë kësaj kohe, pastaj ulen dhe i kërkojnë falje Zotit, ashtu siç kërkon falje i ngarkuari me faj.

Kërkimi i faljes në këtë kohë ka një rëndësi të jashtëzakonshme dhe është tepër i veçantë. Kjo është cilësi e besimtarëve të sinqertë, siç i përshkruan Allahu i Madhërishëm kur thotë: "Ata të cilët thonë: "Zoti ynë, ne sinqerisht besuam, na i fal gjynahet tona dhe na ruaj prej ndëshkimit të Zjarrit"! Dhe ata që janë të durueshëm, të drejtë, të devotshëm e dorëdhënës dhe ata të cilët në kohën e agimit, kërkojnë ndjesë."" [Al Imran 16, 17].

- **"Në pasurinë e tyre kishin përcaktuar pjesë për lypësit dhe për nevojtarët." -** Prej pasurisë së tyre, ata heqin mënjanë pjesën e detyrueshme apo të pëlqyeshme për t'u hequr, për ta shpenzuar atë në bamirësi, për lypësit dhe për nevojtarët që nuk kërkojnë nga njerëzit.

Ajetet 20 – 23


20. Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje,
21. por edhe në vetet tuaja! A nuk i shihni, vallë?
22. Në qiell është furnizimi juaj dhe ato që ju premtohen.
23. Për Zotin e qiellit e të Tokës, kjo është një e vërtetë, ashtu siç është e vërtetë që ju flisni!

Shpjegimi i ajeteve

Duke i ftuar robërit e Tij të meditojnë dhe të marrin mësim, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Në Tokë ka shenja për ata që besojnë me bindje, por edhe në vetet tuaja! A nuk i shihni, vallë?" – Në shenjat e Tokës përfshihet gjithçka që gjendet në të, si detet, malet, lumenjtë, pemët, bimët. Të gjitha këto i tregojnë çdokujt që kërkon të nxjerrë mësime për madhështinë e Krijuesit të tyre, për gjerësinë dhe gjithëpërfshirjen e pushtetit dhe sundimit të Tij. Ato dëshmojnë për bamirësinë e pakufishme dhe për dijen absolute të Allahut.

Gjithashtu, edhe vetë njeriu është dëshmi e urtësisë, dijes dhe mëshirës së madhe të Krijuesit. Allahu është Një dhe i Vetëm. Ai është *El Samed*, të Cilit të gjitha krijesat i drejtohen me lutje dhe për ndihmë. Këto krijesa të mrekullueshme tregojnë se Zoti i ka krijuar ato për një qëllim të madh.


الجزء السابع والعشرون سورة الذاريات
الجزء ٢٧ الجزء ٥٣
* قَالَ فَمَا خَطْبُكُمْ أَيُّهَا الْمُرْسَلُونَ ﴿٣١﴾ قَالُوا إِنَّا أُرْسِلْنَا إِلَىٰ قَوْمٍ
مُجْرِمِينَ ﴿٣٢﴾ لِنُرْسِلَ عَلَيْهِمْ حِجَارَةً مِنْ طِينٍ ﴿٣٣﴾ مُسَوَّمَةً عِنْدَ رَبِّكَ
لِلْمُسْرِفِينَ ﴿٣٤﴾ فَأَخْرَجْنَا مَنْ كَانَ فِيهَا مِنَ الْمُؤْمِنِينَ ﴿٣٥﴾ فَمَا وَجَدْنَا
فِيهَا غَيْرَ بَيْتٍ مِنَ الْمُسْلِمِينَ ﴿٣٦﴾ وَتَرَكْنَا فِيهَا آيَةً لِلَّذِينَ يَخَافُونَ
الْعَذَابَ الْأَلِيمَ ﴿٣٧﴾ وَفِي مُوسَىٰ إِذْ أَرْسَلْنَاهُ إِلَىٰ فِرْعَوْنَ بِسُلْطَانٍ
مُبِينٍ ﴿٣٨﴾ فَتَوَلَّىٰ بِرُكْنِهِ وَقَالَ سَاحِرٌ أَوْ مَجْنُونٌ ﴿٣٩﴾ فَأَخَذْنَاهُ وَجُنُودَهُ
فَنَبَذْنَاهُمْ فِي الْيَمِّ وَهُوَ مُلِيمٌ ﴿٤٠﴾ وَفِي عَادٍ إِذْ أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمُ الرِّيحَ
الْعَقِيمَ ﴿٤١﴾ مَا تَذَرُ مِنْ شَيْءٍ أَتَتْ عَلَيْهِ إِلَّا جَعَلَتْهُ كَالرَّمِيمِ ﴿٤٢﴾
وَفِي ثَمُودَ إِذْ قِيلَ لَهُمْ تَمَتَّعُوا حَتَّىٰ حِينٍ ﴿٤٣﴾ فَعَتَوْا عَنْ أَمْرِ رَبِّهِمْ
فَأَخَذَتْهُمُ الصَّاعِقَةُ وَهُمْ يَنْظُرُونَ ﴿٤٤﴾ فَمَا اسْتَطَاعُوا مِنْ قِيَامٍ
وَمَا كَانُوا مُنْتَصِرِينَ ﴿٤٥﴾ وَقَوْمَ نُوحٍ مِنْ قَبْلُ إِنَّهُمْ كَانُوا قَوْمًا
فَاسِقِينَ ﴿٤٦﴾ وَالسَّمَاءَ بَنَيْنَاهَا بِأَيْدٍ وَإِنَّا لَمُوسِعُونَ ﴿٤٧﴾ وَالْأَرْضَ
فَرَشْنَاهَا فَنِعْمَ الْمَاهِدُونَ ﴿٤٨﴾ وَمِنْ كُلِّ شَيْءٍ خَلَقْنَا زَوْجَيْنِ
لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ ﴿٤٩﴾ فَفِرُّوا إِلَى اللَّهِ إِنِّي لَكُمْ مِنْهُ نَذِيرٌ مُبِينٌ ﴿٥٠﴾
وَلَا تَجْعَلُوا مَعَ اللَّهِ إِلَٰهًا آخَرَ إِنِّي لَكُمْ مِنْهُ نَذِيرٌ مُبِينٌ ﴿٥١﴾
٥٢٢

- "Në qiell është furnizimi juaj dhe ato që ju premtohen." - Furnizimi juaj për këtë dynja dhe për botën tjetër, furnizimi trupor dhe shpirtëror, vjen nga qielli. Nga lart vjen shiu dhe çdo caktim i Zotit. Në qiell janë edhe ato që ju premtohen, qofshin ato shpërblime në dynja apo në ahiret.

Kështu, Allahu i Madhërishëm dhe i Urtë, pasi na udhëzoi të nxjerrim mësime nga këto fakte, siç marrin njerëzit e mençur, vijon të betohet se kjo që Ai premton është po aq e vërtetë, sa edhe fakti që ne flasim me njëri-tjetrin. I Plotfuqishmi thotë:

- "Për Zotin e qiellit e të Tokës, kjo është një e vërtetë, ashtu siç është e vërtetë që ju flisni!" - Ashtu sikurse nuk dyshoni në faktin që ju flisni, po kështu duhet të mos dyshoni në vërtetësinë e ringjalljes.

Ajetet 24 – 37

24. **A e ke dëgjuar ngjarjen me mysafirët e nderuar të Ibrahimit?**
25. **Ata hynë tek ai dhe thanë: "Selami qoftë me ty!" Ai tha: "Selami qoftë gjithnjë me ju, o njerëz të panjohur!"**
26. **Pa u vënë re, ai shkoi te familja e vet, duke sjellë më pas një viç të majmë.**
27. **Pasi ua vuri përpara, u tha: "A nuk po hani tani?!"**
28. **Ai u druajt prej tyre, por ata i thanë: "Mos ki frikë!". Më pas, ata i dhanë sihariqin për një djalë të ditur.**
29. **Gruaja e tij klithi dhe, duke i rënë fytyrës së vet, tha: "Unë jam e moshuar, që nuk mund të lind!"**
30. **Ata i thanë: "Kështu ka thënë Zoti yt, i Cili është i Urti e i Gjithëdijshmi".**
31. **Ai i pyeti: "Cili është misioni juaj, o të dërguar?"**
32. **Ata thanë: "Ne jemi të dërguar për një popull të padrejtë,**
33. **që të hedhim gurë prej balte të pjekur mbi ta,**
34. **të shënuar nga Zoti yt, për secilin nga ata që kishte kaluar kufijtë."**
35. **Ne i larguam të gjithë besimtarët që ishin në atë vend,**
36. **ndonëse aty gjetëm veçse një shtëpi besimtarësh.**
37. **Ne kemi lënë aty shenja për ata që ia kanë frikën dënimit të dhimbshëm.**

Shpjegimi i ajeteve

- "A e ke dëgjuar ngjarjen me mysafirët e nderuar të Ibrahimit? Ata hynë tek ai dhe thanë: "Selami qoftë me ty!" Ai tha: "Selami qoftë gjithnjë me ju, o njerëz të panjohur!"" – Kuptimi: A ke dijeni për ngjarjen e habitshme të Ibrahimit (a.s.) me dy miqtë, që e vizituan atë? Ata ishin melekë të dërguar nga Allahu i Madhërishëm, për të ndëshkuar popullin e Lutit, por që, fillimisht, duhej të vizitonin profetin Ibrahim (a.s.). Ata shkuan tek ai në formën e dy mysafirëve-njerëz.

Pasi hynë në shtëpinë e tij dhe e përshëndetën me selam, ai ua ktheu duke thënë: "Selam edhe për ju, o njerëz të panjohur!" Pra, Ibrahimi (a.s.) nuk i njohu se ishin melekë. Për këtë shkak, ai nxitoi të porosiste familjen e tij që të përgatisnin një viç të majmë të pjekur. Ai u largua si pa u ndier, që t'ua bënte gati sa më shpejt ushqimin.

- "Pa u vënë re, ai shkoi te familja e vet, duke sjellë më pas një viç të majmë. Pasi ua vuri përpara, u tha: "A nuk po hani tani?!" Ai u druajt prej tyre, por ata i thanë:...." - Ai solli një viç të majmë, të gatuar mirë dhe me shije, e u tha: "A nuk po hani tani?" Kur pa që ata nuk po merrnin për të ngrënë, ai u druajt. Atëherë ata, duke e qetësuar, i thanë:

- "Mos ki frikë!". Më pas, ata i dhanë sihariqin për një djalë të ditur." - Ata i dhanë lajmin e gëzueshëm për lindjen e një djali të ditur, që do të ishte Is'haku (a.s.).

- "Gruaja e tij klithi dhe, duke i rënë fytyrës së vet, tha: "Unë jam e moshuar dhe shterpë!"" - Kur gruaja e Ibrahimit (a.s.) dëgjoi sihariqin, klithi nga gëzimi duke goditur fytyrën me dorë. Ky është një veprim i natyrshëm i grave, kur gëzohen tepër. Ato shpesh thonë fjalë, klithin e bëjnë veprime jo të zakonta.

Aty për aty, ajo tha: "Unë jam e vjetër në moshë dhe shterpë. Si të lindë fëmijë një grua si unë, që është shterpë dhe në një

moshë kur nuk mund të bëjë fëmijë?!" Ajo përmendi dy shkaqe, që e bëjnë të pamundur lindjen e fëmijës. Ndërsa në suren Hud, Allahu i Lartësuar na tregon se ajo tha edhe një shkak tjetër: "...burri im është plak...".

- "Ata i thanë: "Kështu ka thënë Zoti yt, i Cili është i Urti e i Gjithëdijshmi"." - Është Allahu i Plotfuqishëm Ai që e përcakton një gjë të tillë. Nuk ka asnjë çudi në caktimet e Zotit tënd. Ai është i Urti, që çdo gjë e vë në vendin që i takon. Ai është i Gjithëdijshmi, që në dijen e Tij ka përfshirë gjithçka. Kështu që, pranojeni caktimin e Allahut dhe tregohuni mirënjohës ndaj Tij.

Më pas, Ibrahimi (a.s.) u tha:

- "Cili është misioni juaj, o të dërguar?" – Kështu, Ibrahimi (a.s.) e ndjeu se ata ishin dërguar nga Zoti për ndonjë çështje të rëndësishme.

- "Ata thanë: "Ne jemi të dërguar për një popull të padrejtë, që të hedhim gurë prej balte të pjekur mbi ta..." – Flitej për popullin e Lutit. Ata ishin idhujtarë e të padrejtë. Ata adhuronin diçka tjetër veç Zotit, mohonin Profetin dhe kryenin një vepër të shëmtuar, të cilën askush para tyre nuk e kishte bërë.

- "...të shënuar nga Zoti yt, për secilin nga ata që kishte kaluar kufijtë." - Çdo gur ishte i shënuar dhe i adresuar se kë do të vriste. Në çdo gur ishte shenja dalluese e viktimës së tij.

Ata, vërtet, i kishin kaluar kufijtë. Megjithatë, Ibrahimi (a.s.) filloi të diskutonte me engjëjt-mysafirë për ndonjë falje të mundshme për popullin e Lutit. Por Allahu i Lartësuar tha: "O Ibrahim, lëre këtë (diskutim), se urdhri i Zotit tënd tashmë ka zbritur. Pa dyshim, ata do të vuajnë një dënim të pashmangshëm." [Hud 74 - 76]. Dhe ashtu ndodhi:

- "Ne i larguam të gjithë besimtarët që ishin në atë vend, ndonëse aty gjetëm veçse një shtëpi besimtarësh." - Ishte shtëpia e Lutit (a.s.), nga e cila përjashtohej gruaja e tij, sepse bënte pjesë tek të ndëshkuarit.

- "Ne kemi lënë aty shenja për ata që ia kanë frikën dënimit të dhimbshëm." - Në ato vise ka shenja, të cilat mund të shërbejnë si mësim për ata që dinë të nxjerrin mësime, për ata që e kuptojnë se Allahu i Lartësuar e ka ndëshkimin tepër të ashpër, për ata që e kuptojnë se profetët kanë thënë të vërtetën dhe se Allahu e ka përforcuar të vërtetën e sjellë prej tyre.

Disa mësime të nxjerra nga kjo histori.

Në rrëfimet e sjella nga Allahu i Lartësuar për ndodhitë e të mirëve dhe të këqijve dhe përfundimet e tyre, ka urtësi të shumta.

Kështu, në këto ajete del qartë rëndësia dhe grada e lartë e Ibrahimit (a.s.). Allahu i Lartësuar e filloi këtë histori duke folur për Ibrahimin (a.s.). Ai ishte pjesë e një ngjarjeje të madhe, prej së cilës duhet të nxjerrim shumë mësime.

- Së pari, mikpritja dhe nderimi i mikut është një virtyt i lartë. Kjo ishte tradita e të dashurit të Zotit, Ibrahimit (a.s.), për pasimin e së cilës Allahu i Lartësuar urdhëroi Muhamedin (a.s.) dhe ymetin e tij. Allahu i Lartësuar e përmendi mikpritjen e Ibrahimit (a.s.) në një kontekst lavdërimi.

- Miku duhet nderuar me fjalë dhe me vepra. Allahu i Lartësuar i përcaktoi miqtë e Ibrahimit si "të nderuar". Ata ishin të nderuar nga Ibrahimi (a.s.), me mikpritjen e tij shembullore, të cilën Zoti e tregoi imtësisht. Ai tregoi në detaje se si Ibrahimi (a.s.) i nderoi miqtë e tij, me fjalë dhe me vepra. Por ata ishin të nderuar edhe nga vetë Zoti i Lartësuar.
- Shtëpia e Ibrahimit (a.s.) ishte një bujtinë e hapur për çdo udhëtar dhe mik. Për këtë arsye, ata hynë brenda pa pyetur e pa kërkuar leje, por thjesht përshëndetën me selam, për mirësjellje. Edhe Ibrahimi (a.s.) ua ktheu me një përshëndetje më të mirë, duke i thënë: "Selami qoftë gjithnjë me ju!"
- Nga ajeti kuptojmë se lejohet prezantimi me ata që të vizitojnë apo me të cilët ke krijuar njëfarë lidhjeje, sepse kjo mund të sjellë mirësi të shumta.
- Edukata e Ibrahimit (a.s.) dhe kujdesi i tij në përzgjedhjen e fjalëve më të mira ishte i madh. Ai u tha atyre: "...o njerëz të panjohur në këto anë...", dhe nuk u tha: "Unë nuk ju njoh ju". Sigurisht që mes dy rasteve ka ndryshim të dukshëm.
- Nga ngjarja mësojmë se duhet të nxitojmë në nderimin e mikut. Bamirësia më e çmuar është ajo që kryhet më së shpejti. Prandaj Ibrahimi (a.s.) nxitoi që t'u shtronte menjëherë tryezën mysafirëve të tij.
- Nderimi i mikut me një ushqim që është i gatshëm, para se miku të vijë, pasi ndoshta është përgatitur për të tjerë, nuk konsiderohet aspak si mungesë respekti për mikun. Allahu i Lartësuar i konsideroi mysafirët e Ibrahimit (a.s.) si miq plotësisht "të nderuar".
- Ne mësojmë gjithashtu për begatitë e mëdha që Allahu i Lartësuar i pati dhënë Ibrahimit. Kjo duket në faktin që ai e kishte viçin gati, madje edhe të gatuar, pa pasur nevojë të shkonte në treg, ta merrte nga fqinjët apo diku tjetër.
- Vërë re se ishte vetë Ibrahimi (a.s.) që u shërbeu miqve, ndërkohë që ai ishte i dashuri i Mëshiruesit. Me këtë, ai dëshmoi se ishte shembulli më i mirë i nderimit të mikut.

Ibrahimi (a.s.) ua afroi ushqimin mysafirëve në vendin ku ishin ulur ata dhe nuk ua shtroi diku tjetër e t'u thoshte "Ejani të hani!". Ai zgjodhi atë gjë që ishte më e thjeshtë dhe më e rehatshme për ta.
- Përzgjedhja e fjalëve me mikun, sidomos në momentin kur u ofron ushqimin. Ibrahimi (a.s.) zgjodhi fjalët më të mira, duke u thënë: "A nuk po hani tani?". Kështu, njeriu duhet të përzgjedhë fjalët më të mira për të ftuar mikun në ushqim, për shembull, të thotë: "A nuk po na nderoni?" ose: "A nuk po urdhëroni?" e të tjera si këto.
- Nëse dikush frikësohet për ndonjë shkak të caktuar, duhet që t'ia largosh atë frikë duke i folur e duke e sqaruar, sikurse vepruan melekët me Ibrahimin (a.s.), kur i thanë: "Mos u frikëso!", dhe më pas i dhanë lajmin e gëzueshëm.
- Gëzimi i madh i Sarës, gruas së Ibrahimit (a.s.), aq sa bëri disa veprime të pazakonta.
- Mirësia e madhe që Allahu i Lartësuar i dhuroi Ibrahimit (a.s.) dhe Sarës, që ishte djali i tyre i ditur, Is'haku (a.s.).

Ajetet 38 – 40

38. Edhe me Musain, kur Ne e dërguam te Faraoni me fakte të qarta.
39. Por ai, me parinë e vet, ia ktheu shpinën dhe tha: "Është magjistar ose i çmendur!"

40. Prandaj Ne e ndëshkuam atë dhe ushtrinë e tij, duke e hedhur në det. Ai e meritoi këtë!

Shpjegimi i ajeteve

Janë të shumta shenjat dhe mrekullitë që Zoti solli me Musain (a.s.), sidomos kur e dërgoi te Faraoni dhe paria e tij. Në këtë ngjarje ka prova të shumta për ata që i frikësohen ndëshkimit të dhimbshëm të Zotit, ndërsa arrogantët i shohin me mospërfillje ato. Kështu veproi Faraoni me Musain dhe mrekullitë që ai solli. Ai e konsideroi Musain si një magjistar dhe mashtrues, madje e konsideroi si të çmendur. Sipas tij, ishin vetëm dy mundësi se si mund të shihej Musai: ose si magjistar, dhe mrekullitë e tij ishin thjesht mashtrime, ose si i çmendur, dhe gjithçka që thoshte nuk duhej marrë në konsideratë. Ai veproi në këtë mënyrë, edhe pse e dinte shumë mirë se Musai ishte i sinqertë në pretendimin e tij, sikurse thotë i Lartësuari: "Ata e mohuan padrejtësisht Musain, edhe pse ishin të sigurt në veten e tyre për vërtetësinë e tij". Po pse e bënin këtë? Vetëm prej mendjemadhësisë së tyre. Në një ajet tjetër tregohet se Musai (a.s.) i tha Faraonit: "Ti e di shumë mirë se këto mrekulli i solli veçse Zoti i qiejve dhe i Tokës, si prova për njerëzit".

Kështu, Faraoni dhe paria e tij e mohuan Musain dhe i shpërfillën porositë e Zotit të sjella prej tij. Për këtë arsye, Zoti e ndëshkoi në momentet kur ai ishte ende arrogant dhe mohues. Ai e ndëshkoi siç di të ndëshkojë Krenari i Plotfuqishëm.

Ajetet 41 – 42

41. Edhe me Adin, kur Ne lëshuam kundër tyre furtunën shkatërrimtare,
42. e cila nuk la gjë pa e shndërruar në mbeturinë.

Shpjegimi i ajeteve

Ad quhej një popull i njohur shumë i fuqishëm. Kur ata mohuan Profetin e dërguar tek ata, Hudin, Allahu i Lartësuar lëshoi si ndëshkim kundër tyre një erë të fuqishme, që nuk përmbante asnjë të mirë, por vetëm shkatërrim dhe ndëshkim. Kudo ku kaloi, ajo shfarosi gjithçka dhe e shndërroi në pluhur, sikur të mos kishin ekzistuar kurrë. Edhe pse ishin një popull tejet i fuqishëm, si askush tjetër në botë, Zoti i zhduku. Kjo tregon për forcën dhe pushtetin absolut të Allahut të Madhërishëm, të Cilit nuk i shpëton asgjë në gjithësi. Ai e ndëshkon ashpër atë që nuk i bindet dhe nuk kthen rrugë.

Ajetet 43 – 45

43. Edhe me Themudin, kur atyre iu tha: "Kënaquni edhe për pak kohë!"
44. Por ata nga kryelartësia, nuk e respektuan urdhrin e Zotit të tyre, prandaj i kapi rrufeja me shkreptimën e saj, ndërkohë që ata ishin duke e parë.
45. Por nuk mundën as të ngrihen e as të kundërvihen.

Shpjegimi i ajeteve

Edhe në popullin e Themudit, Zoti i Lartësuar dërgoi mrekulli të mëdha me profet Salihun. Por ata e shpërfillën dhe u treguan arrogantë me të. Allahu i Lartësuar u solli si mrekulli devenë që doli nga shkëmbi, por kjo u shtoi veçse mosbindjen dhe rebelimin. Si pasojë, Allahu i Lartësuar e

urdhëroi Profetin e Tij t'i paralajmëronte për dënimin e afërt. Kështu, ata i përfshiu ushtima e madhe, e frikshme dhe shkatërruese. Ata as nuk mundën të ngriheshin për të shpëtuar nga ndëshkimi apo, aq më tepër, të vetëmbroheshin.

Ajeti 46

46. Edhe me popullin e Nuhut, që ishte më parë. Vërtet, ai ishte një popull i prishur.

Shpjegimi i ajetit

Po kështu veproi i Madhërishmi edhe me popullin e Nuhut (a.s.), kur ata e trajtuan Nuhun (a.s.) si gënjeshtar dhe nuk iu nënshtruan porosive të Zotit dhe shkelën kufijtë e Tij. Atëherë, Zoti u lëshoi ujë të papërmbajtur, i cili vërshonte nga çdo drejtim. Kështu, u mbytën të gjithë dhe prej vendbanimeve të tyre nuk mbeti më asgjë. I tillë është ndëshkimi i Zotit për ata që nuk i binden dhe shpërfillin profetët, shpalljet dhe porositë e Tij.

Ajetet 47 – 51

47. Ne e ngritëm qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë.
48. Edhe Tokën e kemi shtruar. Sa shtrues të mirë që jemi Ne!
49. Çdo gjë e kemi bërë në çift, që ju të përkujtoni.
50. Atëherë, nxitoni për tek Allahu! Unë vij tek ju si paralajmërues i qartë prej Tij.
51. Mos adhuroni veç Allahut ndonjë zot tjetër! Unë vij tek ju si paralajmërues i qartë prej Tij.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne e ngritëm qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë." - Është Allahu i Lartësuar Ai që e krijoi qiellin me përpikmëri dhe përkujdeset për të dhe për gjithë krijimin e Tij. Ai e bëri qiellin si çati mbrojtëse për Tokën dhe gjithçka në të. Ai e krijoi gjithë këtë madhështi me forcën dhe pushtetin e Tij të pakufishëm. Është po Allahu që i zgjeron skajet dhe anët e qiejve. Allahu zgjeron, gjithashtu, edhe gjendjen e robërve të Tij, duke i furnizuar. Nuk ka kafshë të fshehur në tokë, në thellësi të oqeanit apo në lartësitë e qiejve dhe të tokës, që Zoti të mos përkujdeset për të, duke i mundësuar gjithçka që i nevojitet.

I Lartësuar dhe larg çdo të mete është Ai, që ka përfshirë me mirësinë dhe begatitë e Tij çdo krijesë. Të pafundme janë begatitë e Allahut, mëshira e të Cilit ka përfshirë të gjitha krijesat.

- "Edhe Tokën e kemi shtruar. Sa shtrues të mirë që jemi Ne!" - Allahu i Lartësuar e bëri Tokën të shtruar, në mënyrë të tillë që njerëzit të mund kërkojnë dhe të arrijnë në të mirësitë e Zotit. Ata me lehtësi mund të ndërtojnë në të, të mbjellin pemë, të pushojnë, të udhëtojnë etj. Vërtet, prej diçkaje të shtruar mund të përfitohet, por nuk është e thënë që përfitimi të jetë i plotë në çdo aspekt. Por Allahu i Lartësuar e shtroi tokën në mënyrë të tillë që përfitimi prej saj të jetë i plotë, prandaj e lavdëroi Veten e Tij për këtë vepër. Ai e shtriu dhe e nënshtroi tokën për robërit e Tij, ashtu si e kërkon urtësia, mëshira dhe bamirësia e Tij.

- "Çdo gjë e kemi bërë në çift, që ju të përkujtoni." - Zoti i Lartësuar e krijoi çdo lloj kafshe në çift, mashkull dhe femër, që ju të përkujtoni të mirat e Tij dhe urtësinë e Tij, për mënyrën si bëri që kafshët të ruajnë vazhdimësinë e tyre. Ai ju mundëson juve


që t'i shfrytëzoni këto të mira dhe të kërkoni prej begative të Tij.

Të gjitha këto shenja të madhështisë, pushtetit, dijes dhe urtësisë së Tij, pa dyshim që nxisin frikërespekt për Zotin dhe kthim tek Ai me pendim dhe nënshtrim. Prandaj i Lartësuari tregon më pas qëllimin përse i përmendi këto shenja madhështore:

- "Atëherë, nxitoni për tek Allahu! Unë vij tek ju si paralajmërues i qartë prej Tij." - Qëllimi është që robërit të rendin të pendohen tek Allahu i Madhëruar, të largohen menjëherë nga çdo gjë që Ai e urren dhe e ka ndaluar, të nxitojnë të zhvendosen nga injoranca drejt dijes, nga kufri në iman, nga mosbindja në bindje, nga hutimi në përkujtim të vazhdueshëm të Zotit. Ai që i plotëson këto kushte ka plotësuar besimin e tij, ka shpëtuar nga çdo gjë së cilës i druhet dhe ka për të arritur gjithçka që e synon dhe e dëshiron.

Kur i frikësohesh diçkaje, nxiton të largohesh prej saj. Por e kundërta ndodh kur ke frikë Zotin. Kur i frikësohesh Zotit, nxiton t'i afrohesh Atij. Vetëm kështu mund të gjesh prehje dhe qetësi. Me afrimin te Zoti arrihet çdo mirësi dhe largohet çdo frikë e pasiguri. Prania e Tij sjell lumturi dhe gëzim. Sa më shumë ta kesh frikë Zotin, aq më shumë nxiton drejt Tij i bindur dhe i nënshtruar, me dashuri për Të dhe duke e madhëruar.

- "Mos adhuroni veç Allahut ndonjë zot tjetër! Unë vij tek ju si paralajmërues i qartë prej Tij." - Unë ju paralajmëroj për një ndëshkim të dhimbshëm prej Zotit, nëse nuk dëgjoni dhe bindeni! Qortimi im është i qartë dhe i kuptueshëm.


الجزء السابع والعشرون سورة الذاريات

كَذَٰلِكَ مَآ أَتَى ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِهِم مِّن رَّسُولٍ إِلَّا قَالُواْ سَاحِرٌ أَوۡ مَجۡنُونٌ ﴿٥٢﴾
أَتَوَاصَوۡاْ بِهِۦۚ بَلۡ هُمۡ قَوۡمٞ طَاغُونَ ﴿٥٣﴾ فَتَوَلَّ عَنۡهُمۡ فَمَآ أَنتَ
بِمَلُومٖ ﴿٥٤﴾ وَذَكِّرۡ فَإِنَّ ٱلذِّكۡرَىٰ تَنفَعُ ٱلۡمُؤۡمِنِينَ ﴿٥٥﴾ وَمَا خَلَقۡتُ
ٱلۡجِنَّ وَٱلۡإِنسَ إِلَّا لِيَعۡبُدُونِ ﴿٥٦﴾ مَآ أُرِيدُ مِنۡهُم مِّن رِّزۡقٖ وَمَآ أُرِيدُ
أَن يُطۡعِمُونِ ﴿٥٧﴾ إِنَّ ٱللَّهَ هُوَ ٱلرَّزَّاقُ ذُو ٱلۡقُوَّةِ ٱلۡمَتِينُ ﴿٥٨﴾
فَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُواْ ذَنُوبٗا مِّثۡلَ ذَنُوبِ أَصۡحَٰبِهِمۡ فَلَا يَسۡتَعۡجِلُونِ
﴿٥٩﴾ فَوَيۡلٞ لِّلَّذِينَ كَفَرُواْ مِن يَوۡمِهِمُ ٱلَّذِي يُوعَدُونَ ﴿٦٠﴾

سورة الطور

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

وَٱلطُّورِ ﴿١﴾ وَكِتَٰبٖ مَّسۡطُورٖ ﴿٢﴾ فِي رَقّٖ مَّنشُورٖ ﴿٣﴾ وَٱلۡبَيۡتِ
ٱلۡمَعۡمُورِ ﴿٤﴾ وَٱلسَّقۡفِ ٱلۡمَرۡفُوعِ ﴿٥﴾ وَٱلۡبَحۡرِ ٱلۡمَسۡجُورِ ﴿٦﴾ إِنَّ
عَذَابَ رَبِّكَ لَوَٰقِعٞ ﴿٧﴾ مَّا لَهُۥ مِن دَافِعٖ ﴿٨﴾ يَوۡمَ تَمُورُ ٱلسَّمَآءُ
مَوۡرٗا ﴿٩﴾ وَتَسِيرُ ٱلۡجِبَالُ سَيۡرٗا ﴿١٠﴾ فَوَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ
﴿١١﴾ ٱلَّذِينَ هُمۡ فِي خَوۡضٖ يَلۡعَبُونَ ﴿١٢﴾ يَوۡمَ يُدَعُّونَ إِلَىٰ نَارِ
جَهَنَّمَ دَعّٗا ﴿١٣﴾ هَٰذِهِ ٱلنَّارُ ٱلَّتِي كُنتُم بِهَا تُكَذِّبُونَ ﴿١٤﴾

٥٢٣

Të vraposh tek Allahu do të thotë të largohesh nga çdo gjë tjetër që adhurohet veç Tij, çfarëdo qofshin ato: puta, idhuj, varre etj. Vrapimi drejt Zotit kërkon që çdo adhurim që Zoti e ka përcaktuar si të tillë t'i përkushtohet Atij dhe vetëm Atij, e askujt tjetër. Vetëm Ai duhet adhuruar me fjalë, vepra dhe ndjenja, duke i shprehur dashurinë, madhërimin dhe nënshtrimin e plotë. Dashuria, frikërespekti, shpresa, pendimi i sinqertë, lutjet, kurbani dhe çdo lloj adhurimi tjetër duhet t'i kushtohen e drejtohen vetëm Allahut, dhe askujt tjetër.

Ajetet 52 – 53

52. Po kështu, edhe ata që ishin më parë, sa herë që u shkonte ndonjë profet, thoshin: "Është magjistar ose i çmendur!"

53. A mos kishin mësuar njëri-tjetrin kështu? Jo, por ata ishin njerëz të degjeneruar.

Shpjegimi i ajeteve

- "**Po kështu, edhe ata që ishin më parë, sa herë që u shkonte ndonjë profet, thoshin: "Është magjistar ose i çmendur!"'** - Idhujtarët dhe mohuesit e Zotit gjithmonë i kanë mohuar profetët e Zotit. Ata kanë fyer dhe shpifur për Zotin dhe profetët e Tij. Ky është zakon i pandryshueshëm i tyre. Prandaj Allahu i Lartësuar e sjell këtë fakt në vëmendjen e Profetit të Tij të dashur, për ta ngushëlluar atë nga trajtimi i vrazhdë dhe jo i denjë që i bëhej nga populli i tij. Çdo profet është fyer dhe trajtuar si magjistar ose si i çmendur.

Allahu i Lartësuar bën një pyetje: Për këto fjalë që përsëriten nga të parët dhe të fundit, a mos ka ndonjë marrëveshje mes tyre, që t'i trajtojnë njëlloj profetët e Zotit?! Por nuk është çudi që ndodh diçka të tillë, sepse ata janë njerëz të prishur.

- **"A mos kishin mësuar njëri-tjetrin kështu? Jo, por ata ishin njerëz të degjeneruar." –** Ata ngjajnë në zemrat e tyre, sepse i kanë të mbushura me kufër dhe degjenerim, prandaj i kanë të ngjashme edhe fjalët e veprat e tyre, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Ata që nuk dinë thonë: "Përse Allahu nuk flet me ne, ose, së paku, të na sillte ndonjë shenjë?!" Po kështu thoshin edhe ata që ishin para tyre. Të ngjashme janë fjalët e tyre. Të ngjashme janë edhe zemrat e tyre. Ne i sqaruam argumentet për një popull që është i sigurt." [Bekare 118].

Nga ana tjetër, të gjithë besimtarët, duke qenë se zemrat e tyre i nënshtrohen të vërtetës pasi e kërkojnë atë, i besojnë menjëherë profetët e Zotit, i respektojnë e i nderojnë ata, iu binden dhe iu nënshtrohen porosive të sjella nga ata prej Zotit të gjithësisë.

Ajetet 54 – 55

54. Atëherë, distancohu prej tyre, pasi t'i nuk fajësohesh për ta!
55. Por t'i përkujto, sepse përkujtimi u bën dobi besimtarëve!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Atëherë, distancohu prej tyre, pasi t'i nuk fajësohesh për ta!"** - Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin e Tij që t'u kthente shpinën dhe të largohej nga mohuesit. Ai duhej t'i shpërfillte ata, duke u përqendruar tërësisht në misionin e tij. Profeti nuk mbante përgjegjësi për gjynahet dhe mohimin e tyre. Ai ishte thjesht një përcjellës dhe sqarues i së vërtetës dhe, si i tillë, ai e plotësoi amanetin e ngarkuar.

- **"Por t'i përkujto, sepse përkujtimi u bën dobi besimtarëve!"** - Përkujtimi është dy llojesh:
1. Përkujtim për diçka që njeriu nuk e di nga ana fetare. Nëpërmjet natyrës së pastër dhe logjikës së papërlyer, njeriu e dëshmon, e do dhe e preferon të mirën. Kështu i ka gatuar Zoti natyrën dhe logjikën e pastër të njeriut: që ta duan e zgjedhin të mirën dhe ta urrejnë e largojnë të keqen. Edhe feja është në përputhje me këtë rregull. Çdo urdhër dhe ndalesë e saj është si një përkujtim për natyrën dhe logjikën e pastër, për të pranuar të mirën, të këndshmen, të dobishmen dhe për të larguar të keqen, të dëmshmen dhe të pistën. Një përkujtim i mirë është ai që sqaron mirë dobitë dhe mirësitë që gjenden

në urdhrat e Zotit, si dhe dëmet dhe të këqijat që gjenden në të ndaluarat e Zotit.
2. Përkujtim për ato gjëra që njihen prej besimtarëve, por për shkak të pakujdesisë dhe shpërqendrimit, ato janë harruar. Allahu i Lartësuar na porosit që të përkujtojmë vazhdimisht, me qëllim që porositë e Tij të mësohen dhe nguliten mirë në zemrën tonë, që të kemi gjithnjë forcë, gjallëri dhe vullnet për të punuar dhe për të arritur shpërblimin. Nëpërmjet përkujtimit, besimtari fiton dhe lartësohet. Kur besimtari ka imanin, frikërespektin e dashurinë për Zotin, ai gjithmonë kthehet i penduar dhe me dëshirë për t'iu nënshtruar sërish Zotit dhe për ta kënaqur Atë. Njeriut me këto cilësi gjithmonë i bën dobi përkujtimi. Ndërsa në mungesë të këtyre cilësive, përkujtimi nuk bën dobi ose dobia është e mangët, në varësi të gjendjes së cilësive. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Ti këshillo atë që këshilla i bën dobi. Do të pranojë ai që ka frikë, e do ta refuzojë ai që është shumë i keq, i cili do të hyjë në Zjarrin e madh, ku nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë." [A'la 9 - 13].

Jobesimtarët janë si puna e tokës shkëmbore, së cilës nuk i vlen aspak uji që i hidhet. Këta lloj njerëzish, çfarëdo argumenti t'u sjellësh, nuk kanë për të besuar, derisa ta shohin ndëshkimin me sytë e tyre.

Ajetet 56 – 58

56. Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, por veç që të më adhurojnë.
57. Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as kërkoj që të më ushqejnë.
58. Allahu, Ai është Furnizuesi i madh e Fuqiploti.

Shpjegimi i ajeteve

- "Unë nuk i krijova xhindët dhe njerëzit për gjë tjetër, por veç që të më adhurojnë." - Ky është qëllimi përse Zoti i krijoi xhindët dhe njerëzit. Pikërisht në funksion të këtij qëllimi, i Lartësuari i dërgoi të gjithë profetët.

Adhurimi i Allahut mund të realizohet veçse duke e njohur Atë ashtu si është, dhe kjo sjell dashurinë për Të. Sa më mirë ta njohësh Zotin, aq më shumë do ta duash Atë, aq më shumë do të kthehesh tek Ai i penduar dhe i nënshtruar, aq më shumë do të largohesh nga çdo gjë tjetër e kotë. Sa më mirë ta njohësh Zotin, aq më i plotë do të jetë adhurimi kushtuar Atij.

Për këtë qëllim i bëri Zoti krijesat e përgjegjshme ligjërisht: që ta njohin, ta duan dhe ta adhurojnë vetëm Atë, me madhërim e frikërespekt. Allahu nuk i krijoi ata për ndonjë nevojë të Tijën. Ai nuk kërkon prej tyre ndonjë lloj furnizimi, ashtu si nuk do që ata ta ushqejnë. Ai është i Lartësuar dhe nuk ka nevojë për ndonjë gjë prej krijesave të Tij. Ai është i Pasur dhe i Plotfuqishëm. Të gjithë kanë nevojë për Të dhe mëshirën e Tij, kurse Ai nuk ka nevojë për asgjë, siç thotë më pas:

- "Unë nuk kërkoj prej tyre ndonjë furnizim e as kërkoj që të më ushqejnë. Allahu, Ai është Furnizuesi i madh e Fuqiploti." - Çdo kafshë në tokë, në qiell dhe kudo qoftë, e ka të siguruar rizkun nga Allahu i Lartësuar; Ai kujdeset për çdo nevojë të tyre. Allahu është Fuqiploti. Në dorën e Tij është gjithçka. Me fuqinë dhe pushtetin e Tij, Allahu krijoi këtë madhështi në botën qiellore dhe tokësore. Me pushtetin e Tij, Ai përkujdeset për botën dhe gjithçka ka në të. Çdo gjë ekziston dhe funksionon sipas dëshirës së Tij. Ajo që Allahu ka

dëshiruar është, ndërsa ajo që Allahu nuk e ka dëshiruar nuk është. Askush nuk mund t'i fshihet Atij dhe askush nuk mund t'i shmanget pushtetit dhe sundimit të Tij. Me fuqinë e Tij, Allahu ushqen dhe furnizon çdo krijesë. Me fuqinë e Tij, Ai do t'i ringjallë trupat, pasi ata të jenë tretur e të jenë bërë pluhur në tokë apo të kenë humbur nëpër dete e oqeane. Askush nuk i shpëton dot llogarisë së të Drejtit. I Lartësuar qoftë i Allahu i Plotfuqishëm!

Ajetet 59 – 60

59. Sigurisht, ata që bëjnë padrejtësi meritojnë të njëjtin lloj dënimi si sivëllezërit e tyre, prandaj të mos e kërkojnë shpejtimin e tij!
60. Të mjerët ata që nuk e besojnë ditën që u është premtuar!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Sigurisht, ata që bëjnë padrejtësi meritojnë të njëjtin lloj dënimi si sivëllezërit e tyre, prandaj të mos e kërkojnë shpejtimin e tij!"** - Ata që mohojnë Muhamedin (a.s.) dhe mesazhin e tij do të kenë ndëshkim si popujt e tjerë të ngjashëm, që mohuan të dërguarit e tjerë të Zotit. Ata të mos nguten, sepse Allahu i Lartësuar ka vendosur një rregull të pandryshueshëm: çdo mohues, i cili vazhdon të mos pendohet dhe të mos bindet, patjetër që do të ndëshkohet, edhe nëse mund të vonohet ky ndëshkim për njëfarë kohe.

Më pas, i Lartësuari i kërcënon të tillë njerëz me Ditën e Gjykimit:

- **"Të mjerët ata që nuk e besojnë ditën që u është premtuar!"** - Ajo është Dita e Gjykimit, kur mohuesit e profetëve i pret ndëshkimi i premtuar. Atë ditë, për ata nuk do të ketë ndihmues dhe as shpëtues nga ndëshkimi i Zotit. E lus Allahun të na ruajë nga ky ndëshkim!

Surja 52: Et Tur (mekase) 49 ajete

Ajetet 1 – 16

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Betohem për Tur-in
2. dhe Librin e shkruar në rreshta,
3. në pergamenë të shpalosur!
4. Betohem për Shtëpinë plot vizitorë!
5. Betohem për kupën e ngritur lart
6. dhe për detin e mbushur plot!
7. Vërtet, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë!
8. Atë, askush nuk mund ta pengojë.
9. Atë ditë, qielli do të lëkundet fuqishëm
10. e malet do të shkulen nga vendi e do të lëvizin.
11. Ajo ditë është mjerim i madh për mohuesit,
12. të cilët, të zhytur në gënjeshtra, argëtohen!
13. Dita, kur me rrëmbim, do tërhiqen për në zjarrin e Xhehenemit.
14. Ky është zjarri, që ju e mohonit!
15. Vallë, mos është kjo ndonjë magji, apo ju nuk shihni?!
16. Digjuni në të! E duroni apo nuk e duroni, njësoj është për ju! Ky është i vetmi "shpërblim" për atë që e merituat me veprat tuaja!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar betohet në këto krijesa madhështore, të cilat bartin shumë urtësi të mëdha. Ato tregojnë për vërtetësinë

e ringjalljes dhe shpërblimit me drejtësi si për të devotshmit, ashtu edhe për mohuesit.

- **"Betohem për Tur-in..."** – Ky është betim në malin Tur, mal në të cilin Allahu i Lartësuar i foli profetit të Tij Musa, birit të Imranit (a.s.), duke i shpallur ligje dhe dispozita të ndritshme. Kjo qe një mirësi e madhe, që Zoti ia dhuroi profetit Musa dhe ymetit të tij, e gjithashtu një shenjë e mrekullueshme e përkujdesjes së Zotit për ta, dhuratë për të cilën ata kurrë nuk mund ta falënderojnë ashtu si e meriton.

- **"...dhe Librin e shkruar në rreshta, në pergamenë të shpalosur!"** - Ka mundësi që këtu të flitet për *Leuhi Mahfudh*-in, ku Allahu i Lartësuar ka shkruar çdo gjë. Por ka mundësi që të flitet edhe për Kuranin e madhërishëm, i cili pa dyshim është libri më i mirë që ka shpallur Allahu dhe ku përmenden ngjarjet e të parëve dhe të fundit, njohuritë e të parëve dhe të atyre që do të vijnë.

- **"Betohem për Shtëpinë plot vizitorë!"** - Këtu bëhet fjalë për Shtëpinë e Shenjtë që gjendet sipër qiellit të shtatë. Ajo gjithmonë është e mbushur me melekë të nderuar. Çdo ditë në këtë shtëpi hyjnë shtatëdhjetë mijë melekë, të cilët adhurojnë Zotin e tyre dhe të cilëve nuk u bie më radha të kthehen në të, deri në Ditën e Gjykimit.

Por në ajet mund të bëhet fjalë edhe për Shtëpinë e Zotit në tokë, Qaben, e cila është e mbushur përplot me adhurues të Zotit, që bëjnë tavaf, falen e përkujtojnë Zotin në çdo kohë, duke kryer haxhin dhe umren.


Po kështu është betuar Allahu i Lartësuar në një ajet tjetër, duke thënë: "Për fikun dhe ullirin! Për Turi Sinain dhe për këtë qytet të sigurt!" [Tin 1-3]. E meriton kjo faltore madhështore që Zoti të betohet në të. Ajo është destinacioni i haxhit, që është një nga shtyllat e Islamit. Ajo është faltorja e ndërtuar nga Ibrahimi (a.s.) dhe Ismaili, që Zoti e ka bërë vend qetësie dhe sigurie.

- **"Betohem për kupën e ngritur lart..."** - I Lartësuari betohet për qiellin madhështor, të cilin e ka bërë si çati dhe mburojë për krijesat. Ai shërben si mbrojtës i tokës dhe prej tij vjen drita. Nëpërmjet yjeve të vendosura në qiell, njerëzit udhëzohen dhe gjejnë rrugën në errësirën e tokës dhe të detit. Prej qiellit zbret mëshira, shiu dhe çdo lloj furnizimi tjetër.

- **"...dhe për detin e mbushur plot!"** – Allahu betohet për detin '*mesxhur*', domethënë, e mbushur përplot me ujë, të cilin Ai e ka mbledhur dhe grumbulluar, duke e ndaluar që të shpërthejë dhe të përmbytë tokën. Nëse do të lihej i lirë, natyrshëm ai do të dilte nga vendi i vet dhe do të mbulonte tokën. Por ligji i vendosur nga i Gjithëdijshmi dhe i Urti e bën që ai të qëndrojë i grumbulluar, duke mos dalë nga shtrati i tij. Në këtë mënyrë, Zoti ruan bimësinë, botën shtazore dhe jetën në përgjithësi mbi faqen e dheut. Ky është njëri nga kuptimet e mbiemrit '*mesxhur*', që cilëson fjalën 'det' në ajet.

Sipas disa komentuesve të tjerë, '*mesxhur*' do të thotë "i ndezur flakë". Ashtu siç është deti, aq i madh, i thellë dhe i gjerë, ai do të mbushet me zjarr dhe ndëshkime të larmishme.

Të gjitha këto betime madhështore tregojnë fillimisht se ato janë disa nga shenjat e Allahut të Lartësuar, që dëshmojnë për njëshmërinë e Tij. Së dyti, ato tregojnë se


الجزء السابع والعشرون سورة الطور
أَفَسِحْرٌ هَٰذَآ أَمْ أَنتُمْ لَا تُبْصِرُونَ ﴿١٥﴾ ٱصْلَوْهَا فَٱصْبِرُوٓا۟
أَوْ لَا تَصْبِرُوا۟ سَوَآءٌ عَلَيْكُمْ ۖ إِنَّمَا تُجْزَوْنَ مَا كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٦﴾
إِنَّ ٱلْمُتَّقِينَ فِى جَنَّٰتٍ وَنَعِيمٍ ﴿١٧﴾ فَٰكِهِينَ بِمَآ ءَاتَىٰهُمْ رَبُّهُمْ
وَوَقَىٰهُمْ رَبُّهُمْ عَذَابَ ٱلْجَحِيمِ ﴿١٨﴾ كُلُوا۟ وَٱشْرَبُوا۟ هَنِيٓـًٔۢا بِمَا
كُنتُمْ تَعْمَلُونَ ﴿١٩﴾ مُتَّكِـِٔينَ عَلَىٰ سُرُرٍ مَّصْفُوفَةٍ ۖ وَزَوَّجْنَٰهُم
بِحُورٍ عِينٍ ﴿٢٠﴾ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَٱتَّبَعَتْهُمْ ذُرِّيَّتُهُم بِإِيمَٰنٍ أَلْحَقْنَا
بِهِمْ ذُرِّيَّتَهُمْ وَمَآ أَلَتْنَٰهُم مِّنْ عَمَلِهِم مِّن شَىْءٍ ۚ كُلُّ ٱمْرِئٍۭ بِمَا
كَسَبَ رَهِينٌ ﴿٢١﴾ وَأَمْدَدْنَٰهُم بِفَٰكِهَةٍ وَلَحْمٍ مِّمَّا يَشْتَهُونَ ﴿٢٢﴾
يَتَنَٰزَعُونَ فِيهَا كَأْسًا لَّا لَغْوٌ فِيهَا وَلَا تَأْثِيمٌ ﴿٢٣﴾ ۞ وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ
غِلْمَانٌ لَّهُمْ كَأَنَّهُمْ لُؤْلُؤٌ مَّكْنُونٌ ﴿٢٤﴾ وَأَقْبَلَ بَعْضُهُمْ عَلَىٰ
بَعْضٍ يَتَسَآءَلُونَ ﴿٢٥﴾ قَالُوٓا۟ إِنَّا كُنَّا قَبْلُ فِىٓ أَهْلِنَا مُشْفِقِينَ
﴿٢٦﴾ فَمَنَّ ٱللَّهُ عَلَيْنَا وَوَقَىٰنَا عَذَابَ ٱلسَّمُومِ ﴿٢٧﴾ إِنَّا كُنَّا
مِن قَبْلُ نَدْعُوهُ ۖ إِنَّهُۥ هُوَ ٱلْبَرُّ ٱلرَّحِيمُ ﴿٢٨﴾ فَذَكِّرْ فَمَآ أَنتَ بِنِعْمَتِ
رَبِّكَ بِكَاهِنٍ وَلَا مَجْنُونٍ ﴿٢٩﴾ أَمْ يَقُولُونَ شَاعِرٌ نَّتَرَبَّصُ بِهِۦ رَيْبَ
ٱلْمَنُونِ ﴿٣٠﴾ قُلْ تَرَبَّصُوا۟ فَإِنِّى مَعَكُم مِّنَ ٱلْمُتَرَبِّصِينَ ﴿٣١﴾
الجزء ٥٣
٥٢٤

Allahu i Madhërishëm është i Plotfuqishëm për gjithçka, për të ringjallur të vdekurit dhe për t'i llogaritur e shpërblyer ata.

- **"Vërtet, dënimi i Zotit tënd do të ndodhë! Atë, askush nuk mund ta pengojë."** - Kjo është e padiskutueshme që do të ndodhë dhe askush nuk mund ta pengojë. Askush nuk mund të ndryshojë premtimin dhe fjalën e Zotit. Askush nuk mund të ndërhyjë për ta ndryshuar apo penguar gjykimin e Zotit, sepse pushteti i Tij është absolut dhe i pacenueshëm. Askush nuk mund t'i shpëtojë pushtetit të Tij.

Më pas, ajeti përshkruan atë ditë të vështirë, kur do të godasë fuqishëm ndëshkimi i Zotit:

- "Atë ditë, qielli do të lëkundet fuqishëm e malet do të shkulen nga vendi e do të lëvizin." - Atë ditë, qiejt do të rrotullohen dhe do të lëkunden. Lëkundja e tyre do të jetë e tmerrshme, e vazhdueshme dhe shkatërruese. Ndërsa malet do të shkulen nga vendi dhe do të lëvizin si retë dhe si pluhur në ajër. Kur të tilla dridhje shkaktojnë këto fenomene me krijesat e mëdha, atëherë si do të jetë frika që do të pushtojë njerëzit, qenie aq të vogla dhe të dobëta?!

- "Ajo ditë është mjerim i madh për mohuesit, të cilët, të zhytur në gënjeshtra, argëtohen!" – Ajo ditë është "*uejl*" për mohuesit. Fjala "*uejl*" e përdorur në ajet shënon çdo lloj ndëshkimi, trishtimi, vuajtjeje, ankthi e frike.

Po cili është shkaku që ata meritojnë këtë ndëshkim?! Ata janë tërësisht të angazhuar me gjëra të pavlefshme. Studimet e tyre janë tërësisht të përqendruara në njohjen e gjërave të dëmshme, të cilat të çojnë në mospranimin e të vërtetës. Ata të bëjnë që të besosh dhe pranosh të kotën. Kjo është dituria e tyre. Ndërsa veprat e tyre bëhen vetëm nga injorantët, mendjelehtët dhe të shfrenuarit në dëfrime e lojëra. E tillë është gjendja e njohurive dhe veprave të këtyre mjeranëve, ndryshe nga dijet dhe veprat e besimtarëve, që e pranojnë të vërtetën e Zotit dhe jetojnë me të. Dituria e këtyre të fundit është e dobishme për dynjanë dhe ahiretin. Veprat e tyre mbështeten te kjo dije e dobishme dhe kryhen me sinqeritet për të kënaqur Krijuesin.

- "Dita, kur me rrëmbim, do tërhiqen për në zjarrin e Xhehenemit." - Atë ditë, ata do të thirren për në Xhehenem dhe do të tërhiqen zvarrë me fytyrat e tyre, për t'u hedhur në të. Në një gjendje të tillë ndëshkimi, ata dëgjojnë këto fjalë:

- **"Ky është zjarri, që ju e mohonit!"** - Vuajeni tani ndëshkimin e përjetshëm, të cilin askush nuk mund ta përballojë dhe askush nuk mund ta përshkruajë.

- "Vallë, mos është kjo ndonjë magji, apo ju nuk shihni?!" - Ka mundësi që kjo pyetje të bëhet për Zjarrin ose ndëshkimin me të cilin do të ballafaqohen, sikurse tregon edhe konteksti i ajetit. Pra, kur ata të shohin Zjarrin, në formë ironie do t'u thuhet: "A mos është magji, a mos është diçka jo reale, ashtu sikurse pretendonit në dynja, apo ishit të verbër në dynja dhe nuk e shihnit të vërtetën?" Përgjigjja, sigurisht, është negative: nuk është një magji, por një realitet i pamohueshëm.

Edhe pretendimi i tyre se nuk e shihnin dhe nuk e kuptonin të vërtetën, nuk qëndron. Faktet dhe shenjat e Allahut ishin tërësisht të qarta. Profeti ua qartësoi të vërtetën rreth Zotit dhe mesazhin e Tij. Ai i ftoi me mënyrën më të mirë për të besuar Zotin dhe gjithçka që Ai urdhëroi të besohet. Pas këtij qartësimi, askush nuk mund të justifikohet para Zotit.

Por ka shumë mundësi, gjithashtu, që këtu të flitet për Shpalljen që iu dha Muhamedit (a.s.). Sipas kësaj, kuptimi është: "Vallë, është magji Shpallja që iu dha Muhamedit apo fajin e ka paaftësia juaj në të vështruarit dhe kuptuarit e gjërave?" Kjo është një pyetje retorike, së cilës i dihet përgjigjja. Shpallja që iu dha Muhamedit nuk është aspak magji, por është faji i tyre që e shpërfillin atë, edhe pse ajo është vetë e vërteta e sigurt, e argumentuar dhe e faktuar nga Zoti.

- "Digjuni në të! E duroni apo nuk e duroni, njësoj është për ju!" - Hidhini në Xhehenem, në atë mënyrë që zjarri t'i përfshijë tërësisht trupat e tyre dhe t'u depërtojë deri në zemra.

Durimi atje nuk ka vlerë dhe nuk ua lehtëson aspak dhimbjen që shkakton Zjarri. Po ashtu, edhe pse do të jetë një turmë e madhe që do të ndëshkohet, kjo nuk do t'i ngushëllojë fare. Asgjë nuk mund ta lehtësojë ndëshkimin në Xhehenem, sepse ai nuk është i tillë që mund të kalohet me durim e ngushëllim.

Ky është ndëshkim i merituar për ta, për veprat që kanë bërë vetë, siç thotë i Lartësuari:

- "Ky është i vetmi "shpërblim" për atë që e merituat me veprat tuaja!"

Ajetet 17 – 20

17. Vërtet, të devotshmit do të jenë në kopshtet e Xhenetit dhe në begati,
18. të kënaqur me ato që u ka dhuruar Zoti i tyre. Zoti i tyre i ruajti ata nga vuajtjet në Zjarrin flakërues.
19. "Hani e pini duke u kënaqur, për hir të veprave që keni bërë!"
20. Ata do të rrinë të mbështetur në shtretër të sistemuar mirë. Ne do t'i martojmë ata me hyri sybukura.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për ndëshkimin e jobesimtarëve, Allahu i Lartësuar përshkruan shpërblimin e të devotshmëve, që ruajnë kufijtë e Tij, duke kryer detyrimet dhe duke iu larguar harameve, në shenjë dashurie, madhërimi dhe nënshtrimi ndaj Tij. Kështu, Allahu i Lartësuar vendos paralel kërcënimin dhe inkurajimin, shpresën dhe frikën, të domosdoshme këto për një rob adhurues.

- "**Vërtet, të devotshmit do të jenë në kopshtet e Xhenetit dhe në begati...**" – Të devotshëm janë ata që i druhen zemërimit dhe ndëshkimit të Zotit, duke kryer urdhëresat dhe duke iu larguar harameve, në shenjë adhurimi për Të dhe në kërkim të kënaqësisë së Tij.

Këta fatlumë do të jenë në kopshte, që janë të mbuluar me pemë dhe bimë që dredhojnë sipër tyre. Nëpër këto kopshte të bukura rrjedhin lumenj dhe lartësohen kështjella të stolisura. Atje do të përjetojnë lumturinë, me të gjitha përmasat e saj, me zemër, shpirt dhe me trup.

- "...të kënaqur me ato që u ka dhuruar Zoti i tyre. Zoti i tyre i ruajti ata nga vuajtjet në Zjarrin flakërues." - Ata janë tejet të kënaqur dhe të lumtur me mirësitë që Zoti i tyre u ka dhuruar, të cilat askush nuk mund t'i përshkruajë, sikurse thotë i Lartësuari: "Askush nuk di për ato kënaqësi që u janë caktuar atyre si shpërblim për veprat që kanë bërë." [Sexhde 17].

Zoti u dhuron atyre çdo gjë që e dëshirojnë dhe i ruan nga çdo gjë që i tremben. Kështu vepron me ta i Gjithëmëshirshmi e Bamirësi, sepse edhe ata bëjnë atë që Zoti e dëshiron dhe i largohen asaj që Ai e urren. Duke i uruar dhe përshëndetur, atyre u thuhet:

- **"Hani e pini duke u kënaqur, për hir të veprave që keni bërë!"** - Gjatë ushqimit dhe pijes, gjithashtu, do t'u thuhet: "Ju bëftë mirë dhe u gëzofshi me kënaqësi të njëpasnjëshme! Të gjitha këto që po shijoni i fituat me veprat dhe fjalët tuaja të mira."

- "**Ata do të rrinë të mbështetur në shtretër të sistemuar mirë.**" - Ata do qëndrojnë të shtrirë e të mbështetur, me rehati e kënaqësi të plotë. Shtretërit e tyre janë të zbukuruar dhe të sistemuar. Allahu i Lartësuar i ka përshkruar si shtretër "*mesfufeh*", domethënë, të sistemuar dhe të mirëvendosur. Ata do të qëndrojnë së bashku me gratë e tyre mbi ata shtretër, ku do të kënaqen dhe do t'i thonë njëri-tjetrit fjalë të ëmbla. Duke qenë se ata do të provojnë në Xhenet kënaqësi që lumturojnë zemrën, shpirtin dhe trupin, që askush nuk mund t'i përfytyrojë realisht në dynja, atëherë nuk mbetet gjë tjetër që t'i plotësojë kënaqësitë e tyre, veç grave dhe çfarë ato ofrojnë. Ata do të kenë gratë më të përsosura në cilësitë e tyre trupore, shpirtërore dhe morale:

- "Ne do t'i martojmë ata me hyri sybukura." - Ato janë gra tek të cilat bashkohen bukuria dhe hijeshia fizike me moralin dhe sjelljen e përkryer. Bukuria e tyre çorodit çdo njeri që i shikon e kundron. Zemrat gati pëlcasin nga malli për t'i pasur dhe për të qenë me to, thjesht e vetëm me një shikim të hedhur prej tyre. Sytë e tyre janë shumë të bukur dhe shprehës të dashurisë që fshehin. E bardha dhe e zeza e syve të tyre janë në kontrast vezullues.

Ajetet 21 – 28

21. Besimtarët e vërtetë do t'i bashkojmë me ata pasardhës të tyre që i pasojnë në besim, duke mos u pakësuar asgjë nga veprat e veta. Çdokush është peng i punës së vet.
22. Ne do t'ua shtojmë të mirat atyre: fruta e mish, si t'ua ketë ënda.
23. Atje do t'ia kalojnë njëri-tjetrit kupat e mbushura e nuk do të ketë fjalë të kota e as gjynahe.

24. Mes tyre do të sillen djelmoshat shërbyes, si të ishin margaritarë të fshehur.
25. Ata do të afrohen, duke biseduar me njëri-tjetrin
26. e duke thënë: "Ne, edhe me familjet tona druheshim.
27. Por Allahu na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit në afshin përcëllues të Zjarrit.
28. Ne i jemi falur dhe lutur Atij edhe më parë. Vërtet, Ai është Bamirësi e Mëshiruesi."

Shpjegimi i ajeteve

- **"Besimtarët e vërtetë do t'i bashkojmë me ata pasardhës të tyre që i pasojnë në besim, duke mos u pakësuar asgjë nga veprat e veta."** - Ky është një plotësim i shpërblimit dhe i lumturisë së banorëve të Xhenetit. Fëmijët që pasojnë prindërit e tyre në besim dhe vepra të mira, Allahu i Lartësuar ua bashkëngjit prindërve, që mund të jenë në grada më të larta në Xhenet. Kjo bëhet për të shtuar nderimin e këtyre prindërve, por edhe për të shtuar shpërblimin e fëmijëve që ndjekin rrugën e drejtë të paraardhësve besimtarë. Po kështu ndodh edhe anasjelltas: nëse fëmijët janë në grada më të larta, Allahu i Lartësuar u bashkangjit atyre prindërit besimtarë. Sigurisht, kjo gjë nuk e pakëson shpërblimin e prindërve.

Dikush mund të mendojë gabimisht se edhe me banorët e Zjarrit do të veprohet në të njëjtën mënyrë, domethënë që Allahu i Lartësuar do t'i bashkojë prindërit me pasardhësit e tyre. Por i Madhëruari na tregon se gjykimi për dy vendet nuk është i njëjtë, dhe s'ka se si të jetë i tillë, sepse Zjarri është vendi ku zbatohet drejtësia e Zotit dhe askush nuk ndëshkohet për gjynahet që nuk i ka vepruar vetë apo nuk është bërë shkak, siç thotë i Madhëruari më pas:

- **"Çdokush është peng i punës së vet."** - Askush nuk do të merret në përgjegjësi për veprat e të tjerëve. Askush nuk do të pyetet për gjynahun e tjetrit. Atëherë, ky ajet hedh poshtë keqkuptimet që mund të lindin në këtë drejtim.

- **"Ne do t'ua shtojmë të mirat atyre: fruta e mish, si t'ua ketë ënda."** - Ndër begatitë e shumta me të cilat Zoti do t'i kënaqë banorët e Xhenetit janë edhe frutat e shijshme. Rrushi, shega, molla e shumë fruta të tjera të mrekullueshme, janë kënaqësi që ata do t'i shijojnë, përveç ushqimeve të pakrahasueshme që do të kenë përjetësisht në Xhenet. Nëse kërkojnë mish, do t'u jepet çdo lloj mishi që dëshirojnë: mish shpendësh apo kafshësh të tjera.

- **"Atje do t'ia kalojnë njëri-tjetrit kupat e mbushura..."** - Mes këtyre mirësive, ata do të shkëmbejnë me njëri-tjetrin gota me pije të shijshme, nektar etj. Ato u shërbehen me ibrikë nga djelmosha të përjetshëm, mes kopshteve të bukura. Në Xhenet, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

- **"...nuk do të ketë fjalë të kota e as gjynahe."** - Atje nuk ka fjalë të kota, të padobishme apo, aq më tepër, të dëmshme, që t'i ngarkojnë me gjynahe dhe të sjellin ndëshkime. Por nëse të tilla fjalë nuk ekzistojnë në Xhenet, atëherë atje ka tjetër lloj fjalësh. Ato janë fjalë të ëmbla, të buta e qetësuese, që gëzojnë zemrën dhe lumturojnë shpirtin. Banorët e Xhenetit i drejtohen njëri-tjetrit me fjalët më të mira, me ngrohtësi e dashuri. Gjithashtu, ajo që do të dëgjojnë prej Zotit do t'i lumturojë më tepër, sepse Ai është i kënaqur prej tyre, prandaj u shpreh dashurinë e Tij.

- **"Mes tyre do të sillen djelmoshat shërbyes, si të ishin margaritarë të fshehur."** – Ata janë të rinj shërbëtorë, të cilët duken si margaritarë. Ata do të vërtiten mes tyre për t'u shërbyer gjithçka që dëshirojnë. Kjo është dëshmi e begatisë së madhe që ata do të kenë në Xhenet.

- "Ata do të afrohen, duke biseduar me njëri-tjetrin..." – Ata do të diskutojnë rreth çështjeve të shkuara të dynjasë. Ndër të tjera, duke folur për shkaqet që sollën shpëtimin e tyre dhe hyrjen në Xhenet, ata do të thonë:

- "Ne, edhe me familjet tona druheshim." – Kuptimi: Kur ishim në dynja, ne i druheshim Zotit edhe në gjirin e familjeve tona. Nga frika ndaj Zotit dhe llogarisë para Tij, i lamë gjynahet dhe u munduam të rregullojmë gabimet dhe mangësitë tona.

- **"Por Allahu na dhuroi të mira dhe na ruajti prej dënimit në afshin përcëllues të Zjarrit."** - Allahu i Madhëruar na begatoi me mirësi të mëdha, duke na udhëzuar në rrugën e drejtë dhe duke na ndriçuar për të mësuar dhe kuptuar të vërtetën. Ai na dha sukses dhe forcë për të punuar dhe jetuar sipas udhëzimeve të Tij. Kështu, i Lartësuari na e lehtësoi rrugën drejt shpëtimit dhe na ruajti nga Zjarri përvëlues.

- "Ne i jemi falur dhe lutur Atij edhe më parë. Vërtet, Ai është Bamirësi e Mëshiruesi." - Ne i luteshim Allahut vazhdimisht, që të na ruante nga ndëshkimi i Zjarrit përvëlues dhe të na dhuronte shpërblimin në Xhenetin e përjetësisë. Ne i kërkonim Allahut nëpërmjet lutjeve të drejtpërdrejta dhe lutjeve të shprehura nëpërmjet adhurimit. Koha jonë ishte e mbushur me lutje e adhurime, nëpërmjet të cilave kërkonim mëshirë dhe shpresonim shpërblim prej Allahut të Madhërishëm. Allahu i Lartësuar është *El Beru* - Bamirës dhe *El Rahim* - i Gjithëmëshirshëm. Prej bamirësisë dhe mëshirës së Tij të gjerë mbi ne është edhe fakti që Ai na futi në Xhenet dhe në kënaqësinë e Tij dhe na shpëtoi nga zemërimi dhe Zjarri i Tij.

Ajetet 29 – 43

29. Atëherë, përkujto, sepse ti, me mirësinë e Zotit tënd, nuk je as fallxhor e as i çmendur!
30. Ata thonë: "Ai është veçse një poet, prandaj po presim derisa vdekja ta zhdukë!".
31. Thuaju: "Prisni, se edhe unë po pres bashkë me ju!".
32. Vallë, mendja e tyre po ua imponon apo janë njerëz pa fre?
33. Në fakt, ata thonë: "Ai e trilloi atë!" Jo, kurrsesi nuk është ashtu, por ata nuk besojnë.
34. Le ta sjellin një libër si ai, nëse është e vërtetë ajo që thonë!
35. A mos vallë, ata u krijuan prej hiçit, apo ata vetë janë krijues?
36. Vallë, ata i krijuan qiejt e Tokën?! Jo, nuk është ashtu, por ata nuk janë aspak të bindur.
37. A mos zotërojnë thesaret e Zotit tënd?! Apo mos janë ata mbizotëruesit?!
38. A mos kanë ata shkallë të larta, mbi të cilat përgjojnë? Atëherë, le të sjellë përgjuesi i tyre ndonjë provë të sigurt!
39. Vallë, për Atë janë vajzat, kurse për ju djemtë?!
40. A mos po u kërkon atyre shpërblim, e ata janë të rënduar nga tagri?

41. A mos njohin ata fshehtësitë, që të mund t'i shkruajnë?!


42. A mos po kurdisin kurthe kundër teje? Le ta dinë atëherë, se në kurth do të bien vetëm ata që nuk besojnë.

43. A mos kanë ata ndonjë zot tjetër, veç Allahut? I lartë është Allahu nga gjithçka që ata i shoqërojnë!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Atëherë, përkujto, sepse ti, me mirësinë e Zotit tënd, nuk je as fallxhor e as i çmendur!" -** Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që të përkujtojë dhe paralajmërojë të gjithë njerëzit, besimtarë a jobesimtarë qofshin ata. Kështu bëhej e mundur që zullumqarët të mos kishin më asnjë justifikim, ndërsa të mëshiruarit të kishin mundësinë të gjenin rrugën e drejtë. Allahu i Lartësuar e urdhëron që t'u përkujtojë njerëzve të vërtetën, pa u shqetësuar nga jobesimtarët, të cilët pengonin njerëzit nga rruga e drejtë dhe nga pasimi i Shpalljes së Tij të ndritshme. Ata i kryenin këto krime ndaj Profetit dhe të vërtetës që ai e solli prej Zotit të tij, edhe pse ishin të sigurt për faktin se ai ishte i pastër nga çdo akuzë e tyre.

I Lartësuari mohon çdo mangësi dhe shpifje të trilluar për të Dërguarin e Tij kur thotë: "...me mirësinë e Zotit tënd, nuk je as fallxhor e as i çmendur!" Ai nuk ishte fallxhor, si ata që kanë në shërbim të vet xhindë, të cilët u sjellin ndonjë lajm nga fshehtësitë, të përzier me njëqind gënjeshtra. Ai nuk ishte as i çmendur. Përkundrazi, ai kishte mendjen më të kthjellët ndër njerëz dhe ishte më i ruajturi nga ndikimi i shejtanëve. Ai ishte më i sinqerti, më i dituri dhe më i ploti si njeri.


الجزء السابع والعشرون سورة الطور

أَمْ تَأْمُرُهُمْ أَحْلَٰمُهُم بِهَٰذَآ أَمْ هُمْ قَوْمٌ طَاغُونَ ﴿٣٢﴾ أَمْ يَقُولُونَ تَقَوَّلَهُۥ ۚ
بَل لَّا يُؤْمِنُونَ ﴿٣٣﴾ فَلْيَأْتُوا۟ بِحَدِيثٍ مِّثْلِهِۦٓ إِن كَانُوا۟ صَٰدِقِينَ
﴿٣٤﴾ أَمْ خُلِقُوا۟ مِنْ غَيْرِ شَىْءٍ أَمْ هُمُ ٱلْخَٰلِقُونَ ﴿٣٥﴾ أَمْ خَلَقُوا۟
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ ۚ بَل لَّا يُوقِنُونَ ﴿٣٦﴾ أَمْ عِندَهُمْ خَزَآئِنُ رَبِّكَ
أَمْ هُمُ ٱلْمُصَيْطِرُونَ ﴿٣٧﴾ أَمْ لَهُمْ سُلَّمٌ يَسْتَمِعُونَ فِيهِ ۖ فَلْيَأْتِ
مُسْتَمِعُهُم بِسُلْطَٰنٍ مُّبِينٍ ﴿٣٨﴾ أَمْ لَهُ ٱلْبَنَٰتُ وَلَكُمُ ٱلْبَنُونَ ﴿٣٩﴾
أَمْ تَسْـَٔلُهُمْ أَجْرًا فَهُم مِّن مَّغْرَمٍ مُّثْقَلُونَ ﴿٤٠﴾ أَمْ عِندَهُمُ ٱلْغَيْبُ
فَهُمْ يَكْتُبُونَ ﴿٤١﴾ أَمْ يُرِيدُونَ كَيْدًا ۖ فَٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ هُمُ ٱلْمَكِيدُونَ ﴿٤٢﴾
أَمْ لَهُمْ إِلَٰهٌ غَيْرُ ٱللَّهِ ۚ سُبْحَٰنَ ٱللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٤٣﴾ وَإِن يَرَوْا۟ كِسْفًا
مِّنَ ٱلسَّمَآءِ سَاقِطًا يَقُولُوا۟ سَحَابٌ مَّرْكُومٌ ﴿٤٤﴾ فَذَرْهُمْ حَتَّىٰ يُلَٰقُوا۟
يَوْمَهُمُ ٱلَّذِى فِيهِ يُصْعَقُونَ ﴿٤٥﴾ يَوْمَ لَا يُغْنِى عَنْهُمْ كَيْدُهُمْ شَيْـًٔا
وَلَا هُمْ يُنصَرُونَ ﴿٤٦﴾ وَإِنَّ لِلَّذِينَ ظَلَمُوا۟ عَذَابًا دُونَ ذَٰلِكَ وَلَٰكِنَّ
أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٧﴾ وَٱصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ فَإِنَّكَ بِأَعْيُنِنَا ۖ وَسَبِّحْ
بِحَمْدِ رَبِّكَ حِينَ تَقُومُ ﴿٤٨﴾ وَمِنَ ٱلَّيْلِ فَسَبِّحْهُ وَإِدْبَٰرَ ٱلنُّجُومِ ﴿٤٩﴾

سورة النجم

٥٢٥

Herë të tjera, jobesimtarët shpifnin për të duke thënë:

- "Ai është veçse një poet, prandaj po presim derisa vdekja ta zhdukë!". – Kuptimi: Ai është thjesht një poet dhe orator bindës, prandaj po presim që koha dhe vdekja ta fshijë kujtimin dhe gjurmët e tij.

Ata pretendonin se libri që solli Muhamedi (a.s.) ishte thjesht një poezi, ndërkohë që Zoti e hedh poshtë një shpifje të tillë në ajete të tjera, ku thotë: "Ne nuk i kemi mësuar atij poezi, e cila nuk ka lidhje me të. Në të vërtetë, është veçse një këshillë dhe një Kuran i qartë." [Jasin 69]. Këtyre njerëzve, Zoti porosit që t'u themi:

- **"Thuaju: "Prisni, se edhe unë po pres bashkë me ju!"."** – Thuaji, o Profet, prisni vdekjen time, pasi edhe unë së bashku me

besimtarët po presim që Zoti t'ju ndëshkojë me ndonjë dënim nga Ai ose nëpërmjet duarve tona!

- "**Vallë, mendja e tyre po ua imponon apo janë njerëz pa fre?"** - Mos është mendja e tyre ajo që i shtyn ata të mohojnë dhe të shpifin këto gjëra për Profetin?

Sa të këqija janë këto mendje, të cilat i japin përparësi të kotës dhe gënjeshtrës, që ka një fund të tmerrshëm! Ato e konsiderojnë si të çmendur njeriun më të plotë dhe më të përkryer, ndërsa të vërtetën e pamohueshme e konsiderojnë si gënjeshtrën më të madhe. Edhe më budallenjtë do t'i refuzonin të tilla mendje.

Vallë, ishin mendjet e tyre që i çuan në atë gjendje? Apo ata ishin zullumqarë që nuk kishin kufi? Kjo është e vërteta. Kalimi i kufijve nga ana e tyre nuk kishte të mbaruar. Shfrenimi i tyre ishte i papërmbajtur, ndaj të mos të duket çudi asnjë fjalë dhe vepër e tyre.

- "Në fakt, ata thonë: "Ai e trilloi atë!" Jo, kurrsesi nuk është ashtu, por ata nuk besojnë." – A mos ishte Muhamedi (a.s.) që e trilloi këtë Kuran nga mendja e tij? Jo, kurrsesi! Ata ishin njerëz që nuk besonin. Nëse do të besonin, nuk do të thoshin fjalë të tilla.

- **"Le ta sjellin një libër si ai, nëse është e vërtetë ajo që thonë!"** – Kuptimi: Nëse jeni të sinqertë kur thoni se është Muhamedi (a.s.) ai që e ka trilluar këtë Libër dhe nuk është Shpallje e Zotit, atëherë, duke qenë se ju jeni mjeshtër të krijimit letrar, silleni edhe ju një vepër të tillë apo edhe disa rreshta si ai. Nëse nuk e bëni, atëherë duhet ta pranoni që Kurani është shpallje e Zotit të Madhërishëm. Megjithatë, dijeni se, sikur të mblidheshit të gjithë së bashku, njerëz dhe xhindë, dhe të përpiqeshit të bënit një vepër të tillë, kurrë nuk do t'ia arrinit qëllimit, madje as edhe t'i afroheshit atij. Ju keni dy mundësi: ose ta pranoni Kuranin dhe të udhëzoheni me dritën e tij, ose ta refuzoni atë dhe të vazhdoni në humbje, për kotësinë e së cilës jeni të vetëdijshëm.

- "A mos vallë, ata u krijuan prej hiçit, apo ata vetë janë krijues?" - Ky është një arsyetim, para së cilit atyre nuk u mbetet veçse t'i nënshtrohen të vërtetës dhe ta pranojnë atë, ose, në të kundërt, do t'u duhet të kundërshtojnë logjikën e shëndoshë dhe besimin e drejtë.

Ata e mohojnë njësimin e Zotit, profetët e Zotit dhe shpalljet e Tij. Kjo do të thotë që ata e mohojnë faktin se është Allahu Ai që i ka krijuar. Megjithatë, qoftë nga ana logjike, ashtu edhe nga ana fetare, për pyetjen e shtruar ekzistojnë vetëm tri mundësi përgjigjeje:

1. Ata janë krijuar nga hiçi, pra, pa pasur një krijues, por kjo është e pamundur.
2. Ata janë krijues të vetvetes. Por edhe kjo është po aq e pamundur. Duke qenë se të dyja këto mundësi janë të papranueshme, atëherë mbetet mundësia e tretë:
3. Është Allahu Ai që i krijoi ata dhe gjithçka tjetër. Atëherë, nëse arrihet në këtë përfundim, kjo do të thotë që Allahu të konsiderohet si i vetmi që meriton adhurimin e krijesave, nënshtrimin dhe përkushtimin e tyre. Adhurimi nuk lejohet t'i kushtohet askujt tjetër veç Tij.

- **"Vallë, ata i krijuan qiejt e Tokën?!"** - Kjo është një pyetje së cilës i dihet përgjigjja, por që drejtohet për ta pohuar atë me më tepër

forcë. Askush nuk ka krijuar gjë në këtë gjithësi, as në qiell e as në Tokë, veç Allahut të Vetëm dhe të Gjithëpushtetshëm. Ata nuk kanë asnjë grimë pushteti në qiell dhe në tokë. Kjo është shumë e qartë dhe lehtësisht e kuptueshme, por mohuesit nuk binden, sikurse thotë Zoti:

- **"Jo, nuk është ashtu, por ata nuk janë aspak të bindur."** - Ata nuk janë të bindur, që të mund të përfitojnë nga argumentet e fesë dhe ato logjike.

- "A mos zotërojnë thesaret e Zotit tënd?!" – Vallë, depot e mirësisë së Zotit të Lartësuar janë në duart e këtyre mashtruesve jobesimtarë dhe ata i japin atij që duan dhe privojnë atë që duan? Kjo, me sa duket, është edhe arsyeja që atyre u duket e pamundur dhe jo e drejtë që Allahu i Madhërishëm dhe i Urtë t'ia dhurojë profetësinë robit të Tij, Muhamedit (a.s.). A thua se janë ata përgjegjësit dhe shpërndarësit e mëshirës dhe mirësive të Zotit. Në fakt, ata janë shumë më të ulët dhe të parëndësishëm, që të pretendojnë të tilla gjëra. Ata nuk kanë mundësi të ndihmojnë apo dëmtojnë as veten e vet. Ata nuk mund të dhurojnë jetë, nuk mund të sjellin vdekje dhe nuk mund të ringjallin krijesat. Vetëm në dorë të Zotit është i gjithë pushteti dhe mbretërimi, në qiell dhe në Tokë, në dynja dhe në ahiret. Allahu i Madhëruar thotë: "A thua se janë ata që e përcaktojnë mëshirën e Zotit tënd? Ne kemi përcaktuar për ta se si do të jetojnë në këtë botë. Ne i kemi ngritur disa më lart se të tjerët, që të përfitojnë me shërbimet ndaj njëri-tjetrit. Mëshira e Zotit tënd është shumë më e vlefshme sesa çfarë grumbullojnë ata.". [Zuhruf 32].

- "Apo mos janë ata mbizotëruesit?!" - A mund të marrin ata nën sundim krijesat dhe mbretërinë e Allahut me forcë ose me luftë? Sigurisht që jo. Ata janë të varfër, nevojtarë dhe të pafuqishëm kundrejt madhështisë së Allahut.

- "A mos kanë ata shkallë të larta, mbi të cilat përgjojnë?" - A kanë ata njohuri rreth të fshehtave të Zotit apo ndonjë mundësi që të dëgjojnë bisedat e qiellit, dhe në këtë mënyrë të dinë atë që të tjerët nuk e dinë?

- "Atëherë, le të sjellë përgjuesi i tyre ndonjë provë të sigurt!" - Ai që pretendon të tilla gjëra, le të sjellë ndonjë provë të pranueshme. Po si mund të ndodhë një gjë e tillë, madje si mund të mendohet ajo? Allahu i Madhërishëm është i Gjithëdijshëm për të fshehtat dhe të dukshmet dhe nuk ia tregon askujt të fshehtat e Tij, përveç atyre që i ka përzgjedhur si profetë, të cilëve u mëson aq sa Ai dëshiron.

Muhamedi (a.s.) është profeti më i zgjedhur, më i ditur dhe imami i të gjithë profetëve. Ai njoftoi botën me lajme nga i Madhërishmi dhe i urdhëroi ata që ta njësojnë Atë në adhurim. Ai erdhi ndër njerëz me përgëzime dhe kërcënime dhe solli rrëfime të vërteta për të shkuarën dhe të ardhmen. Ndërsa nga ana tjetër qëndrojnë mohuesit e profetëve, të padituri, të padrejtët e armiqtë e të vërtetës, që trillojnë lloj-lloj gënjeshtrash të pabaza. Atëherë, cili e meriton të dëgjohet dhe të pasohet? Profeti solli aq shumë prova e mrekulli për vërtetësinë e Shpalljes së Zotit, saqë ajo tashmë konsiderohet si dituria më e sigurt dhe e padiskutueshme. Ndërsa pala tjetër nuk arrin as të justifikohet për rrugën që ka

zgjedhur, e aq më pak, të argumentojë saktësinë e saj.

- **"Vallë, për Atë janë vajzat, kurse për ju djemtë?!"** - Si është e mundur vallë, që të trilloni të tilla paturpësi për Zotin e gjithësisë? A kanë fund shpifjet tuaja? A ka kufi paturpësia juaj? Së pari, shpifni dhe thoni se Zoti ka fëmijë. Së dyti, pretendoni se juve ju takon lloji më i preferuar i fëmijëve, pra, meshkujt, ndërsa Zotit i takokan femrat! A ka fyerje më të madhe në adresë të të Madhërishmit të Plotfuqishëm?!

- "A mos po u kërkon atyre shpërblim, e ata janë të rënduar nga tagri?" – A mos po u kërkon atyre ndonjë shpërblim për kumtimin e plotë të Shpalljes së Zotit, dhe kështu ata janë të rënduar nga shpenzimet kundrejt teje? Jo, aspak. Përkundrazi, angazhimi yt i vetëm është që ata të udhëzohen, madje je ti ai që u jep atyre pasuri të shumta, me qëllim që zemrat e tyre të zbuten dhe të pranojnë ftesën tënde, që dituria dhe imani të zenë vend në zemrat e tyre.

- **"A mos njohin ata fshehtësitë, që të mund t'i shkruajnë?! A mos po kurdisin kurthe kundër teje? Le ta dinë atëherë, se në kurth do të bien vetëm ata që nuk besojnë."** - Kurthet që ata ngrejnë rëndojnë veç mbi kurrizin e tyre, sepse nuk dëmtojnë njeri tjetër.

Dhe, vërtet, i Madhërishmi e çoi në vend këtë premtim ndaj të Dërguarit të Tij, prandaj vetëm Allahut i takon falënderimi dhe lavdia për këtë. Edhe pse qafirët nuk lanë asnjë mjet dhe rrugë për të luftuar dhe shfarosur Profetin dhe fenë e tij, Allahu i Madhëruar e ndihmoi të zgjedhurin e vet, duke bërë që feja e tij të triumfojë mbi të gjithë armiqtë.

- "A mos kanë ata ndonjë zot tjetër, veç Allahut? I lartë është Allahu nga gjithçka që ata i shoqërojnë!" - A kanë ata ndonjë zot tjetër, të cilit i luten, sepse shpresojnë shpërblim dhe ndihmë prej tij dhe i frikësohen ndëshkimit të tij?! I lartë është Allahu nga gjithçka që ata i shoqërojnë! Ai nuk ka shok dhe partner në pushtetin dhe mbretërimin e Tij. Ai nuk ka shok edhe në meritën e adhurimit.

Këto fjalë janë në vazhdim të kontekstit të përgjithshëm të sures dhe përforcuese të tij. Këto ajete tregojnë për pavlefshmërinë e adhurimit të çdo gjëje tjetër veç Allahut dhe se çdo adhurim që kryejnë idhujtarët është i papranueshëm, madje i dënueshëm nga i Madhërishmi. I vetmi të Cilit duhet t'i përkushtohen adhurimet, namazi, sexhdeja dhe nënshtrimi është Allahu i Pashoq. Çdo adhurim duhet t'i përkushtohet vetëm Allahut, me sinqeritet të plotë dhe sipas porosive të Tij dhe të Profetit të Tij. Vetëm Allahur i drejtohen lutjet e drejtpërdrejta dhe lutjet e shprehura nëpërmjet adhurimeve. Vetëm Ai është Zoti në qiell dhe në Tokë, sepse vetëm Ai është i ploti në emrat dhe cilësitë e Tij. Të mrekullueshme, të bukura dhe të urta janë veprat e Tij! Ai është i Madhërishmi e Bujari. Ai është Krenari, Ngadhënjyesi e i Pamposhturi. Ai është Një! Allahu është *Samed*, Ai që çdo krijesë i drejtohet për çdo nevojë. Ai është i Madhërishmi, i Lavdishmi, i Lartësuari!

Ajetet 44 – 49

44. Edhe sikur të shihnin ndonjë send duke rënë nga qielli, ata do të thoshin: "Është veç një grumbull resh!"

45. Prandaj, lëri ata derisa të përjetojnë ditën kur ata të shtangin,
46. ditën kur dredhitë e tyre nuk u bëjnë më asnjë dobi e kur nuk do të ndihmohen.
47. Është e vërtetë se për ata që bëjnë padrejtësi, ka një dënim më të afërt se ai, por shumica e tyre nuk e dinë.
48. Bëj durim me gjykimin e Zotit tënd, se t'i je nën mbikëqyrjen Tonë! Madhëroje me falënderim Zotin tënd, kur të ngrihesh!
49. Edhe gjatë natës adhuroje Atë, ashtu si dhe kur yjet nuk duken më.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar na bën të ditur se idhujtarët, të cilët e mohuan të vërtetën e qartë, edhe sikur t'u sillje çfarëdolloj argumenti e prove, kurrë nuk do ta pranonin dhe nuk do ta pasonin atë. Përkundrazi, ata do të vazhdonin me kokëfortësi në kotësinë e tyre dhe do të përdornin çdo lloj justifikimi për të mos e pranuar. Kështu, i Lartësuari thotë:


- "Edhe sikur të shihnin ndonjë send duke rënë nga qielli, ata do të thoshin: "Është veç një grumbull resh!""" - Edhe sikur nga qielli të lëshoheshin sende të mëdha ndëshkuese, ata përsëri nuk do të besonin, por do të vazhdonin në verbërinë e tyre e do të thoshin: "Është veç një grumbull resh! Janë thjesht disa re të mëdha dhe të zakonshme." Ata do t'i kalonin si pa të keq këto shenja, duke mos nxjerrë mësime prej tyre. Për të tillët, ilaçi i vetëm është ndëshkimi, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "Prandaj, lëri ata derisa të përjetojnë ditën kur ata të shtangin..." - Ajo është Dita e Kijametit, kur ata do të ballafaqohen me ndëshkimin, dhimbjen dhe dëshpërimin, që kurrë nuk mund të përshkruhen me fjalë.

- "...ditën kur dredhitë e tyre nuk u bëjnë më asnjë dobi e kur nuk do të ndihmohen." – Atyre nuk do t'u bëjnë më asnjë dobi dredhitë e nuk do të ndihmohen aspak. Në dynja, ata mund t'i mundësojnë vetes ndonjë të mirë dhe të shpëtojnë nga ndonjë e keqe nëpërmjet intrigave dhe hileve të tyre, por kjo nuk ka për të funksionuar Ditën e Kijametit. Atë ditë, dredhitë e tyre nuk kanë për t'u bërë dobi dhe nuk mund t'i shpëtojnë dot nga ndëshkimi i Allahut.

- "Është e vërtetë se për ata që bëjnë padrejtësi, ka një dënim më të afërt se ai, por shumica e tyre nuk e dinë." - Pasi foli për ndëshkimin që i pret zullumqarët Ditën e Kijametit, Allahu i Lartësuar tregon se ata do të përballen me ndëshkimin qysh në jetën e *berzah*-ut, në varr, para se të ndodhë Kijameti. Madje kjo thënie përfshin edhe vuajtjet që Zoti u jep në jetën e dynjasë, me katastrofa, luftëra dhe dënime të ndryshme. Megjithatë, shumica e njerëzve nuk e dinë, prandaj vazhdojnë rrugën e tyre të humbjes dhe mosbesimit, e cila e ka përfundimin në ndëshkim të rëndë.

Kështu, i Lartësuari pasi argumentoi me fakte kotësinë e fjalëve dhe besimeve të mohuesve, urdhëron Profetin e Tij që të mos u kushtojë vëmendje atyre të humburve, por të bëjë durim dhe të presë për gjykimin e Zotit dhe urdhrat e Tij. Ai duhej të përkushtohej në zbatimin e porosive të Zotit, i Cili i premtonte ndihmë dhe sukses, siç thuhet më pas:


الجزء السابع والعشرون سورة النجم

بسم الله الرحمن الرحيم

وَالنَّجْمِ إِذَا هَوَىٰ ﴿١﴾ مَا ضَلَّ صَاحِبُكُمْ وَمَا غَوَىٰ ﴿٢﴾ وَمَا يَنطِقُ عَنِ
الْهَوَىٰ ﴿٣﴾ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ﴿٤﴾ عَلَّمَهُ شَدِيدُ الْقُوَىٰ ﴿٥﴾
ذُو مِرَّةٍ فَاسْتَوَىٰ ﴿٦﴾ وَهُوَ بِالْأُفُقِ الْأَعْلَىٰ ﴿٧﴾ ثُمَّ دَنَا فَتَدَلَّىٰ ﴿٨﴾
فَكَانَ قَابَ قَوْسَيْنِ أَوْ أَدْنَىٰ ﴿٩﴾ فَأَوْحَىٰ إِلَىٰ عَبْدِهِ مَا أَوْحَىٰ ﴿١٠﴾
مَا كَذَبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَىٰ ﴿١١﴾ أَفَتُمَارُونَهُ عَلَىٰ مَا يَرَىٰ ﴿١٢﴾ وَلَقَدْ رَآهُ
نَزْلَةً أُخْرَىٰ ﴿١٣﴾ عِندَ سِدْرَةِ الْمُنتَهَىٰ ﴿١٤﴾ عِندَهَا جَنَّةُ الْمَأْوَىٰ ﴿١٥﴾
إِذْ يَغْشَى السِّدْرَةَ مَا يَغْشَىٰ ﴿١٦﴾ مَا زَاغَ الْبَصَرُ وَمَا طَغَىٰ ﴿١٧﴾ لَقَدْ رَأَىٰ
مِنْ آيَاتِ رَبِّهِ الْكُبْرَىٰ ﴿١٨﴾ أَفَرَأَيْتُمُ اللَّاتَ وَالْعُزَّىٰ ﴿١٩﴾ وَمَنَاةَ
الثَّالِثَةَ الْأُخْرَىٰ ﴿٢٠﴾ أَلَكُمُ الذَّكَرُ وَلَهُ الْأُنثَىٰ ﴿٢١﴾ تِلْكَ إِذًا قِسْمَةٌ
ضِيزَىٰ ﴿٢٢﴾ إِنْ هِيَ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنتُمْ وَآبَاؤُكُم مَّا أَنزَلَ
اللَّهُ بِهَا مِن سُلْطَانٍ إِن يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى الْأَنفُسُ
وَلَقَدْ جَاءَهُم مِّن رَّبِّهِمُ الْهُدَىٰ ﴿٢٣﴾ أَمْ لِلْإِنسَانِ مَا تَمَنَّىٰ ﴿٢٤﴾ فَلِلَّهِ
الْآخِرَةُ وَالْأُولَىٰ ﴿٢٥﴾ ۞ وَكَم مِّن مَّلَكٍ فِي السَّمَاوَاتِ لَا تُغْنِي
شَفَاعَتُهُمْ شَيْئًا إِلَّا مِن بَعْدِ أَن يَأْذَنَ اللَّهُ لِمَن يَشَاءُ وَيَرْضَىٰ ﴿٢٦﴾

الجزء ٥٣

٥٢٦

- "Bëj durim me gjykimin e Zotit tënd, se t'i je nën mbikëqyrjen Tonë!" - Ti je nën vëzhgimin, përkujdesjen dhe ruajtjen Tonë. Është Allahu i Madhërishëm Ai që të mbështet dhe të udhëzon ty në çdo çështje, prandaj bëhu i durueshëm me vendimet e Tij!

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar e urdhëron të shtojë *dhikr*-in dhe adhurimet e tjera:

- "Madhëroje me falënderim Zotin tënd, kur të ngrihesh!" – Ky është urdhër për namaz nate. Pra, kur të ngrihesh për të falur namaz nate, përmende Zotin tënd duke i bërë *tesbih*. Ose ka kuptimin: Kur ngrihesh për të falur pesë namazet farze. Mbase ky është më i saktë, sepse i Lartësuari përmend në vijim edhe *dhikr*-in gjatë natës, kur thotë:

- "Edhe gjatë natës adhuroje Atë, ashtu si dhe kur yjet nuk duken më." – Adhuroje Allahun në fundin e natës, ku bën pjesë edhe namazi i sabahut. Sidoqoftë, Allahu është më i dituri për gjithçka.

Surja 53: En Nexhm (mekase) 62 ajete

Ajetet 1 – 18

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Betohem në yllin kur perëndon,
2. se shoku juaj nuk ka humbur dhe nuk ka devijuar!
3. Ai nuk flet sipas qejfit,
4. por ato janë veçse shpallje, që i vijnë atij.
5. Atë ia mësoi ai, i fuqishmi,
6. që ka mendje të lartë dhe që u shfaq në formën e vet reale,
7. në pikën më të lartë të horizontit.
8. Pastaj u lëshua dhe iu afrua atij,
9. sa largësia mes dy harqeve apo edhe më afër
10. dhe i shpalli robit të Tij atë që i shpalli.
11. Zemra nuk e kundërshtoi atë që ai pa.
12. Vallë, ju po e kundërshtoni për atë që ka parë!
13. Në të vërtetë, ai e ka parë atë edhe një herë tjetër,
14. tek Sidretul Munteha,
15. pranë së cilës është Xheneti Me'ua,
16. kur Sidrën e mbulonte çfarë e mbulonte.
17. Shikimi i tij nuk u shmang e as nuk tejkaloi masën.
18. Ai pa vërtet disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.

Shpjegimi i ajeteve

- "Betohem në yllin kur perëndon..." - Allahu i Lartësuar betohet në yjet, të cilët

zhduken nga horizonti me përfundimin e natës dhe shkrepjen e agimit. Kjo është një dukuri që e meriton që Zoti të betohet në të. Ky betim bëhet për të përforcuar faktin që Shpallja të cilën Allahu ia dha Profetit të Tij është e vërtetë dhe e saktë. Ajo është Shpallje e Zotit të gjithësisë.

Këtu vihet re një paralelizëm i çuditshëm. Allahu i Lartësuar i bëri yjet zbukurues të qiellit dhe udhëzues për njerëzit në errësirë, në det apo në tokë qofshin. Po kështu, edhe Shpallja e Tij është zbukurim dhe udhëzim për njerëzit. Nëse nuk do të ekzistonte dituria e trashëguar nga profetët, njerëzimi do të ishte në errësirë të thellë, si në një natë të errët dhe pa yje.

- "...se shoku juaj nuk ka humbur dhe nuk ka devijuar!" - Betimi bëhet për të treguar se Profeti (a.s.) ishte i ruajtur nga devijimet, qoftë në dituri apo në qëllime. Profeti (a.s.) ishte i udhëzuar nga Zoti me diturinë që Ai i dhuroi, ashtu siç ishte dhe udhëzues për të tjerët.

Nga ajeti kuptojmë, gjithashtu, se qëllimet e këtij Profeti ishin tepër të larta. E si të mos ishin të tilla, kur ato bazoheshin në Shpalljen e të Gjithëdijshmit Mëshirues?! Ai synonte që ta udhëzonte umetin e tij në rrugën më të mirë dhe më të lehtë drejt Zotit të tyre. Ndryshe është gjendja e ftuesve në rrugët e humbjes, dituria e të cilëve është e prishur, e keqe dhe qëllimet e tyre janë të frikshme.

Allahu i Lartësuar thotë: "*sahibukum*" - "shoku juaj" për të kujtuar faktin që ai ishte një njeri i njohur i tyre, të cilit ata ia njihnin prejardhjen fisnike, ashtu si edhe sinqeritetin apo besnikërinë e tij. Ata e kuptonin shumë mirë se ai ishte njeri i udhëzuar. Allahu i Lartësuar e përforcon këtë fakt kur thotë:

- "Ai nuk flet sipas qejfit, por ato janë veçse shpallje, që i vijnë atij." - Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo që thotë është Shpallje nga Zoti. Ai ndjek veçse Shpalljen hyjnore, e cila përmban udhëzimin e drejtë dhe siguron arritjen e devotshmërisë për ata që e zbatojnë.

Ky ajet tregon se edhe Suneti i Profetit (a.s.), ashtu sikurse Kurani, është shpallje nga Zoti i Madhëruar, ashtu sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Po të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij ndaj teje, një grup prej tyre do të tentonin të të devijonin, por ata nuk devijojnë askënd veç vetes së tyre dhe nuk mund të të dëmtojnë aspak. Allahu të shpalli ty Librin dhe Urtësinë e të mësoi çfarë t'i nuk dije. Dhuntia e Allahut ndaj teje është shumë e madhe." [Nisa 113.]

Ajeti, gjithashtu, tregon se Profeti (a.s.) ishte i ruajtur nga gabimet apo devijimet, kur bëhej fjalë për transmetimin e qartë të Shpalljes dhe Ligjit nga Allahu i Lartësuar, sepse në ajet thuhet se ai nuk fliste nga mendja e vet apo sipas dëshirës së tij, por ai ishte transmetues besnik dhe korrekt i Shpalljes së Zotit.

Në vijim, Allahu i Lartësuar përmend mësuesin që ia mësoi Kuranin Profetit (a.s.). Ai është Xhibrili (a.s.) më i miri, më i forti dhe më i përkryeri i melekëve. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Atë ia mësoi ai, i fuqishmi, që ka mendje të lartë dhe që u shfaq në formën e vet reale, në pikën më të lartë të horizontit. Pastaj u lëshua dhe iu afrua atij, sa largësia mes dy harqeve apo edhe më afër..." - Ai që e zbriti Shpalljen nga Zoti te Profeti (a.s.) është Xhibrili (a.s.). Ai është tepër i fuqishëm

në të gjitha aspektet. Allahu i Lartësuar e krijoi të tillë, që të jetë i denjë për të vënë në zbatim urdhrat e Tij. Pa dyshim që vepra më e rëndësishme dhe më madhështore e Xhibrilit (a.s.) ishte përcjellja e Shpalljes me besnikëri te Profeti i Zotit, Muhamedi (a.s.), duke mos lejuar ndërhyrjen e shejtanëve në të. Ata të mallkuar nuk mund të heqin apo të shtojnë asgjë në Shpalljen e Zotit. Allahu i Lartësuar e ka ruajtur të sigurt dhe të paprekshme Shpalljen e Tij, dhe ndër masat më të rëndësishme në këtë aspekt ishte pikërisht ngarkimi me këtë detyrë i melekut Xhibril (a.s.), të dërguarit të Tij besnik dhe të fuqishëm.

Xhibrili (a.s.) u ngrit në pikën më të lartë të horizontit, atje ku shejtanët nuk mund të arrinin dot. Pastaj ai iu afrua Profetit (a.s.), për t'i përcjellë atij Shpalljen e Zotit. Ai qëndroi shumë pranë tij. Ai qëndroi vetëm dy harqe larg Profetit (a.s.), ose edhe më pranë. Kjo tregonte për rëndësinë e madhe të asaj që do të ndodhte. Muhamedit (a.s.) do t'i jepej Shpallja dhe mes tij e Xhibrilit nuk duhej të kishte asnjë ndërmjetës apo përgjues.

- "...dhe i shpalli robit të Tij atë që i shpalli." – Kështu, nëpërmjet Xhibrilit (a.s.), Allahu i Lartësuar i shpalli adhuruesit të Tij, Muhamedit (a.s.), Sheriatin madhështor dhe udhëzimin e drejtë.

- "Zemra nuk e kundërshtoi atë që ai pa." - Zemra, dëgjimi, shikimi dhe e gjithë qenia e Muhamedit (a.s.) u përqendrua për të marrë Shpalljen nga Zoti i Lartësuar. Ky është argument që tregon se sa e përkryer ishte mënyra me të cilën Profeti (a.s.) mori Shpalljen nga Allahu i Madhëruar. Ai e mori Shpalljen në mënyrë shumë të sigurt, që nuk lejonte asnjë dyshim apo luhatje. Zemra e tij nuk e mohoi atë që i panë sytë. Asnjë pasiguri nuk zuri vend në zemrën e tij.

Ka shumë mundësi që këtu të bëhet fjalë për shenjat e mëdha që Muhamedi (a.s.) pa Natën e Israsë, dhe ky është shpjegimi më i saktë i ajetit. Disa të tjerë janë të mendimit se këtu bëhet fjalë për shikimin e Zotit të Lartësuar nga ana e Profetit (a.s.) dhe dëgjimin e fjalëve që Zoti i drejtoi atij Natën e Israsë. Ky është qëndrimi i shumë dijetarëve, - Allahu i mëshiroftë, - të cilët pohojnë se Profeti (a.s.) e pa Zotin e tij në dynja. Sidoqoftë, mendimi më i saktë është se Profeti (a.s.) pa disa shenja të mëdha të Zotit të Lartësuar, por edhe Xhibrilin (a.s.), sikurse kuptohet nga konteksti. Profeti (a.s.) e ka parë Xhibrilin (a.s.) në formën e tij reale dy herë: një herë në kupën e qiellit të dynjasë, në kohën e shpalljes, dhe herën e dytë mbi qiellin e shtatë, Natën e Israsë, siç thotë i Lartësuari:

- "Vallë, ju po e kundërshtoni për atë që ka parë! Në të vërtetë, ai e ka parë atë edhe një herë tjetër, tek Sidretul Munteha, pranë së cilës është Xheneti Me'ua..." - Muhamedi (a.s.) e ka parë Xhibrilin (a.s.) edhe një herë tjetër, te Sidretul Munteha, e cila është një pemë shumë e madhe sipër qiellit të shtatë. Ajo quhet "Sidretul Munteha" - "Sidra e Skajshme", sepse deri tek ajo shkojnë njohuritë e krijesave, pasi ajo është sipër qiejve dhe Tokës, ose edhe për shkaqe të tjera, që Allahu i di më së miri.

Kështu, Muhamedi (a.s.) e pa Xhibrilin (a.s.) pikërisht në atë vend, i cili është vendi i shpirtrave të pastër, të bukur dhe të lartë, vend të cilit nuk mund t'i afrohen shejtanët

dhe shpirtrat e ulët dhe të pisët. Pikërisht pranë asaj peme ndodhet "*Xheneti Me'ua*", domethënë, Xheneti që përmban të gjitha llojet e mirësive dhe begative, Xheneti të cilin e ëndërrojnë të gjithë për ta arritur, Xheneti për të cilin të gjithë janë të përmalluar. Ky ajet dëshmon se Xheneti gjendet në vendin më të lartë, sipër qiellit të shtatë.

- "...kur Sidrën e mbulonte çfarë e mbulonte." - Këtë pemë e mbulon diçka shumë madhështore, të cilën e di vetëm Zoti Krenar dhe i Lartësuar.

- "Shikimi i tij nuk u shmang e as nuk tejkaloi masën." - Shikimi i Profetit (a.s.) nuk devijoi djathtas ose majtas dhe as nuk tejkaloi masën. Kjo tregon për edukatën e lartë të Profetit (a.s.), të shfaqur edhe në shikimin e tij. Edhe pse ai u ngrit në një gradë aq të lartë, ai nuk devijoi dhe nuk e tejkaloi masën në zbatimin e urdhrit, për të treguar kështu moralin e tij të lartë, që nuk mundi ta arrijë askush prej krijesave, nga të parët deri tek të fundit. Njeriu mund ta cenojë gradën e tij në lidhje me detyrimet duke mos i zbatuar fare ato, duke i zbatuar me mangësi ose duke devijuar prej tyre, por Profeti (a.s.) ishte i ruajtur nga të gjitha këto.

- "Ai pa vërtet disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet." - Profeti (a.s.) pa Xhenetin, Xhehenemin e shumë gjëra të tjera të fshehta. Kjo ndodhi Natën e Israsë.

Ajetet 19 – 25

19. A i shihni Latën dhe Uzzanë?
20. Dhe atë të tretin e të fundin, Menatin?
21. A mendoni se meshkujt janë tuajt, e të Atij femrat?
22. Atëherë kjo është një ndarje e padrejtë!
23. Ata nuk janë gjë tjetër, vetëm se emra, që ju dhe prindërit tuaj i caktuat. Allahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Por ata ndjekin vetëm hamendësimet dhe dëshirat e veta, megjithëse prej Zotit të tyre u ka ardhur udhëzimi.
24. A do të arrijë njeriu gjithçka që dëshiron?!
25. Vetëm Allahut i takon bota tjetër dhe kjo botë.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi përshkroi pastërtinë e Shpalljes së Tij, Allahu i Lartësuar flet për kotësinë e besimit të politeistëve, të cilët adhurojnë idhuj, që janë të mangët dhe shumë larg cilësive të larta e të plota të Allahut të Lartësuar, që është i vetmi i Adhuruar me meritë:

- "A i shihni Latën dhe Uzzanë? Dhe atë të tretin e të fundin, Menatin?" – Këta ishin idhujt e tyre, të cilët nuk kishin fuqi e aftësi për të bërë asgjë, as dëm as dobi. Ata ishin thjesht emra të thatë, të vënë nga idhujtarët dhe paraardhësit e tyre injorantë për idhujt e tyre. Në këtë mënyrë, ata thjesht mashtronin vetveten dhe devijonin të tjerët, duke i ftuar që t'u nënshtroheshin atyre gjërave të kota.

Pa dyshim, ata idhuj nuk meritonin asnjë lloj adhurimi, edhe po të kishin emra madhështorë dhe tërheqës, pasi nuk gëzonin asnjë atribut real që mund të tregonin ata emra. Për shembull, ata pretendonin se emri *Lat* e kishte prejardhjen nga fjala '*Ilah*" (Zot), prandaj idhulli me atë emër e meritonte adhurim. Për emrin *Uzza* thoshin se e kishte prejardhjen nga '*Aziz*' (Ngadhënjyesi), ndërsa *Menat* e kishte prejardhjen nga

Menan (Bamirësi). Në fakt, *El Ilah, El Aziz* dhe *El Menan* janë disa nga emrat e Allahut të Lartësuar, të cilët ata ua atribuonin padrejtësisht idhujve të tyre. Kjo qe një padrejtësi dhe paturpësi e madhe e idhujtarisë. Adhurimi i plotë i takon vetëm dhe vetëm Allahut të Lartësuar.

- "A mendoni se meshkujt janë tuajt, e të Atij femrat? Atëherë kjo është një ndarje e padrejtë!" - Ju pretendoni se Allahu ju ka privilegjuar ju me fëmijë meshkuj, ndërsa për Veten e Tij ka mbajtur femra? Sipas kësaj, juve ju takon pjesa më e mirë, ndërsa Zotit pjesa më pak e preferuar. Kjo sigurisht që është një ndarje jo e drejtë, e pretenduar nga ana juaj. E ku ka ndarje më të keqe dhe të padrejtë se ajo që vlerëson krijesën mbi Krijuesin! I lartësuar qoftë Allahu i Madhëruar nga fjalët e tyre!

- "Ata nuk janë gjë tjetër, vetëm se emra, që ju dhe prindërit tuaj i caktuat. Allahu nuk zbriti për ta ndonjë fakt. Por ata ndjekin vetëm hamendësimet dhe dëshirat e veta..." - Çdo besim që nuk argumentohet dhe vërtetohet nga Allahu i Lartësuar është i pasaktë dhe i kotë, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si besim i drejtë. Kështu ishte besimi i idhujtarëve. Ata nuk pasonin çështje të sigurta, të mbështetura në fakte e prova, por thjesht merreshin me hamendësime. Shtoji këtyre injorancën e thellë, dëshirat e prishura dhe prirjet e sëmura drejt shirkut, dhe humbja e tyre bëhej shumë më e thellë. Mos vallë mungonte udhëzimi i drejtë nga Zoti, dhe kështu ata ishin të justifikuar? Jo, kurrsesi. Allahu i Lartësuar thotë:

- "...megjithëse prej Zotit të tyre u ka ardhur udhëzimi." - Atyre u erdhi nga Zoti i Lartësuar udhëzimi i qartë, i cili u tregonte rrugën e drejtë dhe i mësonte se si ta njësonin Zotin dhe si t'i trajtonin profetët e Tij. Ky udhëzim sqaron gjithçka që robërit kanë nevojë ta dinë. Allahu i Lartësuar e ka përforcuar atë me prova dhe argumente të forta, të cilat e bëjnë të detyrueshme për çdo njeri që të nënshtrohet dhe ta zbatojë këtë udhëzim. Pas fakteve të Zotit, askujt nuk i mbetet më justifikim nëse e lëshon rrugën e Tij. E si mund të krahasohet kjo fe madhështore, e faktuar dhe e argumentuar qartë nga Zoti i gjithësisë, me fenë e idhujtarëve, të ndërtuar mbi hamendësime të kota?! Nëse dikush vazhdon përsëri në të kotën, edhe pas këtyre sqarimeve, atëherë e pret ndëshkimi i përjetshëm.

Këta të mjerë vazhdojnë të vetëmashtrohen me kotësinë që ndjekin, por Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë ëndrrat e tyre, duke thënë:

- "A do të arrijë njeriu gjithçka që dëshiron?! Vetëm Allahut i takon bota tjetër dhe kjo botë." - Mos vallë njeriu pretendon se do të arrijë gjithçka që dëshiron në dynja dhe në ahiret. Dynjaja dhe ahireti janë plotësisht në dorën e Allahut të Lartësuar. Ai begaton dhe privon në dynja dhe ahiret atë që dëshiron, sipas dijes dhe urtësisë së Tij absolute. Pra, çështjet nuk shkojnë sipas dëshirave dhe ëndrrave të njeriut.

Ajeti 26

26. Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi, vetëm nëse Allahu i jep leje atij që Ai dëshiron dhe është i kënaqur me të.

Shpjegimi i ajetit

Shumë njerëz adhurojnë engjëjt apo gjëra të tjera, duke pretenduar se ata do të ndërmjetësojnë tek Allahu i Lartësuar për shpëtimin e tyre në Ditën e Gjykimit. Por Allahu i Lartësuar ua hedh poshtë këtë pretendim dhe ua ndërpret këtë shpresë, duke thënë: Sa engjëj ka në qiej, ndërmjetësimi i të cilëve nuk bën asnjë dobi...". Pra, sa e sa melekë të afërt, të nderuar dhe të mëdhenj ka në qiell, të cilët janë të pafuqishëm t'u sjellin dobi atyre që u luten dhe që shpresojnë në ndërmjetësimin e tyre. Allahu i Lartësuar nuk ka lënë në dorën e krijesave asnjë mundësi për të sjellë dëm apo dobi. Edhe ndërmjetësimet e robërve për njëri-tjetrin, hapësirë të cilën Ai e ka lejuar, mund të hyjnë në punë veçse me dy kushte: së pari, Allahu i Lartësuar ta lejojë këtë ndërmjetësim dhe, së dyti, Allahu i Lartësuar të jetë i kënaqur me atë për të cilin do të ndërmjetësohet.


Por dihet mirë se Allahu i Lartësuar nuk pranon asnjë vepër nëse nuk plotësohen dy kushte të saj: 1. ajo të kryhet me sinqeritet ndaj Allahut të Lartësuar dhe duke synuar kënaqësinë e Tij; 2. të kryhet në përputhje me porositë e Profetit të Tij. Për këto arsye, idhujtarët nuk mund të përfitojnë kurrë nga ndërmjetësimet. Ata e kanë privuar vetet nga mëshira e të Gjithëmëshirshmit.

Ajetet 27 – 30

27. Vërtet, ata që nuk e besojnë jetën tjetër, i emërtojnë engjëjt me emra femrash.

28. Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin veçse hamendësime, ndonëse hamendësimi nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën.

29. Largohu prej atyre që i kanë kthyer shpinën Kuranit dhe që synojnë veçse jetën e kësaj bote!



30. Aq është e tërë dituria që ata kanë arritur. Zoti yt është më i dituri rreth atyre që janë larguar nga rruga e Tij dhe Ai është më i dituri rreth atyre që janë në rrugën e drejtë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Vërtet, ata që nuk e besojnë jetën tjetër, i emërtojnë engjëjt me emra femrash."** - Ata që adhurojnë zota të tjerë, që mohojnë profetët e Zotit e që nuk besojnë ahiretin, pikërisht për shkak të këtij mosbesimi, ata kanë guximin të kryejnë të tilla gjynahe të shëmtuara. Ata kanë paturpësinë të thonë fjalë të ulëta, duke treguar armiqësinë e tyre me Allahun dhe Profetin e tij. Ata shpifin e thonë se melekët janë vajzat e Allahut. Në këtë mënyrë, së pari, ata kanë shpifur kundrejt Allahut të Lartësuar, i Cili nuk ka lindur askënd dhe është i pastër nga kjo cilësi dhe, së dyti, kanë shpifur për melekët,

duke thënë se ata janë femra, fakt për të cilin ata nuk kanë dijeni as nga Zoti dhe as nga Profeti (a.s.). Madje, edhe logjika e pastër i hedh poshtë pretendimet e tyre. E vërteta qëndron krejt ndryshe nga ajo që ata pretendojnë. Pa dyshim, Allahu i Lartësuar nuk ka nevojë për fëmijë dhe bashkëshorte, se Ai është Një dhe i Vetëm. Ai është *El Samed* - Zotëruesi i gjithçkaje, të Cilit të gjitha krijesat i drejtohen me lutje e përgjërim për nevojat e tyre. Ai as ka lindur dhe as është i lindur prej kujt. Me Allahun askush nuk mund të jetë i njëjtë dhe i barabartë. Ndërsa melekët janë robër të zgjedhur, të nderuar dhe të afruar tek Allahu, shërbëtorë të nënshtruar dhe të bindur ndaj Tij, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet: "O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej Zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun në asnjë urdhër të Tij, por zbatojnë atë që u është urdhëruar." [Tahrim 6].

- "Ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë, por ndjekin veçse hamendësime, ndonëse hamendësimi nuk mund ta zëvendësojë aspak të vërtetën." - Mohuesit e Zotit dhe idhujtarët nuk kanë asnjë argument dhe fakt të sigurt për këto fjalë të shëmtuara që thonë. Ata thjesht hamendësojnë, dhe dihet që hamendësimet janë shumë larg të vërtetës. E vërteta duhet të mbështetet patjetër në dije të sigurt dhe fakte të qarta. Pa dyshim, burimi i vetëm i këtyre është Shpallja e Zotit të Lartësuar.

Me hamendësimet e tyre, të devijuarit nuk synojnë që të gjejnë të vërtetën. Ata thjesht duan të plotësojnë dëshirat e tyre. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që të distancohet prej atyre:

- "Largohu prej atyre që i kanë kthyer shpinën Kuranit dhe që synojnë veçse jetën e kësaj bote! - Ata i kanë kthyer shpinën Librit të Allahut, Kuranit madhështor, i cili është i mbushur me urtësi dhe begati. Në këtë mënyrë, ata e kanë privuar veten e tyre nga dituria e dobishme, duke iu përkushtuar tërësisht jetës së dynjasë dhe kënaqësive të saj. Dynjaja është i vetmi pikësynim i tyre, prandaj të gjithë mundin ia përkushtojnë vetëm asaj. Njeriu i përkushtohet asaj që ka për qëllim, dhe qëllimi i këtyre të mjerëve është i kufizuar me dynjanë, me çfarëdolloj mënyre u realizoftë ai. I Lartësuari thotë:

- "Aq është e tërë dituria që ata kanë arritur." – Kaq është kufiri i dijes dhe i qëllimeve të tyre. Ndërsa besimtarët, të cilët e besojnë Ditën e Gjykimit, janë të ndriçuar me dijen e sigurt dhe me arsyen e shëndoshë. Qëllimi i tyre është i përqendruar në arritjen e shpërblimit dhe lumturisë në ahiret. Dituria e tyre është më e vyera dhe më e mira, sepse ajo është përftuar nga Libri i Allahut dhe Suneti i Pejgamberit të Tij, Muhamedit (a.s.).

- **"Zoti yt është më i dituri rreth atyre që janë larguar nga rruga e Tij dhe Ai është më i dituri rreth atyre që janë në rrugën e drejtë." -** Allahu i Lartësuar është më i dituri për ata që meritojnë udhëzimin dhe ata që nuk e meritojnë atë. Ata që i mbështeten vetëm Atij dhe ia kërkojnë udhëzimin vetëm Atij, duke e adhuruar si Një të vetëm, Ai i udhëzon në rrugën e drejtë, duke u dhënë dije të saktë dhe duke i ndihmuar të punojnë

sipas saj. Ndërsa ata të cilët e shpërfillin adhurimin e Allahut dhe nuk e marrin për bazë diturinë e ofruar nga Ai dhe Profeti i Tij, Ai i lë të mbështeten në forcat e tyre, dhe kështu humbja e tyre është e pashmangshme. Allahu i Lartësuar është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm, prandaj dhe udhëzimin ia jep atij që e meriton.

Ajetet 31 – 32

31. Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq sipas veprave të veta, e për t'u dhënë atyre që bëjnë mirë shpërblimin më të mirë.

32. Për ata që largohen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave të ndyra, përveç ndonjë gjynahu të vogël, s'ka dyshim se Zoti yt është i gjerë në falje. Ai është më i dituri rreth jush, qysh kur e filloi krijimin tuaj nga dheu dhe qysh kur ishit fetus në bark të nënës suaj. Atëherë, mos e mburrni veten, sepse Ai e di më mirë se cili është vërtet i devotshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, për t'i dënuar ata që bëjnë keq sipas veprave të veta, e për t'u dhënë atyre që bëjnë mirë shpërblimin më të mirë." - Allahu i Lartësuar na tregon në këto ajete se vetëm Ai është Pronari dhe Sunduesi i gjithçkaje. Vetëm në dorën e Tij janë dynjaja dhe ahireti. Çdo gjë që ekziston në qiell dhe në Tokë janë krijesë dhe pronë e Tij, me të cilat Ai vepron si Sundues i madh dhe i plotfuqishëm. Në këtë gjithësi zbatohet vetëm caktimi i Tij. Ligji ndaj të cilit krijesat duhen të nënshtrohen është ligji i Tij. Është Ai, i vetmi, që ka të drejtën të urdhërojë dhe të ndalojë, të vendosë ligje dhe të marrë në llogari për zbatimin e tyre. Allahu i Lartësuar është Ai që do t'i shpërblejë krijesat sipas veprave të tyre, në lidhje me zbatimin e urdhrave dhe respektimin e kufijve të Tij. Të bindurit ndaj Tij, Ai do t'i shpërblejë me mëshirën dhe bujarinë e Tij. Ndërsa ata që nuk i binden, por bëjnë vepra të këqija, Ai do t'i ndëshkojë me drejtësinë e Tij. Ata që janë bamirës, qoftë në drejtim të adhurimit, qoftë në drejtim të marrëdhënieve me njerëzit, Allahu i Lartësuar do t'i shpërblejë në dynja dhe ahiret. Por më e madhe se çdo shpërblim tjetër është kënaqësia e të Madhërishmit dhe lumturia e tyre në përjetësinë e Xhenetit.

Më poshtë, Allahu i Lartësuar përshkruan cilësitë e këtyre bamirësve:

- "Për ata që largohen prej gjynaheve të mëdha dhe veprave të ndyra, përveç ndonjë gjynahu të vogël, s'ka dyshim se Zoti yt është i gjerë në falje." - Ata zbatojnë me përpikmëri detyrimet ndaj Zotit të Lartësuar. Po të lihen pa u zbatuar këto detyrime, konsiderohet si gjynah i madh. Gjithashtu, ata u largohen të gjitha gjynaheve të mëdha, si: zinaja, konsumimi i pijeve dehëse, marrja me fajde, vrasja e padrejtë etj.

Allahu i Lartësuar thotë: "përveç *el lemem*". *El lemem* janë gjynahet e vogla dhe jo të vazhdueshme. Pra, janë ato gjynahe, të cilat robi u kthehet herë pas here, në momente dobësie, por që ndodhin rrallë. Të tilla gjynahe nuk ia heqin robit etiketimin 'bamirës', nëse ai u largohet gjynaheve të mëdha. Me fjalë të tjera, nëse robi kryen detyrat dhe u largohet harameve të mëdha, Allahu i Lartësuar premton se do t'ia falë gjynahet, me mëshirën dhe faljen e Tij të

gjerë, që ka përfshirë gjithçka, kur thotë: ... s'ka dyshim se Zoti yt është i gjerë në falje." Sikur të mos ishte falja dhe mëshira e gjerë e Zotit, njerëzit dhe vendet do të shkatërroheshin. Sikur Allahu i Lartësuar, me drejtësinë e Tij, t'i ndëshkonte krijesat për gjynahet e tyre, qielli do të rrëzohej mbi tokë dhe nuk do të linte në të asnjë gjallesë. Por i Madhëruari, me mëshirën dhe bamirësinë e Tij, i mbulon të metat dhe fal shumë. Gjithashtu, Ai iu ka mundësuar njerëzve që, nëpërmjet veprave të mira, t'ua falë gjynahet, duke i pastruar prej tyre. Kështu, Profeti (a.s.) ka thënë: "Pesë namazet, nga xhumaja në xhuma apo nga ramazani në ramazan, të gjitha këto janë falje për gjynahet e kryera mes tyre, nëse ju u largoheni atyre të mëdhave."

- "Ai është më i dituri rreth jush, qysh kur e filloi krijimin tuaj nga dheu dhe qysh kur ishit fetus në bark të nënës suaj." – Kuptimi: Allahu i Lartësuar ka dijeni të plotë për ju dhe për gjendjet nëpër të cilat kaloni. Ai ka dijeni të plotë për prirjet që ka vendosur tek ju dhe për dobësitë që ju karakterizojnë. Ai e njeh shumë mirë dobësinë tuaj në zbatimin e urdhrave, si dhe prirjen tuaj drejt harameve. Janë të shumta rrugët që të çojnë drejt haramit dhe, shpeshherë, përballja me to është shumë e vështirë, sidomos kur dobësohet besimi dhe mbështetja tek Ai. Allahu i Lartësuar i di të gjitha këto, sepse është Ai që ju krijoi së pari nga toka, ashtu siç është Ai që ju krijon në barkun e nënës suaj. Është e vërtetë që Allahu i Lartësuar ju ka pajisur me forcë të mjaftueshme për të përballuar zbatimin e çdo porosie të Tij dhe kurrë nuk ju ka ngarkuar me vështirësi të tepërta në fenë tuaj. Por, gjithsesi, ju do të vazhdoni të jeni të dobët, prandaj keni nevojë për mbështetjen e të Madhërishmit, mëshirën dhe faljen e Tij të gjerë.

I Lartësuari ua fal gjynahet dhe ua largon të këqijat robërve, sidomos kur qëllimi i tyre është arritja e kënaqësisë së Tij në të gjitha kohët dhe gjendjet. Nëse robi përpiqet vazhdimisht të kryejë punë të mira për t'u afruar tek Allahu dhe largohet nga haramet të cilat Allahu i Lartësuar nuk i do, atëherë i Lartësuari e fal dhe e përfshin në mëshirën e Tij të madhe, edhe pse herë pas here ai mund ta lëshojë veten në ndonjë gjynah. Allahu i Lartësuar është më Bujari dhe më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve. Ai është më i mëshirshëm për robin e Tij sesa nëna për fëmijën e saj, prandaj për të tillë njerëz, mëshira e falja e Tij do të jetë shumë pranë. Allahu i Lartësuar do t'u përgjigjet lutjeve të tyre dhe gjithmonë do t'ua pranojë pendimin.

Në vijim, Allahu i Lartësuar na e bën të qartë që të gjithë kemi nevojë për pastrimin që vjen prej Tij dhe askush nuk mund të pretendojë pastrimin e gjynaheve me forcat e veta. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "Atëherë, mos e mburrni veten, sepse Ai e di më mirë se cili është vërtet i devotshëm." - Mos u lëvdoni para njerëzve, duke pretenduar pastërtinë e shpirtit tuaj dhe devotshmëri. Devotshmëria është thellë në zemër dhe është Allahu që e shikon atë. Është Allahu Ai që do t'i shpërblejë punëmirët për devotshmërinë e tyre, ndërsa njerëzit nuk kanë asgjë në dorë për t'ju shpërblyer apo për t'ju ruajtur nga ndëshkimi i Allahut. Mjafton që Allahu shikon në zemrën tuaj dhe që ju shpërblen, me bamirësinë dhe bujarinë e Tij.

Ajetet 33 – 62

33. A e ke vënë re atë që kthen shpinën,
34. i cili bën pak, e pastaj e ndërpret?
35. Mos vallë, ai ka njohuri për të fshehtën dhe e sheh atë?
36. Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Fletët e Musait
37. dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi të gjitha detyrimet:
38. Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit
39. dhe njeriu meriton vetëm atë që ka bërë vetë.
40. Puna e tij pa dyshim që do të shihet,
41. dhe pastaj ai do të marrë shpërblimin më të plotë;
42. Pa dyshim, te Zoti yt do të jetë kthimi.
43. Ai sjell buzëqeshjen dhe lotët.
44. Ai jep vdekjen dhe jetën.
45. Është Ai që i krijoi llojet në çift - mashkull dhe femër,
46. nga një pikë lëngu, që hidhet.
47. Është detyrë e Tij ringjallja tjetër.
48. Është Ai që pasuron dhe varfëron.
49. Ai është Zoti i Yllit Polar.
50. Është Ai që i shkatërroi adët e lashtë
51. dhe themudët, prej të cilëve nuk mbeti asnjë.
52. edhe popullin e Nuhut më herët. Vërtet, ata ishin edhe më zullumqarë dhe të shfrenuar.
53. edhe mu'tefikët, të cilët i përplasi prej së larti.
54. Ata i përfshiu ajo që i përfshiu!
55. Atëherë, për cilën mirësi të Zotit tënd ke dyshime?
56. Ky është një paralajmërues, si gjithë paralajmëruesit e mëparshëm.
57. E afërta është afruar!
58. Askush nuk mund ta largojë atë, veç Allahut!
59. Vallë, prej këtyre fjalëve po çuditeni
60. dhe po qeshni, e nuk po qani?!
61. Madje, zhyteni me thellë në shkujdesje!
62. Bini në sexhde për Allahun dhe adhurojeni Atë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A e ke vënë re atë që kthen shpinën, i cili bën pak, e pastaj e ndërpret?" - A e ke vënë re se sa e keqe është gjendja e atyre që ftohen për ta adhuruar dhe njësuar Zotin e tyre në çdo aspekt, por ata i kthejnë shpinën kësaj ftese? Edhe nëse në ndonjë moment vetja e tyre i lejon që t'i përgjigjen kësaj ftese, ata nuk vazhdojnë gjatë në të, por shpejt i kthehen zakonit të vjetër, duke u treguar koprracë dhe duke ndaluar veten nga adhurimi i Zotit. Veprat e mira nuk janë shprehi të tyre. Në natyrë, ata janë rebelë dhe gjithmonë i kthejnë shpinën bindjes ndaj Allahut. Nëse ndonjëherë kryejnë ndonjë vepër të mirë, ata nuk vazhdojnë gjatë në këtë rrugë, por përsëri kthehen atje ku ishin. Megjithatë, ata u lëvdohen të tjerëve:

- "Mos vallë, ai ka njohuri për të fshehtën dhe e sheh atë?" - A e shikojnë ata të fshehtën apo thjesht shpifin për Allahun, duke thënë gjëra për të cilat nuk kanë asnjë dijeni? Është Allahu i Lartësuar që pastron ata që Ai dëshiron dhe askush nuk mund ta dijë të fshehtën e Tij.

Këta të mjerë bëjnë dy të këqija: jo vetëm që nuk i binden Zotit, por edhe mburren se janë të pastër e të devotshëm.

- "Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Fletët e Musait dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi të gjitha detyrimet..." - A nuk dinë këta njerëz për ngjarjet që përshkruhen në Fletët e Musait dhe të Ibrahimit (a.s.), i cili me të vërtetë i plotësoi të gjitha urdhëresat e Zotit të tij, të mëdha

dhe të vogla. Në ato fletë kishte shumë ligje dhe dispozita të rëndësishme, ndër të cilat edhe ato që Allahu i Lartësuar i tregon më pas:

- **"Askush nuk do të bartë barrën e tjetrit dhe njeriu meriton vetëm atë që ka bërë vetë."** - Çdokush do të merret në përgjegjësi dhe do të shpërblehet për veprat e tij, të mira apo të këqija qofshin. Askush nuk do të merret në përgjegjësi apo të përfitojë nga veprat e të tjerëve dhe askush nuk do të bartë gjynahun e tjetrit. Gjithashtu, askush të mos harrojë, madje të jetë i sigurt se:

- **"Puna e tij pa dyshim që do të shihet, dhe pastaj ai do të marrë shpërblimin më të plotë."** - Në ahiret do të shfaqen hapur veprat e çdokujt dhe secili do të shpërblehet për çdo të mirë apo të keqe që ka bërë. Shpërblimi do të jetë i plotë, i pacenuar. Për veprat e mira dhe të sinqerta, shpërblimi do të shumëfishohet, ndërsa për veprat e këqija do të ndëshkohet me drejtësi. Të gjitha krijesat atë ditë do të jenë dëshmitare të drejtësisë së Zotit dhe të bamirësisë dhe mëshirës së Tij. Të gjithë, pa përjashtim, do ta lavdërojnë Zotin për këtë. Madje, edhe banorët e Zjarrit, kur të hyjnë në të, zemrat do t'i kenë të mbushura me lavdërim për Zotin dhe do të pranojnë urtësinë e Tij absolute. Ata do të urrejnë vetveten dhe do ta pranojnë se ishin vetë ata shkaktarët që bën të merituar këtë ndëshkim.

Në fjalën e Allahut të Lartësuar: "...njeriu meriton vetëm atë që ka bërë vetë" janë mbështetur ata që thonë se veprat e mira nuk mund t'ju dhurohen të vdekurve dhe as të gjallëve. Askush nuk mund të shpërblehet për veprën e tjetrit. Por kjo mënyrë argumentimi vlen të shikohet më me kujdes. Është e vërtetë se robi do të shpërblehet për atë që ka bërë vetë. Por kjo nuk përjashton mundësinë që, ndonjëherë, ai të përfitojë nga ndonjë mirësi që mund t'i dhurohet nga të tjerët. Një shembull i ngjashëm me këtë është pasuria që zotëron njeriu, e cila i takon vetëm atij, por kjo nuk pengon që ai të përfitojë nga ndonjë dhuratë, që dikush mund t'ia japë.

- **"Pa dyshim, te Zoti yt do të jetë kthimi."** - Të gjitha çështjet kthehen vetëm tek Zoti. Të gjitha krijesat do të ringjallen, tubohen dhe llogariten tek Allahu i Lartësuar. Dituria dhe urtësia e plotë i takon vetëm Allahut të Lartësuar, i Cili është i vetmi Gjykues i drejtë. Atij i takon mëshira e plotë dhe çdo cilësi e plotë.


- **"Ai sjell buzëqeshjen dhe lotët."** - Është Allahu që ka sjellë në ekzistencë shkaqet që të bëjnë të qeshësh apo të qash. Ai ka krijuar të mirën dhe të keqen, gëzimin dhe lumturinë, frikën dhe trishtimin. Të gjitha këto, Allahu i Lartësuar i ka bërë të ekzistojnë sipas dijes dhe urtësisë së Tij absolute.

- **"Ai jep vdekjen dhe jetën." -** Allahu është i vetmi në dorën e të Cilit është jeta dhe vdekja. Ai i krijoi krijesat për t'i urdhëruar dhe ndaluar dhe për t'i marrë në llogari. Ai do t'i ringjallë ato pas vdekjes së tyre dhe do t'i shpërblejë me drejtësi dhe bamirësi, për atë që kanë bërë në jetën e dynjasë.

- "Është Ai që i krijoi llojet në çift-mashkull dhe femër, nga një pikë lëngu, që hidhet." - Allahu i Lartësuar është Ai i Cili çdo gjë e krijoi në çift, njerëzit dhe kafshët. Ai është i vetmi dhe më i miri Krijues.

Mënyra që Allahu i Lartësuar ka përcaktuar për shumimin e krijesave është një nga argumentet më të mëdha, që tregojnë për pushtetin e plotë të Allahut të Lartësuar. Me pushtetin dhe diturinë e Tij, Ai bën të mundur që kafshët, të mëdha apo të vogla qofshin, të shumohen nëpërmjet farës së lëngshme. Allahu e fillon krijimin e njeriut në barkun e nënës, dhe pastaj, me përkujdesin e Tij të vazhdueshëm, njeriu plotësohet në formën më të mirë. Më pas, Allahu i Lartësuar i jep atij mundësinë për të zgjedhur, dhe njeriu ose ngrihet në gradat më të larta ose zhytet në skutat më të ulëta.

Me të vërtetë, mënyra e krijimit të njeriut është e mrekullueshme dhe një argument i pamohueshëm, që tregon për pushtetin absolut të Allahut të Lartësuar, i Cili kështu dëshmon edhe pushtetin e Tij të padiskutueshëm për t'i ringjallur krijesat, siç thotë më pas:


الجزء السابع والعشرون سورة النجم
وَأَنَّهُۥ خَلَقَ ٱلزَّوْجَيْنِ ٱلذَّكَرَ وَٱلْأُنثَىٰ ﴿٤٥﴾ مِن نُّطْفَةٍ إِذَا تُمْنَىٰ
﴿٤٦﴾ وَأَنَّ عَلَيْهِ ٱلنَّشْأَةَ ٱلْأُخْرَىٰ ﴿٤٧﴾ وَأَنَّهُۥ هُوَ أَغْنَىٰ وَأَقْنَىٰ ﴿٤٨﴾ وَأَنَّهُۥ
هُوَ رَبُّ ٱلشِّعْرَىٰ ﴿٤٩﴾ وَأَنَّهُۥٓ أَهْلَكَ عَادًا ٱلْأُولَىٰ ﴿٥٠﴾ وَثَمُودَا۟ فَمَآ
أَبْقَىٰ ﴿٥١﴾ وَقَوْمَ نُوحٍ مِّن قَبْلُ ۖ إِنَّهُمْ كَانُوا۟ هُمْ أَظْلَمَ وَأَطْغَىٰ
﴿٥٢﴾ وَٱلْمُؤْتَفِكَةَ أَهْوَىٰ ﴿٥٣﴾ فَغَشَّىٰهَا مَا غَشَّىٰ ﴿٥٤﴾ فَبِأَىِّ ءَالَآءِ
رَبِّكَ تَتَمَارَىٰ ﴿٥٥﴾ هَٰذَا نَذِيرٌ مِّنَ ٱلنُّذُرِ ٱلْأُولَىٰٓ ﴿٥٦﴾ أَزِفَتِ ٱلْآزِفَةُ
﴿٥٧﴾ لَيْسَ لَهَا مِن دُونِ ٱللَّهِ كَاشِفَةٌ ﴿٥٨﴾ أَفَمِنْ هَٰذَا ٱلْحَدِيثِ
تَعْجَبُونَ ﴿٥٩﴾ وَتَضْحَكُونَ وَلَا تَبْكُونَ ﴿٦٠﴾ وَأَنتُمْ سَٰمِدُونَ
﴿٦١﴾ فَٱسْجُدُوا۟ لِلَّهِ وَٱعْبُدُوا۟ ۩ ﴿٦٢﴾
سجدة
سُورَةُ القَمَرِ
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
ٱقْتَرَبَتِ ٱلسَّاعَةُ وَٱنشَقَّ ٱلْقَمَرُ ﴿١﴾ وَإِن يَرَوْا۟ ءَايَةً يُعْرِضُوا۟ وَيَقُولُوا۟
سِحْرٌ مُّسْتَمِرٌّ ﴿٢﴾ وَكَذَّبُوا۟ وَٱتَّبَعُوٓا۟ أَهْوَآءَهُمْ ۚ وَكُلُّ أَمْرٍ مُّسْتَقِرٌّ ﴿٣﴾
وَلَقَدْ جَآءَهُم مِّنَ ٱلْأَنۢبَآءِ مَا فِيهِ مُزْدَجَرٌ ﴿٤﴾ حِكْمَةٌۢ بَٰلِغَةٌ ۖ فَمَا تُغْنِ
ٱلنُّذُرُ ﴿٥﴾ فَتَوَلَّ عَنْهُمْ ۘ يَوْمَ يَدْعُ ٱلدَّاعِ إِلَىٰ شَىْءٍ نُّكُرٍ ﴿٦﴾
٥٢٨

- "Eshtë detyrë e Tij ringjallja tjetër." - Allahu i Lartësuar do t'i ringjallë njerëzit nga varret dhe do t'i tubojë ata në ditën e përcaktuar, për t'i shpërblyer për të mirat dhe të këqijat.

- "Është Ai që pasuron dhe varfëron." - Është Allahu i Lartësuar Ai që ua lehtëson krijesave çështjet e jetës dhe dynjasë së tyre, si tregtinë apo mënyrat e tjera të përfitimit. Gjithashtu, Ai i bën robërit që të mjaftohen dhe të jenë të kënaqur me atë që Ai u dhuron. Kështu, me mirësitë e dhuruara prej Tij, ata kënaqen dhe vazhdojnë jetën e kësaj dynjaje. Të gjitha mirësitë janë prej Allahut, dhe kjo e bën të detyrueshme që robërit të jenë mirënjohës dhe falënderues ndaj Tij, duke e adhuruar si Një të vetëm dhe të pashoq.

- "Ai është Zoti i Yllit Polar." – Ky yll i njohur quhet (në arabisht) *El Shi'ra*. Allahu i Lartësuar, edhe pse është Zoti i gjithçkaje, e veçoi këtë yll, sepse në kohën e injorancës, ai ishte shndërruar në objekt adhurimi. Kështu, Allahu i Lartësuar tregon se çdo gjë që adhurojnë idhujtarët është diçka e krijuar dhe e nënshtruar ndaj Allahut të Lartësuar. Atëherë, si mund të konsiderohet si e adhuruar diçka e tillë dhe të barazohet me Allahun e Lartësuar, që është i vetëm në meritueshmërinë e adhurimit?!

- "Është Ai që i shkatërroi adët e lashtë dhe themudët, prej të cilëve nuk mbeti asnjë." – Adët ishin populli i profetit Hud (a.s.). Kur ata mohuan Profetin e tyre, Allahu i Madhëruar i shkatërroi me një stuhi të fuqishme. Ndërsa themudët ishin populli i profetit Salih (a.s.). Allahu i Lartësuar e

dërgoi profetin Salih me mrekullinë e qartë të devesë, por populli i tij e shpërfilli këtë mrekulli dhe e vranë devenë. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i shkatërroi ata tërësisht, duke mos lënë të shpëtojë asnjërin.

- "...edhe popullin e Nuhut më herët. Vërtet, ata ishin edhe më zullumqarë dhe të shfrenuar." - Ndër popujt që Allahu i Lartësuar i shkatërroi ishte edhe populli i Nuhut (a.s.). Ata mohuan Profetin e tyre dhe nuk pranuan të nënshtroheshin e t'u bindeshin porosive të Zotit, prandaj i Lartësuari i mbyti ata me ujë.

- "...edhe mutefikët, të cilët i përplasi prej së larti. Ata i përfshiu ajo që i përfshiu! Atëherë, për cilën mirësi të Zotit tënd ke dyshime?" - Mutefikët ishin populli i Lutit (a.s.). Këtij populli të prishur dhe të degjeneruar, Allahu i Lartësuar i dha një ndëshkim, që nuk ia kishte dhënë asnjë populli tjetër. Ai e përmbysi tërësisht vendbanimin e tyre, dhe më pas i goditi furishëm me gurë të ndezur dhe zjarr.

- "Ky është një paralajmërues, si gjithë paralajmëruesit e mëparshëm." - Edhe ky i dërguar, Muhamedi, i biri i Abdullahit, Profeti nga mesi i Kurejshëve dhe Hashimijëve, nuk është profeti i parë i dërguar ndër njerëz. Ishin të shumtë profetët e dërguar para tij, të cilët i ftuan popujt e tyre në të njëjtën fe ku i fton dhe ai. Atëherë, cili është shkaku që ju e mohoni këtë profet dhe Shpalljen që atij iu dha? Çfarë argumenti do të paraqisni para Zotit për mohimin e Shpalljes së Tij? A nuk është morali i tij i njëjtë me moralin e të gjithë profetëve? A nuk urdhëroi ai për çdo të mirë dhe ndaloi nga çdo e keqe, ashtu sikurse bënë vëllezërit e tij profetë? Madje, ky profet solli prej Zotit të tij edhe Kuranin madhështor, një libër të cilit e pavërteta nuk mund t'i afrohet aspak, sepse ai është Shpallje e të Urtit, të Lavdëruarit. Allahu i Lartësuar i shkatërroi ata popuj që mohuan profetët e tyre. Atëherë, mos e harroni këtë fakt, por ruajuni që të mos ju godasë edhe ju ajo që i goditi ata që ishin para jush. Asgjë nuk e pengon ndëshkimin e të Madhërishmit kundër atyre që mohojnë më të zgjedhurin e profetëve, Muhamedin (a.s.), i cili është imami i të devotshmëve dhe udhëheqësi i popullit më të zgjedhur.

- "E Afërta është afruar! Askush nuk mund ta largojë atë, veç Allahut!" - Kijameti është afruar dhe shenjat pararendëse të tij janë shfaqur. Kur ajo ditë të vijë, askush nuk do të mund ta pengojë ndëshkimin e Allahut të Lartësuar, që do të jetë shumë i ashpër.

Pastaj Allahu i Lartësuar vijon që të kërcënojë të gjithë ata që mohojnë profetësinë e Muhamedit (a.s.) dhe refuzojnë Shpalljen që ai solli, Kuranin e lavdishëm. Kështu, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Vallë, prej këtyre fjalëve po çuditeni..." - Shpallja e sjellë nga Profeti i fundit është fjala më e lartë, më e mirë dhe më e përkryer. Ajo është fjala më e zgjedhur, fjala e Allahut të Lartësuar. Atëherë, si çuditeni dhe e mohoni këtë fjalë, duke pretenduar se ajo është në kundërshtim me realitetin? Ky pretendim i kotë e ka burimin tek padituria, devijimi dhe inati juaj, pasi kjo është fjala më e vërtetë. Nëse gjykon për diçka, në të gjen gjykimin më të drejtë. Shpallja hyjnore nuk është fjalë që mund të merret me tallje.

Kurani është fjalë e fuqishme, aq sa po të zbritej në ndonjë mal, mali do të strukej nga frika e Allahut të Madhëruar. Ky libër ua shton urtësinë të urtëve dhe besimtarët i udhëzon dhe i përforcon në rrugë të drejtë. Ai shton besimin dhe sigurinë në premtimet e Zotit. Çudi është vetëm me ata që mohojnë këtë libër, por kjo tregon sigurisht mendjelehtësinë dhe humbjen e tyre të thellë.

- "...dhe po qeshni, e nuk po qani?! Madje, zhyteni me thellë në shkujdesje!" - Në vend që shpirti juaj të zbutet dhe të ndikohet nga madhështia e këtij Kurani, ju çuditërisht qeshni dhe talleni me mesazhet që ai përcjell?! Në vend që sytë tuaj të lotojnë kur të dëgjojnë urdhrat dhe ndalesat e tij, në vend që zemrat tuaja të jenë të vëmendshme dhe plot shpresë e drojë, kur dëgjojnë premtimet dhe kërcënimet e tij, me ju ndodh e kundërta: ju largoheni dhe zhyteni në kotësira. Si është e mundur që ju të jeni të pavëmendshëm dhe mospërfillës ndaj këtij mesazhi të fuqishëm? Ky është tregues i dobësisë të mendjes, arsyes dhe besimit tuaj. Nëse ju do të adhuronit Allahun e Lartësuar dhe vazhdimisht do të synonit kënaqësinë e Tij në të gjitha gjendjet tuaja, nuk do të arrinit në këtë nivel kaq të ulët, të cilin kurrë nuk do ta dëshironin për veten e tyre të urtët dhe të mençurit. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Bini në sexhde për Allahun dhe adhurojeni Atë!" - Edhe sexhdja është një adhurim, por Allahu i Lartësuar e përmend atë në mënyrë të veçantë, për të treguar rëndësinë e madhe të saj. Në fakt, sexhdja është vetë thelbi i adhurimit, sepse ajo shpreh drojën dhe nënshtrimin ndaj Allahut të Lartësuar, bindjen dhe përunjësinë ndaj Tij. Sexhdja shënon momentin më sublim të përuljes së robit, sepse gjatë saj nënshtrohet zemra, trupi dhe pjesët më të nderuara të njeriut, duke u vendosur në tokë, e cila shkelet me këmbë.

Pas urdhrit për sexhde, Allahu i Lartësuar jep një urdhër të përgjithshëm për adhurim. Kështu, Ai urdhëron për çdo fjalë dhe vepër që e do dhe e kënaq Atë, qofshin ato të dukshme apo të padukshme dhe të cilat Allahu i ka shpjeguar nëpërmjet Shpalljes së Tij.

Këtu përfundon tefsiri i sures Nexhm, dhe për këtë falënderimi i plotë i takon vetëm Allahut, të Cilin kurrsesi nuk mund ta lavdërojmë ashtu sikurse e meriton. Ai është i lavdëruar ashtu sikurse e ka lavdëruar Veten e Vet dhe shumë më tepër i lavdëruar sesa mund ta lavdërojnë krijesat! Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhamedin (a.s.)!

Surja 54: El Kamer (mekase) 55 ajete

Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. U afrua Ora dhe Hëna u ça!
2. E, megjithatë, sa herë që ata shohin ndonjë mrekulli, kthejnë shpinën e thonë: "Kjo është magji e vazhdueshme!"
3. Ata e mohojnë të vërtetën dhe ndjekin dëshirat e veta, por çdo çështje do të plotësohet në cakun e fundit!
4. Atyre u kanë ardhur lajme, në të cilat ka mjaft qortime!
5. Kjo është urtësi e përsosur! Por atyre nuk u bëjnë dobi qortimet!

Shpjegimi i ajeteve

- "U afrua Ora dhe Hëna u ça!" - Allahu i Lartësuar na tregon se ora e Kijametit është afruar. Megjithatë, ata që mohojnë Zotin dhe rrefuzojnë ti binden Atij vazhdojnë të mos e besojnë dhe nuk përgatiten për të. Allahu i Lartësuar vazhdimisht u sjell njerëzve shenja dhe argumente të mëdha, të cilat tregojnë se Kijameti ka për të ndodhur dhe dalja para Allahut është e pashmangshme. Argumentet e Tij janë shumë të qarta dhe të besueshme.

Ndër mrekullitë më të mëdha që tregojnë për vërtetësinë e mesazhit që solli Muhamedi (a.s.), Profeti i fundit i Zotit, është edhe kjo ngjarje, e cila ndodhi në kohën e tij. Kur jobesimtarët i kërkuan atij një shenjë, pra, një mrekulli e diçka të jashtëzakonshme, nëpërmjet së cilës të tregonte se ai vërtet ishte profet i Zotit, Profeti (a.s.) tregoi me gisht në drejtim të Hënës dhe, me lejen e Allahut të Lartësuar, ajo u nda në dy pjesë. Njëra pjesë qëndronte mbi malin Ebi Kubejs dhe pjesa tjetër qëndronte mbi malin Kuajka'an. Ndërkohë, idhujtarët dhe jobesimtarët e tjerë e panë me sytë e tyre këtë mrekulli të madhe, që po ndodhte në botën qiellore. Kjo ishte jashtë mundësive njerëzore për ta realizuar apo për ta bërë të duket sikur është e vërtetë. Kjo mrekulli ishte e paparë dhe e padëgjuar më parë. Asnjë profeti të mëparshëm Zoti nuk i kishte dhënë një mrekulli të tillë, që realizohej në qiell, prandaj ata u çuditën me të. Megjithatë, në zemrat e tyre nuk hyri besimi dhe Zoti nuk deshi për ta udhëzimin. Ata menjëherë shpifën duke thënë: "Muhamedi na bëri magji". Por atyre iu dha mundësia të pyesnin edhe njerëzit e tjerë, që vinin prej së largu. Nëse Profeti (a.s.) do mund të magjepste ata që ishin afër dhe sytë e tyre, ai nuk do të mund ta bënte kurrë një gjë të tillë me ata që nuk ishin të pranishëm. Dhe, vërtet, kur u pyetën udhëtarët, ata treguan për ngjarjen e madhe që kishin parë. Gjithsesi, zgjidhja që ata gjetën për situatën ishte të thoshin: "*sihrun mustemir*" – "magji e vazhdueshme", domethënë, magji që prekte edhe të tjerët që vinin më pas. Por kjo qe një shpifje, që mund të pranohej vetëm nga krijesat më mendjelehta, të cilat janë shumë larg udhëzimit dhe logjikës së shëndoshë.

Jobesimtarët nuk mohuan vetëm këtë mrekulli të paraqitur nga Profeti (a.s.), por çdo shenjë tjetër, sado e madhe që të ishte, ata e mohonin dhe konsideronin gënjeshtër, magji ose i vinin emërtime të tjera të kota, mjaft që të dukej e papranueshme, siç thotë i Lartësuari:

- "E, megjithatë, sa herë që ata shohin ndonjë mrekulli, kthejnë shpinën e thonë: "Kjo është magji e vazhdueshme!"" – Domethënë, këtu nuk bëhej fjalë vetëm për çarjen e Hënës, por për çdo mrekulli të Zotit të Lartësuar, pasi qëllimi i tyre nuk ishte gjetja dhe pasimi i të vërtetës, por pasimi i dëshirave të tyre. I Lartësuari thotë:

- "Ata e mohojnë të vërtetën dhe ndjekin dëshirat e veta..." - Ky ajet i përngjan ajetit tjetër të Allahut të Lartësuar: "Thuaj: "Nëse është e vërtetë ajo që pretendoni, atëherë sillni një libër prej Allahut, që është udhëzues më i mirë se këta të dy *(Teurati e Kurani)*, që edhe unë t'i përmbahem atij?" E nëse ata nuk të përgjigjen, atëherë dije se ata thjesht ndjekin dëshirat e veta. E kush është më i humbur se ai që, duke mos pasur fakt prej Allahut, ndjek epshin e vet? S'ka dyshim se Allahu nuk i udhëzon njerëzit zullumqarë." [Kasas 49, 50].


Nëse qëllimi i tyre do të ishte zbulimi dhe pasimi i udhëzimit të drejtë, ata pa dyshim do të kishin besuar dhe do të ishin bërë pasues të Muhamedit (a.s.). E si të mos ndodhte kështu, kur Allahu i Lartësuar i dhuroi atij shenja, mrekulli dhe fakte të prera, të cilat dëshmonin qartë për ligjin dhe fenë e drejtë?!

- "...por çdo çështje do të plotësohet në cakun e fundit!" - Çështjet nuk mbyllen tani. Ato do të vazhdojnë të plotësohen, derisa të mbërrijnë në cakun e fundit. Atëherë, ata që besojnë plotësisht do të lumturohen në Xhenetin e mirësisë, në faljen e Allahut dhe kënaqësinë e Tij. Ndërsa mohuesit do të vuajnë pafundësisht në zemërimin e Zotit dhe ndëshkimin e Tij. Ky është caku i fundit, kur do të plotësohet çdo çështje.

Duke bërë të qartë se këta mohues nuk kishin qëllim të pasonin të vërtetën, por donin thjesht të ndiqnin dëshirat e tyre, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Atyre u kanë ardhur lajme, në të cilat ka mjaft qortime!" - Ishin të shumta lajmet rreth popujve të shkuar dhe atyre që do të vinin më pas, ashtu siç ishin të shumta mrekullitë e qarta që Zoti u solli njerëzve për të vërtetuar besnikërinë e profetëve të Tij dhe saktësinë e mesazhit që ata përcollën. Të gjitha këto lajme dhe mrekulli ishin të mjaftueshme që njerëzit të largoheshin nga padrejtësia dhe rruga e humbjes.

- "Kjo është urtësi e përsosur!" - Kjo është urtësia e Allahut të Lartësuar. Me argumentet dhe mrekullitë e shumta që Ai solli nëpërmjet profetëve, nuk u la asnjë



mundësi justifikimi mohuesve dhe kundërshtarëve.

Sidoqoftë, shenjat dhe mrekullitë nuk u vlejnë aspak atyre që kalojnë kufijtë e Zotit dhe shpërfillin porositë e Tij, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Por atyre nuk u bëjnë dobi qortimet!" - Kjo i ngjan fjalës së Allahut të Lartësuar, kur thotë: "Me të vërtetë, ata të cilët e meritojnë vendimin e Zotit tënd *(për ndëshkim)*, ata nuk besojnë, edhe sikur t'u vijnë të gjitha shenjat, derisa të shohin dënimin e rëndë." [Junus 96, 97].

Ajetet 6 – 8

6. Prandaj largohu prej tyre, deri në ditën kur Lajmëtari (Israfili) t'i thërrasë drejt tmerrit!

7. Të tmerruara do të jenë shikimet e tyre! Ata do të dalin prej varreve si karkaleca të shpërndarë,
8. duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Jobesimtarët do thonë: "Kjo është ditë e vështirë".

Shpjegimi i ajeteve

- "Prandaj largohu prej tyre..." - Duke i qartësuar Profetit të Tij se për mohuesit nuk ka udhëzim, Allahu i Lartësuar e porosit atë se tashmë nuk mbetej gjë tjetër, veçse të distancohej prej tyre.

- "...deri në ditën kur Lajmëtari (Israfili) t'i thërrasë drejt tmerrit!" - Prit ditën kur ata të ballafaqohen me tmerrin e madh. Atë ditë, Israfili (a.s.) do t'i thërrasë krijesat drejt një ngjarjeje të papërshkrueshme. Nuk do të ketë pamje më të frikshme se ajo. Israfili (a.s.) do t'i fryjë Surit, ndërsa të vdekurit do të dalin nga varret, për të qëndruar përpara Zotit të Lartësuar.

- "Të tmerruara do të jenë shikimet e tyre! Ata do të dalin prej varreve si karkaleca të shpërndarë..." – Të tillë do ta kenë vështrimin, prej tmerrit që ka pushtuar zemrat e tyre. Ata do të dridhen nga frika, e kjo do të duket qartë në sytë e tyre.

Kur të dalin nga varret, do të jenë të çoroditur, do të vërtiten dhe shkëmbehen me njëri tjetrin, njësoj si karkaleca të shpërndarë nëpër tokë.

- "...duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Jobesimtarët do thonë: "Kjo është ditë e vështirë"." - Të gjithë do nxitojnë që t'i përgjigjen zërit që i urdhëron të qëndrojnë në vendin e tubimit. Askush nuk mund t'i bëjë bisht kësaj thirrjeje. Kur mohuesit ta ndiejnë ndëshkimin që po u afrohet, do të thonë:" ...kjo është një ditë e vështirë", sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar në një ajet tjetët: "Kur t'i fryhet Surit, atëherë ajo do të jetë ditë e vështirë. Për jobesimtarët është jo e lehtë." [Muddeththir 8- 10]. Ose: "Ditën kur qielli të çahet nga një re dhe engjëjt të zbresin në mënyrë madhështore, atë ditë, sundimi i vërtetë i takon të Gjithëmëshirshmit. Për jobesimtarët ajo do të jetë një ditë e vështirë. Atë ditë, zullumqari do të kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "Oh, i mjeri unë, pse nuk ndoqa udhën e drejtë së bashku me Profetin!" [Furkan 25 - 27]. Nga kjo kuptohet që për besimtarët do të ndodhë e kundërta, pra, për ta ajo ditë do të jetë e lehtë.

Ajetet 9 – 17

9. Para tyre mohoi populli i Nuhut. Ata e refuzuan robin Tonë dhe i thanë: "I marrë!". Ai u mundua dhe u kërcënua prej tyre.
10. Prandaj ai iu drejtua Zotit të vet: "Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!"
11. Atëherë, Ne, me një shi të vrullshëm, hapëm dyert e qiellit,
12. ndërsa nga toka shpërthyem burime uji, dhe kështu uji u bashkua siç ishte caktuar.
13. Ndërsa atë e hipëm në një barkë prej dërrasash dhe gozhdësh,
14. që lundronte nën Sytë Tanë. Kjo, si shpagim për atë që u mohua.
15. Ne e lamë atë si shenjë, por a ka ndonjë që merr mësim?
16. Si ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im!
17. Ne Kuranin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndonjë që merr mësim?

Shpjegimi i ajeteve

- "Para tyre mohoi populli i Nuhut." - Pasi përshkroi gjendjen e atyre që mohuan Profetin e Tij dhe pasi sqaroi se shenjat e Tij nuk ndikonin aspak tek ata, Allahu i Lartësuar vijon që t'i paralajmërojë jobesimtarët për ndëshkime, ashtu sikurse ndëshkoi popujt e shkuar, të cilët mohuan profetët dhe shpalljet e Tij. Fillimisht, përmendet Nuhu (a.s.), i pari profet që Zoti dërgoi në një popull ku adhuroheshin idhuj. Ai i ftoi ata që ta njësonin Allahun e Lartësuar dhe ta adhuronin atë si Një, të Vetëm dhe të Pashoq. Por ata refuzuan që të largoheshin nga idhujtaria, sikurse thotë i Lartësuari: "Nuhu tha: "O Zoti im! Ata nuk m'u bindën mua, por shkuan pas atyre, të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre u shtuan veçse dëshpërim dhe të cilët kurdisën kurthe shumë të mëdha. Ata u thanë: "Kurrë mos i braktisni zotat tuaj! Mos e braktisni Ueddën, as Suvanë, as Jeguthën, Jeukën dhe Nesrën". Ata zhytën në humbje shumë pasues të tyre. Prandaj, Ti shtoju veçse humbje të padrejtëve!" [Nuh 21 – 24].

Nuhu (a.s.) vazhdoi që t'i ftonte ata në adhurimin e Allahut si një Zot të vetëm, natën dhe ditën, fshehtazi dhe haptazi. Por kjo veçse ua shtoi inatin dhe shfrenimin në kalimin e kufijve, duke treguar mosbesimin e tyre te Nuhu (a.s.) dhe mesazhi i tij. I Lartësuari thotë:

- "Ata e refuzuan robin Tonë dhe i thanë: "I marrë!". Ai u mundua dhe u kërcënua prej tyre." – Kështu, ata pretenduan se idhujtaria e tyre ishte diçka e logjikshme, ndërsa mesazhi i Nuhut (a.s.) ishte injorancë dhe humbje, që mund të buronte veçse nga të çmendurit. Sigurisht, ky qe një tjetërsim i realitetit nga ana e tyre. Shpallja që Zoti sjell nëpërmjet profetëve të Tij është e vërteta, që udhëzon mendjet e shëndosha. Ndërsa prirjet e prishura të njerëzve janë injorancë dhe humbje e qartë.

Për të treguar ashpërsinë e refuzimit me të cilën u përball Nuhu (a.s.) kur i ftoi ata që të adhuronin Allahun e Lartësuar si Një të vetëm, është përdorur fjala "*uezduxhir*" - u mundua dhe u kërcënua prej tyre. Allahu i shëmtoftë dhe i shkatërroftë ata! Nuk u mjaftoi që e mohuan dhe shpifën për të, por edhe e torturuan. Kështu ka ndodhur me të gjithë profetët e Zotit. Armiqtë e tyre gjithmonë u kanë dhënë mundim dhe janë sjellë vrazhdë me ta.

- "Prandaj ai iu drejtua Zotit të vet: "Unë jam i mundur, prandaj më ndihmo!"". - Kuptimi: Unë jam i pafuqishëm, o Zoti im, që të fitoj kundër tyre.

Arsyeja ishte se nga populli i Nuhut kishte shumë pak besimtarë, aq sa nuk mund t'i bënin ballë shumicës. Në suren Nuh, Allahu i Lartësuar na e jep të plotë lutjen që bëri Nuhu (a.s.): "Nuhu tha: "O Zoti im! Mos lër mbi tokë asnjë nga jobesimtarët, sepse, nëse Ti i lë, ata do t'i devijojnë adhuruesit e T'u, dhe se prej tyre do të lindin veçse të shfrenuar dhe jobesimtarë! O Zoti im! Më fal mua, prindërit e mi, ata që hynë në shtëpinë time si besimtarë dhe të gjithë besimtarët e besimtaret! Ndërsa jobesimtarëve shtoju veçse dëshpërim!". [Nuh 26 – 28].

Allahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së Nuhut, duke e ndihmuar kundër armiqve të tij:

- "Atëherë, Ne, me një shi të vrullshëm, hapëm dyert e qiellit, ndërsa nga toka shpërthyem burime uji, dhe kështu uji u bashkua siç ishte caktuar." - Allahu i Lartësuar lëshoi sasi të mëdha uji nga qielli

dhe nga toka, madje edhe nga një furrë, nga ku vlonte zjarri. Kështu, me urdhrin e Allahut, uji i zbritur nga qielli u bashkua me atë që buronte nga toka, për t'u plotësuar në këtë mënyrë ajo që Zoti e kishte shkruar, si ndëshkim për zullumqarët.

- "Ndërsa atë e hipëm në një barkë prej dërrasash dhe gozhdësh, që lundronte nën Sytë Tanë." - Allahu i Lartësuar e shpëtoi Nuhun (a.s.) duke e bartur në një anije, e ndërtuar me dërrasa dhe gozhdë. Kjo anije, mbi të cilën qëndronin Nuhu (a.s.), besimtarët dhe disa lloje kafshësh që ai mori me vete, lundronte nën vështrimin dhe kujdesin e Allahut të Lartësuar, që të mos mbytej. Allahu është mbrojtësi dhe ruajtësi më i mirë!

- "Kjo, si shpagim për atë që u mohua." - Kjo që ndodhi, pra, shpëtimi i Nuhut (a.s.) nga përmbytja e përgjithshme, ishte si shpërblim për durimin e tij të madh kundrejt mohimit që i bëri populli i tij. Ai bëri një durim të jashtëzakonshëm dhe për një kohë shumë të gjatë në thirrjen e popullit të tij dhe kurrë nuk u spraps në këtë rrugë.

Por ka mundësi që kuptimi i ajetit të jetë edhe kështu: Ne e shkatërruam popullin e Nuhut me atë ndëshkim të dhimbshëm dhe poshtërues, si shpagim për mohimin dhe arrogancën e tyre.

- "Ne e lamë atë si shenjë, por a ka ndonjë që merr mësim?" - Allahu i Lartësuar e ka bërë historinë e Nuhut me popullin e tij si një shembull, që të përfitojnë ata që dinë të përfitojnë dhe ta kuptojnë mirë se, ata që nuk iu binden profetëve, Allahu i Lartësuar ka për t'i ndëshkuar ashpër.

Por ka mundësi që përemri "atë" të nënkuptojë anijen, si mjet lundrimi. Pra, çdo anije le të shërbejë si kujtim për ngjarjen e popullit të Nuhut (a.s.) dhe për faktin se ishte Allahu i Lartësuar që ia mësoi Nuhut ndërtimin e saj. Ishte Allahu i Lartësuar që e la këtë aftësi ndër njerëz, që ata të përfitojnë prej saj dhe të mësojnë gjithashtu për mëshirën e Allahut të Lartësuar për krijesat, për kujdesin e Tij të madh për to, për pushtetin e Tij të plotë dhe krijimin e Tij perfekt.

Këto janë shenja të lëna nga Allahu i Lartësuar, por a ka ndonjë që merr mësim prej tyre? Kjo është pyetja që shtrohet. Mesazhet e përcjella mes këtyre shenjave janë shumë të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme, por duhet vetëm të meditosh rreth tyre me qëllimin e mirë për të nxjerrë mësime dhe për të gjetur udhëzim.

- "Si ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im!" - Pra, si të duket, o lexues i këtij Kurani, ndëshkimi i ashpër i Zotit dhe paralajmërimet e Tij, të cilat nuk i lënë askujt asnjë mundësi justifikimi? A nuk duhet që Ai të merret në konsideratë ashtu si i takon? Përgjigjen çdokush e jep me veprat e tij.

- "Ne Kuranin e bëmë të lehtë për mësim..." – Kuptimi: Ne e kemi lehtësuar të përfituarit nga Kurani famëlartë. Ne e kemi bërë të thjeshtë tekstin e tij për t'u mësuar dhe për t'u lexuar bukur. Gjithashtu, e kemi thjeshtësuar të kuptuarit dhe marrjen e diturisë prej tij.

Kurani është fjala më e mirë në tekstin dhe termat e tij dhe fjala më e vërtetë në kuptimet që percjell. Ajo është fjala më e qartë dhe më lehtësisht e shpjegueshme dhe e kuptueshme. Çdokush që i përkushtohet

atij, Allahu i Lartësuar ia lehtëson arritjen e të gjitha synimeve që ka me atë libër. Nëpërmjet Kuranit, njerëzit kuptojnë dhe përkujtojnë hallallin dhe haramin, urdhrat dhe ndalesat, shpërblimin dhe ndëshkimin. Ai është një qortues i mirë dhe prej tij nxirren mësime të vyera në lidhje me besimin që duhet të ketë njeriu. Në të gjenden lajmet e vërteta për popujt që shkuan dhe për atë që do të ndodhë në përjetësi. Allahu i Lartësuar e ka lehtësuar që të gjitha këto të arrihen prej Kuranit.

Dija e Kuranit, duke filluar nga leximi, mësimi përmendësh dhe tefsiri i tij, është dija më e rëndësishme, dhe Zoti i Lartësuar e ka lehtësuar marrjen e saj. Kjo është dija e çmuar, të cilën, nëse dikush nis ta kërkojë, Allahu i Lartësuar e ndihmon dhe ia lehtëson atij. Për këtë arsye, disa selefë e kanë shpjeguar ajetin në fjalë kështu: "Ne e kemi lehtësuar Kuranin si përkujtues, prandaj a ka ndonjë që e kërkon dijen prej tij, që të ndihmohet për ta arritur?"

Kështu, Allahu i Lartësuar i fton adhuruesit e Tij që t'i përkushtohen këtij libri dhe të nxjerrin mësime prej tij kur thotë:

- "...po a ka ndonjë që merr mësim?"

Ajetet 18 – 22

18. Adët mohuan, por si i ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im?
19. Ne u lëshuam atyre një erë të fortë, në një ditë ndëshkimi të ashpër dhe të vazhdueshëm.
20. Ajo i shtynte njerëzit sikur të ishin trupa hurmash të shkulura.
21. Si ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im?
22. Ne e bëmë Kuranin të lehtë për të përkujtuar, por a ka ndonjë që përkujton?

Shpjegimi i ajeteve


- "Adët mohuan, por si i ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im?" - Adët ishin një popull i njohur në Jemen, tek të cilët Allahu i Lartësuar dërgoi si profet Hudin (a.s.). Ai i ftoi ata që ta njësonin Allahun e Lartësuar dhe t'i përkushtoheshin vetëm Atij në adhurim. Por ata e refuzuan dhe e mohuan mesazhin e tij.

- "Ne u lëshuam atyre një erë të fortë, në një ditë ndëshkimi të ashpër dhe të vazhdueshëm." – Atëherë, Allahu i Lartësuar dërgoi mbi ta si ndëshkim një erë të fuqishme në një ditë, e cila do të ishte fillimi i një ndëshkimi të ashpër, që do të zgjaste për shtatë net dhe tetë ditë me radhë.

- "Ajo i hidhte njerëzit sikur të ishin trupa hurmash të shkulura." - Aq e fortë ishte era, saqë i ngrinte njerëzit lart në qiell dhe më pas i përplaste fort për tokë. Kështu, ata dukeshin si trungje hurmash të shkulura dhe të shpërndara në tokë. *Subhanallah*! Sa të parëndësishëm dhe të pavlefshëm bëhen njerëzit kur kundërshtojnë urdhrat e Allahut!

- "Si ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im?" - Ai ishte një ndëshkim i dhembshëm dhe paralajmërimi i Zotit ishte tepër i qartë, saqë asnjëri nuk kishte justifikim.

- "Ne e bëmë Kuranin të lehtë për të përkujtuar, por a ka ndonjë që përkujton?" - Allahu i Lartësuar e përsërit këtë porosi në shenjë mëshire dhe përkujdesi për adhuruesit e Tij, duke i ftuar në rrugën që rregullon dynjanë dhe ahiretin e tyre dhe u mundëson lumturinë në to.


الجزء السابع والعشرون سورة القمر

وَنَبِّئْهُمْ أَنَّ الْمَاءَ قِسْمَةٌ بَيْنَهُمْ ۖ كُلُّ شِرْبٍ مُحْتَضَرٌ ﴿٢٨﴾ فَنَادَوْا صَاحِبَهُمْ
فَتَعَاطَىٰ فَعَقَرَ ﴿٢٩﴾ فَكَيْفَ كَانَ عَذَابِي وَنُذُرِ ﴿٣٠﴾ إِنَّا أَرْسَلْنَا عَلَيْهِمْ
صَيْحَةً وَاحِدَةً فَكَانُوا كَهَشِيمِ الْمُحْتَظِرِ ﴿٣١﴾ وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ
لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِن مُّدَّكِرٍ ﴿٣٢﴾ كَذَّبَتْ قَوْمُ لُوطٍ بِالنُّذُرِ ﴿٣٣﴾ إِنَّا أَرْسَلْنَا
عَلَيْهِمْ حَاصِبًا إِلَّا آلَ لُوطٍ ۖ نَّجَّيْنَاهُم بِسَحَرٍ ﴿٣٤﴾ نِّعْمَةً مِّنْ عِندِنَا ۚ
كَذَٰلِكَ نَجْزِي مَن شَكَرَ ﴿٣٥﴾ وَلَقَدْ أَنذَرَهُم بَطْشَتَنَا فَتَمَارَوْا بِالنُّذُرِ
﴿٣٦﴾ وَلَقَدْ رَاوَدُوهُ عَن ضَيْفِهِ فَطَمَسْنَا أَعْيُنَهُمْ فَذُوقُوا عَذَابِي
وَنُذُرِ ﴿٣٧﴾ وَلَقَدْ صَبَّحَهُم بُكْرَةً عَذَابٌ مُّسْتَقِرٌّ ﴿٣٨﴾ فَذُوقُوا
عَذَابِي وَنُذُرِ ﴿٣٩﴾ وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِن مُّدَّكِرٍ ﴿٤٠﴾
وَلَقَدْ جَاءَ آلَ فِرْعَوْنَ النُّذُرُ ﴿٤١﴾ كَذَّبُوا بِآيَاتِنَا كُلِّهَا فَأَخَذْنَاهُمْ
أَخْذَ عَزِيزٍ مُّقْتَدِرٍ ﴿٤٢﴾ أَكُفَّارُكُمْ خَيْرٌ مِّنْ أُولَٰئِكُمْ أَمْ لَكُم بَرَاءَةٌ
فِي الزُّبُرِ ﴿٤٣﴾ أَمْ يَقُولُونَ نَحْنُ جَمِيعٌ مُّنتَصِرٌ ﴿٤٤﴾ سَيُهْزَمُ الْجَمْعُ
وَيُوَلُّونَ الدُّبُرَ ﴿٤٥﴾ بَلِ السَّاعَةُ مَوْعِدُهُمْ وَالسَّاعَةُ أَدْهَىٰ وَأَمَرُّ ﴿٤٦﴾
إِنَّ الْمُجْرِمِينَ فِي ضَلَالٍ وَسُعُرٍ ﴿٤٧﴾ يَوْمَ يُسْحَبُونَ فِي النَّارِ عَلَىٰ
وُجُوهِهِمْ ذُوقُوا مَسَّ سَقَرَ ﴿٤٨﴾ إِنَّا كُلَّ شَيْءٍ خَلَقْنَاهُ بِقَدَرٍ ﴿٤٩﴾
٥٣٠

Ajetet 23 – 32

23. Themudët mohuan të dërguarit.
24. Ata thanë: "A të shkojmë pas një njeriu të vetëm, që doli nga mesi ynë?! Ne, atëherë, do të ishim vërtet të humbur dhe të marrë!"
25. Vallë, vetëm atij iu dha Shpallja ndër ne? Jo, por ai është një gënjeshtar mendjemadh!"
26. Do ta kuptojnë nesër se kush është gënjeshtari, mendjemadhi!
27. Ne do t'u dërgojmë devenë si sprovë, por t'i vetëm vështroji me durim!
28. Lajmëroi ata se uji është i ndarë për ta veç e veç, e secili do të paraqitet për të pirë sipas rregullit.
29. Po ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri atë.
30. Si i ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im!
31. Ne lëshuam kundër tyre një ushtimë të vetme, dhe ata u bënë si shtrojë vathi.
32. Ne Kuranin e bëmë të lehtë për të përkujtuar, por a ka ndonjë që përkujton?

Shpjegimi i ajeteve

- **"Themudët mohuan të dërguarit."** - Themudët kanë qenë një popull i njohur në zonën e Hixhrit. Allahu i Lartësuar dërgoi tek ata profetin Salih. Ai i ftoi që të adhuronin Allahun si Një, të Vetëm dhe të Pashoq dhe i paralajmëroi ata për një ndëshkim të dhimbshëm, nëse do kundërshtonin fjalën e tij. Por ata e refuzuan Profetin e Zotit, madje u treguan arrogantë me të, duke thënë:

- "A të shkojmë pas një njeriu të vetëm, që doli nga mesi ynë?! Ne, atëherë, do të ishim vërtet të humbur dhe të marrë!" - Si të bëhemi pasues të një njeriu të vetëm e të thjeshtë, i cili nuk është mbret apo nga ndonjë popull i fuqishëm? Nëse do të bëheshim pasues të një njeriu të tillë, ne do të ishim të humbur dhe fatkeqë.

Këto fjalë ishin, në fakt, treguese të humbjes dhe fatkeqësisë së tyre. Ata refuzuan të ishin pasues të një Profeti të dërguar dhe mbështetur nga Zoti dhe pranuan të bëheshin adhurues të pemëve, gurëve e figurave.

- "Vallë, vetëm atij iu dha Shpallja ndër ne?" - Përse Allahu zgjodhi atë nga mesi ynë për t'i dhënë Shpalljen? Çfarë e bën atë të veçantë nga ne?

Ky qe një justifikim i kotë i tyre. Jobesimtarët në çdo kohë kanë nxjerrë një justifikim të tillë për refuzimin e profetëve dhe shpalljeve të Zotit. Allahu i Madhëruar i është përgjigjur këtij justifikimi bosh me

fjalët që profetët u kanë thënë popujve të tyre: "Të dërguarit e tyre u thanë: "Ne jemi vetëm se njerëz, sikurse edhe ju, por Allahu ia dhuron mirësinë kujt të dojë nga robërit e vet. Ne nuk na takon t'ju sjellim ndonjë argument, vetëm se me dëshirën e Allahut. Atëherë, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!"." [Ibrahim 11.] Është Allahu i Madhëruar që i zgjedh dhe i veçon profetët nga të tjerët, duke i dalluar me cilësi e vityte të larta. Është Ai që i përzgjedh, që të jenë të aftë të përballojnë peshën e Shpalljes së Zotit të tyre. Gjithashtu, është mëshirë dhe urtësi e madhe nga Allahu i Madhëruar që i zgjodhi ata të jenë prej njerëzve. Nëse do t'i bënte prej melekëve, njerëzit nuk do të mund t'i merrnin mësimet e Zotit, për shkak të vështirësisë së komunikimit mes këtyre dy llojeve të krijesave. Gjithashtu, nëse Zoti do të jepte një shenjë kaq të dukshme, si shfaqja e melekëve, duke plotësuar kështu kërkesat e caktuara nga populli si kushte për të besuar, dhe nëse pas saj njerëzit ende nuk do të besonin, atëherë ndëshkimi do të ishte i menjëhershëm dhe i pashmangshëm. Përfundimisht, është mëshira dhe urtësia e Allahut që profetët kanë qenë njerëz.

Kështu, këto fjalë të themudëve ishin thjesht justifikim për të mohuar profetin Salih. Më pas, ata bënë një deklaratë të shëmtuar për Profetin e tyre, duke thënë:

- ""Jo, por ai është një gënjeshtar mendjemadh!" Do ta kuptojnë nesër se kush është gënjeshtari, mendjemadhi!" – Kuptimi: Ai është mashtrues i madh dhe gjithë ligësi.

Allahu i shëmtoftë dhe i poshtëroftë! Sa mendjelehtë e të paturpshëm, sa të padrejtë e mosmirënjohës të pashembullt që ishin! Si është e mundur që t'i trajtosh në këtë mënyrë njerëzit më të sinqertë dhe dashamirës, njerëzit më të çiltër dhe më të mëshirshëm me popullin e tyre?! Si mund të mohosh këshilluesit e urtë dhe durimtarë, që këshillojnë për çdo të mirë dhe largojnë nga çdo e keqe? Prandaj, kur padrejtësia e tyre kaloi kufijtë, Allahu i Madhëruar i ndëshkoi.

- "Ne do t'u dërgojmë devenë si sprovë..." - Si mrekulli, Zoti u bëri atyre një deve, që të shërbente si provë e mjaftueshme për vërtetësinë e profetit Salih. I gjithë populli mund të pinte nga qumështi i saj dhe u mjaftonte.

Por kjo mrekulli ishte gjithashtu edhe një sprovë për ta, siç thotë i Madhëruari:

- "...por t'i vetëm vështroji me durim!" – Kuptimi: Kjo do të jetë sprovë për ta, prandaj ti bëj durim kur i fton në rrugën e drejtë. Ji i qëndrueshëm dhe i durueshëm në rrugën e thirrjes dhe vështro se çfarë do të ndodhë: a do të besojnë apo do të vazhdojnë të jenë mospërfillës ndaj porosive të Zotit?

- "Lajmëroi ata se uji është i ndarë për ta veç e veç, e secili do të paraqitet për të pirë sipas rregullit." - Njoftoji ata se, për ujin e burimit, të cilin e pinë e freskohen, duhet të ketë një ndarje me ditë: një ditë për njerëzit dhe një ditë për devenë. Ditën që pinë njerëzit nuk duhet të afrohet deveja dhe ditën që pi deveja nuk duhet të afrohen njerëzit. Por si ishte reagimi i tyre?

- "Po ata thirrën shokun e tyre, i cili e mori dhe e theri atë." - Ky ishte më zemërligu i popullit. Ai iu bind kërkesës së kriminelëve për therjen e devesë.

- "Si i ishte ndëshkimi dhe paralajmërimi Im! Ne lëshuam kundër tyre një ushtimë të vetme, dhe ata u bënë si shtrojë vathi." - Ai ishte ndëshkimi më i rëndë. Allahu i Plotfuqishëm lëshoi mbi ta një ushtimë të madhe, që i shkatërroi nga i pari deri tek i fundit, përveç Profetit të Tij Salih dhe të gjithë besimtarëve që e shoqëronin.

- "Ne Kuranin e bëmë të lehtë për të përkujtuar, por a ka ndonjë që përkujton?"

Ajetet 33 – 40

33. Populli i Lutit i mohoi porositë e Pejgamberit të vet.
34. Ne dërguam mbi ta një furtunë me gurë, përveç familjes së Lutit, të cilën e shpëtuam para se të agonte.
35. Kjo ishte mirësi nga ana Jonë. Kështu i shpërblejmë Ne ata që falënderojnë.
36. Ai u tërhoqi vërejtjen atyre për dënimin Tonë të rëndë, por ata dyshuan në këto paralajmërime.
37. Ata deshën t'u afroheshin mysafirëve të tij, por Ne ua verbuam sytë. Vuani, atëherë, ndëshkimin dhe paralajmërimin Tim!
38. Ata i kapi dënimi i përhershëm në befasi, herët në mëngjes.
39. Vuani, atëherë, ndëshkimin dhe paralajmërimin Tim!
40. Ne Kuranin e bëmë të lehtë për të përkujtuar, por a ka ndonjë që përkujton?

Shpjegimi i ajeteve

Ata nuk iu bindën Lutit (a.s.) kur ai i ftoi që të adhuronin Allahun si Një, të Vetëm dhe të Pashoq. Ai i ndaloi nga idhujtaria dhe ajo vepra e shëmtuar, që askush para tyre, në gjithë botën, nuk e kishte bërë, por ata vazhduan me paturpësi në rrugën e tyre. Madje, ata tentuan të poshtëronin me aktet e tyre të turpshme edhe melekët e Zotit, që shkuan te profeti Lut (a.s.). Të mallkuarit u grumbulluan me nxitim te shtëpia e profetit Lut, me synimin që të vepronin me dy miqtë e tij poshtërsitë e tyre, të pashembullta në botë. Allahu i Lartësuar na sqaron se ata këmbëngulën që Luti (a.s.) t'ua dorëzonte dy miqtë, që kishin ardhur si dy burra me mision nga Zoti. Por Allahu i Madhëruar urdhëroi Xhibrilin (a.s.), i cili ua pengoi vështrimin me krahët e Tij.

Pas kësaj, profeti Lut (a.s.) i paralajmëroi për ndëshkimin e ashpër të Allahut, por ata dyshuan në vërtetësinë e këtij paralajmërimi. Atëherë, Allahu i Madhëruar dërgoi mbi ta një furtunë me gurë. Allahu i Madhëruar ua përmbysi vendbanimet, duke ua kthyer pjesën e poshtme sipër tyre, dhe më pas i goditi nga sipër me gurë prej llave të ngurtësuar e të nxehtë, të caktuar që të godisnin çdo mohues e zullumqar. Ndërsa Lutin dhe familjen e Tij, Allahu i Madhëruar i shpëtoi nga ky ndëshkim, si shpërblim për mirënjohjen e tyre dhe për adhurimin e përkushtuar vetëm ndaj Tij, duke e adhuruar si Një, të Vetëm e të Pashoq.

Ajetet 41 – 55

41. Edhe rrethit të Faraonit i kanë ardhur paralajmërime.
42. Ata i mohuan të gjitha argumentet Tona, prandaj Ne i dënuam ashtu siç dënon Ngadhënjyesi, i Plotfuqishmi.
43. Vallë, jobesimtarët tuaj janë më të vlefshëm se ata që u përmendën, apo keni ndonjë premtim shpëtimi në librat e qiellit?
44. Mos vallë po thonë: "Ne jemi një grup, të bashkuar dhe ngadhënjyes?"

45. Ai grup shpejt do të pësojë disfatë dhe ata do t'ia mbathin.

46. Por Kijameti është premtim i pakthyeshëm për ta. Kijameti është edhe më i vështirë, edhe më i hidhur.

47. S'ka dyshim se idhujtarët keqbërës janë në humbje dhe në zjarr të madh.

48. Atë ditë kur, me fytyrat e tyre, të tërhiqen zvarrë në Zjarr, do t'u thuhet: "Vuajeni dënimin në Sekar!".

49. Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të caktuar.

50. Puna Jonë është e shpejtë, sa hap e mbyll sytë.

51. Ne i shkatërruam ata që ishin si ju, por a ka ndonjë që merr mësim?

52. Çdo gjë që bënë ata gjendet e shënuar.


53. Çdo vepër, qoftë e vogël a e madhe, është e shënuar në rreshta.

54. Është e vërtetë se të devotshmit do të jenë në kopshte e në lumenj,

55. në kuvendin e së vërtetës, tek një Sundues i Plotfuqishëm!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Edhe rrethit të Faraonit i kanë ardhur paralajmërime. Ata i mohuan të gjitha argumentet Tona, prandaj Ne i dënuam ashtu siç dënon Ngadhënjyesi, i Plotfuqishmi."** – Për Faraonin dhe familjen e tij erdhën shumë paralajmërime dhe shenja. Allahu i Madhëruar dërgoi tek ata Musain (a.s.), të cilit i foli drejtpërdrejt dhe i dha mrekulli të shumta, që të shërbenin si prova për Faraonin dhe rrethin e tij. Ai u çoi fakte të pamohueshme, që i dëshmuan veç ata. Megjithatë, ata përsëri mohuan, prandaj Allahu i ndëshkoi, ashtu siç ndëshkon Ngadhënjyesi i Plotfuqishëm: Ai i mbyti në det Faraonin me gjithë ushtrinë e tij.


الجزء السابع والعشرون سورة الرحمن

وَمَآ أَمۡرُنَآ إِلَّا وَٰحِدَةٞ كَلَمۡحِۭ بِٱلۡبَصَرِ ٥٠ وَلَقَدۡ أَهۡلَكۡنَآ
أَشۡيَاعَكُمۡ فَهَلۡ مِن مُّدَّكِرٖ ٥١ وَكُلُّ شَيۡءٖ فَعَلُوهُ فِي ٱلزُّبُرِ
٥٢ وَكُلُّ صَغِيرٖ وَكَبِيرٖ مُّسۡتَطَرٞ ٥٣ إِنَّ ٱلۡمُتَّقِينَ
فِي جَنَّٰتٖ وَنَهَرٖ ٥٤ فِي مَقۡعَدِ صِدۡقٍ عِندَ مَلِيكٖ مُّقۡتَدِرِۢ ٥٥

سُورَةُ الرَّحۡمَٰنِ

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

ٱلرَّحۡمَٰنُ ١ عَلَّمَ ٱلۡقُرۡءَانَ ٢ خَلَقَ ٱلۡإِنسَٰنَ ٣ عَلَّمَهُ ٱلۡبَيَانَ ٤
ٱلشَّمۡسُ وَٱلۡقَمَرُ بِحُسۡبَانٖ ٥ وَٱلنَّجۡمُ وَٱلشَّجَرُ يَسۡجُدَانِ ٦
وَٱلسَّمَآءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ ٱلۡمِيزَانَ ٧ أَلَّا تَطۡغَوۡاْ فِي ٱلۡمِيزَانِ ٨
وَأَقِيمُواْ ٱلۡوَزۡنَ بِٱلۡقِسۡطِ وَلَا تُخۡسِرُواْ ٱلۡمِيزَانَ ٩ وَٱلۡأَرۡضَ
وَضَعَهَا لِلۡأَنَامِ ١٠ فِيهَا فَٰكِهَةٞ وَٱلنَّخۡلُ ذَاتُ ٱلۡأَكۡمَامِ ١١
وَٱلۡحَبُّ ذُو ٱلۡعَصۡفِ وَٱلرَّيۡحَانُ ١٢ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
١٣ خَلَقَ ٱلۡإِنسَٰنَ مِن صَلۡصَٰلٖ كَٱلۡفَخَّارِ ١٤ وَخَلَقَ ٱلۡجَآنَّ مِن
مَّارِجٖ مِّن نَّارٖ ١٥ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ١٦ رَبُّ
ٱلۡمَشۡرِقَيۡنِ وَرَبُّ ٱلۡمَغۡرِبَيۡنِ ١٧ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ١٨

الجزء ٥٤

٥٣١

Qëllimi i përkujtimit të gjithë këtyre historive të profetëve me popujt e tyre mohues, është paralajmërimi për njerëzit që mohojnë Muhamedin (a.s.) dhe nuk pasojnë rrugën e tij. Prandaj i Lartësuari thotë më pas:

- **"Vallë, jobesimtarët tuaj janë më të vlefshëm se ata që u përmendën..."** – A mos janë më të mirë këta që mohojnë udhëzimin e më të mirit të profetëve të Zotit, Muhamedit (a.s.), sesa ata popuj të shkuar që mohuan profetët e tyre?! Zoti na i tregoi në Kuran shkatërrimin e të gjithë atyre që refuzuan profetët dhe shpalljet e Tij? Nëse janë më të mirë se mohuesit e mëparshëm dhe nëse janë të sigurt nga ndëshkimi, atëherë le të rinë të qetë, me mendimin se nuk do t'i prekë e njëjta gjë. Por, sigurisht, çështja nuk qëndron kështu. Një gjë është e sigurt: edhe nëse mund të mos jenë në

gjendje më të keqe se ata, në gjendje më të mirë kurrsesi nuk janë.

- "...apo keni ndonjë premtim shpëtimi në librat e qiellit?" – A mos kanë ndonjë premtim nga Allahu, të shpallur në librat e profetëve, që i garanton se janë të shpëtuar nga ndëshkimi i Tij? Kjo, sigurisht, nuk është e vërtetë, madje është e pamundur, qoftë në aspektin logjik, qoftë duke u bazuar në tekstet e shpalljeve të Zotit. E si mundet që, keqbërësve të shfrenuar t'u jepet siguri nga shpalljet e Zotit, të mbushura me drejtësi dhe urtësi? Kjo nuk ka asnjë lidhje me urtësinë e Zotit. Aq më pak, kur bëhet fjalë për refuzimin e më të mirit, më të zgjedhurit e më të dalluarit të profetëve.

Atëherë, nëse nuk keni ndonjë premtim nga Zoti, a mos ndjeni siguri në forcat tuaja? Allahu i Madhëruar thotë:

- "Mos vallë po thonë: "Ne jemi një grup, të bashkuar dhe ngadhënjyes?"" - Le ta dinë se edhe kjo mundësi nuk ekziston. Allahu i Madhëruar ua bën të qartë fundin e tyre kur thotë:

- "Ai grup shpejt do të pësojë disfatë dhe ata t'ia mbathin." - Dhe ndodhi vërtet ashtu sikurse njoftoi i Gjithëdijshmi e i Gjithëpushtetshmi. Allahu i Madhëruar e poshtëroi grupin e tyre më të madh në Bedër. Atë ditë u vranë shumë krerë të kufrit dhe armiq të Profetit (a.s.). Kështu, Zoti e ndihmoi Profetin e Tij, fenë e Tij dhe adhuruesit e Tij besimtarë.

Por nuk do të ishte ky fundi i dënimit për të mjerët. Ata i pret një ditë e madhe, dita kur do të tubohen të parët dhe të fundit, si ata që vuajtën dënim në jetën e dynjasë, ashtu edhe ata që jetuan përkohësisht deri në afatin që Zoti i kishte caktuar:

- "Por Kijameti është premtim i pakthyeshëm për ta. Kijameti është edhe më i vështirë, edhe më i hidhur." - Kijameti është koha e premtuar për ringjalljen dhe llogarinë e tyre. Atë ditë do të marrin të plotë shpërblimin sipas veprave. Atë ditë, çdokujt do t'i jepet ajo që meriton dhe e drejta do të shkojë në vend. Ndëshkimi i Kijametit është më i madh, më i rëndë, më i vështirë dhe më i tmerrshëm se çdo përfytyrim.

- "S'ka dyshim se idhujtarët keqbërës janë në humbje dhe në zjarr të madh." - Keqbërës janë ata që e teprojnë me vepra të këqija e krime. Ata merren me idhujtari, poshtërsi dhe gjynahe të rënda. Këta të mjerë kanë humbur nga e vërteta në këtë dynja. Ata janë të humbur qoftë në diturinë e tyre, qoftë në veprat që bëjnë. Ata nuk kanë dijen e sigurt si të jetojnë dhe ta adhurojnë Zotin dhe nuk bëjnë veprat që Zoti i pëlqen dhe i urdhëron që t'i kryejnë, të cilat Ai i ka bërë shpëtuese nga ndëshkimi i dhembshëm në dynja dhe në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, ata i pret ndëshkimi në këtë jetë, në Ditën e Gjykimit dhe në ditën kur zjarri i ndezur fort t'ua përvëlojë lëkurën dhe trupin e do t'u depërtojë deri në zemër. I Madhëruari thotë:

- "Atë ditë kur, me fytyrat e tyre, të tërhiqen zvarrë në Zjarr..." - Ata do të tërhiqen zvarrë me fytyrat e tyre në Xhehenem, duke u poshtëruar. Dhimbja që do të përjetojnë në fytyrat e tyre do të jetë më e madhe se dhimbja në pjesë të tjera.

Kështu do të poshtërohen dhe nënçmohen ata në Xhehenem. Atyre do t'u thuhet:

- **"Vuajeni dënimin në Sekar!"** - Provojeni dhimbjen e zjarrit, flakëve të tij, vlimit dhe afshit të tij të nxehtë. *Sekar* është një emër i Xhehenemit.

- "Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të caktuar." - "Çdo gjë" nënkupton gjithçka prej botës qiellore e tokësore. Allahu është Krijuesi i tyre dhe është i vetëm në pushtetin e Tij. Ai krijoi gjithçka pasi e përcaktoi me diturinë e Tij dhe pasi e shkroi lapsi i Tij. Çdo gjë Ai e përcaktoi në masë, kohë e çdo cilësi tjetër. Dhe e gjitha kjo është e thjeshtë për Allahun, prandaj i Lartësuari thotë:

- **"Puna Jonë është e shpejtë, sa hap e mbyll sytë."** - Nëse Allahu dëshiron diçka, i thotë "Bëhu!", dhe ajo ekziston ashtu sikurse Ai e dëshiron, brenda një kohe të shkurtër sa lëvizja e shikimit, pa e penguar dot askush dhe pa hasur asnjë vështirësi a lodhje.

- "Ne i shkatërruam ata që ishin si ju, por a ka ndonjë që merr mësim?" – Kuptimi: Allahu i Madhëruar i shkatërroi edhe popujt para jush, të cilët bënë të njëjta punë si ju dhe mohuan ashtu si mohuat edhe ju. A nuk nxirrni mësim se ligji i Allahut si për të parët, edhe për të fundit është i njëjtë? Me urtësinë e Tij, ashtu sikurse gjykoi që ata të ndëshkoheshin, po ashtu do të gjykojë edhe për ju, pasi nuk ka asnjë ndryshim mes jush.

- "Çdo gjë që bënë ata gjendet e shënuar. Çdo vepër, qoftë e vogël a e madhe, është e shënuar në rreshta." - Çdo gjë që ata kanë vepruar është e shkruar në rreshta, në librin e përcaktimit të Zotit.

Çështja e caktimit të Zotit përmblidhet në këtë mënyrë: Allahu është i Gjithëdijshëm. Ai di gjithçka që ndodh e që do të ndodhë. Çdo gjë që Allahu e kishte në diturinë e Tij të plotë e shkroi në *Leuhi Mahfudh*. Çdo gjë që Ai e dëshiroi të ishte, është, dhe atë që Ai nuk e dëshiroi të ishte, nuk është. Çfarë i ndodh njeriut, kurrë nuk mund të mos i ndodhte, dhe ajo që nuk i ndodh, kurrë nuk do të mund t'i ndodhte.

- "Është e vërtetë se të devotshmit do të jenë në kopshte e në lumenj..." - Të devotshëm janë ata që i druhen ndëshkimit dhe zemërimit të Allahut, duke kryer urdhëresat dhe duke iu larguar harameve, që ruhen nga idhujtaria, nga gjynahet e mëdha dhe të vogla. Këta do të jenë në kopshte dhe lumenj të Xhenetit. Atje do të gjejnë atë që syri s'e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe zemra nuk e ka përfytyruar ndonjëherë. Atje ka pemë të mrekullueshme, lumenj që rrjedhin, kështjella të larta, shtëpi të këndshme, ushqim dhe pije të shijshme, hyri të hijshme dhe të bukura. Mes pyjeve, ka kopshte të lulëzuara e stolisura. Mbi të gjitha, atje do të gjejnë kënaqësinë e Mbretëruesit, Sunduesit të vetëm e Shpërblyesit të pamat, ashtu si dhe kënaqësinë e qëndrimit pranë Tij, sikurse thotë i Lartësuari:

- **"...në kuvendin e së vërtetës, tek një Sundues i Plotfuqishëm!"** - Pas kësaj, mos pyet se çfarë do t'u dhurojë Zoti i tyre nga bujaria dhe mirësia e Tij. Ata do të përjetojnë lumturi të papërshkrueshme nga dhuratat e Zotit të tyre. E lusim Allahun të na bëjë prej tyre dhe të mos na privojë nga mirësitë që gjenden tek Ai për shkak të ligësive që ne bëjmë!

Këtu përfundon tefsiri i sures Kamer. Vetëm Allahut i takon lavdia dhe mirënjohja e plotë!

Surja 55: Er Rahman (mekase) 78 ajete

Ajetet 1 – 13

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. I Gjithëmëshirshmi!
2. Ai ua mësoi Kuranin.
3. Ai e krijoi njeriun.
4. Ai e mësoi të shprehet qartë.
5. Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë.
6. Edhe yjet dhe pemët i përulen Atij.
7. Qiellin e ngriti lart dhe vendosi drejtësinë,
8. që ju të mos e shkelni atë.
9. Prandaj matni me drejtësi e mos hani në peshë!
10. Tokën e bëri për krijesat.
11. Në të ka fruta të larmishme: hurma me degët plot,
12. drithëra me gjethe e kërcej dhe *rejhan*.
13. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?!

Shpjegimi i ajeteve

- "I Gjithëmëshirshmi!" - Allahu i Madhëruar e ka çelur këtë sure me emrin e Tij *El Rrahman* - i Gjithëmëshirshmi. Ky emër është tregues i mëshirës së gjerë, përkujdesjes gjithëpërfshirëse, bamirësisë së pamatë dhe mirësive të Tij të shumta.

Më pas, Allahu i Madhëruar përmend konkretisht disa mirësi që vijnë prej mëshirës së Tij. Ato janë mirësi të kësaj dynjaje dhe mirësi të aspektit fetar. Pas përmendjes së çdo mirësie të Tij, ai i nxit njerëzit dhe xhindët që të shprehin mirënjohjen e tyre, duke thënë: "Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?!"

- "Ai ua mësoi Kur'anin." – Allahu u mësoi robërve të Tij tekstin e Kuranit dhe kuptimet e tij. Ai ua lehtësoi ta mësojnë dhe ta kuptojnë, dhe kjo, pa dyshim, është më e madhja mirësi, me të cilën Allahu mëshiroi robërit e Tij. Ai e shpalli Kuranin në gjuhën e pastër arabe, me fjalët më të zgjedhura dhe shpjegimin më të bukur. Kurani përmban çdo mirësi dhe inkurajon për arritjen e saj, duke treguar rrugët dhe veprat me të cilat fitohet ajo. Ai na sqaron edhe veprat që nuk i do e të cilat janë të dëmshme, duke na ndaluar nga kryerja e tyre.

- "Ai e krijoi njeriun." - Allahu e përkreu krijimin e njeriut, duke e bërë atë me organizëm të plotë dhe formë të bukur. Ai e dalloi njeriun mbi të gjitha krijesat e tjera edhe me një veçori tjetër:

- "Ai e mësoi të shprehet qartë." - Allahu e mësoi njeriun si të shprehë atë që ka në shpirtin e tij, me të folur e me të shkruar. Aftësia për të shprehur atë që ndien dhe mendon është nga mirësitë më të mëdha me të cilat Zoti e veçoi njeriun mbi të tjerët.

- "Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë." - Allahu i Madhëruar e krijoi Diellin dhe Hënën dhe i vendosi të lëvizin sipas një rregulli të përcaktuar e të pandryshuar. Këtë e bëri si mëshirë për robërit e Tij dhe si përkujdesje ndaj tyre. Allahu i Madhëruar i vendosi ato në qiell, që nëpërmjet tyre, krijesat të arrijnë shumë dobi, për shembull, të llogarisin vitet, të përcaktojnë kohën dhe afatet në marrëdhëniet mes tyre etj.

- **"Edhe yjet dhe pemët i përulen Atij."** - Yjet në qiell dhe pemët në tokë e njohin madhështinë e Zotit të tyre dhe i bien në sexhde Atij, tregohen të bindur dhe i druhen Atij. Ata i nënshtrohen që të shfrytëzohen për atë që Zoti i krijoi, pra, për dobinë e krijesave në Tokë.

- "Qiellin e ngriti lart dhe vendosi drejtësinë..." - Allahu i Lartësuar e bëri qiellin si tavan dhe mbrojtës për krijesat në tokë. Ai, gjithashtu, vendosi peshoren e drejtësisë mes robërve të Tij. Kjo përfshin gjithçka nëpërmjet së cilës arrihet drejtësia mes krijesave. Allahu i Lartësuar urdhëroi njeriun që të përllogarisë çdo gjë me saktësi e drejtësi, në pesha dhe matje të ndryshme.

- "...që ju të mos e shkelni atë." - Allahu e vuri peshoren e drejtësisë që njerëzit të mos kalojnë kufijtë e të mos shkelin të drejtat e njëri-tjetrit. Nëse çështjet do të liheshin të gjykoheshin thjesht sipas logjikës dhe gjykimit të tyre, atëherë do të kishte shumë padrejtësi dhe do të shkatërroheshin qiejt dhe Toka.

- **"Prandaj matni me drejtësi e mos hani në peshë!"** – Peshoni dhe matni me drejtësi, aq sa janë mundësitë tuaja! Kurrë mos pakësoni e të hani në peshë, sepse ky është krim dhe shkelje e kufijve të Zotit.

- **"Tokën e bëri për krijesat."** - Allahu i Lartësuar e përshtati Tokën për krijesat, që ato të stabilizohen e të jetojnë normalisht në të. Me madhështinë, dendësinë dhe cilësitë e saj të ndryshueshme, ajo është vendbanimi i tyre, ku mund të ndërtojnë, të mbjellin, të hapin rrugë për të lëvizur, të nxjerrin thesaret e fshehura në të etj., duke plotësuar kështu të gjitha nevojat e tyre.

Pastaj i Lartësuari përmend disa nga llojet e sendeve jeike që ka vendosur në tokë:

- "Në të ka fruta të larmishme: hurma me degët plot..." - Te frutat hyjnë të gjitha pemët që japin prodhime, me të cilat njerëzit ushqehen e kënaqen, si: fiku, ulliri, shega, molla, rrushi etj.

Më pas përmenden palmat e hurmave, me degët e mbushura plot me fruta, që njerëzit i konsumojnë ose i ruajnë për më vonë.

- "...drithëra me gjethe e kërcej dhe *rejhan*." - Drithërat janë bimët me kalli, që shërbejnë edhe si ushqim për kafshët dhe bagëtitë. Këtu hyjnë gruri, elbi, misri, orizi etj.

Fjala '*rejhan*' ndoshta përfshin të gjitha perimet jeshile që konsumojnë njerëzit. Por ka mundësi, gjithashtu, që '*rejhan*' të jetë vetëm për borzilokun, bimën aromatike të njohur. Në këtë mënyrë, i Madhëruari u përkujton robërve mirësinë e aromave të këndshme që u ka mundësuar në tokë, të cilat gëzojnë dhe freskojnë shpirtin e tyre.

Pasi përmendi disa nga mirësitë e shumta, të cilat ata i shohin dhe i ndiejnë, Allahu i Madhëruar urdhëron njerëzit e xhindët për të qenë mirënjohës ndaj Tij, duke thënë:

- "Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?!" - Cilën nga mirësitë e Zotit, që kanë lidhje me dynjanë ose me fenë, mohoni ju?

Sa e bukur ishte përgjigjja e xhindëve, kur dëgjuan Profetin t'u lexonte këto vargje. Sa herë që Profeti (a.s.) vinte te ky ajet, ata thoshin: "Asnjë nga të mirat e Tua nuk

mund të mohojmë, o Zoti ynë! Vetëm Ty të takon lavdia dhe mirënjohja!". Pikërisht kështu duhet të veprojë çdo njeri. Sa herë që atij i lexohen dhe kujtohen mirësitë e Allahut, ai duhet t'ia njohë ato Allahut të Madhëruar, duke e lavdëruar Atë për to.

Ajetet 14 – 16

14. Ai e krijoi njeriun nga deltina e tharë,
15. kurse xhindët i krijoi nga flaka e zjarrit.
16. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

- "**Ai e krijoi njeriun nga deltina e tharë...**"
- Allahu i Madhëruar u tregon robërve gjurmët e pushtetit të Tij absolut dhe krijimit të Tij të përkryer e prefekt. Edhe ky informacion, sigurisht, është ndër mirësitë e shumta që Allahu i Madhëruar u ka bërë robërve. Këtu Allahu i Madhëruar na tregon se e krijoi Ademin (a.s.) babain e njerëzimit prej salsal-it. E krijoi njeriun prej balte e lagur mirë e mjaftueshëm. Pastaj ajo u tha mirë dhe u bë si qeramikë që lëshon një zë dhe kumbim (salsaletun) si të ishte e pjekur në zjarr.

- **"...kurse xhindët i krijoi nga flaka e zjarrit." -** Ndërsa babain e xhindëve, Iblisin e mallkuar, e krijoi nga gjuhët e flakës së pastër, ose asaj flake të përzier me tym. Kjo tregon për superjoritetin dhe mirësinë e bazës nga e ecila u krijua njeriu, pra balta e dheu, i cili është i rëndë, i qëndrueshëm, i dobishëm. Ndryshe nga baza e cila u krijuan xhindët, zjarri i cili është i lehtë, i paqëndrueshëm, i keq dhe shkatërrues.

Pasi tregoi krijimin e dy të rëndësishmëve dhe lëndën nga e cila i krijoi, informacion ky që konsiderohet si mirësi nga Allahu i Madhëruar për robërit e Tij, vijoi të thotë:
- "Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"

Ajetet 17 – 18

17. Zoti i dy lindjeve dhe Zoti i dy perëndimeve!
18. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar është Zoti i gjithçkaje që ndriçohet nga Dielli, Hëna dhe yjet dhe Zoti i gjithçkaje ku perëndojnë ato. Çdo gjë që ekziston në to janë nën sundimin dhe përkujdesin e Tij. I Madhëruari përmend dy lindje dhe dy perëndime, ndoshta për të përfshirë lindjen dhe perëndimin e diellit në dimër e në verë.

Ajetet 19 – 23

19. Ai i lejoi dy dete që të takohen,
20. mes të cilëve është një pengesë, që nuk e kapërcejnë.
21. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
22. Prej atyre të dyve nxirren margaritarë e korale.
23. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

Qëllimi këtu është për ujin e ëmbël dhe ujin e kripur. Ata takohen me njëri-tjetrin kur ujërat e ëmbla hidhen në ujërat e kripura. Me këtë kontakt të vazhdueshëm, ata do të përziheshin me njëri tjetrin, por Allahu i Lartësuar ka bërë pengesë mes tyre, që asnjëri të mos përzihet me tjetrin, dhe kështu të mos cenohet dobia e secilit. Secili qëndron në gjendjen e vet, që krijesat të përfitojnë prej tyre. Uji i ëmbël përdoret për

të pirë nga njerëzit dhe kafshët, ashtu siç shërben për të vaditur bimët. Ndërsa nga i kripuri pastrohet ajri dhe nxirren lloje ushqimi, si peshq etj. Gjithashtu, ai është i përshtatshëm për qëndrimin dhe lëvizjen e anijeve e mjeteve të ndryshme të transportit, siç thotë i Lartësuari në vijim:

Ajetet 24 – 25

24. Atij i përkasin anijet që lundrojnë në det dhe që duken si male.
25. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?


Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i mundësoi anijet për robërit e Tij, të cilat, me lejen e Tij, lundrojnë në det. Është i Gjithëmëshirshmi që ia mundësoi njeriut ndërtimin e mjeteve lundruese në përgjithësi. Shpesh, ato janë aq të mëdha, saqë duken si male të larta. Njerëzit hipin në to dhe nëpërmjet tyre transportojnë mallra për tregti etj. Është Allahu i Lartësuar, Ruajtësi i qiejve dhe tokës, Ai që i ruan ata në hapësirat e frikshme të deteve e oqeaneve. Kjo është, sigurisht, një mirësi e madhe e Allahut, për të cilat duhet lavdëruar dhe falënderuar. Prandaj i Lartësuari thotë përsëri: "Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Ajetet 26 – 28

26. Çdo gjë që ndodhet në të ka për t'u zhdukur,
27. e do të mbetet vetëm Fytyra e Zotit tënd, që është i Madhëruar e Bujar!
28. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve



Çdo gjë në këtë botë: njerëz, xhindë, kafshë etj. do të vdesë dhe do të zhduket. Atëherë do të mbetet vetëm i Gjalli, i Cili nuk vdes. Ai është *Dhul Xhelali uel Ikram* - Zotëruesi i madhështisë, krenarisë dhe lartësisë, prandaj meriton madhërimin, adhurimin dhe lavdinë e plotë; ashtu siç është Zotëruesi i bujarisë e mëshirës, që përkujdeset e ka mëshirë për çdo krijesë, në mënyrë të veçantë për të dashurit e Tij, të cilët i ka përzgjedhur mes të tjerëve. Është Allahu, të Cilin adhuruesit e Tij e nderojnë, e respektojnë, e madhërojnë, e duan dhe e lartësojnë. Është Ai tek i Cili besimtarët pendohen dhe kthehen të nënshtruar, është Ai të Cilin të dashurit e Tij e adhurojnë si Një, të Vetëm e të Pashoq.

Ajetet 29 – 30

29. Atij i drejtohet me lutje çfarë është në qiej e në Tokë. Në çdo moment, Ai është i angazhuar me shumë çështje.
30. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

- "Atij i drejtohet me lutje çfarë është në qiej e në Tokë." - Allahu është i Lartësuar, Jonevojtar dhe i pavarur nga të gjitha krijesat e Tij. Ai është i gjerë në bujarinë dhe bamirësinë e Tij. Të gjitha krijesat janë të varfëra dhe të varura nga Ai. Ato i luten e drejtohen Atij për të gjitha nevojat e tyre. Këtë e shprehin si me gjendjen e tyre, ashtu edhe me fjalë e veprime. Krijesat nuk mund të jenë të pavarura nga Ai për asnjë çast. Allahu i Madhëruar thotë:

- "Në çdo moment, Ai është i angazhuar me shumë çështje." - Ai pasuron të varfërin, ndihmon nevojtarin, i jep mirësi dikujt e privon një tjetër, merr jetë dhe jep jetë, krenon disa e poshtëron disa të tjerë. Atë nuk e pengon një çështje nga çështjet e tjera. Atë nuk e ngatërrojnë angazhimet e shumta. Atë nuk e lodhin e as e shqetësojnë insistimet e atyre që luten dhe kërkojnë.

I lartësuar e i pastër nga çdo e metë e mangësi është Bujari e Dhuruesi! Mirësitë e Tij kanë mbuluar krijesat e qiellit dhe të tokës. Butësia dhe mëshira e Tij ka përfshirë të gjitha krijesat, në çdo vend dhe çast. I lavdëruar e i lartësuar qoftë Allahu, të Cilin nuk e pengojnë gjynahet dhe gabimet e gjynahqarëve, që t'u dhurojë atyre nga mirësitë e Tij. Atë nuk e pengon arroganca e injorantëve, që t'i furnizojë e të përkujdeset për ta, megjithëse ata – me injorancën e tyre - shprehin panevojshmëri për bujarinë dhe mirësinë e Tij, ndërkohë që në realitet janë plotësisht nevojtarë dhe të varur nga Ai.

Këto çështje, për të cilat Allahu na tregon se angazhohet çdo ditë, Ai i ka përcaktuar dhe shkruar që në zanafillë. Ai vazhdon t'i realizojë ato në kohën e përcaktuar dhe korrektësisht ashtu si i ka përcaktuar me urtësinë e Tij. Është Allahu që i vendosi si ligjet e funksionimit të gjithësisë së krijuar, ashtu edhe ligjet e fesë. Ai kujdeset për krijesat duke u vendosur atyre Sheriatin, të cilit duhet t'i përmbahen dhe të jetojnë sipas tij. Ai vendosi për ta urdhra e ndalesa, kufij e dispozita, për të cilat do t'i marrë në përgjegjësi Ditën e Gjykimit. Ai vendosi edhe ligjet e krijimit, sipas të cilave Ai kujdeset për krijesat në jetën e kësaj dynjaje, derisa të vijë dita e vdekjes dhe shpërnguljes së tyre në ahiret. Atë ditë do të jetë koha kur do të vihet në zbatim ligji i Tij i shpërblimit me drejtësi. Atë ditë, Ai do t'u paraqesë krijesave drejtësinë, bamirësinë dhe mëshirën e madhe të Tij, nëpërmjet të cilave ato do ta njohin tërësisht dhe do të dëshmojnë se Ai është i Vetëm, i Pakrahasueshëm dhe i Pashembullt në çdo aspekt. Atë ditë krijesat do të zhvendosen nga vendi i provës dhe fatkeqësive, në vendin e shpërblimeve apo shpagimit me drejtësi, në jetën e pasosur. Atë ditë, i Madhërishmi do të veçohet dhe angazhohet me zbatimin e ligjit të shpërblimit të Tij për krijesat, prandaj thotë:

- "Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"

Ajetet 31 – 32

31. Ne do të merremi me ju, o dy të rëndësishmit!
32. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

Ne do të merremi në mënyrë të veçantë me ju, o njerëz dhe xhindë, duke ju llogaritur dhe duke ju dhënë shpërblimin për veprat që bëni në jetën e dynjasë.

Ajetet 33 – 34

33. O masë e xhindëve dhe e njerëzve, nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të Tokës, atëherë dilni! Por ju nuk mund ta bëni këtë, veçse me ndonjë fuqi të madhe.
34. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

Kur t'i mbledhë të gjithë në Ditën e Gjykimit, Allahu i Madhëruar do t'u tregojë njerëzve dhe xhindëve për dobësinë e tyre dhe për fuqinë absolute të Tij. Ai do t'ua bëjë të qartë se vendimtar dhe i padiskutueshëm është vullneti i Tij. Asgjë nuk del jashtë vullnetit dhe pushtetit të Allahut.

Duke u treguar dobësinë e pafuqinë e tyre, Allahu i Madhëruar do t'u thotë krijesave: "Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të Tokës, atëherë dilni! Por ju nuk mund ta bëni këtë, veçse me ndonjë fuqi të madhe." Pra, nëse gjeni ndonjë rrugë e mundësi për të dalë jashtë fushës së sundimit të Allahut, bëjeni! Por ju nuk do mund të dilni kurë, veçse nëse do të kishit fuqi të madhe.

Por nga mund t'u vijë kjo fuqi, ndërkohë që ata nuk mund t'i bëjnë as vetes së vet dëm apo dobi, nuk mund të japin jetë e vdekje dhe nuk mund të ringjallin?! Ditën e Gjykimit, në atë vendqëndrim të frikshëm, askush nuk flet pa lejen e Allahut. Atje do të jenë të barabartë mbretërit dhe skllevërit, udhëheqësit dhe masat, të pasurit dhe të varfërit.

Më pas, Allahu i Madhëruar tregon se çfarë ka përgatitur atë ditë të madhe për ta:

Ajetet 35 – 36

35. Mbi ju të dy do të dërgohet flakë zjarri dhe tym përvëlues, e nuk do të keni mundësi të mbroheni.
36. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?


Shpjegimi i ajeteve

I Plotfuqishmi i paralajmëron njerëzit e xhindët për dy forma të ndëshkimit: "*shuadhun min-nari*" - "flakë të pastra zjarri" dhe "*nuhasun*" - "tym i përzier me zjarr", pra, një tym i nxehtë e përvëlues. (Nuk është çudi që "*nuhasun*" të vijë edhe me kuptimin "plumb i shkrirë".) Këto dy lloje ndëshkimi ju kërcënojnë, o njerëz e xhindë! Zjarri dhe tymi do t'ju rrethojnë dhe nuk do të gjeni ndihmë e shpëtim nga askush, veç Zotit.

Edhe kërcënimet e Allahut ndaj robërve janë mirësi e madhe e Tij, sepse nëpërmjet tyre Ai i udhëzon dhe kthen ata në rrugën e drejtë. Prandaj i Lartësuari thotë përsëri, për të nxitur mirënjohjen e tyre: "Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Ajetet 37 – 42

37. Kur qielli të çahet e të skuqet, si plumb i shkrirë.
38. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
39. Atë ditë nuk pyetet për gjynahet e veta as njeriu, as xhindi.
40. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
41. Keqbërësit njihen me tiparet e tyre, prandaj me forcë do të rrëmbehen për flokësh dhe për këmbësh.


الجزء السابع والعشرون سورة الرحمن

فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٤٢﴾ هَٰذِهِۦ جَهَنَّمُ ٱلَّتِى يُكَذِّبُ بِهَا
ٱلْمُجْرِمُونَ ﴿٤٣﴾ يَطُوفُونَ بَيْنَهَا وَبَيْنَ حَمِيمٍ ءَانٍ ﴿٤٤﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ
رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٤٥﴾ وَلِمَنْ خَافَ مَقَامَ رَبِّهِۦ جَنَّتَانِ ﴿٤٦﴾ فَبِأَيِّ
ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٤٧﴾ ذَوَاتَآ أَفْنَانٍ ﴿٤٨﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا
تُكَذِّبَانِ ﴿٤٩﴾ فِيهِمَا عَيْنَانِ تَجْرِيَانِ ﴿٥٠﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
﴿٥١﴾ فِيهِمَا مِن كُلِّ فَٰكِهَةٍ زَوْجَانِ ﴿٥٢﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
﴿٥٣﴾ مُتَّكِـِٔينَ عَلَىٰ فُرُشٍۭ بَطَآئِنُهَا مِنْ إِسْتَبْرَقٍ ۚ وَجَنَى ٱلْجَنَّتَيْنِ دَانٍ
﴿٥٤﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٥٥﴾ فِيهِنَّ قَٰصِرَٰتُ ٱلطَّرْفِ
لَمْ يَطْمِثْهُنَّ إِنسٌ قَبْلَهُمْ وَلَا جَآنٌّ ﴿٥٦﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
﴿٥٧﴾ كَأَنَّهُنَّ ٱلْيَاقُوتُ وَٱلْمَرْجَانُ ﴿٥٨﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
﴿٥٩﴾ هَلْ جَزَآءُ ٱلْإِحْسَٰنِ إِلَّا ٱلْإِحْسَٰنُ ﴿٦٠﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا
تُكَذِّبَانِ ﴿٦١﴾ وَمِن دُونِهِمَا جَنَّتَانِ ﴿٦٢﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا
تُكَذِّبَانِ ﴿٦٣﴾ مُدْهَآمَّتَانِ ﴿٦٤﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ
﴿٦٥﴾ فِيهِمَا عَيْنَانِ نَضَّاخَتَانِ ﴿٦٦﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٦٧﴾
فِيهِمَا فَٰكِهَةٌ وَنَخْلٌ وَرُمَّانٌ ﴿٦٨﴾ فَبِأَيِّ ءَالَآءِ رَبِّكُمَا تُكَذِّبَانِ ﴿٦٩﴾

٥٣٣

42. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

- **"Kur qielli të çahet e të skuqet, si plumb i shkrirë. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?" -** Ditën e Gjykimit gjendja do të jetë shumë e rëndë. Frikërat do të jenë të llojllojshme. Diellit e Hënës do t'u shuhet drita, ndërsa yjet do të shpërbëhen e rrëzohen. Nga frika e madhe, qielli atë ditë do të jetë si plumb i shkrirë apo diçka e ngjashme me të.

- **"Atë ditë nuk pyetet për gjynahet e veta as njeriu, as xhindi. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Atë ditë nuk do të pyeten njerëzit dhe xhindët për të mësuar se ç'ka ndodhur, sepse Allahu është i Gjithëdituri, që di të dukshmen dhe të fshehtën, të shkuarën dhe të ardhmen. Ai do t'i shpërblejë ata sipas veprave të tyre, të cilat Ai i di shumë mirë.

Allahu i Lartësuar ka bërë që, Ditën e Gjykimit, të mirët dhe të këqijtë të kenë shenja të dukshme, me të cilat do të dallohen nga njëri-tjetri, sikurse thotë i Lartësuari në një sure tjetër: "Ditën kur do të ketë fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen, atyre të cilëve u janë nxirë fytyrat u thuhet: "A mohuat edhe pasi kishit besuar njëherë?! Atëherë, vuajeni dënimin, për shkak të mohimit tuaj!" Ndërsa ata të cilëve u janë zbardhur fytyrat, ata janë në mëshirën e Allahut, ku do të jenë përjetësisht." [Al Imran 106, 107]. Ndërsa në këtë sure thotë:

- "Keqbërësit njihen me tiparet e tyre, prandaj me forcë do të rrëmbehen për flokësh dhe për këmbësh. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?" - Keqbërësit do të kapen me forcë për këmbësh e prej flokëve të ballit, e ashtu zvarrë do të hidhen në Zjarr. Allahu i Madhëruar do t'i pyesë ata veçse për t'i poshtëruar, duke i bërë t'i pranojnë vetë krimet e tyre në dynja, edhe pse Ai është i Gjithëdijshëm për ta. Ai është më i ditur për ta se ata për veten e tyre, por Allahu i Madhëruar dëshiron që t'ua shfaqë haptazi faktet e Tij të pamohueshme dhe urtësinë e Tij të madhe.

Ajetet 43 – 45

43. Ja, ky është Xhehenemi, të cilin keqbërësit e mohonin.
44. Ata do të sillen vërdallë ndërmjet atij dhe ujit të valuar.
45. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?

Shpjegimi i ajeteve

- "Ja, ky është Xhehenemi, të cilin keqbërësit e mohonin." - Këto janë fjalët që u thuhen keqbërësve e mohuesve, refuzuesve të shpalljeve e të ringjalljes, mosbesuesve të premtimeve e kërcënimeve të Allahut. Këto fjalë u thuhen kur Xhehenemi ndizet e përflaket, si "mirëseardhje" për ta. Le të shohin realizimin e asaj që mohuan dhe le ta shijojnë ndëshkimin, dhimbjen, nxehtësinë dhe prangat e ndëshkimit në Zjarr, si 'shpërblim' për mosbesimin e tyre.

- "Ata do të sillen vërdallë ndërmjet atij dhe ujit të valuar. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?" - Ata vërtiten mes niveleve të Xhehenemit e mes ujit të nxehtë në kulm, e ndonjëherë me '*zemherir*' - në të ftohtin e acartë e të dhimbshëm.

Pas ndëshkimit që i pret mohuesit e keqbërësit, përshkruhet shpërblimi i të devotshmëve, që i frikësohen Zotit dhe ndëshkimit të Tij të drejtë.

Ajetet 46 – 78

46. Për atë që i është druajtur daljes para Zotit të vet, janë përgatitur dy xhenete.
47. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
48. Plot pemë, që bëjnë hije.
49. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
50. Tek ata të dy ndodhen dy burime, që rrjedhin.
51. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
52. Tek ata të dy, prej të gjitha frutave ka nga dy lloje.
53. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
54. Ata do të jenë të mbështetur në shtroje, mbulesat e brendshme të të cilave janë prej mëndafshi të stolisur, dhe frytet e pemëve të dy xheneteve janë shumë pranë.
55. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
56. Aty janë ato që i përqendrojnë shikimet e tyre e të cilat nuk i ka prekur kush më parë, as njerëz, as xhindë.
57. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
58. Ato janë si rubinë e korale.
59. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
60. A nuk është shpërblimi i veprës së mirë veçse e mira?!
61. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
62. E nën ata të dy janë edhe dy kopshte të tjera.
63. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
64. Nga gjelbërimi i dendur, ato duken të mbyllura në të zi.
65. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
66. Aty janë dy burime, që gjithnjë gurgullojnë.
67. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
68. Në ata të dy, ka fruta: hurma dhe shegë.
69. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
70. Aty janë ato të mirat e të bukurat.
71. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
72. Ato janë hyri symëdha, që qëndrojnë vetëm brenda kështjellave.
73. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
74. Ato nuk i ka prekur kush më parë, as njeri e as xhind.

75. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
76. Aty rrinë të mbështetura në shtroje të gjelbra e qilima të bukur.
77. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?
78. I lartësuar qoftë emri i Zotit tënd të Madhëruar e Bujar!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Për atë që i është druajtur daljes para Zotit të vet, janë përgatitur dy xhenete. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Për atë që ka frikë qëndrimin para Zotit Ditën e Llogarisë, prandaj iu largohet harameve dhe zbaton urdhëresat e Tij, janë përgatitur dy xhenete, me enë, stoli, ndërtesa e gjithçka prej floriri. Njëri nga xhenetet është përgatitur si shpërblim për largimin nga haramet, ndërsa xheneti tjetër si shpërblim për zbatimin e detyrimeve në bindje ndaj Zotit. I Lartësuari i përshkruan kështu këto dy xhenete:

- **"Plot pemë, që bëjnë hije. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Në to ka mirësi të panumërta për shpirtin dhe trupin, mirësi të cilat as syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar dhe as zemra e robit nuk i ka imagjinuar ndonjëherë. Në to ka pemë të lulëzuara, me degë të lëmuara e të mbushura përplot me fruta të mrekullueshme etj.

- **"Tek ata të dy ndodhen dy burime, që rrjedhin. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** – Atje ka burime, që banorët e Xhenetit mund t'i bëjnë të rrjedhin kur dhe ku të dëshirojnë ata.

- **"Tek ata të dy, prej të gjitha frutave ka nga dy lloje. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Për çdo lloj frute janë bërë dy varietete: secili ka shijen, ngjyrën e aromën që nuk e ka tjetri.

- **"Ata do të jenë të mbështetur në shtroje, mbulesat e brendshme të të cilave janë prej mëndafshi të stolisur..."** – Ky është përshkrimi i shtretërve dhe i vendpushimit të banorëve të Xhenetit. Mënyra e qëndrimit të tyre mbi to tregon qetësinë, prehjen dhe kënaqësinë e tyre të madhe, ashtu si mbretërit në shtretërit e tyre. Bukurinë dhe hijeshinë e shtrojeve të tyre e di veçse Allahu i Madhëruar. Madje, pjesa e poshtme, që zakonisht vendoset në tokë, është prej mëndafshit më të mirë. Atëherë, si do të jetë, vallë, pjesa e sipërme, që prek lëkurën dhe trupin e tyre?!

- **"...dhe frytet e pemëve të dy xheneteve janë shumë pranë. E cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Frutat e pemëve në këto xhenete janë shumë pranë për t'u marrë. Ato mund t'i marrë kollaj ai që është në këmbë, ai që është ulur dhe ai që është i shtrirë ose i mbështetur.

- **"Aty janë ato që i përqendrojnë shikimet e tyre..."** - Vështrimet e këtyre grave janë të kufizuara vetëm te bashkëshortët e tyre, për shkak të bukurisë së burrave dhe dashurisë së fortë të grave për ta. Edhe vështrimet e burrave janë të mbërthyera te gratë e tyre, për shkak të bukurisë së grave dhe kënaqësisë së madhe të kontaktit me to.

- **"...e të cilat nuk i ka prekur kush më parë, as njerëz, as xhindë. Cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** – Këto gra të Xhenetit

nuk i ka prekur askush më parë, as njeri e as xhind. Ato janë të virgjëra dhe shumë të dashuruara pas burrave të tyre. Ato janë shumë të zonja për të falur kënaqësi e dashuri, me fjalë e zëra tërheqës, me përkëdhelje e sjellje të ëmbla. Ato janë sikurse i përshkruan Zoti i tyre:


- **"Ato janë si rubinë e korale. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Kështu përshkruhet kthjelltësia e shikimit të tyre dhe hijeshia e pamjes së tyre.

- **"A nuk është shpërblimi i veprës së mirë veçse e mira?! Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - A ka shpërblim tjetër, veç mirësive të mëdha, për ata që janë bamirës, duke kryer adhurimin ndaj Zotit dhe duke qenë të dobishëm ndaj krijesave të Zotit?! Sigurisht, këtyre u premtohet shpërblim i madh, sukses në çdo të mirë dhe ruajtje nga çdo e keqe. Ata do të kenë begati, paqe e lumturi të përjetshme.

- **"E nën ata të dy janë edhe dy kopshte të tjera. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Ndërtesat, enët dhe stolitë në to janë prej argjendi, të përgatitura për të djathtit.

- **"Nga gjelbërimi i dendur, ato duken të mbyllura në të zi. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** – Ato janë të errëta nga gjelbërimi i shumtë dhe i dendur i tyre. Ky gjelbërim vjen nga uji i shumtë që rrjedh nëpër to.

- **"Aty janë dy burime, që gjithnjë gurgullojnë. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** – Janë burime që



gurgullojnë vazhdimisht e që të kënaqin me tingullin e tyre.

- **"Në ata të dy ka fruta: hurma dhe shegë. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** – Atje ka nga të gjitha llojet e frutave, ku ndër më të veçantat janë hurmat dhe shegët e shijshme e të dobishme.

- **"Aty janë ato të mirat e të bukurat. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Në të gjitha xhenetet ka gra, që Zoti i përshkruan si *'hajratun'* - të mira në moralin e tyre dhe *'hisan'* - të bukura në pamjen e tyre.

- **"Ato janë hyri symëdha, që qëndrojnë vetëm brenda kështjellave. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni? Ato nuk i ka prekur kush më parë, as njeri e as xhind. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e**

mohoni?" - Ato janë mbyllur brenda kështjellave prej smeraldi dhe janë përgatitur e zbukuruar për burrat e tyre.

Por ky përshkrim nuk tregon se ato janë të ndaluara të dalin e të shëtisin nëpër kopshtet e lulishtet e mrekullueshme të Xhenetit. Sikurse ndodh zakonisht me princeshat, ato janë të kufizuara dhe të ruajtura brenda kështjellave.

- **"Aty rrinë të mbështetura në shtroje të gjelbra e qilima të bukur. Atëherë, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni?"** - Në këto xhenete, vendet ku ulen banorët janë me shtroje palë mbi njëra tjetrën, për t'ua shtuar më shumë bukurinë. Ato janë në ngjyrë të gjelbër dhe shumë tërheqëse. Qilimat janë të thurur e të punuar me finesë dhe të butë në prekje. Këto dy kopshte janë poshtë dy xheneteve të para, sikurse thotë i Madhëruari: "E nën ato të dy janë edhe dy kopshte të tjera". Allahu i Madhëruar i ka veçuar dy xhenetet e para me cilësi që nuk i kishin të dytat. Kështu:

- Për të parët thotë: "Tek ata të dy janë dy burime, që rrjedhin", ndërsa për të dytët thotë: "Aty janë dy burime, që gjithnjë gurgullojnë". Dhe kuptohet mirë dallimi mes burimeve që rrjedhin me bollëk dhe burimeve që gurgullojnë.

- Për dy xhenetet e para thuhet që janë: "Plot pemë, që bëjnë hije", dhe kjo nuk thuhet për dy të tjerët.

- Për të parët thuhet: "Tek ata të dy, prej të gjitha frutave ka nga dy lloje", ndërsa për dy të tjerët thuhet: "Në ata të dy ka fruta: hurma dhe shegë."

- Për të parët thuhet: "Ata do të jenë të mbështetur në shtroje, mbulesat e brendshme të të cilave janë prej mëndafshi të stolisur, dhe frytet e pemëve të dy xheneteve janë shumë pranë", përshkrim ky më i plotë dhe më i bukur sesa për të dytët, kur thuhet: "Aty rrinë të mbështetura në shtroje të gjelbra e qilima të bukur."

- Për të parët, duke përshkruar gratë e Xhenetit, thuhet: "Aty janë ato që i përqendrojnë shikimet e tyre, të cilat nuk i ka prekur kush më parë, as njerëz, as xhindë." Dhe: "Ato janë si rubinë e korale". Ndërsa për të dytat thuhet: "Ato janë hyri symëdha, që qëndrojnë vetëm brenda kështjellave" Dhe: "Ato nuk i ka prekur kush më parë, as njeri e as xhind". Kuptohet shumë mirë dallimi mes dy rasteve.

- Për të parët thuhet: "A nuk është shpërblimi i veprës së mirë (*ihsan*) veçse e mira (*ihsan*)?!" Kjo tregon se dy të parët janë shpërblim për bamirësit që arrijnë gradën e *ihsan*-it. Por kjo nuk thuhet edhe për kopshtet e dyta.

- Gjithashtu, thjesht përmendja në fillim e dy xheneteve të para tregon për vlerësimin e tyre më të madh, në krahasim me dy xhenetet e dyta.

Me këto tregues, kuptohet se dy xhenetet e para janë më të mira dhe janë përgatitur për më të zgjedhurit, të afruarit e Zotit, si: profetët, të sinqertët, shehidët dhe bamirësit. Ndërsa dy xhenetet e tjera janë përgatitur për besimtarët e tjerë.

Sidoqoftë në këto xhenete ka mirësi që sytë nuk i kanë parë, veshët nuk i kanë dëgjuar dhe zemra e askujt nuk i ka përfytyruar. Atje do të gjejnë gjithçka që ua dëshiron shpirti dhe që u kënaq syrin. Banorët e tyre do të jenë në kulmin e rehatisë, kënaqësisë, prehjes dhe në vendbanime të mrekullueshme. Aq të lumtur janë, saqë secili prej tyre mendon se askush nuk është në lumturi më të madhe se ajo e tij.

Pasi përshkroi mëshirën dhe bujarinë e Tij të gjerë, duke treguar për mirësitë e Tij të shumta, i Lartësuari thotë:

- "I lartësuar qoftë emri i Zotit tënd të Madhëruar e Bujar!" - Të panumërta janë mirësitë e Allahut! E madhe është bujaria e Tij! Allahut i takon madhështia absolute, krenaria e plotë dhe bujaria e pakufishme, të cilën Ai e ka veçuar për të nderuar të dashurit e Tij.

Përfundoi edhe tefsiri i sures Rrahman. Vetëm Allahut i takon lavdia dhe mirënjohja! Për Allahun janë lavdet më të bukura!

Surja 56: El Uakiah (mekase) 96 ajete

Ajetet 1 – 40

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. E kur të ndodhë Ngjarja,
2. ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë.
3. Disa do t'i ulë e disa do t'i lartësojë.
4. Kur toka të tundet me dridhje të forta,
5. kur malet të thërrmohen e bëhen copë-copë,
6. kur ato të bëhen si pluhur i shpërndarë,
7. atëherë ju do të ndaheni në tri grupe:
8. Janë të djathtët: e cilët janë ata të djathtët se?!
9. Janë të majtët: e cilët janë ata të majtët se?!
10. Pastaj janë të përparuarit, që janë të dalluarit.
11. Ata janë më të afruarit
12. dhe gjenden në kopshte të begatshme.
13. Shumë janë prej të hershmëve
14. e pak prej të mëvonshmëve.
15. Ata janë në shtretër të qëndisur me ar e gurë të çmuar.
16. Të mbështetur qëndrojnë në to, përballë njëri-tjetrit.
17. Atyre u shërbejnë djelmosha të përjetshëm,
18. me kupa, ibrikë dhe me gota plot me pije të kulluar, prej një burimi që rrjedh,
19. pije prej së cilës as nuk u dhemb koka, as nuk dehen;
20. gjithashtu, me fruta sipas përzgjedhjes së tyre,
21. dhe mish shpendësh, si ua ka ënda.
22. Atje do të kenë edhe hyri symëdha
23. të cilat duken si diamante të ruajtura.
24. Ky është shpërblimi për veprat e tyre.
25. Atje nuk dëgjojnë fjalë të kota e as fjalë gjynahesh.
26. Por vetëm fjalë të mira dhe qetësuese.
27. E ata të djathtët: e kush janë të djathtët se?!
28. Ata qëndrojnë mes lotusve pa gjemba,
29. bananeve me fruta palë-palë,
30. nën hije të gjera,
31. pranë një uji që rrjedh,
32. mes frutave të shumëllojshme,
33. që as nuk mbarohen, as nuk janë të ndaluara.
34. Ata qëndrojnë në shtretër të lartë.
35. Ne i kemi bërë ato me një krijim të ri,
36. i kemi bërë virgjëresha,
37. të dashuruara dhe të një moshe,
38. për ata të djathtët,
39. që janë shumë nga të hershmit
40. e shumë nga më të vonshmit.

Shpjegimi i ajeteve

- "E kur të ndodhë Ngjarja..." - Allahu i Madhëruar na flet për ngjarjen e madhe, për Kijametin, që do të ndodhë patjetër.

- "...ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë." – Për të nuk ka dyshim se do të

ndodhë, sepse faktet e vërtetësisë së saj janë të shumta, të qarta dhe të kuptueshme. Kijameti është një ndodhi të cilën e kërkon edhe urtësia e Allahut të Madhëruar.

- "**Disa do t'i ulë e disa do t'i lartësojë.**" - Për disa, ajo ditë ka për të qenë poshtërim dhe zhytje në humnerat më të thella të Zjarrit, ndërsa për disa të tjerë ka për të qenë lartësuese në më të lartat grada të *Ilijin*-it. Ky është njëri nga kuptimet e ajetit.

Kuptimi tjetër është: Ajo është ditë e dëgjueshme për ata që janë afër dhe për ata që janë larg. Në fakt, bëhet fjalë për ushtimën e Kijametit, të cilën do ta dëgjojnë ata që janë pranë dhe ata që janë larg, banorët e Tokës dhe ata të qiellit.

- "**Kur toka të tundet me dridhje të forta...**" - Kur toka të tronditet fort.

- "**...kur malet të thërrmohen e bëhen copë-copë...**" - Kur malet të bëhen thërrime.

- "...**kur ata të bëhen si pluhur i shpërndarë...**" - Toka do të shndërrohet në një vend që nuk ka asnjë të ngritur, sikurse thotë i Madhëruari në një sure tjetër: "Të pyesin ty për malet. Thuaju: "Zoti im do t'i bëjë ato thërrmija të shpërndara dhe vendin e tyre do ta bëjë rrafsh, pa asnjë bimë e ndërtesë. Nuk do të shohësh në të as ultësirë e as lartësirë"." [Ta He 105 – 107].

- "**...atëherë ju do të ndaheni në tri grupe...**" - Krijesat do të ndahen në tri grupe, në varësi të veprave të tyre, të mira apo të këqija. I Madhëruari na i shtjellon më pas gjendjen e këtyre tri grupeve:

- "**Janë të djathtët: e cilët janë ata të djathtët se?!**" - Kjo pyetje tregon rëndësinë e madhe dhe gjendjen e tyre të mrekullueshme.

- "**Janë të majtët: e cilët janë ata të majtët se?!**" – Forma pyetëse nënkupton tmerrin e madh dhe gjendjen e tyre të mjerueshme.

- "**Pastaj janë të përparuarit, që janë të dalluarit. Ata janë më të afruarit dhe gjenden në kopshte të begatshme.**" - *Sabikun*-ët janë të përparuarit, garuesit në dynja për kryerjen e veprave të mira. Ata do të jenë të përparuarit edhe në ahiret, sepse do të hyjnë të parët në mirësitë e Xhenetit. Ata janë të afruarit dhe të zgjedhurit e Allahut, për të qenë në vendet më të larta të *Ilijjin*-it, në Xhenet, ku askush nuk do të jetë më lart se ata. Për këta, Allahu i Madhëruar thotë gjithashtu:

- "**Shumë janë prej të hershmëve e pak prej të mëvonshmëve.**" – Shumica e tyre janë nga brezat e shkuara të këtij umeti dhe të umeteve të tjera. Kjo dëshmon për gradën e lartë të brezave të parë të këtij umeti, në krahasim me brezat e mëvonshëm. *Mukarrabun*-ët janë më të zgjedhurit dhe më të përkryerit e krijesave. Zoti ka përgatitur mrekullira për ta. Ja një përshkrim i këtyre mirësive:

- "**Ata janë në shtretër të qëndisur me ar e gurë të çmuar.**" – Shtretër me flori, argjend diamante, smeralde e stoli të tjera, bukurinë e të cilave vetëm Allahu i Lartësuar e di.


- "**Të mbështetur qëndrojnë në to, përballë njëri-tjetrit.**" - Ata ulen dhe mbështeten mirë në ato shtretër, të rehatuar dhe të lumturuar. Ata qëndrojnë përballë njëri-

tjetrit me fytyrë, me shpirtra të kulluar, me moral të pastër dhe zemra të afruara.

- "Atyre u shërbejnë djelmosha të përjetshëm..." – Këta djem të rinj vërtiten mes banorëve të Xhenetit për t'u shërbyer dhe përmbushur çdo kërkesë dhe dëshirë të tyre. Ata janë djelmosha shumë të bukur dhe të hijshëm. Ata janë ashtu si i përshkruan i Madhëruari, që i krijoi: "si diamantë të ruajtur", pra, si diamantë të fshehur, që nuk i ka dëmtuar apo cenuar gjë. Ata janë krijuar që të jenë të përjetshëm: nuk plaken, nuk ndryshojnë dhe nuk rriten më shumë nga mosha e vogël që Zoti i ka krijuar. Ata vërtiten mes xhenetlinjve me enët e tyre plot pije të mrekullueshme:

- "...me kupa, ibrikë dhe me gota plot me pije të kulluar, prej një burimi që rrjedh..." - Me kupa (*ekuab*), që nuk kanë bisht, dhe ibrikë (*ebarik*). Enët janë të mbushura me pije të shijshme, që nuk të sjellin ndonjë dëm, sikurse thotë i lavdëruari:

- "...pije prej së cilës as nuk u dhemb koka, as nuk dehen..." - Prej atyre pijeve nuk të dhemb koka dhe as të ikën mendja, sikurse ndodh me ndodh me pijet dehëse të dynjasë. Me fjalë të tjera, çdo mirësi që gjendet në Xhenet, lloji i të cilave gjendet edhe në dynja, do të jetë e pastër nga çdo mangësi që ato kanë patur në dynja, sikurse thotë i Madhëruari: "Ja përshkrimi i Xhenetit, i cili u është premtuar të devotshmëve: Në të ka lumenj me ujë gjithnjë të kristaltë, lumenj qumështi me shije të paprishur, lumenj vere të këndshme për ata që pinë dhe lumenj mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe janë të falur nga Zoti i tyre. A janë njëlloj të tillët me atë që është



përgjithmonë në Zjarr dhe etja i shuhet me ujë të valë, që ia copëton zorrët?!" [Muhamed 15].

- "...gjithashtu, me fruta sipas përzgjedhjes së tyre..." - Çdo frut që ua tërheq shikimin dhe ua dëshiron shpirti, atyre do t'u ofrohet në formën më të bukur.

- "...dhe mish shpendësh, si ua ka ënda." – Mish nga çdo lloj shpendi që dëshirojnë, madje çdo lloj mishi që e duan do t'u jepet: të pjekur, të skuqur apo të zier, sipas dëshirës.

- "Atje do të kenë edhe hyri symëdha, të cilat duken si diamante të ruajtura." – Ato janë gra të bukura, me sy të mëdhenj e shumë të bukur. Ato janë, sikurse thotë i Madhëruari: si xhevahirë të rrallë, të shkëlqyeshëm dhe vezullues, të ruajtur dhe

të fshehur, që nuk i kap era, sytë apo dielli, me ngjyrat e nuancat më të bukura. Sado t'i kundrosh, nuk mund të gjesh asnjë mangësi, por vetëm perfeksion. Kështu janë edhe hyritë sybukura. Tek ato nuk mund të gjesh asnjë mangësi, sepse janë të plota në çdo detaj. Çdo gjë që vështron tek ato të sjell kënaqësi për sytë dhe zemrën.

- "Ky është shpërblimi për veprat e tyre." - Për veprat e mira të tyre, Allahu Bujar e i Gjithëmëshirshëm i shpërblen shumëfish. Ai u dhuron mirësi, begati dhe fitoren më të madhe, që është shpëtimi nga çdo e keqe dhe përjetësia në Xhenet.

- "Atje nuk dëgjojnë fjalë të kota e as fjalë gjynahesh." - Në Xhenet nuk do të dëgjojnë fjalë të padobishme dhe as fjalë që të ngarkojnë me gjynahe. Ajo që do të gjëjnë në të është:

- "Por vetëm fjalë të mira dhe qetësuese." - Veç fjalë të ëmbla, të buta dhe lumturuese, sepse ai është vendi ku ka vetëm mirësi dhe kënaqësi. Kjo tregon për edukatën e banorëve të Xhenetit me njëri-tjetrin, që shprehet edhe në fjalët e tyre. E lusim Allahun të na dhurojë nga mirësitë e bujaria e Tij! Pastaj i Madhëruari përmend mirësitë e të djathtëve:

- "E ata të djathtët: e kush janë të djathtët se?!" – Ata janë tepër të rëndësishëm dhe me gradë të lartë.

- "Ata qëndrojnë mes lotusve pa gjemba..." – Lotus pa gjemba dhe pa degë të tepërta e të dëmshme. Madje, në vend të gjembave, janë vendosur fruta. Veçori e këtij lotusi është hija e madhe që bën, nga vjen edhe rehatia e qëndrimit poshtë tij.

- "...bananeve me fruta palë-palë..." – Bananet që qëndrojnë njëra mbi tjetrën në degë.

- "...nën hije të gjera..." – Në hije ku ata rehatohen, duke shijuar çdo mirësi që ua kënaq syrin dhe shpirtin.

- "...pranë një uji që rrjedh..." - Ujë i shumtë, që buron e rrjedh lumë, me bukuri të veçantë.

- "...mes frutave të shumëllojshme, që as nuk mbarohen, as nuk janë të ndaluara." - Ato nuk janë si frutat e dynjasë, që u ndërpritet prodhimi dhe është e vështirë t'i gjesh ndonjëherë. Ato janë gjithmonë të pranishme, mbi degët e rënduara të pemëve, që robi i Zotit të mund t'i marrë në çdo gjendje qoftë: në këmbë, ulur apo shtrirë.

- "Ata qëndrojnë në shtretër të lartë." – Me shtroje që qëndrojnë shumë sipër shtretërve dhe që janë prej mëndafshi, të qëndisura dhe të zbukuruara me flori, diamante e të tjera, që vetëm Zoti i di.

- "Ne i kemi bërë ato me një krijim të ri..." - Gratë e Xhenetit janë të një krijimi të ri, ndryshe nga ai i kësaj dynjaje. Ai është krijim i plotë, që nuk ka fund dhe shkatërrim.

- "...i kemi bërë virgjëresha, të dashuruara dhe të një moshe..." – Të tilla janë si gratë besimtare që kanë vdekur të mëdha, ashtu edhe ato që kanë vdekur të vogla. Ky përshkrim përfshin gjithashtu si hyritë që

Zoti i krijoi në Xhenet, ashtu edhe gratë besimtare të dynjasë, që Zoti i nderon dhe i fut në Xhenet. Virgjëria i shoqëron ato në të gjitha gjendjet.

Edhe dashuria për burrat e tyre është e vazhdueshme, duke e shprehur këtë me fjalë të ëmbla e përkëdhelje. Kur ato flasin, dëgjuesi nuk do dëshironte kurrë që të heshtnin. Zëri dhe këndimi i tyre është i mahnitshëm. Kur qëndrojnë në heshtje, e mbushin zemrën e burrit të tyre me gëzim e lumturi. Kur ato shfaqen diku, e mbushin atë vend me aromë, freski dhe dritë. Ato dinë të shprehin me fjalë kënaqësinë që ndiejnë dhe të kënaqin me fjalë burrin gjatë marrëdhënieve.

Gratë e Xhenetit janë në të njëjtën moshë, të gjitha tridhjetë e tre vjeçe, në kulmin e rinisë dhe kënaqësisë. Ato janë të afruara, të dashura, të kënaqura dhe që dhurojnë kënaqësi. Ato nuk trishtohen dhe kurrë nuk shkaktojnë trishtim, Ato janë shpirtrat më të lumtur e më lumturues, që të kënaqin syrin dhe shpirtin.

- **"...për ata të djathtët..."** - Ky shpërblim është përgatitur për të djathtët.

- **"...që janë shumë nga të hershmit e shumë nga më të vonshmit."** – Nga të djathtët, shumë janë prej brezave të parë dhe shumë prej të mëvonshmëve.

Ajetet 41 – 57


41. **Janë ata të majtit: e kush janë ata të majtit se?!**
42. **Ata janë në afshin përvëlues të zjarrit dhe në ujë të valë,**
43. **nën një hije tymi,**
44. **as të freskët e as të këndshme.**
45. **Më përpara, ata kanë qenë të dhënë pas luksit**
46. **dhe vazhdimisht kryenin gjynahe të mëdha.**
47. **Ata thoshin: "Vallë, pasi të vdesim, të bëhemi dhé e eshtra, vërtet do të ringjallemi?!**
48. **Vallë, edhe etërit tanë të hershëm?"**
49. **Thuaju: "Të jeni të sigurt se, edhe të parët edhe të fundmit,**
50. **keni për t'u tubuar në një ditë të caktuar!**
51. **Atëherë, ju, o të humbur e jobesimtarë,**
52. **keni për të ngrënë prej pemës Zekum**
53. **Prej saj keni për ta mbushur barkun!**
54. **E menjëherë pas saj do të pini prej ujit të vluar,**
55. **do të pini si deveja e etshme!"**
56. **Kjo është "gostia" e tyre në Ditën e Gjykimit.**
57. **Ne ju kemi krijuar ju, përse nuk e pranoni atëherë?**

Shpjegimi i ajeteve

- **"Janë ata të majtit: e kush janë ata të majtit se?!"** - Këtu bëhet fjalë për banorët e Zjarrit, që kanë bërë vepra të këqija. Allahu i Madhëruar tregon për ndëshkimin e merituesheëm të tyre:

- **"Ata janë në afshin përvëlues të zjarrit dhe në ujë të valë..."** - Afshi i nxehtë (*semum*), që vjen nga nxehtësia e madhe e zjarrit të Xhehenemit, ua merr frymën dhe i torturon. Ndërsa kur pinë ujin e nxehtë (*hamîm*), ai ua copëton zorrët dhe barkun.

- **"...nën një hije tymi, as të freskët e as të këndshme."** – Ky është vetë zjarri i Xhehenemit i përzier me tymin e tij të zi, errësirë mbi errësirë. Hija e tij nuk jep freski,


الجزء السابع والعشرون سورة الواقعة
ثُمَّ إِنَّكُمْ أَيُّهَا ٱلضَّآلُّونَ ٱلْمُكَذِّبُونَ ﴿٥١﴾ لَآكِلُونَ مِن شَجَرٍ مِّن زَقُّومٍ ﴿٥٢﴾
فَمَالِـُٔونَ مِنْهَا ٱلْبُطُونَ ﴿٥٣﴾ فَشَٰرِبُونَ عَلَيْهِ مِنَ ٱلْحَمِيمِ ﴿٥٤﴾ فَشَٰرِبُونَ
شُرْبَ ٱلْهِيمِ ﴿٥٥﴾ هَٰذَا نُزُلُهُمْ يَوْمَ ٱلدِّينِ ﴿٥٦﴾ نَحْنُ خَلَقْنَٰكُمْ فَلَوْلَا
تُصَدِّقُونَ ﴿٥٧﴾ أَفَرَءَيْتُم مَّا تُمْنُونَ ﴿٥٨﴾ ءَأَنتُمْ تَخْلُقُونَهُۥٓ أَمْ نَحْنُ
ٱلْخَٰلِقُونَ ﴿٥٩﴾ نَحْنُ قَدَّرْنَا بَيْنَكُمُ ٱلْمَوْتَ وَمَا نَحْنُ بِمَسْبُوقِينَ ﴿٦٠﴾
عَلَىٰٓ أَن نُّبَدِّلَ أَمْثَٰلَكُمْ وَنُنشِئَكُمْ فِى مَا لَا تَعْلَمُونَ ﴿٦١﴾ وَلَقَدْ
عَلِمْتُمُ ٱلنَّشْأَةَ ٱلْأُولَىٰ فَلَوْلَا تَذَكَّرُونَ ﴿٦٢﴾ أَفَرَءَيْتُم مَّا تَحْرُثُونَ
﴿٦٣﴾ ءَأَنتُمْ تَزْرَعُونَهُۥٓ أَمْ نَحْنُ ٱلزَّٰرِعُونَ ﴿٦٤﴾ لَوْ نَشَآءُ لَجَعَلْنَٰهُ
حُطَٰمًا فَظَلْتُمْ تَفَكَّهُونَ ﴿٦٥﴾ إِنَّا لَمُغْرَمُونَ ﴿٦٦﴾ بَلْ نَحْنُ
مَحْرُومُونَ ﴿٦٧﴾ أَفَرَءَيْتُمُ ٱلْمَآءَ ٱلَّذِى تَشْرَبُونَ ﴿٦٨﴾ ءَأَنتُمْ أَنزَلْتُمُوهُ
مِنَ ٱلْمُزْنِ أَمْ نَحْنُ ٱلْمُنزِلُونَ ﴿٦٩﴾ لَوْ نَشَآءُ جَعَلْنَٰهُ أُجَاجًا فَلَوْلَا
تَشْكُرُونَ ﴿٧٠﴾ أَفَرَءَيْتُمُ ٱلنَّارَ ٱلَّتِى تُورُونَ ﴿٧١﴾ ءَأَنتُمْ أَنشَأْتُمْ
شَجَرَتَهَآ أَمْ نَحْنُ ٱلْمُنشِـُٔونَ ﴿٧٢﴾ نَحْنُ جَعَلْنَٰهَا تَذْكِرَةً وَمَتَٰعًا
لِّلْمُقْوِينَ ﴿٧٣﴾ فَسَبِّحْ بِٱسْمِ رَبِّكَ ٱلْعَظِيمِ ﴿٧٤﴾ ۞ فَلَآ أُقْسِمُ
بِمَوَٰقِعِ ٱلنُّجُومِ ﴿٧٥﴾ وَإِنَّهُۥ لَقَسَمٌ لَّوْ تَعْلَمُونَ عَظِيمٌ ﴿٧٦﴾
الجزء ٥٤
٥٣٦

nuk jep qetësi e nuk është privilegj. Ajo ekziston vetëm për ndëshkim, dëshpërim, frikë e ligësi.

Pastaj i Madhëruari përshkruan veprat e tyre, të cilat ishin shkaku i këtij ndëshkimi:

- **"Më përpara, ata kanë qenë të dhënë pas luksit..." -** Dynjaja dhe stolitë e saj i bënë të harrohen dhe të angazhohen tërësisht me të. Ata punuan veç për të, duke u kënaqur e argëtuar, të përhumbur në mirësitë e saj. Ata projektuan ëndrra veç në lidhje me dynjanë e tyre, duke e harruar ahiretin dhe nënvlerësuar veprat e mira, me të cilat arrihet lumturia e përjetshme. Dëfrimet që të bëjnë të harrosh ahiretin dhe të braktisësh veprat e mira, janë të ndaluara dhe të dënueshme nga Zoti.

- **"...dhe vazhdimisht kryenin gjynahe të mëdha."** - Ata ishin fundosur në gjynahe të mëdha dhe nuk pendoheshin asnjëherë për to. Ata vazhdonin pandërprerë në fjalë e vepra që zemëronin Krijuesin, i Cili përkujdesej për ta. Kështu vijuan, deri në momentin kur dolën para Tij, me peshën e rëndë të gjynaheve të tyre, për të cilat nuk kërkuan falje atëherë kur kjo do t'u bënte dobi. Ata, madje, e mohonin ringjalljen dhe vërtetësinë e saj, prandaj thoshin:

- **"Vallë, pasi të vdesim, të bëhemi dhé e eshtra, vërtet do të ringjallemi?! Vallë, edhe etërit tanë të hershëm?"** - Me habi e mosbesim pyesnin: Si do të mund të ringjallemi pasi të jemi tretur e bërë një me dheun, ose pasi të kemi mbetur një grumbull kockash? Sipas tyre, kjo qe diçka e pamundur. Duke u dhënë përgjigje pyetjes së tyre dhe duke i kërcënuar, Allahu i Madhëruar thotë:

- **"Thuaju: "Të jeni të sigurt se, edhe të parët edhe të fundmit, keni për t'u tubuar në një ditë të caktuar!"" -** Të parët dhe të fundit, të gjithë pa përjashtim, ka për t'i ringjallur i Plotfuqishmi, Allahu i Madhëruar, i Cili do t'i tubojë në Ditën e Caktuar. Zoti e përcaktoi atë ditë për të ringjallur për të marrë në llogari krijesat, dhe pastaj për t'i shpërblyer sipas veprave që kanë bërë në dynja.

- **"Atëherë, ju, o të humbur e jobesimtarë..." -** O ju të humbur nga rruga e drejtë dhe ndjekës të rrugës së keqe, ju që nuk besoni profetët e Zotit dhe shpalljet e Tij, o ju mospërfillës të premtimeve dhe kërcënimeve të Tij!

- **"...keni për të ngrënë prej pemës Zekum!" –** Ju keni për të ngrënë nga Zekumi, e cila

është pema më e pështirë dhe më e shëmtuar, me erën më të keqe dhe me pamjen më të tmerrshme.

- "Prej saj keni për ta mbushur barkun!" - Ajo që i bën të hanë si të babëzitur prej kësaj peme, me gjithë pamjen dhe cilësitë e saj të neveritshme, është uria e tejskajshme e tyre, që ua copëton barkun dhe i bën të vuajnë tmerrësisht. Por ky ushqim, të cilin ata e hanë për të larguar urinë, - sikurse e përshkruan i Madhëruari, - nuk ta heq aspak urinë. Edhe pija e tyre është gjëja më e shpifur:

- "E menjëherë pas saj do të pini prej ujit të vluar..." - Pas atij ushqimi të pështirë, ata do të pinë ujë të nxehtë, që ua këput zorrët dhe barkun e tyre. Ata do të pinë, sikurse thotë Allahu:

- "...do të pini si deveja e etshme!" - Domethënë, me etje të madhe, ashtu si një deve e etur në kulm. Madje, '*el him*' quhet edhe një sëmundje që i zë devetë, që i bën ato të pinë e të pinë dhe të mos ndiejnë ngopje.

- "Kjo është "gostia" e tyre në Ditën e Gjykimit." – Me këtë ushqim e pije do të jetë 'pritja' e tyre në Ditën e Llogarisë. Kjo është mikpritja, që vetë ata e përgatitën për veten e tyre. Kësaj gostie i dhanë përparësi, duke privuar veten nga mikpritja e mrekullueshme që Allahu i Lartësuar ka përgatitur për të zgjedhurit e Tij: "S'ka dyshim se ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira kanë si vendpritje xhenetet e Firdeusit. Aty do të jenë përgjithmonë e kurrë nuk do të kërkojnë të largohen prej andej." [Kehf 107, 108].

Pastai i Lartësuari sjell një argument logjik për vërtetësinë e ringjalljes:

- "Ne ju kemi krijuar ju, përse nuk e pranoni atëherë?" – Kuptimi: Allahu që ju krijoi atëherë kur ju nuk ekzistonit as si emër, madje ju krijoi pa u lodhur aspak dhe pa ndier vështirësi, pra, Ai që është i plotfuqishëm për krijimin e gjithçkaje, a nuk është i plotfuqishëm për të ringjallur të vdekurit?! Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka, prandaj edhe ju qorton e paralajmëron për mosbesimin tuaj për ringjalljen. Ju jeni vetë provë e krijimit që ka bërë Allahu, i cili është më i madh se ringjallja juaj.

Ajetet 58 – 62

58. A më tregoni për farën, që e derdhni?
59. Vallë, ju e krijoni atë, apo jemi Ne që e krijojmë?
60. Ne e kemi përcaktuar vdekjen ndër ju dhe Ne askush nuk mund të na pengojë
61. që t'ju zëvendësojmë me të tjerë si ju dhe t'ju krijojmë rishtazi, siç ju nuk dini.
62. Ju e dini mirë krijimin e parë, atëherë përse nuk mendoni?

Shpjegimi i ajeteve

- "A më tregoni për farën, që e derdhni? Vallë, ju e krijoni atë, apo jemi Ne që e krijojmë? Ne e kemi përcaktuar vdekjen ndër ju dhe Ne askush nuk mund të na pengojë që t'ju zëvendësojmë me të tjerë si ju dhe t'ju krijojmë rishtazi, siç ju nuk dini." - A e keni menduar fillimin e krijimit tuaj nga një lëng, që e derdhni? Vallë, ju jeni krijuesit e tij dhe të fetusit që zhvillohet prej tij, apo Ne?! Është Allahu i Madhëruar Ai që krijoi tek ju epshin dhe gjithçka që çon në kënaqësinë seksuale. Është Allahu i

Madhëruar Ai që e bëri çiftin për njëri-tjetrin, me dashuri e dhembshuri të ndërsjelltë. Në këtë mënyrë vazhdon dhe ruhet gjinia njerëzore.

Duke na bërë të meditojmë rreth krijimit të parë, Allahu i Madhëruar na mëson që, nëpërmjet tij, të argumentojmë vërtetësinë e ringjalljes:

- "Ju e dini mirë krijimin e parë, atëherë përse nuk mendoni?" - A nuk e kujtoni faktin se i plotfuqishmi për t'ju krijuar në fillim është i plotfuqishëm për t'ju rikthyer në jetë?

Ajetet 63 – 67

63. A nuk e shihni atë që e mbillni?
64. Vallë, ju e bëni atë të mbijë, apo Ne e bëjmë të mbijë?
65. Sikur Ne të dëshironim, do ta bënim atë të thahej, e ju do të mbeteshit gjithmonë të habitur (duke thënë):
66. "Ne u dëmtuam,
67. madje, mbetëm krejtësisht të privuar".

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk e shihni atë që e mbillni?" - Allahu i Madhëruar u përkujton robërve të Tij mirësitë e mëdha që u ka dhuruar, për t'i ftuar në teuhidin e pastër, në përkushtimin vetëm ndaj Tij dhe në pendimin tek Ai të nënshtruar. Ai i mësoi të mbjellin e kultivojnë bimët dhe pemët, që u nevojiten për jetën e tyre. Prej tyre ka aq shumë mirësi, sa ne nuk mund t'i numërojnë e aq më pak të tregojmë mirënjohjen ndaj Allahut, ashtu si Ai e meriton.

- "Vallë, ju e bëni atë të mbijë, apo Ne e bëjmë të mbijë?" – Vallë, jeni ju që i nxirrni si bimë nga toka, apo jeni ju që i rrisni ato? Ju e nxirrni sythin nga bima, i cili pastaj bëhet frut i pjekur dhe i shijshëm? Apo është Allahu i Madhëruar, i vetmi që i ka krijuar dhe përkujdeset për to? E shumta që ju mund të veproni është ta punoni tokën, të hidhni farën, ta ujisni e ndonjë shërbim tjetër. Pastaj ju nuk e dini se ç'do të ndodhë me të. Nuk është në dorën tuaj zhvillimi i saj. Bima është e shfaqur ndaj shumë rreziqeve, sikur të mos ishte kujdesi i Allahut që ajo të bëhej e dobishme për ju.

- "Sikur Ne të dëshironim, do ta bënim atë të thahej, e ju do të mbeteshit gjithmonë të habitur (duke thënë): "Ne u dëmtuam, madje, mbetëm krejtësisht të privuar". - Sikur të dëshironte Allahu i Madhëruar, do ta bënte bimën dhe frutat e saj, që ju i prisni me aq dëshirë dhe shpresë, të shtypur, të padobishme dhe joushqyese. Atëherë, pas gjithë atyre shpenzimeve të shumta, ju do të dëshpëroheshit shumë për dështimin tuaj. Ju do të thoshit: "Na goditi befasisht fatkeqësia dhe na dëshpëroi, me dëmet që na shkaktoi. Madje, ne jemi të privuar nga të mirat". Atëherë, jini mirënjohës ndaj Allahut, që i bën ato të mbijnë, i zhvillon dhe i lë të piqen dhe nuk i shkatërron, që ju të mbeteni të privuar nga dobitë e tyre!

Ajeti 68 – 70

68. A e shihni ujin, që pini?
69. Vallë, ju e lëshoni atë prej reve, apo jemi Ne që e lëshojmë?
70. Nëse dëshirojmë, Ne e bëjmë atë të kripur. A nuk falënderoni?!

Shpjegimi i ajeteve

Pas mirësisë së ushqimit, Allahu i Madhëruar kujton mirësinë e ujit të pijshëm.

Nëse nuk do të ishte bujaria e Allahut, që na i mundëson këtë mirësi të madhe, ne nuk do të kishim asnjë mundësi për ta arritur atë. Eshtë i Gjithëmëshirshmi që e zbret ujin prej reve, duke mbushur rrëke e lumenj mbi tokë e nën tokë. Po të dëshironte Ai, mund ta bënte ujin të kripur apo të hidhur, domethënë jo të pijshëm. Përse, atëherë, nuk e falënderoni Allahun për këtë mirësi të mrekullueshme?

Ajetet 71 – 74

71. A e keni parë zjarrin, që ju e ndizni?
72. Vallë, ju e krijuat drurin e tij, apo Ne jemi Krijues?
73. Ne e bëmë atë si përkujtim dhe të dobishëm për ata që kanë nevojë.
74. Atëherë, lartësoje emrin e Zoti tënd të Madh!

Shpjegimi i ajeteve

- **"A e keni parë zjarrin, që ju e ndizni? Vallë, ju e krijuat drurin e tij, apo Ne jemi Krijues?" -** Edhe zjarri është një mirësi e domosdoshme, pa të cilin njerëzit nuk mund të bëjnë dot. I Madhëruari i bën njerëzit që të mendojnë rreth zjarrit, që krijohet nga druri. Është Allahu Ai që i ka krijuar pemët, duke i bërë që prej tyre të ndizet zjarri. Njerëzit ndezin zjarr dhe e përdorin sipas nevojave të tyre. Kur mbarojnë punë, ata mund ta shuajnë atë përsëri.

- **"Ne e bëmë atë si përkujtim..."** - Allahu i Madhëruar e bëri zjarrin si përkujtim për mirësitë e Tij dhe për zjarrin e Xhehenemit, që i Madhëruari e ka përgatitur për gjynahqarët. Përkujtimi i Xhehenemit bëhet shkak që ata të binden dhe të nënshtrohen, e pastaj të hyjnë në vendin e mirësive të përjetshme, në Xhenetin e Zotit.

- **"...dhe të dobishëm për ata që kanë nevojë."** - Fjala "muk'uin" e përdorur në ajet ka kuptimin "ata që kanë nevojë" por vjen edhe me kuptimin "udhëtarët". Zjarri u shërben atyre që kanë nevojë për të, si udhëtarët etj. Allahu i Madhëruar i ka veçuar udhëtarët, sepse dobia e zjarrit për ata është më e madhe se për të tjerët. Megjithatë, udhëtarët mbase përmenden sepse vetë jeta e dynjasë është udhëtim. Robi, që kur lind, nis udhëtimin drejt Zotit të tij. Kësisoj, Allahu e ka bërë zjarrin dobiprurës për udhëtarët në mënyrë të veçantë dhe si përkujtim për botën tjetër.

Pasi u përkujton shumë mirësi të Tij, i Madhëruari i fton që të jenë mirënjohës duke i thurur lavde Atij:

- **"Atëherë, lartësoje emrin e Zoti tënd të Madh!"** - Thuri lavde Zotit tënd, duke e lartësuar nga çdo e metë e mangësi që të paditurit trillojnë rreth Tij. Ai është i Plotë në emrat e cilësitë e Tij, Bujar në mirësitë që dhuron. Lavdëroje Allahun me zemrën, gjuhën dhe trupin tënd, sepse Ai e meriton plotësisht këtë. Ai e meriton të falënderohet, t'i tregosh mirënjohje dhe kurrë të mos mohohet e të mos ia thyesh urdhrin.

Ajetet 75 – 87

75. Betohem në momentin e perëndimit të yjeve,
76. ky është një betim i madh, sikur ta dinit,
77. se, me të vërtetë, ai është Kurani bujar,
78. në Librin e Ruajtur.
79. Atë nuk e prek kush, përveç të pastërve.
80. Ai është shpallje prej Zotit të botëve.
81. Vallë, ndaj kësaj Fjale jeni mosbesues
82. dhe si "falënderim" për furnizimin tuaj, ju e mohoni?

83. **Kur shpirti arrin në fyt,**
84. **e ju në atë moment shikoni,**
85. **Ne jemi më afër tij sesa ju, por ju nuk e shihni.**
86. **Përse atëherë, nëse nuk besoni se do të gjykoheni,**
87. **nuk e ktheni atë mbrapsht?**


Shpjegimi i ajeteve

- "Betohem në momentin e perëndimit të yjeve..." - Allahu i Madhëruar betohet për yjet, për kohën kur ato largohen, si dhe për dukuritë që ndodhin gjatë kësaj kohe. Të gjitha këto dëshmojnë për madhështinë e Tij, për krenarinë e Tij dhe për faktin se Allahu është i vetëm në meritën e adhurimit. Më pas, për t'i dhënë rëndësi më shumë këtij betimi, thotë:

- "...ky është një betim i madh, sikur ta dinit..." - Ky është një betim i madh, sepse yjet, lëvizja e tyre dhe perëndimi i tyre janë shenja të mëdha, nga të cilat përfitohet shumë. Po përse betohet Allahu i Madhëruar?

- "...se, me të vërtetë, ai është Kurani bujar..." - Ai betohet për të përforcuar vërtetësinë e Kuranit, për të cilin nuk duhet të ketë asnjë dyshim. Kurani përshkruhet nga Allahu si 'kerim' - "bujar", domethënë, plot mirësi e dituri. Çdo mirësi dhe çdo dituri e dobishme përfitohet nga Libri i Allahut.

- "...në Librin e Ruajtur." - Kurani ndodhet në një libër, që i Madhëruari e përshkruan si '*meknun*' - të ruajtur, të fshehur nga sytë e krijesave. Ky libër, në të cilin është shkruar Kurani, është *Leuhi Mahfudh*, një libër i madh dhe shumë i nderuar tek Allahu i


الجزء السابع والعشرون سورة الواقعة
إِنَّهُۥ لَقُرْءَانٌ كَرِيمٌ ﴿٧٧﴾ فِى كِتَٰبٍ مَّكْنُونٍ ﴿٧٨﴾ لَّا يَمَسُّهُۥٓ إِلَّا
ٱلْمُطَهَّرُونَ ﴿٧٩﴾ تَنزِيلٌ مِّن رَّبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٨٠﴾ أَفَبِهَٰذَا ٱلْحَدِيثِ
أَنتُم مُّدْهِنُونَ ﴿٨١﴾ وَتَجْعَلُونَ رِزْقَكُمْ أَنَّكُمْ تُكَذِّبُونَ ﴿٨٢﴾ فَلَوْلَآ
إِذَا بَلَغَتِ ٱلْحُلْقُومَ ﴿٨٣﴾ وَأَنتُمْ حِينَئِذٍ تَنظُرُونَ ﴿٨٤﴾ وَنَحْنُ أَقْرَبُ
إِلَيْهِ مِنكُمْ وَلَٰكِن لَّا تُبْصِرُونَ ﴿٨٥﴾ فَلَوْلَآ إِن كُنتُمْ غَيْرَ مَدِينِينَ
﴿٨٦﴾ تَرْجِعُونَهَآ إِن كُنتُمْ صَٰدِقِينَ ﴿٨٧﴾ فَأَمَّآ إِن كَانَ مِنَ ٱلْمُقَرَّبِينَ
﴿٨٨﴾ فَرَوْحٌ وَرَيْحَانٌ وَجَنَّتُ نَعِيمٍ ﴿٨٩﴾ وَأَمَّآ إِن كَانَ مِنْ أَصْحَٰبِ
ٱلْيَمِينِ ﴿٩٠﴾ فَسَلَٰمٌ لَّكَ مِنْ أَصْحَٰبِ ٱلْيَمِينِ ﴿٩١﴾ وَأَمَّآ إِن كَانَ مِنَ
ٱلْمُكَذِّبِينَ ٱلضَّآلِّينَ ﴿٩٢﴾ فَنُزُلٌ مِّنْ حَمِيمٍ ﴿٩٣﴾ وَتَصْلِيَةُ جَحِيمٍ
﴿٩٤﴾ إِنَّ هَٰذَا لَهُوَ حَقُّ ٱلْيَقِينِ ﴿٩٥﴾ فَسَبِّحْ بِٱسْمِ رَبِّكَ ٱلْعَظِيمِ ﴿٩٦﴾
سورة الحديد
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿١﴾ لَهُۥ مُلْكُ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ يُحْىِۦ وَيُمِيتُ ۖ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ قَدِيرٌ ﴿٢﴾ هُوَ
ٱلْأَوَّلُ وَٱلْءَاخِرُ وَٱلظَّٰهِرُ وَٱلْبَاطِنُ ۖ وَهُوَ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿٣﴾
٥٣٧

Madhëruar dhe tek melekët më të mëdhenj të qiellit.

Por ka mundësi që 'Libri i Ruajtur' të jetë libri në duart e melekëve që zbresin Shpalljen e Zotit, libër i cili është i ruajtur nga duart dhe ndikimi i shejtanëve. Ata nuk mund ta ndryshojnë atë, as duke shtuar, as duke pakësuar dhe as duke tjetërsuar gjë prej tij.

- "Atë nuk e prek kush, përveç të pastërve." – Kuranin që gjendet në Leuhi Mahfudh mund ta prekin veçse melekët e nderuar, që Zoti i ka bërë të pastër nga mangësitë dhe gjynahet. Gjithashtu, duke qenë se Kuranin e prekin veçse melekët e nderuar dhe të pastër, ndërsa shejtanët e mallkuar nuk munden as t'i afrohen atij, ajeti nënkupton se Kurani nuk lejohet të preket nga as

njerëzit e papastër, sikurse është dëshmuar edhe nga hadithe të Profetit (a.s.). Për këtë arsye, disa studiues mendojnë se ky ajet është një fjali dëftore, por që ka kuptim urdhëror-ndalues. Kështu, kuptimi i tij është: "Kuranin të mos e prekë tjetërkush, veç të pastërve!"

- "Ai është shpallje prej Zotit të botëve." - Kurani i përshkruar me të tilla cilësi të mrekullueshme, është Shpallje e Allahut të Madhërueshëm, që është Zoti i botëve. Kurani është libri i Atij që përkujdeset për dynjanë dhe ahiretin e robërve të Tij. Madje, një ndër mirësitë më të mëdha, me të cilat Allahu ka treguar kujdesin për robërit e Tij besimtarë, është shpallja e Kuranit, librit që ka përmbledhur çdo gjë të dobishme për dynjanë dhe ahiretin e krijesave. Nëpërmjet Kuranit, Allahu i Madhëruar i mëshiroi aq shumë robërit e Tij, saqë ata nuk mund t'ia japin kurrë mirënjohjen dhe falënderimin që meriton. Mirënjohja ndaj Tij kërkon që ata ta zbatojnë sa më shumë Kuranin, të jetojnë sipas tij, ta shpërndajnë mesazhin e tij tek të tjerët dhe të mbrojnë të vërtetën që ai kumton.

- "Vallë, ndaj kësaj Fjale jeni mosbesues..." - Ky është libër madhështor, përkujtim nga Zoti, ndërsa ju frikësoheni prej krijesave dhe prej shpotive të tyre?! Ky nuk është qëndrim i drejtë. Kurani nuk është libër për të cilin duhet të ruhesh nga opinioni i njerëzve. Kështu mund të trajtohet ndonjë libër për të cilin ka pasiguri rreth vërtetësisë së tij, por jo Kurani. Kurani famëlartë është e Vërteta. Kushdo që e lufton atë, ka për t'u mundur dhe dështuar, kushdo që përpiqet ta mposhtë, ka për t'u poshtëruar. Ai është libër që nuk pranon të lihet në hije dhe të harrohet, por ai duhet të zbatohet, të respektohet dhe të përhapet.

- "...dhe si "falënderim" për furnizimin tuaj, ju e mohoni?" - Në këmbim të mirësive të panumërta të Allahut, ju mohoni të vërtetën, duke u treguar mosmirënjohës ndaj bujarisë së Tij. Ju thoni: "Na ra shiu për shkak të filan ylli ose për shkak të kësaj apo asaj gjëje...", duke ia njohur mirësitë jo Allahut, që i dhuroi me bujarinë e Tij të pakufishme. A nuk është më mirë për ju që të falënderoni Allahun e Madhëruar për këto mirësi, që Ai t'jua shtojë edhe më tepër ato?! Mos harroni se mosmirënjohja ndaj Zotit sjell largimin e mirësive të Tij dhe mbulimin nga fatkeqësitë.

- "Kur shpirti arrin në fyt, e ju në atë moment shikoni, Ne jemi më afër tij sesa ju, por ju nuk e shihni." - Kur njeriut në prag të vdekjes i arrin shpirti në gropën e fytit dhe ju e vështroni me keqardhje në atë gjendje, Ne – thotë Allahu – jemi më pranë atij me diturinë Tonë dhe me melekët Tanë, por ju nuk arrini ta shihni këtë realitet.

- "Përse atëherë, nëse nuk besoni se do të gjykoheni, nuk e ktheni atë mbrapsht?" - Nëse mendoni se kurrë nuk do të ringjalleni të llogariteni dhe të shpërbleheni për veprat tuaja, atëherë kthejeni shpirtin e tij dhe shpëtojeni vdekja! Por ju jeni të bindur që nuk mund ta arrini një gjë të tillë. Atëherë, ose nënshtrohuni dhe besojeni ringjalljen, ose mësojeni se si do të jetë përfundimi juaj i dhimbshëm.

Ajetet 88 – 96

88. E nëse ai është prej të zgjedhurve,
89. atëherë do të ketë kënaqësi, ***rejhan*** **dhe Xhenetin e mirësive.**

90. Në qoftë se është nga të djathtët (i thuhet):
91. "Selam të qoftë ty prej të djathtëve!"
92. E në qoftë se është prej gënjeshtarëve të humbur,
93. mirëseardhja e tyre është "gosti" me ujë të valë
94. dhe djegie nga zjarri i Xhehenemit.
95. Nuk ka dyshim se kjo është e vërteta e sigurt.
96. Lartësoje Zotin tënd të Madhëruar!

Shpjegimi i ajeteve

Në fillim të sures, Allahu i Madhëruar përshkroi se si do të jenë tri grupet në ahiret: të zgjedhurit, të djathtët dhe mohuesit. Tashmë përshkruhet se si është fundi i jetës së tyre në dynja, e pikërisht në momentin e vdekjes:

- **"E nëse ai është prej të zgjedhurve, atëherë do të ketë kënaqësi, *rejhan* dhe Xhenetin e mirësive."** - Nëse i vdekuri është prej të zgjedhurve (*mukarabin*), ai do të ketë një pritje të mrekullueshme. Të zgjedhurit janë ata që i kanë plotësuar të gjitha detyrimet fetare e veprat e pëlqyeshme dhe u janë larguar harameve e veprave të papëlqyeshme. Gjithashtu, ata nuk e kanë tepruar me të lejuarat, duke u treguar të përmbajtur me to. Si rezultat, Allahu i Madhëruar tregon se ata do të priten me mirësi të mrekullueshme. Ata do të kenë kënaqësi të zemrës dhe të shpirtit, si lumturi, qetësi e prehje. Gjithashtu, do të kenë edhe "*rejhan*", domethënë çdo lloj kënaqësie fizike, qoftë ajo prej ushqimeve, pijeve etj. Disa kanë thënë se fjala '*rejhan*' në ajet tregon bimën e njohur aromatike të borzilokut. Me këtë kuptim, një mirësi tjetër që do të kenë në Xhenet të përzgjedhurit, do të jetë aroma e mirë.

Për ata është përgatitur edhe Xheneti i mirësive, ku do të shijojnë të gjitha mirësitë trupore dhe shpirtërore. Në të do të gjejnë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe zemra e robit kurrë nuk e ka imagjinuar.

Për përgëzimin e kësaj kategorie njerëzish në momentet e agonisë së vdekjes, i Madhëruari thotë: "S'ka dyshim se atyre që thonë: "Allahu është Zoti ynë", dhe pastaj tregohen të palëkundur në këtë, do t'u zbresin engjëjt *(e do t'u thonë)*: "Mos u frikësoni, mos u pikëlloni, por gëzohuni me Xhenetin, që ju është premtuar! Ne jemi miqtë tuaj, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër. Atje ju do të keni atë që dëshironi dhe gjithçka që kërkoni. Kjo është pritje e nderuar prej Falësit e Mëshirëplotit!"" [Fussilet 30 – 32]. Ose: "Nuk ka dyshim se të dashurit e Allahut nuk kanë frikë dhe as brengosje. Ata kanë besuar dhe janë ruajtur. Atyre u jepet përgëzimi në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër, dhe premtimi i Allahut nuk mund të ndryshohet. Ky, pra, është suksesi i madh!" Është shpjeguar se ky përgëzim u jepet atyre që në jetën e dynjasë, para ahiretit.

- **"Në qoftë se është nga të djathtët..."** – Të djathtët janë ata që i kanë kryer detyrimet fetare dhe u janë larguar harameve, por ndoshta kanë thyer ndonjë prej detyrimeve, pa e cenuar teuhidin dhe imanin e tyre. Këtyre u thuhet:

- "Selam të qoftë ty prej të djathtëve!" - Ke selam nga vëllezërit besimtarë prej të djathtëve.

Miqtë do ta përshëndesin me selam dhe do t'i urojnë mirëseardhjen. Atyre do t'u thuhet: "Paqja ju shoqëroftë gjithmonë! Tashmë do të jeni në paqe e siguri të plotë nga mangësitë, sprovat dhe fatkeqësitë, nga ndëshkimi e vuajtjet, sepse ju jeni prej të djathtëve, të cilët do ta marrin librin e veprave të tyre nga e djathta. Ju jeni të tillë, sepse u ruajtët nga gjynahet e mëdha shkatërruese (*el mubikat*).

- "E në qoftë se është prej gënjeshtarëve të humbur..." – Domethënë, nëse është prej atyre që kanë mohuar të vërtetën, madje e kanë konsideruar atë si mashtrim.

- "...mirëseardhja e tyre është "gosti" me ujë të valë dhe djegie nga zjarri i Xhehenemit." - Mikpritja për ta do të jetë hedhja në Xhehenem, në zjarrin e ndezur fort, i cili do t'i përfshijë tërësisht, me një nxehtësi që do t'u arrijë deri në zemër. Nëse kërkojnë lehtësim për etjen e madhe, i Lartësuari thotë: "Nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran, që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai!". [Kehf 29].

- "Nuk ka dyshim se kjo është e vërteta e sigurt." - Ky shpërblim i robërve sipas veprave të tyre, me të mirë apo me të keq, është e vërteta e sigurt, tek e cila nuk ka dyshime e pasiguri.

Allahu i Madhëruar u tregoi robërve argumente të prera për vërtetësinë e kësaj dite, aq sa të urtët dhe të mençurit e përjetojnë atë sikur ta dëshmonin që në këtë botë, kur lexojnë për të. Ata e lavdërojnë Allahun e Madhëruar për këtë mirësi të madhe që u dhuroi, domethënë për sigurinë e besimit në të fshehtën e në jetën tjetër, prandaj i Madhëruari thotë:

- "Lartësoje Zotin tënd të Madhëruar!" - I pastër nga çdo e metë e i lavdëruar qoftë Zoti ynë i Madhërishëm! I lartësuar dhe larg çdo mangësie është Ai nga ajo që trillojnë e shpifin për Të zullumqarët! Lavdia e plotë i takon vetëm Allahut!

Surja 57: El Hadid (medinase) 29 ajete

Ajetet 1 – 6

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Allahun e lartëson me adhurim çdo gjë që është në qiej e në Tokë; Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti.
2. Atij i takon pushteti në qiej e në Tokë, Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje dhe Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.
3. Ai është i Pari dhe i Fundit, i Larti, i Afërti dhe Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.
4. Është Ai që i krijoi qiejt dhe Tokën vetëm për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron. Ai di gjithçka që futet në tokë dhe gjithçka që del prej saj, çka zbret prej qiellit dhe çka ngrihet në të. Ai është me ju kudo që të jeni. Allahu është vështrues i gjithçkaje që ju punoni.
5. Vetëm Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe vetëm tek Allahu kthehen të gjitha çështjet.
6. Ai e ndërfut natën në ditë dhe e ndërfut ditën në natë; Ai di për të fshehtat që mban kraharori.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahun e lartëson me adhurim çdo gjë që është në qiej e në Tokë..." - Allahu i Lartësuar na tregon rreth madhështisë, lartësisë dhe gjerësisë së pushtetit të Tij. Ai na tregon se çdo gjë në botën qiellore e tokësore, qofshin gjallesa që flasin ose që nuk flasin, qofshin sende e krijesa të gjalla, të gjitha pa përjashtim i bëjnë *tesbih*, duke e lavdëruar dhe duke e lartësuar Atë nga çdo mangësi që nuk i shkon Madhërisë së Tij. Gjithçka është e nënshtruar ndaj Zotit, e përunjur para krenarisë së Tij. Në këtë krijim shfaqet qartë urtësia dhe krenaria e Allahut të Madhëruar. Në këtë ajet del qartë, gjithashtu, nevoja e madhe e të gjitha krijesave, të botës qiellore e asaj tokësore, për Zotin e tyre.

- "Ai është i Gjithëfuqishmi, i Urti." - Allahu na tregon për krenarinë e Tij madhështore dhe për faktin se Ai ka nënshtruar gjithçka nën sundimin e Tij. Ai tregon gjithashtu për urtësinë e Tij të madhe, qoftë në krijimin e Tij, qoftë në ligjet që ka vendosur mes tyre.

- "Atij i takon pushteti në qiej e në Tokë, Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje dhe Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka." - Allahu është Krijuesi dhe Furnizuesi i të gjitha krijesave. Ai përkujdeset dhe rregullon çështjet e tyre, me pushtetin e fuqinë e Tij. Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka dhe asgjë nuk del jashtë sundimit të Tij.

- "Ai është i Pari dhe i Fundit, i Larti, i Afërti..." - Allahu është i Pari, para të Cilit nuk ka gjë, dhe i Fundit, pas të Cilit nuk ka gjë. Allahu është i Larti, sipër të Cilit nuk ka gjë, dhe i Afërti, më pranë se i Cili nuk ka gjë.

- "...dhe Ai është i Gjithëdijshëm për çdo gjë." - Dituria e Allahut ka përfshirë të dukshmet dhe padukshmet, të hapurat dhe të mbuluarat, të shkuarat dhe të ardhmet.

- "Është Ai që i krijoi qiejt dhe Tokën vetëm për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron." - Dita e parë e krijimit ishte dita e dielë dhe përfundimi i krijimit ishte në ditën e xhuma. Pastaj i Lartësuari u ngrit mbi Fronin e Tij, ashtu si i shkon madhështisë së Tij, sipër të gjitha krijesave.

- "Ai di gjithçka që futet në tokë dhe gjithçka që del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngrihet në të." - Allahu e di për ato që hyjnë në tokë, si farërat, shiu etj. Ai e di edhe për ato që dalin nga toka, si bimët, pemët, kafshët etj. Ai di gjithçka që zbret nga qielli, si melekët, kaderi, rizku i Tij etj. Ai i di edhe ata që ngjiten në qiell, si melekët, shpirtrat, lutjet, veprat e robërve etj.

- "Ai është me ju kudo që të jeni." - Kjo i përngjan ajetit tjetër: "Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; e as mes pesë vetave, që Ai të mos jetë i gjashti, e as mes më pak dhe as mes më shumë vetave, që Ai të mos jetë me ta, kudo që të jenë." [Muxhadele]. Kjo është afërsi me diturinë dhe mbikëqyrjen e Tij. Prandaj edhe më pas, Allahu kërcënon dhe përgëzon robërit e Tij se do t'i shpërblejë sipas veprave të kryera, të cilat Ai i di dhe i ka mbikëqyrur imtësisht:

- "Allahu është vështrues i gjithçkaje që ju punoni." - Allahu sheh të gjitha veprat tuaja

dhe do t'ju shpërblejë sipas tyre. Ai i ka ruajtur ato vepra me imtësi dhe korrektësi.


- "Vetëm Atij i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës..." - Allahu është Sunduesi i tyre. Ai është Krijuesi dhe ata janë robërit e Tij, që duhet ta adhurojnë, t'i përkushtohen e nënshtrohen Atij dhe vetëm Atij. Allahu i Madhëruar vepron dhe përkujdeset për ta me ligjet e krijimit dhe të Sheriatit, të ndërtuara mbi urtësinë e Tij.

- "...dhe vetëm tek Allahu kthehen të gjitha çështjet." - Si veprat, ashtu edhe vepruesit e tyre, vetëm tek Allahu e kanë kthimin. Robërit do të paraqiten tek Ai dhe Ai do të ndajë të keqen nga e mira. Ai do ta shpërblejë bamirësin për mirësinë e tij dhe të ligun për ligësinë e tij.

- "Ai e ndërfut natën në ditë dhe e ndërfut ditën në natë..." - Allahu e vendos natën mbi ditën, dhe kështu krijesat i mbulon errësira, që ato të qetësohen e çlodhen. Pastaj e vendos ditën mbi natën, dhe nga toka largohet errësira e gjithçka ndriçon. Atëherë njerëzit fillojnë të lëvizin, për të arritur mirësitë e tyre. Allahu e ndërron natën e ditën duke shkurtuar e zgjatur herë njërën e herë tjetrën, duke krijuar kështu edhe stinët, nëpërmjet të cilave arrihen mirësi të shumta.

I lartësuar dhe plot begati është Allahu i Madhërishëm, Zoti i botëve! I lartësuar qoftë Bujari e Bamirësi, që i begatoi robërit me mirësi të dukshme e të padukshme, të hapura e të fshehura!

- "Ai di për të fshehtat që mban kraharori." - Allahu di për gjithçka që fshihet në kraharor. Ai i jep sukses të përqafojë


الجزء السابع والعشرون سورة الحديد
هُوَ ٱلَّذِى خَلَقَ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضَ فِى سِتَّةِ أَيَّامٍ ثُمَّ ٱسْتَوَىٰ
عَلَى ٱلْعَرْشِ ۖ يَعْلَمُ مَا يَلِجُ فِى ٱلْأَرْضِ وَمَا يَخْرُجُ مِنْهَا وَمَا يَنزِلُ مِنَ
ٱلسَّمَآءِ وَمَا يَعْرُجُ فِيهَا ۖ وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنتُمْ ۚ وَٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ
بَصِيرٌ ﴿٤﴾ لَّهُۥ مُلْكُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَإِلَى ٱللَّهِ تُرْجَعُ ٱلْأُمُورُ
﴿٥﴾ يُولِجُ ٱلَّيْلَ فِى ٱلنَّهَارِ وَيُولِجُ ٱلنَّهَارَ فِى ٱلَّيْلِ ۚ وَهُوَ عَلِيمٌۢ بِذَاتِ
ٱلصُّدُورِ ﴿٦﴾ ءَامِنُوا۟ بِٱللَّهِ وَرَسُولِهِۦ وَأَنفِقُوا۟ مِمَّا جَعَلَكُم
مُّسْتَخْلَفِينَ فِيهِ ۖ فَٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ مِنكُمْ وَأَنفَقُوا۟ لَهُمْ أَجْرٌ كَبِيرٌ ﴿٧﴾
وَمَا لَكُمْ لَا تُؤْمِنُونَ بِٱللَّهِ وَٱلرَّسُولُ يَدْعُوكُمْ لِتُؤْمِنُوا۟ بِرَبِّكُمْ وَقَدْ
أَخَذَ مِيثَٰقَكُمْ إِن كُنتُم مُّؤْمِنِينَ ﴿٨﴾ هُوَ ٱلَّذِى يُنَزِّلُ عَلَىٰ عَبْدِهِۦٓ
ءَايَٰتٍۭ بَيِّنَٰتٍ لِّيُخْرِجَكُم مِّنَ ٱلظُّلُمَٰتِ إِلَى ٱلنُّورِ ۚ وَإِنَّ ٱللَّهَ بِكُمْ
لَرَءُوفٌ رَّحِيمٌ ﴿٩﴾ وَمَا لَكُمْ أَلَّا تُنفِقُوا۟ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ وَلِلَّهِ مِيرَٰثُ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ لَا يَسْتَوِى مِنكُم مَّنْ أَنفَقَ مِن قَبْلِ ٱلْفَتْحِ
وَقَٰتَلَ ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ أَعْظَمُ دَرَجَةً مِّنَ ٱلَّذِينَ أَنفَقُوا۟ مِنۢ بَعْدُ وَقَٰتَلُوا۟ ۚ
وَكُلًّا وَعَدَ ٱللَّهُ ٱلْحُسْنَىٰ ۚ وَٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١٠﴾ مَّن ذَا
ٱلَّذِى يُقْرِضُ ٱللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضَٰعِفَهُۥ لَهُۥ وَلَهُۥٓ أَجْرٌ كَرِيمٌ ﴿١١﴾
٥٣٨

udhëzimin e drejtë atij që e di se e meriton këtë udhëzim. Por nga ana tjetër, Allahu i Madhëruar nuk ia jep udhëzimin e drejtë atij që nuk e meriton atë.

Ajetet 7 – 9

7. Besojini Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai jua ka lënë ta trashëgoni, sepse për ata nga ju që besojnë dhe shpenzojnë për hir të Zotit, ka shpërblim të madh.

8. Ç'është me ju, që nuk i besoni Allahut, kur i Dërguari i Tij ju fton t'i besoni Zotit tuaj, i Cili ka marrë besën nga ju! Mbajeni fjalën, nëse jeni vërtet besimtarë!

9. Ai i shpalli robit të Vet shenja të qarta, për t'ju nxjerrë ju prej errësirave në dritë. Nuk ka dyshim se Allahu është i Butë e i Mëshirshëm me ju.

Shpjegimi i ajeteve

- "Besojini Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe jepni nga ajo që Ai jua ka lënë ta trashëgoni..." - Allahu i Madhëruar i urdhëron robërit e Tij që të besojnë Atë, Profetin e Tij, Shpalljen e Tij, si dhe të shpenzojnë në rrugën e Tij prej pasurisë që po Allahu e vendosi në duart e tyre dhe i bëri kujdestarë të saj, për të parë se si do të veprojnë. Më pas, duke përmendur shpërblimin e madh që i pret, Ai i nxit më tepër, nëse e bëjnë një gjë të tillë:

- "...sepse për ata nga ju që besojnë dhe shpenzojnë për hir të Zotit, ka shpërblim të madh." - Ata që bëjnë këto vepra të mrekullueshme do të kenë shpërblim të madh. Përveç besimit të pastër në Allahun, Profetin dhe në Shpalljen e Tij, ata shpenzojnë pasuri në rrugën e Allahut. Këto vepra do t'u mundësojnë atyre shpërblimin më të madh dhe më të mrekullueshëm. Ata fitojnë kënaqësinë e Zotit dhe nderimin në vendin e mirësisë së përjetshme, në Xhenet. Këto janë mirësitë që Zoti ka përgatitur për besimtarët dhe ata që luftojnë në rrugën e Tij.

- "Ç'është me ju, që nuk i besoni Allahut, kur i Dërguari i Tij ju fton t'i besoni Zotit tuaj, i Cili ka marrë besën nga ju! Mbajeni fjalën, nëse jeni vërtet besimtarë!" - Çfarë ju pengon ju të besoni?! Si mund të mos besoni, ndërkohë që profeti Muhamed, më i miri i profetëve dhe thirrësi më i nderuar në rrugën e drejtë të Zotit, ju fton që të besoni?! Kjo, përkundrazi, duhet t'ju bëjë të nxitoni që t'i përgjigjeni ftesës së tij, që ta përqafoni sa më shpejt të vërtetën që ai ka sjellë prej Zotit. Aq më tepër, kur Allahu i Madhëruar ka marrë besën prej jush se do t'i besoni atij. Atëherë, nëse jeni besimtarë të vërtetë, duhet ta mbani premtimin.

Megjithatë, me butësinë dhe përkujdesin e Tij të madh, Allahu i Madhëruar nuk u mjaftua vetëm me ftesën e sjellë nëpërmjet Profetit më të zgjedhur, por e mbështeti atë edhe me mrekulli të shumta. Allahu i Madhëruar thotë:

- "Ai i shpalli robit të Vet shenja të qarta, për t'ju nxjerrë ju prej errësirave në dritë." - Ai solli shenja të qarta, që i dëshmojnë çdo njeriu me logjikë vërtetësinë e mesazhit të Zotit. Ato shërbejnë që t'ju nxjerrin ju prej errësirave në dritë. Allahu i Madhëruar e dërgoi Profetin e Tij me Shpallje dhe urtësi, që t'ju nxjerrë nga errësirat e injorancës dhe kufrit, në dritën e diturisë dhe të imanit. Kjo është shenjë e butësisë, mëshirës dhe përkujdesit të Allahut për ju.

Allahu është më i mëshirshëm për krijesën e Tij, sesa prindi për fëmijën e tij, sikurse thotë më pas:

- "Nuk ka dyshim se Allahu është i Butë e i Mëshirshëm me ju."

Ajetet 10 – 11

10. Ç'ndodh me ju, që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut, kur dihet se Allahut i mbesin trashëgim qiejt e Toka? Nuk janë të barabartë ndër ju ata që kanë shpenzuar nga pasuria e tyre dhe kanë luftuar para Çlirimit, sepse këta kanë vlerë më të madhe sesa ata që shpenzuan dhe luftuan më pas. Por të gjithëve Allahu u ka premtuar mirësi. Allahu di për gjithçka që ju punoni.

11. Kush është ai që i jep Allahut një hua të mirë, që Ai t'ia shumëfishojë atë dhe të ketë një shpërblim të mirë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Ç'ndodh me ju, që nuk shpenzoni në rrugën e Allahut..."** - Çfarë ju pengon ju që të shpenzoni për hir të Allahut, në të gjitha rrugët e mirësisë? Çfarë ju bën ju që të jeni koprracë, ndërkohë që ju vetë nuk keni asnjë lloj pasurie, por gjithçka i takon Allahut të Madhëruar.

- **"...kur dihet se Allahut i mbesin trashëgim qiejt e Toka?"** - Do të vijë një ditë kur të gjitha llojet e pasurive do të hiqen nga duart tuaja dhe ju të largoheni prej tyre. Gjithçka do të kthehet te Pronari e Sunduesi i vërtetë, tek Allahu i Lartësuar. Prandaj, shfrytëzojini këto pasuri duke i shpenzuar në rrugën e drejtë, sa i keni në përdorim!

Më pas, Allahu i Lartësuar përmend dallimin mes veprave, në varësi të gjendjes kur kryhen dhe të urtësisë hyjnore në vlerësimin e tyre.

- "Nuk janë të barabartë ndër ju ata që kanë shpenzuar nga pasuria e tyre dhe kanë luftuar para Çlirimit, sepse këta kanë vlerë më të madhe sesa ata që shpenzuan dhe luftuan më pas." - Këtu është fjala për çlirimin e Hudejbijes, kur mes Profetit (a.s.) dhe idhujtarëve kurejshë të Mekës u nënshkrua marrëveshja e paqes.

Marrëveshja e Hudejbijes ishte një nga faktorët më të mëdhenj që ndihmoi në përhapjen e Islamit dhe përzierjen e muslimanëve me të tjerët. Gjatë kësaj kohe u mundësua që Islami të predikohej pa pengesë, prandaj edhe njerëzit hynë në fenë e Zotit grupe–grupe, ndërsa Islami u lartësua. Para kësaj marrëveshjeje, muslimanët mund të ushtronin lirisht davetin (propagandën islame) veçse në vendet ku dominonin muslimanët, si në Medinë dhe rrethinat e saj. Ndërsa muslimanët e Mekës ose të viseve të idhujtarëve ishin të frikësuar, prandaj nuk mund të vepronin lirisht.


Për arsyen e mësipërme, ata që pranuan Islamin dhe shpenzuan për hir të Allahut para Çlirimit, ishin në gradë më të lartë dhe meritonin shpërblim më të madh se ata që pranuan Islamin pas Çlirimit. Kjo është në përputhje edhe me urtësinë e Zotit. Po të studiosh situatën, do të shohësh se më të zgjedhurit e sahabëve e pranuan Islamin përpara Çlirimit.

Megjithatë, për të mos i lënë vend ndonjë keqkuptimi në lidhje me shpërblimin, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Por të gjithëve Allahu u ka premtuar mirësi." - Si atyre që shpenzuan dhe luftuan para Çlirimit, ashtu edhe atyre që shpenzuan dhe luftuan pas Çlirimit, Allahu i Madhëruar u ka premtuar Xhenetin. Kjo tregon për vlerën e lartë të të gjithë sahabëve, - Allahu qoftë i kënaqur me ta! - sepse është vetë Allahu që dëshmoi për imanin e tyre të vërtetë dhe që u premtoi Xhenetin.

- "Allahu di për gjithçka që ju punoni." - Secilin prej jush, Allahu i Gjithëdijshëm do ta shpërblejë sipas punës që ka bërë.
Më pas, Allahu i Madhëruar nxit për të shpenzuar në rrugën e Tij, sepse xhihadi mbështetet pikërisht nga këto shpenzime.

- "Kush është ai që i jep Allahut një hua të mirë, që Ai t'ia shumëfishojë atë dhe të ketë një shpërblim të mirë." - Allahu i Madhëruar e ka quajtur shpenzimin e shpërblyeshëm si "hua të mirë", domethënë,


الجزء السابع والعشرون سورة الحديد
يَوْمَ تَرَى ٱلْمُؤْمِنِينَ وَٱلْمُؤْمِنَٰتِ يَسْعَىٰ نُورُهُم بَيْنَ أَيْدِيهِمْ
وَبِأَيْمَٰنِهِم بُشْرَىٰكُمُ ٱلْيَوْمَ جَنَّٰتٌ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ خَٰلِدِينَ
فِيهَا ذَٰلِكَ هُوَ ٱلْفَوْزُ ٱلْعَظِيمُ ﴿١٢﴾ يَوْمَ يَقُولُ ٱلْمُنَٰفِقُونَ وَٱلْمُنَٰفِقَٰتُ
لِلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱنظُرُونَا نَقْتَبِسْ مِن نُّورِكُمْ قِيلَ ٱرْجِعُوا۟ وَرَآءَكُمْ
فَٱلْتَمِسُوا۟ نُورًا فَضُرِبَ بَيْنَهُم بِسُورٍ لَّهُۥ بَابٌۢ بَاطِنُهُۥ فِيهِ ٱلرَّحْمَةُ
وَظَٰهِرُهُۥ مِن قِبَلِهِ ٱلْعَذَابُ ﴿١٣﴾ يُنَادُونَهُمْ أَلَمْ نَكُن مَّعَكُمْ ۖ قَالُوا۟ بَلَىٰ
وَلَٰكِنَّكُمْ فَتَنتُمْ أَنفُسَكُمْ وَتَرَبَّصْتُمْ وَٱرْتَبْتُمْ وَغَرَّتْكُمُ ٱلْأَمَانِىُّ
حَتَّىٰ جَآءَ أَمْرُ ٱللَّهِ وَغَرَّكُم بِٱللَّهِ ٱلْغَرُورُ ﴿١٤﴾ فَٱلْيَوْمَ لَا يُؤْخَذُ مِنكُمْ
فِدْيَةٌ وَلَا مِنَ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ ۚ مَأْوَىٰكُمُ ٱلنَّارُ ۖ هِىَ مَوْلَىٰكُمْ ۖ
وَبِئْسَ ٱلْمَصِيرُ ﴿١٥﴾ ۞ أَلَمْ يَأْنِ لِلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ أَن تَخْشَعَ
قُلُوبُهُمْ لِذِكْرِ ٱللَّهِ وَمَا نَزَلَ مِنَ ٱلْحَقِّ وَلَا يَكُونُوا۟ كَٱلَّذِينَ
أُوتُوا۟ ٱلْكِتَٰبَ مِن قَبْلُ فَطَالَ عَلَيْهِمُ ٱلْأَمَدُ فَقَسَتْ قُلُوبُهُمْ ۖ وَكَثِيرٌ
مِّنْهُمْ فَٰسِقُونَ ﴿١٦﴾ ٱعْلَمُوٓا۟ أَنَّ ٱللَّهَ يُحْىِ ٱلْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا ۚ قَدْ بَيَّنَّا
لَكُمُ ٱلْءَايَٰتِ لَعَلَّكُمْ تَعْقِلُونَ ﴿١٧﴾ إِنَّ ٱلْمُصَّدِّقِينَ وَٱلْمُصَّدِّقَٰتِ
وَأَقْرَضُوا۟ ٱللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُضَٰعَفُ لَهُمْ وَلَهُمْ أَجْرٌ كَرِيمٌ ﴿١٨﴾
٥٣٩

ajo duhet të jetë pasuri e pastër dhe të jepet me sinqeritet për hir të Allahut, për të kënaqur Atë. Këtë lloj shpenzimi Allahu e ka quajtur "hua të mirë", edhe pse dihet se Allahu nuk ka nevojë për hua, madje çdo pasuri është pronë e Tij, edhe vetë robi është pronë e Tij. Por, ashtu si huaja, që është detyrë të kthehet mbrapsht, ashtu premton Allahu se do t'ia kthejë shpërblimin robit që shpenzon për hir të Tij, madje, të shumëfishuar, sepse Allahu është Bujar e Bamirës i madh. Ky shumëfishim bëhet në Ditën e Gjykimit, ditën kur të gjithë do të shohin qartë varfërinë e tyre, kur të gjithë do të kenë nevojë edhe për mirësinë më të vogël. Duke përshkruar këtë ditë, i Madhëruari thotë më pas:

Ajetet 12 – 15

12. Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtaret tek u ndriçon drita përpara dhe në të djathtë të tyre. "Përgëzim për ju sot janë kopshtet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të jeni përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe!"

13. Ditën kur munafikët dhe munafiket u thonë besimtarëve: "Na prisni pak, që edhe të ndriçohemi prej dritës suaj!" U thuhet: "Kthehuni pas dhe kërkoni atje ndonjë dritë!" Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Nga brenda tij është mëshira, ndërsa nga jashtë tij është dënimi.

14. Ata u thërrasin: "A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju!?" - "Po, por ju e shkatërruat veten, sepse ju prisnit kob të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë dhe ju mashtroi jeta e dynjasë, derisa ju erdhi kaderi i Zotit. Gënjeshtari ju mashtroi rreth Allahut.

15. Sot prej jush nuk pranohet asnjë lloj kompensimi, ashtu si as prej jobesimtarëve. Zjarri është vendi juaj, sepse atë meritoni! Sa përfundim i keq është ai!"

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar flet për mirësinë e madhe që do të rrethojë besimtarët Ditën e Gjykimit, mirësi për të cilën do t'i kenë zili të gjithë. Kështu, Ai thotë:

- "Ditën kur i sheh besimtarët dhe besimtaret tek u ndriçon drita përpara dhe në të djathtë të tyre." - Ditën e Gjykimit, Dielli dhe Hëna do të shuhen dhe robërit do të jenë në errësirë. Ura që kalon mbi Xhehenem dhe të çon në Xhenet është vendosur, por është errësirë e plotë. Ajo është e vetmja rrugë për në Xhenet. Atëherë, do të shohësh besimtarët dhe besimtaret që ndriçohen nga një dritë, nga përpara dhe

nga e djathta e tyre. Ashtu, në ato çaste të vështira dhe të frikshme, ata do të ecin të ndriçuar nga drita e tyre. Secili do ta ketë fuqinë e dritës sipas besimit të vet. Në këto çaste, atyre u jepet përgëzimi më i bukur:

- "**Përgëzim për ju sot janë kopshtet, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të jeni përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe!"** – *Subhanallah*! Sa i ëmbël do të jetë ky përgëzim për zemrat e tyre! Ata do përjetojnë lumturi të papërshkrueshme, sepse do të marrin lajmin që arritën çdo gjë që e kishin synuar dhe shpëtuan nga çdo e keqe së cilës i druheshin.

Në këtë vend, kur shohin se si besimtarët ecin të ndriçuar nga drita e imanit të tyre, ndërsa drita e tyre shuhet, munafikët u drejtohen besimtarëve:

- "Ditën kur munafikët dhe munafiket u thonë besimtarëve: "Na prisni pak, që edhe të ndriçohemi prej dritës suaj!"" - Prisni pak, që të na ndriçohet rruga nga drita juaj, për të shpëtuar edhe ne nga ndëshkimi!

Por atyre u thuhet:

- "Kthehuni pas dhe kërkoni atje ndonjë dritë!" – Pra, u thuhet që të kthehen në dynja, nëse është e mundur. Por kjo është diçka e pamundur.

- "Atëherë, ndërmjet tyre vendoset një mur, që ka një derë. Nga brenda tij është mëshira, ndërsa nga jashtë tij është dënimi." – Atëherë, mes besimtarëve dhe munafikëve vendoset një mur i madh dhe i pakalueshëm. Nga njëra anë e tij janë besimtarët në mëshirën e Zotit, ndërsa nga ana tjetër janë munafikët në ndëshkim.

Atëherë, munafikët duke u përgjëruar dhe duke kërkuar mëshirë, u drejtohen besimtarëve dhe u thonë:

- "A nuk kemi qenë edhe ne së bashku me ju!?" - A nuk ishim së bashku me ju në dynja kur thoshim: "*La ilahe il-l'Allah*", kur faleshim, agjëronim, merrnim pjesë në xhihad dhe punonim njëlloj si ju?!

Përgjigjja u vjen kështu:

- "Po, por ju e shkatërruat veten..." - Po, është e vërtetë që ishit me ne në dynja dhe vepronit njëlloj si ne, por veprat tuaja ishin pa besim dhe pa qëllim të pastër.

- "...sepse ju prisnit kob të zi për besimtarët, dyshonit në çështjet e fesë..." - Ju dyshonit në vërtetësinë e Shpalljes së Zotit, e cila nuk pranon asnjë dyshim. Gjithashtu:

- "...dhe ju mashtroi jeta e dynjasë, derisa ju erdhi kaderi i Zotit." - Ju u mashtruat nga ëndrra e kotë se, me gjithë dyshimet tuaja, ju do të arrinit të njëjtin sukses ashtu si besimtarët. Kështu vazhduat, derisa ju erdhi vdekja, me caktimin e Zotit, dhe ju gjeti në atë gjendje të shëmtuar.

- "Gënjeshtari ju mashtroi rreth Allahut." - Ishte Gënjeshtari, Shejtani i mallkuar, ai i cili jua zbukuroi në zemër mohimin dhe dyshimet, aq sa ju gjetët qetësi dhe u kënaqët me atë gjendje. Ju e besuat premtimin e tij të rremë dhe e morët për të vërtetë çdo fjalë të tij.

- "Sot prej jush nuk pranohet asnjë lloj kompensimi, ashtu si as prej jobesimtarëve. Zjarri është vendi juaj,

sepse atë meritoni! Sa përfundim i keq është ai!" - Sikur ta jepni për kompensim të gjithë Tokën me flori, madje edhe një herë aq sa ajo, kurrë nuk do të pranohet prej jush. Vendqëndrimi juaj është Zjarri! Ai do t'ju mbështjellë plotësisht. Sa vend i keq që është Zjarri!

Në një sure tjetër, i Lartësuari thotë: "Ai që do ta ketë të rëndë peshoren e veprave të tij, ai do të bëjë një jetë të këndshme. Ndërsa ai që do ta ketë të lehtë peshoren e veprave të tij, ai e ka vendin në Hauijeh. Ku mësove t'i se ç'është Hauijeh? Ai është zjarri me nxehtësi shumë të lartë." [Kariah 6 – 11].

Ajetet 16 – 17

16. A nuk është koha për besimtarët, që zemrat e tyre të zbuten me këshillat e Allahut e me të vërtetën që u zbriti, dhe të mos bëhen si ata që iu dha libri më parë, të cilët, pasi kaloi një kohë e gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan e shumë prej tyre janë jashtë rrugës?!
17. Dijeni se është Allahu Ai që e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Ne jua kemi sqaruar argumentet, që të kuptoni.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi Allahu i Lartësuar foli për gjendjen në ahiret të besimtarëve e besimtareve, munafikëve dhe munafikeve, kjo duhet t'i bënte zemrat të frikësoheshin dhe të pendoheshin para Zoti të tyre, të nënshtroheshin para madhështisë së Tij. Atëherë, Allahu i Lartësuar i qorton besimtarët, të cilët ende nuk e ndiejnë këtë ndryshim në veten e tyre:

- **"A nuk është koha për besimtarët, që zemrat e tyre të zbuten me këshillat e Allahut e me të vërtetën që u zbriti..."** - A nuk ka ardhur koha që zemrat e besimtarëve të frikësohen e të zbuten nga përkujtimi i Allahut, pra, nga ajetet kuranore?! A nuk ka ardhur koha që ata të nënshtrohen në zbatimin e urdhrave, në largimin nga haramet dhe të nxjerrin mësim nga e vërteta që iu shpall Muhamedit (a.s.).


Kjo është nxitje për të kultivuar frikën dhe përunjësinë e zemrës ndaj Allahut të Lartësuar dhe Shpalljes së Tij. Besimtarët duhet të përkujtojnë këshillat hyjnore dhe të përkushtohen në zbatimin e fesë së Zotit në çdo kohë dhe në çdo gjendje të tyre. Ata duhet të llogarisin veten, para se të vijë çasti kur pendimi nuk pranohet më.

- **"...dhe të mos bëhen si ata që iu dha libri më parë, të cilët, pasi kaloi një kohë e gjatë, zemrat e tyre u ngurtësuan e shumë prej tyre janë jashtë rrugës?!"** - Të mos bëhen si ata të cilëve Zoti u shpalli libër, që duhej të fuste drojë në zemrat e tyre dhe t'u bindeshin urdhrave të Tij, por ata nuk u treguan të qëndrueshëm në këtë rrugë. Përkundrazi, pasi kaloi një kohë e gjatë, ata u harruan në kotësira, derisa imani i tyre u zbeh, ndërsa siguria në fe iu zhduk.

I Madhëruari thotë që "zemrat e tyre u ngurtësuan". Zemrat kanë nevojë të vazhdueshme që të përkujtojnë Shpalljen e Zotit dhe të dëgjojnë urtësitë e Tij. Njeriu nuk duhet të tregohet i pakujdesshëm, sepse kjo bëhet shkak për ngurtësimin e zemrës dhe për largimin e lotëve, që rrjedhin nga frika e Zotit.

- **"Dijeni se është Allahu Ai që e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Ne jua kemi sqaruar argumentet, që të kuptoni."** - Shenjat e Allahut të Madhëruar i tregojnë

njeriut qëllimet e larta hyjnore. Kështu, Ai që e ngjall tokën pas vdekjes së saj është i plotfuqishëm që të ngjallë robërit pas vdekjes së tyre dhe t'i shpërblejë ata sipas veprave të tyre. Ai që ngjall tokën pas vdekjes së saj me ujin që e zbret nga qielli, Ai është i plotfuqishëm që t'i ngjallë zemrat e vdekura me Shpalljen që ia zbriti nga qielli Profetit të Tij. Nga ky ajet nënkuptohet, gjithashtu, se ata që nuk udhëzohen nga shenjat e Allahut janë të palogjikshëm.



Ajetet 18 – 19

18. S'ka dyshim se atyre që japin sadaka dhe që i japin Allahut një hua të mirë, atyre do t'u shumëfishohet ajo dhe do të marrin shpërblim të madh.

19. Ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të sinqertët dhe dëshmorët, ata kanë te Zoti i tyre shpërblimin dhe dritën e vet, ndërsa ata që e mohojnë shenjat Tona janë banorë të Xhahimit.

Shpjegimi i ajeteve

- **"S'ka dyshim se atyre që japin sadaka dhe që i japin Allahut një hua të mirë, atyre do t'u shumëfishohet ajo dhe do të marrin shpërblim të madh."** - Këta janë njerëzit që japin shumë sadaka dhe shpenzojnë për kënaqësinë e Allahut. Ata shpenzojnë pasurinë e tyre për mirësi, që të sigurojnë një furnizim të mirë tek Allahu i Madhëruar. Atyre do t'u shtohet sadakaja dhjetëfish deri në shtatëqindfish. Veç kësaj, ata do të kenë një shpërblim bujar nga Zoti i Madhërishëm, me mirësitë e pafundme të Xhenetit.

- **"Ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të sinqertët dhe dëshmorët, ata kanë te Zoti i tyre shpërblimin dhe dritën e vet..."** - Besimi i vërtetë dhe i saktë, sipas pasuesve të traditës profetike, është ai që përshkruhet dhe urdhërohet në Kuran dhe Sunetin e Profetit (a.s.). Besimi shprehet me fjalë zemre dhe fjalë gjuhe, por edhe me vepra zemre, gjuhe dhe trupi. Kjo përfshin të gjitha çështjet e fesë, si ato të shfaqurat, edhe ato të fshehurat. Ata që e kanë të plotë këtë aspekt, ata janë të sinqertët (*el siddikun*), të cilët kanë gradën më të lartë, mbi të gjithë besimtarët e tjerë dhe poshtë gradës së profetëve. Pra, sipër *sidikun*-ëve qëndrojnë vetëm profetët.

Edhe dëshmorët do të kenë dritën e tyre dhe grada të larta në Xhenet, pranë Zotit, ashtu sikurse vjen në një hadith të saktë: "Vërtet, në Xhenet ka njëqind gradë, largësia mes dy të cilave është sa ajo mes qiellit dhe tokës. Këto grada i ka përgatitur Allahu për ata që luftojnë e përpiqen në rrugën e Tij".

Kjo tregon për gradën e lartë dhe afërsinë e tyre me Allahun e Lartësuar.

Në këto ajete përmenden disa kategori njerëzish, si të sinqertët, dëshmorët, bamirësit dhe banorët e Zjarrit.

Bamirësit (*el mutesaddikun*) janë ata që veprat e mira i kanë kryesisht me bamirësi ndaj krijesave, duke i ndihmuar me shpenzime e gjëra të tjera. Ata gjithmonë japin kontributin e tyre në rrugën e Allahut. Të sinqertët (*el siddikun*) janë ata që i plotësojnë të gjitha nivelet e imanit dhe të veprave të mira sipas këtij imani. Ata kanë arritur diturinë e dobishme dhe sigurinë e plotë në besim.

Ndërsa dëshmorët (*el shuhedau*) janë ata që japin jetën dhe shpenzojnë pasurinë e tyre në luftë dhe përpjekje në rrugën e Zotit, për të lartësuar dhe përhapur fjalën e Tij.

- "...ndërsa ata që e mohojnë shenjat Tona janë banorë të Xhahimit." - *Xhahim* është emër i Xhehenemit. Kështu, banues të Xhehenemit janë qafirët, të cilët mohojnë Zotin, profetët dhe shpalljet e Tij.

Është edhe një grup tjetër, që këtu nuk është përmendur, por e gjen në suren Fatir, ajeti 32: "Pastaj Ne ua lamë librin në trashëgim robërve Tanë, që Ne i përzgjodhëm. Prej tyre ka që janë dëmtues të vetvetes, ka që janë mesatarë (*muktesidun*), e ka prej tyre që, me ndihmën e Allahut, janë të parët në punë të mira. Kjo është mirësia e madhe." Këta janë ata të cilët, i kryejnë detyrimet dhe iu largohen harameve, por tregohen të pakujdesshëm dhe shkelin ndonjë prej të drejtave të Allahut dhe ndonjë detyrim ndaj robërve të Tij. Edhe këta përfundimin e kanë në Xhenet, edhe pse, sipas gabimeve të kryera, mund të ndëshkohen.

Ajetet 20 – 21

20. Dijeni se jeta e kësaj bote është veçse një lojë, kalim kohe në argëtim, stoli e krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve. Ajo i ngjan atij shiu, prej të cilit bima i habit bujqit, por pastaj ajo thahet dhe e sheh të verdhë, mandej përthyhet dhe kalbet. Ndërsa në botën tjetër ka dënim të rëndë, por edhe falje gjynahesh dhe dhurim kënaqësie nga Allahu. Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, vetëm se një përjetim mashtrues.
21. Shpejtoni që të fitoni faljen prej Zotit tuaj dhe Xhenetin, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiellit dhe e Tokës dhe që është përgatitur për ata që i besojnë Allahut dhe të dërguarve të Tij. Ai është mirësia e Allahut, që ia jep kujt të dojë; Allahu është Dhurues i madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "Dijeni se jeta e kësaj bote është veçse një lojë, kalim kohe në argëtim, stoli e krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve." - Allahu i Madhëruar na tregon për dynjanë dhe realitetin e saj, na qartëson përfundimin e saj dhe të atyre që jetojnë në të. Ai na qartëson se ajo është thjesht lojë e dëfrim. Kjo dynja është vendi ku trupi kërkon të dëfrejë dhe zemra të harrohet me kotësira. Ky është realiteti i saj. Nëse dëshiron ta kuptosh këtë realitet, atëherë shiko banorët e kësaj dynjaje dhe mënyrën se si ata jetojnë në të. Nëse do t'i vëresh me kujdes, do të shohësh se ata e kalojnë shumicën e kohës së tyre me argëtime dhe pakujdesi të gjatë ndaj përkujtimit të Allahut. Ata janë të pakujdesshëm ndaj së ardhmes që i pret

përpara dhe prej premtimeve e kërcënimeve të Zotit. Ata e trajtojnë fenë si diçka jo serioze, duke mos i dhënë rëndësinë që i takon.

Ndryshe ndodh me të zgjedhurit, të vëmendshmit, punëtorët dhe kërkuesit e përjetësisë së ahiretit. Zemrat e tyre janë të mbushura me përkujtimin e Allahut, me njohurinë për Allahun dhe dashurinë për Të. Ata e mbushin kohën e tyre me vepra të mira, që të afrojnë tek Allahu. Ata i gjen vazhdimisht duke u marrë me punë të dobishme qoftë për veten e tyre, qoftë për të tjerët.

Në këtë dynja, njerëzit përpiqen që të stolisen e lëvdohen me rroba të bukura, ushqime e pije të shtrenjta, me mjete, shtëpi, pallate, pushtet etj. Dashuruesit e dynjasë mburren mes tyre për luksin dhe pasurinë që zotërojnë. Çdokush dëshiron të duket në sytë e tjetrit dhe të jetë ai më i larti, më i lëvduari dhe më i famshmi. Çdokush dëshiron që të jetë me më shumë pasuri e djem. Ja, kështu ndodh, sidomos me ata që e dashurojnë dynjanë dhe kanë gjetur prehje në të.

Por ndryshe ndodh me ata që e njohin dynjanë me fytyrën e saj reale. Ata e trajtojnë dynjanë ashtu sikurse është në të vërtetë, si vendkalim e jo si vendprehje. Ata garojnë për çdo fjalë e vepër që të afron tek Allahu. Ata marrin të gjitha masat dhe ndjekin të gjitha rrugët që të çojnë në kënaqësinë e Allahut. Nëse të tjerët u lëvdohen e garojnë për shtimin e pasurive të kësaj dynjaje, ata garojnë për të shtuar veprat e mira e për të kërkuar ahiretin.

Pastaj Allahu i Madhëruar i bën një krahasim të goditur kësaj dynjaje dhe bukurive të saj të përkohshme dhe mashtruese:

- "Ajo i ngjan atij shiu, prej të cilit bima i habit bujqit, por pastaj ajo thahet dhe e sheh të verdhë, mandej përthyhet dhe kalbet." - Dynjaja i ngjan shiut që bie prej qiellit, nga i cili del e zhvillohet bima, me të cilën ushqehen njerëzit dhe kafshët. Ajo lulëzon e zbukurohet, duke e habitur kultivuesin e saj dhe duke mashtruar njerëzit që e kanë gjetur prehjen dhe kënaqësinë veçse te kjo dynja. Por nuk zgjat shumë, dhe vjen diçka që e fanit këtë bukuri, që dukej sikur kurrë nuk do të zhdukej. Ajo e than dhe e shndërron ashtu siç ishte në fillim, pa rënë shiu, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë. Bimës i humbet gjelbërimi dhe ngjyrat e saj mahnitëse. Ja kështu është dynjaja, me gjithë stolitë e saj. Edhe sikur të jetë në dorën e robit gjithçka që ka kjo dynja, kur të vijë momenti që ka caktuar Zoti, ajo do t'i largohet prej duarsh dhe robi do të largohet prej saj, duke marrë me vete veç qefinin. U poshtëroftë ai që jepet tërësisht kësaj jete dhe e harron punën për jetën e pasosur pranë Zotit!

Vetëm puna për të fituar ahiretin është e frytshme. Ajo i mundëson robit kënaqësinë e përjetshme, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Ndërsa në botën tjetër ka dënim të rëndë, por edhe falje gjynahesh dhe dhurim kënaqësie nga Allahu." - Në ahiret ekzistojnë dy mundësi:

1. Ndëshkim i rëndë me zjarrin e Xhehenemit, prangat, zinxhirët dhe tmerret e tij. Ky ndëshkim është përgatitur për të gjithë ata që kanë patur dynjanë si pikësynim të vetëm dhe kanë guxuar të kryejnë poshtërsi ndaj Allahut, të mohojnë shpalljet e Tij dhe të jenë mosmirënjohës ndaj dhuratave të Tij.

2. Falje gjynahesh, mbulim të metash, largim prej ndëshkimit dhe arritje të kënaqësisë së Allahut. Këto do t'u dhurohen atyre që Allahu i Madhëruar do t'i fusë në Xhenet, në vendin e kënaqësisë dhe mëshirës së Tij. Ky është vendi i atyre që e kanë njohur dynjanë ashtu sikurse është në të vërtetë dhe kanë punuar për ahiretin ashtu si ai e meriton. Kjo mjafton që ne të bëhemi asketë në dynja dhe t'i përkushtohemi tërësisht ahiretit.

Më pas, i Madhëruari thotë:

- **"Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër, vetëm se një përjetim mashtrues."** - Jeta në dynja është një kënaqësi që kalohet dhe mbaron, një kohë e shkurtër që përmbush vetëm pak nevoja e dëshira të njeriut. Për këtë arsye, kurrë nuk duhet të mashtrohesh dhe të gjesh prehje tek ajo. Ata që e gjejnë kënaqësinë vetëm tek jeta e dynjasë janë njerëzit e dobët, të cilët mashtrohen lehtë nga Shejtani.

Në vijim, i Madhëruari na urdhëron që të garojmë drejt faljes së Tij, drejt kënaqësisë dhe Xhenetit të Tij. Ai thotë:

- **"Shpejtoni që të fitoni faljen prej Zotit tuaj dhe Xhenetin, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiellit dhe e Tokës..."** - Kjo arrihet duke plotësuar ato që Zoti i ka bërë si sebep për falje gjynahesh, si: pendimi i sinqertë, kërkimi i faljes në mënyrë të rregullt, largimi nga gjynahet dhe çdo shteg që të shpie te gjynahet. Ajo arrihet, gjithashtu, duke nxituar në kënaqësinë e Allahut nëpërmjet veprave të mira dhe duke i dhënë rëndësi në mënyrë të vazhdueshme çdo gjëje që e kënaq Allahun. Gjithmonë duhet të përpiqesh për të qenë në shkallën më të lartë të *ihsan*-it qoftë në drejtim të adhurimit të Allahut, qoftë në drejtim të bamirësisë ndaj krijesave.

Më pas, i Madhëruari tregon veprat që e bëjnë të mundur këtë mirësi të madhe:

- **"...dhe që është përgatitur për ata që i besojnë Allahut dhe të dërguarve të Tij."** - Besimi tek Allahu dhe profetët e Tij nënkupton bindjen ndaj porosive të tyre, ku bëjnë pjesë themelet e fesë dhe degëzimet e saj.

- **"Ai është mirësia e Allahut, që ia jep kujt të dojë; Allahu është Dhurues i madh."** - Shpjegimi i qartë i këtyre çështjeve është mirësi e Allahut, që ia jep atij që Ai dëshiron. Në Kuran, i Madhëruari qartësoi rrugën që të çon në Xhenet dhe rrugët që të çojnë në Xhehenem. Mundësia për t'i kuptuar e mësuar këto rrugë është mirësi e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dëshirojë. Edhe shpërblimi i madh i Allahut është një dhuratë që Ai ia jep kujt të dëshirojë. Këto janë nga mirësitë më të mëdha të Allahut mbi robërit e Tij.

Allahu është Zotërues i mirësive të mëdha. Atë askush nuk mund ta lavdërojë ashtu siç e meriton. Ai qoftë i lavdëruar ashtu si e ka lavdëruar vetë Veten e Tij! Allahu qëndron shumë më lart sesa lavdërimet që i bëjnë robërit e Tij.

Ajetet 22 – 24

22. Nuk ndodh asnjë sprovë në tokë e as në trupin tuaj, që të mos jetë në Libër para se të ndodhë. Kjo, me të vërtetë, për Allahun është e lehtë.

23. Kështu, të mos dëshpëroheni tepër për atë që ju ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai ju ka dhënë. Allahu, me të vërtetë, nuk e do asnjë arrogant, që u lavdërohet të tjerëve,

24. që tregohet koprrac dhe po për koprraci i porosit njerëzit. E kush largohet prej dhënies, le ta dijë se Allahu është i Begatshëm e i Lavdishëm.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon në këto ajete për kaderin e Tij, që përfshin gjithçka e çdo çështje:

- "Nuk ndodh asnjë sprovë në tokë e as në trupin tuaj, që të mos jetë në Libër para se të ndodhë. Kjo, me të vërtetë, për Allahun është e lehtë." - Këtu bëhet fjalë për të gjithë sprovat që bien mbi krijesat, qofshin në formë mirësie apo fatkeqësie. Të gjitha janë shënuar në librin Leuhi Mahfudh, të vogla e të mëdha. Kjo është vërtet madhështore, që nuk mund ta perceptojnë mendjet dhe që i çorodit edhe më të mençurit. Por, gjithsesi, ajo për Allahun është e lehtë.

Allahu i Lartësuar i njoftoi robërit e Tij për këtë të vërtetë, që ata të jenë të qartë, të kthjellët dhe të dinë si të veprojnë e sillen në çdo situatë. Ata duhet të mos trishtohen dhe të mos humbasin tërësisht shpresat nëse u ikën ndonjë mirësi, të cilën aq shumë e kanë dashur. Për t'ia lehtësuar vetes diçka të tillë, le të kujtojnë se kështu ka qenë e shkruar në Leuhi Mahfudh, prandaj do të kryhej se s'bën dhe ishte e pamundur që të shmangej apo të ndalej. Por edhe të mos gëzohen tepër, të shfrenuar e me arrogancë, për atë që Allahu u ka dhuruar. Për këtë, thjesht le të kujtojnë se asgjë nuk e kanë arritur me forcën dhe aftësinë e tyre, por vetëm me mirësinë dhe bujarinë e Allahut të Lartësuar. Kështu që, le të punojnë për t'i shprehur Atij mirënjohjen dhe lavdinë që e meriton! Le ta falënderojë Dhuruesin e çdo të mire dhe Shpëtuesin nga çdo e keqe, Allahun e Lartësuar!

- "Kështu, të mos dëshpëroheni tepër për atë që ju ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai ju ka dhënë. Allahu, me të vërtetë, nuk e do asnjë arrogant, që u lavdërohet të tjerëve..." - Allahu nuk i do ata që janë mendjemëdhenj të vrazhdë, që mburren e fryhen me mirësitë që i ka dhënë Ai, sikur t'i kenë fituar vetë ato, me forcën e aftësië e tyre. Në vend që t'ua shtojnë nënshtrimin dhe modestinë, ato mirësi i bëjnë të kalojnë kufijtë edhe më shumë, të harrohen edhe më tepër në gjynahe e shkujdesje, sikurse thotë i Madhëruari: "Kur e godet njeriun ndonjë e keqe, ai na lutet Neve, e kur nga ana Jonë ia shndërrojmë atë në ndonjë të mirë, ai thotë: "Kjo më është dhënë në bazë të dijes sime!" Jo, ajo është një sprovë, por shumica e tyre nuk e dinë." [Zumer 49].

- "...që tregohet koprrac dhe po për koprraci i porosit njerëzit." - Ata bëjnë dy gjëra të shëmtuara, vetëm njëra prej të cilave do të mjaftonte për të kuptuar ligësinë e shpirtit të tyre: janë koprracë, duke mos kryer detyrimet që u takojnë, dhe porosisin edhe të tjerët për koprraci. Nuk u mjafton që janë vetë koprracë, por inkurajojnë edhe të tjerët me fjalë e me vepra që të përvetësojnë këtë ves të ulët dhe të shëmtuar. Këto veprime janë mosbindje ndaj Allahut dhe devijim nga rruga e Tij. Por ata që refuzojnë t'i binden Allahut do të dëmtojnë veçse vetveten dhe aspak Allahun e Madhëruar, i Cili thotë:

- "E kush largohet prej dhënies, le ta dijë se Allahu është i Begatshëm e i Lavdishëm." -

Allahu është i Pasur dhe nuk ka nevojë për askënd. Ai ka pushtetin dhe sundimin e qiejve dhe të Tokës. Është Ai që u jep pasuri robërve të Tij, duke i kënaqur e ngopur ata me gjërat që u mundëson. Ai është *El Hamidu* - i Lavdëruari, që ka çdo emër të bukur e çdo cilësi të plotë. Emrat, cilësitë dhe veprat e Tij janë të bukura dhe të plota, për të cilat meriton lavdërimin, mirënjohjen dhe madhërimin.


Ajetet 25 – 27

25. Ne i çuam të dërguarit Tanë me shenja të qarta, ashtu si Ne u shpallëm atyre Librin dhe drejtësinë, që njerëzit t'i përmbahen së drejtës. Ne e kemi zbritur edhe hekurin, i cili është i fortë dhe i dobishëm për njerëzit, për t'u dalluar qartë para Allahut se kush e ndihmon Atë dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës. S'ka dyshim se Allahu është i Fuqishëm e Krenar.

26. Nuhun dhe Ibrahimin Ne i zgjodhëm si të dërguar dhe mes pasardhësve të tyre vendosëm profetësinë dhe Librin. Prej tyre pati të udhëzuar në rrugën e drejtë, por shumë prej tyre kanë qenë të shfrenuar.

27. Pastaj, në gjurmët e tyre, vazhduam me të dërguarit Tanë, e pas tyre dërguam Isain, të birin e Merjemes. Atij i dhamë Ungjillin, ndërsa në zemrat e ithtarëve të tij futëm butësi e mëshirë. Megjithatë, murgërinë ata e shpikën vetë. Ne nuk ua bëmë detyrim murgërinë, me të cilën edhe pse synuan të arrinin kënaqësinë e Allahut, ata nuk iu përmbajtën ashtu si duhet t'i përmbaheshin. Prandaj, atyre që besuan drejt, Ne ua dhamë shpërblimin, po shumë prej tyre janë të padrejtë.

Shpjegimi i ajeteve


الجزء السابع والعشرون سورة الحديد

لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ
وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ ۖ وَأَنزَلْنَا الْحَدِيدَ فِيهِ
بَأْسٌ شَدِيدٌ وَمَنَافِعُ لِلنَّاسِ وَلِيَعْلَمَ اللَّهُ مَن يَنصُرُهُ وَرُسُلَهُ
بِالْغَيْبِ ۚ إِنَّ اللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٌ ﴿٢٥﴾ وَلَقَدْ أَرْسَلْنَا نُوحًا وَإِبْرَاهِيمَ
وَجَعَلْنَا فِي ذُرِّيَّتِهِمَا النُّبُوَّةَ وَالْكِتَابَ ۖ فَمِنْهُم مُّهْتَدٍ ۖ
وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ فَاسِقُونَ ﴿٢٦﴾ ثُمَّ قَفَّيْنَا عَلَىٰ آثَارِهِم
بِرُسُلِنَا وَقَفَّيْنَا بِعِيسَى ابْنِ مَرْيَمَ وَآتَيْنَاهُ الْإِنجِيلَ ۖ وَجَعَلْنَا
فِي قُلُوبِ الَّذِينَ اتَّبَعُوهُ رَأْفَةً وَرَحْمَةً ۚ وَرَهْبَانِيَّةً
ابْتَدَعُوهَا مَا كَتَبْنَاهَا عَلَيْهِمْ إِلَّا ابْتِغَاءَ رِضْوَانِ اللَّهِ
فَمَا رَعَوْهَا حَقَّ رِعَايَتِهَا ۖ فَآتَيْنَا الَّذِينَ آمَنُوا مِنْهُمْ أَجْرَهُمْ ۖ
وَكَثِيرٌ مِّنْهُمْ فَاسِقُونَ ﴿٢٧﴾ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ
وَآمِنُوا بِرَسُولِهِ يُؤْتِكُمْ كِفْلَيْنِ مِن رَّحْمَتِهِ وَيَجْعَل لَّكُمْ نُورًا
تَمْشُونَ بِهِ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۚ وَاللَّهُ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿٢٨﴾ لِّئَلَّا يَعْلَمَ
أَهْلُ الْكِتَابِ أَلَّا يَقْدِرُونَ عَلَىٰ شَيْءٍ مِّن فَضْلِ اللَّهِ وَأَنَّ
الْفَضْلَ بِيَدِ اللَّهِ يُؤْتِيهِ مَن يَشَاءُ ۚ وَاللَّهُ ذُو الْفَضْلِ الْعَظِيمِ ﴿٢٩﴾

٥٤١

- "Ne i çuam të dërguarit Tanë me shenja të qarta..." - Profetët u dërguan me shenja të qarta, që dëshmonin vërtetësinë e tyre dhe të Shpalljes që përcillnin prej Allahut të Madhëruar.

- "...ashtu si Ne u shpallëm atyre Librin dhe drejtësinë..." - Fjala 'Librin' ka për qëllim të gjithë librat që Allahu i Madhëruar u shpalli profetëve, si udhëzues për krijesat. Këta libra do të ishin të mjaftueshëm për të mësuar e zbuluar gjithçka që u sjell dobi njerëzve në jetën dhe fenë e tyre.

Allahu i Madhëruar u dhuroi profetëve edhe '*el mizan*', pra, drejtësinë në fjalë dhe në vepra. Feja që sollën të gjithë profetët ka qenë drejtësi, barazi e mbarësi në çdo urdhër dhe në çdo ndalesë të vendosur. Ato janë ligjet më të përkryera, që rregullojnë marrëdhëniet mes krijesave. Drejtësia është

baza e çdo dispozite të ligjëruar nga Zoti, në të gjitha fushat e ligjit, si dënimet për krimin, kompensimin, trashëgiminë etj. Qëllimi i Librit dhe drejtësisë është:

- "...që njerëzit t'i përmbahen së drejtës." - Që njerëzit të veprojnë drejt kur të përmbushin detyrimet e fesë dhe të jetës së përditshme, sepse kështu do të kenë shumë mirësi.

Ky ajet tregon se të gjithë profetët kanë patur themel të përbashkët të ligjit: vendosjen e drejtësisë, edhe pse mund të ketë patur ndryshime të caktuara në fusha të ndryshme të zbatimit të kësaj drejtësie, në varësi të kohës, vendeve dhe gjendjes së popujve.

- "Ne e kemi zbritur edhe hekurin, i cili është i fortë dhe i dobishëm për njerëzit..." – Me hekurin prodhohen mjetet luftarake, si armë, mburoja etj. Por ai ka edhe dobi të tjera për njerëzit. Për shembull, prej tij bëhen mjetet e punës, madje mund të thuhet se hekuri gjen përdorim thuajse në çdo fushë.

- "...për t'u dalluar qartë para Allahut se kush e ndihmon Atë dhe të dërguarit e Tij duke i besuar të fshehtës." - Me Shpalljen që solli dhe me forcën e hekurit që vendosi në Tokë, Allahu i Madhëruar dëshiron që t'i sprovojë njerëzit, derisa të dallohen qartë ata që ndihmojnë fenë dhe profetët e Tij, thjesht duke besuar të fshehtën.

Besimi në të fshehtën është besimi i vërtetë, ndërsa veprat e ndërtuara mbi këtë besim janë vepra të mira e të pranueshme. Nga ana tjetër, të besosh atëherë kur do të ndodhë Kijameti dhe çdo gjë do të shfaqet haptazi, është besim i pavlefshëm, që nuk merret për bazë. Ata që e besojnë të fshehtën i përmirësojnë veprat e tyre, duke u nënshtruar sipas Librit dhe duke e përdorur forcën e hekurit me drejtësinë e kërkuar nga Zoti. Pikërisht këta e kalojnë provimin dhe fitojnë shpërblimin.

- "S'ka dyshim se Allahu është i Fuqishëm e Krenar." - Asgjë dhe askush nuk mund t'i shpëtojë apo t'i fshihet Allahut. Fuqinë e Tij e dëshmon edhe hekuri, të cilin Ai e ka zbritur për t'u prodhuar gjithëfarëlloj mjetesh të fuqishme. Allahu është i Plotfuqishëm të triumfojë mbi të gjithë armiqtë e Tij, por Ai dëshiron t'i sprovojë të dashurit e Tij me armiqtë e Tij, që të sipkasin ata që e besojnë të fshehtën dhe ndihmojnë fenë dhe profetët e Tij.

Allahu i përmend bashkë Librin dhe hekurin, sepse Ai do ta ndihmojë fenë e Tij me të dyja mjetet. Ai e qartëson të vërtetën e Tij me Libër, pra, me argumente të pakundërshtueshme, por Ai do ta ndihmojë fenë e Tij edhe me forcën e shpatës së hekurt. Që të dy mjetet, qoftë Libri, qoftë forca e hekurit, do të veprojnë me drejtësi dhe për të vendosur drejtësinë. Kështu do të shfaqet qartë urtësia absolute e Allahut dhe përsosmëria e fesë së Tij, të cilën Ai e vendosi nëpërmjet profetëve të Tij.

Pasi u përmendën profetët në përgjithësi, përmenden në mënyrë të veçantë dy nga profetët më të zgjedhur të Tij, Nuhu dhe Ibrahimi (a.s.). Allahu i Madhëruar vendosi profetësinë në pasardhësit e tyre, duke i bërë ata etër të profetëve vijues.

- "Nuhun dhe Ibrahimin Ne i zgjodhëm si të dërguar dhe mes pasardhësve të tyre vendosëm profetësinë dhe Librin." - Profetët e parë dhe të fundit, të gjithë kanë qenë prej pasardhësve të Nuhut (a.s.) dhe

Ibrahimit (a.s.). Të gjithë librat iu shpallën profetëve pasardhës të këtyre dy profetëve të mëdhenj.

- "Prej tyre pati të udhëzuar në rrugën e drejtë, por shumë prej tyre kanë qenë të shfrenuar." - Prej popujve ku u dërguan këta profetë, pati të udhëzuar, të cilët e pranuan ftesën e profetëve të tyre dhe u nënshtruan për të punuar sipas urdhrave e porosive që ata dhanë. Megjithatë, shumica e tyre ishin njerëz të prishur, sikurse thotë i Madhëruari: "Shumica e njerëzve, edhe nëse insiston me ta, janë jobesimtarë." [Jusuf 103].

- "Pastaj, në gjurmët e tyre, vazhduam me të dërguarit Tanë, e pas tyre dërguam Isain, të birin e Merjemes, të cilit i dhamë Ungjillin..." - Allahu i Madhëruar e përmend në mënyrë të veçantë Isain (a.s.), sepse këto ajete flasin në përgjithësi për të krishterët, që pretendojnë se janë pasues të Isait (a.s.), të cilit iu dha Ungjilli, njëri nga librat më të rëndësishëm që Zoti ka shpallur për njerëzit.

- "...ndërsa në zemrat e ithtarëve të tij futëm butësi e mëshirë." – Në një sure tjetër, i Madhëruari thotë: "Ti do të vëresh se njerëzit me armiqësinë më të fortë kundër besimtarëve janë judejtë dhe idhujtarët. Ndërsa më të butët me besimtarët janë ata që thonë: "Ne jemi të krishterë". Ndodh kështu, sepse prej tyre ka dijetarë dhe adhurues asketë, të cilët nuk tregohen kryeneçë. Kur e dëgjojnë atë që i është shpallur të Dërguarit, do të shohësh që prej syve të tyre rrjedhin lot, nga e vërteta që kanë kuptuar. Ata thonë: "Zoti ynë, ne kemi besuar, pra, na regjistro ndër ata që do të dëshmojnë! Përse të mos e besojmë Allahun dhe të Vërtetën që na erdhi, duke qenë se ne shpresojmë që Zoti ynë të na bashkojë me njerëzit e mirë?!" Për këto që thanë, Allahu i shpërbleu me kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përgjithmonë. Ky është shpërblimi për vepërmirët!" [Maide 82 – 85]. Prandaj të krishterët ishin më zemërbutë se të tjerët, atëherë kur ishin pasues dhe udhëzues të Sheriatit të Isait (a.s.).

- "Megjithatë, murgërinë ata e shpikën vetë." - Murgëria është një lloj adhurimi, të cilin të krishterët e shpikën vetë dhe ia bën detyrim vetes. Allahu i Madhëruar nuk i pati urdhëruar kurrë për murgëri. Ishin ata që ia bënë vetes detyrë diçka të tillë, duke pretenduar se kështu synonin kënaqësinë e Allahut të Lartësuar. Por megjithëse kishin një qëllim të tillë, ata nuk iu përmbajtën atij, siç thotë i Madhëruari:

- "Ne nuk ua bëmë detyrim murgërinë, me të cilën edhe pse synuan të arrinin kënaqësinë e Allahut, ata nuk iu përmbajtën ashtu si duhet t'i përmbaheshin." - Të krishterët nuk arritën ta plotësonin detyrimin që i ngarkuan vetes. Kësisoj, ata gabuan në dy drejtime: së pari, ata shpikën një adhurim që Zoti nuk e kishte caktuar dhe, së dyti, nuk e plotësuan detyrimin që i vunë vetes. Kështu vazhdon përsëri të veprojë shumica e të krishterëve.

Sidoqoftë, disa prej tyre u përqendruan në fenë e Zotit, pa e shtrembëruar atë. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Prandaj, atyre që besuan drejt, Ne ua dhamë shpërblimin..." – Ata që e besojnë Muhamedin (a.s.) ashtu si besojnë në Isain (a.s.), Allahu do t'i shpërblejë sipas veprave të bëra.

- "...po shumë prej tyre janë të padrejtë." – Edhe këta do të marrin atë që meritojnë, sipas padrejtësisë së tyre.

Ajetet 28 – 29

28. O ju që keni besuar, kini drojë Allahun dhe besoni të Dërguarin e Tij, se Allahu ju jep dyfish nga mëshira e Tij, ju dhuron dritë, që të ecni me të, dhe ju fal gjynahet. Allahu është Falës e Mëshirues.
29. Le ta dinë ithtarët e Librit, se ata nuk kanë asgjë në dorë nga mirësia e Allahut, pasi e gjithë mirësia është në dorë të Allahut dhe Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Dhurues i madh.

Shpjegimi i ajeteve


- "O ju që keni besuar, kini drojë Allahun dhe besoni të Dërguarin e Tij, se Allahu ju jep dyfish nga mëshira e Tij..." - Ka mundësi që këto fjalë t'u drejtohen ithtarëve të Librit, domethënë, atyre që besojnë dhe pasojnë Musain ose Isain (a.s.). Allahu i Madhëruar i urdhëron ata që të punojnë sipas besimit të vërtetë. Ai i urdhëron që të kenë drojë (*takua*) ndaj Tij, duke iu larguar gjynaheve dhe mosbindjes, dhe të besojnë të Dërguarin e Tij, Muhamedin (a.s.). Nëse veprojnë kështu, Allahu ka për t'i shpërblyer dyfish, prej mëshirës së Tij: një shpërblim për besimin e tyre në profetët e shkuar dhe një shpërblim për besimin e tyre në Profetin e Fundit, Muhamedin (a.s.).

Por ka mundësi, gjithashtu, që ky urdhër t'u drejtohet të gjithëve, qofshin ithtarë të Librit ose jo. Ky shpjegim është madje më i dukshëm. Kësisoj, Allahu i Madhëruar i urdhëron të gjithë njerëzit për besim dhe drojë (*takua*) ndaj Tij. Ai i urdhëron për pasimin e plotë të fesë së drejtë, me themelet dhe degëzimet e saj, si në veprat e jashtme e të dukshme, ashtu edhe për veprat e fshehta dhe të padukshme. Nëse e zbatojnë këtë urdhër, i Lartësuari u premton dyfish prej mirësisë dhe mëshirës së Tij. Madhësinë e këtij shpërblimi nuk e di askush, veç Allahut të Lartësuar. Një shpërblim është për besimin dhe një shpërblim për *takua*-në; ose një shpërblim për zbatimin e urdhrave dhe një shpërblim për lënien e harameve. Po ashtu, ka mundësi që "ju jep dyfish" të ketë kuptimin: "ju jep shpërblime të shtuara herë pas here". Por jo vetëm kaq, sepse Allahu i Madhëruar thotë në vijim:

- "...ju dhuron dritë, që të ecni me të, dhe ju fal gjynahet." - Përveç shpërblimit të shumëfishuar, Allahu i Lartësuar ka për t'ju dhënë dituri udhëzim dhe dritë, që të ecni mes territ të injorancës. Më tepër akoma, Ai do t'ju falë gjynahet dhe do t'ju mbulojë të metat.

- "Allahu është Falës e Mëshirues." – Prandaj, asnjërit të mos i duken shumë këto premtime për Allahun, që zotëron mirësi të pakufishme, të cilat kanë përfshirë qiejt e Tokën dhe çfarë gjendet mes tyre. Çdo krijesë është rrethuar nga mirësitë e Tij dhe nuk bën dot pa to as sa një pulitje sysh, madje as më pak se kaq.

- "Le ta dinë ithtarët e Librit, se ata nuk kanë asgjë në dorë nga mirësia e Allahut..." – Ne e bëjmë të qartë bujarinë Tonë ndaj atyre që kanë *takua* dhe besim të plotë, duke besuar edhe profetin Muhamed (a.s.), për t'u dhënë një mesazh shumë të rëndësishëm ithtarëve të Librit: ata nuk kanë asnjë lloj mundësie që të përcaktojnë mirësinë e Allahut, se kujt t'i jepet ajo e kujt jo. Le ta



mësojnë mirë, se nuk janë ata, me dëshirat e tyre të sëmura, që përcaktojnë se kujt duhet t'i jepet mëshira e Zotit e kujt jo. Ata të mjerë, sikurse tregon i Madhëruari, thonë: "Nuk ka për të hyrë në Xhenet askush, përveç atij që është çifut ose i krishterë!", por i Madhëruari tha: "Këto janë trille të tyre! Thuaju: "Sillni provat tuaja, nëse keni të drejtë!" Përkundrazi, ai që i është dorëzuar Allahut dhe është bamirës, e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij. Për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten." [Bekare 111, 112]. Pra, të mos vazhdojnë me ëndrra të kota dhe me gjykimet e tyre të padrejta. Le ta dinë se vetëm ata që besojnë Muhamedin (a.s.) dhe kanë *takua*, Allahu do t'u japë dyfish nga mëshira e Tij, do t'u dhurojë dritë e falje gjynahesh, ndryshe nga ç'trillojnë ithtarët e Librit. Ai do t'i shpërblejë punëmirët, edhe nëse këtë e urrejnë arrogantët e pabindur. Le ta kuptojnë ata të vetëmashtruar se:

- "...pasi e gjithë mirësia është në dorë të Allahut dhe Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Dhurues i madh." - Allahu e dhuron mirësinë e Tij sipas urtësisë dhe diturisë së Tij absolute. Bujaria e Tij është e madhe dhe askush nuk mund ta kufizojë atë.

Këtu përfundoi tefsiri i sures Hadidë, dhe kjo është vetëm mirësi dhe bujari prej Allahut. Vetëm Ai qoftë i lavdëruar!

Surja 58: El Muxhadele (medinase) 22 ajete

Ajetet 1 – 4
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Vërtet, Allahu i dëgjoi fjalët e asaj që bisedoi me ty lidhur me burrin e vet dhe u ankua tek Allahu. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj. Allahu është Gjithëdëgjues e Gjithëvështrues.**

2. **Ata nga mesi juaj, të cilët u bëjnë *dhihar* grave të veta, le ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë ato që i kanë lindur. Në fakt, ata thonë fjalë të urryera dhe të pavërteta. Allahu është vërtet Falës i madh dhe Mbulues i gjynaheve.**

3. **Ata që bëjnë *dhihar* dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj tërhiqen nga ajo që kanë thënë, janë të detyruar që, para se të kontaktojnë me to, të lirojnë një rob. Ky është ligji për ju, e Allahu është i Gjithëditur me hollësi rreth veprimeve tuaja.**

4. **E kush nuk ka mundësi, le të agjërojë dy muaj rresht, para se të kryejë marrëdhënie. Kush nuk mundet as për këtë, atëherë le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër. Kjo, për të treguar se ju besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Këto janë kufijtë e**

Allahut. Ndërkaq, mohuesit kanë dënim të rëndë.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë shpallur pas ngjarjes së një ensari me gruan e tij. Gruaja u ankua tek Allahu i Madhëruar dhe ia parashtroi disa herë çështjen Profetit (a.s.). Por çfarë kishte bërë burri i saj? Pas shumë vitesh të martuar e me fëmijë, burri ishte betuar se nuk do të shkonte më me të, duke i thënë se ishte si nëna e tij. Pas kësaj ankese, Allahu i Madhëruar tha:

- "Vërtet, Allahu i dëgjoi fjalët e asaj që bisedoi me ty lidhur me burrin e vet dhe u ankua tek Allahu. Allahu e dëgjoi bisedën tuaj. Allahu është Gjithëdëgjues e Gjithëvështrues." - Allahu i Madhëruar e dëgjoi bisedën mes teje (o i Dërguar) dhe gruas që ankohej për burrin e saj. Allahu është *Semiun* - Gjithëdëgjues. Ai i dëgjon të gjithë zërat, në çdo kohë, për çdo nevojë e kërkesë që parashtrojnë. Allahu është *Basir* – Gjithëshikues. Ai shikon hapat dhe gjurmët e milingonës së zezë që ecën në një gur të zi, në një natë të errët.

Ky ajet na tregon se Allahu përfshin edhe gjërat më të imta me dijen, vështrimin dhe dëgjimin e Tij. Ky ajet tregon, gjithashtu, se Allahu i Madhëruar iu përgjigj ankesës së gruas, duke ia larguar vështirësinë. Ai na bën të ditur gjykimin në lidhje me rastin konkret dhe të rasteve të tjera të ngjashme, duke thënë:

- "Ata nga mesi juaj, të cilët u bëjnë *dhihar* grave të veta, le ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre. Nënat e tyre janë ato që i kanë lindur." – *Dhihar*-i ndodh kur burri i thotë gruas së vet: "Ti je për mua si shpina e nënës time", ose fjalë të tjera, për të shprehur se ajo është haram për të. Është quajtur '*dhihar*' - 'shpina', nisur nga shprehja e mësipërme, e cila përdorej nga arabët me nënkuptimin se burri nuk donte t'i afrohej më bashkëshortes për marrëdhënie intime. Por Allahu i Madhëruar e ndaloi këtë sjellje, duke thënë: "Ata nga mesi juaj, të cilët u bëjnë *dhihar* grave të veta, le ta dinë se ato nuk janë nënat e tyre." Pra, si thonë fjalë të tilla, kur dihet që janë të pavërteta e të shëmtuara?! Ata i krahasojnë gratë e tyre me nënat që i kanë lindur. Kjo është vepër shumë e shëmtuar dhe e ulët:

- "Në fakt, ata thonë fjalë të urryera dhe të pavërteta." – Ata thonë fjalë të shëmtuara dhe të gënjeshërta.

Por përsëri, Allahu i Madhëruar e lë të hapur mundësinë e pendimit, duke thënë:

- "Allahu është vërtet Falës i madh dhe Mbulues i gjynaheve." - Për ata që bëjnë ndonjë veprim në kundërshtim me porositë e Zotit, por pastaj nxitojnë të pendohen sinqerisht, Ai është gjithmonë Falës i madh dhe Mbulues i gabimeve.

- "Ata që bëjnë *dhihar* dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj tërhiqen nga ajo që kanë thënë, janë të detyruar që, para se të kontaktojnë me to, të lirojnë një rob." - Dijetarët kanë mendime të ndryshme për çështjen e tërheqjes nga vendimi për *dhihar*-in: a konsiderohet thjesht ndryshimi i mendimit të burrit apo duhet rikthimi konkret në marrëdhëniet intime? Disa janë të mendimit se si tërheqje nga *dhihar*-i konsiderohet thjesht marrja e vendimit personal nga ana e burrit për të kryer marrëdhënie e jo vetë marrëdhëniet. Në këtë rast, atij i bëhet i detyrueshëm kompensimi i

përshkruar në ajet. Këtë variant e përforcon edhe fakti që Allahu i Madhëruar ka thënë që ky kompensim duhet të bëhet para kryerjes së marrëdhënieve.

Ndërsa dijetarët e tjerë argumentojnë: Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: "Ata që bëjnë *dhihar* dhe largohen nga gratë e veta, e pastaj tërhiqen nga ajo që kanë thënë...", dhe ajo që ata kanë thënë është moskryerja e marrëdhënieve. Atëherë, e kundërta e moskryerjes së marrëdhënieve intime është kryerja e tyre.

Sidoqoftë, nëse ka tërheqje nga vendimi për *dhihar*-in, me cilëndo mënyrë të jetë, atëherë bëhet i detyrueshëm kompensimi i përshkruar në ajet, ku i Lartësuari thotë: "...janë të detyruar që, para se të kontaktojnë me to, të lirojnë një rob.". Pra, kur burri të tërhiqet nga vendimi për *dhihar* ndaj gruas së tij, atëherë e ka detyrë që të lirojë një rob. Në këtë ajet nuk përcaktohet në bëhet fjalë për rob besimtar apo jo, por kjo çështje trajtohet në një ajet tjetër. Nuk ka rëndësi në është rob mashkull apo femër; e rëndësishme është që të mos jetë me mangësi që e bëjnë të paaftë për punë.

Allahu i Madhëruar thotë: "para se të kontaktojnë me to". Kështu, burri e ka të ndaluar që të kryejë marrëdhënie intime me gruan që i ka bërë *dhihar*, derisa të lirojë një rob.

- "Ky është ligji për ju..." - Ky gjykim është ligji i Zotit, i shoqëruar me qortim e me këshillë (siç kuptohet nga fjala '*tuadhune*', që vjen nga '*el ua'dhu*'), në mënyrë që njerëzit të kenë drojë dhe ta trajtojnë atë me respektin e duhur. Kështu, ai që dëshiron të bëjë *dhihar*, kur mendon se duhet ta kompensojë duke liruar një rob, do të frenohet nga kjo vepër e padrejtë.

- "...e Allahu është i Gjithëditur me hollësi rreth veprimeve tuaja." – Për këtë arsye, Allahu do ta shpërblejë çdo njeri sipas veprave që ka bërë.

- "E kush nuk ka mundësi, le të agjërojë dy muaj rresht, para se të kryejë marrëdhënie. Kush nuk mundet as për këtë, atëherë le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër." - Nëse burri nuk zotëron robër ose nuk ka pasuri për të liruar një rob, atëherë kompensimi i gjynahut është me agjërim dy muaj rresht, para se t'i kthehet marrëdhënieve normale. E nëse nuk mundet as të agjërojë në këtë mënyrë, atëherë le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër me ushqimet bazë të përdorshme në vendin e tij, sikurse thonë shumë komentues të Kuranit, ose të ushqejë çdo të varfër me një *mudd*-e (masë sa dy grushta) gruri, ose gjysëm *sa*-i me ushqime të tjera, sipas mendimit të një grupi tjetër komentuesish. Ky gjykim zbriti me qëllimin që:

- "...për të treguar se ju besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij." - Këtë besim ta shprehni duke zbatuar detyrimet me të cilat ngarkoheni. Përkushtimi në zbatimin e ligjeve të Zotit vjen prej besimit dhe është tregues i tij. Madje, zbatimi i ligjeve të Zotit është synimi kryesor i besimit. Nga ana tjetër, me zbatimin e ligjeve të Zotit, besimi shtohet dhe fuqizohet, derisa bëhet i patundur në zemrat e besimtarëve.

- "Këto janë kufijtë e Allahut. Ndërkaq, mohuesit kanë dënim të rëndë." - Këto janë kufijtë e vendosura nga Zoti, të cilët është e ndaluar t'i shpërfillësh apo t'i shkelësh. Ata duhen zbatuar rigorozisht. Nga këto ajete nxirren disa mësime:

1. Së pari, këtu dallohet butësia, mëshira dhe përkujdesi i madh i Allahut për robërit e Tij. Allahu i Madhëruar përmend në Librin e Tij ankesën e një gruaje në nevojë, madje Ai e largoi sprovën e saj, duke ia zgjidhur hallin. Jo vetëm kaq, por Ai solli një ligj gjithëpërfshirës, për të zgjidhur çdo situatë të ngjashme.

2. *Dhihar*-i është i trajtueshëm vetëm kur i bëhet bashkëshortes. Nëse dikush ia bën atë skllaves së vet, atëherë nuk trajtohet si *dhihar*. Pra, nëse një burrë vendos që të ndalojë veten nga marrëdhëniet me skllaven, nuk konsiderohet si *dhihar*, por trajtohet njëlloj si rasti kur i ndalon vetes një ushqim ose një pije të caktuar dhe, si i tillë, nëse e thyen këtë vendim, bëhet i detyrueshëm kompensimi i përcaktuar nga Sheriati për thyerjen e betimit. [25]

3. *Dhihar*-i nuk funksionon me një grua me të cilën burri ende nuk ka nënshkruar aktin e martesës, pasi gruaja konsiderohet si bashkëshorte vetëm kur bëhet akti i martesës. Kjo është njëlloj sikur t'i thuash një gruaje: "Të kam ndarë", ndërkohë që ajo ende nuk është bërë bashkëshortja jote.

4. *Dhihar*-i është një vepër haram, e ndaluar me Sheriat, sepse Allahu i Madhëruar e ka quajtur '*munkeran*' - 'fjalë të urryera' dhe '*zura*' - 'të pavërteta'.

5. Allahu i Madhëruar thotë: '...ato nuk janë nënat e tyre", duke na kujtuar se çdokujt i duhet dhënë haku që i takon, pa i cenuar asnjë të drejtë. Ndaj secilit ekzistojnë detyrime dhe përgjegjësi, të cilat nuk mund të ndryshohen sipas qejfit.

6. Është e papëlqyeshme që burri të thërrasë bashkëshorten me emrat ose mënyrën se si thërret nënën ose motrat e tij, si p.sh.: "O nëna ime! " ose: "O motra ime!" etj., sepse kjo i përngjan *dhihar*-it, edhe nëse nuk është për qëllim.

7. Kompesimi bëhet i detyrueshëm kur burri tërhiqet nga vendimi që ka marrë, sipas dy mendimeve të përmendura më sipër, dhe jo thjesht me veprimin e *dhihar*-it nga ana e tij.

8. Është detyrë plotësimi i kompensimit, cilido qoftë ai, para se burri t'i kthehet marrëdhënieve intime, sepse Allahu e ka përcaktuar vetë diçka të tillë kur thotë: "...para se të kontaktojnë...". Një përjashtim të vogël bën rasti kur kompensimi bëhet duke ushqyer gjashtëdhjetë të varfër, pasi në këtë rast lejohet që çifti të kryejë marrëdhënie intime edhe gjatë kohës kur të varfërit janë duke u ushqyer, dhe nuk ka nevojë që të pritet derisa ata të mbarojnë ushqimin.

9. Është e detyrueshme që, nëse bëhet kompensimi me ushqim, ai t'u shpërndahet gjashtëdhjetë të varfërve. Me fjalë të tjera, nuk është e saktë nëse e mbledh të gjithë ushqimin dhe ia jep vetëm një të varfëri. Duhet të jenë patjetër gjashtëdhjetë të varfër, sepse Allahu i Madhëruar thotë: "...le të ushqejë gjashtëdhjetë të varfër".


Ajeti 5

5. Nuk ka dyshim se ata që i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të Tij janë të poshtëruar, ashtu siç u poshtëruan ata përpara tyre. Ne u shpallëm atyre fakte të qarta. Për mohuesit është përgatitur një dënim i turpshëm.

Shpjegimi i ajetit

- "Nuk ka dyshim se ata që i kundërvihen Allahut dhe të Dërguarit të Tij janë të

[25] Shih në suren Bekare, ajetet 224, 225 dhe tefsirin e tyre.


الجزء الثامن والعشرون سورة المجادلة
أَلَمْ تَرَ أَنَّ ٱللَّهَ يَعْلَمُ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۖ مَا يَكُونُ مِن
نَّجْوَىٰ ثَلَٰثَةٍ إِلَّا هُوَ رَابِعُهُمْ وَلَا خَمْسَةٍ إِلَّا هُوَ سَادِسُهُمْ وَلَآ أَدْنَىٰ
مِن ذَٰلِكَ وَلَآ أَكْثَرَ إِلَّا هُوَ مَعَهُمْ أَيْنَ مَا كَانُوا۟ ۖ ثُمَّ يُنَبِّئُهُم بِمَا
عَمِلُوا۟ يَوْمَ ٱلْقِيَٰمَةِ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ بِكُلِّ شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿٧﴾ أَلَمْ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ
نُهُوا۟ عَنِ ٱلنَّجْوَىٰ ثُمَّ يَعُودُونَ لِمَا نُهُوا۟ عَنْهُ وَيَتَنَٰجَوْنَ بِٱلْإِثْمِ
وَٱلْعُدْوَٰنِ وَمَعْصِيَتِ ٱلرَّسُولِ ۖ وَإِذَا جَآءُوكَ حَيَّوْكَ بِمَا لَمْ يُحَيِّكَ
بِهِ ٱللَّهُ وَيَقُولُونَ فِىٓ أَنفُسِهِمْ لَوْلَا يُعَذِّبُنَا ٱللَّهُ بِمَا نَقُولُ ۚ حَسْبُهُمْ
جَهَنَّمُ يَصْلَوْنَهَا ۖ فَبِئْسَ ٱلْمَصِيرُ ﴿٨﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ إِذَا
تَنَٰجَيْتُمْ فَلَا تَتَنَٰجَوْا۟ بِٱلْإِثْمِ وَٱلْعُدْوَٰنِ وَمَعْصِيَتِ ٱلرَّسُولِ
وَتَنَٰجَوْا۟ بِٱلْبِرِّ وَٱلتَّقْوَىٰ ۖ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ٱلَّذِىٓ إِلَيْهِ تُحْشَرُونَ ﴿٩﴾ إِنَّمَا
ٱلنَّجْوَىٰ مِنَ ٱلشَّيْطَٰنِ لِيَحْزُنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَلَيْسَ بِضَآرِّهِمْ
شَيْـًٔا إِلَّا بِإِذْنِ ٱللَّهِ ۚ وَعَلَى ٱللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ ٱلْمُؤْمِنُونَ ﴿١٠﴾ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ إِذَا قِيلَ لَكُمْ تَفَسَّحُوا۟ فِى ٱلْمَجَٰلِسِ فَٱفْسَحُوا۟ يَفْسَحِ
ٱللَّهُ لَكُمْ ۖ وَإِذَا قِيلَ ٱنشُزُوا۟ فَٱنشُزُوا۟ يَرْفَعِ ٱللَّهُ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ مِنكُمْ
وَٱلَّذِينَ أُوتُوا۟ ٱلْعِلْمَ دَرَجَٰتٍ ۚ وَٱللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ ﴿١١﴾
٥٤٣

poshtëruar, ashtu siç u poshtëruan ata përpara tyre. Ne u shpallëm atyre fakte të qarta." – Këtu flitet për *'el muhaddetu'*, që është kundërshtimi i Allahut dhe Profetit të Tij, sidomos në çështjet më të rëndësishme, si për shembull duke bërë *kufër* e *shirk*, ose me armiqësi ndaj të dashurve të Allahut. Të tillët janë të poshtëruar, ashtu sikurse edhe të tjerët para tyre, që kryen të njëjtat vepra. Këta të mjerë nuk kanë asnjë justifikim para Allahut të Madhërueshëm dhe Krenar. Faktet që Zoti u ka dhënë njerëzve janë të padiskutueshme dhe të pakundërshtueshme. Ai ka sjellë fakte të qarta e mrekulli të shumta, me të cilat ka provuar vërtetësinë e profetëve dhe të shpalljeve të tyre. Allahu i Madhëruar e ka qartësuar të vërtetën dhe u ka mësuar krijesave synimet më të larta që duhet të kenë dhe të punojnë për t'i realizuar. Ata që shkojnë pas këtyre qëllimeve, duke punuar dhe luftuar për t'i plotësuar ato, ata janë të udhëzuarit në rrugën e drejtë, që do të arrijnë me sukses çdo të mirë dhe do të shpëtojnë nga çdo e keqe.

- "Për mohuesit është përgatitur një dënim i turpshëm." – Për ta është përgatitur ndëshkim poshtërues. Ashtu sikurse ata tregohen arrogantë ndaj fakteve të Zotit, ashtu sikurse tregohen shpërfillës të ftesës së Tij, po ashtu Zoti do t'i poshtërojë ata në ahiret.

Ajetet 6 – 7

6. Ditën kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, Ai do t'u pëcjellë se çfarë kanë punuar. Allahu i ka shënuar të gjitha, edhe pse ata i harrojnë. Allahu është Mbikëqyrësi i gjithçkaje.

7. A nuk e di ti se Allahu di për gjithçka që gjendet në qiej dhe për gjithçka që gjendet në Tokë?! Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti, e as mes pesë vetave, që Ai të mos jetë i gjashti, e as mes më pak dhe as mes më shumë vetave, që Ai të mos jetë me ta, kudo që të jenë. Më pas, Ditën e Kijametit, Ai do t'i njoftojë ata për çfarë kanë bërë. Allahu është i Dijshëm për gjithçka.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ditën kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, Ai do t'u pëcjellë se çfarë kanë punuar. Allahu i ka shënuar të gjitha, edhe pse ata i harrojnë." - Allahu i Madhëruar na tregon se ditën kur të ringjallë krijesat, Ai do t'i shpërblejë të gjithë sipas veprave të kryera, të mira apo të këqija qofshin ato, sepse Ai është i Dijshmi për gjithçka dhe i ka shënuar të gjitha veprat e tyre në Leuhi Mahfudh. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar ka

urdhëruar melekët shkrues që t'i regjistrojnë veprat e robërve imtësisht dhe korrektësisht. Allahu i Madhëruar ka regjistruar gjithçka me saktësi, pa i shpëtuar asgjë, sado e vogël të jetë ajo.

- "Allahu është Mbikëqyrësi i gjithçkaje. A nuk e di ti se Allahu di për gjithçka që gjendet në qiej dhe për gjithçka që gjendet në Tokë?!" - Allahu i Madhëruar është dëshmues dhe i ditur për çështjet e shfaqura e ato të fshehura, për të dukshmet dhe për ato që mbahen të fshehta. Dituria e Tij përfshin çdo gjë në qiej dhe në Tokë, e vogël apo e madhe. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar na tregon se:

- "Nuk bëhet bisedë e fshehtë mes tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti, e as mes pesë vetave, që Ai të mos jetë i gjashti, e as mes më pak dhe as mes më shumë vetave, që Ai të mos jetë me ta, kudo që të jenë." – Kjo do të thotë që Allahu është pranë robërve me diturinë e Tij absolute, duke ditur me hollësi edhe bisedat e tyre më të fshehta. Për këtë arsye, Ai thotë më pas:

- "Më pas, Ditën e Kijametit, Ai do t'i njoftojë ata për çfarë kanë bërë. Allahu është i Dijshëm për gjithçka." - Allahu është pranë tyre me diturinë e Tij gjithëpërfshirëse, prandaj edhe shpërblimi i Tij për veprat do të jetë i drejtë dhe korrekt.

Ajetet 8 – 9

8. A nuk i sheh ata të cilët, edhe pse u është ndaluar të bisedojnë fshehtas, ata i kthehen përsëri të ndaluarës dhe pëshpërisin për gjynahe, nxitje armiqësish dhe mosbindje ndaj të Dërguarit? Kur vijnë te ti, ata të përshëndesin jo ashtu si të përshëndet Allahu, por thonë me vete: "Përse nuk na dënon Allahu për këto fjalë që po themi?!" Mjafton për ta Xhehenemi, ku do të hidhen. Eh, sa vend i tmerrshëm është ai!

9. O ju që keni besuar, kur bisedoni fshehtas me njëri-tjetrin, mos bisedoni për gjynahe, nxitje armiqësish dhe mosbindje ndaj Pejgamberit, por bisedoni për punë të mira e devotshmëri. Gjithmonë ta keni frikë Allahun, para të Cilit do të dilni të gjithë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i sheh ata të cilët, edhe pse u është ndaluar të bisedojnë fshehtas, ata i kthehen përsëri të ndaluarës dhe pëshpërisin për gjynahe, nxitje armiqësish dhe mosbindje ndaj të Dërguarit?" - *El nexhua* quhet një bisedë e fshehtë e zhvilluar mes dy ose më shumë personave. Ajo mund të kryhet për mirë ose për keq. Allahu i Madhëruar i urdhëron besimtarët që të bisedojnë vetëm për mirë e jo për keq. Le të diskutojnë për çdo çështje që kënaq Zotin dhe që është adhurim ndaj Tij. Vepra e mirë mund të jetë plotësim i të drejtave të Allahut ose në dobi të krijesave.

Allahu i Madhëruar urdhëron, gjithashtu, që bisedat të jenë në funksion të devotshmërisë, e cila nënkupton largimin nga çdo fjalë e vepër të ndaluar nga Zoti, që sjell ndëshkim e të ngarkon me gjynahe. Besimtarët e zbatojnë me kujdes këtë porosi hyjnore. Në bisedat e tyre të fshehta ata flasin veçse për gjëra që e kënaqin Allahun e Madhëruar dhe që i largojnë nga ndëshkimi i Tij. Ndërsa gjynahqarët i shpërfillin porositë e Allahut. Ata i sheh gjithmonë të flasin për çështje që i ngarkojnë me gjynahe, që nxisin armiqësi dhe urrejtje, në kundërshtim me porositë e Zotit dhe

Profetit. Ata u përngjajnë munafikëve, të cilët e kanë zakon diçka të tillë. Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Kur vijnë te ti, ata të përshëndesin jo ashtu si të përshëndet Allahu..." - Ata tregonin mungesë edukate në mënyrën se si përshëndesnin Pejgamberin (a.s.), duke fshehur brenda tyre mendime, të cilat Allahu, Njohësi i të dukshmes dhe të fshehtës, ua nxori në shesh. Ata thanë:

- "...por thonë me vete: "Përse nuk na dënon Allahu për këto fjalë që po themi?!"" – Ata, si pa të keq, nuk e quanin ndonjë gjë të madhe këtë tallje që bënin dhe, veç kësaj, me paturpësi e mendjelehtësi, thanë: "Pse nuk na ndëshkon Allahu për këto që themi?!" A thua sikur po argumentonin e thoshin që, përderisa Zoti nuk po na ndëshkon për këtë, atëherë kjo është diçka jo e keqe! Sigurisht, këtë e bënin thjesht për tallje. Por Allahu ua bëri të qartë atyre se Ai afatizon, por kurrë nuk harron:

- "Mjafton për ta Xhehenemi, ku do të hidhen. Eh, sa vend i tmerrshëm është ai!" - Mjafton si ndëshkim për ta Xhehenemi, ku janë mbledhur të gjitha llojet e vuajtjeve. Dhimbja ka për t'i rrethuar nga çdo anë. Të jenë të sigurt se ata kanë për të shijuar ndëshkimin e merituar.

Ajeti flet ose për munafikët, që shfaqnin imanin dhe fshihnin kufrin, të cilët kur i flisnin Profetit (a.s.) shtireshin sikur i donin të mirën, por në të vërtetë ishin mashtrues dhe dashakeqës, ose ishin ithtarë të Librit të cilët, kur i drejtoheshin Profetit (a.s.), e përshëndesnin duke i thënë "*Es-samu alejkum*!", pra "Vdekja qoftë mbi ju!", duke shtrembëruar me dinakëri përshëndetjen "*Es-selamu alejkum*!" - "Paqja qoftë mbi ju!"

- "O ju që keni besuar, kur bisedoni fshehtas me njëri-tjetrin, mos bisedoni për gjynahe, nxitje armiqësish dhe mosbindje ndaj Pejgamberit, por bisedoni për punë të mira e devotshmëri. Gjithmonë ta keni frikë Allahun, para të Cilit do të dilni të gjithë!" - Besimi me siguri të plotë për takimin me Allahun dhe llogarinë e drejtë para Tij, është ndihma më e madhe që e bën robin të qëndrojë brenda kufijve të Allahut të Madhëruar dhe t'u përmbahet porosive të Tij.

Ajeti 10

10. Bisedat e fshehta i nxit vetëm Shejtani, për t'u sjellë shqetësime atyre që besojnë. Por ato nuk mund t'i dëmtojnë ata aspak, pa lejen e Allahut. Kështu që, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!

Shpjegimi i ajeteve

- "Bisedat e fshehta i nxit vetëm Shejtani..." - Bisedat e fshehta dhe intrigat që armiqtë thurin kundër besimtarëve janë të nxitura nga Shejtani i mallkuar. Por, megjithatë, intrigat e Shejtanit janë të dobëta. Ajo që armiqtë mund të arrijnë përmes të tilla bisedash është thjesht një mërzitje e besimtarëve, siç thotë i Lartësuari:

- "...për t'u sjellë shqetësime atyre që besojnë." - Ky është qëllimi i këtyre bisedave dhe deri këtu mund të arrijnë. Sido që të jetë, ato nuk mund të dalin nga kontrolli i Allahut të Madhëruar, që thotë:

- "Por ato nuk mund t'i dëmtojnë ata aspak, pa lejen e Allahut." - Allahu i Madhëruar u

premton besimtarëve se do të jetë i mjaftueshëm me mbrojtjen e ndihmën e Tij kundër jobesimtarëve, duke u dhënë fitoren mbi ta.. Allahu i Madhëruar thotë në një ajet tjetër: "...dredhia e keqe nuk godet asnjë tjetër veç atyre që e kurdisin." [Fatir 43]. Armiqtë e Allahut, të Profetit dhe të besimtarëve, sado që të zhvillojnë bisedime të fshehta kundër besimtarëve dhe fesë së Allahut, të dëmtuarit do të jenë vetëm ata, thurësit e intrigave. Ndërsa besimtarët do të goditen veçse aq sa ka përcaktuar Zoti me urtësinë e Tij, prandaj vetëm Zotit le t'i mbështeten ata:

- "Kështu që, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!" - Le t'i mbështeten Allahut, duke patur siguri të plotë në premtimin e Tij. Kush i mbështetet Allahut, Allahu do të jetë i mjaftueshëm për të; Allahu do të marrë përsipër të rregullojë të gjitha çështjet e fesë dhe të dynjasë së këtij robi.

Ajeti 11

11. O ju që keni besuar, nëse ju thuhet: "Lironi pak vend" në tubime, lironi, se Allahu sjell lirim për ju. E nëse ju thuhet: "Ngrihuni", atëherë ngrihuni! Allahu i lartëson ata prej jush që besojnë, ndërsa të begatuarit me dituri i ngre në grada të larta. Allahu është hollësisht i ditur për çfarë ju veproni.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar, nëse ju thuhet: "Lironi pak vend" në tubime, lironi, se Allahu sjell lirim për ju." - Allahu i Madhëruar i edukon besimtarët se si të sillen në kuvende të mëdha. Nëse vjen dikush dhe ju kërkon t'i bëni pak vend, është prej edukatës që ju t'i bëni vend. Kjo nuk sjell asnjë dëm për ju. Përveçse nuk është e dëmshme, ka edhe shpërblim. Ai që i bën lehtësim tjetrit, do të gjejë lehtësim prej Allahut. Kush ndihmon vëllain e vet, atë ka për ta ndihmuar Allahu.

- "E nëse ju thuhet: "Ngrihuni", atëherë ngrihuni! Allahu i lartëson ata prej jush që besojnë, ndërsa të begatuarit me dituri i ngre në grada të larta." - Edhe nëse ju kërkohet që të ngriheni e të largoheni nga kuvendi, për ndonjë nevojë të caktuar, atëherë ngrihuni. Madje, bëjeni këtë duke nxituar e me kënaqësi, për të arritur atë që kërkohet.


Përmbushja e këtyre porosive është treguese e diturisë dhe imanit. Allahu i Lartësuar i ngre gradat e dijetarëve dhe të besimtarëve. Në varësi të dijes dhe imanit të tyre, do të jetë dhe ngritja në grada.

- "Allahu është hollësisht i ditur për çfarë ju veproni." - Allahu do ta shpërblejë këdo sipas veprave të tij, me të mirë ose me të keqe.

Në këtë ajet tregohet vlera dhe rëndësia e madhe e diturisë. Por mësohet gjithashtu se bukuria e dijes del në pah nëse jep frytet e saj, domethënë duke e zbatuar atë.

Ajetet 12 – 13

12. O ju që keni besuar, nëse dëshironi të bisedoni me të Dërguarin, jepni një sadaka para bisedës suaj. Kjo është më mirë dhe më e pastër për ju! Nëse nuk keni çfarë të jepni, Allahu është Falës e Mëshirues.
13. A keni frikë të jepni sadaka në prag të bisedës suaj? Kur ju nuk e bëtë këtë, Allahu jua pranoi pendimin. Atëherë, faleni namazin, jepni zekatin dhe bindjuni


الجزء الثامن والعشرون سورة المجادلة
يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِذَا نَٰجَيۡتُمُ ٱلرَّسُولَ فَقَدِّمُواْ بَيۡنَ يَدَيۡ نَجۡوَىٰكُمۡ
صَدَقَةٗۚ ذَٰلِكَ خَيۡرٞ لَّكُمۡ وَأَطۡهَرُۚ فَإِن لَّمۡ تَجِدُواْ فَإِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٞ رَّحِيمٌ
ءَأَشۡفَقۡتُمۡ أَن تُقَدِّمُواْ بَيۡنَ يَدَيۡ نَجۡوَىٰكُمۡ صَدَقَٰتٖۚ فَإِذۡ لَمۡ تَفۡعَلُواْ
وَتَابَ ٱللَّهُ عَلَيۡكُمۡ فَأَقِيمُواْ ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتُواْ ٱلزَّكَوٰةَ وَأَطِيعُواْ ٱللَّهَ
وَرَسُولَهُۥۚ وَٱللَّهُ خَبِيرُۢ بِمَا تَعۡمَلُونَ ١٣ أَلَمۡ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ تَوَلَّوۡاْ
قَوۡمًا غَضِبَ ٱللَّهُ عَلَيۡهِم مَّا هُم مِّنكُمۡ وَلَا مِنۡهُمۡ وَيَحۡلِفُونَ عَلَى ٱلۡكَذِبِ
وَهُمۡ يَعۡلَمُونَ ١٤ أَعَدَّ ٱللَّهُ لَهُمۡ عَذَابٗا شَدِيدًاۖ إِنَّهُمۡ سَآءَ مَا كَانُواْ
يَعۡمَلُونَ ١٥ ٱتَّخَذُوٓاْ أَيۡمَٰنَهُمۡ جُنَّةٗ فَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِ فَلَهُمۡ
عَذَابٞ مُّهِينٞ ١٦ لَّن تُغۡنِيَ عَنۡهُمۡ أَمۡوَٰلُهُمۡ وَلَآ أَوۡلَٰدُهُم مِّنَ ٱللَّهِ
شَيۡـٔٗاۚ أُوْلَٰٓئِكَ أَصۡحَٰبُ ٱلنَّارِۖ هُمۡ فِيهَا خَٰلِدُونَ ١٧ يَوۡمَ يَبۡعَثُهُمُ
ٱللَّهُ جَمِيعٗا فَيَحۡلِفُونَ لَهُۥ كَمَا يَحۡلِفُونَ لَكُمۡ وَيَحۡسَبُونَ أَنَّهُمۡ
عَلَىٰ شَيۡءٍۚ أَلَآ إِنَّهُمۡ هُمُ ٱلۡكَٰذِبُونَ ١٨ ٱسۡتَحۡوَذَ عَلَيۡهِمُ ٱلشَّيۡطَٰنُ
فَأَنسَىٰهُمۡ ذِكۡرَ ٱللَّهِۚ أُوْلَٰٓئِكَ حِزۡبُ ٱلشَّيۡطَٰنِۚ أَلَآ إِنَّ حِزۡبَ ٱلشَّيۡطَٰنِ
هُمُ ٱلۡخَٰسِرُونَ ١٩ إِنَّ ٱلَّذِينَ يُحَآدُّونَ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥٓ أُوْلَٰٓئِكَ فِي ٱلۡأَذَلِّينَ
٢٠ كَتَبَ ٱللَّهُ لَأَغۡلِبَنَّ أَنَا۠ وَرُسُلِيٓۚ إِنَّ ٱللَّهَ قَوِيٌّ عَزِيزٞ ٢١
٥٤٤

Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Allahu është i Gjithëditur për veprat tuaja.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, nëse dëshironi të bisedoni me të Dërguarin, jepni një sadaka para bisedës suaj. Kjo është më mirë dhe më e pastër për ju! Nëse nuk keni çfarë të jepni, Allahu është Falës e Mëshirues." - Allahu i Madhëruar i urdhëroi besimtarët që, përpara bisedës me të Dërguarin e Tij, të jepnin sadaka, duke i edukuar me moralin më të mirë. Ai i mësoi se si ta nderonin dhe respektonin të Dërguarin e Tij, duke i siguruar se kjo ishte në të mirën e tyre. Kështu do t'u shtohej shpërblimi dhe do të bëhej i mundur pastrimi nga ligësitë, ndër të cilat është edhe mungesa e edukatës me Profetin (a.s.), duke i folur atij me të rëndë e pa vend.

Sadakaja përpara bisedës me Profetin (a.s.) do të shërbente si dallues të atyre që vërtet e donin diturinë dhe të mirën nga ata që thjesht llomotitnin pa ndonjë qëllim të vlefshëm. Po kështu do të mënjanoheshin ata të cilët e shqetësonin Profetin (a.s.) me fjalë të kota. Ndërsa për sa u përket atyre që kishin qëllim të mirë, por nuk kishin mundësi për sadaka, Allahu i Madhëruar nuk ua vështirësoi më tepër, por i toleroi, duke i lejuar që t'i flisnin Profetit (a.s.) edhe pa dhënë sadaka para bisedës.

Por kur besimtarët hasën vështirësi në dhënien e sadakasë para bisedës me Profetin (a.s.), Allahu i Gjithëmëshirshëm, me butësinë e Tij, ua lehtësoi çështjen, duke mos ua bërë të detyrueshme. Vërtet u anulua dhënia e sadakasë para bisedës me Profetin (a.s.), por nderimi dhe respekti ndaj Profetit mbeti përsëri detyrë e rëndësishme. Qëllimi nuk ishte vetë dhënia e sadakasë, por nderimi e respekti ndaj Profetit (a.s.).

Pastaj i Madhëruari i urdhëron besimtarët që të zbatojnë detyrimet e tjera parësore, duke thënë:

- "A keni frikë të jepni sadaka në prag të bisedës suaj? Kur ju nuk e bëtë këtë, Allahu jua pranoi pendimin. Atëherë, faleni namazin, jepni zekatin..." – Nëse nuk e kishin zbatuar urdhrin për sadaka para komunikimit me Profetin (a.s.), të mos mendonin se ishte gjë e vogël, sepse Allahu tha që jua pranoi pendimin. Ata duhej të ishin mirënjohës për faljen dhe mëshirën e Allahut, duke plotësuar porositë madhore të Tij, si falja e namazit, me rregullat e tij, dhe dhënia e zekatit atyre që Zoti i ka përcaktuar. Këto janë dy adhurime që kryhen me trup e me pasuri. Kush i kryen me përpikmëri dhe përkushtim ato, ka

përmbushur detyrimet ndaj Allahut dhe ndaj robërve të Tij.

Pas kësaj, i Madhëruari jep një urdhër gjithëpërfshirës, madje më gjithëpërfshirësin e urdhrave, duke thënë:

- "...dhe bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij." - Ky është urdhri më gjithëpërfshirës, që udhëzon për t'iu bindur Allahut dhe të Dërguarit të Tij, duke zbatuar detyrimet dhe duke iu larguar harameve, duke besuar fjalën e tyre dhe duke qëndruar brenda kufijve të vendosura nga Zoti.

Mbi të gjitha, për bazë merret sinqeriteti dhe bamirësia (*ihsan*), prandaj i Lartësuari thotë:

- "Allahu është i Gjithëditur për veprat tuaja." - Ai është i Gjithëdijshëm për çfarë veproni dhe për qëllimet tuaja. Allahu do t'ju shpërblejë sipas qëllimit që ju fshihni në zemër, sepse Ai di edhe të fshehtat e kraharorit.

Ajetet 14 – 19

14. A e dini për ata që janë miqësuar me një popull, me të cilët Allahu është zemëruar? Ata nuk janë as prej jush, as prej atyre dhe me vetëdije bëjnë betim të gënjeshtërt.
15. Allahu për ta ka përgatitur ndëshkim të ashpër. Vërtet, ajo çfarë veprojnë ata është shumë e keqe.
16. Betimet ata i përdorin si mburojë, teksa pengojnë të tjerët prej rrugës së Allahut, prandaj i pret një dënim poshtërues.
17. Para Allahut, atyre nuk do t'u bëjë dobi as pasuria e as fëmijët e tyre. Ata janë banorët e Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë.
18. Ditën kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij, sikurse ju betohen juve, duke pandehur se kështu do të arrijnë diçka. Në fakt, ata janë veç gënjeshtarë.
19. Ata i ka vënë poshtë Shejtani dhe i ka bërë që të harrojnë porositë e Allahut. Ata janë palë me Shejtanin, e dijeni se palë me Shejtanin janë vetëm të humburit.

Shpjegimi i ajeteve

- "A e dini për ata që janë miqësuar me një popull, me të cilët Allahu është zemëruar? Ata nuk janë as prej jush, as prej atyre dhe me vetëdije bëjnë betim të gënjeshtërt. Allahu për ta ka përgatitur ndëshkim të ashpër. Vërtet, ajo çfarë veprojnë ata është shumë e keqe." - Allahu i Madhëruar na përshkruan sjelljen e poshtër të munafikëve, të cilët miqësohen dhe ndihmojnë qafirët kundër besimtarëve. Ata bëjnë aleancë me jehudët, të krishterët dhe mohues të tjerë, me të cilët Zoti është zemëruar, prandaj kanë mallkimin më të rëndë të Tij. Por i Madhëruari na tregon se këta të mjerë janë të çoroditur dhe, në fakt, nuk i përkasin asnjërës palë. Ata nuk janë as me besimtarët, as me qafirët, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Ata luhaten në mëdyshje: nuk janë as me këta, as me ata. Për këdo që Allahu e shpie në humbje, ti (O Muhamed!) nuk mund të gjesh shpëtim." [Nisa 143]. Munafikët nuk janë me besimtarët me zemër dhe me vepra, sepse e brendshmja e tyre është me qafirët, edhe pse e dukshmja është me muslimanët. Por ata nuk janë as me qafirët, sepse e dukshmja e tyre është me besimtarët. Ky është përshkrimi që Allahu i Madhëruar u ka bërë atyre.

Ata betohen duke gënjyer për diçka që nuk ekziston në zemrat e tyre. Ata betohen se janë besimtarë, por ata janë të bindur se nuk janë të tillë. Atëherë, shpërblimi për këta tradhtarë, intrigantë, mohues e të

pabesë është ndëshkimi i ashpër që Allahu i Drejtë ka përgatitur për ta. Madhësinë dhe dhimbjet e këtij ndëshkimi mund t'i përshkruajë veçse Allahu i Plotfuqishëm. Ata e meritojnë këtë ndëshkim, sepse sjella e tyre është tepër e shëmtuar. Veprat e tyre e zemërojnë Allahun e Madhërishëm dhe e bëjnë të pakthyeshëm mallkimin e Tij.

- "Betimet ata i përdorin si mburojë, teksa pengojnë të tjerët prej rrugës së Allahut..." – Ata i përdorin betimet si mburojë nga qortimet e Profetit dhe besimtarëve. Kështu largohen nga rruga e Allahut, madje pengojnë edhe të tjerët nga kjo rrugë e drejtë, që të çon drejt Xhenetit të mirësisë. Ata që pengojnë nga rruga e Zotit e kanë përfundimin në Zjarr, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "...prandaj i pret një dënim poshtërues." - Ata tregohen fodullë kundrejt fesë së Allahut dhe nënshtrimit sipas Shpalljes së Tij, prandaj meritojnë dënimin poshtërues e të përhershëm, i cili asnjë çast nuk do t'u lehtësohet dhe askush nuk do të mund t'i ndihmojë apo t'u japë afat e mundësi që të kthehen e të ndryshojnë.

- "Para Allahut, atyre nuk do t'u bëjë dobi as pasuria e as fëmijët e tyre." - Pasuria e fëmijët nuk mund ta largojnë asnjë fije ndëshkimin e ahiretit dhe as nuk mund të ndihmojnë me ndopak shpërblim.

- "Ata janë banorët e Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë." - Munafikët nuk do të dalin kurrë nga zjarri i Xhehenemit. Atje do të jenë përgjithmonë.

- "Ditën kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij, sikurse ju betohen juve, duke pandehur se kështu do të arrijnë diçka. Në fakt, ata janë veç gënjeshtarë." - Ai që jeton në një mënyrë, ashtu do të vdesë. Kështu, munafikët në jetën e dynjasë u betohen besimtarëve se janë me ta. Po kështu, edhe Ditën e Gjykimit, kur Allahu t'i ringjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij ashtu sikurse u betohen besimtarëve, duke pandehur se edhe atje do t'u vlejnë betimet. Mohimi, hipokrizia dhe besimi i prishur iu nguliten në zemër, aq sa vetëmashtrohen se vërtet mund të arrijnë diçka me betimet e tyre. Por ata gënjejnë, dhe dihet që gënjeshtra nuk funksionon tek Allahu, te Njohësi i të dukshmes dhe i të fshehtave. Ky është, gjithashtu, roli i Shejtanit të mallkuar, që i ka vënë nën vete. I Mallkuari, duke ua zbukuruar veprat e tyre, i bën që të harrojnë përkujtimin e Allahut. Shejtani është armik i hapur dhe i përbetuar i njeriut, pasi synon veçse ligësinë për të, sikurse thotë i Madhëruari: "Shejtani është armiku juaj, prandaj edhe ju konsiderojeni si armik. Ai i thërret aleatët e vet për t'i bërë banues të Zjarrit." [Fatir 6].

- "Ata i ka vënë poshtë Shejtani dhe i ka bërë që të harrojnë porositë e Allahut. Ata janë palë me Shejtanin, e dijeni se palë me Shejtanin janë vetëm të humburit." - Duke harruar dhe shpërfillur porositë e Allahut, ata shkatërruan dhe humbën fenë, dynjanë, veten dhe familjet e tyre.

Ajetet 20 – 21

20. S'ka dyshim se ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ata do të jenë më të poshtëruarit.

21. Allahu e ka shkruar: "Unë dhe të dërguarit e Mi patjetër do të ngadhënjejmë!" Allahu është i Fortë e Ngadhënjyes.


Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë kërcënim dhe premtim. Kërcënimi është për të gjithë ata që shfaqin armiqësi ndaj Allahut dhe Profetit të Tij duke bërë kufër, duke mos u bindur dhe duke kryer vepra të këqija. Këta do të jenë të braktisur dhe të përçmuar. Ata kurrë nuk do të fitojnë dhe nuk do të ndihmohen.

Ndërsa premtimi e përgëzimi është për ata që besojnë Allahun dhe profetët e Tij, duke jetuar sipas porosive që profetët sollën nga Zoti i tyre. Ata janë pala e Allahut, që do të fitojnë çdo të mirë e do të shpëtojnë nga çdo e keqe. Allahu i Madhëruar premton atyre sukses, fitore dhe ndihmë në dynja dhe në ahiret. Ky është një premtim që nuk thyhet kurrë, sepse është dhënë nga më i Vërteti në premtimet e Tij, më i Fuqishmi, Krenari dhe i Pamposhturi, të Cilit nuk mund t'i shpëtojë asgjë.

Ajeti 22

22. Nuk gjen popull që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, e të dojë ata që e kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur ata të jenë prindërit, fëmijët, vëllezërit ose farefisi i tyre. Të tillët janë ata në zemrat e të cilëve Ai ka shkruar besimin, e ka forcuar me shpirt nga ana e Tij dhe do t'i futë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Aty do të jenë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me punën e tyre dhe ata janë të kënaqur me shpërblimin e Tij. Këta janë pala e Allahut. Ta dini se pala e Allahut janë të shpëtuarit.


الجزء الثامن والعشرون سورة الحشر

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ
اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ
أَوْ عَشِيرَتَهُمْ أُولَٰئِكَ كَتَبَ فِي قُلُوبِهِمُ الْإِيمَانَ وَأَيَّدَهُمْ
بِرُوحٍ مِنْهُ وَيُدْخِلُهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ
خَالِدِينَ فِيهَا رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ أُولَٰئِكَ حِزْبُ
اللَّهِ أَلَا إِنَّ حِزْبَ اللَّهِ هُمُ الْمُفْلِحُونَ ﴿٢٢﴾

سورة الحشر

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ
﴿١﴾ هُوَ الَّذِي أَخْرَجَ الَّذِينَ كَفَرُوا مِنْ أَهْلِ الْكِتَابِ مِنْ دِيَارِهِمْ
لِأَوَّلِ الْحَشْرِ مَا ظَنَنْتُمْ أَنْ يَخْرُجُوا وَظَنُّوا أَنَّهُمْ مَانِعَتُهُمْ
حُصُونُهُمْ مِنَ اللَّهِ فَأَتَاهُمُ اللَّهُ مِنْ حَيْثُ لَمْ يَحْتَسِبُوا وَقَذَفَ
فِي قُلُوبِهِمُ الرُّعْبَ يُخْرِبُونَ بُيُوتَهُمْ بِأَيْدِيهِمْ وَأَيْدِي الْمُؤْمِنِينَ
فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِي الْأَبْصَارِ ﴿٢﴾ وَلَوْلَا أَنْ كَتَبَ اللَّهُ عَلَيْهِمُ
الْجَلَاءَ لَعَذَّبَهُمْ فِي الدُّنْيَا وَلَهُمْ فِي الْآخِرَةِ عَذَابُ النَّارِ ﴿٣﴾

٥٤٥

Shpjegimi i ajetit

Nëse njeriu beson vërtet Allahun dhe Ditën e Gjykimit, patjetër që do të kryejë veprat që ia kërkon besimi i tij i sinqertë. Ndër veprat më të rëndësishme që lypsen nga besimi është dashuria për ata që besojnë Allahun dhe mbështetja e plotë e tyre, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, urrejtja dhe armiqësia ndaj atyre që nuk i nënshtrohen fesë së vërtetë, edhe sikur këta të jenë njerëzit më të afërt të tij.

Ky është besimi i vërtetë: ai që ka fryte e rezultate konkrete. Njerëzve që i arrijnë këto rezultate, Allahu ua ka shkruar imanin në zemrat e tyre, domethënë, e ka bërë atë të patundur, larg çdo pasigurie e dyshimi. Të tilla sëmundje nuk ndikojnë tek imani i tyre. Allahu i ndihmon ata me "*ruh*" prej Tij. *El Ruh* quhet shpirti, por po kështu quhet edhe Shpallja e Zotit. Pra, këta janë ata të cilët

Allahu i Madhëruar i ndihmon me Shpalljen e Tij, me forcën e saj ndikuese në shpirt. Ai i forcon e i mbështet me të gjitha mënyrat, ashtu siç përkujdeset për të zgjedhurit e Tij. Atyre u takon jeta e këndshme në këtë botë dhe Xheneti i mirësisë në botën tjetër. Në ahiret do të kenë gjithçka që ua dëshiron shpirti dhe çdo gjë që ua pëlqen syri. Për ta janë përgatitur mirësitë më të mëdha. Allahu do t'i mbulojë me kënaqësinë Tij dhe kurrë nuk do të zemërohet prej tyre. Ata do të mrekullohen nga gjithë ato privilegje të dhuruara prej Zotit të tyre. Të shumta do të jenë surprizat për këta fatlumë! Të larta do të jenë gradat ku do të ngrihen! Kurrë nuk do të ëndërrojnë atje mirësi më të mëdha se ato që u ka falur i Lavdëruari. Ata nuk do t'ia gjejnë kurrë fundin mirësive të përjetshme të Allahut.

Ndërsa ata që pretendojnë se e duan Allahun dhe e besojnë Ditën e Gjykimit, por kanë dashuri, miqësi dhe aleancë me qafirët, të cilët e shpërfillin besimin dhe shprehin armiqësi ndaj Allahut, ata nuk kanë besim të vërtetë, por thjesht pretendojnë. Çdo pretendim ka nevojë për argumente e fakte për t'u vërtetuar dhe pranuar. Thjesht të pretendosh se ke iman nuk vlen asgjë dhe nuk sjell asnjë përfitim.

Këtu përfundon tefsiri i "*Kadsemiallahu*", me ndihmën dhe udhëzimin e Allahut të Lavdëruar. Vetëm Allahut i takon lavdia e plotë e falënderimi! Ai është Zoti i botëve! Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi Muhamedin (a.s.).

Surja 59: El Hashr (medinase) 24 ajete

Ajetet 1 – 7
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Allahun e madhëron me *tesbih* gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë; Ai është Ngadhënjyesi, i Urti.

2. Është Ai që i nxori prej shtëpive të tyre ata ithtarë të Librit që nuk besuan, në kohën e dëbimit të parë. Ju nuk menduat se ata do të dilnin, ndërsa ata menduan se fortifikatat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të Allahut. Por dënimi i Allahut u erdhi andej nga nuk e prisnin, duke futur frikë në zemrat e tyre. Ai i bëri që t'i prishnin shtëpitë e veta me duart e tyre, si edhe me duart e besimtarëve. Prandaj mësoni nga kjo, o ju të mençur!

3. Sikur Allahu të mos kishte caktuar për ta shpërnguljen, do t'i ndëshkonte që në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër ata i pret dënimi i Zjarrit.

4. Këtë, për shkak se ata iu kundërvunë Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kushdo që i kundërvihet Allahut, le të jetë i sigurt se Allahu është Ndëshkimfortë.

5. Çdo palmë që e keni prerë apo e keni lënë në këmbë, e keni bërë veçse me lejen e Allahut, për t'i poshtëruar e mposhtur të prishurit!

6. Për gjithçka që Allahu i dhuroi të Dërguarit të Tij si plaçkë prej tyre, ju nuk u hipët as kuajve e as deveve, sepse është Allahu Ai që i bën të dërguarit e Vet triumfues kundër kujt të dojë. Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka.

7. Çfarëdo pasurie që Allahu ia dhuroi pa luftë të Dërguarit të Tij si plaçkë nga jobesimtarët, ajo i takon Allahut, të Dërguarit, farefisit të tij, jetimëve, të varfërve e udhëtarëve të mbetur në rrugë, që ajo të mos mbetet vetëm ndërmjet pasanikëve tuaj. Çfarë t'ju japë Pejgamberi, merreni, e çfarë t'ju ndalojë, largojuni prej saj dhe kini drojë Allahun!

Me të vërtetë, Allahu është Ndëshkues i ashpër.

Shpjegimi i ajeteve

Kjo sure quhet ndryshe surja e Benu Nadirit. Këta ishin një fis i madh jehudësh, që jetonin në njërin krah të Medinës, në kohën e Profetit (a.s.). Kur Muhamedit (a.s.) i erdhi Shpallja dhe emigroi për në Medinë, ata e mohuan dhe e refuzuan atë si profet, ashtu sikurse vepruan edhe shumë fise të tjera jehudësh. Pasi mbërriti në Medinë, Profeti (a.s.) lidhi pakt me të gjitha fiseve e jehudëve që jetonin pranë tij në Medinë. Pas ngjarjes së Bedrit, rreth gjashtë muaj ose më shumë pas saj, Profeti (a.s.) shkoi te fisi i Beni Nadirit dhe bisedoi me ta që ta ndihmonin në lidhje me kompensimin e vrasjes së dy idhujtarëve të fisit Kelabije nga Amër Ibn Umeje Ed-Damrij. [26] Ata iu përgjigjën pozitivisht kërkesës së Profetit (a.s.), duke thënë: "Po, do ta bëjmë ne, o Ebu Kasim! Mund të ulesh këtu, derisa të bëjmë gati atë që kërkon." Atëherë, ata u veçuan me njëri tjetrin dhe shejtani i mallkuar filloi t'i nxiste dhe t'u zbukuronte një veprim, i cili do të ishte dëshpërimi i tyre. Atë e meritonin dhe kështu ishte e shkruar për ta.

Duke planifikuar vrasjen e Profetit (a.s.), thanë: "Cili nga ju do ta marrë këtë rrasë

---

[26] Këtu flitet për ngjarjen e Pusit të Maunas. Kjo ndodhi në muajin *sefer* të vitit të katërt të Hixhrit. Shkurtimisht, kjo ngjarje zuri fill me vizitën e Ebu Bera Amër Ibn Malikut, që thirrej me nofkën *Mulaibul Esineh.* Pejgamberi (a.s.) e ftoi atë të pranonte Islamin, por ai për momentin nuk pranoi, ndonëse nuk u duk ndonjë refuzim i fortë prej tij. Ai i tha Pejgamberit (a.s.): "O i Dërguari i Allahut, do të ishte më mirë sikur te populli i Nexhdit të dërgoje shokët e tu, me qëllim që t'i ftojnë ata në përqafimin e fesë tënde. Unë shpresoj që ata të përgjigjen pozitivisht." Pejgamberi (a.s.) ia ktheu: "Kam frikë nga populli i Nexhdit, se mos u bën gjë atyre!" Por Ebu Berai i tha: "Dal unë dorëzanë për ta!"

Atëherë, Pejgamberi (a.s.) dërgoi te populli i Nexhdit (sipas versionit të Ibn Ishakut) dyzet burra, ndërsa në *Sahih*-un e Buhariut dhe të Muslimit thuhet se ishin shtatëdhjetë burra (sigurisht, ky variant i fundit është më i saktë). Pejgamberi (a.s.) i dërgoi ata nën komandën e El Mundhir Ibn Amrit, një nga bijtë e Benu Saides, i ashtuquajturi *El Mu'nik li Jemute.* Ata ishin nga më të mirët e muslimanëve, për sa i përket diturisë, moralit dhe fisnikërisë.

E kështu nisën marshimin, derisa mbërritën te Pusi i Maunas. Ky pus ndodhej ndërmjet trojeve të fisit Benu Amir dhe krastës së Benu Sulejmit. Pasi u vendosën aty, delegacioni i dijetarëve dërgoi Haram Ibn Melhanin, vëllain e Ummu Sulejmit, që t'i paraqiste mesazhin e Pejgamberit (a.s.) armikut të Allahut, Amir Ibn Tufejlit. Ky i fundit as nuk denjoi të shikonte letrën e dërguar nga Pejgamberi (a.s.), madje urdhëroi një nga të tijët për ta goditur lajmëtarin me shtizë pas shpine. Kur shtiza përshkoi tej e tej trupin e lajmëtarit të Pejgamberit (a.s.) dhe gjaku i tij vërshoi, lajmëtari i Pejgamberit, plot kënaqësi, tha: "Fitova, pasha Zotin e Qabes!" Menjëherë pas kësaj, armiku i Allahut u organizua shumë shpejt për të vrarë pjesën tjetër të muslimanëve. Ai thirri në ndihmë fisin e Benu Amirit, por ata nuk iu përgjigjën ftesës së tij, për shkak të besës së dhënë nga Ebu Berai, për të siguruar muslimanët. Atëherë, Amir Ibn Tufejli iu drejtua për aleancë fisit Benu Sulejm, dhe prej këtij fisi arriti të siguronte aleancën e Usejjes, Ri'alit dhe Dhekuanit. Këta u grumbulluan dhe rrethuan shokët e Pejgamberit (a.s.), të cilët luftuan si burrat, derisa u vra edhe i fundit i tyre. I vetmi që shpëtoi, ishte Kab Ibn Zejd Ibn Nexhari. Ai mundi të shpëtonte, duke u shtirë si i vrarë, i mbuluar nga plagët e rënda. Ai jetoi pas kësaj ngjarjeje, derisa u vra në betejën e Hendekut. Ndërkohë, Amër Ibn Umeje el Damri dhe Mundhir Ibn Ukbete Ibn Amiri, të cilët ishin duke ruajtur bagëtitë e muslimanëve, kur panë zogjtë që vërtiteshin sipër vendit të betejës, brofën për te fushëbeteja. Kështu, Mundhir Ibn Muhamedi zbriti dhe luftoi kundër idhujtarëve, derisa u vra bashkë me shokët e tjerë. Ndërsa Amër Ibn Umeje el Damri ra rob në duart e tyre. Kur morën vesh se ai ishte prej Mudari, Amiri ia preu balluket dhe e liroi, për shkak të betimit të nënës së tij se do të lironte një rob nga Mudari.

Amër Ibn Umeje mori rrugën e kthimit dhe, kur arriti në një vend të quajtur Karkaratu, në hyrje të një lugine, u ul poshtë hijes së një peme. Atje kaluan dy burra prej fisit Kilab dhe u ulën për të pushuar pranë tij. Kur ata i zuri gjumi, ai shkoi dhe i vrau në befasi, duke menduar se në këtë mënyrë po merrte hak për shokët e vrarë. Por kjo përbënte shkelje, sepse ata kishin qenë nën mbrojtjen që u jepte një marrëveshje paqeje me Pejgamberin (a.s.), edhe pse Amri nuk e dinte një gjë të tillë. Kur u kthye, ai e lajmëroi Pejgamberin (a.s.) për veprën e tij, ndërsa ai i tha: "Ke vrarë dy vetë, për të cilët duhet të jap shpagim."

guri, të ngjitet mbi mur dhe t'ia shtypë kokën me të?" Më fatziu i tyre, Amër Ibn Xhehashi, u hodh e tha: "E marr unë përsipër ta kryej!" Këtu ndërhyn Selam Ibn Mishkemi, që thotë: "Mos e bëni! Betohem në Allah, se atij do t'i përcillet shumë shpejt ky plan i juaj! Nuk ka dyshim se kjo do të thotë thyerje e paktit, që ne kemi bërë me të."

Ndërkohë, Profetit (a.s.) i zbriti menjëherë Shpallja prej Zotit të tij, duke e njoftuar për komplotin e jehudëve. Ai u ngrit me të shpejtë prej atij vendi dhe u nis për në Medinë.[27] Pas tij shkuan edhe sahabët, të cilët i thanë: "Ti brofe me të shpejtë që andej, kurse ne as nuk e ndiem se si u largove!". Dhe Profeti (a.s.) u kallëzoi për kurthin e jehudëve. Më pas, Profeti (a.s.) u dërgoi një ultimatum Benu Nadirëve, ku thuhej: "Largohuni nga Medina dhe nuk keni për të jetuar më kurrë aty, pranë meje! Ju jap afat dhjetë ditë. Çdokush që gjendet në të pas këtij afati, do të ekzekutohet!" Dhe, vërtet, për disa ditë me radhë, ata nisën të përgatiteshin për largimin, por, papritur, munafiku Abdullah Ibn Ubej Ibn Seluli u dërgoi atyre një mesazh, ku u thoshte: "*Mos u largoni nga vendi juaj, sepse me mua janë 2000 luftëtarë, që do të hyjnë në ndërtesat tuaja dhe janë gati të luftojnë deri në vdekje, së bashku me ju. Në ndihmë do t'ju vijnë edhe Benu Kurejdhat me aleatët e tyre nga Gatafani.*" Ky mesazh i dha shpresë udhëheqësit të Benu Nadirëve, Hujej Ibn Ahtabit, i cili i dërgoi fjalë Profetit (a.s) dhe i tha: "Ne nuk kemi për të dalë nga vendet tona! Vepro çfarë të duash!"

Pasi mori këtë mesazh, Profeti (a.s.) dhe shokët e tij thanë: "*Allahu Ekber*", dhe u nisën drejt tyre. Ishte Ali Ibn Ebu Talibi ai që mbante flamurin. Benu Nadirët, në pritje të ndihmës së aleatëve të tyre, rezistuan në fillim, duke mbrojtur muret me shigjeta e gurë. Por ndihma e premtuar nuk erdhi. Benu Kurejdhat u distancuan, ashtu si Ibn Ubeji me aleatët e tij prej Gatafani nuk e mbajtën fjalën.

Benu Nadirët qëndruan të rrethuar, derisa u dorëzuan, duke kërkuar që të largoheshin

---

[27] Ngjarja e mësipërme shënon edhe shkakun e fillimit të betejës me Benu Nadirët. Ishte Pejgamberi (a.s.) i pari që u nis në këtë luftë. Atje i mbajti të rrethuar ata gjashtë net. Gjatë kësaj kohe, në Medinë la si mëkëmbës Ibn Ummu Mektumin. Kjo ndodhi në muajin *rabiul euel*. Ibn Hazmi thotë që pikërisht në këtë periudhë u ndaluan edhe pijet alkoolike. Në fund, Benu Nadirët u dorëzuan, duke pranuar gjykimin e Pejgamberit (a.s.), i cili i lejoi ata që të largoheshin, por nuk i lejoi të merrnin me vete më shumë sesa mbanin devetë e tyre, përveç armëve.

Kështu pra, ata u dëbuan prej viseve të tyre, për shkak të prishjes së paktit me Pejgamberin (a.s.). Krerët e çifutëve, si Hujej Ibn Ahtabi dhe Selam Ibn Ebu Ukajki, shkuan drejt Hajberit, ndërsa disa të tjerë iu drejtuan Shamit. Prej tyre pranuan Islamin veçse dy vetë, Jamin Ibn Amri dhe Ebu Sad Ibn Uehbi, pasuria e të cilëve u ruajt e paprekur.

Pasurinë e fisit Benu Nadir, Pejgamberi (a.s.) ua shpërndau kryesisht muhaxhirëve të parë, sepse ajo plaçkë nuk ishte fituar në betejë. Prej ensarëve nuk mori kush nga kjo pasuri, përveç Ebu Duxhanes dhe Sehl Ibn Hunejfit, për shkak të gjendjes së tyre shumë të varfër. Në përshkrim të kësaj lufte zbriti edhe sureja Hashër, sipas versionit më të saktë të pranuar nga historianët dhe studiuesit.

Muhamed Ibn Shihab el Zuhri pretendon se ndeshja me Benu Nadirët ndodhi gjashtë muaj pas Luftës së Bedrit, por ky është një gabim dhe keqkuptim nga ana e tij. Është e sigurt dhe e padiskutueshme se beteja me Benu Nadirët ndodhi pas betejës së Uhudit. Në fakt, beteja që u zhvillua gjashtë muaj pas Luftës së Bedrit, ishte beteja me fisin Benu Kajnuka. Beteja me Benu Kurejdhat ndodhi pas Luftës së Hendekut, ndërsa Beteja e Hajberit ndodhi pas Hudejbies. Pejgamberi (a.s.) zhvilloi kundër çifutëve katër luftëra. E para ishte lufta kundër Benu Kajnuka, që ndodhi gjashtë muaj pas betejës së Bedrit. E dyta ishte beteja me Benu Nadirët, që ndodhi pas Luftës së Uhudit. E treta ishte beteja kundër Benu Kurejdhave, që ndodhi pas Luftës së Hendekut, ndërsa beteja e katërt ishte ajo Hajberit, e cila ndodhi pas Hudejbies. [Shih "*Zadul Mead*", v. 3.]

nga Medina. Profeti (a.s.) gjykoi që ata të lejoheshin të dilnin së bashku me familjet e tyre, duke marrë me vete aq plaçka, përveç armëve, sa mund të mbanin devetë e tyre. Kështu, Profeti (a.s.) mbajti pasurinë që ata lanë dhe armët e tyre.

Plaçka e luftës e marrë nga Benu Nadirët ishte e veçantë vetëm për Profetin (a.s.) dhe ishte ai që e përcaktoi ndarjen e saj në dobi të muslimanëve. Kjo pasuri nuk iu nënshtrua rregullit të zakonshëm të ndarjes së plaçkës së luftës, sepse Allahu i Lartësuar ia dhuroi atë Profetit të Tij, pa qenë e nevojshme që muslimanët të luftonin me kalorësinë dhe këmbësorinë e tyre. Jehudët u larguan në drejtim të Hajberit me në krye Hujej Ibn Ahtabin, ndërsa Profeti (a.s.) mori në sundim tokën e tyre. Gjithashtu, ata lanë edhe shumë armatim, si 50 mburoja, 50 përkrenare dhe 340 shpata. Kjo qe shkurtimisht ngjarja me Benu Nadirët, sikurse e kanë përshkruar historianë të ndryshëm.

- "Allahun e madhëron me *tesbih* gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë; Ai është Ngadhënjyesi, i Urti." - Allahu i Lartësuar e hap këtë sure duke na bërë të qartë se gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë i bën *tesbih* Atij, duke e falënderuar e lavdëruar, duke e lartësuar Atë nga çdo mangësi që nuk i shkon madhështisë së Tij, duke e adhuruar Atë me nënshtrim dhe drojë. Allahu është *El Aziz* – Krenari e Ngadhënjyesi, i Cili ka nënshtruar gjithçka dhe asgjë nuk është e pamundur për fuqinë e Tij. Askush nuk mund t'i shpëtojë pushtetit dhe sundimit të Tij. Allahu është *El Hakim* - i Urti, si në krijimin e Tij, edhe në ligjet e vendosura prej Tij. Ai nuk ka krijuar asgjë më kot dhe nuk ka bërë asnjë ligj që të mos jetë me dobi. Të gjitha veprat e Allahut janë bërë me urtësinë e Tij. E tillë ishte edhe ndihma që Allahu i Lartësuar i dhuroi Profetit (a.s.) kundër qafirëve të fisit Benu Nadir. Kur ata tradhtuan, duke e shkelur paktin me Profetin (a.s.), Allahu i nxori nga vendi i tyre, të cilin e donin dhe ishin të lidhur aq shumë:

- "Është Ai që i nxori prej shtëpive të tyre ata ithtarë të Librit që nuk besuan, në kohën e dëbimit të parë." - Ky ishte i pari dëbim, që Allahu e kishte shkruar të kryhej nga duart e Profetit të Tij, Muhamedit (a.s.). Ajeti tregon se për ta do të kishte edhe dëbime të tjera më pas. Dhe, vërtet, ashtu ndodhi, kur Profeti (a.s.) i dëboi ata edhe nga Hajberi, dëbim të cilin e përmbylli Umer Ibn Hatabi – Allahu qoftë i kënaqur me të! - i cili përzuri edhe pjesën e mbetur më vonë.

- "Ju nuk menduat se ata do të dilnin..." – Ju, muslimanë, nuk mendonit se ata do të dilnin nga fortesat e tyre, ku mbroheshin dhe ndiheshin krenarë.

- "...ndërsa ata menduan se fortifikatat e tyre do t'i mbronin prej ndëshkimit të Allahut." - Të mashtruar dhe të vetëkënaqur nga fortifikatat e tyre, ata menduan se nuk do të mposhteshin kurrë dhe askush nuk do të kishte fuqi që t'i përballonte. Por kaderi i Allahut të Lartësuar qëndron mbi të gjitha këto. Para Tij nuk mund të qëndrojë asnjë kështjellë në këmbë. Përpara Tij nuk sjell dobi fuqia dhe aftësia mbrojtëse. I Lartësuari thotë:

- "Por dënimi i Allahut u erdhi andej nga nuk e prisnin, duke futur frikë në zemrat e tyre." - Atyre u erdhi ndëshkimi nga një

portë që nuk e mendonin. Kjo portë ishte "*el rru'bu*" - frika e madhe, paniku që pushton zemrën, i cili është ushtari më i madh i Zotit, para të cilit nuk bën dobi asnjë përgatitje, asnjë fuqi dhe ashpërsi. Ata menduan se i vetmi drejtim nga i cili mund të sulmoheshin dhe të mposhteshin ishin portat e fortesave të tyre, të cilat ata i mendonin se ishin të pathyeshme. Qetësia e shpirtit të tyre ishte e lidhur ngushtë me muret e fortesave. Por dihet se kush i mbështetet çdo gjëje tjetër veç Allahut, ka për t'u befasuar dhe dëshpëruar me dështimin e tij. Edhe ata u befasuan nga kjo ndjenjë, që zbriti nga qielli dhe pushtoi tërësisht zemrat e tyre. Zemra është kalaja e durimit dhe e qëndrueshmërisë, por nëse pushtohet nga frika dhe nuk lidhet me Krijuesin e saj, ajo dobësohet dhe bie. Kështu, Allahu i Lartësuar e largoi durimin dhe kurajën e zemrave të tyre, duke ua zëvendësuar me dobësi dhe tmerr. Ky ishte armiku kryesor, që ata nuk e kishin llogaritur, prandaj u bënë vetë ata shkatërruesit e shtëpive të tyre, siç thotë Allahu i Lartësuar:

- "Ai i bëri që t'i prishnin shtëpitë e veta me duart e tyre, si edhe me duart e besimtarëve." - Profeti (a.s.) u lejoi që të merrnin me vete aq pasuri sa mbanin devetë e tyre, por ata filluan që të shkulnin pragjet, dyert dhe shumë zbukurime që ju pëlqenin, për t'i marrë me vete. Kështu, me duart e tyre, ata shkatërruan shtëpitë dhe vendbanimet e veta. Me tradhtinë ndaj Profetit (a.s.), ata hodhën hapin e parë të shkatërrimit të vetes, duke vazhduar të shkatërronin edhe vendbanimet me duart e tyre.

- "Prandaj mësoni nga kjo, o ju të mençur!" - O ju që i kuptoni drejt mesazhet dhe urtësitë e Zotit! O ju që keni logjikë të shëndoshë! Në këtë ngjarje ka mësime të shumta, nëpërmjet të cilave kuptohet urtësia e Allahut dhe veprimet e Tij madhështore në ndëshkimin e armiqve të të vërtetës dhe pasuesve të epsheve. Atyre nuk u bëri dobi krenaria apo fuqia ushtarake e mbrojtëse që kishin. Ata nuk mundën t'i shpëtonin fortifikatat e tyre prej urdhrit të Zotit. Atyre u erdhi ndëshkimi vetëm si pasojë e gjynaheve të bëra.

Dihet se, gjatë leximit të Kuranit, në konsideratë merret kuptimi gjithëpërfshirës i tekstit dhe jo shkaku specifik pse ai është sjellë. Në këtë mënyrë, këto ajete na nxisin që të nxjerrim mësime dhe të gjykojmë me drejtësi për raste të ngjashme. Ne duhet të meditojmë rreth urtësive dhe ligjeve që përmbajnë këto ajete. Duke medituar rreth tyre, mendja jonë ndriçohet e urtësohet, kurse imani ynë shtohet. Kështu, ne arrijmë të shohim qartë dhe të kuptojmë mirë çdo urtësi të sjellë nga Allahu i Lartësuar dhe të gjykojmë drejt në çdo rast të ngjashëm.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon se këta jehudë nuk e morën të gjithë ndëshkimin që meritonin, sepse Ai u bëri një lehtësim:


- "Sikur Allahu të mos kishte caktuar për ta shpërnguljen, do t'i ndëshkonte që në këtë jetë, ndërsa në jetën tjetër ata i pret dënimi i Zjarrit." - Sikur Allahu i Lartësuar të mos kishte përcaktuar dëbimin e tyre, ata do të kishin tjetër përfundim: ata do të ndëshkoheshin ashpër që në këtë dynja. Megjithatë, edhe pse nuk u goditën nga ndëshkimi që në dynja, në ahiret i pret vuajtja në zjarrin e madh të Xhehenemit, të

cilën mund ta përshkruajë veç Allahu i Lartësuar.

- "Këtë, për shkak se ata iu kundërvunë Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kushdo që i kundërvihet Allahut, le të jetë i sigurt se Allahu është Ndëshkimfortë." - Të mos u shkojë kurrë ndër mend mjeranëve se ndëshkimi i tyre për refuzimin e Profetit, madje për tentativën e vrasjes së tij, përfundoi me dëbimin nga shtëpitë. Le ta dinë se dënimi që ka përgatitur Allahu për refuzuesit e Profetit dhe të Shpalljes së Tij, të cilët nuk janë penduar, është shumë më i madh dhe më i dhimbshëm. E si mund të shpëtojnë nga dënimi në dynja dhe ahiret ata që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, shprehin armiqësi kundër tyre dhe luftojnë për të penguar besimin e drejtë?! Ky është ligji i pandryshueshëm i Zotit në lidhje me ata që kundërshtojnë palën e Tij.

- "Çdo palmë që e keni prerë apo e keni lënë në këmbë, e keni bërë veçse me lejen e Allahut..." - Gjatë kohës së rrethimit, si pjesë e strategjisë për t'i bindur që të dorëzoheshin, Profeti (a.s.) dogji disa nga hurmat dhe pemët e tyre. Nisur nga ky veprim, ata i akuzuan muslimanët për shkatërrim në tokë. Por Allahu i Lartësuar na tregon se qoftë shkatërrimi i hurmave dhe i të mbjellave, qoftë mosprekja e tyre, të gjitha kryheshin me lejen dhe urdhrin e Allahut të Lartësuar, për urtësi të shumta. Ndër këto urtësi është ajo që thotë Allahu i Lartësuar më pas:

- "...për t'i poshtëruar e mposhtur të prishurit!" – Domethënë, duke ju dhënë mundësinë që të shkatërroni hurmat dhe të


الجزء الثامن والعشرون سورة الحشر

ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمْ شَآقُّوا۟ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ ۖ وَمَن يُشَآقِّ ٱللَّهَ فَإِنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ
ٱلْعِقَابِ ﴿٤﴾ مَا قَطَعْتُم مِّن لِّينَةٍ أَوْ تَرَكْتُمُوهَا قَآئِمَةً عَلَىٰٓ
أُصُولِهَا فَبِإِذْنِ ٱللَّهِ وَلِيُخْزِىَ ٱلْفَٰسِقِينَ ﴿٥﴾ وَمَآ أَفَآءَ ٱللَّهُ
عَلَىٰ رَسُولِهِۦ مِنْهُمْ فَمَآ أَوْجَفْتُمْ عَلَيْهِ مِنْ خَيْلٍ وَلَا رِكَابٍ
وَلَٰكِنَّ ٱللَّهَ يُسَلِّطُ رُسُلَهُۥ عَلَىٰ مَن يَشَآءُ ۚ وَٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ
قَدِيرٌ ﴿٦﴾ مَّآ أَفَآءَ ٱللَّهُ عَلَىٰ رَسُولِهِۦ مِنْ أَهْلِ ٱلْقُرَىٰ فَلِلَّهِ وَلِلرَّسُولِ
وَلِذِى ٱلْقُرْبَىٰ وَٱلْيَتَٰمَىٰ وَٱلْمَسَٰكِينِ وَٱبْنِ ٱلسَّبِيلِ كَىْ لَا يَكُونَ
دُولَةًۢ بَيْنَ ٱلْأَغْنِيَآءِ مِنكُمْ ۚ وَمَآ ءَاتَىٰكُمُ ٱلرَّسُولُ فَخُذُوهُ
وَمَا نَهَىٰكُمْ عَنْهُ فَٱنتَهُوا۟ ۚ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۖ إِنَّ ٱللَّهَ شَدِيدُ ٱلْعِقَابِ
﴿٧﴾ لِلْفُقَرَآءِ ٱلْمُهَٰجِرِينَ ٱلَّذِينَ أُخْرِجُوا۟ مِن دِيَٰرِهِمْ وَأَمْوَٰلِهِمْ
يَبْتَغُونَ فَضْلًا مِّنَ ٱللَّهِ وَرِضْوَٰنًا وَيَنصُرُونَ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥٓ ۚ
أُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلصَّٰدِقُونَ ﴿٨﴾ وَٱلَّذِينَ تَبَوَّءُو ٱلدَّارَ وَٱلْإِيمَٰنَ مِن
قَبْلِهِمْ يُحِبُّونَ مَنْ هَاجَرَ إِلَيْهِمْ وَلَا يَجِدُونَ فِى صُدُورِهِمْ
حَاجَةً مِّمَّآ أُوتُوا۟ وَيُؤْثِرُونَ عَلَىٰٓ أَنفُسِهِمْ وَلَوْ كَانَ بِهِمْ خَصَاصَةٌ ۚ
وَمَن يُوقَ شُحَّ نَفْسِهِۦ فَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُفْلِحُونَ ﴿٩﴾
٥٤٦

mbjellat e tyre, Allahu i Lartësuar bëri që ata të ndienin dhimbjen, poshtërimin dhe përçmimin që në këtë dynja. Kjo strategji bëri që ata të kuptonin paaftësinë e plotë të tyre për të mbrojtur atë çka zotëronin, që ishte baza e fuqisë së tyre. Kjo ishte gjendja e fisit Benu Nadir dhe ndëshkimi që Allahu i Lartësuar u dha që në dynja.

Në vijim, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Për gjithçka që Allahu i dhuroi të Dërguarit të Tij si plaçkë prej tyre, ju nuk u hipët as kuajve e as deveve..." – Për pasurinë e Benu Nadirëve, që Allahu i Madhëruar ia mundësoi Profetit të Tij, ju, o muslimanë, nuk luftuat dhe nuk u munduat për ta fituar. Ju nuk u hipët kuajve dhe as luftuat me shpatat tuaja për ta arritur atë, pasi ishte Allahu i Lartësuar Ai i Cili futi frikën në zemrat e tyre, duke e lëshuar

kështu ndër këmbët e Profetit të Tij të gjithë pasurinë që ata lanë, lehtësisht dhe pa luftë.

- **"...sepse është Allahu Ai që i bën të dërguarit e Vet triumfues kundër kujt të dojë. Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka."** - Allahu i Lartësuar është i Plotfuqishëm dhe asgjë nuk është e pamundur për Të. Të gjithë të tjerët, që mbahen për të fortë, janë fare të dobët dhe të përulur para Tij.

"*El fej'u*", në terminologjinë juridike, quhet çdo lloj pasurie e qafirëve e marrë me të drejtë dhe pa luftë. Nga ana gjuhësore, "*el fej'u*" do të thotë "plaçkë e kthyer". E tillë ishte edhe pasuria që braktisën jehudët nga frika e muslimanëve. Ajo u hoq nga duart e qafirëve, të cilët nuk e meritonin, dhe iu kthye muslimanëve, të cilët ishin më të denjë për të. Ky gjykim është gjithëpërfshirës dhe i vlefshëm për të gjitha kohërat.

- "Çfarëdo pasurie që Allahu ia dhuroi pa luftë të Dërguarit të Tij si plaçkë nga jobesimtarët, ajo i takon Allahut, të Dërguarit, farefisit të tij, jetimëve, të varfërve e udhëtarëve të mbetur në rrugë..." - Ky gjykim është i njëjtë si për kohën kur ishte Profeti (a.s.), po ashtu edhe për kohërat pas tij, për ata që udhëheqin umetin. Në suren Enfal është një ajet i ngjashëm me këtë, që thotë: "Ta dini se, çfarëdo që fitoni si plaçkë lufte, një e pesta i takon Allahut, të Dërguarit dhe farefisit të tij, jetimëve, të varfërve dhe udhëtarit që ka ngelur në rrugë, nëse besoni Allahun dhe Shpalljen që ia kemi dhënë robit Tonë në ditën e fitores, atë ditë kur u ndeshën dy ushtritë. Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka."

Kështu, *el fej'u* ndahet në pesë pjesë:

- 1/5 i takon Allahut dhe të Dërguarit të Tij, pasuri kjo e cila shpenzohet për dobi të përgjithshme dhe për shërbimet e muslimanëve.
- 1/5 shkon për farefisin e Profetit (a.s.), të cilët janë Benu Hashimët dhe Benu Mutalibët. Kjo pasuri shpërndahet në mënyrë të barabartë mes meshkujve dhe femrave të këtyre fiseve. Benu Mutalibët trajtuar ashtu si Benu Hashimët, për sa i përket meritës së përfitimit nga "*el fej'u*" dhe plaçka e luftës, ndryshe nga Benu Abdu-Menafët, të cilët nuk përfshihen në një të pestën. Ky ndryshim u bë për shkak se në kohën kur Kurejshët bojkotuan tërësisht Benu Hashimët për tri vite rresht, fisi Benu Mutalib u bashkua me Benu Hashimët, ndryshe nga të tjerët. Vetë Profeti (a.s.) ka thënë në lidhje me Benu Mutalibët: "Ata nuk më braktisën mua as në kohën e injorancës paraislamike, as në Islam!"
- 1/5 u shpërndahet të varfërve dhe jetimëve. Jetim konsiderohet ai që ka humbur babain dhe që nuk ka arritur moshën e pjekurisë.
- 1/5 u jepet nevojtarëve, të cilët punojnë, por nuk nxjerrin aq sa u mjafton.
- 1/5 u takon udhëtarëve të cilët kanë mbetur në mes të rrugës, larg vendit të tyre, pa pasuri dhe pa mundësi për t'u kthyer.

Allahu i Lartësuar e përcaktoi një ndarje të tillë, me qëllim që:

- "...që ajo të mos mbetet vetëm ndërmjet pasanikëve tuaj." - Që pasuritë të mos bëhen pronë vetëm e pasanikëve. Nëse Allahu, me urtësinë dhe mëshirën e Tij, nuk do të vendoste këtë rregull, atëherë pasuritë do të vërtiteshin vetëm në duart e pasanikëve të fuqishëm, ndërsa të dobëtit nuk do të merrnin kurrë ndonjë gjë. Një

padrejtësi e tillë në shpërndarjen e pasurive do të ishte një shkatërrim, që veç Allahu e di. Zbatimi i urdhrave hyjnorë sjell mirësi dhe begati të panumërta, prandaj Allahu thotë më pas:


- "Çfarë t'ju japë Pejgamberi, merreni, e çfarë t'ju ndalojë, largojuni prej saj dhe kini drojë Allahun!" – Ky urdhër përfshin themelet e fesë dhe degëzimet e saj, anën e dukshme dhe anën e fshehur të dispozitave të Allahut të Lartësuar. Me fjalë të tjera, çdo gjë që ka urdhëruar e bërë ligj Profeti (a.s.) është e detyrueshme për robërit që ta pranojnë dhe zbatojnë atë me përpikmëri. Kundërshtimi i tij është kategorikisht i ndaluar. Fjala e Profetit (a.s.) dhe ligjvënia e tij konsiderohen njëlloj si fjala dhe ligjvënia e Allahut, sepse Profeti (a.s.) nuk ka folur dhe vendosur kurrë nga vetja e tij. Gjithçka që ai ka folur dhe vendosur ka ardhur si Shpallje nga Allahu i Madhëruar. Askujt nuk i lejohet dhe nuk i justifikohet shpërfillja ose braktisja e udhëzimeve të Profetit (a.s.). Nuk lejohet, gjithashtu, t'i jepet përparësi fjalës së asnjë njeriu, kushdo qoftë ai, ndaj fjalës së Profetit (a.s.).

Pastaj Allahu i Lartësuar urdhëron për *takua* ndaj Tij, nëpërmjet të cilës rregullohen dhe persosen zemrat e njerëzve, arrihet lumturia në dynja dhe ahiret. Kush ka arritur devotshmërinë ndaj Zotit, ka bërë të vetën lumturinë e përjetshme dhe fitoren më të madhe. Ndërsa ai që cenon ose shpërfill devotshmërinë ndaj Allahut, është duke ecur drejt dëshpërimit të përjetshëm dhe ndëshkimit të pafundëm. I Lartësuari thotë:

- "Me të vërtetë, Allahu është Ndëshkues i ashpër." - Allahu është ndëshkues i ashpër për ata që nuk kujdesen për *takua*-n, por rendin pas dëshirave të shfrenuara.

Ajetet 8 – 13

8. Ajo u takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive dhe pasurisë së tyre, për shkak se kërkonin mirësinë e kënaqësinë e Allahut dhe që të ndihmonin Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht këta janë të vërtetët!
9. Edhe atyre që përgatitën vendin dhe besimin para tyre, të cilët i duan ata që emigruan tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoks smirë për çfarë u jepet atyre. Madje ata u japin përparësi atyre para vetvetes, edhe sikur të kenë vetë nevojë të domosdoshme. Kush u ruajt prej koprracisë së vetes, ata janë të fituarit!
10. Edhe atyre që kanë ardhur më pas e thonë: "Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, që u pajisën me besim para nesh, dhe mos lejo në zemrat tona urrejtje ndaj atyre që besojnë! Zoti ynë, Ti je i Butë e Mëshirues!"
11. A nuk e di se ata që u bënë munafikë, u thanë vëllezërve të vet nga ithtarët e Librit, që nuk besojnë: "Nëse ju dëboheni, edhe ne do të dalim me ju! Gjithashtu, për çështjen tuaj, ne nuk do t'i bindemi askujt! Nëse luftoheni prej dikujt, të jeni të sigurt se ne do t'ju ndihmojmë!" Por Allahu dëshmon se ata janë gënjeshtarë!
12. Nëse ata do të dëbohen, këta nuk do të dalin së bashku me ata, dhe sikur ata të luftohen, këta nuk do t'i ndihmojnë. Por edhe sikur t'i ndihmojnë, shpejt do të kthejnë shpinën, e kështu miqtë e tyre do të mbeten pa ndihmë.
13. Ju, në zemrat e tyre, jeni frikë më e madhe se Allahu. Kjo për shkak se ata janë popull që nuk kuptojnë.


سُورَةُ الحَشر الجزء الثامن والعشرون
وَٱلَّذِينَ جَآءُو مِنۢ بَعۡدِهِمۡ يَقُولُونَ رَبَّنَا ٱغۡفِرۡ لَنَا وَلِإِخۡوَٰنِنَا
ٱلَّذِينَ سَبَقُونَا بِٱلۡإِيمَٰنِ وَلَا تَجۡعَلۡ فِي قُلُوبِنَا غِلّٗا لِّلَّذِينَ
ءَامَنُواْ رَبَّنَآ إِنَّكَ رَءُوفٞ رَّحِيمٌ ١٠ أَلَمۡ تَرَ إِلَى ٱلَّذِينَ
نَافَقُواْ يَقُولُونَ لِإِخۡوَٰنِهِمُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ مِنۡ أَهۡلِ ٱلۡكِتَٰبِ
لَئِنۡ أُخۡرِجۡتُمۡ لَنَخۡرُجَنَّ مَعَكُمۡ وَلَا نُطِيعُ فِيكُمۡ أَحَدًا أَبَدٗا
وَإِن قُوتِلۡتُمۡ لَنَنصُرَنَّكُمۡ وَٱللَّهُ يَشۡهَدُ إِنَّهُمۡ لَكَٰذِبُونَ
١١ لَئِنۡ أُخۡرِجُواْ لَا يَخۡرُجُونَ مَعَهُمۡ وَلَئِن قُوتِلُواْ لَا يَنصُرُونَهُمۡ
وَلَئِن نَّصَرُوهُمۡ لَيُوَلُّنَّ ٱلۡأَدۡبَٰرَ ثُمَّ لَا يُنصَرُونَ ١٢ لَأَنتُمۡ
أَشَدُّ رَهۡبَةٗ فِي صُدُورِهِم مِّنَ ٱللَّهِۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ قَوۡمٞ
لَّا يَفۡقَهُونَ ١٣ لَا يُقَٰتِلُونَكُمۡ جَمِيعًا إِلَّا فِي قُرٗى مُّحَصَّنَةٍ
أَوۡ مِن وَرَآءِ جُدُرِۭۚ بَأۡسُهُم بَيۡنَهُمۡ شَدِيدٞۚ تَحۡسَبُهُمۡ جَمِيعٗا
وَقُلُوبُهُمۡ شَتَّىٰۚ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ قَوۡمٞ لَّا يَعۡقِلُونَ ١٤ كَمَثَلِ
ٱلَّذِينَ مِن قَبۡلِهِمۡ قَرِيبٗاۖ ذَاقُواْ وَبَالَ أَمۡرِهِمۡ وَلَهُمۡ عَذَابٌ
أَلِيمٞ ١٥ كَمَثَلِ ٱلشَّيۡطَٰنِ إِذۡ قَالَ لِلۡإِنسَٰنِ ٱكۡفُرۡ فَلَمَّا
كَفَرَ قَالَ إِنِّي بَرِيٓءٞ مِّنكَ إِنِّيٓ أَخَافُ ٱللَّهَ رَبَّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ١٦
٥٤٧

Shpjegimi i ajeteve

Në vijim, Allahu i Lartësuar na tregon arsyen pse u përcaktoi kategorive të mësipërme pjesë nga *el fej'u*:

- **"Ajo u takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive dhe pasurisë së tyre, për shkak se kërkonin mirësinë e kënaqësinë e Allahut dhe që të ndihmonin Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht këta janë të vërtetët!"** - Muhaxhirët ishin ata të cilët braktisën çdo gjë të dashur në atdheun e tyre. Ata u ndanë nga të afërmit e tyre dhe lanë çdo pasuri që zotëronin, për hir të Allahut dhe në ndihmë të fesë së Tij. Motivi i këtij emigrimi ishin dashuria për Allahun dhe Profetin dhe bindja ndaj tyre. Pikërisht këta janë njerëzit që kanë besim të vërtetë, të cilët kryejnë vepra sipas këtij besimi. Muhaxhirët e vërtetuan imanin që kishin në zemër me vepra të mira dhe të sinqerta dhe me adhurime të vështira, ndryshe nga ata që, edhe pse shtireshin sikur besonin, nuk e vërtetonin atë nëpërmjet xhihadit, hixhretit dhe adhurime të tjera.

- **"Edhe atyre që përgatitën vendin dhe besimin para tyre..."** – Këta ishin ensarët, fiset Eus dhe Hazrexh në Medinë, të cilët e besuan Allahun dhe Profetin e Tij me bindje të plotë, me dashuri dhe zgjedhje të lirë. Ata e strehuan Profetin (a.s.) dhe i siguruan mbrojtje kundër çdo të kuqi e të ziu. Ata përgatitën vendin e hixhretit dhe djepin e imanit, ku do të mbërrinin dhe strehoheshin besimtarët nga Meka. Ai do të bëhej atdheu i çdo muhaxhiri dhe vendstrehimi i çdo muslimani, kur të gjitha të tjerat ishin vende armike, idhujtarie dhe ligësie. Kështu, muhaxhirët u mbështetën dhe u vëllazëruan me ensarët, ndihmuesit e fesë së Allahut në Medinë, derisa Islami u fuqizua dhe u përhap gjerësisht, duke çliruar zemrat e njerëzve me diturinë, imanin dhe Kuranin dhe duke çliruar popujt me forcën e tij nga çdo tiran arrogant e idhujtar.

Ndër cilësitë më të spikatura dhe përshkrimet më të bukura që Allahu i Lartësuar u ka bërë ensarëve të Medinës është:

- **"...i duan ata që emigruan tek ata..."** - Për shkak të dashurisë së tyre të plotë për Allahun dhe Profetin e Tij, ata deshën edhe të dashurit e Allahut dhe të Profetit, deshën ata që ndihmuan fenë e Tij.

- **"...nuk ndiejnë në gjoks smirë për çfarë u jepet atyre."** - Ata nuk i kishin smirë muhaxhirët për mirësitë që Zoti iu fali në

mënyrë të posaçme. Zemrat e tyre ishin të shëndetshme dhe të pastra nga sëmundjet e smirës, urrejtjes, përçmimit etj.

Kjo tregon se muhaxhirët ishin në gradë më të lartë se ensarët, sepse Allahu i Lartësuar i përmend ata të parët dhe na bëri të ditur se ensarët nuk ndiheshin keq për mirësitë me të cilat Ai i dalloi muhaxhirët. Allahu i Lartësuar u dhuroi muhaxhirëve veçori të shumta, të cilat nuk ua dha ensarëve dhe askujt tjetër. Arsyeja ishte se ata bënë dy vepra madhështore: ata ndihmuan fenë e Allahut dhe bënë hixhret për hir të Tij.

- "Madje ata u japin përparësi atyre para vetvetes, edhe sikur të kenë vetë nevojë të domosdoshme." – Një cilësi tjetër e ensarëve, që i ngriti mbi të tjerët, ishte altruizmi i tyre, grada më e lartë e bamirësisë dhe bujarisë. Kjo cilësi shfaqet duke u dhënë të tjerëve pasurinë tënde më të çmuar dhe gjërat më të dashura, madje edhe duke privuar veten nga nevojat e domosdoshme, vetëm për një qëllim të lartë: "Dashuria për hir të Allahut". Sigurisht, këtë cilësi e kanë vetëm ata që janë të pajisur me moral të lartë dhe motivohen nga një qëllim i madh. Dashuria për Allahun e Lartësuar në zemrat e ensarëve ishte më parësore kundrejt dëshirave të nefsit të tyre. Për këtë dëshmon edhe historia e ensarit, për shkak të të cilit u shpallën këto ajete. Ai, për të nderuar mikun e tij, sakrifikoi ushqimin e familjes dhe fëmijëve të tij. Kështu, në përfundim, ata fjetën të gjithë të uritur, veç për të kënaqur mysafirin e tyre." Altruizmi është e kundërta e koprracisë dhe egoizmit. Allahu i Lartësuar thotë më pas:

- "Kush u ruajt prej koprracisë së vetes, ata janë të fituarit!" - Të ruhesh nga koprracia e vetes do të thotë të ruhesh nga koprracia ndaj zbatimit të detyrimeve. Kështu, ai që e ruan veten nga koprracia, ai bindet ndaj urdhrave të Allahut dhe Profetit, madje i zbaton ato me bindje e nënshtrim, me gjoks të zgjeruar dhe të mbushur me kënaqësi. Gjithashtu, ai bindet për lënien e çdo gjëje të ndaluar nga Allahu i Lartësuar, edhe nëse ajo gjë është e dashur për nefsin e tij. Me një shpirt të tillë të edukuar dhe të nënshtruar, arrihet suksesi dhe mirësia dhe largohet dështimi dhe ligësia. Ndryshe ndodh me ata që nuk e kanë shtypur koprracinë e vetes. Këta janë sprovuar me lakmi e pangopësi, nga buron çdo e keqe.

Në këto ajete, Allahu i Madhëruar përshkruan gradën e sahabëve të nderuar, udhëheqësve dhe bartësve të parë të kësaj feje, të cilët u stolisën me virtyte të larta, të cilat i bënë të pakapshëm nga brezat pasardhës. Ata, gjithashtu, u lartësuan mbi të gjithë shokët e profetëve të parë. Ata u bënë besimtarët më të dalluar, krerët e të gjithë muslimanëve dhe imamët e të devotshmëve. Mjafton si nderim për ata që erdhën pas tyre që të ishin ndjekës të rrugës së sahabëve. Allahu i Lartësuar thotë për brezin që erdhi pas sahabëve, i cili ndoqi të njëjtin udhëzim dhe u stolis me të njëjtat virtyte:

- "Edhe atyre që kanë ardhur më pas e thonë..." - Brezi që erdhi pas muhaxhirëve dhe ensarëve, duke këshilluar vetveten dhe të gjithë besimtarët, luteshin e thoshin:

- "Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, që u pajisën me besim para nesh, dhe mos lejo në zemrat tona urrejtje ndaj atyre që

besojnë!" - Kjo është një *dua* e të gjithë besimtarëvë, qofshin nga të parët, qofshin nga të mëvonshmit.

Një nga dobitë më të mëdha të imanit është që besimtarët luten për njëri-tjetrin, për shkak të lidhjes së fortë të imanit mes tyre. Ata janë vëllezër në fe dhe kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit. Ndër detyrimet më kryesore të kësaj vëllazërie është dashuria dhe lutja për njëri-tjetrin. Allahu i Lartësuar përmend lutjen për pastrimin e zemrës nga urrejtja, pasi në zemrën e besimtarëve nuk duhet të ketë asnjë thërrmijë urrejtjeje për vëllezërit e tyre besimtarë. Duke u lutur për pastrimin e zemrës nga urrejtja për besimtarët, sado e vogël qoftë ajo, ata njëkohësisht janë lutur që zemrat e tyre të mbushen me dashuri, miqësi, dhe mirësi kundrejt vëllezërve të tyre muslimanë. Në këtë mënyrë, ata gjithmonë do të dëshirojnë të mirën dhe do të këshillojnë njëri tjetrin për punë të mira dhe durim. Kështu do të përpiqen të përmbushin të gjitha detyrimet vëllazërore të ndërsjellta.

Allahu i Lartësuar e përshkroi brezin pas sahabëve (*tabi'in*-ët) si pasues të të njëjtit iman me sahabët, pasi ata luteshin: "O Zoti ynë, na fal neve dhe vëllezërit tanë që na prinë në iman!" Me fjalë të tjera, ky brez që erdhi pas sahabëve ishin pasues të denjë dhe rigoroz të fesë së sahabëve, në themelin dhe degëzimet e saj. Këta janë ata të cilët quhen "*Ehlu Suneh uel Xhema'a*" – "Pasues të Sunetit dhe xhematit të muslimanëve", sepse ata i plotësonin më së miri cilësitë e përmendura në ajet.

Allahu i Madhëruar tregon se ata luteshin për falje gjynahesh për veten e tyre dhe për besimtarët. Ata e pranonin se ishin gabimtarë ndaj Allahut të Lartësuar, por kërkonin falje si për veten, edhe për vëllezërit e tyre. Ata përpiqeshin shumë që të pastronin zemrat e tyre nga çdo lloj sëmundjeje dhe urrejtjeje për vëllezërit muslimanë dhe kultivonin në zemra veçse dashurinë për njëri tjetrin, për hir të besimit. Ata zbatonin porosinë e Profetit (a.s.), që thoshte: "Nuk beson askush prej jush, derisa të dojë për vëllain e vet atë që do për veten e tij!". Ata gjithmonë këshillonin njëri tjetrin dhe i dëshironin të mirën vëllait, qoftë kur ishte i pranishëm, qoftë kur mungonte, qoftë kur ishte i gjallë, qoftë kur ishte i vdekur. Nga ajeti mësojmë se këto që u përmendën janë disa nga detyrimet e muslimanëve ndaj njëri tjetrit.

- **"Zoti ynë, Ti je i Butë e Mëshirues!"** - Lutja e tyre mbyllet me dy emra të mrekullueshëm të Allahut të Lartësuar, që tregojnë mëshirën e plotë të Allahut të Madhëruar, butësinë e Tij të papërshkrueshme për besimtarët dhe bamirësinë e Tij të madhe ndaj tyre. Ndër mirësitë më të mëdha, madje më e madhja, ishte pajisja e tyre me iman dhe me forcën e mjaftueshme për të punuar sipas tij. Ai u dha sukses atyre për të plotësuar si të drejtat e Allahut të Lartësuar, ashtu edhe përgjegjësitë kundrejt robërve të Tij, dhe në mënyrë të veçantë kundrejt besimtarëve. Këto tri grupe, pra, muhaxhirët, ensarët dhe brezi pas tyre ishin ata që meritonin të merrnin pjesë prej *el fej'u*-t, që shpenzohet në dobi të Islamit dhe muslimanëve. Këta ishin njerëzit më të zgjedhur. Zoti na bëftë prej tyre, me mirësinë dhe bujarinë e Tij!

- "A nuk e di se ata që u bënë munafikë, u thanë vëllezërve të vet nga ithtarët e Librit, që nuk besojnë..." - Në vijim, Allahu i

Lartësuar na tregon për gjendjen e çuditshme të munafikëve, të cilët u jepnin kurajo ithtarëve të Librit, vëllezërve të tyre në kufër. Ata u jepnin besën se do t'i ndihmonin në luftën kundër muslimanëve, duke u thënë:

- **"Nëse ju dëboheni, edhe ne do të dalim me ju! Gjithashtu, për çështjen tuaj, ne nuk do t'i bindemi askujt!"** - Ne nuk kemi për t'iu bindur askujt që na pengon nga aleanca me ju! Ne nuk na ndal asgjë në rrugën tonë për të qenë krahu juaj! Ne nuk i frikësohemi asnjë rreziku, madje:

- **"Nëse luftoheni prej dikujt, të jeni të sigurt se ne do t'ju ndihmojmë! Por Allahu dëshmon se ata janë gënjeshtarë!"** - Por Allahu i Lartësuar dëshmon se këto premtime ishin të gënjeshtërta, duke mashtruar kështu vëllezërit e tyre në kufër. Sidoqoftë, pabesia nuk është ndonjë gjë e madhe, kur bëhet fjalë për ata zullumqarë. Pabesia është cilësia e tyre dalluese, ndërsa mburrja dhe arroganca janë bashkëshoqëruese të tyre. E vërteta është se ata janë frikacakë të përhershëm. Allahu i Lartësuar njoftoi për pabesinë e tyre para se ajo të ndodhte, dhe gjithçka ndodhi ashtu sikurse Ai e përshkroi:

- "Nëse ata do të dëbohen, këta nuk do të dalin së bashku me ata, dhe sikur ata të luftohen, këta nuk do t'i ndihmojnë." - Nëse jehudët do të dëbohen nga vendbanimet e tyre, munafikët nuk kanë për t'i ndjekur pas, ashtu sikurse iu betuan me mendjemadhësi. Ata nuk do të dalin as të luftojnë për aleatët e tyre, sepse dashuria që kanë për pasurinë dhe tokën e tyre është më e madhe se premtimet boshe, të lëshuara nga arroganca. Ata i mbizotëron nga frika, prandaj do të jenë të dështuar.

Në fakt, munafikët i tradhtuan vëllezërit e tyre në kufër në momentet më të vështira, kur kishin nevojë për ta.

- **"Por edhe sikur t'i ndihmojnë, shpejt do të kthejnë shpinën, e kështu miqtë e tyre do të mbeten pa ndihmë."** - Edhe sikur të mendohej që munafikët të dilnin në luftë së bashku me aleatët e tyre, shumë shpejt ata do të dezertonin nga beteja dhe kurrë nuk do të fitonin. Allahu i Lartësuar kurrë nuk do t'ua jepte fitoren atyre frikacakëve. Shkakun për këtë përfundim e sqaron Allahu i Lartësuar kur thotë:

- **"Ju, në zemrat e tyre, jeni frikë më e madhe se Allahu."** – Frika e tyre ndaj jush ishte më e madhe sesa frika ndaj Zotit. Ata iu frikësuan më tepër krijesave, të cilët nuk zotërojnë për veten dhe për të tjerët as dobi e as dëm, sesa Krijuesit, në dorën e të Cilit janë dëmi dhe dobia, dhënia dhe privimi.

- "Kjo për shkak se ata janë popull që nuk kuptojnë." - Ata nuk logjikojnë drejt dhe nuk e njohin realitetin e gjërave. Ata nuk arrijnë të shohin përfundimin e çështjeve.

Aftësia e të gjykuarit drejt dhe të vështruarit saktë të çështjeve është e lidhur ngushtë me frikërespektin ndaj Krijuesit, shpresën në premtimin e Tij dhe dashurinë për Të. Ata që i japin përparësi këtyre ndjenjave kundrejt çdo gjëje tjetër, ata do të pajisen me urtësi të madhe dhe aftësi gjykimi të drejtë.

Ajetet 14 – 17

14. Ata, të gjithë së bashku, nuk kanë guxim t'ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose pas mureve. Pasiguria mes tyre është e madhe. Të duket sikur janë të bashkuar, por në fakt janë me zemra të përçara, sepse janë njerëz që nuk logjikojnë.
15. Ashtu si populli jo shumë larg më parë, të cilët vuajtën pasojat e veprimeve të tyre, edhe ata do të kenë një dënim të rëndë.
16. Ata i përngjajnë Shejtanit, që i thotë njeriut: "Moho fenë!", e kur ky mohon, ai tërhiqet duke thënë: "Unë distancohem prej teje, se unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë!"
17. Dhe kështu, përfundimi i të dy palëve është në Zjarr, ku do të jenë përgjithmonë. Ky është ndëshkimi i zullumqarëve!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ata, të gjithë së bashku, nuk kanë guxim t'ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose pas mureve." – Kuptimi: Edhe kur grumbullohen bashkë në ushtri të organizuara, ata nuk janë të qëndrueshëm kundër jush. Ata mund të luftojnë me ju veçse kur janë nëpër fortifikata, të mbrojtur pas mureve të tyre. Vetëm në të tilla kushte mund të bëjnë ndonjë qëndresë, duke u mbështetur te forca e mureve dhe jo në trimërinë e tyre.

Ky është një përshkrim tejet përçmues për këta frikacakë. Gjithashtu, Allahu i Madhëruar na tregon dhe për realitetin e marrëdhënieve mes tyre:

- "Pasiguria mes tyre është e madhe." – Pasiguria, frika dhe përçarja mes tyre është e madhe. Kjo ndodh jo për shkak të ndonjë mungese në trupat dhe pajisjet e tyre luftarake, por për shkak të një defekti tjetër thelbësor: mungesa e besimit dhe përçarja, siç thotë i Madhëruari:

- "Të duket sikur janë të bashkuar, por në fakt janë me zemra të përçara..." - Ti mendon se ata janë të bashkuar kur i sheh të organizuar, por, në të vërtetë, zemrat e tyre janë të përçara dhe mosbesim për njëri tjetrin. Shkak për këtë gjendje të këtyre të mjerëve është ajo që thotë Allahu i Lartësuar:

- "...sepse janë njerëz që nuk logjikojnë." - Ata nuk kanë logjikë të shëndoshë dhe nuk arsyetojnë drejt. Nëse do të ishin të mençur, do t'i jepnin përparësi asaj që është e mirë dhe më e dobishme, duke mos pranuar për veten alternativën më të keqe. Vetëm me gjykim të drejtë, të bazuar mbi dije të saktë, mbi motive të pastra, mbi një besim të sinqertë tek Allahu i Lartësuar dhe angazhim për të plotësuar çdo detyrim që rrjedh nga ky besim, mund të arrihet bashkimi i zemrave dhe forcimi i radhëve. Vetëm kështu mund të arrihet fitorja. Duke ndihmuar njëri tjetrin në punë të mira dhe devotshmëri, arrihet suksesi në çështjet e fesë dhe të dynjasë.

Në vijim, Allahu i Lartësuar na sjell një shembull tjetër për të kuptuar gjendjen e atyre ithtarëve të Librit të dëshpëruar, kundër të cilëve ndihmoi Profetin e Tij. Allahu i Madhëruar bëri që, nga dora e Profetit të Tij, ata të vuanin poshtërimin që në jetën e dynjasë. Kështu, ata të mjerë u befasuan nga pabesia e aleatëve të tyre, të cilët u premtuan ndihmë, njëlloj siç ndodhi me mohuesit kurejshë pak kohë më parë (në betejën e Bedrit). Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Ashtu si populli jo shumë larg më parë, të cilët vuajtën pasojat e veprimeve të tyre, edhe ata do të kenë një dënim të rëndë."** – Ata ngjajnë me kurejshët, kur Shejtani i mallkuar ua zbukuroi veprat e tyre.

Duke treguar se si i Mallkuari ua zbukuroi veprat e tyre, Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Shejtani ua zbukuroi veprat e këqija dhe u tha: "Askush nuk mund t'ju mposhtë ju sot, ndërsa unë do të jem mbrojtësi juaj!" Por kur dy ushtritë u përballën, ai u tërhoq prapa e tha: "Unë nuk kam të bëj me ju! Unë shoh atë që ju nuk e shihni! Unë i frikësohem Allahut. Allahu vërtet e ka ndëshkimin të ashpër!". [Enfal 48]. Kështu, ata u tradhtuan pabesisht nga aleatët, të cilët nuk u sollën asnjë ndihmë dhe nuk mundën t'i mbronin nga ndëshkimi. Kurejshët shkuan në Bedër plot fodullëk, të bindur se do të arrinin qëllimet e tyre kundër Profetit dhe besimtarëve. Por Allahu i Lartësuar e ndihmoi Profetin e Tij dhe besimtarët, duke u dhënë fitoren kundër mohuesve. Në këtë betejë u vranë krerët e qafirëve, disa u robëruan të tjerët ia mbathën. Kështu, ata korrën çfarë mbollën. Në të njëjtën mënyrë ngjau edhe me jehudët pak më vonë.

Ndërsa munafikët, të cilët tradhtuan vëllezërit e tyre jehudë, krahasohen me dikë tjetër. I Lartësuari thotë:

- **"Ata i përngjajnë Shejtanit, që i thotë njeriut: "Moho fenë!""** – Shejtani ia zbukuron kufrin njeriut dhe e fton në të. Kur njeriu i mashtruar e mohon Zotin e tij, duke nënshkruar në këtë mënyrë dëshpërimin e vet, Shejtani i mallkuar distancohet prej tij dhe nuk e ndihmon ashtu sikurse i ka premtuar. Allahu i Lartësuar thotë:


- **"...e kur ky mohon, ai tërhiqet duke thënë: "Unë distancohem prej teje, se unë i frikësohem Allahut, Zotit të gjithësisë!""** - Unë nuk kam asnjë fuqi e mundësi që të largoj ndëshkimin prej teje. Unë nuk kam asnjë fuqi e mundësi që të ofroj ndonjë të mirë.

- **"Dhe kështu, përfundimi i të dy palëve është në Zjarr, ku do të jenë përgjithmonë."** - Qoftë ftuesi, domethënë Shejtani i mallkuar, qoftë i ftuari, domethënë njeriu i cili i përgjigjet ftesës së Shejtanit, që të dy do të ndëshkohen, që të dy do të jenë përjetësisht bashkë në zjarrin e Xhehenemit. Allahu i Lartësuar thotë: "Shejtani është armiku juaj, prandaj edhe ju konsiderojeni si armik. Ai e thërret grupin e vet për t'i bërë banues të Zjarrit." [Fatir 6].

- **"Ky është ndëshkimi i zullumqarëve!"** - Ky është ndëshkimi i atyre që, së bashku bënë padrejtësi dhe së bashku mohuan të vërtetën, edhe sikur ashpërsia e ndëshkimit të jetë e ndryshme nga njëra palë te tjetra.

Kjo është sjellja e Shejtanit të mallkuar kundrejt të gjithë miqve të tij. Ai i fton dhe inkurajon vazhdimisht ata në çdo rrugë që u sjell dëm, duke i devijuar nga e vërteta. Më pas, kur ata bien në rrjetat e tij dhe ndëshkimi bëhet i pakthyeshëm, ai distancohet dhe i braktis, duke i lënë të vetëm të vuajnë ndëshkimin dhe dëshpërimin.

Ky është një paralajmërim shumë i fortë për të gjithë ata që i binden Shejtanit. Me të vërtetë, Allahu i Lartësuar na i ka bërë të ditura qëllimet e poshtra të të Mallkuarit. Gjithashtu, Ai na e ka qartësuar plotësisht përfundimin e hidhur të atyre që i binden


الجزء الثامن والعشرون سورة الحشر
فَكَانَ عَٰقِبَتَهُمَآ أَنَّهُمَا فِى ٱلنَّارِ خَٰلِدَيْنِ فِيهَا ۚ وَذَٰلِكَ جَزَٰٓؤُا۟
ٱلظَّٰلِمِينَ ﴿١٧﴾ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ ٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ وَلْتَنظُرْ نَفْسٌ
مَّا قَدَّمَتْ لِغَدٍ ۖ وَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ ۚ إِنَّ ٱللَّهَ خَبِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ﴿١٨﴾
وَلَا تَكُونُوا۟ كَٱلَّذِينَ نَسُوا۟ ٱللَّهَ فَأَنسَىٰهُمْ أَنفُسَهُمْ ۚ أُو۟لَٰٓئِكَ
هُمُ ٱلْفَٰسِقُونَ ﴿١٩﴾ لَا يَسْتَوِىٓ أَصْحَٰبُ ٱلنَّارِ وَأَصْحَٰبُ
ٱلْجَنَّةِ ۚ أَصْحَٰبُ ٱلْجَنَّةِ هُمُ ٱلْفَآئِزُونَ ﴿٢٠﴾ لَوْ أَنزَلْنَا هَٰذَا
ٱلْقُرْءَانَ عَلَىٰ جَبَلٍ لَّرَأَيْتَهُۥ خَٰشِعًا مُّتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ
ٱللَّهِ ۚ وَتِلْكَ ٱلْأَمْثَٰلُ نَضْرِبُهَا لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ
﴿٢١﴾ هُوَ ٱللَّهُ ٱلَّذِى لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ۖ عَٰلِمُ ٱلْغَيْبِ وَٱلشَّهَٰدَةِ ۖ
هُوَ ٱلرَّحْمَٰنُ ٱلرَّحِيمُ ﴿٢٢﴾ هُوَ ٱللَّهُ ٱلَّذِى لَآ إِلَٰهَ إِلَّا هُوَ ٱلْمَلِكُ
ٱلْقُدُّوسُ ٱلسَّلَٰمُ ٱلْمُؤْمِنُ ٱلْمُهَيْمِنُ ٱلْعَزِيزُ ٱلْجَبَّارُ
ٱلْمُتَكَبِّرُ ۚ سُبْحَٰنَ ٱللَّهِ عَمَّا يُشْرِكُونَ ﴿٢٣﴾ هُوَ ٱللَّهُ
ٱلْخَٰلِقُ ٱلْبَارِئُ ٱلْمُصَوِّرُ ۖ لَهُ ٱلْأَسْمَآءُ ٱلْحُسْنَىٰ ۚ يُسَبِّحُ
لَهُۥ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۖ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿٢٤﴾
سورة الممتحنة
٥٤٨

dhe pasojnë hapat e tij. Në këtë mënyrë, ata që preferojnë t'i binden Shejtanit të mallkuar, e bëjnë këtë me bindje e vetëdije të plotë, prandaj nuk kanë justifikim para Allahut të Lartësuar.

Ajetet 18 – 21

18. O ju që keni besuar, jini të devotshëm ndaj Allahut! Gjithashtu, le të shikojë njeriu se çfarë ka përgatitur për nesër! Kini drojë Allahun! Nuk ka dyshim se Allahu është i Dijshëm në detaje rreth asaj që ju bëni!

19. Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, prandaj Allahu i bëri që të harrojnë vetveten! Ata janë të degjeneruarit.

20. Nuk janë njëlloj banorët e Xhenetit me banorët e Xhehenemit! Banorët e Xhenetit janë të fituarit.

21. Sikur ta zbrisnim këtë Kuran mbi ndonjë mal, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, me qëllim që ata të mendojnë.

Shpjegimi i ajeteve

- **"O ju që keni besuar, jini të devotshëm ndaj Allahut! Gjithashtu, le të shikojë njeriu se çfarë ka përgatitur për nesër! Kini drojë Allahun! Nuk ka dyshim se Allahu është i Dijshëm në detaje rreth asaj që ju bëni!"** - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuruesit e Tij besimtarë që të kryejnë çdo punë që u dikton imani i tyre, si edhe për devotshmëri ndaj Tij, haptazi dhe fshehtazi, në të gjitha gjendjet. Sipas këtij urdhri, ata duhet të përpiqen të realizojnë sa më mirë çdo porosi të Allahut. Ata duhet të jenë gjithmonë të kujdesshëm për të ruajtur të paprekura kufijtë e vendosura nga Ai. Për këtë, ata duhet të kenë dituri të plotë për të drejtat e tyre, por edhe për përgjegjësitë që rëndojnë mbi ta. Gjithashtu, ata duhet të llogarisin vetveten vazhdimisht, duke e mbajtur atë nën mbikëqyrje të rreptë, për të vëzhguar se çfarë të mirash dhe të këqijash kanë bërë. Qëllimi kryesor i tyre duhet të jetë kënaqja e Allahut dhe arritja e lumturisë në jetën e përjetshme. Nëse ata vendosin ahiretin në plan të parë, sigurisht që do të angazhohen maksimalisht për të bërë punë të mira dhe të mbara. Nëse e përkujtojnë vazhdimisht qëndrimin para Allahut të Lartësuar, do t'u shtohet dëshira dhe vullneti për të kryer vepra të mira dhe për t'u larguar nga të këqijat. Në këtë mënyrë, ata do të pastrojnë veprat e tyre dhe do të kapërcejnë çdo pengesë që i ndalon ose devijon nga qëllimi i lartë. Ky vullnet u shtohet akoma më shumë nëse përkujtojnë

dhe binden se Allahu i Lartësuar është i Dijshëm për gjithçka që ata punojnë. Allahut nuk i fshihet asgjë prej veprave të tyre, sado të imta dhe të fshehura qofshin ato. Ai kurrë nuk ka për t'i shpërfillur dhe nuk ka për t'i lënë pa i shpërblyer për punët e tyre.

Ky ajet është një bazë e fuqishme, që e ndihmon robin në vetëkontroll dhe vetëllogaritje. Adhuruesi duhet ta kontrollojë vazhdimisht veten, në çdo mendim, fjalë apo punë që kryen. Nëse shikon mangësi dhe gabime, përpiqet seriozisht për t'u larguar prej tyre dhe për t'u penduar me sinqeritet. Ai i mbështetet e i kërkon ndihmë Zotit të tij, që ta plotësojë atë urdhër. Besimtari vazhdimisht krahason mirësitë që Allahu i Lartësuar i ka dhuruar, me mangësitë e tij. Kjo i ngjall në zemër atij turpin ndaj Allahut të Madhëruar.

- "Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, prandaj Allahu i bëri që të harrojnë vetveten! Ata janë të degjeneruarit." - Me të vërtetë nuk ka fatkeqësi më të madhe sesa kur njeriu tregohet i pakujdesshëm ndaj këtyre porosive. Kush bën një gjë të tillë iu përngjan njerëzve që harrojnë Allahun e Lartësuar, duke shpërfillur detyrimet ndaj Tij. Ata nuk i japin hakun plotësimit të të drejtave të Allahut të Lartësuar, por angazhohen tërësisht për të plotësuar dëshirat e tyre pa fre. Sidoqoftë, me këto veprime, ata nuk arrijnë kurrë sukses. Përkundrazi, ato janë shkak që Allahu i Madhëruar t'i bëjë të harrojnë mirësitë për veten e tyre. Ashtu të rrëmujshëm, ata koten pas epshit të vet, duke humbur në këtë mënyrë qetësinë dhe lumturinë në të dyja jetët. Dështimi i tyre është i pariparueshëm dhe nuk mund të përshkruhet me fjalë. Këta janë të degjeneruarit, të cilët shkelin kufijtë e Zotit të tyre, duke mos iu bindur Atij.

- "Nuk janë njëlloj banorët e Xhenetit me banorët e Xhehenemit! Banorët e Xhenetit janë të fituarit." - A janë njëlloj ata që kujdesen për t'u pajisur me devotshmëri ndaj Allahut dhe në mënyrë të vazhdueshme kontrollojnë e llogarisin veten për çfarë kanë përgatitur për të nesërmen, me ata të mjerë, të çoroditur dhe të humbur mes errësirave të ligësisë? Sigurisht që jo! Të parët meritojnë Xhenetin e mirësisë dhe jetën e lumtur, në shoqërinë e profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe punëmirëve, që Zoti i begatoi me të mira. Ndërsa ata që nuk kujtojnë Allahun, ata që shpërfillin të drejtat dhe detyrimet ndaj Tij, ata janë të dëshpëruar në dynja dhe meritojnë ndëshkimin në ahiret. Banorët e Xhenetit janë fituesit e çdo të mire dhe të shpëtuarit nga çdo e keqe. Ndërsa banorët e Zjarrit janë të humburit dhe të privuarit.

Pas qartësimit të plotë të urdhrave dhe ndalesave nga Allahu i Lartësuar, është e detyrueshme që robërit të nxitojnë në zbatimin e tyre. Nëse robërit do t'i lexonin ajetet kuranore me vëmendje dhe dëshirë për të mësuar të vërtetën dhe për t'iu nënshtruar asaj, atyre do t'u zbuteshin zemrat, edhe sikur të ishin të forta sa malet. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Sikur ta zbrisnim këtë Kuran mbi ndonjë mal, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu." – Kjo do të thotë që ndikimi i Kuranit në zemra është tepër i fuqishëm. Urdhërat dhe ndalesat që ai përmban janë gjithë urtësi. Ato i ofrojnë robit çdo mirësi dhe e ruajnë nga çdo e keqe, në formën më të plotë dhe me rrugët më të

thjeshta. Kurani e pushton lehtë zemrën. Në Librin e Allahut nuk mund të gjesh asnjë kundërthënie, vështirësi apo teprim. Ligjet e Tij mund të rregullojnë çështjet e krijesave në çdo kohë dhe vend. Çdokush gjen veten e vet në këshillat e Kuranit dhe e ndien se i drejtohen atij.

Në vijim, Allahu i Lartësuar na tregon se Ai ka sjellë shembuj në Kuran për t'u qartësuar adhuruesve të Tij hallallin, haramin dhe çdo çështje për të cilën kanë nevojë. Për këtë arsye, njerëzit duhet të meditojnë thellë rreth ajeteve të Librit të Zotit.

- "Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, me qëllim që ata të mendojnë." - Pa dyshim, meditimi mbi ajetet kuranore i hap robit thesare diturie, i sqaron atij të mirën dhe të keqen, e nxit atë drejt virtyteve më të larta dhe e shtyn që të largohet nga çdo ves i keq. Nuk ka gjë më të dobishme për robin sesa thellimi në ajetet e Kuranit.

Ajetet 22 – 24

22. Ai është Allahu, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me meritë! Ai është Njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes! Ai është Mëshirëploti, Mëshiruesi!
23. Ai është Allahu, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me meritë! Ai është Sunduesi i përgjithshëm, i Pastër nga çdo e metë, Shpëtimtari, Siguruesi, Mbikëqyrësi, Ngadhënjyesi, Mbizotëruesi, Krenari! I Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë!
24. Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi! Atij i takojnë emrat më të bukur! Atë e madhëron çfarë ka në qiej e në Tokë! Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ai është Allahu, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me meritë!" - Këto ajete të mrekullueshme përmbajnë disa nga emrat e bukur dhe cilësitë e larta të Allahut, që nxisin robin për adhurim e devotshmëri. Prej tyre nxirren shumë mësime të mëdha.

Kështu, i Lartësuari na tregon se Ai është Allahu, i Dashuri, i Adhuruari. Ai është i vetmi që meriton adhurimin. Askush tjetër nuk meriton të adhurohet bashkë me Allahun, sepse Ai është i plotë në madhështinë e Tij, gjithëpërfshirës në bujarinë, bamirësinë dhe përkujdesin që tregon ndaj krijesave. Çdo gjë që adhurohet veç Allahut është e kotë dhe nuk meriton asnjë thërrmijë adhurimi, sepse çdo gjë veç Tij është e varfër, e pafuqishme dhe e mangët. Çdo gjë tjetër, veç Allahut, nuk zotëron për veten apo për të tjerët asnjë lloj dobie dhe nuk mund të sjellë asnjë lloj dëmi. Pastaj i Lartësuari e përshkruan Veten e Vet me dituri absolute.

- "Ai është Njohësi i të fshehtës dhe të dukshmes! Ai është Mëshirëploti, Mëshiruesi!" - Allahu është *Alimul gajbi ue shehadeh* - i Gjithëditur për çdo gjë, qoftë për ato që duken dhe krijesat i dëshmojnë, qoftë për ato gjëra që nuk i sheh dhe dëshmon askush tjetër, veç Tij. Allahu është gjithashtu Mëshirëploti e Mëshiruesi. Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjallesë.

Pastaj Allahu deklaron përsëri njëshmërinë e Tij në meritën e adhurimit:

- "Ai është Allahu, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me meritë! Ai është Sunduesi i përgjithshëm, i Pastër nga çdo e metë, Shpëtimtari, Siguruesi, Mbikëqyrësi, Ngadhënjyesi, Mbizotëruesi, Krenari!" -

Allahu është i vetmi që meriton adhurimin me dashuri dhe përunjësi të plotë, sepse Ai është *El Melik* - Sunduesi i përgjithshëm, Pronari i gjithçkaje. Bota e sipërme dhe e poshtme, me banorët e shpërndarë mes tyre, të gjithë pa përjashtim, janë pronë dhe nën pushtetin e Allahut të Lartësuar. Të gjithë janë të varfër, të nënshtruar dhe nevojtarë ndaj Tij.

Allahu është *El Kuddus* - i Pastër nga çdo e metë, dhe *El Mukadesu* – i Pastërti dhe i Lartësuari nga çdo cilësi e ulët. Allahu është *Esselam* - Shpëtimtari. Ai është *El Mu'minu* – Siguruesi, Ai që garantoi vërtetësinë e profetëve të Tij dhe saktësinë e Shpalljeve që ata sollën ndër njerëz prej Tij. Ai e vërtetoi vërtetësinë dhe saktësinë e tyre me shenja të qarta, të prera dhe të pakundërshtueshme.

Allahu është *El Muhejminu* – Mbikëqyrësi. Ai është *El Azizu* - Ngadhënjyesi, Krenari dhe i Pamposhturi. Ai nënshtron gjithçka me krenarinë e Tij dhe askush nuk mund të përballet me Ngadhënjyesin. Të gjithë qëndrojnë kokulur dhe të frikësuar përpara Allahut.

Allahu është *El Xhebbar* – Mbizotëruesi, sepse pushteti i Tij madhështor ka nënshtruar dhe përfshirë të gjitha krijesat. Askush dhe asgjë nuk mund të dalë jashtë pushtetit të Tij. Ai, gjithashtu, i jep fuqi të pafuqishmit dhe i jep pasuri të varfërit.

Allahu është *El Mutekebbir* - i Madhërishmi Krenar. Atij i takon krenaria dhe madhështia. Por me gjithë krenarinë dhe madhështinë e Tij, Allahu është i pastër nga të gjitha mangësitë dhe padrejtësitë, sepse Ai është gjithmonë i drejtë.

- "I Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë!" - Allahu është i Lartësuar dhe i Pastër nga çdo e metë që ia përshkruajnë idhujtarët dhe mohuesit e shpalljeve të Tij.


- "Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi!" - Allahu është Krijuesi dhe Shpikësi i të gjitha krijesave, pa asnjë shembull paraprirës. Ai çdo krijese i dha formën e saj.

Këta tre emra kanë lidhje me krijimin, përcaktimin dhe rregullimin e çështjeve të krijesave dhe janë cilësi vetëm të Allahut të Lartësuar.

- "Atij i takojnë emrat më të bukur!" – Allahu ka shumë emra, të cilët mund t'i dijë tërësisht veçse Ai. Të gjithë emrat e Tij janë të bukur dhe tregues të cilësive më të plota dhe absolute. Në emrat dhe cilësitë e Tij nuk mund të gjesh asnjë lloj mangësie, në çdo lloj aspekti dhe këndvështrimi. Për bukurinë e tyre tregon edhe fakti që Allahu i Lartësuar i do këta emra, i do krijesat që i duan ata dhe kënaqet që adhuruesit e Tij t'i drejtohen me lutje duke e thirrur me këta emra.

- "Atë e madhëron çfarë ka në qiej e në Tokë!" - Allahu është i Plotë dhe Absolut në të gjithë emrat, përshkrimet dhe cilësitë e Tij të larta, dhe këtë e tregon fakti që gjithçka në qiej dhe në Tokë, në mënyrë të pandërprerë të vazhdueshme, është e varur dhe nevojtare për të. Gjithçka në qiej dhe në Tokë e falënderon dhe lavdëron Allahun, vetëm Atij i drejtohen për nevojat e tyre, dhe Ai u dhuron me bujarinë e Tij.

- "Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!" - Gjithçka që dëshiron Allahu të ekzistojë, do të ekzistojë, për shkak të një urtësie të madhe.


الجزء الثامن والعشرون سورة الممتحنة

بسم الله الرحمن الرحيم

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ لَا تَتَّخِذُواْ عَدُوِّي وَعَدُوَّكُمۡ أَوۡلِيَآءَ تُلۡقُونَ
إِلَيۡهِم بِٱلۡمَوَدَّةِ وَقَدۡ كَفَرُواْ بِمَا جَآءَكُم مِّنَ ٱلۡحَقِّ يُخۡرِجُونَ ٱلرَّسُولَ
وَإِيَّاكُمۡ أَن تُؤۡمِنُواْ بِٱللَّهِ رَبِّكُمۡ إِن كُنتُمۡ خَرَجۡتُمۡ جِهَٰدٗا فِي سَبِيلِي
وَٱبۡتِغَآءَ مَرۡضَاتِيۚ تُسِرُّونَ إِلَيۡهِم بِٱلۡمَوَدَّةِ وَأَنَا۠ أَعۡلَمُ بِمَآ أَخۡفَيۡتُمۡ
وَمَآ أَعۡلَنتُمۡۚ وَمَن يَفۡعَلۡهُ مِنكُمۡ فَقَدۡ ضَلَّ سَوَآءَ ٱلسَّبِيلِ ١ إِن
يَثۡقَفُوكُمۡ يَكُونُواْ لَكُمۡ أَعۡدَآءٗ وَيَبۡسُطُوٓاْ إِلَيۡكُمۡ أَيۡدِيَهُمۡ وَأَلۡسِنَتَهُم
بِٱلسُّوٓءِ وَوَدُّواْ لَوۡ تَكۡفُرُونَ ٢ لَن تَنفَعَكُمۡ أَرۡحَامُكُمۡ وَلَآ أَوۡلَٰدُكُمۡۚ
يَوۡمَ ٱلۡقِيَٰمَةِ يَفۡصِلُ بَيۡنَكُمۡۚ وَٱللَّهُ بِمَا تَعۡمَلُونَ بَصِيرٞ ٣ قَدۡ كَانَتۡ
لَكُمۡ أُسۡوَةٌ حَسَنَةٞ فِيٓ إِبۡرَٰهِيمَ وَٱلَّذِينَ مَعَهُۥٓ إِذۡ قَالُواْ لِقَوۡمِهِمۡ إِنَّا
بُرَءَٰٓؤُاْ مِنكُمۡ وَمِمَّا تَعۡبُدُونَ مِن دُونِ ٱللَّهِ كَفَرۡنَا بِكُمۡ وَبَدَا بَيۡنَنَا
وَبَيۡنَكُمُ ٱلۡعَدَٰوَةُ وَٱلۡبَغۡضَآءُ أَبَدًا حَتَّىٰ تُؤۡمِنُواْ بِٱللَّهِ وَحۡدَهُۥٓ إِلَّا قَوۡلَ
إِبۡرَٰهِيمَ لِأَبِيهِ لَأَسۡتَغۡفِرَنَّ لَكَ وَمَآ أَمۡلِكُ لَكَ مِنَ ٱللَّهِ مِن شَيۡءٖۖ
رَّبَّنَا عَلَيۡكَ تَوَكَّلۡنَا وَإِلَيۡكَ أَنَبۡنَا وَإِلَيۡكَ ٱلۡمَصِيرُ ٤ رَبَّنَا لَا تَجۡعَلۡنَا
فِتۡنَةٗ لِّلَّذِينَ كَفَرُواْ وَٱغۡفِرۡ لَنَا رَبَّنَآۖ إِنَّكَ أَنتَ ٱلۡعَزِيزُ ٱلۡحَكِيمُ ٥

٥٤٩

Këtu përfundon tefsiri i sures Hashër. Vetëm Allahut i takon lavdërimi, falënderimi, bujaria dhe mirësia!

Surja 60: El Mumtehineh (medinase) 13 ajete

Ajetet 1 – 9

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. O ju që keni besuar, mos bëni miq armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj, duke treguar dashuri ndaj tyre, kur dihet se ata mohojnë të vërtetën që ju ka ardhur. Ata kanë dëbuar të Dërguarin dhe ju vetëm se besoni Allahun, Zotin tuaj. Mos u miqësoni me ta, nëse vërtet keni dalë për hir të luftës në rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush. Ju u shprehni fshehurazi atyre miqësi, ndërsa Unë e di shumë mirë se çfarë mbani të fshehur dhe çfarë shfaqni haptazi. Çdokush prej jush që vepron kështu, ka devijuar nga rruga e drejtë.

2. Nëse ata ju mundin, ata do të jenë armiqtë tuaj e do t'ju godasin me duart dhe gjuhën e tyre. Ata do të dëshironin shumë që edhe ju të bëheshit jobesimtarë.

3. Ditën e Kijametit nuk do t'ju bëjnë dobi farefisi e as fëmijët tuaj. Allahu do të bëjë ndarjen mes jush. Allahu sheh gjithçka që ju punoni.

4. Një shembull i mirë për ju është Ibrahimi dhe ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne distancohemi prej jush dhe prej çfarë adhuroni ju veç Allahut. Ne ju mohojmë dhe armiqësia ndërmjet nesh është e hapur, derisa ju ta besoni Allahun si Një!" Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit drejtuar babait të vet: "Unë do të kërkoj falje për ty, por nuk kam asnjë mundësi për ty para Allahut!" "Zoti ynë, vetëm Ty të mbështetemi, vetëm para Teje pendohemi dhe vetëm te Ti është kthimi ynë!

5. Zoti ynë, mos na bëj sprovë të atyre që nuk besojnë dhe falna, o Zoti ynë! Ti je Ngadhënjyesi, i Urti!"

6. Vërtet, këta njerëz janë një shembull i mirë për ata që shpresojnë tek Allahu dhe Dita e Fundit. Kushdo që kthen shpinën, le ta dijë se Allahu është Jonevojtari e i Lavdishmi!

7. Ndoshta Allahu, ndërmjet jush dhe atyre me të cilët kishit armiqësi, do të vendosë miqësi. Allahu është i Plotfuqishëm. Allahu është Falës e Mëshirues.

8. Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftojnë për shkak të fesë e që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë.

9. Allahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftojnë për shkak të fesë, që ju nxjerrin prej shtëpive tuaja dhe që ndihmojnë në dëbimin tuaj. Ai ju ndalon të miqësoheni me ta. Çdokush që miqësohet me ta, është zullumqar!

Shpjegimi i ajeteve

Shumë komentues të Kuranit (Allahu i mëshiroftë!) kanë thënë se shkak për zbritjen e këtyre ajeteve të mrekullueshme u bë historia e Hatib Ibn Ebu Beltas.[28] Kur Profeti (a.s.) po përgatitej për të çliruar Mekën, Hatibi u shkroi kurejshëve, duke i njoftuar për qëllimin e Profetit (a.s.). Ai e bëri këtë veprim jo për shkak të hipokrizisë apo të ndonjë dyshimi në fe, por për shkak se familja e tij në Mekë ishte e pambrojtur, prandaj, me këtë shërbim ndaj kurejshëve, ai shpresonte të mbronte familjen e tij. Kështu, Hatibi e nisi mesazhin nëpërmjet një gruaje. Por Profeti (a.s.), që u njoftua menjëherë nga Allahu i Lartësuar për këtë veprim, dërgoi një grup burrash, të cilët e ndaluan gruan para se të mbërrinte në Mekë dhe ia morën mesazhin asaj. Profeti (a.s.) e qortoi rëndë Hatibin, i cili kërkoi ndjesë dhe paraqiti justifikimin e tij, të cilin Profeti (a.s.) e pranoi.[29]

Në këto ajete ndalohet kategorikisht afrimi, miqësimi dhe aleanca me mohuesit, idhujtarët dhe armiqtë e Islamit. Nuk lejohet shfaqja e dashurisë dhe afrimitetit me ta, sepse kjo bie ndesh me imanin e vërtetë dhe është tërësisht në kundërshtim të plotë me fenë e Ibrahimit (a.s.), të dashurit të Allahut. Ky veprim është në kundërshtim edhe me

[28] **Ngjarja e Hatib Ibn Ebu Beltas:** Pejgamberi (a.s.) urdhëroi njerëzit që të përgatiteshin për rrugë, si edhe familjen e tij që t'i bënin gati pajimet. Ebu Bekri shkoi tek e bija, Aishja, të cilën e gjeti duke përgatitur disa pajime të Pejgamberit (a.s.) – "O bija ime, – e pyeti, – a ju ka urdhëruar Pejgamberi (a.s.) që të bëni gati pajimet për udhëtim?" – "Po."– "Për ku mendon se do të niset?" – "Vallahi, nuk e di" – i tha Aisheja. Pastaj Pejgamberi (a.s.) i njoftoi njerëzit se po synonte të sulmonte Mekën, prandaj i porositi që të përgatiteshin mirë dhe të ishin në gatishmëri. Pastaj u lut: "O Allah! Bllokoi shikimet e spiunëve dhe mos lejo që lajmet të shkojnë te kurejshët, derisa t'i zëmë në befasi në vendbanimet e tyre!" Tashmë njerëzit ishin gati.
Ndërkohë, Hatib Ibn Ebu Belta shkroi një letër për kurejshët, ku i tregonte për objektivin e Pejgamberit (a.s.). Këtë letër ia dha një gruaje, të cilës i caktoi një shpërblim, nëse do t'ua dorëzonte kurejshëve. Ajo e fshehu atë në një nga gërshetat e saj, dhe u nis për rrugë. Menjëherë, Pejgamberit (a.s.) i zbriti Shpallja, që e njoftonte se çfarë kishte bërë Hatibi. Kështu, ai dërgoi Aliun dhe Zubejrin në kërkim të gruas. Sipas Ibn Ishakut, Pejgamberi (a.s.) dërgoi Aliun dhe Zubejrin, ndërsa të tjerët thonë se me ta ishte edhe El Mikdadi. Gjithsesi, Pejgamberi u tha atyre: "Keni për të marshuar, derisa të arrini në Reudatu Hah (një vend ky midis Mekës dhe Medinës, dymbëdhjetë milje nga kjo e fundit). Atje do të gjeni një grua, e cila bart me vete një mesazh për kurejshët." Ata u nisën me nxitim dhe e kapën gruan pikërisht në atë vend. Atje e ndaluan dhe i thanë: "Ti ke një letër për kurejshët?" – "Jo, – i thotë ajo, – nuk kam gjë." I kontrolluan kafshën, por nuk gjetën gjë. Atëherë, Aliu i thotë: "Betohem në Allah, se as Pejgamberi (a.s.) nuk gënjeu dhe as ne nuk po gënjejmë! Vallahi, ose do ta nxjerrësh atë letër, ose do të të zhvesh mu këtu!" Kur ajo pa se ata e kishin seriozisht, u tha: "Ktheni kokat e mos shikoni!" Kështu, ajo e nxori letrën prej flokëve të saj dhe ua dha atyre. Ata, me të shpejtë, ia dorëzuan letrën Pejgamberit (a.s.).

[29] Profeti (a.s.) e thirri Hatibin dhe i tha: "Çfarë është kjo, o Hatib?" – "Mos u nxito në gjykimin për mua, o i Dërguari i Allahut! Betohem në Allah se unë e besoj Atë dhe Pejgamberin e Tij. Kurrë nuk e kam tradhtuar Islamin dhe as nuk e kam ndryshuar fenë e Zotit! Arsyeja është se unë nuk jam kurejsh, por i ardhur në Mekë. Unë kam lënë mes tyre familje dhe fëmijë pa mbështetje. Askush nuk i mbron ata! Të gjithë këta që janë me ty kanë të afërm atje, të cilët mund t'ua mbrojnë familjet e tyre. Kështu, duke qenë se nuk kam afërsi gjaku me kurejshët, desha t'u bëja një nder, që, për shkak të tij, të më mbronin familjen." Omeri i tha Pejgamberit (a.s.): "Më lër, o i Dërguari i Allahut, t'ia heq kokën, se ai tradhtoi Allahun dhe të Dërguarin e Tij! Ai e shfaqi hipokrizinë e vet." Pejgamberi (a.s.) ia ktheu: "Por ai ka marrë pjesë në Bedër. E ku e di ti, o Omer! Ndoshta Allahu i Lartësuar i ka parë luftëtarët e Bedrit dhe ka thënë: "Bëni çfarë të doni, se unë jua kam falur të gjitha!" Duke i lotuar sytë, Omeri tha: "Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të ditur." [Shih "*Zad el Mead*", v. 3].

logjikën e pastër e të drejtë, sipas të cilës besimtarët duhet të tregojnë kujdes shumë të madh në marrëdhëniet me armiqtë e tyre. Ata duhet të jenë tepër vigjilentë, sepse dihet mirë se pala kundërshtare nuk lë mënyrë pa provuar, për të realizuar qëllimet e tyre armiqësore. Ata shfrytëzojnë çdo rast që u jepet për të dëmtuar ose shkatërruar besimtarët. Thotë Allahu i Lartësuar:

- "O ju që keni besuar..." – Kështu, Allahu iu drejtohet besimtarëve pikërisht me cilësinë e tyre të besimit, duke i orientuar në këtë mënyrë që të kryejnë çdo detyrim që u dikton imani i tyre. Ndër veprat më të rëndësishme që kërkon imani është shprehja e dashurisë, afërsisë, solidaritetit dhe aleancës me ata që përpiqen të përsosen si besimtarë, nga njëra anë, dhe distancimi, mosafrimi dhe armiqësia me ata që janë armiq të besimtarëve, nga ana tjetër. Ky është kusht themelor i besimit të vërtetë.

Atëherë, duke u nisur nga kjo shenjë dalluese e tyre, i Lartësuari thotë besimtarëve:

- "...mos bëni miq armiqtë e Mi dhe armiqtë tuaj, duke treguar dashuri ndaj tyre, kur dihet se ata mohojnë të vërtetën që ju ka ardhur." - Kurrë mos nxitoni dhe të bini në atë gradë të ulët, duke u shprehur dashuri, afrimitet dhe mbështetje qafirëve dhe idhujtarëve!

Kjo do të thotë që ne duhet të largohemi nga çdo shkak dhe rrugë që sjell një afrimitet të tillë. Nëse në zemrën e dikujt zë vend dashuria për ta, atëherë ajo, pa dyshim, do të pasohet nga solidariteti me ta. Ky veprim e nxjerr robin nga imani, duke e bërë atë njësh me mohuesit dhe duke e larguar nga besimtarët. Gjithashtu, miqësia dhe afrimiteti me qafirët është tregues i mungesës së personalitetit dhe logjkës së shëndoshë. Si është e mundur që një besimtar të miqësohet ose të ndihmojë armikun e përbetuar të tij, i cili synon veçse të keqen e tij, i cili kundërshton Zotin e tij dhe është armiku i miqve të tij, të cilët i duan të mirën, duke e këshilluar dhe ndihmuar për ta arritur atë të mirë?!

Shkak tjetër i armiqësimit me qafirët është edhe fakti që ata e mohojnë të vërtetën, të cilën besimtarët e besojnë, jetojnë sipas saj dhe e propagandojnë. Pa dyshim, nuk ka arsye më të fortë për të urryer sesa kjo. Qafirët mohojnë themelet e fesë së besimtarëve dhe pretendojnë se ata janë të humbur, jo në rrugë të drejtë dhe jo të mbështetur në fakte. Ata mohojnë të vërtetën, e cila nuk të lë asnjë dyshim në saktësinë e saj, dhe dihet mirë se çdokush që refuzon të vërtetën, nuk ka asnjë argument e fakt që të vërtetojë saktësinë e mendimit të tij. Mjafton të njohësh të vërtetën dhe e kupton qartë kotësinë e çdo mendimi që e kundërshton atë.

Përveç këtyre, muslimanët nuk duhet të harronin krimet dhe armiqësinë e mohuesve kundër Profetit (a.s.) dhe besimtarëve të tjerë. Për t'ua kujtuar këtë fakt, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ata kanë dëbuar të Dërguarin dhe ju vetëm se besoni Allahun, Zotin tuaj." - Ata ju kanë përndjekur dhe dëbuar nga vendi juaj pa asnjë të drejtë. I vetmi "krim" është se ju besoni Allahun, Zotin tuaj, ndërkohë që është detyrë për të gjitha krijesat, pa përjashtim, që synim kryesor të tyre të kenë përsosjen e adhurimit ndaj Tij.

Të gjithë duhen të përkushtohen në adhurimin ndaj Allahut të Madhëruar, sepse

Ai i krijoi, Ai i rregullon çështjet e tyre dhe përkujdeset për ta. Ai që u dhuron atyre çdo mirësi të dukshme apo të fshehur është Allahu i Lartësuar. Por mohuesit i kthejnë shpinën këtij qëllimi, i cili është detyrimi më madhor i të gjithë detyrimeve. Ndërsa besimtarët përpiqen ta plotësojnë këtë detyrim, qafirët tregojnë armiqësi duke i dëbuar nga vendet e tyre. Atëherë çfarë feje, personaliteti, logjike dhe arsyetimi i mbeten robit, nëse ai afrohet dhe miqësohet me jobesimtarët, që i kanë këto cilësi në çdo kohë dhe çdo vend?! Ata të mallkuar nuk i ndalon asgjë nga shfaqja e urrejtjes dhe armiqësisë së tyre kundrejt muslimanëve, veçse ndonjë pengesë e fortë ose frika e madhe.

- "Mos u miqësoni me ta, nëse vërtet keni dalë për hir të luftës në rrugën Time, duke kërkuar kënaqësinë Time ndaj jush." - Nëse ju vërtet keni dalë të luftoni për të ngritur lart fjalën e Allahut dhe duke synuar kënaqësinë e Allahut, atëherë plotësoni kushtet që nevojiten për këtë qëllim. Sigurisht, një nga kushtet kryesore që duhet realizuar është dashuria, miqësia dhe ndihma e të dashurve të Allahut, si edhe urrejtja e armiqësia kundër armiqve të tyre. Ky është xhihadi në rrugën e Zotit, një nga veprat më të mëdha që afron besimtarët me Zotin e tyre.

- "Ju u shprehni fshehurazi atyre miqësi, ndërsa Unë e di shumë mirë se çfarë mbani të fshehur dhe çfarë shfaqni haptazi." - Si është e mundur që ju u shprehni dashurinë, miqësinë dhe mbështetjen tuaj mohuesve të Zotit dhe të fesë së Tij, armiqve të besimtarëve, dhe pastaj mundoheni ta fshihni një gjë të tillë, ndërkohë që e dini se Allahu i Madhëruar është i Gjithëdijshëm për ato që ju fshihni dhe shfaqni hapur?! Nëse ju arrini t'ua fshini ligësitë tuaja besimtarëve, dijeni mirë se Allahut të Lartësuar nuk mund t'i fshihet asgjë. Allahu i Lartësuar, me dijen e Tij absolute, ka për t'i shpërblyer robërit për të mirat dhe të këqijat e tyre, të bëra haptazi apo fshehtazi.

- "Çdokush prej jush që vepron kështu, ka devijuar nga rruga e drejtë." - Ata që zënë miq mohuesit dhe i mbështesin ata, pas këtij qortimi nga Allahu i Lartësuar, le ta dinë se i kanë hyrë një rruge, e cila bie ndesh me fenë e Zotit, me logjikën e drejtë dhe me dinjitetin njerëzor.

Për të ngjallur urrejtjen dhe armiqësinë ndaj mohuesve, Allahu i Lartësuar u kujton besimtarëve egërsinë e mohuesve ndaj tyre:

- "Nëse ata ju mundin, ata do të jenë armiqtë tuaj e do t'ju godasin me duart dhe gjuhën e tyre. Ata do të dëshironin shumë që edhe ju të bëheshit jobesimtarë." - Nëse qafirëve u jepet mundësia për t'ju munduar, torturuar dhe poshtëruar, ata asnjëherë nuk kursehen të godasin ashpër. Në çdo rast, ata ju godasin me duart e tyre për t'ju vrarë e poshtëruar. Edhe gjuha e tyre e hidhur nuk resht së luftuari me shpifje e fyerje kundër jush. Gjithçka që mohuesit dëshirojnë prej jush është thjesht t'ju nxjerrin nga feja juaj. Nëse ju përsëri arsyetoni dhe thoni se "ne afrohemi dhe miqësohemi me mohuesit, për shkak të lidhjeve farefisnore" ose "për shkak të tregtisë dhe pasurisë", atëherë dijeni se:

- "Ditën e Kijametit nuk do t'ju bëjnë dobi farefisi e as fëmijët tuaj. Allahu do të bëjë ndarjen mes jush. Allahu sheh gjithçka që ju punoni." - Allahu ju tërheq vërejtjen, që

ju të mos miqësoheni me mohuesit, sepse kjo është në dëmin tuaj.

- "Një shembull i mirë për ju është Ibrahimi dhe ata që ishin me të..." - Për ju, o besimtarë, shembulli më i mirë, nga i cili mund të mësoni shumë, është Ibrahimi (a.s.) dhe besimtarët që e shoqëronin atë. Ju jeni urdhëruar që të pasoni fenë e Ibrahimit, i cili ishte "*hanifa*" - besimdrejtë, që besonte një Zot të vetëm dhe i distancuar nga adhurimi dhe adhuruesit e gjithçkaje tjetër veç Allahut. Ibrahimi (a.s.) dhe besimtarët që ishin me të u distancuan nga populli i tyre idhujtar dhe nga çdo adhurim tjetër, veç adhurimit të Allahut. Madje, ata e deklaruan hapur distancimin e tyre kundër mohuesve, duke thënë:

- "...kur i thanë popullit të vet: "Ne distancohemi prej jush dhe prej çfarë adhuroni ju veç Allahut. Ne ju mohojmë dhe armiqësia ndërmjet nesh është e hapur..." - Ne distancohemi tërësisht prej jush dhe prej atyre që ju adhuroni krahas Allahut. Tashmë armiqësia mes nesh është e shpallur.

Zemra e besimtarit nuk duhet të ketë asnjë lloj dashurie apo animi ndaj mohuesve, ndërsa armiqësia duhet të shfaqet me veprime konkrete. Kjo urrejtje dhe armiqësi nuk ka kufizim kohe dhe vendi, porse vazhdon për sa kohë ata vazhdojnë me mohimin e tyre, siç thuhet më pas:

- "...derisa ju ta besoni Allahun si Një!" - Nëse e besoni Allahun si Një të vetëm, duke kryer adhurimin e kërkuar, atëherë vendin e urrejtjes dhe armiqësisë ndaj jush do ta zerë dashuria, miqësia dhe mbështetja.

Ky është shembulli për ju, o besimtarë! Shikoni dhe mësoni nga Ibrahimi (a.s.) dhe besimtarët që ishin me të, që të përsosni imanin dhe teuhidin. Prej shembullit të Ibrahimit (a.s.) do të mësoni të plotësoni të gjitha veprat dhe adhurimet tuaja.

- "Me përjashtim të fjalës së Ibrahimit drejtuar babait të vet..." - Përjashtim bën vetëm një gjë. Ju nuk duhet ta merrni si shembull atë për fjalët që i tha Azerit, babait të tij idhujtar, i cili ishte mohues dhe armik i së vërtetës. Ibrahimi (a.s.) e ftoi atë në besim dhe në teuhid, por ai refuzoi me forcë. Atëherë, Ibrahimi tha:

- "Unë do të kërkoj falje për ty, por nuk kam asnjë mundësi për ty para Allahut!" - Unë do të kërkoj falje për ty, edhe pse e di mirë se nuk kam asnjë mundësi që të të mbroj prej Allahut dhe ndëshkimit të Tij. Gjithsesi, po e lus Zotin Tim, duke shpresuar që të mos gjej kurrë dëshpërim.

Pra, nuk duhet të merret si shembull Ibrahimi (a.s.) për të kërkuar falje për një mushrik. Askush të mos lutet për idhujtarët dhe të pretendojë që po ndjek traditën e Ibrahimit. Allahu i Lartësuar e përmend arsyen e Ibrahimit (a.s.) për këtë veprim në një ajet tjetër: "Edhe lutja e Ibrahimit për babain e vet ishte veçse për shkak të një premtimi që i kishte dhënë atij. Por kur iu bë e qartë se ai ishte armik i Allahut, ai (Ibrahimi) u largua prej tij. Sigurisht që Ibrahimi ishte shumë i ndjeshëm dhe i butë." [Teube 114].

Ibrahimi (a.s.) dhe besimtarët që ishin me të, le të jenë shembull për ju edhe për lutjen e mrekullueshme që ata i drejtuan Allahut, për mbështetjen e tyre të plotë tek Ai, për kthimin e tyre të penduar e të nënshtruar tek

Allahu i Lartësuar, si edhe për shprehjen e dobësisë dhe nevojës së tyre tek Allahu i Lartësuar, kur thanë:

- "Zoti ynë, vetëm Ty të mbështetemi, vetëm para Teje pendohemi dhe vetëm te Ti është kthimi ynë!" - Ata u lutën: "O Zoti ynë, vetëm Ty të mbështetemi për arritjen e çdo gjëje që na sjell të mira dhe për largimin e çdo gjëje që na dëmton dhe është e keqe. Vetëm tek Ti kemi besim, o Zoti ynë, dhe të gjitha çështjet tona i kemi lënë në dorën Tënde. Vetëm tek Ti kthehemi të penduar e të nënshtruar, për t'iu bindur porosive të Tua, për të kryer çdo gjë që të kënaq Ty dhe që na afron drejt Teje. Ky është qëllimi ynë, për të cilin ne nxitojmë, garojmë dhe bëjmë punë të mira. Ne jemi të bindur se tek Ti do të kthehemi një ditë, prandaj përgatitemi duke kryer çdo vepër që na afron pranë Teje." Lutja e tyre vazhdon:

- "Zoti ynë, mos na bëj sprovë të atyre që nuk besojnë dhe falna, o Zoti ynë!" - Mos u jep jobesimtarëve pushtet mbi ne, për shkak të gjynaheve tona, që ata të na nënshtrojnë dhe poshtërojnë, të na sprovojnë në besimin tonë dhe të na ndalojnë me ç'të munden nga feja jonë. Mos na bëj sprovë për ta, sepse nëse ata e shohin veten fitimtarë mbi ne, do të mashtrohen e do të mendojnë se janë me të vërtetën, kurse ne me të kotën dhe, në këtë mënyrë, do të shtohet mohimi i tyre dhe do të shfrenohen edhe më tej në kalimin e kufijve.


- "Ti je Ngadhënjyesi, i Urti!" – Ata thanë: "Ti je *El Aziz* - Krenari, Ngadhënjimtari, Mposhtësi i gjithçkaje. Ti je *El Hakim* - i Urti, i Cili e vendos çdo gjë në vendin e vet. Me krenarinë dhe urtësinë Tënde, na ndihmo dhe na jep fitore kundër armiqve tanë! Na i mbulo dhe i fal gjynahet tona! Na i rregullo të metat dhe mangësitë tona!"

Pastaj Allahu i Lartësuar e përsërit inkurajimin e marrjes si shembull të Ibrahimit dhe besimtarëve që ishin me të, duke thënë:

- "Vërtet, këta njerëz janë një shembull i mirë..." - Por pasimi i këtij shembulli do të jetë i lehtë jo për të gjithë. Ai do të jetë i lehtë vetëm për ata që kanë një cilësi shumë të rëndësishme:

- "...për ata që shpresojnë tek Allahu dhe Dita e Fundit." - Besimi në jetën tjetër, te dhënia e llogarisë, te shpërblimi dhe ndëshkimi në varësi të veprave, ia lehtëson robit çdo gjë të vështirë. Besimi në takimin me Allahun dhe shpërblimi për veprat e mira është një inkurajim i fortë për të marrë si shembull profetët e Allahut dhe adhuruesit e sinqertë të Tij. Madje, siguria e plotë në takimin me Allahun dhe shpresa e madhe për shpërblimin e Tij bën që robi ta ndiejë si detyrë pasimin e rrugës së këtyre të zgjedhurve.

- "Kushdo që kthen shpinën, le ta dijë se Allahu është Jonevojtari e i Lavdishmi!" - Ai që i kthen shpinën bindjes ndaj Allahut dhe rrugës së profetëve të Tij ka për të dëmtuar veçse veten e vet. Ai nuk mund të dëmtojë aspak Allahun e Lartësuar, sepse Ai është *El Ganij* - i Pasuri, që nuk ka asnjë nevojë për krijesat e Tij. Atij i takon pasuria absolute e pavarësia në çdo aspekt. Allahu nuk ka nevojë për asgjë të krijesave të Tij. Ai është *El Hamid* - i Lavdishmi dhe i Lavdëruari në Qenien, emrat, cilësitë dhe


الجزء الثامن والعشرون سورة الممتحنة
لقد كان لكم فيهم أسوة حسنة لمن كان يرجو الله واليوم الآخر ومن يتول فإن الله هو الغني الحميد ٦ عسى الله أن يجعل بينكم
وبين الذين عاديتم منهم مودة والله قدير والله غفور رحيم ٧ لا ينهاكم الله عن الذين لم يقاتلوكم في الدين ولم يخرجوكم
من دياركم أن تبروهم وتقسطوا إليهم إن الله يحب المقسطين ٨ إنما ينهاكم الله عن الذين قاتلوكم في الدين وأخرجوكم من
دياركم وظاهروا على إخراجكم أن تولوهم ومن يتولهم فأولئك هم الظالمون ٩ يا أيها الذين آمنوا إذا جاءكم المؤمنات مهاجرات
فامتحنوهن الله أعلم بإيمانهن فإن علمتموهن مؤمنات فلا ترجعوهن إلى الكفار لا هن حل لهم ولا هم يحلون لهن وآتوهم
ما أنفقوا ولا جناح عليكم أن تنكحوهن إذا آتيتموهن أجورهن ولا تمسكوا بعصم الكوافر واسألوا ما أنفقتم وليسألوا ما أنفقوا
ذلكم حكم الله يحكم بينكم والله عليم حكيم ١٠ وإن فاتكم شيء من أزواجكم إلى الكفار فعاقبتم فآتوا الذين ذهبت
أزواجهم مثل ما أنفقوا واتقوا الله الذي أنتم به مؤمنون ١١
٥٥٠

veprat e Tij. Allahut i takon falënderimi, mirënjohja, lavdërimi dhe lavdia e plotë!

Është e vërtetë që Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar që t'i urrejmë dhe t'i konsiderojmë armiq qafirët dhe idhujtarët, për sa kohë ata vazhdojnë në kufrin dhe idhujtarinë e tyre. Por nëse ata kthehen në besimin e drejtë dhe të saktë, atëherë gjykimi për ta ndryshon: vendin e urrejtjes dhe armiqësisë e zë dashuria dhe vëllazëria e besimit. Allahu i Lartësuar na tregon se edhe kjo mund të ndodhë, kur thotë:

- "Ndoshta Allahu, ndërmjet jush dhe atyre me të cilët kishit armiqësi, do të vendosë miqësi. Allahu është i Plotfuqishëm. Allahu është Falës e Mëshirues." - Mos e humbisni shpresën, o besimtarë, se ata edhe mund të kthehen në besim, dhe nëse ata kthehen në besim, Allahu i Lartësuar do të bëjë që mes jush të vendoset dashuria për hir të fesë. Allahu është *Kadir* - i Plotfuqishëm për çdo gjë. Pjesë e pushtetit të Tij është udhëzimi i zemrave dhe ndryshimi i tyre nga një gjendje në një gjendje tjetër. Gjithashtu, Allahu është *Gafuru Rahim* - Falës e Mëshirues. Me pendimin e sinqertë dhe të vërtetë, asnjë gjynah nuk mund të jetë shumë i madh për Të që Ai ta falë dhe asnjë mangësi dhe turp nuk është e pamundur për Të që ta mbulojë dhe ta fshijë. I Lartësuari thotë në një ajet: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar veten tuaj me shumë gabime, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, sepse vërtetë Allahu i fal të gjitha gjynahet, Ai është Falësi dhe Mëshiruesi! Kthehuni te Zoti juaj dhe përuljuni Atij, para se t'ju vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë se kush t'ju ndihmojë. Përmbajuni më të mirës që ju është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dënimi befas e ju të mos dini! Askush të mos thotë: "O i mjeri unë, që kam shpërfillur adhurimin dhe bindjen ndaj Allahut! Unë isha prej atyre që talleshin!" Ose të thotë: "Ah, sikur të më kishte udhëzuar Allahu e të kisha qenë prej atyre që u ruajtën!" Apo, kur ta shohë dënimin, të thotë: "Sikur të isha kthyer edhe një herë e të isha bërë prej bamirësve!" Jo, ty të kanë ardhur argumentet e Mia, por ti i mohove ato, u bëre kryeneç dhe ishe prej atyre që nuk besonin." [Zumer 53 – 59].

Ky ajet paralajmëronte se shumë nga ata që ishin fillimisht idhujtarë dhe armiq të besimtarëve, do të pranonin Islamin më vonë. Dhe, vërtet, ashtu ndodhi, lavdi Zotit! Sapo u shpallën këto ajeteve të mrekullueshme, që nxisnin urrejtjen dhe armiqësinë ndaj qafirëve, besimtarët i zbatuan me përpikmëri. Madje, shumë prej tyre u ndien në faj edhe për mbajtjen e lidhjeve farefisnore me të afërmit e tyre

idhujtarë, duke menduar gabimisht se e tillë ishte porosia e Allahut të Lartësuar. Por Allahu i Madhëruar i sqaroi më tej besimtarët, duke u thënë:

- "Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftojnë për shkak të fesë e që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë." - Allahu i Lartësuar nuk ju ndalon nga bamirësia, komunikimi dhe mirësjellja ndaj farefisit. Ai nuk ju ndalon nga mbajtja e drejtësisë dhe barazisë me idhujtarët, qofshin ata farefisi juaj apo jo, nëse ata nuk luftojnë kundër jush dhe nuk ju dëbojnë nga shtëpitë tuaja. Ruajtja e marrëdhënieve me ta në të tilla kushte nuk është e ndaluar dhe as e dëmshme.

Në lidhje me marrëdhëniet që duhet të ketë muslimani me prindërit idhujtarë, Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Ne e kemi urdhëruar njeriun për bamirësi ndaj prindërve të vet, sepse nëna e ka bartur atë mund pas mundi dhe ia ka ndërprerë gjirin pas dy viteve. "Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu!" Vetëm tek Unë është kthimi juaj. E nëse ata të dy të shtyjnë që ti të më përshkruash Mua shok, gjë për të cilën ti nuk ke asnjë fakt, atëherë mos iu bind atyre! Megjithatë, në çështjet e jetës së kësaj bote, të sillesh mirë me ta! Ndiq rrugën e atij që është kthyer drejt Meje! Kthimi juaj është tek Unë, kur Unë do t'ju tregoj gjithçka që keni vepruar." [Lukman 14, 15].

- "Allahu ju ndalon t'u afroheni vetëm atyre që ju luftojnë për shkak të fesë, që ju nxjerrin prej shtëpive tuaja dhe që ndihmojnë në dëbimin tuaj. Ai ju ndalon të miqësoheni me ta." - Porosia e Allahut për distancim, urrejtje dhe armiqësi iu referohet:

- atyre që ju luftojnë për shkak të fesë tuaj, në emër të urrejtjes dhe armiqësisë ndaj Allahut dhe besimtarëve të Tij;
- atyre që ju dëbojnë nga shtëpitë dhe pronat tuaja, për shkak të fesë.
- atyre që ndihmojnë të tjerët që t'ju luftojnë për fenë tuaj dhe që t'ju nxjerrin nga shtëpitë dhe pronat tuaja.

Kështu, Allahu i Lartësuar na ndalon që t'u japim dashuri dhe mbështetje të tillë njerëzve, me vepra ose me fjalë. Ndërsa për sa i përket mirësjelljes me të afërmit apo me njerëzit në përgjithësi, ajo kurrsesi nuk është e ndaluar. Madje, atë e përfshin urdhri i përgjithshëm i Allahut të Lartësuar për bamirësi, bujari dhe moral të mirë.

- "Çdokush që miqësohet me ta, është zullumqar!" - Madhësia e kësaj padrejtësie është e lidhur me nivelin e përkrahjes dhe bashkëpunimit me ta në padrejtësinë e tyre. Nëse përkrahja ose bashkëpunimi me ta në luftën kundër muslimanëve është i plotë, atëherë kjo vepër konsiderohet *kufër* që të përjashton nga Islami. Poshtë këtij niveli ka vepra të tjera, që mund të jenë shumë pranë kufrit ose larg tij.

Ajetet 10 – 11

10. O ju që keni besuar, kur t'ju vijnë besimtaret e shpërngulura, provojeni besimin e tyre, ndonëse Allahu e di më së miri se çfarë besimi kanë! Nëse vërtetoni se ato janë besimtare, atëherë mos i ktheni ato te jobesimtarët, sepse as ato nuk janë të lejuara për ta e as ata nuk janë të lejuar për to! Por kthejuani atyre shpenzimet që kanë bërë për to. Ju nuk jeni të ndaluar të martoheni me to, pasi t'u keni dhënë *mehr*-

in. Mos i mbani si bashkëshorte idhujtaret, por kërkoni t'ju kthehen shpenzimet që keni bërë për to, ashtu si ata le të kërkojnë prej jush t'u ktheni shpenzimet që kanë bërë për to. Këto janë ligjet e Allahut, me të cilat Ai ju gjykon. Allahu është i Gjithëdijshmi e Njohësi në imtësi.

11. Në qoftë se ndonjëra prej grave tuaja shkon te idhujtarët, e më vonë ju fitoni plaçkë lufte prej tyre, atëherë atyre që u kanë shkuar gratë tek ju jepuni aq sa ata kanë shpenzuar për to! Kijeni frikë Allahun, të Cilin e besoni!

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, kur t'ju vijnë besimtaret e shpërngulura, provojeni besimin e tyre, ndonëse Allahu e di më së miri se çfarë besimi kanë!" - Në marrëveshjen e paqes të nënshkruar në Hudejbije, një ndër pikat për të cilat Profeti (a.s.) ra dakord me idhujtarët ishte që, nëse një musliman vinte nga Meka dhe rrethinat e saj (e cila asokohe kontrollohej ende nga idhujtarët), e kërkonte strehim në shtetin islam, në Medinë, ai duhej të kthehej përsëri mbrapsht në vendin e tij, tek idhujtarët. Kjo pikë e marrëveshjes nuk përcaktonte kategori të veçanta, por ishte e përgjithshme për burrat dhe për gratë. Për sa u përket burrave, Allahu i Lartësuar nuk e ndaloi Profetin e Tij që t'i kthente ata përsëri tek idhujtarët, për t'ju përmbajtur kushtit të vendosur. Por për sa u përket grave, duke qenë se kthimi dhe dorëzimi i tyre tek idhujtarët kishte pasoja të rënda, Allahu i Lartësuar i urdhëroi besimtarët që, së pari, të provonin besimin e tyre. Kjo mund të bëhej me mënyra të ndryshme: me pyetje, informacione të marra, betime etj. Ky hetim duhej të bëhej sepse ekzistonte edhe mundësia që gratë të mos ishin të sinqerta në pretendimin se ishin larguar për shkak të besimit, por mund të ishin larguar për ndonjë arsyeje tjetër, për shembull, për t'u martuar me ndonjë burrë, ngase parapëlqenin të jetonin në një vend tjetër apo të tjera qëllime të kësaj dynjaje. Nëse vërtetohej që ato nuk ishin besimtare, por kishin të tilla qëllime, bëhej detyrë ekstradimi në vendin e tyre, pa shkaktuar në këtë mënyrë asnjë dëmtim. Por nëse pas provimit dhe hetimit vërtetohej se ato ishin besimtare, atëherë nuk lejohej riatdhesimi i tyre. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Nëse vërtetoni se ato janë besimtare, atëherë mos i ktheni ato te jobesimtarët, sepse as ato nuk janë të lejuara për ta e as ata nuk janë të lejuar për to! Por kthejuani atyre shpenzimet që kanë bërë për to. Ju nuk jeni të ndaluar të martoheni me to, pasi t'u keni dhënë *mehr*-in." - Plotësimi i marrëveshjeve është kusht i rëndësishëm, prandaj i Lartësuari urdhëroi që idhujtarëve t'u ktheheshin mbrapsht shpenzimet që ata kishin bërë për gratë e tyre, që tashmë ishin emigrante në shtetin islam. Këtu futej mehri dhe gjithçka tjetër që ishte shpenzuar për ato gra. Pas këtij kompensimi, besimtarët në Medinë nuk e kishin më të ndaluar që të martoheshin me gratë e saposhpërngulura, edhe pse ato kishin qenë të martuara me idhujtarë në vendin e shirkut. Kusht tjetër, gjithashtu, ishte që këtyre grave t'u sigurohej nga bashkëshorti i ri mehri dhe shpenzimet e nevojshme, sipas rregullave.

Ashtu sikurse një muslimane nuk është e lejuar të martohet me një qafir, po ashtu nuk është e lejuar që një musliman të martohet me një qafire. Përjashtim nga ky ligj bëjnë vetëm gratë çifute dhe të krishtere, me

kushtet e vendosura nga sheriati. I Lartësuari thotë:

- "Mos i mbani si bashkëshorte idhujtaret..." - Nëse Allahu i Lartësuar na ndalon që t'i mbajmë si bashkëshorte mohueset, ndalesa për lidhjen e një martese të re me to është më parësore.

- "...por kërkoni t'ju kthehen shpenzimet që keni bërë për to, ashtu si ata le të kërkojnë prej jush t'u ktheni shpenzimet që kanë bërë për to." – Këtu, Allahu i Lartësuar i urdhëron besimtarët që, nëse gratë e tyre tradhtonin fenë dhe shkonin në vendin e kufrit, ata të kërkonin prej mohuesve mehrin dhe shpenzimet që kishin dhënë për gratë e tyre, njëlloj siç veprohej në rastin e kundërt.

Ky ajet tregon se privimi nga të drejtat mbi gruan duhet të kompensohet. Me fjalë të tjera, burri duhet të kompensohet për humbjen e të drejtës së bashkëjetesës me të shoqen. Për shembull, nëse dikush bëhet shkak që ta privojë burrin nga të drejtat mbi gruan e tij, si nëpërmjet gjidhënies apo me ndonjë mënyrë tjetër (duke futur përçarje e konflikt mes tyre), ai ka detyrë që ta kompensojë burrin duke i kthyer atij mehrin.

- "Këto janë ligjet e Allahut, me të cilat Ai ju gjykon. Allahu është i Gjithëdijshmi e Njohësi në imtësi." - Allahu është i Gjithëdijshëm. Ai di shumë mirë se çfarë ligjesh janë të dobishme për ju. Të gjitha ligjet që Allahu ka vendosur vijnë prej diturisë dhe urtësisë së Tij të gjerë dhe absolute.

- "Në qoftë se ndonjëra prej grave tuaja shkon te idhujtarët, e më vonë ju fitoni plaçkë lufte prej tyre, atëherë atyre që u kanë shkuar gratë tek ju jepuni aq sa ata kanë shpenzuar për to!" - Ashtu siç u përmend më sipër, nëse gratë e muslimanëve tradhtonin fenë dhe u bashkëngjiteshin mohuesve, këta të fundit duhet t'u kthenin kompensimin burrave muslimanë. Por nëse mohuesit nuk e kthenin kompensimin, atëherë ai merrej nga pasuria e plaçkës së luftës e u jepej ish-bashkëshortëve.


- "Kijeni frikë Allahun, të Cilin e besoni!" - Besimi i vërtetë kërkon që ju të jeni gjithnjë të devotshëm në zbatimin e ligjeve të Allahut të Lartësuar.

Ajeti 12

12. O Profet, kur të vijnë tek ty besimtaret e të japin besën se nuk do t'i shoqërojnë Allahut asgjë, nuk do të vjedhin, nuk do të bëjnë imoralitet, nuk do t'i vrasin fëmijët e tyre, nuk do të gënjejnë e shpifin dhe nuk do të të kundërshtojnë në atë që është e drejtë dhe e arsyeshme, atëherë ti pranoje zotimin e tyre dhe lute Allahun t'i falë ato! Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues.

Shpjegimi i ajetit

- "O Profet, kur të vijnë tek ty besimtaret e të japin besën..." – Këtu flitet për gratë, të cilat jepnin besën për plotësimin e disa detyrimeve, që, në fakt, duhet të plotësohen nga të gjithë, burra apo gra qofshin dhe në çdo kohë. Për sa i përket burrave detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre shtohen dhe pakësohen në varësi të gjendjes dhe nivelit të tyre.


الجزء الثامن والعشرون سورة الصف

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّبِيُّ إِذَا جَآءَكَ ٱلْمُؤْمِنَٰتُ يُبَايِعْنَكَ عَلَىٰٓ أَن لَّا يُشْرِكْنَ بِٱللَّهِ
شَيْـًٔا وَلَا يَسْرِقْنَ وَلَا يَزْنِينَ وَلَا يَقْتُلْنَ أَوْلَٰدَهُنَّ وَلَا يَأْتِينَ
بِبُهْتَٰنٍ يَفْتَرِينَهُۥ بَيْنَ أَيْدِيهِنَّ وَأَرْجُلِهِنَّ وَلَا يَعْصِينَكَ فِى
مَعْرُوفٍ فَبَايِعْهُنَّ وَٱسْتَغْفِرْ لَهُنَّ ٱللَّهَ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ
١٢ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تَتَوَلَّوْا۟ قَوْمًا غَضِبَ ٱللَّهُ عَلَيْهِمْ قَدْ
يَئِسُوا۟ مِنَ ٱلْءَاخِرَةِ كَمَا يَئِسَ ٱلْكُفَّارُ مِنْ أَصْحَٰبِ ٱلْقُبُورِ ١٣

سُورَةُ الصَّفِّ

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

سَبَّحَ لِلَّهِ مَا فِى ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَمَا فِى ٱلْأَرْضِ ۖ وَهُوَ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ
١ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لِمَ تَقُولُونَ مَا لَا تَفْعَلُونَ ٢
كَبُرَ مَقْتًا عِندَ ٱللَّهِ أَن تَقُولُوا۟ مَا لَا تَفْعَلُونَ ٣ إِنَّ
ٱللَّهَ يُحِبُّ ٱلَّذِينَ يُقَٰتِلُونَ فِى سَبِيلِهِۦ صَفًّا كَأَنَّهُم
بُنْيَٰنٌ مَّرْصُوصٌ ٤ وَإِذْ قَالَ مُوسَىٰ لِقَوْمِهِۦ يَٰقَوْمِ لِمَ
تُؤْذُونَنِى وَقَد تَّعْلَمُونَ أَنِّى رَسُولُ ٱللَّهِ إِلَيْكُمْ ۖ فَلَمَّا زَاغُوٓا۟
أَزَاغَ ٱللَّهُ قُلُوبَهُمْ ۚ وَٱللَّهُ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلْفَٰسِقِينَ ٥

٥٥١

Kështu, Profeti (a.s.), në zbatim të urdhrit të Allahut të Lartësuar, kur vinin gratë për t'i dhënë besën për t'ju përmbajtur atyre kushteve, ai e pranonte fjalën e tyre, duke ua qetësuar zemrën dhe duke i kërkuar falje Allahut për çdo mangësi që mund të vinte prej tyre. Profeti (a.s.) i konsideronte ato si besimtare muslimane, me kusht që:

- **"...se nuk do t'i shoqërojnë Allahut asgjë..."** – Pra, së pari, të adhuronin Allahun si Një të vetëm, duke ia përkushtuar vetëm Atij të gjitha adhurimet dhe duke u larguar nga çdo lloj idhujtarie.

- **"...nuk do të vjedhin, nuk do të bëjnë imoralitet, nuk do t'i vrasin fëmijët e tyre..."** - Të largoheshin nga këto vepra të tmerrshme dhe krime të pashembullta, që kryheshin normalisht në kohën e injorancës.

- **"...nuk do të bëjnë imoralitet..."** – Të largoheshin tërësisht nga kjo vepër shkatërrimtare për familjen dhe shoqërinë. Në kohën e injorancës, para Islamit, laviret dhe shtëpitë e poshtërsisë ishin të përhapura, ndërsa tradhtia bashkëshortore ishte një plagë shumë e thellë.

- **"...nuk do të gënjejnë e shpifin..."** - Të mos shpifnin kurrën e kurrës, qoftë në lidhje me burrat e tyre, qoftë për të tjerët.

- **"...dhe nuk do të të kundërshtojnë në atë që është e drejtë dhe e arsyeshme..."** - Të mos kundërshtonin kurrë porositë e Profetit (a.s.), të cilat të gjitha janë të mira dhe të dobishme. Ndër porositë e veçanta të Profetit (a.s.) për gratë ishte për të hequr dorë nga disa zakone të injorancës në rastet e pikëllimit dhe tragjedive, si nga vajtimi me zë, çjerrja e fytyrës, grisja e rrobave atj., që tregonin pakënaqësi ndaj caktimit të Zotit.

- **"...atëherë ti pranoje zotimin e tyre dhe lute Allahun t'i falë ato!"** - Nëse ato i përmbahen të gjitha këtyre kushteve, atëherë pranojua besën dhe kërkoji falje Allahut për mangësitë e tyre, duke i qetësuar dhe gëzuar.

- **"Vërtet, Allahu është Falës e Mëshirues."** - Allahu fal shumë dhe i mbulon gjynahet e robërve. Ai është Falës për gjynahqarët, që pendohen sinqerisht. Ai është, gjithashtu, *Rrahim* - Mëshirues, mëshira e të Cilit ka përfshirë gjithçka, ashtu sikurse edhe mirësia e Tij ka përfshirë të gjitha krijesat.

Ajeti 13

13. O ju që keni besuar, mos zini miqësi me njerëz që kanë zemëruar Allahun. Ata e

kanë humbur shpresën për ahiretin, ashtu sikurse jobesimtarët nuk kanë shpresë për të vdekurit.

Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar, mos zini miqësi me njerëz që kanë zemëruar Allahun." - O ju besimtarë, nëse e besoni vërtet Zotin tuaj, nëse vërtet synoni ta kënaqni Atë dhe të largoheni nga çdo gjë që e zemëron Atë, atëherë mos u miqësoni me njerëz të cilët i ka përfshirë zemërimi i Allahut të Lartësuar. Allahu i Madhëruar është zemëruar me ta, për shkak të kufrit të tyre.

- "Ata e kanë humbur shpresën për ahiretin, ashtu sikurse jobesimtarët nuk kanë shpresë për të vdekurit." - Ata janë të privuar nga mirësitë e ahiretit, të cilat as nuk kanë për t'i parë me sy. Prandaj, bëhuni të kujdesshëm, që të mos afroheni me ta, duke i miratuar dhe i mbështetur në ligësinë e tyre, e në këtë mënyrë të privoheni edhe ju nga mirësitë e ahiretit, ashtu sikurse ata. Kur ata të kalojnë në ahiret dhe të shohin të vërtetën, do ta kuptojnë qartë se nuk kanë pjesë në shpërblimin e atjeshëm.

Kështu, ky ajet tregon se jobesimtarët nuk shpresojnë asnjë shpërblim në ahiret, ashtu sikurse do të ndodhë kjo realisht kur ata të kalojnë në ahiret. Ky është njëri nga kuptimet e ajetit. Sipas një këndvështrimi tjetër, ajeti tregon që jobesimtarët e mohojnë ahiretin dhe refuzojnë ta besojnë se ai është i vërtetë.

Gjithsesi, duke qenë se ata nuk besojnë në jetën tjetër dhe as për shpërblimin në të, mos u çudit aspak me përkushtimin e tyre ndaj veprave të këqija, që e zemërojnë Allahun dhe bëjnë të merituesheëm ndëshkimin e Tij. Këto vepra, që e kanë burimin nga mosbesimi në Ditën e Llogarisë, do t'i bëjnë ata të mjerë që të mbeten të pashpresë gjatë dhënies së shpërblimit në ahiret. Ashtu sikurse mohuesit e shohin të pamundur që të vdekurit do të ringjallen një ditë dhe do të llogariten me drejtësi para Zotit të tyre, ashtu ata do të mbeten të pashpresë në Ditën e Gjykimit për të marrë nga shpërblimi i Allahut.

Përfundoi edhe tefsiri i sures Mumtehine. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Surja 61: Es Saff (medinase) 14 ajete

Ajetet 1 – 3

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Allahun e madhëron ç'gjendet në qiej dhe në Tokë! Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!
2. O ju që keni besuar, pse e thoni atë që vetë nuk e veproni?
3. Për Allahun, është shumë e urryer që ta thoni atë gjë që vetë nuk e veproni.

Shpjegimi i ajeteve

- "Allahun e madhëron ç'gjendet në qiej dhe në Tokë! Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!" - Ajeti tregon, së pari, madhështinë dhe krenarinë e Allahut të Lartësuar. Ai është Ngadhënjyesi, para të Cilit janë nënshtruar të gjitha krijesat. Çdo gjë që ndodhet në qiell dhe në Tokë i bën *tesbih* Atij, duke e lavdëruar dhe duke iu lutur për nevojat e tyre. Allahu është i Urti, që ka përcaktuar dhe ligjëruar çdo gjë me urtësi.

- "O ju që keni besuar, pse e thoni atë që vetë nuk e veproni? Për Allahun, është shumë e urryer që ta thoni atë gjë që vetë nuk e veproni." - Pse u flisni të tjerëve për të

mirën, madje ndoshta lëvdoheni me të, ndërkohë që vetë ju nuk e veproni atë? Pse ndaloni nga të këqijat, dhe ndoshta lëvdoheni para njerëzve për pastërtinë e shpirtit tuaj, ndërkohë ju vetë jeni të përlyer me to? A i shkon për shtat besimtarit kjo sjellje e shëmtuar. Nuk ka gjë më të urrryer për Allahun sesa robi të thotë atë që vetë nuk e vepron.

Atëherë, është detyrë për urdhëruesin për të mira që të jetë i pari që nxiton për t'i vepruar ato. Po kështu, edhe ndaluesi nga të këqijat duhet të jetë vetë njeriu që qëndron më larg tyre. Thotë i Lartësuari në suren Bekare: "Si i urdhëroni njerëzit për të mira, dhe e harroni vetveten, kur ju e lexoni librin?! A nuk po mendoni?!" [Bekare 44]. Shuajbi (a.s.) i tha popullit të vet: "O populli im, mendoni pak! Unë kam argumente të qarta nga Zoti im, i Cili, gjithashtu, më ka furnizuar me të mira e begati. Unë nuk kam qëllim që t'ju kundërshtoj duke vepruar atë nga e cila po ju ndaloj. Unë dëshiroj vetëm që të përmirësoj aq sa mundem, por suksesi vjen vetëm me ndihmën e Allahut. Vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm tek Ai kthehem!" [Hud 88].

Ajeti 4

4. Allahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij të rreshtuar, si një ndërtesë e fortifikuar.

Shpjegimi i ajetit

Ky ajet është, së pari, një nxitje që Allahu i Lartësuar iu bën besimtarëve për të luftuar në rrugën e Tij. Ai i mëson, gjithashtu, se si të qëndrojnë gjatë luftimeve. Besimtarët duhet të formojnë rreshta të drejtë e të ngjeshur, duke mos lënë asnjë hapësirë mes tyre. Në këtë mënyrë, pesha e luftës të shpërndahet në mënyrë të barabartë mes luftëtarëve dhe në mënyrë që ata të ndihmojnë dhe mbështesin njëri-tjetrin. Nga ana tjetër, ata i fusin frikën në zemër armikut dhe i japin forcë njëri-tjetrit. Edhe Profeti (a.s.), kur afrohej lufta, i rregullonte sahabët nëpër formacionet, në mënyrë që askush të mos ia linte peshën e tjetrit, por secili formacion të kryente misionin e vet dhe të mbante frontin ku ishte vendosur. Me rregull, disiplinë dhe përkushtim arrihet suksesi.

Ajeti 5

5. Kur Musai i tha popullit të vet: "O populli im! Pse më mundoni, kur e dini me siguri se, me të vërtetë, unë jam i Dërguari i Allahut për ju!" Por kur ata devijuan, edhe Allahu ua devijoi zemrat. Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë.

Shpjegimi i ajetit

- "Kur Musai i tha popullit të vet..." - Musai (a.s.), duke qortuar popullin e tij për veprat e ulëta dhe për mundimin që i shkaktonin, edhe pse e dinin se ai ishte i dërguar i Allahut, tha:

- "O populli im! Pse më mundoni, kur e dini me siguri se, me të vërtetë, unë jam i Dërguari i Allahut për ju!" - Përse më mundoni me fjalët dhe veprat tuaja, kur ju e dini mirë se unë jam i Dërguari i Allahut për ju. Është detyrim që i Dërguari të nderohet, të respektohet e t'i bindesh urdhrave të tij. Mirësia që Profeti i sjell umetit qëndron mbi të gjitha mirësitë, pas mirësisë së Allahut. Të mundosh të zgjedhurit e Allahut është kulmi i poshtërsisë, injorancës dhe devijimit nga rruga e drejtë.


Bijtë e Israilit e dinin shumë mirë se Musai (a.s.) ishte Profeti i Zotit, por e shpërfillnin atë me vetëdije, prandaj i Madhëruari tha:

- "Por kur ata devijuan, edhe Allahu ua devijoi zemrat." - Kur ata u shmangën nga e vërteta dhe e braktisën atë me vetëdije të plotë, Allahu i Madhëruar ua shmangu zemrat e tyre nga kjo e vërtetë, si ndëshkim për shpërfilljen e tyre. Allahu i Madhëruar nuk u dha sukses për të pasuar rrugën e drejtë, sepse ata nuk e meritonin atë. Ata meritonin veçse humbjen.

- "Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë një popull që kalon kufijtë." - Shkelja e kufijve të Zotit ishte karakteristikë e tyre. Ata as që nuk e dëshironin udhëzimin.

Humbja që Allahu i Madhëruar u shkakton të prishurve, nuk është aspak një padrejtësi nga Ai. Ata nuk mund të kapen kurrsesi pas këtij fakti. Kjo humbje vjen, së pari, nga ata vetë. Janë ata që ia mbyllin vetes së tyre portën e udhëzimit, pasi ajo është tërësisht e hapur para tyre. Pas shpërfilljes së të vërtetës nga ana e tyre, Allahu i Drejtë dhe i Gjithëdijshëm për qëllimet dhe dëshirat e robërve, i "shpërblen" duke i larguar nga e vërteta dhe duke i lënë në humbjen e tyre. Ata nuk kanë më mundësi pas kësaj që të ndryshojnë zemrat e tyre. Kjo vjen si formë ndëshkimi nga i Drejti dhe i Urti, që çdo gjë e vendos në vendin që i takon, sikurse thotë i Madhëruari në suren En'am, ajeti 110: "Ne ua rrotullojmë zemrat dhe shikimet e tyre, ashtu sikurse ata nuk e besojnë atë për herë të parë, dhe i lëmë ata të bredhin të hutuar në shfrenimin e tyre, që të tejkalojnë kufijtë".

Ajetet 6 – 9



6. Dhe kur Isai, biri i Merjemes, tha: "O bijtë e Israilit! Unë jam i dërguar i Allahut për ju. Unë jam vërtetues i Teuratit, që ishte para meje, siç jam lajmës për një profet që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!" E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapur!".

7. E kush është më mizor se ai që shpif për Allahun gënjeshtra, ndërkohë që ai ftohet në fenë Islame?! Por Allahu nuk u ofron udhëzimin e drejtë njerëzve të padrejtë.

8. Ata duan që, me gojën e tyre, të shuajnë dritën e Allahut, por Allahu e forcon dritën e vet, edhe pse jobesimtarët e urrejnë këtë.

9. Është Ai që e çoi të Dërguarin e Vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë të epërme mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë këtë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar na tregon për arrogancën dhe refuzimin e bijve të Israilit ndaj ftesës së Isait (a.s.):

- "Dhe kur Isai, biri i Merjemes, tha: "O bijtë e Israilit! Unë jam i dërguar i Allahut për ju." - Allahu i Madhëruar më dërgoi tek ju që t'ju urdhëroj për të mira dhe t'ju ndaloj nga veprat e këqija. Allahu më pajisi me mrekulli të shumta, që dëshmojnë vërtetësinë time si profet i Tij. Ndër faktet që dëshmojnë për vërtetësinë time është edhe që:

- "Unë jam vërtetues i Teuratit, që ishte para meje..." - Unë kam ardhur me të njëjtat ligje si profetët e tjerë të Zotit dhe si miratues e përforcues i ligjeve të Musait. Nëse do të isha thjesht një gënjeshtar, atëherë fjalët e mia do të binin ndesh me mësimet e të gjithë profetëve të tjerë. Unë e miratoj Shpalljen para meje, pra, Teuratin, dhe unë vërtetoj çfarë është thënë në Teurat për mua. Gjithashtu, unë u dërgova që të jap edhe një sihariq tjetër të madh:

- "...siç jam lajmës për një profet që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!" - Ky profet, për të cilin dha sihariqin Isai (a.s.) ishte Muhamed Ibn Abdil-lah Ibn Abdil Mutalib, Profeti Hashimij, pasardhës i Ismailit, birit të Ibrahimit. Ai do të ishte vula e të gjithë të dërguarve të Zotit.

Kështu, Isai (a.s.) ashtu si të gjithë profetët e vërtetë, pohoi vërtetësinë e profetëve dhe Shpalljeve hyjnore paraardhëse, dhe lajmëroi për ardhjen e Profetit pasardhës. Ndryshe veprojnë profetët e rremë, të cilët i kundërshtojnë të gjithë profetët e tjerë. Sharlatanët ndryshojnë tërësisht nga profetët e vërtetë, qoftë në cilësitë dhe moralin e tyre, qoftë në urdhëresat, ndalesat dhe ligjet që u caktojnë njerëzve.

- "E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapur!"." - Kur atyre u erdhi Muhamedi (a.s.), profeti i paralajmëruar nga Isai, ata e mohuan, ndonëse ai u paraqiti shumë mrekulli, që nuk linin asnjë dyshim. Ardhja e profetit Muhamed (a.s.) u paralajmërua jo vetëm nga Isai (a.s.), por edhe nga profetë të tjerë para tij, në mënyrë që askush të mos dyshonte se ai ishte profet i vërtetë i Zotit.

Duke refuzuar me inat të vërtetën dhe duke e konsideruar padrejtësisht dhe me vetëdije të plotë Shpalljen e Zotit si gënjeshtër, ata e përshkruan atë si "magji e hapur". Ky është një nga qëndrimet më të habitshme dhe më të padrejta: ta quash magji Shpalljen e Zotit, e cila është e qartë si drita e diellit dhe të cilën e solli Profeti. A ka vetëmashtrim më të madh dhe më të pashpresë se ky "justifikim", për të refuzuar Vulën e të gjithë vargut të profetëve të Zotit?! Kjo, pa dyshim, është shpifja më e madhe dhe më e ndëshkueshme, prandaj i Lartësuari thotë:

- "E kush është më mizor se ai që shpif për Allahun gënjeshtra, ndërkohë që ai ftohet në fenë Islame?!" - Këta mohues të së vërtetës janë zullumqarët më të mëdhenj dhe nuk kanë asnjë justifikim për këtë padrejtësi që kryejnë. Ata vazhdimisht ftohen në Islam nga muslimanët, duke iu sqaruar tërësisht argumentet dhe faktet, duke mos u lënë asnjë shteg dyshimeve.

- "Por Allahu nuk u ofron udhëzimin e drejtë njerëzve të padrejtë." - Për sa kohë vazhdojnë në padrejtësi, atyre nuk ka për t'u

bërë dobi asnjë qortim e këshillë. Ata nuk do të binden nga asnjë lloj argumenti. Këta të mjerë janë të pashpresë, sepse kanë marrë përsipër që të kundërshtojnë të vërtetën, duke të nxjerrë lloj-lloj arsyetimesh apo "argumente" - siç i quajnë ata. Për këta, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"Ata duan që, me gojën e tyre, të shuajnë dritën e Allahut..."** - Nëpërmjet argumenteve të pabaza dhe arsyetimeve të shtrembra, ata synojnë të shuajnë dritën e Allahut. Por kjo është gjëja më e pamundur që ekziston, madje të tilla përpjekje fatkeqe dhe të pashpresa veçse ua shtojnë besimin dhe qartësinë pasuesve të të vërtetës dhe i bëjnë të kuptojnë më thellë kotësinë e fjalëve të atyre të mjerëve.

- "... por Allahu e forcon dritën e vet, edhe pse jobesimtarët e urrejnë këtë." - Është Allahu i Lartësuar Ai që ka premtuar dhe ka marrë përsipër ta bëjë këtë fe të triumfojë mbi të gjitha fetë. Allahu do ta çojë në vend të vërtetën, me të cilën dërgoi të gjithë profetët e Tij. Është Allahu i Lartësuar Ai që do ta bëjë dritën e Tij të shkëlqejë në çdo cep të botës, edhe pse mohuesit e urrejnë këtë gjë. Ata fatkeqë, për shkak të urrejtjes së madhe që kanë ndaj të vërtetës, shfrytëzojnë çdo mundësi dhe rrugë për të shuar dritën e Allahut, por përfundimi i pashmangshëm është që ata do të mposhten të turpëruar. Ata janë si ai njeriu që i fryn diellit, për ta shuar atë me frymë. Me veprimet e tyre, jo vetëm që nuk do t'ia arrijnë qëllimit, por tregojnë edhe se sa mendjelehtë që janë.

Në vijim, Allahu i Lartësuar na bën të ditur shkakun e epërsisë së fesë islame, duke thënë:

- "Është Ai që e çoi të Dërguarin e Vet me udhëzim të qartë e fé të vërtetë, për ta bërë të epërme mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë këtë." - Islami do të triumfojë mbi të gjitha fetë, sepse Allahu i Lartësuar e pajisi Profetin e kësaj feje me udhëzim të qartë, domethënë, me dituri të madhe dhe vepra të mira, sipas kësaj diturie. Në këtë mënyrë, robërit njohin rrugën drejt mëshirës dhe Xhenetit të Allahut të Lartësuar. Ata mësojnë veprat dhe virtytet me të cilat kënaqet Allahu i Lartësuar. Me Islamin, ata inkurajohen dhe aftësohen për t'u pajisur me këtë dituri dhe për të punuar sipas saj. Kështu, atyre u lehtësohet rruga për të arritur lumturinë në dynja dhe në ahiret.

Gjithashtu, Allahu i Madhëruar e pajisi profetin Muhamed (a.s.) me '*dinul hak*' – fenë e vërtetë. Kjo është feja që u është ngarkuar robërve, që ta adhurojnë Allahun sipas saj. Kjo është fe e vërtetë dhe e plotë. Në të nuk mund të gjesh asnjë lloj mangësie apo defekti, asnjë lloj padrejtësie, në çdo aspekt që ta shohësh, qoftë në detyrimet ndaj Zotit, qoftë në ligjet që rregullojnë marrëdhëniet ndërnjerëzore. Porositë e kësaj feje janë ushqim për zemrën dhe kënaqësi për trupin. Largimi nga ndalesat e kësaj feje është çlirim dhe siguri nga çdo ligësi dhe shkatërrim.

Atëherë, udhëzimi i qartë dhe feja e vërtetë janë dëshmitë më të qarta, që tregojnë se Muhamedi (a.s.) ishte vërtet i dërguari i Zotit të botëve. Forca ndikuese e Kuranit në zemrat e njerëzve, dituria që përmban ai, këshillat e tij dhe feja që përshkruan ky libër, e cila rregullon jetën njerëzore në të gjitha aspektet e saj, të gjitha përbëjnë mrekullinë më të madhe që Zoti ka sjellë për njerëzit. Për sjelljen e kësaj mrekullie, Allahu i Madhëruar zgjodhi më të mirin e profetëve,

Muhamedin (a.s.), dhe për ta zbatuar atë solli më të mirin e umeteve, umetin Islam. Ndryshe nga të gjithë mrekullitë e tjera, të cilat ishin të kufizuara për popuj, vende dhe periudha të caktuara, kjo mrekulli përfshin të gjithë njerëzit dhe xhindët dhe të gjithë kohërat, deri në Ditën e Gjykimit. Sa më shumë të thellohet njeriu në meditimin dhe studimin e këtij libri, aq më tepër do t'ia shtojë ai gëzimin dhe kthjelltësinë në rrugën që ka zgjedhur, për të jetuar sipas kënaqësisë së Krijuesit dhe për të fituar përjetësinë në Xhenetin pranë Tij. Me të tillë mrekulli, është i pashmangshëm përfundimi triumfues i kësaj feje. Allahu i Lartësuar thotë: "...për ta bërë të epërme mbi të gjitha fetë, edhe pse idhujtarët e urrejnë këtë." Fitorja e Islamit do të arrihet me argumente dhe fakte të qarta, mbi të cilat është ndërtuar kjo fe. Allahu i Lartësuar do të bëjë që pasuesit e kësaj feje të triumfojnë në përballjen me të kotën dhe gënjeshtrën. Shtrirja dhe epërsia e fesë së Zotit janë cilësi të pandashme të saj në çdo kohë dhe vend. Askush dhe asgjë nuk mund të dalë mbi këtë fe. Gjithmonë, nëse dikush përpiqet të polemizojë kundër fesë së vërtetë, do të përfundojë i humbur, i poshtëruar dhe i pashpresë. Gjithmonë e vërteta do ta mposhtë të kotën dhe do të shfaqet e qartë dhe e kuptueshme për të gjithë.

Ndërsa për sa i përket pasuesve të fesë së vërtetë, nëse ata do t'i përkushtohen plotësisht asaj, nëse do të ndriçohen me dritën e saj, nëse do të udhëzohen me parimet e saj për arritjen e mirësive të dynjasë dhe ahiretit, atëherë do të jenë pa dyshim ngadhënjimtarë para çdokujt. Ata do të fitojnë gjithmonë, duke e lartësuar fenë e tyre mbi të gjitha fetë dhe besimet e njerëzve. Por nëse ata i neglizhojnë porositë e kësaj feje, nëse nuk e zbatojnë tërësisht atë, në të gjitha aspektet e jetës së tyre, por do të mjaftohen vetëm me përkatësinë e tyre në Islam, atëherë kjo nuk do t'u sjellë dobi dhe nuk do t'i bëjë kurrë të ngadhënjejnë. Neglizhenca në zbatimin e fesë së Zotit është shkak që armiqtë të sundojnë mbi besimtarët. Për të vërtetuar këtë, mjafton të shohësh dallimin mes muslimanëve të parë dhe të atyre që erdhën më vonë, mjafton të shohësh lulëzimin e shteteve islame dhe më pas rënien e tyre.

Ajetet 10 – 14

10. O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të suksesshme, që ju shpëton prej dënimit të dhembshëm:
11. Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj. Kjo është shumë herë më e dobishme për ju, sikur ta dinit!
12. Ai jua fal gjynahet tuaja, ju fut në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, dhe në pallate të bukura, në xhenetet e amshuar. Ky është suksesi i madh!
13. Edhe të tjera që ju i dëshironi, si: ndihmë prej Allahut dhe fitore të afërt. Atëherë, përgëzoji besimtarët!
14. O ju që keni besuar, bëhuni ndihmës të Allahut, sikurse Isai, biri i Merjemes, u tha dishepujve: "Kush do të jetë ndihmësi im në rrugën e Allahut?" Dishepujt i thanë: "Ne do të jemi ndihmësit e rrugës së Allahut!" Disa prej bijve të Israilit besuan e disa të tjerë kundërshtuan. Ata që besuan, Ne i përkrahëm kundër armiqve të tyre, dhe ata fituan!

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të suksesshme, që ju shpëton prej dënimit të dhembshëm..." - Ky është një propozim i mrekullueshëm, që më i Mëshirshmi i të mëshirshmëve u bën robërve të Tij besimtarë. Me bujarinë e Tij, Ai i fton ata në tregtinë më të madhe, në objektivin më të lartë, që të shpëtojnë nga ndëshkimi i dhimbshëm dhe të arrijnë lumturinë e përjetshme. Allahu i Lartësuar nuk e bën këtë ftesë në formë urdhërore, por në formën e një propozimi shumë të butë dhe dashamirës, për të treguar se çdo i urtë dhe i mençur mund ta arrijë këtë mirësi. Ajo është një ftesë e hapur për të gjithë, sepse është e arritshme për të gjithë, nëse do të gjykonin me urtësi dhe mençuri. Nëse dikush pyet për mënyrën se si arrihet kjo e mirë, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij..." – Fillimisht, të besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij!

Dihet mirë që besimi i vërtetë është bindja e plotë në gjithçka që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar të besohet. Nëse ky besim është i sinqertë, ai e shtyn robin të shfaqë vepra e fjalë të mira. Sigurisht, ndër veprat më të spikatura, që shfaqet në praktikë dhe që dëshmon për sinqeritetin në besim, është xhihadi në rrugën e Zotit. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "...luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe veten tuaj." - Jepni për hir të Allahut pasurinë, madje edhe shpirtin tuaj, për të mposhtur armiqtë e Islamit! Kjo bëhet duke patur një qëllim të vetëm: lartësimin e fjalës së Allahut dhe triumfin e fesë së Tij, që i fton njerëzit në adhurimin e Allahut si Një i vetëm dhe i pashoq. Luftoni me shpirtin dhe pasurinë tuaja për hir të këtij qëllimi të madh, sepse një vepër e tillë, edhe pse është e vështirë, të jeni të sigurt se:

- "Kjo është shumë herë më e dobishme për ju, sikur ta dinit!" - Kjo vepër sjell lumturinë dhe begatinë në dynja dhe në ahiret. Për sa i përket lumturisë së dynjasë, është shumë e qartë se nëpërmjet xhihadit arrihet fitorja kundër armiqve të Allahut, realizohen qëllimet e larta të fesë së Allahut, arrihet epërsia e të mirës kundër së keqes, ndërsa besimtarët fitojnë pasuri, siguri dhe qetësi në zemra. Ndërsa në ahiret, premtimi i pakthyeshëm për këta të zgjedhur është shpërblimi i madh dhe i pashembullt i Allahut të Lartësuar dhe shpëtimi nga ndëshkimi i Tij. I Lartësuari e thekson shpërblimin e tyre në ahiret, duke thënë:

- "Ai jua fal gjynahet tuaja..." - Kjo falje përfshin të gjitha gjynahet, të mëdhatë dhe të voglat. Kështu, besimi i plotë dhe i vërtetë tek Allahu dhe xhihadi në rrugën e Tij i falin të gjitha gjynahet, edhe ato të mëdhatë.

- "...ju fut në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj..." - Poshtë ndërtesave dhe kështjellave, poshtë tendave dhe dhomave të tyre të zbukuruara, mes pemëve të Xhenetit, rrjedhin lumenj, të cilët Allahu i Lartësuar i përshkruan si: "lumenj me ujë të kristaltë, lumenj qumështi me shije të paprishur, lumenj vere të këndshme për ata që pinë dhe lumenj mjalti të kulluar." [Muhamed 15].

- "...dhe në pallate të bukura, në xhenetet e amshuar. Ky është suksesi i madh!" - Në Xhenet ka çdo mirësi dhe begati që të gëzon shpirtin dhe të kënaq syrin. Banorët e tij lumturohen duke kundruar ndërtesat e larta

e të stolisura në mënyrë të mrekullueshme. Madje, banorët e *Ilijin*-it, që ndodhet në gradën më të lartë të Xhenetit, shihen nga banorët e tjerë të Xhenetit, ashtu sikurse shohim sot yjet vezullues në qiellin e dynjasë. Disa ndërtesa të Xhenetit janë të ndërtuara me tulla floriri, ndërsa disa të tjera me tulla argjendi. Tendat e fshehura mes bimësisë së dendur dhe lumenjve janë prej diamanti dhe prej koralesh. Disa vende pushimesh janë prej xhevahiresh me ngjyra të larmishme e të kristalta, aq sa që nga jashtë duket çfarë ka brenda dhe nga brenda mund të shikosh çfarë ka jashtë. Në Xhenet ka aroma të freskëta dhe të mrekullueshme, ka kënaqësi të llojllojshme, që edhe më oratori nuk di t'i përshkruajë. Asnjë prej krijesave të kësaj bote nuk mund ta dijë realisht se si janë ato të mira. Sikur Allahu të mos i krijojë banorët e Xhenetit të pavdekshëm dhe sikur të mos i bëjë në një krijim të ri, që nuk pranon shkatërrimin dhe vdekjen, ata do të vdisnin nga lumturia e madhe, me të cilën do të përballen.

I lavdëruar, i madhëruar dhe i lartësuar larg çdo të mete është Allahu, të Cilin askush nga krijesat e Tij nuk mund ta lavdërojë e falënderojë ashtu siç i takon. Allahu është ashtu sikurse e ka lavdëruar Veten e Vet. Ai është shumë e shumë më i lavdëruar, i madhëruar e i lavdishëm sesa mund ta lavdërojnë robërit e Tij. I lavdëruar dhe i mbushur plot mirësi është Allahu i Gjithëmëshirshëm! I bukur është Ai dhe të bukur janë emrat, cilësitë dhe veprat e Tij. Allahu e krijoi vendin e paqes dhe të mirësisë së përjetshme dhe vendosi brenda tij mrekulli, që çudisin mendjet e krijesave dhe mbushin me mall shpirtin e tyre.

I lartësuar qoftë Allahu, të Cilit i takon urtësia e plotë! Nëse Allahu i Madhëruar do t'i bënte robërit që ta shihnin Xhenetin kur Ai e krijoi atë, atëherë, pasi të kishin parë mirësitë dhe mrekullitë e tij, askush nuk do të gjente më qetësi dhe kënaqësi me jetën e kësaj bote, por do të pushtohej tërësisht nga malli i papërballueshëm për Xhenetin e Allahut të Lartësuar. Të gjithë nuk do të reshtnin së punuari vetëm për arritjen e atyre mirësive. E si mund të hutoheshin e mashtroheshin të këta të përmalluar nga jeta e kësaj dynjaje të shkurtër, mirësitë e të cilës janë të përziera me dhimbje e frikë?!

Xheneti është quajtur '*Adn*' - 'i Përhershëm', për të treguar vazhdimësinë dhe përjetësinë e tij, për të treguar që banorët e tij nuk kanë për t'u larguar kurrë prej tij dhe kurrë nuk kanë për ta ndërruar ketë shpërblim të madh. Ky sukses nuk mund të krahasohet dhe shkëmbehet me asnjë fitore tjetër.

Ky ishte shpërblimi i pashembullt i ahiretit për këtë tregti. Ndërsa për sa i përket shpërblimit në jetën e dynjasë, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Edhe të tjera që ju i dëshironi, si..." - Përveç shpërblimit të madh në ahiret, ju do t'ju jepet edhe një shpërblim i shpejtë në dynja, të cilin ju e dëshironi shumë:

- "...ndihmë prej Allahut dhe fitore të afërt." – Allahu do t'ju japë fitore mbi armiqtë tuaj, e cila do t'ju sjellë krenari dhe gëzim. Kështu do të hapet rrethi i Islamit dhe do të shtohen begatitë. Ky është shpërblimi i premtuar besimtarëve që luftojnë dhe përpiqen në rrugën e Zotit.

Por edhe besimtarëve të tjerë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në xhihad, Allahu i Lartësuar nuk ua pret shpresën për mirësitë e Tij. Duke dhënë një premtim gjithëpërfshirës, Ai thotë:

- "Atëherë, përgëzoji besimtarët!" - Përgëzoji ata me një shpërblim të madh në jetën e dynjasë dhe në jetën tjetër. Secili do të shpërblehet sipas gradës së imanit, edhe pse nuk do të jetë në të njëjtin nivel me ata që kanë luftuar në rrugën e Zotit. Profeti (a.s.) ka thënë: "Me të vërtetë, në Xhenet ka njëqind grada, hapësira mes çdonjërës prej të cilave është sa hapësira mes qiellit dhe Tokës. Këto, Allahu i Lartësuar i ka përgatitur për luftëtarët në rrugën e tij".[30]
Pastaj i Lartësuari thotë:

- "O ju që keni besuar, bëhuni ndihmës të Allahut..." - Jini ndihmues dhe mbështetës së fesë së Allahut, me fjalët dhe me veprat tuaja, duke u përpjekur seriozisht dhe me sinqeritet për të realizuar dhe plotësuar fenë e Tij në veten tuaj, por edhe për përhapjen e saj tek të tjerët. Kjo detyrë kërkon që të pajiseni me dituri, të punoni sipas saj dhe të bëni durim në përhapjen e saj. Ju do të hasni në vështirësi të shumta, që do të kërkojnë edhe të luftoni me armiqtë e kësaj feje, të cilët e pengojnë përhapjen e saj. Ju do t'ju duhet të sakrifikoni pasurinë dhe jetën tuaj. Do t'ju duhet ta luftoni të kotën me dituri dhe argumente të qarta, por edhe me shpatë, kur e përcakton urtësia e Zotit. Kështu, me dituri dhe fjalë të qarta, do ta ndriçoni të vërtetën për njerëzit, do t'u tregoni kotësinë dhe mashtrimin e të padrejtëve dhe do t'i paralajmëroni për rrezikun e rrugës së humbjes.

Atëherë, të ndihmosh fenë e Allahut do të thotë, së pari, të mësosh e studiosh Librin e Allahut dhe Traditën e Profetit të Allahut, dhe pastaj të nxisësh edhe të tjerët që ta bëjnë një gjë të tillë, duke i urdhëruar për të mira dhe duke i ndaluar nga të këqijat, ashtu siç i ka përcaktuar feja e Zotit.


Më pas, Allahu i Madhëruar i nxit besimtarët që të ndjekin shembullin e vëllezërve të tyre të mëparshëm, duke thënë:

- "...sikurse Isai, biri i Merjemes, u tha dishepujve: "Kush do të jetë ndihmësi im në rrugën e Allahut?"" - Isai (a.s.) i ftoi dishepujt të bëheshin ndihmuesit e tij në rrugën e Zotit dhe ata menjëherë i dhanë besën duke i thënë:

- "Dishepujt thanë: "Ne do të jemi ndihmësit e rrugës së Allahut!"" – Kështu, bashkë me dishepujt e tij, Isai (a.s.) sakrifikoi për të ndihmuar dhe përhapur fenë e Zotit, duke duruar në të gjitha vështirësitë që i dolën.

- "Disa prej bijve të Israilit besuan e disa të tjerë kundërshtuan. Ata që besuan, Ne i përkrahëm kundër armiqve të tyre, dhe ata fituan!" – Si rezultat i përpjekjeve dhe thirrjes së Isait dhe dishepujve të tij, besuan disa prej bijve të Israilit, por pjesa tjetër refuzuan t'i përgjigjeshin ftesës së tij. Atëherë, besimtarët e sinqertë luftuan kundër mohuesve dhe Zoti u dha fitoren. Kështu, edhe ju, o populli i Muhamedit, bëhuni ndihmues të fesë së Allahut dhe ftues të njerëzve në rrugën e drejtë, që

[30] Në një kopje tjetër të këtij *Tefsir*-i, në vend të këtij hadithi, autori shkruan: "Profeti (a.s) ka thënë: "Për atë që është i kënaqur me Allahun si Zotin e tij, me Islamin si fenë e tij, me Muhamedin (a.s.) si profetin e tij, për atë është bërë detyrë Xheneti." Ebu Seid el Hudriu (transmetuesi i këtij hadithi) u çudit nga këto fjalë dhe tha: "Ma thuaj edhe një herë, o i Dërguari i Allahut!" Ai ia përsëriti dhe pastaj tha: "Por është edhe diçka tjetër, nëpërmjet së cilës robi ngrihet nëpër 100 gradat e Xhenetit, hapësira mes çdonjërës prej të cilave është sa largësia mes qiellit dhe Tokës." - "Cila është ajo vepër, o i Dërguar i Allahut?" – pyeti Ebu Seid el Hudriu. Profeti (a.s.) tha: "Xhihadi në rrugën e Zotit, xhihadi në rrugën e Zotit". Këtë hadith e ka shënuar Muslimi.


الجزء الثامن والعشرون سورة الجمعة

سورة الجمعة

بسم الله الرحمن الرحيم

يسبح لله ما في السموات وما في الأرض الملك القدوس العزيز
الحكيم ﴿١﴾ هو الذي بعث في الأميين رسولا منهم يتلوا عليهم
ءاياته ويزكيهم ويعلمهم الكتاب والحكمة وإن كانوا
من قبل لفي ضلال مبين ﴿٢﴾ وءاخرين منهم لما يلحقوا بهم
وهو العزيز الحكيم ﴿٣﴾ ذلك فضل الله يؤتيه من يشاء والله
ذو الفضل العظيم ﴿٤﴾ مثل الذين حملوا التوراة ثم لم
يحملوها كمثل الحمار يحمل أسفارا بئس مثل القوم
الذين كذبوا بآيات الله والله لا يهدي القوم الظالمين
﴿٥﴾ قل يا أيها الذين هادوا إن زعمتم أنكم أولياء لله من
دون الناس فتمنوا الموت إن كنتم صادقين ﴿٦﴾ ولا يتمنونه
أبدا بما قدمت أيديهم والله عليم بالظالمين ﴿٧﴾ قل
إن الموت الذي تفرون منه فإنه ملاقيكم ثم تردون
إلى عالم الغيب والشهادة فينبئكم بما كنتم تعملون ﴿٨﴾

الجزء ٢٨

٥٥٣

Allahu i Madhëruar t'ju ndihmojë dhe forcojë këmbët tuaja, ashtu sikurse veproi me besimtarët e sinqertë para jush. Kjo është rruga e fitores mbi armikun tuaj.

Këtu mbyllet tefsiri i sures Saff, dhe për këtë falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar!

Surja 62: El Xhumua (medinase) 11 ajete

Ajeti 1

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Çdo gjë në qiej dhe në Tokë i bën *tesbih* Allahut, Sunduesit, të Pastrit nga çdo e metë, Krenarit, të Urtit!

Shpjegimi i ajetit

Allahut i bën *tesbih*, domethënë, e madhëron, e adhuron dhe i nënshtrohet gjithçka që gjendet në qiej dhe në tokë. Vetëm Allahut i është nënshtruar gjithçka, sepse Ai është i plotë dhe absolut në pushtetin, sundimin dhe mbretërimin e Tij. Allahut i përket pushteti i botës së sipërme dhe asaj të poshtme. Të gjithë janë robër të Allahut, nën pushtetin dhe përkujdesin e Tij. Ai është *El Kudus* - i Pastër nga çdo mangësi. Allahu është *El Aziz* - Krenari, Ngadhënjyesi dhe Mposhtësi i gjithçkaje. Ai është *El Hakim* - i Urti, në çdo gjë që ka krijuar dhe në çdo ligj që ka vendosur. Pa dyshim, këto janë cilësi madhështore, që të ftojnë në adhurimin e Allahut të Lartësuar si Një, të Vetëm e të Pashoq.

Ajetet 2 – 4

2. Është Ai, që u dërgoi të palexuarve Profet nga mesi i tyre, që t'u lexonte ajetet e Tij, t'i pastronte ata, t'u mësonte Librin dhe Urtësinë, kur më parë ata ishin në humbje të plotë;
3. por edhe të tjerëve, që ende nuk u janë bashkuar atyre. Ai është Ngadhënjyesi, i Urti.
4. Kjo është mirësia e Allahut, që ia jep atij që do. Allahu është i Zotëruesi i mirësisë së madhe.

Shpjegimi i ajeteve

- "Është Ai, që u dërgoi të palexuarve Profet nga mesi i tyre, që t'u lexonte ajetet e Tij, t'i pastronte ata, t'u mësonte Librin dhe Urtësinë, kur më parë ata ishin në humbje të plotë..." – "Të palexuarit" ishin ata të cilëve nuk u kishte zbritur ndonjë libër qiellor dhe nuk kishin as gjurmë prej shpalljeve hyjnore ose, me fjalë të tjera, që nuk ishin ithtarë të Librit. Kështu, Allahu i

Lartësuar u dhuroi atyre një mrekulli, një mirësi më të madhe se çdo mirësi që u pati dhënë të tjerëve, sepse ata ishin krejtësisht të humbur në padituri dhe larg çdo të mire. Arabët ishin në një humbje të thellë asokohe, duke adhuruar pemët, gurët e putat. Mund të thuhet me të drejtë se ata ishin si egërsira pylli, ku i forti hante të dobtin dhe tërësisht injorantë rreth profetëve.

Pas gjithë kësaj gjendjeje, Allahu i Lartësuar zgjodhi një profet nga gjiri i tyre, të cilit ata ia njihnin prejardhjen, virtytet dhe, sidomos, sinqeritetin. I Lartësuari e zgjodhi profetin Muhamed (a.s.) për t'i shpallur Librin e Tij, që ai t'ua përcillte më pas atë të tjerëve, duke u kënduar ajetet e qarta, që mbushën zemrat me besim, bindje dhe siguri të plotë. Nëpërmjet kësaj Shpalljeje, ai do të pastronte shpirtrat e tyre, për t'i pajisur me virtytet më të larta. Ai do t'i edukonte shpirtrat e humbur me cilësitë më të mrekullueshme, duke u mësuar çdo mënyrë, fjalë dhe vepër për të arritur këtë qëllim. Ai do t'i pastronte nga cilësitë, fjalët e veprat e ndyra, duke i pajisur dije.

Profeti Muhamed (a.s.) u mësoi njerëzve Librin dhe Urtësinë, domethënë, Kuranin dhe Traditën profetike, mësime që përfshinin njohuritë e të parëve dhe të fundit. Pas këtij edukimi me dituri të madhe dhe të vërtetë, pas pastrimit dhe lartësimit të shpirtrave të tyre, ata u kthyen në njerëzit më të ditur. Madje, ata u bënë krerët e të mençurve dhe të urtëve, të pajisur me fenë më të plotë. Ata u bënë njerëzit me moralin më të lartë, plot fisnikëri dhe urtësi. Ata ndoqën udhën e drejtë me përpikmëri për veten e tyre, por u bënë edhe udhëzues të të tjerëve. Ata u bënë imamët e të udhëzuarve në rrugën e drejtë dhe udhëzues të besimtarëve. Profeti Muhamed (a.s.) dhe Shpallja hyjnore ishin mirësitë më të mëdha që Allahu i Lartësuar u dhuroi këtyre njerëzve.

- "...por edhe të tjerëve, që ende nuk u janë bashkuar atyre. Ai është Ngadhënjyesi, i Urti." – Gjithashtu, nëpërmjet profetit Muhamed (a.s.) dhe Shpalljes së Tij, Allahu i Lartësuar e plotësoi mirësinë e Tij mbi të gjithë popujt e tjerë, dhe jo vetëm mbi 'të palexuarit'. Kjo përfshin të gjithë popujt, si ata që jetuan në kohën e Profetit (a.s.), ashtu edhe ata që do të vinin më vonë, pas tij.

Shpjegimi i mësipërm është njëri kuptim i fragmentit: "...që ende nuk u janë bashkuar atyre". Po ka mundësi që kjo fjali të ketë për qëllim brezat e mëvonshëm, që do të vinin pas atyre që jetuan në kohën e Profetit dhe të cilët nuk do mund të arrinin gradën e brezave të parë në vepra të mira dhe shpërblim. Sidoqoftë, të dyja kuptimet janë të sakta dhe ajeti i përmban ato, pasi nuk ka dyshim se brezi mes të cilëve u dërgua Profeti (a.s.) dhe jetuan në kohën e Shpalljes, duke qenë luftëtarët e parë të Islamit, u dalluan me shumë veçori, aq sa askush pas tyre nuk mund t'i arrijë më ata.

Dërgimi i profetëve që ata t'u lexonin popujve shpalljet e Zotit, për të pastruar zemrat e për t'u mësuar çdo gjë të dobishme për dynjanë dhe ahiretin e tyre, dëshmon për diturinë dhe urtësinë absolute të Allahut të Lartësuar, i Cili nuk do t'i braktiste kurrë krijesat e Tij për t'i lënë në çoroditje dhe përhumbje. Ai dërgoi mes tyre profetë, për t'i urdhëruar dhe për t'i ndaluar, për t'i ngarkuar me ligje e detyra që rregullojnë jetën e tyre dhe për t'i ringjallur pas vdekjes, që t'i shpërblejë me bujarinë, bamirësinë dhe drejtësinë e Tij.

- "Kjo është mirësia e Allahut, që ia jep atij që do. Allahu është i Zotëruesi i mirësisë së madhe." - Udhëzimi në rrugën e drejtë është mirësia më e madhe e Allahut të Urtë, të cilën Ai ua jep atyre robërve të Tij që Ai dëshiron. Mirësia e udhëzimit është shumë herë më e madhe se mirësitë e ushqimit, pijes, pasurisë dhe të çdo gjëje tjetër të kësaj dynjaje. Besimi i drejtë është bazë për arritjen e çdo të mire dhe për fitimin e lumturisë së përjetshme.

Ajetet 5 – 8

5. Përngjasimi i atyre që iu besua Teurati dhe nuk e zbatuan atë, është me gomarin, që thjesht bart libra! Sa i keq është përngjasimi i atyre që mohojnë ajetet e Allahut! Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë zullumqarët!

6. Thuaju: "O ju që i përmbaheni jehudizmit, nëse pretendoni se jeni më të afërmit e Allahut nga të gjithë njerëzit e tjerë, atëherë kërkojeni vdekjen, në qoftë se jeni të sinqertë!".

7. Por ata nuk do ta dëshirojnë kurrë atë, për shkak të veprave që kanë bërë me duart e tyre. Allahu është i Gjithëdijshëm për mizorët!

8. Thuaju: "Vdekja, së cilës ju i ruheni, pa dyshim që ka për t'ju zënë! Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, që e di të padukshmen dhe të dukshmen, dhe atëherë Ai do t'ju tregojë se çfarë keni vepruar."

Shpjegimi i ajeteve

- "Përngjasimi i atyre që iu besua Teurati dhe nuk e zbatuan atë, është me gomarin, që thjesht bart libra! Sa i keq është përngjasimi i atyre që mohojnë ajetet e Allahut!" - Në ajetet e mësipërme, Allahu i Lartësuar përmendi bujarinë e Tij të pashembullt dhe mirësitë e Tij të pakrahasueshme që i dhuroi popullit të paditur dhe të zhytur në humbje, duke dërguar mes tyre Profetin analfabet. Ai i dalloi ata me vlera të larta, të cilat nuk i ka arritur askush prej popujve të tjerë, qofshin ata popuj që nuk kishin libër qiellor, qofshin ithtarë të Librit, të krishterë dhe jehudë. Nëpërmjet Profetit famëmadh dhe Shpalljes së përjetshme që ai solli, populli i palexuar u lartësua mbi të gjithë popujt e tjerë, nga të hershmit dhe të mëvonshmit. Edhe ithtarët e Librit, të cilët pretendonin se ishin dijetarë, edukatorë, të mençur dhe të urtë, mbetën shumë pas këtij populli të zgjedhur, që punoi me sinqeritet, këmbëngulje dhe përpikmëri, për të vënë në zbatim fenë e Zotit të tyre. Ishte pikërisht ky përkushtim shkaku i lartësimit të tyre. Në ajetet vijuese, Allahu i Lartësuar na jep të kuptojmë një fakt të tillë, duke përshkruar sjelljen e kundërt të jehudëve dhe të krishterëve.

Allahu i Lartësuar i kishte ngarkuar jehudët dhe të krishterët që të studionin dhe zbatonin Teuratin, por ata nuk e kryen këtë detyrë. Për këtë arsye, ata nuk e meritonin të ishin popull i përzgjedhur. Ata e shpërfillën amanetin e Zotit, prandaj i Lartësuari i shëmbëlleu ata me gomarin, i cili mban në shpinë një barrë me libra. A përfiton një gomar nga librat që mban mbi shpinë?! A meriton ai të nderohet për shkak të ngarkesës që bart?! Kështu krahasohen dijetarët çifutë dhe të krishterë, të cilët nuk e vunë në zbatim Teuratin, një nga porositë më të rëndësishme të të cilit ishte ajo për pasimin e Muhamedit (s.a.u.s). Ata duhet ta ndiqnin këtë Profet, me cilësi të përshkruara qartë në Teurat. Po çfarë dobie u bëri atyre kjo porosi? Të vetmet gjëra që ata përfituan

prej sjelljes së tyre ishin dëshpërimi dhe fakti që nuk do të kenë më asnjë justifikim para Zotit për mohimin dhe refuzimin e të vërtetës. U poshtëroftë ai popull që mohon argumentet e qarta të Allahut të Lartësuar, të cilat dëshmojnë për vërtetësinë e Profetit të madh të fundit të kohës, Muhamedit (a.s.), dhe vërtetësinë e Shpalljes, që ai përcolli. Le ta dinë këta të mjerë se:

- "Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë zullumqarët!" - Për sa kohë ata kanë si cilësi padrejtësinë, urrejtjen dhe armiqësinë, Allahu i Lartësuar nuk ka për t'i udhëzuar në rrugën e drejtë.

Një nga padrejtësitë e çifutëve është që ata e dinë shumë mirë se janë në rrugë të padrejtë, megjithatë pretendojnë me të madhe se janë në të vërtetën, madje se janë populli i zgjedhur në të gjithë njerëzimin. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që t'u thotë atyre:

- "O ju që i përmbaheni jehudizmit, nëse pretendoni se jeni më të afërmit e Allahut nga të gjithë njerëzit e tjerë, atëherë kërkojeni vdekjen, në qoftë se jeni të sinqertë!" - Nëse jeni të sinqertë kur thoni se jeni në rrugë të drejtë dhe të zgjedhurit e Allahut, atëherë kërkojeni vdekjen. Kjo duhet të jetë shumë e thjeshtë për ju, nëse do të ishit të sigurtë në pretendimin tuaj. Nga ana tjetër, mospranimi i këtij propozimi tregon të kundërtën.


Duke qenë se ata thjesht kishin pretendime boshe dhe kurrë nuk do të guxonin ta pranonin këtë sfidë, i Lartësuari thotë:

- "Por ata nuk do ta dëshirojnë kurrë atë, për shkak të veprave që kanë bërë me duart e tyre. Allahu është i Gjithëdijshëm për mizorët!" - Ngaqë janë të mbushur plot me gjynahe dhe poshtërsi, ata i tremb vdekja. Por të mos harrojnë se Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm për zullumqarët. Asnjë padrejtësi e tyre nuk mund t'i fshihet Atij. Edhe pse ata kurrë nuk do ta kërkonin vetë vdekjen, kjo përsëri nuk ka për t'i shpëtuar, siç thotë i Lartësuari:

- "Thuaju: "Vdekja, së cilës ju i ruheni, pa dyshim që ka për t'ju zënë! Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, që e di të padukshmen dhe të dukshmen, dhe atëherë Ai do t'ju tregojë se çfarë keni vepruar."" - Pa diskutim do të vijë dita kur ata t'i gllabërojë vdekja, të cilën Zoti e ka bërë të pashmangshme për krijesat. Pas plotësimit të afatit të tyre në këtë dynja, kur ata t'i dorëzohen vdekjes, vjen Dita e Kijametit, kur ata do të kthehen të gjithë tek i Gjithëdituri për të fshehtën dhe të dukshmen. Ajo do të jetë dita kur secili do të shpërblehet me drejtësi për gjithçka që ka punuar, të mirë apo të keqe, të vogël apo të madhe.

Ajetet 9 – 11

9. O ju që keni besuar, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhuma, nxitoni për atje ku përmendet Allahu dhe lëreni shitblerjen! Kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse e dini!
10. Pasi të falet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut, por përmendeni shpesh Allahun, që të gjeni shpëtim!
11. Kur ata shohin ndonjë tregti ose dëfrim, rendin drejt tyre, duke të lënë ty në këmbë. Thuaju: "Çfarë gjendet tek Allahu është shumë herë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia, se Allahu është Furnizuesi më i mirë!"


الجزء الثامن والعشرون سورة المنافقون

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓاْ إِذَا نُودِيَ لِلصَّلَوٰةِ مِن يَوۡمِ ٱلۡجُمُعَةِ فَٱسۡعَوۡاْ
إِلَىٰ ذِكۡرِ ٱللَّهِ وَذَرُواْ ٱلۡبَيۡعَۚ ذَٰلِكُمۡ خَيۡرٞ لَّكُمۡ إِن كُنتُمۡ تَعۡلَمُونَ
فَإِذَا قُضِيَتِ ٱلصَّلَوٰةُ فَٱنتَشِرُواْ فِي ٱلۡأَرۡضِ وَٱبۡتَغُواْ
مِن فَضۡلِ ٱللَّهِ وَٱذۡكُرُواْ ٱللَّهَ كَثِيرٗا لَّعَلَّكُمۡ تُفۡلِحُونَ
وَإِذَا رَأَوۡاْ تِجَٰرَةً أَوۡ لَهۡوًا ٱنفَضُّوٓاْ إِلَيۡهَا وَتَرَكُوكَ قَآئِمٗاۚ قُلۡ مَا عِندَ
ٱللَّهِ خَيۡرٞ مِّنَ ٱللَّهۡوِ وَمِنَ ٱلتِّجَٰرَةِۚ وَٱللَّهُ خَيۡرُ ٱلرَّٰزِقِينَ

سُورَةُ الْمُنَافِقُونَ

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

إِذَا جَآءَكَ ٱلۡمُنَٰفِقُونَ قَالُواْ نَشۡهَدُ إِنَّكَ لَرَسُولُ ٱللَّهِۘ وَٱللَّهُ يَعۡلَمُ إِنَّكَ
لَرَسُولُهُۥۖ وَٱللَّهُ يَشۡهَدُ إِنَّ ٱلۡمُنَٰفِقِينَ لَكَٰذِبُونَ ٱتَّخَذُوٓاْ
أَيۡمَٰنَهُمۡ جُنَّةٗ فَصَدُّواْ عَن سَبِيلِ ٱللَّهِۚ إِنَّهُمۡ سَآءَ مَا كَانُواْ
يَعۡمَلُونَ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُمۡ ءَامَنُواْ ثُمَّ كَفَرُواْ فَطُبِعَ عَلَىٰ قُلُوبِهِمۡ فَهُمۡ
لَا يَفۡقَهُونَ وَإِذَا رَأَيۡتَهُمۡ تُعۡجِبُكَ أَجۡسَامُهُمۡۖ وَإِن يَقُولُواْ
تَسۡمَعۡ لِقَوۡلِهِمۡۖ كَأَنَّهُمۡ خُشُبٞ مُّسَنَّدَةٞۖ يَحۡسَبُونَ كُلَّ صَيۡحَةٍ
عَلَيۡهِمۡۚ هُمُ ٱلۡعَدُوُّ فَٱحۡذَرۡهُمۡۚ قَٰتَلَهُمُ ٱللَّهُۖ أَنَّىٰ يُؤۡفَكُونَ

الجزء ٢٨

٥٥٤

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhuma, nxitoni për atje ku përmendet Allahu dhe lëreni shitblerjen!" - Allahu i Lartësuar i urdhëron robërit e Tij besimtarë që të jenë të pranishëm në namazin e xhumasë, madje të nxitojnë për këtë. Ai urdhëron që ata t'i përgjigjen thirrjes për këtë namaz, duke nxituar e duke u kujdesur që ai të jetë angazhimi më i rëndësishëm i asaj dite. Kësisoj, fjala "nxitoni" në ajet nuk nënkupton rendjen me vrap apo të ecurit me nxitim, që janë të ndaluara të bëhen, por ka për qëllim përkushtimin maksimal ndaj namazit të xhumasë. I Lartësuari na urdhëron që, sapo të thirret ezani, ta ndërpresim tregtinë dhe angazhimi ynë i vetëm të jetë pjesëmarrja në aktivitetin e ditës së xhuma. Allahu i Lartësuar na mëson se përgjigjja ndaj kësaj ftese është më e mirë dhe më e begatshme se angazhimi me tregti. Nuk lejohet kurrsesi braktisja e këtij namazi, i cili është një nga detyrimet më të forta.

- "Kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse e dini!" - Nëse e dini që shpërblimi i përgatitur tek Allahu është më i mirë dhe i përjetshëm dhe se kush i jep përparësi dynjasë kundrejt ahiretit, ai ka dështuar dhe ka rënë në humbje të vërtetë, duke menduar se është duke fituar. Urdhri për lënien e shitblerjes vlen vetëm për kohën gjatë namazit, sepse Allahu i Lartësuar thotë më pas:

- "Pasi të falet namazi, atëherë shpërndahuni në tokë dhe kërkoni begatitë e Allahut..." - Pasi të falet namazi, mund të shpërndaheni për të kërkuar fitimin e ndershëm. Duke qenë se angazhimi me shitblerje mund ta hutojë besimtarin, Allahu i Madhëruar na urdhëron që ta shpeshtojmë përkujtimin e Tij, duke na treguar kështu atë që i mban zemrat tona gjallë:

- "...por përmendeni shpesh Allahun, që të gjeni shpëtim!" – Duhet ta përmendim Allahun në çdo gjendje: kur jemi në këmbë, kur jemi ulur, kur jemi shtrirë apo të mbështetur. Nëse e bëjmë këtë, Ai premton se do të gjejmë shpëtim. Sigurisht, shpeshtimi i përkujtimit të Allahut është një nga shkaqet më të mëdha të suksesit në çdo fushë.

- "Kur ata shohin ndonjë tregti ose dëfrim, rendin drejt tyre..." - Ata dalin me nxitim nga xhamia, të joshur nga kotësitë e kësaj dynjaje, duke e lënë mirësinë e vërtetë. Allahu i Madhëruar thotë:

- "...duke të lënë ty në këmbë." - Kjo ndodhi një ditë xhumaje, kur Profeti (a.s.) ishte duke mbajtur hytben në xhami. Në këtë kohë, njerëzit dëgjuan për një karvan plot me mallra tregtie, që kishte ardhur në Medinë, dhe filluan të largoheshin nga xhamia, duke e lënë Profetin (a.s.) duke mbajtur hytbe. Kështu, ata treguan mungesë të theksuar edukate dhe respekti ndaj Profetit (a.s.) dhe ndaj një adhurimi të rëndësishëm, siç është falja e xhumasë. Ata braktisën diçka që nuk duhet ta braktisnin kurrë, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

- "Thuaju: "Çfarë gjendet tek Allahu është shumë herë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia, se Allahu është Furnizuesi më i mirë!"" – Shpërblimi me mirësi dhe begati për devotshmërinë ndaj Zotit, është shumë më i mirë sesa tregtia, lojrat dhe kotësitë. Është e vërtetë që nëpërmjet tregtisë arrihen disa rezultate, por ato janë shumë pak, madje të mundimshme, kur i krahason me mirësitë e shumta të ahiretit. Durimi në zbatimin e urdhrave të Allahut nuk duhet të mendohet kurrë si shkak i varfërimit, sepse Allahu i Lartësuar është Furnizuesi më i mirë. Ata që tregohen të devotshëm ndaj Allahut do të furnizohen prej andej nga nuk e mendojnë e nuk e llogarisin fare.

Nga këto ajete nxirren shumë dobi:

- Adhurimi i xhumasë është detyrim për secilin besimtar. Është detyrë, gjithashtu, përkushtimi në plotësimin e këtij adhurimi.
- Dëgjimi i të dyjave pjesëve të hytbes së xhumasë është farz, sepse Allahu i Lartësuar thotë: "...nxitoni për atje ku përmendet Allahu", dhe është komentuar se këtu flitet për dy pjesët e hytbes.
- Ligjshmëria e thirrjes së ezanit ditën e xhuma, madje urdhërimi për të.
- Ndalesa e shitblerjes pas thirrjes së ezanit. Shitblerja gjatë kësaj kohe është haram, sepse ajo të pengon nga plotësimi i detyrimit. Kjo tregon se çdo çështje, edhe nëse në origjinë mund të jetë e lejuar, nëse në ndonjë gjendje të caktuar ajo të pengon nga kryerja e një detyrimi, atëherë ajo konsiderohet e palejueshme.
- Në këto ajete urdhërohemi që të jemi të pranishëm në të dyja hutbet e ditës së xhuma dhe qortohet rëndë ai që nuk merr pjesë në to. Në mënyrë indirekte, kuptohet gjithashtu se gjatë dy hytbeve është detyrë heshtja dhe përqendrimi në ligjëratë.
- Ajetet na mësojnë se si duhet të veprojë robi i cili, kur thirret në adhurimin e Allahut, gjen vështirësi në veten e vet, sepse joshet nga argëtimet dhe kënaqësitë e kësaj dynjaje, përfshi edhe tregtinë. Në të tilla raste, ilaçi më i mirë për t'u bërë i qëndrueshëm në adhurimin e Allahut, duke mos u kotur në plotësimin e dëshirave të nefsit, është që robi t'i kujtojë vetvetes mirësitë dhe begatitë e shumta që Allahu i Lartësuar premton për besimtarët që u japin përparësi veprave që kënaqin Atë, kundrejt epshit dhe dëshirave të tyre.


Këtu përfundon tefsiri i sures Xhumua, dhe falënderimi i takon Allahut të Madhëruar!

Surja 63: El Munafikun (medinase) 11 ajete

Ajetet 1 – 6

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Kur vijnë tek ti munafikët, thonë: "Dëshmojmë se ti je vërtet i dërguari i Allahut!" Allahu e di se ti je i dërguari i Tij, por Allahu dëshmon se munafikët janë gënjeshtarë!


الجزء الثامن والعشرون سورة المنافقون

وَإِذَا قِيلَ لَهُمْ تَعَالَوْا۟ يَسْتَغْفِرْ لَكُمْ رَسُولُ ٱللَّهِ لَوَّوْا۟ رُءُوسَهُمْ
وَرَأَيْتَهُمْ يَصُدُّونَ وَهُم مُّسْتَكْبِرُونَ ۝٥ سَوَآءٌ عَلَيْهِمْ
أَسْتَغْفَرْتَ لَهُمْ أَمْ لَمْ تَسْتَغْفِرْ لَهُمْ لَن يَغْفِرَ ٱللَّهُ لَهُمْ
إِنَّ ٱللَّهَ لَا يَهْدِى ٱلْقَوْمَ ٱلْفَٰسِقِينَ ۝٦ هُمُ ٱلَّذِينَ يَقُولُونَ
لَا تُنفِقُوا۟ عَلَىٰ مَنْ عِندَ رَسُولِ ٱللَّهِ حَتَّىٰ يَنفَضُّوا۟ وَلِلَّهِ
خَزَآئِنُ ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَلَٰكِنَّ ٱلْمُنَٰفِقِينَ لَا يَفْقَهُونَ
۝٧ يَقُولُونَ لَئِن رَّجَعْنَآ إِلَى ٱلْمَدِينَةِ لَيُخْرِجَنَّ ٱلْأَعَزُّ
مِنْهَا ٱلْأَذَلَّ ۚ وَلِلَّهِ ٱلْعِزَّةُ وَلِرَسُولِهِۦ وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَلَٰكِنَّ
ٱلْمُنَٰفِقِينَ لَا يَعْلَمُونَ ۝٨ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ لَا تُلْهِكُمْ
أَمْوَٰلُكُمْ وَلَآ أَوْلَٰدُكُمْ عَن ذِكْرِ ٱللَّهِ ۚ وَمَن يَفْعَلْ
ذَٰلِكَ فَأُو۟لَٰٓئِكَ هُمُ ٱلْخَٰسِرُونَ ۝٩ وَأَنفِقُوا۟ مِن مَّا رَزَقْنَٰكُم
مِّن قَبْلِ أَن يَأْتِىَ أَحَدَكُمُ ٱلْمَوْتُ فَيَقُولَ رَبِّ لَوْلَآ أَخَّرْتَنِىٓ
إِلَىٰٓ أَجَلٍ قَرِيبٍ فَأَصَّدَّقَ وَأَكُن مِّنَ ٱلصَّٰلِحِينَ ۝١٠ وَلَن
يُؤَخِّرَ ٱللَّهُ نَفْسًا إِذَا جَآءَ أَجَلُهَا ۚ وَٱللَّهُ خَبِيرٌۢ بِمَا تَعْمَلُونَ ۝١١

سورة التغابن

٥٥٥

2. **Ata përdorin si mburojë betimet e tyre dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut. Sa e ligë është kjo sjellje e tyre!**

3. **Ata besojnë e pastaj mohojnë, prandaj zemrat e tyre janë vulosur dhe ata nuk kuptojnë.**

4. **Kur i sheh ata në fizionomi, të mahnisin, e kur flasin, iu dëgjohet fjala! Po ata janë si trungje bosh e të mbështetur. Çdo thirrje e mendojnë sikur është kundër tyre. Ata janë armiq, prandaj ruaju prej tyre! Allahu i vraftë, si shmangen nga e vërteta!**

5. **Kur u thuhet: "Ejani tek i Dërguari i Allahut, se ai do të kërkojë falje për ju", ata tundin kokën dhe i sheh tek të kthejnë shpinën me fodullëk.**

6. **Njësoj është: kërkon apo nuk kërkon falje për ta, sepse Allahu nuk ka për t'i falur kurrsesi! Nuk ka dyshim se Allahu nuk i udhëzon zullumqarët.**

Shpjegimi i ajeteve

Me ardhjen e Profetit (a.s.) në Medinë, muslimanët u shtuan dhe Islami u fuqizua. Gjatë kësaj kohe, pati njerëz prej dy fiseve të mëdha të Medinës, Eus dhe Hazrexh, që nuk e kishin pranuar Islamin me zemër, por thjesht shfaqeshin si të tillë. Brenda në zemra ata fshihnin kufrin, ndërsa silleshin si muslimanë thjesht e vetëm për të ruajtur jetën, pasurinë dhe emrin e tyre. Allahu i Lartësuar solli në Kuran një përshkrim të qartë të tyre, në mënyrë që ata të njiheshin dhe që muslimanët e sinqertë të kishin kujdes dhe të ruheshin prej tyre.

Thotë Allahu i Lartësuar:

- **"Kur vijnë tek ti munafikët, thonë: "Dëshmojmë se ti je vërtet i dërguari i Allahut!""** - Kur ata shkonin te Profeti (a.s.), dëshmonin para tij se e besonin si të dërguar të Zotit. Por kjo dëshmi ishte thjesht një hipokrizi, edhe pse Profeti (a.s.) nuk kishte aspak nevojë për dëshminë apo mbështetjen e tyre, pasi sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

- **"Allahu e di se ti je i dërguari i Tij, por Allahu dëshmon se munafikët janë gënjeshtarë!"** - Allahu i Lartësuar dëshmon se ata gënjejnë kur thonë se të besojnë ty si profet të Tij. Deklaratat e tyre janë të pavërteta dhe nuk u burojnë nga zemrat. Ato thuhen për shkaqe të tjera, të cilat Allahu i Lartësuar na i sqaron më pas:

- "Ata përdorin si mburojë betimet e tyre dhe pengojnë të tjerët nga rruga e Allahut." – Duke u betuar, ata përpiqeshin të mbulonin hipokrizinë e tyre. Kështu, ata e privuan veten nga udhëzimi i drejtë i Zotit. Me hipokrizinë e tyre, ata mundoheshin të helmonin e devijonin edhe të tjerët, të cilët

nuk ishin në dijeni dhe nuk e dallonin hipokrizinë e tyre.

- "Sa e ligë është kjo sjellje e tyre!" – Ishte e ligë, sepse ata hiqeshin sikur besonin, ndërkohë që në zemër fshihnin kufrin. Jo vetëm kaq, por u betoheshin të tjerëve se ishin të sinqertë, që edhe ata t'i shihnin si besimtarë.

- "Ata besojnë e pastaj mohojnë, prandaj zemrat e tyre janë vulosur dhe ata nuk kuptojnë." - Ata arritën në këtë gjendje, për shkak se nuk ishin të qëndrueshëm në mbajtjen dhe respektimin e imanit të vërtetë, ashtu siç i takon atij, por nga njëra anë besonin, pastaj mohonin. Për pasojë, Allahu ua vulosi zemrat, në mënyrë që në to të mos hynte kurrë e mira. Ata e merituan këtë ndëshkim, sepse shpërfillën besimin e vërtetë.

- "Kur i sheh ata në fizionomi, të mahnisin, e kur flasin, iu dëgjohet fjala!" – Po t'i shohësh, ata të mahnisin me pamjen e tyre; edhe kur flasin, atyre u dëgjohet fjala. Kështu, ata gjithmonë rregullojnë pamjen dhe fjalët e tyre, që të tjerët të çuditen me ta dhe të mos shohin se çfarë fshihet pas tyre. E vërteta është se pas fizionomisë dhe fjalëve të tyre nuk ka asgjë prej moralit të mirë dhe as prej udhëzimit të drejtë, për të cilin urdhëron feja e Zotit. Ata janë ashtu sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

- "Po ata janë si trungje bosh e të mbështetur." - Ata janë të padobishëm, madje sjellin veçse dëm.

Allahu i Lartësuar vazhdon të tregojë të tjera cilësi të ulëta të tyre:

- "Çdo thirrje e mendojnë sikur është kundër tyre." - Kjo ndodh për shkak të dobësisë së zemrës së tyre, sepse ata janë frikacakë. Zemra e tyre është e mbushur me dyshime dhe ata janë gjithmonë të frikësuar se mos u zbulohet ajo që e fshehin.

- "Ata janë armiq, prandaj ruaju prej tyre!" – Në fakt, këta janë armiq më të rrezikshëm sesa armiqtë e deklaruar. Munafikët shfaqen si miq dhe të dashur, por në të vërtetë janë armiq të përbetuar, që thurin kurthe dhe intriga. Për këtë arsye, duhet kujdes i madh për t'u ruajtur prej tyre. Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu i vraftë, si shmangen nga e vërteta!" - Si e braktisin ata fenë Islame, pasi iu bënë të qarta argumentet dhe mësimet e mrekullueshme të saj, për të përqafuar kufrin, i cili nuk u sjell asnjë dobi, por veçse dëshpërim dhe shkatërrim?!

- "Kur u thuhet: "Ejani tek i Dërguari i Allahut, se ai do të kërkojë falje për ju"..." - Kur munafikët ftoheshin që të shkonin te Profeti (a.s.), që ai të kërkonte falje për ta, që gjendja e tyre të rregullohej dhe veprat e tyre të pranoheshin, ata e refuzonin në mënyrë të prerë një ftesë të tillë. Allahu i Lartësuar thotë:

- "...ata tundin kokën dhe i sheh tek të kthejnë shpinën me fodullëk." – Ata tundnin kokën, në shenjë mospranimi të ftesës për t'i kërkuar ndjesë Profetit (a.s.) dhe për t'i kërkuar atij që të lutej për faljen e tyre. Përkundrazi, ata do të vazhdonin të pengonin njerëzit nga e vërteta, për shkak të urrejtjes që kishin për të. Ata tregonin

mendjemadhësi ndaj pasimit të rrugës së drejtë.

Kështu vepronin munafikët kur ftoheshin për të shkuar te Profeti (a.s.), që ai të lutej dhe të kërkonte falje për ta. Ky ishte, sigurisht, tregues i butësisë së Allahut të Lartësuar dhe i nderimit për Profetin e tij, duke mos e bërë të mundur që ata të shkonin tek ai dhe t'i kërkonin të lutej për ta. Profeti i Zotit nuk mund të binte në atë nivel dhe të bënte lutje që nuk do t'i pranoheshin. Për të tillë njerëz është njëlloj, kërkon apo s'kërkon falje për ta, sepse Allahu i Madhëruar nuk ka për t'i falur ata:

- **"Njësoj është: kërkon apo nuk kërkon falje për ta, sepse Allahu nuk ka për t'i falur kurrsesi!"** - Ata janë njerëz të prishur, që kanë dalë nga rruga e bindjes ndaj Allahut të Lartësuar dhe i kanë dhënë përparësi kufrit kundrejt imanit. Si të tillë, kërkimi i faljes nga ana e Profetit (a.s.) nuk do t'u bëjë atyre dobi.

Kështu, Allahu i Lartësuar e nderoi Profetin e Tij duke e ruajtur që të mos bënte lutje të pafrytshme. Allahu i Lartësuar ka thënë: "Kërkon falje për ta apo nuk kërkon, edhe sikur të kërkosh shtatëdhjetë herë falje për ta, Allahu nuk do t'i falë, sepse ata mohojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Allahu nuk i udhëzon në rrugë të drejtë ata që shkelin kufijtë." [Teube 80].

- **"Nuk ka dyshim se Allahu nuk i udhëzon zullumqarët."** – Arsyeja është se ata nuk e meritojnë udhëzimin e Allahut të Lartësuar. Ata refuzojnë të kryejnë ato vepra që Zoti i ka përcaktuar si shkaqe të udhëzimit.

Ajetet 7 – 8

7. Ata thonë: "Mos u jepni asgjë atyre që janë me të Dërguarin e Allahut, derisa ata ta braktisin!" Por vetëm Allahut i përkasin pasuritë e qiejve e të Tokës, ndonëse munafikët nuk e kuptojnë.
8. Ata thonë: "Kur të kthehemi në Medinë, pa dyshim, krenarët do t'i dëbojnë prej saj të përçmuarit!" Në fakt, e tërë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por munafikët nuk e dinë këtë.

Shpjegimi i ajeteve

Këtu tregohet urrejtja e madhe e munafikëve ndaj Profetit (a.s.) dhe muslimanëve, urrejtje që kishte mbushur plotësisht zemrat e tyre. Kur ata shihnin se si sahabët rrethonin me dashuri dhe ngrohtësi Profetin (a.s.) dhe garonin se kush e kush më parë ta kënaqte atë, duke zbatuar urdhrat dhe porositë e tij, këta të mjerë - duke ëndërruar dhe shpresuar gjëra të kota - thoshin:

- **"Mos u jepni asgjë atyre që janë me të Dërguarin e Allahut, derisa ata ta braktisin!"** – Kështu, ata pandehnin se po të mos ishte pasuria e munafikëve, muslimanët nuk do të bashkoheshin për të ndihmuar fenë e Allahut. A thua se besimtarët qëndronin rreth e rrotull Profetit (a.s.) dhe zbatonin urdhrat e tij me përkushtim, me shpresë se do të përfitonin pasuri nga këta të mjerë! Sigurisht, kjo qe një hamendje krejt e pabazë dhe e çuditshme. Munafikët ishin njerëzit më të përkushtuar për shkatërrimin e Islamit dhe të muslimanëve, dhe më koprracët njëkohësisht. E si mund të kishin të tilla pretendime ata njerëz?! Dokrrat e tyre mund t'i besonin veçse të paditurit e mendjelehtët, që nuk shohin realitetin e

gjërave. Duke ua përplasur në fytyrë pretendimin, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por vetëm Allahut i përkasin pasuritë e qiejve e të Tokës..." - Allahu furnizon atë që Ai dëshiron dhe e privon atë që Ai dëshiron. Është Allahu i Lartësuar Ai që ia mundëson dhe lehtëson furnizimin atij që Ai dëshiron, me urtësinë e Tij, dhe ia vështirëson atij që Ai dëshiron. Por këtë fakt nuk mund ta kuptojnë të gjithë, e aq më pak munafikët, prandaj i Lartësuari thotë:

- "...ndonëse munafikët nuk e kuptojnë." – Pikërisht për shkak të logjikës së dobët të tyre, ata thanë atë që thanë. Munafikët pretendonin që depot e furnizimit i kishin ata dhe i administronin sipas dëshirës së tyre. Përveç mendjelehtësisë, kjo tregonte edhe arrogancën e tyre, e cila duket më qartë në fjalët më pas:

- "Ata thonë: "Kur të kthehemi në Medinë, pa dyshim, kenarët do t'i dëbojnë prej saj të përçmuarit!"" - Kjo ndodhi në betejën e Murejsit,[31] gjatë së cilës pati një grindje mes ensarëve dhe muhaxhirëve për një çështje të caktuar. Në këtë situatë u shfaq hipokrizia e munafikëve. I pari i tyre, Abdullah Ibn Ubej Ibn Seluli, duke nënkuptuar muhaxhirët, tha: "Puna jonë me këta është ai që tha: "Jepi bukë qenit tënd, që të të kafshojë!". Pastaj tha: "Kur të kthehemi në Medinë, krenarët do t'i dëbojnë prej saj të përçmuarit." Kështu, sipas tij, ai dhe vëllezërit e tij munafikë na ishin krenarët e fisnikët, ndërsa Profeti i Allahut dhe shokët e tij ishin të poshtëruarit, ndërkohë që e vërteta ishte krejtësisht e kundërta, siç thotë i Lartësuari:

- "Në fakt, e tërë krenaria i takon Allahut, të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve, por

---

[31] Kjo ndodhi në muajin *shaban* të vitit 5. Shkak i saj u bë një informacion tjetër që i mbërriti Pejgamberit (a.s.), se Harith Ibn Ebi Dirari, prijësi i fisit Benu Mustalik, kishte filluar te fisi i tij dhe tek arabët e tjerë, një fushatë organizimi për të mbledhur një ushtri dhe për të sulmuar Pejgamberin (a.s.). Pejgamberi (a.s.), për të verifikuar këtë lajm, dërgoi Burejde Ibn Kusaj el Selemin. Ky shkoi atje dhe takoi vetë Harith Ibn Ebu Dirarin, prej të cilit verifikoi lajmin e përgatitjeve për luftë. Fill pas lajmit, Pejgamberi (a.s.) organizoi dhe nxiti besimtarët për luftë, të cilët menjëherë iu përgjigjën ftesës. Bashkë me të, dolën për luftë edhe një grup munafikësh, të cilët nuk kishin luftuar kurrë më parë me Pejgamberin (a.s.). Pejgamberi (a.s.) la si mëkëmbës të tij në Medinë, Zejd Ibn Harithe, por thuhet edhe se ka lënë Ebu Dherrin, apo dhe Numejle Ibn Abdullah el Lejthin. Marshimi filloi natën e së hënës, dy net pasi kishte hyrë muaji *shaban*. Harith Ibn Ebu Dirari dhe pasuesit e tij, kur u njoftuan rreth sulmit që Pejgamberi (a.s.) kish planifikuar kundër tyre, dhe kur morën vesh se muslimanët e kishin kapur spiunin e dërguar prej tij dhe e kishin vrarë, u tmerruan. Ky informacion frikësoi edhe ato pak fise arabe që i ishin bashkëngjitur ushtrisë së tij deri në ato momente, duke i detyruar të shpërndahen dhe të largohen prej tij. Pejgamberi (a.s.) mbërriti në Murejs, që ishte vendi i puseve të tyre, dhe e ngriti çadrën e tij pikërisht në atë vend. Së bashku me Pejgamberin (a.s.), në këtë luftë ishin Aisheja (r.a.) dhe Ummu Selemeja (r.a.). Këtu filloi përgatitja për luftë. Vetë Pejgamberi (a.s.) i renditi në rreshta shokët e tij. Flamurin e muhaxhirëve e mbante Ebu Bekër el Sidiku, ndërsa flamurin e ensarëve e mbante Sad Ibn Ubade...

Duke u kthyer nga kjo luftë, kreu i munafikëve, Ibn Ubeji, tha: "Kur të kthehemi në Medinë, fisnikët dhe të lartit e Medinës do t'i flakin jashtë të ultit dhe të shpërfillurit (nënkuptonte Pejgamberin (a.s.))." Zejd Ibn Erkami, që i dëgjoi këto fjalë, shkoi dhe i tha Pejgamberit (a.s.), por menjëherë Ibn Ubeji shkon te Pejgamberi (a.s.) dhe i betohet se nuk e kishte thënë kurrë diçka të tillë. Pejgamberi (a.s.) heshti. Pas kësaj, Allahu i Lartësuar shpalli suren Munafikun, ku mbështeste dhe vërtetonte fjalën e Zejdit. Pejgamberi (a.s.) e kapi Zejdin për veshi dhe i tha: "Gëzohu Zejd, se Allahu i Lartësuar e vërtetoi fjalën tënde!" Pastaj tha për Zejdin: "Ky e kreu detyrën ndaj Allahut me veshët e vet." Në këtë çast, Omeri i tha Pejgamberit (a.s.): "O i Dërguar i Allahut! Urdhëro Abad Ibn Bishrin që t'ia heqë kokën atij (Ibn Ubejit)!" Pejgamberi (a.s.) ia ktheu: "E si do të vejë puna, kur njerëzit të flasin dhe të thonë se Muhamedi po vret shokët e vet?!" [Shih "*Zadul Mead*", vëll. 3, fq. 123].

munafikët nuk e dinë këtë." - Këta janë krenarët e vërtetë, ndërsa munafikët dhe vëllezërit e tyre idhujtarë janë të përçmuarit. Munafikët nuk e dinë dhe nuk e kuptojnë një fakt të tillë, prandaj dhe pandehin se janë krenarët. Pastaj Allahu i Lartësuar thotë:

Ajetet 9 – 11

9. O ju që keni besuar, as pasuria e as fëmijët tuaj të mos ju shmangin prej përkujtimit të Allahut! Ata që veprojnë ashtu, ata janë të humbur!
10. Shpenzoni nga ajo që Ne ju kemi dhënë, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja e të thotë: "O Zoti im, përse nuk ma shtyve edhe pak afatin, që të jepja sadaka e të bëhesha prej të mirëve!"
11. Por Allahu asnjërit nuk ia shtyn afatin, kur ai i vjen. Allahu është i Gjithëdijshëm për ato që ju punoni.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, as pasuria e as fëmijët tuaj të mos ju shmangin prej përkujtimit të Allahut!" - Allahu i Lartësuar i urdhëron adhuresit e Tij besimtarë që të shtojnë dhe shpeshtojnë përkujtimin e Tij. Fitorja e çdo të mire, shpëtimi nga çdo e keqe dhe arritja e çdo suksesi në dynja dhe ahiret janë të lidhura ngushtë me përkujtimin e shpeshtë të Allahut të Lartësuar. Allahu i Madhëruar i këshillon ata që të bëjnë kujdes dhe të mos hutohen nga fëmijët e tyre dhe pasuria. Nuk ka dyshim se interesi i njeriut për fëmijët dhe pasurinë e tij është diçka e natyrshme, por shumica e njerëzve u japin përparësi këtyre gjërave kundrejt dashurisë për Allahun e Lartësuar, dhe kjo është një humbje e madhe. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ata që veprojnë ashtu, ata janë të humbur!" – Ata që i pengon pasuria dhe fëmijët prej përkujtimit të Allahut të Lartësuar dhe plotësimit të detyrimeve ndaj Tij, ata e kanë shpërfillur të mirën dhe janë në humbje të madhe. Ata e kanë privuar veten nga mirësia e pafundme, sepse i japin përparësi kësaj jete të shkurtër, që do të zhduket shumë shpejt, kundrejt asaj që do të mbetet përgjithmonë. Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: "Nuk ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë veçse sprovë, ndërsa tek Allahu është shpërblimi i madh." [Tegabun 15].

- "Shpenzoni nga ajo që Ne ju kemi dhënë..." - Këtu flitet për të gjitha llojet e shpenzimeve, qofshin të detyrueshme, qofshin të pëlqyeshme. Ndër shpenzimet e domosdoshme mund të përmendim zekatin, kompensime të ndryshme për vepra të caktuara, shpenzimet për gruan, fëmijët, shërbëtorët, robërit etj. Ndërsa shpenzimet e pëlqyeshme e vullnetare janë të shumëllojshme e me gamë të gjerë. Ato duhen kryer duke synuar dobinë e fesë së Allahut të Lartësuar dhe bamirësinë ndaj krijesave, sipas rëndësisë dhe meritës së tyre.

Allahu i Lartësuar na urdhëron që të shpenzojmë "prej asaj që Ai na ka dhënë", për të treguar se nuk kërkon prej nesh të shpenzojmë të gjithë pasurinë tonë, nuk kërkon të na rëndojë me këtë detyrim të vështirë. Ai urdhëron që të shpenzojmë vetëm një pjesë të pasurisë, aq sa të na vijë më lehtë, pa u dëmtuar.

Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar i udhëzon besimtarët që të tregohen mirënjohës ndaj Tij, që ua ka dhuruar pasurinë që kanë, por, gjithashtu, i porosit

që të ndihmojnë vëllezërit e tyre në nevojë. Kështu, ata do të jenë bamirës qoftë në aspektin e përkryerjes së adhurimit ndaj Allahut të Lartësuar, qoftë në aspektin e ndihmës ndaj krijesave, para se t'i kapë vdekja në befasi.

Me vdekjen, njeriut i ndërpritet mundësia për të kryer më vepra të mira, prandaj Allahu i Lartësuar na e përkujton këtë fakt, duke na nxitur që të rendim në kryerjen e veprave të mira:

- "...para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja..." - Kur i vjen vdekja njeriut që nuk ka bërë vepra të mira, ai, i dëshpëruar nga shpërfillja e mundësive të tij të shumta për të kryer vepra të mira, dëshiron të kthehet edhe një herë në dynja, por kjo është e pamundur. Atëherë, ky njeri do të thotë:

- "O Zoti im, përse nuk ma shtyve edhe pak afatin, që të jepja sadaka e të bëhesha prej të mirëve!" – Kuptimi: Më lër të jetoj edhe ca, që të mund të rregulloj ato që shpërfilla deri tani: të besoj drejt, të punoj me sinqeritet sipas këtij besimi dhe të shpenzoj prej pasurisë time, që të shpëtoj nga ndëshkimi dhe të arrij shpërblimin e madh të premtuar nga Allahu për vepërmirët. Por koha për të tilla qëllime tashmë ka përfunduar dhe nuk mund të kthehet më pas, siç thotë Allahu i Lartësuar tha:

- "Por Allahu asnjërit nuk ia shtyn afatin, kur ai i vjen." - Nëse njeriut i vjen çasti i vdekjes, i vendosur nga Allahu i Lartësuar, ai nuk mund të shtyhet për më vonë.

- "Allahu është i Gjithëdijshëm për ato që ju punoni." – Allahu ka për t'ju shpërblyer në bazë të diturisë së Tij të plotë për veprat që keni kryer, qofshin ato të mira apo të këqija.

Këtu përfundon tefsiri i sures Munafikun. Vetëm Allahut i takon falënderimi dhe lavdërimi!

Surja 64: Et Tegabun (medinase) 18 ajete


Ajetet 1 – 4

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Vetëm Allahut i bën *tesbih* gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Vetëm Atij i përket i tërë pushteti dhe vetëm Atij i takon lavdia! Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.
2. Është Ai që ju krijoi që mes jush të ketë mohues, ashtu edhe besimtarë. Allahu e sheh gjithçka se çfarë bëni.
3. Ai krijoi qiejt dhe Tokën për të vërtetën. Ai ju dha pamjen që keni dhe këtë pamje jua bëri të bukur. Vetëm tek Ai është kthimi juaj.
4. Ai e di çfarë ka në qiej e në Tokë, di atë që e fshihni dhe atë që e shfaqni hapur. Allahu është i Gjithëdijshëm edhe për atë që fshihet në kraharor.

Shpjegimi i ajeteve

- "Vetëm Allahut i bën *tesbih* gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë." - Në këto ajete të mrekullueshme përmenden disa nga atributet madhështore të Allahut të Lartësuar. Në to flitet për meritën e plotë të Allahut për të qenë i adhuruar, flitet për zotërimin e Tij absolut dhe për faktin se Ai nuk ka kurrë nevojë për krijesat e Tij, ndërkohë që të gjitha krijesat janë të varfëra, nevojtare, të përulura dhe të nënshtruara ndaj Tij. Gjithçka në qiej dhe në Tokë i bën


الجزء الثامن والعشرون سورة التغابن

بسم الله الرحمن الرحيم

يُسَبِّحُ لِلَّهِ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ
وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ ﴿١﴾ هُوَ الَّذِي خَلَقَكُمْ فَمِنكُمْ كَافِرٌ وَمِنكُم
مُّؤْمِنٌ ۗ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ ﴿٢﴾ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ
بِالْحَقِّ وَصَوَّرَكُمْ فَأَحْسَنَ صُوَرَكُمْ ۖ وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ﴿٣﴾ يَعْلَمُ
مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَيَعْلَمُ مَا تُسِرُّونَ وَمَا تُعْلِنُونَ ۚ وَاللَّهُ
عَلِيمٌ بِذَاتِ الصُّدُورِ ﴿٤﴾ أَلَمْ يَأْتِكُمْ نَبَؤُا الَّذِينَ كَفَرُوا مِن قَبْلُ
فَذَاقُوا وَبَالَ أَمْرِهِمْ وَلَهُمْ عَذَابٌ أَلِيمٌ ﴿٥﴾ ذَٰلِكَ بِأَنَّهُ كَانَت تَّأْتِيهِمْ
رُسُلُهُم بِالْبَيِّنَاتِ فَقَالُوا أَبَشَرٌ يَهْدُونَنَا فَكَفَرُوا وَتَوَلَّوا ۚ وَّاسْتَغْنَى
اللَّهُ ۚ وَاللَّهُ غَنِيٌّ حَمِيدٌ ﴿٦﴾ زَعَمَ الَّذِينَ كَفَرُوا أَن لَّن يُبْعَثُوا ۚ قُلْ بَلَىٰ
وَرَبِّي لَتُبْعَثُنَّ ثُمَّ لَتُنَبَّؤُنَّ بِمَا عَمِلْتُمْ ۚ وَذَٰلِكَ عَلَى اللَّهِ يَسِيرٌ ﴿٧﴾
فَآمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ وَالنُّورِ الَّذِي أَنزَلْنَا ۚ وَاللَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ خَبِيرٌ
﴿٨﴾ يَوْمَ يَجْمَعُكُمْ لِيَوْمِ الْجَمْعِ ۖ ذَٰلِكَ يَوْمُ التَّغَابُنِ ۗ وَمَن يُؤْمِن بِاللَّهِ
وَيَعْمَلْ صَالِحًا يُكَفِّرْ عَنْهُ سَيِّئَاتِهِ وَيُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِن
تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ۚ ذَٰلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ﴿٩﴾

٥٥٦

tesbih Allahut të Lartësuar, duke e lavdëruar dhe duke e adhuruar Atë si Një, të Vetëm dhe të Pastër nga çdo e metë dhe mangësi.

- "Vetëm Atij i përket i tërë pushteti dhe vetëm Atij i takon lavdia!" - Pushteti është totalisht vetëm në dorë të Allahut. Asnjë krijesë nuk del jashtë pushtetit të Tij. Lavdia e plotë, falënderimi dhe mirënjohja i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar. Ai është i lavdëruar për cilësitë e Tij të plota dhe absolute. Ai është i lavdëruar për gjithçka që ka krijuar dhe e ka bërë të ekzistojë. Allahu meriton lavdinë për çdo ligj që ka vendosur për funksionimin e gjithësisë dhe për çdo ligj të sheriatit që e ka vendosur për t'u zbatuar nga krijesat. Ai është i lavdëruar për të gjitha mirësitë që ka dhuruar me bujarinë e Tij. Allahut i takon mirënjohja e plotë!

- "Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka." - Fuqia e Allahut është absolute. Nuk ka asgjë të pamundur për Allahun, nëse Ai dëshiron të bëjë diçka.

- "Është Ai që ju krijoi që mes jush të ketë mohues, ashtu edhe besimtarë." - Allahu i krijoi robërit dhe prej tyre bëri që të ketë besimtarë dhe mohues. Qoftë besimi i tyre, qoftë mohimi i tyre, gjithçka është përcaktuar nga Allahu dhe nuk del jashtë pushtetit të Tij. Allahu i ka dhënë çdokujt forcë dhe vullnet të mjaftueshëm për të arritur gjithçka që dëshiron. Robërit ose do të zbatojnë urdhrat e Zotit, në emër të dashurisë, madhërimit dhe nënshtrimit ndaj Tij, ose do ta shpërfillin këtë që u kërkohet, me zgjedhjen e tyre të lirë. Por ata, gjithsesi, nuk mund të dalin aspak nga pushteti i Allahut të Lartësuar, të Gjithëdijshëm dhe të Urtë, i Cili ia jep dhe ia lehtëson udhëzimin e drejtë atij që e meriton.

Më pas, i Lartësuari thotë:

- "Allahu e sheh gjithçka se çfarë bëni." - Ai i sheh të gjitha veprat e robërve dhe qëllimet e tyre, për t'i shpërblyer më pas të sinqertët, duke u dhuruar udhëzimin, dhe për t'u dhënë hakun gënjeshtarëve, duke i privuar nga udhëzimi i drejtë, të cilin nuk e meritojnë.

Pasi na kujtoi krijimin e njeriut, i cili do të mbajë përgjegjësi për detyrimet që i janë ngarkuar, Allahu i Lartësuar flet për krijesat e tjera të Tij, duke thënë:

- "Ai krijoi qiejt dhe Tokën për të vërtetën." - Allahu krijoi qiejt, Tokën dhe gjithçka që ndodhet mes këtyre krijesave madhështore. Në krijimin e Tij të bukur e të rregullt nuk mund të gjesh asnjë mangësi.

Allahu i krijoi të gjitha këto krijesa për hir të një vërtete të madhe, të synuar nga Ai. Ai i krijoi ato me një urtësi të madhe dhe për qëllime të larta.

- **"Ai ju dha pamjen që keni dhe këtë pamje jua bëri të bukur."** - Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: "Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur." [Tin 4]. Njeriu është krijesa me formën më të mirë dhe me pamjen më të bukur.

Më pas, Allahu i Lartësuar i kujton ata për ditën e takimit me Të:

- "Vetëm tek Ai është kthimi juaj." - Tek Allahu do të ktheheni Ditën e Gjykimit, kur Allahu i Lartësuar do t'ju shpërblejë me bamirësinë dhe drejtësinë e Tij për besimin ose për mohimin tuaj. Ai do t'ju pyesë për mirësitë e shumta që ju ka falur: a u treguat mirënjohës apo jo ndaj tyre.

I Lartësuari përshkruan më tej dijen e Tij gjithëpërfshirëse, duke thënë:

- "Ai e di çfarë ka në qiej e në Tokë, di atë që e fshihni dhe atë që e shfaqni hapur." – Allahu di gjërat e padukshme dhe ato të dukshme, të fshehta dhe të hapura. Ai thotë gjithashtu:

- "Allahu është i Gjithëdijshëm edhe për atë që fshihet në kraharor." - Allahu është i Gjithëditur qoftë për qëllimet e mira që fshihen brenda gjoksit, të cilat Ai i do dhe i shpërblen pa masë me bujarinë e Tij, qoftë edhe për qëllimet e këqija që fshihen brenda tyre, të cilat Allahu i urren dhe e kërcënon me ndëshkim ata që nuk pendohen.

Atëherë, nëse Allahu është i Gjithëdijshëm për të fshehtat që fsheh kraharori, njeriu i mençur dhe i urtë punon dhe përpiqet gjithmonë për të ruajtur të pastër shpirtin e tij. Ai përpiqet ta pastrojë atë nga çdo ves i ulët e qëllim i keq, nga njëra anë, dhe ta pajisë atë me virtyte të larta, nga ana tjetër.

Ajetet 5 – 6

5. A nuk ju kanë treguar për ata të mëparshmit që nuk besonin, ndaj dhe vuajtën pasojat e rënda të veprave të veta? Ata i pret një dënim tepër i dhimbshëm.
6. Kjo, për shkak se, kur atyre u shkonin të dërguarit me argumente të qarta, ata thoshin: "Vallë, njerëzit do të na e tregojnë ne udhën?" Kështu, ata nuk besuan dhe kthyen shpinën. Por Allahu nuk ka nevojë për ta, se Allahu është i Pasur e i Lavdëruar vetvetiu.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk ju kanë treguar për ata të mëparshmit që nuk besonin, ndaj dhe vuajtën pasojat e rënda të veprave të veta?" - Duke përshkruar cilësitë e Tij të plota, prej të cilave robërit njohin realisht madhështinë e Tij, Allahu i Lartësuar i nxit që ta adhurojnë Atë, të bëjnë çdo gjë të përcaktuar nga Allahu për ta kënaqur Atë dhe t'i largohen çdo vepre që e zemëron Atë.

Në ajetet që vijojnë, Allahu i Lartësuar na tregon rreth popujve të shkuar, historitë e të cilëve janë përcjellë me saktësi edhe nga profetët e Tij dhe vazhdojnë të përkujtohen ndër breza. Allahu i Lartësuar na rrëfen se çfarë bëri me këta popuj, të cilët, kur profetët u përçuan të vërtetën dhe porositë e Tij, ata i mohuan dhe i shpërfillën me urrejtje e armiqësi. I Lartësuari na bën të ditur se të gjithë ata që mohuan shpalljet dhe profetët e Tij, Ai i goditi me një ndëshkim të rëndë dhe poshtërues që në jetën e dynjasë, për të vuajtur kështu pasojat e mohimit të tyre. Por

ndëshkimi i Allahut në ahiret është shumë herë më i dhimbshëm. Ai thotë:

- **"Ata i pret një dënim tepër i dhimbshëm."** - Në jetën tjetër, për ta do të ketë ndëshkim tepër të dhimbshëm. Allahu i Lartësuar tregon edhe një herë shkakun e këtij ndëshkimi, kur thotë:

- "Kjo, për shkak se, kur atyre u shkonin të dërguarit me argumente të qarta, ata thoshin: "Vallë, njerëzit do të na e tregojnë ne udhën?"" – Ata morën ndëshkimin e merituar, sepse kur profetët e Zotit dërgoheshin tek ata me argumente të qarta, që bënin të dallueshme të vërtetën nga e kota, ata shprehnin neveri e arrogancë ndaj profetëve dhe mesazhit që ata përcillnin. Ata thoshin: "Vallë, njerëzit do të na e tregojnë ne udhën? Përse duhet t'ju ndjekim ju, ndërkohë që ju jeni njerëz, sikurse dhe ne? Çfarë të veçante keni ju, që jeni më të mirë se ne?" Në një ajet tjetër thuhet: "Të dërguarit e tyre u thanë: "Ne jemi veçse njerëz, sikurse edhe ju, por Allahu ia dhuron mirësinë atij robi të Vet që Ai dëshiron. Ne nuk na takon t'ju sjellim ndonjë argument, përveçse me dëshirën e Allahut. Atëherë, vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!". [Ibrahim 11].

Ata nuk pranuan ta merrnin në konsideratë mirësinë që Zoti u dhuroi profetëve të Tij, duke i bërë ata edukatorët dhe udhëzuesit e krijesave. Në vend që të tregoheshin mirënjohës, ata u treguan kryeneçë dhe refuzuan të bindeshin e të jetonin sipas porosive hyjnore. Si pasojë, ata u sprovuan dhe u dënuan, duke u bërë adhurues të gurëve, të pemëve apo të çdo gjëje tjetër veç Allahut. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kështu, ata nuk besuan dhe kthyen shpinën." - Ata e mohuan Allahun e Lartësuar dhe refuzuan t'i bindeshin Atij. Por harruan të mjerët se, në këtë mënyrë, dëmtuan vetveten dhe se Allahu nuk ka nevojë për adhurimin e krijesave. I Lartësuari thotë:

- "Por Allahu nuk ka nevojë për ta, se Allahu është i Pasur e i Lavdëruar vetvetiu." - Atë nuk e dëmton aspak mosadhurimi nga ana e krijesave dhe futja e tyre në humbje, sepse Ai është *Ganijun* - i Pasur dhe *Hamid* - i Lavdëruar vetvetiu. Allahu është i Pasuri, të Cilit i takon pasuria e plotë dhe absolute në të gjitha drejtimet. Allahut i takon, gjithashtu, lavdërimi i plotë për fjalët, veprat dhe të gjitha atributet e Tij.

Ajeti 7

7. Mohuesit pandehin se nuk do të ringjallen kurrë. Thuaju: "Po, për Zotin tim, patjetër do të ringjalleni dhe do t'ju paraqitet gjithçka që keni bërë. Kjo është lehtë për Allahun!"

Shpjegimi i ajetit

- "Mohuesit pandehin se nuk do të ringjallen kurrë." - Allahu i Lartësuar na tregon rreth mohimit që qafirët i bëjnë me kokëfortësi ringjalljes, pa pasur për këtë asnjë lloj diturie të sigurt, udhëzim të qartë apo libër hyjnor.

Më i nderuari dhe më i zgjedhuri i krijesave urdhërohet që të betohet në Zotin e tij se ringjallja e krijesave është një çështje e sigurt, që nuk ka asnjë dyshim. Dita kur ata do të shpërblehen për veprat e tyre të poshtra dhe për mohimin e të vërtetës ka për të ardhur patjetër:

- "Thuaju: "Po, për Zotin tim, patjetër do të ringjalleni dhe do t'ju paraqitet gjithçka që keni bërë. Kjo është lehtë për Allahun!"" - Ringjallja dhe llogaria e krijesave për gjithçka që kanë bërë, e madhe apo e vogël qoftë, edhe pse për krijesat duket si diçka e vështirë, madje e pamundur që të arrihet, ajo nuk është aspak e pamundur për Allahun. Sikur të mblidheshin të gjitha krijesat dhe të përpiqeshin të gjitha së bashku për të ringjallur një njeri të vetëm, kurrë nuk do t'ia arrinin. Por Allahu i Lartësuar, nëse dëshiron diçka, mjafton të thotë "Bëhu!" dhe ajo bëhet. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "Kur t'i fryhet Surit, do të bjerë e vdekur gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu. Pastaj, atij do t'i fryhet edhe një herë tjetër, dhe pastaj të gjithë ata, të ngritur, do të presin!" [Zumer 68].

Ajeti 8

8. Atëherë, besojeni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Dritën që Ne e zbritëm! Allahu është i Gjithëditur për atë që ju veproni!

Shpjegimi i ajetit

- "Atëherë, besojeni Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Dritën që Ne e zbritëm!" - Në ajetet e mësipërme, Allahu i Lartësuar foli për ata që nuk e besojnë ringjalljen dhe llogarinë e drejtë në Ditën e Gjykimit. Pa dyshim, mohimi i Ditës së Gjykimit është tregues i mohimit të Zotit dhe Shpalljes së Tij, prandaj në ajetet vijuese Allahu i Lartësuar na urdhëron të bëjmë diçka që na ruan nga ndëshkimi, shkatërrimi dhe dëshpërimi. Ai na urdhëron për të besuar drejt Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Librin e Tij, bazuar në dije të saktë dhe të sigurt. Allahu e quan Librin e Tij "*Nur*", dritë. Drita është e kundërta e errësirës dhe larguesja e saj. Nuk ka dyshim se Libri të cilin Allahu i Lartësuar ia shpalli Profetit të Tij është i mbushur me dituri dhe ligje, që i ndriçojnë robit rrugën mes errësirës së frikshme të injorancës. Çdo lloj udhëzimi i kërkuar jashtë Librit të Allahut dhe Traditës së Profetit të Tij (s.a.u.s) dhe çdo lloj diturie e përftuar jashtë tyre, nëse nuk përputhet me mësimet e Shpalljes, atëherë sherri që vjen prej tyre është më i madh se mirësia që pritet. E tillë është çdo lloj njohurie, përveç atyre që plotësojnë disa kushte, si:


- të jenë në përputhje me qëllimet e mëdha, për të cilat u dërguan profetët;
- të ndihmojnë në përforcimin e besimit tek Allahu i Lartësuar, i Dërguari dhe te Shpallja e Tij;
- të sjellin një siguri të plotë në vërtetësinë e porosive që profetët sollën nga Zoti i tyre;
- të ndihmojnë që të punosh në mënyrë korrekte, duke kryer urdhrat dhe duke u larguar nga ndalesat, sipas besimit të drejtë.

Me pak fjalë, çdo njohuri që ndihmon të arrish këto synime të larta, është e vlefshme. Ndërsa njohuritë që të largojnë nga të tilla synime ose i cenojnë ato, janë të gjitha të dëmshme, në varësi të cenimit që ato u shkaktojnë synimeve të larta.

- "Allahu është i Gjithëditur për atë që ju veproni!" - Prandaj do t'ju shpërblejë sipas veprave që keni bërë, të mira apo të këqija qofshin.

Ajetet 9 – 10

9. Ditën e Ringjalljes, kur Ai t'ju tubojë, do të jetë dita e humbjes dhe fitimit. Kush beson Allahun dhe bën vepra të mira, Ai do t'ia fshijë të këqijat dhe do ta fusë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe


الجزء الثامن والعشرون سورة التغابن

وَالَّذِينَ كَفَرُوا۟ وَكَذَّبُوا۟ بِـَٔايَـٰتِنَآ أُو۟لَـٰٓئِكَ أَصْحَـٰبُ ٱلنَّارِ
خَـٰلِدِينَ فِيهَا ۖ وَبِئْسَ ٱلْمَصِيرُ ﴿١٠﴾ مَآ أَصَابَ مِن مُّصِيبَةٍ
إِلَّا بِإِذْنِ ٱللَّهِ ۗ وَمَن يُؤْمِنۢ بِٱللَّهِ يَهْدِ قَلْبَهُۥ ۚ وَٱللَّهُ بِكُلِّ
شَىْءٍ عَلِيمٌ ﴿١١﴾ وَأَطِيعُوا۟ ٱللَّهَ وَأَطِيعُوا۟ ٱلرَّسُولَ ۚ فَإِن
تَوَلَّيْتُمْ فَإِنَّمَا عَلَىٰ رَسُولِنَا ٱلْبَلَـٰغُ ٱلْمُبِينُ ﴿١٢﴾ ٱللَّهُ لَآ إِلَـٰهَ
إِلَّا هُوَ ۚ وَعَلَى ٱللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ ٱلْمُؤْمِنُونَ ﴿١٣﴾ يَـٰٓأَيُّهَا
ٱلَّذِينَ ءَامَنُوٓا۟ إِنَّ مِنْ أَزْوَٰجِكُمْ وَأَوْلَـٰدِكُمْ عَدُوًّا
لَّكُمْ فَٱحْذَرُوهُمْ ۚ وَإِن تَعْفُوا۟ وَتَصْفَحُوا۟ وَتَغْفِرُوا۟
فَإِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ﴿١٤﴾ إِنَّمَآ أَمْوَٰلُكُمْ وَأَوْلَـٰدُكُمْ
فِتْنَةٌ ۚ وَٱللَّهُ عِندَهُۥٓ أَجْرٌ عَظِيمٌ ﴿١٥﴾ فَٱتَّقُوا۟ ٱللَّهَ مَا ٱسْتَطَعْتُمْ
وَٱسْمَعُوا۟ وَأَطِيعُوا۟ وَأَنفِقُوا۟ خَيْرًا لِّأَنفُسِكُمْ ۗ وَمَن يُوقَ
شُحَّ نَفْسِهِۦ فَأُو۟لَـٰٓئِكَ هُمُ ٱلْمُفْلِحُونَ ﴿١٦﴾ إِن تُقْرِضُوا۟
ٱللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا يُضَـٰعِفْهُ لَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ۚ وَٱللَّهُ شَكُورٌ
حَلِيمٌ ﴿١٧﴾ عَـٰلِمُ ٱلْغَيْبِ وَٱلشَّهَـٰدَةِ ٱلْعَزِيزُ ٱلْحَكِيمُ ﴿١٨﴾

سورة الطلاق

٥٥٧

ku do të jenë përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe!

10. Ndërsa ata që nuk besojnë dhe i mohojnë argumentet Tona, ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Ky është përfundimi më i keq!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ditën e Ringjalljes, kur Ai t'ju tubojë, do të jetë dita e humbjes dhe fitimit." - Përkujtoni ditën kur Allahu i Lartësuar do t'i tubojë të gjithë, të parët dhe të fundit, në sheshin e madh.

Atë ditë, Ai do t'i shpërblejë robërit për veprat e tyre. Atë ditë do të dallohet qartë ndryshimi mes krijesave. Atë ditë do të ketë njerëz që do të ngrihen në gradat më të larta të *Ilijin*-it, në banesat ku i presin të gjitha mirësitë, begatitë dhe kënaqësitë e përgatitura nga Allahu i Lartësuar, me mëshirën dhe bujarinë e Tij. Atë ditë do të ketë grupe që do të zhyten të poshtëruar në skutat më të ulëta të Xhehenemit, të mbushura me tmerr, ankth e dëshpërim. Ai është vendi i ndëshkimit të ashpër. Si shpërblimet, ashtu edhe ndëshkimet e të gjitha gradave janë fryt i atyre çfarë krijesat bëjnë dhe përgatisin vetë, në ditët dhe netët e dynjasë.

I Lartësuari e përshkruan atë ditë si "*Jeumu Tegabun*". *Tegabun* është dallimi mes humbjes dhe fitimit. Pikërisht atë ditë do të shfaqet qartë dallimi që ekziston mes të fituarve dhe të humburve. Besimtarët do të fitojnë mirësi të shumta në tregtinë e tyre me Allahun e Lartësuar, ndërsa keqbërësit do të hidhërohen për humbjen e tyre të madhe.

Nëse dikush pyet se me çfarë mund të arrihet fitorja dhe çfarë e shkakton humbjen, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kush beson Allahun dhe bën vepra të mira..." - Domethënë, shkaqet që sjellin suksesin dhe mirësinë janë:

1. Besimi i plotë tek Allahu dhe i të gjitha çështjeve që Allahu i Madhëruar ka urdhëruar të besohen.

2. Kryerja e veprave të mira sipas këtij besimi, me sinqeritet për të fituar kënaqësinë e Allahut. Këtu futen të gjitha veprat e mira, të detyrueshme apo të pëlqyeshme, qofshin detyrime ndaj Allahut të Madhëruar, qofshin detyrime ndaj krijesave.

Për cilindo që i plotëson këto kushte, Allahu i Lartësuar premton dhe thotë:

- "Ai do t'ia fshijë të këqijat dhe do ta fusë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të jenë përgjithmonë. Kjo është fitorja e madhe!" - Atje do të kenë gjithçka që ua dëshiron shpirti dhe që iu kënaq syrin.

Atje mund të zgjedhin çfarë të duan. Kjo kënaqësi do të vazhdojë përjetësisht.

Ndërsa duke treguar shkakun e ndëshkimit të atyre që do të hidhen në Zjarr, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ndërsa ata që nuk besojnë dhe i mohojnë argumentet Tona, ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë." - Ata mohojnë argumentet e Zotit pa qenë të bazuar në ndonjë fakt, argument logjik ose tekste hyjnore. Madje, përkundrazi, atyre u vijnë argumente të qarta dhe të pakundërshtueshme për të besuar të vërtetën dhe për të jetuar sipas saj, por ata i kundërshtojnë me urrejtje e kokëfortësi. Për këta, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ky është përfundimi më i keq!" – Në Xhehenem janë mbledhur ndëshkimet më të ashpra. Banorët e atij vendi janë të pashpresë, pasi atje do të mbeten përgjithmonë.

Ajetet 11 – 13

11. Çdo fatkeqësi që godet, ndodh veçse me lejen të Allahut. Kush i beson Allahut, Ai ia udhëzon zemrën. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë.
12. Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit! Nëse ju ktheni shpinën, atëherë dijeni se detyra e të Dërguarit tonë është vetëm kumtimi i qartë.
13. Allahu është Ai që, veç Tij, nuk ka të adhuruar tjetër, prandaj vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!

Shpjegimi i ajeteve

- "Çdo fatkeqësi që godet, ndodh veçse me lejen të Allahut. Kush i beson Allahut, Ai ia for zemrën. Allahu është i Gjithëdijshëm për çdo gjë." – Ajeti flet për të gjitha llojet e fatkeqësive: ato që na ndodhin në veten tonë, në pasuri, në fëmijë, në të dashurit dhe në çdo aspekt tjetër.

Çdo gjë që e godet robin ndodh me përcaktimin dhe lejimin e Zotit. Allahu i Madhëruar e ka ditur që më parë gjithçka që do të ndodhte dhe këtë dituri absolute të Allahut e shkroi lapsi i Tij. Atë që lapsi i Tij e shkroi, Allahu i Madhërishëm e krijoi në realitet, duke e renditur saktësisht dhe duke e bazuar në urtësinë e Tij të plotë për gjithçka.

Vallë, a është në rregull njeriu në raport me këtë çështje të rëndësishme të besimit apo jo? Është e ditur se Allahu i Lartësuar i ka lënë çdokujt mundësi të lirë zgjedhjeje, nga njëra anë, dhe ka premtuar për ata që zgjedhin të mirën dhe përpiqen për të se do t'i ndihmojë dhe udhëzojë në më të mirën, nga ana tjetër. Nëse robi kryen atë që kërkohet prej tij, ai do të fitojë shpërblimin e madh dhe mirësi të shumta në dynja dhe ahiret. Nëse robi beson se gjithçka që ndodh në këtë dynja, qoftë ato që na gëzojnë, qoftë ato që na hidhërojnë, ndodhin me lejen dhe përcaktimin e Allahut të Urtë, atëherë ai i pranon ato dhe kënaqet me përcaktimin e Allahut. Nëse robi iu bindet porosive të Tij, atëherë Allahu i Lartësuar ka për t'ia udhëzuar zemrën. Rrjedhimisht, ky njeri do të jetë tërësisht i qetë dhe i përmbajtur gjatë sprovave të vështira, ndryshe nga ç'ndodh me ata që Zoti nuk ua ka udhëzuar zemrat.

Të udhëzuarit janë të qëndrueshëm që në momentet e para kur godet sprova dhe, në këtë mënyrë, përveç shpërblimit të madh që Zoti i Lartësuar u jep në këtë dynja, ata rezervojnë një shpërblim të pamatë për Ditën e Llogarisë. Allahu i Lartësuar thotë:

"Thuaj: "O robër besimtarë, kini frikë Zotin tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë jetë, kanë shpërblim të madh. Me të vërtetë, Toka e Allahut është e gjerë. Ndërsa durimtarëve do t'u jepet shpërblim pa masë!" [Zumer 10]. Nga kjo kuptohet se kush nuk beson në kaderin e Zotit gjatë goditjes së fatkeqësive, por bazohet tërësisht vetëm në vëzhgimin e shkaqeve dhe pasojave, ai ka për të humbur i pashpresë, sepse Zoti i Lartësuar ka për ta lënë atë të mbështetet te vetja. Dihet se, nëse robi nuk ka mbështetetje tjetër veç vetvetes, për të do të ketë veç ankth, frikë dhe dëshpërim. Këto janë pjesë e ndëshkimit të dynjasë, para ndëshkimit të ahiretit. Këto ndëshkime janë tërësisht të meritueshme, për shkak të mungesës së durimit ndaj kaderit të Zotit.

Ndërsa po ta shohim ajetin në një spektër më të gjerë, dalim në përfundimin se: çdokush që beson gjithçka që është urdhëruar të besohet, siç është besimi në Allahun e Lartësuar, në melekët e Tij, shpalljet e Tij, profetët e Tij, Ditën e Gjykimit, dhe në caktimin e të mirës dhe të keqes prej Tij, dhe më pas e vërteton këtë besim me veprat përkatëse, atëherë ky njeri ka plotësuar kushtin kryesor që Allahu i Lartësuar t'ia hapë zemrën për udhëzimin e drejtë. Me fjalë të tjera, nga robi kërkohet që ai të besojë gjithçka që duhet besuar, duke u bazuar në dijen e saktë dhe të sigurt të sjellë nga Shpallja e Allahut dhe të punojë me sinqeritet sipas këtij besimi. Nëse ai e bën këtë, Allahu i Lartësuar ka për t'i dhuruar udhëzimin e drejtë, duke e ndihmuar dhe forcuar që të rregullojë dhe përsosë gjendjen, fjalët dhe veprat e tij. Ky është shpërblimi më i mirë që Allahu i Lartësuar u jep besimtarëve, ashtu sikurse na e ka bërë të ditur këtë fakt shumë herë në Kuran.

Qëndrueshmëria e zemrës gjatë sprovës kalitet nëpërmjet sigurisë së plotë në premtimin e Allahut, i Cili thotë: "Allahu i forcon ata që besojnë me fjalën e mirë si në jetën e kësaj bote, edhe në botën tjetër, ndërsa të padrejtët Allahu i lë në humbje. Allahu vepron gjithçka që dëshiron." [Ibrahim 27].

Kështu, besimtarët e vërtetë janë njerëzit me zemrën më të qetë dhe më të qëndrueshme gjatë sprovave dhe përballjeve të vështira. Ata janë njerëzit më të mençur, më të urtë, më të matur dhe më të përmbajtur, për shkak të imanit që mbush zemrat e tyre.

- "Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!" - Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij duke zbatuar me përpikmëri urdhrat e tyre. Pa dyshim, bindja ndaj Allahut dhe bindja ndaj Profetit janë themelet mbi të cilat ndërtohet lumturia. Ato janë rruga e vetme e suksesit, në aspektin e sigurimit të çdo të mire dhe të shpëtimit nga çdo e keqe, në dynja dhe në ahiret.

- "Nëse ju ktheni shpinën, atëherë dijeni se detyra e të Dërguarit tonë është vetëm kumtimi i qartë." - Nëse refuzoni të bindeni ndaj Allahut dhe ndaj Profetit të Tij, dijeni se përgjegjësia e Profetit është thjesht qartësimi i së vërtetës, duke jua bërë tërësisht të kuptueshme Shpalljen, me të cilën Allahu i Madhëruar e dërgoi ndër ju. Pas këtij qartësimi, askujt nuk i mbetet më justifikim para Allahut të Lartësuar. Detyra e Profetit nuk është që t'ju bëjë ta pranoni të vërtetën dhe të jetoni sipas saj. Edhe llogaria juaj nuk është detyrë e tij. Ai që do t'ju marrë në llogari dhe do t'ju shpërblejë ose ndëshkojë, në lidhje me bindjen ose jo ndaj Allahut dhe

ndaj Profetit të Tij, është Njohësi i të fshehtave dhe i të dukshmeve, Allahu i Vetëm dhe i Pashoq.

- "Allahu është Ai që, veç Tij, nuk ka të adhuruar tjetër..." - Allahu dhe vetëm Ai e meriton adhurimin. Çdo adhurim i kushtuar dikujt tjetër veç Allahut është adhurim i kotë, i papranueshëm, i padobishëm dhe i dënueshëm.

- "...prandaj vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët!" - Vetëm Allahut le t'i mbështeten dhe t'i kërkojnë ndihmë besimtarët, për gjithçka që i shqetëson dhe për gjithçka që duan të arrijnë. Asnjë çështje nuk realizohet pa ndihmën e Allahut. Nuk ka mundësi tjetër për arritjen e qëllimeve, por veçse me mbështetjen e Allahut.

Mbështetja (*teuekkul*) e plotë dhe e rregullt tek Allahu i Lartësuar arrihet veçse duke pasur mendim të mirë për Allahun e Lartësuar, duke pasur siguri të patundur se Allahu i Plotfuqishëm është plotësisht i mjaftueshëm si ndihmues për realizimin e çështjeve. Grada e *teuekkul*-it është në varësi të besimit. Sa më i fortë të jetë besimi, aq më e madhe është mbështetja tek Allahu i Lartësuar.

Ajetet 14 – 15

14. O ju që keni besuar, vërtet, disa nga bashkëshortet dhe fëmijët tuaj janë armiqtë tuaj, prandaj kini kujdes ndaj tyre. Nëse i falni, toleroni dhe ua mbuloni gabimet e tyre, ta dini se edhe Allahu është Falës e Mëshirues.
15. Nuk ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë veçse sprovë, ndërsa tek Allahu është shpërblimi i madh.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ju që keni besuar, vërtet, disa nga bashkëshortet dhe fëmijët tuaj janë armiqtë tuaj, prandaj kini kujdes ndaj tyre." - Allahu i Lartësuar i këshillon besimtarët që të mos hutohen me gratë dhe fëmijët e tyre, sepse disa prej tyre mund të jenë edhe armiq. Armik është ai që të dëshiron të keqen, prandaj detyra jote është që të jesh i kujdesshëm, i përgatitur mirë dhe vigjilent ndaj tij.

Sigurisht, njeriu është i prirur për nga natyra e tij që t'i dojë bashkëshorten dhe fëmijët, por Allahu i Lartësuar i këshillon robërit e Tij që të jenë të kujdesshëm dhe të mos iu përgjigjen kërkesave të grave dhe të fëmijëve të tyre, kur ato bien në kundërshtim me kërkesat e fesë. Allahu i Lartësuar i nxit robërit e tij që të zbatojnë porositë e Tij dhe gjithmonë t'i japin përparësi kënaqësisë së Tij, duke u kujtuar shpërblimin e madh që ka përgatitur për ta. Ata duhet që t'i japin përparësi ahiretit, kundrejt kësaj dynjaje të përkoshme dhe mashtruese, e cila një ditë do të zhduket.

Dikush mund ta keqkuptojë këtë porosi, duke menduar gabimisht se duhet të tregohet i ashpër me gratë dhe fëmijët. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e bën të qartë duke na urdhëruar që, nga njëra anë, të kemi kujdes, por gjithashtu të tregohemi të butë, tolerant dhe falës me ta. Duke zbatuar këtë porosi të Allahut të Lartësuar, do të arrijmë mirësi të panumërta:

- "Nëse i falni, toleroni dhe ua mbuloni gabimet e tyre, ta dini se edhe Allahu është Falës e Mëshirues." - Shpërblimi i Allahut është sipas veprës së robit. Kur një njeri e fal tjetrin, edhe Allahu e fal atë, nëse tregohet i butë dhe tolerant me tjetrin, edhe Allahu i Lartësuar tregohet i butë dhe e toleron atë,

nëse ai ua mbulon të metat dhe tregohet i mëshirshëm me njerëzit e tjerë, Allahu ia mbulon të metat dhe tregohet i mëshirshëm me këtë njeri. Ai që bën veprat që e kënaqin Allahun e Lartësuar dhe i trajton njerëzit e tjerë ashtu si ata kënaqen, por duke u ruajtur nga haramet dhe gjërat e dëmshme, ai ka për të arritur dashurinë e Allahut dhe dashurinë e krijesave. Përveç kësaj, mbarësia e çështjeve të tij do të jetë e vijueshme dhe e sigurt.

- "Nuk ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë veçse sprovë, ndërsa tek Allahu është shpërblimi i madh." – Të jeni të kujdesshëm në marrëdhëniet me ta! Ai që i ruan kufijtë e Allahut në çdo aspekt të jetës, le ta dijë se tek Allahu e pret një shpërblim i madh. Atje e pret përjetësia në Xhenetin e mirësisë dhe bujarisë së pamatë të Allahut të Lartësuar.

Ajetet 16 – 18

16. Tregoni devotshmëri ndaj Allahut sa të mundeni, dëgjoni, binduni dhe shpenzoni për bamirësi. Kjo është në të mirën tuaj. Kush i ruhet koprracisë së vetes, ai është i shpëtuar.
17. Nëse i jepni Allahut një 'hua' të mirë, Ai do t'jua shumëfishojë atë dhe do t'ju falë gjynahet. Allahu është Mirënjohës i madh dhe i Butë.
18. Ai është i Gjithëdijshmi për të fshehtat dhe të dukshmet, Ngadhënjyesi dhe i Urti.

Shpjegimi i ajeteve

- "Tregoni devotshmëri ndaj Allahut sa të mundeni..." - Allahu i Lartësuar na urdhëron për devotshmëri ndaj Tij. Devotshmëria realizohet me kryerjen e urdhëresave dhe largimin nga haramet, me dashuri, madhërim dhe nënshtrim ndaj Allahut të Lartësuar.

Urdhrin për devotshmëri Allahu i Lartësuar e ka lidhur ngushtë me mundësinë dhe fuqinë tonë për ta realizuar atë. Ai na ka urdhëruar të jemi të devotshëm sa të kemi mundësi dhe fuqi, jo jashtë mundësive tona. Ky ajet tregon, gjithashtu, se për çdo detyrim të Sheriatit që robi nuk ka mundësi dhe fuqi ta zbatojë, ai nuk do të merret në përgjegjësi. Nga ana tjetër, nëse robi ka mundësi që të realizojë një pjesë të detyrimit, por nuk ka mundësi ta realizojë pjesën tjetër, ai duhet ta kryejë patjetër atë që ka mundësi. Për pjesën tjetër ai është i justifikuar dhe nuk merret në përgjegjësi. Kjo i ngjan thënies së Profetit (s.a.u.s.): "Nëse ju urdhëroj për diçka, zbatojeni aq sa keni mundësi!". Ky rregull i Sheriatit vlen për një mori çështjesh të Sheriatit.

- "...dëgjoni, binduni dhe shpenzoni për bamirësi." - Allahu i Lartësuar urdhëron për disa gjëra, të cilat, nëse zbatohen, Ai premton *el felah*-un, domethënë, fitoren e madhe, arritjen e çdo mirësie dhe shpëtimin nga të këqijat. Allahu i Lartësuar thotë së pari:

- "Dëgjoni!" – Pra, dëgjoni këshillat, qortimet dhe paralajmërimet që Allahu ju jep. Dëgjoni ligjet që Zoti ju ka caktuar për të jetuar sipas tyre! Dëgjoni diturinë e dobishme dhe të vërtetë, me qëllimin që të bindeni dhe të punoni sipas saj me sinqeritet për Allahun!
- "Binduni!" - Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij në të gjitha porositë e tyre, të cilat janë udhëzimi më i mirë dhe rruga e vetme për rregullimin e çështjeve tuaja!
- "Shpenzoni!" - Shpenzoni për hir të Allahut, qoftë duke bërë shpenzimet e

detyrueshme, të urdhëruara nga Allahu, qoftë shpenzimet e pëlqyeshme e vullnetare. Pa dyshim, kjo është gjëja më e mirë për ju, qoftë në lidhje me mbarësinë në jetën e dynjasë, qoftë në lidhje në përfundimin e mirë në ahiret.

- "Kjo është në të mirën tuaj." - Nuk ka dyshim se e gjithë mirësia është e lidhur ngushtë me zbatimin e porosive të Allahut të Lartësuar dhe nënshtrimin ndaj ligjit të Tij. Nga ana tjetër, e gjithë e keqja vjen nga moszbatimi i porosive të Allahut të Lartësuar dhe mosnënshtrimi ndaj ligjit të Tij. Por është një faktor, i cili pengon shumë njerëz që të bëjnë shpenzimet e detyrueshme. Ky është vesi i koprracisë, që karakterizon shumicën e njerëzve. Ajo i bën njerëzit që të dëshirojnë gjithçka për vete dhe të urrejnë ndarjen e pasurisë së tyre me të tjerët.

Për ata që Allahu i Lartësuar i ka ruajtur nga koprracia, të cilët shpenzojnë lirshëm në fushat e mirësisë, thuhet:

- "Kush i ruhet koprracisë së vetes, ai është i shpëtuar." - Ata janë të shpëtuar dhe të fituar, sepse arrijnë të gjitha gjërat e mira që dëshirojnë dhe shpëtojnë nga çdo gjë së cilës i druhen.

Ky ajet nuk bën fjalë vetëm për shpenzimin në rrugën e Allahut, por ai është nxitje për të zbatuar me përpikmëri çdo urdhër të Allahut të Lartësuar dhe të Profetit të Tij. Arsyeja është se kur shpirti i njeriut është i mbushur me koprraci, ai nuk bindet për asnjë porosi hyjnore. Koprracia e mban robin të prangosur, duke e privuar atë nga shumë të mira, të dynjasë dhe të ahiretit, dhe duke e bërë atë të harrojë edhe vetveten.

Nga ana tjetër, nëse shpirti i njeriut është i çliruar nga koprracia, nëse është i qetë dhe plot besim në dobitë dhe mirësitë që sjell zbatimi i ligjeve të Zotit, nëse ai synon që të kënaqë Zotin e Lartësuar, madje e bën këtë lajtmotivin e jetës së tij, atëherë atë nuk e pengon asgjë nga veprat e mira, qoftë në kryerjen e detyrimeve, mes të cilave edhe shpenzimi në rrugët e mirësive, qoftë në largimin nga haramet. Mjafton që ai të mësojë një porosi të Zotit apo të Profetit, dhe ai menjëherë nxiton që ta kryejë atë me të gjitha mundësitë e tij, sepse e di se zbatimi i saj e kënaq Zotin e Lartësuar. Të tillë adhurues do të fitojnë çdo mirësi të premtuar nga Zoti i Lartësuar dhe do të jenë të sigurt nga çdo e keqe apo ndëshkim.

Pastaj Allahu i Lartësuar vijon të inkurajojë në mënyrë të veçantë dhe të theksuar për shpenzimin në rrugën e Tij. Ai thotë:

- "Nëse i jepni Allahut një 'hua' të mirë, Ai do t'ju shumëfishojë atë dhe do t'ju falë gjynahet." – Një 'hua' e tillë konsiderohet çdo shpenzim prej pasurisë hallall, nëse robi me të synon të kënaqë Allahun e Lartësuar dhe të lumturohet me vështrimin në fytyrën e Allahut në Xhenet, por edhe duke e shpenzuar atë atje ku duhet. Për këtë vepër të mirë, Allahu i Lartësuar e shumëfishon dhjetëfish, shtatëqindfish e shumë herë më tepër shpërblimin, në krahasim me shpenzimin e kryer. Madje, si pjesë e shpërblimit të atij që shpenzon për hir të Zotit është edhe falja e gjynaheve, sepse i Lartësuari thotë: "...dhe do t'ju falë gjynahet". Nuk ka dyshim se gjynahet fshihen nga Allahu i Lartësuar nëpërmjet veprave të mira në përgjithësi, dhe nga sadakaja në mënyrë të veçantë, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Fale namazin në dy

skajet e ditës dhe në orët e afërta të natës. S'ka dyshim se veprat e mira i fshijnë ato të këqijat. Ky është përkujtim për ata që përkujtojnë. Dhe ji i durueshëm, se Allahu nuk ua humb shpërblimin bamirësve!" [Hud 114, 115].

- "Allahu është Mirënjohës i madh dhe i Butë." - Allahu i Lartësuar është *Shekur* - Mirënjohës i madh. Ai nuk shpërfill asgjë të mirë, sado e vogël dhe e parëndësishme të duket. Allahu pranon dhe shpërblen pa masë, me bujarinë e Tij të pashembullt, madje edhe për veprat më të të vogla të kryera nga robi. Edhe pse ato vepra mund të jenë të vogla, të mangëta dhe të padenja si lavdërim për madhështinë e Krijuesit, përsëri Bujari i Madhërishëm shpërblen shumë për to. Allahu i Lartësuar tregohet mirënjohës dhe shpërblyes shumë i madh për atë rob që, për hir të Tij, duron vështirësitë dhe rëndesat, duron gjatë përpjekjeve për të plotësuar detyrimet që Ai i ka ngarkuar. I Lartësuari e ka bërë rregull të pakthyeshëm: nëse dikush lë diçka për hir të Allahut, Allahu ka për t'ia zëvendësuar atë gjë me diçka më të mirë se ajo.

Allahu i Lartësuar është *Halim* - i Butë, pra, nuk nxitohet që ta ndëshkojë menjëherë gabimtarin, por e afatizon dhe i jep mundësi atij të pendohet. Ai e afatizon, por kurrë nuk e harron dhe ta lërë pa e marrë në përgjegjësi. Allahu i Lartësuar thotë: "Sikur Allahu t'i kapte njerëzit sipas veprave të tyre, nuk do të linte mbi faqen e dheut asnjë gjallesë, por Ai i afatizon deri në një moment të caktuar. E kur të vijë afati i tyre, s'ka dyshim se Allahu është Gjithëshikuesi i robërve të Vet." [Fatir 45].

- "Ai është i Gjithëdijshmi për të fshehtat dhe të dukshmet, Ngadhënjyesi dhe i Urti." - Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm për çdo gjë të fshehtë apo të dukshme. Ai është i Gjithëdijshëm qoftë për ushtritë e Tij, të cilat i di vetëm Ai dhe askush tjetër, qoftë për krijesat të cilat shihen edhe nga robërit.

Allahu i Lartësuar është *El Aziz* - Ngadhënjyesi, i Pamposhturi. Atij nuk mund t'i shmanget askush. Para pushtetit të Tij, çdo gjë është e nënshtruar.

Allahu është *El Hakim* - i Urti. Çdo gjë që e ka krijuar, Allahu e ka bërë me një urtësi të madhe. Çdo ligj që ka vendosur, Allahu e ka vendosur me urtësinë e Tij. Ai çdo gjë e vendos në vendin e vet, duke i dhënë hakun që i takon.

Këtu përfundon tefsiri i sures Tegabun, dhe vetëm Allahut i takon falënderimi dhe mirënjohja për gjithçka!

Surja 65: Et Talak (medinase) 12 ajete

Ajetet 1 – 3


Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. O Profet! Nëse i ndani gratë, ndajini ato në prag të hyrjes së kohëpritjes së tyre! Kohën e pritjes llogariteni mirë dhe kini frikë Allahun, Zotin tuaj! Mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre dhe ato gjithashtu të mos dalin, vetëm nëse ato sillen haptas në mënyrë të shëmtuar. Këto janë ligjet e Allahut, e kush del jashtë ligjeve të Allahut, e ka dëmtuar rëndë vetveten. E ku mund ta dish ti, Allahu pas kësaj mund të sjellë diçka tjetër.

2. E kur ato t'i afrohen mbarimit të afatit të tyre, atëherë ose mbajini si duhet, ose

ndajini si është më e mira! Për këtë kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj. Dëshminë bëjeni me korrektësi e për hir të Allahut! Kështu këshillohet ai që i beson Allahut dhe Ditës së Fundit. Kush tregon devotshmëri ndaj Allahut, Ai i jep rrugëzgjidhje për gjithçka

3. dhe e furnizon atë prej nga nuk e pret. Kush i mbështetet Allahut, mjaftohet me Të. Allahu ka për ta realizuar vendimin e Tij dhe Ai çdo gjë e ka përcaktuar me korrektësi.



Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar, duke iu drejtuar Profetit të Tij dhe besimtarëve, thotë:

- "O Profet! Nëse i ndani gratë, ndajini ato në prag të hyrjes së kohëpritjes së tyre!" - Nëse vendosni që të divorconi gruan, duhet ta bëni brenda udhëzimeve të Sheriatit. Nuk duhet të nxitoni e ta kryeni divorcin menjëherë, që në çastin kur ndodh shkaku i tij, duke mos marrë në konsideratë porositë e Allahut të Lartësuar rreth kësaj çështjeje.

Një rregull që duhet patur parasysh është ai që thotë Allahu i Lartësuar: "...ndajini ato në prag të hyrjes së kohëpritjes së tyre!" Kështu, divorci duhet të kryhet gjatë kohës kur gruaja është e pastër, domethënë jo në kohën e periodave të saj, dhe kur burri nuk ka kryer marrëdhënie me të pas pastrimit. Në këtë mënyrë, kohëpritja e gruas është më e qartë dhe më e lehtë për t'u përcaktuar. Nëse burri do të deklaronte divorcin gjatë kohës së ciklit mujor të saj, ky cikël nuk do të llogaritej në kohëpritjen e saj dhe, në këtë mënyrë, pritja e gruas do të ishte më e gjatë, sepse do të shkonte në katër cikle, gjë që është në dëm të gruas, duke e vështirësuar çështjen e saj. Gjithashtu, nëse burri do të deklaronte divorcin kur gruaja nuk është me periodat, por gjatë kësaj periudhe ai do të kishte kryer marrëdhënie me të, atëherë përsëri kohëpritja nuk do të sillte sigurinë e nevojshme, sepse gruaja mund të ketë mbetur shtatzënë ndërkohë. Për këto arsye, Allahu i Lartësuar na mëson kohën e rregullt të deklarimit të divorcit. Ai nuk kryhet që në momentin kur gruaja e ka bërë hak të divorcohet për shkaqe të caktuara, por pasi ajo është pastruar nga periodat dhe burri ende nuk ka kryer marrëdhënie me të.

Më pas, Allahu i Lartësuar na urdhëron që të përllogarisim mirë kohëpritjen (*el iddeh*) e gruas:

- "Kohën e pritjes llogariteni mirë" - Këtu paraqiten disa raste:

1. Nëse gruaja është e tillë që i kalon të përmuajshmet (pra, nuk është shtatzënë ose nuk i pret më periodat për shkak të menopauzës, ose ende nuk i kanë ardhur

periodat e para), atëherë koha e pritjes llogaritet me ardhjen e tri cikleve. Me fjalë të tjera, pas deklarimit të divorcit, gruaja duhet të presë që të shohë periodat tri herë rresht. Me të parë periodat e treta, kohëpritja e saj është plotësuar.

2. Nëse gruaja është nga ato që nuk kanë perioda dhe nuk është shtatzënë, koha llogaritet me muaj. Në këtë rast, ajo pret plot tre muaj hënorë.

3. Nëse gruaja është shtatzënë, atëherë koha e pritjes është derisa ajo të lindë fëmijën.

Gruaja duhet ta llogarisë drejt dhe saktë kohën e pritjes, sepse kështu ajo përmbush porosinë e Allahut, i jep hakun e burrit të saj që e divorcon (duke mos e ngarkuar atë me shpenzimet ndaj saj për një kohë më të gjatë sesa e ka detyrë) dhe hakun e burrit tjetër, nëse ajo do të martohet më pas. Kjo është më e mirë dhe më e pastër për të gjithë. Nëse llogaritet mirë koha e pritjes, të gjithë kanë për të qenë me të qetë dhe më të qartë për të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta.

Urdhri për llogaritjen e drejtë të kohëpritjes i drejtohet gruas, nëse ajo është e përgjegjshme ligjërisht; nëse jo, atëherë urdhri i drejtohet kujdestarit ligjor të saj.

Më pas, Allahu i Madhëruar na udhëzon për devotshmëri dhe drejtësi:

- "...dhe kini frikë Allahun, Zotin tuaj!" - Pra, jini të devotshëm ndaj Allahut të Lartësuar, duke zbatuar porositë e Tij në të gjitha çështjet. Frikësojuni Zotit dhe plotësoni me drejtësi çdo detyrim kundrejt grave tuaja, kur i divorconi ato.

- "Mos i nxirrni ato prej shtëpive të tyre..." - Mos i nxirrni gratë e divorcuara nga shtëpitë e tyre gjatë kohës së pritjes. Ato duhet të qëndrojnë në shtëpinë e bashkëshortit, në atë shtëpi ku ai e divorcon. Ndërkohë, burri e ka detyrim strehimin dhe shpenzimet për gruan e divorcuar gjatë kohës së pritjes së saj, prandaj nuk lejohet që ai ta cenojnë këtë përgjegjësi ndaj saj. Edhe për gruan është një ndalesë:

- "...dhe ato gjithashtu të mos dalin..." - Gruas nuk i lejohet që të largohet nga streha bashkëshortore, sepse kjo do të ishte shkelje e përgjegjësive ndaj burrit.

Këto porosi, qoftë për burrin, qoftë për gruan, vazhdojnë të jenë në fuqi deri në përfundim të kohëpritjes. Por Allahu i Lartësuar bën përjashtim për raste të caktuara, kur thotë:

- "...vetëm nëse ato sillen haptas në mënyrë të shëmtuar." - Nëse gruaja shfaq sjellje të shëmtuar, aq sa e bën të detyrueshme nxjerrjen e saj jashtë, dhe nëse ajo u shkakton probleme të rënda banorëve të tjerë të shtëpisë, me fjalët dhe veprat e këqija të saj, atëherë burrit i lejohet që ta përzërë nga shtëpia, sepse është ajo që e shkakton këtë veprim. Strehimi i gruas në shtëpi bëhet për respekt ndaj saj, gjë të cilën ajo nuk e meriton, kur e përdhos vetë me sjelljen e saj.

Kështu veprohet në rastin e divorcit kur burri mund ta kthejë përsëri gruan e tij gjatë kohëpritjes. Ky quhet '*talak raxh'ij*' - divorc i kthyeshëm. Ndërsa me "*talak el bain*" - divorcin e pakthyeshëm,[32] burri nuk e ka për

[32] Në suren Bekare, ajeti 229, i Lartësuari thotë: **"Ndarja mund të bëhet dy herë."** Pra, ndarja pas së cilës burri ka të drejtë që ta rikthejë gruan e vet, është e lejuar të bëhet vetëm dy herë. Kështu, burrit i jepet mundësia për ta rikthyer gruan e tij vetëm dy herë. Kaq është mëse e mjaftueshme që ai të reflektojë kundrejt gruas së tij ashtu si duhet. Nëse veprimi përsëritet më shumë se dy herë, atëherë nuk konsiderohet i drejtë, madje mund të jetë tregues që me ndarjen dëshirohet vuajtja dhe

detyrë strehimin dhe shpenzimet për gruan e divorcuar.

- "Këto janë ligjet e Allahut, e kush del jashtë ligjeve të Allahut, e ka dëmtuar rëndë vetveten." - Këta janë kufijtë e Allahut, që Ai i ka vendosur për robërit e Tij, janë ligjet e Tij për ta, që t'i zbatojnë me përpikmëri. Kush nuk iu përmbahet kufijve të Zotit, por i shkel ose i cenon ato, ai i ka bërë padrejtësi vetes, duke u privuar nga mirësitë dhe begatitë e shumta që sjell zbatimi i porosive të Zotit. Duke mos e nënshtruar veten në zbatimin e porosive të Allahut, robi humbet lumturinë e dynjasë dhe të ahiretit.

- "E ku mund ta dish ti, Allahu pas kësaj mund të sjellë diçka tjetër." - Allahu i Madhëruar e rregulloi çështjen e divorcit dhe të kohëpritjes me dispozita, në të cilat fshihen urtësi të shumta dhe të mrekullueshme. Prej tyre mund të përmendim:

1. Gjatë kohëpritjes, kur gruaja qëndron në shtëpinë e burrit, ndoshta Allahu i Madhëruar bën që në zemrën e bashkëshortit të zgjohet mëshira, butësia dhe dashuria për gruan e tij, dhe kështu çifti ribashkohet në një fillim të ri.

2. Kur burri e divorcon gruan për ndonjë problem që vjen prej saj, atëherë gjatë kohëpritjes ky problem mund të ndreqet, e kështu bëhet i mundur ribashkimi.

3. Koha e pritjes është e nevojshme për gruan që të verifikohet se ajo nuk është shtatzënë nga burri që e ka divorcuar.

- "E kur ato t'i afrohen mbarimit të afatit të tyre, atëherë ose mbajini si duhet, ose ndajini si është më e mira!" - Kur afrohet fundi i kohëpritjes, burri është ende në kohë të bëjë zgjedhjen e tij: ose ta mbajë gruan me mirësi e mirëkuptim, duke përmbushur detyrimet e ndërsjellta, ose ta lëshojë atë. Por nëse koha e pritjes mbaron, ai nuk ka më të drejtë ta kthejë atë grua, veçse me një akt të ri martesor. Nuk lejohet që burri ta kthejë më atë, sepse kështu e bën të vuajë më tepër. Edhe ndarja duhet të bëhet sipas rregullave islame, me drejtësi dhe larg harameve, larg fyerjeve dhe pa e shtrënguar gruan që t'i marrësh mbrapsht pasurinë (*mehr*-in) që i ke dhënë.

- "Për këtë kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj..." - Qoftë kur bëni divorcin, qoftë kur e ktheni gruan, merrni dy dëshmitarë të drejtë nga mesi juaj, domethënë dy burra muslimanë, që janë të drejtë e të ndershëm. Nëpërmjet kësaj dëshmie i pritet rruga çdo keqkuptimi e grindjeje. Gjithashtu, nëpërmjet dëshmisë, të drejtat dhe përgjegjësitë nuk mund të fshihen apo të shkelen padrejtësisht. Pastaj Allahu i Lartësuar u drejtohet dëshmitarëve dhe u thotë:

---

lëndimi i gruas. Burri që e përsërit një veprim të tillë kundrejt gruas së tij tregon se ai nuk ka qëllim që të jetojë me të normalisht, madje synon dëmtimin e saj. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i urdhëron burrat që, pas bashkimit prej ndarjes së dytë, të kenë: **"ose jetesë bashkëshortore normale, ose divorc me mirëkuptim."** Këto dy raste quhen *talak raxh'ij*. Ndërsa për herë të tretë, divorci konsiderohet *'bain'* - i pakthyeshëm dhe, siç thotë i Madhëruari: **"E nëse ai e ndan sërish atë, pas kësaj atij nuk i lejohet më ta rimarrë, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër."** Pra, pas ndarjes së tretë, burrit nuk i lejohet më që ta kthejë gruan e tij, derisa të plotësojë disa kushte. Së pari, ajo duhet të martohet me një burrë tjetër. Termi "martesë" në Sheriat nënkupton martesë të plotë, me të gjitha kushtet e saj, përfshirë edhe marrëdhëniet intime mes bashkëshortëve. Së dyti, martesa e gruas me një burrë tjetër duhet të jetë me dëshirë dhe jo me qëllimin që ajo të mund të kthehet te burri i parë.

- "Dëshminë bëjeni me korrektësi e për hir të Allahut!" - Dëshmoni me drejtësi dhe saktësi, pa shtuar dhe pakësuar gjë. Me dëshminë tuaj, të synoni kënaqësinë e Allahut të Lartësuar dhe mos e shtrembëroni atë për hir të lidhjeve shoqërore e farefisnore.

- "Kështu këshillohet ai që i beson Allahut dhe Ditës së Fundit." - Nga këto rregulla merr mësim ai që beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit. Nuk ka dyshim se besimi në Allahun dhe Ditën e Gjykimit është një nga shkaktarët më të fortë që e bën njeriun që të përfitojë nga këshillat e Zotit, t'i japë përparësi ahiretit dhe të kryejë punë të mira sa të ketë mundësi. Ndryshe ndodh me njeriun që e ka zemrën larg prej imanit. Atë nuk e shqetëson aspak ligësia dhe humbja ku është zhytur dhe këshillat nuk i bëjnë aspak dobi.

- "Kush tregon devotshmëri ndaj Allahut, Ai i jep rrugëzgjidhje për gjithçka dhe e furnizon atë prej nga nuk e pret." - Duke qenë se divorci sjell shqetësim, trishtim e ngushtim për robin, Allahu i Lartësuar urdhëron për devotshmëri ndaj Tij. Ai na urdhëron që, edhe në këtë gjendje të vështirë, të përkushtohemi në zbatimin e porosive të Tij. Nëse burri e kryen divorcin brenda normave të Sheriatit, ashtu siç u përshkrua më lart, atëherë ai ka hapësirë zgjedhjeje, pasi edhe mund ta kthejë këtë vendim, nëse ndërron mendje. Atij që vepron në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar ka për t'i sjellë çlirim, lehtësim e rrugëdalje nga vështirësia.

Edhe pse ajeti flet veçanërisht për divorcin, më i rëndësishëm është aspekti gjithëpërfshirës i tij. Në këtë mënyrë, ajeti tregon që çdokush që i frikësohet Allahut, duke qëndruar brenda kufijve të Tij për çdo çështje, duke synuar me këtë arritjen e kënaqësisë së Allahut të Lartësuar, do të shpërblehet nga Ai me plot të mira në dynja dhe në ahiret. Ndër shpërblimet që Allahu i Lartësuar premton për devotshmërinë është edhe çlirimi, lehtësimi ose rrugëdalja në çdo situatë të rëndë.

Ashtu sikurse ai që i frikësohet Allahut do të gjejë çlirim dhe lehtësim, ashtu edhe ai i cili nuk tregohet i devotshëm e ka gjithmonë të vështirë daljen nga situatat e krizës, pasi e ka lidhur veten me prangat e mosbindjes. Le të marrim shembullin e divorcit. Nëse robi nuk tregohet i devotshëm, pra, nuk zbaton porositë e Zotit në këtë çështje, por e kryen divorcin jashtë normave të caktuara (si për shembull, duke deklaruar divorcin tri herë në një moment), ai ka për t'u penduar thellë për veprimin e tij, por tashmë nuk mund të rregullojë më asgjë.

Gjithashtu, atij që tregohet i devotshëm, Allahu i Lartësuar ka për t'ia lehtësuar rizkun dhe mirësitë në mënyra që robi kurrë nuk i ka llogaritur apo menduar.

- "Kush i mbështetet Allahut, mjaftohet me Të." – Për robin që i mbështetet Allahut në çështjet e fesë dhe të dynjasë, duke i kërkuar ndihmë Atij për arritjen e të mirave dhe për mbrojtjen nga të këqijat, duke qenë i bindur se kjo ndihmë do t'i jepet, Allahu i Lartësuar do të jetë i mjaftueshëm për të. Allahu i Lartësuar do ta ndihmojë patjetër këtë njeri për nevojat që ka. Allahu i Lartësuar është më i Pasuri, i Fuqishmi, Krenari dhe i Gjithëmëshirshmi. Allahu është më pranë robit se çdo gjë tjetër. Ai mund t'i plotësojë

lutjet dhe kërkesat e robit menjëherë, në çast dhe pa u vonuar. Por ndoshta urtësia e Tij e kërkon që përgjigjja të vonohet për një kohë më të përshtatshme, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Allahu ka për ta realizuar vendimin e Tij dhe Ai çdo gjë e ka përcaktuar me korrektësi." - Çdo urdhër dhe ligj i Tij do të ekzekutohet patjetër, por Allahu i Lartësuar ka përcaktuar kohën, vendin dhe masën e çdo gjëje dhe asgjë nuk mund të dalë jashtë përcaktimit të Tij.

Ajetet 4 – 5

4. Për ato gra të cilave u është ndërprerë cikli mujor, nëse nuk jeni të sigurt për to, dijeni se koha e pritjes së tyre është tre muaj, e po kaq është edhe për ato që ende nuk u kanë ardhur menstruacionet. Ndërkaq, për shtatzënat, afati i pritjes është derisa ato të lindin. E kush i frikësohet Allahut, Ai ka për t'ia lehtësuar çështjet.
5. Ky është gjykimi i Allahut, të cilin e shpalli për ju. Kush e ka frikë Allahun, Ai ia mbulon të këqijat dhe ia shton shpërblimin.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na mësoi që një divorc i rregullt kërkon të plotësohen disa rregulla, mes të cilave edhe kohëpritja (*el iddeh*). Në vijim tregohen disa rregulla që lidhen me kohëpritjen, në raste të ndryshme:

- "Për ato gra të cilave u është ndërprerë cikli mujor, nëse nuk jeni të sigurt për to, dijeni se koha e pritjes së tyre është tre muaj..." – Flitet për gratë që kanë pasur menstruacione, por pastaj u janë ndërprerë për shkak të moshës ose për shkaqe të tjera, dhe nuk shpresojnë më që ato t'u kthehen. Kohëpritja e kësaj kategorie është tre muaj. Kështu, në vend të çdo periode llogaritet një muaj.


- "...e po kaq është edhe për ato që ende nuk u kanë ardhur menstruacionet." – Domethënë, për vajzat që ende nuk u kanë ardhur periodat, për shkak të moshës tepër të re, ose për ato vajza të rritura të cilave ende nuk u kanë ardhur periodat plotësisht dhe qartësisht. Edhe këto konsiderohen si kategoria e mësipërme, për sa i përket kohëpritjes. Ato duhet të presin tre muaj.

Kohëpritjen e grave që u kanë ardhur rregullisht periodat, Allahu i Lartësuar e ka përcaktuar në suren Bekare, ajeti 228, ku thotë: "Gratë e divorcuara janë të detyruara të presin deri në tri perioda."[33]

- "Ndërkaq, për shtatzënat, afati i pritjes është derisa ato të lindin." – Kështu, koha e pritjes së tyre nuk matet as me muaj dhe as me perioda.

- "E kush i frikësohet Allahut, Ai ka për t'ia lehtësuar çështjet." - Atij që i druhet Allahut të Lartësuar, duke zbatuar porositë

[33] Dijetarët kanë mendime të ndryshme rreth kuptimit të fjalës "*kur'un*", që është përmendur në ajet. Kështu, disa janë të mendimit se ajo tregon ciklin e mestruacioneve. Pra, sipas këtij shpjegimi, gruaja e ndarë duhet të presë deri sa t'i kalojnë tri cikle mestruacionesh. Ndërsa të tjerë mendojnë se me fjalën "*kur'un*" është për qëllim shikimi i pastrimit, pas përfundimit të mestruacioneve. Sipas këtij mendimi, gruaja e ndarë duhet të presë sa të bëhen tri periudha pastrimi. Megjithatë, më i saktë është mendimi i parë, që thotë se '*kur'un*' quhet cikli i mestruacioneve. Pra, sipas mendimit më të saktë, gruaja duhet të presë që asaj t'i vijnë tri herë të përmuajshmet.



e Tij, Allahu ia lehtëson çështjet dhe çdo gjë të vështirë ia bën më të thjeshtë.

- "Ky është gjykimi i Allahut, të cilin e shpalli për ju." - Këto rregulla të Zotit, që Ai jua qartësoi mirë, duhet të trajtohen nga ju ashtu siç e meritojnë, domethënë, duke i zbatuar dhe plotësuar me dëshirë dhe madhërim.

- "Kush e ka frikë Allahun, Ai ia mbulon të këqijat dhe ia shton shpërblimin." – Kështu, ky njeri shpëton nga çdo e keqe dhe arrin të realizojë çdo synim të tij, duke u kënaqur.

Ajetet 6 – 7

6. Ato, sipas mundësisë suaj, vendosini në të njëjtin vend ku banoni edhe vetë, e mos i ngushtoni për t'i detyruar të dalin. Në qoftë se ato janë shtatzëna, atëherë furnizojini derisa të lindin fëmijën! Nëse ato u japin gji fëmijëve tuaj, atëherë jepuni atyre shpërblimin që u takon dhe urdhëroni njëri-tjetrin për mirë! Në qoftë se kini probleme mes jush, atëherë le ta ushqejë me gji një tjetër.

7. Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që ka pak pasuri, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu! Allahu nuk ngarkon asnjë më tepër se sa i ka dhënë. Pas vështirësisë, Allahu sjell lehtësim.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ato, sipas mundësisë suaj, vendosini në të njëjtin vend ku banoni edhe vetë..." - Në fillim të kësaj sureje, Allahu i Lartësuar e bëri të ndaluar nxjerrjen e gruas së divorcuar nga shtëpia e burrit në kohën e pritjes. Ndërsa në këto ajete, Ai përcakton mënyrën dhe masën e kujdesit ndaj saj. Strehimi dhe shërbimet për të duhet të bëhen ashtu si e kërkon zakoni për sojin dhe nivelin shoqëror të burrit dhe të gruas. Sigurisht, kjo të bëhet brenda mundësive të burrit, duke mos e rënduar atë.

- "...e mos i ngushtoni për t'i detyruar të dalin." - Mos e ngushtoni gruan me fjalë, vepra dhe me sjellje të vrazhdë, që t'a detyroni atë të dalë nga shtëpia para plotësimit të kohëpritjes, sepse në këtë mënyrë, edhe pse ajo mund të duket sikur del me dëshirën e saj, jeni ju që e keni detyruar, gjë për të cilën Allahu ju ka ndaluar. Është e vërtetë që Allahu i Lartësuar e ka ndaluar edhe gruan që të dalë nga streha bashkëshortore përgjatë kohëpritjes, por kjo s'do të thotë që ajo të torturohet me vështirësi dhe padrejtësi.

- **"Në qoftë se ato janë shtatzëna, atëherë furnizojini derisa të lindin fëmijën!"** - Nëse gruaja e divorcuar është shtatzënë, është detyrë për burrin të kujdeset për të. Kjo bëhet për shkak të frytit që ajo mban në barkun e saj. Edhe një herë - e theksoj - kjo është detyrë në rastin e divorcit të kthyeshëm (*talak raxh'ij*). Ky detyrim përfundon me lindjen e fëmijës. Pas lindjes, ajo ose e ushqen me gji fëmijën e saj ose jo, sipas rregullit të përcaktuar nga Allahu i Lartësuar.[34]

- "Nëse ato u japin gji fëmijëve tuaj, atëherë jepuni atyre shpërblimin që u takon..." - Është detyrë për burrin që ta paguajë nënën e fëmijës për gjidhënien, sipas marrëveshjes mes tyre, nëse ka marrëveshje. Nëse jo, ajo meriton të trajtohet njëlloj si gratë e ngjashme të fisit të saj.

- "...dhe urdhëroni njëri-tjetrin për të mirë!" - Të dy bashkëshortët duhet ta urdhërojnë njëri tjetrin për çdo gjë që u sjell mirësi për dynjanë dhe ahiretin e tyre.

Braktisja e urdhërimit për të mirë dhe largimi nga të këqijat sjell dëme që mund t'i dijë dhe përshkruajë veçse Allahu i Lartësuar. Kjo porosi është mëse e dobishme për rastin në fjalë, sepse gjatë kohëpritjes, sidomos kur gruaja është shtatzënë, hapen debate e mosmarrëveshje për çështje të ndryshme, si: masa e shpenzimeve për gruan apo edhe për fëmijën pas ndarjes etj. Të gjitha këto nxisin urrejtje, armiqësi dhe grindje, të cilat bëjnë që robi t'i shkelë kufijtë e Allahut. Ndërsa urdhërimi për të mira dhe nxitja për devotshmëri në mënyrë të ndërsjelltë e zbut atmosferën e rënduar dhe siguron drejtësinë, aq të vështirë për t'u çuar në vend. Ligji i Zotit na mëson që të sillemi mirë, me butësi, mëshirë dhe tolerancë dhe të mbajmë drejtësi në çdo gjendje dhe situatë.

- "Në qoftë se kini probleme mes jush, atëherë le ta ushqejë me gji një tjetër." - Nëse nuk bini dakord për gjidhënien e fëmijës, atëherë zgjidhni një gjidhënëse tjetër, sipas rregullit. Allahu i Lartësuar thotë në një ajet tjetër: "...Nëse ju dëshironi gjidhënëse tjetër për fëmijën tuaj, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ju, me kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur. Ruajuni prej Allahut dhe dijeni se Allahu ju sheh se çfarë bëni." [Bekare 233].

Kështu veprohet nëse fëmija e pranon gjirin e grave të tjera, veç nënës së tij. Por nëse fëmija pranon veçse gjirin e nënës së tij, atëherë ajo e ka detyrë gjidhënien. Madje, nëse refuzon që ta bëjë këtë shërbim, nëna detyrohet që ta bëjë një gjë të tillë, sigurisht kundrejt një vlere, e cila paguhet nga babai ose kujdestarët e fëmijës. Për këtë merret për bazë masa që u jepet gjidhënëseve të fisit të saj, nëse nuk bien dakord për pagesën. Ky gjykim është përnxjerrë nga kuptimi i ajetit.

Kur fëmija është në barkun e nënës, është e detyrueshme për kujdestarin e tij (babain) të shpenzojë për të dhe për nënën. Pas

---

[34] Shih te surja Bekare, vëll. 1 / 206. Allahu i Lartësuar thotë: "Nënat le t'u japin gji foshnjave të tyre dy vite të plota, për ato që duan ta plotësojnë gjidhënien. I ati i fëmijës ka përgjegjësi për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre, ashtu si është zakoni. Askush nuk ngarkohet më tepër sesa ka mundësi. Nëna të mos dëmtohet me fëmijën e saj, e as babai me fëmijën e tij. Edhe trashëgimtari ka të njëjta përgjegjësi. E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi, ata vendosin për ndërprerjen e gjidhënies, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ta. Nëse ju dëshironi gjidhënëse tjetër për fëmijën tuaj, kjo nuk përbën ndonjë gjynah për ju, me kusht që pagesën t'ia bëni në mënyrë të duhur. Ruajuni prej Allahut dhe dijeni se Allahu ju sheh se çfarë bëni." [Bekare, 233].

lindjes, nëse fëmija mund të ushqehet me gji edhe nga gjidhënëse të tjera, përveç nënës së tij, Allahu i Lartësuar jep dy alternativa për kujdestarin (babain) e fëmijës: ose pagesën e nënës së fëmijës për gjidhënien e saj, sipas një marrëveshjeje mes palëve, ose përzgjedhjen e një gjidhënëse tjetër, kundrejt pagesës së pranuar. Ndërsa kur fëmija nuk pranon gji tjetër veç gjirit të nënës, atëherë situata i ngjan kohës kur fëmija është ende në barkun e nënës, prandaj nëna e ka detyrë ta ushqejë me gji, ndërsa kujdestari i fëmijës e ka për detyrë mbulimin e shpenzimeve.

Në vijim, Allahu i Lartësuar përcakton masën e këtyre shpenzimeve në varësi të gjendjes së burrit, duke thënë:

- "Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që ka pak pasuri, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu!" - Burri që është i pasur të shpenzojë si të pasurit, dhe jo të tregohet koprrac duke shpenzuar poshtë nivelit të tij. Ndërsa ata të cilët janë të varfër ose janë ngushtë, duhet të shpenzojnë nga ajo pasuri që Allahu u ka dhënë dhe ua ka lehtësuar. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Allahu nuk ngarkon asnjë më tepër se sa i ka dhënë." - Kjo përshtatet plotësisht me urtësinë dhe mëshirën gjithëpërfshirëse të Allahut të Madhëruar, i Cili nuk ngarkon asnjë përtej mundësive të tij. Madje, Allahu ia lehtëson gjendjen atij që është në vështirësi. Çdokush ngarkohet aq sa i është dhënë mundësia për të përballuar. Kështu realizohet sprova në këtë dynja, qoftë në çështjen e shpenzimeve, qoftë në çdo çështje tjetër. Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Pas vështirësisë, Allahu sjell lehtësim." - Ky është një përgëzim për ata që janë në vështirësi, se Allahu i Lartësuar ka për t'ua larguar sprovën, madje do t'ua kthejë atë në prehje dhe qetësi, sikurse thotë në një ajet tjetër: "Pa dyshim, pas vështirësisë vjen lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi!" [Inshirah 5, 6.]

Ajetet 8 – 11

8. Sa e sa banorë të vendbanimeve të shumta, që u treguan kryeneçë ndaj urdhrit të Zotit të tyre dhe ndaj të dërguarve të Tij, Ne u kemi bërë një llogari të ashpër dhe u kemi dhënë një dënim të papërshkrueshëm!
9. Ata vuajtën pasojat e punës së vet dhe fundi i tyre qe shkatërrimi.
10. Allahu ka përgatitur për ta dënim të rëndë, prandaj frikësojuni Allahut, o njerëz të mençur që keni besuar! Allahu ju solli një Përkujtues,
11. një të Dërguar, që ju lexon Shpalljen e Allahut me shpjegime të qarta, për t'i nxjerrë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira prej errësirave në dritë. Kush i beson Allahut dhe bën vepra të mira, Ai do ta fusë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të jetë përgjithmonë. Allahu ka për t'i dhënë atij një furnizim të mirë.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon për ndëshkimin që Ai u ka dhënë popujve të shkuar, të cilët mohuan profetët dhe refuzuan t'i nënshtroheshin ligjit të Zotit. Atyre nuk u bëri aspak dobi fuqia dhe numri i tyre i madh për t'u mbrojtur nga llogaria e ashpër dhe ndëshkimi i dhimbshëm. Allahu i Madhëruar dërgoi mbi

secilin prej tyre atë lloj ndëshkimi që e meritonin me veprat e tyre. Ky ishte ndëshkimi i tyre në dynja, ndërsa në ahiret dënimi është shumë herë më i ashpër.

Allahu i Lartësuar thotë: "Allahu ka përgatitur për ta dënim të rëndë, prandaj frikësojuni Allahut, o njerëz të mençur që keni besuar!" Ajeti u drejtohet njerëzve të mençur, të cilët i kuptojnë mirë porositë e Allahut. Ai i cili i shkatërroi popujt e shkuar, për shkak të mohimit të tyre, kështu ka vepruar gjithnjë dhe kështu do të veprojë me të gjithë ata popuj që bëjnë të njëjtin krim. Nuk bëhet asnjë diferencim mes atyre që kanë cilësi të njëjta, për sa i përket shpërblimit dhe ndëshkimit.

Më pas, Allahu i Lartësuar u kujton robërve të Tij Kuranin (Përkujtuesi), të cilin ia shpalli Muhamedit (a.s.). Ai u thotë, gjithashtu, që të mos bëhen si ata popujt e shkuar, që mohuan profetët e tyre. Allahu i Lartësuar e dërgoi Muhamedin (a.s.) me udhëzim të qartë, për t'i nxjerrë krijesat nga errësirat e kufrit, injorancës, poshtërsive dhe mosbindjes, në dritën e imanit, diturisë, devotshmërisë dhe bindjes ndaj Tij.

Sidoqoftë, jo të gjithë njerëzit besojnë. Ka prej atyre që nuk besojnë. Për ata që besojnë, Allahu i Lartësuar thotë: "Kush i beson Allahut dhe bën vepra të mira, Ai do ta fusë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj e ku do të jetë përgjithmonë." Këta e besojnë Allahun e Lartësuar duke u bazuar në dituri të saktë dhe të qartë, e cila ka ardhur prej Shpalljes, dhe punojnë sipas kësaj Shpalljeje, me sinqeritet për të kënaqur Allahun e Lartësuar. Për të tillët, Allahu i Lartësuar premton se do t'i fusë në xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të kenë mirësi të përjetshme. Atje do të kenë atë që syri se ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe as mendja nuk e ka përfytyruar. Përveç kësaj: "Allahu ka për t'i dhënë atij një furnizim të mirë."


Ndërsa ata të cilët nuk besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij ose që nuk kanë besim të saktë, të bazuar në dije të qartë, dhe nuk bëjnë me sinqeritet vepra të mira sipas këtij besimi, ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.

Ajeti 12

12. Allahu është Ai që krijoi shtatë qiej dhe prej Tokës aq sa ata. Nëpër to zbret vendimi i Tij, për të qenë të bindur se Allahu është i Plotfuqishëm për gjithçka dhe se me të vërtetë Allahu ka përfshirë gjithçka me dijen e Vet.

Shpjegimi i ajetit

Është Allahu i Lartësuar Ai që krijoi shtatë qiejt dhe gjithçka në to, ashtu si edhe shtatë tokat dhe gjithçka në to. Është Ai që krijoi edhe gjithçka mes tyre dhe që vendosi ligje në gjithësinë e Tij. Allahu i Lartësuar është Ai i Cili vendosi ligjet fetare, të cilat ua shpalli profetëve të Tij, për të këshilluar, udhëzuar, përgëzuar dhe qortuar robërit. Edhe ligjet e gjithësisë, që rregullojnë funksionimin e krijimit, janë vendosur nga Allahu, i Urti, i Gjithëdijshmi dhe i Plotfuqishmi. Të gjitha këto: krijimin e qiejve, Tokës e gjithçka mes tyre, vendosjen e ligjeve të funksionimit të gjithësisë dhe zbritjen e shpalljeve, Allahu i Lartësuar i bëri që krijesat ta njohin madhështinë e Tij, diturinë dhe urtësinë e Tij, pushtetin dhe krenarinë e Tij. Pushteti dhe dituria e Tij përfshijnë gjithçka. Nëse robërit do ta njohin Zotin e tyre me emrat dhe atributet e Tij të plota dhe bukura, do ta adhurojnë Atë, do ta


الجزء الثامن والعشرون سورة التحريم

سُورَةُ التَّحۡرِيمِ

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّبِيُّ لِمَ تُحَرِّمُ مَآ أَحَلَّ ٱللَّهُ لَكَۖ تَبۡتَغِي مَرۡضَاتَ أَزۡوَٰجِكَۚ وَٱللَّهُ
غَفُورٞ رَّحِيمٞ ١ قَدۡ فَرَضَ ٱللَّهُ لَكُمۡ تَحِلَّةَ أَيۡمَٰنِكُمۡۚ وَٱللَّهُ مَوۡلَىٰكُمۡۖ وَهُوَ
ٱلۡعَلِيمُ ٱلۡحَكِيمُ ٢ وَإِذۡ أَسَرَّ ٱلنَّبِيُّ إِلَىٰ بَعۡضِ أَزۡوَٰجِهِۦ حَدِيثٗا فَلَمَّا
نَبَّأَتۡ بِهِۦ وَأَظۡهَرَهُ ٱللَّهُ عَلَيۡهِ عَرَّفَ بَعۡضَهُۥ وَأَعۡرَضَ عَنۢ بَعۡضٖۖ فَلَمَّا
نَبَّأَهَا بِهِۦ قَالَتۡ مَنۡ أَنۢبَأَكَ هَٰذَاۖ قَالَ نَبَّأَنِيَ ٱلۡعَلِيمُ ٱلۡخَبِيرُ ٣ إِن
تَتُوبَآ إِلَى ٱللَّهِ فَقَدۡ صَغَتۡ قُلُوبُكُمَاۖ وَإِن تَظَٰهَرَا عَلَيۡهِ فَإِنَّ ٱللَّهَ
هُوَ مَوۡلَىٰهُ وَجِبۡرِيلُ وَصَٰلِحُ ٱلۡمُؤۡمِنِينَۖ وَٱلۡمَلَٰٓئِكَةُ بَعۡدَ ذَٰلِكَ
ظَهِيرٌ ٤ عَسَىٰ رَبُّهُۥٓ إِن طَلَّقَكُنَّ أَن يُبۡدِلَهُۥٓ أَزۡوَٰجًا خَيۡرٗا مِّنكُنَّ
مُسۡلِمَٰتٖ مُّؤۡمِنَٰتٖ قَٰنِتَٰتٖ تَٰٓئِبَٰتٍ عَٰبِدَٰتٖ سَٰٓئِحَٰتٖ ثَيِّبَٰتٖ
وَأَبۡكَارٗا ٥ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ قُوٓاْ أَنفُسَكُمۡ وَأَهۡلِيكُمۡ نَارٗا
وَقُودُهَا ٱلنَّاسُ وَٱلۡحِجَارَةُ عَلَيۡهَا مَلَٰٓئِكَةٌ غِلَاظٞ شِدَادٞ
لَّا يَعۡصُونَ ٱللَّهَ مَآ أَمَرَهُمۡ وَيَفۡعَلُونَ مَا يُؤۡمَرُونَ ٦ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ
كَفَرُواْ لَا تَعۡتَذِرُواْ ٱلۡيَوۡمَۖ إِنَّمَا تُجۡزَوۡنَ مَا كُنتُمۡ تَعۡمَلُونَ ٧

٥٦٠

duan me gjithë shpirt dhe do të plotësojnë çdo detyrim ndaj Tij.

Atëherë, qëllimi i krijimit dhe i ligjeve të vendosura, është njohja e Allahut të Lartësuar dhe adhurimi i Tij. Njohja e Allahut dhe adhurimi i Tij është qëllimi i jetës për adhuruesit e sinqertë të Allahut, ndërkohë që zullumqarët i kthejnë shpinën këtij qëllimi, duke mbyllur sytë dhe shpërfillur madhështinë e Atij që e krijoi këtë gjithësi dhe vendosi ligjet në të.

Këtu përfundon komenti i sures Talak. Falënderimi i takon vetëm Allahut të Lartësuar!

Surja 66: Et Tahrim (medinase) 12 ajete

Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. **O Profet, pse ia ndalon vetes atë që Allahu ta lejoi, duke dashur t'u bësh qejfin grave të tua?! Allahu është Falës e Mëshirues.**

2. **Allahu e ka caktuar zgjidhjen për betimet që bëni. Allahu është kujdestari juaj; Ai është i Gjithëdijshmi, i Urti.**

3. **Kur Pejgamberi i tregoi një sekret njërës prej grave të veta, ajo e përhapi atë lajm. Allahu ia bëri të ditur këtë të Dërguarit të Tij, i cili i tregoi asaj vetëm për një pjesë të lajmit, duke mos i thënë gjë për pjesën tjetër. Kur ai i tha asaj se çfarë kishte ndodhur me lajmin, ajo i tha: "E kush ta tregoi ty këtë?" Ai tha: "Ma tregoi i Gjithëdijshmi, Njohësi i të fshehtave!"**

4. **Ju të dyja pendohuni tek Allahu, sepse zemrat tuaja kanë gabuar. Por nëse bashkëveproni kundër tij, ta dini se Allahu është Mbrojtësi i tij, ashtu si edhe Xhibrili e besimtarët e ndershëm. Jo vetëm kaq, por edhe engjëjt e ndihmojnë atë!**

5. **Nëse ai ju divorcon, është Zoti i tij që kujdeset t'i dhurojë atij si zëvendësim gra edhe më të mira se ju: muslimane, besimtare, të bindura, që pendohen te Zoti, adhuruese, muhaxhire, që kanë qenë të martuara ose virgjëresha.**

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete ishin një qortim nga Allahu i Madhëruar drejtuar Profetit të Tij, kur ai ia ndaloi vetes së tij skllaven Maria, ose ujin me mjaltë, për të përmbushur kështu tekën e njërës prej grave të tij, sikurse thuhet në një histori të njohur. Për këtë, Allahu i Madhëruar shpalli këto ajete:

- "O Profet, pse ia ndalon vetes atë që Allahu ta lejoi, duke dashur t'u bësh qejfin

grave të tua?!" - O ti njeri, të cilit Zoti i dhuroi mirësinë më të madhe duke e bërë lajmëtar të Tij e duke i dhënë Shpalljen! Përse ia bën haram vetes atë mirësi që Zoti ta ka bërë të lejuar ty, madje edhe ymetit tënd? A kërkon që me këtë thjesht të kënaqësh gratë e tua?!

- **"Allahu është Falës e Mëshirues."** - Ky ajet tregon qartë se Allahu i Lartësuar e ka falur plotësisht Profetin e Tij. Allahu e ka mëshiruar Profetin e Tij. Madje, ky vetëprivim i Profetit u bë shkak që Allahu i Urtë dhe i Gjithëditur të shpallte një dispozitë të rëndësishme, të vlefshme për të gjithë ymetin, dispozitën e kompensimit për thyerjen e betimeve. I Madhëruari thotë më pas:

- **"Allahu e ka caktuar zgjidhjen për betimet që bëni."** - Allahu i Madhëruar e ka caktuar mënyrën si bëhet një betim dhe si zgjidhet çështja e thyerjes së këtij betimi. Si sqarim për këtë janë edhe ajetet 87 - 89 në suren Maide, ku i Madhëruari thotë: "O ju që keni besuar! Mos i bëni haram të mirat që Allahu i lejoi për ju dhe mos i kaloni kufijtë, se, pa dyshim, Allahu nuk i do ata që i kalojnë kufijtë. Hani nga ajo me të cilën Allahu ju furnizoi si hallall të mirë dhe ruajuni dënimit të Allahut, të Cilit ju i besoni. Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta, por për ato që i keni bërë duke pasur si qëllim përbetimin. Shpagimi i tij është ushqimi i dhjetë të varfërve me po atë ushqim mesatar që ushqeni edhe familjen tuaj, ose veshja e tyre, ose lirimi i një robi. Kush nuk ka mundësi t'i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagimi për betimet tuaja të thyera. Ruajini betimet tuaja! Kështu jua sqaron Allahu dispozitat e Veta, që të jeni mirënjohës." Kështu çdokush që ia bën vetes së vet haram diçka që në origjinë është e lejuar nga Zoti, si ndonjë ushqim, pije apo veprim të caktuar, ose betohet në Zotin se do të veprojë diçka apo nuk do të veprojë diçka, por pastaj dëshiron që ta thyejë ose e thyen këtë betim, ai ka si detyrë të bëjë kompensimin e caktuar për këtë rast. Allahu i Madhëruar thotë:

- "Allahu është kujdestari juaj..." - Allahu ka në dorë çështjet tuaja. Ai ju edukon, mëson e përkujdeset për ju në formën më të mirë, në lidhje me çështjet që kanë lidhje me dynjanë apo me ahiretin tuaj. Ai kujdeset që t'ju ruajë nga çdo e keqe, prandaj edhe caktoi për ju mënyrën e zgjidhjes së betimeve tuaja, për të cilat keni përgjegjësi. Nëpërmjet zbatimit të këtyre rregullave përmbushen detyrimet tuaja dhe nuk ngarkoheni me gjynahe për shkeljen e tyre.

- **"Ai është i Gjithëdijshmi, i Urti."** - Allahu është i Gjithëdijshmi. Dija e Tij ka përfshirë atë që duket dhe atë që fshihet prej jush. Allahu është *El Hakim* - i Urtë në gjithçka që ka krijuar e gjithçka që ka ligjëruar. Ai vendosi ligje të mrekullueshme, sepse e di shumë mirë se ato janë të dobishme, të mira e të përshtatshme për robërit e Tij.

- "Kur Pejgamberi i tregoi një sekret njërës prej grave të veta, ajo e përhapi atë lajm. Allahu ia bëri të ditur këtë të Dërguarit të Tij, i cili i tregoi asaj vetëm për një pjesë të lajmit, duke mos i thënë gjë për pjesën tjetër." - Shumë mufesirinë janë të mendimit se këtu bëhet fjalë për Hafsën (Allahu qoftë i kënaqur me të!), së cilës Profeti (a.s.) i tregoi diçka dhe e porositi që të mos ia tregonte

kujt. Por ajo ia tregoi Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Atëherë, Allahu i Madhëruar e njoftoi Profetin (a.s.) se çfarë kishte bërë Hafsa. Kështu, Profeti (a.s.) i tha Hafsës që ajo ia kishte treguar të tjerëve (Aishes) një pjesë të lajmit. Profeti (a.s.) nuk i tha se ajo e kishte treguar të gjithë lajmin, për t'u treguar i butë me të.

- "Kur ai i tha asaj se çfarë kishte ndodhur me lajmin, ajo i tha: "E kush ta tregoi ty këtë?"" - Kush ta tregoi këtë fakt, që askush tjetër nuk e dinte? Përgjigjja qe:

- "Ma tregoi i Gjithëdijshmi, Njohësi i të fshehtave!" – Ma tregoi Allahu, të Cilit nuk mund t'i fshihet asgjë e hapur apo e fshehtë. Ai është Njohësi i të fshehtave dhe të pashprehurave.

- "Ju të dyja pendohuni tek Allahu, sepse zemrat tuaja kanë gabuar." - Kjo u drejtohej dy grave të Profetit (a.s.), Aishes dhe Hafsës (Allahu qoftë i kënaqur me to), të cilat u bën shkak që Profeti (a.s.) t'i bënte vetes haram diçka që ai e dëshironte. Allahu i Madhëruar i ftoi ato të pendoheshin, duke u bërë të ditur se me veprën e tyre zemrat e tyre kishin rënë disi nga ai nivel ku duhej të ishin. Ato duhej të ishin të sjellshme, të përmbajtura e shumë të kujdesshme në marrëdhëniet me bashkëshortin e tyre, Profetin e Zotit, Muhamedin (a.s.). Ato nuk duhej ta kundërshtonin apo të silleshin në atë mënyrë që ta shqetësonin atë.

- "Por nëse bashkëveproni kundër tij..." - Nëse ato do të bashkëpunonin me njëra tjetrën për ta lënduar Profetin e dashur të Zotit dhe do të vazhdonin në këtë rrugë, atëherë:

- "...ta dini se Allahu është Mbrojtësi i tij, ashtu si edhe Xhibrili e besimtarët e ndershëm. Jo vetëm kaq, por edhe engjëjt e ndihmojnë atë!" - Të gjithë e ndihmojnë dhe mbështesin Profetin (a.s.). Për këtë arsye, ai do të jetë gjithmonë i fituari, ndërsa kundërshtarët e tij do të jenë të dështuar e të humbur.

Në këtë ajet përshkruhet nderimi më i madh që Zoti i ka bërë më të zgjedhurit dhe zotërisë së të gjithë profetëve, Muhamedit (a.s.). Vetë Zoti Bujar dhe i Madhërishëm e përcaktoi Vetveten si ndihmues dhe mbështetës të Profetit të zgjedhur. Po kështu i përcaktoi edhe krijesat më të zgjedhura të tij: melekët, Xhibrilin dhe besimtarët e sinqertë. Edhe këta janë ndihmues të Profetit të madh.

Këto ajete janë qortim e këshillë e fortë për gratë e Profetit. Madje, Ai iu kujton diçka që gratë i tremb më së shumti, divorcin. Allahu i Lartësuar tha:

- "Nëse ai ju divorcon, është Zoti i tij që kujdeset t'i dhurojë atij si zëvendësim gra edhe më të mira se ju: muslimane, besimtare, të bindura, që pendohen te Zoti, adhuruese, muhaxhire..." - Të mos mbaheni me të madh me të, sepse edhe nëse ai ju divorcon, kjo nuk e rëndon aspak atë. Ai nuk është aspak i varur prej jush, sepse Allahu mund t'i japë atij gra më të mira se ju, në drejtim të fesë, besimit e bukurisë. Për këtë arsye, nëse ju vazhdoni të veproni në mënyrë të gabuar, gjë që nuk ndodh, Allahu mund ta bëjë edhe këtë zëvendësim. E gjithë kjo është me "nëse...".

Falë Zotit, Profeti (a.s) nuk i divorcoi ato. Nëse ai do t'i divorconte, Allahu i Lartësuar do t'ia zëvendësonte me gra të mrekullueshme, ashtu siç duhet të jenë

gratë. Së pari, ato duhet të jenë muslimane, domethënë, të jenë të përkushtuara në zbatimin e dispozitave që kanë lidhje me fjalët e veprat e dukshme. Së dyti, të jenë besimtare, pra, të jenë të përkushtuara në zbatimin e dispozitave që kanë lidhje me besimin, diturinë dhe sjelljen e zemrës. Gjithashtu, ato duhet të jenë të bindura, domethënë, me bindje të vazhdueshme e sistematike ndaj porosive të Allahut dhe Profetit të Tij. Gratë duhet të jenë edhe "*el taibat*" - që pendohen për çdo vepër që Zoti e urren. Ato duhet të përpiqen të bëjnë gjithçka që kënaq Zotin dhe të pendohen për gjithçka që Zoti e urren. Të gjitha këto, Allahu i Lartësuar i ka qartësuar nëpërmjet Shpalljes, prandaj është Shpallja ajo që duhet të mësohet dhe zbatohet.

- "...që kanë qenë të martuara ose virgjëresha." - Allahu i Lartësuar mund t'i dhurojë Profetit të Tij larmishmëri, që ai të kënaqet. Allahu mund t'i mundësojë atij gra të virgjëra ose jo të virgjëra, ashtu si ai t'i dëshirojë.

Kështu, pasi Allahu i Lartësuar i qortoi dhe këshilloi ato gra, ato nxituan që të kënaqnin Profetin (a.s.), duke u mveshur me cilësitë më të mira, që u përshkruan nga Allahu i Madhëruar. Ato u bënë gratë më të mira mes besimtarëve.

Nga këto ajete mësojmë se Allahu i Madhëruar zgjodhi për Profetin e Tij gjërat më të mira, njerëzit më të çmuar dhe atributet më të larta. Kështu, duke qenë se Allahu i Madhëruar gjykoi që këto gra të qëndronin me të, kjo tregoi se ato ishin gratë më të mira dhe më të kompletuarat me cilësitë që Ai përshkroi.

Ajeti 6

6. O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej Zjarrit, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër, që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron, por i zbatojnë ato çfarë u urdhërohen.


Shpjegimi i ajetit

- "O ju që keni besuar, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej Zjarrit..." - O ju të cilëve Zoti ju fali besimin, përpiquni seriozisht e punoni për të plotësuar kushtet e këtij besimi, duke bërë vepra të mira. Ruani veten dhe familjen tuaj nga Zjarri, i përshkruar me cilësi të tmerrshme!

Ruajtja e vetes arrihet duke e nënshtruar atë të zbatojë porositë e Zotit, me sinqeritet për Të dhe sipas udhëzimeve të Tij, dhe duke iu larguar harameve, me drojë e me madhërim për Zotin. Veç kësaj, duhet edhe pendim për çdo vepër që zemëron Allahun dhe që bën të merituesHëm ndëshkimin e Tij. Ndërsa ruajtja e familjes dhe e fëmijëve arrihet nëpërmjet edukimit të tyre me cilësi të larta e me besim të sinqertë e të drejtë, ashtu siç dëshiron Zoti. Njeriu nuk shpëton e nuk mund të gjejë qetësi ndryshe, vetëm nëse përpiqet për të plotësuar porositë e Allahut për veten dhe për ata që ka nën përgjegjësinë e tij, si fëmijët, gratë etj.

Allahu i Madhëruar e përshkroi Zjarrin me këto cilësi, që robërit të Tij të frenojnë veten nga gjërat që Ai i urren dhe i ka ndaluar. Ai thotë:

- "..lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët." - Kjo i ngjan thënies tjetër të Allahut: "Pa dyshim, ju dhe ato që ju adhuroni veç Allahut keni për të qenë lëndë djegëse e Xhehenemit." [Enbija 98].


الجزء الثامن والعشرون سورة التحريم

يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ تُوبُوٓاْ إِلَى ٱللَّهِ تَوۡبَةٗ نَّصُوحًا عَسَىٰ رَبُّكُمۡ
أَن يُكَفِّرَ عَنكُمۡ سَيِّـَٔاتِكُمۡ وَيُدۡخِلَكُمۡ جَنَّٰتٖ تَجۡرِي
مِن تَحۡتِهَا ٱلۡأَنۡهَٰرُ يَوۡمَ لَا يُخۡزِي ٱللَّهُ ٱلنَّبِيَّ وَٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ
مَعَهُۥۖ نُورُهُمۡ يَسۡعَىٰ بَيۡنَ أَيۡدِيهِمۡ وَبِأَيۡمَٰنِهِمۡ يَقُولُونَ رَبَّنَآ
أَتۡمِمۡ لَنَا نُورَنَا وَٱغۡفِرۡ لَنَآۖ إِنَّكَ عَلَىٰ كُلِّ شَيۡءٖ قَدِيرٞ ٨
يَٰٓأَيُّهَا ٱلنَّبِيُّ جَٰهِدِ ٱلۡكُفَّارَ وَٱلۡمُنَٰفِقِينَ وَٱغۡلُظۡ عَلَيۡهِمۡۚ
وَمَأۡوَىٰهُمۡ جَهَنَّمُۖ وَبِئۡسَ ٱلۡمَصِيرُ ٩ ضَرَبَ ٱللَّهُ مَثَلٗا
لِّلَّذِينَ كَفَرُواْ ٱمۡرَأَتَ نُوحٖ وَٱمۡرَأَتَ لُوطٖۖ كَانَتَا تَحۡتَ
عَبۡدَيۡنِ مِنۡ عِبَادِنَا صَٰلِحَيۡنِ فَخَانَتَاهُمَا فَلَمۡ يُغۡنِيَا عَنۡهُمَا
مِنَ ٱللَّهِ شَيۡـٔٗا وَقِيلَ ٱدۡخُلَا ٱلنَّارَ مَعَ ٱلدَّٰخِلِينَ ١٠
وَضَرَبَ ٱللَّهُ مَثَلٗا لِّلَّذِينَ ءَامَنُواْ ٱمۡرَأَتَ فِرۡعَوۡنَ إِذۡ
قَالَتۡ رَبِّ ٱبۡنِ لِي عِندَكَ بَيۡتٗا فِي ٱلۡجَنَّةِ وَنَجِّنِي مِن فِرۡعَوۡنَ
وَعَمَلِهِۦ وَنَجِّنِي مِنَ ٱلۡقَوۡمِ ٱلظَّٰلِمِينَ ١١ وَمَرۡيَمَ ٱبۡنَتَ
عِمۡرَٰنَ ٱلَّتِيٓ أَحۡصَنَتۡ فَرۡجَهَا فَنَفَخۡنَا فِيهِ مِن رُّوحِنَا
وَصَدَّقَتۡ بِكَلِمَٰتِ رَبِّهَا وَكُتُبِهِۦ وَكَانَتۡ مِنَ ٱلۡقَٰنِتِينَ ١٢

٥٦١

- "Atë e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër..." – Melekët mbikëqyrës janë të vrazhdë në sjellje dhe të rreptë në veprim. Ata të tmerrojnë vetëm me zërin kërcënues të tyre. Pamja e tyre është gjithashtu e papërballueshme. Me forcën dhe ashpërsinë e tyre, ata i poshtërojnë banorët e Zjarrit. Ata zbatojnë me përpikmëri urdhrat e Zotit të tyre:

- "...që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron, por i zbatojnë ato çfarë u urdhërohen." - Ky është një lëvdim për melekët e nderuar, për nënshtrimin e tyre të plotë ndaj Zotit dhe për zbatimin e plotë të urdhrave të Tij.

Ajeti 7

7. O ju që mohuat, sot mos u justifikoni! Ju do të shpërbleheni vetëm për atë që keni vepruar.

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Madhëruar do t'u drejtohet me këto fjalë qortuese e poshtëruese banorëve të Zjarrit në Ditën e Kijametit. Atyre u thuhet: Sot mos u justifikoni, sepse koha e justifikimit dhe mundësia për t'u penduar tashmë ka përfunduar. Sot nuk bën më dobi asnjë justifikim. Kjo është dita kur jepet shpërblimi për veprat e bëra, ndërsa ju keni sjellë këtu veçse mohimin e Allahut dhe të shpalljeve të Tij, armiqësinë kundër profetëve dhe të dashurve të Allahut.

Ajeti 8

8. O ju që keni besuar, drejtohuni tek Allahu me pendim të sinqertë! Kështu shpresohet që Zoti juaj t'ju mbulojë të këqijat e t'ju vendosë në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj, atë ditë, kur Allahu nuk ka për ta turpëruar Pejgamberin e as ata që besuan bashkë me të. Drita e tyre do të ndriçojë para dhe në të djathtë të tyre, ndërsa ata do të thonë: "Zoti ynë, forcoje dritën tonë dhe na i mbulo gjynahet tona! Vërtet, Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë!".

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Lavdëruar na urdhëron në këtë ajet për pendim të sinqertë e të vërtetë dhe premton për këtë falje, mbulim të të këqijave e futje në Xhenet. Ai premton për sukses në arritjen e çdo të mire e shpëtim nga çdo e keqe. Kjo fitore do të shfaqet plotësisht Ditën e Gjykimit, kur besimtarët të ecin të ndriçuar nga drita e imanit të tyre. Kështu, ata do të jenë me zemër të qetë e të sigurt. Kur të shohin që munafikëve do t'u shuhet drita, ata, me drojë, do t'i luten Zotit e do të thonë: "Zoti ynë, forcoje dritën tonë dhe na i mbulo

gjynahet tona! Vërtet, Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë!". Dhe Allahu i Madhëruar do t'i përgjigjet lutjes së tyre, duke ua forcuar dritën e imanit të tyre, e cila do t'i ndihmojë të arrijnë të sigurt në Xhenetin e mirësisë. Ky përfundim është fryt i pendimit të sinqertë e të vërtetë, që është bërë për të gjitha gjynahet e në mënyrë të vazhduar.

Ajeti 9

9. O ti i Dërguar, luftoji jobesimtarët e hipokritët dhe qëndro ashpër kundër tyre! Vendi i tyre është Xhehenemi, i cili është vendi më i shëmtuar!

Shpjegimi i ajetit

Allahu i Madhëruar e urdhëron Profetin e Tij që të luftojë me ashpërsi kundër mohuesve dhe munafikëve. Lufta kundër këtyre kategorive bëhet me dy mënyra:

1. Duke u qartësuar të vërtetën me argumente të sakta, duke i ftuar me fjalë të mira dhe duke shkatërruar të gjitha rrugët e tyre të humbjes.

2. Duke i luftuar me armë, nëse nuk i përgjigjen ftesës së Zotit dhe nuk i nënshtrohen ligjit të Tij.

Mënyra e parë zhvillohet me urtësi, butësi dhe me fjalët më të mira, ndërsa e dyta bëhet me ashpërsi dhe forcë.

Mohuesit dhe munafikët kanë dënim të madh në dynja, që vjen prej humbjes dhe poshtërimit të tyre përballë xhihadit të Profetit dhe besimtarëve të Zotit. Por në ahiret ata i pret një dënim akoma më i ashpër, që është zjarri i Xhehenemit. Ky është përfundimi më i keq.

Ajetet 10 – 12

10. Atyre që mohojnë, Allahu u sjell si shembuj gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robërit Tanë të mirë, por i tradhtuan ata. Për këtë arsye, bashkëshortët e tyre nuk do të mund t'i mbrojnë ato aspak tek Allahu. Atyre të dyjave do t'u thuhet: "Hyni të dyja në Zjarr, së bashku me të tjerët që hyjnë në të!"

11. Ndërsa atyre që besojnë, Allahu u sjell si shembull gruan e Faraonit, e cila tha: "Zoti im, më bëj një vend tek Ti në Xhenet! Më shpëto prej Faraonit dhe veprave të tij, më shpëto edhe prej popullit mizor!"

12. Edhe Merjemja, e bija e Imranit, e cila e ruajti mirë nderin e saj. Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë. Ajo besoi plotësisht fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij. Gjithashtu, ajo ishte e devotshme.

Shpjegimi i ajeteve

- "Atyre që mohojnë, Allahu u sjell si shembuj gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit." - Këta shembuj shërbejnë që njerëzit të kuptojnë se lidhjet e ndryshme mes besimtarëve e mohuesve nuk kanë asnjë efekt te përfundimi i secilit prej tyre. Kështu, afërsia me besimtarin nuk ka për t'i sjellë qafirit asnjë dobi. Gjithashtu, lidhja me qafirin nuk ka për ta dëmtuar aspak besimtarin, nëse ky i fundit i ka kryer detyrimet kundrejt tjetrit.

Kjo duket si një këshillë dhe vërejtje për gratë e Profetit (a.s.), që ato të ruheshin nga gabimet dhe mosbindja, duke e kuptuar mirë se lidhja e tyre me Profetin (a.s.) nuk do t'u sillte asnjë dobi, nëse ato nuk besonin dhe nuk i bindeshin Allahut të Lartësuar. Më tej, thotë i Madhëruari:

- "Ato ishin të martuara me dy nga robërit Tanë të mirë, por i tradhtuan ata." - Ato

ishin bashkëshorte të dy profetëve të nderuar, Nuhut (a.s.) dhe Lutit (a.s.). Por ato tradhtuan, duke mos e pranuar besimin dhe fenë e burrave të tyre. Pra, këtu nuk flitet assesi për tradhti bashkëshortore. Nuk ka ndodhur kurrë që një grua profeti të ketë tradhtuar nderin dhe shtratin e tij. Zoti i Lartësuar kurrë nuk do të bënte kurrë që gruaja e një profeti të ishte e përdalë dhe shkelëse e nderit bashkëshortor.

Meqenëse ato e tradhtuan fenë e burrave të tyre, statusi i tyre si bashkëshorte profetësh nuk u bëri asnjë dobi. I lartësuari thotë:

- "Prandaj, bashkëshortët e tyre nuk do të mund t'i mbrojnë ato aspak tek Allahu. Atyre të dyjave do t'u thuhet: "Hyni të dyja në Zjarr, së bashku me të tjerët që hyjnë në të!"" – Kështu, profetët Nuh dhe Lut (a.s.) nuk do të mund t'i ndihmojnë ato tek Allahu i Madhëruar. Ndërsa për besimtarët, Allahu i Lartësuar sjell shembull tjetër:

- "Ndërsa atyre që besojnë, Allahu u sjell si shembull gruan e Faraonit..." - Ajo ishte Asijah (Allahu qoftë i kënaqur me të!), e bija e Mizahimit, e cila iu drejtua Zotit të saj me këtë lutje:

- "Zoti im, më bëj një vend tek Ti në Xhenet! Më shpëto prej Faraonit dhe veprave të tij, më shpëto edhe prej popullit mizor!" - Allahu i Madhëruar e përshkruan atë si besimtare të sinqertë dhe të nënshtruar, e cila iu lut me përkushtim Atij. Ajo iu drejtua Zotit të saj me kërkesat më të larta për të cilat mund të lutet njeriu: për hyrjen në Xhenet dhe për të qenë afër Zotit të botëve, Bujarit të Gjithëmëshirshëm. Ajo iu lut Allahut, gjithashtu, që ta shpëtonte nga e keqja e Faraonit dhe nga e keqja e çdo zullumqari. Allahu i Madhëruar iu përgjigj lutjes së saj, dhe prandaj ajo jetoi me besim të pastër, të plotë e të patundur. Allahu, gjithashtu, e shpëtoi atë nga të gjitha sprovat. Për këtë çështje, Profeti (a.s.) ka thënë: "Prej burrave ka pasur shumë njerëz të përkryer. Ndërsa prej grave kanë qenë të përkryera veçse Merjemja - e bija e Imranit, Asijah - e bija e Mizahimit, Hadixhja - e bija e Huejlidit, dhe Aishja, vlera e së cilës mbi gratë e botës është si vlera e *therid*-it [35] mbi ushqimet e tjera."

- "Edhe Merjemja, e bija e Imranit, e cila e ruajti mirë nderin e saj." - Ajo u ruajt nga çdo e ligë, sepse kishte besim të plotë dhe të drejtë, si edhe moral të kulluar.

- "Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë. Ajo besoi plotësisht fjalët e Zotit të saj dhe librat e Tij." – Këtu përshkruhet shkalla e lartë e diturisë së Merjemes.

Në ajet thuhet: "Ajo besoi plotësisht fjalët e Zotit të saj." Fjalët e Zotit janë dy llojesh: fjalët e kaderit, domethënë të përcaktimit të Tij të gjërave, dhe fjalët e Ligjit që Ai vendosi për njerëzit, për t'u treguar atyre mënyrën se si ta adhurojnë Atë e si të jetojnë sipas vullnetit, dëshirës e kënaqësisë së Tij. Merjemja i besoi dhe i jetësoi të dyja llojet e fjalëve të Zotit. Ajo i besoi gjithashtu të gjithë librat e Zotit.

Por një besim nuk mund të quhet i drejtë dhe i saktë nëse nuk bëhet me dituri të plotë dhe nëse nuk punohet sipas tij. Për këtë arsye, i Madhëruari e sqaron këtë çështje, kur thotë për Merjemen:

---

[35] *Therid*-i ishte një lloj ushqimi, më i miri për atë kohë dhe vend. Krahasimi tregon thjesht se Aishja qëndron mbi të gjitha gratë e botës.

- "Gjithashtu, ajo ishte e devotshme." - Ajo ishte e bindur ndaj Zotit, sistematike dhe me drojë në adhurimin e Tij. Ky përshkrim dëshmon për veprat e shumta të saj të adhurimit. Merjemja ishte *siddikah* - e vërtetë dhe e sinqertë, dhe grada e vërtetësisë e sinqeritetit arrihet veçse me dituri të plotë dhe me punë sipas kësaj diturie.

Këtu përfundon edhe surja Tahrim, dhe për këtë falënderimi i qoftë Allahut!


Surja 67: El Mulk (mekase) 30 ajete

Ajetet 1 – 4

1. I Madhëruar është Ai, në dorën e të Cilit është i tërë sundimi, Ai i Cili është i Plotpushtetshëm për gjithçka.
2. Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi.
3. Ai krijoi shtatë qiej, palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë mospërputhje. Vëzhgo, atëherë: a sheh ndonjë të çarë?!
4. Përsëri e përsëri vëzhgo, por ky vëzhgim do të të kthehet mbrapsht i përulur dhe i dorëzuar!

Shpjegimi i ajeteve

- "I Madhëruar është Ai, në dorën e të Cilit është i tërë sundimi, Ai i Cili është i Plotpushtetshëm për gjithçka." - *Tebârake* është një fjalë që tregon madhështi, begati, gjerësi e bekim. Pra, të mëdha, të mrekullueshme e të shumta janë mirësitë e Allahut. Bamirësia dhe mëshira e Tij janë gjithëpërfshirëse. Prej madhështisë së Allahut është edhe fakti që në dorën e Tij është pushteti, mbretërimi i botës qiellore dhe tokësore, në të cilat Ai krijon dhe



vepron si të dëshirojë. Allahu ka përcaktuar gjithçka në këtë ekzistencë. Ai ka vendosur për krijesat e Tij një ligj ekzistence, jete dhe adhurimi, bazuar në urtësinë e Tij absolute. Prej madhështisë së Tij është që Ai "është i Plotpushtetshëm për gjithçka". Me fuqinë dhe pushtetin e Tij absolut, Ai ka krijuar këto krijesa madhështore, si qiejt, tokën dhe gjithçka mes tyre.

- "Është Ai që krijoi vdekjen dhe jetën..." - Ai krijoi jetën dhe vdekjen. Ai përcaktoi që krijesat të jetojnë dhe të vdesin. Qëllimi i kësaj tregohet në vijim:

- "...për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë." – Domethënë, për të na sprovuar me qëllim që të dalë qartë se cili është vërtet *aĥsenu amelâ*, pra, cili kryen vepra që Zoti i ka cilësuar si *aĥsenu* - "më të mirat".

Që një vepër të jetë "*aĥsenu*", ajo duhet të plotësojë dy kushte:

1. të kryhet me sinqeritet vetëm për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar;

2. të jetë e saktë dhe sipas mësimeve e udhëzimeve të Allahut dhe Profetit, sepse çdo adhurim që duhet të kryejmë për të kënaqur Allahun e Lartësuar është sqaruar plotësisht nga Allahu dhe Profeti i Tij.

Allahu i Lartësuar i krijoi krijesat dhe i vendosi ato të jetojnë jetën e kësaj dynjaje në këtë tokë. Ai i njoftoi ata, gjithashtu, se do të vijë një ditë që do të largohen prej saj, për t'u kthyer përsëri tek Ai që i krijoi dhe për t'u marrë në përgjegjësi. Për këtë arsye, Ai u caktoi urdhra e ndalesa, që rregullojnë jetën e tyre. Pastaj krijoi brenda tyre dëshira e prirje të shumta, për t'i sprovuar ata në zbatimin e ligjeve. Atyre që i nënshtrohen urdhrave të Tij dhe i rregullojnë veprat në bazë të këtyre urdhrave, Allahu i Lartësuar ka për t'ua përmirësuar dhe shtuar shpërblimet e Tij në të dyja jetët. Por ata që ndjekin dëshirat dhe pasionet e pakontrolluara të shpirtit dhe i flakin tej porositë e Zotit të tyre, sigurisht që do të meritojnë shpërblimin më të keq.

- "Ai është Ngadhënjyesi, Mëkatfalësi." - Allahu është *El Azîzu* - Ngadhënjyesi. Atij i takon pushteti absolut. Me pushtetin e Tij të plotë, Allahu sundon mbi gjithçka. Këtij pushteti i janë nënshtruar të gjitha krijesat.

Allahu është *El Ĝafûr*, pra Falës dhe Mëkatmbulues i Madh. Ai është Falës për ata që gabojnë, bëjnë gjynahe dhe lënë mangët detyrimet dhe porositë e Tij. Nëse robërit pendohen dhe kthehen tek Ai duke i kërkuar falje, Ai ua fal gjynahet, edhe nëse këto arrijnë në kupën e qiellit. Ai, gjithashtu, ua mbulon të metat e tyre, edhe nëse janë aq të shumta sa të mbulojnë gjithë dynjanë.

- "Ai krijoi shtatë qiej, palë mbi palë." Allahu krijoi shtatë qiej njëri mbi tjetrin. Pra, qiejt janë në shtatë shtresa. Allahu i krijoi qiejt në një gradë absolute bukurie dhe saktësie.

- "Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë mospërputhje." - Në krijimin e Mëshiruesit nuk do të gjesh asnjë defekt apo mangësi. Kështu, nëse në të nuk do të gjesh asnjë lloj mangësie, atëherë ai është plotësisht i bukur, i rregullt dhe i mrekullueshëm. Ngjyra, forma, lartësia e qiejve, dielli, hëna, yjet dhe gjithë ato trupa qiellorë janë të mrekullueshëm e të pashembullt në rregullsinë dhe bukurinë e tyre.

Përsosmëria e krijimit të Tij është e sigurt, prandaj Allahu i Lartësuar urdhëron që ne t'i kthejmë e t'i rikthejmë vëzhgimet tona te ky krijim.

- "Vëzhgo, atëherë: a sheh ndonjë të çarë?! Përsëri e përsëri vëzhgo, por ky vëzhgim do të të kthehet mbrapsht i përulur dhe i dorëzuar!" - Allahu na udhëzon që ta vëzhgojmë thellë dhe shpesh krijimin e Tij. Por vëzhgimet tona për të gjetur ndonjë mangësi a çrregullim do të përfundojnë gjithmonë të dështuara e të dorëzuara. Edhe nëse do të provonim me të gjitha forcat të dallonim ndonjë gjë të tillë, do të mposhteshim gjithnjë para kësaj mrekullie dhe madhështie të krijuar nga i Urti.

Më tej, Allahu i Lartësuar tregon me hollësi bukuritë e këtij qielli.

Ajetet 5 – 11

5. Qiellin e dynjasë, Ne e kemi zbukuruar me kandilë (yje), që i kemi bërë gjuajtës kundër shejtanëve, ndaj të cilëve kemi përgatitur dënimin me zjarr të ndezur fort.
6. Dënimi në Xhehenem është edhe për ata që nuk i besojnë Zotit të tyre. Sa vend i keq është ai!
7. Kur të hidhen në të, ata do t'ia dëgjojnë ushtimën e vlimit të tij.
8. Nga zemërimi që ka, ai gati sa nuk shpërthen! Sa herë që ndonjë turmë do të hidhet në të, roja do t'i pyesë: "A s'ju erdhi ndonjë paralajmërues?"
9. Ata thonë: "Po, na erdhën paralajmërues (nga Zoti), por ne i mohuam duke iu thënë: "Allahu nuk ka shpallur asgjë, ndërsa ju nuk jeni gjë tjetër, por veçse njerëz në një humbje të madhe!"
10. Ata do thonë gjithashtu: "Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim tani ndër banorët e Zjarrit!".
11. Pra, kështu i pranojnë ata gjynahet e veta. Larg mëshirës qofshin banorët e Zjarrit!

Shpjegimi i ajeteve

- "Qiellin e dynjasë, Ne e kemi zbukuruar me kandilë (yje), që i kemi bërë gjuajtës kundër shejtanëve..." – Qielli i dynjasë është ai të cilin e shohim me sy, pra, ai që ndodhet më pranë nesh. Allahu e ka stolisur këtë qiell me kandilë, pra, me yje të shumtë dhe të ndryshëm, për sa i përket dritës dhe shkëlqimit të tyre. Përfytyroni një qiell bosh, pa këto drita të bukura dhe qetësuese. Me siguri, ai do të ishte një mbulesë e zezë, e errët, e shëmtuar dhe e frikshme. Por Allahu i Lartësuar e stolisi qiellin e dynjasë me yjet ndriçues, nëpërmjet të cilëve udhëzohen njerëzit në errësirën e tokës dhe të detit.

Nëse Allahu i Lartësuar tregon se e ka zbukuruar qiellin e dynjasë me yje, kjo nuk përjashton mundësinë që shumë yje të ndodhen edhe në qiejt e tjerë më sipër, sepse qiejt janë transparentë. Në këtë mënyrë, qielli i dynjasë zbukurohet, edhe nëse yjet nuk ndodhen në të.

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar i ka bërë yjet si gjuajtës të shejtanëve, të cilët duan që të vjedhin me përgjime lajmet e zbritura nga qielli. Këto yje janë si roje mbrojtës në qiell, të cilat nuk lejojnë që të vidhen prej shejtanëve lajmet e qiellit në lidhje me tokën. Këta trupa qiellorë, të cilët godasin shejtanët, janë krijuar dhe vendosur në qiell prej Allahut të Lartësuar, si ndëshkim për ta në jetën e dynjasë. Ndërsa në jetën tjetër:

- "...kemi përgatitur dënimin me zjarr të ndezur fort." - Shejtanët janë rebeluar kundër Allahut, pengojnë njerëzit nga feja e Tij dhe punojnë vazhdimisht për t'i humbur e devijuar ata. Për këtë arsye, ata dhe të gjithë pasuesit e rrugës së tyre të humbur do të jenë banorë të *Seaîr*-it, pra, të Zjarrit.

Allahu i Lartësuar e përforcon këtë kërcënim duke e përsëritur:

- "Dënimi në Xhehenem është edhe për ata që nuk i besojnë Zotit të tyre. Sa vend i keq është ai!" – Vërtet, ai është vend përfundimi më i keq, sepse aty do të provojnë poshtërimin e madh dhe të pafundmë.

- "Kur të hidhen në të, ata do t'ia dëgjojnë ushtimën (*shehîķan*) e vlimit të tij." - *Shehîķan* është një zë tmerrues shumë i fortë.

- "Nga zemërimi që ka, ai gati sa nuk shpërthen!" - Për shkak të masës së stërmadhe të tij, që zien brenda vetes, ai gati

sa nuk shpërthen. Po ashtu, ai gati sa nuk ndahet në copa nga urrejtja dhe zemërimi i tij ndaj qafirëve.

Kështu vlon Xhehenemi nga urrejtja për ta. Por si do të ndodhë kur ata do të jenë futur brenda tij?!

Pastaj Allahu i Lartësuar përmend fjalët qortuese, me të cilat melekët u drejtohen banorëve të Xhehenemit.

- "Sa herë që ndonjë turmë do të hidhet në të, roja do t'i pyesë: "A s'ju erdhi ndonjë paralajmërues?" - Kuptimi: Meqë ju jeni në Zjarr dhe keni merituar këtë ndëshkim, duket sikur ju nuk jeni paralajmëruar rreth këtij tmerri.

- "Ata thonë: "Po, na erdhën paralajmërues *(nga Zoti)*, por ne i mohuam duke iu thënë: "Allahu nuk ka shpallur asgjë, ... - Ata jo vetëm që mohuan profetët e dërguar për ta, por bënë një mohim edhe më të përgjithshëm. Ata mohuan të vërtetën e sigurt, që quhet Shpallje hyjnore. Ata paturpësisht pretenduan se Allahu kurrë nuk ka sjellë ndonjë shpallje si udhëzim për njerëzit. Porse ky ishte veçse një trillim.

Megjithatë, edhe kjo sikur nuk u mjaftoi, prandaj thanë:

- "...ndërsa ju nuk jeni gjë tjetër, por veçse njerëz në një humbje të madhe!" - Ata pretenduan që profetët ishin veçse njerëz të humbur dhe të gabuar, njerëz shumë larg të vërtetës dhe realitetit. Ndërsa ata vetë ishin të udhëzuarit, të vërtetët, që mund të udhëzonin njerëzimin drejt përparimit dhe lartësimit! Jo vetëm kaq, por e konsideruan rrugën e profetëve si një kotësi dhe humbje të madhe.

Subhanallah! A ka ndonjë mendjemadhësi, padrejtësi dhe kufër më të madh se kaq?!

- "Ata do thonë gjithashtu: "Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim tani ndër banorët e Zjarrit!"." - Këto fjalë do të jenë një dëshmi nga vetë ata që tregojnë pazotësinë dhe pamerituesshmërinë e tyre për t'u udhëzuar në rrugën e drejtë. Vetë ata do ta pranojnë që kurrë nuk e merituan që të shpëtonin prej Zjarrit të madh.

Dihet që rruga e udhëzimit është dëgjimi i Shpalljes dhe i udhëzimeve të Zotit dhe kuptimi qartë i qëllimit të tyre. Duke dëgjuar udhëzimin e qartë dhe të sigurt të sjellë prej Zotit dhe profetëve të Tij, njeriu fiton sigurinë rreth urtësisë dhe qëllimeve të Zotit, nga njëra anë, dhe detyrave të tij si rob, nga ana tjetër. Duke vënë në përdorim logjikën, nëpërmjet së cilës çdo njeri mund të dallojë të dobishmen nga e dëmshmja, të drejtën nga e padrejta, të vërtetën nga e kota, ai duhet që ta disiplinojë veten sipas të vërtetës së sigurt, që i ka ardhur prej Zotit. Nëpërmjet kësaj logjike, ai duhet që të largohet dhe të ruhet nga çdo gjë kërcënuese, të marrë të mirat dhe të largohet nga të këqijat.

Pavarësisht nga kjo, ata të mjerë do dëshmojnë vetë se nuk e vunë në përdorim atë mirësi të dhuruar prej Zotit të tyre. E si mund të trajtoheshin të tilla krijesa njëlloj me robërit e përzgjedhur, që kanë siguri dhe dije të plotë mbi udhëzimet e Zotit dhe të profetëve, që janë të mbushur me besim dhe sinqeritet për të Adhuruarin?! Ata e mbështesin besimin e tyre në dëshmi të përcjella qartë dhe në mënyrë të kontrolluar. Ata e dëgjojnë ashtu siç është, pa ndryshime e tjetërsime, mesazhin e Allahut dhe të

Profetit të Tij. Ata, gjithashtu, e kuptojnë drejt këtë mesazh, sikurse i mësoi dhe i udhëzoi Profeti i tyre. Pas të kuptuarit të drejtë, ata e ndërtojnë jetën e tyre mbi mësimet e tij, mbi këtë themel të patundur, dhe kështu ngrihet lart kështjella e besimit të tyre. Dituria, të kuptuarit dhe veprat e sinqerta: këto janë bashkëudhëtarët e jetës së tyre. Ata dinë të dëgjojnë argumentet fetare të përcjella prej Profetit të tyre, por dinë gjithashtu që të argumentojnë drejt edhe me logjikën e tyre. Me shumë thjeshtësi, ata dallojnë udhëzimin e drejtë nga rrugët e devijuara, mirësinë nga poshtërsia dhe të bukurën nga e shëmtuara. Bazat fetare dhe logjike të argumentimit, mbi të cilat ata ndërtojnë besimin e tyre, janë një mirësi e madhe, që Zoti ua jep vetëm atyre, si robër të përzgjedhur. Allahu i Lartësuar dhe i Urtë veçon me mirësinë e Tij atë që Ai dëshiron. Ai është i Gjithëditur dhe e di shumë mirë se kush i meriton e kush jo dhuratat e Tij.

Allahu i Lartësuar na tregon sërish rreth këtyre banorëve të Zjarrit, të cilët do t'i pranojnë padrejtësitë dhe gjynahet e tyre.

- "Pra, kështu i pranojnë ata gjynahet e veta. Larg mëshirës qofshin banorët e Zjarrit!" - Ky është një mallkim, që bëhet për trishtimin, dëbimin dhe dëshpërimin e tyre.

Sa të dëshpëruar dhe të shkatërruar janë ata të cilët do humbin përfundimisht shpërblimin e Allahut! Ata nuk i ndahen rrugës së Zjarrit, prandaj do të jenë përjetësisht në *Seaîr*. *Seaîr* është një zjarr i ndezur fort. Ai do të flakërojë në trupat e tyre dhe nxehtësia e tij do t'u futet deri në zemër.

Ajeti 12

12. Pa dyshim se, për ata që i frikësohen Zotit të vet pa e parë Atë, do të ketë falje dhe shpërblim të madh!


Shpjegimi i ajetit

Pasi foli për gjendjen e të dëshpëruarve, Allahu i Lartësuar vijon me gjendjen e vepërmirëve të lumtur.

- "Pa dyshim se, për ata që i frikësohen Zotit të vet pa e parë Atë..." - Ata i ruhen shikimit të Zotit të tyre në të gjitha gjendjet, madje edhe atëherë kur nuk i vështron askush tjetër përveç Atij. Ata nuk ia lejojnë kurrë vetes të hedhin qoftë edhe një hap për të kryer gjynahe ndaj Allahut. Ata, gjithashtu, nuk tërhiqen dhe nuk ia lejojnë vetes të lënë mangët ndonjë urdhër të Tij.

- "...do të ketë falje dhe shpërblim të madh!" - Atyre u takon falja dhe mbulimi i gjynaheve. Nëse Allahu t'i mbulon gjynahet, kjo tregon se do të jesh i sigurt dhe i shpëtuar nga të këqijat që ato sjellin në këtë jetë dhe në jetën tjetër, si edhe nga ndëshkimi i Xhehenemit.

Por jo vetëm kaq: "*dhe shpërblim të madh*". Ky është premtim për atë që Allahu i Lartësuar ka përgatitur për ta në Xhenet, siç janë mirësitë dhe kënaqësitë e mrekullueshme dhe të përjetshme, pasuritë madhështore, kënaqësitë trupore dhe shpirtërore të pandërprera e të pakrahasueshme, kështjellat dhe ndërtesat e larta, hyritë me bukuri të papërshkrueshme, shërbëtoret dhe djelmoshat. Por mbi të gjitha këto qëndron kënaqësia e Rrahmanit ndaj banorëve të Xhenetit, që kurrë nuk do të largohet.



Ajetet 13 – 14

13. I fshihni ose i thoni fjalët tuaja haptas, nuk ka dyshim se Ai e di çka fshihni në zemrat tuaja.
14. A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai është i Gjithëdituri në imtësi rreth sekreteve.

Shpjegimi i ajeteve

Këtu Allahu i Lartësuar na tregon për dijen e Tij absolute rreth gjithçkaje që ekziston dhe për gjerësinë e butësisë dhe mëshirës së Tij.

- "I fshihni ose i thoni fjalët tuaja haptas, nuk ka dyshim se Ai e di çka fshihni në zemrat tuaja." - Allahu i Lartësuar është i ditur për çdo motiv dhe qëllim që fshihet në zemra. Sigurisht, Ai di hollësisht edhe veprat e hapura e të dukshme, që dëgjohen e shikohen.

Pastaj Allahu i Lartësuar sjell një argumentim logjik, për të treguar dijen e Tij të gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Ai thotë:

- "A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai është i Gjithëdituri në imtësi rreth sekreteve." - A ka mundësi që Ai që bëri krijesat në formën më të bukur të mos i njohë dhe të mos dijë në hollësi gjithçka që lidhet me ta. Dija e Tij është *latîfun*, pra, e hollësishme. Dija e Allahut përfshin të fshehtat dhe ndërgjegjet e njerëzve. Ai di në hollësi çdo sekret dhe fshehtësi të dynjasë. Në suren Ta Ha, i Lartësuari thotë: "Ai di të fshehtën dhe më të fshehtën". Ky është një shpjegim i fjalës *latîfun*.

Sipas një shpjegimi tjetër të fjalës *latîfun*, ajo tregon butësinë, mëshirën dhe përkujdesin e madh që Allahu i Lartësuar tregon për adhuruesit dhe të dashurit e Tij. Ai përkujdeset që t'u japë atyre mirësi dhe inspirim për vepra të drejta, me mënyra që adhuruesit kurrë nuk do t'i mendonin. Me butësinë e Tij, Allahu i Lartësuar largon prej tyre të këqijat që ata as nuk arrijnë ta mendojnë se si t'u ruhen. Me butësinë, mëshirën dhe përkujdesin e Tij, Ai i lartëson ata në gradat më të larta, me mënyra që adhuruesit kurrë nuk do mund t'i mendonin, e aq më tepër t'i arrinin. Ndoshta me butësinë dhe mëshirën e Tij, Ai lejon që adhuruesit dhe të dashurit e Tij të goditen nga fatkeqësi dhe sprova, nëpërmjet të cilave ata të arrijnë mirësitë më mëdha dhe gradat më të larta të Xhenetit.

Ajeti 15

15. Është Ai që e bëri tokën të përshtatshme për ju. Ecni nëpër të dhe shfrytëzoni begatitë e Tij. Vetëm tek Ai është e ardhmja.

Shpjegimi i ajetit

- "Është Ai që e bëri tokën të përshtatshme për ju." – Kuptimi: Ai e nënshtroi tokën për ju, duke ua bërë të përshtatshme dhe të ndryshueshme sipas dëshirës suaj, me qëllim që të nxirrni dhe të përfitoni prej saj gjithçka që ju nevojitet. Në të, ju mund të mbillni, të ndërtoni dhe ta kultivoni. Ju mund të ndërtoni mbi të rrugë, për të shkuar nga lindja në perëndim.

- "Ecni nëpër të dhe shfrytëzoni begatitë e Tij. Vetëm tek Ai është e ardhmja." - Pasi të largoheni nga kjo botë, të cilën Zoti e bëri vend mbjelljeje dhe vendkalim për të arritur në jetën tjetër, ju do të ringjalleni nga varret dhe do të tuboheni te Zoti juaj. Ky grumbullim është i pashmangshëm. Atje do të shpërbleheni për çdo vepër që bëni, e mirë apo e keqe qoftë.

Ajetet 16 – 18

16. A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që të mos ju përpijë toka kur të dridhet?!
17. Apo u garantuat prej Atij që është në qiell, që të mos lëshojë kundër jush ndonjë stuhi me rrebesh gurësh?! Ju do ta kuptoni se si është ndëshkimi Im!
18. Edhe ata që ishin para tyre mohuan, por si ishte dënimi Im?

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë një kërcënim i ashpër për këdo që vazhdon me arrogancë rrugën e gjynaheve, kalimit të kufijve, armiqësisë ndaj Zotit dhe Profetit dhe të mosbindjes ndaj tyre. Këta e bëjnë të pakthyeshëm zemërimin e Allahut të Plotfuqishëm dhe e meritojnë ndëshkimin e Tij. Kështu, i Lartësuari thotë:

- "A u garantuat ju prej Atij që është në qiell, që të mos ju përpijë toka kur të dridhet?!" - Nëse Allahu e shtrin tokën nën këmbët tuaja, ajo do të tronditet derisa t'ju shkatërrojë e t'ju shfarosë.

- "Apo u garantuat prej Atij që është në qiell, që të mos lëshojë kundër jush ndonjë (*Ĥâŝibâ*) stuhi me rrebesh gurësh?!" - *Ĥâŝibâ* është ndëshkim i ashpër shfarosës nga qielli.

- "Ju do ta kuptoni se si është ndëshkimi Im!" – Kuptimi: Mos u mashtroni nga afatizimi dhe siguria e përkohshme që ju jep Allahu i Lartësuar. Moszbritja e ndëshkimit nga qielli dhe nga toka të mos ju bëjë të mendoni se jeni përfundimisht të sigurt, të shpëtuar dhe të ruajtur. Ajo që kanë paralajmëruar profetët dhe librat hyjnorë do të ndodhë pa diskutim. Ju do ta shihni vetë se ato kërcënime do të zbatohen në realitet. Herët apo vonë, ju do të dëshmoni çdo paralajmërim të Zotit.

- "Edhe ata që ishin para tyre mohuan, por si ishte dënimi Im?" – Kuptimi: Popujt që jetuan para jush i shpërfillën kërcënimet e sjella nga profetët e tyre në librat e Zotit, ashtu sikurse mohoni edhe ju sot. Por ju e dini shumë mirë se si i shfarosi dhe i shkatërroi Allahu i Lartësuar ata. Si ishte ndëshkimi i Allahut për ata të dëshpëruar? Ai i ndëshkoi që në këtë jetë, para se të vuajnë ndëshkimin e merituar në jetën tjetër. Pra, jini të kujdesshëm, që të mos e pësoni dhe të goditeni nga i njëjti ndëshkim si ata.

Ajeti 19

19. A nuk i vështrojnë shpendët përmbi ta, kur qëndrojnë pezull krahëhapur dhe kur krahët i mbledhin? Ata nuk i mban kush në ajër veç të Gjithmëshirshmit.. Ai është Shikues i gjithçkaje.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i vështrojnë shpendët përmbi ta, kur qëndrojnë pezull krahëhapur dhe kur krahët i mbledhin?" - Me këtë ajet, Allahu i Lartësuar na qorton dhe na nxit që ne të vështrojmë zogjtë e qiellit, të cilëve Allahu i Lartësuar ua ka vënë në përdorim ajrin, që ata të qëndrojnë dhe të lëvizin në qiell si të dëshirojnë. Shpendët mund t'i hapin krahët për të fluturuar lart dhe për të qëndruar pezull në ajër, ose mund t'i mbledhin krahët për t'u lëshuar poshtë si shigjetë, sipas nevojave të tyre.

- "Ata nuk i mban kush në ajër veç të Gjithmëshirshmit." - Allahu u mundësoi shpendëve ajrin si ambientin e tyre jetik, duke e bërë atë kusht të domosdoshëm dhe të përshtatshëm për fluturimin dhe të gjitha manovrat ajrore. Allahu i Lartësuar përshtati edhe trupat e tyre për të qenë të zhdërvjellët dhe të aftë për të fluturuar. Çdokush që studion konstruktin e një shpendi dhe taktikat e tij të fluturimit bindet plotësisht se "Projektuesi" i tij është madhështor, i gjithëdijshëm dhe i plotpushtetshëm. Kjo dëshmon për përkujdesjen e jashtëzakonshme të Allahut për t'u siguruar krijesave gjithçka që u rregullon dhe u përmbush nevojat dhe kërkesat e tyre në këtë jetë. Këto krijesa dëshmojnë se Allahu i Lartësuar është Një dhe i Vetëm. Vetëm Ai meriton të njësohet, duke e adhuruar me dashuri, madhërim, nënshtrim dhe bindje të plotë. Vetëm Allahu i Lartësuar i meriton adhurimet e krijesave, askush tjetër.

- "Ai është Shikues i gjithçkaje." - Allahu i Lartësuar përkujdeset dhe administron çështjet e krijesave të Tij, në bazë të dijes, mëshirës dhe urtësisë së Tij.

Ajetet 20 – 21

20. Ç'është ajo ushtri e juaja që mund t'ju ndihmojë, veç Rrahmanit? Nuk ka dyshim se jobesimtarët janë të zhytur në një mashtrim të madh.
21. Kush është ai që do t'ju furnizojë, nëse Ai jua ndërpret furnizimin e Vet? Jo, askush, por ata vazhdojnë me arrogancë e kundërshtime.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete, Allahu i Lartësuar u drejtohet arrogantëve që e urrejnë dhe i janë larguar bindjes ndaj Tij, atyre që i kanë kthyer shpinën udhëzimit të drejtë:

- "Ç'është ajo ushtri e juaja që mund t'ju ndihmojë, veç Rrahmanit?" - Nëse Rrahmani dëshiron dhe e përcakton që juve t'ju godasë ndonjë e keqe, atëherë kush mund t'ju ndihmojë dhe ta pengojë këtë të keqe? Kush është ai që mund t'ju ndihmojë kundër armiqve tuaj, veç Rrahmanit?!

Allahu i Lartësuar është i vetmi ndihmues dhe mbrojtës, i vetmi që nderon atë që Ai do dhe që poshtëron atë që Ai do. Sikur të mblidheshin të gjitha krijesat për të ndihmuar një rob kundër çdo armiku apo të keqi, kurrë nuk do të bënin dot gjë; nuk do të mund të lëviznin as edhe një grimcë të

vogël në këtë gjithësi, pa lejen dhe ndihmën e Rrahmanit.

- "Nuk ka dyshim se jobesimtarët janë të zhytur në një mashtrim të madh." - Pa dyshim, të gjithë ata mohues dhe refuzues të së vërtetës, duke vazhduar rrugën e tyre të shkatërrimit, edhe pasi e dinë shumë mirë se suksesi dhe fitorja janë në dorën e Rrahmanit, tregojnë se janë të zhytur dhe të harruar në një mashtrim të thellë.

- "Kush është ai që do t'ju furnizojë, nëse Ai jua ndërpret furnizimin e Vet?" - Furnizimi dhe begatitë vijnë të gjitha prej Allahut të Lartësuar, Zotit të Vetëm. Nëse Ai ju ndërpret rrizkun e Tij, kush mund t'jua japë atë? Krijesat janë të pafuqishme që të sigurojnë furnizimin për vetveten, prandaj si mund t'ua sigurojnë atë të tjerëve?!

Furnizuesi dhe Dhuruesi i çdo mirësie është Allahu i Lartësuar dhe i Mëshirshëm. Asnjë mirësi nuk mund të pritet prej dikujt tjetër, veç Tij. Është pikërisht Ai që e meriton adhurimin tonë.

Por, a i nxit ky fakt qafirët që ta adhurojnë Allahun e Lartësuar?!

- "Jo, askush, por ata vazhdojnë me arrogancë e kundërshtime." – Përkundrazi, ata zhyten edhe më thellë në ashpërsinë e tyre dhe kurrë nuk i zbusin zemrat për të përqafuar të vërtetën, madje vrapojnë si të çmendur për t'u larguar nga e vërteta, nga e vetmja rrugë e lumturisë së tyre.

Ajeti 22

22. Ai që ecën i përmbysur me fytyrë për tokë është më i udhëzuar, apo ai që ecën me ekuilibër të plotë në rrugën e drejtë?!

Shpjegimi i ajetit

- "Ai që ecën i përmbysur me fytyrë për tokë është më i udhëzuar..." - A është i udhëzuar në rrugën e drejtë ai që ecën i çoroditur në mjegullën e humbjes dhe i zhytur në kufër?! Në fakt, ky njeri e ka humbur aftësinë për të parë dhe dalluar të vërtetën nga e kota. Ai e sheh të vërtetën si të gabuar, ndërsa humbjen e sigurt e konsideron si rrugë të drejtë.

- "...apo ai që ecën me ekuilibër të plotë në rrugën e drejtë?!" - Apo është ai që e njeh të vërtetën e Zotit? Ky njeri i jep përparësi të vërtetës kundrejt çdo rruge tjetër. Ai punon për të zbatuar të gjitha udhëzimet e dhuruara prej Zotit Bujar. Ai është i qëndrueshëm dhe ecën i sigurt në rrugën e drejtë, të ndriçuar nga mësimet e Zotit dhe të Profetit të Tij. Fjalët, veprat dhe gjendjet e këtij njeriu janë sipas mësimeve të Zotit dhe me sinqeritet për Të, prandaj ai ecën i sigurt dhe me shpresë të madhe te Zoti i tij.

Mjafton t'i hedhësh një shikim të shpejtë pasuesve të secilës rrugë, për të gjykuar rreth tyre. Duket ai që është në rrugën e drejtë dhe ai që sorollatet i pasigurt në errësirat e humbjes dhe të dëshpërimit. Gjendja e njerëzve flet shumë më mirë se gojët e tyre.

Ajetet 23 – 26

23. Thuaj: "Është Ai që ju krijoi, që ju dhuroi të dëgjuarit, shikimin dhe aftësinë e të menduarit, por shumë pak mirënjohje po tregoni ndaj Tij."
24. Thuaj: "Është Ai që ju krijoi e ju shumoi në tokë dhe vetëm tek Ai do të tuboheni!"
25. Ata thonë: "Kur do të realizohet ky premtim, nëse jeni të saktë?"

26. Thuaj: "Atë e di vetëm Allahu, ndërsa unë jam veçse një qortues, që ju qartësoj të vërtetën!"

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na qartëson se Ai është i vetmi që meriton adhurimin dhe, në të njëjtën kohë, na fton që të tregohemi mirënjohës ndaj Tij dhe të njësojmë Atë me përkushtimin e çdo adhurimi.

- "Thuaj: "Është Ai që ju krijoi, që ju dhuroi të dëgjuarit, shikimin dhe aftësinë e të menduarit..."" - Është Allahu i Lartësuar Ai që ju bëri të ekzistoni nga mosekzistenca. Ai nuk pati asnjë ndihmëtar apo këshilltar në këtë çështje. Ai jo vetëm që ju solli në ekzistencë, por e plotësoi ekzistencën tuaj, duke ju dhuruar dëgjimin, shikimin dhe logjikën. Këto janë aftësitë më të mira të njeriut.

Megjithëse këto dhurata kërkojnë një mirënjohje dhe falënderim të thellë, njeriu është mospërfillës, prandaj i Lartësuari thotë:

- "...por shumë pak mirënjohje po tregoni ndaj Tij." - Pra, të pakët janë mirënjohësit dhe e vogël është mirënjohja juaj.

- "Thuaj: "Është Ai që ju krijoi e ju shumoi në tokë dhe vetëm tek Ai do të tuboheni!"" – Kuptimi: Është Allahu i Lartësuar që ju mundësoi të shpërndaheni nëpër botë dhe që ju mundësoi jetesën në çdo vend. Nëpërmjet profetëve dhe librave të Tij, Ai ju sqaroi urdhrat dhe ndalesat e Tij, ju tregoi çdo gjë që ju mundëson lumturinë tuaj dhe ju furnizoi me çdo lloj mirësie nga mund të përfitoni. Pastaj ju bëri të ditur se do të vijë një ditë gjykimi, kur do të tuboheni të gjithë për t'u gjykuar dhe për t'u shpërblyer sipas veprave që keni bërë në këtë jetë.

Por kryeneçët dhe të padrejtët e vënë në diskutim edhe këtë premtim të padiskutueshëm, prandaj pyesin me dyshim:

- "Ata thonë: "Kur do të realizohet ky premtim, nëse jeni të saktë?"" - Shiko se sa të padrejtë që tregohen! Ata konsiderojnë si të vetmin argument që mund të vërtetojë saktësinë dhe vërtetësinë e Ditës së Gjykimit pikërisht lajmin se kur do të jetë ajo.


- "Thuaj: "Atë e di vetëm Allahu, ndërsa unë jam veçse një qortues, që ju qartësoj të vërtetën!"" – Ata e dinë shumë mirë se këtë gjë e di vetëm Zoti i gjithësisë, por përsëri e kërkojnë dhe e duan ta përdorin si argument. Kjo është padrejtësi e hapur. Nuk ka asnjë lidhje mes vërtetësisë së këtij lajmi dhe kohës kur do të ndodhë. Vërtetësia e një lajmi provohet me argumente e fakte dhe, pa dyshim, Allahu i Lartësuar ka sjellë argumente dhe fakte të shumta, të cilat nuk të lënë asnjë dyshim për vërtetësinë e Ditës së Gjykimit; normalisht, për ata që dëgjojnë me vëmendje dhe synojnë udhëzimin e drejtë.

Ajetet 27 – 30

27. Kur ta shohin atë (Xhehenemin) që t'u afrohet, fytyrat e jobesimtarëve do shëmtohen. Ndërsa atyre u thuhet: "Ky është ai që ju kërkonit ta shihnit realisht!"
28. Thuaj: "Më tregoni ju, nëse Allahu ma merr shpirtin mua dhe atyre që janë me mua, ose na mëshiron, kush do t'i mbrojë jobesimtarët prej një dënimi të mundimshëm?!"
29. Thuaj: "Ai është i Mëshirshmi! Atij i kemi besuar dhe vetëm tek Ai jemi

mbështetur! Kurse ju do ta kuptoni se kush është i humburi i vërtetë!"

30. Thuaj: "Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjellë juve ujë në sipërfaqe?"



Shpjegimi i ajeteve

- "Kur ta shohin atë (Xhehenemin) që t'u afrohet, fytyrat e jobesimtarëve do shëmtohen." - Mohimi i profetëve funksionon vetëm gjatë kësaj jete në dynja, sepse Ditën e Llogarisë dhe Shpërblimit me drejtësi, ditën kur ata të shohin dënimin pranë, ata do të binden se ajo që nuk donin ta besonin tashmë po ndodh realisht.

Në ato momente, fytyrat e tyre do të ligështohen e shëmtohen. Këtë e shkakton frika dhe dëshpërimi që do t'u kaplojë shpirtin. Dëshpërimi i tyre do të arrijë kulmin kur ata të qortohen dhe kur t'u përmendet mohimi i tyre i padrejtë i të vërtetës, rreth së cilës folën dhe njoftuan profetët dhe librat e shenjtë.

- "Ndërsa atyre u thuhet: "Ky është ai që ju kërkonit ta shihnit realisht!"" – Kuptimi: Sot ju po e përjetoni plotësisht atë që padrejtësisht e shpërfillët dhe e latë në harresë, atë që nuk deshët ta besonit. Sot çështja për ju është shumë e qartë, por tashmë nuk keni më asnjë mundësi për t'i shpëtuar dënimit që po ju afrohet. Tani, nuk ju mbetet gjë tjetër, veçse të përjetoni atë që mund t'i shmangeshit, nëse do të mendonit mirë dhe do të bënit zgjidhjen e duhur.

Refuzuesit e profetit Muhamed (a.s.), të cilët e shpërfillën ftesën dhe udhëzimin e sjellë prej tij nga Zoti i gjithësisë për mbarë njerëzimin, prisnin me padurim vdekjen apo vrasjen e tij. Ata prisnin ditë e natë një lajm të tillë. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e Tij që t'u bëjë këtyre mendjelehtëve një ftesë për t'u menduar më thellë.

- "Thuaj: "Më tregoni ju, nëse Allahu ma merr shpirtin mua dhe atyre që janë me mua, ose na mëshiron, kush do t'i mbrojë jobesimtarët prej një dënimi të mundimshëm?!"" – Kuptimi: Edhe nëse ndodh ajo që prisni me aq ngut, pra, vdekja ime dhe e atyre që më pasojnë mua, duhet të kuptoni se kjo nuk përbën asnjë dobi apo arritje për ju. Ju duhet të kuptoni se ju keni bërë një krim të madh, që e bën të pashmangshëm ndëshkimin tuaj. Ju keni shpërfillur dhe mohuar shenjat dhe argumentet e vërteta të Allahut, të sjella nëpërmjet meje. Në këtë mënyrë, vdes apo jo Profeti, ju nuk mund t'i shpëtoni ndëshkimit të drejtë të Allahut të Lartësuar. Nëse Ai vendos me drejtësinë e Tij t'ju ndëshkojë,

kush mund t'ju sigurojë mbrojtje e strehim?! Provoni të mendoni në këtë mënyrë, dhe shumë thjesht do të kuptoni se planet dhe përpjekjet tuaja për vrasjen time dhe të atyre që pasojnë dhe përhapin fjalën time janë të kota dhe të pafrytshme. Qëllimet tuaja kurrë nuk do të gjejnë zbatim, ndërsa planet tuaja nuk do t'ju ruajnë nga ndëshkimi, që e keni merituar dhe që po ju afrohet.

Mohuesit e udhëzimit të sjellë nga Muhamedi (a.s.) prej Zotit të botëve pretendonin se udhëzimi i tyre ishte më i drejtë, ndërsa Profeti (a.s.) ishte në humbje. Ky pretendim nga ana e tyre shkaktoi mjaft luftëra e padrejtësi. Ata polemizuan ashpër, me armiqësi e urrejtje dhe me gjuhën e dhunës.

Më pas, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin (a.s.) e Tij që t'u rikujtojë këtyre kryeneçëve se me kë kanë të bëjnë:

- "Thuaj: "Ai është i Mëshirshmi! Atij i kemi besuar dhe vetëm tek Ai jemi mbështetur! Kurse ju do ta kuptoni se kush është i humburi i vërtetë!"" - Ai është Mëshiruesi dhe ne jemi adhuruesit e Tij të sinqertë e të përkushtuar. Devotshmëria jonë në rrugën që kemi nisur e ka burimin në besimin e sinqertë dhe mbështetjen e plotë tek i Përjetshmi, që nuk vdes kurrë. Udhëzimi që ne ofrojmë është i pakundër-shtueshëm, sepse edhe devotshmëria që ne i kushtojmë Atij është e pathyeshme.

Kjo është një ftesë për të meditуar rreth këtij fakti të rëndësishëm, për të gjykuar drejt se cili është udhëzimi i drejtë që duhet të ndiqet, dhe cilët janë rrugët e humbjes, të cilave duhet t'u largohesh.

Dallimi mes pasuesve të Rrahmanit dhe pasuesve të humbjes është, së pari, deklarimi gjithëpërfshirës dhe madhështor: "Atij i kemi besuar". Imani është pranim dhe miratim i sinqertë i çdo gjëje që duhet besuar, dhe vërtetim i këtij besimi nëpërmjet veprave të brendshme dhe të jashtme. Së dyti, është mbështetja (*et-teuekkul*) e plotë vetëm tek Allahu për arritjen e çdo të mire dhe për të larguar e shpëtuar nga çdo e keqe. Kjo është një nga veprat e zemrës, prandaj e përfshin koncepti "iman".

Siç e thamë, edhe *et-teuekkul* bën pjesë në iman, por ai përmendet i veçuar në këtë ajet, ashtu si edhe në shumë ajete të tjera. Përse? Arsyeja është se të gjitha veprat e tjera, qoftë ato që qëndrojnë në themel të imanit, qoftë ato plotësuese të imanit, kanë nevojë për *teuekkul*, domethënë për mbështetjen dhe kërkimin e ndihmës nga Allahu i Gjithëpushtetshëm. Asnjë vepër nuk mund të niset, nuk mund të vazhdojë dhe as të kryhet në formën e saj më të mirë dhe më të plotë, pa patur së pari *teuekkul*-in. Pikërisht për shkak të rëndësisë së madhe të kësaj pune të zemrës, ajo është përmendur në mënyrë të veçantë, si cilësi dalluese e të drejtudhëzuarve.

Argument që tregon se *teuekkul*-i është pjesë e imanit, është fjala e Allahut të Lartësuar: "Dhe vetëm Allahut mbështetjuni, nëse jeni besimtarë". Kështu, argument për praninë e besimit në zemër është *teuekkul*-i ose mbështetja e plotë tek i Gjithëpushtetshmi Mëshirues, për arritjen e çdo të mire dhe largimin nga çdo e keqe.

Këto janë cilësitë e Profetit (a.s.) dhe të atyre që pasojnë atë: Besimi i sinqertë dhe pa mëdyshje, i bazuar në dije të saktë dhe të sigurt prej Zotit, si edhe mbështetja e plotë tek i Plotpushtetshmi Mëshirues në zbatimin dhe përhapjen kudo në botë të këtij udhëzimi të pakrahasueshëm dhe mbizotërues ndaj çdo udhëzimi tjetër.

Këto dy cilësi janë formula e vetme e lumturisë së njeriut. Ndërsa cilësitë e armiqve dhe kundërshtarëve të profetëve janë krejt të kundërta. Kësisoj, vetëm duke vëzhguar me kujdes se çfarë ofrojnë të dy palët, mund të gjykosh shumë thjesht se cilët janë në udhën e lumturisë dhe cilët në rrugët e shkatërrimit dhe trishtimit të përjetshëm.

Pastaj Allahu i Lartësuar na rikujton një fakt shumë të rëndësishëm, për të gjykuar dhe për të marrë një vendim të drejtë. Ai na kujton se është i vetmi që sjell mirësitë në këtë jetë dhe në tjetrën. Ai ka veçuar në këtë ajet mirësinë e ujit, si burim i jetës së gjithçkaje. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Thuaj: "Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t'ju sjellë juve ujë në sipërfaqe?"" - Kuptimi: Nëse uji fshihet nëpër tokë e në brendësi të saj, kush do t'ju sjellë juve ujë që të pini apo që të ujisni bimësinë e kafshët tuaja?

Kjo pyetje nuk ka nevojë për t'u menduar gjatë, që t'i japësh përgjigjen. Pra, askush nuk mund t'jua japë atë, veç Allahut të Plotpushtetshëm dhe Mëshirues.

Surja 68: El kalem (mekase) 52 ajete

Ajetet 1 – 7

Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!

1. *Nun*! Betohem në lapsin dhe në atë çka shkruajnë!
2. Ti, me dhuratën e Zotit tënd, nuk je i çmendur!
3. Ti, pa dyshim, do të kesh një shpërblim të pandërprerë!
4. Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!
5. Më vonë ti do të shohësh, por edhe ata do të shohin,
6. se cili prej jush është i çmendur.
7. S'ka dyshim se Zoti yt është më i ditur se cili është ai që ka humbur rrugën e Tij dhe Ai është më i ditur për të udhëzuarit.

Shpjegimi i ajeteve

- "*Nun*! Betohem në lapsin dhe në atë çka shkruajnë!" - Allahu i Lartësuar betohet në laps. *El ḳalem* është emër që përfshin të gjithë mjetet me të cilët shkruhet dhe ruhet dituria, prozat dhe poezitë, fjalët dhe mendimet e ndryshme. Ai është nga shenjat dhe mirësitë më të mëdha të dhuruara nga Allahu i Lartësuar, prandaj e meriton që Allahu të betohet në emër të tij. Allahu i Lartësuar betohet në këtë mirësi të madhe, për të treguar se Profeti (a.s.) është i pastër dhe larg shpifjeve që thuhen për të. Armiqtë e akuzonin atë për çmenduri, por Allahu i Lartësuar, me këtë betim, tregoi se mirësia e Tij ndaj Muhamedit është aq e madhe, sa është e pamundur që të akuzohet për çmenduri.

- "Ti, me dhuratën e Zotit tënd, nuk je i çmendur!" – Kuptimi: Me mirësitë e shumta të Zotit tënd mbi ty, ti nuk mund të jesh i çmendur. Allahu i Lartësuar të dalloi ty duke të dhuruar një mendje të plotë dhe të shëndoshë, një arsyetim të shëndetshëm, me fjalë të drejta dhe të prera. Madje, Ai të dhuroi ty, o Muhamed, më të mirat fjalë që janë shkruar ndonjëherë nga *kalemi* dhe që bota i ka ruajtur. Allahu i Lartësuar të dhuroi ty Kuranin dhe Urtësinë. Kjo është lumturia që Zoti yt të fali në këtë dynja. Ndërsa në ahiret:

- "Ti, pa dyshim, do të kesh një shpërblim të pandërprerë!" – Do të kesh shpërblim të madh dhe të vazhdueshëm.

Në gjuhën arabe, fjala "*exh'ran*" - shpërblim, kur është në trajtën e pashquar tregon që ky shpërblim është i madh. Shpërblimi, gjithashtu, është cilësuar si "*gajru munûn*" - i pandërprerë, i vazhdueshëm.

Ky shpërblim i madh dhe i pandërprerë vjen si fryt i veprave të mrekullueshme dhe i moralit të shkëlqyer të profetit Muhamed (a.s.), siç thotë i Madhëruari më tej:

- "Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!" – Domethënë: Ti qëndron shumë lart me moralin tënd, me të cilin të pajisi Zoti yt, si mirësi dhe bamirësi prej Tij.

Morali i Profetit (a.s.) ishte Kurani, siç e ka përshkruar Aishja, Nëna e besimtarëve, kur e pyetën për këtë gjë. Mjafton, gjithashtu, për ta kuptuar më mirë, që të lexojmë edhe ajete të tjera të Kuranit, si p.sh.: "Pranoje ndjesën, urdhëro për mirësi dhe distancohu nga injorantët. E nëse të ngacmon Shejtani me ndonjë vesves, kërko strehim tek Allahu, sepse Ai është Dëgjues dhe i Ditur." [A'raf 199, 200].

"Me mëshirën që të fali Zoti yt, ti je i butë ndaj tyre. Sikur të ishe i vrazhdë e zemërgur, ata do largoheshin prej teje. Fali dhe kërko ndjesë për ta! Konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetju Allahut! Allahu, pa dyshim, i do ata që i mbështeten Atij." [Al Imran 159].

"Juve ju erdhi një i Dërguar nga lloji juaj, të cilit i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju. Ai është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët." [Teube 128].

Si këto, ka edhe shumë ajete të tjera, që tregojnë se Profeti (a.s.) kishte virtytet më të larta njerëzore. Në të njëjtën mënyrë, ajetet që nxisin për virtyte të larta të kujtojnë se vetë Profeti (a.s.) qëndronte në gradën më të lartë të tyre. Ai ishte i pari dhe më i ploti në moral.

Profeti (a.s.) ishte i thjeshtë, i butë dhe shumë pranë njerëzve. Ai i përgjigjej ftesës së çdokujt që e ftonte. Ai gjykonte dhe plotësonte kërkesat e atyre që i kërkonin ndihmë. Gjithmonë ia qetësonte zemrën atij që i kërkonte diçka dhe kurrë nuk ia thyente zemrën apo ta kthente bosh dhe të dëshpëruar. Kur shokët i kërkonin diçka, ai gjithmonë përpiqej që t'i kënaqte dhe t'ua plotësonte kërkesën, nëse nuk ishte e ndaluar. Nëse duhej të vendoste për diçka, nuk bënte me kokën e vet, por gjithmonë këshillohej me shokët. Profeti (a.s.) dinte të përgëzonte vepërmirët dhe të falte gabimtarët. Nëse ulej me dikë, ishte shembullor dhe jepte maksimumin për ta kënaqur tjetrin. Kurrë nuk e ngryste fytyrën dhe kurrë nuk tregohej i ashpër në fjalë. Buzëqeshte gjithmonë dhe asnjëherë nuk gërmonte te gabimet e tjetrit. Nuk mbante qëndrim ndaj ashpërsisë së bashkëfolësit, por tregonte durim dhe tolerancë.

Duke qenë se armiqtë e tij e fyen duke shpifur për të se ishte i çmendur, pavarësisht se Allahu i Lartësuar e ngriti dhe e përsosi atë në të gjitha aspektet, i Lartësuari thotë:

- "Më vonë ti do të shohësh, por edhe ata do të shohin, se cili prej jush është i çmendur." - Është shumë e qartë se Profeti (a.s.) ishte njeriu më i udhëzuar, më i ploti në vetvete dhe më i dobishmi për të tjerët. Ndërsa armiqtë e tij ishin njerëzit më të

humbur dhe më të dëmshëm për veten e vet dhe për të tjerët. Ata sprovuan njerëzit dhe, në mënyrë të veçantë, adhuruesit e Zotit, duke dashur t'i devijonin nga rruga e drejtë. Por mjafton që Allahu i Lartësuar është i Gjithëditur rreth kësaj të vërtete, sepse Ai është Llogaritësi i shpejtë, që shpërblen me drejtësi.

- "S'ka dyshim se Zoti yt është më i ditur se cili është ai që ka humbur rrugën e Tij dhe Ai është më i ditur për të udhëzuarit." - Ky është një kërcënim i frikshëm për të humburit nga rruga e drejtë dhe një premtim shpresëdhënës dhe përgëzues për të udhëzuarit në rrugën e drejtë. Kjo tregon, gjithashtu, edhe urtësinë e madhe të Allahut të Lartësuar, i Cili e di më mirë se kushdo se cilët meritojnë udhëzimin dhe cilët humbjen.

Ajetet 8 – 16

8. Prandaj, ti mos u pajto me gënjeshtarët!
9. Ata do të dëshironin që ti të bësh lajka, që edhe ata të bëjnë lajka.
10. Mos e respekto asnjë që betohet shumë dhe është i poshtër,
11. që është përgojues e përhap fjalë ngatërrestare ndër njerëz,
12. që është shumë koprrac ndaj rrugës së mbarë, armiqësor, gjynahqar i madh,
13. shumë i vrazhdë dhe, përveç këtyre, është edhe kopil!
14. Vetëm pse ka pasuri e djem!
15. Kur atij i lexohen ajetet Tona, ai thotë: "Legjenda të të parëve!"
16. Ne do ta damkosim atë në hundë!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i thotë Profetit të Tij:

- "Prandaj, ti mos u pajto me gënjeshtarët!" – Kuptimi: Mos iu bind atyre që të mohuan dhe të refuzuan armiqësisht dhe padrejtësisht, sepse ata nuk e meritojnë. Ata kërkojnë veçse gjëra që iu përshtaten epsheve dhe pasioneve të tyre. Ata synojnë dhe dëshirojnë veçse të kotën. Kush iu bindet atyre shkon me këmbët e veta drejt rrugës që e dëmton.

Kjo është një ndalesë që përfshin çdo lloj gënjeshtari dhe mohuesi të profetëve. Ajo përfshin, gjithashtu, çdo bindje ndaj së kotës dhe mashtrimit, edhe pse shkaku i ajetit është një rast i veçantë. Idhujtarët i kërkuan Profetit që ai të heshtte dhe të mos vinte në dukje të metat e idhujve të tyre dhe, në këmbim të kësaj, ata do të heshtnin ndaj tij, siç thotë i Lartësuari:

- "Ata do të dëshironin që ti të bësh lajka, që edhe ata të bëjnë lajka." – Kuptimi: Idhujtarët do të dëshironin shumë sikur ti "*tud'hinu*", pra, të heshtësh, të mbyllësh sytë, t'i miratosh ata në të kotën e tyre, qoftë me fjalë apo me vepra, apo qoftë edhe me heshtjen tënde, për rastet kur është detyrë qartësimi i së vërtetës. Nëse do të bëje një gjë të tillë, edhe ata do të uleshin dhe do të të miratonin.

Kështu, Allahu i Lartësuar e urdhëroi Profetin që të mos u bindej atyre, por të zbatonte vetëm urdhrat e Tij, duke shfaqur hapur dhe me krenari fenë e të Lartësuarit. Sigurisht, shfaqja e së vërtetës nënkupton edhe qartësimin e së kotës dhe hedhjen poshtë të çdo gjëje që është në kundërshtim me të vërtetën.

- "Mos e respekto asnjë që betohet shumë dhe është i poshtër..." - Mos i dëgjo ata që përbetohen shumë, sepse e bëjnë këtë vetëm

ngaqë janë mashtrues të mëdhenj. Si të tillë, ata janë të poshtër dhe me qëllime të ulëta. Ata nuk kanë ndonjë synim për vepra të mira, por vetëm për të plotësuar epshet dhe dëshirat e tyre kafshërore.

- "...që është përgojues e përhap fjalë ngatërrestare ndër njerëz..." – Mos dëgjo as ata që janë fyes e ofendues të mëdhenj, duke mbajtur nëpër gojë të tjerët dhe duke i tallur ata. As ata që përhapin fjalë ngatërrestare mes njerëzve, domethënë, me qëllim për të futur armiqësi dhe urrejtje mes tyre.

- "...që është shumë koprrac ndaj rrugës së mbarë, armiqësor, gjynahqar i madh..." - Mos iu bind as atyre që janë dorështrënguar me të mirën, domethënë, që nuk japin atë gjë që e kanë për detyrë ta japin, siç janë shpenzimet e domosdoshme për jetesë, kompensimet e detyrueshme ligjore e fetare, zekati etj.

Mos iu bind as atyre që janë armiqësorë e agresivë, të cilët, me padrejtësitë e tyre ndaj krijesave, i tejkalojnë kufijtë, duke shkelur mbi gjakun, pasurinë dhe nderin e tyre. Të tillët janë edhe '*ethîm*', njerëz që bëjnë shumë gjynahe kundrejt Allahut të Lartësuar. Pra, me gjynahet e tyre, ata shkelin edhe të drejtat e Krijuesit.

- "...shumë i vrazhdë dhe, përveç këtyre, është edhe kopil!" – Ata janë të ashpër dhe shumë të egër ndaj krijesave. Ata nuk i nënshtrohen kurrë të vërtetës dhe të drejtës. Veç kësaj, janë edhe kopilë, domethënë, që nuk iu njihen baballarët.

Prej këtyre njerëzve nuk pritet asnjë e mirë, asnjë sukses dhe shpëtim, sepse cilësitë e tyre janë tipike të poshtra. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar na ndalon që t'i bindemi çdokujt që bart të tilla cilësi, pra, që betohet shumë dhe është gjynahqar i madh, i poshtër dhe i ulët, sidomos kur është nga ata që i pëlqen vetja e është mendjemadh, që nuk pranon të vërtetën dhe kërkon të qëndrojë mbi të tjerët, që përbuz dhe përqesh njerëzit, që hap fjalë ngatërrestare, që bën padrejtësi të shumta ndaj krijesave dhe gjynahe ndaj Allahut të Lartësuar.

Në fakt, edhe pse janë shpallur për njerëz të veçantë mes idhujtarëve të kohës së Profetit, si Ibn Mugira e të tjerë si ai, këto ajete janë të përgjithshme dhe vlejnë për këdo që ka të tilla cilësi, sepse Kurani u shpall si udhëzim dhe këshillë për të gjithë njerëzimin, nga i pari deri tek i fundit. Shpesh ajetet janë shpallur për shkak të ndonjë personi apo çështjeje të veçantë, por qëllimi i tyre është që të nxirret dhe caktohet një rregull i përgjithshëm, për raste që janë të ngjashme. Thotë i Lartësuari:


- "Vetëm pse ka pasuri e djem!" - Ai tejkalon kufijtë dhe tregohet mendjemadh ndaj së vërtetës, për shkak të pasurisë dhe pasardhësve të shumtë që ka. Ai e refuzon të vërtetën, edhe pse ajo i paraqitet shumë e qartë. Madje, me paturpësi, ai e konsideron atë si përrallë të hershme:

- "Kur atij i lexohen ajetet Tona, ai thotë: "Legjenda të të parëve!"" - Ai i trajton ajetet e Allahut si të ishin trillime, që mund të pranohen apo të refuzohen. Por Allahu i Lartësuar e kërcënon këdo që ka të tilla cilësi, duke thënë:

- "Ne do ta damkosim atë në hundë!" - Allahu i Lartësuar do t'i japë një ndëshkim të dukshëm, në vendin më të vështirë të trupit, pra, në fytyrën e tij.

Ajetet 17 – 33

17. Ne i sprovuam ata, siç sprovuam *pronarët e kopshtit*, kur u betuan se do ta vilnin atë herët në agim,
18. por pa thënë: "Në dashtë Allahu!"
19. Atëherë, atë (kopshtin) e goditi një ndëshkim nga Zoti yt, ndërkohë që ata ishin në gjumë,
20. dhe u gdhi i nxirosur si nata e errët.
21. Ata thirrën njëri-tjetrin në mëngjes:
22. "Ngrihuni e shkoni herët te prodhimet tuaja, nëse doni t'i vilni!"
23. Ata u nisën, duke pëshpëritur mes njëri-tjetrit:
24. "Sot, nuk do të lejojmë asnjë fukara të afrohet atje!"
25. U nisën herët dhe plot entuziazëm për planet e tyre, të sigurt për prodhimin e madh që i priste.
26. Por kur vajtën dhe panë vendin, thanë: "Oh, paskemi gabuar drejtim!"
27. "Jo, kemi humbur atë që kishim!"
28. Më i urti prej tyre tha: "A nuk ju thashë përse nuk e përmendni Zotin?"
29. Atëherë, ata thanë: "I pastër nga çdo e metë është Zoti ynë! Pa dyshim, ne u treguam të padrejtë".
30. Dhe më pas iu kthyen njëri-tjetrit me qortime,
31. duke thënë: "Të mjerët ne, që tejkaluam kufijtë!
32. Shpresojmë që Zoti ynë të na e zëvendësojë këtë fatkeqësi me diçka më të mirë se ajo që na humbi! Ne e mbajmë shpresën vetëm te Zoti ynë!"
33. Ja, i tillë do të jetë dënimi. Ndërsa në botën tjetër, dënimi do të jetë shumë më i ashpër, sikur ta kuptonin!



Shpjegimi i ajeteve

- **"Ne i sprovuam ata, siç sprovuam *pronarët e kopshtit*..." –** Këtu, Allahu i Lartësuar na tregon mënyrën se si i ka sprovuar mohuesit e së vërtetës. Ai i sprovoi ata duke u dhënë shumë të mira dhe duke i afatizuar. Ai u dhuroi pasuri, fëmijë, jetë të gjatë e shumë gjëra që përmbushnin dëshirat e tyre. Allahu i Lartësuar nuk e bëri këtë për t'i nderuar ata, por për t'i afruar dalëngadalë drejt ndëshkimit befasues. Vetëmashtrimi i tyre me këto mirësi, të cilat i patën si sprovë, është i ngjashëm me atë çfarë u ndodhi *pronarëve të kopshtit*.

Në fakt, flitet për disa njerëz, që ishin pronarë të përbashkët të një kopshti. Kur u poqën frutat dhe pemët ishin rënduar prej tyre, erdhi koha e vjeljes. Tashmë, pronarët ishin të sigurt se kjo pasuri ishte në duart e tyre, prandaj:

- **"...u betuan se do ta vilnin atë herët në agim, por pa thënë: "Në dashtë Allahu!"" –** Të ngazëllyer, ata menduan se tashmë askush nuk do të mund t'i ndalte nga marrja e atyre të mirave, prandaj u betuan se të nesërmen do të shkonin të vilnin prodhimin aq të shumë pritur. Por ata nuk thanë: "*Inshâallâh*"- "Në dashtë Allahu". Ata nuk e menduan se Allahu qëndron gjithmonë në pritë dhe se ndëshkimi i Tij do të shkonte në kopsht para tyre. Thotë i Drejti dhe i Urti:

- "Atëherë, atë (kopshtin) e goditi një ndëshkim nga Zoti yt, ndërkohë që ata ishin në gjumë..." – Gjatë natës, kur ata ishin në gjumë, zbriti një ndëshkim dhe e shkatërroi të gjithë kopshtin.

- "...dhe u gdhi i nxirosur si nata e errët." - Kopshti u nxi, si një natë e errët. Pemët dhe frytet e tyre u zhdukën.

Por pronarët nuk kishin marrë vesh gjë dhe nuk e prisnin këtë realitet të dhembshëm, prandaj në agim i thanë fshehtas njëri-tjetrit:

- "Ata thirrën njëri-tjetrin në mëngjes: "Ngrihuni e shkoni herët te prodhimet tuaja, nëse doni t'i vilni!"" - Ata u nisën drejt pronës të tyre plot dëshirë për pasurinë që i priste.

- "Ata u nisën, duke pëshpëritur mes njëri-tjetrit: "Sot, nuk do të lejojmë asnjë fukara të afrohet atje!"" – Kështu, ata diskutonin fshehtas mes njëri-tjetrit që të pengonin të drejtën e Allahut në pasurinë e tyre. Ata nxisnin njëri-tjetrin që të vilnin frytet herët në mëngjes, para se të zgjoheshin e të dilnin njerëzit, e që të ndalonin fukarenjtë të merrnin ndonjë gjë nga pasuria e tyre. Ata flisnin fshehtas, me zë të ulët, nga frika se mos i dëgjonte kush dhe lajmëronte fukarenjtë.

- "U nisën herët dhe plot entuziazëm për planet e tyre, të sigurt për prodhimin e madh që i priste." - Kjo ishte gjendja e tyre në momentin kur u nisën për të vjelë frytet: të pamëshirshëm dhe zemërgurë. Ata ishin të vendosur që të mos e jepnin të drejtën e Allahut në pasurinë e tyre, edhe pse i kishin mundësitë që ta jepnin atë.

- "Por kur vajtën dhe panë vendin, thanë: "Oh, paskemi gabuar drejtim!"" - Kur e panë kopshtin e tyre në atë gjendje, nga tronditja e madhe që pësuan, nuk po u besonin syve. Ata menduan se kishin humbur rrugën dhe kishin shkuar tjetërkund, pasi ai nuk mund të ishte kopshti i tyre. Por kur u qetësuan, thanë:

- "Jo, kemi humbur atë që kishim!" – Kështu, ata e kuptuan se ky qe një ndëshkim. Në këto momente, më i miri dhe më i drejti mes tyre i qortoi duke thënë:

- **"Më i urti prej tyre tha: "A nuk ju thashë përse nuk e përmendni Zotin?"** - Ai i qortoi ata pse nuk kishin madhëruar Allahun e Lartësuar, duke i mohuar çdo cilësi që nuk i shkon madhështisë dhe krenarisë së Tij. Ata nuk duhej të mendonin se ishin të pavarur nga i Plotpushtetshmi. Ata mund të vepronin veçse me lejen e Tij, prandaj duhej të thonin: "*Inshâallâh*!" – "Në dashtë Allahu!". Ata duhej të kujtonin dhe të pranonin me përulje faktin se asnjë dëshirë e tyre nuk mund të realizohet pa ndihmën e Allahut të Plotpushtetshëm dhe Mbizotërues mbi gjithçka.

- "Atëherë, ata thanë: "I pastër nga çdo e metë është Zoti ynë! Pa dyshim, ne u treguam të padrejtë"." - Ata u penduan dhe u kthyen në rrugën e drejtë, por tashmë ndëshkimi kishte rënë në kopshtin e tyre dhe nuk kthehej pas. *Tesbîĥ*-u dhe pranimi i fajit do t'u vlente për faljen e gjynaheve, pasi pendimi i tyre ishte vërtet shumë i madh.

- "Dhe më pas iu kthyen njëri-tjetrit me qortime..." - Ata iu kthyen njëri-tjetrit me qortime për atë që kishin bërë. Ata kishin shpërfillur të drejtën e Allahut dhe të drejtën e të varfërve në pasurinë e tyre, por e pranuan se kishin kaluar çdo kufi:

- "...duke thënë: "Të mjerët ne, që tejkaluam kufijtë!" - Ata qortuan veten dhe shprehën pendimin që kishin shkelur të drejtat e Allahut dhe të krijesave.

- "Shpresojmë që Zoti ynë të na e zëvendësojë këtë fatkeqësi me diçka më të mirë se ajo që na humbi! Ne e mbajmë shpresën vetëm te Zoti ynë!" - Ata shprehën shpresën e tyre se Allahu i Lartësuar do t'ua zëvendësonte atë që humbën me diçka më të mirë, prej bamirësisë së Tij. Ata dhanë fjalën se, nga ai çast e tutje, gjithmonë do të synonin kënaqësinë e Allahut.

Nëse e kanë mbajtur fjalën, sigurisht që Allahu i Lartësuar do t'ua ketë zëvendësuar në këtë jetë atë që humbën, duke e realizuar shpresën e tyre, pasi çdokush që e lut Allahun me sinqeritet nga zemra, duke shpresuar dhe duke punuar që të kënaqë Atë, pa dyshim që do ta marrë atë që kërkon. Më pas, Allahu i Lartësuar, duke qartësuar atë që ndodhi, thotë:

- "Ja, i tillë do të jetë dënimi." - Ky është ndëshkimi në këtë jetë për këdo që kryen të tilla vepra. Allahu i Lartësuar e privon robin nga ato të mira me të cilat e ka kaluar kufirin dhe është treguar i pabindur, duke i dhënë përparësi kësaj jete kundrejt kënaqësisë së Allahut dhe jetës tjetër. Le ta dijë çdokush që i ka këto cilësi, se Allahu i Lartësuar mund t'ia largojë nga duart e tij ato pasuri e të mira që i zotëron pikërisht në momentet kur ai do të jetë tejet i nevojshëm për to.

- "Ndërsa në botën tjetër, dënimi do të jetë shumë më i ashpër, sikur ta kuptonin!" - Duhet të kujtoni gjithashtu edhe diçka tjetër: ndëshkimi i ahiretit është më i madh se ai i kësaj dynjaje. Nëse jeni të sigurt rreth kësaj çështeje, pa dyshim do të tregoheni shumë të kujdesshëm, që të shpëtoni nga ndëshkimi.

Ajetet 34 – 41

34. Është e sigurt se për të devotshmit do të ketë kopshte të begatshme te Zoti i tyre.
35. A do t'i konsiderojmë kriminelët të barabartë me muslimanët?!
36. Ç'është me ju? Si gjykoni ashtu?!
37. A mos keni ndonjë libër, nga i cili mësoni
38. se ju do të keni atje çka të dëshironi?!
39. A mos keni ndonjë zotim të fortë prej Nesh, që vazhdon deri në Kijamet, se do ta arrini atë që gjykoni dhe dëshironi?!
40. Pyeti: "Cili prej tyre jua garanton atë?"
41. Apo kanë ortakë, që u japin garanci?! Le t'i sjellin "ortakët" e vet, nëse thonë të vërtetën!

Shpjegimi i ajeteve

- "Është e sigurt se për të devotshmit do të ketë kopshte të begatshme te Zoti i tyre." - Në këtë ajet, Allahu i Lartësuar na tregon se

çfarë ka përgatitur për të devotshmit, të cilët i ruhen kufrit dhe mosbindjes ndaj Tij. Për ta janë përgatitur mirësi të shumta dhe të pashtershme, një jetë të këndshme dhe e sigurt nga çdo e keqe dhe, mbi të gjitha, përjetësia pranë Zoti Bujar e Madhështor.

- "A do t'i konsiderojmë kriminelët të barabartë me muslimanët?!" - Allahu i Lartësuar na kujton se urtësia e Tij absolute nuk mund t'i konsiderojë njëlloj muslimanët, që janë të dorëzuar dhe të përkushtuar ndaj të Adhuruarit të tyre të vetëm, që janë të bindur ndaj urdhrave të Tij dhe që me përgjërim kërkojnë kënaqësinë e Tij, me kriminelët, që janë të zhytur në gjynahe ndaj Allahut të Madhëruar, të përhumbur në kufër dhe në shpërfilljen e argumenteve të Tij, të egër ndaj Profetit të Tij dhe luftues kundër të dashurve të Tij. Çdokush që mendon se Allahu i Lartësuar do të gjykojë njëlloj mes tyre ka një mendim shumë të keq për Allahun e Urtë dhe të Gjithëditur. Gjykimi i tij është i kotë dhe i ulët, siç thotë i Lartësuari:

- "Ç'është me ju? Si gjykoni ashtu?! A mos keni ndonjë libër, nga i cili mësoni se ju do të keni atje çka të dëshironi?!" - Këta kriminelë nuk kanë asnjë bazë për të mbështetur gjykimin e tyre të padrejtë. Ata nuk kanë ndonjë libër, ku të lexojnë dhe të mësojnë se do të jenë banorë të Xhenetit, në të cilin do të kenë gjithçka që dëshirojnë. Ata nuk kanë as ndonjë premtim nga i Madhëruari, që t'u japë siguri se gjykimi i tyre është i drejtë. Prandaj i Madhëruari thotë më tej:

- "A mos keni ndonjë zotim të fortë prej Nesh, që vazhdon deri në Kijamet, se do ta arrini atë që gjykoni dhe dëshironi?!" - Ata nuk kanë as ndonjë ndihmues, për të arritur ato që dëshirojnë. Madje, le t'i paraqesin këta ndihmës, nëse janë të sigurt në pretendimet e tyre.

- "Pyeti: "Cili prej tyre jua garanton atë?" Apo kanë ortakë, që u japin garanci?! Le t'i sjellin "ortakët" e vet, nëse thonë të vërtetën!" - Dihet shumë mirë se e gjitha kjo është e pamundur. Ata nuk kanë libër të sigurt, ku të mbështeten, nuk kanë premtim nga Allahu i Lartësuar për shpëtim, nuk kanë as ndihmës, që garantojnë ndihmën e tyre. Prandaj, pretendimet e tyre janë boshe dhe të pabaza.

Fjalia e parë është një pyetje, por që në të njëjtën kohë mohon mundësinë që dikush të mund të marrë përsipër një pozitë të tillë të pamundur dhe, si përfundim, askush nuk mund të mbështetet në një arsyetim të tillë.

Ajetet 42 – 43

42. Ditën kur të zbulohet Kërciri dhe ata do të ftohen për të bërë sexhde, por nuk do të munden.
43. Të përulura e të tmerruara janë shikimet e tyre, ndërsa ata i kaplon poshtërimi, pasi dihet se ata u ftuan të bënin sexhde kur ishin tepër të aftë.

Shpjegimi i ajeteve


- "Ditën kur të zbulohet Kërciri..." - Ditën e Kijametit, kur të fillojnë dridhjet, tmerret dhe ankthet që nuk mund të imagjinohen, atëherë kur Allahu i Lartësuar do të vijë për të dhënë gjykimin dhe shpërblimin me drejtësi mes krijesave, atë ditë Allahu i Lartësuar do të zbulojë atë që quhet '*Essâḳ*', pra, Kërcirin e Tij, që nuk i përngjan asgjëje

që Ai ka krijuar. Atë ditë krijesat do të shohin prej madhështisë së Allahut shenja që nuk mund të shpjegohen me fjalë. Pikërisht në të tilla gjendje që ta zbrazin shpirtin dhe zemrën, ata ftohen për të rënë në sexhde para të Madhëruarit. Thotë i Lartësuari:

- "...dhe ata do të ftohen për të bërë sexhde, por nuk do të munden. Të përulura e të tmerruara janë shikimet e tyre, ndërsa ata i kaplon poshtërimi..." - Pas kësaj ftese, të gjithë besimtarët të cilët edhe në këtë jetë kanë rënë në sexhde për Allahun e Lartësuar me dëshirë dhe me bindje, do të bien në atë sexhde shumë madhështore dhe qetësuese. Ndërsa kriminelët qafirë dhe munafikë nuk do të munden që të bien në sexhde. Shpinat e tyre do të bëhen të forta e të ngurta si brirët e lopëve, kështu që nuk do të mund të përkulen. Ky është një shpërblim i merituar për ta, sipas veprave që kanë bërë.

- "...pasi dihet se ata u ftuan të bënin sexhde kur ishin tepër të aftë." - Ata ftoheshin vazhdimisht në dynja për të rënë në sexhde për Allahun e Lartësuar dhe për ta adhuruar Atë si Një i vetëm. Ata i kishin të gjitha mundësitë për ta bërë një gjë të tillë, por, me arrogancë, i kthenin shpinën kësaj ftese të Zotit të tyre. Atëherë, mos pyet për gjendjen e tyre fatkeqe dhe për përfundimin e tyre të frikshëm. Allahu është i zemëruar me ta dhe ndëshkimi është bërë tashmë i pakthyeshëm për ta. Shpresat, mundësitë dhe mjetet e tyre nuk bëjnë më dobi. Madje edhe pendimi apo kërkimi i faljes janë të pavlefshme atë ditë.

Këto përshkrime mjaftojnë për ta shqetësuar zemrën në mënyrë të tillë që ajo t'u largohet gjynaheve dhe mosbindjes dhe të kthehet e


الجزء التاسع والعشرون سورة القلم
خَٰشِعَةً أَبۡصَٰرُهُمۡ تَرۡهَقُهُمۡ ذِلَّةٞۖ وَقَدۡ كَانُواْ يُدۡعَوۡنَ إِلَى ٱلسُّجُودِ وَهُمۡ
سَٰلِمُونَ ﴿٤٣﴾ فَذَرۡنِي وَمَن يُكَذِّبُ بِهَٰذَا ٱلۡحَدِيثِۖ سَنَسۡتَدۡرِجُهُمۡ
مِّنۡ حَيۡثُ لَا يَعۡلَمُونَ ﴿٤٤﴾ وَأُمۡلِي لَهُمۡۚ إِنَّ كَيۡدِي مَتِينٌ ﴿٤٥﴾ أَمۡ تَسۡـَٔلُهُمۡ
أَجۡرٗا فَهُم مِّن مَّغۡرَمٖ مُّثۡقَلُونَ ﴿٤٦﴾ أَمۡ عِندَهُمُ ٱلۡغَيۡبُ فَهُمۡ يَكۡتُبُونَ
﴿٤٧﴾ فَٱصۡبِرۡ لِحُكۡمِ رَبِّكَ وَلَا تَكُن كَصَاحِبِ ٱلۡحُوتِ إِذۡ نَادَىٰ
وَهُوَ مَكۡظُومٞ ﴿٤٨﴾ لَّوۡلَآ أَن تَدَٰرَكَهُۥ نِعۡمَةٞ مِّن رَّبِّهِۦ لَنُبِذَ بِٱلۡعَرَآءِ
وَهُوَ مَذۡمُومٞ ﴿٤٩﴾ فَٱجۡتَبَٰهُ رَبُّهُۥ فَجَعَلَهُۥ مِنَ ٱلصَّٰلِحِينَ
﴿٥٠﴾ وَإِن يَكَادُ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ لَيُزۡلِقُونَكَ بِأَبۡصَٰرِهِمۡ لَمَّا سَمِعُواْ
ٱلذِّكۡرَ وَيَقُولُونَ إِنَّهُۥ لَمَجۡنُونٞ ﴿٥١﴾ وَمَا هُوَ إِلَّا ذِكۡرٞ لِّلۡعَٰلَمِينَ ﴿٥٢﴾
سورة الحاقة
بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
ٱلۡحَآقَّةُ ﴿١﴾ مَا ٱلۡحَآقَّةُ ﴿٢﴾ وَمَآ أَدۡرَىٰكَ مَا ٱلۡحَآقَّةُ ﴿٣﴾ كَذَّبَتۡ ثَمُودُ وَعَادُۢ
بِٱلۡقَارِعَةِ ﴿٤﴾ فَأَمَّا ثَمُودُ فَأُهۡلِكُواْ بِٱلطَّاغِيَةِ ﴿٥﴾ وَأَمَّا عَادٞ فَأُهۡلِكُواْ بِرِيحٖ
صَرۡصَرٍ عَاتِيَةٖ ﴿٦﴾ سَخَّرَهَا عَلَيۡهِمۡ سَبۡعَ لَيَالٖ وَثَمَٰنِيَةَ أَيَّامٍ حُسُومٗاۖ فَتَرَى
ٱلۡقَوۡمَ فِيهَا صَرۡعَىٰ كَأَنَّهُمۡ أَعۡجَازُ نَخۡلٍ خَاوِيَةٖ ﴿٧﴾ فَهَلۡ تَرَىٰ لَهُم مِّنۢ بَاقِيَةٖ ﴿٨﴾
٥٦٦

penduar dhe e nënshtruar te Zoti i saj, përderisa ka ende kohë. Çdokush që ka siguri në fjalën e Zotit përpiqet të arrijë ato gjëra që ka lënë mangët.

Ajetet 44 – 52

44. Pra, më lër Mua me ata që e mohojnë këtë Kuran! Ne do t'i afrojmë ata gradualisht, prej nga nuk e presin.

45. Unë u jap afat atyre, sepse ndëshkimi Im është shumë i fortë.

46. A mos po u kërkon atyre shpërblim e ata të rëndohen nga shpenzimet?!

47. A mos ndoshta dinë të fshehtën, e kështu të trumbetojnë?!

48. Po ti bëhu i durueshëm ndaj caktimit të Zotit tënd dhe mos u bëj si ai i peshkut në kohën kur u lut, në atë gjendje të ngarkuar ankthi e trishtimi.

49. **Sikur të mos i vinte mëshira nga Zoti i tij, ai do të hidhej në shkretëtirë i braktisur dhe i fajësuar.**
50. **Por Zoti i tij e bëri atë të zgjedhur dhe prej të mirëve.**
51. **Ata që nuk besojnë gati sa nuk të hanë me shikimet e tyre dhe thonë: "Ai është i marrë!"**
52. **Po ai nuk është gjë tjetër, por veçse këshillë për botët.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Pra, më lër Mua me ata që e mohojnë këtë Kuran!" - Ky është një kërcënim vërtet i frikshëm. Allahu i Lartësuar thotë: Më lër Mua vetëm për vetëm me ata që e mohojnë dhe e hedhin poshtë Kuranin dhe mos kërko përshpejtimin e ndëshkimit për ta, se dënimi i përgatitur për ta është shumë i rëndë.

- "Ne do t'i afrojmë ata gradualisht, prej nga nuk e presin. Unë u jap afat atyre, sepse ndëshkimi Im është shumë i fortë." - Allahu i Lartësuar na tregon se Ai i afron gradualisht ata drejt një ndëshkimi, që ata as nuk arrijnë ta imagjinojnë dhe, gjithashtu, i afatizon ata. Ai i furnizon me pasuri dhe fëmijë, ua shton stolitë e kësaj bote, që ata të kënaqen dhe të vazhdojnë në rrugën e humbjes dhe shkatërrimit. Ky është kurthi i Allahut për armiqtë jobesimtarë, dhe kurthi i Tij është i fortë e i pathyeshëm. Ai ka për t'i ndëshkuar ata në përmasa që ata as mund ta mendojnë tani.

- "A mos po u kërkon atyre shpërblim e ata të rëndohen nga shpenzimet?!" - Largimi tyre prej teje është i pa justifikueshëm. Edhe për neverinë që shprehin dhe mosbesimin ndaj së vërtetës, ku ti i fton, ata nuk mund të shfaqin asnjë shkak të pranueshëm e të qenësishëm. Ti po u mëson atyre besimin e drejtë dhe po i fton në rrugën e së mirës, pa iu kërkuar asnjë lloj shpërblimi, por thjesht se kështu është më mirë edhe për ta. Ata nuk rëndohen aspak nga ftesa jote. Kështu, ata nuk kanë asnjë arsye që të justifikojë mosbesimin e tyre.

- "A mos ndoshta dinë të fshehtën, e kështu të trumbetojnë?!" – Ata, gjithashtu, nuk kanë ndonjë premtim nga Zoti i gjithësisë që u siguron se do të kenë shpërblime të mëdha prej Tij. Ata janë thjesht një grup mohuesish kryeneçë dhe të padrejtë, që nuk kanë as dëshirën më të vogël për të ndryshuar dhe për t'u kthyer te Zoti i tyre, prandaj nuk mbetet gjë tjetër veçse të kalisësh durimin për t'u përballur me padrejtësitë e tyre.

I Madhëruari i drejtohet Profetit të Tij dhe i thotë:

- "Po ti bëhu i durueshëm ndaj caktimit të Zotit tënd..." - Bëhu i durueshëm ndaj gjykimit të Zotit tënd, qoftë për përcaktimet e Tij, qoftë për detyrimet fetare. Bëj durim në çdo vështirësi që do të hasësh dhe mos u zemëro apo të shprehësh pakënaqësi ndaj përcaktimit të Zotit tënd. Pranoje gjithçka me zemër të nënshtruar dhe të kënaqur plotësisht me urdhrin e Zotit të saj.

- "...dhe mos u bëj si ai i peshkut..." - Këtu bëhet fjalë për Junus Ibn Mettâ-n (a.s.). Pra, mos u bëj si ai, në gjendjen ku arriti, e cila u bë shkak që të qëndronte më pas në barkun e peshkut. Ai nuk bëri durim ndaj popullit të tij, ashtu siç pritej dhe kërkohej prej tij, por u largua i zemëruar prej tyre. Më pas, kur hipi në një anije, njerëzit që ishin në të u detyruan që të lehtësonin anijen nga pesha e

rëndë. Për të zgjedhur se cili do të hidhej në det, ata hodhën short. Shorti i ra Junusit, të cilin, kur e hodhën në det, atë e gëlltiti një peshk i madh.

- "...në kohën kur u lut, në atë gjendje të ngarkuar ankthi e trishtimi." - Ai u dëshpërua mjaft në barkun e peshkut, prandaj filloi të lutej duke thënë: "*Lâ ilâhe illâ Ente! Sub'ânneke! Innî kuntu mineđhđhâlimîn*" (Nuk ka asnjë të adhuruar me meritë veç Teje! Ti je larg çdo të mete! Nuk ka dyshim se unë isha prej të padrejtëve!).
Atëherë, Allahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së tij dhe e urdhëroi peshkun që ta nxirrte atë në tokë të hapur. Junusi ishte i sëmurë dhe Allahu i Lartësuar bëri që pranë tij të mbinte një kungull. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Sikur të mos i vinte mëshira nga Zoti i tij, ai do të hidhej në shkretëtirë i braktisur dhe i fajësuar." - Nëse Allahu i Lartësuar, me mëshirën e Tij, nuk do ta shpëtonte Junusin, ai do të flakej në një tokë të shkretë i fajësuar. Por me mëshirën e Tij, Allahu e shpëtoi atë dhe e bëri që të jetë i lëvduar ndër njerëz.
Gjendja e Junusit pas kësaj sprove ishte më e mirë se para saj, prandaj i Madhëruari thotë:

- "Por Zoti i tij e bëri atë të zgjedhur dhe prej të mirëve." - Allahu i Lartësuar e dalloi, e zgjodhi dhe e shpëtoi atë nga çdo fatkeqësi dhe mangësi. Ai e bëri atë prej *sâlihîn*-ëve, veprat, fjalët dhe qëllimet e të cilëve janë të mira.

Edhe Muhamedi (a.s.) bëri durim dhe e zbatoi plotësisht urdhrin e Zotit të tij, ashtu si askush tjetër në këtë botë, prandaj Allahu i Lartësuar e nderoi atë duke i premtuar fitore dhe një përfundim të mirë.

- "Ata që nuk besojnë gati sa nuk të hanë me shikimet e tyre..." - Armiqtë nuk mundën të arrinin qëllimet e tyre kundër Profetit të nderuar, megjithëse u përpoqën me çdo mënyrë, me vepra dhe me fjalë. Aq e madhe ishte urrejtja e tyre për të, saqë ata gati sa nuk e dëmtonin me shikimet e tyre, të mbushura plot smirë, urrejtje e armiqësi. Por ndihmëtari dhe ruajtësi i tij ishte Allahu i Lartësuar. Deri këtu shkonte persekutimi i tyre me vepra, ndërsa me fjalë:

- "...thonë: "Ai është i marrë!"" - Ata flisnin ashtu siç ua diktonte zemra. Herë thonin se ai ishte i çmendur, herë thonin magjistar e herë të tjera poet.

- "Po ai nuk është gjë tjetër, por veçse këshillë për botët." - Kurani madhështor është veçse përkujtim e këshillë për botën. Nëpërmjet Kuranit, njerëzit përkujtohen për të arritur mirësitë e fesë dhe të dynjasë së tyre.

Surja 69: El Hak-kah (mekase) 52 ajete

Ajetet 1 – 8

Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!

1. ***El Hãkkah*!**
2. Çfarë është *El Hãkkah*?!
3. E ku mund ta dish ti se ç'është *El Hãkkah*?!
4. Themudi dhe Adi mohuan Ditën e Tmerrit.
5. Sa i përket Themudit, ata u shkatërruan me një ushtimë të tmerrshme.

6. **Ndërsa Adi u shkatërrua me një stuhi të fuqishme e të zhurmshme,**
7. **që Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht. T'i shihje njerëzit të shembur përdhe, si të ishin trungje hurmash të zgavruara.**
8. **A e gjen ndonjë që ka mbetur prej tyre?**

Shpjegimi i ajeteve

- "*El Hãkkah*! Çfarë është *El Hãkkah*?!" - *El Hãkkah* është një prej emrave të Ditës së Kijametit. Quhet kështu sepse është ditë e pashmangshme dhe se gjatë saj do të shfaqen hapur të gjitha të vërtetat, madje edhe ato që mbahen fshehur në gjoks.

Allahu i Lartësuar ia shton rëndësinë kësaj dite, duke e përsëritur emrin e saj dhe duke pyetur:

- "E ku mund ta dish ti se ç'është *El Hãkkah*?!" - Rëndësia e saj është shumë e madhe dhe tmerri që ajo sjell është i papërshkrueshëm. Aq e rëndësishme është kjo ditë, saqë Allahu i Lartësuar ka shkatërruar shumë popuj që nuk i kanë besuar vërtetësisë së saj që në këtë dynja.

Më pas, Allahu i Lartësuar na jep një shembull për të kuptuar madhështinë e Kijametit, duke sjellë raste të ndëshkimeve që përfshinë popuj të ndryshëm nëpër kohë. Thotë i Madhëruari:

- "Themudi dhe Adi mohuan Ditën e Tmerrit." - Themudi ishte një popull që banonte në Hixhër. Allahu i Lartësuar dërgoi tek ata profetin Salih (a.s.), për t'i këshilluar që t'i largoheshin *shirk*-ut dhe të adhuronin vetëm Allahun Krenar dhe të Lartësuar si Një, të Vetëm dhe të Pashoq. Por ata e refuzuan ftesën e tij dhe e mohuan atë. Ata nuk e besuan lajmin e madh të Ditës së Kijametit, të ashtuquajturës "*el Kâriatu*". Ajo quhet kështu sepse *jeḳra'u* - të tmerron me pamjet dhe situatat e saj të frikshme dhe dëshpëruese.

Kështu veproi edhe populli i Adit, të cilët jetonin në Hadrameut. Allahu i Lartësuar dërgoi mes tyre profetin Hud (a.s.). Edhe ai i ftonte në *teuhid* dhe të besonin Ditën e Kijametit, por ata nuk e pranuan. Atëherë, Allahu i Lartësuar i shkatërroi këta dy popuj me një ndëshkim të përshpejtuar që në këtë dynja:

- "Sa i përket Themudit, ata u shkatërruan me një ushtimë të tmerrshme." – Ata u shkatërruan nëpërmjet një zhurme të madhe e të papërballueshme, nga e cila atyre u ngrinë zemrat dhe iu dolën shpirtrat. Në të gdhirë, të gjithë kishin të vdekur dhe nuk dukej asgjë tjetër, veçse gërmadhat dhe kufomat e tyre.

- "Ndërsa Adi u shkatërrua me një stuhi të fuqishme e të zhurmshme..." - Ata u shkatërruan me një furtunë të fuqishme dhe shumë të zhurmshme. Ulërima e saj ishte më e fortë dhe më e frikshme se gjëmimi i bubullimës. Fjala *âtijeh* tregon që ajo kaloi çdo përmasë të zakonshme.

- "...që Ai e lëshoi kundër tyre shtatë net e tetë ditë rresht." - Ajo solli një ndëshkim të madh dhe befasues, që i shkatërroi të gjithë, për shtatë net dhe tetë ditë rresht.

- "T'i shihje njerëzit të shembur përdhe, si të ishin trungje hurmash të zgavruara." - Pas këtij ndëshkimi, kufomat e njerëzve dukeshin si trungje hurmash të zgavruara, të stivosur njëri mbi tjetrin.

- "A e gjen ndonjë që ka mbetur prej tyre?" - Kjo është një pyetje, së cilës i dihet përgjigjja. Nuk ka dyshim se ata u shfarosën plotësisht.


Ajetet 9 – 12

9. Faraoni, ata që ishin para tij dhe të përmbysurit kryen vepra të padrejta.
10. Ata kundërshtuan të Dërguarin e Zotit të tyre, prandaj Ai i ndëshkoi me një dënim edhe më të ashpër.
11. Pasi vërshoi uji, Ne ju hipëm në anije,
12. që të shërbente si përkujtim për ju dhe për ta kuptuar çdo vesh (zemër) përkujtues.".

Shpjegimi i ajeteve

- "Faraoni, ata që ishin para tij dhe të përmbysurit kryen vepra të padrejta." – Ashtu si popujt e Adit dhe Themudit, pati edhe shumë të tjerë që i kaluan kufijtë me padrejtësi. I tillë ishte Faraoni në Egjipt, tek i cili Allahu i Lartësuar dërgoi adhuruesin dhe profetin e Tij, Musa Ibn Imran (a.s.). Allahu i Lartësuar i mundësoi Faraonit që të shihte shumë shenja të qarta, nëpërmjet të cilave mund të krijonte një siguri të plotë rreth së vërtetës, por ai mohoi me kryeneçësi dhe i kaloi kufijtë me padrejtësi e dhunë. Edhe të tjerë, para e pas tij, vepruan në të njëjtën mënyrë, si populli i Lutit (*el mu'tefiḳâtu*), të cilët, gjithashtu, u ndëshkuan, sepse të gjithë kundërshtuan profetin dhe përhapën të keqen. Ata mohuan Zotin, profetët dhe porositë e tyre, bënin padrejtësi, luftonin hapur kundër të vërtetës dhe përhapësve të saj, e çdo lloj gjynahu, ligësie dhe imoraliteti. I Lartësuari thotë:

- "Ata kundërshtuan të Dërguarin e Zotit të tyre, prandaj Ai i ndëshkoi me një dënim



edhe më të ashpër." - Të gjithë ata që u përmendën më lart e refuzuan profetin që Allahu i Lartësuar u dërgoi dhe nuk besuan e ndoqën mësimet e tij. Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar i goditi me një ndëshkim shumë të rëndë, të papërfytyrueshëm nga njerëzit. I tillë ishte, për shembull, populli i Nuhut (a.s.), që Allahu i Lartësuar e ndëshkoi duke e mbytur në ujë, i cili mbuloi gjithçka, edhe vendet më të larta. Megjithatë, Allahu i Lartësuar i shpëtoi ata që i besuan Profetit, nga të cilët rodhi njerëzimi sërish. Ai i shpëtoi ata duke i ruajtur në anijen që Nuhu (a.s.), me urdhrin e Allahut, ndërtoi.

- "Pasi vërshoi uji, Ne ju hipëm në anije..." - Allahu i Lartësuar na barti në anije kur ende ishim në shpinat e stërgjyshërve tanë. Ai na shpëtoi, prandaj duhet ta lavdërojmë dhe t'i shprehim mirënjohjen tonë Atij. Allahu i Lartësuar na këshillon që të marrim

mësime dhe përvojë nga këto shenja dhe fakte, që tregojnë njëshmërinë e Tij në meritën e adhurimit me dashuri, nënshtrim, bindje dhe përkushtim. I Madhëruari thotë:

- "...që të shërbente si përkujtim për ju..." - Çdo anije që shihni duhet t'ju përkujtojë anijen e parë të prodhuar nga njerëzit, historinë e saj dhe pikërisht ngjarjen se si Allahu i Lartësuar shpëtoi nëpërmjet saj ata që i besuan Atij dhe pasuan udhëzimin e sjellë prej Profetit të Tij. Ndërsa ata që mohuan dhe refuzuan të nënshtroheshin ndaj së vërtetës mbetën jashtë asaj anijeje.

- "...dhe për ta kuptuar çdo vesh (zemër) përkujtues." – Me qëllim që të urtët e të mençurit të logjikojnë dhe të nxjerrin mësime prej saj. Ndërsa refuzuesit dhe shpërfillësit e së vërtetës, mendjelehtët dhe mendjengushtët, të cilët nuk arrijnë që të përfitojnë nga ajetet dhe shenjat e Allahut, nuk dinë të logjikojnë dhe të nxjerrin mësime. Ata nuk dinë të meditojnë dhe të kuptojnë mesazhet e Zotit të gjithësisë.

Ajetet 13 – 18

13. E kur t'i fryhet Surit vetëm një herë,
14. dhe të ngrihen toka e malet dhe, me një të goditur të vetme, të përplasen me njëri-tjetrin,
15. në këtë ditë ndodh e Vërteta!
16. E çahet qielli, që atë ditë është i rraskapitur,
17. ndërsa engjëjt qëndrojnë në skajet e tij. Atë ditë, Arshin e Zotit tënd e bartin mbi vete tetë prej tyre.
18. Atë ditë, ju do të dilni zbuluar, duke mos mbetur i fshehtë asnjë sekret i juaji.

Shpjegimi i ajeteve

Në ajetet më sipër, Allahu i Lartësuar tregoi se çfarë bëri me refuzuesit dhe mohuesit e profetëve të Tij, se si i "shpërbleu" ata dhe si ua përshpejtoi ndëshkimin që në këtë jetë. Ai na tregoi, gjithashtu, se si i shpëtoi nga ky ndëshkim i ashpër profetët dhe pasuesit e tyre të sinqertë. Të gjitha këto shërbejnë si një hyrje, për të rrëfyer më pas ndëshkimin e përgatitur për ta në jetën tjetër dhe faktin e padiskutueshëm që të gjitha veprat do të shpërblehen plotësisht në ahiret.

Në vijim, tregohen ngjarjet e mëdha që do të ndodhin Ditën e Gjykimit. Gjithçka do të fillojë me fryrjen e Surit nga ana e Israilit, melekut të Allahut të Lartësuar. Thotë i Lartësuari:

- "E kur t'i fryhet Surit vetëm një herë..." – Në këtë çast, trupat do të mbijnë sërish, sikurse mbin bima nga fara e saj, dhe çdo shpirt do të kthehet në trupin nga i cili ka dalë. E kështu, i gjithë njerëzimi do të qëndrojë para Zotit të botëve, duke përjetuar tmerrin e asaj dite të vështirë.

- "..dhe të ngrihen toka e malet dhe, me një të goditur të vetme, të përplasen me njëri-tjetrin..." - Malet do të thërrmohen, do të goditen e do të bëhen një me tokën, e cila do të shndërrohet në një tjetër tokë, sikurse thotë i Lartësuari në këtë ajet: "Të pyesin ty për malet. Thuaju: "Ata do t'i shkulë Zoti im e do t'i thërrmojë plotësisht. Tokën do ta shndërrojë në një vend të sheshtë, ku nuk do të shohësh më reliev të thyer"." [Ta Ha 105-107]. Kjo është ajo që Zoti do të bëjë me tokën dhe ç'ka mbi të, atë ditë. Ndërsa për sa i përket qiellit, mjafton të përmendim se ajo është dita e ndodhisë së madhe:

- "...në këtë ditë ndodh e Vërteta! E çahet qielli, që atë ditë është i rraskapitur..." - Atë ditë të vështirë, qielli do të tronditet dhe do të shpaloset. Ai do të çahet dhe do të ndryshojë ngjyrë. Qielli, që dikur e mbante ajo forcë e madhe, tani do të copëtohet. E kjo do të ndodhë për shkak të një ngjarjeje shumë të madhe dhe për trishtimin e makthin që po afrojnë.

- "...ndërsa engjëjt qëndrojnë në skajet e tij." - Melekët e nderuar qëndrojnë në skajet dhe shtyllat e qiellit, me përunjësi për Zotin e tyre, të frikësuar nga madhështia e Tij.

- "Atë ditë, Arshin e Zotit tënd e bartin mbi vete tetë prej tyre." - Këta të tetë janë melekë të mëdhenj dhe jashtëzakonisht të fuqishëm, që do të mbajnë Arshin e Allahut të Madhëruar, kur Ai të vijë për të bërë llogarinë me drejtësi dhe me mëshirë. Ajo është Dita e Llogarisë dhe e Gjykimit të madh, për çdo gjë të madhe e të vogël, për çdo të fshehtë e të dukshme. I Lartësuari thotë:

- "Atë ditë, ju do të dilni zbuluar, duke mos mbetur i fshehtë asnjë sekret i juaji." - Për Allahun nuk ka të fshehta as në trupin e krijesave dhe as në sendet, veprat dhe sjelljet e tyre. Allahu është Njohësi i të fshehtës dhe i të dukshmes. Ai do t'i ringjallë njerëzit të zhveshur, këmbëzbathur dhe të pa bërë synet. Ata do të qëndrojnë në një tokë të sheshtë. Atje do të dëgjojnë zërin që i grumbullon në Vendin e Llogarisë dhe do të ndiejnë, me plot kuptimin e fjalës, frikën e qëndrimit përpara Zotit të tyre. Atje do të shpërblehen me drejtësi e bamirësi për ato që kanë bërë.

Më pas, Allahu i Lartësuar tregon llojet e llogarisë dhe të shpërblimit:

Ajetet 19 – 24

19. Ai të cilit do t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij, do të thotë: "Ej, ju të gjithë! Ja, lexojeni librin tim!"
20. Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time!"
21. Ai do të jetë në një jetë të kënaqshme,
22. në një Xhenet të lartë,
23. ku pemët e veta do t'i ketë shumë pranë.
24. Hani e pini shijshëm, se ju e keni përgatitur këtë në ditët e kaluara.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ai të cilit do t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij..." - Këta janë të lumturit, fatbardhët, të cilëve libri i punëve të mira do t'u jepet nga e djathta e tyre. Kjo do të bëhet që ata të dallohen mes të tjerëve dhe të shfaqet qartë grada e tyre e lartë.

Secili prej tyre, i mbushur me gëzim dhe lumturi të papërshkruar, do të jetë i papërmbajtshëm në dëshirën e tij për t'u treguar të tjerëve për veprat e mira që gjenden në librin e tij, për të cilat i dha sukses Allahu i Lartësuar:

- "...do të thotë: "Ej, ju të gjithë! Ja, lexojeni librin tim!"" – Kuptimi: Ja ku e keni librin e punëve të mia! Lexojeni! Ky libër është përgëzim, që premton Xhenetin, mirësi e nderime të llojllojshme, falje gjynahesh dhe mbulim të metash. Nuk ka dyshim se ky gëzim dhe lumturi më erdhi prej mirësisë së Zotit tim. Është Ai që më dha sukses dhe më udhëzoi që të besoja në Ditën e Ringjalljes dhe të llogarisë para Tij. Është Allahu i Lartësuar që më ndihmoi, ma lehtësoi, ma bëri të dashur dhe të bukur përgatitjen për

këtë ditë. Vetëm Ai më dha sukses që të bëja vepra të mira për këtë ditë të takimit me Të.

- "Unë kam qenë i bindur se do të jap llogarinë time!" - Kuptimi: Unë isha i bindur plotësisht dhe pa mëdyshje se do të vinte dita kur unë do të jepja llogarinë time. Ishte kjo dije e sigurt që më shtyu në kryerjen e urdhrave dhe ndalimin nga haramet.

- "Ai do të jetë në një jetë të kënaqshme..." - Ajo jetë është e stolisur me çdo mirësi që e dëshiron shpirti dhe me të cilën kënaqen sytë. Është një jetë me të cilën ata do të jenë të lumtur dhe kurrë nuk do të kërkojnë të largohen prej saj, sepse asgjë nuk mund të krahasohet me mirësitë e përjetshme dhe të mrekullueshme që janë në të.

- "...në një Xhenet të lartë, ku pemët e veta do t'i ketë shumë pranë." - Të larta janë ndërtesat dhe kështjellat e tyre, të larta janë edhe gradat e tyre, ku ata do të lumturohen përjetësisht. Degët e mbushura plot me fruta do të qëndrojnë gjithmonë pranë tyre dhe ata mund t'i shijojnë pa u lodhur dhe kur të dëshirojnë. Këto degë do qëndrojnë pranë tyre në çdo çast, kur ata të jenë në këmbë, ulur, shtrirë apo të mbështetur, dhe frutat e shijshme do t'u afrohen në dorë.

Në shenjë nderimi, atyre u bëhet një ftesë, që ua shton edhe më tepër kënaqësinë:

- "Hani e pini shijshëm..." - Kuptimi: Hani prej çdo ushqimi të shijshëm dhe pini çdo lloj lëngu të këndshëm. Kënaqësia që është përgatitur për ju është e plotë, e gjithanshme, pa lodhje dhe pa dëmtime anësore. Ky shpërblim është për ju, për shkak të veprave të mira që bëtë në jetën e dynjasë.

- "...se ju e keni përgatitur këtë në ditët e kaluara." – E keni përgatitur me vepra të mira dhe me largimin nga veprat e këqija, të motivuar nga dashuria dhe madhërimi për Allahun e Lartësuar. Ju e adhuruat të Madhëruarin me namaz, agjërim, zekat, haxh, me bamirësi ndaj krijesave, dhikër, pendim të sinqertë dhe me kthim të vazhdueshëm tek Ai. Allahu i Lartësuar i ka bërë këto vepra shkaqe për të hyrë në Xhenet. Janë këto vepra që ua shtojnë mirësinë dhe bukurinë përjetimeve në botën tjetër. Ato janë lumturueset e punuesve të tyre në këtë jetë dhe në tjetrën.

Ajetet 25 – 37

25. Ndërkaq, kujt i jepet libri nga e majta e vet, ai thotë: "Oh, i mjeri unë! Ah, sikur të mos më jepej fare ky libri im,
26. e kështu të mos e dija se si është llogaria ime!
27. Ah, sikur të kishte qenë ai fund i përhershëm për mua!
28. Pasuria nuk më bëri aspak dobi!
29. M'u hoq edhe pushteti!"
30. Kapeni atë dhe vendosjani prangat!
31. Pastaj hidheni në Xhehenem!
32. Mandej lidheni me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kutë.
33. Se ai nuk besonte Allahun e Madhëruar.
34. Ai nuk nxiste për të ushqyer të varfërit.
35. Ai sot nuk ka këtu ndonjë mik,
36. as ushqim tjetër, përveç *gislin*-it,
37. që nuk e ha kush, përveç të gabuarve!

Shpjegimi i ajeteve

- "Ndërkaq, kujt i jepet libri nga e majta e vet..." - Këta janë të dëshpëruarit e mëdhenj, të cilëve do t'u jepet libri i veprave nga e majta e tyre, si një damkë, poshtërim, turpërim dhe përbuzje për ta. Ata do të mbushen me trishtim dhe ankth. Secili prej tyre do të thotë:

- "Oh, i mjeri unë! Ah, sikur të mos më jepej fare ky libri im..." - Ai thotë kështu, sepse në atë libër është vendimi për përjetësinë në zjarrin e Xhehenemit.

- **"...e kështu të mos e dija se si është llogaria ime!" –** Ai do të donte të ishte harruar dhe të mos kujtohej më. Do të dëshironte që çështja të ishte mbyllur me vdekjen e tij dhe të mos përballej kurrë me llogarinë e veprave. Ai do të dëshironte që të ishte dhé dhe të mos ringjallej më, prandaj thotë:

- "Ah, sikur të kishte qenë ai fund i përhershëm për mua!" - Ah, i mjeri unë, sikur pas vdekjes time të mos kishte ringjallje! Ah, sikur me vdekjen të mbyllej gjithçka!

Ai kujton i dëshpëruar pasurinë dhe pushtetin që kishte në jetën e dynjasë, të cilët nuk i përdori për të fituar kënaqësinë e Krijuesit të Tij dhe lumturinë në ahiret. Ato tashmë nuk mund t'i shërbejnë për ta shpëtuar nga ndëshkimi i të Drejtit, qoftë edhe sikur të jepte për kompensim të gjithë tokën. Secili nga këta do të thotë:

- "Pasuria nuk më bëri aspak dobi! M'u hoq edhe pushteti!" - Pasuria nuk bën më dobi, sepse tashmë është shkatërruar dhe është zhdukur. Në fakt, ajo pasuri nuk i ka bërë dobi as në dynja. Po ashtu, janë zhdukur edhe ushtritë që ai kishte në dynja, siç janë zhdukur edhe aleatët e tij të fortë, tek të cilët mbështetej. Tashmë nuk i vlen as fama e gjerë dhe as prestigji i tij ndër njerëz. Të gjitha këto janë fshirë, si pluhuri prej furtunës. Bashkë me to, kanë humbur shanset për shpërblime, të cilat ishin plotësisht të mundura që t'i arrinte duke punuar në jetën e dynjasë. Vendin e tyre e kanë zënë ankthi, dëshpërimi dhe vuajtja.

Pikërisht në këtë moment të frikshëm vjen urdhri për ta ndëshkuar në Xhehenem:

- "Kapeni atë dhe vendosjani prangat!" - Shtrëngojeni me pranga, të cilat të marrin frymën.

- "Pastaj hidheni në Xhehenem!" - Zhyteni në prushin dhe zjarrin e ndezur fort të Xhehenemit.

- "Mandej lidheni me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kutë." - Lidheni atë me një prej zinxhirëve të nxehtë të Xhehenemit.

Në fakt, fjala '*feslukûh*' do të thotë: Le ta përshkojë ky zinxhir trupin e tij, duke iu futur nga prapa dhe duke i dalë nga goja, dhe pastaj të lidhet e shtrëngohet rreth tij. Kështu do të vazhdojë të vuajë me turp këtë ndëshkim poshtërues.

Le ta kujtojmë shkakun që do t'i çojë në këtë gjendje, në mënyrë që edhe ne të ruhemi prej saj:

- **"Se ai nuk besonte Allahun e Madhëruar." -** Ai ishte mohues i Zotit, arrogant me profetët, refuzues dhe mohues i së vërtetës, të cilën profetët e sollën nga Zoti i tyre.

- "Ai nuk nxiste për të ushqyer të varfërit." – Gjithashtu, ai nuk kishte pikë dhembshurie në zemër, që të mëshironte të varfërit dhe nevojtarët. Jo vetëm që nuk i ushqente dhe ndihmonte ata me pasurinë e tij, por nuk nxiste as të tjerët ta bënin këtë gjë.

E çfarë mund t'i bëjë këto zemra që të ndiejnë butësi dhe mëshirë, kur ato janë bosh nga të tilla ndjenja njerëzore?! Këta janë njerëzit më fatkeqë dhe më të dëshpëruar që mund të ekzistojnë. Lumturia e njeriut është e kushtëzuar nga dy gjëra. Në varësi të plotësimit të tyre, do të jetë edhe lumturia e njeriut. Së pari: sinqeriteti në adhurimin e Allahut të Lartësuar, baza e të cilit është besimi i plotë dhe i saktë në Zotin, në profetët dhe në shpalljet e Zotit. Së dyti: bamirësia ndaj krijesave, me të gjitha llojet dhe mënyrat e saj. Pa dyshim, bamirësia më e madhe ndërnjerëzore është plotësimi i kushteve të nevojtarëve në të gjitha aspektet e jetës: në ushqim, veshmbathje, strehim, siguri, paqe etj. Por ata fatzinj nuk pranuan as sinqeritetin ndaj Krijuesi dhe as bamirësinë ndaj krijesave, prandaj e merituan atë që morën.


- "Ai sot nuk ka këtu ndonjë mik..." – Kuptimi: Sot, pra, Ditën e Gjykimit, këta nuk kanë asnjë mik ose ndihmës, që mund t'i shpëtojë nga ndëshkimi apo t'u japë shpërblim. Askush nuk mund t'u ofrojë atyre ndërmjetësim te Zoti i botëve, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "...tek Ai nuk bën dobi ndërmjetësimi, përveç i atij të cilit Ai i jep leje.". [Sebe, 23]. Ata njerëz që mund të ndërmjetësojnë atë ditë janë vetëm besimtarët, të cilët nuk mund të ndërmjetësojnë për qafirët dhe kriminelët, siç thotë i Lartësuari: "Për zullumqarët nuk ka miq dhe as ndërmjetësues që u dëgjohet fjala".

- "...as ushqim tjetër, përveç *gislin*-it, që nuk e ha kush, përveç të gabuarve!" - Ushqimi i vetëm i tyre është *ĝislîn*-i. *Ĝislin* quhet vreri ose qelbi që del nga plagët e banorëve të Zjarrit. Ai është përvëlues, me erë tepër rëndë dhe i pështirë kur e sheh. Ai është, gjithashtu, shumë i hidhur për t'u përballuar Këtë ushqim do ta hanë veçse të ashtuquajturit "*el ĥâṫiûne*" – të gabuarit, domethënë, ata që nuk zgjodhën rrugën e drejtë, por ndoqën me vetëdije rrugët e humbjes dhe të zjarrit. Për këtë arsye, ata merituan ndëshkimin e dhembshëm.

Ajetet 38 – 52

38. Unë betohem në atë që e shihni!
39. Edhe në atë që nuk e shihni!
40. Se me të vërtetë ai është Fjalë që e lexon i Dërguari i ndershëm.
41. Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, por ju nuk besoni.
42. Nuk është as fjalë e ndonjë falltori, por ju nuk përkujtoni.
43. Ai është shpallje prej Zotit të botëve!
44. Sikur ai të trillonte për Ne ndonjë fjalë,
45. Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë,
46. e pastaj do t'ia këputnim atij arterien e zemrës.
47. E askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij.
48. Ai është këshillë për të devotshmit.
49. S'ka dyshim se Ne dimë që prej jush ka edhe mohues.
50. Ai pa dyshim do të jetë dëshpërim për jobesimtarët.
51. Ai është e vërteta e sigurt!
52. Prandaj, ti lartësoje nga të metat Zotin tënd të Madhëruar!

Shpjegimi i ajeteve


الجزء التاسع والعشرون سورة الحاقة
وَلَا طَعَامٌ إِلَّا مِنْ غِسْلِينٍ ﴿٣٦﴾ لَّا يَأْكُلُهُۥٓ إِلَّا ٱلْخَٰطِـُٔونَ ﴿٣٧﴾ فَلَآ أُقْسِمُ
بِمَا تُبْصِرُونَ ﴿٣٨﴾ وَمَا لَا تُبْصِرُونَ ﴿٣٩﴾ إِنَّهُۥ لَقَوْلُ رَسُولٍ كَرِيمٍ ﴿٤٠﴾ وَمَا هُوَ
بِقَوْلِ شَاعِرٍ ۚ قَلِيلًا مَّا تُؤْمِنُونَ ﴿٤١﴾ وَلَا بِقَوْلِ كَاهِنٍ ۚ قَلِيلًا مَّا تَذَكَّرُونَ
﴿٤٢﴾ تَنزِيلٌ مِّن رَّبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ﴿٤٣﴾ وَلَوْ تَقَوَّلَ عَلَيْنَا بَعْضَ ٱلْأَقَاوِيلِ ﴿٤٤﴾
لَأَخَذْنَا مِنْهُ بِٱلْيَمِينِ ﴿٤٥﴾ ثُمَّ لَقَطَعْنَا مِنْهُ ٱلْوَتِينَ ﴿٤٦﴾ فَمَا مِنكُم
مِّنْ أَحَدٍ عَنْهُ حَٰجِزِينَ ﴿٤٧﴾ وَإِنَّهُۥ لَتَذْكِرَةٌ لِّلْمُتَّقِينَ ﴿٤٨﴾ وَإِنَّا
لَنَعْلَمُ أَنَّ مِنكُم مُّكَذِّبِينَ ﴿٤٩﴾ وَإِنَّهُۥ لَحَسْرَةٌ عَلَى ٱلْكَٰفِرِينَ
﴿٥٠﴾ وَإِنَّهُۥ لَحَقُّ ٱلْيَقِينِ ﴿٥١﴾ فَسَبِّحْ بِٱسْمِ رَبِّكَ ٱلْعَظِيمِ ﴿٥٢﴾
سورة المعارج
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
سَأَلَ سَآئِلٌۢ بِعَذَابٍ وَاقِعٍ ﴿١﴾ لِّلْكَٰفِرِينَ لَيْسَ لَهُۥ دَافِعٌ ﴿٢﴾
مِّنَ ٱللَّهِ ذِى ٱلْمَعَارِجِ ﴿٣﴾ تَعْرُجُ ٱلْمَلَٰٓئِكَةُ وَٱلرُّوحُ إِلَيْهِ
فِى يَوْمٍ كَانَ مِقْدَارُهُۥ خَمْسِينَ أَلْفَ سَنَةٍ ﴿٤﴾ فَٱصْبِرْ صَبْرًا جَمِيلًا
﴿٥﴾ إِنَّهُمْ يَرَوْنَهُۥ بَعِيدًا ﴿٦﴾ وَنَرَىٰهُ قَرِيبًا ﴿٧﴾ يَوْمَ تَكُونُ ٱلسَّمَآءُ
كَٱلْمُهْلِ ﴿٨﴾ وَتَكُونُ ٱلْجِبَالُ كَٱلْعِهْنِ ﴿٩﴾ وَلَا يَسْـَٔلُ حَمِيمٌ حَمِيمًا ﴿١٠﴾
٥٦٨

- “Unë betohem në atë që e shihni! Edhe në atë që nuk e shihni!” - Allahu i Lartësuar betohet në gjërat që i shohim dhe në ato që nuk i shohim. Kjo do të thotë që Allahu betohet në të gjitha krijesat. Madje, në këtë betim Allahu i Lartësuar përfshin edhe Veten e Vet. Ai betohet në gjithçka që ekziston për besnikërinë e Profetit dhe për vërtetësinë e Kuranit. Allahu i Lartësuar betohet se Profeti e ka kumtuar Kuranin me besnikëri, duke hedhur kështu poshtë çdo shpifje për të.

- “Se me të vërtetë ai është Fjalë që e lexon i Dërguari i ndershëm. Ai nuk është fjalë e ndonjë poeti, por ju nuk besoni. Nuk është as fjalë e ndonjë falltori, por ju nuk përkujtoni.” - Armiqtë e Profetit e quajtën me emra të ndryshëm të trilluar, si: poet, fallxhor apo magjistar. Por Allahu i Lartësuar e lëvdon Profetin e Tij duke i hedhur poshtë shpifjet e tyre.

Allahu i Lartësuar na e tregon shkakun pse ata shpifnin kundër Profetit, kur thotë: “ju nuk besoni” dhe “ju nuk përkujtoni”. Pra, ata as besonin dhe as përkujtonin, prandaj edhe shkuan atje ku shkuan. Nëse do të besonin dhe të përkujtonin Shpalljen e Zotit, do të arrinin të mësonin çdo gjë të dobishme dhe do të kuptonin mirë çdo gjë që i dëmton. Nëse do të shikonin dhe mendonin me kujdes rreth Muhamedit, rreth cilësive e virtyteve të tij, do ta kuptonin se ai ishte profeti i Allahut, ndërsa libri që ai solli është shpallje e Zotit të botës.

- “Ai është shpallje prej Zotit të botëve!” - Ai libër nuk mund të jetë fjalë krijese. Ai është fjalë që tregon madhështinë e Atij që e ka folur dhe e ka shpallur, tregon lartësinë dhe bukurinë e cilësive të Tij, përkujdesin e madh të Tij për krijesat, lartësinë e Tij mbi çdo gjë që ekziston. Të mendosh që dikush mund të shpifë kundër Zotit dhe mund të trillojë rreth Tij është një mendim i gabuar, që nuk përkon aspak me madhështinë dhe urtësinë e Allahut të Gjithëditur dhe të Gjithëfuqishëm. I Lartësuari thotë:

- “Sikur ai të trillonte për Ne ndonjë fjalë, Ne do ta kapnim atë me fuqinë Tonë, e pastaj do t’ia këputnim atij arterien e zemrës.” - *El uetîn* quhet arteria e zemrës, që, nëse këputet, njeriu vdes menjëherë. Pra, nëse Muhamedi (a.s.) do të shpifte dhe trillonte fjalë që Zoti nuk i ka thënë – gjë që kurrë nuk mund të mendohet për Profetin e Mëshirës – Allahu i Lartësuar do ta përshpejtonte ndëshkimin e tij. Ai do ta

ndëshkonte menjëherë atë, sikurse di të ndëshkojë Krenari i Gjithëpushtetshëm.

Një gjë e tillë nuk mund të ndodhë, sepse Allahu i Lartësuar është *El Hakîm*, i Urti, dhe urtësia e Tij nuk mund të lejojë një mashtrues që të flasë gënjeshtra ndaj të Madhërishmit. Allahu i Lartësuar dhe i Urtë nuk mund të lejojë të ketë sukses një mashtrues, që pretendon se Allahu ia ka bërë të lejueshme gjakun dhe pasurinë e kundërshtarëve të tij. Ai nuk mund të tolerojë një mashtrues që të thotë se ai dhe pasuesit e tij janë fitimtarët dhe të shpëtuarit, ndërsa kundërshtarët e tyre janë të humburit dhe të shkatërruarit. Një trillues i tillë nuk mund t'i shpëtojë ndëshkimit të të Plotpushtetshmit. I Lartësuari thotë:

- "E askush prej jush nuk do të mund të ndërhynte për mbrojtjen e tij." - Allahu i Lartësuar jo vetëm që nuk e ndëshkoi këtë njeri, por e ndihmoi dhe e përforcoi me mrekulli, argumente dhe fakte të shumta, që tregojnë besnikërinë e tij dhe vërtetësinë e Kuranit që ai solli te njerëzit. Allahu i Lartësuar e ndihmoi atë duke i mundësuar fitore të mëdha dhe të vazhdueshme mbi armiqtë e tij. Ai i dhuroi Profetit pushtet mbi të gjithë ata që treguan armiqësi ndaj tij. Të gjitha këto janë dëshmi të vërtetësisë së profetësisë së tij; të gjitha dëshmojnë se Muhamedi ishte një profet besnik i Zotit të Plotfuqishëm dhe të Urtë.

- "Ai është kështillë për të devotshmit." - Kurani është përkujtim dhe mësim për të devotshmit. Nëpërmjet mësimit dhe përkujtimit të tij, ata njohin dhe kuptojnë rrugën e arritjes së mirësive të dynjasë dhe të ahiretit. Aty kuptojnë besimin e tyre të pastër dhe prej tij stolisen me cilësitë dhe virtytet më të larta, që kënaqin dhe gëzojnë gjithkënd. Ai është burimi i ligjeve të jetës dhe i adhurimeve të tyre. Jeta e tyre ndërtohet mbi këtë libër. Me të jetojnë dhe vdesin. Nëpërmjet tij, ata bëhen dijetarë të mëdhenj dhe edukatorë të njerëzimit, adhurues të ditur dhe të urtë, udhëheqës që udhëzojnë në rrugën e drejtë, me lejen e Zotit të tyre.

- "S'ka dyshim se Ne dimë që prej jush ka edhe mohues." - Njoftimi se Allahu i Lartësuar i di ata që e mohojnë Kuranin madhështor, është një kërcënim i madh për dënimin e fortë që i pret ata.

- "Ai pa dyshim do të jetë dëshpërim për jobesimtarët." - Mohuesit e Kuranit, ata të cilët nuk e besojnë dhe nuk e trajtojnë atë si librin e Zotit, kur të shohin dhe vuajnë ndëshkimin e paralajmëruar, kanë për t'u pushtuar nga një dëshpërim i thellë. Ata do të dëshpërohen se nuk i pranuan dhe nuk iu nënshtruan porosive të këtij libri. Ata do të pikëllohen për mirësitë e premtuara në të për besimtarët, të cilat tashmë nuk mund t'i arrijnë, dhe për ndëshkimin e paralajmëruar në të për mohuesit, nga i cili kurrë nuk do të shpëtojnë. Atë ditë nuk do të ketë asnjë mundësi kthimi prapa e pendimi.

- "Ai është e vërteta e sigurt!" - Kurani është *ĥaķul jeķîn*, grada më e lartë e sigurisë që mund të arrihet rreth diçkaje. *Jeķîn* është siguria e plotë rreth diçkaje, siguri e cila është e padiskutuesh me, e qëndrueshme, që nuk mund të hidhet poshtë dhe nuk mund të vihet në dyshim.

Jeķîn-i është në tri nivele. Niveli pasardhës është më i lartë se ai paraardhës:

1. *Ilmul jeḳîn* (siguri prej dijes), që përfitohet nga përcjellja me saktësi e dijes ose informacionit.
2. *Ajnul jeḳîn* (siguri prej vështrimit me sy), e cila përfitohet nëpërmjet shqisës së të parit (ose shqisave të tjera).
3. *Ĥaḳul jeḳîn* (siguri totalisht e vërtetë) ose (siguri e përjetuar), e cila është dija e përfituar nga shijimi dhe përjetimi i drejtpërdrejtë i së vërtetës me gjithë dimensionet e përjetimit. [36]

Atëherë, Kurani është në gradën më të lartë të sigurisë së dijes, në gradën e *Ĥaḳul jeḳîn*-it, sepse ata që dinë ta kuptojnë dhe jetojnë me diturinë e tij, me të vërtetat e imanit që thuhen në të, me faktet dhe dëshmitë rreth jetës dhe përjetësisë, ata arrijnë *Ĥaḳul jeḳîn*-in. [37]

- "Prandaj, ti lartësoje nga të metat Zotin tënd të Madhëruar!" - Lavdëroje Allahun e Lartësuar me *tesbih*, duke e Lartësuar Atë nga çdo gjë që nuk i shkon madhështisë dhe krenarisë së Tij. Shenjtëroje Atë, duke përmendur cilësitë e madhështisë dhe bukurisë së Tij.

Surja 70: El Mearixh (mekase) 44 ajete

Ajetet 1 – 7

Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!

1. Dikush kërkoi dënimin e pashmangshëm.
2. Askush nuk mund ta ndalë atë për jobesimtarët.
3. Ai dënim vjen nga Allahu, Pronari i rrugëve të larta.
4. Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti në një ditë, e cila zgjat pesëdhjetë mijë vjet.
5. Ti bëj durim, një durim të hijshëm.
6. Ata e shohin atë larg,
7. kurse Ne e shohim atë afër.

Shpjegimi i ajeteve

Në këto ajete tregohet për injorancën dhe arrogancën e kundërshtarëve të Profetit, të cilët kërkonin me nxitim ndëshkimin e

---

[36] Imam ibnul kaj-jimi duke folur për jakin-in sigurinë dhe gradat e saj, thotë: "Tre gradat e jakinit janë shpjeguar nëpërmjet një shembulli të thjeshtë: Dikush të cilit i beson dhe nuk ke asnjë dyshim në lajmin që të jep, së pari të njofton rreth mjaltit, pastaj ta tregon atë që ta shohësh dhe në fund të jep që ta provosh atë. E para është ilmul jakin, e dyta është ajnul jakin dhe e treta është hakkul jakin. Kështu dituria jonë e sigurt që marim prej shpalljes së Zotit (Kuran e synet) rreth xhennetit dhe zjarrit p.sh., na mundëson neve "ilmul jakin" sigurinë prej dijes. Kur xhenneti t'u afrohet të devotshmëve dhe zjarri të shfaqet për të humburit atëherë krijesat do të arrijnë "ajnul jakin" sigurinë prej vështrimit me shqisa. Ndërsa kur banorët e xhennetit të hyjnë në xhennet dhe banorët e zjarrit të hyjnë në zjarr atëherë do të përjetojnë "hakkul jakin" sigurinë totalisht të plotë pra sigurinë e përjetimit. Shih "Medarixhus-salikin" 2 / 445.

[37] Imam ibnul kaj-jimi duke folur për hakul jakin-in sigurinë e përjetimit thotë: "Mësoje se kjo gradë nuk arrihet në këtë dynja veçse nga Profetët e Zotit. Kështu Profeti ynë Muhammedi a.s. e pa me sy xhennetin dhe zjarrin, Musa a.s. dëgjoi Zotin realisht që i foli drejt përdrejt pa ndërmjetës. Po, është e vërtetë që edhe besimtarët ndodh që të përjetojnë dhe të arrijnë gradën e "hak-kul jakinit" sigurisë totalisht të vërtetë kur bëhet fjalë për përjetimin e ëmbëlsisë së imanit dhe ndjenjave të fuqishme që prodhon imani i vërtetë dhe i qartë. Ndërsa kur bëhet fjalë për çështjet e ahiretit si xhenneti zjarri, shikimi i Zotit realisht me sytë e ballit dhe të zemrës dëgjimi i fjalës së Tij realisht dhe pa ndërmjetës, të tilla çështje besimtari do ti përjetojë veçse në jetën tjetër. Ndërsa në këtë jetë atij i takon ti besojë me iman të plotë që arrin në gradën e ilmil jakin." Shih "Medarixhus-salikin" 2 / 445.

Me sa duket shejh Sadi ka për qëllim këtë nivel të "hakkul jakinit", pra gradën e "hak-kul jakinit" sigurisë totalisht të vërtetë që bën fjalë për përjetimin e ëmbëlsisë së imanit dhe ndjenjave të fuqishme që prodhon imani i vërtetë dhe i qartë. Dhe pa dyshim ky Kur'an është burrimi i vërtetë i kësaj sigurie dhe prodhuesi i këtyre ndjenjave dhe përjetimeve të mrekullueshme.

Allahut të Lartësuar, duke e bërë këtë në formë talljeje, mospërfilljeje dhe mosbesimi. I Lartësuari thotë:

- "Dikush kërkoi dënimin e pashmangshëm. Askush nuk mund ta ndalë atë për jobesimtarët." - Dikush kërkoi të realizohej menjëherë paralajmërimi për ndëshkim.

Këta të mjerë kërkojnë që të realizohet ai ndëshkim, të cilin askush nuk mund ta kthejë më pas dhe nga i cili jobesimtarët nuk mund të shpëtojnë. Askush nuk mund ta përshpejtojë ndodhinë e tij, para afatit të përcaktuar nga Sunduesi i gjithësisë, dhe askush nuk mund ta vonojë apo ndalojë atë, kur ai të ndodhë.

Ky ajet bën fjalë për El Nadr Ibn Harith el Kurashij apo për ndonjë idhujtar tjetër, që, sikurse u citua, i bëri Allahut një kërkesë të çuditshme. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "Kur thanë: "O Allah! Nëse është ky (Kurani) vërtet prej Teje, lësho gurë nga qielli kundër nesh, ose sillna ndonjë dënim të rëndë". Por Allahu nuk do t'i dënojë ata, derisa ti (Muhammed) je në mesin e tyre, dhe Allahu nuk do t'i dënojë ata, përderisa ata kërkojnë falje". [Enfal 32, 33].

Ndëshkimi i Allahut të Drejtë dhe Krenar do të godasë patjetër mbi ta: ose që në jetën e dynjasë ose në jetën tjetër. Nëse ata do ta njihnin Allahun e Lartësuar, nëse do të njihnin madhështinë e Tij, pushtetin e Tij absolut dhe gjithëpërfshirës, emrat dhe cilësitë e Tij më të larta, ata nuk do ta kërkonin kurrë atë ndëshkim. Përkundrazi, ata do të tregoheshin të kujdesshëm dhe me edukatë.

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar u tërheq atyre vëmendjen për madhështinë e Tij:

- "Ai dënim vjen nga Allahu, Pronari i rrugëve të larta." – Është i Lartësuari, i Madhëruari e Madhështori që përkujdeset për të gjitha krijesat.

- "Atje ngjiten engjëjt dhe Shpirti." - Tek Ai ngjiten engjëjt, që realizojnë detyrat dhe urdhrat e Zotit. Atje lart ngjitet edhe "*el rruh*" – shpirti, që është një emër i përgjithshëm, i cili përfshin të gjithë llojet e shpirtrave.
Kështu, shpirtrat e vepërmirëve (*ebrar*) ngjiten për tek Allahu i Lartësuar. Portat e qiellit u hapen njëra pas tjetrës, derisa të mbërrijnë në lartësitë mbi të cilat është Allahu i Madhëruar. Kur mbërrijnë atje, Allahu i Madhëruar i përshëndet me *selam*, si mirëseardhje për ta. Këta shpirtra fatlumë lumturohen në praninë e të Adhuruarit të tyre. Allahu i Lartësuar i nderon dhe i lumturon, duke i lavdëruar mes banorëve të qiellit, duke u dhuruar mirësi e një pozitë të lartë.

Ndërsa shpirtrat e vepërkëqinjve kanë tjetër pritje e trajtim. Kur ata mbërrijnë në portat e qiellit të dynjasë dhe kërkojnë leje për të vazhduar në qiejt e tjerë, portat nuk hapen, dhe kështu ata kthehen në tokë.

Pastaj Allahu i Lartësuar tregon distancën të cilën e përshkojnë engjëjt dhe shpirti:

- "...në një ditë, e cila zgjat pesëdhjetë mijë vjet..." – Kjo është largësia që përshkojnë engjëjt dhe shpirtrat, me mundësitë dhe forcën që u jep Krijuesi i tyre. Allahu i Lartësuar iu mundëson atyre që, me lehtësi dhe shpejtësi, të kalojnë një distancë që, me një lëvizje normale, do të kërkonte 50 mijë vjet të përshkohej.

E gjithë kjo mbretëri madhështore, kjo botë kaq e gjerë dhe e lartë, ka një Sundues,

një Mbretërues, që përkujdeset dhe administron gjithçka në të. Ai është Allahu, më i Larti. Ai di gjithçka për krijesat e Tij, gjendjen e tyre të jashtme dhe të brendshme, të padukshmen dhe të dukshmen. Ai di vendqëndrimin e gjithçkaje dhe kujdeset për furnizimin e tyre. Ai u dhuron pandërprerë prej mëshirës, bamirësisë dhë rizkut të Tij aq shumë, sa i përfshin dhe u mjafton të gjithëve. Ai ka vendosur që ndër ta të zbatohen ligjet universale të Tij. Ai, gjithashtu, i ka ngarkuar ata që të zbatojnë ligjet e Tij të Sheriatit dhe është Ai që do të zbatojë me drejtësi gjykimin e Tij.

Mjerë për ata popuj që nuk e marrin në konsideratë madhështinë e Allahut dhe nuk dinë t'i japin hakun që i takon, madje guxojnë paturpësisht që ta sfidojnë Atë duke i kërkuar ta përshpejtojë ndëshkimin, për të provuar të vërtetën. *Subhanallah*! Sa i butë dhe i mëshirshëm është Allahu i Lartësuar, që nuk ua përshpejton ndëshkimin! Por një gjë është e sigurt: Ai është i drejtë dhe nuk ka për t'i lënë ata pa i marrë në përgjegjësi. Edhe pse e fyejnë dhe thonë të tilla fjalë, Ai tregohet i duruar, u jep atyre shëndet, përkujdeset dhe i furnizon ata me mirësi, pa të cilat nuk mund të vazhdonin të ekzistonin.

Ky është njëri nga kuptimet e mundshme të ajetit, pra, që kjo ngjitje e zbritje ndodh në dynja, siç del edhe nga konteksti. Por një mundësi tjetër është që të bëhet fjalë për Ditën e Gjykimit. Atë ditë, Allahu i Lartësuar do t'u shfaqë krijesave madhështinë, sundimin dhe mbretërimin e Tij, duke shfaqur shkallë të larta, në të cilat ngjiten dhe zbresin engjëjt dhe shpirtrat, me urdhrin e Tij. Ajo ditë do të jetë 50 mijë vjet, për nga kohëzgjatja dhe vështirësia e saj, por për besimtarët do të jetë më e lehtë.


- "Ti bëj durim, një durim të hijshëm." – Kuptimi: Në rrugën e vështirë për të ftuar popullin tënd në shpëtim trego një durim model, të hijshëm, pa u ankuar e zemëruar për përgjigjen jo të denjë të popullit dhe pa i humbur shpresat. Vazhdo të zbatosh urdhrin e Allahut, duke ftuar njerëzit që të përqafojnë teuhidin. Mos u step kur i sheh të refuzojnë që t'i binden adhurimit të Allahut dhe mungesën e dëshirës nga ana e tyre për të pranuar ftesën tënde. Dije mirë se, duke duruar përgjatë kësaj rruge, ka mirësi të shumta.

- "Ata e shohin atë larg, kurse Ne e shohim atë afër." - Kjo është një fjali dëftore, që flet për Ditën e Gjykimit, kur do të ndodhë ndëshkimi që jobesimtarët kërkojnë të përshpejtohet. Kjo ditë u duket atyre shumë larg, ashtu si ata që nuk e besojnë fare atë, të cilët janë si të dehur. Ndërsa Allahu i Lartësuar e sheh atë pranë. Allahu i Lartësuar është i Mëshirshëm dhe i Butë, nuk nxitohet në ndëshkim, por ajo që ka për të ardhur është afër.

Më pas, Allahu i Lartësuar përshkruan gjendjen e vështirë të asaj dite:

Ajetet 8 – 18

8. Ditën kur qielli të bëhet si plumb i shkrirë,
9. malet të bëhen si lesh i shprishur,
10. dhe asnjë mik të mos pyesë për mikun,
11. kur ata të shihen ndërmjet tyre. Krimineli do të dëshironte ta shpaguante dënimin e asaj dite me bijtë e vet,
12. me gruan dhe me vëllain e vet,
13. me të afërmit e tij, tek të cilët mbështetej;
14. madje, me gjithë ç'ka në tokë, vetëm për të shpëtuar!



15. **Jo, kurrsesi! Ajo është *Ledhá*,**
16. **që ta shkul lëkurën e kokës.**
17. **Ai zjarr thërret atë që është sprapsur e larguar,**
18. **atë që vetëm grumbullonte dhe fshihte.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Ditën kur qielli të bëhet si plumb i shkrirë..." – Siç kuptohet, atë ditë qielli do të çahet dhe tmerri do të arrijë kulmin.

- "...malet të bëhen si lesh i shprishur..." - Pra, malet do të shpërbëhen dhe nuk do të jenë më.
Atëherë, duke qenë se tmerri i asaj dite do të jetë kaq i madh, sa do të bëjë këto krijime kaq të mëdha të shkatërrohen, si mendon se do të jetë gjendja e robit të dobët të rënduar edhe nga gjynahet dhe padrejtësitë e tij?! A nuk do të ishte e drejtë që zemra e tij të shqetësohej, të frikësohej dhe ta konsideronte atë si çështjen më të rëndësishme se çdo gjë tjetër?!
Kjo është një ngjarje shumë e madhe dhe patjetër do të vijë dita kur ajo të ndodhë. Për këtë arsye, le t'i japim rëndësinë dhe vëmendjen e merituar, para se të vijë dita kur çdokush do të frikësohet aq shumë, sa nuk do të pyesë për asnjë, përveç vetes. I Madhëruari thotë:

- "...dhe asnjë mik të mos pyesë për mikun, kur ata të shihen ndërmjet tyre." - Njeriu sheh atje mikun e vet të dikurshëm, por nuk ka asnjë merak apo mundësi që ta pyesë për gjendjen e tij. Atë ditë, askush nuk interesohet për njeri, përveçse për veten. Madje, gjendja është më e tmerrshme se kaq:

- "Krimineli do të dëshironte ta shpaguante dënimin e asaj dite me bijtë e vet, me gruan dhe me vëllain e vet, me të afërmit e tij, tek të cilët mbështetej..." - Ai do të sakrifikonte të gjithë sa u përmendën dhe të gjithë ata që në jetën e dynjasë ishin ndihma dhe mbështetja e tij. Por atë ditë askush nuk mund t'i bëjë dobi ndokujt dhe askush nuk mund të ndërmjetësojë për njeri, veçse me lejen e Zotit. Atë ditë, çështja e vetme për të gjithë është vetvetja.

- "...edhe me gjithë ç'ka në tokë, vetëm për të shpëtuar!" - Edhe nëse do të mund ta paguante shpëtimin nga ndëshkimi i Zotit me gjithçka që ndodhet në tokë, ai që meriton ndëshkimin nuk do mund të shpëtojë.

- "Jo, kurrsesi! Ajo është *Ledhá*, që ta shkul lëkurën e kokës." - Ata nuk kanë asnjë mundësi dhe mjet për t'i shpëtuar

ndëshkimit. Ka marrë fund fjala dhe gjykimi i Allahut të Lartësuar se të prishurit nuk kanë për të besuar, prandaj do të vuajnë ndëshkimin. Askush nuk mund t'i ndihmojë apo t'u largojë ndëshkimin atyre: as miqtë, as të afërmit. Ajo nuk është dita kur dikush mund të bëjë dobi. I shpëtuar është vetëm ai që Allahu e mëshiron.

Ajo që i pret është *Ledhá*, zjarri që i shkrin gjymtyrët e jashtme dhe të brendshme të trupit, nga nxehtësia e madhe. Ky do të jetë ndëshkimi i tyre i madh dhe i padurueshëm.

- "Ai zjarr thërret atë që është sprapsur e larguar, atë që vetëm grumbullonte dhe fshihte." - Ky zjarr thërret për të futur brenda dhe për të djegur këdo që është sprapsur nga pasimi i të vërtetës dhe që i ka kthyer shpinën asaj, këdo që kishte si qëllim të jetës vetëm grumbullimin e pasurisë, të cilën e fshihnte, që të mos shpenzonte për hir të Allahut.

Ajetet 19 – 35

19. Pa dyshim, njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm.
20. Kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi.
21. Ndërsa, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac.
22. Përveç atyre që falen,
23. të cilët janë të vazhdueshëm në faljen e namazit të tyre.
24. Edhe përveç atyre që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar
25. për lypësin dhe për nevojtarin.
26. Edhe përveç atyre që e besojnë me siguri të plotë Ditën e Gjykimit,
27. dhe atyre që prej dënimit të Zotit të tyre frikësohen.
28. Nuk ka dyshim se prej dënimit të Zotit të tyre nuk ka shpëtim.
29. Përjashtohen edhe ata që e ruajnë ndershmërinë e vet,
30. dhe shkojnë veç me gratë e veta ose me robëreshat që kanë në zotërim, për të cilat nuk fajësohen.
31. Ndërsa ata që kërkojnë më tepër, ata janë të shfrenuarit.
32. Edhe ata të cilët janë besnikë ndaj amanetit që u është besuar dhe ndaj premtimit të dhënë.
33. Edhe ata që dëshminë e vet nuk e fshehin.
34. Edhe ata që ndaj namazit të tyre janë të kujdesshëm.
35. Të gjithë këta janë në Xhenete, të nderuar.

Shpjegimi i ajeteve

- "Pa dyshim, njeriu është i prirur të jetë i padurueshëm." - Kjo është një cilësi e natyrës njerëzore, e cila shpjegohet më pas:

- "Kur e godet ndonjë e keqe, ai ankohet së tepërmi." - Kur e kap varfëria ose ndonjë sëmundje, ose kur humbet ndonjë të dashur, fëmijë, familjar apo edhe pasuri, ai nuk bën durim e nuk kënaqet me caktimin e Allahut të Lartësuar, por ankohet.

- "Ndërsa, kur e gjen e mira, ai bëhet tepër koprrac." – Domethënë, ai nuk shpenzon nga ato që i ka dhuruar Allahu dhe nuk e falënderon Allahun për mirësitë e Tij. Kështu, kur e kap e keqja, nuk duron, ndërsa kur i vjen e mira, nuk falënderon dhe nuk e shpërndan mirësinë e tij tek të tjerët.

Por nuk janë të tillë disa njerëzi të tjerë, të cilët kanë disa cilësi të vyera. Kur i vjen e mira, ata falënderojnë Allahun dhe shpenzojnë për hir të Tij, ndërsa kur i godet e keqja, ata bëjnë durim dhe llogarisin shpërblimin e Allahut të Lartësuar. Më pas,

Allahu i Madhërishëm na sjell cilësitë e këtyre të zgjedhurve:

- "Përveç atyre që falen..." - Përjashtim bëjnë vetëm ata që falin namaz, të cilët kanë cilësitë e mëposhtme. Kur i vjen e mira, ata tregojnë mirënjohje dhe e lavdërojnë Allahun e Lartësuar. Në shenjë mirënjohjeje dhe adhurimi ndaj Allahut të Madhërishëm, ata shpenzojnë prej mirësive me të cilat Ai i ka begatuar. Ndërsa kur goditen nga fatkeqësia, ata bëjnë durim dhe shpresojnë shpërblimin e Allahut të Madhërishëm, duke u kënaqur me caktimin e Tij për ta.

Më poshtë, Allahu i Madhërishëm vijon me cilësitë e tjera të këtyre të zgjedhurve:

- "...të cilët janë të vazhdueshëm në faljen e namazit të tyre." - Ata janë të vazhdueshëm në faljen e namazit, duke qenë të kujdesshëm në plotësimin e kushteve, detyrave dhe veprave të pëlqyeshme dhe plotësuese të tij. Ata kujdesen që të jenë korrekt me kohët e namazit. Nuk janë si ata që nuk e falin namazin apo e falin në disa kohë dhe e braktisin në kohë të tjera, dhe as si ata që e falin me mangësi.

- "Edhe përveç atyre që në pasurinë e vet kanë ndarë një pjesë të caktuar për lypësin dhe për nevojtarin." - Ata veçojnë vazhdimisht prej pasurive të tyre një pjesë të caktuar, për ta shpenzuar për hir të Allahut. Ata japin për të plotësuar detyrimin fetar, por edhe në formë sadakaje. Ata tregohen bamirës ndaj krijesave, duke ndihmuar lypësit dhe të skamurit që nuk lypin, të cilët nuk i dallon dot që kanë nevojë.

- "Edhe përveç atyre që e besojnë me siguri të plotë Ditën e Gjykimit..." - Këta besojnë plotësisht gjithçka për të cilën i ka lajmëruar Allahu i Madhërishëm dhe gjithçka për të cilën kanë njoftuar profetët e Tij. Allahu i Lartësuar dhe profetët e Tij kanë njoftuar për Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë me drejtësi, dhe besimtarët e besojnë me siguri të plotë këtë. Ky besim i bën ata të përpiqen seriozisht dhe të përgatiten për atë ditë. Ata punojnë për atë ditë, ashtu sikurse janë udhëzuar nga Allahu i Madhërishëm dhe profetët e Tij. Besimi i plotë në ditën e Llogarisë nënkupton edhe besimin e plotë në profetët e Zotit dhe në shpalljet hyjnore, të cilat Ai ua shpalli atyre, si udhëzim për njerëzimin, që të mësojnë si të përgatiten për atë ditë.

- "...dhe atyre që prej dënimit të Zotit të tyre frikësohen." – Kjo frikë dhe respekt për të Madhërishmin i bën që vazhdimisht të jenë të kujdesshëm dhe t'i largohen çdo fjale e veprimi që i çon drejt dënimit dhe zemërimit të të Madhërishmit.

- "Nuk ka dyshim se prej dënimit të Zotit të tyre nuk ka shpëtim." - Ndëshkimi i të Drejtit është i tillë që vërtet duhet t'i frikësohesh dhe ruhesh. Askush nuk mund të pretendojë se është i sigurt nga ndëshkimi i Zotit të tij, përderisa jeton në këtë dynja. Të gjithë janë të sprovuar dhe mund të bien në gabime, që të meritojnë ndëshkimin e të Drejtit.

- "Përjashtohen edhe ata që e ruajnë ndershmërinë e vet..." - Ata janë të kujdesshëm dhe të ruajtur, për sa i përket nderit dhe moralit të tyre. Ata nuk e kënaqin epshin me marrëdhënie jashtë martese, me homoseksualitet, me bashkëshorten në rrugë anale apo në kohën e periodave të saj etj.

Gjithashtu, ata janë të kujdesshëm edhe me vështrimet dhe prekjet e tyre, duke mos u futur në haram. Ata u largohen të gjitha mjeteve dhe rrugëve që të afrojnë në harame. Ata janë plotësisht të rregullt dhe i plotësojnë dëshirat veçse me mënyrat e lejuara nga Zoti i tyre.

- "...dhe shkojnë veç me gratë e veta ose me robëreshat që kanë në zotërim, për të cilat nuk fajësohen." - Ata kufizohen vetëm me bashkëshortet dhe me robëreshat që i kanë në pronësinë e tyre, sepse këto janë të lejuara nga Zoti. Ata kënaqen me to sipas mënyrave të lejuara nga Allahu i Madhërishëm.

- "Ndërsa ata që kërkojnë më tepër, ata janë të shfrenuarit." - Por ata që e teprojnë dhe kërkojnë të kënaqin dëshirat e tyre përtej këtij kufiri, pra, përtej grave dhe robëreshave, ata konsiderohen si të shfrenuar, që e kalojnë cakun e Zotit.

Ky ajet është tregues i ndalimit të martesës së përkohshme (*el mut'ate*) me marrëveshje nga të dyja palët, sepse në këtë lloj martese femra nuk konsiderohet as bashkëshorte me të drejta të plota si e tillë dhe as si skllave. Ky është shfrytëzim i femrës me një mënyrë jo të lejuar nga Allahu i Lartësuar. Mënyra e lejuar nga i Madhërishmi është ose bashkëshortësia, që ka kushtet e saj të përcaktuara, të cilat martesa *el mut'ate* nuk i plotëson, ose pronësia mbi një grua, si skllave e jotja.

- "Edhe ata të cilët janë besnikë ndaj amanetit që u është besuar dhe ndaj premtimit të dhënë." - Ata janë shumë të kujdesshëm për t'i plotësuar këto gjëra, duke mos u treguar kurrë neglizhentë ndaj tyre.

Këtu bëhet fjalë për të gjitha llojet e amaneteve të marra dhe premtimeve që robi i ka dhënë Zotit të tij, për të cilët do të mbajë përgjegjësi. Ata që janë besimtarë nuk i harrojnë kurrë këto premtime dhe amanete. Gjithashtu, robi mund të marrë e japë premtime dhe amanete edhe me njerëzit e tjerë, në lidhje me pasurinë ose me çështje të tjera. Për çdo premtim dhe amanet, njeriu do të merret në përgjegjësi dhe do të pyetet nga Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Urtë: a i plotësoi ato, apo i shkeli?

- "Edhe ata që dëshminë e vet nuk e fshehin." - Ata dëshmojnë veçse për atë gjë rreth të cilës kanë dije të plotë dhe të sigurt. Ata nuk shtojnë dhe as pakësojnë më tepër se kaq në dëshmitë që sjellin. Ata, gjithashtu, nuk e fshehin kurrë dëshminë e tyre, për asnjë arsye në këtë botë. Ata dëshmojnë me drejtësi, edhe nëse është kundër të dashurve, të afërmve dhe miqve të tyre në dynja, sepse qëllimi kryesor i tyre është kënaqësia e Allahut të Lartësuar. E si mund të veprojnë dhe të mendojnë ndryshe, kur i Madhërishmi thotë: "Dëshmoni me drejtësi, për hir të Allahut!" Ose: "O ju që keni besuar, të jeni përherë dëshmues të së drejtës për hir të Allahut, edhe nëse kjo është kundër vetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve tuaj..." [Nisa, 135].

- "Edhe ata që ndaj namazit të tyre janë të kujdesshëm." - Ata që kujdesen shumë për namazin, duke qenë të vazhdueshëm dhe të rregullt në kryerjen e tij.

- "Të gjithë këta janë në Xhenete, të nderuar." – Të tillët janë në Xhenete, të nderuar dhe të begatuar.

Allahu i Lartësuar ka për t'u dhuruar privilegje dhe mirësi të përjetshme, gjëra që i dëshirojnë dhe që iu kënaqen sytë. Ata do të jenë të përjetshëm në Xhenet, me lumturi e kënaqësi të pandërprera.

Në gjithë këto ajete, Allahu i Lartësuar na përshkroi të lumturit dhe fatbardhët, me cilësitë dhe veprat e tyre të mrekullueshme. Ata kanë virtyte të larta dhe janë adhurues të rregullt të Allahut. Ata bëjnë adhurime të dukshme, siç është namazi, por edhe adhurime të zemrës, siç është frikë-respekti ndaj të Madhërishmit, që i udhëzon te veprat e fjalët e mira. Ata e adhurojnë Allahun e Lartësuar edhe me pasurinë e tyre, duke u treguar bamirës ndaj krijesave. Dija dhe besimi i tyre janë të pastër dhe të dobishëm. Morali i tyre është i përsosur. Sjellja e tyre ndaj Allahut dhe ndaj krijesave të Allahut është më e mira dhe më e dobishmja. Ata dinë të mbajnë premtimet e amanetet. Ata dëshmojnë me drejtësi dhe dije të plotë. Ata janë njerëzit më të ndershëm dhe më të dëlirë, sepse qëndrojnë brenda kufijve që Zoti ka vendosur. Vetëm me të tillë njerëz përhapet lumturia dhe rregulli në tokë.

Ajetet 36 – 39

36. Ç'është me ata që nuk besojnë, të cilët pandërprerë zgjasin shikimet drejt teje
37. e që sorollaten në grupe, djathtas e majtas teje?
38. A mos duan që të hyjnë në Xhenetin e begatshëm?!
39. Kurrsesi! Ne i krijuam ata prej asaj që ata e dinë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ç'është me ata që nuk besojnë, të cilët pandërprerë zgjasin shikimet drejt teje e që sorollaten në grupe, djathtas e majtas teje?" – Kuptimi: Ç'është me mohuesit, të cilët ngulin shikimet drejt teje?! Ç'është me ta, që grupohen majtas dhe djathtas teje dhe të vështrojnë ngultas?! Ata shpërfillin ftesën tënde dhe vetëkënaqen me atë rrugë që kanë zgjedhur për veten e tyre.


- "A mos duan që të hyjnë në Xhenetin e begatshëm?!" – Mos, vallë, ata pretendojnë që të fitojnë Xhenetin? Çfarë vepre kanë bërë ata, që të shpresojnë të hyjnë në Xhenetin e mirësive të përjetshme? Ata nuk kanë përgatitur gjë tjetër për veten, veç mohimit të së vërtetës dhe mosbesimit në Zotin e botëve. Ata shpërfillin mesazhin e Tij, të sjellë nëpërmjet Profetit, prandaj nuk meritojnë që të hyjnë në Xhenetin e mirësive të përjetshme. Për këtë arsye, i Lartësuari thotë:

- "Kurrsesi! Ne i krijuam ata prej asaj që ata e dinë." – Përkundrazi, çështja nuk qëndron sikurse ëndërrojnë jobesimtarët. Ata kurrë nuk kanë për ta arritur me forcat e tyre atë që dëshirojnë. Ne i kemi krijuar ata prej një lloj lëngu, që hidhet me forcë, sikurse thotë i Lartësuari: "Le të shikojë njeriu se prej çfarë është krijuar? Ai është krijuar prej një lloj lëngu, që hidhet fuqishëm e që del nga mesi i shpinës dhe dërrasa e gjoksit." [Tarik 5-7]. Ata janë shumë të dobët dhe nuk kanë as më të voglën mundësi për t'i bërë dobi vetes apo për ta dëmtuar atë. Ata nuk kanë mundësi të japin jetë dhe vdekje dhe as të ringjallin, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Mirëpo ata (idhujtarët), në vend të Tij, adhuruan zota të tjerë, të cilët nuk krijuan asgjë, sepse ata edhe vetë janë të krijuar. Ata nuk kanë në dorë për vetveten as dëm, as

dobi; ata nuk kanë në dorë as vdekje, as jetë e as ringjallje.” [Furkan 3].

Ajetet 40 – 44

40. Betohem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve, se Ne jemi të plotfuqishëm,
41. që t’i zëvendësojmë ata me të tjerë më të mirë se ata, dhe askush nuk mund të na dalë para Ne.
42. Por ti lëri ata të zhyten edhe më thellë dhe le të dëfrehen, derisa të përjetojnë Ditën e tyre, që iu është paralajmëruar;
43. ditën kur, duke u ngutur, do të dalin prej varreve, sikur të ishin duke nxituar drejt idhujve të tyre.
44. Të përulura do jenë shikimet e tyre. Ata do t’i ketë kapluar poshtërimi. Kjo është dita që iu është premtuar!



Shpjegimi i ajeteve

- “Betohem në Zotin e lindjeve dhe të perëndimeve, se Ne jemi të plotfuqishëm, që t’i zëvendësojmë ata me të tjerë më të mirë se ata...” - Allahu i Madhëruar betohet në Veten e Tij, duke përmendur se Ai është Zoti i lindjeve dhe perëndimeve. Allahu është Zoti i lindjeve dhe perëndimeve të shumta: të diellit, hënës dhe yjeve, të cilat janë shenja madhështore dhe bindëse, që tregojnë vërtetësinë e ringjalljes dhe pushtetin e plotë të Allahut të Madhërishëm për t’i rikrijuar gjërat. Ai që i krijoi nga hiçi me këtë rregull madhështor, është i plotfuqishëm që t’i krijojë ato sërish nga çfarë mbetet prej tyre. I Madhëruari thotë më tej:

- “...dhe askush nuk mund të na dalë para Ne.” – Kuptimi: Askush nuk mund të na dalë Ne para, të na shpëtojë apo të shmanget nga rikrijimi. Nëse Ne duam t’i rikrijojmë, askush nuk mund të na pengojë apo t’i shmanget rikrijimit. Ne të gjitha këto ka argumente për vërtetësinë dhe sigurinë e ringjalljes dhe llogarisë para Zotit. Por nëse ata vazhdojnë të mohojnë këtë lajm të madh, atëherë:

- “Por ti lëri ata të zhyten edhe më thellë dhe le të dëfrehen...” - Lëri ata të thellohen në fjalë dhe besime të kota dhe të paargumentuara nga i Madhërishmi. Lëri të luajnë me fenë e tyre. Lëri të dëfrehen dhe të kënaqen me ushqim, pije dhe kënaqësi të kësaj bote, derisa të ballafaqohen me ngjarjen që iu është premtuar.

- “...derisa të përjetojnë Ditën e tyre, që iu është paralajmëruar...” - Allahu i Lartësuar u ka premtuar atyre se, në Ditën e Ringjalljes dhe Shpërblimit me drejtësi, ka përgatitur

një shpagim të drejtë për talljet dhe mosbesimin e tyre të padrejtë.

Pastaj Allahu i Lartësuar flet për gjendjen e krijesave gjatë asaj dite të premtuar, që do të vijë patjetër:

- "...ditën kur, duke u ngutur, do të dalin prej varreve, sikur të ishin duke nxituar drejt idhujve të tyre." - Ata do të dalin prej varreve me të shpejtë, për t'iu përgjigjur thirrjes që do të bëhet. Ata do t'i drejtojnë vështrimet andej nga vjen thirrja, a thua se po shohin ndonjë flamur, dhe do të nxitojnë drejt tij. Pra, jo vetëm që nuk mund ta refuzojnë thirrjen, por nxitojnë drejt saj të nënshtruar, të frikësuar dhe të fiksuar pas saj.

Ata nxitojnë, për të qëndruar të frikësuar para Zotit të botëve e për të dhënë llogari para Tij:

- "Të përulura do jenë shikimet e tyre. Ata do t'i ketë kapluar poshtërimi." - Kjo ndodh sepse zemrat dhe shpirtrat e tyre i ka pushtuar frika dhe ankthi për llogarinë e vështirë dhe qëndrimin para të Plotpushtetshmit. Aq të frikësuara janë zemrat e tyre, saqë kjo u duket qartë në sy. Ata nuk lëvizin dot asnjë gjymtyrë, nga ankthi që përjetojnë. Nga goja e tyre nuk del asnjë pëshpërimë, nga frika e këtij momenti.

- "Kjo është dita që iu është premtuar!" - Kjo është dita që nuk i shpëton askush. Kjo është Dita e Premtuar, dhe Allahu i Lartësuar e mban premtimin.

Surja 71: Nuh (mekase) 28 ajete

Ajetet 1 – 4
Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!

1. Ne e dërguam Nuhun te populli i vet: "Tërhiqja vërejtjen popullit tënd, para se ata t'i godasë një dënim i dhembshëm!"
2. Ai tha: "O populli im! Unë për ju jam një paralajmërues i qartë.
3. Adhurojeni Allahun, ruhuni prej Tij dhe bindmuni mua!
4. Ai ju mbulon gjynahet tuaja dhe ju jep afat deri në një moment të caktuar. Por kur të vijë afati i caktuar prej Allahut, ai nuk shtyhet për më vonë, nëse e dini.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne e dërguam Nuhun te populli i vet: "Tërhiqja vërejtjen popullit tënd, para se ata t'i godasë një dënim i dhembshëm!"" - Allahu i Lartësuar nuk ka përmendur në këtë sure histori tjetër, veç asaj të Nuhut (a.s.), i cili punoi dhe e ftoi popullin e tij për një kohë shumë të gjatë. Për qindra vjet me radhë, ai ia përsëriste ftesën popullit të tij që ata të njësonin Allahun e Lartësuar në adhurim dhe t'i largoheshin idhujtarisë. Allahu i Lartësuar na tregon se e dërgoi Nuhun tek ai popull në shenjë mëshire për ta, për t'i paralajmëruar që të ruheshin nga ndëshkimi i dhembshëm. Ai u dërgoi atyre Nuhun (a.s.), sepse ata po vazhdonin me arrogancë dhe të shfrenuar në kufrin e tyre dhe po e bënin të pashmangshëm ndëshkimin e përjetshëm.

Nuhu (a.s.) iu bind urdhrit të Allahut të Madhërishëm dhe nisi menjëherë të ftonte popullin e tij:

- "Ai tha: "O populli im! Unë për ju jam një paralajmërues i qartë." – Kuptimi: Jam i qartë në këshillën që ju jap dhe vërejtjen që ju drejtoj. Jam i qartë në tregimin e të gjitha rrugëve nëpërmjet të cilave arrihet shpëtimi

dhe fitorja. Çdo gjë që ju keni nevojë të dini, unë jua sqaroj plotësisht.

Nuhu (a.s.) u përcolli atyre ajkën e urdhrave, që ata duhet të zbatonin:

- "Adhurojeni Allahun, ruhuni prej Tij dhe bindmuni mua!" - Ai i urdhëroi që të adhuronin Allahun dhe t'i ruheshin ndëshkimit të Tij duke e njësuar Atë në përkushtimin e adhurimeve, si dhe duke iu larguar idhujtarisë, me të gjitha rrugët e saj. Nuhu (a.s.) premtoi se nëse ata do tregoheshin të devotshëm ndaj Allahut, duke e njësuar Atë në adhurim dhe duke iu larguar idhujtarisë, Allahu i Madhërishëm do t'ua mbulonte të metat dhe do t'ua falte gjynahet. Nëse Allahu i Lartësuar të fal gjynahet dhe të mbulon mangësitë, kjo do të thotë që i ke shpëtuar ndëshkimit dhe ke fituar shpërblimin e pamatë të Bujarit të Mëshirshëm.

Gjithashtu, i Madhëruari premton se edhe në këtë botë do t'u mundësojë një jetë të mirë, deri në afatin e caktuar:

- "Ai ju mbulon gjynahet tuaja dhe ju jep afat deri në një moment të caktuar." – Pra, Ai do t'u japë një furnizim të këndshëm deri në afatin e caktuar dhe nuk do t'i shfarosë me ndëshkim.

Megjithatë, kënaqësitë e kësaj bote nuk janë të përjetshme, sepse vdekja është e pashmangshme, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Por kur të vijë afati i caktuar prej Allahut, ai nuk shtyhet për më vonë, nëse e dini." – Ajo që është përcaktuar nga i Urti do të ndodhë pakthyeshmërisht, prandaj për të duhen përgatitje serioze.

Megjithatë, pavarësisht nga kjo thirrje e gjatë dhe e qartë nga ana e Nuhut (a.s.), ata përsëri e mohuan Allahun e Madhëruar. Ata nuk iu përgjigjën ftesës së tij, duke treguar kokëfortësi, prandaj Nuhu (a.s.) iu ankua Allahut të Lartësuar:

Ajetet 5 – 9

5. Ai tha: "O Zoti im! Unë e ftova popullin tim natën dhe ditën,
6. por ftesa ime vetëm sa ia shtoi largimin.
7. Sa herë që unë i ftoja ata tek Ti, për t'ua falur gjynahet, ata i vendosnin gishtat në veshët e tyre dhe mbulonin kokat me teshat e tyre, për të vazhduar në të tyren me një arrogancë të madhe.
8. Unë i ftova ata haptazi.
9. Ua drejtova thirrjen botërisht e shumë herë edhe fshehurazi".


Shpjegimi i ajeteve

- "Ai tha: "O Zoti im! Unë e ftova popullin tim natën dhe ditën, por ftesa ime vetëm sa ia shtoi largimin." - Ftesa ime u shtoi veçse largimin nga e vërteta. Atëherë, pas kësaj kohe të gjatë dhe kësaj përgjigjeje jo të denjë, nuk ka më arsye që thirrja të vazhdojë.

Qëllimi i thirrjes është arritja e plotë ose e pjesshme e pikësynimit të saj. Por nëse nuk ndodh as njëra, as tjetra, atëherë pritet ndëshkimi.

Më pas, Nuhu ankohet nga ai popull kaq kokëfortë dhe arrogant në kufrin e tij.

- "Sa herë që unë i ftoja ata tek Ti, për t'ua falur gjynahet..." – Kuptimi: Sa herë që unë i ftoja ata në faljen Tënde të madhe, ata vazhdonin me këmbëngulje në kufrin e tyre dhe mospërfillës të së vërtetës. Nëse do t'i përgjigjeshin ftesës së Allahut, Ai do t'ua falte gjynahet. Por kufri dhe arroganca e tyre ishin të shfrenuara. Ata vazhdonin në


الجزء التاسع والعشرون سورة نوح

يُرْسِلِ ٱلسَّمَآءَ عَلَيْكُم مِّدْرَارًا ﴿١١﴾ وَيُمْدِدْكُم بِأَمْوَٰلٍ وَبَنِينَ وَيَجْعَل
لَّكُمْ جَنَّٰتٍ وَيَجْعَل لَّكُمْ أَنْهَٰرًا ﴿١٢﴾ مَّا لَكُمْ لَا تَرْجُونَ لِلَّهِ وَقَارًا ﴿١٣﴾
وَقَدْ خَلَقَكُمْ أَطْوَارًا ﴿١٤﴾ أَلَمْ تَرَوْا۟ كَيْفَ خَلَقَ ٱللَّهُ سَبْعَ سَمَٰوَٰتٍ
طِبَاقًا ﴿١٥﴾ وَجَعَلَ ٱلْقَمَرَ فِيهِنَّ نُورًا وَجَعَلَ ٱلشَّمْسَ سِرَاجًا ﴿١٦﴾
وَٱللَّهُ أَنۢبَتَكُم مِّنَ ٱلْأَرْضِ نَبَاتًا ﴿١٧﴾ ثُمَّ يُعِيدُكُمْ فِيهَا وَيُخْرِجُكُمْ
إِخْرَاجًا ﴿١٨﴾ وَٱللَّهُ جَعَلَ لَكُمُ ٱلْأَرْضَ بِسَاطًا ﴿١٩﴾ لِّتَسْلُكُوا۟ مِنْهَا
سُبُلًا فِجَاجًا ﴿٢٠﴾ قَالَ نُوحٌ رَّبِّ إِنَّهُمْ عَصَوْنِى وَٱتَّبَعُوا۟ مَن لَّمْ يَزِدْهُ
مَالُهُۥ وَوَلَدُهُۥٓ إِلَّا خَسَارًا ﴿٢١﴾ وَمَكَرُوا۟ مَكْرًا كُبَّارًا ﴿٢٢﴾ وَقَالُوا۟
لَا تَذَرُنَّ ءَالِهَتَكُمْ وَلَا تَذَرُنَّ وَدًّا وَلَا سُوَاعًا وَلَا يَغُوثَ وَيَعُوقَ
وَنَسْرًا ﴿٢٣﴾ وَقَدْ أَضَلُّوا۟ كَثِيرًا ۖ وَلَا تَزِدِ ٱلظَّٰلِمِينَ إِلَّا ضَلَٰلًا ﴿٢٤﴾
مِّمَّا خَطِيٓـَٰٔتِهِمْ أُغْرِقُوا۟ فَأُدْخِلُوا۟ نَارًا فَلَمْ يَجِدُوا۟ لَهُم مِّن دُونِ
ٱللَّهِ أَنصَارًا ﴿٢٥﴾ وَقَالَ نُوحٌ رَّبِّ لَا تَذَرْ عَلَى ٱلْأَرْضِ مِنَ ٱلْكَٰفِرِينَ
دَيَّارًا ﴿٢٦﴾ إِنَّكَ إِن تَذَرْهُمْ يُضِلُّوا۟ عِبَادَكَ وَلَا يَلِدُوٓا۟ إِلَّا فَاجِرًا
كَفَّارًا ﴿٢٧﴾ رَّبِّ ٱغْفِرْ لِى وَلِوَٰلِدَىَّ وَلِمَن دَخَلَ بَيْتِىَ مُؤْمِنًا
وَلِلْمُؤْمِنِينَ وَٱلْمُؤْمِنَٰتِ ۗ وَلَا تَزِدِ ٱلظَّٰلِمِينَ إِلَّا تَبَارًا ﴿٢٨﴾
٥٧١

rrugën e kotësisë dhe të largimit nga e vërteta. Ja cili qe reagimi i tyre:

- "...ata i vendosnin gishtat në veshët e tyre dhe mbulonin kokat me teshat e tyre, për të vazhduar në të tyren me një arrogancë të madhe." - Ata refuzuan që ta dëgjonin se çfarë u thoshte profeti Nuh (a.s.). Për këtë, ata mbulonin kokën me rrobat e tyre. Ata këmbëngulnin në rrugën e humbjes. Me mendjemadhësi, ata u larguan nga e vërteta dhe e shtuan sherrin e tyre.

- "Unë i ftova ata haptazi. Ua drejtova thirrjen botërisht e shumë herë edhe fshehurazi". - Nuhu u foli haptazi, që të dëgjonin të gjithë, por edhe fshehtazi ose në veçanti. Ai u përpoq me të gjitha mënyrat, me të cilat mendonte se do t'i bënte ata të dëgjonin dhe besonin.

Nuhu (a.s.) u bëri edhe disa premtime të mrekullueshme, nëse ata do të bindeshin, duke u thënë:

Ajetet 10 – 20

10. Unë u thashë: "Kërkojini falje Zotit tuaj, se Ai vërtet është Falës i madh.
11. Ai do t'ju lëshojë nga qielli shi me bollëk,
12. do t'ju begatojë me pasuri dhe fëmijë, do t'ju mundësojë të keni kopshte dhe lumenj.
13. Ç'është kështu me ju, që nuk i shprehni Allahut madhërinë që e meriton,
14. kur Ai ju krijoi në disa etapa?!
15. A nuk e shihni se si Allahu ka krijuar shtatë qiej, palë-palë.
16. Dhe në ta, hënën e bëri dritë e diellin e bëri ndriçues.
17. Allahu ju nxori ju prej tokës, si bimë.
18. Pastaj ju kthen në të, për t'ju nxjerrë sërish.
19. Allahu e bëri tokën shtrojë për ju,
20. që nëpër të, të ecni rrugëve të gjera".

Shpjegimi i ajeteve

- "Unë u thashë: "Kërkojini falje Zotit tuaj, se Ai vërtet është Falës i madh." – Kuptimi: Lërini gjynahet dhe kërkojini falje Allahut të Lartësuar. Nëse e bëni këtë, ta dini dhe të jeni të sigurt se Allahu i Lartësuar fal shumë. Ai e fal atë që pendohet dhe i kërkon faljen Atij.

Pra, Nuhu (a.s.) i ftoi ata që pendoheshin dhe premtoi se Allahu do t'ua falte gjynahet dhe do t'u jepte shumë të mira, të cilat ua ka premtuar të gjithë atyre që u largohen gjynaheve, që pendohen dhe kërkojnë falje.
Nuhu (a.s.) u premtoi, gjithashtu, edhe shumë mirësi të kësaj jete, me shpresë që ata

të ktheheshin te lumturia që sjell besimi dhe pendimi tek i Madhëruari. Ai u tha:

- "Ai do t'ju lëshojë nga qielli shi me bollëk..." - Do t'ju dhurojë shi të vazhdueshëm, kohë pas kohe, që të mbushë rezervat tuaja ujore dhe të shtojë prodhimet tuaja. Me të, Ai i jep jetë tokës suaj.

- "...do t'ju begatojë me pasuri dhe fëmijë..." – Do t'ju shtojë pasurinë, fëmijët e çdo mirësi të kësaj dynjaje.

- "...do t'ju mundësojë të keni kopshte dhe lumenj." - Të gjitha këto që u përmendën janë mirësitë më të mëdha që mund të synojë dhe arrijë njeriu në dynja.

- "Ç'është kështu me ju, që nuk i shprehni Allahut madhërinë që e meriton..." - Ç'është me ju, që nuk e kuptoni madhështinë e të Lartësuarit dhe nuk frikësoheni prej Tij? A nuk keni në zemrat tuaja asnjë shenjë të madhërimit të Allahut të Lartësuar?! A nuk mendoni pak në fazat e krijimit tuaj?!

- "...kur Ai ju krijoi në disa etapa?!" - Është Allahu i Lartësuar Ai që ju krijoi dhe që përkujdeset për ju në çdo moment të jetës tuaj. Ai ju krijoi dhe formësoi në barkun e nënës. Pastaj vjen koha e mëkimit në gji, më pas fëmijëria, pastaj adoleshenca, mosha e pjekurisë, e kështu me radhë; në çdo kohë, është i Lartësuari që përkujdeset e që ju mëshiron. Ai është i vetmi që krijon dhe që përkujdeset për krijesat, me mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse dhe madhështore. Për këtë arsye, Ai duhet të jetë i vetmi që duhet të njësohet në përkushtimin e adhurimeve.

Duke u përkujtuar krijesave krijimin e tyre të parë, Allahu i Lartësuar u tërheq vërejtjen se Ai është i plotfuqishëm që t'i ringjallë dhe t'i rikrijojë sikurse kanë qenë. Ai që i krijoi nga hiçi, kur nuk ekzistonin fare, është i plotfuqishëm që t'i krijojë nga mbetjet e tyre në tokë, pasi të kenë vdekur.

Më pas, Allahu i Lartësuar u argumenton atyre për ringjalljen edhe me madhështinë e krijimit të qiejve dhe të tokës:

- "A nuk e shihni se si Allahu ka krijuar shtatë qiej, palë-palë." - Ai i krijoi qiejt me kate, njëri mbi tjetrin.

- "Dhe në ta, hënën e bëri dritë e diellin e bëri ndriçues." – Këtu flitet për madhështinë e krijimit dhe për dobitë e shumta që Allahu i Lartësuar u ka dhuruar krijesave me këto trupa qiellorë. Dielli dhe hëna janë shumë të nevojshëm për tokën dhe jetën në të. Kjo tregon për mëshirën e Allahut të Lartësuar dhe Bujar, për bamirësinë e Tij të gjerë. Kësisoj, Ai që është Madhështor, i Gjithëmëshirshëm dhe Bamirës është detyrë që të njësohet me adhurim, dashuri, mirënjohje, por edhe me frikërespekt për llogarinë e Tij të drejtë dhe shpresë për shpërblimin e Tij të madh.

- "Allahu ju nxori ju prej tokës, si bimë. Pastaj ju kthen në të, për t'ju nxjerrë sërish." – Kuptimi: Allahu ju krijoi prej tokës, sikurse bari mbin prej tokës. (Këtu bëhet fjalë për Ademin, pasardhës i të cilit është i gjithë njerëzimi).
Pastaj përsëri do të ktheheni në tokë, kur të vdisni. Pas vdekjes, Ditën e Gjykimit, Allahu do t'ju nxjerrë përsëri të gjallë, për t'ju gjykuar me drejtësi.

- "Allahu e bëri tokën shtrojë për ju, që nëpër të, të ecni rrugëve të gjera." - Është Allahu i Lartësuar që e bëri tokën të përshtatshme për ju dhe lehtësisht të shfrytëzueshme, që të përfitoni prej saj. Nëse nuk do ta bënte të tillë, ju nuk do të mund të lëviznit lehtësisht nëpër të, nuk mund të punonit, plugonit, mbillnit, ndërtonit apo edhe të qëndronit mbi të.

Pas përmendjes së këtyre argumenteve, Nuhu ankohet te Zoti i tij:

Ajetet 21 – 25

21. Nuhu tha: "O Zoti im! Ata nuk m'u bindën mua, por shkuan pas atyre, të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre u shtuan veçse dëshpërim,
22. dhe të cilët u kurdisën kurthe shumë të mëdha.
23. Ata u thanë: "Kurrë mos i braktisni zotat tuaj! Mos e braktisni Ueddën, as Suvânë, as Jeguthën, Jeûkën dhe Nesrën".
24. Ata zhytën në humbje shumë pasues të tyre. Prandaj, të padrejtëve Ti shtoju veçse humbje!"
25. Për shkak të gjynaheve të tyre, ata u përmbytën dhe u hodhën në zjarr. Ata nuk gjetën ndihmës, që t'i shpëtonin prej Allahut.

Shpjegimi i ajeteve

- "Nuhu tha: "O Zoti im! Ata nuk m'u bindën mua, por shkuan pas atyre, të cilëve pasuria dhe fëmijët e tyre u shtuan veçse dëshpërim..." - I gjithë ky kështillim nuk vleu aspak për ata. Ata nuk iu bindën urdhrave që Profeti përcillte prej Allahut. Ata kundërshtuan Profetin besnik, që i këshillonte për të mirën dhe u mësonte si të ruheshin nga e keqja. Ata ndoqën parinë e tyre, pasuritë dhe fëmijët e të cilëve u shtonin veçse humbjen dhe dështimin në arritjen e të mirave.

Kur kjo ishte gjendja e udhëheqësve, si do të ishte, vallë, gjendja e pasuesve? Sigurisht, ata do të ishin më të dështuar e më të humbur se zotërinjtë e tyre.

- "...dhe të cilët u kurdisën kurthe shumë të mëdha." - Ata luftonin me çdo formë të vërtetën dhe me kryeneçësi pengonin njerëzit nga rruga e drejtë. Ata ngrinin kurthe të mëdha kundër të vërtetës dhe bartësve të saj. Ata ftonin besimtarët në idhujtari, duke ua zbukuruar atë me fjalë dhe sllogane, me të cilat mashtronin veten dhe të tjerët.

- "Ata u thanë: "Kurrë mos i braktisni zotat tuaj! Mos e braktisni Ueddën, as Suvânë, as Jeguthën, Jeûkën dhe Nesrën"." - Ata ftonin në idhujtari, ku ishin edhe vetë të zhytur, dhe që të mos braktisnin traditën e të parëve të tyre të vjetër. Madje, ua përmendnin edhe me emra idhujt e tyre duke thënë:

- "Ata u thanë: "Kurrë mos i braktisni zotat tuaj! Mos e braktisni Ueddën, as Suvânë, as Jeguthën, Jeûkën dhe Nesrën"." - Të gjithë këta ishin emra të njerëzve të mirë të popullit të Nuhut. Pas vdekjes së tyre, Shejtani i joshi me idenë që ata t'i pikturonin dhe gdhendnin figurat e tyre, me pretendimin që kjo do t'i nxiste më shumë për adhurimin e Zotit. Por pasi kaluan vite e vite, pasi ikën brezat e parë dhe erdhën breza të tjerë njerëzish, Shejtani u tha: "Të parët tuaj i adhuronin këto statuja e piktura dhe u kërkonin të ndërmjetësonin tek Allahu. Nëpërmjet tyre, ata kërkonin shiun dhe çdo të mirë tjetër." Dhe kështu filloi

adhurimi i idhujve. Brezat kalonin dhe porosisnin njëri-tjetrin që të mos hiqnin dorë nga idhujtaria. Të njëjtën gjë bënë edhe mohuesit e kohës kur jetoi Nuhu (a.s.).

- "Ata zhytën në humbje shumë pasues të tyre." - Këta udhëheqës dhe prijës, me ftesën që u bënin pasuesve të tyre, humbën dhe devijuan shumë njerëz nga rruga e drejtë e adhurimit të një Zoti të vetëm.

Udhëheqësit e humbur devijuan shumë e shumë breza, prandaj e meritonin atë që tha Nuhu (a.s.) më pas:

- "...Prandaj, të padrejtëve Ti shtoju veçse humbje!" – Kuptimi: Këtyre zullumqarëve, që nuk u japin profetëve hakun që u takon, veçse humbje shtoju! Ata dëgjonin vetëm udhëheqësit e tyre dhe shpërfillnin profetët e Zotit, dhe për sa kohë që ata shpërfillin profetët dhe Shpalljen e Zotit, nuk ka asnjë shpresë udhëzimi për ta në rrugën e drejtë.

Më pas, i Madhërishmi përmend ndëshkimin e tyre në këtë jetë dhe në jetën tjetër duke thënë:

- "Për shkak të gjynaheve të tyre, ata u përmbytën dhe u hodhën në zjarr." – Që në këtë jetë, ata u mbytën me ujë, që i përfshiu nga të gjitha drejtimet. Trupat e tyre i përpiu uji, por shpirtrat u përvëluan në zjarr. Kjo ndodhi për shkak të gjynaheve të tyre, për të cilat Profeti i paralajmëroi dhe i urdhëroi që t'i braktisnin dhe të kërkonin falje.

Nuhu (a.s.) ua bëri të qartë rrezikun e këmbënguljes në mohim dhe mosbindje, por ata e shpërfillën, prandaj i kapi ndëshkimi i ashpër, prej të cilit nuk mund të shpëtonin. E kush mund t'i ndihmonte të shpëtonin?!

- "Ata nuk gjetën ndihmës, që t'i shpëtonin prej Allahut." - Askush nuk mund t'i ndihmonte kur ndëshkimi po ekzekutohej. Askush nuk mund ta ndalojë a kthejë pas gjykimin, përcaktimin dhe vendimin e të Plotpushtetshmit.

Ajetet 26 – 28

26. Nuhu tha: "O Zoti im! Mos lër mbi tokë asnjë nga jobesimtarët!
27. Sepse, nëse Ti i lë, ata do t'i devijojnë adhuruesit e Tu, dhe se prej tyre do të lindin veçse të shfrenuar dhe jobesimtarë!
28. O Zoti im! Më fal mua, prindërit e mi, ata që hynë në shtëpinë time si besimtarë dhe të gjithë besimtarët e besimtaret! Ndërsa jobesimtarëve shtoju veçse dëshpërim!".


Shpjegimi i ajeteve

- "Nuhu tha: "O Zoti im! Mos lër mbi tokë asnjë nga jobesimtarët!" – Kështu, Nuhu (a.s.) i mallkoi mohuesit dhe i kërkoi Allahut të Lartësuar që të mos linte asnjë qafir të vërtitej nëpër tokë. Pra, u lut që Allahu t'i shfaroste ata plotësisht. Shkaku i këtij mallkimi ishte se:

- "...nëse Ti i lë, ata do t'i devijojnë adhuruesit e Tu, dhe se prej tyre do të lindin veçse të shfrenuar dhe jobesimtarë!" - Lënia e tyre gjallë sjell vetëm dëme dhe shkatërrime, për ta dhe për të tjerët.

Nuhu (a.s.) bëri këtë lutje sepse, duke qëndruar gjatë mes tyre, ai ua njohu mirë veprat e shfrenuara dhe devijuese, dhe kështu gjykoi se prej tyre nuk pritej më asnjë e mirë.

Pa dyshim, Allahu i Lartësuar e plotësoi lutjen e Nuhut dhe i mbyti ata të gjithë në


الجزء التاسع والعشرون سورة الجن

سورة الجن

بسم الله الرحمن الرحيم

الجزء ٥٨

قل أوحي إلي أنه استمع نفر من الجن فقالوا إنا سمعنا قرءانا
عجبا ١ يهدي إلى الرشد فآمنا به ولن نشرك بربنا أحدا ٢
وأنه تعالى جد ربنا ما اتخذ صاحبة ولا ولدا ٣ وأنه كان
يقول سفيهنا على الله شططا ٤ وأنا ظننا أن لن تقول الإنس
والجن على الله كذبا ٥ وأنه كان رجال من الإنس يعوذون برجال
من الجن فزادوهم رهقا ٦ وأنهم ظنوا كما ظننتم أن لن يبعث
الله أحدا ٧ وأنا لمسنا السماء فوجدناها ملئت حرسا
شديدا وشهبا ٨ وأنا كنا نقعد منها مقاعد للسمع فمن
يستمع الآن يجد له شهابا رصدا ٩ وأنا لا ندري أشر أريد
بمن في الأرض أم أراد بهم ربهم رشدا ١٠ وأنا منا الصالحون
ومنا دون ذلك كنا طرائق قددا ١١ وأنا ظننا أن لن نعجز
الله في الأرض ولن نعجزه هربا ١٢ وأنا لما سمعنا الهدى
آمنا به فمن يؤمن بربه فلا يخاف بخسا ولا رهقا ١٣

٥٧٢

1. **Thuaj: "Mua më është shpallur se një grup xhindësh mbajtën vesh dhe thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kuran të çuditshëm.**

2. **Ai udhëzon tek e vërteta, prandaj i besuam atij dhe kurrë nuk do të adhurojmë gjë tjetër, veç Zotit tonë..**

3. **Pa dyshim, lartësia dhe madhështia e Zotit tonë nuk lejon që Ai të ketë grua apo fëmijë.**

4. **S'ka dyshim se ai mendjelehti ynë thoshte gënjeshtra të mëdha ndaj Allahut.**

5. **Ndërsa ne mendonim se as njerëzit, as xhindët nuk mund të thonin gënjeshtra për Allahun.**

6. **Ka pasur burra prej njerëzve, që u kërkonin ndihmë disa burrave prej xhindëve, duke ua shtuar kështu edhe më tepër arrogancën.**

7. **Dhe ata mendonin, siç mendoni edhe ju, se Allahu nuk ka për të ringjallur asnjë.**

ujë. Ata që shpëtuan ishin Nuhu dhe besimtarët që pasuan atë.

- "O Zoti im! Më fal mua, prindërit e mi, ata që hynë në shtëpinë time si besimtarë dhe të gjithë besimtarët e besimtaret! Ndërsa jobesimtarëve shtoju veçse dëshpërim!" – Me kategoritë e para që përmendi në lutjen e tij, Nuhu (a.s.) tregoi rëndësinë dhe gradën e tyre dhe faktin që ata janë njerëzit më parësorë për t'u bërë mirësi dhe për t'u lutur. Më pas, ai e përgjithësoi lutjen, duke futur të gjithë besimtarët dhe besimtaret. Ndërsa për jobesimtarët, ai u lut që Allahu i Lartësuar t'u shtonte atyre veçse dëshpërim e shkatërrim.

Surja 72: El Xhinn (mekase) 28 ajete
Ajetet 1 – 7
Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "Mua më është shpallur se një grup xhindësh mbajtën vesh..." - Allahu i Lartësuar e porosit Profetin e Tij që t'u rrëfejë njerëzve për ngjarjen që kishte ndodhur. Kështu, Allahu i Lartësuar u mundësoi disa xhindëve që të dëgjonin ajetet e Kuranit, me qëllim që edhe ata të ballafaqoheshin me argumentet e tij dhe t'u jepej mundësia për të pranuar mirësinë dhe udhëzimin e tij. Allahu i Lartësuar lejoi që ata të shkonin dhe të dëgjonin Profetin (a.s.) duke lexuar Kuran, që ata të dëgjonin udhëzimin hyjnor dhe të ktheheshin te populli i tyre si paralajmërues të ndëshkimit dhe përgëzues të shpërblimit. Allahu i Lartësuar urdhëroi Profetin e Tij që t'ua tregonte njerëzve këtë histori.

Xhindët heshtën dhe dëgjuan me kujdes Kuranin. Ata arritën të kuptonin urtësitë

dhe vërtetësitë e tij, të cilat depërtuan në zemrat e tyre.

- "...dhe thanë: "Ne kemi dëgjuar një Kuran të çuditshëm." - Ata dëgjuan çudira, që ishin shumë të shtrenjta dhe ambicioze.

- "Ai udhëzon tek e vërteta..." - Domethënë, që udhëzon njerëzit të arrijnë dhe plotësojnë mirësitë dhe synimet e fesë dhe dynjasë së tyre.

- "...prandaj i besuam atij dhe kurrë nuk do të adhurojmë gjë tjetër, veç Zotit tonë." – Ata bënë për vete imanin, i cili përfshin të gjitha veprat e mira, dhe devotshmërinë, që nënkupton lënien e të këqijave, në krye të të cilave është *shirk*-u.

Nga kjo kuptojmë se shtysa drejt imanit ishin pikërisht ato që dëgjuan nga Kurani, pra, udhëzimet dhe mësimet e vyera të tij. Udhëzimet e Kuranit për arritjen e mirësisë dhe për ruajtjen nga e keqja janë të qarta dhe të padiskutueshme, për ata që ndriçohen nga drita e tij dhe duan të udhëzohen me të. Imani i dobishëm sjell fryte të mira. Ky është imani i ndërtuar mbi udhëzimet e Kuranit, ndryshe nga imani i përciptë dhe thjesht zakonor. Ata që e pranojnë dhe pasojnë fenë thjesht si traditë të të parëve të tyre, pa u mbështetur në mësimet e Kuranit dhe Sunetit, ata janë të rrezikuar vazhdimisht nga dyshimet ose nga sprova të tjera.

- "Pa dyshim, lartësia dhe madhështia e Zotit tonë nuk lejon që Ai të ketë grua apo fëmijë." - U lartësoftë madhështia e Allahut dhe u shenjtërofshin emrat e Tij! Duke dëgjuar për madhështinë e Allahut dhe duke e njohur Atë, xhindët arritën në përfundimin se pretendimi i atyre që thonë se Ai ka grua dhe fëmijë është i kotë dhe i turpshëm. Atij i takon madhështia dhe Ai është absolut në çdo cilësi që ka. Të pasurit grua dhe fëmijë cenon madhështinë dhe krenarinë e Tij, sepse bie në kundërshtim me faktin se Ai është i Pasuri, që nuk ka nevojë për asgjë prej krijesave të Tij.

- "S'ka dyshim se ai mendjelehti ynë thoshte gënjeshtra të mëdha ndaj Allahut." – Ai thoshte gënjeshtra të mëdha, shumë larg të vërtetës, duke shprehur armiqësi ndaj saj.

Ajeti bën të qartë se ata që thonë të tilla poshtërsi e bëjnë vetëm prej mendjemadhësisë dhe logjikës së tyre të dobët. Nëse do të ishin të urtë dhe të mençur, nuk do të thoshnin dhe as ta mendonin diçka të tillë.

- "Ndërsa ne mendonim se as njerëzit, as xhindët nuk mund të thonin gënjeshtra për Allahun." – Kuptimi: Para se të dëgjonim këtë libër madhështor, ne ishim të mashtruar nga udhëheqësit tanë, njerëz dhe xhindë, për të cilët kishim konsiderata të larta. Kurrë nuk mendonim se ata mund të guxonin të thonin gënjeshtra për Zotin, prandaj ndiqnim udhëzimet e tyre. Por sot, duke qenë se e vërteta doli në shesh, ne e përqafojmë atë me bindje dhe nënshtrim. Kurrë nuk do të sprapsemi nga udha e drejtë, për çfarëdo orientimi që bie ndesh me fenë e Zotit tonë.

- "Ka pasur burra prej njerëzve, që u kërkonin ndihmë disa burrave prej xhindëve, duke ua shtuar kështu edhe më tepër arrogancën." – Këta njerëz adhuronin xhindët dhe i kërkonin ndihmë, në raste frike dhe nevoje. Por me këtë adhurim,

njerëzit ua shtuan xhindëve arrogancën. Ata u bënë edhe më kryelartë, kur shihnin njerëzit që i adhuronin dhe kërkonin ndihmë prej tyre. Nga ana tjetër, xhindët ua shtuan njerëzve frikën, me qëllim që ata t'i përkushtoheshin edhe më shumë. Kështu, për shembull, kur futeshin në ndonjë luginë të frikshme, njerëzit thoshin: "Kërkoj mbrojtje prej xhindit që zotëron në këtë luginë, që të më ruajë prej së keqes së mendjelehtëve të popullit të tij (xhind)."[38]

[38] Për këtë çështje, imam Ibn Kajjimi ka thënë: "Ai të Cilit i kërkohet mbrojtja dhe ndihma është Allahu, i Adhuruari i vetëm, sepse Allahu i Lartësuar është Zoti, Sunduesi i agimit, Zoti i njerëzve, Sunduesi i tyre, i Adhuruari i tyre. Nuk lejohet t'i kërkosh mbrojtje dhe ndihmë askujt tjetër, veç Allahut. Vetëm Ai i mbështet dhe mbron ata që i kërkojnë mbrojtje e ndihmë. Vetëm Ai mund t'ua largojë atyre të keqen, prej së cilës ata ruhen dhe kërkojnë mbrojtje.

Allahu i Lartësuar na tregon në Librin e Tij se, nëse ndihma dhe mbrojtja kërkohet prej krijesave, atyre u shtohet edhe më tepër arroganca dhe mospërmbajtja. Kështu, duke cituar besimtarët xhindë, i Lartësuari thotë: "Ka pasur burra prej njerëzve, që u kërkonin ndihmë disa burrave prej xhindëve, duke ua shtuar kështu edhe më tepër arrogancën." Në tefsirin e këtij ajeti është thënë se, në kohën e injorancës paraislamike, kur arabët udhëtonin dhe kalonin përmes tokave të pa njohura, kërkonin ndihmë prej xhindëve, duke thënë: "*Kërkoj mbrojtje prej xhindit që zotëron në këtë luginë, që të më ruajë prej së keqes së mendjelehtëve të popullit të tij xhind*." Në këtë mënyrë, ata mendonin se do ta kalonin natën të sigurt, të ruajtur prej sherrit të xhindëve të asaj lugine, deri në agim. Por duke u kërkuar ndihmë atyre, njerëzit ua shtuan edhe më shumë arrogancën dhe mospërmbajtjen krerëve të xhindëve. Prandaj thotë i Lartësuari: "Ka pasur burra prej njerëzve, që u kërkonin ndihmë disa burrave prej xhindëve, duke ua shtuar kështu edhe më tepër arrogancën." Pra, për shkak se u kërkohej ndihmë, xhindëve iu shtua edhe më tepër shfrenimi në kalimin e kufijve të Allahut. Ata thonin: "I sunduam edhe xhindët, edhe njerëzit bashkë!".

- "Dhe ata mendonin, siç mendoni edhe ju, se Allahu nuk ka për të ringjallur asnjë." - Kur nuk besuan as ringjalljen, ata u zhytën thellë në *shirk* dhe në gjynahe.

Ajetet 8 – 13

8. Vërtet, ne kemi hulumtuar që të arrijmë në qiell, por e kemi gjetur atë plot me roje të fuqishëm dhe me shkëndija.
9. Ne, më parë, arrinim të dëgjonim diçka, por kush përpiqet tashmë të dëgjojë atje, has në pusinë e shkëndijës së zjarrtë.
10. Ne nuk e dimë a është për qëllim ndonjë e keqe për ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre dëshiron që t'i udhëzojë.
11. Është e vërtetë se prej nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë aq të mirë. Ne kemi qenë në drejtime të ndryshme.
12. Ne jemi të bindur se Allahut nuk mund t'i shmangemi në tokë, e as nuk mund t'i shpëtojmë Atij duke ikur.
13. Dhe ne, sapo e dëgjuam udhëzimin, i besuam atij. E kush i beson Zotit të vet, nuk i druhet ndonjë dëmtimi e as ndonjë padrejtësie!

Shpjegimi i ajeteve

- "Vërtet, ne kemi hulumtuar që të arrijmë në qiell, por e kemi gjetur atë plot me roje të fuqishëm dhe me shkëndija." – Kuptimi: Ne kontrolluam nëpër qiell, por e gjetëm atë të mbrojtur me roje, që nuk lejojnë të afrohesh dhe të depërtosh nëpër të. Në të ka edhe shumë shkëndija të zjarrta, që godasin këdo që përpiqet të përgjojë vjedhurazi diçka nga lajmet e qiellit. Kjo që ndodhi ishte ndryshe nga ajo që ishim mësuar më parë, kur ne kishim mundësi që të afroheshim në qiell dhe të mësonim diçka nga lajmet që vinin prej andej.

- "Ne, më parë, arrinim të dëgjonim diçka..." - Më parë mund të dëgjonim diçka nga lajmet e qiellit, aq sa dëshironte të lejonte Allahu. Por tani ndryshon puna:

- "...por kush përpiqet tashmë të dëgjojë atje, has në pusinë e shkëndijës së zjarrtë." - Për këdo që kërkon të vjedhë diçka nga lajmet e qiellit qëndron në pritë një shkëndijë e zjarrtë, që është përgatitur për ta djegur dhe shkatërruar atë.

Duke parë gjithë këto masa të forta sigurie, ata e kuptuan se bëhej fjalë për diçka të madhe, për një lajm shumë të rëndësishëm. Në tokë po ndodhte diçka e jashtëzakonshme. Allahu i Lartësuar po përgatiste një ngjarje të madhe, të mirë ose të keqe, prandaj thanë:

- "Ne nuk e dimë a është për qëllim ndonjë e keqe për ata që janë në tokë, apo Zoti i tyre dëshiron që t'i udhëzojë." - Duhej të ndodhte patjetër diçka e madhe, sepse ata vërejtën një ndryshim të pazakontë, që tregonte se Allahu i Lartësuar dëshironte diçka për banorët e tokës.

Në fjalët e tyre tregohet edukata ndaj Allahut të Lartësuar, sepse ata nuk e lidhën të keqen drejtpërdrejt me Allahun, por thanë: "...a është për qëllim ndonjë e keqe...". Ndërsa kur folën për të mirën, thanë: "...apo Zoti i tyre dëshiron që t'i udhëzojë".

- "Është e vërtetë se prej nesh ka të mirë, por ka edhe që nuk janë aq të mirë. Ne kemi qenë në drejtime të ndryshme." - Ka të mirë, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me sinqeritet dhe sipas porosive të Zotit dhe të Profetit. Por ka edhe të tjerë, që i shkelin kufijtë e Zotit, bëjnë krime dhe shkatërrime dhe mohojnë Zotin.


Pra, janë grupacione të shumta dhe të ndryshme. Çdo grupacion i gëzohet asaj që beson, pa dije dhe pa argument të qartë.

- "Ne jemi të bindur se Allahut nuk mund t'i shmangemi në tokë, e as nuk mund t'i shpëtojmë Atij duke ikur." – Kuptimi: Vetëm tani e kuptuam qartë dhe plotësisht pushtetin absolut të Allahut të Madhërishëm, dhe paaftësinë, dobësinë dhe varfërinë tonë të skajshme kundrejt këtij pushteti. Qenia jonë është tërësisht në dorë të të Gjithëpushtetshmit. Nuk ka asnjë mundësi që t'i shpëtojmë Atij në këtë tokë. Ne nuk mund të fshihemi dhe të shpëtojmë prej Allahut duke u arratisur, edhe nëse marrim çdo masë të mundshme. Është e pamundur t'i shpëtosh dhe të dalësh jashtë pushtetit të të Madhërishmit. Nuk ka vendstrehim që të mbron prej Tij, por mbrojtja është vetëm duke vrapuar dhe duke u afruar tek Ai.

- "Dhe ne, sapo e dëgjuam udhëzimin, i besuam atij." - Fjala *'hudâ'* – 'udhëzim' ka për qëllim Kuranin. Kur ata dëgjuan Kuranin, që udhëzon në rrugën e drejtë, fjalët madhështore dhe të drejta të tij ndikuan në zemrat dhe në shpirtrat e tyre, prandaj ata besuan në të.

Më pas, ata tregojnë një të vërtetë, që nxit dhe e gëzon çdo besimtar dhe adhurues të Zotit:

- "E kush i beson Zotit të vet, nuk i druhet ndonjë dëmtimi e as ndonjë padrejtësie!" - Çdokush që beson në Zotin e Madhërishëm, me një iman të vërtetë, të sinqertë dhe të bazuar në argumente të ndritura nga i Madhërishmi, nuk ka për të pasur frikë as për mangësi të shpërblimit në këtë jetë dhe


الجزء التاسع والعشرون سورة الجن

وَأَنَّا مِنَّا ٱلْمُسْلِمُونَ وَمِنَّا ٱلْقَٰسِطُونَ ۖ فَمَنْ أَسْلَمَ فَأُو۟لَٰٓئِكَ
تَحَرَّوْا۟ رَشَدًا ﴿١٤﴾ وَأَمَّا ٱلْقَٰسِطُونَ فَكَانُوا۟ لِجَهَنَّمَ حَطَبًا ﴿١٥﴾
وَأَلَّوِ ٱسْتَقَٰمُوا۟ عَلَى ٱلطَّرِيقَةِ لَأَسْقَيْنَٰهُم مَّآءً غَدَقًا ﴿١٦﴾ لِّنَفْتِنَهُمْ
فِيهِ ۚ وَمَن يُعْرِضْ عَن ذِكْرِ رَبِّهِۦ يَسْلُكْهُ عَذَابًا صَعَدًا ﴿١٧﴾ وَأَنَّ
ٱلْمَسَٰجِدَ لِلَّهِ فَلَا تَدْعُوا۟ مَعَ ٱللَّهِ أَحَدًا ﴿١٨﴾ وَأَنَّهُۥ لَمَّا قَامَ عَبْدُ ٱللَّهِ
يَدْعُوهُ كَادُوا۟ يَكُونُونَ عَلَيْهِ لِبَدًا ﴿١٩﴾ قُلْ إِنَّمَآ أَدْعُوا۟ رَبِّى وَلَآ أُشْرِكُ
بِهِۦٓ أَحَدًا ﴿٢٠﴾ قُلْ إِنِّى لَآ أَمْلِكُ لَكُمْ ضَرًّا وَلَا رَشَدًا ﴿٢١﴾ قُلْ إِنِّى
لَن يُجِيرَنِى مِنَ ٱللَّهِ أَحَدٌ وَلَنْ أَجِدَ مِن دُونِهِۦ مُلْتَحَدًا ﴿٢٢﴾ إِلَّا بَلَٰغًا
مِّنَ ٱللَّهِ وَرِسَٰلَٰتِهِۦ ۚ وَمَن يَعْصِ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ فَإِنَّ لَهُۥ نَارَ جَهَنَّمَ
خَٰلِدِينَ فِيهَآ أَبَدًا ﴿٢٣﴾ حَتَّىٰٓ إِذَا رَأَوْا۟ مَا يُوعَدُونَ فَسَيَعْلَمُونَ
مَنْ أَضْعَفُ نَاصِرًا وَأَقَلُّ عَدَدًا ﴿٢٤﴾ قُلْ إِنْ أَدْرِىٓ أَقَرِيبٌ مَّا تُوعَدُونَ
أَمْ يَجْعَلُ لَهُۥ رَبِّىٓ أَمَدًا ﴿٢٥﴾ عَٰلِمُ ٱلْغَيْبِ فَلَا يُظْهِرُ عَلَىٰ غَيْبِهِۦٓ
أَحَدًا ﴿٢٦﴾ إِلَّا مَنِ ٱرْتَضَىٰ مِن رَّسُولٍ فَإِنَّهُۥ يَسْلُكُ مِنۢ بَيْنِ
يَدَيْهِ وَمِنْ خَلْفِهِۦ رَصَدًا ﴿٢٧﴾ لِّيَعْلَمَ أَن قَدْ أَبْلَغُوا۟ رِسَٰلَٰتِ
رَبِّهِمْ وَأَحَاطَ بِمَا لَدَيْهِمْ وَأَحْصَىٰ كُلَّ شَىْءٍ عَدَدًا ﴿٢٨﴾

٥٧٣

jetën tjetër, as për padrejtësi kundër tij, dhe as për vuajtje, mundime apo fatkeqësi. Pra, do të jetë i ruajtur nga çdo e keqe dhe i uruar me çdo të mirë. Besimi i vërtetë, i sinqertë dhe i bazuar në argumente të ndritura nga i Madhërishmi, është e vetmja mundësi për të arritur çdo të mirë dhe për të shpëtuar nga çdo e keqe, në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ajetet 14 – 17

14. **Është e vërtetë se prej nesh ka besimtarë, ashtu si ka që janë jashtë rrugës. Kush pranoi Islamin, ai gjeti rrugën e shpëtimit.**

15. **Ndërsa ata që e braktisën rrugën, ata u bënë lëndë e Xhehenemit!**

16. **Sikur ata t'i përmbaheshin rrugës së drejtë, Ne do t'u lëshonim atyre ujë me bollëk,**

17. **për t'i sprovuar me të. Atë që ia kthen shpinën Përkujtimit të Zotit të vet, Ai e shpie në vuajtje të padurueshme.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Është e vërtetë se prej nesh ka besimtarë, ashtu si ka që janë jashtë rrugës. Kush pranoi Islamin, ai gjeti rrugën e shpëtimit." - Prej nesh ka që janë të dorëzuar ndaj Zotit të gjithësisë, por ka edhe që i kalojnë kufijtë e Zotit dhe jashtë rrugës së drejtë, që Ai e sqaroi nëpërmjet librave të shpallur dhe profetëve që dërgoi ndër njerëz.

- "Kush pranoi Islamin, ai gjeti rrugën e shpëtimit." - Ata që iu dorëzuan Zotit, duke përmbushur porositë e Tij dhe të profetëve të Tij, këta i janë futur rrugës së drejtë, nëpërmjet së cilës arrihet e mira dhe ruhesh nga e keqja. Kjo është e vetmja rrugë që të çon në Xhenetet e Tij të përjetshme dhe në kënaqësinë e pafundme.

- "Ndërsa ata që e braktisën rrugën, ata u bënë lëndë e Xhehenemit!" - Ky do të jetë ndëshkimi i tyre me drejtësi, të cilin e fituan vetë, me veprat e tyre të këqija. Allahu nuk i bën kurrë padrejtësi ndokujt. Madje, Ai na tregon se, nëse ata do të përqendroheshin në rrugën e drejtë, do të ndodhte ndryshe:

- "Sikur ata t'i përmbaheshin rrugës së drejtë, Ne do t'u lëshonim atyre ujë me bollëk..." – Pra, Ai do t'u dhuronte ujë të bollshëm dhe të begatshëm. Por ata nuk i pengoi kush nga udha e drejtë, përveçse padrejtësia dhe armiqësia e tyre ndaj së vërtetës dhe ithtarëve të saj.

- "...për t'i sprovuar me të." - Veç të tjerash, me mirësitë që dhuron, Allahu i Lartësuar

kërkon t'i provojë njerëzit, që të dallojë mirënjohësit nga mohuesit e mirësive, të sinqertët në adhurim nga hipokritët, që synojnë mirësitë vetëm të kësaj dynjaje.

- "Atë që ia kthen shpinën Përkujtimit të Zotit të vet, Ai e shpie në vuajtje të padurueshme." - Përkujtimi është Kurani. Pra, ai që ia kthen shpinën Kuranit, duke mos e besuar dhe duke mos iu nënshtruar udhëzimeve të tij, që tregohet mospërfillës dhe tallet me të, ky ka për t'u hedhur në një ndëshkim, që Allahu i Lartësuar e ka përshkruar si *ŝa'adâ* - të ashpër, të padurueshëm.

Ajetet 18 – 24

18. Me të vërtetë, xhamitë janë vetëm që t'i lutesh Allahut, prandaj mos ju lutni në to askujt tjetër veç Allahut!
19. Dhe, vërtet, kur robi i Allahut u ngrit ta adhurojë Atë, ata gati sa hipën njëri mbi tjetrin, për ta dëgjuar.
20. Thuaj: "Unë adhuroj veçse Zotin tim dhe nuk konsideroj si të barabartë me Të asgjë!"
21. Thuaj: "Unë nuk kam në dorë që t'ju dëmtoj dhe as t'ju udhëzoj në rrugë të drejtë!"
22. Thuaj: "Është e vërtetë se mua nuk më mbron askush prej Allahut dhe, përveç se tek Ai, unë nuk mund të gjej mbështetje askund tjetër.
23. Unë jam veçse përcjellës i Allahut dhe i shpalljeve të Tij. Atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij u takon zjarri i Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë, pa mbarim.
24. Kur të shohin atë që u është premtuar, atëherë do të kuptojnë se cili është vërtet ndihmësi më i dobët dhe më i vogël në numër.

Shpjegimi i ajeteve

- "Me të vërtetë, xhamitë janë vetëm që t'i lutesh Allahut, prandaj mos ju lutni në to askujt tjetër veç Allahut!" - Lutja *(dua*-ja) është adhurim, dhe adhurimi nuk lejohet t'i përkushtohet askujt tjetër, veç Allahut të Madhërishëm.

Dua-ja është dy llojesh:

1. *Dua* e kërkesës (*duaul mes'eleh*), kur i lutesh të Adhuruarit shprehimisht për diçka, me fjalë.

2. *Dua* e adhurimit (*duaul ibâdeh*), kur i lutesh të Adhuruarit të të japë atë që dëshiron apo të të ruajë nga ajo së cilës i druhesh, jo shprehimisht me fjalë, por nëpërmjet adhurimeve, të cilat Ai i ka përcaktuar si të tilla, pra, si mundësuese të të mirave dhe larguese të të këqijave.

Në këtë ajet kemi të bëjmë me një urdhër për të njësuar të Madhëruarin me adhurimet tona, mes të cilave është *dua*-ja. Pra, nuk lejohet që *dua*-ja, me të dyja mënyrat e saj, t'i drejtohet dikujt a diçkaje tjetër, veç Allahut të Madhërishëm, të Lartësuar, të Gjithëmëshirshëm dhe Bujar. Xhamitë, të cilat janë shtëpitë e Allahut dhe vendet më të rëndësishme të adhurimit, duhet të jenë të pastra nga idhujtaria, me të gjitha mënyrat e saj. Këto shtëpi të Allahut duhet të ndërtohen me adhurime të sinqerta dhe të përkushtuara veç për të Vetmin që i meriton ato, për Allahun e Madhërishëm. Allahu i Lartësuar duhet të adhurohet veçse me mënyrën dhe rrugët që Ai i ka përcaktuar si adhurime. Xhamitë e Allahut duhet të mbushen me madhërimin dhe përunjësinë e adhuruesve të sinqertë për Allahun e Madhërishëm; me nënshtrimin e plotë të tyre ndaj Krenarit të Gjithëpushtetshëm.

- "Dhe, vërtet, kur robi i Allahut u ngrit ta adhurojë Atë, ata gati sa hipën njëri mbi tjetrin, për ta dëgjuar." – Njëherë, kur Muhamedi (a.s.) qëndronte në këmbë dhe adhuronte Allahun e Lartësuar, duke bërë *dua* dhe duke lexuar Kuran, një numër i madh xhindësh qëndronin njëri mbi tjetrin për të dëgjuar dhe parë adhurimin që bënte Profeti (a.s.). Ata ishin shumë të përqendruar dhe të përkushtuar në dëgjimin e Kuranit, që të ndriçoheshin nga drita dhe udhëzimi i tij.

- "Thuaj: "Unë adhuroj veçse Zotin tim dhe nuk konsideroj si të barabartë me Të asgjë!"" - Thuaju atyre, o Profet, duke i sqaruar mirë: "Unë adhuroj veçse Zotin tim dhe nuk konsideroj asnjë si të barabartë me Të!"

Allahu i Lartësuar është i Vetmi që meriton adhurimet e krijesave, dhe ky është një urdhër i prerë. Ai adhurohet veçse sipas mënyrës dhe rrugëve të cilat Ai i ka qartësuar nëpërmjet Profetit dhe Shpalljes së Tij. Thelbi i ftesës së Profetit të fundit është adhurimi i Allahut si i Vetëm dhe i Pashoq, me mënyrën që Ai e ka përcaktuar, dhe largimi nga çdo gjë tjetër që idhujtarët dhe qafirët adhurojnë veç Tij.

- "Thuaj: "Unë nuk kam në dorë që t'ju dëmtoj dhe as t'ju udhëzoj në rrugë të drejtë!"" - Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin e tij të dashur dhe të zgjedhur që t'i këshillojë njerëzit dhe t'ua bëjë të qartë se ai, si gjithë profetët e tjerë, është veçse një njeri, një krijesë e Allahut, një adhurues si të gjithë adhuruesit e Allahut. Në të nuk ka asgjë hyjnore apo mbinjerëzore. Çdo gjë është në dorën e Zotit të botëve dhe Sunduesit të gjithësisë, Allahut të Lartësuar.

Kjo bëhet për t'i prerë rrugën çdo idhujtarie në lidhje me profetët e Allahut të Madhërishëm. Dobia dhe dëmi janë në dorën e të Plotpushtetshmit absolut. Nëse Ai dëshiron të të dhurojë dhe begatojë me mirësitë e Tij, askush nuk mund ta pengojë Atë. Nëse Allahu dëshiron të të sprovojë me ndonjë të keqe, sipas drejtësisë dhe urtësisë së Tij, askush nuk mund ta ndalojë Atë dhe askush nuk mund të të ndihmojë për të shpëtuar prej përcaktimit të Tij. Vetëm Allahu udhëzon në rrugën e drejtë dhe vetëm Ai të shpëton nga humbja. Vetëm Allahut i kërkohet udhëzimi dhe vetëm tek Ai mund të mbështetesh plotësisht për arritjen e çdo të mire dhe largimin nga çdo e keqe. Profetët janë thjesht përcjellës të qartë dhe besnikë të Mesazhit hyjnor ndër njerëz. Ata janë adhurues të pastër dhe të sinqertë të të Madhërishmit. Ky është misioni i tyre, prandaj ata nuk duhen adhuruar.

- "Thuaj: "Është e vërtetë se mua nuk më mbron askush prej Allahut dhe, përveç se tek Ai, unë nuk mund të gjej mbështetje askund tjetër. Unë jam veçse përcjellës i Allahut dhe i shpalljeve të Tij." - Askush nuk ka pushtet të të shpëtojë nga ndëshkimi i Allahut, madje as profetët e Allahut nuk kanë strehim dhe shpëtim gjetkë, përveç se tek Allahu i Lartësuar.

Atëherë, kur profetët e Allahut, të cilët janë krijesat më të mira të Tij, bëjnë të qartë se nuk kanë në dorë as dëm e as dobi, atëherë çfarë mund të thuhet për të tjerët, që qëndrojnë poshtë tyre?! Profetët e Allahut nuk i dallon asgjë prej njerëzve të tjerë, veç faktit që ata janë qartësues të së vërtetës dhe ftues në rrugën e Allahut të Lartësuar. Nëpërmjet tyre qartësohet e vërteta dhe zbulohet rruga e drejtë.

Pas sqarimit të profetëve, askush nuk mund të justifikohet para Allahut të Madhëruar. Të zgjuarit i dëgjojnë me kujdes dhe përkushtim porositë e tyre, ndërsa të mjerët i shpërfillin ato, dhe u larguan shumë larg të vërtetës.

- "Atyre që kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij u takon zjarri i Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë, pa mbarim." - Këtu është fjala për kundërshtimet që konsiderohen si kufër apo idhujtari. Ata që bëjnë të tilla kundërshtime janë të kërcënuar me qëndrim të përjetshëm në zjarrin e Xhehenemit, ndërsa ata që bëjnë gabime poshtë kufrit dhe idhujtarisë nuk do të vuajnë përjetësisht në Xhehenem, sikurse tregojnë ajetet e Kuranit dhe hadithet e sakta të Profetit (a.s.). Ky është një mendim konsensual dhe i pakundërshtueshëm i dijetarëve të parë dhe imamëve të këtij umeti.

- "Kur të shohin atë që u është premtuar, atëherë do të kuptojnë se cili është vërtet ndihmësi më i dobët dhe më i vogël në numër." - Kur ata ta shohin me sytë e ballit dhe të sigurohen për ndëshkimin që i pret, atëherë do ta njohin realisht se cili është ndihmësi më i dobët dhe më i vogël në numër, sepse atë ditë nuk do të kenë as ushtri e as përkrahës që mund t'i ndihmojnë, madje as vetveten nuk do mund ta ndihmojnë. Të gjithë do të ringjallen tek i Lartësuari të vetëm, sikurse i ka krijuar herën e parë.

Ajetet 25 – 28

25. Thuaj: "Unë nuk e di a do të jetë afër ajo që u premtohet, apo Zoti im do ta vonojë atë shumë?"

26. Ai është Njohësi i të fshehtës dhe fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt,
27. me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai dëshiron. Atëherë, Ai vë roje para edhe prapa tij,
28. për t'u bërë e qartë se ata i kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre dhe se Ai ka përfshirë gjithçka të tyre. Ai e di sasinë e çdo gjëje që ekziston.

Shpjegimi i ajeteve

Nëse ata të pyesin se kur do të bëhet realitet ky premtim:

- "Thuaju: "Unë nuk e di a do të jetë afër ajo që u premtohet, apo Zoti im do ta vonojë atë shumë?"" - Kjo është një dije që i Lartësuari e ka fshehur nga krijesat dhe askush nuk mund të japë përgjigje për të. Atë e di vetëm Ai.

- "Ai është Njohësi i të fshehtës dhe fshehtësinë e Vet nuk ia zbulon askujt..." - Ai është i vetmi që di të fshehtën dhe çfarë fshihet në gjoks. Ai nuk ia zbulon askujt prej krijesave të tij të fshehtën, përveç ndonjë profeti, të cilit i shpalli nga e fshehta aq sa Ai dëshironte dhe në kushte shumë të larta sigurie dhe fshehtësie.

- "...me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai dëshiron." - Allahu i Lartësuar u zbuloi profetëve prej të fshehtës aq sa e vendosi urtësia e Tij që t'u zbulonte. Ai u tregoi çdo gjë të nevojshme për njerëzimin. Ai i veçoi ata me këtë dhunti, sepse ata nuk ishin si të tjerët.

Allahu i Lartësuar u dha një ndihmë të madhe në të gjitha aspektet dhe u siguroi një mbrojtje të veçantë në drejtim të ruajtjes së Shpalljes. Ai krijoi çdo lehtësi të nevojshme,

që ata ta transmetonin qartë dhe saktë Shpalljen e Tij. Shejtani e kishte të pamundur që t'i turbullonte dhe devijonte këta të përzgjedhur. Ai nuk mund të bënte që ata të shtonin apo të pakësonin diçka nga Shpallja e të Madhërishmit, i Cili thotë:

- **"Atëherë, Ai vë roje para edhe prapa tij..." –** Roje që, me urdhrin e Allahut të Lartësuar, e mbrojnë nga çdo ndikim dhe pengesë e të Mallkuarit.

- "...për t'u bërë e qartë se ata i kanë kumtuar shpalljet e Zotit të tyre..." – Domethënë, me qëllim që Shpallja të jetë e sigurt dhe e qartë për robërit dhe që, në momentin e zbritjes së saj, të mos lejohet asnjë lloj devijimi nga i Mallkuari.

- "...dhe se Ai ka përfshirë gjithçka të tyre. Ai e di sasinë e çdo gjëje që ekziston." - Allahu i Lartësuar di gjithçka që fshihet dhe që shfaqet haptazi. Atij nuk mund t'i fshihet asgjë në qiell dhe në tokë. Askush nuk mund t'i fshehë Allahut ndonjë gjë, aq më pak në çështjet e Shpalljes hyjnore.

Në këtë sure ka shumë mësime dhe ne mund të përmendim disa prej tyre. Kështu, së pari, ajo tregon se xhindët ekzistojnë. Jo vetëm kaq, por ata janë të përgjegjshëm ligjërisht, domethënë, ashtu sikurse edhe njerëzit, ata janë të detyruar të zbatojnë urdhrat e Allahut. Ata do të merren në përgjegjësi për zbatimin e shpalljeve të Allahut dhe porosive të profetëve të Tij. Edhe ata do të shpërblehen sipas veprave të tyre, mirë ose keq.

Kjo sure tregon, gjithashtu, se Muhamedi (a.s.), është profeti i Allahut, i dërguar jo vetëm për gjithë njerëzimin, por edhe për botën e xhindëve. Pra, ai konsiderohet edhe si profet i xhindëve. Allahu i Lartësuar i urdhëroi xhindët që të dëgjonin Shpalljen e Tij dhe ta përcillnin qartë në popullin e tyre. Kjo sure tregon për zgjuarsinë e xhindëve dhe aftësinë e tyre për të njohur dhe pranuar të vërtetën, për të argumentuar dhe arsyetuar drejt rreth së vërtetës. Ajetet tregojnë se ajo që i shtyu xhindët të besonin Kuranin ishte siguria që ata krijuan rreth udhëzimeve dhe mësimeve të vyera që ai përmban. Me arsyetimin e tyre të kujdesshëm, ata i besuan plotësisht këtij libri madhështor. Po ashtu, këtu duket edukata e lartë e këtyre xhindëve në trajtimin e Librit të Zotit dhe porosive të Tij.

Nga kjo sure mësojmë për përkujdesin e madh të Allahut të Madhërishëm për profetin e Tij dhe për ruajtjen të paprekur të Shpalljes që ai solli ndër njerëz. Në ajete lexojmë se kur Allahu i Lartësuar vendosi që t'i zbriste të Përzgjedhurit të Tij Shpalljen hyjnore, një ndryshim i madh ndodhi në qiell dhe në tokë. Portat e qiellit u mbushën me melekë roje, ndërsa shejtanët u gjuajtën me zjarr, që të mos arrinin të merrnin më asgjë nga lajmet e qiellit. Shejtanët u dëbuan nga vendqëndrimet e tyre në hapësirat qiellore, nga ku edhe përgjonin ndonjë të re. Nëpërmjet këtij Profeti, Allahu i Lartësuar i mëshiroi banorët e tokës si asnjëherë më parë. Ai dëshironte që ta përkryente udhëzimin dhe lumturinë për ta. Tashmë kishte filluar një epokë e re për jetën në tokë. Allahu i Lartësuar do t'u dhuronte banorëve të tokës fenë e Tij madhështore dhe të përkryer, njohurinë e pastër dhe të sigurt rreth emrave, cilësive dhe veprave të Tij, rreth gjithçkaje që duhet mësuar prej njohurisë hyjnore. Kjo dhuratë do të lumturonte zemrat dhe do të gëzonte çdo të ditur dhe të mençur që jeton në këtë tokë.

Ky ishte fillimi i shfaqjes së Islamit dhe i shkatërrimit të idhujtarisë dhe kufrit.

Në këtë sure duket qartë përkushtimi i madh i xhindëve në dëgjimin e porosive të Zotit dhe të Profetit, sepse ata hipën mbi njëri-tjetrin për të dëgjuar Profetin (a.s.) teksa lexonte Kuranin.


Kjo sure urdhëron për *teuhid* dhe ndalon nga *shirk*-u. Në të tregohet grada e krijesave. Asnjë krijesë nuk meriton ndonjë grimcë adhurimi, sepse kur vetë Profeti urdhërohet të deklarojë se është i pafuqishëm dhe nuk ka asnjë pushtet për të mundësuar të mirat apo për t'u ruajtur nga të këqijat, qoftë edhe kur bëhet fjalë për veten e vet, atëherë ç'mund të thuhet për krijesat e tjera, që janë ku e ku më poshtë se ai?! Të gjitha krijesat janë të tilla: të pafuqishme dhe të papushtetshme, prandaj është gabim shumë i madh që të konsiderosh si të adhuruar ndonjë prej tyre, pasi përbën idhujtari, e cila të përjetëson në zjarrin e Xhehenemit.

Në këto ajete mësojmë se njohja e të fshehtës (*gajb*) është e pamundur për krijesat. Ajo është një dituri që Allahu e ka veçuar vetëm për veten e Tij. Ai zbulon prej saj veçse aq sa Ai dëshiron, sipas urtësisë së Tij, dhe atë ia zbulon veçse profetëve të Tij.

Surja 73: El Muzzemil (mekase) 20 ajete

Ajetet 1 – 11

Me emrin e Allahut,
Të Gjithmëshirshmit Mëshirëplotit!



1. O ti i mbështjellë!
2. Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj:
3. gjysmën e saj, ose diçka më pak se gjysmën,
4. ose shto pak më tepër, dhe lexoje Kuranin me vëmendje.
5. Ne do të shpallim ty fjalë me peshë.
6. E s'ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë.
7. Vërtet, ti, gjatë ditës, ke angazhim të gjatë.
8. Por, megjithatë, ti përmende Zotin tënd dhe përkushtoju plotësisht Atij!
9. Ai është Zoti i lindjes dhe i perëndimit! Nuk ka të adhuruar tjetër veç Tij, prandaj vetëm Atë zgjidh për mbështetje!
10. Bëj durim ndaj asaj që të thonë dhe largohu prej tyre me maturi!
11. M'i lër Mua ata gënjeshtarë pasanikë dhe jepu atyre një afat të shkurtër.

Shpjegimi i ajeteve

- "O ti i mbështjellë!" – I mbështjellë (*el muzzemmil*), domethënë: "i mbështjellë në

rroba". *El muzzemmil* ka të njëjtin kuptim me "*muddeththir*". Ky është një cilësim i Profetit të Zotit në momentet e para të Shpalljes. Kur Zoti e nderoi atë me Shpalljen, i dërgoi melekun Xhibril, i cili filloi t'i zbriste ajetet e para. Kur Xhibrili (a.s.) u afrua, Profeti (a.s.) pa diçka që, sikur të mos ishte profet, nuk do të arrinte ta përballonte. Kontakti i parë me melekun madhështor i krijoi atij një gjendje frike të fortë, të pa ndier më parë, aq sa filloi të dridhej. Në atë gjendje, Profeti (a.s.) nxitoi për te familja e tij, te Hadixhja (r.a.). Atje, duke u dridhur, thoshte: "Më mbështillni, më mbështillni!".

Profetit (a.s.) i erdhi Xhibrili dhe i tha: "Lexo!". Më pas, Allahu i Lartësuar e bëri atë që të ishte i qëndrueshëm dhe ta përballonte Shpalljen e Tij. Kështu, Profeti i zgjedhur vazhdoi ta përhapte mesazhin e Zotit, derisa arriti gradën më të lartë mes të dërguarve dhe profetëve të Zotit. *Subhanallah*! Sa i madh është ndryshimi mes gjendjes fillestare dhe përfundimtare të profetësisë së tij!

Kështu, Allahu i Lartësuar i drejtua Profetit të Tij me atë cilësi të fillimit të profetësisë. Fillimisht, Allahu i Lartësuar e urdhëroi që t'i përkushtohej Atij me adhurime, dhe pastaj për të qenë i durueshëm kundrejt padrejtësive dhe mundimeve që do t'i jepnin armiqtë e besimit dhe të Allahut. Ai duhej të bënte durim në ftesën e njerëzve për të adhuruar vetëm Zotin dhe për të lartësuar fjalën e Tij. Ai duhej të bënte durim në zbatimin e plotë të porosive të të Madhërishmit.

Allahu i Lartësuar e urdhëroi së pari për më të dashurin, më të nderuarin dhe më të zgjedhurin e adhurimeve: e urdhëroi për namazin. Dhe jo për çdo lloj namazi, por për namazin në kohën më të nderuar dhe më të zgjedhur: namazin e natës.

- "Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj: gjysmën e saj, ose diçka më pak se gjysmën, ose shto pak më tepër, dhe lexoje Kuranin me vëmendje." - Nga mëshira e Tij, Allahu i Madhëruar nuk e urdhëroi për t'u falur gjatë gjithë natës, por një pjesë të saj, të cilën e shpjegon më pas. Ai mund të falej gjysmën e natës, ose më pak, pra, një të tretën, ose diçka më shumë se gjysma, pra, dy të tretat e natës.

Dhe, gjatë namazit, ai duhej të recitonte bukur Kuranin, sepse këndimi i Kuranit të mundëson që të meditosh thellë rreth tij. Ai i bën zemrat të lëvizin e të ndiejnë besimin dhe ëmbëlsinë e tij. Nëpërmjet këndimit të Kuranit adhurohet Allahu dhe, duke zbatuar porositë e Tij, arrihet përgatitja më e plotë dhe më e mirë për takimin me Të.

- "Ne do të shpallim ty fjalë me peshë." - Shpallja e Zotit është diçka shumë e madhe dhe e rëndë për t'u mbartur. Kuptimet e saj janë madhështore, cilësitë e saj janë të mrekullueshme dhe të paarritshme. Një fjalë e tillë e meriton tërësisht që ta lexosh dhe të përgatitesh mirë për bartjen, zbatimin dhe përhapjen e saj. Ajo është një fjalë për të cilën duhet medituar shumë. Gjithmonë duhet të mësosh dhe punosh sipas saj.

Më pas, tregohet urtësia e porosisë për të lexuar Kuranin dhe për ta adhuruar Zotin me namaz përgjatë natës:

- "E s'ka dyshim se aktiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë." - Namazi i natës, pasi je çlodhur me gjumë, është më i dobishëm. Përfitimi prej Kuranit është më i madh larg zhurmave dhe angazhimeve të

ditës. Në këtë kohë, Kurani lexohet me gojë, por edhe ndihet me zemër. Kështu rregullohen çështjet e robit dhe merret plotësisht udhëzimi prej Kuranit.

Ndërsa ditën, këto qëllime janë më të vështira për t'u arritur, prandaj i Lartësuari thotë:

- "Vërtet, ti, gjatë ditës, ke angazhim të gjatë." – Kuptimi: Ti je i angazhuar për të siguruar nevojat jetësore të tua dhe të familjes, gjë që ta ngarkon disi zemrën tënde. Këto angazhime nuk të lënë të përqendrohesh tërësisht në këndimin dhe kuptimin e fjalës së Zotit.

Sidoqoftë, Zoti i jep të dashurit të Tij një porosi të rëndësishme edhe për gjatë ditës:

- "Por, megjithatë, ti përmende Zotin tënd dhe përkushtoju plotësisht Atij!" - Përmende Zotin tënd me të gjitha llojet e *dhikr*-it dhe gjithmonë kthehu te Zoti yt! Përkushtimi i plotë ndaj Zotit bëhet duke u afruar me zemrën tënde drejt Tij, edhe pse trupin mund ta kesh mes njerëzve. Me zemrën tënde, ti kthehu i penduar te Zoti yt dhe përkujtoje Atë, edhe pse jeton e punon mes krijesave. Zemra jote është e mbushur me dashurinë për Allahun dhe në të nuk ka vend për asnjë krijesë. Zemra jote do dhe synon veçse Allahun dhe çdo vepër e fjalë që kënaq Atë. E si të mos jetë kështu, kur dihet se:

- "Ai është Zoti i lindjes dhe i perëndimit! Nuk ka të adhuruar tjetër veç Tij, prandaj vetëm Atë zgjidh për mbështetje!" - Allahu është Zoti i të gjitha lindjeve dhe i të gjitha perëndimeve; Ai është, gjithashtu, Zoti i çdo gjëje që ekziston mes tyre. Ai është Zoti i botës qiellore dhe tokësore. Allahu është Krijuesi, Furnizuesi dhe Përkujdesësi për gjithçka. Ai është Rregulluesi i të gjitha çështjeve. Nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet me dashuri, madhërim, nënshtrim e përulësi, veçse Allahu i Madhëruar! Ai është i Vetëm dhe i Pashoq, në çdo aspekt. Çdo gjë është në dorën e Tij, prandaj urdhëroi dhe tha:

"...prandaj vetëm Atë zgjidh për mbështetje." Vetëm Atë zgjidhe për të të ruajtur dhe për t'u kujdesur për ty dhe për të gjitha çështjet e tua!

Pasi e porositi Profetin e Tij për namaz, në mënyrë të veçantë, dhe për dhikër, në mënyrë të përgjithshme, aktivitete këto që e përgatisin njeriun për të mbartur detyrime të mëdha, Allahu i Lartësuar e urdhëroi për durim:

- "Bëj durim ndaj asaj që të thonë dhe largohu prej tyre me maturi!" - Bëj durim ndaj shpifjeve dhe fyerjeve të armiqve të tu! Duro fyerjet ndaj teje dhe ndaj Shpalljes, që ti e përcjell nga Zoti yt! Zbato me përpikmëri atë që të shpallet! Kurrë mos u spraps dhe ngadalëso në rrugën e Zotit tënd! Distancohu nga penguesit në mënyrën më të urtë dhe të mirë të mundshme! Mos bier në nivelin e tyre dhe t'i ofendosh ata me të njëjtën mënyrë, por thjesht largohu i nderuar! Dialogo dhe polemizo me ta në mënyrën më të sjellshme!

- "M'i lër Mua ata gënjeshtarë pasanikë dhe jepu atyre një afat të shkurtër." – Kuptimi: M'i lër Mua t'i ndëshkoj ata gënjeshtarë mosbesues, të cilëve u kam dhënë plot të mira e begati, por në vend që të tregohen mirënjohës, ata i kalojnë kufijtë, duke menduar se janë të pavarur, jo

nevojtarë dhe të pamposhtur, sikurse thuhet në suren Ikra: "Pa dyshim, është e vërtetë se ai (njeriu) i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur."

Më pas, i Lartësuari i kërcënon ata me ndëshkim të ashpër ditën kur të kthehen tek Ai:

Ajetet 12 – 14

12. Se, me të vërtetë, tek Ne ka ndëshkim dhe zjarr!
13. Ka ushqim që nuk gëlltitet dhe dënim të dhembshëm!
14. Atë ditë, kur toka e malet të dridhen dhe kur malet bëhen rërë e paqëndrueshme!

Shpjegimi i ajeteve

- "Se, me të vërtetë, tek Ne ka ndëshkim (*enkâlen*) dhe zjarr (*xhaĥimen*)!" - *Enkâlen* është një ndëshkim i rëndë, i cili qëndron në pritë, për të gllabëruar me forcë atë që ka qenë gjithnjë i zhytur në gjynahe. Ndërsa *xhaĥimen* është një zjarr përvëlues, i ndezur fort.

- "Ka ushqim që nuk gëlltitet dhe dënim të dhembshëm!" - Ai ushqim nuk mund të gëlltitet, për shkak të hidhësisë dhe pështirësisë së tij. Pamja dhe kutërbimi i tij janë shumë të tmerrshëm dhe të padurueshëm. Ndëshkimi me të cilin do të përballen në Xhehenem do të jetë torturues dhe i tmerrshëm. Kjo do të ndodhë:

- "Atë ditë, kur toka e malet të dridhen dhe kur malet bëhen rërë e paqëndrueshme!" - Nga tmerri i madh i asaj dite, edhe malet e larta, aq të forta dhe të patundshme, do të shndërrohen në pluhur dhe rërë, aq sa edhe një erë e lehtë mund t'i shpërndajë në ajër. Pas tronditjes së madhe, malet do të zhduken si pluhuri në erë.

Ajetet 15 – 16

15. Ne sollëm tek ju një të Dërguar, që do dëshmojë kundër jush, ashtu siç çuam edhe te Faraoni një të Dërguar.
16. Por Faraoni e kundërshtoi të Dërguarin, prandaj Ne e ndëshkuam atë me një dënim të rëndë.

Shpjegimi i ajeteve


Lavdërojeni dhe adhurojeni Allahun për Profetin arab analfabet që ju dërgoi, si përgëzues dhe paralajmërues për ju. Është ai që do të dëshmojë për umetin e tij dhe saktësinë e veprave të tyre. Tregoni mirënjohje dhe respektojeni këtë mirësi të madhe e të paçmueshme, duke punuar sipas porosive të Zotit dhe Profetit të Tij.

Kujdes dhe ruajuni që kurrë të mos bëheni mohues dhe shpërfillës të saj, duke mos iu bindur Profetit tuaj. Nëse veproni kështu, atëherë ju do të jeni si Faraoni, i cili shpërfilli dhe e mohoi Profetin e Allahut, Musain (a.s.). Profeti Musa e ftoi Faraonin të adhuronte Allahun dhe t'i nënshtrohej Atij, por ai nuk e besoi dhe e konsideroi si gënjeshtar. Ai nuk iu bind porosive dhe ftesës së Profetit, prandaj Allahu i Madhërishëm i dha një ndëshkim të ashpër dhe të rëndë.

Ajetet 17 – 19

17. Nëse ju mohoni, atëherë si do të mbroheni prej dënimit të asaj dite, që fëmijët do t'i bëjë pleq?
18. Atë ditë, qielli do të çahet dhe premtimi i Tij do të realizohet.
19. Këto janë një përkujtim qortues. Kush do, ai e zgjedh rrugën për tek Zoti i vet.

Shpjegimi i ajeteve


الجزء التاسع والعشرون سورة المزمل
الحزب ٥٨
* إِنَّ رَبَّكَ يَعْلَمُ أَنَّكَ تَقُومُ أَدْنَىٰ مِن ثُلُثَيِ ٱلَّيْلِ وَنِصْفَهُۥ وَثُلُثَهُۥ وَطَآئِفَةٌ
مِّنَ ٱلَّذِينَ مَعَكَ ۚ وَٱللَّهُ يُقَدِّرُ ٱلَّيْلَ وَٱلنَّهَارَ ۚ عَلِمَ أَن لَّن تُحْصُوهُ فَتَابَ
عَلَيْكُمْ ۖ فَٱقْرَءُوا۟ مَا تَيَسَّرَ مِنَ ٱلْقُرْءَانِ ۚ عَلِمَ أَن سَيَكُونُ مِنكُم مَّرْضَىٰ
وَءَاخَرُونَ يَضْرِبُونَ فِى ٱلْأَرْضِ يَبْتَغُونَ مِن فَضْلِ ٱللَّهِ وَءَاخَرُونَ
يُقَٰتِلُونَ فِى سَبِيلِ ٱللَّهِ ۖ فَٱقْرَءُوا۟ مَا تَيَسَّرَ مِنْهُ ۚ وَأَقِيمُوا۟ ٱلصَّلَوٰةَ وَءَاتُوا۟
ٱلزَّكَوٰةَ وَأَقْرِضُوا۟ ٱللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا ۚ وَمَا تُقَدِّمُوا۟ لِأَنفُسِكُم مِّنْ خَيْرٍ تَجِدُوهُ
عِندَ ٱللَّهِ هُوَ خَيْرًا وَأَعْظَمَ أَجْرًا ۚ وَٱسْتَغْفِرُوا۟ ٱللَّهَ ۖ إِنَّ ٱللَّهَ غَفُورٌ رَّحِيمٌ ٢٠
سورة المدثر
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
يَٰٓأَيُّهَا ٱلْمُدَّثِّرُ ١ قُمْ فَأَنذِرْ ٢ وَرَبَّكَ فَكَبِّرْ ٣ وَثِيَابَكَ فَطَهِّرْ ٤
وَٱلرُّجْزَ فَٱهْجُرْ ٥ وَلَا تَمْنُن تَسْتَكْثِرُ ٦ وَلِرَبِّكَ فَٱصْبِرْ ٧ فَإِذَا نُقِرَ
فِى ٱلنَّاقُورِ ٨ فَذَٰلِكَ يَوْمَئِذٍ يَوْمٌ عَسِيرٌ ٩ عَلَى ٱلْكَٰفِرِينَ غَيْرُ يَسِيرٍ ١٠
ذَرْنِى وَمَنْ خَلَقْتُ وَحِيدًا ١١ وَجَعَلْتُ لَهُۥ مَالًا مَّمْدُودًا ١٢ وَبَنِينَ
شُهُودًا ١٣ وَمَهَّدتُّ لَهُۥ تَمْهِيدًا ١٤ ثُمَّ يَطْمَعُ أَنْ أَزِيدَ ١٥ كَلَّآ ۖ إِنَّهُۥ
كَانَ لِـَٔايَٰتِنَا عَنِيدًا ١٦ سَأُرْهِقُهُۥ صَعُودًا ١٧ إِنَّهُۥ فَكَّرَ وَقَدَّرَ ١٨
٥٧٥

- "Nëse ju mohoni, atëherë si do të mbroheni prej dënimit të asaj dite, që fëmijët do t'i bëjë pleq?" – Kuptimi: E si mund ta mendoni se do të shpëtoni Ditën e Gjykimit, atë ditë, kur, nga tmerri i madh, harrohet çdo gjë! Ajo është dita që edhe fëmijëve do t'u nxjerrë thinja, nga frika e madhe. Atë ditë, edhe krijesat më të mëdha, siç janë malet, do të shpërbëhen dhe bëhen pluhur.

- "Atë ditë, qielli do të çahet dhe premtimi i Tij do të realizohet." - Atë ditë, qiejt do të shpërbëhen, yjet do të shkatërrohen dhe shuhen. Ajo është dita kur do të bëhet realitet premtimi i Zotit. Askush nuk ka mundësi ta ndalojë këtë premtim të të Plotpushtetshmit.

- "Këto janë një përkujtim qortues." - Këto përshkrime të Ditës së Gjykimit janë një përkujtim i dobishëm për ata që i frikësohen Zotit, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave, dhe për ata që e adhurojnë me sinqeritet Zotin e tyre, ashtu sikurse Ai i ka porositur dhe mësuar nëpërmjet Profetit dhe Shpalljes së Tij.

Këto kërcënime u vlejnë besimtarëve, të cilët gjithmonë pendohen për gabimet që bëjnë dhe i kthehen rrugës së Zotit. Rruga e Zotit të tyre është rruga që Ai e ka sqaruar nëpërmjet Shpalljes së tij. Ai e ka qartësuar këtë rrugë me mënyrën më të mirë.

- "Kush do, ai e zgjedh rrugën për tek Zoti i vet." - Ky ajet tregon se Allahu i Lartësuar u ka lënë robërve mundësi zgjedhjeje dhe veprimi. Pra, nuk është sikurse thotë sekti *xhebrijeh*, që robërit i kryejnë veprat pa vullnetin e tyre dhe jo me zgjedhjen e tyre, por të detyruar dhe të imponuar. Sigurisht, ky është një mendim i gabuar, që bie ndesh me logjikën e pastër dhe me argumentet tekstuale të Sheriatit, si ky ajet i sapocituar.

Ajeti 20

20. Zoti yt e di se, ti dhe një grup i atyre që janë me ty kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës, ose gjysmën e saj, ose një të tretën e saj. Allahu e di gjatësinë e natës dhe të ditës dhe Ai e dinte që ju nuk do të mund t'i përmbaheshit asaj, prandaj ju bëri lehtësime. Atëherë, duke lexuar Kuran, faluni aq sa t'ju bëhet më lehtë! Ai e dinte se nga ju do të kishte të sëmurë, do të kishte nga ata që lëvizin nëpër tokë për të kërkuar begatitë e Allahut, ashtu si edhe të tjerë që luftojnë në rrugën e Allahut. Kësisoj, faluni dhe lexoni, aq sa t'ju bëhet

më lehtë! Faleni me rregull namazin, jepni zekatin dhe jepni për hir të Allahut hua të mirë! Çfarëdo të mire të përgatisni për veten tuaj, atë do ta gjeni tek Allahu më të mirë dhe më të shpërblyer! Kërkoni falje prej Allahut, se, pa dyshim, Allahu është Mëkatfalës e Mëshirues!

Shpjegimi i ajetit

- "Zoti yt e di se, ti dhe një grup i atyre që janë me ty kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës, ose gjysmën e saj, ose një të tretën e saj." - Në fillim të kësaj sureje, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Profetin e Tij që të falej natën: gjysmën e saj, një të tretën, dy të tretat, më pak a më shumë. Natyrisht, ai mbetet shembulli më i mirë, të cilin umeti e pason. Kështu, në këtë ajet, Allahu i Lartësuar tregon se, porosinë e Tij për t'u falur gjatë natës e kreu jo vetëm Profeti (a.s.), por edhe një pjesë e shokëve të tij.

Por njerëzit nuk mund ta përcaktonin me saktësi kohën që Zoti urdhëroi për të falur namaz nate. Përcaktimi ekzakt i saj do të ishte i vështirë për ta, prandaj Allahu i Lartësuar u bëri një lehtësim, duke thënë:

- "Allahu e di gjatësinë e natës dhe të ditës dhe Ai e dinte që ju nuk do të mund t'i përmbaheshit asaj, prandaj ju bëri lehtësime." – Kuptimi: Allahu e di saktësisht kohën e natës, çfarë kalon dhe çfarë mbetet prej saj. Ai e dinte që ju nuk do t'i përmbaheshit me përpikmëri kohës kur Ai dëshiron që ju ta adhuroni me namaz, prandaj, duke jua lehtësuar, kërkon që ju ta adhuroni ashtu si t'ju vijë më lehtë. Tashmë, edhe nëse e shtoni apo e pakësoni kohën e adhurimit të natës, Zoti ju ka bërë lehtësim dhe jua ka pranuar pendimin.

- "Atëherë, duke lexuar Kuran, faluni aq sa t'ju bëhet më lehtë!" – Kuptimi: Lexoni Kuran aq sa dini, pa u vënë në vështirësi.

Ai që fal namaz nate duhet ta bëjë këtë adhurim për sa kohë është energjik, ndërsa nëse është i lodhur, i plogësht dhe i përgjumur, le të çlodhet dhe të qetësohet. Namazi duhet të falet me qetësi dhe përkushtim të plotë. Më pas, i Lartësuari na tregon arsyet e lehtësimit:

- "Ai e dinte se nga ju do të kishte të sëmurë..." - Sëmundja përmendet e para. Kur njeriu është i sëmurë, ai e ka të vështirë që të ngrihet e të falë namaz dy të tretat e natës, gjysmën apo një të tretën e saj. Kësisoj, ai mund të falet një pjesë të natës, aq sa t'i vijë më lehtë. Gjithashtu, të sëmurit i lejohet që, nëse nuk mund të falet në këmbë, të falet ulur, e nëse edhe kështu e ka të vështirë, i lejohet të falet shtrirë ose i mbështetur. Nëse është aq i rënduar saqë nuk mund të falë namaze nafile dhe synete, atëherë edhe mund të mos i falë ato, dhe shpërblimin ka për ta marrë të plotë, sikur vepronte kur ishte i shëndetshëm. Profeti (a.s.): "Nëse robi sëmuret apo niset për udhëtim, atij i shkruhet i plotë shpërblimi i veprave që i kryente kur ishte i shëndetshëm apo jo në udhëtim." Pastaj përmendet një arsye tjetër lehtësimi:

- "...do të kishte nga ata që lëvizin nëpër tokë për të kërkuar begatitë e Allahut, ashtu si edhe të tjerë që luftojnë në rrugën e Allahut. Kësisoj, faluni dhe lexoni, aq sa t'ju bëhet më lehtë!" - Ka të tjerë që udhëtojnë për të bërë tregti, në mënyrë që të mos jenë nevojtarë për njerëzit dhe të mos u zgjasin dorën atyre.

Kështu, edhe udhëtimi është një gjendje vështirësie, që bën të lejueshëm zbatimin e kushteve lehtësuese, siç është bashkimi i namazeve farz: yleja me ikindinë dhe akshami me jacinë, si edhe shkurtimi i namazeve katër-rekatësh në dy rekatë.

Siç shihet, Allahu i Lartësuar përmendi dy lloje lehtësimesh:

1. Lehtësime për ata që janë të shëndetshëm dhe jo në udhëtim. Allahu i Lartësuar i udhëzoi besimtarët në të tilla kushte, që të përzgjedhin kohën më të përshtatshme, kur ata janë aktivë dhe të gjallë, për të kryer adhurimin e natës. Ata nuk ka pse ta teprojnë dhe të rëndojnë vetveten për të gjetur pikërisht kohën kur Zoti i porosit që ta adhurojnë gjatë natës. Mjafton që të përpiqet që të falet në kohët më të zgjedhura dhe më të mira të natës, por edhe që të jetë i përqendruar dhe i vëmendshëm në namaz. Le të zgjedhë, për shembull, një të tretën e fundit të natës, kur ai ka bërë gjumë të mjaftueshëm dhe është i çlodhur.

2. Lehtësime për të sëmurët dhe udhëtarët, pavarësisht a është udhëtimi për tregti, për xhihad në rrugën e Zotit apo për kryerje adhurimesh, si haxhi, umreja etj. Në të gjitha këto raste, Allahu i Lartësuar nuk e ngarkon robin përtej mundësive të tij. I lavdëruar qoftë Allahu i Madhëruar, që nuk e rëndoi këtë umet dhe nuk la asnjë vështirësi në fenë e tyre. Ai e lehtësoi Sheriatin, në varësi të nevojave dhe gjendjes së robërve, duke u kujdesur për mirësinë e trupit, dynjasë dhe të fesë së tyre.

Më pas, Allahu i Lartësuar urdhëron për dy adhurime shumë të rëndësishme, që konsiderohen si shtylla të çdo adhurimi tjetër. Ai urdhëron për faljen e rregullt të namazit, pa të cilin feja e robit nuk mund të qëndrojë në këmbë, dhe për dhënien e zekatit, i cili është tregues i vërtetësisë së imanit dhe bamirësisë ndaj krijesave. Ai thotë:

- "Faleni me rregull namazin, jepni zekatin dhe jepni për hir të Allahut hua të mirë!" - Faleni namazin me rregull, duke plotësuar të gjitha shtyllat, themelet, detyrat dhe pjesët e pëlqyeshme të tij.

Gjithashtu, shpenzoni për hir të Zotit, me sinqeritet të plotë vetëm për të kënaqur Atë. Jepni për hir të Zotit, duke qenë të vendosur në atë që bëni, dhe jo me zemër të lëkundur. Jepni nga pasuria hallall, me të cilën Zoti ju ka begatuar. Këtu flitet për shpenzimet e detyrueshme dhe ato të pëlqyeshme.

Pastaj Allahu i Lartësuar porosit për kryerjen e veprave të mira në përgjithësi, duke thënë:

- "Çfarëdo të mire të përgatisni për veten tuaj, atë do ta gjeni tek Allahu më të mirë dhe më të shpërblyer!" - Një e mirë shpërblehet nga Zoti me dhjetëfish deri në shtatëqindfish, madje edhe më shumë. Le ta dinë besimtarët se, një grimcë mirësie e bërë në këtë dynja për hir të Zotit do të shpërblehet në Xhenetet e përjetësisë dhe të mirësive të pafundme shumë më tepër se e gjithë dynjaja, me gjithë stolitë e saj. Vepra e mirë e besimtarit ka për t'u shpërblyer me kënaqësi dhe përjetime të mrekullueshme, të cilat nuk ka asnjë mënyrë për t'i përfituar, veç përkushtimit në adhurimin e Zotit, nëpërmjet atyre fjalëve dhe veprave që Ai na ka porositur nëpërmjet Profetit dhe Shpalljes së Tij.

Subhanallah! Sa e sa kohë humbet me kotësi të kësaj dynjaje! Sa e sa kohë e gjatë harxhohet pa bërë asnjë vepër të mirë për të kënaqur Allahun Bujar dhe të

Gjithëmëshirshëm! O Zot, na ndihmo për këto zemra, tek të cilat nuk po ndikon më paralajmërimi Yt dhe nuk po përmallohen për takimin me Ty, që je më i Mëshirshëm për to se vetë ato për veten e vet! O Allah! I Lavdëruar qofsh! Vetëm tek Ti ankohemi dhe qahemi! Vetëm Ty të kërkojmë ndihmë! Nuk ka ndryshim të gjendjes dhe nuk ka forcë, veçse ai që mbështetet tek Ti!

- "Kërkoni falje prej Allahut, se, pa dyshim, Allahu është Mëkatfalës e Mëshirues!" - Pasi na porositi për të kryer vepra të mira dhe për bindje ndaj Tij, Allahu i Lartësuar na urdhëron për t'i kërkuar falje Atij. Kjo është shumë e dobishme, sepse robi tregon vazhdimisht mangësi në kryerjen e urdhrave dhe porosive të Zotit: ai ose nuk i zbaton fare ato, ose i zbaton me mangësi. Prandaj, që veprat tona të jenë të denja për t'u pranuar dhe shpërblyer, Allahu i Lartësuar na urdhëron që t'i kërkojmë falje Atij. Të mos harrojmë, gjithashtu, se robi bën gabime dhe gjynahe gjatë natës dhe ditës, kështu që është gjithmonë në nevojë për faljen dhe mëshirën e Zotit të tij. Nëse Zoti nuk e përfshin në mëshirën e Vet, shkatërrimi është i sigurt dhe i pakthyeshëm.

Këtu përfundon tefsiri i sures Muzzemmil.

Surja 74: El Muddethir (mekase) 56 ajete

Ajetet 1 – 7

1. O ti i mbuluar!
2. Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen atyre!
3. E madhëroje Zotin tënd!
4. Rrobat e tua pastroji!
5. Të keqes së ndyrë largoju!
6. Mos u mburr me atë që jep e mos të të duket shumë!
7. Dhe për hir të Zotit tënd, duro!

Shpjegimi i ajeteve

- "O ti i mbuluar!" - *El Muddeththir* ka të njëjtin kuptim si *El Muzzemmil*, pra: "i mbuluar, i mbështjellë".

Profeti urdhërohet që të përpiqet me adhurime ndaj Allahut të Madhëruar, qofshin ato adhurime me dobi të kufizuar personale, qofshin me dobi të përgjithshme. Fillimisht, në suren Muzzemmil, i Madhëruari e urdhëroi Profetin (a.s.) për adhurime personale dhe për durim ndaj mundimit të sjellë nga populli i tij. Ndërsa në këtë sure, Allahu i Lartësuar e urdhëron që ta shfaqë haptas thirrjen dhe t'u tërheqë vërejtjen njerëzve:

- "Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen atyre!" - Ngrihu me ambicie e gjallëri dhe tërhiqu vërejtjen njerëzve, me fjalë dhe me vepra, që duhen për të arritur qëllimin. Sqarojua mirë mesazhin, që ata ta kenë më të lehtë zbatimin e tij.

- "E madhëroje Zotin tënd!" – Pra, madhëroje Atë, duke e njësuar në adhurim! Qëllimi yt në këshillimin e njerëzve të jetë kënaqësia e Allahut të Lartësuar dhe që ata ta madhërojnë Atë duke ia përkushtuar të gjitha adhurimet vetëm Atij.

- "Rrobat e tua pastroji!" - Ka mundësi që "rrobat e tua" të nënkuptohet si "veprat e tua", të gjitha e pa përjashtim. Vepra është e pastër kur e kryen me sinqeritet, duke synuar të jesh i dobishëm me të, si edhe kur e kryen në formën më të plotë, duke e ruajtur nga çdo gjë që e prish saktësinë dhe pranueshmërinë e saj. Vepra është e pastër

kur e ruan nga idhujtaria, hipokrizia, syfaqësia, vetëkënaqësia, mendjemadhësia, shpërfillja e çdo mangësi tjetër.

Megjithatë, ajeti përfshin edhe pastrimin e rrobave nga ndyrësitë. Edhe kjo vepër konsiderohet si pastrim i veprave, sidomos kur bëhet fjalë për namazin. Madje, shumë dijetarë e kanë konsideruar pastrimin e rrobave nga ndyrësitë si kusht për saktësinë e namazit. Por, gjithsesi, edhe nëse kemi të bëjmë me një urdhër për të pastruar anën tonë të jashtme, duhet të dimë se pastrimi i jashtëm është plotësues i pastërtisë së brendshme.

- "Të keqes së ndyrë largoju!" - Këtu me fjalën "*er-ruxhz*" – "e keqe e ndyrë", mund të jenë pasur për qëllim putat dhe idhujt, që janë adhuruar përveç Allahut. Pra, Allahu i Madhëruar e urdhëron që të largohet prej tyre; të distancohet nga çdo mashtrim dhe trillim i njerëzve rreth "bëmave" të këtyre idhujve.

Por ka mundësi që me fjalën "*er-ruxhz*" të jenë pasur për qëllim të gjitha llojet e veprave dhe fjalëve të këqija. Kështu, Allahu i Lartësuar e urdhëron Profetin (a.s.) që të largohet dhe të ruhet nga gjynahet, të vogla a të mëdha qofshin, të dukshme a të fshehta, duke filluar nga idhujtaria e gjithçka poshtë saj.

- "Mos u mburr me atë që jep e mos të të duket shumë!" - Mos u lëvdo e mos të të duket shumë ndonjë e mirë që u ke bërë apo që u ke dhënë njerëzve, në lidhje me dynjanë apo me fenë. Mos e zmadho shumë këtë të mirë, por vazhdo të përpiqesh maksimalisht për të ndihmuar të tjerët. Bëj mirë dhe harroje atë! Mos kërko asnjë shpërblim e vlerësim gjetkë, veçse tek Allahu i Madhëruar. Ata që u ke bërë ndonjë të mirë konsideroji njëlloj si të tjerët.


Disa kanë thënë se kuptimi i ajetit është: "Mos i bëj mirësi askujt me qëllimin që ai të ta kthejë bamirësinë me diçka më tepër se ajo". Kështu që këtu kemi të bëjmë me një urdhër të veçantë vetëm për Profetin (a.s.).

- "Dhe për hir të Zotit tënd, duro!" - Me durimin tënd, syno vetëm shpërblimin dhe kënaqësinë e Allahut!

Profeti (a.s.) i zbatoi menjëherë urdhrat e Zotit të tij. Ai i paralajmëroi njerëzit, u sqaroi të gjitha urdhrat hyjnorë dhe i njohu ata me madhështinë e Allahut të Lartësuar. Ai i ftoi të gjithë që ta madhëronin Allahun, të pastronin veprat e fjalët e tyre, të dukshmet dhe të fshehurat, ashtu sikurse ai vetë i pastroi ato nga çdo ndyrësi. Ai u distancua nga çdo gjë që e largonte nga Allahu i Madhëruar: nga idhujt dhe idhujtaria, nga e keqja dhe nga të këqijtë. Profeti (a.s.) ishte bamirësi më i madh ndaj njerëzve, pas mirësisë së Allahut Bujar dhe të Gjithëmëshirshëm, pa u kërkuar atyre asnjë shpërblim e vlerësim për këtë. Ai duroi për hir të Allahut të Madhëruar, me mënyrën më të mirë. Ai duroi për të qenë i bindur dhe zbatues i urdhrave të Allahut, duroi kundrejt poshtërsive dhe gjynaheve, duke u larguar prej tyre, duroi edhe në përcaktimet e dhembshme të Allahut të Urtë. Me këto cilësi, ai i tejkaloi dhe u lartësua mbi të gjithë profetët, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të e mbi ta!

Ajetet 8 – 10

8. E, kur të fryhet në Sur,
9. atëherë është një ditë e vështirë,
10. që nuk është e lehtë për jobesimtarët.



Shpjegimi i ajeteve

Kjo është dita kur do t'i fryhet Surit, që njerëzit të ringjallen nga varret e tyre dhe të qëndrojnë para Zotit, për llogarinë dhe shpërblimin me drejtësi. Ajo do të jetë një ditë e vështirë, për shkak të ndëshkimeve që do të ndodhin. Ajo do të jetë e tmerrshme, sidomos për qafirët, të cilët nuk do të kenë asnjë shpresë për shpëtim. Atë ditë, ata do të binden se ndëshkimi është i vërtetë dhe i pashmangshëm. Nga ajeti kuptohet, gjithashtu, se ajo ditë, ndryshe nga qafirët, për besimtarët do të jetë e lehtë. Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar thotë: "Të tmerruara do të jenë shikimet e tyre. Ata do të dalin prej varreve si të ishin karkaleca të shpërndarë, duke shpejtuar drejt Lajmëtarit. Jobesimtarët do thonë: "Kjo është ditë e vështirë!". [Kamer 7, 8].

Ajetet 11 – 30

11. Ma lër Mua atë që e krijova të vetmuar,
12. që i mundësova të ketë pasuri të madhe;
13. që e bëra edhe me djem, të cilët i ka me vete.
14. Unë ia kam dhënë të gjitha mundësitë,
15. ndërsa ai lakmon që t'ia shtoj edhe më tepër!
16. Por jo! Ai u tregua vërtet mohues i fakteve Tona!
17. Atë do ta ndrydh dhe do ta ngarkoj me një dënim të rëndë e të padurueshëm.
18. Ai mendonte dhe gjykonte!
19. Qoftë i shkatërruar! Po si gjykonte?!
20. Prapë qoftë i shkatërruar! E si gjykonte?!
21. Ai thellohej e thellohej në mendime,
22. pastaj vrenjtej dhe bëhej i vrazhdë.
23. Por në fund, ktheu shpinën dhe tregoi mendjemadhësi.
24. Ai tha: "Ky nuk është gjë tjetër, veçse një magji, që përcillet prej të tjerëve.
25. Ky nuk është gjë tjetër, veçse "fjalë njerëzish""!
26. Prandaj Unë do ta flak atë në Sekar!
27. E ku e di ti se çfarë do të thotë *Sekar*?!
28. Ai është i tillë që nuk lë send pa e djegur.
29. Ai i përcëllon dhe i nxin lëkurat.
30. Nëntëmbëdhjetë janë mbikëqyrësit e tij.

Shpjegimi i ajeteve

Këto ajete janë shpallur dhe flasin për El Uelid Ibn Mugirah, urrejtësin, kundërshtuesin dhe armikun e hapur të së vërtetës, Allahut dhe të Profetit të Tij. Allahu i Madhëruar e paralajmëroi këtë njeri ashtu si asnjë tjetër, duke i treguar atij dhe neve se si do të jetë ndëshkimi për këdo që armiqësohet me të vërtetën dhe me inat e

refuzon dhe e shpërfill atë. Ai na tregon se të tillët do të jenë të poshtëruar në dynja, ndërsa në ahiret ndëshkimi do të jetë më poshtërues dhe i hidhur se ai i dynjasë. Thotë i Madhërishmi:

- "Ma lër Mua atë që e krijova të vetmuar, që i mundësova të ketë pasuri të madhe; që e bëra edhe me djem, të cilët i ka me vete." – Kuptimi: E krijova atë të vetmuar, pa pasuri dhe pushtet, pa mbështetës e pasues. Pastaj, në vazhdimësi, e begatuam dhe u kujdesëm për të, duke i dhënë pasuri, duke i falur djem, të cilët i qëndrojnë gjithnjë pranë, për t'i kënaqur zemrën dhe syrin dhe për t'i qenë krah e mbështetje.

Gjithashtu Allahu i Madhëruar thotë:

- "Unë ia kam dhënë të gjitha mundësitë, ndërsa ai lakmon që t'ia shtoj edhe më tepër!" - Kuptimi: I dhashë shumë shanse në këtë dynja, në mënyrë që ai të arrinte çdo gjë që dëshironte prej saj. Por, pas këtyre, ai pretendon se do të arrijë edhe mirësitë e ahiretit, ashtu sikurse arriti ato të dynjasë, duke menduar se është i zoti për gjithçka që dëshiron, ashtu si në dynja.

I Madhëruari e hedh poshtë këtë iluzion, duke thënë:

- "Por jo! Ai u tregua vërtet mohues i fakteve Tona! Atë do ta ndrydh dhe do ta ngarkoj me një dënim të rëndë e të padurueshëm." – Jo, nuk është aspak ashtu si i mendon ky i vetëkënaqur e i mashtruar nga pushteti dhe mundësitë që i janë dhënë në këtë dynja. Ai do të befasohet me të kundërtën e asaj që ëndërron, sepse ai është kokëfortë kundrejt ajeteve të Allahut. Allahu e cilëson atë si '*aniid*' - kokëfortë, që i njeh dhe i kupton tërësisht argumentet, por përsëri i mohon ato. Faktet e qarta e ftojnë atë që t'i nënshtrohet së vërtetës, por ai nuk nënshtrohet dhe nuk bindet. Megjithatë, ai nuk mjaftohet që mohon padrejtësisht të vërtetën, por e lufton atë me fjalë dhe me vepra, për ta hedhur poshtë dhe për ta paraqitur si një diçka të kotë dhe të pavërtetë. Allahu i Madhëruar thotë për këtë të mjerë dhe për këdo që i përngjan atij:

- "Ai mendonte dhe gjykonte!" - Ai mendua gjatë për mënyrën se si do ta trajtonte Kuranin, me qëllimin për ta hedhur poshtë dhe deklaruar si të pavëretë, si libër jo të shpallur nga Zoti.

- "Qoftë i shkatërruar! Po si gjykonte?! Prapë qoftë i shkatërruar! E si gjykonte?! Ai thellohej e thellohej në mendime, pastaj vrenjtej dhe bëhej i vrazhdë." – Qoftë i shkatërruar, sepse ai doli në një përcaktim që nuk i takonte dhe që nuk duhej të guxonte ta bënte. Ai nuk kishte asnjë të drejtë ta bënte këtë, sepse është paturpësi që të japësh të atillë gjykim për Librin dhe Shpalljen e Zotit. Është jashtë kapacitetit të njeriut që të gjykojë mbi Librin e të Madhërishmit.

Ai, pasi u mendua mirë për atë që do të shpifte kundër Kuranit, u vrenjt në fytyrë, duke treguar urrejtje për të vërtetën dhe mosdëshirë për ta pranuar atë. Në përfundim, ai i ktheu shpinën të vërtetës dhe nisi me shpifjet dhe trillimet rreth Shpalljes së Zotit.

- "Por në fund, ktheu shpinën dhe tregoi mendjemadhësi. Ai tha: "Ky nuk është gjë tjetër, veçse një magji, që përcillet prej të tjerëve. Ky nuk është gjë tjetër, veçse "fjalë njerëzish"!" – Kështu, ai tha: Kjo nuk është

fjalë e Allahut, por fjalë e njerëzve. Madje nuk është as fjalë e njerëzve të mirë, por e njerëzve më të këqij, fjalë e magjistarëve.

Mallkuar qoftë ky njeri! Sa larg të vërtetës shkoi dhe sa shumë e meritoi ndëshkimin!? Si është e mundur që një njeri ta krahasojë Fjalën më madhështore dhe më të lartë, Fjalën e Zotit të madh, Bujarit të Madhërishëm, me fjalën e krijesave të varfëra dhe të mangëta?! Si e mori guximin ky gënjeshtar kokëfortë që të gjykonte në këtë mënyrë fjalën e Zotit, që i krijoi krijesat në fillim dhe që do t'i ringjallë pas vdekjes?! Një arrogant i tillë meriton veçse ndëshkimin më të ashpër dhe poshtërues, siç thotë i Lartësuari:

- "Prandaj Unë do ta flak atë në Sekar! E ku e di ti se çfarë do të thotë *Sekar*?!" – Ky është zjarr që përshkon gjithçka. Dhimbja që shkakton ai e përfshin totalisht të dënuarin.

- "Ai është i tillë që nuk lë send pa e djegur. Ai i përcëllon dhe i nxin lëkurat." - Ai të zhyt në dhimbje dhe në ndëshkim. Flakët e tij përpijnë gjithçka. Me ashpërsinë dhe nxehtësinë e madhe të tij, ai nuk u lë asnjë shpresë të ndëshkuarve.

- "Nëntëmbëdhjetë janë mbikëqyrësit e tij." – Xhehenemin e mbikëqyrin nëntëmbëdhjetë melekë të Zotit, të cilët janë të fortë dhe të vrazhdë. Ata kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por veprojnë dhe i ekzekutojnë ato me përpikmëri.

Për shkak të forcës dhe ashpërsisë së tyre, Allahu i Madhëruar i zgjodhi për të qenë gardianë të Xhehenemit.

Ajetet 31 – 37

31. Ne bëmë mbikëqyrës të Zjarrit veç engjëj, numrin e të cilëve e bëmë veçse si *fitne* për ata që nuk besojnë, që të binden ata që u është dhënë Libri, që besimtarëve t'u shtohet edhe më shumë besimi, që ata të cilëve u është dhënë Libri dhe besimtarët të mos kenë asnjë dyshim, ndërsa ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje dhe jobesimtarët të thonë: "Çfarë deshi Allahu me këtë shembull?" Ja, kështu Allahu e lë të humbur atë që Ai do dhe e udhëzon atë që do. Ushtritë e Zotit tënd nuk i di askush veç Tij. Ky është veçse një përkujtim për njerëzit.
32. Jo, betohem në Hënën, nuk është ashtu!
33. Edhe në natën, kur ajo tërhiqet!
34. Edhe në agimin, kur ai shkrep!
35. S'ka dyshim se ai është një nga vështirësitë më të mëdha!
36. Ai është vërejtje për njerëzit!
37. Për atë nga mesi juaj që dëshiron të përparojë apo të ngecë në vend.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne bëmë mbikëqyrës të Zjarrit veç engjëj, numrin e të cilëve e bëmë veçse si *fitne* për ata që nuk besojnë..." – Në bazë të kuptimit të fjalës '*fitne*', ajeti mund të kuptohet në dy mënyra:
1. *fitne* = ndëshkim.
Kuptimi i ajetit: Atë numër melekësh e bëmë për të ndëshkuar kriminelët në ahiret dhe për t'i dëshpëruar ata ditën kur të ballafaqohen me këta melekë në Xhehenem.
Në Kuran, fjalën '*fitne*' me kuptimin 'ndëshkim' e gjen edhe në suren Tur, ku Allahu i Lartësuar thotë: "*Dhuku fitnetekum*", pra, "Shijoni ndëshkimin tuaj!", ose në ajetin: "*Jeume hum alen-nari juftenun*" – "...ditën kur do të ndëshkohen në Zjarr".
2. *fitne* = sprovë.

Kuptimi i ajetit: Ne ju treguam për numrin e melekëve për t'ju provuar kush do të besojë e kush jo.

Varianti i dytë mbështetet nga konteksti i këtij ajeti dhe nga ajetet në vijim, ku Allahu i Lartësuar thotë:

- **"...që të binden ata që u është dhënë Libri, që besimtarëve t'u shtohet edhe më shumë besimi..."** - Sa u përket ithtarëve të Librit, nëse kjo është e njëjtë me atë që kanë në librat e tyre, atyre do t'u shtohet siguria për të vërtetën e sjellë nga Kurani. Ndërsa besimtarët muslimanë, sa herë që zbret ndonjë shpallje nga Zoti, ata e besojnë dhe e pranojnë, pa shprehur rezerva apo mëdyshje, dhe kështu imani i tyre shtohet e forcohet.

- "...që ata të cilëve u është dhënë Libri dhe besimtarët të mos kenë asnjë dyshim..." – Domethënë, që atyre t'u largohet çdo dyshim nga e vërteta e Zotit.

Ky është qëllimi i lartë, që duan të arrijnë të mençurit e të urtët. Ata përpiqen e sakrifikojnë shumë për të patur *jakin*-in, sigurinë e plotë të imanit. Ata synojnë të arrijnë dijen e saktë dhe të plotë për çdo çështje të fesë e të besimit, sepse kështu largojnë çdo dyshim, që i pengon njerëzit për pranimin e të vërtetës. Allahu i Madhëruar e bëri Shpalljen, që ia dhuroi Profetit (a.s.), si burim të pashtershëm të urtësive të mrekullueshme, të cilat forcojnë besimin dhe largojnë dyshimet.

Por kjo Shpallje do të bëjë edhe dallimin mes të sinqertëve dhe gënjeshtarëve mosbesues, në varësi të mënyrës se si ata do të trajtojnë ajetet e Zotit të Madhëruar, i Cili thotë:

- **"...ndërsa ata që në zemrat e tyre kanë sëmundje dhe jobesimtarët të thonë: "Çfarë deshi Allahu me këtë shembull?""** - Ata që i kanë zemrat të sëmura me sëmundjen e dyshimit dhe të hipokrizisë, ashtu si dhe mohuesit, thonë: "Çfarë deshi Zoti me këtë shembull?!" Kështu, ata tregojnë se janë të çoroditur, të zhytur në dyshime dhe mohues të ajeteve të Allahut.

Në lidhje me besimin në Shpalljen e Allahut, njerëzit ndahen në:
- të udhëzuar, të cilëve Allahu u ka dhënë sukses të besojnë Shpalljen e Tij;
- të paudhëzuar, të cilëve Allahu nuk u ka dhënë sukses të pranojnë Shpalljen e Tij. Këta i nënvleftësojnë dhe hedhin dyshime për ajetet e Allahut.

Ky është udhëzimi i Allahut, të cilin Ai ia jep atij që Ai do, siç thuhet më pas:

- **"Ja, kështu Allahu e lë të humbur atë që Ai do dhe e udhëzon atë që do."** - Ata të cilët Zoti i udhëzon e konsiderojnë Shpalljen e Tij ashtu sikurse është: mëshirë e mirësi, si përforcues dhe shtues të imanit dhe si plotësues të fesë së tyre. Ndërsa për ata që Ai i ka lënë në humbje, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij, kjo Shpallje bëhet shkak për shtimin e dëshpërimit dhe fatkeqësisë së tyre. Ata tregohen mohues, ndërkohë që kanë për detyrë t'i pranojnë fjalët dhe porositë e Allahut dhe të Profetit të Tij, duke u dorëzuar dhe duke punuar e jetuar sipas tyre.

- "Ushtritë e Zotit tënd nuk i di askush veç Tij." - Ushtritë e Zotit, me melekë e me krijesa të tjera, nuk i di askush tjetër, veç Zotit që i krijoi. Atëherë, meqenëse ju nuk dini gjë rreth ushtrive të Tij, atëherë është

detyrim për ju që t'u besoni fjalëve të Tij, pa pasur e shprehur asnjë dyshim a pasiguri.

- "Ky është veçse një përkujtim për njerëzit." - Ky paralajmërim nuk është një kotësi dhe lojë, por ka një qëllim të rëndësishëm. Ai është sjellë për të përkujtuar njerëzit, me qëllim që t'i udhëzojë ata te gjërat që u sjellin dobi dhe për t'i larguar nga çdo vepër e dëmshme për ta.

- "Jo, betohem në Hënën, nuk është ashtu! Edhe në natën, kur ajo tërhiqet! Edhe në agimin, kur ai shkrep!" - Allahu i Madhëruar betohet në Hënën, kur ajo është e plotë, betohet në natën, kur ajo largohet e ia lë vendin ditës, dhe në agimin, kur ai çel. Këto janë betime të rëndësishme në disa krijesa të mrekullueshme, të cilat janë shenja madhështore të Allahut të Lartësuar. [39] Ato dëshmojnë për pushtetin e urtësinë e Tij të plotë e absolute, tregojnë për sundimin dhe mbretërimin e Tij të gjerë, për mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse, si edhe për diturinë e Tij të madhe dhe të pakufishme.

Po përse betohet i Madhëruari? Ai thotë:

- "S'ka dyshim se ai është një nga vështirësitë më të mëdha! Ai është vërejtje për njerëzit! Për atë nga mesi juaj që dëshiron të përparojë apo të ngecë në vend." – Pra, Zjarri pa dyshim që është nga çështjet më të mëdha dhe më të rëndësishme, për të cilin duhet patur shumë kujdes.

Kështu, i Madhëruari betohet për vërtetësinë e zjarrit të Xhehenemit. Kjo do të thotë që, secili prej nesh që dëshiron të përparojë, le të bëjë ato vepra që e afrojnë te Zoti dhe që fitojnë kënaqësinë e Tij, le të nxitojë drejt Xhenetit të bujarisë së të Gjithëmëshirshmit, në atë vend ku Ai i nderon të zgjedhurit e Tij. Ndërsa ata që nuk e dëshirojnë afrimin me Zotin dhe mirësitë e premtuara prej Tij, ata vazhdojnë e merren me kotësira e mosbindje ndaj Zotit. Ata i kanë kthyer shpinën qëllimit për hir të të cilit Zoti i krijoi, pra, adhurimit të përkushtuar ndaj Tij, si Një i Vetëm dhe i Pashoq, me dashuri e madhërim. Ata nuk synojnë ato fjalë e vepra që Zoti i dëshiron prej tyre, por zhyten në gjynahe e në mosbindje, në mospërfillje të paralajmërimeve të sjella nga Zoti, përmes shpalljeve dhe profetëve. Kështu, ata vazhdojnë të afrohen në zjarrin e Xhehenemit, derisa e bëjnë të pakthyeshëm ndëshkimin në të.

I Lartësuari e ka qartësuar të vërtetën dhe rrugën që të çon tek Ai dhe në Xhenetet e Tij. Ai, gjithashtu, i ka nxitur njerëzit që të kryejnë ato vepra që i ka treguar në Shpalljen e Tij. Pas kësaj, çdo njeri ose do të besojë i qartë, ose do të mohojë i qartë dhe me vetëdije të plotë. Në një ajet tjetër, i Madhëruari thotë: "Thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj, prandaj kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zjarr, muret e të cilit do t'i rrethojnë ata. Nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran, që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije e vend i keq është ai!" [Kehf, 29].

Ajetet 38 – 48

38. **Çdo njeri është peng i veprave të veta!**
39. **përveç të djathtëve,**

[39] Allahu i madhëruar betohet në krijest e Tij ndërsa krijesat nuk lejohet të betohen veçse për Allahun zotin e tyre.

40. të cilët do jenë në Xhenete dhe do i bëjnë pyetje njëri-tjetrit
41. dhe zullumqarëve:
42. "Çfarë ju solli në Sekar?"
43. Ata do përgjigjen: "Nuk ishim prej atyre që falnin namaz,
44. nuk ushqenim të varfërit,
45. por përziheshim me të tjerët në vepra të kota.
46. Ne, gjithashtu, nuk e besonim Ditën e Gjykimit,
47. derisa na erdhi e vërteta e sigurt!"
48. Tashmë, atyre nuk do t'u bëjë më dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Çdo njeri është peng i veprave të veta!"** - Çdokush është peng i veprave të veta të këqija, që janë në kundërshtim me porositë e Zotit. Ato i rëndojnë dhe i mbështillen atij rreth qafës. Nëse ai nuk çlirohet prej tyre, ato kanë për ta hedhur në ndëshkim. Ato e mbajnë robin të lidhur, aq sa ai nuk ka nga lëviz. Vetëm kush çlirohet prej tyre do të jetë i shpëtuar dhe i lumtur.

Më tej, i Madhëruari thotë:

- "Përveç të djathtëve, të cilët do jenë në Xhenete dhe do i bëjnë pyetje njëri-tjetrit dhe zullumqarëve..." – Pra, këta nuk kanë mbetur të lidhur pas gjynaheve të tyre, duke kënaqur dëshirat dhe epshet vetjake, por janë të çliruar dhe gëzojnë lumturinë që të fal adhurimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit. Në ahiret, ata do të jenë në Xhenet, ku do të bisedojnë me njëri-tjetrin rreth kriminelëve. Atje do t'u përmbushet çdo kërkesë e kënaqësi që e dëshirojnë, duke shijuar rehatinë dhe prehjen e plotë. Të kënaqur e të gëzuar do të bisedojnë me njëri-tjetrin si vëllezër. Gjatë bisedave të tyre, ata do të pyesin njëri-tjetrin për kriminelët dhe gjendjen ku ata kanë përfunduar. Gjithashtu, duke vështruar kriminelët që ndëshkohen në mesin e Xhehenemit, do t'i pyesin në e kanë parë të vërtetuar tashmë premtimin e Allahut. Pastaj do t'i pyesin:


- "Çfarë ju solli në Sekar?" – Cili qe shkaku që ju futi në Xhehenem? Çfarë gjynahu bëtë, që merituat ndëshkimin në Zjarr?

- **"Ata do përgjigjen: "Nuk ishim prej atyre që falnin namaz, nuk ushqenim të varfërit, por përziheshim me të tjerët në vepra të kota."** – Ata nuk patën as sinqeritet në adhurimin e Allahut dhe as bamirësi ndaj krijesave në nevojë. Ata ishin bosh nga këto vlera e vepra të domosdoshme e u morën me gjëra të kota.

Kështu, zullumqarët do ta pranojnë që janë marrë vetëm me kotësira, madje që kanë gjetur prehje me to. Ata do ta pranojnë që, nëpërmjet saj, janë përpjekur të hidhnin poshtë të vërtetën.

- "Ne, gjithashtu, nuk e besonim Ditën e Gjykimit..." - Ky është përfundimi i angazhimit me të kotën dhe i shpërfilljes së të vërtetës e porosive të Zotit. Mohimi i të vërtetës, sidomos për Ditën e Gjykimit, atëherë kur Zoti do t'i shpërblejë njerëzit sipas veprave të tyre, është shkaku i dëshpërimit dhe i ndëshkimit të përjetshëm. Atë ditë, krijesave do t'u shfaqet i qartë dhe i plotë pushteti dhe mbretërimi i Allahut. Atë ditë do të duket gjykimi i Tij i drejtë dhe i urtë për gjithçka dhe për gjithkënd.

- "...derisa na erdhi e vërteta e sigurt!" - Kështu vazhduan në këto errësira, derisa i befasoi vdekja. Kur i kapi vdekja, humbi dhe


الجزء التاسع والعشرون سورة القيامة

فَمَا لَهُمْ عَنِ التَّذْكِرَةِ مُعْرِضِينَ ﴿٤٩﴾ كَأَنَّهُمْ حُمُرٌ مُّسْتَنفِرَةٌ ﴿٥٠﴾ فَرَّتْ مِن قَسْوَرَةٍ ﴿٥١﴾ بَلْ يُرِيدُ كُلُّ امْرِئٍ مِّنْهُمْ أَن يُؤْتَىٰ صُحُفًا مُّنَشَّرَةً ﴿٥٢﴾ كَلَّا ۖ بَل لَّا يَخَافُونَ الْآخِرَةَ ﴿٥٣﴾ كَلَّا إِنَّهُ تَذْكِرَةٌ ﴿٥٤﴾ فَمَن شَاءَ ذَكَرَهُ ﴿٥٥﴾ وَمَا يَذْكُرُونَ إِلَّا أَن يَشَاءَ اللَّهُ ۚ هُوَ أَهْلُ التَّقْوَىٰ وَأَهْلُ الْمَغْفِرَةِ ﴿٥٦﴾

سورة القيامة

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَٰنِ الرَّحِيمِ

لَا أُقْسِمُ بِيَوْمِ الْقِيَامَةِ ﴿١﴾ وَلَا أُقْسِمُ بِالنَّفْسِ اللَّوَّامَةِ ﴿٢﴾ أَيَحْسَبُ الْإِنسَانُ أَلَّن نَّجْمَعَ عِظَامَهُ ﴿٣﴾ بَلَىٰ قَادِرِينَ عَلَىٰ أَن نُّسَوِّيَ بَنَانَهُ ﴿٤﴾ بَلْ يُرِيدُ الْإِنسَانُ لِيَفْجُرَ أَمَامَهُ ﴿٥﴾ يَسْأَلُ أَيَّانَ يَوْمُ الْقِيَامَةِ ﴿٦﴾ فَإِذَا بَرِقَ الْبَصَرُ ﴿٧﴾ وَخَسَفَ الْقَمَرُ ﴿٨﴾ وَجُمِعَ الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ ﴿٩﴾ يَقُولُ الْإِنسَانُ يَوْمَئِذٍ أَيْنَ الْمَفَرُّ ﴿١٠﴾ كَلَّا لَا وَزَرَ ﴿١١﴾ إِلَىٰ رَبِّكَ يَوْمَئِذٍ الْمُسْتَقَرُّ ﴿١٢﴾ يُنَبَّأُ الْإِنسَانُ يَوْمَئِذٍ بِمَا قَدَّمَ وَأَخَّرَ ﴿١٣﴾ بَلِ الْإِنسَانُ عَلَىٰ نَفْسِهِ بَصِيرَةٌ ﴿١٤﴾ وَلَوْ أَلْقَىٰ مَعَاذِيرَهُ ﴿١٥﴾ لَا تُحَرِّكْ بِهِ لِسَانَكَ لِتَعْجَلَ بِهِ ﴿١٦﴾ إِنَّ عَلَيْنَا جَمْعَهُ وَقُرْآنَهُ ﴿١٧﴾ فَإِذَا قَرَأْنَاهُ فَاتَّبِعْ قُرْآنَهُ ﴿١٨﴾ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا بَيَانَهُ ﴿١٩﴾

الجزء ٢٩ ٥٨

٥٧٧

mundësia e tyre për të shpëtuar nga ndëshkimi i të Drejtit. Në këtë moment, portat e shpresës u përplasën e u mbyllën përjetësisht para fytyrave të tyre.

- **"Tashmë, atyre nuk do t'u bëjë më dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve."** – Arsyeja është se ata ndërmjetësojnë veçse për ata me të cilët Zoti është i kënaqur, por, pa dyshim, Allahu i Drejtë dhe i Urtë nuk kënaqet me veprat e zullumqarëve.

Pasi tregon përfundimin e dhembshëm të atyre që vdesin si mohues dhe të zhytur në kotësi, Allahu i Madhëruar vijon të paralajmërojë e këshillojë ata që ende nuk kanë vdekur dhe janë duke vazhduar në kotësinë e mosbindjes ndaj Tij.

Ajeti 49 – 56

49. Po çfarë kanë ata që i largohen këshillës?
50. Ata janë si gomarë të egër të trembur,
51. që vrapojnë prej luanit.
52. Secili prej tyre dëshiron t'i jepet një libër i posaçëm.
53. Jo! Ata nuk i frikësohen botës tjetër.
54. Jo, sepse kjo është, pa dyshim, një këshillë e vyer,
55. që, kush dëshiron, përfiton prej saj.
56. Por ata mund të mësojnë prej saj, vetëm nëse do Allahu. Vetëm Ai e meriton që t'i ruhesh dhe që të jetë Falës i gjynaheve!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Po çfarë kanë ata që i largohen këshillës? Ata janë si gomarë të egër të trembur, që vrapojnë prej luanit."** – Ata janë të pavëmendshëm, mospërfillës e të painteresuar. Ata i largohen dhe i urrejnë aq shumë paralajmërimet dhe kërcënimet e Allahut, sa u përngjajnë gomarëve të egër, që vrapojnë të të tmerruar nga luani dhe që trembin edhe njëri-tjetrin, që të largohen sa më shumë. Ja, kështu i largohen ata të vërtetës.

Me gjithë urrejtjen që kanë për të vërtetën, ata lëshojnë pretendime të mëdha, sikurse thotë i Madhëruari :

- "Secili prej tyre dëshiron t'i jepet një libër i posaçëm. Jo! Ata nuk i frikësohen botës tjetër." - Ata pretendojnë që mund t'i nënshtrohen të vërtetës veçse nëse secilit prej tyre i zbret nga qielli një libër i shkruar. Në fakt, ata janë veç gënjeshtarë. Sikur çdo lloj shenje e argumenti t'u sillej atyre nga Zoti dhe Kurani, ata nuk do ta besonin të vërtetën, derisa të shohin ndëshkimin e dhembshëm. Atyre u kanë ardhur argumente shumë të qarta për të vërtetën,

prandaj, nëse do të kishin ndonjë fije mirësi, do të kishin besuar. Më pas, i Madhëruari thotë:

- "Jo, sepse kjo është, pa dyshim, një kështillë e vyer..." - Allahu i Madhëruar nuk do t'ua japë kurrë atë që kërkojnë, sepse ata, me këto mrekulli e shenja, thjesht duan të justifikojnë mosbesimin e tyre. Ata nuk e besojnë ahiretin dhe ringjalljen para Zotit. Nëse do ta besonin, ata nuk do të merrnin atë rrugë që kanë marrë dhe nuk do t'u ndodhte ashtu siç do t'u ndodhë.

Përemri 'kjo' në këtë fragment shënon ose këtë shpallje, ose këshillat, paralajmërimet dhe mësimet që kjo shpallje përcolli.

- "...kush dëshiron, përfiton prej saj." – Arsyeja është se Allahu i Madhëruar ua ka bërë të qartë rrugën e drejtë, argumentet dhe çdo gjë të nevojshme rreth saj. Por jo çdokush nxjerr mësime prej kësaj, sepse, siç thotë Allahu i Madhëruar:

- "Por ata mund të mësojnë prej saj, vetëm nëse do Allahu." - Dëshira dhe vullneti i Zotit janë vendimtare dhe patjetër të ekzekutueshme. Ato janë gjithëpërfshirëse: prej tyre nuk shpëton asgjë, e madhe apo e vogël qoftë, e shumtë apo e pakët.

Ky ajet është argument kundër kaderive, të cilët i përjashtojnë veprat e robërve nga dëshira dhe vullneti i Zotit. Por ky ajet është argument edhe kundër xhebrive, të cilët pretendojnë se robi nuk ka asnjë pushtet dhe nuk i është dhënë liri veprimi dhe zgjedhjeje. Këta besojnë se njeriu është i detyruar që t'i kryejë veprat e tij dhe i pafuqishëm që ta zgjedhë vetë atë që vepron.

Kështu, në këtë ajet dhe në të tjerë si ai, i Lartësuari na tregon se robi ka liri zgjedhjeje dhe dëshire, po ashtu edhe aftësi e fuqi për të bërë atë që e zgjedh vetë, me dëshirën e tij. Por kjo është sigurisht brenda vullnetit dhe dëshirës së Zotit të Urtë, të Drejtë, të Gjithëdijshëm dhe të Mëshirshëm.

- "Vetëm Ai e meriton që t'i ruhesh dhe që të jetë Falës i gjynaheve!" - Allahu i Madhëruar është i Vetmi që meriton të adhurohet dhe të Cilit duhet t'i frikësohesh më shumë se çdo gjë tjetër. Është Ai ndaj të Cilit duhet të tregohesh i devotshëm. Allahu është, gjithashtu, Falësi i madh, që e fal dhe mëshiron atë që i frikësohet Atij, duke zbatuar urdhrat e duke lënë haramet, për hir të kënaqësisë së Tij.

Këtu përfundon edhe tefsiri i sures Muddeththir.

Surja 75: El Kijameh (mekase) 40 ajete

Ajetet 1 – 6

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Betohem në Ditën e Kijametit!
2. Betohem në shpirtin shumë qortues!
3. A mendon njeriu se Ne nuk do t'ia bashkojmë sërish eshtrat atij?
4. Përkundrazi, Ne jemi të Plotpushtetshëm ta rikrijojmë sikurse ka qenë, deri te majat e gishtave të tij
5. Por njeriu dëshiron të vazhdojë edhe më tej në mëkate
6. e pyet: "Kur është Dita e Kijametit?!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Betohem në Ditën e Kijametit!" - Allahu i Madhëruar betohet në ditën e ringjalljes së krijesave, pas vdekjes së tyre. Ai betohet në ditën e daljes së njerëzve nga varret e tyre, për të qëndruar në pritje të llogarisë para Zotit të botëve.

- "Betohem në shpirtin shumë qortues!" - Këtu është fjala për të gjithë shpirtrat, të mirët dhe të këqijtë. Shpirti është quajtur 'qortues', sepse ai është vazhdimisht qortues dhe ndryshon nga një gjendje në një gjendje tjetër. Ai nuk qëndron asnjëherë në një gjendje të vetme. Ai është cilësuar qortues, edhe sepse në momentin e vdekjes ai e qorton bartësin e tij për veprat që ka bërë. Madje, shpirti i besimtarit e qorton bartësin e tij edhe në jetën e dynjasë, për gabimet dhe mangësitë e tij, për lëshimet në ndonjë detyrim, si edhe për ndonjë pakujdesi.

Allahu i Madhëruar është betuar në Ditën e Gjykimit për të përforcuar vërtetësinë e saj, se ajo nuk ka dyshim që do të ndodhë. Ai është betuar, gjithashtu, edhe në ata mbi të cilët do të ekzekutohet shpërblimi ose ndëshkimi me drejtësi.

Pastaj i Madhëruari na tregon se, gjithsesi, disa kryeneçë do ta mohojnë Ditën e Gjykimit dhe vërtetësinë e saj. Ai thotë:

- "A mendon njeriu se Ne nuk do t'ia bashkojmë sërish eshtrat atij?" - Disa njerëz dyshojnë në faktin se Zoti do t'ua bashkojë rishtaz eshtrat pas vdekjes, për t'i sjellë në një krijim të ri, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet, dhe thotë: "Kush i ngjall eshtrat, pasi ato të jenë kalbur?" Thuaji: "I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, se Ai di gjithçka për çdo krijim. Prej pemëve të gjelbra, Ai nxjerr për ju zjarrin, të cilin e ndizni. A nuk është i fuqishëm Ai që krijoi qiejt e tokën, që t'i rikrijojë ata?" Po, Ai është Krijuesi e i Gjithëdijshmi. Kur Ai dëshiron diçka, mjafton vetëm t'i thotë: "Bëhu!" - e ajo menjëherë bëhet. I Lartë është Ai, në dorën e të Cilit është pushteti mbi gjithçka dhe vetëm tek Ai do të ktheheni". [Ja Sin, 78 - 83].

Nga injoranca dhe arroganca e tyre, disa njerëz mendojnë si të pamundur për fuqinë dhe pushtetin e Zotit që Ai të realizojë diçka të tillë. Sipas tyre, është e pamundur që Zoti ta krijojë trupin e njeriut ashtu si ishte më parë. Por i Madhëruari e i Plotpushtetshmi thotë:

- "Përkundrazi, Ne jemi të Plotpushtetshëm ta rikrijojmë sikurse ka qenë, deri te majat e gishtave të tij!" - Allahu është i Plotpushtetshëm që t'i krijojë njerëzit ashtu siç i krijoi herën e parë, deri edhe majat e gishtave e të kockave të tyre. Pra, Ai është i Plotpushtetshëm ta krijojë trupin e robit nga e para, me të gjitha imtësitë e tij.

- "Por njeriu dëshiron të vazhdojë edhe më tej në mëkate e pyet: "Kur është Dita e Kijametit?!"" - Mohimi i këtyre të mjerëve nuk vjen për shkak të mungesës së fakteve që dëshmojnë për të, por sepse synimi dhe dëshira e tyre është thjesht mohimi i ringjalljes. *El fuxhur* është mohim me vetëdije. Në vijim, Allahu i Lartësuar tregon pamje të ndryshme nga Dita e Gjykimit.

Ajetet 7 – 15

7. Kur shikimi të tmerrohet,
8. kur Hëna të fshihet,
9. dhe Dielli e Hëna të bashkohen,

10. **atë ditë, njeriu do të thotë: "Ku të futem!"**
11. **Jo, nuk ka se ku të futet!**
12. **Atë ditë, vetëm te Zoti yt është kthimi.**
13. **Atë ditë, njeriu do të njihet me atë që ka bërë dhe me atë që ka lënë pa bërë.**
14. **Madje, njeriu do të jetë dëshmitar i vetvetes,**
15. **edhe nëse paraqet arsyetime.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur shikimi të tmerrohet…" - Kur të ndodhë Kijameti, shikimet do të ngrijnë nga tmerri, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Kurrsesi mos e mendo Allahun si të pavëmendshëm ndaj veprimeve të zullumqarëve; Ai vetëm po ua shtyn ndëshkimin për ditën kur vështrimet do të ngrijnë. Duke vrapuar me kokat lart, sytë e tyre të hapur nuk puliten, ndërsa zemrat i kanë të zbrazëta". [Ibrahim 42, 43].

- "…kur Hëna të fshihet…" - Drita e Hënës do të shuhet.

- "…dhe Dielli e Hëna të bashkohen…" - Ata nuk janë bashkuar asnjëherë me njëri tjetrin, që kur Zoti i krijoi. Por Ditën e Gjykimit Zoti do t'i bashkojë ata. Dielli do të mbështillet e drita e tij do të zhduket, ashtu si edhe drita e hënës. Pastaj ata të dy do të hidhen në zjarrin e Xhehenemit, që robërit të shohin se Dielli e Hëna ishin thjesht dy krijesa të Zotit, të nënshtruara ndaj Tij. Në këtë mënyrë, kush ka adhuruar Diellin dhe Hënën do të bindet se ka qenë i mashtruar dhe mashtrues.

- "…atë ditë, njeriu do të thotë: "Ku të futem!"" - Kur njeriu të shohë këtë ngjarje të frikshme, do të mendojë për shpëtim, duke thënë: "Ku të shkoj? Si mund të shpëtoj nga kjo që po ndodh?"

- "Jo, nuk ka se ku të futet! Atë ditë, vetëm te Zoti yt është kthimi." - Nuk ka asnjë strehë mbrojtëse, përveçse tek Allahu. Përfundimi i të gjithëve është para Allahut. Të gjithë robërit, pa përjashtim, do të grumbullohen para të Gjithëpushtetshmit. Askush nuk do të ketë mundësi të fshihet apo t'i shmanget Atij. Të gjithë do të mblidhen bashkë, për t'u shpërblyer sipas veprave që kanë bërë.

- "Atë ditë, njeriu do të njihet me atë që ka bërë dhe me atë që ka lënë pa bërë." – Ditën e Gjykimit do të paraqiten të gjitha punët e njeriut, të mirat e të këqijat, të parat dhe të fundit, dhe ai nuk mund të mohojë asnjë prej tyre. Ai do të jetë i vetëdijshëm për to dhe do të pranojë gjithçka. Thotë i Madhëruari:

- "Madje, njeriu do të jetë dëshmitar i vetvetes, edhe nëse paraqet arsyetime." - Ai mund ta gjykojë veten e vet, edhe nëse mund të hedhë justifikime, të cilat janë të papranueshme dhe të pavlefshme.
Vetë robi do të pranojë çdo punë që ka bërë dhe do të dëshmojë për vërtetësinë e saj, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Lexo librin tënd, sot mjafton të jesh vetë llogaritës i vetvetes". [Isra 14]. Edhe nëse ai kërkon të mohojë ose të justifikohet për atë që ka bërë, kjo do të jetë e pavlefshme, sepse do të jenë vetë dëgjimi, shikimi dhe të gjitha gjymtyrët e tij që do të dëshmojnë se ç'ka bërë. Mundësia për të rregulluar diçka tashmë ka përfunduar dhe çdo përpjekje është e padobishme, siç thuhet në këtë ajet: "Atë ditë, atyre që kanë bërë zullum nuk do

t'u bëjë dobi arsyetimi e as që do t'u kërkohet të justifikohen." [Rum 57].

Ajetet 16 – 19

16. Ti mos u ngut me gjuhë, që ta lexosh atë sa më shpejt,
17. sepse e kemi Ne detyrë se si do të ngulitet dhe lexohet ai!
18. Pasi të ta kemi lexuar atë, atëherë fillo ti!
19. Pastaj e kemi Ne për detyrë që ta sqarojmë atë.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ti mos u ngut me gjuhë, që ta lexosh atë sa më shpejt..." - Kur engjëlli Xhibril (a.s.) i përcillte Shpalljen e Zotit, Profeti (a.s.) nxitonte të përsëriste fjalët e saj, ndërkohë që Xhibrili (a.s.) ende nuk kishte përfunduar së lexuari të gjithë mesazhin. Profeti (a.s.) e bënte këtë me qëllim që ta fiksonte menjëherë atë dhe të mos e harronte. Por i Madhëruari e këshilloi që të mos vepronte ashtu, sikurse thotë në një ajet tjetër: "I Lartë është Allahu, Sundimtari i vërtetë. Ti mos nxito me Kuranin para se të përfundojë shpallja e tij, por thuaj: "Zoti im, ma shto diturinë!" [Ta Ha 114]. Ndërsa këtu, i Lartësuari thotë: "Ti mos u ngut me gjuhë, që ta lexosh atë sa më shpejt!", sepse është Allahu i Madhëruar Ai që do të mundësojë që Profeti i Tij ta mësojë dhe lexojë Kuranin e çmuar. Është Allahu që do ta ngulisë atë në gjoksin e Profetit të Tij, siç thotë më tej:

- "...sepse e kemi Ne detyrë se si do të ngulitet dhe lexohet ai!" – Kuptimi: Përpjekja dhe nxitimi yt për të përsëritur vjen nga frika se mos e harron dhe nuk e fikson mirë mesazhin në zemrën tënde, por kur Allahu të siguron që nuk do të ketë harresa dhe ngatërresa në këtë drejtim, atëherë nuk ke nevojë më që të kryesh diçka të tillë.

- "Pasi të ta kemi lexuar atë, atëherë fillo ti!" - Kuptimi: Vetëm pasi Xhibrili (a.s.) të ketë mbaruar së kënduari Shpalljen Tonë për ty, atëherë mund ta lexosh atë. Pastaj është vetë i Madhëruari që do të ta mësojë ty kuptimin e kësaj Shpalljeje:

- "Pastaj e kemi Ne për detyrë që ta sqarojmë atë." – Kështu, i Madhëruari premton se do ta ruajë tekstin e Kuranit nga ndryshimet, tjetërsimet apo nga harresa, madje do të ruajë edhe shpjegimin e tij të saktë. Kjo është grada më e lartë e sigurisë dhe e ruajtjes.

Pas kësaj këshille nga Zoti i tij, Muhamedi (a.s.) e dëgjonte Xhibrilin deri në fund, dhe pastaj vijonte ta lexonte ai këndimin e Kuranit.

Ky ajet na mëson, gjithashtu, diçka rreth e dukatës së marrjes dhe nxënies së diturisë. Kështu, nxënësi nuk duhet të nxitohet dhe t'i ndërhyjë mësuesit, para se ai të mbarojë së shpjeguari dhe shtjelluari temën e mësimit. Vetëm pasi të ketë mbaruar mësuesi, nxënësi mund të pyesë për ato gjëra që i ka të paqarta. Gjithashtu, nxënësi nuk duhet të nxitohet në nxjerrjen e konkluzioneve, kur mësuesi ende nuk ka përfunduar mirë shpjegimin e mësimit. Vetëm pasi mësuesi të ketë mbaruar me shtjellimin e çështjes, atëherë nxënësi mund t'i ketë gjërat më të qarta, për të nxjerrë një konkluzion të saktë.


Ajeti dëshmon, gjithashtu, se Profeti (a.s.), ashtu sikurse ia mësoi umetit të tij tekstin, leximin dhe këndimin e e Kuranit, po ashtu u mësoi atyre edhe kuptimin dhe shpjegimin e saktë të tij.

Ajetet 20 – 25

20. Por ju doni këtë të ngutshmen
21. dhe e lini pas dore atë të ardhmen.
22. Atë ditë do të ketë fytyra të ndritura,
23. që Zotin e tyre do të shikojnë.
24. Atë ditë do të ketë edhe fytyra të zymta,
25. që presin t'u thyhet kurrizi.

Shpjegimi i ajeteve

- "Por ju doni këtë të ngutshmen dhe e lini pas dore atë të ardhmen." – Kuptimi: Ajo që ju bën të jeni të shkujdesur dhe që t'i ktheni shpinën përkujtimit të Zotit dhe këshillave të Tij është pikërisht dashuria juaj e madhe për këtë dynja. Ju punoni pa u lodhur për kënaqësitë dhe bukuritë e saj, për të përmbushur epshet dhe dëshirat tuaja. Dashuria për të ju bën që t'i jepni përparësi asaj dhe ta lini punën për fitimin e mirësive të premtuara nga Zoti në ahiret. Ju parapëlqeni dynjanë, sepse kënaqësitë dhe bukuritë e saj shijohen shpejt dhe njeriu është i nxituar dhe e do të shpejtën. Ndërsa mirësitë e ahiretit vonohen, edhe pse janë të përjetshme e të pafundme. Ju shpërfillni punën për ahiretin, a thua se nuk jeni krijuar për të, por për t'u përjetësuar në dynja. E trajtoni këtë dynja të shkurtër sikur të jetë ajo vendi i përjetësisë, për të cilën ia vlen të shpenzosh çdo gjë të vyer dhe që të luftosh natën e ditën. Kështu, ju e transformoni realitetin dhe i përmbysni qëllimet tuaja, për të shkaktuar dëshpërimin dhe shkatërrimin e vetvetes. Nëse do t'i jepni përparësi ahiretit kundrejt dynjasë dhe të vështroni me kujdes përfundimin e punëve, do të fitoni shumë mirësi, pa asnjë humbje, dhe do të arrini lumturinë e përhershme, që nuk e prish asnjë trishtim.



Pastaj i Lartësuari përmend disa gjëra, të cilat mund të na nxisin për t'i dhënë përparësi ahiretit. Ai na tregon shpërblimin e ahiretit për të mirët, duke thënë:

- "Atë ditë do të ketë fytyra të ndritura…" – Fytyrat do të jenë të bukura, të shndritshme, të këndshme dhe vezulluese, prej lumturisë nga mirësitë dhe kënaqësitë që përjetojnë në ahiret. Lumturia dhe kënaqësia shpirtërore reflektohen qartë në fytyrat e tyre, duke i zbukuruar dhe duke u dhënë një shkëlqim vezullues. E si të mos shkëlqejnë nga lumturia, kur Allahu i lartësuar thotë për ta se:

- "…Zotin e tyre do të shikojnë." - Ata do të vështrojnë Zotin e tyre, në varësi të gradave ku ndodhen. Do të ketë prej tyre që do ta shohin Allahun çdo ditë, mëngjes e mbrëmje, ashtu si do të ketë që do ta shohin

çdo ditë xhumaje. Sidoqoftë, të gjithë ata do të përjetojnë një lumturi të madhe kur të vështrojnë Fytyrën e të Madhëruarit dhe bukurinë e Tij mahnitëse, që nuk i përngjan asgjëje. Kur të shohin Atë, do të harrojnë çdo mirësi tjetër që i rrethon. Ata do të përjetojnë një lumturi, e cila nuk mund të shprehet dot me fjalë. Kjo do të duket qartë në fytyrat e tyre të shndritshme dhe të ngazëllyera. Kur të shohin Zotin e tyre, këto fytyra do të zbukurohen shumë e më shumë, mbi bukurinë që kanë. E lus Allahun Bujar të na bëjë prej tyre dhe të na bashkojë me ata fatlumë!

Ndërsa kur flet për ata që i dhanë përparësi dynjasë kundrejt ahiretit të përjetshëm, Allahu i Madhëruar thotë:

- "Atë ditë do të ketë edhe fytyra të zymta, që presin t'u thyhet kurrizi." – Ato do të jenë të zymta dhe të vrenjtura nga frika, të poshtëruara e të tmerruara nga ndëshkimi i rëndë që i pret.

Ajetet 26 – 40

26. Jo! Kur shpirti t'i arrijë në gropë të fytit,
27. dhe kur të thonë: "Kush do t'i këndojë?"
28. Kur ai të bindet se i ka ardhur çasti i ndarjes,
29. ndërkohë që kërcinjtë do t'i bashkohen me njëri-tjetrin,
30. atë ditë, atij i fillon rruga për te Zoti yt.
31. Por ai nuk beson dhe as nuk fal namaz,
32. por vetëm mohon dhe kthen shpinën,
33. e pastaj shkon te familja e vet, gjithë fodullëk!
34. Mjerë për ty, mjerë!
35. Mjerë për ty, mjerë!
36. A mos mendon njeriu se do të lihet pa u marrë në llogari?!
37. A nuk ka qenë ai një pikë lëng, që hidhet me forcë,
38. e pastaj u bë gjak i trashë, që Ai krijon dhe e përsos,
39. dhe, prej tij, Ai bën mashkullin dhe femrën?!
40. A nuk është Ai, pra, i Plotpushtetshëm për të ngjallur të vdekurit?!

Shpjegimi i ajeteve

- "Jo! Kur shpirti t'i arrijë në gropë të fytit..." – Këtu, Allahu i Madhëruar i përkujton robërit e Tij me gjendjen e agonisë së vdekjes. Kur shpirti të arrijë në gropë të fytit, atje ku eshtrat e dërrasës së kraharorit afrohen me gurmazin, atëherë gjendja e agonisë vështirësohet shumë dhe njeriu kërkon pak lehtësim dhe qetësi.

- "...dhe kur të thonë: "Kush do t'i këndojë?"" – Të pranishmit do të thonë: "Kush do t'i bëjë rukje ose t'i këndojë, për ta shëruar?" Pra, pasi i kanë humbur shpresat nga mjetet e njohura për shërim, ata kërkojnë format fetare të shërimit. Por kur vjen koha e përmbushjes së caktimit të Zotit, ai ekzekutohet e nuk ka kush ta ndalë apo ta kthejë pas. Atëherë robi do të bindet se po ndahet nga dynjaja.

- "Kur ai të bindet se i ka ardhur çasti i ndarjes, ndërkohë që kërcinjtë do t'i bashkohen me njëri-tjetrin, atë ditë, atij i fillon rruga për te Zoti yt." - Gjendja vështirësohet shumë, sepse po nxirret shpirti jashtë trupit, që ishte mësuar brenda tij. Ai nxirret jashtë, për t'u kthyer tek Zoti dhe për t'u shpërblyer për veprat e kryera dhe për të pranuar gjithçka që ka bërë.

Ky përkujtim për këtë moment të vështirë i nënshtron shpirtrat që të ndjekin rrugën e

shpëtimit të tyre dhe t'i largohen rrugëve të shkatërrimit. Megjithatë, kryeneçët mendjemëdhenj, tek të cilët nuk ndikojnë aspak shenjat dhe ajetet e Zotit, vazhdojnë me tejkalimin e kufijve, me gjynahe e poshtërsi.

- "Por ai nuk beson dhe as nuk fal namaz, por vetëm mohon dhe kthen shpinën, e pastaj shkon te familja e vet, gjithë fodullëk!" - Ata nuk besojnë Allahun, engjëjt, shpalljet, profetët, Ditën e Gjykimit dhe caktimin e Tij për mirë dhe për keq. Gjithashtu, ata nuk falin namazin, por e konsiderojnë gënjeshtër gjithçka që duhej të besohej dhe u kthejnë shpinën urdhrave e ndalesave të Zotit. Kjo kategori njerëzish nuk kanë drojë nga Zoti i tyre. Ata kthehen në familje të pashqetësuar nga ajo që i pret, siç është qëndrimi para Zotit dhe llogaria e vështirë. Por Allahu i Madhëruar i kërcënon:

- "Mjerë për ty, mjerë! Mjerë për ty, mjerë!" - I Madhëruari e përsërit kërcënimin për ta theksuar atë.

- "A mos mendon njeriu se do të lihet pa u marrë në llogari?!" – A mendon njeriu se do të lihet i shpërfillur, se nuk do të urdhërohet e të ndalohet, se nuk do të shpërblehet dhe nuk do të ndëshkohet? Ky, sigurisht, është një mendim i gabuar dhe arsyetim jo i saktë. Ky është një vlerësim jo i drejtë për Allahun e Madhëruar dhe për urtësinë e Tij.

Më pas, i Madhëruari i kujton njeriut fillimin e krijimit të tij:

- "A nuk ka qenë ai një pikë lëng, që hidhet me forcë, e pastaj u bë gjak i trashë, që Ai krijon dhe e përsos dhe, prej tij, Ai bën mashkullin dhe femrën?! A nuk është Ai, pra, i Plotpushtetshëm për të ngjallur të vdekurit?!" - Këto janë fazat nëpër të cilat kalon njeriu në barkun e nënës, para se të formohet e të kompletohet nga i Madhërishmi. Ai i krijoi njerëzit në çifte, meshkuj e femra. Atëherë, Ai që e krijoi njeriun në këto faza të ndryshme, a nuk është i Plotfuqishëm që t'i ringjallë të vdekurit? Pa dyshim, Ai është i Plotfuqishëm për gjithçka.

Këtu përfundon tefsiri i sures Kijame, me mirësinë dhe bujarinë e Allahut të Madhëruar.

Surja 76: El Insan (medinase) 31 ajete

Ajetet 1 – 3
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Vërtet, ka kaluar një periudhë kohore, që njeriu nuk ekzistonte as si i përmendur.
2. Ne e krijuam njeriun prej një lëngu të përzier, për ta sprovuar atë, dhe e bëmë që të dëgjojë e të shohë.
3. Ne i treguam atij rrugën e drejtë, e kështu ai do të jetë mirënjohës ose përbuzës.

Shpjegimi i ajeteve

Në këtë sure të mrekullueshme, Allahu i Madhëruar përshkruan fillesat e njeriut, vazhdimësinë dhe përfundimin e tij. Allahu i Madhëruar thotë se ka kaluar një kohë e gjatë para se njeriu të ekzistonte dhe para se emri 'njeri' të përmendej, sepse ai ende nuk ishte krijuar.

Kur Allahu deshi të krijonte njerëzit, fillimisht krijoi prej balte babain e njerëzimit, Ademin (a.s.), pastaj bëri që të tjerët të shumoheshin nëpërmjet një lloj lëngu të pështirë. Kjo qe një sprovë për njeriun: a do të kujtohet ai se si ka qenë fillesa e tij dhe të

pozicionohet ashtu si duhet, duke qenë modest dhe i nënshtruar, apo do ta harrojë këtë dhe do të tregohet arrogant dhe i vetëmashtruar?

I Madhëruari e krijoi njeriun duke i dhënë atij aftësi të brendshme dhe të jashtme, duke i dhënë shikim, dëgjim etj. Allahu i Lartësuar e kompletoi krijimin e njeriut, duke i falur çdo gjë që do të ishte e nevojshme për të. Pastaj u dërgoi popujve profetë, u zbriti libra dhe u tregoi udhën që të afron tek Ai. Kështu, Ai i ftoi në rrugën e lumturisë, duke u treguar se çfarë i pret nëse i përgjigjen kësaj ftese bujare, kur të takohen me Allahun e Madhëruar. Po ashtu, Ai këshilloi që të kenë kujdes e të largohen nga shtigjet që të çojnë drejt shkatërrimit, duke u treguar se çfarë i pret nëse hyjnë në ato shtigje.

Përballë këtyre dy alternativave, njerëzit janë ndarë në grupe:

1. Falënderuesit për mirësitë e Allahut dhe mirënjohësit e Tij. Këta janë ata të cilët angazhohen për të kryer tërësisht dhe sa më mirë detyrimet dhe përgjegjësitë me të cilat Allahu i ka ngarkuar.

2. Mohuesit e mirësive të Allahut dhe mosmirënjohësit ndaj Tij. Allahu i Madhëruar u ka dhuruar këtyre shumë mirësi të kësaj dynjaje, të fesë dhe të besimit, por ata nuk tregojnë mirënjohje dhe respekt për to. Përkundrazi, ata e mohojnë Zotin e tyre dhe janë futur në shtigjet e shkatërrimit. Në ajetet më pas, i Madhëruari tregon më në hollësi për gjendjen e këtyre dy grupeve gjatë shpërblimit për veprat e tyre.

Ajetet 4 – 22

4. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr.

5. S'ka dyshim se të devotshmit do të pinë në kupa, që kanë koktej me *kafur*,

6. i cili është një burim, prej të cilit do pinë adhuruesit e Allahut dhe të cilin do ta gjejnë atje ku do të dëshirojnë e me bollëk.

7. Janë ata që zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një dite, tmerri i së cilës është gjithëpërfshirës.

8. Janë ata që, për hir të Tij, u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të kapurve robër.

9. "Ne (thonë këta të devotshëm) po ju ushqejmë veçse për hir të Allahut dhe nuk kërkojmë prej jush ndonjë shpërblim e as falënderim.

10. Ne i frikësohemi Zotit tonë për një ditë, që fytyrat i bën të zymta dhe që është shumë e vështirë".

11. Allahu i ka ruajtur ata prej sherrit të asaj dite dhe u ka dhuruar shkëlqim në fytyra e lumturi.

12. Për shkak se ata bëjnë durim, Ai i shpërblen me Xhenet dhe me veshje mëndafshi.

13. Ata do jenë atje, të mbështetur në kolltukë dhe nuk do ndiejnë nxehtë e as të ftohtë.

14. Hijet do t'u bien sipër dhe kalaveshët e pemëve do t'u afrohen shumë.

15. Atyre do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe me gota të kristalta,

16. gota të tejdukshme prej argjendi, që ata vetë do t'i përcaktojnë si të duan.

17. Do t'u jepen gota të pinë koktej me xhenxhefil,

18. prej një burimi aty, që quhet Selsebil.

19. Mes tyre lëvizin duke shërbyer djem të rinj, që do jenë përherë të tillë e që, kur i kundron, duken si margaritarë të shpërndarë.

20. Kur hedh shikimin atje, sheh begati e pasuri të mëdha,

21. **Ata janë të veshur me mëndafsh të hollë e të gjelbër dhe me mëndafsh të trashë, të stolisur me bylyzykë të argjendtë. Ndërkohë, Zoti i tyre u jep të pinë pije të kulluar.**


22. **Ky është shpërblimi për ju, sepse e keni merituar me përpjekjet tuaja.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne kemi përgatitur për jobesimtarët zinxhirë, pranga dhe zjarr."- Për ata që kanë mohuar Allahun dhe profetët dhe që paturpësisht kanë guxuar të kryejnë gjynahe ndaj Allahut të Madhëruar, Ai ka përgatitur për ta në zjarrin e Xhehenemit zinxhirë dhe pranga, me të cilat do t'u lidhen duart dhe do t'u shtrëngohen fort pas qafe, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Kapeni atë dhe vendosjani prangat! Pastaj hidheni në Xhehenem dhe lidheni me një zinxhir të gjatë shtatëdhjetë kutë, sepse ai nuk besonte Allahun e Madhëruar." [Hakka 30 – 33].

Allahu i Madhëruar ka përgatitur edhe zjarr të ndezur fort, i cili i përfshin trupat me furi dhe i shkrumbon, sikurse ka thënë i Madhëruari: "Nuk ka dyshim se ata që kanë mohuar argumentet Tona, do t'i flakim në Zjarr. Sa herë që do t'u digjet një lëkurë, Ne do t'ua zëvendësojmë me lëkurë tjetër, që ta 'shijojnë' mirë dënimin. Me të vërtetë, Allahu është i Plotfuqishëm e i Urtë." [Nisa 56]. Ky ndëshkim do të jetë i vazhdueshëm për ta, në përjetësi.

Ndërsa bamirësit janë ata të cilët i kanë rregulluar zemrat e tyre me dashurinë për Allahun, me njohjen e Tij dhe me moral të mirë. Kështu janë përmirësuar edhe gjymtyrët e tyre, të cilat binden për të bërë veprat e mira, që kënaqin Zotin. Për këta, Zoti na tregon dhe thotë se:


الجزء التاسع والعشرون سورة الإنسان

عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا عِبَادُ اللَّهِ يُفَجِّرُونَهَا تَفْجِيرًا ﴿٦﴾ يُوفُونَ بِالنَّذْرِ وَيَخَافُونَ
يَوْمًا كَانَ شَرُّهُ مُسْتَطِيرًا ﴿٧﴾ وَيُطْعِمُونَ الطَّعَامَ عَلَىٰ حُبِّهِ مِسْكِينًا
وَيَتِيمًا وَأَسِيرًا ﴿٨﴾ إِنَّمَا نُطْعِمُكُمْ لِوَجْهِ اللَّهِ لَا نُرِيدُ مِنكُمْ جَزَاءً وَلَا شُكُورًا
﴿٩﴾ إِنَّا نَخَافُ مِن رَّبِّنَا يَوْمًا عَبُوسًا قَمْطَرِيرًا ﴿١٠﴾ فَوَقَاهُمُ اللَّهُ شَرَّ ذَٰلِكَ
الْيَوْمِ وَلَقَّاهُمْ نَضْرَةً وَسُرُورًا ﴿١١﴾ وَجَزَاهُم بِمَا صَبَرُوا جَنَّةً وَحَرِيرًا ﴿١٢﴾
مُّتَّكِئِينَ فِيهَا عَلَى الْأَرَائِكِ لَا يَرَوْنَ فِيهَا شَمْسًا وَلَا زَمْهَرِيرًا ﴿١٣﴾
وَدَانِيَةً عَلَيْهِمْ ظِلَالُهَا وَذُلِّلَتْ قُطُوفُهَا تَذْلِيلًا ﴿١٤﴾ وَيُطَافُ عَلَيْهِم بِآنِيَةٍ
مِّن فِضَّةٍ وَأَكْوَابٍ كَانَتْ قَوَارِيرَا ﴿١٥﴾ قَوَارِيرَا مِن فِضَّةٍ قَدَّرُوهَا تَقْدِيرًا ﴿١٦﴾
وَيُسْقَوْنَ فِيهَا كَأْسًا كَانَ مِزَاجُهَا زَنجَبِيلًا ﴿١٧﴾ عَيْنًا فِيهَا تُسَمَّىٰ سَلْسَبِيلًا
﴿١٨﴾ وَيَطُوفُ عَلَيْهِمْ وِلْدَانٌ مُّخَلَّدُونَ إِذَا رَأَيْتَهُمْ حَسِبْتَهُمْ لُؤْلُؤًا مَّنثُورًا
﴿١٩﴾ وَإِذَا رَأَيْتَ ثَمَّ رَأَيْتَ نَعِيمًا وَمُلْكًا كَبِيرًا ﴿٢٠﴾ عَالِيَهُمْ ثِيَابُ سُندُسٍ
خُضْرٌ وَإِسْتَبْرَقٌ وَحُلُّوا أَسَاوِرَ مِن فِضَّةٍ وَسَقَاهُمْ رَبُّهُمْ شَرَابًا
طَهُورًا ﴿٢١﴾ إِنَّ هَٰذَا كَانَ لَكُمْ جَزَاءً وَكَانَ سَعْيُكُم مَّشْكُورًا ﴿٢٢﴾ إِنَّا
نَحْنُ نَزَّلْنَا عَلَيْكَ الْقُرْآنَ تَنزِيلًا ﴿٢٣﴾ فَاصْبِرْ لِحُكْمِ رَبِّكَ وَلَا تُطِعْ
مِنْهُمْ آثِمًا أَوْ كَفُورًا ﴿٢٤﴾ وَاذْكُرِ اسْمَ رَبِّكَ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ﴿٢٥﴾

٥٧٩

- "S'ka dyshim se të devotshmit do të pinë në kupa, që kanë koktej me *kafur*..." – Do të shijojnë pije të këndshme, të përzier me *kafur*, i cili shërben për ta freskuar ose zbutur shijen e saj.

Kafuri i Xhenetit është shumë i shijshëm, i këndshëm dhe i pastër nga çdo element turbullues, që zakonisht gjendet në kafurin e dynjasë. Megjithatë, asgjë nga mangësitë e sendeve të dynjasë nuk ekziston në sendet që Zoti ka treguar se do të jenë në Xhenet, edhe pse mund të kenë të njëjtin emër. Kështu, për shembull, kur përshkruan vendpushimet e banorët e Xhenetit, i Madhëruari thotë: "Ata do rrinë në rrëzë të pemëve pa gjemba, të bananeve me fruta palë-palë." [Uakia]. Ndërsa kur përshkruan mirësitë dhe gratë e tyre në Xhenet, i Madhëruari thotë: "Përgëzoji ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, se do të kenë xhenete, nën të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë

që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Me të tilla mirësi jemi furnizuar edhe më parë". Atyre u dhurohen mirësi të ngjashme. Atje do të kenë bashkëshorte të pastra. Ata do të jenë atje *(në Xhenet)* përjetësisht.". [Bekare 25]. Ose: "Për ta është përgatitur vendi i paqes te Zoti i tyre, i Cili është mbrojtësi i tyre, për veprat që bënë". [En'am 127].

Vetëm Allahu i Lartësuar e di realitetin e kënaqësive dhe të lumturisë së shpirtrave në Xhenet. Ai thotë: "O adhuruesit e Mi, (do t'u thuhet në ahiret) sot për ju nuk ka më frikë dhe nuk do të dëshpëroheni më kurrë!". Ata i besuan shpalljet Tona dhe ishin muslimanë! "Hyni në Xhenet, ju dhe bashkëshortet tuaja, të gëzuar!" Atyre u shërbejnë me enë e gota të arta. Aty do të kenë çfarë t'u dëshirojë shpirti dhe t'u kënaqet syri. "Ju do të jeni aty përgjithmonë. Ky është Xheneti, që e trashëguat për shkak të veprave të bëtë. Aty keni plot fruta për të ngrënë"." [Zuhruf 68 – 73].

- "...i cili është një burim, prej të cilit do pinë adhuruesit e Allahut dhe të cilin do ta gjejnë atje ku do të dëshirojnë e me bollëk." - Ata nuk do kenë frikë se mos u mbarohen gotat e mrekullueshme me atë pije të shijshme. Gotat nuk u mbarojnë, sepse ato mbushen nga një burim i pashtershëm, që gjithmonë rrjedh e gurgullon. Adhuruesit e Allahut do ta bëjnë këtë burim të rrjedhë ku të dëshirojnë ata, kur të dëshirojnë dhe si të dëshirojnë. Kështu, nëse dëshirojnë, ata mund ta drejtojnë atë te kopshtet e pasura me lloj-lloj bimësie, te pallatet e tyre fantastike ose në çdo drejtim që ata duan.

Më pas, i Madhëruari tregon disa nga veprat e këtyre fatlumëve, që i bënë të meritonin këto mirësi:

- "Janë ata që zbatojnë premtimet e tyre..." - Ata çojnë në vend çdo detyrë me të cilën e kanë ngarkuar veten për hir të Allahut dhe çdo premtim ose besë të dhënë. Duke qenë se ata plotësojnë edhe këto detyra, që Zoti nuk ua ka detyruar, por që ata vetë ia kanë detyruar vetvetes, atëherë kjo do të thotë që, plotësimi i detyrave të vendosura nga Zoti është më i sigurt se do të kryhet nga ata.

- "...dhe i frikësohen një dite, tmerri i së cilës është gjithëpërfshirës." - Ata frikësohen se mos i godet tmerri i asaj dite, prandaj ruhen nga çdo gjë që e shkakton këtë.

- "Janë ata që, për hir të Tij, u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të kapurve robër." – Edhe pse mund ta dëshirojnë për vete pasurinë dhe ushqimin, ata i japin përparësi dashurisë së Allahut dhe urdhrave të Tij kundrejt dëshirave të vetes. Ata kujdesen që të ushqejnë njerëzit më të nevojshëm dhe më parësorë për këtë ndihmë, të cilët – siç i përmend Allahu i Madhëruar, – janë të varfërit, jetimët dhe robërit.

Me shpenzimet dhe ushqimin e dhënë nevojtarëve, ata synojnë vetëm kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, siç thonë më pas:

- "Ne *(thonë këta të devotshëm)* po ju ushqejmë veçse për hir të Allahut dhe nuk kërkojmë prej jush ndonjë shpërblim e as falënderim. - Nuk synojmë ndonjë shpërblim material e as ndonjë lëvdatë nga ju.

- "Ne i frikësohemi Zotit tonë për një ditë torturuese, që fytyrat i bën të zymta" - Allahu i Madhëruar e ka quajtur atë ditë

shumë të frikshme, të ashpër, të ankthshme dhe torturuese.

- "Allahu i ka ruajtur ata prej sherrit të asaj dite dhe u ka dhuruar shkëlqim në fytyra e lumturi." - Ata nuk do t'i trazojë ai tmerr i madh e gjithëpërfshirës, ndërsa melekët do t'u thonë: "Kjo është dita që ju premtohej".

Allahu i Madhëruar do t'i nderojë ata, duke u dhuruar dritë gëzimi në fytyrë dhe lumturi në zemër, mirësi të dukshme dhe të brendshme.

- "Për shkak se ata bëjnë durim, Ai i shpërblen me Xhenet dhe me veshje mëndafshi." - Ata tregohen të duruar në bindjen ndaj Zotit, duke kryer urdhrat e Tij aq sa kanë mundësi; tregohen të duruar kundrejt gjynaheve, duke i lënë ato dhe duke u larguar prej tyre, si edhe të duruar me kaderin e Zotit, duke mos u zemëruar dhe mos shprehur mospajtim me caktimin e Tij, por duke e pranuar atë me nënshtrim dhe dorëzim të plotë. Për këtë durim, Allahu i Madhëruar i shpërblen ata me Xhenet të mbushur plot mirësi dhe të ruajtur nga çdo gjë e keqe dhe dëmtuese. Ai i shpërblen ata edhe me veshje mëndafshi, sikurse thotë në një ajet tjetër: "Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Allahu i vendos në Xhenete, nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Atje stolisen me rrathë të artë e me xhevahirë, ndërsa veshjet e tyre janë të mëndafshta." [Haxh 23].

Allahu i Madhëruar e përmend në mënyrë të veçantë mëndafshin, sepse ai është diçka e dukshme, që tregon për gjendjen e mirë të njeriut që e ka veshur.

- "Ata do jenë atje, të mbështetur në kolltukë dhe nuk do ndiejnë nxehtë e as të ftohtë." – Ata do jenë të mbështetur mirë, ashtu sikurse ulesh kur dëshiron të rehatohesh dhe kënaqesh. Ata do të qëndrojnë në "*el erâik*", domethënë, në disa shtretër me mbulesa të zbukuruara. Atje nuk kanë për të ndier kurrë më vapë apo ftohtë, sepse klima në Xhenet nuk do të jetë as e nxehtë dhe as e ftohtë, por e butë dhe mesatare. Trupi kënaqet dhe rehatohet në këtë lloj klime të mrekullueshme.

- "Hijet do t'u bien sipër dhe kalaveshët e pemëve do t'u afrohen shumë." - Frutat i afrohen atij që i dëshiron, në çdo gjendje qoftë: i shtrirë, ulur e në këmbë, që ai t'i marrë kur të dëshirojë.

- "Atyre do t'u shërbehet me enë të argjendta dhe me gota të kristalta, gota të tejdukshme prej argjendi, që ata vetë do t'i përcaktojnë si të duan." - Mes banorëve të Xhenetit vërtiten djemtë e rinj, të cilët do t'u shërbejnë kupa të mbushura me pije të këndshme. Kupat janë prej argjendi, por janë të tejdukshme si diamanti. Është tepër e çuditshme: argjendi aq i dendur, të jetë i tejdukshëm si diamant!

Allahu i Madhëruar përmend edhe një hollësi tjetër rreth atyre gotave: "...që ata do t'i përcaktojnë si të duan". Pra, ato do të jenë aq sa të kënaqen dhe të ngopen besimtarët: as më shumë e as më pak. Nëse do ishin më të mëdha, ata do të veleshin, e nëse do ishin më të vogla, nuk të kënaqeshin ose ngopeshin plotësisht.

Ka mundësi që kuptimi të jetë se: do të jenë vetë banorët e Xhenetit ata që do t'i përzgjedhin e i përcaktojnë ato, sipas dëshirës dhe shijes së tyre. Dhe ato do t'u shërbehen ashtu sikurse ata i dëshirojnë në mendjen e tyre.

- "Do t'u jepen gota të pinë koktej me xhenxhefil, prej një burimi aty, që quhet Selsebil." - Në Xhenet, ata do të shijojnë gota të mbushura me pije dhe nektar, të përzier me xhenxhefil, me shije dhe aromë të mrekullueshme.

Në Xhenet ndodhet në burim, që quhet Selsebil. Ai quhet kështu për shkak të bukurisë, pastërtisë dhe rrjedhshmërisë së tij çlodhëse dhe të këndshme.

- "Mes tyre lëvizin duke shërbyer djem të rinj, që do jenë përherë të tillë..." - Mes banorëve të Xhenetit, gjatë ushqimit e gostive të tyre, do të vërtiten si shërbëtorë djelmosha të vegjël shumë të bukur, që nuk rriten dhe as ndryshojnë. Kur i sheh të shpërndahen në shërbim, ata ngjajnë si margaritarë. Kjo është një kënaqësi tjetër e banorëve të Xhenetit. Shërbëtorët e tyre do të jenë djelmosha të bukur, që të gëzojnë kur i sheh, sepse ata të shërbejnë plot gaz. Kur hyjnë nëpër banesat e xhenetlinjve, nuk ka pasiguri dhe ndrojtje prej tyre. Ata përmbushin kërkesat e xhenetlinjve në çdo moment.

- "...kur i kundron, duken si margaritarë të shpërndarë. Kur hedh shikimin atje, sheh begati e pasuri të mëdha..." - Nëse i kundron, do të shihje pasuri dhe mirësi të mëdha. Nëse do të shihje pasuritë e ndonjërit prej tyre, do të mahniteshe nga kështjellat, banesat, dhomat e gdhendura e të zbukuruara, të cilat nuk mundesh t'i përshkruash. Ata zotërojnë kopshte të lulëzuara dhe plot fruta, që janë të lehta për t'u arritur dhe të shijshme. Mes këtyre kopshteve të çuditshme, rrjedhin lumenj dhe këndojnë zogj të ndryshëm këngëtarë. Të gjitha këto kënaqin zemrën dhe lumturojnë shpirtin.

Atje, gjithashtu, presin gra jashtëzakonisht të bukura dhe të hijshme; të bukura nga jashtë e nga brenda, nga trupi dhe nga shpirti. Ato ua mbushin zemrat dhe shpirtin me gëzim burrave të tyre. Rreth tyre vërtiten e shërbejnë djelmosha të përjetshëm, që e shtojnë dhe plotësojnë rehatinë dhe kënaqësinë.

Pastaj, mbi të gjitha këto kënaqësi dhe bukuri, qëndron lumturia më e madhe: vështrimi te Zoti i gjithësisë, tek i Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti, dëgjimi i fjalës së Tij, prania e afërt e Tij, kënaqësia e Zotit me ta dhe, në fund, përjetësia në këto mirësi, të cilat vetëm shtohen dhe bëhen më të larmishme. I Lartësuar dhe Lavdëruar qoftë Allahu, Mbreti, Sunduesi i gjithçkaje, i Vërteti, depot e mirësive të të Cilit nuk shterin dhe nuk pakësohen kurrë. Ashtu si cilësitë e Tij, që janë të pafundme, ashtu janë edhe mirësitë e dhuruara nga bujaria e Tij.

- "Ata janë të veshur me mëndafsh të hollë e të gjelbër dhe me mëndafsh të trashë." - Ata janë të veshur me petka të bukura prej mëndafshi jeshil të hollë (*sundus*) dhe me mëndafsh të trashë (*istebrek*), që janë nga llojet më të mira të mëndafshit.

- "Janë të stolisur me bylyzykë të argjendtë." - Duart e tyre, të meshkujve dhe të femrave, janë të stolisura me byzylykë e bizhuteri argjendi. Ky është një premtim i dhënë nga Zoti, dhe premtimi i Tij patjetër që do të mbahet, sepse Ai është më Fjalëdrejti dhe Besniku.

- "Ndërkohë, Zoti i tyre u jep të pinë pije të kulluar." – Do t'u jepet një lloj pijeje, që

është e pastër nga çdo turbullirë dhe ndyrësi, nga njëra anë, dhe pastruese e barkut të tyre nga çdo gjë e keqe dhe e dëmshme, nga ana tjetër.

- "Ky është shpërblimi për ju, sepse e keni merituar me përpjekjet tuaja." - Ky shpërblim i madh ju jepet si shpërblim për veprat që keni kryer. Madje, edhe për veprat më të vogla, Allahu Bujar dhe i Gjithëmëshirshëm ka përgatitur për ju mirësi të përjetshme të papërshkrueshme.

Pasi foli për mirësitë e Xhenetit, Allahu i Madhëruar thotë:


Ajetet 23 – 27

23. Ne ta shpallëm Kuranin pjesë-pjesë.
24. Prandaj, ti bëhu i durueshëm ndaj gjykimit të Zotit tënd, e mos dëgjo asnjë gjynahqar ose jobesimtar prej tyre.
25. Adhuroje Zotin tënd mëngjes e mbrëmje!
26. Bëj sexhde për Të në një pjesë të natës! Madhëroje Atë natën e gjatë!
27. Vërtet, ata e duan shumë këtë jetë dhe e shpërfillin Ditën e Rëndë, që i pret.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ne ta shpallëm Kuranin pjesë-pjesë." - Në Kuran, i Madhëruari ka sjellë premtime dhe kërcënime, ka sqaruar gjithçka për të cilët robërit kanë nevojë dhe na urdhëron që të zbatojmë plotësisht çdo ligj dhe porosi të Tij. Për të gjitha këto nevojitet durim, prandaj Allahu i Madhëruar thotë më tej:

- "Prandaj, ti bëhu i durueshëm ndaj gjykimit të Zotit tënd, e mos dëgjo asnjë gjynahqar ose jobesimtar prej tyre." – Kuptimi: Bëhu i durueshëm ndaj gjykimit të


الجزء التاسع والعشرون سورة المرسلات
وَمِنَ ٱلَّيۡلِ فَٱسۡجُدۡ لَهُۥ وَسَبِّحۡهُ لَيۡلٗا طَوِيلًا ٢٦ إِنَّ هَٰٓؤُلَآءِ
يُحِبُّونَ ٱلۡعَاجِلَةَ وَيَذَرُونَ وَرَآءَهُمۡ يَوۡمٗا ثَقِيلٗا ٢٧ نَّحۡنُ خَلَقۡنَٰهُمۡ
وَشَدَدۡنَآ أَسۡرَهُمۡۖ وَإِذَا شِئۡنَا بَدَّلۡنَآ أَمۡثَٰلَهُمۡ تَبۡدِيلًا ٢٨ إِنَّ
هَٰذِهِۦ تَذۡكِرَةٞۖ فَمَن شَآءَ ٱتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِۦ سَبِيلٗا ٢٩ وَمَا تَشَآءُونَ
إِلَّآ أَن يَشَآءَ ٱللَّهُۚ إِنَّ ٱللَّهَ كَانَ عَلِيمًا حَكِيمٗا ٣٠ يُدۡخِلُ
مَن يَشَآءُ فِي رَحۡمَتِهِۦۚ وَٱلظَّٰلِمِينَ أَعَدَّ لَهُمۡ عَذَابًا أَلِيمَۢا ٣١
سورة المرسلات
بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
وَٱلۡمُرۡسَلَٰتِ عُرۡفٗا ١ فَٱلۡعَٰصِفَٰتِ عَصۡفٗا ٢ وَٱلنَّٰشِرَٰتِ نَشۡرٗا ٣
فَٱلۡفَٰرِقَٰتِ فَرۡقٗا ٤ فَٱلۡمُلۡقِيَٰتِ ذِكۡرًا ٥ عُذۡرًا أَوۡ نُذۡرًا ٦ إِنَّمَا
تُوعَدُونَ لَوَٰقِعٞ ٧ فَإِذَا ٱلنُّجُومُ طُمِسَتۡ ٨ وَإِذَا ٱلسَّمَآءُ فُرِجَتۡ
٩ وَإِذَا ٱلۡجِبَالُ نُسِفَتۡ ١٠ وَإِذَا ٱلرُّسُلُ أُقِّتَتۡ ١١ لِأَيِّ يَوۡمٍ أُجِّلَتۡ
١٢ لِيَوۡمِ ٱلۡفَصۡلِ ١٣ وَمَآ أَدۡرَىٰكَ مَا يَوۡمُ ٱلۡفَصۡلِ ١٤ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ
لِّلۡمُكَذِّبِينَ ١٥ أَلَمۡ نُهۡلِكِ ٱلۡأَوَّلِينَ ١٦ ثُمَّ نُتۡبِعُهُمُ ٱلۡأٓخِرِينَ
١٧ كَذَٰلِكَ نَفۡعَلُ بِٱلۡمُجۡرِمِينَ ١٨ وَيۡلٞ يَوۡمَئِذٖ لِّلۡمُكَذِّبِينَ ١٩
٥٨٠

Zotit mbi fatin tënd, dhe kurrë mos ji i pakënaqur me të. Po ashtu, bëhu i durueshëm edhe ndaj gjykimit të Zotit në ligjet e Tij, duke i vënë në zbatim ato dhe duke jetuar sipas tyre. Mos lejo asgjë e asnjë të të pengojë në këtë rrugë. Mos iu bind të zhyturve në gjynahe dhe në mosbesim. Bindja ndaj gjynahqarëve e mohuesve do të të çojë patjetër në gjynahe dhe kalim kufijsh, sepse ata urdhërojnë veçse për gjëra që ua kërkon epshi i tyre pa fre.

Duke qenë se, për të qenë i durueshëm dhe i qëndrueshëm të ndihmon adhurimi i Zotit dhe shtimi i përkujtimit të Tij, në vijim thuhet:

- "Adhuroje Zotin tënd mëngjes e mbrëmje!" – Pra, adhuroje Zotin në fillim dhe në fund të ditës. Këtu hyjnë namazet e detyrueshme dhe *nafile*-t që kryhen së bashku me to, si: *dhikr*-et, *tesbih*-et, *tahlil*-et,

tekbir-et e çdo *dhikër* tjetër gjatë këtyre kohëve. [40]

- "Bëj sexhde për Të në një pjesë të natës!" - Shtoji sexhdet që bën për Zotin tënd! Por kjo mund të ndodhë veçse duke shtuar namazet e përkushtuara ndaj Tij.

- "Madhëroje Atë natën e gjatë!" - Madhëroje Allahun me tesbihe e adhurim natën e gjatë.

Ky është urdhër për të madhëruar Allahun gjithë natën e gjatë. Por në suren Muzzemmil, Allahu i Madhëruar na e ka shpjeguar si dhe sa duhet ta madhërojmë Atë: "Ngrihu për falje natën, përveç një pjese të vogël të saj: gjysmën e saj, ose diçka më pak se gjysmën, ose shto pak më tepër, dhe lexoje Kuranin me vëmendje."

- Vërtet, ata e duan shumë këtë jetë dhe e shpërfillin Ditën e Rëndë, që i pret." – Kuptimi: Mohuesit, të cilët nuk të besojnë si profet, edhe pse u ballafaquan me shumë argumente, kështilla e paralajmërime për të pranuar të vërtetën, përsëri i japin përparësi dynjasë së shpejtë, duke e gjetur prehjen tek ajo. Ata i përkushtohen tërësisht asaj dhe e braktisin të vërtetën, duke harruar se i pret një ditë e rëndë dhe e vështirë, dita e Kijametit, gjatësia e së cilës është pesëdhjetë mijë vjet, me llogarinë tuaj. Ajo do të jetë një ditë e vështirë, sikurse thuhet në ajetin tjetër: "Të tmerruara do të jenë shikimet e tyre. Ata do të dalin prej varreve si karkalecë të shpërndarë dhe do shpejtojnë drejt Lajmëtarit. Jobesimtarët thonë: "Kjo është ditë e vështirë"." [Kamer 7, 8]. Ata i përkushtohen kësaj bote, a thua se janë krijuar thjesht për këtu!

[40] *Dhikr*-i është përkujtimi i Allahut në përgjithësi me çdo lloj përkujtimi. *Tesbih*-u është të thënurit e adhuruesit: "*Subhânell-llah*" i lartësuar dhe i pastër nga çdo e metë është Allahu. "*Tahlil*-i" është të thënurit e adhuruesit: "*La ilahe il-lall-llâh*" nuk ka të adhuruar me meritë veç Allahut. "*Tekbir*-i" është të thënurit e adhuruesit: "*Allahu ekber*" Allahu është më i madh (se çdo gjë).

Ajetet 28 – 31

28. Ne i krijuam ata dhe Ne e përsosëm krijimin e tyre. Kur të dëshirojmë, Ne do t'i rikthejmë ata me një krijim të ri.
29. Vërtet, këto janë këshilla, prandaj kush dëshiron, e gjen rrugën që e çon te Zoti i vet.
30. Po ju mund të doni diçka, veç nëse do Allahu. Pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.
31. Atë që Ai e do, Ai e përfshin në mëshirën e Vet. Kurse për zullumqarët, Ai ka përgatitur dënim të dhembshëm.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar jep për ringjalljen një argument logjik, duke u kujtuar krijesave fillimin e tyre. Ai thotë:

- "Ne i krijuam ata dhe Ne e përsosëm krijimin e tyre." - Është Allahu i Lartësuar Ai që i bëri njerëzit të ekzistojnë nga hiçi. Përveç kësaj, Ai e përkreu krijimin e tyre, duke i pajisur me nerva e damarë, me organe të jashtme e të brendshme, derisa u plotësua çdo gjë. Allahu i Lartësuar e bëri trupin e njeriut në mënyrë të tillë që ai të plotësojë nevojat e veta.

Atëherë, Ai që i bëri njerëzit të ekzistojnë në këtë formë, Ai është i Plotpushtetshëm që t'i ringjallë ata sërish pas vdekjes së tyre, për t'i shpërblyer. Ai i Cili i solli në këtë jetë, për të kaluar këtë fazë, nuk ka se si t'i lërë të

braktisur, pa i urdhëruar e pa i ndaluar, pa i shpërblyer dhe pa i ndëshkuar, për atë që meritojnë. Më pas, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Kur të dëshirojmë, Ne do t'i rikthejmë ata me një krijim të ri." – Kuptimi: Do t'ju ringjallim, për t'ju dhënë një jetë tjetër. Do t'ju ringjallim të gjithëve, pa përjashtim, me një krijim të ri.

- "Vërtet, këto janë këshilla, prandaj kush dëshiron, e gjen rrugën që e çon te Zoti i vet." - Besimtari përfiton nga këto këshilla e paralajmërime, që nxisin frikën dhe shpresën. Ai që dëshiron, mund të marrë rrugën që të çon tek Allahu i Madhëruar, i Cili, pasi e ka qartësuar mirë këtë rrugë, i ka lënë të lirë njerëzit të zgjedhin: ose të ndjekin udhëzimin e Tij, ose ta shpërfillin atë.

- "Po ju mund të doni diçka, veç nëse do Allahu. Pa dyshim, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë." – Është dëshira e Allahut ajo që ekzekutohet dhe vihet në jetë. Ai është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm, kur udhëzon dikë në rrugën e drejtë, ashtu siç është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm kur lë në humbje dhe devijim atë që zgjedh humbjen dhe devijimin.

- "Atë që Ai e do, Ai e përfshin në mëshirën e Vet. Kurse për zullumqarët, Ai ka përgatitur dënim të dhembshëm." - Ata që Allahu i ka futur në mëshirën e Tij, ata i ka veçuar me përkujdesje të veçantë, duke u bërë të mundur çdo mjet dhe rrugë për të arritur lumturinë. Është Ai që i udhëzon ata në udhë të drejtë, me mëshirën dhe urtësinë e Tij.

Ndërsa për zullumqarët, të cilët kanë zgjedhur devijimin kundrejt udhëzimit, Ai ka përgatitur ndëshkim të dhembshëm. Ky ndëshkim është i drejtë për ta, për shkak të zullumit dhe armiqësisë së tyre.

Surja 77: El Murselat (mekase) 50 ajete

Ajetet 1 – 15

Me emrin e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për ata që dërgohen njëri pas tjetrit me mirësi,
2. ata që janë të shpejtë si furtunë!
3. Për shpërndarësit, që shpërndajnë!
4. Për ata që ndajnë saktë!
5. Për ata që sjellin shpallje hyjnore,
6. si dëshmi ose si paralajmërim!
7. S'ka dyshim se ajo që u është premtuar ka për të ndodhur patjetër,
8. atëherë kur yjet të shuhen,
9. kur qielli të çahet,
10. kur malet të shpërbëhen,
11. e kur të dërguarve u është caktuar koha për të dëshmuar.
12. E në ç'ditë u është caktuar atyre koha?
13. Ditën e Gjykimit!
14. E ku e di ti se ç'është Dita e Gjykimit?
15. Ajo ditë është shkatërrim për ata që kanë mohuar.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Madhëruar bën një sërë betimesh për vërtetësinë e Ditës së Ringjalljes dhe Llogarisë së drejtë.

- "Për ata që dërgohen njëri pas tjetrit me mirësi..." – "Ata" janë melekët, që Zoti i dërgon të zbatojnë vendimet e Tij, të kujdesen për krijesat dhe për botën, të zbatojnë urdhrat e Tij që kanë të bëjnë me fenë dhe me jetën e kësaj bote. Allahu i

Madhëruar i ka përshkruar melekët si '*urfa*', pra, të mbushur dhe të dërguar plot mirësi, urtësi dhe dobi, jo me kotësi e ligësi.

- **"...ata që janë të shpejtë si furtunë!"** - Edhe ky është një përshkrim i melekëve, si robër të bindur e të nënshtruar, të cilët nxitojnë menjëherë që të zbatojnë urdhrat, detyrimet dhe misionet e ngarkuara nga i Madhërishmi. Ata janë të shpejtë dhe të përpiktë në zbatimin e urdhrave dhe realizimin e detyrave. Ata janë të shpejtë si stuhitë e furishme. Por ka mundësi që ky të jetë një betim në stuhitë e furishme kur fryjnë me furi. Në këtë rast kuptimi do të ishte "Për erërat që fryjnë furishëm!"

- **"Për shpërndarësit, që shpërndajnë!" –** Edhe këtu ka mundësi që të flitet për melekët, të cilën shpërndajnë atë që Zoti ka urdhëruar të shpërndahet. Por ka mundësi që të flitet edhe për retë, të cilat Zoti i shpërndan nëpër qiell dhe, nëpërmjet ujit të zbritur prej tyre, ringjall tokën, pas vdekjes së saj.

- **"Për ata që ndajnë saktë!" –** pra për melaiket të cilët vijnë me urdhërin e Zotit që dallon e ndan të vërtetën nga e kota, hallallin nga harami.

- **"Për ata që sjellin shpallje hyjnore, si dëshmi ose si paralajmërim!" –** Këta janë gjithashtu melekët, që kryejnë detyrën më të rëndësishme dhe më të nderuar: ata zbresin shpalljet e Zotit, nëpërmjet të cilave Ai i mëshiron robërit e Tij dhe i udhëzon në rrugën e mirësisë dhe lumturisë.

Zoti i Madhëruar ua përcjell shpalljet profetëve të Tij, që të jenë si dëshmi kundër jobesimtarëve, në mënyrë që ata të mos kenë asnjë justifikim para Tij, dhe si paralajmërim për njerëzit, për tmerrin që i pret përpara.

- **"S'ka dyshim se ajo që u është premtuar ka për të ndodhur patjetër..."** - Ringjallja dhe llogaria e drejtë për veprat është një ngjarje që patjetër do të ndodhë, pa asnjë dyshim.

Kur të vijë ajo ditë, do të ndodhin shumë ndryshime në botë, të cilat do të shkaktojnë tmerr dhe frikë, siç thotë i Madhëruari:

- **"...atëherë kur yjet të shuhen, kur qielli të çahet, kur malet të shpërbëhen..."** - Yjet do të shuhen dhe do të këputen nga vendi i tyre. Malet do të shpërbëhen dhe sheshohen. Ato do të bëhen pluhur, që do shpërndahet në ajër. Toka do të bëhet e sheshtë, pa male e gropa.

Kjo është, gjithashtu, dita e përcaktuar për dëshminë e profetëve:

- **"...e kur të dërguarve u është caktuar koha për të dëshmuar. E në ç'ditë u është caktuar atyre koha?"** - Atë ditë, profetët do të dëshmojnë për popujt e tyre, për besimin apo mosbesimin e tyre. Pyetja më pas është bërë për të treguar rëndësinë dhe madhështinë e asaj dite. Asaj i përgjigjet Allahu i Madhëruar, duke thënë:

- **"Ditën e Gjykimit! E ku e di ti se ç'është Dita e Gjykimit?"** - Ajo është dita e ndarjes mes krijesave. Çdokush do të llogaritet më vete dhe i vetëm.

Pastaj i Madhëruari kërcënon mohuesit e kësaj dite:

- **"Ajo ditë është shkatërrim për ata që kanë mohuar."** - Mjerë ata, për dëshpërimin dhe ndëshkimin e rëndë që i pret! Mjerë ata, për

fundin e keq ku po shkojnë! Allahu i Madhëruar i ka paralajmëruar për këtë ditë, madje, është betuar për vërtetësinë e saj, por ata sërish e mohojnë, prandaj e meritojnë ndëshkimin e dhembshëm.

Ajetet 16 – 19

16. A nuk i shkatërruam Ne popujt më të hershëm,
17. dhe pastaj të tjerët që i shoqëruan?
18. Kështu bëjmë Ne me zullumqarët.
19. Ajo ditë është mjerim i madh për mohuesit.

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk i shkatërruam Ne popujt më të hershëm..." – Kuptimi: A nuk i shkatërruam jobesimtarët e popujve të shkuar?!


- "...dhe pastaj të tjerët që i shoqëruan?" - Po kështu ndëshkuam të gjithë ata mohues e arrogantë prej popujve që erdhën më pas, të cilët e konsideruan Ditën e Ringjalljes dhe të Llogarisë si mashtrim.

- "Kështu bëjmë Ne me zullumqarët." - Ky është rregulli i pandryshueshëm i Zotit për zullumqarët: ndëshkim i pakthyeshëm. Atëherë, pse nuk merrni mësim nga ato që shihni dhe dëgjoni?!

- "Ajo ditë është mjerim i madh për mohuesit." - Mjerë ata që mohojnë të vërtetën, pas vështrimit të argumenteve të qarta dhe pasi mësuan rreth ndëshkimeve të Zotit kundër mohuesve.

Ajetet 20 – 24

20. A nuk ju krijojmë nga një lëng i dobët,
21. që e vendosim në një vend të sigurt,



22. deri në një afat të caktuar?!
23. Ne e bëjmë përcaktimin e krijimit. Sa përcaktues të mirë jemi!
24. Ajo ditë është shkatërrim për ata që nuk e njohin fuqinë Tonë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk ju krijojmë nga një lëng i dobët, që e vendosim në një vend të sigurt, deri në një afat të caktuar?!" - A nuk ju krijojmë, o njerëz, prej një lëngu të nënçmuar, i cili del nga mesi shpinës dhe dërrasës së kraharorit?! Pastaj atë lëng e vendosim në një vend të sigurt, ku zhvillohet deri në një afat të caktuar. Pastaj e zhvillojmë embrionin mes disa errësirave, duke e kaluar nëpër faza të ndryshme. Nga një pikë uji, kthehet në gjak të mpiksur, pastaj ngjan me një kafshatë të përtypur, derisa Allahu e formon atë si një trup, e pastaj atij trupi i fryn

shpirtin. Por ka edhe që vdesin para kësaj kohe.

- "Ne e bëjmë përcaktimin e krijimit. Sa përcaktues të mirë jemi!" - Allahu i Lartësuar lavdëron Veten e Vet, sepse të gjitha përcaktimet e Tij janë me urtësi dhe e meritojnë lavdërimin.

- "Ajo ditë është shkatërrim për ata që nuk e njohin fuqinë Tonë!" - Mjerë për mohuesit, pasi Allahu ua sqaroi argumentet dhe pasi u tregoi historitë e ndëshkimit të popujve mohues të mëparshëm!

Ajetet 25 – 28

25. A nuk e bëmë Ne tokën që të mbajë në gjirin e vet
26. të gjallë dhe të vdekur?!
27. A nuk kemi vënë në të male të forta e të larta?! A nuk ju kemi dhënë ujin, që jua shuan etjen?!
28. Ajo ditë është mjerim për ata që mohojnë!

Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk e bëmë Ne tokën që të mbajë në gjirin e vet të gjallë dhe të vdekur?!" – Kuptimi: A nuk kemi bërë mirësi të madhe për ju kur e nënshtruam tokën dhe e bëmë të tillë që ju të përfitoni prej saj?! Gjatë jetës, ju ndërtoni shtëpitë mbi të, ndërsa pas vdekjes, ajo ju shërben për varrin tuaj. Sikurse shtëpitë mbi tokë janë mirësi nga Allahu i Madhëruar për robërit e Tij, po ashtu janë edhe varret nën tokë. Varri është mëshirë për njeriun, sepse ai mbulon dhe ruan kufomën që të mos bjerë pre e egërsirave dhe të përdhoset prej tyre.

- "A nuk kemi vënë në të male të forta e të larta?!" - Allahu i Madhëruar i vendosi malet në tokë, me qëllim që ajo të jetë e qëndrueshme. Që toka të mos lëvizë bashkë me banorët e saj, i Madhërishmi e forcoi atë me male të forta, të larta dhe të gjëra.

- "A nuk ju kemi dhënë ujin, që jua shuan etjen?!" – Ju kemi dhënë ujë të ëmbël, të pijshëm e të këndshëm, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "A e shihni ujin që pini? A jeni ju që lëshoni atë prej reve, apo jemi Ne që e lëshojmë? Nëse dëshirojmë, Ne e bëjmë atë të njelmët. A nuk po falënderoni, pra?" [Uakia 68 – 70].

- "Ajo ditë është mjerim për ata që mohojnë!" - Mjerë ata që e mohojnë Ditën e Gjykimit, edhe pse Zoti u ka dhuruar gjithë ato mirësi, të cilat vetëm Ai mund t'i dhurojë. Ai i ka privilegjuar ata me shumë gjëra, por ata, në vend të mirënjohjes, përgjigjen me mohim dhe mosbesim.

Ajetet 29 – 34

29. Shkoni tek ai vend, që ju e konsideruat të gënjeshtërt!
30. Shkoni tek ajo hije, që ka tri degëzime,
31. që nuk bën as fresk e as nuk mbron prej flakëve.
32. Ai hedh shkëndija të mëdha, sa një kështjellë,
33. që duken sikur të ishin deve të verdha!
34. Ajo ditë është shkatërrim për mohuesit!

Shpjegimi i ajeteve

- "Shkoni tek ai vend, që ju e konsideruat të gënjeshtërt!" – Ky është mjerimi që i pret kriminelët në Ditën e Gjykimit. Atyre do t'u

thuhet: "Shkoni tani tek ai vend, të cilin ju e mohonit!".
Më pas, Allahu i Lartësuar e qartëson se ç'është ky vend:

- **"Shkoni tek ajo hije, që ka tri degëzime, që nuk bën as fresk e as nuk mbron prej flakëve."** – Kuptimi: Shkoni në hijen e zjarrit të Xhehenemit, në të cilin dallohen tri gjuhë të mëdha flakësh.
Ajo është një hije, në të cilën nuk ka freski e as prehje. Kush qëndron në të nuk i shpëton dot flakëve të Zjarrit, të cilat të përpijnë në çdo drejtim: djathtas, majtas, lart e poshtë, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Ata do të kenë shtresa zjarri nga sipër dhe nga poshtë. Kështu i frikëson Allahu robërit e Vet. O robërit e Mi, kini frikë!" [Zumer 16]. Ose: "Për ata është përgatitur Xhehenemi si shtrat, ku edhe nga sipër kanë mbulesë prej zjarri. Kështu i shpërblejmë Ne zullumqarët." [A'raf, 41].
Më pas, i Lartësuari përshkruan shkëndijat e Zjarrit, që tregojnë për madhësinë, tmerrin dhe pamjen e frikshme të Xhehenemit:

- **"Ai hedh shkëndija të mëdha, sa një kështjellë, që duken sikur të ishin deve të verdha!"** – Devetë e verdha kanë, në fakt, një ngjyrë të verdhë të errët. Kjo tregon se edhe zjarri i Xhehenemit është i errët. Kështu janë flakët, thëngjijtë dhe shkëndijat e tij. Ai ka pamje të tmerrshme dhe nxehtësi të llahtarshme. Unë lus Allahun të na ruajë nga ky zjarr dhe nga veprat që të çojnë në të!

- **"Ajo ditë është shkatërrim për mohuesit!"** - Mjerë atë ditë për ata që e konsiderojnë ringjalljen si të rreme! Mjerë ata, për zjarrin që i pret!

Ajetet 35 – 40

35. Kjo është ditë kur ata nuk flasin,
36. kur nuk u lejohet as që të justifikohen!
37. Mjerë mohuesit atë ditë!
38. Kjo është Dita e Gjykimit, që do ju mbledhë ju dhe ata të mëparshmit.
39. Nëse keni ndonjë dredhi, atëherë ejani e bëjeni!
40. Ajo ditë është shkatërrim për ata që nuk besojnë!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Kjo është ditë kur ata nuk flasin, kur nuk u lejohet as që të justifikohen! Mjerë mohuesit atë ditë!"** - Ajo do të jetë një ditë shumë e rëndë për mohuesit, të cilët nuk do të jenë në gjendje as të flasin, nga frika dhe tmerri i madh. Edhe nëse mund të justifikohen për mohimin e tyre të Ditës së Gjykimit, atyre nuk do t'u pranohen justifikimet, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Atë ditë, zullumqarëve nuk do t'u bëjnë dobi justifikimet, madje as që u kërkohet të justifikohen". [Rum 57].

- **"Kjo është Dita e Gjykimit, që do ju mbledhë ju dhe ata të mëparshmit. Nëse keni ndonjë dredhi, atëherë ejani e bëjeni! Ajo ditë është shkatërrim për ata që nuk besojnë!"** - Ajo është dita kur Allahu i Madhëruar do të bëjë ndarjen dhe gjykimin e drejtë mes krijesave.

- **"Nëse keni ndonjë dredhi, atëherë ejani e bëjeni!"** – Kuptimi: Nëse keni ndonjë mundësi të dredhoni për të dalë jashtë pushtetit dhe mbretërimit Tim dhe të shpëtoni prej ndëshkimit Tim, bëjeni! Por ju nuk keni asnjë mundësi për diçka të tillë, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "O turmë e xhindëve dhe e njerëzve! Nëse keni mundësi të dilni përtej kufijve të qiejve e të tokës,

depërtoni pra! Por ju nuk mundeni veçse me ndonjë fuqi të fortë". [Rrahman 33].
Atë ditë do të shkatërrohen dhe humbasin të gjitha kurthet dhe intrigat e zullumqarëve. Ata do të dorëzohen të pafuqishëm ndaj ndëshkimit të Allahut dhe do të sigurohen plotësisht se ishin gënjeshtarë.

- "Ajo ditë është shkatërrim për ata që nuk besojnë!" - Mjerë mohuesit, për dënimin që i pret, para të cilit do të jenë të pafuqishëm dhe nuk do të kenë asnjë mundësi për t'i shpëtuar.

Ajetet 41 – 45

41. Nuk ka dyshim se të devotshmit do të jenë nën hije, pranë burimeve,
42. me larmi frutash, si t'i dëshirojnë.
43. Hani e pini duke shijuar e me ëndje, për veprat që keni bërë!
44. Kështu i shpërblejmë Ne mirëbërësit!
45. Ajo ditë është mjerim për mohuesit.

Shpjegimi i ajeteve

Pasi foli për ndëshkimin e mohuesve të Ditës së Gjykimit, i Lartësuari tregon tani për shpërblimin e besimtarëve:

- **"Nuk ka dyshim se të devotshmit do të jenë nën hije, pranë burimeve..."** - Të devotshmit janë ata që ruhen nga mosbesimi dhe mohimi i të vërtetës, janë të sinqertët dhe të vërtetët në fjalë dhe në vepra. Ata e arrijnë këtë gradë veçse pasi kryejnë të gjitha detyrimet dhe lënë të gjitha haramet. Ata do të jenë nën hijet e dendura të pemëve të shumëllojshme, të bukura e plot fruta. Afër do të kenë burime me ujë selsebili, me nektar etj., që rrjedhin nëpër kopshte.

- "...me larmi frutash, si t'i dëshirojnë". - Atje do të kënaqen me frutat më të mira dhe më të freskëta. Atyre u thuhet:

- "Hani e pini duke shijuar e me ëndje, për veprat që keni bërë!" - Hani e pini ushqime të shijshme dhe pije të këndshme, pa u munduar dhe pa u velur. Ajo është kënaqësi e pastër dhe e plotë. Mirësitë e kënaqësitë këtu nuk përfundojnë kurrë. Ato i fituat me besimin dhe veprat tuaja të mira.

- "Kështu i shpërblejmë Ne mirëbërësit!" - Veprat tuaja ju bënë të arrinit e meritonit këto mirësi të përjetshme. Kështu shpërblehet çdokush që përkryen adhurimin ndaj Allahut dhe është bamirës ndaj krijesave.

- **"Ajo ditë është mjerim për mohuesit."** - Sikur ata të kishin si ndëshkim veçse privimin nga mirësitë e përshkruara më lart, kaq do të mjaftonte si vuajtje e mjerim për ta.

Ajetet 46 – 50

46. Hani e kënaquni për pak kohë, sepse ju jeni vërtet kundërshtues!
47. Ajo ditë është mjerim për mohuesit e të mirave të Zotit,
48. ata që, kur u thuhej: "Përkuluni në namaz!", ata nuk përkuleshin.
49. Ajo ditë është mjerim për mohuesit.
50. Çfarë fjale besojnë ata, pas kësaj?!

Shpjegimi i ajeteve

- "Hani e kënaquni për pak kohë, sepse ju jeni vërtet kundërshtues! Ajo ditë është mjerim për mohuesit e të mirave të Zotit..." - Edhe ky është një kërcënim i rëndë drejtuar mohuesve, të cilët, edhe pse në jetën e


dynjasë hanë, pinë dhe kënaqen me mirësi të shumta, ata nuk tregohen mirënjohës. Përkundrazi, me veprat e tyre të ndyra, ata tregojnë se janë kriminelë. Ata i kushtojnë rëndësi vetëm kënaqësive trupore, duke shpërfillur adhurimin e Zotit dhe veprat e mira që të afrojnë tek Ai. Për këtë arsye, ata do të dënohen njëlloj si kriminelët. Kur të ndahen nga kjo dynja, do t'u ndërpriten mirësitë dhe do t'u mbeten vetëm gjynahet, për të cilat do të marrin atë që meritojnë.

Fakt tjetër i zullumit të tyre është dhe refuzimi i ftesës për namaz:

- "...ata që, kur u thuhej: "Përkuluni në namaz!", ata nuk përkuleshin." - Ata nuk i përgjigjen thirrjes së Zotit për të fituar çdo të mirë e për t'u ruajtur nga çdo e keqe. Atëherë, pyesim: A ka kriminel më të madh se ai që e privon veten nga e mira dhe hidhet vetë në ndëshkim?!

- "Ajo ditë është mjerim për mohuesit." - Mjerimi për ta fillon që kur para tyre mbyllen dyert e suksesit për të arritur të mirat e për t'u ruajtur nga të këqijat. Ndodh kështu, sepse ata kundërshtojnë dhe mohojnë Kuranin e lavdishëm, i cili qëndron në piedestalin më të lartë të drejtësisë e diturisë së vërtetë. Ata refuzojnë që të nënshtrohen dhe të jetojnë sipas tij.

- **"Çfarë fjale besojnë ata, pas kësaj?!"** – Mos, vallë, besojnë të kotën, të cilën Kurani e ka shpallur si të tillë?! Apo besojnë fjalët e ndonjë idhujtari, të tejmbushur me gjynahe e padrejtësi? Besimi i tyre nuk ka themele, ku mund të mbështetesh. Pëtej dritës së qartë të sjellë dhe të ruajtur nga Zoti, ekzistojnë veçse errësira të thella të mashtrimit dhe devijimit. Përtej të vërtetës të mbështetur në



fakte dhe argumente të pakundërshtueshme, ndodhen veçse gënjeshtrat dhe trillimet e gjynahqarëve të shfrenuar. Shkatërruar qofshin, sa të verbër janë! Mjerë për ta, sa të humbur e të dëshpëruar janë!

Në fund, lus Allahun të na falë dhe të na ruajë nga këto fatkeqësi dhe errësira! Ai është Bamirësi dhe Bujari!

Xhuz'i Amme
Surja 78: El Nebe' (mekase) 40 ajete
Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut,
të Gjithmëshirëshmit Mëshiruesit!

1. Për çfarë i bëjnë pyetje ata njëri-tjetrit?
2. Për Lajmin e madh e tronditës,
3. për të cilin aq shumë kundërshtohen e polemizojnë!

4. **Jo, të mos pyesin, sepse ata do ta kuptojnë!**
5. **Përsëri jo, se ata do ta kuptojnë.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Për çfarë i bëjnë pyetje ata njëri-tjetrit?" - Allahu i Lartësuar e nis me një pyetje, e cila përmban në vetvete edhe një kërcënim. Pra, për çfarë pyesin dhe polemizojnë ata që mohojnë ajetet dhe mrekullitë e Allahut?!

Vetë Allahu i Lartësuar e sqaron se për çfarë pyesin ata me skepticizëm dhe me tallje.

- "Për Lajmin e madh e tronditës, për të cilin aq shumë kundërshtohen e polemizojnë!" - Ata diskutojnë gjatë për Lajmin e madh, rreth të cilit kanë shumë kundërshtime, pasi e shohin atë si të pabesueshëm, megjithëse ai është i vërtetë dhe i padiskutueshëm. Nuk ka dyshim që ai do të ndodhë, por mohuesit e takimit me Allahun nuk e besojnë atë, edhe sikur t'u shfaqet çdo lloj mrekullie, derisa ndëshkimi i Allahut t'i rrëmbejë e përpijë.

Më tej, i Lartësuari thotë:

- "Jo, të mos pyesin, sepse ata do ta kuptojnë! Përsëri jo, se ata do ta kuptojnë." - Kur të zbresë mbi ta ndëshkimi i ashpër dhe pa kthim i Zotit, atëherë do ta kuptojnë qartë atë që nuk po e besojnë. Ditën kur t'u bëhet 'ftesa' e trishtueshme për në Xhehenem, të cilën ata nuk do të mund që ta refuzojnë apo t'i shmangen, atyre do t'u thuhet: "Ky është Zjarri, të cilin ju nuk e besonit!"

Më poshtë, Allahu i Lartësuar numëron shumë mirësi, të cilat ua ka dhuruar njerëzve, mirësi të cilat tregojnë qartë vërtetësinë dhe sigurinë e asaj çka njoftuan dhe kumtuan profetët e Tij.

Ajetet 6 – 16

6. **A nuk e bëmë Ne Tokën të përshtatshme për ju,**
7. **ndërsa malet shtylla?**
8. **Ne ju krijuam në çifte.**
9. **Gjumin tuaj jua bëmë për pushim.**
10. **Natën jua bëmë mbulesë,**
11. **ndërsa ditën jua bëmë për aktivitet.**
12. **Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë,**
13. **dhe kemi vënë Ndriçuesin, që ngroh.**
14. **Prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të bollshëm,**
15. **që, nëpërmjet tij, të rrisim drithëra e bimë** ***(foragjere)***
16. **edhe kopshte të dendura, palë mbi palë.**

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i pyet njerëzit: A nuk ju kam dhuruar gjithë këto mirësi, që ju të gjykoni për madhështinë Time dhe të më jeni mirënjohës?!

- "A nuk e bëmë Ne Tokën të përshtatshme për ju..." - Allahu i Lartësuar e krijoi Tokën dhe e shtroi atë, në mënyrë që njerëzit të jetojnë dhe të përfitojnë lehtë prej saj. Në të mund të mbillet, të ndërtohet, të hapen rrugë dhe të lëvizet normalisht, për të kërkuar mirësitë që Zoti ka vendosur tek ajo.

- "...ndërsa malet shtylla?" - Allahu i Lartësuar i ka bërë malet si shtylla, që ta mbajnë Tokën të lidhur e të qëndrueshme. Në këtë mënyrë, Allahu i Lartësuar e ka bërë Tokën të përshtatshme, për një jetë normale. Jo vetëm kaq, por, me pamjen

madhështore të maleve, Allahu i Lartësuar e ka bërë edhe më të bukur Tokën, ku ne jetojmë.

- "Ne ju krijuam në çifte." - Allahu na ka krijuar në çifte, mashkull e femër të të njëjtit lloj, me qëllim që të gjejmë prehjen dhe qetësinë te njëri-tjetri. Vendosi mes këtyre dy gjysmave, që plotësojnë njëra-tjetrën, dashurinë dhe mëshirën, prej të cilave lind dhe vazhdon jeta. Kështu, mbi bazat e dashurisë dhe të mëshirës, formohet e zhvillohet më tej shoqëria njerëzore. Përveç kësaj, Allahu i Gjithëmëshirshëm ka bërë të mundur që çifti të shijojë edhe kënaqësinë e marrëdhënieve mes tyre.

- "Gjumin tuaj jua bëmë për pushim." - Pra Allahu i Lartësuar e bëri gjumin si qetësim dhe çlodhje për ne nga gjithë ato angazhime dhe vepra të ngarkuara gjatë ditës, që nëse do të ishin të vazhdueshme do të na dëmtonin dhe lodhnin shumë, fizikisht dhe shpirtërisht.

- "Natën jua bëmë mbulesë, ndërsa ditën jua bëmë për aktivitet." - i Gjithëmëshirshmi e ka bërë natën dhe gjumin si mbulesë për njerëzit, që të qetësojë e çlodhë trupin e mendjen e tyre. Ndërsa ditën Ai e bëri për aktivitet, për të kërkuar mirësitë e Tij.

I lavdëruar qoftë i Lartësuari, për mirësitë e tij të panumërta!

- "Ne kemi ndërtuar mbi ju një shtatëshe të fortë..." - Allahu i Lartësuar ka ndërtuar sipër nesh shtatë qiej madhështorë dhe të fuqishëm. Është i Plotfuqishmi që i mban ato në atë rregull aq preciz, që të mos shkatërrohen.

Përveçse si mburojë për tokën, i Madhërishmi e ka bërë qiellin me shumë mirësi, që janë të domosdoshme për jetën në Tokë. Një nga këto mirësi jetike për Tokën është edhe Ndriçuesi, pra, Dielli, të cilin i Lartësuari e përmend në mënyrë të veçantë:

- "...dhe kemi vënë Ndriçuesin, që ngroh." - Allahu i Lartësuar e ka përshkruar Diellin me dy cilësi të tij, pa të cilat jeta në planetin Tokë do të ishte e pamundur: ai është '*sirâxh*' - ndriçues dhe '*uehhâxh*' - ngrohës. Pa dritën dhe ngrohtësinë e Diellit dhe pa mijëra e mijëra kushte të tjera, jeta në Tokë do të ishte e pamundur. Mos, vallë, të gjitha këto janë mbledhur rastësisht në këtë planet?!

- "Prej reve të shtrydhura kemi lëshuar shi të bollshëm..." - Me rregullin e mrekullueshëm, sipas të cilit funksionon kjo gjithësi, Allahu i Lartësuar ka mundësuar që, nga retë të bjerë shi, të cilin i Gjithëmëshirshmi e ka përshkruar si '*thexh-xhâxhâ*', pra, të bollshëm. Jo vetëm kaq, por Ai e lëshon shiun me formën më të dobishme për krijesat. Çfarë do të ndodhte nëse shiu do të binte mbi tokë dhe mbi krijesat vetëm me vrull e forcë?!

- "...që, nëpërmjet tij, të rrisim drithëra e bimë (*foragjere*), edhe kopshte të dendura, palë mbi palë." - Nëpërmjet shiut, i Lartësuari u jep jetë, në mënyrë të veçantë, drithërave, si: grurit, elbit, misrit, orizit etj., që janë ushqim kryesor për njerëzit, po ashtu edhe të gjithë bimëve të tjera, që Allahu i Lartësuar i ka bërë si ushqim të domosdoshëm për kafshët. Me ujin e shiut, gjithashtu, rriten pemët, çelin frytet e tyre dhe gjelbërojnë kopshtet e pyjet.

Atëherë, duke qenë se Allahu i Lartësuar ju ka falur të tilla begati e mrekulli, si është e mundur që ju e mohoni dhe nuk tregoni mirënjohje ndaj Tij? Si është e mundur që ju ta quani të gënjeshtërt lajmin e Tij rreth vërtetësisë së Ditës së Gjykimit, të cilin Ai e ka sjellë nëpërmjet profetëve të Tij?! Si është e mundur që, duke shfrytëzuar mirësitë dhe begatitë e dhuruara prej Tij, ju të bëni gjynahe apo të tregoheni arrogantë dhe mospërfillës ndaj urdhrave të Tij?!

Ajetet 17 – 30

17. **S'ka dyshim se Dita e Gjykimit është caktuar.**
18. **Ajo është dita kur do t'i fryhet Surit, ndërsa ju do të vini grupe-grupe.**
19. **Qielli do të hapet e do të bëhet dyer-dyer.**
20. **Malet do të shkulen e do të bëhen pluhur.**
21. **Me të vërtetë, Xhehenemi është në pritë.**
22. **Ai është vendstrehim i arrogantëve,**
23. **të cilët do të mbesin atje pafundësisht.**
24. **Atje nuk do të shijojnë as freski, as ndonjë pije,**
25. **përveçse ujë të valë e kalbësira,**
26. **si ndëshkim i merituar.**
27. **Ata nuk besojnë se do të japin llogari**
28. **dhe argumentet Tona i mohojnë me këmbëngulje.**
29. **Ne kemi shkruar çdo gjë me përpikmëri.**
30. **Tani vuani, se Ne do t'ju shtojmë vetëm se vuajtje.**

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na tregon se çfarë do të ndodhë Ditën e Gjykimit, ditë rreth së cilës polemizojnë mohuesit e profetëve dhe kokëfortët. Ajo është një ditë e madhe, të cilën Zoti e ka dalluar nga ditët e tjera. Ai thotë për të:

- "S'ka dyshim se Dita e Gjykimit është caktuar." - Ajo është dita që Zoti e ka caktuar për llogarinë me drejtësi. Askush nuk do t'i shpëtojë asaj dite, sepse ajo do t'i mbledhë të gjithë.

- "Ajo është dita kur do t'i fryhet Surit, ndërsa ju do të vini grupe-grupe." - Ajo është Dita e Tubimit të krijesave. Menjëherë pas fryrjes së Surit, njerëzit do të grumbullohen para Zotit të botëve për të dhënë llogari. Tronditja do të jetë aq e madhe, saqë fëmijët do të thinjen, ndërsa zemrat do të jenë të zbrazëta. Në fakt, pamjet e asaj dite janë të vështira të shpjegohen realisht. I Madhëruari thotë:

- "Qielli do të hapet e do të bëhet dyer-dyer. Malet do të shkulen e do të bëhen pluhur." - Atë ditë, në qiell do të bëhen çarje të mëdha, ndërsa malet do të bëhen pluhur dhe do të treten në ajër. Atë ditë, Allahu i Drejtë dhe Krenar do të gjykojë krijesat me drejtësinë e Tij, pa i bërë askujt padrejtësi.

Tashmë, zjarri i Xhehenemit është nxirë nga nxehtësia e madhe dhe qëndron në pritë të kriminelëve jobesimtarë dhe gjynahqarë. I Lartësuari thotë:

- "Me të vërtetë, Xhehenemi është në pritë. Ai është vendstrehim i arrogantëve..." - Ai do të jetë vendstrehimi dhe vendpritja i atyre që shkelin me arrogancë kufijtë e Zotit. Këta do të qëndrojnë në Xhehenem përgjithmonë, siç thotë i Lartësuari:

- "...të cilët do të mbesin atje pafundësisht." – *'Aĥḳâbâ'*, sipas disa

komentuesve të Kuranit, është një periudhë prej 80 vjetësh. Pra, ata do të qëndrojnë në Xhehenem një pafundësi *aĥḳâbâ*-sh.

- "Atje nuk do të shijojnë as freski, as ndonjë pije, përveçse ujë të valë e kalbësira, si ndëshkim i merituar." - Kur të hyjnë në Xhehenem, ata nuk do të ndiejnë më freski për trupin, që do t'u digjet vazhdimisht, dhe as pije të freskët, që të shuajnë etjen e tyre. Për të pirë, atyre do t'u jepet *ĥamîma*, pra, ujë të përvëluar, nga nxehtësia e të cilit, vetëm sa t'u afrohet, digjet dhe shkrihet mishi dhe lëkura e fytyrës dhe këputen zorrët e barkut. Atyre u jepen për të pirë dhe *ĝassâḳâ*, domethënë, qelbi dhe pisllëqet që dalin nga trupat që digjen në Xhehenem. Ajo është shumë e keqe, për sa i përket erës dhe mundimit që u jep banorëve të Zjarrit.

Ky ndëshkim është plotësisht i merituar për ta, për shkak të veprave të tyre të ulëta dhe të shfrenuara në mosbindje ndaj të Madhërishmit. Allahu i Lartësuar nuk u bën padrejtësi, sepse janë vetë ata që shkatërrojnë veten dhe e zgjedhin rrugën e humbjes. Më tej, i Madhëruari tregon veprat e tyre, prej të cilave ata meritojnë ndëshkimin:

- "Ata nuk besojnë se do të japin llogari..." - Ata nuk besojnë ringjalljen. Ata nuk besojnë që Allahu i Lartësuar do t'i llogarisë dhe shpërblejë me drejtësi njerëzit, për veprat e tyre të mira apo të këqija. Ata nuk përpiqen për ahiretin dhe as nuk shpresojnë për shpërblimin atje.

- "...dhe argumentet Tona i mohojnë me këmbëngulje." - Ata i refuzojnë haptazi dhe pa dorashka argumentet fetare, dhe pse ato janë të faktuara saktë nga profetët e Allahut. Ata i mohojnë ato thjesht me kokëfortësi dhe inat.


- "Ne kemi shkruar çdo gjë me përpikmëri." - Allahu i Lartësuar e ka shkruar çdo gjë me përpikmëri, e madhe apo e vogël qoftë, e mirë apo e keqe qoftë ajo. Asgjë nuk i shpëton Librit të Zotit. Allahu i Lartësuar ka shkruar çdo gjë në *Leuhi Mahfudh*. Kështu, kriminelët nuk do të ndëshkohen kurrë për krime që nuk i kanë bërë dhe as nuk do të lihen pa marrë shpërblimin e çdo të mirë apo të keqe që kanë bërë në këtë dynja. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "Kur libri t'u vihet përpara, ti do t'i shohësh gjynahqarët të frikësuar nga shënimet në të, të cilët do të thonë: "Të mjerët ne! Ç'qenka ky libër, që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar?!" Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë bërë. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt". [Kehf 49].

- "Tani vuani, se Ne do t'ju shtojmë vetëm se vuajtje." – Kuptimi: Të gjithë ju që keni mohuar Shpalljen dhe takimin me të Plotpushtetshmin, vuajeni këtë dënim të dhembshëm dhe poshtërimin e përjetshëm! Çdo moment që kalon, ky dënim vetëm shtohet dhe ashpërsohet.

Ky është nga ajetet më të frikshme për ndëshkimin që do të përjetojnë banorët e Zjarrit. E lusim Allahun e Lartësuar që të na ruajë nga dënimi i Zjarrit dhe poshtërimi në të!

Ajetet 31 – 36

31. S'ka dyshim se të devotshmit do të kenë shpërblime të mëdha,
32. kopshte e vreshta rrushi,


الجزء الثلاثون سورة النبإ

إِنَّ لِلْمُتَّقِينَ مَفَازًا ﴿٣١﴾ حَدَآئِقَ وَأَعْنَـٰبًا ﴿٣٢﴾ وَكَوَاعِبَ أَتْرَابًا ﴿٣٣﴾ وَكَأْسًا
دِهَاقًا ﴿٣٤﴾ لَّا يَسْمَعُونَ فِيهَا لَغْوًا وَلَا كِذَّٰبًا ﴿٣٥﴾ جَزَآءً مِّن رَّبِّكَ عَطَآءً
حِسَابًا ﴿٣٦﴾ رَّبِّ ٱلسَّمَـٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ وَمَا بَيْنَهُمَا ٱلرَّحْمَـٰنِ لَا يَمْلِكُونَ
مِنْهُ خِطَابًا ﴿٣٧﴾ يَوْمَ يَقُومُ ٱلرُّوحُ وَٱلْمَلَـٰٓئِكَةُ صَفًّا ۖ لَّا يَتَكَلَّمُونَ
إِلَّا مَنْ أَذِنَ لَهُ ٱلرَّحْمَـٰنُ وَقَالَ صَوَابًا ﴿٣٨﴾ ذَٰلِكَ ٱلْيَوْمُ ٱلْحَقُّ ۖ فَمَن
شَآءَ ٱتَّخَذَ إِلَىٰ رَبِّهِۦ مَـَٔابًا ﴿٣٩﴾ إِنَّآ أَنذَرْنَـٰكُمْ عَذَابًا قَرِيبًا يَوْمَ يَنظُرُ
ٱلْمَرْءُ مَا قَدَّمَتْ يَدَاهُ وَيَقُولُ ٱلْكَافِرُ يَـٰلَيْتَنِى كُنتُ تُرَٰبًۢا ﴿٤٠﴾

سورة النازعات

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَـٰنِ ٱلرَّحِيمِ

وَٱلنَّـٰزِعَـٰتِ غَرْقًا ﴿١﴾ وَٱلنَّـٰشِطَـٰتِ نَشْطًا ﴿٢﴾ وَٱلسَّـٰبِحَـٰتِ سَبْحًا ﴿٣﴾
فَٱلسَّـٰبِقَـٰتِ سَبْقًا ﴿٤﴾ فَٱلْمُدَبِّرَٰتِ أَمْرًا ﴿٥﴾ يَوْمَ تَرْجُفُ ٱلرَّاجِفَةُ ﴿٦﴾
تَتْبَعُهَا ٱلرَّادِفَةُ ﴿٧﴾ قُلُوبٌ يَوْمَئِذٍ وَاجِفَةٌ ﴿٨﴾ أَبْصَـٰرُهَا خَـٰشِعَةٌ ﴿٩﴾
يَقُولُونَ أَئِنَّا لَمَرْدُودُونَ فِى ٱلْحَافِرَةِ ﴿١٠﴾ أَءِذَا كُنَّا عِظَـٰمًا نَّخِرَةً ﴿١١﴾ قَالُوا۟
تِلْكَ إِذًا كَرَّةٌ خَاسِرَةٌ ﴿١٢﴾ فَإِنَّمَا هِىَ زَجْرَةٌ وَٰحِدَةٌ ﴿١٣﴾ فَإِذَا هُم بِٱلسَّاهِرَةِ
﴿١٤﴾ هَلْ أَتَىٰكَ حَدِيثُ مُوسَىٰٓ ﴿١٥﴾ إِذْ نَادَىٰهُ رَبُّهُۥ بِٱلْوَادِ ٱلْمُقَدَّسِ طُوًى ﴿١٦﴾

٥٨٣

33. **edhe vasha të një moshe,**
34. **edhe gota të mbushura plot verë.**
35. **Aty nuk do të dëgjojnë fjalë të kota e as gënjeshtra.**
36. **Shumë shpërblime e dhurata të dhëna nga Zoti.**

Shpjegimi i ajeteve

Pasi tregoi përfundimin e të dëshpëruarve, Allahu i Lartësuar vijon me premtimet për të devotshmit:

- "S'ka dyshim se të devotshmit do të kenë shpërblime të mëdha..." - Atyre të cilët pajisen në këtë dynja me cilësinë e *takua*-s, Allahu i Lartësuar u premton *mefâzâ*-n, pra, shpëtimin nga Zjarri dhe çdo e keqe në dynja dhe në ahiret, si dhe arritjen e çdo të mire që shpresojnë në të dyja jetët. Por kjo është e kushtëzuar me *takua*-n.

Takua është mbrojtja nga dënimi dhe zemërimi i Allahut duke kryer urdhrat e Tij dhe duke iu larguar ndalesave të Tij, i motivuar nga dashuria për Të dhe madhërimi i Tij. Kështu, të gjithë ata që i përkushtohen Atij me bindje dhe nënshtrim, që i largohen çdo gjëje të cilën Ai e ka ndaluar, do të jenë të shpëtuar nga Zjarri dhe do të shpërblehen me mirësi të shumta. Prej mirësive që i presin këta fatlumë, i Lartësuari na tregon:

- "...kopshte e vreshta rrushi..." - Kopshte të mrekullueshme, plot pemë të bukura dhe bimësi të dendur. Mes frutave të mrekullueshme rrjedhin dhe gurgullojnë lumenj të kulluar. Allahu i Lartësuar e përmend në veçanti rrushin, sepse ai do të jetë i bollshëm dhe i shumëllojshëm atje, por edhe sepse ai është një nga frutat më të dashura për njerëzit.

- "...edhe vasha të një moshe..." - Ata do të kënaqen në Xhenet me gratë e tyre, që do të jenë sipas dëshirës dhe kënaqësisë së tyre. Allahu i Lartësuar i përshkruan ato si *keuâib* dhe si *etrâbâ*. *El keuâib* do të thotë: bukuroshe, trupderdhura, të freskëta e plot afsh, me gjoks *keuâib*, pra, të rrumbullakosur, që kurrë nuk i prishet forma dhe bukuria. Ndërsa *etrâbâ* tregon se ato janë të një moshe, por jo vetëm kaq. *Etrâbâ* janë ato gra që dinë të joshin dhe të kënaqin burrat e tyre. Ato janë, gjithashtu, shumë të përkushtuara dhe të dashuruara pas burrave të tyre. Ato do të jenë në moshën më të plotë dhe të freskët: tridhjetë e tre vjeçe.

- "...edhe gota të mbushura plot verë." - Ato do të jenë të mbushura me pije të mrekullueshme dhe të freskëta.

- "Aty nuk do të dëgjojnë fjalë të kota e as gënjeshtra." - *Leĝuen* janë fjalët e kota, të padobishme, ndërsa *kidhdhâbâ* janë fjalët e këqija, të cilat e ngarkojnë njeriun me gjynahe, pra, janë fjalë të ndëshkueshme, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Ata nuk do dëgjojnë atje fjalë të kota dhe as fjalë gjynahqare. Ata do dëgjojnë veçse përshëndetje e selam pas selami." [Uakiah].

Pastaj i Madhëruari na tregon se Ai ua dhuron shpërblimet këtyre fatbardhëve nga bujaria dhe mëshira e Tij e pakufishme:

- "Shumë shpërblime e dhurata të dhëna nga Zoti..." - Këto mirësi janë dhuratë e të Madhërishmit Bujar, por edhe si shpërblim për mundin dhe veprat e tyre të mira që kanë bërë në këtë jetë.

Bujaria e të Madhërishmit është shumë herë më e madhe sesa ne mund të mendojmë dhe të shpresojmë. Ai shpërblen shumë edhe për veprat e vogla, të cilat i shton me bujarinë e Tij. Madje, edhe ato vepra të mira që kryejnë të devotshmit janë prej mirësisë së Dhuruesit të mirësive. Është Ai që u jep sukses për të bërë vepra të mira, me urtësinë e Tij, dhe është po Ai që ua pranon veprat e mangëta dhe i shpërblen shumë më tepër sesa mund ta mendojnë. I lavdëruar qoftë Ai, që për këto vepra të pakta dhe të mangëta, vendosi si çmim Xhenetin dhe mirësitë e përjetshme në të.

Ajetet 37 – 40

37. Zoti i qiejve e i tokës dhe ç'ka ndërmjet tyre, që është i Gjithëmëshirshmi, të Cilit askush nuk ka të drejtë t'i bëjë vërejtje.
38. Atë ditë, Xhibrili dhe engjëjt do të qëndrojnë të rreshtuar; askush nuk mund të flasë, veç atij që e lejon i Gjithëmëshirshmi dhe që thotë të vërtetën.
39. Ajo është ditë e vërtetë, prandaj kush dëshiron, le t'i kthehet rrugës për te Zoti i vet.
40. Ne i kemi paralajmëruar ata për një dënim të afërt, ditën kur njeriu do të shikojë se çfarë i kanë sjellë duart e veta, ndërsa jobesimtari do thotë: "Ah, sikur të isha dhé!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Zoti i qiejve e i tokës dhe ç'ka ndërmjet tyre, që është i Gjithëmëshirshmi..." – Kuptimi: Ai që ua dhuroi këto mirësi është Allahu, i vetmi i Adhuruar në qiell dhe në tokë. Ai është i Gjithëmëshirshmi, Zoti i qiejve dhe i tokës. Është Ai që ka krijuar gjithçka, rregullon çështjet në qiell dhe në tokë dhe përkujdeset për krijesat. Mëshira e Tij ka përfshirë çdo gjë, por për besimtarët është një mëshirë e veçantë. Është Ai që kujdeset për ta me mëshirën e Tij të veçantë, duke i udhëzuar tek e mira dhe duke i ruajtur nga e keqja. Nëpërmjet mëshirës dhe suksesit të dhënë prej Tij, ata kanë arritur deri këtu. Pastaj i Lartësuari flet për pushtetin dhe sundimin e Tij të madh në Ditën e Gjykimit:

- "...të Cilit askush nuk ka të drejtë t'i bëjë vërejtje." - Atë ditë, asnjë krijesë nuk nxjerr zë dhe nuk flet pa iu dhënë leje. Askush nuk mund të kundërshtojë të Madhërishmin, madje nuk mundet as të flasë, qoftë edhe një fjalë, pa lejen e Tij.

Ajo është vërtet një ditë shumë e madhe dhe e vështirë. E si mund të flasin ata, kur rreth e rrotull tyre do të qëndrojnë engjëjt madhështorë të të Madhërishmit?! Thotë i Lartësuari:

- "Atë ditë, Xhibrili dhe engjëjt do të qëndrojnë të rreshtuar..." - Edhe engjëjt do

të qëndrojnë të rreshtuar dhe nuk do të flasin, veç nëse i jep leje Rrahmani.

- "...askush nuk mund të flasë, veç atij që e lejon i Gjithëmëshirshmi dhe që thotë të vërtetën." - Ai që flet duhet të plotësojë dy kushte: ta lejojë Rrahmani dhe të thotë të vërtetën, sepse ajo është dita kur do të zbulohen të vërtetat.

- "Ajo është ditë e vërtetë..." - Atë ditë, e kota nuk mund të shitet dhe të pranohet si e drejtë dhe gënjeshtra nuk bën më dobi.

Pasi paralajmëroi dhe përgëzoi në ajetet e mësipërme, Allahu i Lartësuar thotë:

- "...prandaj kush dëshiron, le t'i kthehet rrugës për te Zoti i vet." – Pra, ai që dëshiron të shpëtojë atë ditë, le të bëjë vepra të mira, që të jenë shpresë dhe shpëtim për të, sepse atë ditë nuk të sjell dobi dhe shpëtim asgjë, përveç veprave të mira, sipas besimit të drejtë të rrëfyer nga të dërguarit e Zotit.

- "Ne i kemi paralajmëruar ata për një dënim të afërt..." - Çdo gjë që pritet të vijë është afër. Edhe Dita e Gjykimit është shumë pranë. Të mos ju duket e largët dita e takimit me të Madhërishmin. Ajo do të jetë një ditë shumë e trishtueshme, nëse nuk fillon që tani të adhurosh Allahun e Madhëruar.

- "...ditën kur njeriu do të shikojë se çfarë i kanë sjellë duart e veta..." - Asgjë nuk mund të të shpëtojë atë ditë, veç nëse ke bërë vepra të mira për të kënaqur Allahun e Lartësuar. Atë ditë njeriu do të shohë se çfarë ka bërë me duart e veta, dhe kjo është vetmja shpresë për shpëtim.

Për këtë arsye, në këtë botë, njeriu duhet të llogarisë vetveten dhe të rregullojë marrëdhëniet me Zotin e tij, para se të jetë shumë vonë, sikurse thuhet në Kuran:
"O ju që keni besuar, jini të devotshëm ndaj Allahut! Le të shikojë njeriu se çfarë ka përgatitur për nesër! Kini drojë Allahun! Nuk ka dyshim se Allahu është i Gjithëdijshëm se çfarë punoni ju! Mos u bëni si ata që e kanë harruar Allahun, të cilët Allahu i bën që ta harrojnë vetveten! Të tillë janë të prishurit. Nuk janë të barabartë banorët e Xhenetit dhe banorët e Xhehenemit. Banorët e Xhenetit janë fatbardhët që ia arrijnë qëllimit. Sikur Ne ta zbritnim këtë Kuran mbi ndonjë mal, do ta shihje malin të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë. Ai është Allahu, e nuk ka të adhuruar tjetër me meritë, veç Tij. Ai është Njohësi i të fshehtës dhe i të dukshmes. Ai është Mëshirëploti e Mëshiruesi! Ai është Allahu, e nuk ka të adhuruar tjetër me meritë, veç Tij. Ai është Sunduesi i përgjithshëm, i Dëlirë, Shpëtimtar, Sigurues, Mbikëqyrës, i Plotfuqishëm, Mbizotërues, i Madhërishëm! I Lartësuar është Allahu nga çka i shoqërojnë! Ai është Allahu, Krijuesi, Shpikësi, Formësuesi! Atij i takojnë emrat më të bukur. Atë *(Allahun)* e madhëron çfarë ka në qiej e në tokë. Ai është Ngadhënjyesi, i Urti!"

- "...ndërsa jobesimtari do thotë: "Ah, sikur të isha dhé!"" - Qafirët do të dëshironin të zhdukeshin dhe të mos ekzistonin më. Ata do të dëshironin të vdisnin dhe të mos ngjalleshin më, sepse ajo ditë do të jetë e mbushur me dëshpërim dhe dhimbje për ta.

Çdokush që ka një mirësi, le të falënderojë Allahun e Lartësuar, ndërsa çdokush që i bie një e keqe, le të qortojë veç vetveten. E lusim Allahun që të na ruajë nga kufri dhe nga çdo e keqe tjetër, se Ai është Bamirës dhe Bujar i madh.

Surja 79: En Naziat (mekase) 46 ajete

Ajetet 1 – 14

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Për ata që marrin shpirtra me ashpërsi!
2. Dhe për ata që marrin shpirtra me shkathtësi!
3. Për ata që notojnë me shpejtësi!
4. Dhe për ata që nxitojnë, të cilët me shpejtësi në vendin e vet dërgojnë!
5. Për ata që çdo çështje rregullojnë!
6. Për Ditën kur befas do të bëhet dridhja,
7. pas së cilës një tjetër do të vijë!
8. Atë ditë zemrat do të jenë të tronditura,
9. ndërsa shikimet do të jenë të ulura
10. Ata thonë: "A thua, do të bëhemi përsëri kështu si jemi,
11. edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbura?!"
12. Ata thonë: "Atëherë, ai kthim do të jetë dëshpërues për ne!"
13. Ajo do të jetë veç një britmë e vetme,
14. kur ata t'ia behin mbi sipërfaqen e tokës.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar betohet në melekët e Tij dhe në detyrat me të cilat i ka ngarkuar ata. Në zbatimin e këtyre detyrave, ata tregojnë bindje dhe nënshtrim të plotë. Ata janë zbatues të nënshtruar të urdhrave të Zotit.

Janë dy shpjegime të mundshme të arsyes pse Allahu i Lartësuar bën gjithë këto betime:

1. Allahu i Lartësuar i bën këto betime për të përforcuar vërtetësinë e Ditës së Gjykimit. Ky është një shpjegim i pranueshëm, sepse menjëherë pas betimeve, bëhen disa përshkrime të Ditës së Gjykimit.


2. Allahu i Lartësuar është betuar në melekët, pikërisht për të treguar rëndësinë e melekëve dhe rëndësinë e besimit për melekët, besim ky i cili konsiderohet si njëri nga gjashtë shtyllat e imanit. Por duke përmendur veprat e tyre, mund të kuptojmë se betimet janë bërë edhe për të vërtetuar faktin e shpërblimit të krijesave në momentin kur u merret shpirti, dhe më pas, në Ditën e Gjykimit. Kështu, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Për ata që marrin shpirtra me ashpërsi!" - *En-naziati* janë melekët që e shkulin shpirtin me forcë. Këta engjëj zhyten brenda trupit, derisa e nxjerrin shpirtin jashtë, për ta shpërblyer sipas veprave që ka kryer.

- "Dhe për ata që marrin shpirtra me shkathtësi!" - Edhe këtu bëhet fjalë për melekët, dhe pikërisht për ata engjëj që tërheqin shpirtrat me forcë dhe shkathtësi.

Megjithatë, sipas një shpjegimi tjetër, *nâziât* janë engjëjt që tërheqin dhe nxjerrin shpirtrat e besimtarëve, ndërsa *neshtâ* janë engjëjt që nxjerrin me forcë dhe dhimbje shpirtrat e qafirëve.

- "Për ata që notojnë me shpejtësi!" – Edhe këtu, *es-sâbiĥât (notuesit)* janë engjëjt, të përshkruar si krijesa që ngjiten dhe zbresin vazhdimisht në hapësirat qiellore.



- "Dhe për ata që nxitojnë, të cilët me shpejtësi në vendin e vet dërgojnë!" - Allahu i Lartësuar betohet përsëri në melekët, që tashmë i përshkruan me një cilësi tjetër. Ai i quan ata *sâbiḳât* – nxitues e parakalues. Ata nxitojnë dhe arrijnë para shejtanëve, që të marrin Shpalljen e Allahut dhe ta përcjellin atë te Profeti, pa u lejuar shejtanëve që të mund të marrin vjedhurazi ndonjë gjë prej Shpalljes.

- "Për ata që çdo çështje rregullojnë!" - Allahu i Lartësuar ka quajtur "*el mudebbirât*" melekët e ngarkuar me çështjet dhe veprat e kësaj dynjaje. Ata janë të ngarkuar me detyra të shumta, si me formimin dhe zbritjen e shiut, përkujdesjen për bimësinë, pemët, erërat, detet, oqeanet, embrionet në barkun e nënave, kafshët etj., por edhe ata që përkujdesen për Xhenetin, për Zjarrin etj.

- "Për Ditën kur befas do të bëhet dridhja, pas së cilës një tjetër do të vijë!" - Këtu bëhet fjalë për tronditjet e të njëpasnjëshme dhe shkatërruese të Kijametit. Ato do të jenë tronditje të mëdha dhe të tmerrshme.

- "Atë ditë zemrat do të jenë të tronditura..." - Zemrat do të jenë shumë të frikësuara dhe të tronditura nga gjithçka që do dëgjojnë dhe shohin atë ditë.

- "...ndërsa shikimet do të jenë të ulura." - Vështrimet atë ditë do të jenë të përulura nga tmerri. Edhe zemrat do të mbushen vetëm me frikë, duke mos lënë vend për asgjë tjetër. Shpirtrat do të jenë të trembura si asnjëherë tjetër. Të gjithë do të jenë të frikësuar, të trishtuar dhe të rraskapitur.

Por megjithëse njerëzimin e pret një ditë e tillë, mohuesit e këtij takimi të madh me Zotin e gjithësisë thonë:

- "A thua, do të bëhemi përsëri kështu si jemi, edhe pasi të jemi bërë eshtra të kalbura?!" – Ata, me mosbesim dhe habi, thonë: 'Vallë, pasi të jemi tretur në tokë dhe të jemi kthyer në dhé, ne do të ringjallemi sërish?! Jo, kjo është e pamundur.'

- "Ata thonë: "Atëherë, ai kthim do të jetë dëshpërues për ne!" - Ata nuk e besojnë që Allahu i Lartësuar ka për t'i ringjallur dhe rikrijuar sikurse janë tani. Kjo tregon injorancën e madhe dhe paturpësinë e tyre kundrejt madhështisë së të Plotpushtetshmit. Por Allahu i Lartësuar, për t'ua qartësuar sa më thjeshtë fuqinë e Tij absolute për t'i ringjallur krijesat, thotë:

- "Ajo do të jetë veç një britmë e vetme, kur ata t'ia behin mbi sipërfaqen e tokës." - Ajo

është dita kur, sapo t'i fryhet Surit, të gjitha krijesat do të dalin në faqen e tokës. Të gjithë do të ngrihen dhe do qëndrojnë duke vështruar. Allahu i Lartësuar do t'i grumbullojë dhe gjykojë, me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij. Gjykimi i Tij është i drejtë dhe çdokush do të marrë atë që meriton.

Ajetet 15 – 26

15. A të kanë rrëfyer historinë e Musait,
16. kur Zoti i tij e thirri në luginën e bekuar Tuva?
17. Shko te Faraoni, se vërtet ai e ka tepruar!
18. E thuaji atij: "A ke ndër mend të pastrohesh?"
19. Unë të udhëzoj te Zoti yt, që ti t'ia kesh frikën!"
20. Ai i tregoi mrekullinë e madhe,
21. por ai e mohoi dhe e kundërshtoi.
22. Pastaj u kthye prapa dhe iku me të shpejtë.
23. Bëri një tubim dhe mbajti fjalim,
24. dhe tha: "Unë jam Zoti juaj më i lartë!"
25. Atëherë, Allahu e ndëshkoi atë rëndë, për këtë të fundit dhe për atë të parën.
26. Ky ndëshkim është mësim për ata që frikësohen.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i drejtohet Profetit të Tij të dashur dhe të zgjedhur, Muhamedit (a.s.):

- "A të kanë rrëfyer historinë e Musait, kur Zoti i tij e thirri në luginën e bekuar Tuva?" – Nga kjo pyetje kuptojmë se një ngjarje e madhe ka ndodhur në të shkuarën, nga e cila duhet të nxjerrim mësime. Ajo është ngjarja e Musait, kur Allahu i Lartësuar e thirri atë që prej luginës Tuva. Ky është vendi ku Allahu i Lartësuar i foli Musait (a.s.) dhe ku e zgjodhi atë për profetësinë, për të kryer misionin e Zotit të tij. Në luginën Tuva, Musai (a.s.) mori urdhrat nga Allahu i Lartësuar.

- "Shko te Faraoni, se vërtet ai e ka tepruar!" - Allahu i Lartësuar e dërgoi Musain (a.s.) me një mision të lartë te Faraoni, i cili i kishte kaluar kufijtë me arrogancë dhe padrejtësi. Ai e urdhëroi Musain që ta këshillonte Faraonin për të hequr dorë nga padrejtësitë dhe zullumet, por duke e bërë këtë këshillë me fjalë të buta dhe të urta. Madje, e mësoi atë konkretisht se çfarë t'i thoshte Faraonit:

- "E thuaji atij: "A ke ndër mend të pastrohesh?"" - Me një stil shumë të butë dhe dashamirës, ai do ta ftonte Faraonin te diçka shumë e mirë. Kuptimi është ky: A nuk është mirë, o Faraon, që të bësh një veprim të lartë, të cilin e synojnë dhe e lakmojnë të mençurit?! A nuk është mirë që ta pastrosh veten nga ndyrësia e kufrit dhe e padrejtësisë?! A nuk është mirë që të përqafosh imanin e pastër dhe të drejtë, si dhe veprat e mira e të sinqerta për të Plotpushtetshmin Bujar?!

- "Unë të udhëzoj te Zoti yt, që ti t'ia kesh frikën!" - Unë të rrëfej rrugën që të çon drejt Zotit, rrugën e pastrimit të shpirtit dhe të adhurimit të Zotit. Unë të tregoj se çfarë e kënaq dhe çfarë e zemëron Zotin e Plotpushtetshëm. Unë të ndihmoj që t'i të gjesh rrugën e drejtë dhe ta kuptosh atë. Nëse e kupton të vërtetën dhe punon me sinqeritet për të kënaqur Krijuesin, në zemrën tënde do të lindë ndjenja e mrekullueshme e frikërespektit ndaj Tij. Çdokush që e njeh mirë rrugën e drejtë,

pajiset me frikërespekt për të Madhërishmin dhe qëndron brenda kufijve të Tij.

Megjithatë, edhe pse u ftua me stil të butë dhe dashamirës, Faraoni refuzoi t'i përgjigjet ftesës. Atëherë, Musai (a.s.) i shfaqi atij disa shenja të mëdha:

- "Ai i tregoi mrekullinë e madhe, por ai e mohoi dhe e kundërshtoi." - Allahu i Lartësuar e ndihmoi Musain (a.s.) me shumë mrekulli, siç ishte shkopi që u kthye në gjarpër, i cili gëlltiti të gjithë litarët e magjistarëve, që dukeshin si gjarpërinj. Shenjë tjetër ishte dora e Musait (a.s.), e cila, kur ai e fuste në gjoksin e tij, ajo dilte e bardhë dhe e ndritshme.

Por, me gjithë këto shenja, Faraoni mohoi dhe e konsideroi të vërtetën e Allahut të Lartësuar si gënjeshtër. Ai refuzoi t'u bindej urdhrave të Zotit, të përcjella nga Profeti Musa (a.s.). Madje, padrejtësia dhe arroganca e tij nuk ndaloi këtu.

- "Pastaj u kthye prapa dhe iku me të shpejtë." - Ai u spraps nga e vërteta dhe e luftoi maksimalisht atë. Ai, me shpejtësi, mori çdo masë që të pengonte përhapjen e të vërtetës.

- "Bëri një tubim dhe mbajti fjalim..." - Faraoni grumbulloi ushtritë dhe shërbëtorët e tij dhe u mbajti një fjalim shumë të poshtër, që tregonte për arrogancën e tij të pakufishme:

- "...dhe tha: "Unë jam Zoti juaj më i lartë!"" - Kjo qe vërtet një mendjemadhësi e paturpshme, që meritonte ndëshkimin, madje një ndëshkim që në këtë jetë, para atij të përjetshmit në ahiret.

- "Atëherë, Allahu e ndëshkoi atë rëndë, për këtë të fundit dhe për atë të parën." - Allahu i Lartësuar e ndëshkoi atë dhembshëm, duke e bërë mësim dhe provë për të besuar vërtetësinë e ndëshkimit në këtë jetë dhe në tjetrën.

Megjithatë, jo çdokush merr mësim nga këto shenja dhe argumente. Ata që përfitojnë prej tyre janë vetëm një kategori e caktuar e njerëzish:

- "Ky ndëshkim është mësim për ata që frikësohen." - Ata të cilët i frikësohen dhe e madhërojnë Allahun me dije të plotë për madhështinë e tij, pra, vetëm ata përfitojnë dhe marrin mësime nga shenjat e Allahut të Madhërishëm. Kur ata mësojnë për ndëshkimin e Faraonit dhe të pasuesve të tij të verbër, ata e kuptojnë qartë se çdokush që tregohet mendjemadh dhe kryeneç ndaj urdhëresave të të Madhërishmit të Lartësuar dhe të Plotpushtetshëm, do të ndëshkohet në dynja dhe në ahiret. Ndërsa ata që janë bosh në zemër dhe nuk e njohin madhështinë e Allahut, ata nuk kanë frikërespekt për Të, prandaj atyre nuk u bën dobi asnjë lloj shenje dhe argumenti, sado i madh qoftë.

Ajetet 27 – 33

27. A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit, të cilin Ai e ngriti!
28. Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë.
29. Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi.
30. E pastaj tokën e sheshoi,
31. prej së cilës nxori ujin dhe kullotat e saj,
32. kurse malet ia përforcoi,
33. si furnizim për ju dhe për kafshët tuaja.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar u drejtohet atyre që nuk e besojnë ringjalljen e njerëzve me një argument shumë thjesht të kuptueshëm:

- "A është më i rëndë krijimi juaj apo ai i qiellit, të cilin Ai e ngriti!" - O njerëz! Vallë, a mos jeni ju krijesa më madhështore apo qielli i lartë?! Ai që e ngriti qiellin dhe i vendosi atë rregullsi të përkryer është Allahu i Gjithëpushtetshëm dhe i Gjithëditur.

- "Ngriti kupën e tij dhe e përsosi atë. Natën ia errësoi e ditën ia ndriçoi." - Allahu e ngriti kupën e qiellit dhe e zbukuroi pamjen e tij. Ai i dha atë madhështi dhe rregullsi, që habit çdo të mençur dhe të urtë. Natën e bëri të errët, ndërsa ditën e bëri të shkëlqejë me diell, duke u mundësuar krijesave çdo gjë të dobishme për dynjanë dhe ahiretin e tyre.

- "E pastaj tokën e sheshoi, prej së cilës nxori ujin dhe kullotat e saj, kurse malet ia përforcoi..." - Pasi krijoi qiellin, Allahu i Lartësuar sheshoi tokën dhe vendosi në të çdo gjë të dobishme dhe të nevojshme për jetën e krijesave, si për shembull, ujin, kullotat etj. Malet i bëri si shtylla përforcuese, që e mbajnë tokën të qëndrueshme.

Nga këto ajete mësohet se shtrimi dhe kompletimi i tokës është bërë pas krijimit të qiejve. Ndërsa krijimi i vetë tokës është bërë para krijimit të qiejve, sikurse thotë i Lartësuari në suren Fusilet: "Thuaju: "Ju jeni ata që nuk i besoni Atij, i Cili e krijoi tokën për dy ditë?! Ju i përshkruani Atij shok, Atij që është Zoti i botëve?! Atij që vuri në të (tokë) male të fuqishme, që ia shtoi asaj të mirat dhe, brenda katër ditëve të plota, përcaktoi të gjitha kushtet për të jetuar në të?!" Kjo është për ata që pyesin. Më pas, Ai synoi qiellin, i cili fillimisht ishte tym, dhe i tha atij dhe tokës: "Bindjuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!" Të dy thanë: "Do bindemi me dëshirë!" Dhe Ai krijoi shtatë qiej brenda dy ditëve dhe secilit qiell i caktoi gjërat që i nevojiteshin. Qiellin më të afërt e stolisëm me yje ndriçuese dhe e bëmë të mbrojtur. Ky është caktim i të Plotfuqishmit, të Dijshmit."

Kështu, fillimisht, Allahu i Lartësuar krijoi tokën për dy ditë, pastaj krijoi qiejt për dy ditë të tjera, dhe pas krijimit të qiellit, Ai e shtroi tokën dhe vendosi në të gjithçka të nevojshme dhe të dobishme për jetën.

- "...si furnizim për ju dhe për kafshët tuaja." - Të gjitha këto mirësi, Allahu i Lartësuar i krijoi dhe i lehtësoi për njerëzit dhe kafshët.

E tërë kjo do të thotë që, Ai i Cili bëri gjithë këtë krijim madhështor dhe vendosi gjërat e domosdoshme për jetën në të, pa dyshim që do të ringjallë të përgjegjëshmit ligjërisht dhe do t'i marrë në llogari për veprat e tyre. Allahu i Lartësuar do të shpërblejë me drejtësi për çdo të mirë dhe të keqe që është punuar. Kush ka bërë mirë do të shpërblehet mirë, dhe kush ka bërë keq të mos fajësojë asnjë tjetër, veç vetes. Për këtë arsye, pas gjithë këtyre shenjave, i Madhëruari flet për Ditën e Ringjalljes dhe të Shpërblimit:

Ajetet 34 – 41

34. E kur të vijë vala e madhe,
35. atë ditë njeriu do të kujtojë se çfarë ka bërë.
36. Xhehenemi do shfaqet sheshazi për atë që e sheh.
37. Për sa i përket atij që i ka kaluar kufijtë

38. dhe i ka dhënë përparësi jetës së kësaj bote,
39. Xhehenemi do të jetë vendi i tij.
40. E për atë që i është druajtur daljes para Zotit të vet dhe e ka ndaluar veten prej epsheve,
41. Xheneti do të jetë vendi i tij.

Shpjegimi i ajeteve

- "E kur të vijë vala e madhe..." - Kur të vijë Kijameti i madh, tmerri i pashembullt, para të cilit çdo gjë të duket e thjeshtë dhe e lehtë, atë ditë çdo prind do të shkujdeset dhe do të braktisë fëmijën e vet, nga frika e madhe. Atë ditë, burri do të braktisë gruan e vet dhe çdo i dashur do të largohet dhe do të harrojë të dashurin e vet. Ajo është dita kur:

- "...atë ditë njeriu do të kujtojë se çfarë ka bërë." - Atë ditë, njeriu do të kujtojë se çfarë ka bërë në dynja, në jetën e provës, në jetën ku njerëzit mbjellin atë që do të korrin Ditën e Gjykimit. Atë ditë, ai do të shohë të mirat dhe të këqijat që ka kryer në dynja dhe do të dëshirojë t'u kishte shtuar veprave të mira qoftë edhe një thërrmijë të vogël, që t'i shërbente për këtë ditë të gjatë dhe të vështirë. Atë ditë, njeriu do të dëshirojë të ishte ruajtur nga të këqijat dhe të kishte bërë qoftë edhe një thërrmijë më pak nga të këqijat, që të mos i shtohet dënimi dhe trishtimi, atë ditë kur dëshpërimi i punëkëqijve do të jetë i papërshkrueshëm. Të gjithë do të binden atë ditë se lumturia apo dëshpërimi i robërve në përjetësi janë të lidhura ngushtë me veprat që kanë bërë në dynja.

- "Xhehenemi do shfaqet sheshazi për atë që e sheh." - Atë ditë, Xhehenemi do të shfaqet hapur për të gjithë. Të gjithë do të shohin atë. Ai mezi pret dhe, me një zemërim të papërshkruar, është gati të gllabërojë banorët e Zjarrit, që nuk u janë bindur Allahut dhe profetëve. Xhehenemi pret vetëm urdhrin e Zotit të tij për të ndëshkuar dhembshëm ata që e meritojnë.

- "Për sa i përket atij që i ka kaluar kufijtë dhe i ka dhënë përparësi jetës së kësaj bote..." – Ky është ai që i ka kaluar kufijtë, duke kryer poshtërsi të mëdha dhe i ka dhënë përparësi jetës së dynjasë, duke iu përkushtuar plotësisht dhe totalisht asaj. Ai ia ka përkushtuar të gjithë kohën dhe mundin e tij arritjes dhe plotësimit të qëllimeve të kësaj jete dhe kënaqësive të saj. Ai nuk ka punuar aspak për jetën e përtejme dhe e ka shpërfillur ftesën e Allahut dhe të profetëve të Tij.

Kështu, ai që ka këto cilësi, ai do të jetë banor i Xhehenemit dhe nuk do të ketë shpëtim prej tij. I Lavdëruari thotë:

- "...Xhehenemi do të jetë vendi i tij." – Xhehenemi do të jetë vendqëndrimi i përhershëm i tij, ku do të kalojnë veçse ndëshkim pas ndëshkimi, dëshpërim pas dëshpërimi.

Ndërsa më pas, për të ruajtur shpresën, Allahu i Lartësuar na flet për të lumturit:

- "E për atë që i është druajtur daljes para Zotit të vet dhe e ka ndaluar veten prej epsheve..." - Këta fatlumë karakterizohen nga dy cilësi:
1. Ata i druhen qëndrimit para Zotit të tyre për të dhënë llogari dhe për t'u shpërblyer me drejtësi për veprat e bëra. Nga dija e tyre e saktë dhe e sigurt ka ardhur frikërespekti ndaj Zotit. Për këtë shkak, ata plotësojnë edhe cilësinë e dytë:

2. Ata e ndalojnë veten nga dëshirat e shfrenuara dhe shkelja e kufijve të Zotit. Dëshirat e shfrenuara e shtyjnë njeriun të shkelë kufijtë e Zotit dhe të mos zbatojë urdhrat e Tij. Por këta të zgjedhur i nënshtrojnë dëshirat e tyre për të ndjekur porositë e Allahut dhe të Profetit të Tij. Ata luftojnë me vetveten dhe nuk i binden asaj për të shkelur urdhrat e Tij. Për këta të lumtur është një premtim i mrekullueshëm:

- "Xheneti do të jetë vendi i tij." - Ata do të kenë si vendqëndrim Xhenetin e përjetshëm, pranë të Gjithëmëshirshmit Bujar.

Ajetet 42 – 46

42. Ty të pyesin për Kijametin: "Kur do të ndodhë ai?!
43. Po, ku je në gjendje ti, që t'ua tregosh atë?
44. Vetëm Zoti yt e ka dijeninë për të.
45. Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i druhen Atij.
46. Ditën kur ta përjetojnë atë, atyre do t'u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj.

Shpjegimi i ajeteve

- "Ty të pyesin për Kijametin: "Kur do të ndodhë ai?!""" - Mohuesit e kësaj dite, ata të cilët nuk e besojnë ringjalljen dhe llogarinë me drejtësi para të Drejtit të Gjithëdijshëm, pyesin në formë mosbesimi dhe habie se kur do të jetë kjo ditë kaq e përfolur dhe e frikshme. Allahu i Lartësuar u kthen një përgjigje shumë kuptimplotë:


- "Po, ku je në gjendje ti, që t'ua tregosh atë?" - Çfarë dobie kanë ata dhe ti nga njohja e kohës së Kijametit?! Kjo nuk sjell asnjë dobi për ta.

Pikërisht se njohja e këtij momenti nuk ka asnjë lloj dobie fetare apo të kësaj jete, Allahu i Lartësuar e ka fshehur atë dhe nuk ia ka treguar askujt prej krijesave. Madje, më e dobishme është që ajo të mbetet e fshehtë, dhe i vetmi që di për të është Allahu i Madhërishëm, i Gjithëditur dhe i Urtë:

- "Vetëm Zoti yt e ka dijeninë për të." - Kjo është një dije e posaçme për Allahun e Lartësuar, sikurse thotë Ai në një ajet tjetër: "Të pyesin ty (Muhamed) për Çastin, se kur do të ndodhë ai. Thuaj: "Atë e di vetëm Zoti im; kohën e tij nuk mund ta zbulojë kush, veç Tij. Çështja e tij është angazhim i rëndë për ata në qiej e në tokë. Ai do t'ju vijë vetëm se befas". Të pyesin ty, sikur ti di për të. Thuaju: "Për të di vetëm Allahu, por shumica e njerëzve nuk e kuptojnë".

- "Ti je vetëm paralajmërues i atyre që i druhen Atij." - Paralajmërimet e tua janë të vlefshme, ndikuese dhe të dobishme vetëm për ata që i frikësohen takimit me të Madhërishmin e Plotpushtetshëm. Vetëm ata që kanë frikë nga qëndrimi para të Drejtit përpiqen sinqerisht dhe përgatiten për atë ditë. Ndërsa ata të cilët nuk e besojnë si të vërtetë ringjalljen dhe llogarinë me drejtësi, ata nuk mendojnë fare për të. Kësisoj, përgjigjja për pyetje të tilla është krejt e kotë për ta, sepse ata nuk pyesin për të mësuar, por thjesht për të mohuar dhe për t'u tallur.

Allahu i Lartësuar është shumë më i Ditur dhe i Urtë për t'u dhënë përgjigje këtyre të mjerëve, por të jenë të bindur ata se, ditën kur ta shohin qartazi atë që e mohojnë dhe e konsiderojnë të largët, do të



dëshpërohen pa masë dhe do ta kuptojnë kotësinë e kësaj jete mashtruese, e cila ishte aq e shkurtër dhe e pavlefshme. Thotë i Lartësuari:

- "Ditën kur ta përjetojnë atë, atyre do t'u duket sikur nuk kanë jetuar më tepër se një mbrëmje ose një mëngjes të saj." - Mjerë për ta dhe për tregtinë e tyre aq të humbur dhe dëshpëruese!

Surja 80: Abese (mekase) 42 ajete

Ajetet 1 – 10
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

1. Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin,
2. kur i erdhi i verbëri.
3. E ku mund ta dish ti, ndoshta ai dëshiron të pastrohet,
4. ose të këshillohet, dhe këshilla t'i bëjë dobi!
5. Ndërsa sa për atë që hiqet si i pavarur,
6. ti atij i kushton vëmendje,
7. edhe pse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet!
8. Ndërsa ai që vjen tek ti duke nxituar
9. dhe me drojë,
10. ti atij nuk ia vë veshin!

Shpjegimi i ajeteve

Shkaku i shpalljes së këtyre ajeteve ishte vajtja e një besimtari të verbër te Profeti (a.s.) për ta pyetur rreth fesë dhe për të mësuar prej tij. Gjithashtu, në të njëjtën kohë, te Profeti (a.s.) vajti edhe një pasanik, po për të pyetur. Profeti (a.s.), që ishte shumë i përkushtuar në udhëzimin e njerëzve, anoi më shumë për udhëzimin e pasanikut, që ai të pastrohej, dhe, në njëfarë mënyre, e shmangu pak të verbërin e varfër, që ishte besimtar. Por Allahu i Lartësuar e qortoi Profetin e Tij të dashur për këtë zgjedhje, që nuk ishte më e mira që duhej të bënte. Qortimi ishte i ëmbël dhe shumë i ngrohtë. Allahu i Lartësuar na përshkruan të gjithë ngjarjen:

- "Ai u vrenjt dhe ktheu kurrizin, kur i erdhi i verbëri." – Kuptimi: Ai e rrudhi fytyrën dhe ktheu shpinën, kur pa se i verbëri po afrohej, ndërkohë që ai ishte duke ftuar në Islam pasanikun.

Por Allahu i Lartësuar na tregon dobitë e mëdha që vijnë së bashku me ata që e kërkojnë dijen sinqerisht:

- "E ku mund ta dish ti, ndoshta ai dëshiron të pastrohet..." – Domethënë, ky që po të vjen, i verbëri varfanjak, kërkon që të pastrohet nga cilësitë e këqija dhe të

stoliset me cilësitë e mira, në të cilat të udhëzon fjala e Zotit dhe e Profetit të Tij. Për këtë arsye, një njeri i tillë duhet respektuar dhe trajtuar me dashuri, kujdes dhe përkushtim. Ndaj tij nuk duhet treguar asnjë shenjë pakënaqësie, qoftë edhe me mimikë, edhe kur kërkuesi i dijes nuk e vë re një gjë të tillë.

Njerëz të tillë, kur mësojnë diçka të re nga Allahu dhe Profeti (a.s.), përfitojnë prej saj dhe punojnë me të. Në këtë mënyrë, ata pastrohen dhe ngrhen më lart në grada, siç thotë i Lartësuari:

- "...ose të këshillohet, dhe këshilla t'i bëjë dobi!" – Këta janë ata që përfitojnë nga mësimet e Zotit dhe të Profetit (a.s.). Kjo, pa dyshim, është një mirësi shumë e madhe, së cilës i duhet kushtuar vëmendje, sepse pikërisht për atë janë dërguar profetët dhe atë e synon çdo thirrës në fe. Përfundimisht, kushtimi ndaj atyre që kërkojnë të vërtetën dhe që duan të pastrohen, është detyrë shumë e rëndësishme.

- "Ndërsa sa për atë që hiqet si i pavarur, ti atij i kushton vëmendje..." - Ndërsa angazhimi me ata që e shohin veten të pavarur dhe mendojnë se nuk kanë nevojë për porositë e Zotit dhe të Profetit, me ata pasanikë mendjemëdhenj, që kërkojnë të bien në sy dhe të dëgjojnë veçse kur u shkon nga pas, pra, ky angazhim nuk duhet të jetë më parësor se përkushtimi ndaj të tjerëve, që janë më të mirë. Mendjemëdhenjtë nuk interesohen për të mirën, sepse ata nuk e preferojnë atë, prandaj angazhimi me ta dhe lënia mënjanë e të përkushtuarve nuk është zgjedhja më e mirë. Ti nuk e ke detyrë pastrimin e tyre, me gjithë përkushtimin dhe dëshirën tënde që ata të udhëzohen.

- "...edhe pse nuk ke përgjegjësi, nëse ai nuk dëshiron të pastrohet! Ndërsa ai që vjen tek ti duke nxituar dhe me drojë, ti atij nuk ia vë veshin!" - Nuk është detyrë dhe as përgjegjësia jote që ata të pastrohen nga e keqja e tyre.

Kjo na kujton një parim shumë të njohur, që thotë: "Një çështje e ditur mirë nuk lihet për një çeshtje të dyshimtë.". Ose: "Një çështje me dobi të sigurt nuk lihet për një tjetër me dobi të supozuar dhe të pasigurt".

Ky ajet tregon, gjithashtu, se është detyrë përkushtimi dhe përkujdesja ndaj nxënësit të dijes, që kërkon prej teje dije dhe njohuri. Nxënësi i përkushtuar meriton përkujdesje dhe trajtim më të veçantë se të tjerët.

Ajetet 11 – 32

11. Mos vepro ashtu! Në të vërtetë këto janë këshilla,
12. dhe kush dëshiron, merr mësim.
13. Ai ndodhet në faqe të çmueshme,
14. të larta e të pastërta,
15. në duar të udhëtuesve,
16. të ndershëm e punëmirë.
17. Mallkuar qoftë njeriu! Sa mohues i keq është ai!
18. Prej çfarë gjëje e krijon Ai atë?
19. Prej një pike e krijon dhe e përcakton.
20. Pastaj rrugën ia lehtëson.
21. Mandej e bën të vdesë dhe një varr i ka caktuar.
22. Pastaj, kur të dëshirojë, e ringjall.
23. Megjithatë, ai ende nuk i ka zbatuar ato që Ai urdhëroi.
24. Le të shikojë njeriu ushqimin e vet!
25. Ne lëshojmë ujë me bollëk.
26. Pastaj e çajmë tokën në thellësi,
27. dhe bëjmë që në të të mbijnë drithëra,
28. edhe rrush e perime,
29. edhe ullinj e hurma,

30. edhe kopshte të dendura,
31. edhe pemë e kullota;
32. si furnizim për ju dhe për bagëtinë tuaj.

Shpjegimi i ajeteve

- "Mos vepro ashtu! Në të vërtetë këto janë këshilla..." - Ky është një përkujtim, me të cilin Allahu i Lartësuar këshillon dhe mëson adhuruesit e Tij. Nëpërmjet këtij libri madhështor, Ai u mëson adhuruesve të Tij atë që kanë nevojë dhe u bën të qartë udhën e drejtë nga e gabuara.

Pra, të gjithë mund të përfitojnë nga ky udhëzim. Allahu i Lartësuar ua ka afruar udhëzimin e Tij të gjithëve, dhe ai që dëshiron mund ta pasojë rrugën e mbarë:

- "...dhe kush dëshiron, merr mësim." - Ai që dëshiron vërtet udhëzimin dhe rrugën e lumturisë, e ndjek atë, ndërsa ai që nuk e do udhëzimin, nuk e ndjek atë. Secili bën një zgjedhje të lirë dhe Allahu i Lartësuar bën që udhëzohet në rrugën e drejtë atë që Ai dëshiron, sipas urtësisë dhe dijes së Tij absolute. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "E ti thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë. Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një zjarr muret e të cilit i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije dhe i keq është ai vend". [El kehf 29] Më pas, Allahu i Lartësuar përshkruan gradën e lartë të Librit madhështor. Ai thotë:

- "Ai ndodhet në faqe të çmueshme, të larta e të pastërta..." - Fletët e Librit janë shumë të larta në gradën e tyre. Ato janë të pastra nga çdo mangësi dhe shtrembërim. Ato nuk mund të trazohen nga duart e shejtanëve apo të shfrytëzohen prej tyre. Ata të mallkuar nuk mund të vjedhin apo shkëpusin gjë nga ky libër i pastër. Fletët e pastra me këshilla dhe mësime të çmuara qarkullojnë nëpër duart e melekëve.

- "...në duar të udhëtuesve, të ndershëm e punëmirë." - Këto melekë, të cilësuar si *kirâmin berarah*, udhëtojnë mes Zotit dhe krijesave. *Kirâm* domethënë: të mbushur me mirësi, begati dhe bekim; ndërsa *berarah* do të thotë: të mirë në shpirt dhe të mirë në veprat e tyre. Allahu i Lartësuar përkujdeset për Librin e Tij duke vendosur si korrierë këta ëngjëj të bekuar, të mirë, të fuqishëm, të bindur, që kurrë nuk lodhen nga adhurimet që i përkushtojnë Atij. Allahu i Lartësuar e ka ruajtur Librin nga ndërhyrjet e shejtanëve. Kjo na bën që ta pranojmë dhe besojmë plotësisht këtë libër, pa as më të voglën mëdyshje. Çdo gjë e përmendur në të duhet të besohet plotësisht dhe çdo dispozitë e tij duhet të trajtohet me respekt dhe kujdes të madh. Atje është udhëzimi dhe drita. Atje është shpëtimi dhe mirësia.

Megjithatë, njeriu përsëri refuzon ta pranojë dhe ta besojë këtë dhuratë kaq të vyer të Zotit të tij. Për këtë arsye, i Madhëruari thotë:

- "Mallkuar qoftë njeriu! Sa mohues i keq është ai!" - Sa mohues i paturpshëm i mirësive të Zotit që është njeriu! Sa e ashpër dhe e paskrupull është urrejtja dhe armiqësia e tij ndaj të vërtetës, edhe pas qartësimit të saj në mënyrë të plotë dhe të pakundërshtueshme! Dhe të mendosh se çfarë është njeriu dhe nga çfarë është krijuar:

- "Prej çfarë gjëje e krijon Ai atë? Prej një pike e krijon dhe e përcakton." - Allahu i

Lartësuar e krijon njeriu prej një lëngu të përbuzur, prandaj njeriu është një krijesë shumë e dobët në fillesat e tij. Allahu i Lartësuar e përcakton dhe e krijon atë në formën që dëshiron. Është përsëri Ai që i dhuron njeriut forcat e jashtme dhe të brendshme, nëpërmjet të cilave ai jeton në këtë botë, madje edhe sundon në të.

- "Pastaj rrugën ia lehtëson." - Është Allahu i Mëshirshëm dhe i Urtë Ai që ia lehtëson rrugën kësaj krijese, që quhet njeri, duke i mundësuar atij çdo mjet dhe ndihmë të nevojshme për të arritur të mirat e kësaj jete dhe të jetës tjetër. Është i Gjithëdijshmi Ai që ia hap njeriut sytë e zemrës, për të gjetur të mirën dhe për t'u larguar nga të këqijat. Allahu i Mëshirshëm dhe i Urtë ia qartëson njeriut rrugën e drejtë dhe e ndihmon atë në këtë drejtim, nëse ai përkushtohet sinqerisht dhe vërtet e dëshiron një gjë të tillë. Është po Ai që e vë në provë njeriun duke e urdhëruar dhe duke e ndaluar atë. Ai ka vendosur për të kufij dhe ligje, që duhet t'i respektojë dhe t'i verë në jetë. Allahu e krijoi këtë jetë, që njerëzit të mbjellin në të atë që do të korrin në jetën e pasosur.

- "Mandej e bën të vdesë dhe një varr i ka caktuar." - Allahu i Lartësuar ka përcaktuar për njeriun që jeta e tij të ketë një fund në këtë dynja. Më pas, Ai e nderoi njeriun, duke urdhëruar që për të të ketë një varr, dhe nuk e bëri si krijesat e tjera, të cilat qelben dhe thahen mbi dhé.

- "Pastaj, kur të dëshirojë, e ringjall." - Allahu i Lartësuar do ta ringjallë njeriun pas vdekjes, për t'i dhënë shpërblimin e merituar me drejtësi, sipas veprave që ka bërë dhe sipas korrektësisë në ruajtjen e kufijve të Tij.

- "Megjithatë, ai ende nuk i ka zbatuar ato që Ai urdhëroi." - Megjithëse Allahu i Lartësuar është i vetmi që ka në dorë gjithçka nga sa u përmend, njeriu përsëri tregohet mospërfillës ndaj urdhëresave dhe kufijve të të Madhëruarit. Më pas, Allahu i Lartësuar e nxit njeriun që të meditojë mbi ushqimin e tij:

- "Le të shikojë njeriu ushqimin e vet! Ne lëshojmë ujë me bollëk. Pastaj e çajmë tokën në thellësi..." - Le të mendohet njeriu për fazat në të cilat ka kaluar ushqimi, pa të cilin ai nuk mund të jetojë, dhe le të kuptojë se sa i varur dhe nevojtar është për mëshirën e Allahut, që ka mundësuar dhe rregulluar çdo të mirë në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Mos, vallë, është njeriu ai që e bën shiun të bjerë nga lart, me aq mirësi dhe begati?! Mos është ai që e urdhëron shiun të bjerë në pika të vogla dhe aq ëmbëlsisht, për të ushqyer njerëzinë dhe gjithçka tjetër?! Mos është njeriu ai që e çan tokën për bimësinë dhe krijon për to çdo kusht të nevojshëm nëpërmjet tokës, ajrit, diellit etj.?!

- "...dhe bëjmë që në të të mbijnë drithëra..." – Mos, vallë, është njeriu ai që i bën bimët të dalin dhe të rriten?! Jo. Ai është Allahu i Gjithëmëshirshëm dhe Fuqiplotë. Ai nxjerr prej tokës drithërat, me të gjithë larminë e tyre.

- "...edhe rrush e perime..." - Eshtë i Lartësuari që, me mirësinë e Tij, i ka dhuruar tokës rrush dhe perime, të të gjitha llojeve, aq të mira, të dobishme dhe të freskëta.

- "...edhe ullinj e hurma..." - Ai na ka falur edhe pemë të tilla, si ulliri dhe hurmat, të cilat mund të magazinohen dhe ruhen për t'u përdorur gjatë. Këto pemë kanë shumë vlera ushqyese dhe kuruese. Allahu i Lartësuar veçon katër kategoritë e mësipërme të frutave dhe perimeve për të treguar rëndësinë e madhe të tyre.

- "**edhe kopshte të dendura...**" - Allahu i Lartësuar dhe i Mëshirshëm na ka dhuruar edhe kopshte të dendura, me bimësi dhe shtazë, pyje të bukura dhe të dobishme për jetën tonë.

- **"...edhe pemë e kullota..."** - Allahu i Lartësuar ka bërë për njerëzit pemë dhe shumë bimë aromatike e të shijshme, si portokalli, limoni, shega, fiku, ananasi, rrushi etj. Ai u ka mundësuar atyre edhe kullota për kafshët që mbajnë. Të gjitha këto, i Lartësuari i ka krijuar për të shprehur mëshirën dhe mirësinë e Tij ndaj nesh, prandaj thotë:

- "...si furnizim për ju dhe për bagëtinë tuaj." - Allahu i Lartësuar i krijoi dhe i nënshtroi ato për ne.

Çdokush që vështron dhe mendon për këto mirësi do të arrijë në përfundimin se mirënjohja ndaj Zotit është e detyrueshme dhe do të përpiqet maksimalisht për t'u kthyer tek Ai i penduar dhe i bindur. Meditimi mbi mirësitë e Zotit ndihmon për të qenë të bindur ndaj porosive të Tij dhe për të besuar fjalën e Tij.

Ajetet 33 – 42

33. Por kur të vijë Ushtima,
34. është dita kur njeriu ikën prej vëllait të vet,
35. prej nënës dhe prej babait të vet,
36. prej gruas dhe prej fëmijëve të vet.
37. Çdo njeriu, atë ditë, i mjafton çështja e vet.
38. Atë ditë do të ketë fytyra të shndritura,
39. të buzëqeshura e të gëzuara.
40. Atë ditë do të ketë edhe fytyra të pluhurosura,
41. që i ka mbuluar errësira e zezë,
42. Pikërisht këta janë mohuesit, gjynahqarët!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Por kur të vijë Ushtima..."** - Kur të dëgjohet ushtima e Kijametit, nga zhurma e së cilës buçasin veshët dhe tronditen shpirtrat, atë ditë njerëzit do të shohin tmerrin me sy. Frika do të jetë shumë e madhe dhe çdokush do të dëshironte që të kishte qoftë edhe një vepër të mirë, sado e vogël qoftë ajo, për t'i shpëtuar dënimit të asaj dite të vështirë.

- "...është dita kur njeriu ikën prej vëllait të vet, prej nënës dhe prej babait të vet, prej gruas dhe prej fëmijëve të vet." - Atë ditë, askush nuk do të pyesë për asgjë dhe për asnjë në këtë botë. Çdokush do të shqetësohet vetëm për veten e vet. Madje, në ato momente, njeriu do të braktisë edhe njerëzit më të dashur dhe më të shtrenjtë të tij, sepse tmerri është shumë i madh.

- "Çdo njeriu, atë ditë, i mjafton çështja e vet." - Çdokush do të shqetësohet vetëm për veten dhe për të shpëtuar nga ndëshkimi. Asgjë dhe askush nuk i hyn më në sy.

Ajo është dita kur njerëzit do të ndahen në dy grupe: të shpëtuarit, që do të lumturohen në kënaqësinë dhe në mëshirën e Allahut të Lartësuar, dhe të dështpëruarit, që do të vuajnë ndëshkimin e të Drejtit të

Plotpushtetshëm. Ata do të dallohen nga fytyrat e tyre:

- "Atë ditë do të ketë fytyra të shndritura, të buzëqeshura e të gëzuara." - Fytyrat e fatbardhëve do të jenë të shndritura, në të cilat do të dallohet qartë kënaqësia dhe mirësia që përjetojnë, kur përgëzohen me shpëtimin nga Zjarri dhe hyrjen në Xhenetin e mirësive të përjetshme. Ato do të jenë fytyra të qeshura dhe të gëzuara.

- "Atë ditë do të ketë edhe fytyra të pluhurosura që i ka mbuluar errësira e zezë." - Ndërsa fytyrat e të mjerëve do të jenë të mbuluara nga pluhuri dhe errësira. Ata do të jenë shumë të dëshpëruar, sepse nuk shpresojnë asnjë të mirë dhe janë plotësisht të sigurt për dënimin që do të vuajnë përjetësisht. Ata e meritojnë këtë ndëshkim, sepse janë mohues dhe shkelës të kufijve të Zotit. I Lartësuari thotë:


- "Pikërisht këta janë mohuesit, gjynahqarët." - Ky do të jetë përfundimi i të gjithë atyre që mohojnë mirësitë e Allahut, që nuk i besojnë shpalljet e Tij dhe guxojnë të shkelin dhe kufijtë e Tij.

E lusim Allahun e Lartësuar që të na ruajë dhe të na shpëtojë! Ai është vërtet Bamirës i madh dhe Bujar!

Surja 81: Et Tekuir (mekase) 29 ajete

Ajetet 1 – 14

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!


الجزء الثلاثون
سورة التكوير
تَرۡهَقُهَا قَتَرَةٞ ٤١ أُوْلَٰٓئِكَ هُمُ ٱلۡكَفَرَةُ ٱلۡفَجَرَةُ ٤٢
سورة التكوير
بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
إِذَا ٱلشَّمۡسُ كُوِّرَتۡ ١ وَإِذَا ٱلنُّجُومُ ٱنكَدَرَتۡ ٢ وَإِذَا ٱلۡجِبَالُ
سُيِّرَتۡ ٣ وَإِذَا ٱلۡعِشَارُ عُطِّلَتۡ ٤ وَإِذَا ٱلۡوُحُوشُ حُشِرَتۡ
٥ وَإِذَا ٱلۡبِحَارُ سُجِّرَتۡ ٦ وَإِذَا ٱلنُّفُوسُ زُوِّجَتۡ ٧ وَإِذَا
ٱلۡمَوۡءُۥدَةُ سُئِلَتۡ ٨ بِأَيِّ ذَنۢبٖ قُتِلَتۡ ٩ وَإِذَا ٱلصُّحُفُ نُشِرَتۡ
١٠ وَإِذَا ٱلسَّمَآءُ كُشِطَتۡ ١١ وَإِذَا ٱلۡجَحِيمُ سُعِّرَتۡ ١٢ وَإِذَا ٱلۡجَنَّةُ
أُزۡلِفَتۡ ١٣ عَلِمَتۡ نَفۡسٞ مَّآ أَحۡضَرَتۡ ١٤ فَلَآ أُقۡسِمُ بِٱلۡخُنَّسِ ١٥
ٱلۡجَوَارِ ٱلۡكُنَّسِ ١٦ وَٱلَّيۡلِ إِذَا عَسۡعَسَ ١٧ وَٱلصُّبۡحِ إِذَا تَنَفَّسَ ١٨
إِنَّهُۥ لَقَوۡلُ رَسُولٖ كَرِيمٖ ١٩ ذِي قُوَّةٍ عِندَ ذِي ٱلۡعَرۡشِ مَكِينٖ ٢٠ مُّطَاعٖ
ثَمَّ أَمِينٖ ٢١ وَمَا صَاحِبُكُم بِمَجۡنُونٖ ٢٢ وَلَقَدۡ رَءَاهُ بِٱلۡأُفُقِ ٱلۡمُبِينِ
٢٣ وَمَا هُوَ عَلَى ٱلۡغَيۡبِ بِضَنِينٖ ٢٤ وَمَا هُوَ بِقَوۡلِ شَيۡطَٰنٖ رَّجِيمٖ ٢٥
فَأَيۡنَ تَذۡهَبُونَ ٢٦ إِنۡ هُوَ إِلَّا ذِكۡرٞ لِّلۡعَٰلَمِينَ ٢٧ لِمَن شَآءَ مِنكُمۡ أَن
يَسۡتَقِيمَ ٢٨ وَمَا تَشَآءُونَ إِلَّآ أَن يَشَآءَ ٱللَّهُ رَبُّ ٱلۡعَٰلَمِينَ ٢٩
٥٨٦

1. Kur Dielli të jetë mbështjellë
2. dhe yjet të kenë rënë;
3. kur malet të zhduken,
4. kur devetë e shtrenjta të braktisen
5. dhe egërsirat të tubohen;
6. kur detet të vlojnë,
7. dhe shpirtrat të bashkohen;
8. kur, vajzat e varrosura për së gjalli, të pyeten,
9. për çfarë gjynahu ato janë mbytur.
10. Kur fletët të jenë shpërndarë,
11. dhe qielli të zhvishet;
12. kur Xhehenemi të jetë flakëruar
13. dhe Xheneti të jetë afruar;
14. atëherë njeriu do ta shohë se çfarë ka përgatitur.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na sjell një pamje të Ditës së Gjykimit, ditë në të cilën çdokush do të shohë se çfarë ka bërë në dynja, mirë apo keq. Atë ditë, njeriu do të mësojë plotësisht se çfarë e pret: dënimi apo shpërblimi.

- "Kur Dielli të jetë mbështjellë dhe yjet të kenë rënë..." - Dielli do të mbështillet dhe do të shuhet. Po kështu, edhe Hëna do të shuhet, dhe të dy, bashkë me Diellin, do të hidhen në Xhehenem. Edhe yjet do të ndryshojnë dhe do të shkëputen nga vendi i tyre. Çdo trup qiellor do të shkatërrohet dhe qielli do të ndryshojë tërësisht.

- "...kur malet të zhduken..." - Toka, me gjithçka që përmban, do të pësojë një tronditje të tmerrshme. Malet do të shpërbëhen e copëtohen, pastaj do të rrënohen e bëhen si lesh i tjerrur, pastaj do të bëhen pluhur dhe do të zhduken fare.

- "...kur devetë e shtrenjta të braktisen..." - Njerëzit do të harrojnë çdo lloj pasurie, sado e madhe dhe e vyer qoftë ajo, sepse tmerri i Kijametit është shumë i madh. Allahu i Lartësuar përmend në veçanti devetë e shtrenjta, si një nga pasuritë më të çmuara për arabët, për të nënkuptuar edhe llojet e tjera.

- "...dhe egërsirat të tubohen..." - Ditën e Gjykimit, edhe egërsirat do të grumbullohen bashkë, që Allahu i Lartësuar të vendosë mes tyre drejtësinë, duke ndëshkuar me të njëjtën mënyrë ato që, padrejtësisht kanë dëmtuar të tjerat. Atë ditë, krijesat do të shohin drejtësinë e plotë të të Plotpushtetshmit. Çdo padrejtësi do të ndëshkohet dhe drejtësia do të vihet në vend. Për shembull, asaj deleje që nuk ka pasur brirë do t'i jepen brirë dhe do t'i mundësohet që të hakmerret ndaj asaj kafshe që në jetën e dynjasë e ka goditur me brirë. Pasi të vendoset drejtësia, kafshëve do t'u thuhet: "Bëhuni dhé!", dhe ashtu do të bëhen.

- "...kur detet të vlojnë..." - Detet do të ndizen. Me gjithë madhësinë dhe gjerësinë e tyre, ata do të digjen si një zjarr gjigand.

- "...dhe shpirtrat të bashkohen..." - Njerëzit do të grumbullohen bashkë, në varësi të veprave që kanë punuar në dynja: të mirët me të mirët dhe të ligjtë me të ligjtë. Besimdrejtët do të martohen me hyritë symëdha. Ndërsa mohuesit e të Madhërishmit do të bashkohen me shejtanët më të shëmtuar. Kjo i ngjan shumë ajetit, ku i Madhëruari thotë: "E ata që nuk besojnë do të sillen në Xhehenem grupe-grupe. Kur arrijnë tek ai, dyert e tij do hapen e roja e tij do t'u thotë: "A nuk ju erdhën të dërguar nga mesi juaj, që ju lexuan shpalljet e Zotit tuaj dhe ju paralajmëruan për ballafaqimin tuaj në këtë ditë?!" Ata do thonë: "Po". Por vendimi i dënimit për jobesimtarët tashmë është bërë realitet! Atyre do t'u thuhet: "Hyni në dyert e Xhehenemit! Aty do të jeni përgjithmonë! Eh, sa vend i keq është ai për kryeneçët!" [El zumer 71, 72]

Ndërsa për të mirët, i Madhëruari thotë: "Ata që kanë qenë të devotshëm ndaj Zotit të tyre, do sillen në Xhenet grupe-grupe. Kur të arrijnë aty, dyert e tij do t'i gjejnë të hapura, ndërsa roja e tij do t'u thotë: "Selamun alejkum! Ishit të pastër, prandaj hyni në të! Aty do të jeni përgjithmonë". [El zumer 73]

- "...kur, vajzat e varrosura për së gjalli, të pyeten, për çfarë gjynahu ato janë mbytur." – Kështu vepronin jobesimtarët në kohën e injorancës paraislamike. Ata i varrosnin vajzat të gjalla, pa asnjë shkak, thjesht nga frika e varfërisë. Por Ditën e Gjykimit, vajzat e varrosura për së gjalli do të pyeten: "Për çfarë gjynahu u varrosët ju?". Eshtë e ditur

që ato nuk kishin kurrfarë gjynahu, por kjo kujtesë është një kërcënim i ashpër dhe poshtërim për ata që e kanë kryer një vepër kaq të shëmtuar.

- "Kur fletët të jenë shpërndarë, dhe qielli të zhvishet..." - Fletët në të cilat janë shkruar me besnikëri dhe përpikmëri veprat e robërve, të mirat dhe të këqijat e tyre, atë ditë do t'u shpërndahen të zotëve të tyre. Fatbardhët do t'i marrin fletët e shënimeve të tyre nga e djathta, ndërsa të mjerët do t'i marrin ato nga e majta ose pas shpine.

Atë ditë, qielli do të çahet dhe do të hiqet nga vendi, sikurse thotë i Lartësuari: "Ditën kur qielli të çahet nga një re dhe engjëjt të zbresin në një mënyrë madhështore. Atë ditë, sundimi i vërtetë i takon të Gjithëmëshirshmit. Për jobesimtarët ajo do të jetë një ditë e vështirë. Atë ditë, zullumqari do të kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "Oh, i mjeri unë, pse nuk ndoqa udhën e drejtë së bashku me Profetin!" [Furkan 25 – 27]. Ose: "Ata nuk e çmojnë Allahun me madhështinë që i takon, por Ditën e Kijametit e tërë toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij. Ai është i pastër nga të metat dhe i lartë nga çka ata i shoqërojnë!" [Zumer 67]. Ose: "Atë ditë, Ne e palosim qiellin, siç palosen fletët e një libri. Ashtu siç e filluam krijimin, ashtu e rikthejmë atë. Ky është premtimi Ynë dhe Ne do ta realizojmë atë." [Enbija 104].

- "...kur Xhehenemi të jetë flakëruar, dhe Xheneti të jetë afruar..." - Atë ditë, Xhehenemi do të flakërojë dhe ndizet si asnjëherë tjetër. Ai do të jetë i zemëruar ndaj mohuesve të Zotit. Ndërsa Xheneti do të afrohet me plot të mira për të devotshmit. Kjo do të jetë dita e gëzimit dhe lumturisë që nuk do të kenë fund, ose dita e trishtimit, dhimbjes dhe dëshpërimit, që, gjithashtu, nuk do të kenë kurrë fund.

- "...atëherë njeriu do ta shohë se çfarë ka përgatitur." - Çdo shpirt do të shohë se çfarë ka bërë, pa përjashtim. Çdo vepër që ka bërë në dynja do ta gjejë pranë vetes dhe do të përgjigjet për të. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Kur libri t'u vihet përpara, do t'i shohësh gjynahqarët të frikësuar nga shënimet në të, që do të thonë: "Të mjerët ne! Çfarë është ky libër, që nuk ka lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël, pa e shënuar atë?!" Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë bërë. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt." [Kehf 49].

Përshkrimet e kësaj dite të madhe dhe të vështirë trondisin çdo zemër dhe frikësojnë çdo shpirt. Ato nxisin të mençurit, që të përgatiten për takimin me Krenarin e Plotpushtetshëm, me Allahun e Lartësuar. Kështu, ata u largohen harameve, që t'i shpëtojnë frikës së asaj dite trishtuese. Ndërsa në lidhje me këtë sure, disa selefë kanë thënë: "Kush dëshiron që të shohë Ditën e Kijametit sikur ta kishte para syve, le të lexojë dhe meditojë thellë mbi suren El tekuir".

Ajetet 15 – 29

15. Betohem për yjet që tërhiqen,
16. të cilët udhëtojnë e fshihen;
17. për natën, kur bie terri,
18. dhe për agimin, kur zgjohet!
19. S'ka dyshim se ai është fjalë e të Dërguarit fisnik.
20. Ai është i fortë dhe me pozitë të lartë te Zoti i Arshit.
21. Ai është i respektuar dhe besnik.
22. Shoku juaj nuk është i marrë!

23. **Me të vërtetë, ai e pa atë në horizontin e qartë lindor.**
24. **Ai kurrë nuk mund të jetë mbulues i të fshehtës,**
25. **dhe ai nuk është fjalë e Shejtanit të mallkuar,**
26. **prandaj, ku po shkoni?!**
27. **Ai është veçse këshillë për njerëzit,**
28. **për këdo prej jush që dëshiron të përqendrohet.**
29. **Po ju nuk mundeni të dëshironi, pa dëshiruar Allahu, Zoti i botëve!**

Shpjegimi i ajeteve

- **"Betohem për yjet që tërhiqen, të cilët udhëtojnë e fshihen"** - I Lartësuari betohet në yjet, të cilët lëvizin në një sistem preciz dhe të mrekullueshëm.

- **"...për natën, kur bie terri, dhe për agimin, kur zgjohet!"** - I Lartësuari betohet edhe në këto dy dukuri mahnitëse dhe të domosdoshme për jetën në tokë. Këto janë shenja shumë të mëdha, të cilat përmenden për një çështje shumë të madhe. I Lartësuari betohet në to për të treguar vërtetësinë dhe madhështinë e Kuranit:

- **"S'ka dyshim se ai është fjalë e të Dërguarit fisnik."** - Kurani është një libër shumë i rëndësishëm, i zbritur nga i Gjithëmëshirshmi, nëpërmjet një meleku shumë madhështor, Xhibrilit (a.s.). Ai është një libër i ruajtur, të cilit Shejtani i mallkuar as mund t'i afrohet, siç thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Pa dyshim, ai (Kurani) është shpallje e Zotit të botëve. Atë e solli Shpirti besnik *(Xhibrili)* në zemrën tënde, për t'u bërë paralajmërues, me gjuhë të kulluar arabe. Me të vërtetë, ai është i përmendur edhe në librat e mëparshëm." [Shuara 192 – 195].

- **"Ai është i fortë dhe me pozitë të lartë te Zoti i Arshit."** - Allahu i Lartësuar e përshkruan Xhibrilin (a.s.) me cilësi të larta, si "*emîn*" - besnik, "*kerîm*" - i nderuar, "*dhî ḳuuetin*" - i fortë, që zbaton me përpikmëri çdo urdhër të të Plotpushtetshmit. Prej fuqisë së tij të madhe mund të përmendim që ai përmbysi qytetin e popullit të Lutit, duke i shkatërruar plotësisht ata. Xhibrili (a.s.) ka pozitën më të lartë pranë Allahut të Lartësuar. Pa dyshim, ai është meleku më i mirë dhe më i nderuar pranë të Plotpushtetshmit.

- **"Ai është i respektuar dhe besnik."** - Xhibrili është i respektuar mes engjëjve dhe atij i dëgjohet urdhri. Ai ka nën komandë ushtri me melekë, madje edhe prej melekëve më të afruar të Zotit të Lartësuar. Ai është besnik, pra, zbatues i përpiktë i urdhrave të marra nga i Gjithëpushtetshmi. Ai nuk lë mangët dhe as nuk e tepron me zbatimin e urdhrave.

Të gjitha këto tregojnë për rëndësinë dhe famën e lartë të Kuranit. Për të sjellë këtë fjalë, Madhështori, Sunduesi i qiejve dhe i tokës dërgoi këtë melek gjigand.

Pas të dërguarit-engjëll, Allahu i Lartësuar përmend edhe të dërguarin-njeri dhe gradën e tij të lartë:

- **"Shoku juaj nuk është i marrë!"** - Muhamedi (a.s.) nuk është ashtu si e përshkruajnë armiqtë e profetëve, të cilët, me këto fyerje dhe shpifje ndaj tij, kërkojnë të shuajnë dritën që solli ai, me lejen e të Madhëruarit. Përkundrazi, ai është njeriu më i plotë në mendjen dhe moralin, që ia

dhuroi Zoti i tij. Ai është më mendimdrejti dhe më fjalëmbli.

- "Me të vërtetë, ai e pa atë në horizontin e qartë lindor." - Muhamedi (a.s.) e pa Xhibrilin (a.s.) në formën e tij të plotë, ashtu sikurse e ka krijuar Zoti i tij. Ai e pa atë tek fluturonte në horizontet e largëta.

- "Ai kurrë nuk mund të jetë mbulues i të Vërtetës..." - Ky profet i rëndësishëm nuk mund të jetë fshehës apo shtrembërues i të vërtetës së shpallur nga i Gjithëpushtetshmi. Ai është besniku i qiejve dhe i tokës dhe kurrsesi nuk mund të mendohet se mund të shtojë apo të pakësojë gjë prej Shpalljes.

Profeti Muhamed (a.s.) e përcolli plotësisht Shpalljen dhe e çoi në vend amanetin e Zotit të tij. Ai ia kumtoi këtë të vërtetë të gjithëve: të pasurve dhe të varfërve, mbretërve dhe skllevërve, burrave dhe grave, të qytetëruarve dhe nomadëve. Ai u dërgua mes një populli të paditur, në skajet e injorancës, dhe nuk u largua nga kjo botë, derisa ata u shndërruan në dijetarë dhe edukatorë të njerëzimit. Ata u bënë udhëheqës dhe mësues të së mirës në botë. Bota nuk mundi të jetë më shumë se "nxënës" para popullit që edukoi ky profet i mëshirës dhe i mirësisë.

Pasi lëvdoi me cilësitë më të larta të dy profetët e Tij, njëri melek dhe tjetri njeri, dhe pasi tregoi gradën e lartë të Kuranit, Allahu i Lartësuar mohon çdo mangësi apo shpifje ndaj kësaj Shpalljeje të sigurt. I Lartësuari thotë:


- "...dhe ai nuk është fjalë e Shejtanit të mallkuar..." – Ky libër nuk mund të jetë kurrsesi fjalë e të Mallkuarit. Madje, i Mallkuari as që mund ta durojë këtë fjalë të madhe plot dritë dhe jetë. Ky është një mendim shumë i largët, që as duhet llogaritur fare.

- "...prandaj, ku po shkoni?!" - Si është e mundur që t'ju shkojë kjo ndër mend?! Si mund të gjykoni në këtë mënyrë?! Si mund ta quani të vërtetën e sigurt nga Zoti i gjithësisë një gënjeshtër të trilluar nga Shejtani i mallkuar?! A nuk është ky një shtrembërim i paturpshëm i të vërtetës dhe realitetit?!

Mësojeni dhe mbajeni mend mirë se kjo është shpallje e Atij që ka në dorë pushtetin e qiejve dhe të tokës. Kujtoni që në gjithësinë e krijuar prej Tij nuk ndodh asgjë pa lejen dhe vullnetin e Tij. Është vetë Ai që e ruan shpalljen e Tij të paprekshme dhe të pastër, ashtu si Ai dëshiron.

- "Ai është veçse këshillë për njerëzit..." - Kurani është përkujtim dhe mësim për botët. Nëpërmjet tij, bota njeh Krijuesin dhe Sunduesin e saj me emrat e Tij të bukur, me cilësitë e Tij të larta dhe veprat e Tij të urta dhe plot mirësi e mëshirë. Nëpërmjet tij, njerëzit njohin Zotin, të Adhuruarin e tyre të pastër dhe të lartësuar nga çdo e metë. Në Kuran, ata mësojnë si ta adhurojnë dhe ta madhërojnë Allahun e Lartësuar, duke zbatuar urdhrat e Tij. Kurani është drita, udhëzimi, mëshira dhe shërimi i tyre. Ai është udhërrëfyesi për të arritur mirësitë e dynjasë dhe të ahiretit dhe për të shpëtuar nga e keqja në dynja dhe ahiret. Ai është rruga drejt lumturisë në të dyja botët, rruga drejt Xhenetit të përjetësisë, pranë Zotit të gjithësisë.

- "...për këdo prej jush që dëshiron të përqendrohet." - Kjo ftesë është e vlefshme



për të gjithë ata që dëshirojnë vërtet të mirën dhe lumturinë e tyre. Pas sqarimit të vërtetës nga e kota, të gjithë janë të barabartë në mundësinë për ta përqafuar atë, por kjo duhet që të kërkohet prej Allahut të Lartësuar. Çdokush që e kërkon udhëzimin prej Bujarit të Gjithëmëshirshëm, do ta arrijë atë. Besimi është dhuratë e Allahut të Lartësuar dhe vetëm Ai mund të udhëzojë tek e Vërteta. Për këtë arsye, Shpallja dhe i Dërguari i Allahut duhen trajtuar me respektin dhe dashurinë më të madhe, nëse duam që Ai të na udhëzojë në rrugën e drejtë. Më tej, i Madhëruari thotë:

- **"Po ju nuk mundeni të dëshironi, pa dëshiruar Allahu, Zoti i botëve!"** - Dijeni se çfarë dëshiron Ai do të ndodhë patjetër dhe askush nuk mund të pengojë dëshirën e Tij. Allahu është i Urtë, i Gjithëdijshëm dhe e vendos çdo gjë në vendin e vet. Ai udhëzon në rrugën e drejtë atë që e meriton udhëzimin dhe e lë në humbje atë që, me shpërfilljen e Shpalljes së Tij, e meriton humbjen.

Ky ajet dhe të tjerë të ngjashëm me të, janë argumentet më të mira kundër xhebrive dhe kaderive [41].

Surja 82: El infitar (mekase) 19 ajete

Ajetet 1 – 5

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Kur qielli të çahet
2. dhe yjet të derdhen;
3. kur detet të përzihen
4. dhe varret të trazohen;
5. atëherë çdokush do ta shohë se çfarë ka punuar dhe çfarë ka lënë pa bërë!

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur qielli të çahet dhe yjet të derdhen..." - Kur qielli të shkatërrohet, kur bukuria dhe rregullsia e tij të prishen, kur yjet të shkëputen dhe të bien, atëherë do të jetë një ditë e vështirë dhe e frikshme.

- "...kur detet të përzihen dhe varret të trazohen..." - Kur detet të shpërthejnë dhe të bëhen një det i vetëm, kur varret të zbrazen, duke nxjerrë jashtë të gjithë të vdekurit brenda tyre, atëherë do të jetë Dita e Llogarisë.

---

[41] të cilët ose e zhveshin robin nga çdo lloj përgjegjësie dhe mundësie veprimi, ose i japin atij pavarësi, mundësi dhe fushë veprimi absolute, të pavarur prej dëshirës dhe vullnetit suprem të Allahut të Madhëruar.

- **"...atëherë çdokush do ta shohë se çfarë ka punuar dhe çfarë ka lënë pa bërë!"** - Kjo është dita kur shfaqen të fshehtat dhe dalin në shesh të gjitha veprat e robërve. Çdokush do të mësojë se çfarë ka bërë dhe fituar. Jobesimtarët dhe zullumqarët do të dëshpërohen dhe do të vuajnë. Kur të shohin haramet e tyre, që do rëndojnë mbi peshoren e veprave, ata do të kafshojnë duart e tyre, por kjo nuk do t'ua lehtësojë aspak dhimbjen dhe dëshpërimin. Kjo është dita kur veprat e secilit zbulohen dhe peshohen me drejtësi nga i Drejti dhe i Gjithëdijshmi. I mjeri ai që e ka ngarkuar veten me padrejtësi dhe i ka kthyer shpinën udhëzimit të të Gjithëmëshirshmit, se atë ditë, për të, do të fillojë një ndëshkim dhe dëshpërim, që kurrë nuk do të ketë fund.

Atë ditë do të gëzohen dhe lumturohen punëmirët dhe besimdrejtët. Ata do të përjetojnë mirësi pas mirësie, gëzim pas gëzimi, në përjetësi. Ata do të jenë të sigurt dhe të ruajtur nga frika e asaj dite dhe ndëshkimi i Krenarit të Plotpushtetshëm.

Ajetet 6 – 12

6. O njeri, ç'të mashtroi ty, që nuk i besove Zotit tënd Bujar?
7. i Cili të krijoi, të rregulloi dhe të drejtoi,
8. të dha formën që Ai dëshiroi!
9. Por jo! Ju mohoni Ditën e Gjykimit.
10. Pa dyshim, mbi ju qëndrojnë rojet!
11. Ata janë shkrues të ndershëm.
12. Ata dinë çdo gjë që ju veproni.

Shpjegimi i ajeteve

- "O njeri, ç'të mashtroi ty, që nuk i besove Zotit tënd Bujar?" - Allahu i Lartësuar i drejtohet me këto fjalë njeriut, i cili është aq i mangët dhe i pakujdesshëm në kryerjen e detyrimeve ndaj Zotit të tij dhe aq i paturpshëm në shkeljen e kufijve të Tij: Çfarë të shtyu që të sillesh në këtë formë? Mos vallë, mospërfillja jote ndaj të drejtave të Krenarit të Plotfuqishëm?! Apo shpërfillja e kërcënimeve dhe ndëshkimit të Tij të dhembshëm?! Apo mos, vallë, nuk je i sigurt në ringjalljen dhe shpërblimin e të Drejtit të Gjithëmëshirshëm?! Pa mendohu pak për krijimin tënd!

- "...i Cili të krijoi, të rregulloi dhe të drejtoi..." - A nuk është Allahu i Lartësuar Ai që të krijoi në formën më të bukur, Ai që të plotësoi me gjithçka të nevojshme dhe të drejtoi në rrugën më të mirë?! Përse, atëherë, e mohon mirësinë e Zotit tënd Bujar dhe Bamirës? Kjo tregon padrejtësinë që fshihet në shpirtin tënd, tregon natyrën tënde tinëzare dhe tradhtare, injorancën dhe shpirtin tënd armiqësor.

- "...të dha formën që Ai dëshiroi!" - Falëndero Allahun që nuk të krijoi në formën e qenit apo gomarit, apo të çdo kafshe tjetër. Forma në të cilën të krijoi Zoti yt është më e bukura. Mirësitë me të cilat të ka pajisur Zoti yt kërkojnë të jesh mirënjohës dhe adhurues i Tij.

Por edhe pas kësaj këshille, ju vazhdoni të mohoni Ditën e Përgjegjësisë:

- "Por jo! Ju mohoni Ditën e Gjykimit." – Megjithatë, ajo do të ndodhë patjetër, e besoni ju apo jo. Ju do të dilni një ditë para të Madhëruarit dhe të llogariteni për veprat tuaja në këtë jetë. Për llogaritjen dhe shënimin e veprave tuaja, Allahu i Lartësuar ka vendosur shkruesit e ndershëm, siç thotë më pas:

- "Pa dyshim, mbi ju qëndrojnë rojet! Ata janë shkrues të ndershëm. Ata dinë çdo gjë që ju veproni." - Ata shkruajnë me përpikmëri çdo fjalë dhe vepër tuajën, të cilat ata i njohin me imtësi. Këtu hyjnë veprat e zemrës dhe veprat e gjymtyrëve. Për këtë arsye, ju duhet të tregoni respekt ndaj pranisë së këtyre rojeve. Ju nuk duhet ta lejoni veten në vepra e fjalë të këqija, sepse ata janë pranë jush dhe i shënojnë veprat tuaja. Por turpi juaj duhet të jetë më i madh ndaj të Gjithëdijshmit, që ju vështron dhe di me imtësi se çfarë shfaqni dhe çfarë e mbani të fshehur në shpirtin tuaj.

Dijeni se nuk janë njëlloj të mirët dhe të këqijtë, të ruajturit nga të këqijat dhe të shfrenuarit në gjynahe dhe mosbindje ndaj të Madhëruarit:

Ajetet 13 – 19

13. Me të vërtetë, vepërmirët do jenë në kënaqësi.
14. Ndërsa gjynahqarët do të jenë në Xhehenem,
15. ku do të futen Ditën e Gjykimit
16. dhe nuk kanë për të dalë kurrë prej tij.
17. E kush ta mësoi ty se ç'është Dita e Gjykimit?!
18. Edhe njëherë, kush ta mësoi ty se ç'është Dita e Gjykimit?!
19. Ajo është dita kur askush nuk do të mund të ndihmojë asnjë, pasi e tërë çështja, atë ditë, i takon vetëm Allahut!

Shpjegimi i ajeteve

- "Me të vërtetë, vepërmirët do jenë në kënaqësi." - Vepërmirë (*el ebrar*) janë ata që përpiqen dhe punojnë sinqerisht për të përmbushur detyrimet ndaj të Madhëruarit dhe janë të kujdesshëm në plotësimin e detyrimeve ndaj krijesave, duke iu ruajtur çdo lloj padrejtësie ndaj tyre. Këta janë të vazhdueshëm dhe sistematikë në vepra të mira, qofshin ato të dukshme, qofshin të fshehura në zemrat e tyre. Shpërblimi i këtyre fatlumëve është lumturia dhe kënaqësia e shpirtit dhe e trupit në këtë jetë, në jetën e varrit dhe në përjetësi, pranë Zotit të tyre.

- "Ndërsa gjynahqarët do të jenë në Xhehenem..." – Ndërsa *el fuxhxhâr* - gjynahqarët janë ata që shkelin dhe shpërfillin të drejtat e Allahut dhe të krijesave. Këta kanë të prishura si zemrat, ashtu edhe veprat e fjalët e tyre. Ata janë të padrejtë dhe të shfrenuar në gjynahe. Këta do të jenë në një ndëshkim të dhembshëm, në këtë jetë, në jetën e varrit dhe në përjetësi, në zjarrin e Xhehenemit.

- "...ku do të futen Ditën e Gjykimit dhe nuk kanë për të dalë kurrë prej tij" - Ata do të flaken në Xhehenem. Kjo do të ndodhë me ta në Ditën e Shpërblimit. Ata do të jenë përjetësisht në Zjarr dhe kurrë nuk kanë për të dalë prej tij.

- "E kush ta mësoi ty se ç'është Dita e Gjykimit?! Edhe njëherë, kush ta mësoi ty se ç'është Dita e Gjykimit?!" - Ky është një kërcënim për madhështinë dhe tmerrin e asaj dite, e cila turbullon çdo mendje. Askush nuk do të pyesë për të tjerët në ato momente, sado të dashur dhe të afërt qofshin ata. Secilit i mjafton çështja e vet, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "Ajo është dita kur askush nuk do të mund të ndihmojë asnjë, pasi e tërë çështja, atë ditë, i takon vetëm Allahut!" - Të gjithë do të kërkojnë shpëtimin për

vetveten dhe nuk do të pyesin për asnjë në botë, sepse do të jenë të pushtuar tërësisht nga frika. Askush nuk mund të ndihmojë apo shpëtojë as njerëzit më të dashur të zemrës, sepse atë ditë e gjithë çështja është në dorë të Allahut të Lartësuar. Është Ai që do të vendosë drejtësinë mes krijesave. Është Ai që do të shpërblejë me drejtësi dhe mëshirë secilin, sipas asaj që meriton. Allahu është më i Dituri për gjithçka.

Surja 83: El Mutaffifin (mekase) 36 ajete

Ajetet 1 – 6


Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Mjerë për ata që mangët masin e peshojnë,
2. të cilët kur masin për veten, masin me saktësi,
3. ndërsa kur u masin ose u peshojnë të tjerëve, ua lënë mangët.
4. A nuk mendojnë ata se kanë për t'u ringjallur
5. në një ditë të madhe,
6. ditën kur njerëzit do të ngrihen për të dalë para Zotit të botëve?

Shpjegimi i ajeteve

- "Mjerë për ata që mangët masin e peshojnë, të cilët kur masin për veten, masin me saktësi, ndërsa kur u masin ose u peshojnë të tjerëve, ua lënë mangët." – Siç shihet, *el mutaffifin* janë ata që kanë këto dy cilësi:

1. Kur masin për veten e vet, masin me saktësi, pa pranuar asnjë lloj mangësie. Por, nga ana tjetër:


الجزء الثلاثون سورة المطففين
لِيَوْمٍ عَظِيمٍ ۝٥ يَوْمَ يَقُومُ ٱلنَّاسُ لِرَبِّ ٱلْعَٰلَمِينَ ۝٦ كَلَّآ إِنَّ كِتَٰبَ
ٱلْفُجَّارِ لَفِى سِجِّينٍ ۝٧ وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا سِجِّينٌ ۝٨ كِتَٰبٌ مَّرْقُومٌ ۝٩
وَيْلٌ يَوْمَئِذٍ لِّلْمُكَذِّبِينَ ۝١٠ ٱلَّذِينَ يُكَذِّبُونَ بِيَوْمِ ٱلدِّينِ ۝١١ وَمَا يُكَذِّبُ
بِهِۦٓ إِلَّا كُلُّ مُعْتَدٍ أَثِيمٍ ۝١٢ إِذَا تُتْلَىٰ عَلَيْهِ ءَايَٰتُنَا قَالَ أَسَٰطِيرُ ٱلْأَوَّلِينَ
كَلَّا بَلْ ۜ رَانَ عَلَىٰ قُلُوبِهِم مَّا كَانُوا۟ يَكْسِبُونَ ۝١٤ كَلَّآ إِنَّهُمْ عَن رَّبِّهِمْ
يَوْمَئِذٍ لَّمَحْجُوبُونَ ۝١٥ ثُمَّ إِنَّهُمْ لَصَالُوا۟ ٱلْجَحِيمِ ۝١٦ ثُمَّ يُقَالُ هَٰذَا
ٱلَّذِى كُنتُم بِهِۦ تُكَذِّبُونَ ۝١٧ كَلَّآ إِنَّ كِتَٰبَ ٱلْأَبْرَارِ لَفِى عِلِّيِّينَ ۝١٨
وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا عِلِّيُّونَ ۝١٩ كِتَٰبٌ مَّرْقُومٌ ۝٢٠ يَشْهَدُهُ ٱلْمُقَرَّبُونَ ۝٢١
إِنَّ ٱلْأَبْرَارَ لَفِى نَعِيمٍ ۝٢٢ عَلَى ٱلْأَرَآئِكِ يَنظُرُونَ ۝٢٣ تَعْرِفُ فِى
وُجُوهِهِمْ نَضْرَةَ ٱلنَّعِيمِ ۝٢٤ يُسْقَوْنَ مِن رَّحِيقٍ مَّخْتُومٍ ۝٢٥ خِتَٰمُهُۥ
مِسْكٌ ۚ وَفِى ذَٰلِكَ فَلْيَتَنَافَسِ ٱلْمُتَنَٰفِسُونَ ۝٢٦ وَمِزَاجُهُۥ مِن
تَسْنِيمٍ ۝٢٧ عَيْنًا يَشْرَبُ بِهَا ٱلْمُقَرَّبُونَ ۝٢٨ إِنَّ ٱلَّذِينَ أَجْرَمُوا۟ كَانُوا۟
مِنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ يَضْحَكُونَ ۝٢٩ وَإِذَا مَرُّوا۟ بِهِمْ يَتَغَامَزُونَ ۝٣٠
وَإِذَا ٱنقَلَبُوٓا۟ إِلَىٰٓ أَهْلِهِمُ ٱنقَلَبُوا۟ فَكِهِينَ ۝٣١ وَإِذَا رَأَوْهُمْ قَالُوٓا۟
إِنَّ هَٰٓؤُلَآءِ لَضَآلُّونَ ۝٣٢ وَمَآ أُرْسِلُوا۟ عَلَيْهِمْ حَٰفِظِينَ ۝٣٣
٥٨٨

2. kur duhet t'u japin njerëzve hakun që u takon, masin e peshojnë me mangësi. Kjo, sigurisht, është vjedhje e pasurisë së njerëzve dhe shkelje e drejtësisë në marrëdhëniet me ta.

Nëse ky kërcënim u drejtohet atyre që thjesht hanë në masë ose në peshë, atëherë si mendon se do të jetë gjendja e atyre që vjedhin ose grabisin me forcë?! Sigurisht, këta janë më të kërcënuar dhe më në rrezik sesa të përmendurit në ajet.

Nga ajeti mësojmë se njeriu, ashtu sikurse kërkon që të tjerët t'ia japin të plota të drejtat e tij, ashtu duhet t'ua japë edhe ai atyre gjërat që u takojnë, në çdo lloj bashkëpunimi ndërnjerëzor. Madje, kjo lloj drejtësie duhet të zbatohet edhe në sferën e debatit. Është e vërtetë që çdo njeri synon të mbrojë tezën e vet, por për të qenë i drejtë, duhet që t'u kushtojë vëmendje edhe argumenteve të

kundërshtarit. Kështu, ai mund të ruhet nga mendjemadhësia dhe mospërfillja.

E lusim Allaun e Madhërishëm që të na udhëzojë dhe ndihmojë të arrijmë çdo mirësi dhe virtyt të lartë.

Në vijim, Allahu i Madhërishëm i kërcënon *mutaffifin*-ët me fjalë që shprehin çudi për vazhdimësinë e tyre në këtë rrugë të gabuar, duke marrë parasysh se çfarë i pret. Ai thotë:

- "A nuk mendojnë ata se kanë për t'u ringjallur në një ditë të madhe, ditën kur njerëzit do të ngrihen për të dalë para Zotit të botëve?" - Ajo që i shtyn ata në këtë padrejtësi është mosbesimi i tyre në Ditën e Gjykimit. Nëse do të ishin të sigurt për takimin me Allahun e Lartësuar, i Cili do t'i llogarisë dhe shpërblejë me drejtësi për çdo gjë të madhe dhe të vogël, me siguri do të frenoheshin dhe do të ktheheshin tek Ai të penduar dhe të nënshtruar.

Ajetet 7 – 17

7. Sigurisht! Pa dyshim, veprat e gjynahqarëve do të jenë në *Sixhxhin*.
8. E ku e di ti se ç'është *Sixhxhin*-i?
9. Ai është një libër i shkruar.
10. Mjerë mohuesit atë ditë,
11. ata të cilët nuk e besojnë Ditën e Përgjegjësisë!
12. Atë ditë nuk e mohon kush, përveç atij që ka e tepruar me mizori dhe vepra të këqija,
13. ai i cili, kur i lexohen ajetet Tona, thotë: "Përralla të vjetra!".
14. Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që bëjnë, ua kanë vulosur zemrat.
15. Jo dhe jo! Atë ditë do të ketë pengesë mes tyre dhe Zotit të tyre.
16. Pastaj, pa dyshim, ata do të flaken në Xhehenem,
17. dhe më pas do t'u thuhet: "Ky është ai të cilin e quanit gënjeshtër!"

Shpjegimi i ajeteve

- "Sigurisht! Pa dyshim, veprat e gjynahqarëve do të jenë në *Sixhxhin*." - Këtu përfshihen të gjithë gjynahqarët: qafirët, munafikët dhe ata që shkelin kufijtë e Allahut. Të gjithë veprat e këtyre *fuxhxhar*-ëve do të jenë në *Sixhxhin*. I Lartësuari shpjegon më pas se çfarë është *Sixhxhin*-i:

- "E ku e di ti se ç'është *Sixhxhin*-i? Ai është një libër i shkruar." - Ai është një libër, ku shënohen hollësisht veprat e shëmtuara. *Sixhxhin* është gjithashtu edhe një vend i ngushtë e mbytës. Ai është e kundërta e *Illijin*-it, librit të vepërmirëve, sikurse do të shpjegohet më poshtë.

Është thënë, gjithashtu, se *Sixhxhin*-i është shtresa më e thellë e tokës së shtatë, në të cilën ndëshkohen *fuxhxhar*-ët.

- "Mjerë mohuesit atë ditë, ata të cilët nuk e besojnë Ditën e Përgjegjësisë!" - Ky është kërcënim për mohuesit dhe mosbesuesit, ata të cilët nuk e besojnë Ditën e Përgjegjësisë, Ditën e Shpërblimit, kur Zoti do ta trajtojë çdo njeri në varësi të veprave që ka bërë.

- "Atë ditë nuk e mohon kush, përveç atij që ka e tepruar me mizori dhe vepra të këqija..." - Ditën e Përgjegjësisë e mohojnë ata që kanë dy cilësi:

1. Ata që e teprojnë dhe shkelin kufijtë e Zotit, që lënë gjërat e ligjshme dhe marrin të paligjshmet.

2. Ata që janë të zhytur thellë në gjynahe.

Të tillët janë të prirur të tregohen kryeneçë ndaj të vërtetës së Zotit.

- "...ai i cili, kur i lexohen ajetet Tona, thotë: "Përralla të vjetra!"." - Kur këtyre u lexohen ajetet e Zotit, që dëshmojnë të vërtetën, ata i mohojnë me arrogancë. Ata i shpërfillin shpalljet e Zotit, duke pretenduar se ato janë thjesht përralla dhe histori të popujve të harruar. Por kjo është thjesht mendjemadhësi nga ana e tyre.

- "Jo, nuk është ashtu! Por të këqijat që bëjnë, ua kanë vulosur zemrat." - Kush kërkon të vërtetën dhe tregohet i paanshëm, ai nuk e mohon Ditën e Gjykimit, sepse Allahu i Madhërishëm ka sjellë aq shumë argumente dhe fakte për vërtetësinë e saj, saqë askush nuk mund të dyshojë në të. Zemrat e lira e shohin këtë të vërtetë, ashtu si sytë shohin diellin. Por zemrat e robëruara dhe të vulosura nga veprat e këqija nuk mund ta shohin të vërtetën.

- "Jo dhe jo! Atë ditë do të ketë pengesë mes tyre dhe Zotit të tyre. Pastaj, pa dyshim, ata do të flaken në Xhehenem, dhe më pas do t'u thuhet: "Ky është ai të cilin e quanit gënjeshtër!"" - Ky është shpagim i drejtë për shpërfilljen e treguar prej tyre. Ashtu sikurse ata nuk i lejojnë zemrat e tyre të ndriçohen nga drita e ajeteve të Zotit, ashtu do të shpërblehen në ahiret duke u privuar nga kënaqësia që të fal shikimi i Zotit.

Pas këtij ndëshkimi të madh, ata do të flaken në zjarrin e Xhehenemit, ku do të vuajnë hidhësinë dhe dëshpërimin e përzgjedhjes së tyre të gabuar. Dhimbja e tyre do të jetë shumë e madhe kur t'u thuhet: "Ky është ai të cilin ju e quanit gënjeshtër!".

Këtu janë përmendur tri lloje ndëshkimi për këta kriminelë: ndëshkimi i zjarrit të Xhehenemit, ndëshkimi përmes fjalëve therëse, dhe ndëshkimi më i madh: privimi nga kënaqësia e vështrimit të Allahut të Madhërishëm. Ky i fundit është ndëshkim më i madh dhe më dëshpërues edhe se vetë ndëshkimi i Zjarrit.

Ajeti i kuptuar nga ana e kundërt tregon se besimtarët do ta shohin Zotin e tyre në Ditën e Gjykimit dhe në Xhenet. Ajo do të jetë kënaqësia më e madhe e tyre, më e madhe se çdo kënaqësi tjetër që do të shijojnë përjetësisht në Xhenet. Besimtarët do të jenë shumë të lumtur me praninë e të Madhërishmit dhe do të shijojnë kënaqësinë që të fal fjala e Zotit drejtuar atyre. Kjo është përmendur në shumë ajete kuranore dhe në shumë hadithe të sakta nga Profeti (a.s.).

Këto ajete tërheqin fort vërejtjen për t'u ruajtur dhe penduar nga gjynahet, sepse ato dalëngadalë shkaktojnë vulosjen e zemrës dhe i heqin asaj aftësinë për të dalluar të vërtetën nga e kota. Ato sjellin errësirë dhe pengojnë dritën e Zotit që të hyjë në zemër. Ato sjellin vdekjen e zemrës, dhe kështu ajo nuk do të jetë në gjendje të udhëzohet: të mirën do ta shohë si të keqe dhe të vërtetën do ta shohë si të gënjeshtërt. Të mos harrojmë se këto janë vetëm një pjesë e të këqijave që sjellin gjynahet.

Ajetet 18 – 28

18. Jo, nuk janë të njëjtë! Me të vërtetë, libri i vepërmirëve gjendet në *Il-lijjin*!
19. E ku e di ti se çfarë është *Il-lijjun*-i?
20. Ai është një libër i qëndisur qartë,
21. të cilin e dëshmojnë më të afërmit.

22. Me të vërtetë, vepërmirët do të jenë në kënaqësi.
23. Të mbështetur në kolltukë, ata kundrojnë.
24. Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë që përjetojnë.
25. Atyre u jepet të pinë pije nga enë të vulosura,
26. pije që në fund i vjen era misk! Për të tilla mirësi le të garojnë ata që lakmojnë të mirën.
27. Kjo pije ka brenda edhe prej *Tesnim*-it,
28. burim nga i cili pinë më të afërmit e Zotit.

Shpjegimi i ajeteve

- "Jo, nuk janë të njëjtë! Me të vërtetë, libri i vepërmirëve gjendet në *Il-lijjin*! E ku e di ti se çfarë është *Il-lijjun*-i? Është një libër i qëndisur qartë, të cilin e dëshmojnë më të afërmit." - Pasi tregoi se libri *Sixhxhin* është në vendin më të ngushtë dhe më të thellë të Zjarrit, Allahu i Madhërishëm thotë se libri i vepërmirëve është në *Il-lijjin*, në vendin më të lartë dhe më të gjerë në Xhenet. Këtë libër e shohin dhe dëshmojnë më të afërmit e Zotit, të cilët janë melekë, shpirtrat e profetëve, të të sinqertëve dhe të dëshmorëve në rrugën e Zotit. Këta të mirë Allahu i Madhërishëm i veçon në mbretërinë e qiellit. *Ilijjun* është edhe një nga emrat e Xhenetit më të lartë.

- "Me të vërtetë, vepërmirët do të jenë në kënaqësi.." - Ata do të jenë në "*neim*", një emër ky që përfshin të gjitha llojet e kënaqësive të zemrës, shpirtit dhe të trupit, që këtyre fatlumëve u premtohen.

- "Të mbështetur në kolltukë, ata kundrojnë." - Ata do të rrinë të mbështetur në kolltukë të zbukuruar dhe do të kundrojnë me ëndje gjithçka që i Madhëruari u ka përgatitur si shpërblim. Por mbi të gjitha ato është kënaqësia që përjetojnë kur shikojnë Fytyrën e të Madhërishmit. Për të kuptuar se sa të lumtur janë, mjafton të shohësh në fytyrat e tyre:

- "Në fytyrat e tyre mund të kuptosh kënaqësinë që përjetojnë." - Ato janë fytyra të shndritshme, të bukura dhe të lumturuara. Janë mirësitë e vazhdueshme që i japin fytyrës ndriçim, hijeshi dhe gëzim.

- "Atyre u jepet të pinë pije nga enë të vulosura, pije që në fund i vjen era misk!" - Ajo është nga më e mira dhe më e shijshmja pije që mund të ekzistojë. Fundi i saj vjen era misk. Pra, ajo pjesë e pijes që në dynja zakonisht hidhet poshtë apo lihet në fund të enës, në Xhenet është aq e mirë, sa i vjen era misk. Atëherë çfarë mund të mendosh për vetë pijen?! Ajo pije ruhet në enë të vulosura, që të mbetet vazhdimisht e mirë dhe e shijshme.

- "Për të tilla mirësi le të garojnë ata që lakmojnë të mirën." - Ato do të jenë mirësi të përjetshme dhe të pandërprera. Masën dhe bukurinë e tyre nuk e di veçse Ai që i krijoi. Për to garojnë ata që synojnë dhe kanë për qëllim të mirën. Ata garojnë në vepra të mira, që Zoti i ka bërë sebep dhe rrugë për arritjen e këtyre të mirave. Kjo është çështja më e rëndësishme, për hir të së cilës ia vlen të shpenzosh çdo gjë të vyer. Për të tilla mirësi garuan më të mëdhenjtë dhe të zgjedhurit e Zotit.

- "Kjo pije ka brenda edhe prej *Tesnim*-it, burim nga i cili pinë më të afërmit e Zotit."

- Kjo pije është e përgatitur me ujë nga burimi i quajtur *Tesnim*, në të cilin pinë më të afruarit dhe më të zgjedhurit e Zotit. Uji i këtij burimi është absolutisht pija më e mirë e Xhenetit. Nëse pija e banorëve të Xhenetit është aq e mirë, sepse përzihet me këtë ujë, atëherë si mund të jetë vetë ky burim?! Pa dyshim që është i mrekullueshëm dhe i pakrahasueshëm, prandaj edhe u posaçërua për më të mirët dhe më të zgjedhurit. Ata do të jenë në gradat më të larta dhe në mirësitë më të mëdha të Xhenetit.

Ajetet 29 – 36

29. Vërtet, zullumqarët talleshin me besimtarët,
30. sepse kur kalonin pranë tyre, ata ia bënin me sy njëri-tjetrit.
31. Kur ktheheshin në familjet e veta, ata ishin të kënaqur.
32. Kur i shihnin, thonin: "Me të vërtetë, këta janë të humbur!"
33. Por Ne nuk i caktuam ata si roje të tyre.
34. Por sot, janë besimtarët që do të tallen me jobesimtarët.
35. Duke qëndruar mbështetur në kolltukë, ata do të vështrojnë.
36. A u shpërblyen plotësisht jobesimtarët për atë që kanë bërë?

Shpjegimi i ajeteve


Pasi foli për shpërblimin e *muxhrimin*-ëve dhe atë të *mu'minin*-ëve, Allahu i Lartësuar tregon shkaqet e këtij dallimi mes tyre:

- "Vërtet, zullumqarët talleshin me besimtarët, sepse kur kalonin pranë tyre, ata ia bënin me sy njëri-tjetrit." - Në jetën e dynjasë, kriminelët gjynahtarë talleshin me besimtarët dhe i përqeshnin ata me fjalë dhe me veprime. Kur besimtarët kalonin pranë tyre, ata i shihnin me qesëndi dhe i përqeshnin duke i bërë shenja fyese njëri-tjetrit. Megjithëse kjo ishte një vepër shumë e fëlliqur, ata ndiheshin të qetë, pa asnjë lloj ndjenje faji:

- "Kur ktheheshin në familjet e veta, ata ishin të kënaqur. Kur i shihnin, thonin: "Me të vërtetë, këta janë të humbur!"" - Kur ktheheshin pranë familjeve tyre, në mëngjes ose në mbrëmje, ata ishin të gëzuar dhe të fryrë me mendjemadhësinë e tyre. Ky ishte një nivel shumë i frikshëm vetëkënaqësie dhe vetëmashtrimi. Ata jo vetëm që kryenin vepra të ulëta dhe të këqija, por ishin fare të qetë për këtë, a thua se kërcënimi i Zotit nuk ekzistonte. A thua se Zoti u kishte premtuar se do të ishin të shpëtuar dhe të lumtur. Ata ishin aq arrogantë, sa deklaronin se ishin ata të udhëzuarit në udhë të drejtë, ndërsa besimtarët ishin njerëz të humbur dhe larg realitetit të jetës. Ky pretendim sigurisht që konsiderohet si shpifje dhe si e folur pa dije rreth Zotit. Më tej, Allahu i Lartësuar thotë:

- "Por Ne nuk i caktuam ata si roje të tyre." - Allahu i Madhëruar nuk i vendosi ata si ruajtës dhe mbikëqyrës të besimtarëve, që të gjykojnë se cilët janë në humbje dhe cilët të udhëzuar. Vepra e shëmtuar e tyre tregonte veçse arrogancë, për të cilën nuk kanë asnjë justifikim, prandaj edhe ndëshkimi i tyre në ahiret do të jetë në përputhje me atë që kanë bërë, siç thotë i Lartësuari:

- "Por sot, janë besimtarët që do të tallen me jobesimtarët. Duke qëndruar mbështetur në kolltukë, ata do të vështrojnë." – Ditën e Gjykimit, do të jenë


الجزء الثلاثون سورة الانشقاق

فَلَآ أُقۡسِمُ بِٱلشَّفَقِ ﴿١٦﴾ وَٱلَّيۡلِ وَمَا وَسَقَ ﴿١٧﴾ وَٱلۡقَمَرِ إِذَا ٱتَّسَقَ ﴿١٨﴾
لَتَرۡكَبُنَّ طَبَقًا عَن طَبَقٖ ﴿١٩﴾ فَمَا لَهُمۡ لَا يُؤۡمِنُونَ ﴿٢٠﴾ وَإِذَا قُرِئَ
عَلَيۡهِمُ ٱلۡقُرۡءَانُ لَا يَسۡجُدُونَ ۩ ﴿٢١﴾ بَلِ ٱلَّذِينَ كَفَرُواْ يُكَذِّبُونَ
﴿٢٢﴾ وَٱللَّهُ أَعۡلَمُ بِمَا يُوعُونَ ﴿٢٣﴾ فَبَشِّرۡهُم بِعَذَابٍ أَلِيمٍ ﴿٢٤﴾

سورة الانشقاق

بِسۡمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحۡمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

إِذَا ٱلسَّمَآءُ ٱنشَقَّتۡ ﴿١﴾ وَأَذِنَتۡ لِرَبِّهَا وَحُقَّتۡ ﴿٢﴾ وَإِذَا ٱلۡأَرۡضُ مُدَّتۡ
﴿٣﴾ وَأَلۡقَتۡ مَا فِيهَا وَتَخَلَّتۡ ﴿٤﴾ وَأَذِنَتۡ لِرَبِّهَا وَحُقَّتۡ ﴿٥﴾ يَٰٓأَيُّهَا
ٱلۡإِنسَٰنُ إِنَّكَ كَادِحٌ إِلَىٰ رَبِّكَ كَدۡحٗا فَمُلَٰقِيهِ ﴿٦﴾ فَأَمَّا مَنۡ أُوتِيَ
كِتَٰبَهُۥ بِيَمِينِهِۦ ﴿٧﴾ فَسَوۡفَ يُحَاسَبُ حِسَابٗا يَسِيرٗا ﴿٨﴾ وَيَنقَلِبُ
إِلَىٰٓ أَهۡلِهِۦ مَسۡرُورٗا ﴿٩﴾ وَأَمَّا مَنۡ أُوتِيَ كِتَٰبَهُۥ وَرَآءَ ظَهۡرِهِۦ ﴿١٠﴾ فَسَوۡفَ
يَدۡعُواْ ثُبُورٗا ﴿١١﴾ وَيَصۡلَىٰ سَعِيرًا ﴿١٢﴾ إِنَّهُۥ كَانَ فِيٓ أَهۡلِهِۦ مَسۡرُورًا ﴿١٣﴾
إِنَّهُۥ ظَنَّ أَن لَّن يَحُورَ ﴿١٤﴾ بَلَىٰٓۚ إِنَّ رَبَّهُۥ كَانَ بِهِۦ بَصِيرٗا ﴿١٥﴾

الجزء ٥٩ — سجدة

٥٨٩

besimtarët që do të tallen me jobesimtarët, kur t'i shohin të vuajnë në ndëshkimin e drejtë dhe të merituar. Kur çdo vendim i Zotit të jetë bërë realitet, qafirët do të vuajnë atë që vetë e zgjodhën për veten e tyre, ndërsa besimtarët, të kënaqur mes mirësive të Zotit të tyre, që e adhuruan si Një të vetëm dhe të pashoq, do të jenë të ulur dhe të rehatuar në shtretërit dhe kolltukët e tyre të stolisur dhe të zbukuruar. Ata do të kundrojnë mirësitë që Zoti ka përgatitur për ata dhe do të vështrojnë Fytyrën e Zotit të tyre të Dashur dhe Bujar.

Dhe një pyetje shtrohet, ndërkohë që përgjigjja e saj dihet:

- "A u shpërblyen plotësisht jobesimtarët për atë që kanë bërë?" - Sigurisht që po. Ashtu sikurse u tallën me besimtarët në këtë dynja, duke shpifur për ta se janë të humbur, po kështu besimtarët do të tallen me ta kur t'i shohin të vuajnë ndëshkimin e të Drejtit, si shpërblim për humbjen dhe mosbesimin e tyre. Pa dyshim, ata do të shpërblehen me drejtësi dhe urtësi nga Allahu i Madhërishëm, i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.

Surja 84: El inshikak (mekase) 25 ajete

Ajetet 1 – 15
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Po kur qielli të çahet,
2. duke dëgjuar me bindje e nënshtrim Zotin e vet, ashtu siç e ka për detyrë!
3. Po kur Toka të shtrihet në gjerësinë e saj,
4. të nxjerrë çfarë ka brenda e të çlirohet,
5. duke dëgjuar me bindje e nënshtrim Zotin e saj, ashtu siç e ka për detyrë!
6. O njeri! Vërtet, ti që bën përpjekje të mëdha, që të afrojnë te Zoti yt, ato do t'i gjesh!
7. Për sa i përket atij të cilit, libri i vet do t'i jepet nga e djathta,
8. atij do t'i bëhet një llogari e lehtë,
9. dhe do të kthehet te familja e vet i gëzuar.
10. E për sa i përket atij të cilit, libri i vet do t'i jepet nga pas shpine
11. ai do të lutet për t'u asgjësuar,
12. dhe do të flaket në një zjarr të ndezur fort.
13. Ai jetonte i gëzuar në familjen e vet.
14. Ai vërtet mendonte se nuk kishte për t'u ringjallur .
15. Por, në fakt, Zoti i tij e ka patur gjithnjë nën vëzhgim atë!

Shpjegimi ajeteve

- "Po kur qielli të çahet, duke dëgjuar me bindje e nënshtrim Zotin e vet, ashtu siç e ka për detyrë!" - Allahu i Lartësuar flet për

disa ngjarje të mëdha, që do të ndodhin Ditën e Kijametit. Atë ditë, qielli do të çahet dhe do të ndahen shtresat e tij, duke u dalluar nga njëra-tjetra. Yjet që janë në të do të shpërndahen. Dielli dhe Hëna do të shuhen. Qielli do t'i bindet urdhrit të Zotit, duke e dëgjuar me vëmendje dhe përulje. E si mund të ndodhte ndryshe, kur dihet se qielli i është nënshtruar Zotit dhe është nën drejtimin e një meleku të madh, i cili kurrë nuk e thyen urdhrin e Zotit, por gjithmonë e çon në vend gjykimin dhe vendimin e Tij.

- "Po kur Toka të shtrihet në gjerësinë e saj..." - Toka do të pësojë një dridhje të fortë, aq sa malet dhe çdo gjë mbi të do të sheshohen. Zoti do ta shtrijë atë, ashtu siç hapet një lëkurë e thatë, dhe Toka do të bëhet shumë e gjerë. Ajo do të nxërë të gjithë ata që do të ringjallen në të, të cilët do të jenë të shumtë. Mbi Tokë nuk do të shihet më as gropa e as lartësi.

- "...të nxjerrë çfarë ka brenda e të çlirohet, duke dëgjuar me bindje e nënshtrim Zotin e saj, ashtu siç e ka për detyrë!" - Toka do të nxjerrë jashtë çdo gjë që fshihet dhe prehet brenda saj: të vdekurit, thesaret e gjithçka, dhe kështu do të çlirohet prej tyre. Kur t'i fryhet Surit, të gjithë të vdekurit do të ringjallen, për të dalë mbi sipërfaqen e Tokës. Edhe thesaret do të dalin jashtë, për t'u shndërruar në një shtyllë të madhe, të cilën do ta shohin të gjitha krijesat dhe do të dëshpërohen për atë që garonin në dynja dhe e cila tashmë nuk ka asnjë vlerë. Kështu, edhe Toka, ashtu si qielli, i nënshtrohet Zotit të saj, ashtu sikurse e ka për detyrë.

- "O njeri! Vërtet, ti që bën përpjekje të mëdha, që të afrojnë te Zoti yt, ato do t'i gjesh!" – Kuptimi: O njeri! Ti je duke nxituar për të shkuar tek Zoti yt. Ti ose do të jesh nga ata që kryejnë urdhrat dhe u largohen ndalesave, duke ruajtur kufijtë e Tij, ose nga ata që shpërfillin takimin e Zotit dhe harrohen në gjynahet e tyre. Realiteti është i njëjtë për të gjithë: çdo ditë që kalon, ju i afroheni takimit me Zotin tuaj. Ajo që ndryshon janë veprat e përpjekjet e secilit. Kurrë mos mendo se do të mbetesh pa u shpërblyer me të mira, nëse je prej të mirëve, apo pa u dënuar, nëse je prej të këqijve.

Në vijim, Allahu i Madhërishëm jep hollësi për drejtësinë e asaj dite. Ai thotë:

- "Për sa i përket atij të cilit, libri i vet do t'i jepet nga e djathta, atij do t'i bëhet një llogari e lehtë, dhe do të kthehet te familja e vet i gëzuar." - Këta janë të lumturit, të shpëtuarit, fatlumët. Këtyre do t'u bëhet një llogari e lehtë. Ata thjesht do të paraqiten para Allahut të Madhërishëm. Ai do t'u kujtojë atyre gjynahet që kanë kryer në dynja dhe ata do t'i pranojnë ato. Kur të mendojnë se ndëshkimi i Zotit është i merituesheëm për ta, Ai do t'i thotë secilit prej tyre: "Unë t'i mbulova dhe t'i fsheha gjynahet në dynja, prandaj edhe sot unë do të t'i fsheh dhe mbuloj gjynahet e tua.". Atëherë, ata do të kthehen te familjet e tyre në Xhenet, të gëzuar, të lumtur dhe të përmalluar. Ata tashmë kanë shpëtuar nga ndëshkimi dhe do të gëzohen përjetësisht mes shpërblimeve.

- "E për sa i përket atij të cilit, libri i vet do t'i jepet nga pas shpine, ai do të lutet për t'u asgjësuar, dhe do të flaket në një zjarr të ndezur fort." - Këta do ta marrin librin e veprave të tyre nga pas shpine, me të majtën e tyre. Ata do të luten për shkatërrim, për shkak të poshtërimit dhe ndëshkimit

të merituar për veprat e këqija që kanë bërë, të cilat i shohin të shkruara në libër, dhe nuk janë penduar për to. Ata nuk kanë për të shpëtuar, por do të përfshihen nga flakët e ndezura fort.

- **"Ai jetonte i gëzuar në familjen e vet. Ai vërtet mendonte se nuk kishte për t'u ringjallur. Por, në fakt, Zoti i tij e ka patur gjithnjë nën vëzhgim atë!"** - Ky ndëshkim, sepse atyre nuk u shkon ndër mend ringjallja dhe takimi me Zotin. Ata vazhdojnë jetën të gëzuar në familjet e tyre dhe tërësisht mospërfillës ndaj ftesës së Zotit për besim. Por, të mjerët, gabojnë shumë rëndë, sepse Dita e Gjykimit para Zotit është e pashmangshme. Çdokush do të shpërblehet ose do të ndëshkohet në varësi të asaj që ka punuar.

Ajetet 16 – 25

16. **Betohem në kuqëlimin e muzgut,**
17. **në natën e në çka ajo mbulon me errësirën e saj,**
18. **edhe në hënën e plotë,**
19. **se ju, me siguri, do të kaloni gjendje pas gjendjeje.**
20. **Çfarë kanë ata që nuk besojnë?**
21. **Përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen?**
22. **Përse mohojnë ata që nuk besojnë?!**
23. **Por Allahu e di më së miri atë çfarë fshehin ata.**
24. **Lajmëroi ata për një dënim të dhembshëm,**
25. **përveç atyre që besojnë e bëjnë vepra të mira, të cilët do të kenë shpërblim të pandërprerë!**

Shpjegimi ajeteve

- **"Betohem në kuqëlimin e muzgut, në natën e në çka ajo mbulon me errësirën e saj, edhe në hënën e plotë..."** – Allahu i Lartësuar betohet në disa shenja të mëdha, të cilat shfaqen natën. Kështu, fillimisht betohet në dritën e kuqërremtë, që mbetet nga dielli, kur ai perëndon. Kjo shënon fillimin e natës. Pastaj, Allahu i Lartësuar betohet në natën dhe në gjithçka që ajo mbulon me errësirën e saj. Ai betohet, gjithashtu, edhe në hënën e plotë, aq të dobishme dhe të bukur.
Por për çfarë betohet i Plotpushtetshmi?

- **"...se ju, me siguri, do të kaloni gjendje pas gjendjeje. Çfarë kanë ata që nuk besojnë?"** - Ju keni për të kaluar gjendje pas gjendjeje, fazë pas faze, për të shkuar atje ku jeni njoftuar. Pas një pike uji, ju ktheheni në gjak të ngjizur, të ngjitur në muret e barkut të nënës, pastaj shndërroheni në një copë mishi të ngjashëm me një mish të përtypur, për të kaluar në fazat e tjera të zhvillimit, që në fund t'ju fryhet shpirti. Pastaj dilni në këtë jetë si fëmijë të dobët dhe të varur. Më pas, filloni të dalloni dhe të arsyetoni, derisa arrini moshën e përgjegjësisë, kur lapsi fillon të shënojë veprat tuaja. Gjatë jetës tuaj, Zoti ju kërkon zbatimin e ligjit të Tij dhe qëndrimin brenda kufijve të Tij. Pas vdekjes, Ai ju premton ringjalljen dhe llogaritjen e drejtë të veprave tuaja, për t'ju shpërblyer me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij.

Të gjitha këto faza nëpër të cilat kalon njeriu tregojnë se vetëm Allahu është Ai që meriton adhurimet tona, sepse Ai është i vetmi që përkujdeset për krijesat e Tij, me mëshirën dhe urtësinë e Tij. Çdo krijesë është e dobët, e varfër dhe e pafuqishme

përpara Krenarit të Gjithëmëshirshëm. Megjithatë, shumë prej njerëzve nuk besojnë.

- **"Çfarë kanë ata që nuk besojnë? Përse, kur u lexohet Kurani, nuk përulen?"** – Ç'është me këta njerëz që nuk besojnë Allahun dhe në madhështinë e Tij, që nuk besojnë në Kuranin e Tij, që nuk nënshtrohen për të zbatuar urdhrat e Tij dhe për t'u larguar nga ndalesat e Tij?


- **"Përse mohojnë ata që nuk besojnë?!"** - Ata që mohojnë Zotin e quajnë të vërtetën si mashtrim dhe e kundërshtojnë atë me urrejtje, pasi u është bërë e qartë. Prandaj, mos u çudisni që ata e mohojnë Kuranin dhe nuk nënshtrohen për ta zbatuar atë. Ata që e mohojnë të vërtetën nga kryeneçësia dhe urrejtja, për ta nuk ka mundësi udhëzimi. Nëse ata e urrejnë të vërtetën, si mund ta pranojnë atë dhe t'i nënshtrohen?

- **"Por Allahu e di më së miri atë çfarë fshehin ata."** - Allahu i Gjithëdijshëm di çdo vepër dhe qëllim të tyre, e shfaqin apo e mbajnë të fshehur në shpirtin e tyre, dhe do t'i shpërblejë me drejtësi për to.

- **"Lajmëroi ata për një dënim të dhembshëm..."** - Kjo është gjendja e shumicës së njerëzve: ata nuk e besojnë Kuranin dhe e mohojnë mesazhin e tij.

Megjithatë, janë edhe disa që Zoti i ka përzgjedhur ndër njerëzit e tjerë, për t'i udhëzuar dhe ndriçuar me këtë Kuran.

- **"...përveç atyre që besojnë e bëjnë vepra të mira, të cilët do të kenë shpërblim të pandërprerë!"** - Ata e besojnë Kuranin dhe çdo kumt të sjellë nga profetët e Zotit,


الجزء الثلاثون
سورة البروج
إِلَّا ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ لَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ﴿٢٥﴾
سُورَةُ البُرُوجِ
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
وَٱلسَّمَآءِ ذَاتِ ٱلْبُرُوجِ ﴿١﴾ وَٱلْيَوْمِ ٱلْمَوْعُودِ ﴿٢﴾ وَشَاهِدٍ وَمَشْهُودٍ ﴿٣﴾
قُتِلَ أَصْحَٰبُ ٱلْأُخْدُودِ ﴿٤﴾ ٱلنَّارِ ذَاتِ ٱلْوَقُودِ ﴿٥﴾ إِذْ هُمْ عَلَيْهَا
قُعُودٌ ﴿٦﴾ وَهُمْ عَلَىٰ مَا يَفْعَلُونَ بِٱلْمُؤْمِنِينَ شُهُودٌ ﴿٧﴾ وَمَا نَقَمُوا۟
مِنْهُمْ إِلَّآ أَن يُؤْمِنُوا۟ بِٱللَّهِ ٱلْعَزِيزِ ٱلْحَمِيدِ ﴿٨﴾ ٱلَّذِى لَهُۥ مُلْكُ
ٱلسَّمَٰوَٰتِ وَٱلْأَرْضِ ۚ وَٱللَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَىْءٍ شَهِيدٌ ﴿٩﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ
فَتَنُوا۟ ٱلْمُؤْمِنِينَ وَٱلْمُؤْمِنَٰتِ ثُمَّ لَمْ يَتُوبُوا۟ فَلَهُمْ عَذَابُ جَهَنَّمَ وَلَهُمْ
عَذَابُ ٱلْحَرِيقِ ﴿١٠﴾ إِنَّ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَعَمِلُوا۟ ٱلصَّٰلِحَٰتِ لَهُمْ
جَنَّٰتٌ تَجْرِى مِن تَحْتِهَا ٱلْأَنْهَٰرُ ۚ ذَٰلِكَ ٱلْفَوْزُ ٱلْكَبِيرُ ﴿١١﴾ إِنَّ بَطْشَ
رَبِّكَ لَشَدِيدٌ ﴿١٢﴾ إِنَّهُۥ هُوَ يُبْدِئُ وَيُعِيدُ ﴿١٣﴾ وَهُوَ ٱلْغَفُورُ ٱلْوَدُودُ ﴿١٤﴾
ذُو ٱلْعَرْشِ ٱلْمَجِيدُ ﴿١٥﴾ فَعَّالٌ لِّمَا يُرِيدُ ﴿١٦﴾ هَلْ أَتَىٰكَ حَدِيثُ ٱلْجُنُودِ
﴿١٧﴾ فِرْعَوْنَ وَثَمُودَ ﴿١٨﴾ بَلِ ٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ فِى تَكْذِيبٍ ﴿١٩﴾ وَٱللَّهُ مِن
وَرَآئِهِم مُّحِيطٌۢ ﴿٢٠﴾ بَلْ هُوَ قُرْءَانٌ مَّجِيدٌ ﴿٢١﴾ فِى لَوْحٍ مَّحْفُوظٍۭ ﴿٢٢﴾
٥٩٠

angazhohen me sinqeritet për të zbatuar çdo porosi të dhënë prej tyre. Këtyre fatlumëve, Zoti u ka premtuar shpërblim të pandërprerë. Ata do të jenë përjetësisht në kënaqësi të pafundme, të cilat syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar dhe askush prej njerëzve nuk ka arritur as t'i imagjinojë.

Surja 85: El Buruxh (mekase) 22 ajete
Ajetet 1 – 22
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për qiellin me plot yje!
2. Për Ditën e Premtuar!
3. Për atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet!
4. Mallkuar qofshin ata që hapën hendeqet,
5. me zjarr, të mbushur me lëndë djegëse!
6. Kur ata rrinin ulur rreth tij,

7. dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët.
8. Nuk kishin pse t'i urrenin, përveç se ata e besuan Allahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin,
9. të Cilit i takon sundimi i qiejve e i tokës! Allahu është dëshmitar i çdo gjëje!
10. Është e sigurt se ata që sprovojnë besimtarët dhe besimtaret dhe nuk pendohen, kanë dënimin e Xhehenemit; për ta është përgatitur dënimi me djegie.
11. Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, kanë vërtet Xhenete, nëpër të cilët burojnë lumenj; ky është suksesi më i madh.
12. Është e vërtetë se ndëshkimi i Zotit tënd është i fortë.
13. Në të vërtetë, është Ai që krijon nga e para dhe rikrijon.
14. Ai është Falësi, i Dashuri!
15. Ai është Sunduesi i Fronit të madhërishëm!
16. Ai vepron gjithçka që dëshiron!
17. A të ka ardhur ty lajmi i ushtrive
18. të Faraonit dhe të Themudit?
19. Këta që mohojnë vazhdojnë me gënjeshtrën,
20. por Allahu i ka përfshirë ata!
21. Përkundrazi, ai është Kuran i famshëm,
22. në Pllakën e Ruajtur!

Shpjegimi i ajeteve

- "Për qiellin me plot yje!" – I Madhërishmi betohet në qiellin plot yje dhe rrugë. Në të janë vendosur rruga e diellit dhe e hënës, rrugët e yjeve aq të rregullta dhe të sistemuara, të cilat tregojnë për pushtetin absolut të Allahut, për mëshirën e Tij të gjerë, për dijen e Tij gjithëpërfshirëse dhe urtësinë e Tij të madhe.

- "Për Ditën e Premtuar!" - Allahu betohet për Ditën e Kijametit, kur Ai ka premtuar se do të ringjallë dhe tubojë krijesat nga i pari, deri tek i fundit, nga më i largëti, deri tek më të afërmit në kohë. Ky premtim nuk ka për të ndryshuar kurrë, sepse Allahu i Madhërishëm nuk e thyen premtimin e Vet

- "Për atë që dëshmon dhe atë që dëshmohet!" - Këtu përfshihet gjithçka që ka këtë cilësi. Allahu i Madhërishëm betohet në çdo gjë që shikon dhe në çdo gjë që shikohet, betohet në çdo gjë që dëshmon dhe në çdo gjë të dëshmuar.

Betimet në këto shenja të madhështisë dhe pushtetit të Allahut të Lartësuar, që tregojnë për urtësinë e Tij mahnitëse dhe mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse, shërbejnë për të përforcuar një mesazh shumë të rëndësishëm, që vijon më pas:

- "Mallkuar qofshin ata që hapën hendeqet, me zjarr, të mbushur me lëndë djegëse!" - Ky është mallkim për shkatërrimin e tyre. Ata ishin një popull mohues, që sunduan një popull besimtar dhe filluan t'i detyronin që të ktheheshin në besimin e tyre. Por besimtarët nuk pranuan ta tradhtonin fenë e vet. Atëherë, qafirët hapën hendeqe në tokë dhe, pasi ndezën zjarre brenda tyre, u ulën rreth e rrotull, për të dëshmuar vuajtjet e besimtarëve që do të hidheshin aty brenda. Kështu i sprovuan ata besimtarët. I kërcënuan se do t'i flaknin në zjarrin e ndezur fort, nëse nuk kthenin fenë. Dhe vërtet, kushdo që i kundërshtonte dhe nuk e ndryshonte besimin e tij, hidhej në zjarr. Kjo qe grada më e lartë e armiqësisë dhe urrejtjes kundër Allahut dhe adhuruesve të Tij besimtarë të sinqertë. Për

këtë arsye, ata merituan mallkimin dhe ndëshkimin më të rëndë.

Në fillim, Zoti i mallkoi ata e, më pas, Ai tregon veprën e tyre të pamëshirshme kur thotë:

- "Kur ata rrinin ulur rreth tij, dhe dëshmonin atë që bënin me besimtarët." - Kjo tregon se sa të pashpirt dhe çnjerëzorë ishin ata mohues të Zotit dhe torturues të besimtarëve. A ka krim më të rëndë se ky? E përse i urrenin ata besimtarët e përkushtuar?

- "Nuk kishin pse t'i urrenin, përveç se ata e besuan Allahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin, të Cilit i takon sundimi i qiejve e i tokës! Allahu është dëshmitar i çdo gjëje!" – Ata i urryen thjesht për një cilësi të tyren, për të cilën ata do të shpërblehen nga Zoti i tyre: besimi i patundur në Allahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin, të Cilit i takon sundimi i qiejve e i tokës. Ai është *El Aziz* – Krenari, Ngadhnjyesi mbi gjithçka që ekziston. Çdo gjë është e nënshtruar dhe e përulur para madhështisë dhe krenarisë së Tij. Ai është El Hamid - i Lavdëruari, i Lavdishmi, të Cilit i takon falënderimi dhe mirënjohja e plotë për gjithçka. Allahut i takon pushteti i qiejve dhe i tokës. Ai i krijoi ato, prandaj gjithçka duhet t'i nënshtrohet Atij. Vetëm Ai meriton adhurimin dhe dashurinë e plotë të krijesave. Ai ka të drejtën të veprojë mbi ta, ashtu sikurse ia lejon mbretërimi dhe sundimi i Tij. Ai urdhëron dhe ndalon, Ai vendos kufijtë dhe merr në përgjegjësi për respektimin e tyre. Ai është Mbikëqyrës dhe Dëshmues mbi gjithçka, me dijen, shikimin dhe dëgjimin e Tij.

A nuk patën frikë ata të mjerë, që u armiqësuan me Allahun e Madhërishëm? A nuk patën frikë ata nga ndëshkimi i Krenarit të Plotfuqishëm. A nuk e dinin ata se ishin thjesht pronë e Allahut? Askush nuk ka pushtet mbi dikë tjetër, veçse me lejen e të Madhërishmit. A e harruan ata se Allahu i ka shënuar veprat e tyre dhe do t'i shpaguajë për to?!

Qafirët janë të zhytur thellë në mashtrim. Ata janë të zhytur në injorancën dhe verbërinë që sjellin veprat e tyre, prandaj vështirë se mund të shohin rrugën në të cilën Zoti i fton e vështirë se pendohen:

- "Është e sigurt se ata që sprovojnë besimtarët dhe besimtaret dhe nuk pendohen, kanë dënimin e Xhehenemit; për ta është përgatitur dënimi me djegie." - Nëse nuk e pranojnë ftesën e të Gjithëmëshirshmit, ata i pret ndëshkimi përvëlues i Xhehenemit.

Hasen el Basriu ka thënë: "Shikoni bujarinë dhe mëshirën e madhe të Zotit të botëve. Ata torturuan dhe vranë të dashurit dhe të zgjedhurit e tij, të bindurit dhe adhuruesit e nënshtruar dhe besnikë, ndërsa Ai i fton në pendim."

Pasi bëri kërcënimin për qafirët, Allahu i Lartësuar vijon me shpërblimin e premtuar për besimtarët.

- "Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, kanë vërtet Xhenete, nëpër të cilët burojnë lumenj; ky është suksesi më i madh." - Ata që besojnë me zemër, por edhe bëjnë vepra të mira me sinqeritet, sipas besimit të tyre, do të kenë Xhenete, nëpër të cilët burojnë lumenj. Ky është suksesi më i madh. Nuk ka mirësi më të madhe se kënaqësia e Allahut dhe përjetësia në mirësitë e premtuara nga Ai.

- "Është e vërtetë se ndëshkimi i Zotit tënd është i fortë." - Të mos harrojnë kriminelët dhe jobesimtarët se ndëshkimi i Zotit për ta do të jetë shumë i rëndë dhe i vështirë. Ai është gati për t'u dhënë atë që meritojnë, sikurse thotë i Madhërishmi: "Ja, kështu është ndëshkimi i Zotit tënd, kur dënon vendet e zullumit. Vërtet, ndëshkimi i Tij është i dhembshëm e i ashpër". [Hud 102].

- "Në të vërtetë, është Ai që krijon nga e para dhe rikrijon." - Allahu është i vetmi që krijon dhe i vetmi që e rikthen krijimin e Tij. Askush nuk mund t'i ketë këto cilësi, përveç Tij. Ai është *El Gafuru* – Falësi, i Cili i fal të gjitha gjynahet e atyre që pendohen dhe kthehen tek Ai të bindur dhe të nënshtruar. Ai i mbulon të metat atyre që i kërkojnë falje dhe shprehin pendesë tek Ai.
Allahu është *El Uedud* - i Dashuri, i Cili i do të zgjedhurit e Tij me një dashuri që nuk i përngjan asnjë dashurie tjetër. Ashtu sikurse është i pashembullt në cilësitë e Tij të madhështisë, bukurisë dhe të veprave të Tij, ashtu edhe dashuria që Ai ka ka vendosur në zemrat e të zgjedhurve të Tij për Të nuk i përngjan asnjë lloj dashurie tjetër.

Dashuria për Allahun është esenca e adhurimit. Dashuria për Të qëndron mbi çdo dashuri tjetër dhe i mposht ato. Çdo dashuri tjetër që nuk buron nga dashuria për Të dhe nuk ka lidhje me Të, ajo është vuajtje dhe trishtim për zemrën të cilën ka pushtuar. Allahu i do të zgjedhurit e Tij dhe ata e duan Atë, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Ai i do ata dhe ata e duan Atë". *El Meueddetu* është dashuri e kulluar dhe e kthjellët.

Allahu i Lartësuar ka përmendur së bashku dy cilësi të Tij: Falës dhe i Dashur. Kjo ka një nënkuptim shumë të bukur: Ai jo vetëm që i fal ata që pendohen dhe kthehen tek Ai të nënshtruar, por edhe i do ata me dashurinë e Tij. Disa mendojnë se Allahu vetëm u fal gjynahet atyre që pendohen, por nuk i do ata. Por ky ajet i hedh poshtë këto pretendime. Madje, Allahu i Madhërishëm gëzohet shumë për pendimin e robit të Tij gabimtar. Profeti (a.s.) na jep një shembull për të treguar gëzimin e madh të Allahut të Lartësuar. Ai thotë: "Allahu gëzohet më shumë për pendimin e robit të Vet kur ai pendohet, sesa ndonjëri prej jush i cili, duke udhëtuar me deve nëpër shkretëtirë, e humbet devenë së bashku me ujin dhe ushqimin. Ai kërkon dhe e kërkon, derisa e humb shpresën për ta gjetur. Kështu, i lodhur e shpresë humbur, ulet nën hijen e një peme. Por kur hap sytë dhe e sheh devenë e vet duke qëndruar përpara tij, ai ngrihet, e kap për litari dhe nga gëzimi i madh bërtet: "O Zoti im! Ti je robi im dhe unë jam zoti Yt", duke gabuar nga gëzimi i madh." Kësisoj, gëzimi i Allahut për pendimin e robit është më i madh sesa gëzimi i atij robi. Allahu qoftë i lavdëruar dhe i madhëruar! Sa e madhe është mirësia e Tij! Sa e gjerë është bujaria e Tij e sa të shumta janë dhuratat e Tij!

- "Ai është Falësi, i Dashuri! Ai është Sunduesi i Fronit të madhërishëm!" - Ai është Pronari dhe Sunduesi i Fronit të madh, i cili ka përfshirë qiejt, Tokën dhe Kursijin. Të gjitha këto të fundit, në krahasim me Fronin, janë si një unazë e hedhur në një shkretëtirë të madhe. Allahu i Lartësuar është Sunduesi dhe Pronari i gjithësisë, por e veçoi Fronin, duke e përshkruar me madhështinë e tij, për shkak se ai është krijimi më pranë Zotit të Lartësuar.

- **"Ai vepron gjithçka që dëshiron!"** - Nuk ka gjë që Allahu ta dëshirojë dhe të mos e arrijë dot. Nëse dëshiron diçka, Ai vetëm i thotë "Bëhu!", dhe ajo bëhet. Askush nuk është veprues i gjithçkaje që dëshiron, përveç Allahut të Madhërishëm. Krijesat, nëse dëshirojnë diçka, gjithmonë kanë nevojë për ndihmë dhe për të larguar pengesat. Ndërsa Allahu i Madhërishëm nuk ka nevojë për ndihmë dhe askush nuk mund ta pengojë Atë nga ajo që Ai dëshiron. Në vijim, Allahu i Madhërishëm përmend disa nga veprat e Tij, që tregojnë për besnikërinë e profetëve të Tij dhe vërtetësinë e Shpalljes që ata sollën prej Tij.

- "A të ka ardhur ty lajmi i ushtrive të Faraonit dhe të Themudit?" - Ata u bënë mohues dhe refuzues të Profetit, prandaj Allahu i shkatërroi, si mësim për brezat e mëvonshëm.

- **"Këta që mohojnë vazhdojnë me gënjeshtrën, por Allahu i ka përfshirë ata!"** - Me gjithë faktet e lëna nga Zoti ndër breza dhe me gjithë argumentet e shumta të sjella prej Tij, ata vazhdojnë në mohimin dhe mosbesimin e tyre me kokëfortësi dhe armiqësi. Atyre nuk u bëjnë dobi shenjat dhe argumentet e Zotit dhe as paralajmërimet e sjella nga profetët e Tij. Por Allahu i ka përfshirë me dijen dhe pushtetin e Tij mbi ta. Askush nuk mund t'i fshihet dijes dhe pushtetit të Tij gjithëpërfshirës. Ai është gati, prandaj le të kenë frikë nga ndëshkimi i Tij në çdo moment.


Ky është një kërcënim shumë i frikshëm për qafirët. Ai, në dorën e të Cilit janë shpirtrat dhe çdo çështje e tyre, i kërcënon që të kthehen sa nuk është vonë. Ai i fton që të nënshtrohen, duke e besuar Kuranin dhe punuar sipas tij.

- "Përkundrazi, ai është Kur'an i famshëm, në Pllakën e Ruajtur!" - Mesazhet dhe urtësitë e Kuranit janë madhështore dhe të thella. Mirësitë dhe dituritë që përmban ai janë të mrekullueshme dhe të shumta. Kurani është i paprekshëm dhe i pandryshueshëm. Ai ruhet në *Leuhi Mahfudh*, ose në Pllakën e Ruajtur, dhe askush nuk mund të shtojë, pakësojë apo të tjetërsojë diçka nga ai. Kurani është i ruajtur nga ndikimi dhe ndërhyrjet e shejtanëve. Ai është i ruajtur në *Leuhi Mahfudh*, ku është shkruar gjithçka.

Kjo tregon rëndësinë e madhe të Kuranit tek Allahu i Lartësuar dhe dobitë e tij të pakrahasueshme. Allahu është më i ditur për gjithçka.

Surja 86: Et Tarik (mekase) 17 ajete
Ajetet 1 – 17
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Për qiellin dhe "trokitësin"!**
2. **E ku e di ti se çfarë është "trokitësi"?**
3. **Ai është ylli tejshpues.**
4. **Nuk ka asnjë njeri që të mos ketë mbikëqyrës.**
5. **Le të shikojë njeriu se prej çfarë është krijuar!**
6. **Ai është krijuar prej një lëngu, që hidhet fuqishëm,**
7. **që del nga mesi i shpinës dhe dërrasa e gjoksit.**
8. **S'ka dyshim se Ai është i Plotfuqishëm për ta rikthyer atë në jetë,**
9. **ditën kur të zbulohen të fshehtat,**
10. **kur ai nuk do të ketë as forcë e as ndihmues.**


الجزء الثلاثون سورة الطارق سورة الأعلى
سورة الطارق
بسم الله الرحمن الرحيم
وَالسَّمَاءِ وَالطَّارِقِ ﴿١﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا الطَّارِقُ ﴿٢﴾ النَّجْمُ الثَّاقِبُ ﴿٣﴾
إِن كُلُّ نَفْسٍ لَّمَّا عَلَيْهَا حَافِظٌ ﴿٤﴾ فَلْيَنظُرِ الْإِنسَانُ مِمَّ خُلِقَ ﴿٥﴾
خُلِقَ مِن مَّاءٍ دَافِقٍ ﴿٦﴾ يَخْرُجُ مِن بَيْنِ الصُّلْبِ وَالتَّرَائِبِ ﴿٧﴾ إِنَّهُ عَلَىٰ
رَجْعِهِ لَقَادِرٌ ﴿٨﴾ يَوْمَ تُبْلَى السَّرَائِرُ ﴿٩﴾ فَمَا لَهُ مِن قُوَّةٍ وَلَا نَاصِرٍ
﴿١٠﴾ وَالسَّمَاءِ ذَاتِ الرَّجْعِ ﴿١١﴾ وَالْأَرْضِ ذَاتِ الصَّدْعِ ﴿١٢﴾ إِنَّهُ
لَقَوْلٌ فَصْلٌ ﴿١٣﴾ وَمَا هُوَ بِالْهَزْلِ ﴿١٤﴾ إِنَّهُمْ يَكِيدُونَ كَيْدًا ﴿١٥﴾
وَأَكِيدُ كَيْدًا ﴿١٦﴾ فَمَهِّلِ الْكَافِرِينَ أَمْهِلْهُمْ رُوَيْدًا ﴿١٧﴾
سورة الأعلى
بسم الله الرحمن الرحيم
سَبِّحِ اسْمَ رَبِّكَ الْأَعْلَى ﴿١﴾ الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّىٰ ﴿٢﴾ وَالَّذِي قَدَّرَ فَهَدَىٰ
﴿٣﴾ وَالَّذِي أَخْرَجَ الْمَرْعَىٰ ﴿٤﴾ فَجَعَلَهُ غُثَاءً أَحْوَىٰ ﴿٥﴾ سَنُقْرِئُكَ
فَلَا تَنسَىٰ ﴿٦﴾ إِلَّا مَا شَاءَ اللَّهُ إِنَّهُ يَعْلَمُ الْجَهْرَ وَمَا يَخْفَىٰ ﴿٧﴾ وَنُيَسِّرُكَ
لِلْيُسْرَىٰ ﴿٨﴾ فَذَكِّرْ إِن نَّفَعَتِ الذِّكْرَىٰ ﴿٩﴾ سَيَذَّكَّرُ مَنْ يَخْشَىٰ ﴿١٠﴾
الجزء ٣٠
٥٩١

11. **Për qiellin, që herë pas here kthehet!**
12. **Për tokën, që herë pas here hapet!**
13. **Vërtet, ai është Fjalë dalluese.**
14. **Ai nuk është diçka e parëndësishme!**
15. **Ata vërtet bëjnë kurthe të mëdha.**
16. **Po edhe Unë përgatis dështimin e kurtheve të tyre!**
17. **"Lëri edhe ca kohë jobesimtarët! Jepu atyre edhe pak kohë!"**

Shpjegimi i ajeteve

- "Për qiellin dhe "trokitësin"! E ku e di ti se çfarë është "trokitësi"? Ai është ylli tejshpues." - Allahu i Lartësuar betohet në qiellin dhe në "trokitësin". Më pas shpjegon se çfarë është "trokitësi", duke thënë se ai është ylli që shpon errësirën me dritë. Ai, që prej largësish të mëdha, e shpon errësirën me dritën e tij, për t'u parë deri në tokë. Pra, fjala "*tarik*" (trokitësi) nënkupton yllin, si trup qiellor, që shpon errësirën me dritën e tij. Ai është quajtur "trokitësi", sepse ai troket natën. Ky betim është bërë për të përforcuar atë që do të përmendet në vijim:

- "Nuk ka asnjë njeri që të mos ketë mbikëqyrës." - Këta mbikëqyrës regjistrojnë veprat e robërve, të mira apo të këqija qofshin, që në Ditën e Gjykimit çdokush të shpërblehet me drejtësi për atë që ka punuar.

- "Le të shikojë njeriu se prej çfarë është krijuar! Ai është krijuar prej një lëngu, që hidhet fuqishëm, që del nga mesi i shpinës dhe dërrasa e gjoksit." - Le të meditojë njeriu se si është krijuar dhe si kanë qënë fillimet e tij. Ai është krijuar nga një lëng (fara e mashkullit) i hedhur me forcë, i cili formohet mes shtyllës kurrizore dhe dërrasës së kraharorit. Kështu, Ai i Cili e krijon njeriun nga ky lëng, që formohet në këtë vend të vështirë, është i Plotfuqishëm që ta rikthejë dhe ta rikrijojë atë në ahiret.

- "S'ka dyshim se Ai është i Plotfuqishëm për ta rikthyer atë në jetë, ditën kur të zbulohen të fshehtat, kur ai nuk do të ketë as forcë e as ndihmues." - Allahu është i Plotfuqishëm që t'i ringjallë të gjithë dhe t'i shpërblejë për veprat e tyre. Atë ditë do të shfaqen haptazi të fshehtat e zemrave, të mira apo të këqija qofshin. Të fshehtat do të shfaqen në fytyrat e njerëzve, siç thotë i Lartësuari: "Ditën kur do të ketë fytyra që zbardhen dhe fytyra që nxihen, atyre të cilëve u janë nxirë fytyrat u thuhet: "A mohuat edhe pasi kishit besuar njëherë?! Vuajeni, pra, dënimin, për shkak të mohimit tuaj!" Ndërsa atyre të cilëve u janë zbardhur

fytyrat, ata do të jenë në mëshirën e Allahut. Ata do të jenë të përjetshëm atje".

Në dynja, shumë çështje mbahen fshehur dhe nuk shfaqen për t'u dëshmuar nga njerëzit. Por në Ditën e Gjykimit do të shfaqen si veprat e punëmirëve, ashtu edhe krimet e të këqijve, për t'u shpërblyer me drejtësi. Atë ditë, njeriu nuk do të gjej asnjë mundësi për të mbrojtur veten e vet dhe as ndonjë ndihmues ku mund të mbështetet.

Në vijim, Allahu i Lartësuar bën një tjetër betim për të vërtetuar saktësinë e Kuranit. Ai thotë:

- "Për qiellin, që herë pas here kthehet! Për tokën, që herë pas here hapet!" - Qielli kthehet kohë pas kohe me reshje, e po kështu edhe toka kohë pas kohe sjell prodhim. Në këtë mënyrë, jetojnë njerëzit dhe kafshët. Por nga qielli zbresin edhe përcaktimet e Zotit kohë pas kohe. Po kështu, edhe toka hapet kohë pas kohe për të marrë në barkun e saj ata që vdesin.

- "Vërtet, ai është Fjalë dalluese!" - Kurani është i gjithi i vërtetë dhe i sqaruar mirë. Ai nuk është i parëndësishëm, por përmban në vetvete çështje madhore dhe serioze. Ai është gjykuesi i drejtë mes grupacioneve dhe besimeve. Ai është sqaruesi mes kundërshtive.

- "Ata vërtet bëjnë kurthe të mëdha. Po edhe Unë përgatis dështimin e kurtheve të tyre!" - Ata që nuk besojnë Profetin (a.s.) dhe Kuranin, por i konsiderojnë si të gënjeshtërt, ata që thurin kurthe për të mbuluar të vërtetën dhe për të mbrojtur të kotën, ta dinë se Allahu i Lartësuar i shkatërron kurthet e tyre dhe bën që të triumfojë e vërteta, edhe nëse e urrejnë qafirët. Ai do ta zhdukë të kotën, për të treguar qartë se cili është fitimtari. Njeriu është shumë shumë i dobët që të dalë kundër të Plotfuqishmit e të Gjithdijshmit, me çfarëdo lloj hileje dhe kurthi që mund të përdorë.

- "Lëri edhe ca kohë jobesimtarët! Jepu atyre edhe pak kohë!" – Kuptimi: Lëri ata të veprojnë edhe për pak kohë, se do ta mësojnë mirë se si do të jetë fundi i tyre në momentin kur mbi ta të zbresë ndëshkimi.

Surja 87: El Ea'la (mekase) 19 ajete
Ajetet 1 – 19
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Madhëroje Zotin tënd, më të Lartësuarin,
2. i Cili krijoi dhe përsosi,
3. i Cili përcaktoi e orientoi,
4. i Cili mundëson mbirjen e kullotës,
5. e pastaj atë e bën pleh të zi.
6. Ne do ta lexojmë ty e nuk do të harrosh,
7. përveç asaj që Allahu dëshiron. Ai e di të dukshmen e të fshehtën.
8. Ne do të mundësojmë për ty më të lehtën.
9. Këshillo aty ku këshilla bën dobi!
10. Do ta pranojë këshillën ai që ka devotshmëri,
11. e do ta refuzojë atë ai që është shumë i keq,
12. i cili do të hyjë në Zjarrin e madh,
13. aty ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë.
14. Ka shpëtuar ai që është pastruar,
15. ai i cili e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe fal namazin.
16. Por ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote,

17. **kur dihet se jeta e botës tjetër është më e mirë dhe e përjetshme.**
18. **Vërtet, kjo gjendej edhe në shkrimet e hershme,**
19. **në shkrimet e Ibrahimit dhe të Musait.**

Shpjegimi i ajeteve

- "Madhëroje Zotin tënd, më të Lartësuarin, i Cili krijoi dhe përsosi..." - Allahu i Lartësuar urdhëron që të bëjmë *tesbih* për Të. *Tesbih*-u ndaj Tij nënkupton përkujtimin, adhurimin dhe nënshtrimin ndaj lartësisë dhe madhështisë së Tij. Kjo duhet të bëhet ashtu si i shkon madhështisë së Allahut, duke përmendur emrat e Tij të bukur, duke e adhuruar Allahun ashtu siç dikton kuptimi i drejtë dhe i saktë i këtyre emrave, duke kujtuar dhe përmendur veprat e Tij madhështore dhe të urta, mes të cilave edhe fakti që Ai i ka bërë krijesat në formën më të plotë dhe të përkryer.

- "...i Cili përcaktoi e orientoi..." - Allahu i Lartësuar ka bërë të gjitha përcaktimet dhe i ka udhëzuar krijesat sipas këtyre përcaktimeve. Këtu bëhet fjalë për udhëzimin e përgjithshëm, i cili u shërben krijesave për të arritur dobitë vetjake, nëpërmjet të cilave rregullohet vazhdimësia e tyre në këtë jetë. Është Ai që përkujdeset për të gjitha krijesat e Tij. Çdo mirësi e kësaj dynjaje është mirësi e Tij. Prandaj, në vijim, Allahu i Lartësuar përmend disa nga këto mirësi:

- "...i Cili mundëson mbirjen e kullotës, e pastaj atë e bën pleh të zi." - Është Allahu që zbret shiun nga qielli dhe, nëpërmjet tij, nxjerr lloje të shumta të bimësisë, me të cilën ushqehen njerëzit, kafshët e tyre dhe çdo lloj kafshe tjetër. Më pas, Ai i bën ato të vyshken dhe të shndërrohen në pleh të nxirë.

Pastaj i Lartësuari përmend mirësinë më të madhe që u ka dhuruar krijesave, Kuranin madhështor:

- "Ne do ta lexojmë ty e nuk do të harrosh, përveç asaj që Allahu dëshiron. Ai e di të dukshmen e të fshehtën." – Kuptimi: Ne do të bëjmë që Kurani të zërë vend në zemrën tënde, që ti ta kuptosh plotësisht atë, dhe pastaj të mos harrosh gjë prej tij.

Ky është një përgëzim madhështor nga Allahu i Lartësuar drejtuar adhuruesit dhe Profetit të tij, Muhamedit (a.s.). Allahu i Madhërishëm do t'i mësonte atij një dituri, që nuk kishte për ta harruar. Kjo do të thotë që Profeti (a.s.) nuk harroi asgjë prej Shpalljes së Zotit, përveç asaj që Zoti, me urtësinë e Tij, e gjykoi se ishte e dobishme që të lihej në harresë. Allahu e di shumë mirë se çfarë është e dobishme dhe çfarë e dëmshme për robërit e Tij, prandaj vendos për ta ashtu si dëshiron Ai, me urtësinë e Tij madhështore.

- "Ne do të mundësojmë për ty më të lehtën." - Edhe ky është një tjetër përgëzim i mrekullueshëm dhe i madh për këtë Profet të zgjedhur. Allahu i Lartësuar do t'ia lehtësonte atij të gjitha çështjet, madje edhe feja e sjellë prej tij do të ishte vetëm lehtësim dhe mirësi për njerëzit.

- "Këshillo aty ku këshilla bën dobi!" - Ftoji njerëzit të zbatojnë dhe jetojnë sipas ligjit të Zotit dhe porosive të Tij. Por kjo këshillë është përkufizuar me një porosi tjetër: "Këshillo atje ku këshilla bën dobi!", domethënë, nëse ajo dëgjohet dhe pranohet, sido që të jetë, këshillë e plotë apo e


pjesshme. Ajeti tregon se, nëse këshilla nuk sjell dobi, por veçse e shton të keqen dhe e pakëson të mirën, ajo nuk është e detyrueshme, madje është e ndaluar që të bëhet.

Në lidhje me këshillimin, njerëzit ndahen në dy grupe: përfitues dhe jo përfitues prej tij. Duke sqaruar të dy llojet, i Lartësuari thotë:

- "Do ta pranojë këshillën ai që ka devotshmëri..." - Ata që përfitojnë nga këshilla janë të pajisurit me *hashjeh*, pra, me frikërespekt për Zotin. Ata i druhen qëndrimit para Zotit të tyre dhe dhënies së llogarisë. Kjo ndjenjë e bën robin që të ndalet nga gjynahet dhe të nxitojë për të kryer vepra të mira, në bindje ndaj Zotit të tij. Ndërsa mospërfituesit nga këshilla janë ata të cilët Allahu i Lartësuar i ka përshkruar me fjalët:

- "...e do ta refuzojë atë ai që është shumë i keq, i cili do të hyjë në Zjarrin e madh, aty ku as nuk do të vdesë, as nuk do të jetojë." - Këta do të flaken në Zjarrin e ndezur fort, nxehtësia e të cilit arrin deri në zemër. Atje do të vuajë një ndëshkim të dhembshëm të pandërprerë, pa gjetur kurrë qetësi dhe shpëtim. Ata do të dëshirojnë vdekjen dhe shkatërrimin, por kjo nuk do t'u mundësohet, sikurse thotë i Lartësuari: "Për jobesimtarët është zjarri i Xhehenemit. Atyre as nuk u përcaktohet vdekja e as nuk u lehtësohet ndëshkimi. Kështu e ndëshkojmë secilin që është mohues i madh". [Fatir 36].

- "Ka shpëtuar ai që është pastruar, ai i cili e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe fal namazin." - Ka shpëtuar nga çdo e keqe dhe ka fituar çdo të mirë ai që ka këto cilësi:


الجزء الثلاثون سورة الغاشية

وَيَتَجَنَّبُهَا ٱلْأَشْقَى ﴿١١﴾ ٱلَّذِى يَصْلَى ٱلنَّارَ ٱلْكُبْرَىٰ ﴿١٢﴾ ثُمَّ لَا يَمُوتُ
فِيهَا وَلَا يَحْيَىٰ ﴿١٣﴾ قَدْ أَفْلَحَ مَن تَزَكَّىٰ ﴿١٤﴾ وَذَكَرَ ٱسْمَ رَبِّهِۦ فَصَلَّىٰ ﴿١٥﴾
بَلْ تُؤْثِرُونَ ٱلْحَيَوٰةَ ٱلدُّنْيَا ﴿١٦﴾ وَٱلْءَاخِرَةُ خَيْرٌ وَأَبْقَىٰٓ ﴿١٧﴾ إِنَّ
هَٰذَا لَفِى ٱلصُّحُفِ ٱلْأُولَىٰ ﴿١٨﴾ صُحُفِ إِبْرَٰهِيمَ وَمُوسَىٰ ﴿١٩﴾

سورة الغاشية

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

هَلْ أَتَىٰكَ حَدِيثُ ٱلْغَٰشِيَةِ ﴿١﴾ وُجُوهٌ يَوْمَئِذٍ خَٰشِعَةٌ ﴿٢﴾ عَامِلَةٌ
نَّاصِبَةٌ ﴿٣﴾ تَصْلَىٰ نَارًا حَامِيَةً ﴿٤﴾ تُسْقَىٰ مِنْ عَيْنٍ ءَانِيَةٍ ﴿٥﴾ لَّيْسَ
لَهُمْ طَعَامٌ إِلَّا مِن ضَرِيعٍ ﴿٦﴾ لَّا يُسْمِنُ وَلَا يُغْنِى مِن جُوعٍ ﴿٧﴾ وُجُوهٌ
يَوْمَئِذٍ نَّاعِمَةٌ ﴿٨﴾ لِّسَعْيِهَا رَاضِيَةٌ ﴿٩﴾ فِى جَنَّةٍ عَالِيَةٍ ﴿١٠﴾ لَّا تَسْمَعُ
فِيهَا لَٰغِيَةً ﴿١١﴾ فِيهَا عَيْنٌ جَارِيَةٌ ﴿١٢﴾ فِيهَا سُرُرٌ مَّرْفُوعَةٌ ﴿١٣﴾ وَأَكْوَابٌ
مَّوْضُوعَةٌ ﴿١٤﴾ وَنَمَارِقُ مَصْفُوفَةٌ ﴿١٥﴾ وَزَرَابِىُّ مَبْثُوثَةٌ ﴿١٦﴾ أَفَلَا يَنظُرُونَ
إِلَى ٱلْإِبِلِ كَيْفَ خُلِقَتْ ﴿١٧﴾ وَإِلَى ٱلسَّمَآءِ كَيْفَ رُفِعَتْ ﴿١٨﴾ وَإِلَى
ٱلْجِبَالِ كَيْفَ نُصِبَتْ ﴿١٩﴾ وَإِلَى ٱلْأَرْضِ كَيْفَ سُطِحَتْ ﴿٢٠﴾
فَذَكِّرْ إِنَّمَآ أَنتَ مُذَكِّرٌ ﴿٢١﴾ لَّسْتَ عَلَيْهِم بِمُصَيْطِرٍ ﴿٢٢﴾

٥٩٢

1. Është i pastruar, domethënë është i pastër nga *shirk*-u, padrejtësitë e çdo lloji dhe veset e këqija.

2. Përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet. Zemra e tij është e mbushur me këtë përkujtim, dhe kjo e shtyn atë që të bëjë vepra të mira për të kënaqur Zotin. Nga këto vepra të mira është veçuar namazi, i cili është tregues i qartë i imanit dhe pastrues i gjynaheve.

Disa janë të mendimit se përcaktimi "*që është pastruar*" nënkupton dhënien e zekatit të fitrit, i cili është pastrim për agjëruesin, ndërsa kur thuhet: "*dhe fal namazin*" është për qëllim namazi i Bajramit. Por megjithëse ajeti i përfshin këto raste, nuk mund të themi se ka për qëllim vetëm ato, sepse ai është më i gjerë dhe gjithëpërfshirës.

- "Por ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote..." – Kuptimi: Ju e parapëlqeni dhe e

vlerësoni më shumë këtë botë se ahiretin. Ju u jepni përparësi kënaqësive të saj të shkurtra dhe të përziera me lodhje dhe vuajtje, duke harruar se:

- "...jeta e botës tjetër është më e mirë dhe e përjetshme." - Ahireti është më i mirë se dynjaja, në çdo këndvështrim. Ahireti është i përjetshëm e i mrekullueshëm, ndërsa dynjaja është vend i përkohshëm. Besimtari, i cili është i ditur dhe i zgjuar, nuk e zgjedh kurrë të keqen dhe të braktisë të mirën, nuk e zgjedh kënaqësinë e përkohshme, kundrejt kënaqësisë së përjetshme. Parapëlqimi i dynjasë kundrejt ahiretit është koka e çdo të keqeje dhe gjynahu.

- "Vërtet, kjo gjendej edhe në shkrimet e hershme, në shkrimet e Ibrahimit dhe të Musait." - Këto që po ju thuhen në këtë sure të bekuar janë të njëjta me ato që gjenden edhe në librat e parë, që Zoti u shpalli Ibrahimit dhe Musait, të cilët janë të zgjedhurit dhe ndër më të nderuarit profetë të Zotit, pas Muhamedit (a.s.). Këto porosi janë sjellë në çdo ligj të shpallur nga Zoti ndër shekuj, sepse ato janë garantuese të mirësive të dynjasë dhe ahiretit.

Këtu përfundon tefsiri i sures El ea'la. Allahut i takon falënderimi dhe lavdia e plotë!

Surja 88: El Gâshijeh (mekase) 26 ajete
Ajetet 1 – 26
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. A të ka ardhur lajmi për Belanë gjithëpërfshirëse?
2. Atë ditë sheh fytyra të tmerruara,
3. të lodhura e të rraskapitura.
4. Ata do hyjnë në një zjarr të ndezur fort.
5. Atyre u jepet të pinë prej një kroi të valë.
6. Ata nuk kanë ushqim tjetër, veç një ferre helmuese,
7. e cila nuk jep fuqi, as nuk largon uri.
8. Atë ditë sheh fytyra të ndritshme,
9. të cilat janë të kënaqura për veprat e veta,
10. në një Xhenet të shkallës së lartë,
11. ku nuk dëgjojnë fjalë të pakëndshme.
12. Aty ka kroje, që rrjedhin.
13. Ata kanë shtretër të lartë,
14. kupa të vendosura pranë,
15. jastëkë të renditur për mbështetje
16. dhe qilima të shtruar.
17. A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar,
18. qiellin se si është ngritur lart,
19. malet se si janë vendosur,
20. Tokën se si është shtruar?!
21. Ti këshillo, se je veçse një përkujtues,
22. dhe nuk je kontrollues i tyre!
23. Përveç atij që sprapset e nuk beson,
24. të cilin Allahu me vuajtje të mëdha do e dënojë.
25. Pa dyshim, vetëm tek Ne është kthimi i tyre.
26. Dhe, pa dyshim, detyrë vetëm e Jona është llogaria e tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- "A të ka ardhur lajmi për Belanë gjithëpërfshirëse?" - Allahu i Lartësuar përshkruan në këtë sure disa nga situatat dhe gjendjet e tmerrshme të Ditës së Gjykimit. Ajo ditë do të përfshijë me vështirësitë e saj të gjitha krijesat. Të gjithë do të shpërblehen sipas veprave që kanë bërë dhe do të ndahen në dy grupe të mëdha: një grup për në Xhenet dhe një grup për në Zjarrin e ndezur fort. I Madhëruari jep cilësitë dhe veçoritë e secilit grup. Në

fillim, duke përshkruar banorët e Zjarrit, i Madhërishmi thotë:

- "Atë ditë sheh fytyra të tmerruara, të lodhura e të rraskapitura." - Në Ditën e Gjykimit do të ketë fytyra, të cilat Zoti i përshkruan me dy cilësi:
Së pari, ato do të jenë të tmerruara dhe të dërrmuara nga poshtërimi, turpi dhe nënçmimi.
Së dyti, ato do të jenë të lodhura dhe të rraskapitura nga ndëshkimi. Lodhja dhe vuajtja do të mbërthehen në fytyrat e tyre, të cilat do të mbulohen nga Zjarri përvëlues.
Ky ishte njëri nga mendimet e komentuesve të Kuranit rreth kuptimeve të këtij ajeti. Të tjerë shpjegojnë se Ditën e Gjykimit do të ketë fytyra që, edhe pse në jetën e dynjasë janë përpjekur e lodhur me adhurime të shumta, ato do të jenë përsëri të tmerruara dhe të poshtëruara, sepse atyre do t'u mungojë kushti i domosdoshëm që i bën adhurimet të pranueshme dhe të shpërblyeshme nga Zoti: imani i saktë dhe i drejtë. Për këtë arsye, veprat dhe adhurimet e tyre do të shndërrohen në pluhur.

Shpjegimi i dytë, edhe pse mund të jetë i saktë nga ana e kuptimit, nuk mund të thuhet se mbështetet nga konteksti. Prandaj mendimi më i saktë, madje i padiskutueshëm, është ai i pari. Këtë e përforcon edhe fakti se qëllimi i këtyre ajeteve është një përshkrim i përgjithshëm i gjendjes së banorëve të Zjarrit. Kufizimi i këtij përshkrimi vetëm për një kategori të caktuar nuk ka mbështetje në fakte. Në këtë mënyrë, ai do të vlente vetëm për një pjesë të vogël të banorëve të Zjarrit. Nga ana tjetër, saktësinë e mendimit të parë e mbështet edhe fakti se këto ajete flasin thjesht për gjendjen e njerëzve në momentin kur ata i përfshin tmerri i asaj dite, pa cilësuar ndonjë gjë prej jetës së tyre në dynja.

- "Ata do hyjnë në një zjarr të ndezur fort. Atyre u jepet të pinë prej një kroi të valë." - Zjarri ka nxehtësi të madhe dhe i përfshin brenda tij. Edhe uji që do t'u jepet është i vluar. I Lartësuari thotë në suren El kehf: "Ne kemi përgatitur për jobesimtarët një zjarr muret e të cilit i rrethojnë ata, e nëse kërkojnë shpëtim, ndihmohen me një ujë si katran që përzhit fytyrat. E shëmtuar është ajo pije, e vend i keq është ai"." [El kehf 29]
Ndërsa për sa i përket ushqimit të tyre, i Madhërishmi thotë:

- "Ata nuk kanë ushqim tjetër, veç një ferre helmuese, e cila nuk jep fuqi, as nuk largon uri." - Funksioni i ushqimit është ose largimi i urisë dhe vuajtjes që ajo krijon, ose forcimi i trupit dhe ruajtja e tij nga dobësimi. Asnjë prej këtyre nuk ekziston tek ushqimi i banorëve të Xhehenemit, pasi ai është një ushqim tejet i pështirë, i hidhur dhe i urryer. E lusim Allahun e Madhërishëm të na ruajë nga kjo e keqe!

Ndërsa banorët e Xhenetit meritojnë tjetër shpërblim:

- "Atë ditë sheh fytyra të ndritshme, të cilat janë të kënaqura për veprat e veta..." - Fytyrat e fatlumëve do të jenë të shndritshme dhe të lumtura. Kënaqësitë dhe lumturia e papërshkrueshme që i ka pushtuar duket qartë në shkëlqimin e fytyrave dhe trupave të tyre. Ata do të jenë të kënaqur për veprat e mira që kanë kryer në dynja, si adhurim ndaj Zotit dhe si bamirësi ndaj robërve të Zotit. Ata do të jenë të kënaqur, sepse shpërblimi i përgatitur për

ta është i madh dhe i mrekullueshëm. Ata do të kenë në Xhenet gjithçka që dëshirojnë.

- "...në një Xhenet të shkallës së lartë, ku nuk dëgjojnë fjalë të pakëndshme." - Ata do të jenë në kopshte me të gjitha llojet e mirësive, në lartësitë e *Il-lijin*-ëve. Banesat e tyre janë të larta, me dhoma të ndërtuara njëra mbi tjetrën, prej të cilave ata kundrojnë të lumtur mirësitë që Zoti u ka dhuruar. Në Xhenet nuk dëgjohen kurrë fjalë të kota dhe të padobishme, e aq më pak fjalë të ndaluara dhe të këqija. Fjalët që do të flasin e dëgjojnë në të do të jenë të mira, të bukura dhe të dobishme, siç është përkujtimi i Zotit dhe i mirësive me të cilat Ai i ka begatuar. Ata do të kënaqen me bisedat mes tyre, në zemër e në shpirt.

- "Aty ka kroje, që rrjedhin. Ata kanë shtretër të lartë, kupa të vendosura pranë, jastëkë të renditur për mbështetje dhe qilima të shtruar." - Në Xhenet ka kroje të shumta, që burojnë dhe gurgullojnë sa herë që banorët e tij e dëshirojnë një gjë të tillë, si ta dëshirojnë dhe ku ta dëshirojnë. Atje ka shtretër të vendosur në vende të larta dhe të stolisur bukur, me shtroje të buta dhe të rehatshme. Banorëve do t'u shërbehen kupa të mbushura me pije të shijshme dhe të këndshme, që do të vendosen mu para tyre, për t'i marrë dhe shijuar. Ato pije janë përgatitur enkas për ta dhe shërbehen nga djelmosha të përjetshëm, që vërtiten dhe shërbejnë mes tyre. Atje do të kenë jastëkë të renditur, të vendosur për t'u rehatuar: jastëkë prej mëndafshi e prej materialesh të tjera, që vetëm Zoti i di. Ata janë të sistemuar, pa pasur nevojë që besimtarët ta bëjnë këtë vetë. Vendet ku ata qëndrojnë janë të shtruar me qilima të mrekullueshëm, që mbushin çdo cep e anë.

- "A nuk i shikojnë devetë se si janë krijuar, qiellin se si është ngritur lart, malet se si janë vendosur, Tokën se si është shtruar?!" - Ajeti u drejtohet këtu atyre që nuk besojnë Profetin e Allahut, por dhe të tjerëve, që të meditojnë rreth krijesave të Allahut të Madhëruar, të cilat dëshmojnë për njëshmërinë e Tij.

A nuk e shohin ata mrekullinë në krijimin e devesë, e cila është bërë që të përballojë vështirësi të mëdha dhe t'i kryejë njeriut shërbime shumë të vyera dhe të veçanta.

A nuk i vështrojnë ata malet, se si janë vendosur dhe çfarë roli luajnë?! Allahu i ka bërë malet stabilizues të tokës dhe fiksues të saj, që ajo të mos tronditet dhe lëkundet. Jo vetëm kaq, por brenda tyre Allahu i Madhërishëm ka vendosur thesare dhe mirësi të shumta për njerëzit.

A nuk e shohin ata Tokën, se si është shtrirë dhe sheshuar? Ajo është përshtatur më së miri për njerëzit, të cilët qëndrojnë lehtësisht mbi të, e punojnë dhe e mbjellin atë, ndërtojnë mbi të, lëvizin nëpër rrugët e saj, për të arritur qëllimet e tyre.

Fakti që Toka është e sheshuar dhe e shtruar nuk kundërshton faktin tjetër që ajo është e rrumbullakët, me gjithësinë rrotull saj. Për këtë tregojnë argumente tradicionale, logjike, shqisore dhe të dëshmuara. Shumica e njerëzve e njohin dhe e pranojnë këtë fakt, sidomos në këto kohë, kur njeriu ka arritur të hulumtojë çdo cep të globit, nëpërmjet mundësive të lehtësuara nga Zoti i Madhërishëm. Nëse do të bëhej fjalë për ndonjë trup të vogël të rrumbullakët, vërtet shtrirja e tij do t'ia ndryshonte formën, por kur bëhet fjalë për madhësinë e Tokës, ajo

është e shtrirë, e sheshtë dhe e lehtë për t'u shfrytëzuar, edhe pse në të njëtën kohë është e rrumbullakët.


- "Ti këshillo, se je veçse një përkujtues, dhe nuk je kontrollues i tyre!" – Kuptimi: Përkujto, qorto, këshillo, përgëzo dhe kërcëno! Ti je dërguar në botë për t'i ftuar krijesat në adhurimin e Allahut si Një i vetëm dhe që t'u kujtosh atyre shpërblimin dhe ndëshkimin e Tij. Ti nuk je kontrollues i tyre, që të mund t'i detyrosh të besojnë, dhe as përgjegjës për veprat e tyre. Nëse kryen detyrën tënde, atëherë ti nuk je përgjegjës për çfarë bëjnë ata. Kjo i ngjan fjalës së Allahut të Lartësuar në suren Kaf: "Ne e dimë shumë mirë se çfarë thonë ata, ndërsa ti nuk mund t'i detyrosh. Ti këshilloje me Kuran atë që i druhet kërcënimit Tim!" [Kaf 45].

- "Përveç atij që sprapset e nuk beson, të cilin Allahu me vuajtje të mëdha do e dënojë." - Por ata të cilët i kthejnë shpinën bindjes ndaj Zotit dhe e mohojnë Atë, ata do të kenë ndëshkim të rëndë, të madh dhe të vazhdueshëm.Askush nuk mund t'i shpëtojë llogarisë së Allahut, sepse:

- "Pa dyshim, vetëm tek Ne është kthimi i tyre. Dhe, sigurisht, detyrë vetëm e Jona është llogaria e tyre." - Të gjitha krijesat do të kthehen te Krijuesi i tyre në Ditën e Gjykimit. Ai është i vetmi që do të gjykojë me drejtësi mbi ta për veprat e tyre dhe do t'i shpërblejë ata, me drejtësinë dhe bamirësinë e Tij.

Surja 89: El Fexhr (mekase) 30 ajete

Ajetet 1 - 5


الجزء الثلاثون
سورة الفجر
إِلَّا مَن تَوَلَّىٰ وَكَفَرَ ﴿٢٣﴾ فَيُعَذِّبُهُ ٱللَّهُ ٱلْعَذَابَ ٱلْأَكْبَرَ ﴿٢٤﴾
إِنَّ إِلَيْنَآ إِيَابَهُمْ ﴿٢٥﴾ ثُمَّ إِنَّ عَلَيْنَا حِسَابَهُم ﴿٢٦﴾
سورة الفجر
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
وَٱلْفَجْرِ ﴿١﴾ وَلَيَالٍ عَشْرٍ ﴿٢﴾ وَٱلشَّفْعِ وَٱلْوَتْرِ ﴿٣﴾ وَٱلَّيْلِ إِذَا يَسْرِ ﴿٤﴾
هَلْ فِي ذَٰلِكَ قَسَمٌ لِّذِي حِجْرٍ ﴿٥﴾ أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِعَادٍ ﴿٦﴾
إِرَمَ ذَاتِ ٱلْعِمَادِ ﴿٧﴾ ٱلَّتِي لَمْ يُخْلَقْ مِثْلُهَا فِي ٱلْبِلَادِ ﴿٨﴾ وَثَمُودَ ٱلَّذِينَ
جَابُوا۟ ٱلصَّخْرَ بِٱلْوَادِ ﴿٩﴾ وَفِرْعَوْنَ ذِي ٱلْأَوْتَادِ ﴿١٠﴾ ٱلَّذِينَ طَغَوْا۟ فِي
ٱلْبِلَادِ ﴿١١﴾ فَأَكْثَرُوا۟ فِيهَا ٱلْفَسَادَ ﴿١٢﴾ فَصَبَّ عَلَيْهِمْ رَبُّكَ سَوْطَ
عَذَابٍ ﴿١٣﴾ إِنَّ رَبَّكَ لَبِٱلْمِرْصَادِ ﴿١٤﴾ فَأَمَّا ٱلْإِنسَٰنُ إِذَا مَا ٱبْتَلَىٰهُ
رَبُّهُۥ فَأَكْرَمَهُۥ وَنَعَّمَهُۥ فَيَقُولُ رَبِّيٓ أَكْرَمَنِ ﴿١٥﴾ وَأَمَّآ إِذَا مَا ٱبْتَلَىٰهُ
فَقَدَرَ عَلَيْهِ رِزْقَهُۥ فَيَقُولُ رَبِّيٓ أَهَٰنَنِ ﴿١٦﴾ كَلَّا ۖ بَل لَّا تُكْرِمُونَ
ٱلْيَتِيمَ ﴿١٧﴾ وَلَا تَحَٰٓضُّونَ عَلَىٰ طَعَامِ ٱلْمِسْكِينِ ﴿١٨﴾ وَتَأْكُلُونَ
ٱلتُّرَاثَ أَكْلًا لَّمًّا ﴿١٩﴾ وَتُحِبُّونَ ٱلْمَالَ حُبًّا جَمًّا ﴿٢٠﴾ كَلَّآ إِذَا
دُكَّتِ ٱلْأَرْضُ دَكًّا دَكًّا ﴿٢١﴾ وَجَآءَ رَبُّكَ وَٱلْمَلَكُ صَفًّا صَفًّا ﴿٢٢﴾
٥٩٣

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për agimin!
2. Për dhjetë netët!
3. Për çiftin dhe për tekun!
4. Për natën që udhëton!
5. A nuk janë këto betime për të mençurit?!

Shpjegimi i ajeteve

- "Për agimin! Për dhjetë netët! Për çiftin dhe për tekun!" - I Madhëruari betohet në agimin, i cili shënon fundin e natës dhe fillimin e ditës, dukuri kjo që tregon për pushtetin e madh dhe gjithëpërfshirës të Allahut të Madhërishëm, se është Ai i vetmi që administron të gjitha çështjet e krijesave të Tij dhe, si i tillë, askush përveç Tij nuk meriton që ta adhurosh e që t'i nënshtrohesh. Pikërisht në agim është koha

e kryerjes së një adhurimi të mrekullueshëm, që me të vërtetë e meriton që Allahu i Madhëruar të betohet për të, e ai është namazi i sabahut.

I Madhërishmi vijoi me betimin për dhjetë netët, të cilat, sipas mendimit më të saktë, janë dhjetë netët e fundit të muajit Ramazan, ose dhjetë ditët e Dhul Hixhes. Këto janë net dhe ditë të veçanta, në të cilat kryhen adhurime që nuk kryhen në periudha të tjera. Në dhjetë netët e fundit të Ramazanit ndodhet nata e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj, ndërsa në ditët e tij kryhet agjërimi, i cili është njëri nga shtyllat e Islamit. Ndërsa në dhjetëditëshin e Dhul Hixhes ndodhet Dita e Arafatit, ditë kur Allahu i fal dhe mbulon gjynahet e robërve me një falje të madhe dhe të mrekullueshme, me të cilën dëshpëron Shejtanin e mallkuar. Kurrë nuk është parë Shejtani i mallkuar më i poshtëruar dhe më i pavlerë sesa në ditën e Arafatit, kur mëshira dhe begatitë e Zotit zbresin mbi robërit e Tij njësues. Gjatë këtyre ditëve zhvillohen shumë adhurime të haxhit dhe të umres. Të gjitha ato janë shumë të rëndësishme, aq sa e meritojnë që i Madhërishmi të betohet në to.

- "Për natën që udhëton!" - I Urti betohet në kohën kur nata udhëton nëpër tokë dhe me errësirën e saj mbulon tokën. Në këtë kohë, robërit çlodhen dhe qetësohen nga aktiviteti i ditës. Ky është tregues i mëshirës së Allahut dhe i urtësisë së Tij të madhe.

- **"A nuk janë këto betime për të mençurit?!"** - Kjo është një pyetje, përgjigjja ndaj së cilës është: "Po, o Zoti ynë, madje vetëm një pjesë e tyre do të ishin të mjaftueshme, për të marrë mësim dhe përvojë çdokush që ka zemër të gjallë dhe dëgjon me vëmendje."

Ajetet 6 – 14

6. A e di ti se ç'bëri Zoti yt me Adin,
7. apo me banorët e Iremit, me ndërtesa të larta?
8. Si ata nuk është krijuar askush në tokë.
9. Po me Themudin, të cilët gdhendën shkëmbinjtë në luginë,
10. apo me Faraonin e përforcuar me ushtri?
11. Këta i kaluan kufijtë me padrejtësi në tokë
12. dhe në të shtuan shkatërrimin.
13. Por Allahu lëshoi kundër tyre kamzhik të ashpër ndëshkimi.
14. Pa dyshim, Zoti yt u rri në pritë.

Shpjegimi i ajeteve

- "A e di ti se ç'bëri Zoti yt me Adin, apo me banorët e Iremit, me ndërtesa të larta? Si ata nuk është krijuar askush në tokë." - Kuptimi: A e ke parë, me zemrën dhe mendjen tënde, atë që Zoti yt bëri me këta popuj të shfrenuar në gjynahe?

Iremi ka qenë një vend i njohur në Jemen, me ndërtesa të larta, nëpërmjet të cilave ata tregonin forcën, arrogancën dhe tiraninë e tyre.

Askush nuk është krijuar si populli i Adit, për sa i përket forcës dhe ashpërsisë së tyre. Profeti Hud u tha atyre: "A mos ju erdhi çudi që Shpallja nga Zoti juaj ju erdhi përmes një njeriu nga mesi juaj, për t'ua tërhequr vërejtjen? Përkujtoni kur Ai ju bëri sundues pas popullit të Nuhut dhe jua shtoi fuqinë fizike. Përkujtoni të mirat e Allahut, që të gjeni shpëtim." [Araf 69].

- "Po me Themudin, të cilët gdhendën shkëmbinjtë në luginë..." - Me fuqinë e tyre, ata gdhendnin shkëmbinjtë në luginën Kura, dhe pastaj banonin në to.

- "...apo me Faraonin e përforcuar me ushtri? Këta i kaluan kufijtë me padrejtësi në tokë dhe në të shtuan shkatërrimin." - Faraoni e kishte përforcuar pushtetin e tij nëpërmjet ushtrive të shumta. Të gjithë këta popuj të përmendur: Adi, Themudi dhe Faraoni me ushtritë e tij, i kishin shtuar padrejtësitë në tokë, i kishin kaluar kufijtë me gjynahe dhe me vuajtjet që u shkaktonin robërve të Zotit, në çështjet e fesë dhe të dynjasë. Shkatërrimi që ata sollën në tokë ishte kufri dhe frytet e tij të hidhura. Ata këmbëngulën në luftën kundër profetëve të Zotit dhe në pengimin e njerëzve nga rruga e Tij. Por kur arritën kulmin me gjynahe, që e bënte të detyrueshëm ndëshkimin e tyre, atëherë:

- "Allahu lëshoi kundër tyre kamzhik të ashpër ndëshkimi." – Allahu i Madhërishëm dhe Krenar lëshoi kundër tyre disa ndëshkime të ashpra. Kështu ndëshkohet çdo kriminel kryeneç.

- "Pa dyshim, Zoti yt u rri në pritë." - Allahu i Madhërishëm rri në pritë të çdokujt që nuk i bindet dhe kundërshton adhurimin e Tij. Ai vërtet e afatizon robin, që ai të ketë kohë mjaftueshëm për të reflektuar dhe për t'u kthyer i penduar e i nënshtruar tek Zoti i tij, por kur ndëshkimi i Tij zbret mbi zullumqarin, ai është i dhembshëm dhe i ashpër, ashtu si di të ndëshkojë Krenari i Plotpushtetshëm.


Ajetet 15 – 20

15. Kur Zoti e sprovon njeriun me privilegje dhe begati, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar!"
16. Por kur e sprovon duke ia pakësuar furnizimin, ai thotë: "Zoti im më ka nënçmuar!"
17. Jo, nuk është ashtu! Por ju nuk përfillni jetimin,
18. Nuk nxisni njëri-tjetrin për të ushqyer të varfërin,
19. Ju e hani trashëgiminë me teprim dhe pa ngopje,
20. dhe e doni pasurinë me një dashuri të tepruar.

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur Zoti e sprovon njeriun me privilegje dhe begati, ai thotë: "Zoti im më ka nderuar!" Por kur e sprovon duke ia pakësuar furnizimin, ai thotë: "Zoti im më ka nënçmuar!" Jo, nuk është ashtu!" - Allahu i Madhëruar na tregon rreth natyrës së njeriut, duke thënë që njeriu është i prirur drejt injorancës dhe padrejtësisë.

Njeriu është i paditur rreth përfundimit të çështjeve. Ai mendon se gjendja në të cilën ndodhet nuk ka për të ndryshuar, por do të vazhdojë ashtu. Njeriu mendon se mirësitë që Zoti i jep atij në jetën e kësaj bote tregojnë se ai është i nderuar dhe i privilegjuar te Zoti i gjithësisë. Por kur Allahu i Madhëruar dhe i Urtë ia pakëson furnizimin, duke i dhënë veçse aq sa ka të nevojshme, dhe jo më tepër, njeriu e mendon si një poshtërim nga Allahu për të. Por Allahu i Madhëruar ia hedh poshtë këtë lloj gjykimi të pavërtetë dhe thotë: "Jo, nuk është ashtu!" Pra, jo çdokush të cilit Allahu i ka dhuruar begatitë e kësaj dynjaje është i dashur dhe i zgjedhuri i Tij, dhe jo çdokush të cilit Ai ia ka pakësuar këto begati është i poshtëruar dhe i pavlefshëm tek Allahu.


الجزء الثلاثون سورة البلد

وَجِاْيٓءَ يَوْمَئِذٍۭ بِجَهَنَّمَ ۚ يَوْمَئِذٍ يَتَذَكَّرُ ٱلْإِنسَٰنُ وَأَنَّىٰ
لَهُ ٱلذِّكْرَىٰ ﴿٢٣﴾ يَقُولُ يَٰلَيْتَنِى قَدَّمْتُ لِحَيَاتِى ﴿٢٤﴾ فَيَوْمَئِذٍ
لَّا يُعَذِّبُ عَذَابَهُۥٓ أَحَدٌ ﴿٢٥﴾ وَلَا يُوثِقُ وَثَاقَهُۥٓ أَحَدٌ ﴿٢٦﴾ يَٰٓأَيَّتُهَا
ٱلنَّفْسُ ٱلْمُطْمَئِنَّةُ ﴿٢٧﴾ ٱرْجِعِىٓ إِلَىٰ رَبِّكِ رَاضِيَةً مَّرْضِيَّةً ﴿٢٨﴾
فَٱدْخُلِى فِى عِبَٰدِى ﴿٢٩﴾ وَٱدْخُلِى جَنَّتِى ﴿٣٠﴾

سورة البلد

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

الحزب ٦٠

لَآ أُقْسِمُ بِهَٰذَا ٱلْبَلَدِ ﴿١﴾ وَأَنتَ حِلٌّۢ بِهَٰذَا ٱلْبَلَدِ ﴿٢﴾ وَوَالِدٍ وَمَا وَلَدَ
﴿٣﴾ لَقَدْ خَلَقْنَا ٱلْإِنسَٰنَ فِى كَبَدٍ ﴿٤﴾ أَيَحْسَبُ أَن لَّن يَقْدِرَ عَلَيْهِ
أَحَدٌ ﴿٥﴾ يَقُولُ أَهْلَكْتُ مَالًا لُّبَدًا ﴿٦﴾ أَيَحْسَبُ أَن لَّمْ يَرَهُۥٓ أَحَدٌ
﴿٧﴾ أَلَمْ نَجْعَل لَّهُۥ عَيْنَيْنِ ﴿٨﴾ وَلِسَانًا وَشَفَتَيْنِ ﴿٩﴾ وَهَدَيْنَٰهُ
ٱلنَّجْدَيْنِ ﴿١٠﴾ فَلَا ٱقْتَحَمَ ٱلْعَقَبَةَ ﴿١١﴾ وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا ٱلْعَقَبَةُ ﴿١٢﴾
فَكُّ رَقَبَةٍ ﴿١٣﴾ أَوْ إِطْعَٰمٌ فِى يَوْمٍ ذِى مَسْغَبَةٍ ﴿١٤﴾ يَتِيمًا ذَا مَقْرَبَةٍ
﴿١٥﴾ أَوْ مِسْكِينًا ذَا مَتْرَبَةٍ ﴿١٦﴾ ثُمَّ كَانَ مِنَ ٱلَّذِينَ ءَامَنُوا۟ وَتَوَاصَوْا۟
بِٱلصَّبْرِ وَتَوَاصَوْا۟ بِٱلْمَرْحَمَةِ ﴿١٧﴾ أُو۟لَٰٓئِكَ أَصْحَٰبُ ٱلْمَيْمَنَةِ ﴿١٨﴾

٥٩٤

Mësojeni, pra, se pasuria dhe varfëria, rehatia dhe trazimet, të gjitha janë sprovë prej Allahut të Madhërishëm, nëpërmjet të cilave Ai bën të dallohen qartë cilësitë dhe veprat e robërve. Kështu dallohen ata që janë mirënjohës ndaj të Madhërishmit Bujar dhe të durueshëm ndaj porosive të Tij. Atyre që tregojnë mirënjohje dhe durim sikurse Zoti ka porositur, Ai u premton shpërblim të pamatë. Ndërsa për ata që shpërfillin këto porosi dhe kalojnë kufijtë, Ai ka përgatitur ndëshkim të dhembshëm dhe poshtërues.

Angazhimi i njeriut veçse me dëshirat dhe synimet e veta është tregues i vullnetit të tij të dobët, prandaj i Madhëruari i qorton ata që nuk interesohen për gjendjen dhe nevojat e të tjerëve, duke thënë:

- **"Por ju nuk përfillni jetimin..."** – Jetim është fëmija që nuk e ka babain apo një kujdestar të ligjshëm, prandaj edhe ka nevojë për ngushëllim ngrohtësi dhe bamirësi. Por njerëzit nuk kujdesen për ta, madje i poshtërojnë dhe nuk u japin hakun. Kjo tregon se zemrat e tyre nuk njohin mëshirë dhe nuk synojnë shpërblim nga Zoti.

- "Nuk nxisni njëri-tjetrin për të ushqyer të varfërin..." – Nuk nxisni njëri-tjetrin për shkak të koprracisë dhe dashurisë së pamatë që keni për këtë dynja, e cila ka pushtuar çdo skutë të zemrave tuaja. Për shkak të kësaj makutërie:

- **"Ju e hani trashëgiminë me teprim dhe pa ngopje, dhe e doni pasurinë me një dashuri të tepruar."** – Dashuria e tyre për pasurinë është shumë e fortë, sikurse thotë i Madhërishmi në ajete të tjera, si: "Ju po i jepni përparësi jetës së kësaj bote, kur dihet se jeta e botës tjetër është më e mirë dhe e përjetshme". [El ea'la 16, 17]. Ose: "Ju doni atë të ngutshmen *(dynjanë)* dhe lini pas dore atë të ardhmen". [Kijame 20, 21].

Ajetet 21 – 30

21. Jo, mosni ashtu! Kur të dridhet toka njëpasnjëshëm!
22. Kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt të qëndrojnë radhë-radhë!
23. Ajo është dita kur do të sillet Xhehenemi. Atë ditë, njeriu ndërgjegjësohet, por atij nuk do t'i vlejë ky ndërgjegjësim?
24. Ai do të thotë: "Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time!"
25. Atë ditë, askush nuk mund të dënojë si Ai,
26. e askush nuk mund të lidhë me pranga si Ai.
27. O ti shpirt i bindur plotësisht!

28. Kthehu te Zoti yt, i kënaqur e i pranuar!
29. Hyr në turmën e adhuruesve të Mi!
30. Dhe hyr në Xhenetin Tim!

Shpjegimi i ajeteve

- "Jo, mosni ashtu! Kur të dridhet toka njëpasnjëshëm! Kur të vijë Zoti yt dhe engjëjt të qëndrojnë radhë-radhë!" – Pasuria, të cilën aq shumë e doni dhe dëshirat për arritjen e të cilave aq shumë garoni, nuk kanë për të mbetur gjatë. Përpara jush është një ditë e madhe, që ju pret, një tmerr i madh, që ka për t'ju përfshirë të gjithëve dhe gjithçka. Atë ditë, toka dhe gjithçka mbi të do të përplasen dhe tronditen fort, aq sa çdo gjë do të kthehet në pluhur dhe toka do të jetë e shtrirë, pa gropa dhe pa male në të. Atë ditë, do të vijë Allahu i Madhërishëm përmes hijeve të reve, do të vijnë melekët e mëdhenj dhe të nderuar dhe të gjithë banorët e qiellit do të vendosen në rreshta të rregullt. Melekët e çdo qielli do të vendosen në rreshtat e tyre, duke përfshirë krijesat poshtë tyre. Këto rreshta manifestojnë nënshtrimin dhe përuljen para pushtetit suprem të të Madhërishmit dhe Mbretëruesit të Plotpushtetshëm.

- "Ajo është dita kur do të sillet Xhehenemi. Atë ditë, njeriu ndërgjegjësohet, por atij nuk do t'i vlejë ky ndërgjegjësim?" - Xhehenemi do të tërhiqet me zinxhirë nga melekët, atë ditë të vështirë dhe të madhe. Njeriu do të shohë për të gjetur ndonjë vepër të mirë, nëpërmjet së cilës të shpëtojë nga ndëshkimi i Allahut të Madhërishëm. Të mirat dhe të këqijat do të dalin në shesh dhe njeriu do të shohë qartë se çfarë ka përgatitur për atë ditë. Atëherë, ai do të dëshirojë që të kthehet në dynja dhe të bëjë vepra të mira, por kurrë nuk do të mund të kthehet. Koha e pendimit mbaroi me dynjanë. Kështu, i dëshpëruar, njeriu do të thotë në dënesë:

- "Ai do të thotë: "Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time!"" – Kuptimi: Ah, sikur të kisha punuar dhe të isha përgatitur për këtë ditë të vështirë me vepra të mira, që të fitoja përjetësinë në kënaqësitë e ahiretit. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Ditën kur qielli të çahet nga një re dhe engjëjt të zbresin në një mënyrë madhështore. Atë ditë, sundimi i vërtetë i takon të Gjithëmëshirshmit. Për jobesimtarët ajo do të jetë një ditë e vështirë. Atë ditë, zullumqari do të kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "Oh, i mjeri unë, pse nuk ndoqa udhën e drejtë së bashku me Profetin!"O shkatërrimi im! Oh i mjeri unë të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, ai më largoi mua prej udhëzimit *(të Zotit)* pasi mu paraqit *(qartësisht dhe plotësisht).* Djalli është ai që njeriun e humb *(e devijon me mashtrim nga rruga e drejtë)* dhe e lë të vetmuar." [El furkan, 25 - 29]. Nga ky ajet mësojmë se jeta për të cilën robi duhet të përpiqet, është jeta e ahiretit, sepse ajo është e pasosur.

- "Atë ditë, askush nuk mund të dënojë si Ai, e askush nuk mund të lidhë me pranga si Ai." – Për ata që e kanë harruar atë ditë dhe nuk përgatiten për të, Allahu i Madhëruar ka përgatitur ndëshkim të dhembshëm. Ata do të lidhen në pranga prej zjarri dhe do të tërhiqen zvarrë për në zjarrin e ndezur fort të Xhehenemit. Ky do të jetë ndëshkimi i kriminelëve. Ndërsa atyre të cilët e kanë gjetur prehjen dhe qetësinë në adhurimin e Zotit, që e besojnë sinqerisht

Zotin dhe ndjekin rrugën e profetëve, atyre do t'u thuhet:

- "O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt, i kënaqur e i pranuar! Hyr në turmën e adhuruesve të Mi! Dhe hyr në Xhenetin Tim!" - Kuptimi: O ti shpirt i kënaqur me përkujtimin e Zotit dhe me dashurinë për Të! O ti shpirt që ke gjetur qetësinë duke adhuruar Zotin tënd! Kthehu te Zoti yt, që u kujdes për ty duke të dhuruar mirësi të shumta dhe mirësinë më të madhe: besimin, nëpërmjet të cilit u bëre pjesëtar i robërve të zgjedhur dhe të dashur të Zotit. Kthehu te Zoti dhe i Dashuri yt, tek Allahu i Madhërishëm! Kthehu i kënaqur me Zotin tënd, me mirësitë e shumta që Ai ka fshehur në Xhenet për ty! Kthehu te Zoti yt, që është i kënaqur prej teje!

- "Hyr në turmën e adhuruesve të Mi! Dhe hyr në Xhenetin Tim!" - Këto fjalë i drejtohen shpirtit në Ditën e Gjykimit dhe në momentin e vdekjes.

Falënderimi dhe lavdija e plotë i qofshin vetëm Allahut të Madhërishëm, Zotit të botëve!

Surja 90: El Beled (mekase) 20 ajete
Ajetet 1 – 20
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Betohem në këtë qytet,
2. kur ti gjendesh në këtë qytet!
3. Betohem në Babain dhe në ata që lindën prej tij!
4. Vërtet, Ne e krijuam njeriun për vështirësi të njëpasnjëshme.
5. A mendon ai, se atë nuk mund ta mposhtë kush?
6. Ai thotë: "Unë kam shpenzuar shumë pasuri!"
7. A mendon ai se nuk e ka parë kush?!
8. A nuk i dhamë atij dy sy?
9. Edhe gjuhë e dy buzë?
10. Dhe ia sqaruam atij të dyja rrugët.
11. Ndërsa ai nuk zgjodhi "rrugën e përpjetë".
12. E ku e di ti se ç'është "rruga e përpjetë"?
13. Ajo është lirimi i një skllavi,
14. ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria
15. ndonjë jetimi, që është i afërt,
16. ose ndonjë të varfëri, që e ka dëshpëruar varfëria.
17. Të bëhesh prej atyre që besojnë, që këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe që këshillojnë për të mëshiruar.
18. Këta janë të anës së djathtë.
19. Ndërsa ata që nuk i besojnë argumentet Tona, ata janë të së majtës.
20. Kundër tyre është Zjarri i mbyllur.

Shpjegim i ajeteve

- "Betohem në këtë qytet, kur ti gjendesh në këtë qytet! Betohem në Babain dhe në ata që lindën prej tij!" - Allahu i Lartësuar betohet në qytetin e sigurisë, në Mekën e nderuar, që është absolutisht vendi më i shenjtë dhe më i nderuar në botë. Rëndësia dhe shenjtëria e saj ishte më e madhe sidomos në kohën kur Profeti i zgjedhur i Zotit, Muhamedi (a.s.) ishte në të. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishëm betohet në Mekën kur në të ishte Profeti (a.s.). Ai betohet gjithashtu edhe në Ademin (a.s.) dhe pasardhësit e tij. Por për çfarë betohet i Lartësuari? Arsyeja e betimit vjen më poshtë, kur Allahu i Madhëruar thotë:

- "Vërtet, Ne e krijuam njeriun për vështirësi të njëpasnjëshme." - Ky ajet mund të shpjegohet në dy mënyra:

1. Njeriu është krijuar për të kaluar në sprova të njëpasnjëshme në jetën e dynjasë, në jetën e varrit dhe në Ditën e Gjykimit. Për këtë arsye, atij i duhet të punojë shumë për t'ia lehtësuar vetes këto vështirësi dhe për t'iu mundësuar arritja e lumturisë së përjetshme në kënaqësinë e Zotit. Nëse nuk e bën, atëherë ai ka për të qenë i rrethuar nga vuajtjet e vazhdueshme, derisa të përfundojë në ndëshkimin e përjetshëm në ahiret.

2. Njeriu është krijuar për vështirësi të njëpasnjëshme, domethënë, ai është krijuar i fortë dhe i aftë për të përballuar çdo punë të vështirë dhe të rëndë. Megjithatë, ai nuk tregohet falënderues dhe mirënjohës për këtë mirësi të dhuruar nga Zoti i tij. Përkundrazi, fuqinë dhe aftësitë e tij ai i përdor me arrogancë, duke u treguar mospërfillës ndaj Zotit që e ka krijuar. Me injorancën dhe padrejtësinë e tij, nga të cilat është i prirur, ai mendon se kjo gjendje do të jetë e vazhdueshme për të dhe kurrë nuk do t'i largohet, por i Lartësuari thotë:

- "A mendon ai, se atë nuk mund ta mposhtë kush?" - A mendon njeriu se nuk do të mposhtet kurrë, prandaj tregohet arrogant, prandaj lëvdohet ndër njerëz për pasurinë që ka harxhuar në përmbushjen e epsheve të tij:

- "Ai thotë: "Unë kam shpenzuar shumë pasuri!"" – Domethënë, ka shpenzuar pasuri të madhe në përmbushjen e dëshirave të tij të liga.

Kur flet për shpenzimin e pasurisë në harame, Allahu i Lartësuar përdor shprehjen "*ehlektu mâlen*", që, saktësisht, do të thotë: "kam prishur, kam shkatërruar shumë pasuri". Pra, shpenzimin e pasurisë në harame Zoti e ka konsideruar si të shkatërruar e të hedhur kot për shpenzuesin, sepse ajo pasuri i sjell shpenzuesit veçse trishtim, varfërim, lodhje dhe dëshpërim.

Ndryshe ndodh me atë që shpenzon pasurinë për të arritur kënaqësinë e Allahut. Ky person ka bërë tregti shumë fitimprurëse dhe lumturuese me Allahun Bujar dhe të Gjithëmëshirshëm. Ai ka për të fituar shumëfish nga ajo që shpenzon për hir të Tij. Më pas, duke kërcënuar ata që shkatërrojnë pasurinë e tyre për përmbushjen e epsheve në harame, Allahu i Lartësuar thotë:

- "A mendon ai se nuk e ka parë kush?!" - Si mendojnë këta të mjerë, që veprojnë në këtë mënyrë. Mos, vallë, mendojnë se Allahu nuk i ka parë dhe nuk di për veprat e tyre, të mëdha apo të vogla qofshin?! Mos mendojnë ata se nuk kanë për t'u llogaritur edhe për gjërat më të imëta? Jo, përkundrazi, e vërteta është krejt ndryshe dhe tepër e hidhur për ta. Allahu i Gjithëdijshëm dhe Gjithëshikues i ka parë të gjitha. Ai i ka regjistruar dhe ruajtur veprat e tyre. Për çdo njeri, Ai ka ngarkuar dy melekë të ndershëm dhe shkrues besnikë. Çdo gjë që robi ka vepruar, të mirë apo të keqe, është e regjistruar me saktësi në librin e vet.

Më pas, Allahu i Madhërishëm i kujton njeriut mirësitë që i ka dhuruar, me qëllim që të mendohet mirë për zgjedhjet që bën. Ai thotë:

- "A nuk i dhamë atij dy sy? Edhe gjuhë e dy buzë?" - Zoti e ka zbukuruar njeriun me këto mirësi, me qëllimin gjithashtu që të shikojë dhe të flasë. Ai i ka dhuruar edhe plot mirësi të tjera, të domosdoshme për

njeriun. Këto janë mirësitë e dynjasë, ndërsa për mirësinë e besimit dhe të fesë, Ai thotë:

- "Dhe ia sqaruam atij të dyja rrugët." - Zoti ia ka sqaruar njeriut rrugën e drejtë nga e gabuara, nëpërmjet shpalljeve dhe profetëve.

Për këto mirësi, robi duhet të jetë mirënjohës ndaj Dhuruesit dhe të angazhohet maksimalisht për të plotësuar detyrimet ndaj Tij. Ai duhet që t'i shfrytëzojë këto mirësi për të kënaqur Zotin dhe jo për të plotësuar dëshirat e veta në harame. Por këta lloj njerëzish nuk veprojnë në këtë mënyrë, siç thuhet më pas:

- "Ndërsa ai nuk zgjodhi "rrugën e përpjetë". E ku e di ti se ç'është "rruga e përpjetë"?" - Ata nuk ndjekin rrugën e drejtë, sepse u pëlqen të përmbushin dëshirat e veta. Rruga e drejtë është e vështirë për ta.

Më pas, Allahu i Madhërishëm përshkruan këtë rrugë të drejtë, të cilën të shfrenuarit në harame e konsiderojnë të vështirë për ta ndjekur:

- "**Ajo është lirimi i një skllavi..."** - Lirimi nga skllavëria bëhet ose duke e blerë lirinë e një skllavi, duke paguar shumën e kërkuar nga zotëria i tij, ose duke e ndihmuar të ashtuquajturin *el mukâtib* në pagesën e një pjese të çmimit të lirisë së tij. *El mukatib* quhet ai skllav që ka rënë dakord me padronin për ta blerë lirinë e vet kundrejt një shume të caktuar. Pa dyshim, në lirimin nga skllavëria bën pjesë edhe lirimi i muslimanëve të kapur robër nga qafirët, madje kjo është më parësore për t'u marrë në konsideratë.

- "...ose dhënia e ushqimit në kohën kur mbretëron uria ndonjë jetimi, që është i afërt, ose ndonjë të varfëri, që e ka dëshpëruar varfëria." - Të japësh ushqim dhe ndihmë pikërisht në ditët më të vështira, kur njerëzit janë tepër në nevojë. Ndihmën duhet ta përqendrosh më shumë në një kategori të caktuar njerëzish, siç janë jetimët, sidomos jetimët që i ke edhe të afërt në fis. Të ndihmosh njerëzit sipas nevojës dhe afërsisë farefisnore ka shpërblim më të madh.

Allahu i Madhëruar na nxit, gjithashtu, për të ndihmuar "*miskinen metrabeh*", që, fjalë për fjalë, do të thotë: një të vobektë, që nga nevoja e madhe, është shtrirë përdhe. Kështu, ne duhet të jemi bamirës ndaj krijesave pa mbështetje dhe që janë në nevojë.

Pastaj Allahu i Madhëruar jep një tjetër këshillë të vyer, duke thënë:

- "Të bëhesh prej atyre që besojnë, që këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe që këshillojnë për të mëshiruar." - Allahu i Madhëruar urdhëron për të patur këto cilësi të mrekullueshme:

1. Besim të vërtetë dhe të sinqertë në gjithçka që duhet besuar dhe të cilën Zoti e ka shpallur nëpërmjet Profetit të Tij.
2. Vepra të mira, me plot kuptimin e fjalës "të mira". Që puna të jetë e mirë, ajo duhet të kryhet me sinqeritet për të kënaqur Krijuesin dhe me mënyrën e përcaktuar nga Krijuesi, qoftë vepër e detyrueshme, qoftë e pëlqyeshme.
3. Të këshillojmë njëri-tjetrin për durim, në të tri aspektet e tij kryesore: durim për të zbatuar porositë e Zotit, durim për t'u ruajtur dhe larguar nga ndalesat e Zotit dhe durim ndaj caktimit të Zotit mbi ne, duke e

pranuar të kënaqur këtë caktim, pa ankesa dhe rebelim. Ne duhet të këshillojmë njëri-tjetrin për nënshtrim dhe vazhdimësi në rrugën drejt kënaqësisë së Allahut të Madhërishëm, për qetësi dhe siguri të plotë në ndihmën dhe mbështetjen e afërt të Tij.


4. Të këshillojmë njëri-tjetrin për të qenë mëshirues dhe të butë me krijesat, duke ndihmuar nevojtarët, duke mësuar të paditurit, duke udhëzuar të humburit, duke u shërbyer atyre në të gjitha drejtimet që kanë nevojë, duke i ndihmuar ata të rregullojnë çështjet e dynjasë dhe të fesë, duke dashur për të tjerët atë që e dëshirojmë për veten tonë dhe të urrejmë për ta atë që e urrejmë edhe për veten tonë.

Pikërisht ata që përpiqen dhe i plotësojnë këto cilësi i kanë hyrë asaj rrugë të vështirë, që do t'i nxjerrë në lumturi të paimagjinueshme. Këta janë ata që librin e veprave të tyre do ta marrin nga e djathta, siç thotë i Lartësuari:

- "Këta janë të anës së djathtë." – Arsyeja është se këta përpiqen që të plotësojnë detyrimet ndaj Zotit dhe ndaj krijesave. Ata, gjithashtu, largohen nga haramet e Zotit. Pikërisht kjo është rruga e lumturisë dhe kënaqësisë së përjetëshme.

Ndërsa ata që nuk ndjekin këtë rrugë, por zgjedhin mohimin dhe shpërfilljen e porosive të Zotit, ata kanë tjetër trajtim. I Madhëruari thotë:

- "Ndërsa ata që nuk i besojnë argumentet Tona, ata janë të së majtës. Kundër tyre është Zjarri i mbyllur." - Ata i shpërfillin dhe flakin pas shpine porositë dhe këshillat e Allahut. Ata nuk e besojnë Allahun dhe asgjë që Ai urdhëron të besohet. Ata nuk bëjnë vepra të mira sipas besimit të drejtë


الجزء الثلاثون
سورة الشمس سورة الليل
وَٱلَّذِينَ كَفَرُوا۟ بِـَٔايَـٰتِنَا هُمْ أَصْحَـٰبُ ٱلْمَشْـَٔمَةِ ﴿١٩﴾ عَلَيْهِمْ نَارٌ مُّؤْصَدَةٌ ﴿٢٠﴾
سُورَةُ الشَّمْسِ
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَـٰنِ ٱلرَّحِيمِ
وَٱلشَّمْسِ وَضُحَىٰهَا ﴿١﴾ وَٱلْقَمَرِ إِذَا تَلَىٰهَا ﴿٢﴾ وَٱلنَّهَارِ إِذَا جَلَّىٰهَا ﴿٣﴾
وَٱلَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰهَا ﴿٤﴾ وَٱلسَّمَآءِ وَمَا بَنَىٰهَا ﴿٥﴾ وَٱلْأَرْضِ
وَمَا طَحَىٰهَا ﴿٦﴾ وَنَفْسٍ وَمَا سَوَّىٰهَا ﴿٧﴾ فَأَلْهَمَهَا فُجُورَهَا
وَتَقْوَىٰهَا ﴿٨﴾ قَدْ أَفْلَحَ مَن زَكَّىٰهَا ﴿٩﴾ وَقَدْ خَابَ مَن دَسَّىٰهَا
﴿١٠﴾ كَذَّبَتْ ثَمُودُ بِطَغْوَىٰهَآ ﴿١١﴾ إِذِ ٱنۢبَعَثَ أَشْقَىٰهَا ﴿١٢﴾ فَقَالَ لَهُمْ
رَسُولُ ٱللَّهِ نَاقَةَ ٱللَّهِ وَسُقْيَىٰهَا ﴿١٣﴾ فَكَذَّبُوهُ فَعَقَرُوهَا فَدَمْدَمَ
عَلَيْهِمْ رَبُّهُم بِذَنۢبِهِمْ فَسَوَّىٰهَا ﴿١٤﴾ وَلَا يَخَافُ عُقْبَىٰهَا ﴿١٥﴾
سُورَةُ اللَّيْلِ
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَـٰنِ ٱلرَّحِيمِ
وَٱلَّيْلِ إِذَا يَغْشَىٰ ﴿١﴾ وَٱلنَّهَارِ إِذَا تَجَلَّىٰ ﴿٢﴾ وَمَا خَلَقَ ٱلذَّكَرَ وَٱلْأُنثَىٰٓ ﴿٣﴾
إِنَّ سَعْيَكُمْ لَشَتَّىٰ ﴿٤﴾ فَأَمَّا مَنْ أَعْطَىٰ وَٱتَّقَىٰ ﴿٥﴾ وَصَدَّقَ بِٱلْحُسْنَىٰ ﴿٦﴾
فَسَنُيَسِّرُهُۥ لِلْيُسْرَىٰ ﴿٧﴾ وَأَمَّا مَنۢ بَخِلَ وَٱسْتَغْنَىٰ ﴿٨﴾ وَكَذَّبَ بِٱلْحُسْنَىٰ ﴿٩﴾
٥٩٥

dhe nuk i mëshirojnë krijesat e Zotit. Këtyre do t'u jepet libri i veprave të tyre nga e majta, shenjë kjo se i pret ndëshkimi i dhembshëm. Ata i pret izolimi në Zjarr, ku do të jenë të mbyllur pas hekurash dhe kurrë nuk do të shpëtojnë prej tij. Ashtu të burgosur në Zjarr do të ndëshkohen dhe do të vuajnë të dëshpëruar.

Këtu përfundon komenti i sures Beled. Falënderimi i takon vetëm Allahut të Madhëruar!

Surja 91: Esh Shems (mekase) 15 ajete
Ajetet 1 – 15
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për Diellin dhe dritën e tij!
2. Për Hënën, që vjen pas tij!
3. Për ditën, kur ai e zbardh!
4. Për natën, e cila e mbulon atë!

5. **Për qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë!**
6. **Për Tokën dhe Atë që e sheshoi atë!**
7. **Për shpirtin dhe Atë që e krijoi atë!**
8. **Që i mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij.**
9. **Me siguri, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten!**
10. **Ndërsa ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten!**
11. **Themudi mohoi për shkak të arrogancës së vet**
12. **Kur më i keqi i tyre u ngrit me të shpejtë,**
13. **ndërkohë që Profeti u kishte thënë: "Kini kujdes Devenë e Allahut dhe mos e pengoni që të pijë ujë".**
14. **Por ata nuk e besuan dhe e therën atë. Atëherë, Zoti i tyre ua rreshtoi ndëshkimet, për shkak të gjynahut të tyre, dhe i rrafshoi.**
15. **Dhe Ai nuk u frikësohet aspak pasojave të atij ndëshkimi.**

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar betohet në këto shenja të mëdha të madhështisë së Tij, për të treguar përfundimin e shpirtmirëve dhe të shpirtkëqijve. Ai thotë:

- "Për Diellin dhe dritën e tij! Për Hënën, që vjen pas tij! Për ditën, kur ai e zbardh! Për natën, e cila e mbulon atë!" - Allahu i Lartësuar betohet fillimisht në Diellin dhe dritën e tij aq të dobishme për krijesat. Më pas, Ai betohet në Hënën, që e pason dritën e diellit dhe ndriçon botën natën. Pastaj Allahu i Lartësuar betohet në ditën, gjatë së cilës ndriçohet gjithçka në faqen e dheut, dhe në natën, gjatë së cilës errësohet gjithçka mbi të.

Këmbimi i ditës me natën, këmbimi i Diellit me Hënën sipas një rregulli të përpiktë, kujdesi ndaj krijesave duke u dhënë gjithçka që u nevojitet për një jetë normale, të gjitha këto tregojnë se Allahu i Lartësuar është i Dijshëm dhe i Pushtetshëm për gjithçka. Të gjitha këto tregojnë se Allahu i Lartësuar është i vetmi që meriton adhurimin e krijesave. Çdo adhurim i dedikuar dikujt tjetër veç Allahut është i kotë dhe i padrejtë.

- "Për qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë!" - Ky ajet mund të kuptohet në dy mënyra:
1. Për qiellin dhe Atë që e ndërtoi atë. Kështu, betimi është në qiellin dhe në Atë që e ndërtoi atë, domethënë Allahu i Madhërishëm betohet në Veten e Tij.
2. Për qiellin dhe atë rregull, me të cilin ai është ndërtuar.

Po me këto dy mënyra mund të kuptohen edhe betimet e mëposhtme:

- "Për Tokën dhe Atë që e sheshoi atë!" - Allahu i Madhëruar e shtroi Tokën dhe e bëri të përshtatshme për të jetuar lehtë në të. Ai u mundësoi krijesave të përfitojnë prej saj me të gjitha mënyrat.

- "Për shpirtin dhe Atë që e krijoi atë! Që i mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij." - Fjala "shpirt" mund të kuptohet në dy mënyra:
1. Si çdo shpirt i botës shtazore, të cilin Zoti e ka krijuar, sepse fjala "shpirt" përfshin gjithçka të asaj kategorie.
2. Si shpirti i njeriut dhe i xhindit, pra, i krijesave të përgjegjëshme ligjërisht, që do të merren në llogari. Këtë qëndrim e përforcon edhe vijimi i ajeteve.

Sidoqoftë, shpirti është një argument madhështor, që e meriton që Zoti të betohet në të. Shpirti është një krijesë e jashtëzakonshme e Allahut. Ai është aq i lehtë dhe i imët, i shpejtë në lëvizje dhe ndryshim, ai ndikohet dhe reagon shumë shpejt dhe në mënyrë të çuditshme. Ai bart në vete, ambicie, dëshira, pasione, synime, dashuri dhe urrejtje. Ai ndryshon dhe lëviz mes këtyre gjendjeve shumë natyrshëm. Nëse nuk do të ishte shpirti, trupi i njeriut do të ishte thjesht një statujë e pajetë dhe e padobishme. Kështu, krijimi i shpirtit, me të tilla cilësi dhe tipare, është një shenjë e madhe e madhështisë së Krijuesit të tij.

- "Me siguri, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten!" – Kuptimi: Ka shpëtuar ai që pastroi vetveten prej gjynaheve, ai që e ruajti veten prej mangësive, ai që e lartësoi veten nëpërmjet bindjes ndaj Zotit dhe adhurimit të Tij, që u pajis me dije të dobishme dhe që punoi sipas saj, në shenjë dashurie, madhërimi dhe nënshtrimi ndaj Zotit të tij.

- "Ndërsa ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten!" – Domethënë, e ka poshtëruar shpirtin e vet, këtë krijesë aq të vyer të Zotit, e cila kurrsesi nuk e meriton të përdhoset. Shpirti nuk duhet ngarkuar me gjynahe, por duhet pastruar me vepra e cilësi që e plotësojnë atë.

- "Themudi mohoi për shkak të arrogancës së vet. Kur më i keqi i tyre u ngrit me të shpejtë..." - Për shkak të arrogancës dhe kryeneçësisë ndaj të vërtetës, ata mohuan Profetin e tyre Salih dhe e shpërfillën porositë e tij. Ata e konsideruan Profetin si gënjeshtar dhe, me në krye me më të ligun e tyre Kidar Ibn Salif, ata ranë dakord për ta therur Devenë e paprekshme të Zotit.

- "...ndërkohë që Profeti u kishte thënë: "Kini kujdes Devenë e Allahut dhe mos e pengoni që të pijë ujë!"" - Ata ranë dakord ta shkelnin porosinë e Profetit Salih, edhe pse ai i kërcënoi që të mos e trazonin Devenë, të cilën Zoti e kishte sjellë si shenjë për vërtetësinë e Profetit të Tij. Përveç se një shenjë e madhe nga Zoti, Deveja ishte edhe begati, sepse ata përfitonin prej qumështit të saj. Kështu, ata nuk duhej ta shpërfillnin mirësinë e Zotit, sepse përndryshe do të ndëshkoheshin ashpër. Por me gjithë kërcënimin e bërë, ata e shkelën porosinë:

- "Por ata nuk e besuan dhe e therën atë. Atëherë, Zoti i tyre ua rreshtoi ndëshkimet, për shkak të gjynahut të tyre, dhe i rrafshoi." - Allahu i përfshiu ata me ndëshkim, duke u dërguar një britmë të madhe nga sipër dhe një tronditje nga poshtë. Ata u gdhinë kufoma të ftohta dhe të gjunjëzuara. Kështu, në atë vend nuk u dëgjua më asnjë zë që të lutej dhe asnjë zë që të përgjigjej. Allahu i rrafshoi mohuesit, duke i ndëshkuar të gjithë, pa përjashtim dhe pa dallim.

- "Dhe Ai nuk u frikësohet aspak pasojave të atij ndëshkimi." - E si të frikësohet Mbisunduesi dhe Nënshtruesi i gjithçkaje; asnjë krijesë nuk del jashtë sundimit të Tij. Allahu është i Urtë në çdo gjë që përcakton në gjithësi dhe në çdo ligj me të cilin ngarkon krijesat e Tij. Çdo vepër e Allahut është e drejtë dhe e urtë.

Këtu përfundon komenti i sures El shems. Falënderimi i takon vetëm Allahut!

Surja 92: El Lejl (mekase) 21 ajete
Ajetet 1 – 21
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për natën, që me errësirë mbulon gjithësinë!
2. Për ditën, kur ajo shkëlqen!
3. Për Atë që krijoi mashkullin e femrën!
4. Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme.
5. Atij që jep dhe ruhet,
6. që e beson me bindje të plotë më të mirën,
7. Ne do t'ia lehtësojmë atij më të lehtën.
8. Atij që tregohet koprrac dhe e ndien veten të pavarur,
9. që mohon më të mirën,
10. Ne do t'ia lehtësojmë atij më të vështirën,
11. ndërsa pasuria nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të shkatërrohet.
12. Është detyrë e Jona udhëzimi.
13. Vetëm e Jona është bota tjetër, edhe kjo.
14. Unë ju kam tërhequr vërejtjen për Zjarrin e ndezur fort.
15. Në të nuk hyn tjetërkush, veç më fatziu,
16. i cili mohon dhe sprapset.
17. Ndërsa më i devotshmi do të jetë larg tij;
18. ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet,
19. jo për të shpërblyer dikë, që i ka bërë mirë më parë,
20. por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit.
21. Pa dyshim, ai do ta gëzojë atë kënaqësi!

Shpjegim i ajeteve

Allahu i Madhëruar betohet në kohën e përbërë nga netët dhe ditët, përgjatë së cilave robërit bëjnë veprat e tyre të ndryshme, të mira apo të këqija. Ai thotë:

- "Për natën, që me errësirë mbulon gjithësinë! Për ditën, kur ajo shkëlqen!" - Allahu i Madhëruar betohet në natën, kur ajo mbulon krijesat me errësirën e saj dhe kur çdokush kthehet dhe gjen prehjen në folenë e vet. Robërit qetësohen nga angazhimet e shumta të ditës së shkuar dhe përgatiten për ditën që vjen, me forca dhe energji të reja. Ai betohet, gjithashtu, për ditën, kur ajo shkëlqen mbi krijesat, kur ata ndriçohen me dritën e saj dhe shpërndahen për të kërkuar nga mirësitë e Zotit.

- "Për Atë që krijoi mashkullin e femrën!" - Ky ajet mund të kuptohet në dy mënyra:
1. Për Atë që krijoi mashkullin e femrën! Pra, i Lartësuari betohet në Veten e Vet.
2. Për atë të cilën e krijoi mashkull dhe femër. Me këtë mënyrë të dytë vështrimi, i Lartësuari betohet në krijesat e Tij, të cilat Ai i ka bërë çift. Kjo tregon për urtësinë e Allahut në krijimin e gjallesave dhe të mënyrës se si ato të vazhdojnë të ekzistojnë. Që të sigurohet vazhdimësia e gjallesave, Ai i krijuar ato në meshkuj e femra dhe i ka pajisur me dëshirë të ndërsjelltë, ku njëra palë dëshiron tjetrën. I Madhëruar dhe i Lavdëruar qoftë Allahu, më i miri Krijues!

Të gjitha këto betime i Lartësuari i solli për të përforcuar faktin që:

- "Vërtet, veprat tuaja janë të ndryshme." - Veprat dhe përpjekjet tuaja, o njerëz dhe xhindë, që jeni të përgjegjshëm ligjërisht, janë të ndryshme dhe të llojllojshme. Ato dallojnë nga njëra-tjetra qoftë në drejtim të masës dhe cilësisë së tyre, qoftë edhe në drejtim të qëllimit me të cilin janë bërë. A synoni të kënaqni Allahun dhe të fitoni kënaqësinë e Tij, dhe kështu përpjekjet tuaja të jenë të frytshme dhe të shpërblyeshme në


përjetësi? Apo synoni këtë dynja dhe stolitë e saj, që do zhduken një ditë, e kështu edhe veprat tuaja të zhduken, sikurse objektivi juaj? I tillë është përfundimi i çdo vepre nëpërmjet së cilës nuk synohet kënaqësia e Allahut. Më pas, i Madhëruari bën dallimin mes dy rasteve, duke thënë:

- "Atij që jep dhe ruhet, që e beson me bindje të plotë më të mirën..." – Cilësitë e fatlumëve janë:

1. Ata japin. Domethënë, ata japin atë që e kanë për detyrë ta japin, qoftë ajo pasuri, siç janë zekati, detyrimet kompensuese, shpenzimet e detyrueshme nga Sheriati, qoftë adhurim trupor, si falja e namazit, agjërimi etj., qoftë adhurim i ndërthurur pasuror-trupor, si kryerja e haxhit, umres etj.
2. Ata ruhen. Domethënë, ata ruhen prej harameve të Zotit, duke mos shkelur kufijtë e Tij. Ata u ruhen gjynaheve, për hir të Zotit dhe në shenjë madhërimi, dashurie e nënshtrimi për Të.
3. Ata besojnë më të mirën me bindje të plotë. Kjo do të thotë që ata e besojnë me bindje të plotë dhe pa mëdyshje dëshminë e teuhidit "*Lâ ilâhe il-l'All-llâh*". Ata e dinë se çfarë nënkupton kjo dëshmi, ku bazohet ajo dhe u nënshtruan e jetuan sipas saj. Ata janë të sigurt për shpërblimin e tyre, nëse jetojnë dhe punojnë sipas kësaj dëshmie. Ky është besimi me bindje i "më të mirës".

Për këta, Allahu i Lartësuar ka dhënë këtë premtim të mrekullueshëm e qetësues:

- "...Ne do t'ia lehtësojmë atij më të lehtën." - Allahu i Gjithëmëshirshëm dhe i Gjithëdijshëm i premton kujtdo që pajiset me cilësitë e mësipërme se Ai do t'ia lehtësojë dhe thjeshtësojë arritjen e të mirave dhe do t'ia lehtësojë largimin nga të këqijat.


الجزء الثلاثون سورة الضحى سورة الشرح

فَسَنُيَسِّرُهُۥ لِلْعُسْرَىٰ ﴿١٠﴾ وَمَا يُغْنِى عَنْهُ مَالُهُۥٓ إِذَا تَرَدَّىٰٓ ﴿١١﴾ إِنَّ عَلَيْنَا
لَلْهُدَىٰ ﴿١٢﴾ وَإِنَّ لَنَا لَلْءَاخِرَةَ وَٱلْأُولَىٰ ﴿١٣﴾ فَأَنذَرْتُكُمْ نَارًا تَلَظَّىٰ ﴿١٤﴾
لَا يَصْلَىٰهَآ إِلَّا ٱلْأَشْقَى ﴿١٥﴾ ٱلَّذِى كَذَّبَ وَتَوَلَّىٰ ﴿١٦﴾ وَسَيُجَنَّبُهَا
ٱلْأَتْقَى ﴿١٧﴾ ٱلَّذِى يُؤْتِى مَالَهُۥ يَتَزَكَّىٰ ﴿١٨﴾ وَمَا لِأَحَدٍ عِندَهُۥ مِن نِّعْمَةٍ
تُجْزَىٰٓ ﴿١٩﴾ إِلَّا ٱبْتِغَآءَ وَجْهِ رَبِّهِ ٱلْأَعْلَىٰ ﴿٢٠﴾ وَلَسَوْفَ يَرْضَىٰ ﴿٢١﴾

سورة الضحى

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

وَٱلضُّحَىٰ ﴿١﴾ وَٱلَّيْلِ إِذَا سَجَىٰ ﴿٢﴾ مَا وَدَّعَكَ رَبُّكَ وَمَا قَلَىٰ ﴿٣﴾
وَلَلْءَاخِرَةُ خَيْرٌ لَّكَ مِنَ ٱلْأُولَىٰ ﴿٤﴾ وَلَسَوْفَ يُعْطِيكَ رَبُّكَ
فَتَرْضَىٰٓ ﴿٥﴾ أَلَمْ يَجِدْكَ يَتِيمًا فَـَٔاوَىٰ ﴿٦﴾ وَوَجَدَكَ ضَآلًّا فَهَدَىٰ
﴿٧﴾ وَوَجَدَكَ عَآئِلًا فَأَغْنَىٰ ﴿٨﴾ فَأَمَّا ٱلْيَتِيمَ فَلَا تَقْهَرْ ﴿٩﴾
وَأَمَّا ٱلسَّآئِلَ فَلَا تَنْهَرْ ﴿١٠﴾ وَأَمَّا بِنِعْمَةِ رَبِّكَ فَحَدِّثْ ﴿١١﴾

سورة الشرح

بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ

أَلَمْ نَشْرَحْ لَكَ صَدْرَكَ ﴿١﴾ وَوَضَعْنَا عَنكَ وِزْرَكَ ﴿٢﴾

٥٩٦

Ky është shpërblimi i tyre, sepse ata marrin të gjitha masat për të merituar një ndihmë dhe lehtësim të tillë nga Bujari i Gjithëmëshirshëm.

- "Atij që tregohet koprrac dhe e ndien veten të pavarur, që mohon më të mirën, Ne do t'ia lehtësojmë atij më të vështirën..." - E kundërta ndodh me ata që veprojnë ndryshe. Këta të mjerë kanë disa cilësi:

1. Ata tregohen koprracë, domethënë nuk japin atë që e kanë për detyrë ta japin. Ata shpërfillin shpenzimet, të detyrueshme apo të pëlqyeshme qofshin ato, duke e penguar veten që të kryejnë detyrimet ndaj Zotit.
2. Ata ndihen të pavarur nga Zoti dhe e braktisin adhurimin e Tij. Ata hiqen sikur nuk kanë nevojë për mëshirën dhe përkujdesjen e Zotit, ndërkohë që, në realitet, janë tejet të varur dhe të varfër,

jashtëzakonisht nevojtarë për mëshirën e të Gjithëmëshirshmit. Nuk ka asnjë mundësi tjetër për robin që të shpëtojë, të lumturohet dhe të arrijë gjithçka dëshiron, veçse duke qenë Allahu më i dashuri i zemrës së tij, duke qenë Ai i vetmi i Adhuruar, i vetmi të Cilit robi i përkushtohet me madhërim dhe nënshtrim, i vetmi të Cilit robi i mbështetet dhe i kërkon ndihmë, i vetmi kënaqësinë e të Cilit të synojë.

3. Ata mohojnë "më të mirën", domethënë nuk besojnë gjithçka që Zoti ka urdhëruar të besohet dhe të veprohet, nëpërmjet profetëve të Tij.

Zoti na tregon se këta do t'i zhysë në gjendjen dhe rrugët më të vështira, në cilësitë më të ulëta dhe më të shëmtuara. Këtyre do t'u lehtësohen rrugët e arritjes së të keqes, kudo dhe kurdo qoftë. Këtyre do t'u zbukurohet kryerja e poshtërsive.

E lusim Allahun të na ruajë dhe të na udhëzojë në rrugën e drejtë!

- "...ndërsa pasuria nuk do t'i bëjë dobi, kur ai të shkatërrohet." - Pasuria e tyre, nëpërmjet së cilës ata ndihen të pavarur, - prandaj i kalojnë kufijtë dhe i shkelin porositë e Zotit, - nuk ka për t'u bërë dobi kur të vdesin. Në jetën tjetër, vetëm veprat e mira bëjnë dobi. Ndërsa pasuria që nuk është pastruar nëpërmjet dhënies së zekatit ka për të qenë fatkeqësi dhe ndëshkim për ta. Njerëz të tillë nuk shpenzojnë prej pasurisë së tyre që të fitojnë ahiretin.

- "Është detyrë e Jona udhëzimi." - Udhëzim i vërtetë, i drejtë dhe i sigurt është vetëm ai që ofrohet prej Allahut, prandaj vetëm Allahut i duhet kërkuar udhëzimi. Ky udhëzim të afron drejt Allahut dhe bën të mundur kënaqësinë e Tij. Çdo rrugë tjetër është humbje dhe devijim, që përfundimin e ka në Zjarr, në ndëshkimin më të rëndë.

- "Vetëm e Jona është bota tjetër, edhe kjo." – Pushteti, mbretërimi, pronësia, e drejta dhe mundësia për të vepruar dhe administruar dynjanë dhe ahiretin janë vetëm në dorën e Zotit. Askush nuk ka mundësi dhe pushtet në këto drejtime. Prandaj, çdokush që synon ahiretin dhe dynjanë, le ta mësojë se ato janë tërësisht në dorën e Zotit dhe vetëm prej Tij duhen kërkuar. Vetëm tek Ai duhet shpresuar dhe vetëm me Të duhet të lidhen zemrat.

- "Unë ju kam tërhequr vërejtjen për Zjarrin e ndezur fort. Në të nuk hyn tjetërkush, veç më fatziu, i cili mohon dhe sprapset." - Xhenemi është një zjarr i ndezur fort, në të cilin do të ndëshkohen veçse fatzinjtë që kanë dy cilësi: ata nuk besojnë të vërtetën e Zotit dhe ata u kthejnë shpinën urdhrave dhe porosive të Zotit.

Ndërsa të shpëtuarit kanë të tjera cilësi:

- "Ndërsa më i devotshmi do të jetë larg tij; ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet..." - Qëllimi i adhurimeve dhe i shpenzimeve është pastrimi i shpirtit nga gjynahet dhe mangësitë, thjesht për të kënaqur Allahun e Lartësuar.

Nga kjo kuptohet se, po të bësh një shpenzim të pëlqyeshëm, duke shpërfillur një shpenzim të detyrueshëm, është e palejueshme. Kështu, për shembull, nëse nuk ke plotësuar nevojat e familjes, atëherë nuk ke pse të shpenzosh për drejtime të tjera. Ose, nëse ke borxhe dhe detyrime financiare të detyrueshme për të shlyer, atëherë nuk duhet të merresh me shpenzime të tjera veç këtyre. Jo vetëm që nuk është e

pëlqyeshme, por sipas shumë dijetarëve, ato janë shpenzime të papranueshme dhe të pashpërblyeshme nga Zoti, sepse shpirti nuk pastrohet duke kryer diçka të pëlqyeshme, që çon në lënien e një detyrimi.

- "...jo për të shpërblyer dikë, që i ka bërë mirë më parë, por vetëm për të fituar kënaqësinë e Zotit të vet, më të Lartit. Pa dyshim, ai do ta gëzojë atë kënaqësi!" - Këta të devotshëm nuk u lënë hapësirë njerëzve që të jenë bamirës ndaj tyre, sepse përpiqen që gjithmonë ta kthejnë të mirën me më të mirë. Ata u bëjnë mirë njerëzve më shumë sesa njerëzit bëjnë mbi ta. Ata janë vetëm robër të Zotit dhe të bamirësisë së Tij. Ata nuk e kërkojnë shpërblimin nga njerëzit, por vetëm nga Zoti. Nëse do të kishin ndonjë borxh dhe bamirësi pa shlyer ndaj krijesave, kjo do ta cenonte sadopak sinqeritetin e tyre në fjalë dhe në vepra. Por ata, përkundrazi, nuk u kanë asnjë borxh krijesave. Qëllimi i tyre i vetëm është vetëm Krijuesi dhe ata janë borxhlinj vetëm ndaj Bujarisë së Tij.

Ky ajet përfshin këdo që ka të tilla cilësi, edhe pse shkaku i shpalljes së tij është Ebu Bekri. Pra, ajeti bën fjalë në mënyrë të veçantë për Ebu Bekrin, - Allahu qoftë i kënaqur me të! Ai ishte një njeri tejet i devotshëm dhe i sinqertë me Zotin e tij, aq sa u quajt Ebu Bekër *el Siddik*, pra, i Sinqerti. Ai nuk ishte borxhli ndaj askujt, madje as ndaj vetë Profetit (a.s.), veç për mirësinë e profetësisë dhe ftesës në Islam, borxh të cilin askush prej krijesave nuk mund t'ia shlyejë atij. Megjithatë, ajo hyn në mirësinë e Allahut të Lartësuar, për të cilat krijesat i janë borxhli dhe kurrë nuk mund ta falënderojnë dhe lavdërojnë, ashtu sikurse e meriton Dhuruesi i saj, Allahu i Madhërishëm.

Atëherë, ashtu si Ebu Bekri, çdo adhurues i Zotit që ka këtë cilësi të vyer meriton të njëjtin shpërblim dhe gradë të lartë. Cila është kjo cilësi? Të jesh borxhli vetëm ndaj Zotit të Madhërishëm dhe i sinqertë vetëm për Të. Veprat e tua të mos kryhen për të shpërblyer dikë për mirësinë e tij ndaj teje, por vetëm për të kënaqur Zotin. Dhe kjo mund të realizohet plotësisht vetëm nëse krijesat i ke shpërblyer tërësisht për ndonjë mirësi që të kanë bërë, madje edhe më shumë se aq, dhe kështu veprat e tua të mira mbeten thjesht vetëm për Zotin e gjithësisë. Këta të sinqertë do të gëzohen dhe kënaqen me mirësitë dhe dhuratat, që Zoti do t'u japë.

Këtu përfundon komenti i sures El-lejl. Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!

Surja 93: Ed Duha (mekase) 11 ajete
Ajetet 1 – 11
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për kohën e paradites!
2. Për natën, që mbulon gjithçka!
3. Zoti yt nuk të ka braktisur, as nuk të ka urryer.
4. Bota e ardhshme është për ty shumë më e mirë se kjo e para.
5. Zoti yt do të të japë, e ti do të kënaqesh.
6. A nuk të gjeti ty jetim, e të bëri vend?
7. A nuk të gjeti të paudhëzuar, por të udhëzoi?
8. A nuk të gjeti të varfër, por të begatoi?
9. Jetimin kurrë mos e nënçmo!
10. Lypësin kurrë mos e përzë me vrazhdësi!
11. Ndërsa të mirat që të ka dhënë Zoti yt, tregoji!

Shpjegim i ajeteve

- "Për kohën e paradites! Për natën, që mbulon gjithçka!" - Allahu i Lartësuar betohet për atë kohë të ditës në të cilën shpërndahet dhe shkëlqen drita dhe ngrohtësia e saj. Më pas, Ai betohet në natën, kur errësira mbulon gjithçka. Me këto betime, i Madhëruari kërkon të tregojë përkujdesin e madh të Tij për Profetin e zgjedhur, prandaj Ai thotë:

- "Zoti yt nuk të ka braktisur, as nuk të ka urryer." – Kuptimi: Zoti yt kurrë nuk të ka lënë, por gjithmonë është përkujdesur për ty. Ai kurrë nuk të braktis, por përkujdeset dhe rregullon çështjet e tua më së miri. Ai do të të lartësojë gradë pas grade.

Gjithashtu, Zoti yt kurrë nuk do të të urrente, sepse të zgjodhi për të të dashur. Mohimi i urrejtjes nënkupton pohimin e nivelit më të lartë të të kundërtës së saj, sepse vetëm mohimi i diçkaje nuk konsiderohet lavdërim, veç nëse ai nënkupton pohimin e të kundërtës së saj.

Kjo ishte gjendja e Profetit, e shkuara dhe e tashmja e tij. Ai kishte dashurinë e plotë dhe përkujdesjen e vazhdueshme të Zotit të tij. Ai ishte vazhdimisht në rritje, për sa u përket gradave të tij të përsosmërisë si adhurues i Zotit. Ndërsa për sa i përket të ardhmes që e priste, i Lartësuari thotë:

- "Bota e ardhshme është për ty shumë më e mirë se kjo e para." – Për çdo moment që kalonte, gjendja e Profetit do të ishte më e mirë se e shkuara. Çdo çast që kalonte e gjente Profetin më lart në grada, më të epërm mbi armiqtë e tij dhe me fe më tepër dominuese. Kështu plotësohej mirësia dhe begatia e Zotit të tij mbi të, mbi fenë e tij dhe mbi umetin e tij, derisa ndërroi jetë. Kur ndërroi jetë, ai tashmë kishte arritur një gradë, që askush nga të parët dhe të fundit nuk e kishin arritur dhe as do të mund ta arrijnë.

Më pas, mos pyet për mirësinë dhe lumturinë që i është premtuar Profetit në ahiret. Allahu i Madhërishëm thotë:

- "Zoti yt do të të japë, e ti do të kënaqesh." - Nuk ka shprehje më të plotë për të treguar mirësitë e mëdha që i premtohen Profetit në ahiret, sesa kjo shprehje e dhënë nga i Madhërishmi. Pastaj Allahu i Lartësuar i përkujton Profetit të Tij mirësitë e veçanta që i dhuroi atij dhe përkujdesin e veçantë që tregoi për të në faza të ndryshme të jetës së tij:

- "A nuk të gjeti ty jetim, e të bëri vend?" - Kuptimi: Në kohën kur ti nuk kishe as nënë, as baba dhe kur nuk ishe në gjendje të kujdeseshe për veten tënde, i Madhërishmi u kujdes për ty, duke bërë të mundur që të të rriste gjyshi yt, Abdul Mutalibi. Kur vdiq gjyshi, kujdestaria i kaloi xhaxhait tënd, Ebu Talibit. Më pas, Allahu i Lartësuar e forcoi krahun tënd me ndihmën dhe mbështetjen e Tij të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet besimtarëve të shumtë.

- "A nuk të gjeti të paudhëzuar, por të udhëzoi?" - Ti nuk e dije se ç'është Shpallja dhe as imani. Zoti yt të mësoi atë që nuk e dije. Ai të bëri të gatshëm dhe të inspiroi që të bësh veprat më të mira dhe të stolisesh me virtytet më të larta.

- "A nuk të gjeti të varfër, por të begatoi?" - Ti ishe i varfër, por Zoti të pasuroi duke bërë që, për një kohë të shkurtër, pasuritë e

mbretërve dhe perandorëve të ishin nën këmbët e tua dhe të umetit tënd. Kështu, Ai që largoi prej teje këto mangësi, Ai do të përkujdeset vazhdimisht për ty. Ai që të pasuroi dhe të strehoi, Ai që të dha fitoren mbi çdo armik dhe të udhëzoi në rrugën më të ndritur, Ai meriton falënderimin, adhurimin dhe mirënjohjen tënde të thellë.


Mirënjohjen ndaj Tij shprehe me të gjitha format dhe mënyrat, mes të cilave:

- "Jetimin kurrë mos e nënçmo!" - Kurrë mos u sill keq me jetimin! Asnjëherë mos u bezdis dhe mos u ngushto me përkujdesin ndaj tij. Kurrë mos e nënçmo jetimin apo ta fyesh atë me fjalë rënduese, por nderoje dhe tregohu bujar me të, ashtu si të vijë më lehtë. Trajtoje jetimin ashtu si do të dëshiroje që të tjerët të trajtonin fëmijët e tu pas vdekjes tënde.

- "Lypësin kurrë mos e përzë me vrazhdësi!" - Kur t'i drejtohesh lypësit, kujdes! Mos e rëndo me fjalë dhe mos e përzë me vrazhdësi! Jepi lypësit, nëse ke mundësi, ose, në të kundërt, largoje me butësi dhe mirësjellje.

Këtu bëhet fjalë jo vetëm për kërkuesin e pasurisë dhe të mirave materiale, por për çdo lloj lypësi dhe kërkuesi, siç është edhe kërkuesi i diturisë. Për këtë arsye, mësuesi duhet të sillet me nxënësin me mirësjellje, me butësi, dashuri dhe ngrohtësi, sepse kjo ndihmon shumë në arritjen e synimit nga nxënësi. Mirësjellja është një ndihmë e madhe për ata që kërkojnë të rregullojnë shoqërinë dhe vendin.

- "Ndërsa të mirat që të ka dhënë Zoti yt, tregoji!" - Këtu bëhet fjalë për të mirat e fesë dhe të dynjasë. Kështu, kuptimi është:


الجزء الثلاثون
سورة التين سورة العلق
الذي أنقض ظهرك ﴿٣﴾ ورفعنا لك ذكرك ﴿٤﴾ فإن مع العسر يسرا ﴿٥﴾
إن مع العسر يسرا ﴿٦﴾ فإذا فرغت فانصب ﴿٧﴾ وإلى ربك فارغب ﴿٨﴾
سورة التين
بسم الله الرحمن الرحيم
والتين والزيتون ﴿١﴾ وطور سينين ﴿٢﴾ وهذا البلد الأمين ﴿٣﴾
لقد خلقنا الإنسان في أحسن تقويم ﴿٤﴾ ثم رددناه أسفل سافلين
﴿٥﴾ إلا الذين آمنوا وعملوا الصالحات فلهم أجر غير ممنون ﴿٦﴾
فما يكذبك بعد بالدين ﴿٧﴾ أليس الله بأحكم الحاكمين ﴿٨﴾
سورة العلق
بسم الله الرحمن الرحيم
اقرأ باسم ربك الذي خلق ﴿١﴾ خلق الإنسان من علق ﴿٢﴾ اقرأ
وربك الأكرم ﴿٣﴾ الذي علم بالقلم ﴿٤﴾ علم الإنسان
ما لم يعلم ﴿٥﴾ كلا إن الإنسان ليطغى ﴿٦﴾ أن رآه استغنى
﴿٧﴾ إن إلى ربك الرجعى ﴿٨﴾ أرأيت الذي ينهى ﴿٩﴾ عبدا
إذا صلى ﴿١٠﴾ أرأيت إن كان على الهدى ﴿١١﴾ أو أمر بالتقوى ﴿١٢﴾
٥٩٧

Lavdëroje Allahun për mirësitë që të ka dhuruar, duke i përmendur ato edhe në mënyrë të veçantë, nëse ka dobi në përmendjen e tyre. Ose thjesht fol dhe përmend mirësitë e përgjithshme që Allahu të ka dhuruar, sepse pohimi haptas i këtyre mirësive është një nxitës i madh për të qenë falënderues dhe mirënjohës ndaj Allahut dhe shton dashurinë për Të. Zemrat janë të prirura që ta duan atë që u bën mirësi.

Këtu përfundon komenti i sures Duha dhe, për këtë, falënderimi i takon vetëm Allahut!

Surja 94: El inshirah (mekase) 8 ajete
Ajetet 1 – 8
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. A nuk ta zgjeruam gjoksin tënd?!
2. A nuk të hoqëm barrën,
3. e cila rëndonte mbi shpinën tënde?!

4. **A nuk e ngritëm lart famën tënde?**
5. **Pa dyshim, bashkë me vështirësinë, vjen lehtësimi.**
6. **Vërtet, bashkë me vështirësinë, vjen lehtësimi.**
7. **Pasi të kesh përfunduar, atëherë, për hir të Zotit tënd, përpiqu,**
8. **dhe vetëm te Zoti yt përqendroje synimin!**

Shpjegim i ajeteve

Duke përmendur mirësitë më të cilat e begatoi dhe dalloi Profetin e Tij, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"A nuk ta zgjeruam gjoksin tënd?!"** - Zgjerimi i gjoksit nënkupton:
1. Bërjen e Profetit të denjë dhe të aftë për të pranuar dispozitat e fesë dhe për të ftuar njerëzit në rrugën e Allahut, në Islam.
2. Zbukurimin e shpirtit të tij me moralin më të lartë dhe me cilësitë më të vyera.
3. Aftësimin për devotshmëri, për të fituar ahiretin nëpërmjet adhurimeve të mrekullueshme.
4. Lehtësimin e çdo të mire dhe aftësimin e shpirtit të Profetit për t'i pranuar dhe kultivuar ato, ndryshe nga ç'ndodh me gjokset e ngushtuara dhe të rënduara, të cilët kurrsesi nuk nënshtrohen për të vërtetën dhe të mirën. Ata gjithmonë janë të shtrënguar ndaj mirësisë që u ofrohet.

- **"A nuk të hoqëm barrën, e cila rëndonte mbi shpinën tënde?!"** - Barra e përmendur këtu është pesha e gjynaheve. Pra, Allahu i Madhërueshëm e shkarkoi dhe lehtësoi Profetin e Tij nga barra e gjynaheve, duke ia falur të gjitha, sikurse thotë i Madhëruari në një ajet tjetër: "Ne të ty dhamë *(vendosëm për)* një fitore të sigurt. Që Allahu të ti mbulojë ty ato që kaluan prej gabimeve të tua dhe ato të mëvonshmet, ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj teje dhe të të udhëzojë ty në një rrugë të drejtë; dhe që Allahu të të ndihmojë ty me një ndihmë të fortë." [El fet'h 1 - 3].

- **"A nuk e ngritëm lart famën tënde?"** - Kuptimi: Ne e lartësuam gradën dhe famën tënde. Ti do të lëvdohesh dhe përkujtohesh gjithmonë me mirësi ndër njerëz në botë. Asnjë krijesë tjetër nuk do të gëzojë famën dhe lavdinë tënde. Sa herë që do të përkujtohet Allahu i Madhërishëm, së bashku me të do të përkujtohet edhe Profeti dhe adhuruesi i Tij i sinqertë, Muhamedi (a.s.). Kur pranon Islamin, njeriu shpreh shehadetin, kur thirret ezani dhe ikameti, përmendet shehadeti, nëpër hytbe përmendet shehadeti, e shumë e shumë raste të tjera. Domethënë, sa herë dëshmohet që Allahu është i vetmi i Adhuruar me meritë, dëshmohet gjithashtu se Muhamedi është Profeti dhe adhuruesi i sinqertë i Allahut. Dashuria e umetit për Profetin është një dashuri që askush nuk e ka për udhëheqësin e vet. Allahu e shpërbleftë, e nderoftë dhe e shtoftë lavdinë e Muhamedit (a.s.)!

- **"Pa dyshim, bashkë me vështirësinë, vjen lehtësimi. Vërtet, bashkë me vështirësinë, vjen lehtësimi."** - Ky është një përgëzim i madh dhe i mrekullueshëm. Sa herë që të ekzistojnë vështirësia dhe ngushtia, së bashku me to do të vijnë lehtësimi dhe zgjerimi. Edhe sikur vështirësia të struket dhe të fshihet në vrimën e hardhucës, edhe lehtësimi do të hyjë bashkë me të, për ta nxjerrë jashtë dhe për ta larguar, sikurse thuhet në një ajet tjetër: "Allahu, pas vështirësisë, do të sjellë lehtësim". Apo sikurse ka thënë edhe Profeti (a.s.): "Me të

vërtetë, çlirimi vjen së bashku me ngushtinë dhe, së bashku me vështirësinë, vjen lehtësimi.”.

Po të shohim me kujdes në ajet, fjala “*el usr*” – “vështirësi” është (në arabisht) në trajtën e shquar, që e nënkupton atë si një të vetme, ndërsa fjala “lehtësim” është (në arabisht) në trajtën e pashquar, që nënkupton se ai përsëritet. Pra, për çdo vështirësi, Zoti i Lartësuar sjell lehtësim pas lehtësimi. Kësisoj, një vështirësi nuk mund të jetë asnjëherë më e madhe se dy lehtësime. Gjithashtu, duhet të theksojmë se fjala “*el usr*”, e shoqëruar me nyjen ‘*el*’, sipas rregullave të arabishtes, ajo i përfshin të gjitha llojet e vështirësive, sado të mëdha dhe të pazgjithshme të mund të duken. Kështu, sido që të jetë, në fund të fundit, vështirësia do t’ia lërë vendin lehtësimit dhe çlirimit. Kjo është diçka e pashmangshme.

Më pas, Allahu i Madhërishëm e urdhëron Profetin dhe popullin e tij që të tregohen mirënjohës për mirësitë që Ai u ka dhuruar:

- “Pasi të kesh përfunduar, atëherë, për hir të Zotit tënd, përpiqu, dhe vetëm te Zoti yt përqendroje synimin!” - Kuptimi: Pasi të kesh përfunduar veprat dhe angazhimet e tua të shumta e të përditshme dhe kur të mos kesh pengesë për zemrën tënde, atëherë përqendrohu thellësisht në adhurim dhe në lutjet drejtuar Zotit tënd. Vetëm Zotit tënd përkushtoju dhe vetëm kënaqësinë e Tij syno! Ky është kusht, që adhurimet dhe lutjet e tua të pranohen nga i Madhërishmi.

Mos u bëj si ata që, kur mbarojnë angazhimet e tyre, zhyten në argëtime dhe pakujdesi, duke u larguar nga Zoti i tyre dhe përkujtimi i Tij. Kjo është rruga e të dështuarve dhe e humbësve.

Disa janë të mendimit se ajeti kuptohet kështu: “Pasi të kesh mbaruar namazin tënd, përkushtohu dhe përqendrohu në lutjen drejtuar Allahut të Madhërishëm. Vetëm Allahut përkushtoja lutjet dhe drejtoja kërkesat e tua”.

Në këtë ajet mbështeten ata që quajnë të lejuar bërjen e *dua*-së pas namazit farz, por Allahu është më i dijshëm për të vërtetën.

Këtu përfundon edhe komenti i sures Inshirah. Falënderimi i takon vetëm Allahut!

Surja 95: Et Tin (mekase) 8 ajete
Ajetet 1 – 8
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Për fikun dhe ullirin,
2. për Turi Sinain
3. dhe për këtë qytet të sigurisë!
4. Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur.
5. Pastaj do ta zbresim atë në më të ultin e të ultëve.
6. Përveç atyre që kanë besuar dhe bëjnë vepra të mira, të cilët do të kenë shpërblim të pandërprerë.
7. E pas gjithë kësaj, ç’të shtyu të mohosh Ditën e Shpërblimit?
8. A nuk është Allahu më i Urti i gjykuesve?

Shpjegim i ajeteve

- “Për fikun dhe ullirin, për Turi Sinain dhe për këtë qytet të sigurisë!” - Allahu i Madhërishëm betohet fillimisht në fikun dhe ullirin, sepse këto janë dy pemë shumë të dobishme për njerëzit dhe sepse ato kultivohen më së shumti në tokën e Shamit, vendin ku u shfaq Profeti i madh Isa, i biri i Merjemes. Pastaj i Madhërishmi betohet në

Turi Sinain ose në Malin e Sinait, i cili është vendi ku Musait (a.s.) iu shpall profetësia. Më pas vjen betimi në"qytetin e sigurisë", pra, në Mekën e nderuar dhe të bekuar, vendi ku Allahu i shpalli të zgjedhurit të Tij, Muhamedit (a.s.), profetësinë. Kështu, i Madhërishmi betohet në këto tre vende të shenjta, të cilat Ai i zgjodhi për të shpallur shpalljet më të mëdha dhe më të rëndësishme për njerëzimin.

Po përse betohet Allahu i Madhërishëm në këto vende? Përgjigjja vjen më poshtë:

- "Vërtet, Ne e krijuam njerin në formën më të bukur." – Allahu i Lartësuar e bëri njeriun një krijim të plotë e të bukur, me gjymtyrë të përshtatshme, me një trup të qëndrueshëm, të cilit i është mundësuar çdo gjë për të cilën ka nevojë, qoftë në aspektin e jashtëm të dukshëm, qoftë në aspektin e brendshëm.

Por me gjithë këto mirësi, të cilat Zoti i ka ofruar njerëzve, shumica e tyre nuk i shprehin Atij mirënjohjen, ashtu sikurse do duhej të vepronin. Ata janë të angazhuar në dëfrime dhe përjetimet mashtruese të kësaj jete dhe pranojnë që të bien në nivelet më të ulëta. Ata merren me gjëra të poshtra, që përlyejnë dhe prishin moralin dhe vlerat me të cilat Zoti i ka urdhëruar që të pajisen. Prandaj edhe i Madhëruari thotë:

- "Pastaj do ta zbresim atë në më të ultin e të ultëve." - Allahu i Lartësuar kërcënon se do t'i zhysë ata në vendin më të thellë në zjarrin e Xhehenemit. Atje është vendi i të gjithë kryeneçëve, që shpërfillin porositë e Zotit dhe nënshtrimin ndaj Tij.

Të shpëtuarit janë vetëm ata që Zoti u ka bërë mirësi duke u dhuruar besimin e drejtë dhe të cilët kanë punuar me atë besim, siç thotë i Lartësuari:

- "Përveç atyre që kanë besuar dhe bëjnë vepra të mira, të cilët do të kenë shpërblim të pandërprerë." - Këta Zoti i ka nderuar duke u dhuruar besimin e drejtë dhe moral të lartë. Zoti u premton atyre grada të larta dhe shpërblim të pandërprerë. Ata do të shijojnë kënaqësi të shumta dhe lumturi të përhershme, në përjetësi. Begatitë e tyre kurrë nuk do të mbarojnë, ushqimet e tyre do të vazhdojnë përjetësisht, e po ashtu edhe hijet e mrekullueshme ku do të qëndrojnë.

- "E pas gjithë kësaj, ç'të shtyu të mohosh Ditën e Shpërblimit?" - Pra, pas gjithë këtyre shenjave dhe fakteve të sjella nga i Gjithëdijshmi dhe i Plotpushtetshmi, cili është shkaku që të shtyn në mosbesim dhe në mospranim të Ditës së Llogarisë? Ato duhej që të të sillnin siguri të plotë për takimin me Allahun dhe për llogarinë e drejtë. Mirësitë dhe begatitë e shumta me të cilat Zoti të ka privilegjuar, duhej të nxisnin tek ti mirënjohjen dhe nënshtrimin për Dhuruesin. Të gjitha ato duhej të ishin një nxitje e fortë, që të mos mohoje asgjë për të cilën të ka njoftuar Allahu i Madhërishëm nëpërmjet Profetit të Tij.

- "A nuk është Allahu më i Urti i gjykuesve?" - Është jashtë logjike që Zoti të kishte krijuar robërit e Tij dhe pastaj t'i linte ata të braktisur, pa i urdhëruar e ndaluar, pa u vendosur kufij dhe rregulla dhe pa i marrë në llogari e shpërblyer, me drejtësinë dhe urtësinë e Tij. A mund të logjikohet që Allahu, i Cili e krijoi njeriun fazë pas faze, i Cili i dhuron atij mirësi pas mirësie, i Cili përkujdeset dhe e ndihmon atë në çdo hap,

dhe pastaj, në fund, ta lërë atë të humbasë në tokë, sikur të mos kishte ekzistuar kurrë? Jo, përkundrazi! Allahu i Madhërishëm do t'i kthejë njerëzit në një vend, ku do të qëndrojnë përgjithmonë, sipas asaj që kanë merituar dhe e synuar në jetën e dynjasë. Ai do t'i lërë përjetësisht në atë vend për të cilin janë përpjekur dhe e kanë zgjedhur për veten e tyre.

Këtu përfundon komenti i sures Tin. Falënderimi i takon vetëm Allahut!

Surja 96: El Alek (mekase) 19 ajete
Ajetet 1 – 19
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi.
2. Ai krijoi njeriun, prej një gjaku të ngjizur.
3. Lexo, se Zoti yt është më Bujari!
4. Ai që e mësoi të shkruajë me penë,
5. i mësoi njeriut atë që nuk e dinte.
6. Pa dyshim, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë,
7. për shkak se e ndien veten të pavarur.
8. Por, pa dyshim, vetëm te Zoti yt është kthimi.
9. A e ke parë atë që pengon
10. një adhurues, kur ai falet?
11. Ç'mendon ky, kur tjetri është në rrugë të drejtë,
12. ose kur është që urdhëron për sinqeritet?!
13. A e di ai se ç'ndodh, nëse mohon dhe kthen shpinën?
14. A nuk e di ai se Allahu e sheh?!
15. Jo, jo! Nëse nuk heq dorë, vërtet do ta rrëmbejmë prej ballukeve,
16. prej "ballukeve" mashtruese e gjynahqare.
17. Pastaj ai le të thërrasë ata të vetët!
18. Ndërsa Ne do t'i thërrasim zebanitë!
19. Jo, jo! Ti mos iu bind atij, por vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit me të!

Shpjegim i ajeteve

Kjo është surja e parë që i është shpallur Profetit (a.s.). Ajo është shpallur në hapat e para të profecisë, atëherë kur Muhamedi (a.s.) nuk e dinte çfarë ishte Libri i Zotit dhe as çfarë ishte imani. Në këtë kohë, atij i erdhi Xhibrili (a.s.) me Shpalljen hyjnore dhe e urdhëroi që të lexonte. Por Muhamedi (a.s.), i cili nuk dinte shkrim e këndim, i tha: "Unë nuk di të lexoj." Por Xhibrili vazhdoi të kërkonte prej tij që të lexonte, derisa në fund tha:

- "Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi. Ai krijoi njeriun, prej një gjaku të ngjizur."
- Është Allahu që, me pushtetin e Tij, ka krijuar gjithçka.

Pastaj Allahu i Lartësuar përmend në veçanti krijimin e njeriut dhe gjendjen e tij në fillim të krijimit, në barkun e nënës. Ai që e krijon njeriun në ato fazat të para, duke u kujdesur për të, pa dyshim do të kujdeset për të edhe në një drejtim tjetër shumë të rëndësishëm për lumturinë e tij. Ai do të kujdeset për njeriun duke i përcaktuar urdhëra dhe ndalesa, duke i vendosur program jete dhe adhurimi, duke i dërguar profetë dhe duke i shpallur libra. Pikërisht për këtë arsye, Zoti urdhëroi për të lexuar dhe, menjëherë më pas përmend faktin që Ai është Krijuesi, që kujdeset për krijesat e Tij. Kështu, domethënia është: Ju që jeni nevojtarë që Zoti të kujdeset për ju, duke ju krijuar ju dhe gjithçka që keni nevojë, po ashtu jeni nevojtarë, madje edhe më shumë, që të lexoni atë që Zoti ju ka shpallur, që të

mund të arrini lumturinë e plotë në dynja dhe në ahiret. Pastaj i Lartësuari thotë:

- "Lexo, se Zoti yt është më Bujari! Ai që e mësoi të shkruajë me penë, i mësoi njeriut atë që nuk e dinte." - Allahu është i cilësuar dhe emërtuar me cilësitë dhe emrat më të lartë. Bamirësia dhe bujaria e Tij janë të pakufishme dhe të gjera. Prej bujarisë së Allahut është edhe dija që i dhuron njeriut dhe aftësia për ta shkruar këtë dije. Allahu i Lartësuar e nxjerr njeriun nga barku i nënës, dhe në këtë gjendje njeriu është tërësisht i paditur. Por është Allahu i Madhërishëm dhe Bujar që e pajis atë me aftësinë për të parë, për të dëgjuar, për të arsyetuar e gjykuar. Është Allahu i Lartësuar Ai që ia lehtëson njeriut rrugët dhe mundësitë e diturisë dhe zhvillimit.

Allahu i mësoi njeriut Kuranin dhe Urtësinë Profetike. Ai i mësoi njeriut të shkruarit, nëpërmjet të cilit njeriu mund të ruajë diturinë dhe ta transmetojë ndër breza. Nëpërmjet shkrimit ruhen të pandryshuara të drejtat dhe detyrimet. Shkrimi është zëdhënësi më i mirë, në pamundësinë e të folurit. I Lavdëruar qoftë Allahu për të gjitha këto mirësi të mrekullueshme, për të cilat njeriu kurrë nuk do të mundë që ta lavdërojë Zotin e tij ashtu si e meriton dhe kurrë nuk do të mund t'i shprehë Atij mirënjohjen e plotë.

Është përsëri Allahu i Madhërishëm Ai që i begaton krijesat me pasuri, por njeriu, për shkak të natyrës së tij të prirur drejt injorancës dhe padrejtësisë, e sheh veten si të pavarur, prandaj i kalon kufijtë dhe i shkel të drejtat:

- "Pa dyshim, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë, për shkak se e ndien veten të pavarur. Por, pa dyshim, vetëm te Zoti yt është kthimi." - Njeriu shpërfill udhëzimin e Zotit, duke harruar se vetëm tek Ai do të jetë përfundimi. Për shkak të kësaj shpërfilljeje, njeriu nuk e ka frikë llogarinë para Zotit të tij.

Gjendja e njeriut mund të përkeqësohet aq shumë, saqë jo vetëm që e shpërfill udhëzimin e Zotit për veten e vet, por nxit edhe të tjerët që ta bëjnë një gjë të tillë, siç thotë i Lartësuari:

- "A e ke parë atë që pengon një adhurues, kur ai falet?" – Pra, ai pengon tjetrin të falë namaz, që është treguesi më i madh i imanit. Për të tillë njerëz të poshtër, Allahu i Madhërishëm thotë:

- "Ç'mendon ky, kur tjetri është në rrugë të drejtë, ose kur është që urdhëron për sinqeritet?!" - O ti njeri që ndalon robin që t'i falet Zotit të tij, si vepron në këtë mënyrë, kur robi të cilin po e ndalon është tërësisht i udhëzuar nga Zoti i tij, me dije të saktë rreth së vërtetës dhe punon sipas kësaj dijeje?! Si vepron në këtë mënyrë, kur ai të cilin ti e ndalon dhe e pengon është duke urdhëruar për devotshmëri ndaj Zotit, është duke urdhëruar për t'iu përmbajtur urdhrave dhe për t'iu larguar ndalesave, në shenjë madhërimi dhe dashurie për Zotin? Si arrin që një i tillë të pengohet dhe të luftohet?! Kjo vërtet konsiderohet si luftë kundër të vërtetës dhe kundër vetë Zotit.

Kjo ndalesë u drejtohet atyre të cilët nuk janë të udhëzuar dhe të cilët urdhërojnë për të kundërtën e devotshmërisë. Më tej, Allahu i Lartësuar i kërcënon këta lloj njerëzish, duke thënë:


- "A e di ai se ç'ndodh, nëse mohon dhe kthen shpinën? A nuk e di ai se Allahu e sheh?!" - A e di ai i mjerë, që kundërshton dhe lufton të vërtetën, se kjo që bën ai do të sjellë ndëshkimin e tij me vuajtje të padurueshme? A nuk frikësohet dhe të kthejë rrugë, sa nuk është vonë?! A nuk e di ai i mjerë, se Allahut nuk i shpëton asgjë dhe se Ai sheh çdo vepër dhe fjalë të robit. Llogaria me drejtësi është e pashmangshme dhe do të vijë shpejt.

Më tej, i Lartësuari e kërcënon këtë të mjerë se, nëse nuk ndalet nga këto vepra dhe nga lufta kundër të vërtetës dhe bartësve të saj, atëherë ajo që e pret është shumë e dhembshme:

- "Jo, jo! Nëse nuk heq dorë, vërtet do ta rrëmbejmë prej ballukeve, prej "ballukeve" mashtruese e gjynahqare." - Ai rrëmbim do të jetë shumë i ashpër. Vërtet, koka e meriton që të ndëshkohet, për shkak të gabimeve dhe mosbindjes së saj. Njeriu që është mashtrues në fjalët e tij dhe gjynahqar i rëndë në veprat e tij e meriton këtë ndëshkim të dhembshëm.

- "Pastaj ai le të thërrasë ata të vetët! Ndërsa Ne do t'i thërrasim zebanitë!" - Le të thërrasë ai që meriton këtë ndëshkim kë të dëshirojë, prej ushtrive dhe mbështetësve të tij. Ndërsa Allahu do të urdhërojë zebanitë, rojet e Xhehenemit, për të ekzekutuar ndëshkimin. Atëherë keni për ta parë se kush do të fitojë dhe kush është më i fuqishëm!

Kjo do të jetë gjendja e atij që lufton dhe pengon të vërtetën. Ndërsa besimtarin, atë të cilin e pengojnë dhe luftohet për shkak të së vërtetës, Allahu i Lartësuar e urdhëron që të


الجزء الثلاثون
سورة القدر
سورة البينة
أرءيت إن كذب وتولى ﴿١٣﴾ ألم يعلم بأن الله يرى ﴿١٤﴾ كلا لئن لم ينته
لنسفعا بالناصية ﴿١٥﴾ ناصية كذبة خاطئة ﴿١٦﴾ فليدع ناديه ﴿١٧﴾
سندع الزبانية ﴿١٨﴾ كلا لا تطعه واسجد واقترب ﴿١٩﴾ سجدة
سورة القدر
بسم الله الرحمن الرحيم
إنا أنزلناه في ليلة القدر ﴿١﴾ وما أدرىك ما ليلة القدر ﴿٢﴾
ليلة القدر خير من ألف شهر ﴿٣﴾ تنزل الملئكة والروح فيها
بإذن ربهم من كل أمر ﴿٤﴾ سلم هي حتى مطلع الفجر ﴿٥﴾
سورة البينة
بسم الله الرحمن الرحيم
لم يكن الذين كفروا من أهل الكتب والمشركين منفكين حتى
تأتيهم البينة ﴿١﴾ رسول من الله يتلوا صحفا مطهرة ﴿٢﴾ فيها كتب
قيمة ﴿٣﴾ وما تفرق الذين أوتوا الكتب إلا من بعد ما جاءتهم
البينة ﴿٤﴾ وما أمروا إلا ليعبدوا الله مخلصين له الدين
حنفاء ويقيموا الصلوة ويؤتوا الزكوة وذلك دين القيمة ﴿٥﴾
٥٩٨

mos ua verë veshin dhe të mos u nënshtrohet këtyre ndaluesve:

- "Jo, jo! Ti mos iu bind atij, por vazhdo me sexhde dhe afroju Zotit me të!" - Allahu i Lartësuar ndalon veçse nga ato gjëra të cilat sjellin shkatërrim në dynja dhe në ahiret. Pra, mos iu bind këtyre fatzinjve, por vazhdo të afrohesh tek Zoti yt me sexhde dhe me të gjitha llojet e adhurimit dhe bindjes ndaj Tij!

Ky ajet përfshin të gjithë llojet e ndaluesve dhe luftuesve të së vërtetës dhe të gjithë mbrojtësit dhe përhapësit e saj, edhe pse është shpallur fillimisht dhe flet në mënyrë të veçantë për Ebu Xhehlin, i cili pengonte Profetin (a.s.) nga namazi dhe nga përhapja e të vërtetës.

Këtu përfundon komenti i sures Alek. Falënderimi i takon vetëm Allahut!

Surja 97: El Kadr (mekase) 5 ajete
Ajetet 1 – 5
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit.
2. E ku mund ta dish ti se ç'është Nata e Kadrit?!
3. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj!
4. Në të zbresin engjëjt dhe Shpirti, me lejen e Zotit të tyre, për çdo çështje.
5. Paqe është ajo, deri në agim.

Shpjegimi i ajeteve

Duke treguar mirësinë dhe gradën e lartë të Kuranit, Allahu i Madhërishëm thotë:

- "Ne e zbritëm atë në Natën e Kadrit." - Në suren Duhan, ajetet 3 dhe 4, Allahu i Madhëruar e përshkruan këtë natë si "*mubârake*" - të begatshme e të bekuar. Ai thotë: "Ne e zbritëm atë në një natë *mubârake*. Ne gjithmonë ju kemi qortuar! Në atë (natë) vendoset çdo çështje në mënyrë të prerë." Dhe është shumë e vërtetë që Allahu i Madhërishëm e filloi shpalljen e Kuranit në muajin e Ramazanit, pikërisht natën e Kadrit. Kështu, Zoti i përfshiu robërit me një mëshirë të gjerë, për të cilën ata kurrë nuk do të mund ta falënderojnë dhe t'i shprehin mirënjohjen ashtu si e meriton. Ajo është quajtur Nata e Kadrit, për shkak të vlerës së madhe të saj. Në këtë natë, Allahu përcakton gjithçka do të ndodhë gjatë vitit, si afatin e jetës, rizkun e fëmijës etj.

Më tej, për t'i dhënë më shumë rëndësi çështjes së Natës së Kadrit, Allahu bën një pyetje:

- "E ku mund ta dish ti se ç'është Nata e Kadrit?!" - Ajo është një natë shumë e rëndësishme dhe dobia e saj është e jashtëzakonshme.

- "Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj!" - Ajo është më e vlefshme se një mijë muaj. Edhe veprat e mira të kryera gjatë saj janë më të vlefshme dhe më të mira se puna në një mijë muaj, në të cilat nuk do të ishte ajo natë.

Ky fakt çorodit arsyen e të mençurve dhe të urtëve, për bujarinë dhe mirësinë e madhe që Allahu i Madhërishëm i ka dhuruar këtij umeti. Me bujarinë e Tij, Ai ka bërë një natë, puna në të cilën është më e mirë dhe më e shpërblyeshme se puna në një mijë muaj, pa atë natë mes tyre. Pra, çdo pjesëtar i këtij umeti, nëse e kërkon atë natë, mund të marrë shpërblim për një vepër që as për 80 vjet jetë të mbushur me adhurime e vepra të mira nuk do t'ia arrinte.

- "Në të zbresin engjëjt dhe Shpirti, me lejen e Zotit të tyre, për çdo çështje." - Gjatë kësaj nate, duke filluar që nga perëndimi i diellit e deri në agim, melekët dhe Xhibrili shpeshtojnë zbritjen në tokë dhe ngjitjen prej saj.

Zoti e ka përshkruar dhe emërtuar atë natë si *selam* - paqe, për shkak se ajo është e pastër nga sherri dhe është e mbushur me mirësi dhe bekime:

- "Paqe është ajo, deri në agim." - Janë të shumta hadithet rreth mirësisë dhe dobisë së madhe të kësaj nate dhe faktit që ajo është në muajin e Ramazanit, madje në dhjetënetëshin e fundit të tij, e pikërisht në netët teke. Ajo përsëritet çdo vit, deri në Ditën e Gjykimit.

Për këtë arsye, gjatë këtyre dhjetë netëve të fundit të Ramazanit, Profeti (a.s.) hynte në *itikaf* dhe shtonte adhurimet, me shpresë që të arrinte shpërblimin e mrekullueshëm të kësaj nate. Por Allahu është më i ditur për gjithçka.

Surja 98: El Bejjine (medinase) 8 ajete
Ajetet 1 – 8
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Mohuesit prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarët nuk do të shkëputeshin, derisa t'u vinte argumenti i qartë:
2. i Dërguari prej Allahut, që lexon Fletë të Pastra,
3. në të cilat ka vetëm dispozita të drejta.
4. Ata të cilëve iu dha Libri u përçanë vetëm pasi u erdhi argumenti i qartë.
5. Ndërkohë, ata nuk ishin të urdhëruar për gjë tjetër, përveçse që të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë dhe të përkushtuar ndaj Tij, duke qenë *hunefae*, të falnin namazin, të jepnin zekatin, se kjo është feja e drejtë.
6. S'ka dyshim se ata ithtarë të Librit dhe idhujtarë, të cilët nuk besojnë, do të futen në zjarrin e Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.
7. Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ata janë krijesat më të mira.
8. Shpërblimi për ta është te Zoti i tyre, në Xhenetet e Adnit, nëpër të cilët burojnë lumenj, e ku do të jenë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ta, por edhe ata janë të kënaqur me Të. Kjo është për ata që i druhen Zotit të tyre.

Shpjegimi i ajeteve

- **"Mohuesit prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarët nuk do të shkëputeshin, derisa t'u vinte argumenti i qartë..."** - Ithtarët e Librit, të krishterë apo jehudë qofshin, dhe idhujtarët e çdo kategorie, do të vazhdonin të mos i ndaheshin rrugës së tyre të gabuar të idhujtarisë dhe mohimit të Zotit, derisa Ai t'u sillte fakte të qarta dhe argumente bindëse.

Pastaj i Madhëruari tregon se çfarë argumenti u solli popujve për të gjetur rrugën e drejtë:

- **"...i Dërguari prej Allahut, që lexon Fletë të Pastra, në të cilat ka vetëm dispozita të drejta."** - Argumenti i qartë që udhëzon në rrugën e drejtë ishte një profet, të cilit Zoti do t'i shpallte një libër e që do t'i ftonte njerëzit në të vërtetën dhe të drejtën. Këtë libër ai do t'ua lexonte njerëzve, për t'u mësuar atyre Urtësinë, për të pastruar shpirtrat e tyre dhe për t'i nxjerrë nga errësirat në dritë.

I Madhërishmi e ka cilësuar Librin e Tij si "*Suĥufen Mutahherah*" - Fletë të Pastra. Pra, ai është një libër i pastër nga çdo e metë dhe atij nuk mund t'i afrohen shejtanët. Atë e prekin veçse të pastrit, sepse është fjala e më të Lartit, që asgjë nuk mund t'i afrohet për nga madhështia, rëndësia dhe begatia.

I Madhërishmi thotë gjithashtu për librin e Tij që: "...ka vetëm dispozita të drejta.". Të vërteta janë historitë e tij, të padiskutueshme janë parashikimet e tij, të drejta janë dispozitat e tij. Ai udhëzon në rrugën e drejtë.

Me ardhjen e këtij libri, do të dallohej qartë kërkuesi i sinqertë i së vërtetës nga mashtruesi dhe shtiracaku. Pas dërgimit të Profetit dhe shpalljes së librit të Tij, çdokush do të mësojë të vërtetën dhe nuk do të ketë më justifikim tek i Madhëruari. Ai që do të besojë do ta bëjë këtë me dije e siguri të

plotë, ndërsa ai që do të mohojë do ta bëjë këtë me vetëdije të plotë, jo për shkak të paditurisë dhe paqartësisë, sepse ky libër nuk lë asgjë pa shpjeguar dhe qartësuar prej çështjeve të besimit dhe udhëzimit.

Nëse ndodh që ithtarët e Librit nuk e besojnë Kuranin, dijeni se kjo nuk është ndonjë gjë e re. Devijimi që ata preferojnë dhe inati i tyre gjithmonë i ka çuar në përçarje dhe armiqësi, edhe pas qartësimit të së vërtetës me fakte të qarta dhe argumente bindëse. I Madhërishmi thotë:

- "Ata të cilëve iu dha Libri u përçanë vetëm pasi u erdhi argumenti i qartë." - Argumentet e qarta normalisht duhet të sjellin unitet, por për shkak të prirjeve të sëmura që kanë, atyre u shtohet edhe më tepër devijimi; drita e argumenteve të qarta ua shton edhe më shumë verbërinë. Ky është shpjegimi i vetëm i refuzimit të tyre, sepse librat hyjnorë kanë të gjithë të njëjtin burim, Zotin e gjithësisë. Në çdo shpallje të Tij, Zoti ka urdhëruar për fenë dhe besimin e drejtë, që çojnë në bashkimin e njerëzve. Të gjithë profetët kanë dhënë të njëjtat udhëzime dhe kanë predikuar të njëjtën fe, siç thotë i Lartësuari më pas:

- **"Ndërkohë, ata nuk ishin të urdhëruar për gjë tjetër, përveçse që të adhuronin Allahun me një adhurim të sinqertë dhe të përkushtuar ndaj Tij, duke qenë *hunefa*, të falnin namazin, të jepnin zekatin, se kjo është feja e drejtë."** - Urdhri i parë dhe i përhershëm është: adhurim i sinqertë dhe me përkushtim veçse për Allahun e Madhërishëm. Të gjitha adhurimet t'i përkushtohen vetëm Allahut dhe askujt tjetër, në shenjë dashurie e përunjësie, me frikërespekt dhe duke shpresuar kënaqësinë dhe shpërblimin e Tij bujar në të dyja jetët.

Urdhri i dytë është për të qenë *hunefa*, pra, besimtarë të vërtetë në njësimin e Zotit, të distancuar nga çdo besim që largohet nga teuhidi dhe praktikon idhujtarinë.

Urdhri i tretë është për namazin dhe zekatin. Edhe pse këto dy adhurime i përfshin edhe urdhri i parë, ato janë përmendur veçmas, për shkak të rëndësisë dhe vlerës së tyre të lartë dhe sepse mbi këto dy adhurime mbështeten të gjitha adhurimet e tjera të Islamit.

Atëherë, kjo është feja e drejtë, kjo është udha e sigurt, që të shpie në Xhenetin e mirësive të përjetëshme. Çdo rrugë tjetër veç saj të çon në humbje, të çon në zjarrin e Xhehenemit.

Më pas, Allahu i Madhëruar tregon për ndëshkimin e mohuesve dhe të pabindurve, të cilët e shpërfillin të vërtetën, edhe pas qartësimit të saj:

- "S'ka dyshim se ata ithtarë të Librit dhe idhujtarë, të cilët nuk besojnë, do të futen në zjarrin e Xhehenemit, ku do të jenë përgjithmonë." - Ata do të ndëshkohen në zjarrin e Xhehenemit, i cili do t'i përfshijë dhe mbulojë tërësisht brenda tij dhe do t'i stërmundojë me përvëlimin e tij. Atje do të qëndrojnë përgjithmonë dhe kurrë nuk do t'u lehtësohet ndëshkimi. Ata do të jenë të përjetshëm në ndëshkim dhe të pashpresë për shpëtim apo lehtësim.

- "Ata janë krijesat më të këqija." – Janë të tillë, sepse pasi e kanë njohur të vërtetën, e shpërfillin dhe e refuzojnë atë, duke shkatërruar në këtë mënyrë dynjanë dhe ahiretin e tyre.

- "Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, ata janë krijesat më të mira." - Janë të tillë, sepse ata e njohin Allahun dhe e adhurojnë Atë, duke fituar kështu mirësitë dhe lumturinë e dynjasë dhe të ahiretit.


- "Shpërblimi për ta është te Zoti i tyre, në Xhenetet e Adnit, nëpër të cilët burojnë lumenj, e ku do të jenë përgjithmonë." - Ata do të jenë në Xhenete të përjetshme, ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Atje nuk do të kenë lodhje dhe kurrë nuk do të largohen. Atje do të jenë në mirësi, nga të cilat kurrë nuk do të velen dhe nuk do të dinë të kërkojnë më shumë e më mirë sesa janë. Nëpër kopshtet e tyre do të rrjedhin lumenj dhe ata do të shijojnë të lumtur çdo mirësi të dhuruar nga Bujari i Madh.

- "Allahu është i kënaqur me ta, por edhe ata janë të kënaqur me Të. Kjo është për ata që i druhen Zotit të tyre." - Allahu është i kënaqur me ta, për bindjen dhe adhurimin e tyre të sinqertë për Të, sikurse Ai i mësoi dhe i udhëzoi nëpërmjet profetëve. Edhe ata janë të kënaqur me Allahun, për mirësitë dhe dhuratat e shumta që Ai u jep.

Këto shpërblime të mrekullueshme u premtohen vetëm atyre që i druhen Zotit të tyre dhe i nënshtrohen Atij me respekt, duke zbatuar porositë e Tij, në shenjë dashurie dhe madhërimi për Të, dhe duke u larguar nga haramet që ka caktuar Ai.

Këtu përfundon komenti i sures Bejjine. Falënderimi dhe lavdërimet i qofshin vetëm Allahut të Madhëruar!


Surja 99: Ez Zelzele (medinase) 8 ajete
Ajetet 1 – 8
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!



1. Kur të tronditet toka, me një dridhje të fuqishme!
2. Kur toka të nxjerrë atë që mban në barkun e saj!
3. Kur njeriu të thotë: "Çfarë ka kjo?!"
4. Atë ditë, ajo rrëfen historitë e veta,
5. sepse Zoti yt e ka urdhëruar atë.
6. Atë ditë, njerëzit shfaqen të ndarë në grupe, që të shpërblehen për veprat e tyre.
7. Kush ka bërë ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë!
8. Dhe kush ka bërë ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë!

Shpjegimi i ajeteve

- "Kur të tronditet toka, me një dridhje të fuqishme!" - Allahu i Lartësuar na tregon për atë që do të ndodhë Ditën e Kijametit. Toka do të tronditet fort, derisa çdo ndërtesë apo gjë e ngritur mbi të të sheshohet. Malet


الجزء الثلاثون
سورة القارعة سورة التكاثر
إِنَّ ٱلْإِنسَٰنَ لِرَبِّهِۦ لَكَنُودٌ ۝٦ وَإِنَّهُۥ عَلَىٰ ذَٰلِكَ لَشَهِيدٌ ۝٧ وَإِنَّهُۥ لِحُبِّ
ٱلْخَيْرِ لَشَدِيدٌ ۝٨ أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعْثِرَ مَا فِى ٱلْقُبُورِ ۝٩
وَحُصِّلَ مَا فِى ٱلصُّدُورِ ۝١٠ إِنَّ رَبَّهُم بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّخَبِيرٌۢ ۝١١
سورة القارعة
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
ٱلْقَارِعَةُ ۝١ مَا ٱلْقَارِعَةُ ۝٢ وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا ٱلْقَارِعَةُ ۝٣ يَوْمَ
يَكُونُ ٱلنَّاسُ كَٱلْفَرَاشِ ٱلْمَبْثُوثِ ۝٤ وَتَكُونُ ٱلْجِبَالُ
كَٱلْعِهْنِ ٱلْمَنفُوشِ ۝٥ فَأَمَّا مَن ثَقُلَتْ مَوَٰزِينُهُۥ ۝٦ فَهُوَ فِى
عِيشَةٍ رَّاضِيَةٍ ۝٧ وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَٰزِينُهُۥ ۝٨ فَأُمُّهُۥ هَاوِيَةٌ
وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا هِيَهْ ۝١٠ نَارٌ حَامِيَةٌۢ ۝١١
سورة التكاثر
بِسْمِ ٱللَّهِ ٱلرَّحْمَٰنِ ٱلرَّحِيمِ
أَلْهَىٰكُمُ ٱلتَّكَاثُرُ ۝١ حَتَّىٰ زُرْتُمُ ٱلْمَقَابِرَ ۝٢ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ۝٣ ثُمَّ
كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ ۝٤ كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ ٱلْيَقِينِ ۝٥ لَتَرَوُنَّ ٱلْجَحِيمَ ۝٦
ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ ٱلْيَقِينِ ۝٧ ثُمَّ لَتُسْـَٔلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ ٱلنَّعِيمِ ۝٨
٦٠٠

dhe kodrat do të fshihen nga faqja e dheut dhe toka do të shndërrohet e tëra në një sipërfaqe të sheshtë e të ndritshme, pa gropa apo male.

- "Kur toka të nxjerrë atë që mban në barkun e saj!" - Toka do të nxjerrë gjithçka që mban barku i saj, siç janë të vdekurit apo thesaret që fshihen brenda saj.

- "Kur njeriu të thotë: "Çfarë ka kjo?!"" - Kur njeriu të shohë se çfarë do t'i ndodhë tokës atë ditë, do të thotë i tmerruar: "Ç'po ndodh sot me këtë tokë?!"

- "Atë ditë, ajo rrëfen historitë e veta, sepse Zoti yt e ka urdhëruar atë." - Atë ditë toka do të dëshmojë për gjithçka që bota ka punuar mbi shpinën e saj, të mira apo të këqija qofshin. Atë ditë, edhe toka, ashtu si shumë dëshmitarë të tjerë, do të dëshmojë për veprat e robërve, sepse ky është urdhri i Zotit të saj, dhe ajo kurrsesi nuk mund ta thyejë urdhrin e Tij.

- "Atë ditë, njerëzit shfaqen të ndarë në grupe, që të shpërblehen për veprat e tyre." – Ditën e Kijametit, kur Zoti të gjykojë njerëzit, ata do të jenë të ndarë në grupe veç e veç. Allahu i Lartësuar do t'i bëjë ato grupe që t'i shohin vetë veprat e tyre, të mira apo të këqija qofshin, dhe pastaj do t'u japë shpërblimin e merituar. Askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi, as sa një thërmijë, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "Kush ka bërë ndonjë të mirë që peshon sa grimca, atë do ta gjejë! Dhe kush ka bërë ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë!" - Llogaria e Zotit është absolutisht e drejtë. Asaj nuk i shpëton asnjë lloj pune, sado e vogël qoftë ajo, e mirë apo e keqe. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "Atë ditë, çdo njeri do të gjejë pranë vetes ato vepra të mira që vetë ka bërë. Ndërsa për të këqijat që ka bërë, do të dëshirojë që, në mes tij dhe tyre, të jetë një distancë shumë e madhe. Allahu ju paralajmëron me dënimin që vjen prej Tij. Por Allahu është shumë i Mëshirshëm ndaj robërve." [Al Imran 30]. Ose: "Kur libri t'u vihet përpara, ti do t'i shohësh gjynahqarët të frikësuar nga shënimet në të, të cilët do të thonë: "Të mjerët ne! Ç'qenka ky libër, që nuk paska lënë asnjë vepër të madhe apo të vogël pa e shënuar?!" Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë bërë. Zoti yt nuk i bën padrejtësi askujt." [Kehf 49].

Surja 100: El Adijat (mekase) 11 ajete
Ajetet 1 – 11
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Për vrapuesit e shpejtë, që hingëllijnë,**
2. **që me thundrat e tyre nxjerrin xixëllima nga gurët!**
3. **Ata të cilët vërsulen herët në agim,**
4. **duke ngritur pluhurin përpjetë,**
5. **dhe ashtu hidhen mu në mes të turmës.**
6. **Vërtet, njeriu ndaj Zotit të vet është përbuzës,**
7. **dhe për këtë ai është dëshmues.**
8. **Dashurinë për pasuri ai e ka shumë të madhe,**
9. **por a nuk e di ai se kur të dalin jashtë ato çfarë varret mbajnë,**
10. **dhe kur të dalin në shesh ato çfarë fshihen në kraharorë,**
11. **atë ditë, vërtet, Zoti i tyre i di me hollësi veprat e tyre!**

Shpjegimi i ajeteve

- "Për vrapuesit e shpejtë, që hingëllijnë, që me thundrat e tyre nxjerrin xixëllima nga gurët! Ata të cilët vërsulen herët në agim, duke ngritur pluhurin përpjetë, dhe ashtu hidhen mu në mes të turmës." - Allahu i Lartësuar betohet në kuajt, në këto krijesa të mrekullueshme dhe aq të çmuara për njerëzit, për cilësitë e veçanta që kanë. Allahu betohet edhe për gjendjet nëpër të cilat kuajt kalojnë, ndryshe nga kafshë të tjera. Kuajt vrapojnë furishëm dhe gjatë këtij vrapimi ata hingëllijnë. Kur me thundrat dhe potkonjtë e tyre të fortë shkelin nëpër gurë, ata nxjerrin xixëllima. Kuajt, me luftëtarët sipër tyre, lëshohen si shigjetë në mes të turmës së armikut. Këto momente dhe veprime janë ato në të cilat betohet Allahu i Lartësuar.

Ndërsa shkaku i betimit tregohet më poshtë, kur i Lartësuari thotë:

- "Vërtet, njeriu ndaj Zotit të vet është përbuzës..." - Njeriu nuk shpreh mirënjohjen ndaj Zotit, për mirësitë që Ai i ka dhënë. Për nga natyra e tij, ai nuk e dëshiron shpenzimin dhe nuk pranon që t'i plotësojë detyrimet e tij plotësisht. Ai është përtac dhe koprrac, që gjithmonë përpiqet t'u bëjë bisht detyrimeve pasurore apo trupore, me të cilat është ngarkuar. Këtu bëjnë përjashtim ata që Zoti i ka udhëzuar dhe i ka pastruar nga të tilla cilësi të këqija.

- "...dhe për këtë ai është dëshmues." – Cilit i referohet përemri vetor "ai"? Mundësitë janë:
1. "Ai" është njeriu. Në këtë rast, kuptimi i ajetit është: Për këtë mosmirënjohje edhe vetë njeriu është dëshmues dhe nuk e mohon një fakt të tillë. Kjo është një çështje e dukshme dhe e pamohueshme, që çdokush mund ta vërejë.
2. "Ai" është Allahu. Kështu, kuptimi i ajetit del: Për këtë mosmirënjohje është Allahu dëshmitar. Ky është një kërcënim i ashpër dhe i rëndë për ata që tregohen mosmirënjohës ndaj mirësive të Zotit dhe mospërfillës ndaj detyrimeve dhe përgjegjësive karshi Tij. Allahu është dëshmitar i këtyre veprave dhe çdokujt do t'i japë shpërblimin e merituar.

- "Dashurinë për pasuri ai e ka shumë të madhe..." - Dashuria e njeriut për pasuri është shumë e fortë. Është pikërisht kjo dëshirë e papërmbajtur që e bën atë të shpërfillë detyrimet dhe përgjegjësitë ndaj Zotit. Kështu ai i jep përparësi plotësimit të dëshirave të vetes, kundrejt të drejtave të Zotit të tij. Kjo ndodh për shkak se ai është dritëshkurtër dhe i lidhur ngushtë vetëm me këtë dynja, duke qenë i pavëmendshëm ndaj

ahiretit. Prandaj Allahu i Lartësuar, për të nxitur te robi frikën për Ditën e Llogarisë, thotë:

- **"...por a nuk e di ai se kur të dalin jashtë ato çfarë varret mbajnë, dhe kur të dalin në shesh ato çfarë fshihen në kraharorë..."** - Le të kujtojnë këta të mashtruar se do të vijë dita kur të gjithë të vdekurit do të dalin nga varret e tyre, do të ringjallen dhe do të tubohen para Zotit, për t'u llogaritur me drejtësi. Atë ditë do të shfaqet sheshazi çdo gjë që fshihet brenda gjokseve të tyre, e mirë apo e keqe qoftë, dhe të gjithë do të shijojnë frytet e veprave të tyre.

- **"...atë ditë, vërtet, Zoti i tyre i di me hollësi veprat e tyre!" -** Allahu i Lartësuar është i Dijshëm për të gjitha veprat e robërve, të fshehta apo të shfaqura, të vogla apo të mëdha qofshin, dhe Ai ka për t'i shpërblyer ata me drejtësi. Ai është i Dijshëm jo vetëm atë ditë, por në të gjitha ditët, por ky veçim është bërë për të treguar se krijesat do të shpërblehen për çdo vepër të kryer. Ajo është Dita e Llogarisë nga i Gjithëdijshmi.

Surja 101: El Kariah (mekase) 11 ajete
Ajetet 1 – 11
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Krisma!**
2. **Çfarë është Krisma?**
3. **Ku mësove ti se ç'është Krisma?**
4. **Ajo është dita kur njerëzit do bëhen si insekte të shpërndara**
5. **dhe malet do të bëhen si lesh i shprishur.**
6. **Ai që do ta ketë të rëndë peshoren e veprave të tij,**
7. **ai do të bëjë një jetë të këndshme.**
8. **Ndërsa ai që do ta ketë të lehtë peshoren e veprave të tij,**
9. **ai e ka vendin në Hauijeh.**
10. **Ku mësove ti se ç'është Hauijeh?**
11. **Ai është zjarri me nxehtësi shumë të lartë.**

Shpjegimi i ajeteve

"Krisma" është një prej emrave të Ditës së Kijametit. Ajo do të jetë një ditë e tmerrshme për krijesat, prandaj dhe i Lartësuari, për të treguar rëndësinë dhe madhështinë e kësaj dite, thotë:

- **"Krisma! Çfarë është Krisma? Ku mësove ti se ç'është Krisma? Ajo është dita kur njerëzit do bëhen si insekte të shpërndara..."** - Atë ditë, nga frika e madhe, njerëzit do të lëvizin si të ishin insekte të shpërndarë, valë-valë njëri mbi tjetrin. "*El ferash*", siç thuhet në këtë ajet, janë fluturat e natës, të cilat lëvizin në mënyrë të çrregullt, duke u përplasur me njëra-tjetrën, pa ditur nga drejtohen. Nëse ndizet një zjarr, ato nxitojnë për tek ai, pa e ditur se çfarë i pret. E tillë do të jetë gjendja e njerëzve.

Ndërsa për malet e larta dhe aq të forta, Allahu i Lartësuar thotë:

- **"...dhe malet do të bëhen si lesh i shprishur."** – Malet do të bëhen si leshi i shprishur, i cili fluturon tutje nëse fryn qoftë edhe një erë e lehtë. Në një ajet tjetër, i Lartësuari thotë: "Ditën kur i fryhet Surit, do të tmerrohet çdokush që gjendet në qiej dhe në tokë, përveç atyre që Allahu do. Të gjithë do t'i vijnë Atij të përulur. Ti i shikon malet dhe mendon se janë të palëvizshëm, por ata lëvizin si retë. E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai është i Gjithëdijshëm për atë që punoni". [Neml 87, 88].

Më pas, malet kthehen në pluhur, i cili shpërndahet në ajër, dhe kështu nuk mbetet më asgjë prej maleve. Atë ditë do të vendoset peshorja e drejtë për veprat e robërve, të cilët do të ndahen në dy grupe: të lumturit dhe të dëshpëruarit.

- "Ai që do ta ketë të rëndë peshoren e veprave të tij, ai do të bëjë një jetë të këndshme. Ndërsa ai që do ta ketë të lehtë peshoren e veprave të tij, ai e ka vendin në Hauijeh." – Atyre që do t'u peshojnë më tepër veprat e mira se veprat e këqija, atyre do t'u jepet një jetë e kënaqshme dhe e pasosur në Xhenet. Ndërsa për ata të cilët nuk do të kenë aq vepra të mira sa të fshijnë veprat e këqija, do të jetë Zjarri vendqëndrimi i tyre, një nga emrat e të cilit është edhe Hauije. Zjarri do të jetë i përhershëm për ta, sepse kurrë nuk kanë për t'u larguar nga ai vend.

Disa kanë thënë se kuptimi i këtij ajeti është: "Ata do të hidhen me kokë poshtë në Zjarr."

- "Ku mësove ti se ç'është Hauijeh? Ai është zjarri me nxehtësi shumë të lartë." - Kjo është thënë për të treguar fuqinë e këtij zjarri, nxehtësia e të cilit është shumë e madhe. E lusim Allahun e Lartësuar të na ruajë nga zjarri i Xhehenemit!

Surja 102: Et Tekathur (mekase) 8 ajete
Ajetet 1 – 8
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ju ju angazhon përpjekja për shumim,
2. derisa të "vizitoni" varrezat.
3. Jo, nuk është ashtu! Gjithsesi, këtë do ta kuptoni më vonë!
4. Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni!
5. Jo, po ta dinit me siguri.
6. Ju patjetër do ta shihni Xhehenemin.
7. Madje, do ta shihni dhe do të bindeni plotësisht për të.
8. Pastaj, atë ditë, do të pyeteni për të mirat.

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar e fillon këtë sure me një qortim drejtuar robërve që angazhohen me mbledhjen e pasurisë dhe të stolive të kësaj dynjaje, në vend që të angazhohen për qëllimin për të cilin janë krijuar. Allahu i Lartësuar i krijoi njerëzit dhe xhindët me të vetmin qëllim: që ta adhurojnë Atë si Një të vetëm, pa i shoqëruar asgjë në këtë adhurim. Ai i krijoi ata që të angazhohen për ta njohur Atë me emrat, cilësitë dhe atributet e Tij të shkëlqyera. Allahu i krijoi ata që gjithmonë të kthehen tek Ai të penduar, të bindur dhe të nënshtruar dhe gjithmonë t'i japin përparësi dashurisë për Të kundrejt çdo dashurie tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

- "Ju ju angazhon përpjekja për shumim, derisa të "vizitoni" varrezat." – Kuptimi: Ju u morët me gjëra të tjera, duke u shmangur nga qëllimi i lartë për të cilin Zoti ju krijoi.

Këtu nuk përcaktohet se për çfarë shumimi bëhet fjalë, dhe kështu ai i përfshin të gjitha llojet e shumimit të cilat i synon robi, si: shumimi i pasurisë, i fëmijëve, i aleatëve, i ushtarëve, i shërbëtorëve, i miqësive etj., me të cilët nuk synohet kënaqësia e Allahut të Lartësuar dhe sinqeritetit ndaj Tij.

Ky angazhim i tyre zgjat deri kur të vijë dita që ata të "vizitojnë varrezat". Në këtë çast, atyre do t'u hiqet perdja nga sytë dhe

do të shohin qartë. Por tashmë nuk do të jetë më i mundur kthimi prapa.

Vëreni me kujdes! Allahu i Lartësuar thotë: "...derisa të "vizitoni" varrezat", gjë që tregon qartë se jeta e varrit është vetëm një urë kalimi mes kësaj dynjaje dhe botës së përjetshme. Njeriu do të jetë në varr vetëm përkohësisht, para se të shkojë, sipas veprave që ka bërë, atje ku e meriton: ose përjetësisht në Xhenet, ose përjetësisht në Zjarr. Më pas, i Lartësuari paralajmëron:

- "Jo, nuk është ashtu! Gjithsesi, këtë do ta kuptoni më vonë! Përsëri jo, jeni gabim! Më vonë do ta kuptoni! Jo, po ta dinit me siguri." - Nëse do të ishit të bindur se çfarë ju pret, nuk do të harroheshit pas shtimit të stolive të kësaj dynjaje, por do të nxitonit pa humbur kohë në kryerjen e veprave të mira. Mungesa e bindjes suaj ju bën të harroheni në rendjen pas kësaj dynjajeje.

- "Ju patjetër do ta shihni Xhehenemin. Madje, do ta shihni dhe do të bindeni plotësisht për të." - Kuptimi: Është absolutisht e sigurt që ju do ta përjetoni Kijametin dhe do ta shihni Zjarrin e ndezur fort, të cilën Allahu i Lartësuar e ka përgatitur për qafirët. Ju do ta shihni Zjarrin me sytë tuaj dhe atëherë nuk do të keni asnjë dyshim për ndëshkimin që i pret jobesimtarët. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "Kriminelët do ta shohin Zjarrin dhe do të binden se do të hidhen në të; ata nuk do të gjejnë shtegdalje prej tij." [Kehf 53].

- "Pastaj, atë ditë, do të pyeteni për të mirat." - Kuptimi: Për të gjitha mirësitë që keni marrë në dynja, Allahu i Lartësuar do t'ju marrë në përgjegjësi: a u treguat mirënjohës për to, duke i dhënë Allahut të Lartësuar hakun që i takon, apo i shfrytëzuat ato të mira për të bërë poshtërsi ndaj Allahut dhe për të mos iu bindur Atij? Nëse jeni treguar mirënjohës dhe e keni adhuruar Atë si Një të vetëm, atëherë me të vërtetë ju i keni shfrytëzuar këto mira në mënyrë të drejtë, prandaj dhe Allahu i Lartësuar do t'ju dhurojë të mira dhe begati më të shumta dhe më të mrekullueshme se ato. Por nëse ju u vetëmashtruat me luksin e kësaj dynjaje dhe nuk treguat mirënjohje ndaj Atij që jua dhuroi, madje i përdorët ato për ta kundërshtuar Allahun e Lartësuar dhe për të kryer poshtërsi të ndaluara prej Tij, atëherë Ai do t'ju ndëshkojë për këtë. Allahu i Lartësuar thotë: "Ditën kur jobesimtarët të dalin para Zjarrit (u thuhet): "Ju i shfrytëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe u kënaqët me to, ndërsa sot do të shpërbleheni me dënimin poshtërues, për shkak të arrogancës që treguat në tokë, pa të drejtë, dhe për shkak se nuk respektuat urdhrat e Zotit". [Ahkaf 20].

Surja 103: El Asr (mekase) 3 ajete
Ajetet 1 – 3
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!


1. Për kohën!
2. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.
3. Me përjashtim të atyre që besojnë, që bëjnë vepra të mira, që porosisin njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshillojnë njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.

Shpjegimi i ajeteve

- "Për kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt." - Allahu i Lartësuar betohet në kohën, e cila përbëhet

nga netët dhe ditët, nëpër të cilat kalon jeta e njeriut. Përgjatë kohës, robërit kryejnë veprat e tyre, për të cilat do të merren në përgjegjësi. Kësisoj, ky është betim tepër i rëndësishëm.

Allahu i Lartësuar bën këtë betim për të përforcuar faktin se njeriu është në një humbje të sigurt. Humbja është e kundërta e suksesit. Ajo është, gjithashtu, e niveleve të ndryshme. Robi mund të jetë në humbje të plotë, nëse ka humbur dynjanë dhe ahiretin, nëse humb shpërblimin e Allahut të Lartësuar dhe meriton ndëshkimin në zjarrin e Xhehenemit. Por robi mund të jetë edhe në humbje të pjesshme, që prek vetëm disa aspekte, në varësi të veprave dhe përkushtimit të tij. Prandaj Allahu i Lartësuar është betuar se asnjë njeri nuk shpëton nga humbja, përveç atyre që kanë katër cilësi:


الجزء الثلاثون
سورة العصر سورة الهمزة سورة الفيل
سورة العصر
بسم الله الرحمن الرحيم
وَالْعَصْرِ ﴿١﴾ إِنَّ الْإِنسَانَ لَفِي خُسْرٍ ﴿٢﴾ إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا
وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَاصَوْا بِالْحَقِّ وَتَوَاصَوْا بِالصَّبْرِ ﴿٣﴾
سورة الهمزة
بسم الله الرحمن الرحيم
وَيْلٌ لِّكُلِّ هُمَزَةٍ لُّمَزَةٍ ﴿١﴾ الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ ﴿٢﴾
يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ ﴿٣﴾ كَلَّا لَيُنبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ ﴿٤﴾
وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ ﴿٥﴾ نَارُ اللَّهِ الْمُوقَدَةُ ﴿٦﴾ الَّتِي تَطَّلِعُ
عَلَى الْأَفْئِدَةِ ﴿٧﴾ إِنَّهَا عَلَيْهِم مُّؤْصَدَةٌ ﴿٨﴾ فِي عَمَدٍ مُّمَدَّدَةٍ ﴿٩﴾
سورة الفيل
بسم الله الرحمن الرحيم
أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ ﴿١﴾ أَلَمْ يَجْعَلْ
كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ ﴿٢﴾ وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ ﴿٣﴾
تَرْمِيهِم بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ ﴿٤﴾ فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ ﴿٥﴾
٦٠١

- "Me përjashtim të atyre që besojnë, që bëjnë vepra të mira, që porosisin njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshillojnë njëri-tjetrin të jenë të durueshëm." – Së pari, ata kanë besimin, domethënë besojnë gjithçka që Allahu i Lartësuar ka urdhëruar të besohet. Por besimi duhet të jetë i ndërtuar mbi dije të saktë dhe të sigurt, të shpallur nga Zoti.

Së dyti, ata bëjnë vepra të mira, të cilat duhen sipas atij imani që u tha më parë, të mbështetur në dije. Këtu futen të gjitha veprat e mira, të dukshme dhe të fshehta, ato që kanë lidhje me të drejtën e Zotit dhe ato që kanë lidhje me të drejtën e krijesave, veprat e mira të detyrueshme dhe ato që janë të pëlqyeshme.

Së treti, ata këshillojnë njëri-tjetrin për t'iu përmbajtur së vërtetës. Por cila është kjo e vërtetë? Ajo është besimi i bazuar mbi dije të saktë dhe veprat e mira sipas atij besimi, me sinqeritet për Zotin.

Së katërti, ata këshillojnë njëri-tjetrin për të qenë të durueshëm në bindjen ndaj Zotit, duke kryer porositë e Tij, të durueshëm ndaj gjynaheve, duke mos iu afruar atyre, dhe të durueshëm ndaj përcaktimeve të dhembshme të Allahut të Madhëruar mbi ta. Me dy cilësitë e para, njeriu rregullon dhe plotëson veten e vet. Ndërsa me dy të fundit, ai rregullon dhe plotëson të tjerët. Me plotësimin e këtyre katër cilësive, mund të thuhet se njeriu nuk ka për të humbur, por ka për të arritur fitoren e madhe.

Surja 104: El Humeze (mekase) 9 ajete
Ajetet 1 – 9
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Mjerë për atë që ofendon e përqesh,

2. **i cili ka mbledhur pasuri dhe e ruan, që të mos i pakësohet.**
3. **Ai mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm.**
4. **Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të flaket në Hutame.**
5. **E ku mund ta dish ti se ç'është Hutame?!**
6. **Është zjarri i Allahut, i ndezur fort,**
7. **që depërton deri në zemër.**
8. **Ai i mbyll ata, ua zë frymën.**
9. **Ndërsa ata do të jenë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme.**

Shpjegimi i ajeteve

- **"Mjerë për atë që ofendon e përqesh..."** - Mjerë ata që kanë këto cilësi të ulëta, për ndëshkimin e rëndë që i pret. Ata përqeshin dhe tallen me njerëzit, me fjalë dhe me veprime. *Humeze* është ai që i fyen dhe i tall njerëzit nëpërmjet veprimeve të tij, ndërsa *lumeze* është ai që e bën këtë me fjalë.

- **"...i cili ka mbledhur pasuri dhe e ruan, që të mos i pakësohet. Ai mendon se pasuria e tij do ta bëjë të përjetshëm."** - Prej cilësive të këtyre njerëzve është edhe lakmia e madhe për grumbullimin e pasurisë. I vetmi qëllim dhe shqetësim i tyre është mbledhja e pasurisë, ruajtja e saj që të mos pakësohet dhe mburrja me të. Ata nuk mendojnë asnjëherë që ta shpenzojnë atë për bamirësi, për mbajtjen e lidhjeve farefisnore etj. Nga injoranca e tyre, ata mendojnë se pasuria do t'i bëjë të përjetshëm në shijimin e mirësive të kësaj dynjaje. Për këtë arsye, të gjithë mundin dhe aftësitë e tyre i shpenzojnë për të grumbulluar dhe ruajtur pasurinë. Ata shpresojnë se pasuria do të zgjasë edhe jetën e tyre, por nuk e dinë të mjerët se koprracia e shkurton jetën dhe i pakëson begatitë e saj, si edhe i shkatërron popujt.

- **"Jo, të mos mendojë ashtu! Se ai patjetër do të flaket në Hutame."** - Mendimi i tyre është i gabuar, prandaj nëse nuk kthehen nga ajo rrugë, do të hidhen në Hutame.

Pastaj, për të treguar tmerrin e madh të këtij zjarri, i Lartësuari bën pyetjen:

- **"E ku mund ta dish ti se ç'është Hutame?!"** - Vetëm Ai që e ka krijuar mund ta dijë realisht dhimbjen që ajo fsheh brenda saj. Në vijim, i Madhërishmi shpjegon se çfarë është Hutame:


- **"Është zjarri i Allahut, i ndezur fort, që depërton deri në zemër. Ai i mbyll ata, ua zë frymën. Ndërsa ata do të jenë të lidhur në pranga të njëpasnjëshme."** - Lënda djegëse e këtij zjarri janë njerëzit dhe gurët. Aq e fortë është nxehtësia e tij, saqë ajo depërton deri thellë në zemër. Ata do të jenë të izoluar brenda kësaj nxehtësie dhe pa shpresë se mund të dalin ndonjëherë prej saj. Pas portave, janë vendosur kangjella të larta, që ata të mos dalin jashtë. I Lartësuari thotë në një ajet tjetër: "Ndërsa për ata që i kalojnë kufijtë, skutë e tyre është Zjarri. Sa herë që tentojnë të dalin nga ai, ata kthehen mbrapsht duke iu thënë: "Shijoni dënimin e Zjarrit, që ju e konsideronit gënjeshtër". [Sexhde 20].

E lus Allahun të na ruajë nga ky përfundim dhe të na ruajë nga çdo vepër që e bën atë të merituesheim!

Surja 105: El Fil (mekase) 5 ajete
Ajetet 1 – 5
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me zotëruesit e Elefantit?**

2. **A nuk ua bëri përpjekjen të dështuar?**
3. **Ai lëshoi kundër tyre shpendë, që erdhën tufa-tufa**
4. **dhe që i gjuajtën ata me gurë prej baltës së pjekur,**
5. **duke i bërë ata si gjethe të përtypura!**



Shpjegimi i ajeteve

- "A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me zotëruesit e Elefantit? A nuk ua bëri përpjekjen të dështuar?" - A nuk sheh në këtë ngjarje të jashtëzakonshme pushtetin madhështor të Allahut, mëshirën e Tij gjerë për adhuruesit e Tij, argumentet e njëshmërisë së Tij në meritën e adhurimit dhe fakte që tregojnë vërtetësinë e të zgjedhurit të Tij, Muhamedit (a.s.)?

Kujto se çfarë bëri Zoti yt me ushtrinë e Elefantit, të cilët kishin synim të shkatërronim Shtëpinë e Tij! Ata përgatitën një ushtri të madhe, duke marrë edhe elefantë të mëdhenj, për ta shkatërruar atë. Ajo ishte një ushtri e jashtëzakonshme, me luftëtarë të mbledhur nga Abisinia dhe Jemeni, para së cilës arabët ishin të pafuqishëm. Banorët e Mekës dolën nga qyteti dhe u larguan për t'i shpëtuar kësaj ushtrie. Ndërsa Allahu i Madhërishëm dërgoi kundër tyre një prej ushtrive të Tij të shumta, që vetëm Ai i di.

- "Ai lëshoi kundër tyre shpendë, që erdhën tufa-tufa dhe që i gjuajtën ata me gurë prej baltës së pjekur, duke i bërë ata si gjethe të përtypura!" - Këta zogj të grupuar bartnin gurë të nxehtë dhe me ta gjuajtën mbi ushtrinë e Abrahas, nga i pari deri tek i fundit, derisa i shtypën dhe i dërrmuan, duke i bërë të ngjanin si gjethe të përtypura. Allahu ishte i mjaftueshëm për ta thyer këtë ushtri dhe zbriti ndëshkimin e Tij mbi kokat e tyre.

Kjo histori është shumë e njohur dhe e dëgjuar. Pikërisht në atë vit lindi Profeti i Fundit, Muhamedi (a.s.). Kjo ngjarje ishte njëra nga shenjat pararendëse të epokës së tij të ndritshme, të ndihmuar nga Zoti i qiejve dhe i tokës. Vetëm Atij i takon lavdia dhe mirënjohja për çdo mirësi!

Surja 106: El Kurejsh (mekase) 4 ajete
Ajetet 1 – 4
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. **Për hir të garancisë që e gëzojnë kurejshitët!**
2. **Garantimit të udhëtimit të tyre të lirë, gjatë dimrit dhe verës!**
3. **Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie,**

4. i Cili i ushqeu pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!

Shpjegimi i ajeteve

- **"Për hir të garancisë që e gëzojnë kurejshitët! Garantimit të udhëtimit të tyre të lirë, gjatë dimrit dhe verës!"** - Shumë komentues të Kuranit janë të mendimit se këto ajete duhen shikuar si vazhdim i sures para saj. Kështu, kuptimi i tyre është: Ne vepruam ashtu me ushtrinë e Elefantit pikërisht për hir të kurejshëve, për hir të plotësimit të interesave të tyre. Për të siguruar udhëtimet e tyre tregtare gjatë dimrit drejt Jemenit dhe, gjatë verës, drejt Shamit, Allahu i Lartësuar i ndëshkoi ata që synonin t'i shkatërronin.

Në këtë mënyrë, i Madhëruari e ngriti lart ndër popujt arabë vlerën dhe rëndësinë e Qabes dhe të banorëve që kujdeseshin për të. Ata ishin shumë të nderuar dhe të respektuar nga njerëzit, saqë askush nuk i trazonte, në çdo udhëtim që ndërmerrnin. Për këtë arsye, i Lartësuari i urdhëron që të jenë mirënjohës ndaj Tij, duke u thënë:

- "Pra, le ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie..." - Le ta adhurojnë Atë si Një të vetëm dhe të pashoq dhe vetëm ndaj Tij të përkushtohen, me sinqeritet, të bindur dhe të nënshtruar.

- **"...i Cili i ushqeu pas urisë dhe i siguroi prej çdo frike!"** - Furnizimi i mirë dhe i bollshëm dhe siguria nga çdo lloj frike janë nga mirësitë më të mëdha të kësaj dynjaje, për të cilat njeriu duhet të tregohet mirënjohës ndaj Dhuruesit të vetëm të tyre, ndaj Allahut të Lartësuar.

Vetëm Ty, o i Adhuruari ynë, të takon lavdia dhe mirënjohja e plotë për të gjitha begatitë, të shfaqura dhe të fshehura!

Allahu i Lartësuar e ka përshkruar veten si *Rabbul Bejt* - Zoti i Shtëpisë, edhe pse Ai është Zoti i Shtëpisë dhe i gjithçkaje tjetër. Ky posaçërim është bërë për të treguar rëndësinë dhe madhështinë e Qabes. Ajo është Shtëpia ku adhurohet i Madhërishmi dhe Ai është Zoti i saj.

Surja 107: El Maun (mekase) 7 ajete
Ajetet 1 – 7
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. A e ke parë atë, që mohon përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?
2. Po! Ai e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin
3. dhe nuk nxit për të ushqyer të varfërin.
4. Mjerë për ata që falen,
5. të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm.
6. Ata që vetëm shtiren
7. dhe nuk japin as sendin më të vogël.

Shpjegimi i ajeteve

Duke qortuar ata që shpërfillin të drejtat e Zotit dhe të drejtat e krijesave, i Lartësuari thotë:

- "A e ke parë atë, që mohon përgjegjësinë dhe llogarinë në botën tjetër?" - Ata nuk besojnë ringjalljen dhe dhënien e llogarisë, ashtu si nuk besojnë mesazhet e sjella nga profetët prej Zotit të gjithësisë. Pikërisht këta lloj njerëzish janë ata të cilët shpërfillin edhe të drejtat e krijesave:

- "Po! Ai e përzë në mënyrë të vrazhdë jetimin dhe nuk nxit për të ushqyer të varfërin." – Ata e dëbojnë jetimin me ashpërsi, duke mos treguar aspak mëshirë për të. Kjo sjellje vjen nga zemërngurtësia e tyre, për shkak se nuk shpresojnë shpërblim nga Allahu i Lartësuar dhe as nuk frikësohen nga ndëshkimi i Tij. Jo vetëm që sillen kështu për veten e vet, por pengojnë dhe të tjerët që ushqejnë jetimët dhe të vobektët.

- "Mjerë për ata që falen, të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm." - Ky është një kërcënim për ata njerëz që janë të pakujdesshëm ndaj namazit, duke mos e falur në kohën e tij apo duke lënë mangët shtyllat dhe detyrat e namazit. Kjo vjen nga mosvëmendja e tyre ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme. Ata nuk i japin rëndësinë që i takon këtij adhurimi, i cili konsiderohet si më kryesori dhe mënyra më e mirë për t'iu afruar Allahut të Lartësuar.

Këtu bëhet fjalë për pakujdesi me vetëdije ndaj çështjeve të namazit. Ndërsa pakujdesia nga harresa mund t'i ndodhë çdokujt madje edhe Profetit (a.s.) i ka ndodhur që të ketë harruar diçka prej namazit.

Ata që janë të pakujdesshëm ndaj namazit Allahu i Lartësuar i ka përshkruar si zemërgurë, të pamëshirshëm dhe shtiracakë. Ai thotë:

- "Ata që vetëm shtiren dhe nuk japin as sendin më të vogël." - Ata kryejnë adhurime sa për t'u dukur në sy të njerëzve. Përveç kësaj, ata janë shumë koprracë, madje edhe për gjëra fare të vogla, dhënia e të cilave nuk dëmton aspak, siç mund të jetë dhënia e një kove, e një kazme etj. Zakonisht, njerëzit japin dhe marrin të tilla gjëra pa asnjë problem, por për ata është përsëri e pamundur. Kur ata nuk duan që të japin edhe gjëra kaq të vogla, ç'mund të thuash për gjëra më të mëdha?!

Në këtë sure, Allahu i Lartësuar na nxit për bamirësi ndaj jetimëve dhe të varfërve, madje na qorton nëse nuk e bëjmë këtë, duke e konsideruar si një sjellje të ngjashme me ata që nuk besojnë ringjalljen. Gjithashtu, kjo sure na nxit për të qenë të kujdesshëm në faljen e namazit. Ajo na nxit për sinqeritet në kryerjen e tij dhe në të gjitha adhurimet e tjera. Allahu i Lartësuar na nxit për të bashkëpunuar me njëri tjetrin, duke shkëmbyer shërbime dhe mjete të ndryshme, sepse në të kundërt do të jemi si ata të cilët qortohen në këtë sure.

Allahu është më i ditur dhe falënderimi i takon Atij, që është Zoti i botërave!


Surja 108: El Keuther (mekase) 3 ajete
Ajetet 1 – 3
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Ne, vërtet, të dhamë ty Keutherin.
2. Prandaj, ti falu për hir të Zotit tënd dhe bëj kurban për Të!
3. S'ka dyshim se hasmi yt është farëshuar!

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar i drejtohet Profetit të Tij të dashur (a.s.), duke i përkujtuar mirësitë e mëdha që ka përgatitur për të:

- "Ne, vërtet, të dhamë ty Keutherin." – *Keuther*-in, domethënë mirësitë e mëdha të Zotit të Lartësuar ndaj Profetit (a.s.). Mes këtyre mirësive dhe begative të pamata, është edhe një lumë në Xhenet, që quhet *Keuther*, të cilin Allahu i Lartësuar e ka


الجزء الثلاثون
سورة الكافرون سورة النصر سورة المسد
سورة الكافرون
بسم الله الرحمن الرحيم
قل يا أيها الكافرون ﴿١﴾ لا أعبد ما تعبدون ﴿٢﴾
ولا أنتم عابدون ما أعبد ﴿٣﴾ ولا أنا عابد ما عبدتم ﴿٤﴾
ولا أنتم عابدون ما أعبد ﴿٥﴾ لكم دينكم ولي دين ﴿٦﴾
سورة النصر
بسم الله الرحمن الرحيم
إذا جاء نصر الله والفتح ﴿١﴾ ورأيت الناس
يدخلون في دين الله أفواجا ﴿٢﴾ فسبح بحمد ربك
واستغفره إنه كان توابا ﴿٣﴾
سورة المسد
بسم الله الرحمن الرحيم
تبت يدا أبي لهب وتب ﴿١﴾ ما أغنى عنه ماله وما كسب ﴿٢﴾
سيصلى نارا ذات لهب ﴿٣﴾ وامرأته حمالة الحطب ﴿٤﴾
في جيدها حبل من مسد ﴿٥﴾
٦٠٣

ruajtur për Profetin (a.s.). Një prej mirësive të tij është edhe Hauđi, gjatësia dhe gjerësia e të cilit është një muaj. Uji i tij është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Gotat që janë vendosur pranë tij janë të shumta dhe të shndritshme si yjet në qiell. Kush pi një herë të vetme prej tij, nuk do të ketë më etje kurrë. Prej këtij Hauđi do të pinë besimtarët, të cilëve do t'ua japë vetë me dorën e tij Muhamedi (a.s.).

Pasi i kujtoi Profetit të Tij (a.s.) këto mirësi të premtuara, Allahu i Lartësuar e urdhëron atë që të jetë mirënjohës për to:

- **"Prandaj, ti falu për hir të Zotit tënd dhe bëj kurban për Të!" -** Janë veçuar këto dy rite, sepse ato janë ndër më të rëndësishmet dhe ndër rrugët më të dashura për t'u afruar tek Allahu i Madhëruar.

Namazi shpreh nënshtrimin e plotë të zemrës dhe gjymtyrëve vetëm për Allahun e Lartësuar. Gjatë tij, zemra dhe trupi, me përkushtim dhe dashuri ndaj Allahut, kalojnë nga një adhurim në tjetrin. Kur qëndron në këmbë, besimtari këndon me drojë ajetet kuranore, pastaj me përunjësi të plotë bie në ruku, duke bërë *tesbih* dhe lavde për Allahun e Madhëruar, për të kaluar pastaj në sexhde, e cila është kulmi i përulësisë dhe momenti më pranë Allahut, kur Ai dëgjon çdo lutje drejtuar nga robi i Tij.

Ndërsa kurbani edukon bujarinë dhe shtyp koprracinë. Robi zgjedh më të bukurën dhe më të mirën bagëti për t'ia përkushtuar Zotit si kurban.

- **"S'ka dyshim se hasmi yt është farëshuar!" –** Kuptimi: Ai që të urren ty, që të fyen dhe të përmend për keq, pikërisht ai është "*el ebter*" – farëshuar, sepse veprat do t'i asgjësohen dhe nami do t'i zhduket.

Ndërsa Muhamedi (a.s.) është tërësisht i kompletuar me cilësitë më të mira si një krijesë e Zotit. Ai do të përkujtohet shumë ndër njerëz dhe pasuesit e rrugës së tij do të jenë të jashtëzakonshëm.

Surja 109: El Kafirun (mekase) 6 ajete
Ajetet 1 – 6
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Thuaj: "O ju jobesimtarë!
2. Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni!
3. As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj!
4. Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni!
5. Por as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj!
6. Ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time!

Shpjegimi i ajeteve

- "Thuaj: "O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuroni!" - Allahu i Lartësuar na mëson që ne ta shfaqim haptazi distancimin tonë nga çdo adhurim tjetër, veç adhurimit të Tij. Madje, Ai na mëson që t'u drejtohemi qafirëve dhe të gjithë atyre që kanë të adhuruar të tjerë veç Allahut, dhe t'ua deklarojmë hapur distancimin tonë nga çdo i adhuruar veç Allahut të Vetëm dhe të Pashoq.

Ne distancohemi nga mohuesit dhe idhujtarët në të gjitha aspektet, me fjalët dhe veprat tona të jashtme dhe të brendshme, të dukshme dhe të padukshme. Muslimani dhe muslimania duhet të ketë pamje dhe vepra dalluese si të tillë, që e karakterizojnë dhe e shquajnë nga të gjithë të tjerët.

- "As ju nuk jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj!" - Kuptimi: Ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj, sepse veprave tuaja u mungon sinqeriteti. Ato pak vepra që ju kryeni dhe që janë të përziera me idhujtari nuk meritojnë të quhen adhurime, dhe si të tilla nuk janë të pranueshme nga Allahu i Lartësuar. Që një vepër të jetë e pranuar si "adhurim" tek Allahu, ajo duhet të plotësojë dy kushte: të jetë e sinqertë vetëm për Allahun, larg çdo lloj *shirk*-u, dhe të jetë sipas porosive të Allahut të Lartësuar dhe traditës së Profetit të Tij.

- "Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë e adhuroj!" - Allahu i Lartësuar e përsërit këtë fakt për të treguar se tiparet e dy grupeve do të mbeten gjithmonë të tilla për ta. Kështu, besimtarët kurrë nuk adhurojnë ato që adhurojnë mohuesit dhe idhujtarët, ndërsa idhujtarët kurrë nuk mund të konsiderohen si adhurues të Atij që adhurojnë besimtarët, pra, të Allahut të Lartësuar, vetëm nëse pendohen dhe kthehen në rrugë të drejtë. Secili grup ndjek fenë e vet dhe refuzon fenë e tjetrit, siç thotë i Lartësuari më pas:

- "Ju keni fenë tuaj dhe unë kam fenë time!" - Secili grup do të ndjekë rrugën e vet, ashtu siç i shkon për shtat, sikurse thotë i Lartësuari në një ajet tjetër: "Thuaj: "Secili vepron sipas rrugës së vet, dhe Zoti juaj e di më së miri se cili është në rrugë më të drejtë"." [Isra, 84]. Ose: "Ka prej tyre që e besojnë atë (Kuranin), ashtu siç ka që nuk e besojnë. Zoti i njeh më së miri kokëfortit. Po nëse ata të mohojnë ty, thuaju: "Mua më takon vepra ime e juve vepra juaj. Ju nuk përgjigjeni për atë që bëj unë, e as unë për atë që bëni ju!". [Junus 40, 41].

Surja 110: En Nasr (medinase) 3 ajete
Ajetet 1 – 3
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi,
2. dhe kur t'i shohësh njerëzit që të hyjnë grupe-grupe në fenë e Allahut,
3. atëherë, lartësoje Zotin tënd, falënderoje Atë dhe kërko falje nga Ai! Ai vërtet është Pranues i madh i pendimit.

Shpjegimi i ajeteve

Në këtë sure gjen: një sihariq për Profetin (a.s.), një urdhër për të, pasi lajmi i mirë të bëhet realitet, dhe një një parashikim se çfarë pritej të ndodhte më tej.

- **"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi, dhe kur t'i shohësh njerëzit që të hyjnë grupe-grupe në fenë e Allahut..."** - Ky është sihariqi për Profetin (a.s.). Pra, Allahu i Lartësuar i dha Profetit të Tij lajmin e mirë se do ta ndihmonte dhe do t'i dhuronte fitoren e madhe, çlirimin e Mekës dhe përhapjen masive të Islamit. Njerëzit do të hynin grupe-grupe në fenë e Allahut, duke shtuar pasuesit e fesë së Tij. Madje, edhe shumë armiq të Profetit apo pjesëtarë të fisit të tij, që më parë e kishin mohuar, do ta besonin dhe do të bëheshin pasues të udhëzimit që ai solli prej Allahut të Lartësuar. Kjo ndodhi me të vërtetë me çlirimin e Mekës.

Ndërsa urdhri i drejtuar Profetit, pas kësaj mirësie të dhuruar nga Allahu i Lartësuar, është:

- "...atëherë, lartësoje Zotin tënd, falënderoje Atë dhe kërko falje nga Ai! Ai vërtet është Pranues i madh i pendimit." - Ai u urdhërua për tesbiĥ, për falënderim dhe mirënjohje ndaj Zotit të tij dhe për *istigfar* ose kërkim falje.

Ndërsa parashikimi se çfarë pritej të ndodhte më tej është, së pari, një përgëzim: kjo fe do të vazhdonte të përhapej dhe të pushtonte gjithë botën. Kjo nënkuptohet pas *tesbih*-ut, falënderimit dhe kërkimit të faljes nga Profeti dhe umeti i tij, sepse falënderimi për mirësitë i shton ato, sikurse thotë Allahu i Lartësuar: "Nëse falënderoni, do t'jua shtoj.". Pra, ndihma e Allahut për Profetin e Tij, fenë e Tij do të ishte e vazhdueshme. Futja e njerëzve në fenë e Zotit do të vijonte pandërprerë.

Dhe vërtet kështu ndodhi. Feja Islame ka shkuar atje ku asnjë fe tjetër nuk mund të përhapej. Kjo vazhdoi, derisa njerëzit nisën të kundërshtonin urdhrat e Allahut dhe të Profetit të Tij, dhe kështu Allahu i Lartësuar i sprovoi dhe ata u përçanë në grupe-grupe, duke ndodhur kjo që e shohim sot. Megjithatë, Allahu i Lartësuar ka ruajtur mirësi, mëshirë dhe begati për këtë fe dhe ithtarët e saj, që askush nuk mund t'i përkufizojë dhe zbulojë plotësisht. Mirësia vazhdon ta ndjekë këtë umet të bekuar dhe këtë fe të zgjedhur dhe të ndihmuar nga Zoti i gjithësisë.

Parashikimi tjetër se çfarë pritej të ndodhte më tej ishte se exheli i Profetit të Zotit tashmë qe afruar. Jeta e Profetit ishte një mirësi e madhe që iu dhurua njerëzimit, prandaj edhe Allahu i Lartësuar është betuar për jetën e Profetit. Në fund të çdo mirësie, Allahu ka urdhëruar që të kërkojmë falje. Kështu, për shembull, ne jemi urdhëruar të veprojmë në përfundim të namazit, të haxhit etj. Atëherë, në të njëjtën mënyrë, urdhri i Allahut të Lartësuar drejtuar Profetit të Tij për *tesbih,* falënderim dhe *istigfar* ishte një tregues se misioni i Profetit përfundoi me sukses dhe tashmë kishte ardhur koha për takimin me Zotin e tij. Për këtë arsye, ai duhej të përgatitej për këtë takim në formën më të mirë dhe ta mbyllte misionin e vet me falënderim dhe kërkim falje, që Allahu i Lartësuar t'ia plotësonte më tej mirësinë e Tij. Po për këtë arsye, duke zbatuar këtë urdhër, Profeti (a.s.) thoshte në namazin e tij, në ruku dhe në sexhde: "*Subhaneke Allahumme, ue bi hamdike! Allahumme gfir li*!" (I Pastër nga çdo e metë dhe i Lavdëruar je, o i Adhuruari im! O i Adhuruari im, më fal mua!).

Surja 111: El Mesed (mekase) 5 ajete
Ajetet 1 – 5
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai është i shkatërruar!
2. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo që fitoi!
3. Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë.
4. Ashtu edhe gruaja e tij, ajo që barti dru,
5. e cila do të ketë në qafë një litar të zjarrtë.

Shpjegimi i ajeteve

Ebu Lehebi ishte xhaxhai i Profetit, por ishte dhe armiku më i ashpër i tij, me mundimet që i shkaktonte Profetit (a.s.). Ai nuk kishte as besim në Allahun dhe as dashuri për farefis, Allahu e shëmtoftë! Prandaj Allahu i Lartësuar e poshtëroi e i dha këtë mallkim të madh, që do të jetë për të deri në Ditën e Kijametit. I Lartësuari thotë:

- "Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai është i shkatërruar!" – Kuptimi: U dëshpëroftë dhe iu thafshin duart nga mirësitë! Kurrë mos paftë mirësi dhe mbarësi!

- "Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo që fitoi!" - Kuptimi: Pasuria e tij e madhe, e cila u bë shkak që ai të kalonte kufijtë dhe të tregohej mospërfillës, tashmë nuk i sjell më dobi. Po kështu, edhe ato që ai fitoi nuk e ruajnë dot nga ndëshkimi i Alahut. Asgjë nuk mund ta shpëtojë atë nga vuajtjet dhe ndëshkimi. Çështja e tij tashmë ka marrë fund.

- "Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë." - Zjarri do ta përfshijë atë nga çdo drejtim dhe nuk do të ndihmohet dhe as do të dalë më prej atje. Por jo vetëm ai. Ashtu si ai do të dënohet edhe gruaja e tij, e cila, gjithashtu, e mundonte Profetin (a.s.).

- "Ashtu edhe gruaja e tij, ajo që barti dru, e cila do të ketë në qafë një litar të zjarrtë." - Ajo bashkëpunonte me burrin e saj në vepra të këqija dhe armiqësi ndaj Profetit dhe besimtarëve. Ata përhapnin të keqen dhe përpiqeshin si askush tjetër që të mundonin Profetin (a.s.) dhe besimtarët. Por ajo nuk bënte gjë tjetër, veçse ngarkonte shpinën e saj me gjynahe të rënda, ashtu sikurse dikush ka ngarkuar dru mbi shpinë dhe në qafë është i lidhur me litar.

Por ajeti mund të kuptohet edhe ndryshe: Ajo do të detyrohet në zjarrin e Xhehenemit që të ngarkojë dru mbi shpinën e saj dhe, me to, të ndezë fort zjarrin e të shoqit dhe të sajin, pafundësisht, duke patur një litar prej zjarri të lidhur në grykë.

Në këtë sure kemi të bëjmë me një mrekulli dhe shenjë të profecisë së Muhamedit (a.s.). Këto ajete u shpallën para vdekjes së Ebu Lehebit dhe gruas së tij, dhe Allahu i Lartësuar tregoi se ata të dy do të ndëshkoheshin në zjarrin e Xhehenemit. Ky qe një tregues se ata nuk do ta pranonin Islamin kurrë. Dhe vërtet ashtu ndodhi. Ata nuk e pranuan Islamin dhe vdiqën si mohues dhe armiq të Zotit dhe të Profetit të Tij. Ata nuk e pranuan Islamin, qoftë edhe formalisht. Kështu, përfundimisht, ndodhi ashtu sikurse paralajmëroi Njohësi i së fshehtës dhe i të dukshmes, Allahu i Lartësuar.


الجزء الثلاثون
سورة الإخلاص سورة الفلق سورة الناس
سورة الإخلاص
بسم الله الرحمن الرحيم
قل هو الله أحد ١ الله الصمد ٢ لم يلد ولم يولد ٣
ولم يكن له كفوا أحد ٤
سورة الفلق
بسم الله الرحمن الرحيم
قل أعوذ برب الفلق ١ من شر ما خلق ٢ ومن شر
غاسق إذا وقب ٣ ومن شر النفاثات في العقد ٤
ومن شر حاسد إذا حسد ٥
سورة الناس
بسم الله الرحمن الرحيم
قل أعوذ برب الناس ١ ملك الناس ٢ إله
الناس ٣ من شر الوسواس الخناس ٤ الذي
يوسوس في صدور الناس ٥
من الجنة والناس ٦
٦٠٤

Surja 112: El ihlas (mekase) 4 ajete
Ajetet 1 – 4
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Thuaj: "Ai, Allahu është Një!
2. Allahu është *Samed*!
3. Ai as s'ka lindur kë, as nuk është i lindur,
4. dhe me Të askush nuk është i barabartë."

Shpjegimi i ajeteve

- **"Thuaj: Ai, Allahu është Një!"** - Allahu i Lartësuar na udhëzon që të bëjmë një deklaratë, të cilën duhet ta besojmë plotësisht dhe të jemi tërësisht të sigurt për vërtetësinë e saj. Ai na urdhëron që të bëjmë një deklaratë tepër të fuqishme, duke ia ditur kuptimin e saj të qartë dhe të saktë. Po ç'qenka kjo deklaratë, të cilën i Lartësuari na urdhëron që ta themi hapur? Ajo është: "Allahu është *Ehad*", domethënë Ai është i Një, i Vetëm e Unik, në çdo aspekt. Ai është i vetmi me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta dhe absolutisht të plota. Ai është i vetmi me veprat e Tij madhështore, që nuk kanë shembull dhe ngjashmëri me asgjë tjetër në ekzistencë.

- **"Allahu është *Samed*!"** - Allahu është Ai të Cilit i drejtohet çdo gjë për nevojat e veta. Çdo krijesë, qoftë ajo e botës qiellore, qoftë krijesë e botës tokësore, të gjithë pa përjashtim janë të varur dhe të nevojshëm për përkujdesjen dhe mëshirën e Tij. Të gjithë i luten *Samed*-it për plotësimin e nevojave të tyre. Për çdo gjë që i duhet, krijesat i drejtohen vetëm Allahut. Atë e lusin dhe i kërkojnë ndihmë, sepse Allahu është i Ploti dhe Absoluti në cilësitë e Tij. Ai është, gjithashtu, *El Alîmu* - i Gjithëdijshmi, dija e të Cilit është absolutisht e plotë. Allahu është *El Halîmu* - i Buti dhe i Mëshirshmi, butësia dhe mëshira e të Cilit janë absolutisht të plota. Ai është *Er-Rahîmu* - Mëshirëploti, mëshira e të Cilit ka përfshirë gjithçka. E të tillë janë të gjithë emrat dhe cilësitë e mrekullueshme të Allahut. Pikërisht prej cilësive të Tij është edhe fakti që:

- "Ai as s'ka lindur kë, as nuk është i lindur..." - Sepse Allahu është është absolutisht i Pasur dhe nuk ka nevojë për asgjë nga krijesat e Tij. Të gjithë kanë nevojë dhe janë të varfër para bujarisë dhe mirësisë së Tij, ndërsa Ai është i Pasuri vetvetiu, që nuk ka nevojë absolutisht për asgjë nga krijesat e Tij.

- "...dhe me Të askush nuk është i barabartë." - Askush nuk mund t'i afrohet apo t'i përngjasë, apo të jetë si shembulli i Tij, as në emrat e Tij, as në cilësitë e Tij dhe as në veprat e Tij. I Lartësuar dhe Begati-sjellës është emri i Tij.

Kjo sure është sqaruese dhe vërtetuese e teuhidit *esmâu ue sîfât*, që ka të bëjë me emrat dhe cilësitë unike të Zotit të Lartësuar.

Surja 113: El Felek (mekase) 5 ajete
Ajetet 1 – 5
Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Thuaj: "I mbështetem Zotit të agimit,
2. prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi,
3. dhe prej errësirës së natës, kur ngryset plotësisht,
4. dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyje,
5. dhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron!"

Shpjegimi i ajeteve

Allahu i Lartësuar na mëson se si të kërkojmë ndihmë, strehim, mbrojtje, ruajtje nga çdo sherr që na kanoset. Ai na urdhëron që të kërkojmë ndihmën e Tij, duke thënë:

- "Thuaj: "I mbështetem Zotit të agimit..." – Domethënë, i drejtohem për ndihmë, mbrojtje, strehim ose ruajtje Allahut.

Ne porositemi që t'i drejtohemi për ndihmë, mbrojtje, strehim ose ruajtje Allahut, që quhet edhe *Rabbul feleḳ* - Zoti i agimit. Është Allahu që e bën të çelë agimin. Është Ai që e bën farën të çelë dhe të mbijë, prandaj vetëm Atij lutjuni, që t'ju ruajë nga çdo e keqe që i druheni!

- "...prej dëmit të çdo krijese, që Ai e krijoi..." - Kjo përfshin të gjitha krijesat e Zotit. Pra, Allahu i Lavdëruar na mëson që të kërkojmë mbrojtjen dhe ruajtjen e Tij nga sherri i të gjitha krijesave të Tij: i njerëzve, i xhindëve, i kafshëve etj. E ku mund të gjesh ruajtje dhe strehim prej sherrit të krijesave, më mirë se te Krijuesi i tyre?!

Pasi i përmendi në përgjithësi krijesat prej të cilave duhet të ruhemi, Allahu i Lartësuar veçon disa prej tyre. Ai thotë:

- "...dhe prej errësirës së natës, kur ngryset plotësisht..." - Allahu i Lartësuar na mëson që t'i kërkojmë Atij strehim dhe mbrojtje, që të na ruajë nga e keqja që shfaqet në botë kur atë e mbulon nata e errët, sepse kjo është koha kur përhapen më shumë shpirtrat dhe krijesat armiqësore. Natën përhapen në tokë edhe shumë kafshë dëmtuese dhe sulmuese.

- "...dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyje..." - Allahu i Lartësuar na mëson që të kërkojmë ndihmë dhe strehim tek Ai që të na ruajë prej sherrit dhe dëmit që sjellin magjia dhe magjistarët, të cilët kryejnë dhe përgatisin magjitë e tyre duke fryrë nëpër nyje.

- "...dhe prej dëmit të smirëkeqit, kur sipas smirës vepron!" - *El Hâsidu* është smirëziu apo ziliqari, ai i cili dëshiron që tjetrit t'i largohen mirësitë. Ai përpiqet që ta privojë tjetrin nga mirësitë me ç'të mundë dhe me çdo mënyrë. Kështu pra, edhe kjo është një e keqe, prej së cilës mund të ruhesh dhe t'i shpëtosh veçse duke kërkuar strehim tek Allahu i Lartësuar, Zoti dhe Krijuesi i gjithçkaje. Vetëm me ndihmën Allahut mund t'i mposhtim kurthet dhe dëshirat dashakeqe të këtyre smirëzinjve të mjerë.

Në të njëjtën mënyrë, duhet trajtuar me kujdes edhe e keqja që vjen nga syri i keq, sepse mësyshi shkaktohet zakonisht prej dikujt që është i ngarkuar me smirë dhe urrejtje për tjetrin.

Kjo sure përmban porosi të mrekullueshme për t'u ruajtur dhe për t'i shpëtuar sherrit të çdo krijese në përgjithësi, edhe të atyre që janë përmendur në mënyrë të veçantë.

Gjithashtu, kjo tregon se magjia është diçka reale, e cila dëmton me të vërtetë. Ajo është një e keqe, që, për t'i shpëtuar, duhet të kërkosh ndihmë dhe strehim vetëm tek Allahu i Lartësuar.

Surja 114: En Nas (mekase) 6 ajete
Ajetet 1 – 6
Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

1. Thuaj: "Mbështetem te Zoti i njerëzve,
2. Sunduesi i njerëzve,
3. i Adhuruari i njerëzve,
4. prej të keqes së nxitësit të vesveseve, që fshihet,
5. i cili fut vesvese në zemrat e njerëzve,
6. qoftë ai nga xhindët apo nga njerëzit!"

Shpjegimi i ajeteve

Kjo sure na udhëzon që të kërkojmë ndihmë, mbështetje, mbrojtje dhe strehim te Zoti i njerëzve, Sunduesi dhe Pronari i tyre, i Adhuruari i tyre, që të na ruajë nga Shejtani i mallkuar, i cili është shkaku i të gjitha të këqijave dhe lënda bazë e tyre.

- "Thuaj: "Mbështetem te Zoti i njerëzve, Sunduesi i njerëzve..." – Kështu, i Lartësuari na udhëzon që vazhdimisht të kërkojmë mbrojtje, strehim dhe mbështetje tek Ai si Zoti i njerëzve, sepse Ai është Krijuesi, Sunduesi, Furnizuesi dhe i Plotpushtetshmi mbi ta. Të gjitha krijesat janë të nënshtruarara nën zotërimin dhe pushtetin e Allahut.

- "...i Adhuruari i njerëzve..." – Gjithashtu, i Lartësuari na udhëzon që ne të kërkojmë mbrojtje dhe strehim tek Ai si i vetmi që meriton adhurimet tona. Allahu i Lartësuar na krijoi për një qëllim të vetëm: që ta adhurojmë Atë me dashuri dhe madhërim, duke zbatuar urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij. Ky është qëllimi i ekzistencës tonë. I Mallkuari kërkon të na pengojë nga ky qëllim. Allahu i Lartësuar na udhëzon që, nëpërmjet adhurimit të Tij, të ruhemi nga ndikimi i të Mallkuarit. Nëpërmjet adhurimit, ne mund të ruhemi prej nxitjeve të Shejtanit dhe hileve të tij. Ai i mallkuar synon që ne të pasojmë hapat e tij dhe të bëhemi prej banorëve të Zjarrit të ndezur fort. Ndërsa ajeti na udhëzon që të ruhemi prej këtij sherri, duke e lutur Allahun e Lartësuar, që është Zoti, Sunduesi dhe i Adhuruari i njerëzve.

- "...prej të keqes së nxitësit të vesveseve, që fshihet, i cili fut vesvese në zemrat e njerëzve..." - Prej sherrit të Shejtanit janë dhe vesveset që ai fut në zemrat dhe shpirtrat e njerëzve. Ai ua hijeshon dhe zbukuron atyre të keqen. Ai i nxit tek ata dëshirën për ta vepruar të keqen dhe i bën entuziastë për këtë. Po ashtu, ai ua shëmton të mirën njerëzve dhe i rëndon ata, duke ua vështirësuar kryerjen e të mirave. Shejtani i mallkuar ua paraqet të mirën jo me pamjen e saj të vërtetë, por me një formë të shëmtuar, të lodhshme dhe të keqe. Kjo është puna e tij e vazhdueshme me njerëzit.

I Mallkuari vazhdimisht fut vesvese dhe pastaj fshihet, tërhiqet e struket, sa herë që robi përkujton Zotin e tij dhe mbështetet tek Ai për arritjen e çdo të mire dhe largimin nga çdo e keqe. Prandaj, në këtë ajet, thuhet që i Mallkuari është ai "që fshihet". Sa herë që robi përkujton Zotin e tij dhe mbështetet plotësisht tek Ai, për t'u ruajtur nga sherri i vesveseve dhe nga dëmi i Shejtanit, ky i mallkuar struket i pafuqishëm dhe i poshtëruar.

Vesveset vijnë prej xhindëve, por vijnë edhe prej njerëzve, prandaj i Lartësuari thotë më tej:

- **"..qoftë ai nga xhindët apo nga njerëzit!"** – Pra, i Lartësuari na udhëzon që të kërkojmë mbrojtjen dhe strehimin tek Ai, prej vesveseve të sjella nga xhindët dhe nga njerëzit.

Lavdia e plotë qoftë për Allahun e Lartësuar, fillim e mbarim, haptas dhe fshehtas! E lusim Allahun e Lartësuar që ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj nesh. E lus të Madhërishmin që të na i falë dhe mbulojë gjynahet tona, që aq shumë janë bërë pengesë dhe privim nga begatitë dhe bereqeti i Tij. E lus të Madhëruarin që të na i falë gabimet tona dhe dëshirat e gabuara, të cilat aq shumë i kanë privuar dhe penguar zemrat tona nga meditimi në Librin e Allahut. E lus të Madhëruarin që të mos na i privojë të mirat dhe begatitë e Tij për shkak të sherrit dhe padrejtësisë sonë. Ne kurrë nuk e humbasim shpresën nga mëshira e Zotit. Shpresat nga mëshira e Zotit i humbasin veçse njerëzit mohues dhe të humbur.

Paqja, bekimet dhe mëshira e Zotit qofshin mbi Profetin e Tij, Muhamedin, familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij! Të përhershme e të vazhdueshme qofshin salavatet mbi ta! Falënderimi i qoftë Allahut, me bujarinë e të Cilit plotësohen të gjitha mirësitë!

Këtu përfundon tefsiri i Librit të Allahut, me ndihmën dhe suksesin e dhuruar prej Tij. E mblodhi dhe e përpunoi Abdurrahman Ibn Nasir Ibn Abdilah, i njohur me emrin Ibn Sadi. Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!

Fillimi i muajit *rabiul euuel*, viti 1344 h
(fillimi i muajit shtator, viti 1925).

Tabela e lëndës

Fq

- **Surja 40: El Gafir (mekase) 85 ajete ..... 1.**
- **Surja 41: El Fussilet (mekase) 54 ajete ..... 47.**
- **Surja 42: Esh Shûrâ (mekase) 53 ajete ..... 73.**
- **Surja 43: Ez Zuhruf (mekase) 89 ajete ..... 113.**
- **Surja 44: Ed Duhan (mekase) 59 ajete ..... 143.**
- **Surja 45: El Xhathije (mekase) 37 ajete ..... 154.**
- **Surja 46: El Ahkaf (mekase) 35 ajete ..... 167.**
- **Surja 47: Muhamed (medinase) 38 ajete .... 186.**
- **Surja 48: El Fet'h (medinase) 29 ajete ..... 205.**
- **Surja 49: El Huxhurat (medinase) 18 ajete ..... 228.**
- **Surja 50: Kaf (mekase) 45 ajete ..... 241.**
- **Surja 51: Edh Dharijat (mekase) 60 ajete ..... 254.**
- **Surja 52: Et Tur (mekase) 49 ajete ..... 267.**
- **Surja 53: En Nexhm (mekase) 62 ajete ..... 279.**
- **Surja 54: El Kamer (mekase) 55 ajete ..... 292.**
- **Surja 55: Er Rahman (mekase) 78 ajete ..... 305.**
- **Surja 56: El Uakiah (mekase) 96 ajete ..... 316.**
- **Surja 57: El Hadid (medinase) 29 ajete ..... 328.**
- **Surja 58: El Muxhadele (medinase) 22 ajete ..... 345.**
- **Surja 59: El Hashr (medinase) 24 ajete ..... 357.**
- **Surja 60: El Mumtehineh (medinase) 13 ajete ..... 375.**
- **Surja 61: El Saff (medinase) 14 ajete ..... 386.**
- **Surja 62: El Xhumua (medinase) 11 ajete ..... 395.**
- **Surja 63: El Munafikun (medinase) 11 ajete ..... 400.**
- **Surja 64: Et Tegabun (medinase) 18 ajete ..... 406.**
- **Surja 65: Et Talak (medinase) 12 ajete ..... 417.**
- **Surja 66: Et Tahrim (medinase) 12 ajete ..... 427.**
- **Surja 67: El Mulk (mekase) 30 ajete ..... 434.**
- **Surja 68: El kalem (mekase) 52 ajete ..... 446.**
- **Surja 69: El Hak-kah (mekase) 52 ajete ..... 456.**
- **Surja 70: El Mearixh (mekase) 44 ajete ..... 466.**
- **Surja 71: Nuh (mekase) 28 ajete ..... 475.**
- **Surja 72: El Xhinn (mekase) 28 ajete ..... 481.**
- **Surja 73: El Muzzemil (mekase) 20 ajete ..... 490.**
- **Surja 74: El Muddethir (mekase) 56 ajete ..... 497.**
- **Surja 75: El Kijameh (mekase) 40 ajete ..... 506.**
- **Surja 76: El Insan (medinase) 31 ajete ..... 512.**
- **Surja 77: El Murselat (mekase) 50 ajete ..... 520.**
- **Surja 78: El Nebe' (mekase) 40 ajete..... Xhuz'i Amme ..... 526.**
- **Surja 79: En Naziat (mekase) 46 ajete ..... 534.**
- **Surja 80: Abese (mekase) 42 ajete ..... 541.**
- **Surja 81: Et Tekuir (mekase) 29 ajete ..... 546.**
- **Surja 82: El infitar (mekase) 19 ajete ..... 551.**
- **Surja 83: El Mutaffifin (mekase) 36 ajete ..... 554.**
- **Surja 84: El inshikak (mekase) 25 ajete ..... 559.**

- Surja 85: El Buruxh (mekase) 22 ajete ..... 562.
- Surja 86: Et Tarik (mekase) 17 ajete ..... 566.
- Surja 87: El Ea'la (mekase) 19 ajete ..... 568.
- Surja 88: El Gâshijeh (mekase) 26 ajete ..... 571.
- Surja 89: El Fexhr (mekase) 30 ajete ..... 574.
- Surja 90: El Beled (mekase) 20 ajete ..... 579.
- Surja 91: Esh Shems (mekase) 15 ajete ..... 582.
- Surja 92: El Lejl (mekase) 21 ajete ..... 585.
- Surja 93: Ed Duha (mekase) 11 ajete ..... 588.
- Surja 94: El inshirah (mekase) 8 ajete ..... 590.
- Surja 95: Et Tin (mekase) 8 ajete ..... 592.
- Surja 96: El Alek (mekase) 19 ajete ..... 594.
- Surja 97: El Kadr (mekase) 5 ajete ..... 597.
- Surja 98: El Bejjine (medinase) 8 ajete ..... 598.
- Surja 99: Ez Zelzele (medinase) 8 ajete ..... 600.
- Surja 100: El Adijat (mekase) 11 ajete ..... 601.
- Surja 101: El Kariah (mekase) 11 ajete ..... 603.
- Surja 102: Et Tekathur (mekase) 8 ajete ..... 604.
- Surja 103: El Asr (mekase) 3 ajete ..... 605.
- Surja 104: El Humeze (mekase) 9 ajete ..... 606.
- Surja 105: El Fil (mekase) 5 ajete ..... 607.
- Surja 106: El Kurejsh (mekase) 4 ajete ..... 608.
- Surja 107: El Maun (mekase) 7 ajete ..... 609.
- Surja 108: El Keuther (mekase) 3 ajete ..... 610.
- Surja 109: El Kafirun (mekase) 6 ajete ..... 611.
- Surja 110: En Nasr (medinase) 3 ajete ..... 612.
- Surja 111: El Mesed (mekase) 5 ajete ..... 614.
- Surja 112: El ihlas (mekase) 4 ajete ..... 615.
- Surja 113: El Felek (mekase) 5 ajete ..... 616.
- Surja 114: En Nas (mekase) 6 ajete ..... 617.
- Tabela e lëndës ..... 619.